

Punime të Kuvendit
Legjislatura e 18-të
Viti 2010, nr.1

Përgatiti për botim
Drejtoria e Shërbimit të Botimeve Parlamentare

PUNIME TË KUVENDIT

Seancat plenare

Viti 2010

1

Botim i Kuvendit
Tiranë, 2010



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Punime të Kuvendit

Seancat plenare

LEGJISLATURA E 18-të

Sesioni i dytë

E hënë, 18.01.2010
Seanca e pasdites, ora 17:00

Drejton seancën Kryetarja e Kuvendit,
zonja Jozefina Topalli (Çoba)

Rendi i ditës:

1. Informim dhe debat mbi situatën emergjente në qarkun e Shkodrës dhe masat e marra për përballimin e saj.

2. Njoftim për miratimin e programit të punimeve të Kuvendit për periudhën 21 janar- 26 shkurt 2010 nga Konferenca e Kryetarëve.

3. Njoftim për miratimin e kalendarit të punimeve të Kuvendit për periudhën 21 janar- 4 shkurt 2010 nga Konferenca e Kryetarëve.

Jozefina Topalli - Të nderuar deputetë, hapim seancën.

(Lexon rendin e ditës.)

I nderuar zoti Kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Sot Kuvendi i Shqipërisë zhvillon një seancë të jashtëzakonshme, një seancë për të plotësuar e për të nderuar kërkesën e deputetëve të Partisë Socialiste që, publikisht, dy ditë rresht, kërkuan një seancë të jashtëzakonshme, ndërkohë që Kuvendi

do të niste punën në komisione, ashtu siç e parashikon Kushtetuta dhe Rregullorja. Kërkesën e deputetëve të opozitës e vlerësova si të drejtë e të përgjegjshme dhe me kryetarët e grupeve parlamentare e plotësuam brenda 24 orëve. Edhe në këto momente, duke parë karriget bosh të këtyre deputetëve, nuk guxoj të mendoj se kërkesën ata e kishin vetëm një farsë.

Si shqiptare, më vjen keq që, kundër interesit të tyre dhe të vendit, ata nuk gjetën kurajë për t'i qëndruar fjalës e dëshirës së tyre të shprehur publikisht.

Si kryetare e Kuvendit dua t'i garantoj të gjithë se jam e vendosur të plotësoj çdo kërkesë të çdo deputeti, çdo herë dhe në çdo kohë, për çdo çështje që është në përputhje me ligjet e vendit.

Në çdo vend, në kohët e emergjencave civile, kur një qark përjeton fatkeqësi madhore natyrore, ashtu siç përjetoi Shkodra këto ditë, deputetët janë në zonën e fatkeqësisë dhe brenda Kuvendit. Ju të gjithë e keni bërë këtë me humanizëm, me sens të madh përgjegjësie, me dhimbje, me dashuri, me

sinqeritet, me sens detyre, ndaj unë dua t'ju falënderoj të gjithëve.

Në këtë seancë të jashtëzakonshme do të diskutohet mbi situatën emergjente në qarkun e Shkodrës dhe masat e marra për përballimin e saj. Kryetari i grupit ka dorëzuar listën me emrat e deputetëve që kanë kërkuar të flasin mbi këtë çështje.

Zoti Kryeministër, urdhëroni!

Sali Berisha – E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar zonja e zotërinj deputetë,

Të dashur qytetarë të Shkodrës,

Të dashur qytetarë anembanë Shqipërisë,

Seanca e jashtëzakonshme, e thirrur sot për fatkeqësinë e madhe natyrore të Shkodrës dhe të rrethinave të saj, është një moment i veçantë për të paraqitur edhe një herë përpara shqiptarëve këtë zhvillim, i cili, sipas observatorëve më seriozë të planetit, ka një kohëndodhje më të rrallë se 1 herë në 100 vjet. Kjo përbën një rast të veçantë për mua, Qeverinë dhe deputetët, për të paraqitur këtu qëndrimin tonë, të qytetarëve të Shkodrës, në trajtimin e këtij moti të mbrapshtë dhe në trajtimin e pasojave të tij.

Të nderuar deputetë,

Ditët e fundit të dhjetorit dhe java e parë e janarit u karakterizuan nga fenomene natyrore të rralla, të rënda dhe të pazakonta, në një rën të rrethësuar dhe të mëdha, të cilat patën përqendrimin maksimal në Verilindje të Shqipërisë dhe nga ana tjetër një rritje, një dalje e paparë e detit dhe vërshimi i tij në zonën e Ultësirës Bregdetare të qarqeve Kurbin dhe Shkodër. Një rrymë afrikane ajri rriti me shpejtësi temperaturat në Shqipërinë e Mesme me 24 gradë, në Verilindje të vendit në 20 deri në 22 gradë. Të gjitha këto bënë që lumenjtë Mat, Drin i Zi, Drin i Bardhë, Valbonë, lumi Curraj, lumi Gjadër, lumi i Gomsiqes, Kiri, Përroi i Thatë dhe Moraça të vërshonin me tërbim drejt liqenit, drejt Shkodrës dhe rrethinave të saj. Kaskada e Drinit ka derdhur rreth qytetit dhe rrethinave të tij mbi 2.4 miliardë metër kub ujëra.

Në këtë sasi kolosale nuk përfshihen ujërat e Gjadrit, Kirit, Përroit të Thatë, Cemit dhe Moraçës. Në ditët e fundit të dhjetorit dhe fillimit të janarit u krijua një situatë shumë emergjente. Niveli i liqeneve në kaskadën e Drinit rritej me shpejtësi, jo në ditë, por në orë. Këtë situatë Qeveria, sipërmarrja energjetike e vendit, KESH-i, autoritetet vendore të Shkodrës, prefektura, bashkia, qarku dhe komunat

e pritën me një shkallë angazhimi maksimal. Autoritetet vendore bënë të gjitha përpjekjet dhe u fitua kohë që kjo fatkeqësi natyrore të zhvillohej gradualisht, në mënyrë që të siguronim çdo jetë njerëzore të kërcënuar. Objektivi i parë madhor ishte shpëtimi i jetëve njerëzore. Pati komente të ndryshme në të cilat unë nuk dua të ndalem, sepse në tërësi jemi në një vlerësim jashtëzakonisht pozitiv.

Mediat luajtën një rol pozitiv në përballimin e situatës. Ato me raportimet e tyre direkte nga zonat më të rrezikuara kanë luajtur një rol mjaft pozitiv. Mendimi i ekspertëve më të mirë shqiptarë asnjëherë nuk ka lëvizur me kaq shpejtësi. Ata dhanë mendime dhe opinione shumë të vjera për kapërcimin e situatës. Nga ana tjetër, dua të them se të gjitha spekulimet e bëra për sa i përket menaxhimit, janë amorale dhe të ulëta.

Do të ndalem në dy çështje:

Së pari, ata që çirreshin "larg duart politika", do t'i quaja dritëshkurtër, për të mos u thënë më shumë. Aty ku jetët e shqiptarëve janë në kërcënim dhe në rrezik, politika është më aktive se kurrë për t'i shpëtuar ata. Ata të mos mendojnë se kaskada e Drinit, digat e liqenit janë mulli personalë të tyre. Njerëzit kanë bërë një harmonizim të madh me shtetin, i cili ka bashkëpunuar me autoritetet vendore të Dajçit, anës së Malit, Bushatit, Velipojës, qytetit të Shkodrës. Është bërë përpjekje maksimale për t'u ardhur në ndihmë këtyre banorëve.

Nëpërmjet menaxhimit të derdhjeve u shmangën shembjet që mund të sillnin rrymat e fuqishme mbi digat, urat e zonës së Nënshkodrës; është bërë përpjekje mjaft e madhe që t'u jepej koha e nevojshme qytetarëve që të bindeshin për t'u evakuuar.

Druaj se një zë i thatë klith sot, kur sheh se nuk ka asnjë viktimë. Nuk kam si t'i kuptoj disa qëndrime në të cilat e bardha quhet e zezë dhe e zeza quhet e bardhë. Disa përpiqen me çdo kusht të shpifin dhe të trillojnë duke bërë, më falni për shprehjen, edhe budallanë. Për ditë të tëra u thanë shqiptarëve se digat u mbajtën të mbushura, sepse Berisha donte të shiste energji me çmim më të shtrenjtë. Sipas tyre, kjo vinte nga fakti se ERE kishte rritur çmimin e energjisë që KESH-i i jep OSSH-së, nga 17 lekë të vjetra në 22 lekë të vjetra. Kjo është e turpshme! Në qoftë se ishte puna për të shitur energji, Qeveria ime e shiste atë në tetor, në nëntor dhe jo me 17 lekë, por me 50 lekë. E vërteta është se kaskada ka një rregullore, e cila harmonizon

prodhimin e energjisë elektrike, harmonizon mbrojtjen e digave nga mbingarkesat e mëdha, harmonizon shmangien sa më të mundshme të përmbytjeve.

Ata që kanë projektuar digat, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në botë, kanë parashikuar gjithmonë mbingarkesat që u krijohen, kanë parashikuar shkarkimet e ujërave të tepërta. Realiteti është se në përputhje me këtë rregullore, e cila po i afrohet 30-vjetorit të saj, Korporata Energjetike e vendit e ka zbatuar pikë për pikë rregulloren.

Më 22 dhjetor liqeni i Fierzës ka qenë 5 metra nën nivelin e parashikuar nga rregullorja. Nuk po flas për 27 dhjetorin, datë e cila, në përputhje me prurjet, e ngriti këtë nivel në 296 metra. Për asnjë rast, për asnjë moment, për asnjë sekondë, nuk ka pasur asnjë rrezik absolut për digat, portat, tunelet e tyre. Rreziku ishte iminent për Nënshkodrën, për Dajçin, për Velipojën, Bushatin dhe Anën e Malit, sepse prurjet po rrisnin dhe do të rrisnin me shpejtësi nivelin e ujërave në këto zona. Qyteti nuk kishte asnjë kërcënim nga digat, përkundrazi, digat kësaj radhe dhe në çdo radhë janë një mbrojtje ndaj vërshimeve të Drinit. Duke thënë këtë nuk them se Drini dhe prurjet në Shkodër nuk përbëjnë një problem shumë madhor.

Qeveria ka qenë e pranishme në të gjithë situatën, përfshi edhe natën e Vitit të Ri. Ndodhi që dalja e detit vuri përpara një argjaturë betoni, bunkerë dhe ç'kishte në bregun e tij dhe po kërcënonte në mënyrën më serioze mbi 7 mijë hektarë dhe qindra e qindra familje në Tale. Prefektura e Shkodrës ka qenë e tëra në angazhim të plotë për trajtimin sa më eficient të kësaj përmbytjeje. Qeveria krijoi Komitetin Ndërmator të Emergjencës.

Në zonën e përmbytjes kanë vepruar nga Qeveria qendrore rreth 1 700 punonjës të Forcave të Armatosura, të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Rezervave të Shtetit, të sistemit shëndetësor, të bordeve të kullimit. Qindra të tjerë kanë qenë qeveritarë vendorë. Unë dua të theksoj se në rast se kjo fatkeqësi e madhe natyrore u kapërcye pa u shndërruar në një katastrofë njerëzore, kjo nuk erdhi se ujërat ishin të pakta. Edhe tani që po flasim, në fushat e Çasit, të Bushatit, të Vilunit ka mbi dy metra ujë. Mund të ketë zona edhe me tre metra. Pra, përmbytjet ishin kolosale, por mbi to dominoi kurajua e qytetarëve të Shkodrës dhe Nënshkodrës, të cilët e trajtuan problemin me një trimëri dhe gjakftohtësi të

jashtëzakonshme dhe me aftësi të mëdha.

Ishin këta faktorë dhe angazhimi total i strukturave qendrore dhe vendore, të cilat bënë që sot ne të mos kemi asnjë jetë njerëzore të humbur. Kemi në regjistër 6 lopë, kemi 10-11 viça, mund të jenë edhe më shumë, por këto janë të evidentuara. Fatmirësisht, në këtë zonë matrikullimi i gjësë së gjallë është bërë i plotë. Shpëtimi i saj pas jetës së njerëzve ka qenë objektivi i dytë madhor.

Nëpërmjet një operacioni shpëtimi të paparë ndonjëherë në vend janë evakuuar mbi 5 mijë qytetarë, mbi 10 mijë krerë gjedhë, mijëra e mijëra të imta. Pra, u zhvillua ndërkohë operacioni më i suksesshëm i shpëtimit në historinë e vendit. Një solidaritet i madh shpërtheu brenda dhe jashtë vendit. Sot nuk ka komunë të Shqipërisë, nuk ka qytet që të mos ketë nisur dhjetëra, mijëra, miliona lekë ndihma monetare e materiale për zonat e përmbytura. Me mijëra janë qytetarët. Janë jo të paktë pensionistët që kanë dhënë nga pensionet e tyre, fshatarët që kanë dhënë mullarët e barit për familjet e përmbytura.

Një bujari të madhe kanë dëshmuar kompanitë, bizneset e mëdha e të vogla. Me mijëra tonë në ushqime e njerëz për gjënë e gjallë, ujë, mbulesa, rroba janë dhuruar gjatë këtyre ditëve për zonën e përmbytur. Kosova, shqiptarët në Maqedoni kanë dhënë ndihma të mëdha. Diaspora sot më informoi nga Nju Jorku se kisha e Zojës së Këshillit të Mirë ka krijuar mbrëmë një fundraising, në të cilin janë grumbulluar rreth 80 mijë dollarë ndihma për zonën e përmbytur. Emigrantët nga Greqia, Italia, Gjermania kanë bërë një mobilizim të madh për të ndihmuar këtë zonë. Por shumë i madh ishte edhe solidariteti ndërkombëtar.

Kryeministri i Italisë, Silvio Berlusconi, në emergjencë të plotë i ndërpreu udhëtimin këshilltarit të tij për energjinë dhe digat dhe e solli në Shqipëri në kulmin e përmbytjeve. Austria, Franca, Turqia, Greqia, Maqedonia, Kosova, Sllovenia, Moldavia dhe shumë vende të tjera e institucione ndërkombëtare, Banka Botërore dhe zëvendës-presidenti i saj, kanë dhënë ndihma të mëdha. Ekipet e ushtrisë italiane, Forcat e Sigurisë së Kosovës, zjarrfikës të Greqisë, të Maqedonisë, kanë punuar dhe punojnë ditë e natë në zonën e përmbytur. I gjithë ky operacion bëri të mundur që të vijmë sot pa jetë të humbura; të vijmë sot me dëmin më minimal në gjënë e gjallë; të vijmë sot me një program të qartë afatshkurtër, afatmesëm e afatgjatë për trajtimin e problemeve të mëdha që nxori kjo fatkeqësi natyrore.

Komiteti Ndërmintëror, deputetët e Shkodrës, zonja Topalli, qeveritarët vendorë, deputetët e tjerë dhe shumë e shumë deputetë nga ju këtu, keni dhënë një ndihmë shumë të madhe. U dëshmuat qytetarëve të Shkodrës, në historitë e dhimbshme të përmbytjeve, solidaritetin më të madh, mbështetjen më të fuqishme që ata meritojnë. Në stadin aktual detyrat janë edhe më komplekse. Detyra e parë është evakuimi i ujit nga zonat e përmbytura. Akoma janë me qindra shtëpi nën ujë në zonën e Velipojës, në Bushat. Komiteti Ndërmintëror ka shqyrtuar mbrëmë në një mbledhje të zgjatur të gjitha modalitetet e ndërhyrjes, në mënyrë që kjo zonë të çlirohet sa më shpejt nga ujërat.

Kam besim se me masat që po merren për fuqizimin e hidrovorit të Çasit, për thellimin e kanalit të Velipojës, të Vilunit, për improvizimin me emergjencë të një hidrovorit në anën e Bunës, sasi të mëdha ujore që u gjenden të depozituara do të mund të evakohen shumë më shpejt sesa në kursin e tyre natyral.

Emergjent mbetet sigurimi i bazës ushqimore për blegtorinë. Kjo fatkeqësi ka nevojë për një trajtim shumëplanësh. Komiteti Ndërmintëror ka marrë porosi të sigurojë dhe kontraktotë ushqimin për dy muaj për të gjithë krrerët e të imtave, gjedhëve, derrave, kuajve dhe të gjithë gjësë së gjallë të kësaj zone. Përlllogaritja e dëmit është një imperativ madhor yni.

Unë dua të garantoj qytetarët e Shkodrës se Qeveria do të qëndrojë plotësisht në premtimin për zhdëmtimin e plotë të të gjitha dëmeve të krijuara nga përmbytja, në përputhje të plotë me ligjin e digave. Në këtë situatë jo të thjeshtë Komiteti Ndërmintëror ka marrë porositë dhe është angazhuar të bëjë disponibël të gjitha fotot satelitore të kulmit të përmbytjes, në mënyrë që të bëhet vlerësimi më i ndershëm dhe në interes të qytetarëve. Fatmirësisht, e gjithë gjëja e gjallë e kësaj zone, blegtoria, është e matrikulluar. Kemi një regjistër të plotë të saj dhe do të veprohet në përputhje me këtë regjistër. Njerëzit kanë humbur shumë. Ju, ministrat, deputetët, në kontakt të vazhdueshëm me ta keni ndërjerë fisnikërinë e tyre dhe këtë e kam ndier edhe unë, dhe jam frymëzuar nga kjo fisnikëri. Por kam ndier gjithnjë edhe tronditjen e thellë shpirtërore për ato që kanë humbur, sepse u është mbytur investimi i tyre që kanë bërë në dekada. Unë kam takuar jo pak qytetarë, të cilët, ndonëse e përballon dhimbjen me fisnikëri, e shprehin atë në fytyrë me

zërin që u dridhej.

Dëmet kanë qenë thelbësore për qindra familje, në mos për mijëra familje të këtyre zonave. Qeveria disponon të gjitha fondet, të gjitha mjetet e një zhdëmtimi të ndershëm, të plotë dhe total, jo vetëm të dëmeve të krijuara në shtëpitë, orenditë, mallin që kanë pasur, por edhe të të gjitha dëmeve të tjera. E rëndësishme është që, sikundër gjer sot, në çdo gjë do të ketë transparencë të plotë, transparencë në përlllogaritje, transparencë në disbursim, dhe jam i bindur se këtë provë që kaluam me një sukses të plotë, provën më të rëndë të një 100-vjeçari, për sa u përket përmbytjeve ujore, ne disponojmë të gjitha njësitet potenciale që edhe këtë provë të dëmshpërblimit, të kompensimit ta kalojmë po me kaq sukses të plotë.

Zonja dhe zotërinj,

Cilido që njeh Shkodrën, ose ka pasur rastin ta sodisë atë, nga kalaja e saj kupton se ajo gjendet brenda një mrekullie ujore. Shkodra, si asnjë qytet tjetër, rrethohet nga të gjitha anët nga ujëra të mrekullueshme, liqeni, Buna, Drini, Kiri, të cilët periodikisht shfrenohen dhe i krijojnë asaj fatkeqësinë. Është detyrimi i kësaj Qeverie, i këtij shteti që, pavarësisht nga çmimi, Shkodrës përmbytja ujore të mos i qëndrojë më si shpata e Demokleut. Kjo kërkon projekte të mëdha, kërkon ndërhyrje ndër më seriozet. Një pjesë e madhe e territorit të saj është ultësirë, me nivelin e Bunës dhe të detit, vetë qyteti i Shkodrës është 8 metër mbi këtë nivel, por Qeveria dhe shteti janë më të fuqishëm se kurrë në të gjitha kohërat, janë më të mëkëmbur, janë më të aftë dhe tani marrin përsipër që këtë fatkeqësi ta shndërrojnë në mundësi të mëdha për qytetin.

Digat janë një faktor jashtëzakonisht i fuqishëm mbrojtës për Shkodrën. Më shumë investime të mëdha duhet të bëhen nën diga për të krijuar disiplinimin më të madh të mundshëm të prurjeve dhe të shkarkimeve të tyre. Kiri, një lum që Shkodrës i ka krijuar periodikisht fatkeqësi, kësaj radhe nuk ia doli, sepse argjinaturat e ndërtaura në vitin 2006-2007 i bënë mbrojtje të plotë. Argjinaturat e ndërtaura gjatë 2 vjetëve të fundit, të modelit më të mirë, do të vazhdojnë të shtrihen. Mbi 1400 metër kub ujë u shkarkua në Mat dhe asnjë metër tokë nuk u përmbyt nga Mati, dhe ishte shumë larg potencialit të përmbytjes, për shkak të argjinaturave të fuqishme. Të tilla argjinatura do të vazhdojmë të ndërtojmë, sot në lumin Kir, le të jenë të kushtueshme, por të jenë sa më të sigurta, sepse

janë jetike për jetët e njerëzve.

Një projekt i madh është në Nënshkodër. Ata që e njohin, e dinë mirë që është një sistem i tërë digash dhe argjinaturash. Në atë zonë, një sipërfaqe shumë e madhe ka qenë kënetë dhe është e bonifikuar. Absolutisht, asnjë metër katror nuk do të shndërrohet në kënetë. Duke studiuar dinamizmin e ujit të kësaj përmbajtjeje me metodat më bashkëkohore, jo vetëm që do të ndërtohet sistemi më i mirë i pritave, i argjinaturave dhe digave, por do të rindërtohet sistemi i kullimit në të gjithë territorin, nga Velipoja në Bërdicë, në Gurin e Zi.

Së fundi, një projekt tjetër madhor është thellimi i Bunës, projekt i cili duhet të nisë me emergjencë. Një inxhinier, marinar, në kulmin e krizës, Ismet Teli, më dërgon një mesazh, ku më thotë: "Zoti Kryeministër, e njoh Bunën me pëllëmbë. Unë jam marinar, njoh detin dhe Bunën. Në derdhjen e saj ajo është shumë e lartësuar dhe pengon". E vërteta është se matjet batimetrike provuan se zoti Teli kishte shumë të drejtë, dhe filloi thellimi. Natyrisht, ky është thellim emergjence, por Buna do të thellohet në të gjithë trajektoren e saj. Ky është një projekt shumë i kushtueshëm, jo i thjeshtë, sepse ajo duhet të thellohet, por liqenin nuk duhet ta boshatisim. Pra, nga njëra anë është thellimi e lundrimi dhe nga ana tjetër është derdhja e kontrolluar e saj. Të gjitha këto duhet të harmonizohen dhe ne duhet ta ndërmarrim këtë projekt.

Udha me Kryeministrin e Malit të Zi u bë në shtator. Ky projekt duhet të ecë. Ministria e Punëve Publike ka marrë porosinë që të studiojë modalitetet e hapjes së një tenderi ndërkombëtar për projektin. Unë kam besimin se me kompletimin e këtyre ndërhyrjeve ne do të bëjmë që fatkeqësitë natyrore nga uji të jenë jo një herë në 100 vjet, por le të shpresojmë që pas këtyre masave as një herë në 300 vjet.

Dua ta mbyll fjalën time duke shprehur edhe një herë mirënjohjen time më të thellë ndaj të gjithë atyre që me përkushtimin më të madh punuan ditë e natë, ndaj të gjithë atyre njerëzve që me bujarinë më të madhe dhuruan dhe bënë çdo gjë për të lehtësuar pasojat e kësaj fatkeqësie, ndaj vendeve mike, institucioneve ndërkombëtare.

Dua t'i garantoj qytetarët e Shkodrës, të Nënshkodrës dhe të rrethinave përreth se kjo përmbajtje do të shndërrohet në një kapitull të ri mundësish dhe projektesh, me të cilat kjo Qeveri do të bëjë që të përballohet çdo lloj përmbajtjeje me

kostot më minimale.

Falemnderit!

(Duartrokitje)

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Kryeministër!

Fjalën e ka zonja Trashani.

Arenca Trashani - Falemnderit, zonja Kryetare! I nderuar zoti Kryeministër,

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Në radhë të parë, dua që t'ju falënderoj ju, zonja Kryetare, dhe Konferencën e Kryetarëve për organizimin e kësaj seance në lidhje me përmbajtjet e dy javëve të fundit në qarkun e Shkodrës.

Në këto dy javë qarku i Shkodrës përjetoj një fatkeqësi natyrore, ku moti na sfidoi të gjithëve. Ne jemi në një situatë klimaterike të përmasave shekullore, një situatë që na sfidoi si shqiptarë, si Qeveri, si pushtetarë vendorë, si të zgjedhur, si bashkëpunëtorë e si politikanë.

Banorët dhe Qeveria u përballën me këtë situatë në mënyrë dinjitoze dhe me një reagim emergjence civile nga më të mëdhatë dhe më të suksesshmet që kishte njohur jo vetëm kjo zonë, por e gjithë Shqipëria. Si rezultat i këtij reagimi nuk pati asnjë humbje të jetëve njerëzore, shumë pak humbje në bagëti dhe asnjë shkatërrim të infrastrukturës së rëndësishme rrugore ose mbrojtëse.

Edhe këtë herë tradita e shqiptarëve që njerëzve në fatkeqësi t'u gjendesh në mendime e mbështetje triumfoi dhe në këto ditë shumë të vështira ne arritëm të njohim miqtë dhe dashamirësit e vërtetë.

Shumë energji u shpenzua për të minimizuar pasojat e kësaj fatkeqësie natyrore, por jo më pak energji u shpenzua nga lidershipi i Partisë Socialiste për të krijuar panik dhe nxitur banorët për mosbindje civile ndaj bashkëpunimit që u kërkuan organet qeveritare, ato qendrore dhe vendore, duke shpifur se nuk ishte një fatkeqësi natyrore, por një përmbajtje që Qeveria u bëri banorëve të qarkut të Shkodrës. Ishte një përpjekje mjerane, dashakeqe, e përmasave shekullore, e njëjtë me fatkeqësinë natyrore, do të thosha, që Partia Socialiste dhe lidershipi i saj bënë për të konfrontuar banorët e Shkodrës me Qeverinë në mes të një fatkeqësie natyrore. Kësaj i thonë të shtypësh mbi plagën e hapur duke fajësuar mjekun për operacionin që sapo të bëri. E kush mund ta bëjë një gjë të tillë përveç politikanëve perversë që duan përfitim politik mbi çdo dhimbje dhe fatkeqësi?

Por populli i qarkut të Shkodrës e përballoi me dinjitet dhe mençuri fatkeqësinë dhe braktisi me

përçmim lojën e ndyrë politike të Partisë Socialiste. Sa më shumë që lidershipi i Partisë Socialiste u mundua të instrumentalizonte fatkeqësinë, aq më shumë banorët e qarkut të Shkodrës vlerësuan ndihmën e Qeverisë, miqve tanë dhe të të gjithë atyre që u solidarizuan, mbështetën e po vazhdojnë të mbështesin kapërcimin e emergjencës dhe rikthimin e zonës së përmbytur në normalitet.

Ne u jemi mirënjohës të gjithë banorëve dhe bizneseve të zonave të prekura nga fatkeqësia natyrore për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin me organet qeveritare, si dhe të gjithë të tjerët që na u gjetën afër për të kapërcyer situatën e emergjencës.

Këto dy javë Shkodra dhe qytetarët e saj do t'i kujtojnë gjatë. Do t'i kujtojnë gjatë sepse u përballën me një fatkeqësi natyrore të paparë prej kohësh. Miliarda kub ujë, jo vetëm nga kaskada e Drinit, por edhe nga lumenjtë që e rrethojnë atë dhe furnizojnë liqenin e Shkodrës, vërshuan në Shkodër dhe kjo solli përmbytjen e disa fshatrave në komunat Dajç, Anamal, Bushat, Velipojë, Guri i Zi, Bërdicë dhe Bashkinë Shkodër. U përmbytën në total 11.400 hektarë tokë dhe si rrjedhojë 2.649 shtëpi.

Shkodranët do t'i mbajnë mend gjatë këto dy javë sepse si kurrë më parë ata kanë pasur pranë shtetit, që ka qenë prezent në çdo minutë të këtyre dy javëve. Janë evakuar brenda një kohe rekord 5.173 banorë, 11.018 krerë bagëti të trasha dhe 7.804 dele. Ka qenë një operacion i shkëlqyer, një bashkërendim i jashtëzakonshëm. Të gjithë ata qytetarë që u përballën me këtë dukuri natyrore mbijetuan mrekullisht në sajë të ndërhyrjes imediate të shtetit. Për këtë operacion një gjë ishte primare, të mos kishte asnjë humbje njerëzore, gjë e cila u arrit plotësisht.

Një solidarizim i paparë u vu re këto ditë në Shkodër dhe unë gjej rastin të falënderoj bashkëqytetarët e mi, të cilët si gjithmonë ofruan ndihmën e tyre të vyer e të pakursyer për të gjithë banorët e zonave të përmbytura. Ata ofruan gjithçka që kishin, madje edhe shtëpitë e tyre, ndonëse shpeshherë shtëpi të vogla dhe jo vila luksoze, ushqime, veshmbathje, madje dhe libra shkolle për fëmijët e zonave të përmbytura.

Një falënderim i veçantë shkon për Forcat e Armatosura, me rreth 900 forca të dislokuara në Shkodër, për Policinë e Shtetit me rreth 600 trupa efektive në Shkodër, forcat e ndërhyrjes së shpejtë, bluzat e bardha, si edhe prefektin e Qarkut Shkodër dhe të gjithë ata drejtues vendorë, kryetarë komunash e bashkish, të cilët, si kurrë më parë,

kanë qenë pranë bashkëqytetarëve të tyre në çdo moment, pa dallim ngjyrimi politik, duke u krijuar banorëve të zonave të përmbytura mundësi evakuimi dhe akomodimi.

Gjatë këtyre dy javëve në Shkodër kam parë e takuar burra, gra, pleq, të rinj e të reja, fëmijë, të cilët ishin evakuuar nga shtëpitë e tyre për të shpëtuar jetën dhe gjëja e parë që ata thoshin ishte: "Falemnderit Sali Berisha! Falemnderit Qeverisë tënde!". Asnjëherë më parë nuk ka pasur një reagim të tillë të shtetit.

Shembulli i përveçëm i mossolidarizimit gjatë këtyre dy javëve të vërshimit të ujit në Shkodër ka qenë opozita, apo më mirë të themi lidershipi i saj, ajo e Edvinit me mercenarët e tij. Shkodranët do ta mbajnë mend gjatë fyerjen dhe keqpërdorimin që ky grup antishkodran dhe antishqiptar i bëri fatkeqësisë natyrore që u ndodhi.

Ata sot nuk janë këtu, megjithëse e kërkuan vetë një seancë të tillë. T'ju them të drejtën, nuk më vjen aspak keq që nuk ndodhen këtu, sepse reagimi i tyre për Shkodrën tashmë është krejtësisht i hapur. Ata nuk e deshën kurrë atë. Nuk e deshën, sepse ajo kurrë nuk i pranoi ata si pasardhës të denjë biologjikë dhe historikë të atyre që e dogjën, i përvëluan shpirtin dhe mendjen, vetëm për një arsye, sepse ajo donte demokracinë, Perëndimin dhe jo diktaturën. Edhe këtë radhë ata derdhën me kot ca lotë krokodili në turet e tyre të pasuara me dreka e darka të majme, për të kaluar hidhërimin se çdo gjë po shkonte shumë mirë, për të tretur dhe përpunuar ndaj saj strategji strukturash paralele paranojake si ato të Mitrovicës, si ajo e 6 dhe 7 janarit për hapje apo çarje digash, që vetëm mendje tërësisht antishqiptare mund t'i prodhojnë.

Folën çfarë i pille mendja paranojake kryetarit të tyre: keqmenaxhimi hidrocentralesh, mostransparencë etj., kur çdo gjë ishte e qartë në të gjitha mediat. Prurjet dhe derdhjet në kaskadë ishin më të kontrolluara se kurrë, transparente dhe të menaxhuara shumë mirë, thënë kjo edhe nga ekspertët ndërkombëtarë. Folën për mungesë ushqimesh, kur në dispozicion të operacionit humanitar vetëm nga rezerva e shtetit u vunë 330 tonë ushqime, 225 tonë ujë, 3.2 tonë detergjentë dhe 54 tonë ushqime për bagëtinë.

Prezenca e këtij budallai ishte e përqëndruar në disa zona, ku ai mendonte se mund të nxirrte tek-tuk ndokënd duke u përqëndruar vetëm te fytyra e shpërfytyruar e Edvin Beqes me shokë, pa reflektuar absolutisht reagimin e vërtetë të banorëve,

të cilët nuk pranuan të bëheshin vegla e tyre.

Nga kjo foltore e nderuar, unë i them këtij grupi mafiozësh se e humbën shansin e tyre duke treguar se kanë shumë pak përgjegjësi ndaj atyre që i votuan, e humbën që të ditën e parë të përmytjes kur u thanë atyre: mos lëvizni nga vendi, e humbën kur u thanë: ju kuptojmë pse nuk lëvizni, e humbët kur hapët panikun në Shkodër me metoda të Sigurimit të Shtetit apo thënë me saktë me metodat e baballarëve tuaj për përmytje të krejt qytetit, e humbën kur i shanë ata se u nxorën jashtë e u thanë se kanë shtetin me vete, e humbën kur nuk iu ra ndër mend asnjë ditë të vetme të kërkonin raport zyrtar apo të bashkëpunonit me strukturat shtetërore, madje e humbën edhe kur hapën kontot bankare për të përfutur për vete në një rast të tillë fatkeqësie natyrore.

Por Shkodra dhe shkodranët ua dhanë përgjigjen e merituar. Në mënyrë konsekuente e nxorën jashtë, u thanë të largoheshin, sepse nuk kanë asgjë të përbashkët me ta, sepse shkodranët duan njeriun, duan qetësinë, duan jetën normale, duan shtetin e së drejtës dhe demokracinë, në ndryshim nga Edvini, që në ditët e fundit të mbijetesës së tij politike, nuk di më se çfarë marrëzie të sajorë. Tani që Shkodrës i iku uji, ku do të mbytet politika shpifëse dhe dëshirë dhe Partisë Socialiste, e lidershipit, e kryetarit të saj?

Sa e rëndë ishte situata, aq më shumë doli në pah forca reaguese e organeve qeveritare, si dhe solidariteti mes shqiptarëve, mes banorëve të Shkodrës dhe miqve tanë brenda dhe jashtë Shqipërisë. Në emër të banorëve i dërgoj falënderimet më të thella, në radhë të parë, Kryeministrit të Shqipërisë dhe Qeverisë së tij, të cilët kanë qenë non-stop prezentë jo vetëm në zonat e përmytura, por në krejt qarkun e Shkodrës, por dhe të gjithë atyre që na u gjendën pranë me ndihma e me fjalë inkurajuese, të cilët unë i inkurajoj të vazhdojnë mbështetjen për normalizimin e zonës dhe eliminimin e pasojave.

Punë e madhe na pret për të ndihmuar këto zona të riintegruhen, por ne në Shkodër themi "fillimi i mbarë, gjysma e punës". Unë jam e bindur se shumë shpejt këto zona do t'i kthehen normalitetit të jetës së tyre të përditshme, madje edhe më mirë se më parë. Projekte madhore na presin, por unë jam e bindur se me këtë forcë menaxhimi që kemi treguar deri tani dhe me dëshirën për të ecur përpara, mund t'ia dalim.

Ju faleminderit!

(Duartrokitje)

Jozefina Topalli – Falemnderit, zonja Trashani!
(Fjalën e merr Kryetarja e Kuvendit, zonja Jozefina Topalli.)

Jozefina Topalli – 2.6 miliardë metër kub ujë të tepërt, të mbledhur vetëm në dy javë për shkak të ndryshimeve klimaterike, hodhi natyra mbi Alpet dhe Veriun e Shqipërisë. Global Disaster Center (Qendra Botërore Studimore e Fatkeqësive Natyrore të Përmytjeve) e cilësoi këtë si një ngjarje të shkallës së dytë të rrezikshmërisë, që mund të shkaktonte, përveç të tjerave, 100-1000 apo më shumë të humbur, po të përkeqësohej situata.

Në këto kushte prurjet në Fierzë nga 400 metra kub në sekondë u rritën në 1600 metra kub në sekondë. Lumi i Kirit e i Gjadrit po fryheshin më shumë. Batica dhe shiroku nuk lejonin daljen e Bunës në det. Drini po dilte nga shtrati dhe temperatura brenda 24 orëve nga minus 4 gradë celsius, u ngrit në 16 gradë celsius. Reshjet e forta dhe bora që shkriu mund të rrezikonin edhe më shumë. Liqeni u rrit si asnjëherë më parë.

Kryeministri u kërkoi banorëve të Shkodrës që të evakuheshin. Shkodra ishte e rrethuar nga ujërat. Shkodra ishte në rrezik. Shkodranët kësaj radhe do të kalonin një provë tjetër. Shkodra kishte nevojë për ndihmë. Ato ditë zona ishte gjysmë e boshatisur, nën ujë, por duke pritur që jeta e shpresa të kthehej. Jetesa e qindra banorëve ndryshoi nga ujërat e papërmbajtur.

Detyra numër një ishte shpëtimi i jetëve. Sot, dy javë pas shpalljes së gjendjes së emergjencës, suktesi është shpëtimi i jetëve. Një ditë, në Dajç, një banor më tha: "Unë e humba shtëpinë, i humba dhe të mbjellat, por unë kam shpëtuar familjen dhe kam shpresë."

Detyra numër dy: evakuimi i gjësë së gjallë. Sot pas dy javësh, shumica e tyre janë të padëmtuara.

Detyra numër tre: ngritja e rrjetit të menjëhershëm të koordinimit të mbledhjes dhe shpërndarjes së ushqimit, ujit, ilaçeve dhe ushqimit të gjësë së gjallë. Suktesi i tretë ishte shpërndarja e 400 tonë ushqimeve, 200 tonë koncentreve dhe ushqimeve për gjënë e gjallë, pajisjeve shtëpiake, ilaçeve, batanijeve, dyshekëve etj.

Mjekë, infermierë, ushtarë, policë, punonjës të ndërmarrjeve veterinarë e bujqësore, të bordeve u shpërndanë në të gjithë zonën. Puna me evakuimin u bë mjaft mirë. Puna për rimëkëmbjen po ecën përpara. Zyrtarët, ministrat, specialistë të mjedisit e pushtetit lokal vazhdojnë të jenë në terren. Pompat

po punojnë pa pushim dhe ndihmat në ushqime e pajisje vijnë.

Ishte hera e parë që Shkodra u paralajmërua tri ditë më parë. Detyra e madhe, qëllimi i madh, ishte që Shkodra të rikthehej sa më shpejt në jetën normale. Sot qyteti është kthyer pothuajse krejt në normalitet. Në këto dy javë kam parë të njëjtin shpirt, forcën e zemrës dhe të karakterit që i mbijeton çdo fatkeqësie, besimin te Zoti, fuqinë e shqiptarit të vendosur për të larguar dëmet e për ta ndërtuar jetën edhe më mirë.

Ishin ditë kur gjithë Shqipëria shikonte nga Shkodra, ishin ditë kur së bashku me shkodranët luftonim kundër kohës, ishin ditë kur shkodranët grumbulluan forcat e tyre dhe vendi do të certifikonte leadershipin. Çdo natë sillte rreziqe të reja dhe çdo ditë kërkonte kurajë të re. Ishin ditë kur të gjithë u bashkuam. Ishte hera e parë kur Shkodra nuk po braktisej.

Kryetari i Qeverisë, me shumicën e ministrave, u instaluan aty ku kishte nevojë për ndihmë. Shteti u çua në këmbë. Ashtu si në historinë e vendit tonë dhe të traditës shqiptare, humanizmi dhe solidariteti i kombit u dëshmuar që në ditën e parë. Ishte operacioni më i madh i evakuimit dhe i shpëtimit në raste fatkeqësish natyrore.

Ato ditë u thosha banorëve të përmytur: "Ju duhet ta dini se i gjithë kombi e ka mendjen te ju, por dhe në ditët e ardhshme ne do të jemi këtu. Ne do të qëndrojmë këtu sa kohë që duhet për të rikthyer jetën."

Të gjitha komunat dhe bashkitë e Shqipërisë, nga Tropoja në Sarandë, në një aksion humanitar, iu drejtuan Shkodrës për ta mbështetur dhe unë dua t'i falënderoj të gjithë nga zemra: biznesmenë, individë, shoqata të huaja, donatorë, vendas dhe të huaj.

Forma e solidaritetit shkoi përtej kufijve, shqiptarët nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi me mend, me trup e me zemër ishin në Shkodër. Por në këtë fatkeqësi natyrore, që hodhi në Shkodër miliarda metra kub ujë, pati ndonjë që nxiti telefonata. Ata që telefonuan ato ditë për të hapur panik, gabuan rëndë kur menduan se shkodranët do të binin pre e frikës apo tmerrit. Qëllimi ishte i mbrapshtë, por edhe qyteti ua ktheu mbrapsht. Ata ishin kundër frymës dhe shpirtit shqiptar të atyre momenteve.

Të gjithë atyre që pyesin për të ardhmen e Shkodrës, do t'u them një gjë: Shqipëria nuk mund të imagjinohet pa Shkodrën, por edhe Shkodra nuk mund të imagjinohet pa këto komuna dhe ato do të

ringrihen përsëri, edhe më mirë se më parë.

Gjatë këtyre ditëve të fatkeqësisë natyrore, që ndodh një herë në 100 vjet, dikush tha se 2.6 miliardë metra kub ujë nuk vijnë nga Zoti, por nga rob. Kur e dëgjova për herë të parë thashë: është lajthitje. Kur e dëgjova herën e dytë thashë: është papërgjegjshmëri. Sot i them atij që e ka thënë: i ke kapërcyer të gjithë kufijtë, je jashtë frymës, je jashtë njerëzores, je jashtë racionale, je jashtë çdo lloj morali. Nuk dua ta them, por e kam menduar vazhdimisht: ti shpresoje atë që kurrkush nuk e donte që të ndodhte.

Ndryshimet klimaterike goditën edhe Britaninë, edhe Gjermaninë, ku pati edhe viktima. Numri i tyre vetëm në Poloni gjatë këtyre ditëve shkoi në mbi 100, por askush nuk tha se ishte marrëzia e pushtetit apo farsa e Parlamentit.

Ju ftoj ju, zotërinj deputetë, por edhe ju qytetarë të mos e kujtojmë më, ta fshijmë nga kujtesa urdhrin e tij për këshilltarët socialistë në Këshillin Bashkiak të Tiranës që të votonin kundër fondit për Bashkinë e Shkodrës. Ajo nuk është historia jonë, nuk është histori shqiptare, nuk ishte njerëzore. Fshijeni nga kujtesa! Ajo nuk kishte ndodhur kurrë në historinë e kombit tonë dhe s'ka për të ndodhur kurrë ndonjëherë në historinë tonë. Përgjigja e shtetit ishte përgjigje pa precedent ndaj një përmytjeje të paprecedent në një shekull që tregoi dhimbjen dhe ndihmën e kombit tonë.

Dje, ai, në një montazh filmik u tregoi shqiptarëve hartën e zonave të përmytura nga uji. Ngjyra e ujit nuk ishte blu, por ngjyrë e kuqe gjaku. Vetëm një mendje e sëmurë mund ta pikturonte ashtu zonën e Shkodrës. Ndërkohë, angazhimi ynë është: kur të gjithë fshatrat të dalin nga uji, ato do të bëhen më të bukura e më të forta nga ç'ishin përpara përmytjes.

Kur një gazetar pyeti një banor të evakuuar, ai tha: "Unë do ta rindërtoj shtëpinë, por do ta bëj më të lartë". Ky është vizioni ynë për të ardhmen. Në këto fshatra, në këtë qark, në të gjithë Shqipërinë, ne jo vetëm do të dëmshpërblejmë, por do t'i bëjmë më të larta shtëpitë, më të mirë e më të bukur jetën e shkodranëve. Të mbrosh shtëpitë që janë më poshtë se uji nuk është e lehtë, por ne mund dhe duhet ta bëjmë, dhe kur t'i mbarojmë të gjitha këto punë, shqiptarët do të kenë edhe diçka tjetër, për të cilën do të jenë edhe më shumë krenarë.

Në historinë e kombit tonë shpesh na është kujtuar se natyra është një forcë e tmerrshme dhe se vetë jeta është e brishtë, gati-gati si gastare.

Shqiptarët nuk e kanë lënë kurrë fatin e tyre në trillet e natyrës dhe sigurisht që ne nuk e lejuam as kësaj radhe. Fatkeqësia në Shkodër na rikujtoi se ka një shpresë përtej çdo dhimbjeje, se jemi të lidhur të gjithë si komb dhe se dhimbja na prek të gjithëve njëllë. Shkodranët gjatë historisë së tyre kanë kapërcyer vuajtje të mëdha, por me dinjitet të madh. Edhe kësaj radhe treguan se as nuk ankohen dhe as nuk dorëzohen.

Gjatë historisë ata i kanë dhënë Shqipërisë dashuri të pakursyer, qytetërim e dije dhe nuk kanë kërkuar kurrë asgjë. Ata janë sot të pamposhtur, por edhe fisnikë për të thënë fjalën e mirë edhe kur janë në ditë të keqe. Nuk ishte hera e parë që po përmytëshin, por ishte hera e parë që një qeveri po i ndihmonte dhe kjo atyre u dukej e jashtëzakonshme.

Dje një qytetar, një banor i fshatit të Dajçit, më tha: "Thuaji Sali Berishës faleminderit! Mos harro Jozefinë, thuaja Sali Berishës!"

Faleminderit të gjithëve!

(Duartrokitje)

Zoti Spaho, urdhëroni!

Edmond Spaho – Faleminderit, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Përmytja në zonën e Shkodrës tregoi shkallën e lartë të reagimit të të gjitha strukturave të shtetit shqiptar në kushtet e një fatkeqësie natyrore me përmasa mjaft të mëdha.

Gjatë ditëve të fundit të muajit dhjetor 2009 dhe ditëve të para të muajit janar 2010 reshjet e mëdha në të gjithë zonën ujëmbledhëse të lumenjve Drin, Bunë, Gjadër, Kir dhe batica në detin Adriatik shkaktuan një situatë të paprecedentë për dhjetëra vjet. Rritja e temperaturave për dy herë më radhë gjatë një harku dhjetëditor bëri që rezervat e borës që shkrijnë në muajin mars të shkrijnë në mënyrë të menjëhershme dhe prurjet në liqenet e hidrocentraleve në kaskadën e lumit Drin arritën nivele jashtëzakonisht të larta, me rreth 2000-2500 m³ në sekondë, duke bërë të paevitueshme hapjen e portave të shkarkimit për të mbrojtur digat.

Reagimi i Qeverisë shqiptare dhe i strukturave të tjera të shtetit, përfshirë ushtrinë, policinë, forcat e emergjencës civile, strukturat ndihmëse të Ministrisë së Bujqësisë, Transportit, Shëndetësisë, të njësive të pushtetit vendor, bashkisë, prefekturës dhe qarkut të Shkodrës ka qenë i menjëhershëm, me objektiv mbrojtjen e jetëve njerëzore dhe minimizimin e pasojave në të gjitha drejtimet e mundshme.

Për dy javë rresht, me dhjetëra dhe qindra trupa të strukturave të mësipërme evakuuan mijëra banorë dhe pasurinë e gjallë të mbi 2500 familjeve të komunave më të përmytura. Operacioni i ndërmarrë në zonën e Shkodrës është më i madhi i këtij lloji i zhvilluar ndonjëherë në vendin tonë dhe me rezultate thellësisht pozitive. Është një arritje e pamohueshme që nga përmytjet e shkaktuara nga kushtet e motit, që përsëriten një herë në 100 a më shumë vjet, të evitohet humbja qoftë edhe e një jetë të vetme njerëzore.

Të gjithë të evakuarve iu garantua strehim, si dhe iu siguruan furnizime të mjaftueshme: ushqime, ujë, veshmbathje, medikamente, ushqim për bagëtinë, transport dhe nevojat e tjera të jetës së përditshme. Paralelisht me to shtabi i emergjencës angazhoi forca të mjaftueshme të cilat punonin ditë e natë në forcimin e argjaturave, mbajtjen kolektorëve në punë me kapacitet maksimal, rritjen e kapaciteteve thithëse dhe zbrastëse, në instalimin e dhjetëra pompave të fuqishme, madje në ditët e fundit u intervenua edhe në thellimin e grykëderdhjes së lumit Buna.

Në përballimin e gjendjes së jashtëzakonshme në qarkun Shkodrës populli shqiptar dëshmoi një ndjenjë të lartë përgjegjësie dhe solidariteti. Me mijëra individë, biznesmenë, shoqata, komuna, bashki, dërguan ndihma materiale dhe monetare, si dhe forca njerëzore në terren. I menjëhershëm ishte solidariteti dhe angazhimi i vendeve fqinje dhe i disa vendeve të NATO-s, të cilat dërguan trupa të specializuara për operacionet e shpëtim- evakuimit. Ndhimë mjaft e rëndësishme u dha nga bashkëkombasit tanë dhe nga Qeveria e Kosovës, e cila si edhe herë të tjera u radhit krahu për të ndihmuar në përballimin e pasojave të përmytjeve me përmasa të mëdha. Solidaritet shprehën të gjithë institucionet e BE-së, përfaqësitë e vendeve mike, diaspora shqiptare kudo që ndodhet dhe miq të tjerë të vendit tonë.

Në kundërshtim me këto qëndrime, krejtësisht i papërgjegjshëm dhe destruktiv ishte qëndrimi i opozitës shqiptare dhe veçanërisht i PS-së. Që nga fillimi i përmytjeve, për çdo ditë dhe orë, kryetari i PS-së dhe përfaqësues të tjerë të saj u përpoqnë të shfrytëzojnë dhe instrumentalizojnë përmytjen për qëllime politike. Si në asnjë rast dhe ndryshe nga çdo vend tjetër i botës, ku opozita në kushtet e fatkeqësive natyrore bashkohet rreth kombit për të përballuar pasojat, opozita jonë filloi të fabrikojë dhe të falsifikojë faktet dhe të kërkojë prerje kokash.

Me qëndrime krejt të çuditshme dhe alogjike kur gjithë populli angazhoi në operacionet e shpëtimit, përfaqësuesit e PS-së flisnin për nxjerrje përgjegjësish, krijonin struktura paralele të cilat s'do të siguronin as ujë për të pirë për deputetët socialistë, kërkonin kompensim me lekë në dorë ditën e tretë të përmytjeve dhe përpiqeshin të ngjallnin panik në qytetin e Shkodrës. Përpjekjet fatkeqe për të përfituar kapital politik arritën deri atje, sa nxorën në media disa mjeranë të vetëquajtur ekspertë, diabolikë të lindur, të cilët ulërinin se digat po çahen, apokalipsi po vjen dhe vendi po merr fund.

Qëndrime të papranueshme mbajtën disa kandidatë për deputetë të PS-së, të cilët me vajtjet e tyre në zonë nuk kishin synim mbështetjen morale të banorëve të zonës dhe përpjekjen për shpëtimin e tyre, por vetëm të shanin Qeverinë me fjalor banal, si dhe përpjekjen për të nxitur banorët në pakënaqësi dhe mundësisht në revolta. I papranueshëm dhe i turpshëm është qëndrimi i këshilltarëve socialistë në bashkinë e Tiranës të cilët votuan kundër dhënies së një fondi ndihme për zonat e përmytura. Me qëndrimin e tyre të diktuar nga kryetari i bashkisë ata dëshmuuan mungesë përgjegjësie dhe fytyrën e një specieje të rrezikshme politike, e cila, për objektivat e veta, është gati të shkelë çdo normë e parim njerëzor dhe të përbaltë virtyte të cilat kanë karakterizuar kombin tonë në çdo kohë të vështirë .

Të nderuar kolegë deputetë,

Pas dy javë përpjekjesh të jashtëzakonshme të Qeverisë dhe të strukturave të saj kemi arritur që ujërat të vihen nën kontroll dhe situata të shkojë drejt normalizimit. Një fazë shumë e rëndësishme e punës është afër përfundimit, por një fazë tjetër po aq e rëndësishme është përpara. Rehabilitimi i zonës së përmytur do të përbëjë prioritetin e kësaj maxhorance në ditët dhe javët në vazhdim. Kompensimi i dëmeve për banorët e zonës, mbi bazën e kriterëve sa më të studiuar, do të jetë prioriteti tjetër më i rëndësishëm në periudhën e ardhshme. Pavarësisht se sa do të jetë fatura financiare, kompensimi i dëmeve që kanë pësuar banorët e zonës do të jetë i plotë. Për kompensimin e tyre Qeveria do të përdorë jo vetëm fonde të destinuar për raste të tilla, por edhe ato nga zëra të tjerë të buxhetit.

Qeveria do të shpenzojë jo vetëm për kompensimin e dëmeve të familjeve të zonës, por edhe për rehabilitimin sa më shpejt të saj nëpërmjet rihapjes së kanaleve kulluese, pastrimit të zonës,

sistemimit, rehabilitimit të rrjetit rrugor, urave, shkollave, çerdheve, kopshteve, qendrave shëndetësore dhe gjithçkaje tjetër që është në shërbim të banorëve. Më tej do të realizohen investime të karakterit afatgjatë, si: forcimi dhe thellimi i argjinaturave ekzistuese, ndërtimi i argjinaturave të reja dhe thellimi i lumit Buna në mënyrë që probabiliteti i përsëritjes së ngjarjeve të tilla nga forcat e natyrës të jetë sa më minimal.

Në fund, dëshiroj të falënderoj popullin e qarkut të Shkodrës për qëndrimin fisnik, kurajën e madhe dhe realizmin që tregoi në kapërcimin e kësaj prove të madhe, përballë së cilës na vunë forcat e natyrës.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Spaho!

Zoti Prifti, urdhëroni!

Dritan Prifti – I nderuar zoti Kryeministër,

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Më vjen shumë mirë që ne ia dolëm të përballonim një nga egërsitë natyrore më të mëdha të ndodhura në Shqipëri në 100 vjetët e fundit. Observatorë me famë botërore, të specializuar vetëm për përmytjet, si ai i Dartmuthit të SHBA-së, e klasifikuan situatën e reshjeve, të shkrirjes së borës, të fryrjes së lumenjve Drin, Bunë, Kir, Gjadër, por edhe atyre të Malit të Zi, që përfundojnë në liqenin e Shkodrës, të fryrjes së liqenit të Shkodrës dhe të reagimit të detit Adriatik me batica dhe zbatica që ndalnin shkarkimin normal të lumenjve në të, si një situatë që përsëritet vetëm një herë në 100 vjet.

Lumi Drin ka pasur edhe herë të tjera prurje të mëdha, por asnjëherë në 100 vjet këto nuk janë shoqëruar me fryrje të lumenjve të tjerë, të liqenit apo edhe të detit. Baticat bënin bllokimin e derdhjes së Bunës në det, por sillnin me vete miliona m³ nga deti, duke shkaktuar fryrjen dhe derdhjen e Bunës përtej kufijve të argjinaturave tona, të cilat, për fat të mirë, në pjesën më të madhe, ishin ndërtuar rishtazi. Lumi Buna në derdhjen e tij në det grumbullon ujërat e një pellgu ujëmbledhës me një sipërfaqe të përgjithshme prej 19582 km², pothuajse të 60% të territorit të vendit tonë. Në daljen e liqenit të Shkodrës Buna grumbullon ujërat e një pellgu ujëmbledhës prej 5179 km², prej të cilave vetëm 1025 km² përfshihen brenda territorit të Shqipërisë, pjesa tjetër shtrihet në territorin shtetëror të Malit të Zi. Buna përfaqëson lumin më të madh që derdhet në brigjet e Adriatikut Lindor dhe të dytin në të gjithë Adriatikut, pas lumit Po të Italisë Veriore, për sa i përket sipërfaqes së pellgut ujëmbledhës, ashtu

edhe madhësisë ujore, duke derdhur në Adriatik një prurje mesatare shumëvjeçare prej mbi 700 m³ në sekondë dhe 60% të rrjedhës mesatare shumëvjeçare të të gjithë territorit hidrografik të Shqipërisë.

Përmbytja e janarit të këtij viti, sipas shkencëtarëve më të mirë shqiptarë, e ka zanafillën në valën baticore të 31 dhjetorit dhe në vazhdim, e cila u shkaktua nga pozicioni hapësinor Hënë- Tokë-Diell (jam duke cituar këtu, të nderuar kolegë deputetë, një raport të disa shkencëtarëve tanë, përfaqësues të Institutit Hidrologjik të Shqipërisë, të cilët kanë analizuar me detaje shkaqet e kësaj situatë). Siç e vumë re në natën e ndërrimit të viteve, toka mbuloi 8% të sipërfaqes së Hënës, çka do të thotë se të trija këto objekte ndodheshin në një vijë të drejtë mes tyre. Ky pozicion hapësinor në Hënën e plotë 15- ditore dhe Hënën e re 1-ditore përfaqëson gjithmonë amplitudë baticore maksimale. Në rastin tonë, data 31 dhjetor 2009 koïncidon me ditën e pesëmbëdhjetë të Hënës Muharrem, çka do të thotë se batica e zbatica e kësaj hëne ka shfaqur vlerat më të larta të nivelit të ujit në detin Adriatik. Përveç kësaj, erërat e fuqishme jugore me shpejtësi 15 metër në sekondë shkaktuan një valë baticore, e cila jo vetëm bllokoi rrjedhën e lumit Buna, por shkaktoi edhe një rrymë të fuqishme dhe të shpejtë të ujërave të kripura të detit në drejtim të kundërt me rrjedhën e ujërave të lumit Buna. Në këtë mënyrë ujërat e detit, të cilat në kushtet e një baticë sado të vogël, që zakonisht vihet re edhe në nivelet më të ulëta të lumit Buna, në Dajç, në këtë rast një pjesë e sipërfaqes së lagur të profilit tërthor të lumit Buna, do të rrisnin masën dhe lartësinë e ujit të kripur në këtë shtrat lumor, duke penguar aftësinë ujëheqëse të këtij lumi në drejtim të detit dhe fryrjen e niveleve të tij.

Kolegë deputetë, u zgjata pak në shpjegimin e këtij fenomeni natyror, sepse është i nevojshëm për të kuptuar që përmbytja në Shkodër nuk erdhi aspak si rrjedhojë e shkarkimeve nga kaskada e Drinit, por si rrjedhojë e disa fenomeneve natyrore tepër komplekse.

Siç e përmenda edhe pak më parë, unë kam një raport me shumë faqe që sqaron këto efekte deri në detaje. Ne kemi shkencëtarë shumë të mirë që i kanë studiuar dhe i sqarojnë mjaft mirë këto fenomene. Institutet tona shkencore kanë bërë matjet e niveleve të të gjithë tërësisë ujore, të liqeneve dhe të lumenjve gjatë gjithë ditëve të përmbytjes dhe fenomeni natyror që ka ndodhur

është i njohur e plotësisht i shpjegueshëm.

Si Ministri e Energjetikës ne kemi bërë përpjekje maksimale për të kontrolluar situatën e përmbytjeve, nëpërmjet menaxhimit sa më efikas të kaskadës së lumit Drin. Menaxhimi i shkarkimeve të plota të kaskadës së Drinit sot bëhet nëpërmjet dy rregulloreve të ndryshme që plotësojnë njëra-tjetrën. Njëra rregullore është aprovuar në vitin 1988 nga qeveria e kohës, kurse tjetra është aprovuar në 12 qershor të vitit 2006 nga ministri Ruli.

Rregullorja e vitit 2006 ngre një sekretariat teknik të përhershëm me drejtues dhe ekspertë nga sistemi ynë energjetik, që menaxhon shkarkimin e flotave në kaskadën e Drinit, duke zhvlerësuar në një pikë rregulloren e vitit '88, e cila kërkon që ministri i Energjetikës të ngrinte një komision të posaçëm me përfaqësues të dikastereve të ndryshme që në kohën kur Fierza ishte në nivelin 285 metra. Rregullorja e vitit 2006 i jep të drejtën sekretariatit teknik t'i kërkojë ministrit ngritjen e këtij komisioni të posaçëm në funksion të situatës. Edhe sot që flasim, situatën e ka drejtuar dhe e drejton me shumë kompetencë sekretariati teknik, i cili është ngritur me urdhrin e ministrit Ruli që në vitin 2006.

Ligji i emergjencave civile, që prevalon mbi çdo rregullore të veçantë në rast emergjencash, kërkon një rakordim ndërministror të cilin Qeveria e bëri në kohën e duhur me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1, më 6 janar 2010. Me këtë vendim të Këshillit të Ministrave u krijua Komiteti Ndërministror për menaxhimin e situatës, i cili ngriti një qendër operacionale, 24 orë në funksion të plotë, për të rakorduar të gjithë situatën në vend. Pavarësisht rregulloreve të ndryshuara apo ligjeve që prevalojnë në një moment apo tjetrin, unë si ministër i Energjetikës, në datën 8 nëntor 2009, me urdhrë të veçantë ministror, kam ngritur një grup të posaçëm pune për të menaxhuar situatën në kaskadën e Drinit, me në krye zëvendësministrin përgjegjës për energjetikën edhe me pjesëmarrjen e specialistëve tanë më të mirë të sistemit tonë energjetik.

Në datën 26 dhjetor, kur Fierza nuk kishte kaluar ende pragun e 290 metrave, unë kam dalë në një konferencë shtypi dhe kam paralajmëruar situatën e prurjeve të mëdha dhe mundësinë e daljes së lumenjve nga shtrati. Kam kërkuar të merren masa. Në datën 27 dhjetor kam bërë një letër të cilësuar "Tepër urgjent", ku kam njoftuar kabinetin e Kryeministrit dhe të gjitha ministritë kryesore të Qeverisë sonë për situatën dhe nevojën e masave urgjente. Në të njëjtën ditë Kryeministri ka urdhëruar

të mbledheshin ministrat kryesorë, për të menaxhuar situatën dhe ne jemi mbledhur në Ministrinë e Brendshme me në krye ministrin Basha, me pjesëmarrjen e ministrit Olldashi, Ruli, Imami, Prifti, Vasili dhe me të gjitha strukturat e emergjencës së Qeverisë shqiptare.

Qeveria mori masa të menjëhershme për të njoftuar situatën në çdo komunë dhe bashki, në çdo kryeplak fshati, në të gjitha zonat ku mendohej se mund të kishte përmbajtje. Për masat e marra kanë folur edhe kolegët dhe ato i kanë parë shumë mirë shkodranët dhe të gjithë shqiptarët si rrallë ndonjëherë më parë. Edhe pse në Shkodër ka pasur përmbajtje të shpeshta, Qeveria nuk kishte mobilizuar ndonjëherë një armatë kaq të madhe forcash, në një operacion ndihme dhe shpëtimi që nuk ka ndodhur asnjëherë në historinë e qeverive të këtij vendi. Operacioni doli me sukses të plotë, duke mos pasur asnjë viktimë njerëzore. Të gjithë ministrat e komitetit të emergjencës kanë bërë detyrën me përgjegjësi të lartë.

Ministria e Energjetikës në këtë kuadër vendosi një shërbim 24 orë në të gjithë vendin, për të menaxhuar situatën siç duhet. Kemi thyer rekorde historike duke prodhuar 29 milionë kilovat/orë në ditë, rekorde të cilat as specialistët tanë më të mirë nuk i mendonin se mund të ishin të arritshme. Kemi eksportuar 12 milionë kilovat/orë në ditë. Ky është një rekord i paarritur ndonjëherë nga sistemi energjetik shqiptar. Kemi mbrojtur hidrocentralet, digat, nënstationet, linjat, aparaturat e tyre si gjëja jonë më e shtrenjtë.

Unë me kënaqësi i raportoj Kuvendit se nuk kemi pasur asnjë defekt, asnjë problem, asnjë avari gjatë gjithë ditëve të emergjencës civile. Në orët e vona të mbrëmjes, kur shkova në Dajç, shikoja shtëpitë 2 metra të zhytura nën ujë dhe jam habitur që në dritaret e tyre llamburitnin dritat.

Na akuzojnë kolegë deputetë se me digat tona kemi mbytur Shkodrën. Nuk mund ketë shpifje dhe manipulim më të madh sesa kjo akuzë. Digat dhe HEC-et tona e shpëtuan Shkodrën nga një katastrofë edhe më e madhe. Në Shkodër, vetëm nga Drini, për shkak të reshjeve dhe prurjeve, janë shkarkuar rreth 2.5 miliardë metër kub ujë. Në Shkodër, nga lumenjtë Kir dhe Gjadër mund të jenë shkarkuar po ashtu më shumë se 1 miliard e gjysmë metra kub ujë.

Unë e garantoj Shkodrën se disiplinimi që u bëri kaskada e Drinit shkarkimeve, akumulimi që i bënë liqenet e Drinit prurjeve të jashtëzakonshme, e

shpëtuan Shkodrën. Vetëm në Fierzë ne bllokua rreth 500 milionë metër kub ujë, që i mbajtëm në kaskadë dhe ia kursyem Shkodrës.

Nëse nuk do të ishte kaskada dhe nëse nuk do të menaxhohej me kaq eficiencë nga specialistët tanë, niveli i ujit në zonat e përmbytura mund të ishte edhe një metër më i lartë sesa ai që u arrit. Nëse ekspertët tanë nuk do të kishin vepruar me profesionalizëm dhe me përgjegjësi të lartë atdhetare, komiteti i emergjencës nuk do të kishte kohë të evakuonte ata mijëra njerëz nga shtëpitë e tyre.

Opozita na akuzon se duhet t'i kishim shkarkuar ujërat më shpejtë. Ata na thonë se kemi shkelur rregulloren duke lejuar nivelin e Fierzës mbi 290 metra. Nëse do të kishim vepruar ashtu, sot do të kishim dhjetëra viktima nga përmbajtjet e dy javëve të fundit.

Zoti e ka ndihmuar Shqipërinë dhe Shkodrën që në pushtet nuk është ajo opozitë sot. Ata flasin për rregullore, bëjnë prezantime mashtruese në asamblenë e tyre, duke fshehur dhe manipuluar të dhënat tona. Ata deklaruan se nuk gjenin të dhënat për datën 27 dhjetor 2009 në asnjë institucion të shtetit tonë. Mashtrim dhe vetëm mashtrim.

Ata e fshehën datën 27 dhjetor 2009, sepse në atë datë prurjet në Fierzë shkuan 1668 metër kub në sekondë dhe sipas rregullores Fierza mund të lejohet të shkojë deri në nivelin 296.5 metra.

Sekretariati teknik zbatoi pikë për pikë rregulloren, lejoi një rritje të Fierzës dhe unë e them me garanci që shpëtuan Shkodrën. Opozita, sigurisht, e fsheh të vërtetën, i fsheh të dhënat e kaskadës, vetëm që të manipulojë dhe të gënjejë opinionin publik se fajin e ka Qeveria dhe keqmenaxhimi i kaskadës së lumit të Drinit.

Unë kam thirrur për konsultim ekspertët më të mirë që ka Shqipëria për energjetikën gjatë ditëve të përmbajtjes. Kam sqaruar veprimet tona dhe kam kërkuar mendime nga ata. Të gjithë ata që janë me të vërtetë ekspertë të pavarur, ata që shërbimin e atdheut nuk e lidhin me shërbimin ndaj një partie të vetme politike, na ka ndihmuar jashtë mase në këtë menaxhim. Ndaj unë, nga foltorja e Kuvendit, dëshiroj t'i falënderoj të gjithë.

Më kujtohet reagimi i profesor Farudin Hoxhës në një takim tonin në Ministrinë e Energjetikës. Pasi unë u kërkova të falur ekspertëve që i nxora nga shtëpia në orën 11 të natës, për të bërë konsultime, profesor Farudin Hoxha më tha: "Dritan, na thirr gjithmonë natën, se ne të vjetrit natën nuk na zë

gjumi, na rri mendja te puna.”

Kam thirrur në konsultim edhe ekspertë të huaj, italianë, francezë, zviceranë, anglezë dhe të gjithë kanë konfirmuar garancinë e digave tona dhe një menaxhim të shkëlqyer të situatës nga ekspertët tanë. Disa prej tyre, ju i keni parë, kanë folur në televizionet shqiptare, italiane dhe ato angleze.

Vetëm opozita jonë, kolegë deputetë, është e pakënaqur që nuk kishte viktimë. Kjo opozitë është e pakënaqur që nuk kishim asnjë problem me digat dhe me hidrocentralet tona. Ata donin viktimë, katastrofë, me qëllim që ta shfrytëzonin atë për t'u rikthyer në pushtet. Në fakt, unë jam i impresionuar nga puna e jashtëzakonshme që është bërë nga ekipi i Kryeministrit Berisha për të menaxhuar situatën. Me Kryeministrin kam komunikuar, pa ekzagjerim, çdo 10 minuta, gjatë ditës dhe natës, në ditët e vështira të kësaj situatë.

Në mënyrë të veçantë zoti Basha ka bërë një punë të jashtëzakonshme në drejtimin e këtij operacioni. Shqipëria ka nevojë për politikanë që i shërbejnë popullit dhe nuk ka nevojë për politikanë që shpifin dhe manipulojnë me të vërtetën.

Të tillë politikanë janë Sali Berisha, Ilir Meta, Lulzim Basha, Genc Ruli, Sokol Olldash, Petrit Vasili, Arben Imami, Fatmir Mediu, të cilët shumicën e këtyre ditëve kanë qenë në Shkodër, për t'u shërbyer atyre që u kanë dhënë votën. Të tillë janë deputetët e Shkodrës, të cilët me të vërtetë më kanë impresionuar gjatë gjithë kohës që kam shkuar në Shkodër për vizitë, duke qëndruar në frontet më të vështira, në krye të menaxhimit të situatës.

Dua të falënderoj edhe Kryetaren e Kuvendit, e cila ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm dhe të veçantë në menaxhimin e gjithë kësaj situatë. Ne ia dolëm mbanë pjesës më të madhe të vështirësisë, kolegë deputetë, por misioni ynë nuk ka mbaruar ende. Ne duhet të garantojmë kthimin në normalitet të të gjithë vëllezërve dhe motrave tona në zonat e përmbytura. Kemi për të dëmshpërblyer ata në çdo qindarkë të humbur nga kjo fatkeqësi natyrore; kemi edhe për të hartuar, siç e përmendi edhe zoti Kryeministër, projekte të mëdha për të mbështetur Shkodrën në të ardhmen.

Një falënderim të veçantë e kam për qytetarët e Shkodrës. Ata më kanë treguar se arsyja qytetare ka forcë të mposhtë mashtrimin mesjetar. Për hir të së vërtetës, unë kam shkuar në Shkodër disa herë gjatë kësaj periudhe dhe kam pasur një farë ndrojtjeje edhe për shkak të akuzave që bënte gjithë kohës opozita në drejtim të emrit tim, sikur kaskada e

shkaktoi problemin në Shkodër, por jam habitur me qytetarinë e shkodranëve. Më kanë ndaluar në rrugë dhe më kanë thënë: “Dritan, të falënderojmë shumë që dole në televizor dhe na sqarove. Na hoqe panikun që na e përhapën shtëpi më shtëpi disa telefonata anonime se gjoja do të shpërthenin digat, se gjoja fëmijët i kemi të pasigurt”

Pra, në vend që të bënin kritika, për shkak të manipulimeve të opozitës, shkodranët i kishin sytë e hapur dhe e kuptuan që kjo Qeveri u ngrit në këmbë për t'u shërbyer atyre.

Unë do ta mbyll duke thënë: Falemnderit Shkodrës dhe të gjithë juve që morët pjesë në këtë mision të jashtëzakonshëm shpëtimi dhe ndihme për të përballuar situatën e përmbytjeve!

Falemnderit të gjithëve! (*Duartrokitje*)

(*Ndërkohë, drejtimin e seancës e ka marrë zoti Turku.*)

Ardian Turku – Falemnderit, zoti Ministër!

Zoti Basha, urdhëroni!

Lulzim Basha – Falemnderit, zoti drejtues i seancës!

Të nderuar kolegë deputetë,

Do të bëj një përmbledhje të shkurtër të funksionimit të Komitetit Ndërministror të Emergjencës dhe Komitetit të Emergjencës në Shkodër, sipas kronologjisë, për t'ua lënë vendin pastaj, në raportime të veçanta, anëtarëve të këtij komiteti, kolegëve ministra, sipas fushave që ata kanë mbuluar.

Komiteti Ndërministror i Emergjencave u krijua më 6 janar me vendim të Këshillit të Ministrave, ndonëse funksionet e vërteta i filloi më 27 dhjetor dhe i vazhdoi gjatë gjithë ditëve në vijim, duke veçuar këtu datën 2 janar, kur në Shkodër u shpall emergjenca civile dhe u përcaktuan strukturat përkatëse sipas ligjit. Pas mbledhjes së Qeverisë, më 6 janar pasdite u mblodh për herë të parë Komiteti Ndërministror i Emergjencave Civile dhe vendosi krijimin e një qendre të bashkuar operacionale në Ministrinë e Brendshme, me përfaqësues të përhershëm nga të gjitha ministrinë e linjës dhe institucionet e përfshira në përballimin e situatës emergjente. Detyrë e Qendrës së Bashkuar Operacionale ishte të mblidhte informacionin në kohë reale dhe ta përcillte këtë informacion në çdo tri orë, të përditësuar, për Komitetin Ndërministror dhe anëtarët e tij. Në funksion të kësaj, çdo ministri e linjës dhe çdo institucion varësie përcaktoi personat përgjegjës dhe mjetet e kontaktit për çdo informacion të detajuar

pranë Qendrës Operacionale.

Ministritë e linjës paraqitën në Komitetin Ndërmintoror planet e azhurnuara të masave të secilit prej këtyre dikastereve, të përshtatura me situatën aktuale dhe me zhvillimet e ditëve në vijim, si dhe informacionin mbi burimet njerëzore e materiale të gatshme operacionale dhe gati për t'u futur në veprim, bazuar në secilin prej skenarëve të mundshëm të përshkallëzimit të situatës së emergjencës. Për veçoritë e situatës së krijuar lindi si i nevojshëm bashkëpunimi i ngushtë dhe permanent i anëtarëve të Komitetit Ndërmintoror, të cilët, që prej ditës së nesërme e deri në përfundim të situatës, vendosën që mbledhjet e këtij komiteti t'i zhvillojnë në Shkodër, si dhe monitorimin e situatës në terren dhe veprimet operacionale t'i bashkërendojnë me prezencën fizike të anëtarëve të këtij komiteti në Shkodër.

E njëjta gjë vlejti edhe për drejtuesit e strukturave në varësi, të cilët u ngarkuan me detyra specifike për të monitoruar, verifikuar dhe drejtuar problematikën e dalë në terren. Në këtë mbledhje u vendos edhe për përcjelljen e informacionit të shpejtë, transparent e të qartë për opinionin publik, të rifreskua 2-3 herë në ditë apo sipas ngjarjeve.

Në kulmin e emergjencës, niveli maksimal i baseneve paraqitej si më poshtë:

Fierza 293,23 metra; Komani 174,97 m dhe Vau i Dejës 75,68 m. Niveli maksimal i prurjeve në Fierzë ishte 1800 metra kub për sekondë, në Koman 760 metra kub për sekondë, në Vaun e Bejës 300 metra kub për sekondë. Niveli maksimal i prurjeve ishte 2860 metra kub për sekondë, ndërsa shkarkimet maksimale në Vaun e Dejës ishin 2465 metra kub për sekondë. Totali i derdhur vetëm nga kaskada e Drinit ishte 2 miliardë e 103 milionë e 232 metra kub. Kësaj i shtohen edhe prurjet nga liqeni i Shkodrës dhe burimet hidrike që furnizojnë këtë liqen si dhe prurjet e tjera atmosferike nëntokësore apo ujore, me një total të përlllogaritur në 2,6 miliardë metra kub.

Statistikat e situatës në kulmin e emergjencës ishin: 11 mijë e 400 hektarë të përmblytur, 2649 shtëpi të përmblytura ose në praninë e ujit, 5173 banorë të evakuuar, 13 645 banorë të transportuar, 1118 krerë bagëti të trasha dhe 7804 dele të evakuara.

Infrastruktura parësore dhe sekondare paraqitej si vijon: ultësirat e komunave Dajç, Ana e Malit, Bërdicë, Shkodër, Bushat, Velipojë, Gur i Zi, të rrezikuara ose jashtë përdorimit të ujit të pijshëm;

ndërprerja e qarkullimit në akset rajonale, komunare, të cilat gjendeshin nën ujë në Bashkinë Shkodër; në rrugën nacionale, Harkun e Bërdicës, rrugen e Dajçit, rrugen e Velipojës, rrugën e Anës Malit, Darragjatit, Çamrishtit, Shirgjit etj.; dëmtime në argjinaturën e lumit Buna në Darragjat, Çamrisht, Dajç, Shirgj; dëmtim në argjinaturën e Çasit dhe ndalimi i punës në hidrovorin e Çasit.

Përballë kësaj situatë emergjente, Komiteti Ndërmintoror vendosi këto prioritete: 1. Mbrojtjen e jetës së qytetarëve. 2. Evakuimin e suksesshëm i banorëve të rrezikuar. 3. Strehimin dhe kujdesin për banorët e evakuar dhe ata të rrezikuar. 4. Furnizimin e gjithë popullsisë së rrezikuar me artikuj ushqimorë, ujë, çadra, çizme, pelerina, medikamente mjekësore dhe mjete të tjera. 5. Mbrojtjen dhe riparimin i argjinaturave, mbrojtjen dhe mbajtjen hapur të kanaleve kulluese dhe kolektorëve, hidroforëve, si dhe funksionalitetin e plotë të tyre dhe të të gjitha kapaciteteve thithëse dhe shkarkuese. 6. Furnizimin me energji elektrike dhe garantimin e sigurisë publike, të gjendjes shëndetësore dhe mbajtjen funksionale të arterieve të akteve kombëtare. 7. Evakuimin e gjësë së gjallë dhe mbështetjen e blegtorisë me ushqim, medikamente etj.

Nën drejtimin e Komitetit Ndërmintoror u mobilizuan 3542 forca të mbështetura edhe nga popullsia, duke përfshirë këtu Forcat e Armatosura, Policinë e Shtetit, Ministrinë e Bujqësisë, Shëndetësisë, Punëve Publike, KESH-it, Institutin Gjeodezik dhe njësitë vendore, komisionet e emergjencave të prefekturës së Shkodrës, Drejtorisë së Emergjencave Civile të Ministrisë së Brendshme, të detajuara si më poshtë:

Komiteti Ndërmintoror 30, Komiteti i Emergjencave Civile të Shkodrës 32; Këshilli i Qarkut Shkodër 100, Bashkia Shkodër 300, Komuna Bushat 50, Ana e Malit 128, Dajç 50, Gur i Zi 38, Bërdicë 50, Velipojë 120, Rrethina 25 dhe Malësi e Madhe 25. Për një raport më të hollësishëm të numrit të forcave, mjeteve dhe llojeve të operacioneve të forcave të Armatosura do të raportojë ministri i Mbrojtjes. Ministri i Bujqësisë do të raportojë mbi aktivitetet e bordit të kullimit dhe forcimit të argjinaturave, kurse ministri i Punëve Publike do të informojë për aktivitetet e Drejtorisë Rajonale të Rrugëve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

Nga strukturat e Policisë së Shtetit janë angazhuar 579 forca, nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Shkodër dhe Tiranë, Policia e Kufirit, forcat

e Ndërhyrjes së Shpejtë Tiranë, Fier, Shkodër, Forcat RENE A dhe DELTA. U angazhuan 60 automjete, 6 mjete lundruese dhe 3 helikopterë. Veprimet operacionale kanë qenë të përqendruara në zonat më problematike, si fshatrat e Komunës Dajç, Obot, të Komunës Ana e Malit, në fshatin Mali i Jushit, Hoten, Trush i Poshtëm, të Komunës Bushat, në fshatrat Luaz e Ças, të Komunës Velipojë, në disa fshatra të Komunës Bërdicë, në fshatrat Kuç e Rrenc, të Komunës Gur i Zi, në lagjet periferike Ajasëm, Baçallëk e Livade. Në të gjitha fshatrat dhe komunat e përmbytura janë dislokuar forca policie dhe është caktuar për çdo komunë një oficer kontakti, për çdo kryeplak dhe për çdo ujësjellës është caktuar një punonjës policie.

Po kështu, janë organizuar operacione për sigurimin e rendit dhe të sigurisë rrugore dhe pronën e shtetasve në kthesën e Dajçit, në Urën e Shirgjit, në Malin e Jushit, në Bishtin e Jukës, në stacionin e ujësjellësit të qytetit, në lagjen Kiras dhe në Harkun e Bërdicës. Gjatë operacioneve të kryera nga forcat e rendit janë evakuar 2 314 persona dhe 1 858 krerë bagëti, nga të cilat 910 lopë, 590 të imta, 322 derra, 36 njëhundurakë.

Në Komunën Ana e Malit evakuimi dhe transporti i mallrave ushqimore është bërë vetëm me mjete lundruese nga ana e policisë, me një tanker, një skaf dhe dy gomone. Nga fshati Obot janë evakuar 260 shtetas dhe 256 krerë bagëti. Në datën 5 janar janë dërguar 5 tonë ndihma dhe janë shpërndarë në fshatin Obot në prezencën e policisë. Në fshatin Boriç janë dërguar 2,5 tonë ushqime, 1,5 tonë pako ushqimore dhe 1 ton ujë. Për Komunën Dajç, janë dërguar 2 tonë ndihma, në fshatin Gramsh 5 tonë ndihma, 1200 litra karburant, 1000 bukë, 3 tonë ujë, 200 palë çizme dhe 30 çadra.

Në katër raste, në fshatin Obot janë transportuar për në spitalin rajonal 4 shtetas. Janë transportuar 6 ekipe mjekësore të huaja dhe vendase për në Komunën e Dajçit dhe fshatin Obot, janë shoqëruar pranë lumit Buna 4 ekipe specialistësh të huaj për të eksploruar shtratin e tij. Në një ceremoni varrimi janë transportuar me mjete lundruese nga Murrigani në Dajç dhe anasjelltas 367 shtetas, është bërë çdo ditë ndërrimi i turnit të ekipit mjekësor nga Murrigani në Dajç. Qysh nga data 14 ka filluar transporti i shtetasve nga Murrigani në Obot, ku janë rikthyer në banesa rreth 100 persona, me tre tonë ushqime dhe bazë ushqimore. Në Komunën Dajç janë evakuar 1328 persona dhe 402 krerë bagëti, nga të cilat 270 lopë dhe 132 të imta; në Bërdicë

220 persona, 670 krerë bagëti, nga të cilat 370 lopë dhe 300 të imta; në Bushat, nga efektivat e policisë janë evakuar 300 persona, 530 krerë bagëti, nga të cilat 100 lopë, 98 të imta, 302 derra dhe 30 njëhundurakë; në Komunën Gur i Zi, janë evakuar nga policia 94 persona; në lagjet e qytetit 112 persona. Vetëm në Murrigani janë vepruar 4 mjete lundruese të policisë, një tanker, një skaf dhe 2 gomone, të cilat kanë realizuar transportin nga Murrigani në Dajç dhe Obot. Po kështu, në një lagje të përmbytur të qytetit ka vepruar një gomone e forcave DELTA.

Në të gjitha fshatrat dhe komunat janë dislokuar forca policie. Përveç ndërlikohësve të caktuar për 24 orë dhe të ndërruar me turne për secilin prej kryetarëve të Komunës, në mënyrë që linjat e komunikimit të ishin në mënyrë permanente të hapura, për çdo kryeplak ka qenë i vendosur një punonjës policie dhe për çdo ujësjellës në zonat e përmbytura është caktuar një punonjës policie. Konkretisht, vendosja e forcave të policisë sipas komunave është: Bashkia Shkodër 32 punonjës policie; në lagjet Baçallëk, Kiras, Tophanë dhe Ajasëm; në Dajç 72; Velipojë 11; Bërdicë 38; Ana e Malit 34; Bushat 31; Gur i Zi 31; rrethina 5; Hajmel 5. Efektivat e policisë, gjithsej 80 punonjës, janë angazhuar në procesin e mbushjes, transportit dhe vendosjes së thasëve në forcimin e argjinaturave në fshatrat Velaj, Dajç, Shirgj, Samrisht, Darragjat e Gramsh, duke përdorur 4 kamionë. Është mbajtur kontakt i vazhdueshëm me efektivat e angazhuar në zonat e përmbytura, duke marrë informacion mbi situatën dhe nevojat e banorëve në këto zona dhe duke bashkëpunuar me shtabet lokale të emergjencës për zgjidhjen e problemeve.

Në të gjitha rastet ku janë marrë informacione për banorët në nevojë është ezauruar ky informacion nëpërmjet dhënies së ndihmës nëpërmjet dy dhomave operacionale të Forcave të Armatosura dhe të policisë pranë prefekturës Shkodër. Është realizuar shoqërimi i autokolonave me ndihma të ardhura gjatë ditës. Krahas efektiveve të angazhuara me shërbim në këto zona, me qëllim sigurimin e rendit dhe qetësisë publike dhe parandalimin e goditjen e krimit, në Qarkun e Shkodrës janë shtuar dhe dubluar shërbimet e policisë për ruajtjen e rendit dhe qetësisë dhe për parandalimin e veprave kriminale. Janë marrë masat e nevojshme dhe është bërë shoqërimi i personalitetëve të larta shtetërore dhe të huaja, të ardhura në qytetin e Shkodrës, si gjatë lëvizjes në qytet edhe në zonat e përmbytura,

duke bashkëpunuar ngushtë me Gardën e Republikës dhe me grupet e shoqërimit. Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit ka angazhuar në operacione humanitare 125 vetë. Janë vënë në dispozicion të operacioneve humanitare 350 tonë ushqime, 332 tonë ujë i pijshëm, 13 tonë detergjente, 54 tonë koncentre dhe 51 tonë kashtë, duke përfshirë ushqimin e kafshëve, për të cilin do ta raportojë ministri i Bujqësisë.

Sipas të dhënave të njërive të qeverisjes vendore, rezultojnë të shpërndara këto materiale: artikuj ushqimorë 305 tonë, ujë i pijshëm 130 tonë, detergjentë dhe sapunë 12,6 tonë, koncentre 135 tonë. Sipas Bashkisë Shkodër dhe komunave informacioni është i detajuar dhe disponibël në faqen e internetit të Ministrisë së Brendshme.

Donacione nga shtete dhe organizata ndërkombëtare: Qeveria italiane dërgoi 3 helikopterë, 20 pompa thithëse uji, 15 gjeneratorë, koli biskotash 720, gomone shpëtimi 6, çadra strehimi 87, thasë lini 19 200 copë etj. Qeveria e Moldavisë dërgoi 40 tonë mallra ushqimore, 3 thithëse uji, 4 gjeneratorë, 5 paketa mjekësore dhe 3 mijë 340 pako. Qeveria greke solli mallra ushqimore 5 tonë, pompa thithëse uji dhe një gjenerator. Qeveria e Sllovakisë, 1 gjenerator me kapacitet 15 kw dhe 5 me kapacitet 10 kw, 3 pompa uji, 1290 paketa ilaçe, 200 kostume zhytjeje, veshje 1000. Maqedonia 17 gjeneratorë, 4 varka shpëtimi, pompa uji 12, skuadra shpëtimi me 47 persona, mjete të tjera 4, çadra 8. Turqia 15 gjeneratorë, ushqime 7,2 tonë, gjeneratorë të lëvizshëm 15. Ilaçet do të jenë nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Shëndetësisë. Qeveria e Austrisë solli 5 pompa uji, 8 gjeneratorë të lëvizshëm; Qeveria e Francës 11 pompa uji; Qeveria e Kroacisë 25 tonë karburant, Qeveria e Kosovës 2 skuadra shpëtimi, ndihma materiale dhe financiare, që do të specifikohen nga ministri i Financave, Sllovenia 13 gjeneratorë të lëvizshëm, një ekspert shpëtimi dhe emergjencash nga OKB-ja dhe 240 mijë dollarë nga delegacioni i PNUD-it në Tiranë.

7 ekspertë shpëtimi emergjence erdhën nga Qendra e Emergjencave të BE-së, 1000 veshje nga Kryqi i Kuq Italian, 50 mijë dollarë nga SHBA-ja për Kryqin e Kuq Shqiptar, 25 tonë mallra ushqimore nga Dhoma Ekonomike e Kosovës, 20 tonë mallra ushqimore, 1,2 tonë detergjentë, 45 koli oriz nga komuna Prizren, 1,2 tonë mallra ushqimore nga Komuna Ferizaj, 2 barka me 40 kuaj fuqi nga Mbretëria e Belgjikës, 3 tonë medikamente po nga Mbretëria e Belgjikës dhe një numër i madh

ndihmash nga donacione të ndryshme të vendit, të kaluara përmes Rezervave të Shtetit, të reflektuara në pasqyra që përditësohen dhe për hir të mospërditësimit të sotëm, nuk po e përmend listën.

Për shpërndarjen e konцентratit për bagëtitë, siç ju thashë, është raporti i ministrit të Bujqësisë dhe po kështu dëshiroj të specifikoj se nga strukturat e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes ka pasur të angazhuar në vijimësi 50 persona që kanë furnizuar 18 abonentët nga 6 nënstacione elektrike. Furnizimi me energji elektrike ka qenë pa ndërprerje në 96% të numrit të abonentëve dhe sot në 100% të numrit të abonentëve

Për angazhimin e strukturave të shëndetësisë do të raportojë ministri i Shëndetësisë.

Situata në rrethin e Shkodrës sot paraqitet si më poshtë:

Sipërfaqe të përmbytura 5499 hektarë, shtëpi të rrethuara nga uji 1103, banorë të mbetur në praninë e ujit, banorë të mbetur në evakuim 1825 vetë.

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Gjatë mbledhjes së fundit të Komitetit Ndërmënor u ndanë detyra specifike për të vazhduar operacionet me prioritetet e përcaktuara qartë për t'i zgjeruar ato sipas porosive të Kryeministrit. Në veçanti, porosi u dhanë për planifikim intensiv të fazës së dytë të përgjigjeve, për sa i përket evakuimit në zonat më problematike: në Velipojë, Mali i Jushit dhe në Ças; furnizimin e pandërprerë të popullsisë me ujë të ambalazhuar dhe kontrollin e pandërprerë të puseve, të ujës jellësve, për të lejuar përdorimin e ujit në momentin që ai konsiderohet i sigurt; furnizimin e pandërprerë të popullsisë me konцентrat dhe ushqim bagëtitish, për të mos lejuar asnjë pakësim të rezervave ushqimore në dispozicion të bagëtive të evakuara dhe atyre në zonat e rrezikuara. Po kështu u lanë detyra për të vazhduar më tej me ato aspekte të emergjencës, të cilat kanë të bëjnë me prioritetet afatmesme, siç është procesi i thellimit të Bunës, i thellimit të kanalit të Velipojës, i përfundimit të hidrovorëve, i përfundimit të kapaciteteve thithëse dhe shfryrëse në zonat ku uji ka arritur thellësi të konsiderueshme, si dhe mbështetja e gjithanshme e popullsisë me ushqime, medikamente etj.

Në përfundim të këtij informacioni të përmbledhur, siç e thashë, më i detajuar do të jetë sipas anëtarëve të Komitetit Ndërmënor.

Si ministër i Brendshëm përfitoj nga rasti që të falënderoj, në veçanti, drejtuesit e pushtetit lokal, prefektin e Shkodrës, zotin Maxhit Cungu, kryetarin

e qarkut, zotin Gjovalin Kolombi, kryetarin e Bashkisë së Shkodrës, zotin Lorenc Luka, kryetarin e komunës Bushat, zotin Zef Hila, kryetarin e Komunës Ana e Malit, zotin Arben Çeni, kryetarin e Komunës Dajç, zotin Arben Gjura, kryetarin e Komunës Guri i Zi, zotin Bros Marku, kryetarin e Komunës Bërdicë, zotin Qamil Gjureta, kryetarin e Komunës Velipojë, zotin Nikollë Markut, në rrethinat përreth, zotin Gëzim Hardolli, në Malësinë e Madhe, zotin Isa Ramaj, të cilët gjatë gjithë kësaj emergjence janë gjendur 24 orë në krye të detyrës, duke neglizhuar çdo angazhim personal në shërbim të qytetarëve.

Falemnderit!

Ardian Turku – Falemnderit, zoti Basha!

Ju folët dhe në cilësinë e kryetarit të Komitetit Ndërmëntor.

Fjalën e ka zoti Ruli, ministër i Bujqësisë, gjithashtu dhe anëtar i këtij komiteti.

Genc Ruli – I nderuar zoti drejtues i seancës, Të nderuar kolegë deputetë,

Ministria e Bujqësisë dhe i tërë sistemi i saj u ndodhën përballë fenomenit të reshjeve dhe të përmblytjeve që në momentet e para, ndoshta që në fund të nëntorit dhe më tej me angazhimin edhe më impenjues, në kuadrin të situatës së emergjencës që u shpall nga Qeveria në fillim të janarit 2010.

Sigurisht që dinamika e fenomenit të përmblytjeve u zhvillua pothuajse në mënyrën më të dukshme, sidomos pas datës 25 dhjetor të vitit të shkuar, ku në mënyrë pothuajse të pandërprerë deri në datën 10 janar, vendi ynë ka qenë i përfshirë nga një mot me reshje të vazhdueshme, më të larta sesa mesatarja 20-vjeçare e reshjeve për të njëjtën periudhë të vitit, me temperatura tepër të larta dhe jo të zakonshme në fillim të dimrit, shoqëruar kjo me një shkrirje masive të borës në zonat e Alpeve, që kryesisht u shkarkua në pellgun mbledhës të Drinit dhe të lumenjve të tjerë që derdhen në zonën e Nënshkodrës.

Deri në datën 7 janar ne patëm një nivel shkarkimesh në hidrocentralin e Vau të Dejës prej 1300 metër kub ujë në sekondë dhe sipërfaqja e përmblytur deri në këtë moment ishte rreth 3500 hektarë. Në vijim, me rritjen e shkarkimeve, për shkak dhe të rritjes së prurjeve deri në 2500 metër kub ujë në sekondë nga Vau i Dejës, kjo kryesisht në datat 12-14 janar, sipërfaqja maksimale e përmblytjes arriti deri në 11 mijë e 400 hektarë.

Niveli maksimal i prurjeve në kaskadën e Drinit arriti në një shifër rekord prej 2800 metër kub ujë në

sekondë.

Në dallim nga përmblytjet e mëparshme, duke marrë përmblytjet më të fundit, të krahasueshme me vitin 2004, kjo përmblytje pati edhe një karakteristikë tjetër: tejzgjatjen e saj në kohë në krahasim me to.

Sot, për shkak të ndërprerjes së reshjeve dhe të shkarkimeve në të gjithë kaskadën e Drinit dhe të lumenjve të tjerë që derdhen në këtë basen ka filluar rënia e nivelit të ujit, pra e sipërfaqeve të përmblytura dhe deri më sot kemi vetëm 6500 hektarë tokë të përmblytur, që vazhdon të zvogëlohet me shpejtësi nga dita në ditë. Sipërfaqja e mbjellë brenda kësaj sipërfaqe të përmblytur, me nivelin maksimal prej 11 mijë e 400 hektarë ishte rreth 5 mijë hektarë.

Masat e marra nga institucioni që unë drejtoj:

Që në momentin e paralajmërimit të shkarkimeve të larta në hidrocentralin e Vaut të Dejës, të gjitha strukturat e ministrisë, sidomos strukturat rajonale, bordi i kullimit dhe Drejtoria Rajonale e Bujqësisë u angazhuan menjëherë për përbalimin e kësaj situatë. Për më tepër, në kuadrin e veprimit të Komitetit Ndërmëntor të Emergjencave Civile, strukturat tona arritën të hartojnë dhe të miratojnë në kohë planin specifik të masave, të ndërhyrjeve paralele, ndërkohë që në vetvete skenari i përmblytjes zhvillohej. Dua të theksoj se që në fillim të sezonit të shirave, në muajin tetor, kemi marrë masa rigorozë duke lëshuar edhe urdhra me shkrim për të siguruar rritjen e sigurisë së digave, duke mbajtur nivelin në të gjitha digat e rezervuarve ujëmbledhës që shërbejnë për vaditje në Shqipëri në kuota minimale, ose në disa raste edhe të zbrazura; aty ku digat kishin probleme të rrjedhjes së tyre, garantimin e kullimit duke bërë kontrollin, por dhe punimet në kanalet kryesore kulluese në këtë periudhë të parë të vjeshtës; ruajtjen e qëndrueshmërisë së argjinaturave dhe mbajtjen në gatishmëri të hidrovoreve.

Në zonën e Nënshkodrës, me fillimin e shkarkimeve, vëmendja u përqendrua kryesisht në mbikëqyrjen moment pas momenti të argjinaturave të të gjitha veprave, si dhe të kolektorëve kryesorë kullues, dhe në funksionimin e dy hidrovoreve kryesore të kësaj zone, duke lëvizur mjetet dhe teknikën tonë sipas rastit nga njëri vend në tjetrin. Falë ndërhyrjeve që kemi bërë në kohë, si reagim të momentit, së bashku me strukturat e ushtrisë dhe ndihmesën që dhanë banorët e komunave dhe të bordit të kullimit në Shkodër, u bë e mundur që

të gjitha këto argjinatura të rezistonin dhe të mos shkatërroheshin, ndonëse kanë qenë të projektuara për prurje maksimale të lumit Bunë, vetëm rreth 2 mijë metër kub ujë në sekondë. Ky ka qenë niveli teknik i sigurisë për të cilat ato janë projektuar. Ndërsa në realitetin e këtyre përmbajtjeve prurjet maksimale në Bunë arritën në rreth 4 mijë-4 mijë e 500 metër kub ujë në sekondë. Ndërhyrjet e mëpasshme në argjinatura, sidomos në Komunën Dajç, në Samërisht, në Daragjat, janë kryer duke bërë mbilartësimin e tyre dora-dorës, teksa uji rriste nivelin, e në të njëjtën kohë duke riparuar pjesët e dëmtuara të tyre.

Në argjinaturën e Çasit uji arriti ta kapërcejë, duke shkaktuar edhe një çarje të pjesshme të saj, pavarësisht përforcimeve që po bënim me emergjencë në bashkëpunim me strukturat e ushtrisë. Kjo argjinaturë faktikisht nuk e luan më funksionin e saj mbajtës dhe për momentin edhe hidrovari i Çasit qoftë për shkak të përmbajtjes, qoftë për shkak të barazimit të nivelit të ujërave në të dyja fushat që ai ndan, është i bllokuar dhe pritet të vihet në punë.

Me pakësimin e shkarkimeve në Vaun e Dejës niveli i ujërave po bie me shpejtësi dhe po lirohen mjaft nga sipërfaqet e përmbytura. Lumi i Bunës po zbrit në shtratin e tij normal dhe faktikisht janë ndërprerë edhe shkarkimet në fushën e Dajçit. Për më tepër, hapja momentale e rrugëve rurale na ka mundësuar që t'i bëjmë në mënyrë më intensive ndërhyrjet me teknikën tonë kudo që janë vënë re probleme dhe dëmtime të argjinaturave mbrojtëse.

Faktikisht, duke e quajtur të kapërcyer fazën e emergjencës dhe të përgjigjes së menjëhershme ndaj emergjencës, ne kemi filluar planin e rehabilitimit, si faza e dytë e sistemit të kullimit dhe të argjinaturave mbrojtëse të zonës, duke pasur si objektiv që brenda pak javësh të kthejmë të gjithë sistemin e mbrojtjes nga përmbytja dhe të kanaleve të kullimit e të gatishmërisë së hidrovoeve në gjendjen që kishin para përmbajtjes, gjithmonë duke pasur kujdesin me reshjet e pranverës, që mund të jenë prapë përballë.

Objektivi i dytë i këtyre masave, gjatë fazës së rehabilitimit, është që të sigurohet kullimi sa më i shpejtë i të gjithë zonës. Një pjesë e madhe e zonës brenda pak ditësh do të kullojë për shkak dhe të vetë gravitetit, por në zonë ka dhe xhepa, kullimi i të cilëve do të mundësohet vetëm nëpërmjet hidrovoeve, fuqizimit të tyre dhe thellimit të menjëhershëm të kanaleve kulluese.

Sigurisht që plani më madhor është plani që do të zhvillohet jashtë kuadrit të krizës së emergjencës dhe do të synojë jo vetëm normalizimin e të gjitha sistemeve mbrojtëse dhe kulluese të fushës së Nënshkodrës, të Lezhës, por edhe të Vjosës, që janë zonat më të rrezikuara, por dhe një përmirësim cilësor të standardeve të garancisë dhe të sigurisë që duhet të kenë këto vepra kulluese dhe mbrojtëse.

Një problem të cilit i kemi kushtuar shumë vëmendje gjatë kësaj periudhe ka qenë gjendja e blegtorisë dhe masat për mbrojtjen e kafshëve në periudhën e përmbajtjes, duke pasur parasysh se kjo është një zonë intensive e prodhimit bujqësor dhe blegtoral, duke pasur parasysh edhe devotshmërinë që treguan këta banorë për të shpëtuar krahas jetëve të tyre dhe të familjeve të tyre, edhe jetën e kafshëve. Pa dyshim që ishte një detyrim imediat për ne që t'u siguronim atyre atë që u mungonte: bazën ushqimore për të mbajtur bagëtinë. Në ditët e përmbajtjes, krahas transportit shumë të vështirë, shpeshherë me varka dhe helikopterë, të ushqimeve dhe ujit, si nevojë prioritare e këtyre banorëve të izoluar, ne dërguam edhe në zonat më të izoluar rreth 350 tonë koncentrat, si dhe mbi 120 tonë ushqime të tjera për bagëtinë.

Në bazë të vlerësimit që u kemi bërë nevojave ushqimore edhe për periudhën pas përmbajtjes (nga ne janë llogaritur rreth 120 ditë), mendojmë se do të nevojiten rreth 760 tonë koncentrat dhe rreth 2900 tonë ushqime të llojeve të tjera. Në këto momente, drejtoritë e bujqësisë po identifikojnë se ku mund të gjenden këto sasi, si dhe po marrin masa për kontraktimin dhe magazinimin e tyre.

Për sa u përket përmbajtjeve në zonën e Lezhës, këtu situata u paraqit më e favorshme, ndonëse rreziku ishte në momentet e para, sidomos në datën 28 dhjetor, ku patëm një baticë të madhe të detit, ku uji i tij vërshoi furishëm dhe arriti të shkatërrojë edhe digën e hidrovarit të Tales, duke rrezikuar të përmbyste me ujë të kripur rreth 3000 hektarë të fushës së Lezhës. Nga ndërhyrja deri dhe heroike qoftë e trupave të ushtrisë, por edhe e subjekteve private që treguan solidaritetin dhe gatishmërinë për të ndihmuar, u arrit shmangia e këtij rreziku. Përballimi deri në këtë nivel i situatës së përmbajtjeve në këtë zonë, sigurisht, nuk ka qenë vetëm rastësor dhe nuk ka ardhur vetëm për shkak të përmbajtjes së faktorëve natyrorë, por kanë qenë edhe investimet madhore të kryera në periudhën 2006-2009, që për nga vlera janë pothuajse njësoj me ç'është investuar në 8 vjetët e mëparshëm në

sistemet e kullimit dhe në hidrovorë. Të shumta janë argjinaturat e rehabilituara dhe të bëra nga e para. Thellimet në lumenjtë Kir, Gjadër, Bunë, Drin, Mat dhe të kanaleve të ujërave të larta e të kullimit, rinovimi i teknikës në pjesën më të madhe të hidrovorëve, bënë që përmbytja të shfaqet vetëm në këto përmasa. Në rast të kundërt, pa këto investime, përmasat e përmbytjes do të kishin qenë disa herë më të mëdha.

Do të desha të theksoja edhe diçka. Pasojat tashmë të dukshme të ndryshimeve të mëdha klimatike në globin tonë, vlerësimi i situatave të tilla të jashtëzakonshme, sikundër ishte kjo përmbytje e fundit, rastësia probabilitare e kombinimit në kohë dhe në hapësirë të një morie faktorësh natyrorë riskues që shkaktojnë jo vetëm përmbytje, por edhe shumëfishojnë përmasat dhe dimensionet e tyre, na detyrojnë sot të fillojmë të rishikojmë sa më parë planin kombëtar të sigurisë nga ky fenomen, duke reflektuar saktësisht dhe shkencërisht praninë e njëkohshme të këtyre faktorëve të riskut dhe duke përcaktuar dhe zbatuar qartë standardet teknike më të larta të sigurisë sesa ato që kemi përdorur gjatë 80 vjetëve në projektimin e veprave tona të sistemeve mbrojtës dhe të kullimit. Ky është konkluzioni kryesor që duhej nxjerrë nga eksperiencia e kësaj përmbytje të fundit.

Do të më lejoni, zoti drejtues i seancës, që, duke u ndalur fare pak te ky argument, të deklaroja se ka qenë thellësisht e padenjë për integritetin profesional, fyese dhe e turpshme për mendjen dhe gjykimin racional, sharlatanizëm dhe papërgjegjshmëri për këdo që e quan veten politikan apo subjekt politik, lloji i analizave, i komenteve apo i skenarëve të shpëtimit nga përmbytja, që një tabor me zell ekstrem, me xhaketa profesionistësh apo politikanësh prodhoi dhe përmbyti opinionin publik dhe mendjen e shqiptarëve, madje duke bërë garë edhe me rrebeshin e natyrës.

Asnjëherë dhe për asnjë çast ky tabor, që Rama mobilizoi në përgjigje të përmbytjes, nuk guxoi të shikonte fenomenin në realitetin dhe përmasat në të cilat ai u shfaq, por, me parathënie fallxhorësh dhe hesape matematikore groteske, dha shpejt konkluzionin e stisur se përmbytja ishte qind për qind e shmangshme, përmbytjen e shkaktoi Qeveria dhe konkluzioni ishte: hajde të mbysim Qeverinë, pa le t'i lëmë për më vonë njerëzit në përmbytjen e tyre.

Faktorët u analizuan edhe nga kolegët parafolës dhe matematika, e cila do të gjykonte çdo mendje

të shëndoshë, për të parë sesa e beftë dhe mizore është nganjëherë forca e natyrës dhe si duhet të reagojmë ne ndaj saj, është për të thënë që 2 miliardë e 70 milionë metra kub ujë të shkarkuara nga të gjitha nivelet e kaskadës së Drinit në Bunë, që faktikisht përbëjnë 4 herë volumin e kupës së Vaut të Dejës, 5 herë atë të Komanit, apo gati nivelin e dobishëm të Fierzës, duhen marrë parasysht për t'iu përgjigjur argumentit: Si do të realizohej skenari i shpëtimit i propozuar në asamblenë e PS-së për të mos derdhur asnjë pikë ujë në Bunë? Vetëm me supozimin që Vau i Dejës të mbahej bosh, Komani të mbahej bosh dhe Fierza, kur filluan reshjet, të ishte jo më shumë se 275 metra?

Sigurisht, ky skenar është absurd, sepse kaskada është ngritur për një logjikë ekonomike dhe për një interes kombëtar që të sigurojë energjinë për kombin. Por edhe sikur ta pranionim këtë absurd, për t'i shkuar deri në fund absurdit të palës tjetër: Kur duhej të ishte bërë kjo zbrazje dhe si duhej të ishim paralajmëruar për të? Si dhe kush duhej të na kishte lajmëruar për këtë zbrazje? Sigurisht, zbrazja duhej të kishte filluar që në shtator, në mënyrë që të paktën në dhjetor të ishim në këto nivele që supozohet, të ishin bosh pjesa më e madhe e tyre.

Cili nga shërbimet sinoptike të botës, edhe më i sofistikuari, parashikoi që në Adriatik do të kishim baticat më të larta në 100 vjetët e fundit, që e rritën detin 2 metra dhe që krijuan një lloj cunami, një hyrje të fuqishme të valës së detit, e cila jo vetëm bllokoi lumenjtë, por hyri fuqishëm dhe dëmtoi edhe argjinaturat mbrojtëse në thellësi të tokës? Cili vallë do të parashikonte një temperaturë afrikane në fund të dhjetorit, që shkriu borën e rënë vetëm 10 ditë më parë? Cili vallë do të parashikonte pleksjen dhe shfaqjen në të njëjtën kohë të këtyre faktorëve, që natyra deri tani i ka lidhur bashkë vetëm një herë në shekull? Pra, në vetvete, absurdi i palës tjetër është më se evident.

Sigurisht, atmosfera e përmbytjes ndoshta na lejon të bëjmë edhe ndonjë krahasim, që ndonëse është alegorik, sidoqoftë, mendoj se nuk i mungon realizmi. Zoti Rama çdo ditë e më shumë po e ndrydh dhe po e fut PS-në dhe ndjekësit e saj në një platformë dhe në një gjendje politike absurde. Meqenëse jemi te përmbytja, ai ngjan me Noen e lashtë, patriarkun e dikurshëm, që grumbulloi të gjithë speciet dhe gjallesat në tokë dhe i futi në varkën legendare, për t'i shpëtuar nga apokalipsi. Dhe Noe vërtet ia arriti qëllimit të tij, sepse ishte edhe i urtë, edhe i mençur.

Zoti Rama, kujdes varkën! Së pari, sepse nuk je Noe dhe s'je as i urtë, as i mençur. Së dyti, nuk je nga ajo racë kapitenësh, që kur varka është në rrezik, rri i fundit dhe shpëton të gjithë të tjerët. Përkundrazi!

Ju falemnderit! (*Duartrokitje*)

(*Ndërkohë, drejtimin e seancës e ka marrë zonja Topalli.*)

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Ruli!

Zonja Doda e ka fjalën. Pastaj Gëzim Dibra dhe Gjok Ulledaj.

Mesila Doda – Falemnderit, zonja Kryetare!

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Seanca e sotme vjen pas një prove tejet të madhe, me të cilën vendit iu desh të përballej, me katastrofën e madhe natyrore që solli moti i keq në Veri të vendit. Kur them katastrofë mendoj se këtu është rasti të ndalemi pak dhe të reflektojmë mbi shprehjen: "Kur Zoti flet, njeriu hesht". Ndoshta kjo periudhë e zhvillimit njerëzor, e cila është shënjuar fort nga mendjemadhësia njerëzore, do të na sjellë shpesh e më shpesh para syve tablo të tilla si shenja apokaliptike të asaj që vetë njerëzimi po ia ndërson vetes, prishjen e një ekuilibri mijëravjeçar mes njeriut dhe habitatit të tij natyror.

Ky fakt duhet të na bëjë të gjithëve më të ndjeshëm për ruajtjen e këtij ekuilibri dhe që të kuptojmë se ruajtja e mjedisit ku ne jetojmë ka vetëm një kusht për vazhdimin e ekzistencës së tij, respektimin e natyrës në çdo formë të shfaqjes së saj, që nga pastërtia e mjedisit dhe ujërave, nga ruajtja e maleve, pyjeve dhe bimësisë, deri te respektimi i çdo forme të jetës bimore dhe shtazore që plotëson habitatin tonë natyror.

Për këtë arsye politikat tona qeverisëse do të duhet të kenë një vëmendje të jashtëzakonshme ndaj mjedisit dhe së bashku me institucionet përkatëse qeverisëse të paraqesin një paketë masash lidhur me respektimin dhe pastërtinë e ujërave tanë, të masave që duhet të merren ndaj industrisë që emeton sasi gazesh helmuese, masa që parashikojnë një pyllëzim të ri të maleve dhe bjeshkëve, të cilat janë prerë në mënyrë kriminale gjatë gjithë këtyre viteve dhe, mbi të gjitha, një plan të qartë, i cili do të krijonte mundësinë e zgjidhjes së përhershme të problemit të përmytjeve në ultësirën tonë veriperëndimore.

Duke thënë këtë do të më duhet të sjell sot në vëmendjen tuaj disa nga fenomenet e rëndësishme që u vërejtjen gjatë kësaj situatë të jashtëzakonshme dhe që sot mund dhe duhet të na

shërbejnë për të kuptuar më mirë njerëzit që na kanë dhënë ose jo votën, por, mbi të gjitha, të kuptojmë kërkesat e standardeve drejt të cilave rrekemi të afrohem çdo ditë.

Ajo çka të gjithë patëm rastin të vërenim në kontakt me banorët e zonës ishte zemërgjerësia dhe durimi i jashtëzakonshëm i shkodranëve, të cilët treguan jo vetëm maturi dhe mirëkuptim për situatën e krijuar, por u shfaqën mirënjohës për të gjithë vëmendjen e jashtëzakonshme që tregoi pushteti qendror dhe ai lokal. Sot mund dhe duhet të shprehim një falënderim të thellë për të gjithë këtë sjellje fisnike që treguan shkodranët.

Një solidaritet i thellë u shfaq nga të gjitha qarqet e vendit. Nga qarku i Fierit, qark të cilin unë sot e përfaqësoj në Kuvend, pati ndihma të konsiderueshme nga biznesmenët e qytetit, nga komuna e Divjakës, nga komunat e Kolonjës, Mbrostarit, Strumit, Krutjes dhe pothuajse nga të gjitha komunat e drejtuara nga Partia Demokratike, të cilat kanë dërguar dhe vazhdojnë të mbledhin ndihma dhe ushqim për blegtorinë për t'i dërguar në zonat e përmytura.

Sot gjej rastin t'i falënderoj të gjithë dhe të nënvizoj këtë tipar të jashtëzakonshëm të shqiptarëve, solidaritetin e pakufi në raste të tilla. Kjo do të thotë që ne gjithmonë mund të besojmë në ndjenjat fisnike të këtyre njerëzve dhe është detyra jonë, e politikës, që të mendojmë të nxisim këtë frymë bashkëpunimi dhe dashamirësie, që kjo të mos shfaqet vetëm në raste të jashtëzakonshme, por të kthehet në sistemin tonë të komunikimit, në sistemin tonë të vlerave, pasi mbi të gjitha ne jemi njerëz dhe shqiptarë.

Nuk ka ndjesi a mendje të mbrapshtë që do të mund të zhbëjë faktin se ne jemi të gjithë shqiptarë dhe se nuk jemi të ndarë në veriorë apo jugorë, të djathtë apo të majtë, të gjithë jemi një. Cilido që punon kundër kësaj ndjesie të thellë të unitetit tonë kombëtar është i destinuar të jetë humbës dhe i turpëruar nga historia e këtij kombi.

Të nderuara zonja dhe zotërinj,

Pa dyshim që kjo periudhë ka shënuar një standard të ri në menaxhimin e situatave kritike. Katastrofa që ndodhi ishte shumë serioze, por, për fat, nuk patëm asnjë jetë njeriu të humbur dhe për të gjithë këtë merita i shkon Qeverisë së vendit, që bëri të mundur një menaxhim jashtëzakonisht të suksesshëm të situatës. Kjo shënoi një standard të ri në jetën e vendit, shënoi standardin europian të menaxhimit të situatave të katastrofave natyrore dhe

dha para shqiptarëve shembullin e një përkushtimi dhe aftësie të madhe në drejtimin e momenteve kritike. Sot 800 mijë shqiptarë që votuan këtë koalicion kanë mundësinë të ndihen mirë për kalimin me sukses të kësaj prove.

Përkundër kësaj historie suksesi, sakrifice, bashkëpunimi dhe solidariteti sot kemi një grusht mjeranësh që po mundohen të shtrëngojnë radhët e brigadave të kuqe pranë komandantit të tyre pengmarrës. Kurrë në historinë e demokracisë shqiptare nuk kemi pasur një grup të marrosurish që tentojnë të bëjnë shtet paralel dhe struktura paralele, që të shpërndajnë hamburgera e çizme për llogari të Edi Ramës. Kurrë në historinë e këtyre 20 vjetëve nuk kemi pasur deputetë kaq pa dinjitet që një ditë deklarojnë se do të marrin pjesë në një seancë të jashtëzakonshme për Shkodrën dhe të nesërmen pranojnë që kryetari i tyre të thotë të kundërtën. Turp për ata deputetë socialistë të Shkodrës që sot fshehin kokën si struci kur në këtë sallë diskutohet për fatkeqësinë që ra në derë të tyre!

Kjo politikë e ndarjes, e përdhosjes dhe tentativës për të shkatërruar çdo imazh pozitiv të Shqipërisë dhe shqiptarëve, për të minuar çdo arritje demokratike të këtyre 20 vjetëve, është shenja më e madhe e marrëzisë, e dëshpërimit dhe e ligësisë që ka kapluar këtë pjesë të politikës. Kjo është opozita shqiptare, që përballë kohës dhe përballë standardeve europiane që po dëshmojnë shqiptarët dhe maxhoranca, po tregon standarde të kohës së Haxhi Qamilit. I ftoj të gjithë votuesit e tyre që herën tjetër, kur të mendojnë t'i votojnë, të mendojnë këto standarde që ata kësaj radhe na treguan.

Falemnderit!

(Ndërkohë, drejtimin e seancës e ka marrë zoti Turku.)

Ardian Turku – Falemnderit, zonja Doda!

Fjalën e ka zoti Dibra.

Gëzim Dibra – Falemnderit, zoti drejtues i seancës!

Të nderuar kolegë,

Po e fillojmë këtë sesion të ri pa kaluar shumë ditë nga situata e rëndë e krijuar nga përmbytjet, peshë kjo shumë e madhe për të gjithë ata banorë të zonave të përmbytura, të cilët po e përballojnë këtë situatë me shumë urtësi, me shumë fisnikëri dhe ajo që është më e rëndësishme në bashkëpunim të gjithanshëm me strukturat e pushtetit lokal, me forcat e emergjencave civile, me ushtrinë, me policinë, me ndërhyrjen e shpejtë, me forcat

vullnetare të ardhura nga Kosova, Maqedonia, Italia dhe Greqia.

Këta banorë, me maturinë e tyre, nuk u bënë pre e tentativave keqdashëse që kërkonin të mbillnin panik në të gjithë qarkun e Shkodrës me teoritë e shpërthimit të digave, teori këto që i krijonin specialistët bolshevikë të PS-së. Por kjo nuk funksionoi dhe nuk ka për të funksionuar kurrë, sepse populli i Shkodrës e ka kuptuar problemin e digave politikisht dhe teknikisht, që digat nuk shpërthejnë sepse janë ndërtuar me parametrat e duhur dhe janë tunelet e shkarkimit të ndërtuara posaçërisht për mbrojtjen e digave në rast të rritjeve të shpejta të nivelit të ujit.

Përfitoj nga rasti të siguroj banorët e qarkut të Shkodrës se kjo situatë e rëndë nuk do të përsëritet më, sepse Qeveria do ta zgjidhë këtë problem jo me zgjidhje të pjesshme, por me projekte madhore, projekte këto që synojnë në zgjidhjen e problemit me tërë kompleksitetin e tij, që është shumëfishimi i konsumit të energjisë në vitet e fundit, varësia totale e prodhimit të energjisë nga hidrocentralet, ndryshimet klimaterike, krijimi i veprave të reja bonifikuese, përmirësimi i kapaciteteve shkarkuese të lumenjve, disiplinimi i ndërtimeve në zonat me rrezik përmbytjeje etj.

Nuk gaboj kur them se specialistët kanë filluar tashmë punën për këto projekte. Madje, krijimi i burimeve të reja energjetike, që do të ndikonte ndjeshëm në zgjidhjen e këtij problemi, ka kohë që ka filluar, sepse është një nga pikat kryesore të programit të Qeverisë. Tashmë janë nënshkruar kontrata për ndërtimin e shumë hidrocentraleve me kapacitete të ndryshme, për ndërtimin e parqeve eolike dhe po shikohet mundësia e krijimit të parqeve me panele fotovoltaike. Nuk po zgjatëm shumë, sepse e di që të gjithë këtu dëshirojnë të thonë dytri fjalë.

Në radhë të parë dua të falënderoj shumë gjithë banorët e zonave të përmbytura që me pjekurinë e tyre, me besimin te Qeveria dhe me bashkëpunimin që treguan u bënë shembull për të gjithë ne, duke filluar nga Qeveria dhe duke mbaruar tek ushtari më i thjeshtë. Dua t'i garantoj ata banorë se kjo makinë e fuqishme që Qeveria ngriti në këmbë për t'u ardhur në ndihmë, ashtu siç funksionoi me sukses në fazën e parë të shpëtimit dhe të shpërnguljes, kur realizoi me suksesin më të madh objektivin kryesor të shpëtimit të jetës së banorëve dhe siç po funksionon në fazën e shpërndarjes së ndihmave ushqimore për të dëmtuarit dhe bagëtitë e tyre, do të funksionojë

edhe në fazat e tjera që pasojnë, siç janë verifikimi dhe evidentimi i dëmeve dhe pastaj dëmshpërblimi.

Kurrë ndonjëherë shteti nuk ka qenë kaq afër këtyre banorëve, kurrë ndonjëherë nuk është parë një mobilizim i tillë i të gjitha hallkave të shtetit për t'u ardhur atyre në ndihmë, pa as më të voglin dallim politik. Në emër të këtyre banorëve dëshiroj të përcjell një falënderim të veçantë për zotin Kryeministër që me impenjimin, me preokupimin, me praninë e vazhdueshme, ka qenë promotor i këtij mekanizmi të fuqishëm. Gjithmonë në emër të këtyre banorëve, dua të falënderoj shumë zonjën Topalli që jo vetëm si Kryetare e Kuvendit, por edhe si deputete e vajzë Shkodre ka dhënë një kontribut shumë të madh me praninë e saj të vazhdueshme në çdo zonë të dëmtuar.

Pa dyshim, një falënderim të veçantë dua të përcjell për të gjithë anëtarët e Qeverisë, edhe për ata anëtarë që për shkak të impenjimeve qeveritare shumë të rëndësishme s'mundën të jenë prezentë vazhdimisht si kolegët e tyre anëtarë të komisionit ndërmnisht, të cilët vazhdimisht, ditë dhe natë, pa pushim, me një ndjenjë të lartë përgjegjësie, kanë punuar për koordinimin e operacioneve së bashku me shtabin e emergjencave të kryesuar nga prefekti i Shkodrës, të cilin e falënderoj shumë për përkushtimin dhe punën efikase që ka bërë.

Falënderoj shumë edhe ata kolegë deputetë që na u gjendën pranë me vizita apo me telefonata, falënderoj shumë gjithë personelin inxhiniero-teknik të hidrocentraleve dhe specialistët e Ministrisë së Energjetikës që, natë e ditë, nën një presion të vazhdueshëm si rrjedhojë e përgjegjësisë së madhe që kishin në vendimmarrje, punuan me një ndjenjë të lartë përgjegjësie për menaxhimin e kaskadës!

Dua të falënderoj shumë kryetarët e komunave Dajç, Ana e Malit, Bushat, Velipojë, Guri i Zi, që kanë bërë një punë të jashtëzakonshme në koordinimin e të gjithë operacioneve direkt në terren në zonat e tyre!

Po kështu falënderoj shumë kryetarin e Bashkisë Shkodër dhe kryetarin e qarkut që punuan shumë në koordinim e operacioneve në zonat periferike të Shkodrës!

Falënderoj shumë të gjithë punonjësit e stacioneve të pompave, të hidrovorëve, të stacioneve elektrike, të shëndetësisë, të arsimit, të zjarrfikësve e të tjerë që punuan pa u lodhur dhe vazhdimisht për të ofruar shërbimet e tyre!

Falënderoj shumë të gjithë vullnetarët e ardhur nga Kosova, Maqedonia, Italia, Greqia, të cilët dhanë

një kontribut të madh në evakuimin e personave dhe shpërndarjen e ndihmave!

Falënderoj shumë gjithë ata persona, politikanë, biznesmenë, artistë, sportistë, organizata të ndryshme, institucione, fondacione e shumë të tjerë që ofruan ndihma financiare dhe materiale duke demonstruar kështu një ndjenjë të lartë solidariteti.

Falënderoj median për transparencën dhe punën që ka bërë në kushte shumë të vështira dhe, me qëllim, falënderimin e fundit dua ta bëj për gjithë ata bij nënash, ushtarë, policë, forca speciale, forcat e emergjencave civile, që me në krye eprorët e tyre, edhe me gradat më të larta, kanë bërë një punë heroike, sidomos në operacionet e shpëtimit dhe të evakuimit!

Duke e mbyllur po ju them që pata shumë dëshirë që në këtë listë të gjatë të falënderimeve të ishin edhe deputetët e PS-së. E kisha këtë dëshirë, sepse, vazhdimisht, gjatë këtyre ditëve shpresoja që të vinte ndonjë grup pt jeryre pranë shtabit të emergjencës dhe të ofronte kontributin në koordinimin e operacioneve, kontribut ky që do të vlerësohej shumë nga shtabi, megjithëse vlerësimin më të madh do ta merrnin nga populli. Por ata nuk erdhën, sepse shefi i tyre nuk donte. Përkundrazi, ai fërkonte duart nga gëzimi për atë që ndodhi, me një cinizëm që edhe vetë Neroni po të ishte gjallë do t'ia kishte zili. Zoti e faltë!

Me këto falënderime u mundova të përcjell mesazhin e banorëve të zonave të dëmtuara që po shohin se shtetin e kanë më pranë se asnjëherë dhe falënderimi i këtyre njerëzve të thjeshtë mendoj se është vlerësimi më i mirë për punën e bërë nga të gjithë ne.

Falemnderit!

Ardian Turku – Falemnderit, zoti Dibra!

Urdhëroni, zoti Uldedaj!

Gjokë Uldedaj – I nderuar zoti drejtues i seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Si deputet i qarkut të Shkodrës desha ta filloj diskutimin tim me një mirënjohje të thellë për banorët e zonave të përmbytua, duke theksuar mirëkuptimin dhe bashkëpunimin e tyre të plotë përballë kësaj fatkeqësie natyrore, e cila, falë një angazhimi dhe menaxhimi në një front të gjerë nga të gjithë strukturat e qeverisjes vendore dhe qendrore, me një vëmendje të jashtëzakonshme të Kryeministrit, zotit Sali Berisha, u vu nën kontroll. Kanë qenë ditë shumë të vështira për banorët e atyre zonave, por ata në asnjë moment nuk kanë qenë

vetëm. Në kuadrin e këtyre ditëve Kryeministri shqiptar ka ardhur mbi gjashtë herë në Shkodër për të parë këto zona dhe ka mbajtur kontakte me të gjitha nivelet.

Shkodra dhe rrethinat e saj nuk do ta harrojnë kurrë këtë përqendrim të jashtëzakonshëm të vëmendjes ndaj saj, me prezencën e një komiteti ndërministror, me ministrat Basha, Ruli, Olldashi, Imami, Tafaj, Vasili, Mediu, Prifti, me forca të mëdha të angazhuara të ushtrisë dhe të Policiës së Shtetit, si dhe me prezencën çdo ditë të Kryetares së Parlamentit. Mbi të gjitha, Shkodra gjatë këtyre ditëve dhe në vazhdim është ballafaquar me një solidaritet të paimagjinueshëm jo vetëm nga e gjithë Shqipëria pa përjashtim, por edhe nga vendet fqinje, si: Italia, Greqia, Kosova, Maqedonia, kontributi i të cilave ka qenë jo vetëm me ndihma materiale, por edhe me forca të specializuara e mjete. Po kështu, ndihma konkrete e angazhime ka pasur edhe nga një sërë vendesh të tjera, si: Turqia, Franca, Kroacia, Austria, Sllovenia, Sllovakia e të tjera, si dhe institucione që veprojnë brenda dhe jashtë Shqipërisë, ku në mënyrë të veçantë do të veçoja Caritas-in shqiptar.

Fatkeqësitë natyrore nuk kanë ngjyra partiake. Përballimi i tyre u përket të gjitha forcave politike, pasi janë probleme kombëtare. Pse ta fshehim që këto ditë të vështira ne kishim bindjen se edhe opozita do të kontribuonte pozitivisht në ndihmë të këtyre zonave? Por ndodhi e kundërta. Ne gjatë gjithë këtyre ditëve jemi ballafaquar me manipulime dhe spekulime në terren, nëpërmjet keqinformimeve dhe panikut të krijuar që, fatmirësisht, nuk na kushtoi jetë njerëzish. Të kërkosh të përfitosh nga fatkeqësitë natyrore, është sa antinjerëzore, aq edhe antikombëtare. Por ishte qetësia, mençuria dhe vlerësimi me objektivitet i njerëzve përballë kësaj demagogjie boshe që bënë të dështojnë përpjekjet destruktive të kësaj opozite që nuk di as çfarë bën, as çfarë kërkon.

Këto janë fakte dhe ne i kemi parë gjatë gjithë këtyre ditëve. Nuk dua të merrem me deputetët solaicistë se, siç erdhën punët, është kohë e humbur. Por, të paktën, sot ata duhet të ishin në Kuvend, të jepnin alternativën e tyre, e cila deri më sot ka mbetur vetëm një shpifje mediatike.

Para se të shtroj një sërë problemesh që duhen parë me prioritet do të doja të bëja një falënderim të veçantë që vjen nga banorët e zonave të përmbytura për menaxhimin e jashtëzakonshëm të kësaj situatë të jashtëzakonshme nga të gjithë strukturat

shtetërore të angazhuara. Në këto 15 ditë të para të vitit ata nuk kanë parë asnjëherë më shumë përkushtim dhe përgjegjësi nga të gjithë këto struktura që, në radhë të parë, synonin të mos humbej asnjë jetë njerëzore. Kjo u arrit falë një solidariteti përtej përkatësive politike, përtej ndarjeve krahinore apo moshave. Personalisht, dua të bëj një falënderim të veçantë për strukturat e ushtrisë e të policisë dhe Rezervat e Shtetit, të cilat ia dolën mbanë më së miri, edhe pse në kushte të paparashikuara. Nuk mund të anashkaloj ndihmën e dhënë nga sipërmarrja shqiptare, por edhe ajo kosovare, ndihmë që vazhdon edhe në momentet që unë po flas e do të vazhdojë deri atëherë kur situata të shkojë drejt normalizimit përfundimtar.

Shqiptarët kanë dëshmuar se dinë të jenë për njëri-tjetrin në ditë të vështira, por që të mos gjendemi më në kushte të tilla emergjence duhen marrë një sërë hapash konkretë në menaxhimin e situatave, që nuk janë në dorën tonë. Është e nevojshme të përshtatemi me kërkesat e kohës dhe me nevojat që ka vendi e për këtë duhet të ngremë institucione të posaçme, duke patur një këndvështrim të perspektivës së zhvillimit të vendit. Jo se kjo në plan afatshkurtër ka munguar, por duhen parë zgjidhjet në planin hapësinor, rajonal e kombëtar të territorit, pasi ky është momenti më i mirë për të korrigjuar edhe disa gabime të bëra në vite, që lidhen me ndërtimet, si dhe me ruajtjen dhe mirëmbajtjen sidomos të sistemit të argjaturave dhe të sistemit të kullimit, kaq shumë të domosdoshëm në situata të tilla.

Në këtë moment ne kemi shumë për të bërë për normalizimin e situatës deri në zhdukjen e të gjithë pasojave dhe të fillimit të jetës normale në këto zona. Dëmet janë në vlera të konsiderueshme, por kompensimi, referuar premtimit të Kryeministrit, do të jetë i plotë dhe thellësisht transparent. Për këtë, krahas kontributit nga buxheti, duhet të mbështetemi më shumë edhe te donacionet. Shumë njerëz në këto zona kanë shumë nevojë për ne dhe për përkrahjen tonë të vazhdueshme. E nëse hedhim sytë përtej përmbytjeve, duhen marrë një sërë masash për një zhvillim të qëndrueshëm rajonal. Midis oportunitetit dhe perspektivës duhet të zgjedhim këtë të fundit. Kjo kërkon vendimmarrje që përmban në vetvete edhe riskun, por nga ana tjetër rrit sigurinë përballë situatave të jashtëzakonshme. Për këtë unë mund të sjell disa mendime konkrete që mund të analizohen dhe të shihen mundësitë për implementimin e tyre.

Duhet hartimi dhe zbatimi i normave standarde të projekteve, që të rrisin qëndrueshmërinë e projekteve me rëndësi strategjike. Eksperiencia e fituar dhe ekspertët e huaj do të na bëjnë të ishim të suksesshëm në këtë pikë. Po kështu, rasti i fundit duhet të na bëjë më të ndjeshëm në ndërgjegjësimin dhe futjen në kulturën tonë të sigurimit nga fatkeqësitë natyrore. Tashmë ne kemi një treg të zhvilluar të sigurimeve dhe vetë individit duhet të sigurojë jetën e tij, me gjithçka e rrethon.

Të gjitha këto kërkojnë, në radhë të parë, forcimin e institucioneve të prognozës. Duhet një reformim i strukturave të emergjencës duke e ngritur atë në standarde evropiane, pasi gama e përballjeve me problemet e natyrës është rritur. Po kështu, ne duhet t'u përgjigjemi ndryshimeve të këndvështrimit ndaj pronës. Kjo kërkon një legjislacion të plotë mbi territorin, duke përcaktuar zonat ku ndërtohet dhe ku nuk ndërtohet. Në të kundërt rreziku i përballjes së rish me të tilla pasoja, me gjithë masat e marra dhe të premtuara, ekziston.

Të nderuar kolegë,

Pa dashur të bëj një bilanc të kostos reale për përballimin e situatës, pasi ju jeni njohur dhe do të njiheni hap pas hapi nga strukturat përkatëse të ngritura për këtë qëllim, do të doja në fund të kësaj fjale të bëja një falënderim të veçantë inkurajues për banorët e zonave më të prekura nga përmbytjet e ditëve të fundit. Do ta filloja me komunën Dajç e cila ishte epiqendra, që përballoi vështirësitë më të mëdha dhe pati një presion dhe ngarkesë të jashtëzakonshme. Bashkëveprimi perfekt midis komunave dhe forcave të tjera në kuadrin e shtabit të emergjencës bëri që të shmangeshin dëme të pallogaritshme për këtë komunë. Desha të falënderoj fshatarët e Shirqit, Darragjatit, Mushanit, Samrshit, Belajt e të tjerë që ishin të jashtëzakonshëm, komunat Velipojë, Ana e Malit dhe Oboti, që ishte fshati i parë i përmbytur, Bushati, Bërdica, Guri i Zi, lagjet e Shkodrës: Bahçallëk, Ajasëm, Kiras e të tjera, të gjithë komunarët, prefektin e Shkodrës, kryetarin e qarkut, kryetarin e baskisë. Banorët e këtyre zonave edhe pse në ditët e para e patën të vështirë të pranonin situatën, ditën të jenë bashkëpunues me forcat e shtetit, duke na bërë ne të besonim edhe më shumë në forcën tonë për përballimin e situatave të tilla.

Ju falënderoj, zotërinj deputetë, për solidaritetin dhe për kontributin e dhënë!

Ardian Turku – Falemnderit, zoti Uldedaj!
Urdhëroni, zoti Paloka!

Edi Paloka – Falemnderit, zoti drejtues i seancës!

Unë sot flas si deputet i qarkut të Lezhës, ku historikisht ka pasur probleme me përmbytjet. Unë besoj se jo vetëm lezhjanët që e vuajtën direkt këtë fatkeqësi natyrore, por edhe të gjithë qytetarët shqiptarë, që i kanë ndjekur kronikat televizive në vite, e dinë se nuk ka pasur vit me reshje kur jo vetëm fshatrat e komunat, por edhe vetë qyteti i Lezhës të mos ktheheshin në një liqen të vërtetë. Për këtë arsye, kur më njoftuan se në ishullin e Shëngjinit kishte pasur përmbytje, u shqetësova se mos përsëritej e njëjta situatë si ajo e viteve të shkuara, ndoshta edhe më keq.

U shqetësova për njerëzit, por për të qenë i sinqertë edhe për ego, sepse gjatë fushatës duke përmendur investimet e Qeverisë pikërisht në zonat që kishin pasur probleme me përmbytjet, u kisha thënë atyre se ato ishin një çështje e mbyllur. Ndaj nuk doja të zhgënjeja njeri dhe në fakt askush nuk u zhgënjye. Në sajë të investimeve të realizuara në këtë qark, pavarësisht motit të vështirë, krahasuar me vitet e kaluara, Lezha u shpëtoi përmbytjeve. Ajo që ndodhi në ishullin e Shëngjinit kishte lidhje me një fenomen tepër të rrallë, që u shpjegua edhe këtu. Duke pasur parasysh ndryshimet e klimës në rang global, mendoj se duhet të fillojmë të bëjmë llogaritë dhe investimet e duhura që këto fenomene, të cilat mund të përsëriten, të mos kenë më pasoja në qarqe si ai i Lezhës dhe sidomos në atë pjesë të bregdetit ku ka disa kohë që deti vazhdon të zaptojë tokën.

Ndërkaq, unë dua të falënderoj institucionet e shtetit që vepruan me shpejtësi dhe efikasitet në zonat e përmbytura nga deti. Një falënderim të veçantë do të kisha edhe për biznesmenët Pjetër Pacani, Behar Raxhia dhe shumë të tjerë që me iniciativën e me mjetet e tyre dhanë një kontribut vërtetë të çmueshëm për shmangien dhe eliminimin e pasojave në qarkun e Lezhës.

Pak më parë theksova se askush nuk u zhgënjye nga ajo çfarë ndodhi në qarkun e Lezhës. Këtë herë përmbytja dëmtoi një qark tjetër, atë të Shkodrës. Nga gjithë kjo fatkeqësi pati shumë të zhgënjyer, por të zhgënjyerit më të mëdhenj ishin Edvin Rama dhe çunat e bllokut. Të mërziturit e mëdhenj ishin Edvin Rama dhe çunat e bllokut në Partinë Socialiste. U zhgënjyen çunat e bllokut, të cilët luteshin për çarje digash; që çdo mëngjes, ndryshe nga të gjithë shqiptarët e tjerë, çoheshin me sy nga qielli dhe gëzonin kur qielli nxihej, e nxiheshin kur

qielli hapej.

Janë zhgënjyer çunat e bllokut që u bënin thirrje njerëzve të mos dëgjonin Qeverinë, e cila u kërkonte të largoheshin nga shtëpitë në ditët e përmytjes, por të qëndronin aty e të binin theror për Edvin Ramën; u zhgënjyen ata që kërkonin e luteshin për një fatkeqësi si ajo e Gërdecit. Janë zhgënjyer çunat e bllokut, sepse askush nuk e humbi jetën në këtë fatkeqësi të madhe; janë zhgënjyer, sepse ata luteshin për vdekjen, dëshironin të kishte qoftë edhe një viktimë të vetme. Por kur panë që nuk ndodhi asgjë, filluan t'i sajnin. "Korrespondentët" e Ramës donin dhe prisnin viktima dhe për këtë, ai mori shembull vdekjen natyrale të një banori të zonës së Lezhës, që gazetat pranë Ramës e cilësuan viktimën e parë të përmytjeve. Këta janë çunat e bllokut që bashkë me baballarët e tyre janë e vetmja fatkeqësi e madhe njerëzore që i ka ndodhur këtij vendi.

U zhgënjyen ata që as për hipokrizi, as për sy e faqe, nuk u erdhën në ndihmë njerëzve, por u tallën duke nxjerrë përpara Bashkisë së Tiranës kuti gjoja për të mbledhur ndihma për qytetarët e zonave të përmytura. Shqiptarët e Shkodrës prisnin të shikonin vullnetarët e Edvin Ramës, por në fakt panë vetëm një grup pëshpëritës fantazmash që bridhnin poshtë e lartë dhe që qarkullonin me në krye Ramën, duke iu pëshpëritur njerëzve se fajin e ka Qeveria. Ky ishte i gjithë qëllimi i tij.

Lidhur me këtë opozitë, unë e kam deklaruar edhe një herë tjetër, mendoj ndryshe nga disa kolegë të mi që vazhdojnë t'u bëjnë thirrje Ramës dhe atyre që e pasojnë të hyjnë në Parlament. Unë mendoj se një opozitë e tillë si ajo që përfaqëson Edvin Rama dhe çunat e bllokut, nuk e meriton të ulet në këtë Parlament. Do të jetë një fatkeqësi nëse njerëz të tillë do të guxojnë të vishen me petkun e përfaqësuesve të shqiptarëve.

Falemnderit!

Ardian Turku – Falemnderit, zoti Paloka!

Zoti Arben Imami, urdhëroni!

Arben Imami – Falemnderit, zoti drejtues i seancës!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në përmbushje të misionit të Forcave të Armatosura për të ndihmuar popullsinë në rastet e fatkeqësive natyrore dhe detyrimeve që lindin nga ligji për emergjencat civile, për përballimin e situatës së krijuar nga reshjet e shumta dhe përmytjet në qarkun e Shkodrës, janë kryer një sërë operacionesh me qëllim parandalimin, përballimin dhe riaftësimin

e gjendjes së shkaktuar nga këto përmytje. Të gjitha veprimet e ndërmarra nga Forcat e Armatosura të mbështetura në ligjin për emergjencat civile, në vendimin e Këshillit të Ministrave për shpalljen e gjendjes së emergjencës dhe në planin kombëtar për emergjencat civile, duke filluar nga data 2 janar deri në datën 5, Forcat e Armatosura u angazhuan me një pjesë të kapaciteteve operacionale, rreth 150 forca, 25 mjete, 2 varka dhe 2 gomone.

Me përqendrimin e gjendjes në datën 6 u rrit edhe niveli i angazhimit të Forcave të Armatosura në terren. U instalua edhe qendra operacionale e Forcave të Armatosura me detyrë monitorimin dhe menaxhimin e situatës, si dhe përdorimin e kapaciteteve operacionale të strukturave të Forcave të Armatosura për përballimin e emergjencës së krijuar.

Forcat e Armatosura kanë ndjekur dhe monitoruar pa ndërprerje situatën e emergjencave civile në prefekturën e Shkodrës dhe kanë kryer operacione të kërkim-shpëtimit, evakuimit të popullsisë me përparësi, evakuimit dhe transportimit të të sëmurëve, forcimit të argjinaturave, shpërndarjes së ushqimeve dhe mallrave të ndryshme. Çdo ditë është punuar në bazë të planeve operacionale, të cilat janë hartuar në bazë të kërkesave të marra nga kryetari i Komitetit të Emergjencave, zoti Basha.

Forcat e Armatosura kanë pasur një bashkëpunim shumë të mirë me të gjitha institucionet qendrore dhe vendore të përfshira në përballimin e emergjencës. Kontributi i tyre në këtë operacion është përqendruar në disa drejtime kryesore: kërkim-shpëtimin dhe evakuimin e banorëve, gjësë së gjallë dhe të materialeve të ndryshme, shpërndarjen e ndihmave në zonat e përmytura. Një pjesë e ushqimeve dhe materialeve të tjera janë shpërndarë në rrugë ajrore, me helikopterë, në veçanti për komunën e Dajçit, e cila u gjet e gjitha nën ujë dhe në Velipojë, e cila ndodhej krejtësisht e izoluar nga uji; në forcimin e objekteve, argjinaturave, zhvendosjen e inerteve, me qëllim funksionimin e infrastrukturës dhe të transportit në këto zona, ndërtimin e kampingjeve për strehimin e popullsisë së evakuuar dhe sistemimin e tyre në ambiente të caktuara etj., etj.

Për realizimin me sukses të këtij operacioni janë angazhuar forca dhe mjete nga brigada e reagimit të shpejtë, batalioni i parë dhe i dytë, brigada e mbështetjes rajonale, komanda e mbështetjes së logjistikës regjimenti i komandave, regjimenti i

helikopterëve dhe brigadat detare. Pra, janë angazhuar çdo ditë rreth 900 trupa të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, duke filluar nga ushtarë, nënoficerë, oficerë deri te shefi i Shtabit të Përgjithshëm. Gjithashtu, kemi pasur të angazhuara edhe këto mjete: 3 helikopterë, 15 mjete të transportit tokësor, 23 mjete vetëshkarkuese, 60 motobarka, 2 transportues amfib, 6 ambulanca etj.

Si asnjëherë më parë, Forcat e Armatosura kanë pasur bashkëpunim të shkëlqyer edhe me vendet fqinje, që sollën në ndihmë të zonës së përmblytur 115 forca ushtarake, konkretisht: forcat greke, me një personel prej 29 personash, 22 pompa, 2 autobusë, 2 motobarka dhe 1 furgon; forcat italiane me 6 persona, 3 helikopterë, transport të mesëm, ku u pa dhe u vlerësua se ishte tepër i vlefshëm, kur u ndërpre në të gjitha rrugët e komunikimit tokësor me dy komunat e sipërpërmendura; forcat e sigurisë së Kosovës, të cilat u paraqitën të parat dhe punuan me një përkushtim dhe profesionalizëm të lartë, me 33 persona, 10 mjete transporti, 2 motobarka dhe 1 ambulancë; forcat maqedonase me 47 persona, 21 pompa thithëse, 5 barka, 8 çadra për 50 vetë dhe 10 gjeneratorë.

Operacionet e ndërhyrjes në planet operationale të përditshme të hartuara në bazë të kërkesave të Komitetit Ndërmnistror të Emergjencës Civile janë shtrirë në këto njësi të qeverisjes vendore: komuna Dajç, Bushat, Bërdicë, Anë e Malit, Velipojë, Guri i Zi, Vau i Dejës, Bashkia në Shkodër dhe rrethinat e saj.

Rezultatet e misionit të Forcave të Armatosura janë: evakuim njerëzish 2499 persona, ku 10 të sëmurë janë evakuuar nga ajri me helikopterë, 750 krerë gjë e gjallë, janë transportuar rreth 450 tonë ushqime, 250 tonë ujë i pijshëm, 172 tonë koncentrat, 42 tonë jonxhë, bar i thatë, pastaj janë shpërndarë çadra, pelerina, çizme, 8 gjeneratorë, 9 pompa të mëdha, xhupa pambuku, çorape leshi, batanije, dyshekë, kokore, kostume policie dhe deri në 10 tonë detergjent.

Të nderuar deputetë,

Forcat e Armatosura, paralelisht me evakuimin dhe shpërndarjen e ndihmave, kanë kryer edhe operacione tejet të vështira, për të bërë të mundur kalimin në infrastrukturën rrugore dhe për të përforcuar objekte të rëndësishme. Kështu janë përforcuar 1115 metra linear argjinaturë, argjinaturat me thasë në Darragjat, Dajç, Samrisht, Mushan, Velaj, Ças, Trush etj., me rreth 45 mijë thasë dhe afërsisht 890 metër kub inerte. Stacione pompash

në Trush me 430 thasë dhe Dobraç me 260 thasë. Në nënstacionet elektrike me 290 thasë, është vendosur një urë teli me gjatësi 9 metër me përmasa 4 me katër, me peshë mbajtje deri në 24 tonë. Janë transportuar në Goricë të Anës së Malit rreth 230 metër kub inerte, janë transportuar dhe përdorur për përmirësimin e argjinaturave në Dajç dhe Velipojë, gati 1 500 metër kub inerte.

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë gjenden aty dhe do të vijojnë përbushjen e detyrave ligjore për aq kohë sa vijon situata.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ky është operacioni më i madh i kryer nga Forcat e Armatosura, një sprovë e rëndësishme edhe për ato vetë. Megjithatë ka kaluar vetëm 1 vit nga anëtarësimi në NATO, FA dëshmuar kapacitete, standarde dhe profesionalizëm të lartë. Veç kësaj, Forcat e Armatosura ishin një mbështetje e madhe morale dhe psikologjike për banorët e prekur nga fatkeqësia. Prezenca e ushtarakëve, ashtu si edhe e policëve, mjekëve dhe gjithë punonjësve të bujqësisë dhe ujërave në zonën e Shkodrës, ditën dhe natën, shpesh edhe pa ndërrim turnesh për pamundësi të komunikimit me mjete ajrore dhe tokësore, krijoi siguri për banorët e zonës. Përballimi i kësaj situatë nuk erdhi thjesht dhe vetëm për shkak të profesionalizmit, gatishmërisë, sakrificës, shpesh edhe guximit, por edhe sepse ushtarakët tanë treguan vlerat e një humaniteti të madh, pa të cilin kjo veprimtari do të kishte qenë e pamundur.

Më lejoni t'ju them diçka: operacioni që kryem në Shkodër nuk ishte një operacion i parashikuar dhe i planifikuar, por një kundërpërgjigje ndaj një fatkeqësie natyrore, ishte përgjigje ndaj situatave emergjente që krijoheshin aty, në terren. Në këto kushte, intuita dhe vendimmarrja individuale e aktorëve të përfshirë në operacion merr një rëndësi të veçantë, prandaj ne do të duhet ta nisim vlerësimin e këtij operacioni nga produkti i tij. Vlera e çdo operacioni matet me produktin dhe aty duket nëse vendimmarrja e aktorëve ka qenë e drejtë dhe në fakt kështu ka qenë, sepse nuk u lejua asnjë viktimitë njerëzore, pavarësisht se mijëra njerëz u gjendën në rrezik dhe u shpërngulën, askush nuk mbeti pa marrë ndihmën e shtetit. U kufizua maksimalisht niveli i humbjeve të gjësë së gjallë, pavarësisht se situata e emergjencës zgjati me ditë.

Ky produkt na tregon se të gjitha strukturat shtetërore, të përfshira në këtë operacion, u gjetën të përgatitura dhe kishin kapacitetet organizative për

të përballuar situatën e emergjencës, ku do të futeshin, së pari, strukturat lokale e qendrore, deputetët, prefekti, kryetari i bashkisë, kryetarët e komunave, këshilltarët lokalë, kryepleqtë, Policia e Shtetit, personeli shëndetësor, i ujërave, i bujqësisë dhe, më në fund, edhe FA; të gjithë aktorët, të cilët dëshmuar dhe faktuan efikasitetin e zinxhirit të strukturave shtetërore.

Dua të përmend edhe një fakt: në kohë paqeje mund të duket sikur solidariteti njerëzor, për t'iu gjetur pranë njëri-tjetrit, vlera këto të një populli të qytetëruar, humbet. Nuk mund të mos theksoj se çdo popull do të kishte dashur nga opozita politike një solidaritet. Nuk jam kundër çdo lloj kritikizmi, por në një situatë emergjence si kjo do të duhej të mbizotëronte solidariteti, ndjenja e bashkësisë për të përballuar fatkeqësinë. Qëmtimi i barbarizmave në fjalorin e shqipes nuk sjell gjë tjetër veçse kënaqësinë e padobishme të artikulesve të tyre.

Unë nuk mund ta kuptoj sesi mijëra banorë në kushte të vështira ekzistenciale nuk e shqiptuan dot një fjalë të keqe, ndërkohë "djemka" nga rrugët e Tiranës apo hotelet e Shkodrës gjetën mundësinë ta thonë fjalën e keqe dhe kjo është e pafalshme. Forcat e Armatosura sigurisht që do ta prisnin solidaritetin e të gjithë deputetëve të qarkut të Shkodrës, të maxhorancës, por edhe të opozitës, për më tepër sepse ushtria është kombëtare. Gjithsesi, kjo është një ditë, kur të gjithë ne ndihemi krenarë se të gjitha Forcat tona të Armatosura e kryen detyrën e tyre.

Falemnderit!

(Ndërkohë, drejtimin e seancës e ka marrë zonja Topalli.)

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Imami!

Zoti Vasili, urdhëroni!

Petrit Vasili – E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar zotërinj deputetë,

Me fillimin e katastrofës natyrore, Ministria e Shëndetësisë veprroi menjëherë në mënyrë energjike, në bashkëpunim të plotë me të gjitha strukturat e Shkodrës dhe njëkohësisht duke vendosur një sistem gatishmërie për të gjitha strukturat e tjera që eventualisht mund të mbështesnin operacionet mjekësore ne terren. Ministria e Shëndetësisë përcaktoi një radhë prioritesh, ku në radhë të parë mbizotëroi mbrojtja e shëndetit të personave të evakuar nga shtëpitë e tyre në qendra grumbullimi, kujdesi për personat në zonat e izoluara nga përmbytjet, vëmendja dhe ndjekja e kujdesshme e situatës epidemiologjike

për të parandaluar përhapjen e infeksioneve në popullatë në të gjithë zonën.

I gjithë sistemi lokal atje, por edhe qarqet afër, Lezha, Durrësi, Tirana, u vunë në dispozicion të kësaj gatishmërie, duke ndërhyrë sipas rastiit dhe nevojave. Në tërësinë e këtij operacioni mbi 370 mjekë, infermierë, mami dhe personel ndihmës u vunë në dispozicion të tij, nga të cilët 110 kanë mbuluar shërbimin 24-orësh ne komuna dhe fshatra në terren, duke improvizuar shpeshherë dhënien e shërbimit mjekësor edhe në rrethana mjaft të vështira. Këtu është vendi për të përshëndetur punën e të gjithë mjekëve dhe infermierëve, të cilët, pa parë kushtet e tyre, improvizuar shpeshherë një shërbim shëndetësor edhe në banesat e banorëve të zonës, të cilët i ofruan me bujari. Këto operacione do të ishin të pamundura, në rast se do të mungonte bashkëpunimi i shkëlqyer me forcat e mbrojtjes, me ato të policisë dhe me të gjithë aktorët në terren, e në mënyrë të veçantë me të zgjedhurit lokalë, ku kryetarët e komunave dhe banorët u treguan bashkëpunues.

Kujdesi Shëndetësor Parësor ka ofruar shërbim 24 orësh. U urdhërua nga ne në datën 2 janar mospërdorimi i ujit të inonduar, por i atij të ambalazhuar, duke eliminuar çdo premisë për ngjarje të karakterit epidemiologjik. Janë kryer në tërësinë e tyre mbi 6000 vizita mjekësore të të gjitha llojeve dhe është siguruar edhe transportimi i rasteve të rënda për shkak të sëmundjeve kronike dhe jo për shkaqe të tjera, të cilat u verifikuan, duke siguruar një transport, që për nga eficienta do ta kishte zili edhe ai i një dite të zakonshme e pa përmbytje, duke arritur që në më pak se 40 minuta të merrej ndihma në stacionin më të afërt, që ishte Shkodra. Kur ishte e nevojshme, kanë ardhur ekupe mjekësore edhe nga Tirana për ndihmë mjekësore më të specializuar.

Një kapitull i veçantë ka qenë shëndeti publik si shtylla kryesore në situata të tilla dhe prioriteti për të kontrolluar në mënyrë të vazhdueshme ujin e pijshëm dhe ujësjellësit e zonës, ku janë kryer mbi 800 analiza për monitorimin e ujit të pijshëm. Shkodra dhe të gjitha komunat e rrethinat u furnizuan me ujë higjienikisht të pastër, pa shkaktuar asnjë ngjarje të karakterit epidemik. Janë monitoruar nga inspektorët tanë të gjitha ujërat e përdorura, si dhe monitorim i shkarkimeve të ujërave të zeza dhe sipërfaqësore në lidhje me nivelin e ndotjes mikrobiologjike, kimike, fizike, në bashkëpunim me Inspektoratin e Mjedisit dhe strukturat e pushtetit

vendor.

Është ndjekur me vëmendje edhe siguria ushqimore. Ne kemi bërë ekzaminime të vazhdueshme dhe atje ku kemi konstatuar ushqime që paraqesin dyshime të karakterit sanitar, kemi urdhëruar bllokimin e tyre dhe mospërdorimin e mëtejshëm, duke eliminuar çdo lloj premise për intoksikacione të karakterit epidemik.

Një front i rëndësishëm ka qenë kontrolli i sëmundjeve infektive, ndjekja e përditshme e incidencës së sëmundjeve infektive, veçanërisht sëmundjeve gastro-intestinale dhe të lëkurës. Intensifikim i raportimit sipas mekanizimit ALERT-it bëri të mundur që kjo ndjekje të ishte mjaft efikase. Edhe parandalimi i dëmtimeve dhe aksidenteve, në bazë të informacionit të shpërndarë për popullatën në lidhje me risqet e mundshme, bëri të mundur kontrollin e situatës në terren.

Duke mos neglizhuar situatën e vështirë dhe duke pasur parasysh që inondata krijojnë edhe probleme të një ngarkese emocionale të veçantë, mjaft punonjës të shërbimeve sociale janë ofruar për të dhënë ndihmën e tyre lidhur me probleme të mundshme të shëndetit mendor për të ndihmuar edhe më një asistencë psikologjike të evokuarit që vinin nga zona të vështira. Kujdesi spitalor ka qenë dhe vazhdon të jetë një gatishmëri e plotë e Spitalit Rajonal Shkodër dhe Spitalit Rajonal Lezhë, për përballimin e fluksit të mundshëm me të sëmurë me sëmundje infektive, fëmijë dhe të sëmurë kronikë (shtretër të lirë, medikamente, ekzaminime). Gjithashtu, ka pasur gatishmëri numër një të Shërbimeve të Urgjencës, për përballimin e urgjencave në çdo moment.

Një element më vete ka qenë furnizimi me medikamente, materiale të konsumueshme. Që në ditët e para të konstatimit të kësaj gjendjeje të vështirë u morën masa për sigurimin e sasive të bollshme të medikamenteve dhe këto barna u vunë në dispozicion të mjekëve që operonin në terren, për të evituar të gjitha procedurat burokratike dhe për të bërë vizitat dhe shpërndarjen e barnave në vend, duke evituar çdo lloj sorollatjeje dhe vonese në dhënien e ndihmës mjekësore me barna.

Është vendi këtu për të falënderuar edhe grosistët e farmacive, të cilët dhuruan medikamente për këto zona. Sot, stoku i krijuar është i tillë që ne mund të përballojmë pa asnjë lloj problemi çdo nevojë për mbështetje me barna. Ngritja e ekipeve ndihmëse të inspektimit të zonave nga Ministria e Shëndetësisë dhe ISHP-ja, në ndihmë të ekipeve

të rajonit të Shkodrës për monitorimin e situatës shëndetësore vazhdojnë të punojnë në terren edhe sot, duke monitoruar në mënyrë profesionale të gjithë gjendjen e indekseve themelore të shëndetit publik.

Ministria e Shëndetësisë, duke vlerësuar shkallën e gjerë të inondimit; grumbullimin në sasi të mëdha të mbeturinave të karakterit organik, inorganik dhe materialeve të tjera të ngurta; ngordhjen e bagëtive dhe gjallesave të ndryshme dhe qëndrimin e tyre për një kohë të caktuar në inondata; ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe pjesërisht të atyre nëntokësore; inondimin e disa ujësjellësve, kryesisht në fshatra; ka hartuar një plan konkret për shëndetësimin higjieno-sanitar të zonave të prekura, veçanërisht duke e vlerësuar këtë në kompleksin e një zone rurale me profil të spikatur blegtoral, duke u konsultuar edhe me planet përkatëse që Organizata Botërore e Shëndetësisë sugjeron për emergjencat në rastet e përmytjeve, ka përpiluar edhe planin e emergjencës shëndetësore për zonat e përmytura, duke bërë që i gjithë kontrolli i situatës sanitare të jetë i artikuluar qartë, i koordinuar mirë me të gjithë aktorët, duke mundësuar kësaj që ne të kemi një kontroll të vazhdueshëm të kësaj situate dhe duke mos lejuar asnjëherë daljen e saj jashtë kontrollit.

Në këtë mënyrë, ne kemi një veprim anti-epidemik shumë të qartë në terren dhe një kontroll të shërbimit ambulator dhe atij spitalor, plotësisht brenda parametrave të duhur. Mendoj se ecuria e të gjithë situatës humanitare, në bazë të masave të predispozuara, bëri që ne të mos kemi asnjë lloj rrisjeje sanitar dhe banorët e zonave mund të përballen me vështirësi të karakterit ekonomik, por jo me ato të karakterit sanitar.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Vasili!

Fjalën e ka zonjusha Pavlina Hoti.

Pavlina Hoti – E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe unë nga kjo foltore nuk mund të mos përcjell falënderimet e ngrohta dhe solidaritetin e banorëve të qarkut të Lezhës për ndihmën, kontributin, përballimin dhe kapërcimin e situatës në Shkodër dhe në Lezhë.

Dua të falënderoj në veçanti Kryeministrin Berisha dhe ministrat e tij, që me përgjegjshmëri dëshmuar gjakftohtësi dhe seriozitet maksimal dhe se në krye të detyrës për qeverisjen dhe drejtimin e vendit kanë vendosur qytetarin dhe jetën e tij. Gjithashtu, dua të citoj këtu një shprehje të thjeshtë

të një banori të Tales më 2 janar, i cili tha: "Falemnderit, zoti Kryeministër! Ardhja juaj na jep shpresë. E ku është parë që të lëvizë e gjithë Qeveria për një fshat në ditë festive?" Pra, kjo thënie mjafton që të shprehë falënderimin, vlerësimin, sinqeritetin dhe gatishmërinë e treguar nga kjo Qeveri për t'iu gjendur pranë të gjithë banorëve të qarkut të Lezhës e Shkodrës dhe për ta përballuar situatën në mënyrë të atillë sa të minimizoheshin pasojat materiale, si dhe të eliminoheshin të gjitha pasojat në njerëz.

Përballë kësaj gatishmërie dhe mobilizimi total të Qeverisë, banorët e zonës sime dhe vetë unë nuk e kuptojmë politizimin e situatës nga opozita, "solidaritetin" që u ofruan banorëve në vështirësi, përfitimin e paturpshëm të tyre nga kjo fatkeqësi natyrore.

Të dashur kolegë,

Të mos duash të njohësh dhe të pranosh shkallën e organizimit dhe menaxhimit të situatës nga Qeveria, nga maxhoranca, mund të duket normale, por të ngjallësh panik në një situatë fatkeqësie natyrore është jonormale. Të shash Qeverinë se nuk po e menaxhon situatën si duhet për një opozitë të katandisur si kjo e jona është normale, por në kulmin e përmbytjeve të deklarosh se shkak për këtë është Qeveria, kjo është papërgjegjshmëri qytetare, është iracionalitet mendor dhe politik.

Personalisht kam ndjekur me vëmendje mirorganizimin dhe përkushtimin e Komitetit Ndërmnistror, të deputetëve të Partisë Demokratike të qarkut të Shkodrës, të autoriteteve vendore dhe kjo më ka krijuar një qetësi të brendshme për realizimin e padiskutueshëm të operacionit për shpëtimin e jetës së njerëzve. Ndërkohë më ka trishtuar thellësisht qëndrimi i pamatur dhe i papërgjegjshëm i opozitës e në mënyrë të veçantë i liderit të saj. Ndiej keqardhje edhe sonte për vendet bosh në këtë seancë të kërkuar prej tyre.

Gjatë gjithë kontakteve me njerëzit e qarkut, por dhe me të afërmit e mi në qarkun e Shkodrës kam hasur vetëm respekt dhe vlerësim maksimal për angazhimin e pashoq të Qeverisë, si dhe të strukturave shtetërore, e në të njëjtën kohë keqardhje për politizimin e fatkeqësisë natyrore nga ana e opozitës.

Kjo situatë në përmasa krejt të vogla, gati-gati të papërfillshme në krahasim me qarkun e Shkodrës, edhe qarku i Lezhës e ndjeu problemin e përmbytjes, por jo nga uji i lumenjve, nga derdhjet ose shirat e shumtë, por nga batica, nga fryrja e

detit, e cila rrezikoi disa banesa në Fushë-Kuqe, në Tale, në Shëngjin dhe në Kune, duke dëmtuar gjithashtu edhe brezin rënor të bregdetit të këtij qarku, duke prishur kështu një sasi të ngastrave të mbjella nga uji i kripur.

Dua të përfitoj nga rasti të falënderoj drejtuesit dhe administratën e autoriteteve vendore, komunat, qarkun dhe prefekturën, si dhe strukturat e PD-së të kësaj zone për angazhimin maksimal në zgjidhjen e situatës së krijuar nga batica e natës së Vitit të Ri dhe nga rrëshqitja e dherave, si rezultat i shirave të shumtë në Rrëshen dhe në Komunën e Milotit, fshati Gallatë.

Dua të falënderoj përzemërsisht të gjithë banorët e zonave të përmendura më sipër për shkallën e lartë të bashkëpunimit dhe të mirëkuptimit që më kanë dëshmuar, për përfshirjen e tyre të drejtpërdrejtë në zgjidhjen e problemit. Dua t'u siguroj atyre se projekte të tjera, edhe më të mëdha se ai i sistemimit të shtratit të lumit Drin, i cili bëri që Lezha të mos lundronte në ujin e saj, ose ai i argjinaturës së shtratit të Matit, do të bëhen realitet në këtë qark nga kjo Qeveri.

Së fundi, dua të falënderoj të gjithë ata që kanë kontribuar në forma të ndryshme, financiarisht ose me ndihma të tjera, për të përballuar situatën e emergjencës dhe të postemergjencës, si dhe t'u shpreh atyre mirënjohjen time të thellë.

Falemnderit!

Jozefina Topalli - Falemnderit, zonjusha Hoti! Fjalën e ka zoti Turku.

Ardian Turku – E nderuar zonja Kryetare, Të nderuar kolegë deputetë,

Ndodhemi këtu, në këtë seancë të jashtëzakonshme, për sprovën e madhe që po kalon vendi, sprovë kjo, në radhë të parë, e komuniteteve në zonat e përmbytura, sprovë e qeverisjeve të tyre lokale, sprovë e Qeverisë shqiptare, sprovë e të gjithë shoqërisë sonë. Për më shumë se kaq kjo ishte dhe vazhdon të jetë sprovë e demonstrimit të përgjegjësisë shtetërore nga ana e të gjitha institucioneve lokale e qendrore, e demonstrimit të përgjegjësive morale dhe shoqërore nga një mori organizatash joqeveritare ose e institucioneve të këtij lloji, sprovë e demonstrimit të një pasqyrimi me preokupim maksimal edhe nga ana e mediave. Ky ishte demonstrimi i një solidariteti të pashoq, i kësaj cilësie të vyer dhe treguesi të rëndësishëm të vitalitetit të kombit tonë, por edhe të shtetit tonë, sepse në konceptin tim, të jesh vital nuk do të thotë që të jesh patjetër i pasur, do të thotë të jesh i

ndjeshëm, energjik, të kesh aftësi organizative profesionale, të reagosh, të menaxhosh, të maksimalizosh energjitë njerëzore, të maksimalizosh resurset, të prodhosh maksimumin edhe në situata ekstreme.

Për fat të keq, fatkeqësia natyrore u bashkëshoqërua me politizimin ekstrem nga opozita, për ta përdorur si provë të drejtësisë së kauzës së saj, në fakt të aventurizmit të saj. E si gjithmonë, opozita me fjalamanët, në rrekje për të mbushur mendjet e njerëzve, për ta paraqitur katastrofën si paaftësi ose dhe më keq akoma, si e bërë me qëllim, vuri në dispozicion të gjithë arsenalin e saj njerëzor e logjistik. E përsëris, si gjithmonë, në ndjekje të kujdesshme në labirinthe e sofizmave të tyre pa fund, evidentoj se kudo harrojnë shifra e dikush shtrembëron, diku kapërcehen data, diku ndërrohet rendi i datave, e ndërmjet tyre bëhet mbushja me frazat tashmë tepër të konsumuara, që e paraqesin maxhorancën si regjimin më të zi që mund të ketë qeverisur ndonjëherë këtë vend. Në fund të fundit, është puna e saj. Ndoshta i kemi dëgjuar shumë dhe nuk ia vlen të harxhojmë kaq shumë energji me ta, sepse kemi përgjegjësinë e qeverisjes dhe duhet të djersijmë.

Sipas meje, i vetmi element ku mund të mos jenë të qartë qytetarët është nëse ka pasur shkelje në zbatimin e Rregullores së menaxhimit të digave ose jo. Unë kurrë dhe për asnjë rast nuk mund t'i lejoj vetes të bëj rolin e prokurorit, aq më tepër që kam besim të strukturat tona, që nga ministria e deri të KESH-i. Nuk mund të bëj as rolin e gjykatësit që dikton me vendimet e tij. Për hir të së vërtetës nuk mund të bëhem as avokat mbrojtës i ministrisë ose KESH-it për gjëra kaq teknike, prandaj dhe inkurajoj qetësinë, por edhe qëndrimin permanent të zotit Prifti dhe të strukturave të KESH-it për transparencën që kanë bërë dhe gatishmërinë që kanë shprehur, që edhe në të ardhmen, me dokumente autentike, të ballafaqohemi, t'i nënshtrohen ekspertizave profesionale të kujtdo, por dhe të atyre që do të kenë detyrimin t'u hedhin gjërat në letër dhe të firmosin, duke mbajtur përgjegjësi ligjore, jo të fjalamanëve.

Do të doja të fokusohesha në diçka tjetër shumë të rëndësishme:

Pushteti lokal konfirmohet edhe një herë si pikë fokale, si një segment shumë i rëndësishëm i qeverisjes, si një agregat i fuqishëm jo vetëm lëvizës, por edhe ndërlidhës e harmonizues midis komuniteteve dhe Qeverisë qendrore, midis

komuniteteve dhe institucioneve të tjera joqeveritare, madje si agregat i fuqishëm jo vetëm lëvizës, por dhe amortizues.

Zoti Basha në fjalën e tij dha disa shifra. Më bëri përshtypje fakti se përveç Komitetit Ndërmësor me 30 vetë, duke u nisur që nga Komisioni i Emergjencave Civile të qarkut të Shkodrës, duke vazhduar me Këshillin e Qarkut, Bashkinë e Shkodrës, Komunën Bushat, Ana e Malit, Dajç, Guri i Zi, Bërdicë, Velipojë dhe Komunën Qendër-Malësi e Madhe, në strukturat menaxhuese të kësaj periudhe janë 1368 vetë, shumica prej të cilëve në strukturat e pushtetit lokal dhe pushtetarë lokalë. E pamundur që situata të menaxhohej pa shkallën e njohjes, pa të dhënat, pa komunikimin e pushtetarëve lokalë me çdo qytetar në çdo shtëpi e familje; e pamundur që situata të menaxhohej pa evidentimin e çdo problemi dhe përcjelljen e tij në instancat përkatëse për vendimmarrje dhe anasjelltas, për veprime konkrete pa pushtetarët lokalë; e pamundur që situata të menaxhohej suksesshëm, duke shmangur edhe tragjedi njerëzore, pa zgjidhjet e shpejta e me operativitet të pushtetarëve lokalë. E për të gjithë këtë, për atë se çfarë kanë bërë për komunitetet e tyre meritojnë jo vetëm mirënjohjen dhe respektin e popullsisë të prekura, por edhe tonat, të të gjithë shqiptarëve.

Pushteti lokal ka përpara detyrime shumë të rëndësishme që shtrojnë fazat e mëtejshme të këtij operacioni të madh. Qeveria ka premtuar kompensimin deri në një të dëmeve të shkaktuara nga përmbytja. Ky është një operacion tjetër tejet delikat, ku mungesa e përgjegjësisë mund të prishë edhe imazhin e kësaj sprove të madhe, ndoshta mund të krijojë edhe më shumë pakënaqësi se vetë përmbytja, për të cilën mund të them se banorët e përballuan me dinjitet. Unë jam i bindur se edhe në këtë rast të zgjedhurit lokalë me strukturat e tyre do të jenë në lartësinë e detyrës.

Tashmë e gjithë Shqipëria është përfshirë në një aksion të madh humanitar. Çdo qytetar po e përjeton si shqetësim të vetin dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë shqetësimin e komuniteteve të prekura nga përmbytja. Në të gjithë vendin po evidentohet qartë fuqia e solidaritetit vëllazëror, si një nga tiparet më fisnike të shoqërisë shqiptare. Me kënaqësi konstatojmë se raporti i individit në shoqëri po shkon dita-ditës në kuotat më të larta të përsosmërisë dhe bashkëpunimit. Krahas njësive të qeverisjes vendore, për të kontribuar me të ardhurat e tyre personale janë angazhuar edhe qytetarë të thjeshtë të çdo

moshe, punonjësit e administratës, biznesmenët vendas, shoqatat humanitare, shkollat etj.

Dita-ditës spektrit politik të të zgjedhurve vendorë të djathtë po i shtohen me humanizëm edhe përfaqësues vendorë të Partisë Socialiste dhe asaj të të Drejtave të Njeriut, si dhe shumë shoqata, aktivistë të shoqërisë civile. E konsideroj si shumë pozitive këtë që po ndodh. Nga informacione të ndryshme që jam përpjekur të mbledh nëpërmjet Shoqatës së Komunave, Shoqatës së Qarqeve dhe Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë, mund të jap disa shifra si më poshtë:

Sipas Shoqatës së Komunave, nga komuna të ndryshme janë raportuar ndihma financiare me vlerë 143,8 milionë lekë të vjetra, disa prej të cilave po lëvrohen, ndërsa shumata e tjera janë në procedura e miratime në këshillat komunalë, po kështu dhe rreth 9 mijë euro, rreth 20 milionë lekë ushqime tashmë të dërguara dhe rreth 5 milionë lekë ushqime për kafshët.

Nga Shoqata e Qarqeve të Shqipërisë, në procedura me këshillat e qarqeve, janë të konfirmuara 10 qarqe që nuk janë prekur nga përmbytja, të cilat kanë dhënë ndihma me vlerë 6 mijë euro secili, të konvertuara në lekë shqiptare, pra në total 60 mijë euro.

Nga Shoqata e Bashkive të Shqipërisë informohemi se pothuajse të gjitha bashkitë po planifikojnë shuma të konsiderueshme, që presin t'i miratojnë në këshillat përkatëse, si më të fuqishme financiarisht se njësitë e tjera të pushtetit lokal. Është e pritshme se shuma do të jetë e konsiderueshme nga anëtarët e kësaj shoqate, që janë bashkitë e vendit.

Sado të konsiderueshme të jenë këto shuma, buxheti i shtetit do të jetë ai që do të mbajë peshën më të madhe të kompensimit. Por për mua si individ rëndësi absolute ka të kuptuarit e rëndësisë së këtij solidarizimi, të kuptuarit se përtej asaj nuk do të dëshironim kurrë të kishim katastrofa të tjera, të asnjë lloji. Asnjëherë, as unë dhe askush tjetër nuk mund të jetë i imunizuar prej tyre dhe askush nuk do të mund t'i përballonte i vetëm edhe në të ardhmen. Pikërisht për këtë arsye ka shumë rëndësi ky solidaritet.

Falemnderit!

Jozefina Topalli- Falemnderit, zoti Turku!

Fjalën e ka zoti Bushati.

Astrit Bushati - E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Asnjë nga ne nuk do ta kishte dëshiruar një

seancë të tillë, ku të flitej për një fatkeqësi natyrore në një zonë të Shqipërisë. Sigurisht që fatkeqësitë janë pjesë e jetës dhe që përmasat e tyre të mos përshkallëzohen kërkohet forcë, besim, përkushtim dhe transparencë.

Një fatkeqësi e tillë ndodhi në zonën e Shkodrës, ku prej reshjeve më se 1-mujore, shkrirjes së dëborës dhe rritjes së nivelit të detit, si asnjëherë më parë, Ultësira e Nënshkodrës dhe një pjesë e qytetit të saj, për një periudhë dyjavore, pritën dhe po përcjellin rreth 3 miliardë metër kub ujë. Kjo sasi uji përmbysi rreth 11 mijë hektarë tokë dhe më shumë se 2600 banesa. Sikur këto të dhëna t'i jepeshin paraprakisht një eksperti të emergjencave civile, sigurisht që do të kishte thënë se në këtë rast numri i të vdekurve duhet të kishte qenë më shumë se 100 vetë dhe numri i bagëtive të humbura më shumë se 2 mijë, pa llogaritur dëme të tjera. Por nuk ndodhi kështu, sepse Kryeministri i vendit, pa filluar ende gjendja e emergjencës, ishte në qytetin e Shkodrës për të evituar katastrofën, duke u bërë thirrje qytetarëve të zonave që të fillonin evakuimin e njerëzve, kryesisht të moshuarve, grave dhe fëmijëve.

Gjej rastin që në emër të qytetarëve të Shkodrës, por kryesisht të atyre që e përjetuan fatkeqësinë natyrore drejtpërdrejt, të falënderoj Kryeministrin Berisha për kryesimin me sukses të një aksioni humanitar që shpëtoi jetët e njerëzve, të gjësë së gjallë, por edhe ndërmori nismën e dëmshpërblimit të çdo humbjeje nga përmbytja.

Nuk ndodhi ashtu siç mund të ishte parashikuar, sepse makina e shtetit funksionoi 24 orë, duke nisur nga celulati më të vogla, që nga kryeqendri, nga shtabet e emergjencave të komunave, komisionet e emergjencave në prefekturën e Shkodrës, Komitetin Ndërmëntor të atashuar në Shkodër, drejtuesit e KESH-it, drejtuesit e emergjencave civile, të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, të zjarrfikësve etj.

I falënderoj të gjithë në emër të qytetarëve të Shkodrës!

Gjej rastin të falënderoj deputetët që mbështetën dhe u gjendën pranë familjeve në fatkeqësi. Në emër të shkodranëve, gjej rastin të falënderoj të gjithë shqiptarët, individë dhe institucione, brenda dhe jashtë territorit shtetëror, për mbështetjen e tyre morale dhe materiale në lehtësimin e dhimbjeve të fatkeqësisë

Gjithashtu, falënderoj të gjithë organizmat e huaja, shoqatat, qeveritë, ndërmarrjet e kompanitë

private që kontribuan dhe u shprehën solidarë me qytetarët e prekur nga fatkeqësia!

Tashmë ne jemi në pragun e daljes nga emergjenca, por sërish dua të falënderoj si faktorë kryesorë të përballimit me sukses të kësaj fatkeqësie banorët e zonave të përmbytura dhe atyre përreth, të cilët me fisnikërinë, me forcën, me solidaritetin, këmbënguljen dhe gjakftohtësinë e tyre, i bënë ballë kësaj situatë të jashtëzakonshme.

Normalisht, në një situatë të ngjashme fjala duhet mbyllur vetëm me falënderime, pasi hollësitë e operacioneve të Komitetit Ndërmnistror dhe Komisionit të Emergjencës u detajuan nga kolegët. Por jemi të detyruar t'u japim përgjigje disa hienave të politikës, që ngasin turravrap pas fatkeqësive të të tjerëve për t'u ushqyer me to. Sigurisht që në zonën e Shkodrës dhe në zonat e përmbytura helmi i tyre nuk zë vend, pasi i kanë provuar përmbytjet edhe në kohën e tyre.

Cili do të ishte dallimi mes menaxhimit të dy situatave analoge dhe menaxhimit të shkarkimeve dhe përmbytjeve të vitit 2004 me atë të sotmen? Përveç përmasave, të cilat janë të pakrahasueshme, sepse sasia e ujit në situatën e këtyre ditëve ka qenë 3 herë më e madhe sesa ajo e vitit 2004, ato dallojnë në 3 elemente kryesore:

Së pari, pranë pushtetit lokal të Shkodrës, komunave e bashkive që u prekën nga përmbytja e vitit 2004, nuk ka pasur asnjëherë asnjë informacion nga KESH-i apo Qeveria e asaj kohe dhe ministri Viktor Doda. Ndërkohë që në ditët që ne kaluam është bërë e ditur në çdo moment, në çdo orë, sasia e shkarkimeve nga secili hidrocentral.

Së dyti, në vitin 2004, megjithëse shkarkohej edhe në masën 3.000-3.500 metra kub në sekondë dhe nuk prodhohej asnjë kilovator energji për të ulur humbjet, i gjithë rrethi i Shkodrës ishte me 6 orë energji në 24 orë, përsëri me urdhër të ministrit Doda. Ndërkohë që përveç dy fshatrave, në situatën e sotme, në asnjë zonë tjetër të përmbytur nuk ka munguar asnjë çast energjia elektrike.

E treta, në vitin 2004, pas përfundimit të përmbytjeve, që arritën deri në mesin e qytetit të Shkodrës, nuk pati asnjë dëmshpërblim për zonat e përmbytura, që ishin pothuajse sa këto të sotmet.

Këtu nuk po përmend një faktor të katërt, i cili ka të bëjë me menaxhimin e kaskadës dhe politikën e dëmshpërblimit dhe solidaritetin njerëzor. Në vitin 2004 nuk pati asnjë solidarizim, as vizita të qeveritarëve në zonat e përmbytura, përveç vizitës së kryetarit të opozitës së asaj kohe, zotit Sali

Berisha. Ndërkohë që në këto 2 javë, Kryeministri ka qenë 6 herë, pa folur për Kryetaren e Parlamentit që ka qenë çdo ditë, pa folur për deputetët, të cilët kanë qenë së bashku me ministrat e Komitetit Ndërmnistror në ndjekje të situatës hap pas hapi.

Ndërkohë, hienat e politikës fillimisht tentuan të organizonin panik kolektiv, por nuk ia arritën. Pastaj erdhën në kërkim të viktimave njerëzore nga përmbytjet, por nuk i gjetën. Pastaj, krahu për krahu me gazetarët e mediave të majta, u vunë në kërkim të kafshëve të ngordhura, por përsëri nuk i gjetën. Tani janë vënë në kërkim të epidemive dhe viruseve, por përsëri nuk po i gjejnë dot. Janë vënë edhe në kërkim të ndihmave të trafikuar dhe nuk po i gjejnë. E vetmja gjë që po gjen kukuvajka e Edvinit për Shkodrën, Ilir Beqja, është përbuzja e qytetarëve të Shkodrës.

Tashmë Qeveria "Berisha" është angazhuar në projekte serioze për sistemimin e rajonit ujëmbledhës të Shkodrës, për ta kthyer atë, që dje ishte një kërcënim, në një mundësi të madhe zhvillimi të gjithanshëm turistik dhe ekonomik të këtij rajoni.

Ju falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Bushati!
Zoti Olldashi e ka fjalën.

Sokol Olldashi- Falemnderit, zonja Kryetare!
Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Në radhë të parë do të doja të falënderoja të gjithë banorët e zonës së Shkodrës, të qytetit, të Nënshkodrës dhe të komunave të përmbytura, t'u shprehja mirënjohjen dhe respektin tim më të thellë për kurajën, për gjakftohtësinë, për solidaritetin, për zemërgjerësinë dhe për dinjitetin që treguan në përballimin e këtyre ditëve kaq të vështira për ta dhe shumë impenjative për ne, cilësi këto që e bënë shumë më të lehtë punën e gjithsecilit prej anëtarëve të Komitetit Ndërmnistror të Emergjencave, por edhe të pushtetit lokal, të deputetëve, të të gjithë aktorëve që u angazhuan për të zgjidhur problemin. Ka qenë një ndihmë shumë e madhe që meriton falënderimet më të thella të gjithsecilit prej nesh.

Në kuadër të Komitetit Ndërmnistror të Emergjencës kam qenë i angazhuar dhe i ngarkuar me detyrën e mbajtjes nën monitorim të situatës së infrastrukturës rrugore dhe veçanërisht të infrastrukturës së ujësjellësve dhe, në pikëpamjen e organizimit, sipas njësive të qeverisjes vendore, kam qenë i ngarkuar të ndjek situatën në komunën e Bushatit, një ndër më të goditurat nga përmbytjet.

Në mënyrë të përmbledhur po ju raportoj se ç'është bërë dhe si është përballuar situata.

Situata më emergjente që u paraqit që ditën e parë të përmbytjes ka qenë situata me stacionet e pompimit të ujësjellësve të zonës së fshatit, por edhe të ujësjellësit të qytetit, megjithëse ky me më pak probleme sesa të tjerët.

Kemi pasur gjithsej 32 pompa nën ujë, në Bërdicën e Sipërme, në Bërdicën e Madhe, në Zus, Oblig, Zogaj, Hajmel, Obot i Ri, Mali Hebe, në Trush dhe në Velipojë. Në sajë të angazhimi 24-orësh të 20 punonjësve të ndërmarrjes së ujësjellësit për fshatin është bërë e mundur që të gjitha këto stacione të jenë sot në gjendje efektive pune, të padëmtuara, duke kursyer kështu miliona euro investime të bëra për këto sisteme, por nga ana tjetër duke mënjanuar një situatë që mund të ishte shumë më e komplikuar në rast se stacionet do të kishin dalë jashtë funksionimit dhe sot do të kishim mijëra familje në nevojë për furnizim me ujë.

Edhe në këtë rast më duhet të falënderoj punonjësit e ujësjellësit, qoftë të qytetit, qoftë të fshatit, për impenjimin e tyre, për sakrificën që kanë bërë (disa prej tyre kanë ndenjur me ditë të tëra në ishuj, siç ishin kthyer stacionet, të izoluar nga të katër anët nga uji), pa u ankuar asnjë minutë, pa u shmangur asnjë minutë nga detyrimi për të mbrojtur punën e tyre dhe investimet që kjo Qeveri ka bërë në zonë.

U morën masa nëpërmjet shtabit të emergjencës për t'u vajtur në ndihmë. Kemi çuar 10 pompa për të nxjerrë ujin nga stacionet, 698 thasë me rërë për të bërë izolimin e tyre, për t'i mbajtur si ishuj të mbyllur dhe në këtë mënyrë u bë e mundur që stacionet sot të jenë në rregull.

Për sa u përket rrugëve nacionale, problemin kryesor e kemi pasur në aksin nacional Tiranë-Shkodër, për dy ditë, në atë vend që quhet Harku i Bërdicës, apo në kthesën e Velipojës, për shkak të prezencës së ujit, një problem që zgjati për rreth 48 orë, por që nuk shkaktoi vështirësi qarkullimi për shkak se u morën masat bashkë me Policinë e Shtetit që trafiku i mjeteve të vogla të devijojë në itinerarin Shkodër-Mjedë-Tiranë, ndërkohë që trafiku i mjeteve të rënda të vazhonte përmes rrugës nacionale nga Harku i Bërdicës.

U ndërhy nëpërmjet Drejtorisë Rajonale të Rrugëve për përforcimin e urës së Spatharit me 1.550 metra kub inerte dhe me 960 metra kub inerte për mbrojtjen e ujësjellësit të qytetit, me 130 metra kub për mbajtjen të kalueshme të urës së vjetër të Bunës që lidh Shkodrën me Muriqanin dhe në këtë operacion të Drejtorisë Rajonale të Shkodrës u

angazhuan të 40 punonjësit e kësaj drejtorie, të cilët përsëri meritojnë falënderimet e të gjithëve.

Konkretisht, gjendja e rrugëve nacionale sot paraqitet e tillë:

Rruga Ura e Bunës – Shirokë është e qarkullueshme edhe me automjete të vogla, në lagjen Ajasëm, megjithëse ka pasur rënie të nivelit të ujit, ende janë disa banesa që kani prani uji, në rruga Bërdicë-Dajç, te kthesa e Dajçit është e kalueshme nga automjetet e larta (kamionë), ende e pakalueshme nga veturat; rruga Pentar-Velipojë është ende e pakalueshme, rrugët e brendshme të qendrës së komunës së Dajçit janë të kalueshme nga të gjitha automjetet; ura e Gjon Lulit, në aksin Shkodër-Velipojë është e kalueshme nga mjete të larta; rruga nga Mali i Jushit në Velipojë, me drejtimin nga Benti, është e kalueshme me mjete të larta; rrugët nga qendra e komunës me të gjitha fshatrat e Velipojës janë të kalueshme; në Bërdicë qarkullimi në të gjithë akset është normal, me përjashtim të segmentit Ana e Malit- Obot që është me probleme dhe vështirësisht i kalueshëm nga mjetet e larta.

Në komunën e Bushatit, me gjithë praninë e ujit në Malin e Jushit, rruga është e kalueshme dhe të gjitha fshatrat e tjerë të kësaj komune janë të arritshëm nga të gjitha mjetet e transportit. Kemi situatë pa probleme në qarkullim edhe në komunën e Gurit të Zi, veçanërisht në fshatrat Kush dhe Rrenc që kanë qenë më problematikët.

Për sa i përket impenjimit në komunën e Bushatit, më duhet të informoj se u evakuan gjatë operacionit 300 persona dhe 530 bagëti dhe u bë e mundur që jo vetëm të mos kemi humbje në jetë njerëzore, që ishte impenjimi ynë kryesor, por me asistencën shumë të mirë të forcave të ushtrisë, të Policisë së Shtetit, të ekipeve që erdhën nga Kosova dhe Maqedonia, bëmë të mundur edhe evakuimin e bagëtive për këtë komunë me drejtim të fortë blegtoral.

Kemi bërë furnizimin gjatë këtyre ditëve me 40 mijë kilogramë artikuj ushqimorë, me 45 mijë litra ujë të pijshëm, me rreth 2 mijë litra detergjentë dhe sapun, me 65 mijë kilogramë koncentrat për bagëtinë, 85 tonë bar, 10 mijë kilogramë miell, çadra, batanije dhe rreth 2.200 kilogramë ushqime të konservuara.

Kemi ezauruar tërësisht kërkesat e komunës për bazë ushqimore, qoftë për banorët e komunës, qoftë për gjënë e gjallë dhe kemi krijuar një rezervë për ditët që do të vijnë, për sa kohë situata do të jetë e përmirësuar apo të jetë kthyer në normalitet

në të gjitha drejtimet.

Do të doja të falënderoja edhe këtu kryetarin e komunës së Bushatit, zoti Zef Hila, për angazhimin e tij të jashtëzakonshëm, por edhe kryepleqtë e disa fshatrave me probleme. Do të doja të falënderoja drejtuesit lokalë të fshatit Mali i Jushit, Frang Curri, Tom Kola, ndonjëri prej tyre i Partisë Socialiste, për angazhimin që patën në shpërndarjen e të gjitha ndihmave që u dhanë këtij fshati.

Ka pasur një solidaritet të jashtëzakonshëm edhe nga komunat e qarkut të Fierit. Si deputet i këtij qarku kam bërë një apel dhe do të doja t'i falënderoja të gjithë ata që menjëherë iu përgjigjën këtij apeli dhe erdhën në ndihmë të komunave të Shkodrës, veçanërisht komunës së Bushatit.

Do të doja të falënderoja komunën Qendër në Mallakastër, Qendër në Fier, komunën Zharrës, Strumë, Krutje, Divjakë, Dushk, Grabjan, Tërbuf, Kolonjë (më falni nëse kam harruar ndonjë) për solidaritetin e shprehur duke siguruar bazë ushqimore, sidomos për bagëtinë, por edhe ushqime për banorët e komunave.

Zonja Kryetare,

Sigurisht që debati në një seancë të jashtëzakonshme për problemet e përmbytjeve në Shkodër është i mirëpritur nga të gjithë njerëzit që e kanë ndjekur me vëmendje të veçantë atë që ka ndodhur këto ditë në këtë qark, por, në një farë mënyre, kjo seancë zhvillohet në vazhdimësi. Pse? Ne, praktikisht, kemi qenë në seancë, nuk kemi qenë të mbledhur në sallën e Parlamentit, por e gjithë Qeveria, pothuajse të gjithë deputetët e maxhorancës kanë qenë këto ditë në Shkodër. Pra, ne kemi qenë në një seancë të vazhdueshme, çdo orë, çdo ditë të kësaj periudhe që kemi pasur përmbytjet në Shkodër dhe do të ishte mirë që sot këtu të ishin ata që s'janë, ata që s'janë dhe ata që e kërkuan këtë seancë, ata që dolën paturpësisht në televizione dhe gënjen duke thënë se donin një seancë të jashtëzakonshme për Shkodrën që të ktheheshin në Parlament dhe sot mungojnë, ata që dolën dhe u përgjyruan për hallet e Shkodrës dhe të shkodranëve dhe që sot u kanë kthyer kurrizin, sikurse ua kishin kthyer kurrizin edhe dje, edhe pardje, por menduan se me një manovër demagogjike do të arrinin t'ia hidhnin. Nuk është aspak kështu as për zotin Beqja, që parapëlqen të quhet biri i Shkodrës, që doli paturpësisht para të gjithëve dhe tha se do të vinte në Parlament. Nuk është sot. Nuk ishte as dje, kur të gjithë ne, bashkë me deputetët e Shkodrës, shpërndanim ndihma

nëpër komuna. Pra, është e gjitha vetëm një propagandë e turpshme, e pistë, e padenjë, e pacipë, e ndërmarrë nga kryetari i PS-së zoti Rama, i cili nuk ka asnjë lidhje jo vetëm me Shkodrën, por me asnjë nga qytetet e këtij vendi, sepse nuk i intereson fati i asnjë individi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të njërit dhe ky është vetë zoti Rama.

Na ka akuzuar se e përmbytëm Shkodrën, se bëmë këtë, se bëmë atë dhe kur i jemi përgjigjur na ka thënë që të mos bënim politikë për fatkeqësinë, sepse kështu keni bërë ju kur keni qenë në opozitë. Nuk kemi bërë kështu ne kur kemi qenë në opozitë, nuk kemi akuzuar ne në vitin 2004 se pati përmbytje në Shkodër, por akuzuam Qeverinë, me shumë të drejtë, se në vitin 2004 kur e përmbytëm Shkodrën, u zhdukën, asnjë nga anëtarët e Qeverisë së atëhershme, asnjë nga administrata e atëhershme, nuk vajti qoftë edhe një ditë në Shkodër të jepte qoftë edhe një ndihmë të vetme, të takonte qoftë edhe një qytetar të vetëm.

E njëjta gjë ka ndodhur në vitin 2003, kur përmbyti Tiranën. Nuk është e njëjtë situata. E akuzuam vërtet ne atëherë zotin Rama, por e akuzuam, sepse në një ditë me diell, kur nuk binte asnjë pikë shi, vajti një i marrë atje, hapi portat dhe mbyti gjysmën e qytetit dhe nuk pagoi asnjë nga dëmet që u shkaktoi lagjeve të tëra të kryeqytetit. Pra, janë dy gjëra krejt të ndryshme. E akuzuam ne vërtet Qeverinë për ngjarjet e 9 janarit, por e akuzuam vetëm për mosveprimin e vet, sepse kur njerëzit që ishin në mes të detit kërkonin ndihmë, të gjithë mbyllën telefonat, duke filluar nga ministri i Mbrojtjes e ministri i Brendshëm, pavarësisht se të gjithë tragjedinë e kishin organizuar strukturat shtetërore. Pra, janë gjëra krejt të ndryshme.

Nuk është se po bëhet politikë me ngjarjen. Ne treguam përgjegjësinë tonë si qeverisje, si maxhorancë dhe iu gjendëm pranë të gjithë atyre që kishin nevojë për ne në një rrethanë natyrore shumë të vështirë, në një rrethanë natyrore shkencërisht të vërtetuar që ndodh një herë në 100 vjet. Megjithatë, ia dolëm ta menaxhonim në mënyrën më të mirë të mundshme, ia dolëm ta menaxhojmë pa pasur asnjë viktimë, pa pasur humbje të gjësë së gjallë. Do ta vazhdojmë këtë operacion deri sa e gjithë situata në qytetin e Shkodrës, por veçanërisht në komunat e përmbytura, në zonat rurale të Shkodrës, të kthehet aty ku ka qenë, të kthehet në përditshmërinë e saj normale. Ne e morëm përsipër këtë punë dhe do ta çojmë

deri në fund, do ta kryejmë si një detyrim normal qytetar, por edhe qeveritar që kemi ndaj asaj zone, si ndaj çdo zone tjetër të Shqipërisë.

U tha që po mbledhin ndihma. Nxorën dy kuti te sheshi "Skënderbej" dhe bënë sikur hidhnin lekë, por ndërkohë që Këshilli Bashkiak, këshilltarët e PD-së dhe të LSI-së kërkonin që të votohej paketa për të ndihmuar Shkodrën, votuan kundër. Ajo që po bën zoti Rama është një gjë shumë cinike, shumë e ligë.

Do të më lejoni t'ju tregoj një histori që mund të tingëllojë si humor i zi, por, në fakt, është një ngjarje e vërtetë: Ka qenë dikur në Selenicë të Vlorës një njeri që quhej Refat, i cili ishte aq i varfër, sa jetonte duke shkuar për vizita vdekjesh dhe kthehej gjithmonë i lumtur, sepse kur e pyesnin, u thoshte se hedh një paketë e pi dy, po ha edhe një drekë, po fus edhe ndonjë kore bukë në xhep t'ua çoj kalamajve. Varfëria ekstreme e kohës së komunizmit që për shumë nga ju është e njohur. Një ditë Refati u pa i mërziur dhe kur e pyetën ç'ke, tha se ishte ditë e keqe: sot rrojnë të gjithë, ngela pa bukë.

Kjo është politika e Edi Ramës dhe kjo është politika që nuk të çon asgjëkund. Nuk ka asnjë fatkeqësi natyrore së cilës një administratë e përgjegjshme nuk mund t'i bëjë ballë. Ka pasur një shprehje që me ujin, zjarrin dhe qeverinë nuk luhet. Ne dëshmuam këto ditë që me ujin luhet, kur ke një qeveri që të mbështet. Ka vetëm një fatkeqësi natyrore së cilës ne nuk kemi në mend t'i bëjmë ballë, sepse nuk duam ta trajtojmë. E vetmja gjë që do të bëjmë ndaj saj është që të bëjmë argjinaturat ligjore të ngritura për t'i vënë kufirin te thana dhe kjo fatkeqësi nuk është natyrore, por është humane dhe quhet Edi Rama.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Olldashi! Urdhëroni, zoti Demi!

Leonard Demi – Falemnderit, zonja Kryetare! Të nderuar kolegë,

Përmbytja është një fenomen i përvitshëm global, i cili është intensifikuar vitet e fundit për shkak të ndryshimeve të motit. Vetëm këtë muaj janë përmbytur mijëra vende rreth botës, në të gjitha kontinentet, në Europë, Amerikë, Azi, Afrikë dhe Oqeani. Kudo që kanë ndodhur përmbytjet kanë shkaktuar vdekje të shumta, kanë prishur shtëpi, kanë prishur të lashta, kanë sjellë sëmundje, shpërngulje, si dhe kanë krijuar kushte të rënda jetese dhe vështirësi të mëdha ekonomike. Kjo gjë nuk ndodhi në Shkodër, nuk ndodhi për shkak të

atyre që dëgjuam nga Kryeministri, nga ministrat, nga Komisioni Ndërmëntor, nga angazhimi i deputetëve të Shkodrës, i zonjës Topalli dhe i mbështetjes dhe solidaritetit të të gjithë shqiptarëve. Kjo është për t'u lavdëruar, për këtë ne jemi krenarë dhe shprehim gjithë mirënjohjen tonë sonte.

Në emër të Komisionit të Sigurisë dua të bëj të njohur dhe të shpreh mirënjohje të thellë për Forcat tona të Armatosura dhe për Policinë e Shtetit. Dua të shpreh mirënjohje për Brigadën e Reagimit të Shpejtë, për Regjimentin Komando, për Brigadën e Mbrojtjes Rajonale, për Regjimentin e Infrastrukturës, për Brigadën Mbështetëse, për Brigadën Ajrore, të cilat jo vetëm që morëm pjesë me qindra trupa, por vunë në shërbim të kësaj fatkeqësie të madhe natyrore kapacitete të shumta ushtarake. Operacionet e Forcave të Armatosura përfshinë shpëtimin e të përmbyturve, evakuimin e popullsisë dhe të gjësë së gjallë, përforcimin dhe përmirësimin e argjinaturave në zonën e Dajçit dhe të Velipojës dhe kudo në zonat e përmbytura, gatishmërinë dhe mirëfunksionimin e pompave të ujit dhe të stacioneve elektrike.

Forcat tona të Armatosura bashkëpunuan ngushtë me Komisionin Ndërmëntor, Komisionin e Emergjencave të Qarkut të Shkodrës, me ekipet e vendeve aleate, trupat civile greke, maqedonase, italiane, trupat e Forcës së Sigurisë së Kosovës, si dhe organizatat e tjera qeveritare dhe joqeveritare. Në këtë detyrë kushtetuese ato, për herë të parë, vepruan me sukses në operacione konkrete të politikës europiane të sigurisë dhe të mbrojtjes, gjë që tregon më së miri karshi gjithë Europës se sa të integruara dhe të afta janë për të kryere detyra të rëndësishme, në situata tepër të vështira. Këto forca, krahas detyrave të Aleancës dhe të marrjes pjesë në operacionet e mbështetjes së paqes, janë të gatshme të kryejnë me sukses operacione që ka merr përsipër të kryej BE-ja dhe për këtë ne jemi të gjithë krenarë dhe po i përshëndesim sot nga kjo tribunë.

Gjithashtu, Policia e Shtetit, ashtu siç vuri në dukje zoti Basha, ka falënderime të mëdha nga komisioni ynë dhe nga të gjithë ata që e kanë ndjekur në këto ditë të vështira. Forcat e saj morën pjesë në operacionet e evakuimit të banorëve të zonës së përmbytur, të evakuimit të gjësë së gjallë, në ruajtjen e rendit në zonat e përmbytura, duke bërë që të mos ndodhte asnjë ngjarje e jashtëzakonshme dhe kjo ishte një nga detyrat kryesore dhe më të rëndësishme të kësaj shtate. Korrektësia dhe

përkushtimi që treguan ushtarakët, si të Forcave të Armatosura ashtu edhe të Policisë së Shtetit, kanë qenë shembull për të gjithë ne dhe unë sonte gjej rastin t'i falënderoj në emër të Komisionit të Sigurisë Kombëtare.

Zonja Kryetare,

Të nderuar deputetë,

Si deputet i rrethit të Sarandës dhe Delvinës jam krenar për solidaritetin dhe altruizmin e qytetarëve të të dy rretheve dhe përkushtimin për të ndihmuar në fatkeqësinë e banorëve të përmblytur të rrethit të Shkodrës. Bashkia e Sarandës ka vënë në dispozicion 50 milionë lekë, plus ndihmat e mëdha të të gjitha komunave të të dy qyteteve. Bashkia e Delvinës ka vënë në shërbim 5 mijë euro. Nga kjo tribunë dua të veçoj Ndërmarrjen e Ujësjetës të qytetit të Sarandës, Shtëpinë e Fëmijës dhe Shtëpinë e të Moshuarve, të cilët kanë dhënë në shërbim të të përmblyturve të gjithë atë që kishin. Njëkohësisht, dua të falënderoj edhe drejtuesin e PD-së të qytetit të Sarandës dhe kryetarin e bashkisë.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Demi!

Urdhëroni, zoti Sterkaj!

Paulin Sterkaj – E nderuar zonja Kryetare,

I nderur zoti Kryeministër,

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Si deputet i qarkut të Shkodrës jam këtu për të falënderuar dhe shprehur mirënjohjen time më të thellë për Kryeministrin, zotin Berisha, Kryetaren e Kuvendit, zonjën Topalli, kryetarin e Këshillit Ndërmnistror për Emergjencën, zotin Basha, si dhe të gjithë ministrat e Qeverisë shqiptare për përballimin me sukses të përmblytjeve që goditën zonën e Nënshkodrës. Njëkohësisht, falënderoj edhe deputetët e qarkut të Shkodrës, gjithashtu edhe deputetët të tjerë që dhanë mbështetjen e tyre për kalimin e kësaj emergjence.

Falënderimin e dytë e kam për dinjitetin dhe qytetarinë e bashkëqytetarëve të mi. Qofshin të nderuar për qëndrimin e tyre! Garantoj të gjithë shqiptarët dhe në mënyrë të veçantë opozitën se përmblytja ishte një fatkeqësi e pastër natyrore. Shkaqet e përmblytjes i thanë edhe deputetët të tjerë, i tha edhe Kryeministri, i thanë ministrat, pra, kanë ardhur nga reshjet e mëdha, prurjet nga Alpet dhe nga lumenjtë anësorë, siç është Kiri, Moraça, Gjadri, gjithashtu edhe prurjet e ujërave nëntokësore të liqenit të Shkodrës.

Unë do të kisha thënë që kaskada e Drinit dhe

rezervuari i Shtodrit në Shkodër në vitet e fundit nuk kanë shërbyer asnjëherë për përmblytjen e Shkodrës, por janë për stabilizimin e sistemit hidrik, por në raste të veçanta siç ishte ky, u pa e pamundur përballimi me rezervuarët që kanë ato. Këto raste ndodhin një në shekull.

Si deputet i Komisionit të Sigurisë Kombëtare shpreh mirënjohjen për Forcat e Armatosura dhe ato të Policisë së Shtetit për kontributin që dhanë në përballimin e emergjencave. Ishte puna e jashtëzakonshme e Qeverisë dhe koordinimi i veprimeve me organet përgjegjëse të KESH-it dhe Ministrisë së Energjetikës që shpëtuan Shkodrën nga një katastrofë si pasojë e reshjeve. Objektivi kryesor ishte që të mos shkatohej asnjë viktimë dhe kjo u realizua, ku meritën më të madhe e ka Qeveria, që si asnjëherë tjetër u tregua e gatshme për të përballuar një nga përmblytjet më të mëdha që goditën Shkodrën dhe rrethinat e saj. Shkodra ka qenë gjithmonë e kërcënuar nga përmblytjet.

Strategjia më e turpshme në histori ishte ajo e përdorimit të politikës për situatën e krijuar nga reshjet. Opozita tregoi edhe njëherë qorrsoakun ku e ka futur kryetari i saj Edi Rama. Qeveria shqiptare, së bashku me të gjitha institucionet e shtetit shqiptar, mirëmenaxhuan situatën e krijuar duke dalë fitimtarë nga ajo situatë aq e vështirë. Jam këtu sot për të garantuar të gjithë banorët e zonave të përmblytura se Qeveria do t'i dëmshpërblejë të gjithë sipas dëmtimeve që kanë pësuar. Përballimi i kësaj situatë bëri si asnjëherë tjetër në historinë e Shqipërisë të mos humbë asnjë jetë njerëzore.

Ky operacion është një ndër operacionet më të suksesshme që ka organizuar ndonjëherë Qeveria shqiptare. U realizuan me sukses operacionet e emergjencave të cilët bënë të mundur evokimin, transportimin e ushqimeve për njerëzit dhe gjënë e gjallë, sigurimin e energjisë elektrike në 24 orë në të gjitha qendrat spitalore në zonat e përmblytura.

Përgjigjen më të mirë opozitës shqiptare ia dha pak ditë më parë eurodeputetja Doris Pack, e cila kritikoi qëndrimin e opozitës, për sa i përket përmblytjes në Veri-Perëndim të Shqipërisë. Ajo tha: "Më kujtohet përmblytja në Gjermani disa vjet më parë. Këto janë gjëra që ndodhin rrallë. Si rrjedhim mund t'ju them se janë dy gjëra të ndryshme të jesh i përgatitur për këtë dhe të menaxhosh situatën. Menaxhimi i Qeverisë shqiptare ka bërë atë që duhej dhe unë dua t'i përgëzoj për punën e mirë që kanë bërë ushtria, Qeveria për organizimin e operacioneve

dhe aktorëve të tjerë në terren.

Mendoj se zoti Rama nuk e ka mësuar mësimin, pasi ai përmytjet po i përdor për diskutime partiake. Siç e lexoj në shtyp është e turpshme, pasi kur kujtoj përmytjet e mëdha në Gjermani, të gjithë forcat politike u bashkuan dhe nuk akuzuan qeverinë. Kjo është një situatë ku shqiptarët duhet të qëndrojnë së bashku.” Zoti Rama, për mua i zhyturi, pretendoi të përfitonte nga të përmyturit. Përballimi me sukses i përmytjeve në zonën e Nënshkodrës ishte një goditje shumë e fortë për politikën e Partisë Socialiste dhe të Edvinit, i cili e ka kthyer Partinë Socialiste, siç thonë vetë opozitarët, në një OJQ ndërtimi.

Zoti i madh na ruajt nga fatkeqësitë si në Haiti! Imagjinoni se çfarë shansi do të kishte Edi Rama një situatë të tillë të ngjashme! Opozita kërkoi të manipulojë dhe të përfitojë nga fatkeqësitë. Këto fatkeqësi asnjëherë nuk duhet të përdoren politikisht nga opozita. Thirrja ime për opozitën është që të vijë në Parlament dhe të dalë nga përmytjet, ashtu siç doli zona e Nënshkodrës.

Lajmi i fundit na vjen nga kolegët e grupit parlamentar të Partisë Socialiste se kuotat e Partisë Socialiste kanë shkuar në masën 196 metra. I bëj thirrje kryetarit të saj të hapë digat dhe t'i lejojë deputetët të vijnë në Parlament, se do të ketë probleme përmytjeje brenda partisë së vet.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Sterkaj!
Zoti Çota, urdhëroni!

Rrahim Çota – E nderuar zonja Kryetare,
I nderuar zoti Kryeministër,
Të nderuar kolegë deputetë,

Në vazhdimin e transparencës së Qeverisë ishte e domosdoshme thirrja e kësaj seance të jashtëzakonshme parlamentare, e cila merr shkas nga ngjarjet në qarqet e Shkodrës dhe të Lezhës, të klasifikuara nga ekspertët e vendit dhe të huaj si katastrofë natyrore. Transparenca, si nevojë dhe rregull më elementar i një shoqërie demokratike, respekton dialogun me të gjithë faktorët konstruktivë të zhvillimit të vendit dhe ata që i vijnë në mbështetje të arsyetimit se katastrofa natyrore që sapo kemi lënë pas kërkon reflektim të sinqertë dhe transparent.

Jam krejtësisht konsekuent kur gjykoj se kjo seancë parlamentare është treguesi më efektiv e më eficient i konsekuetit politik të qeverisjes dhe angazhimit total të klasës politike të përgjegjshme, e cila ka kurajën për të qenë e emancipuar, për ta kuptuar e interpretuar realitetin shqiptar, veçanërisht

atë që ka ndodhur në Shkodër, ashtu siç është në të vërtetë.

Popullsia e Shkodrës, ashtu siç njihet historikisht, edhe në kushtet e katastrofës natyrore të kohëve të fundit, ka treguar një maturi e fisnikëri të admirueshme dhe ka dhënë një mbështetje të jashtëzakonshme për Qeverinë dhe faktorët e tjerë, të vendit dhe të huaj. Të nderuar kolegë, shqiptarët si dhe shumë popuj të tjerë, kanë një traditë të shkëlqyer, në ditë të vështira ata bashkohen, i kapërcejnë inatet e vogla, veset e vogla, për të bërë më të mirën dhe atë që është e domosdoshme për të ardhmen e tyre.

Këtë ka kërkuar edhe Qeveria shqiptare dhe Kryeministri i vendit, zoti Sali Berisha, për katastrofën natyrore në Shkodër. Përballë fatkeqësive, e gjithë klasa politike e vendit, të gjithë faktorët tanë shoqërorë, duhet të jenë solidarë dhe reflektivë. Këtë bënë edhe Qeveria dhe Kryeministri i saj dhe vështirë se do të gjendet një mundësi për opozitën dhe kundërshtarët politikë të Partisë Demokratike e të koalicionit të vendit, për ta treguar atë solidaritet. Fronti opozitar, për më shumë se gjashtë muaj, po sundon foltoret me njerëzit më të afërt të trashëgimitarit të drejtpërdrejtë të ish-nomeklaturës së kuqe dhe duket se ka mbetur në llogoren vrastare, në llogoren e keqinterpretimit të inatit të natyrës.

E gjithë kjo katastrofë natyrore është administruar në mënyrën më të mirë të mundshme nga qeverisja e vendit që në fillimet e saj, por kursi destruktiv i Edvin Ramës vazhdon precedentin e rrezikshëm të dezinformimit.

Në historinë njerëzore dezinformimi është kujtesa më e keqe, më e pandershme që politikanët dritëshkurtër kanë aplikuar në shoqërinë njerëzore. Dezinformimi ka prodhuar viktima të pamata dhe absolutisht të pafajshme në historinë e luftërave dhe të paqes. Dezinformimi ka rrëzuar perandori të ndritura, të cilat kanë vënë themelet e zhvillimit të njerëzimit. E gjithë koha e sundimit totalitar në Shqipëri, për gati 50 vjet, e drejtuar nga njerëz të paditur, të pashkolluar, intrigantë, demagogë dhe të paemancipuar, ka qenë histori e dezinformimit të shqiptarëve dhe u është imponuar të gjithëve ajo që s'ndodhte në botën e qytetëruar dhe të emancipuar.

E gjithë historia e opozitës, sidomos nën kursin e sunduesve të Edi Ramës, njërit nga eksponentët e familjeve të dëgjura të bllokut komunist në vend, ka krijuar grupin e dezinformuesve, i cili në një mënyrë apo një tjetër është në një konkurrencë e

cila nuk i shërben vendit dhe të ardhmes së tij.

Shqipëria në të kaluarën komuniste ka një histori të trishtuar dhe vrasëse për shkakun e dezinformimit, të manipulimit të së vërtetës, për shkak të cilës janë vrarë dhe dënuar mijëra njerëz.

Edvini çdo mbrëmje bie në gjumë me ëndrrën se diçka do të ndodhë në Shqipëri, një katastrofë, se do të shembet një rrugë, se do të përplasen një makinë, se do të vdesë dikush dhe këto do të shërbejnë si lajm. Të gjithë ne kemi njohje dhe kujtesë të freskët sesi e interpretoi dhe si e dezinformoi opinionin publik Partia Socialiste dhe eksponentë të caktuar të saj, të ashtuquajtur mediatikë, lidhur me bregdetin shqiptar. Nuk kaloi shumë kohë dhe të gjithë shqiptarët, jo vetëm nëpërmjet transparencës së qeverisjes demokratike, por edhe të faktorit ndërkombëtar, morën vesh të vërtetën e Jalës.

Pyes opozitën dezinformuese: Pse nuk i përgjigjet deklaratës së zëvendës drejtorit të Bankës Botërore? Pyes opinionin publik: A duhen besuar këta opozitarë dezinformues për Gërdecin, për Kalimashin apo për Fierzën?

Teoria dhe mekanizmi i dezinformimit të Ramës, i cili është njeriu më tipik i kësaj gjëje të pandreqshme dhe manipuluese, janë praktikuar në të gjitha eventimentet e reformave që qeveria demokratike e vendit ka ndërmarrë, që nga viti 2005 e në vazhdim. Të gjithë kemi kujtesë në atë që ndodhi në kohën kur Shqipëria anëtarësohej në NATO, kur Shqipëria aplikonte për kandidat në BE, kur Shqipëria vlerësohej për rritjen ekonomike më të mirë se e shumë vende të tjera, kur Shqipëria pret lëvizjen pa viza. Jo më larg se dje, në foltoren e PS-së, lajkatarët e Ramës, natyrisht të dirigjuar prej tij, njerëzit tipik antidot, antizhvillim, vijuan dezinformimin e radhës për të gjitha ato që kanë ndodhur dhe po ndodhin në Shkodër.

Dezinformuesit janë vënë në krye të PS-së dhe duket se vazhdojnë ta përdorin në mënyrë halucinante atë që ka ndodhur. Dezinformuesit shqiptarë, në Shkodër, as u pritën, as u përcollën, as u shoqëruan nga ata njerëz që takuan. Populli i Shkodrës e di pse duhet t'i jetë mirënjohës kësaj Qeverie. Batuta më e mirë shqiptare del gjithmonë nga Shkodra. Batuta tregon zgjuarsin, një popull i zgjuar nuk e pranon dezinformimin. Çunat e bllokut dhe kryecuca e tyre, Edi Rama, e kuptojnë mirë dezinformimin që ata përdorin t'i bëjnë asaj që ka ndodhur në Shkodër, pasi njeriu më i thjeshtë i këtyre trevave, djali me syze i Shkodrës, ua tha

hapur të vërtetën dhe mbështetjen që ata kanë gjetur te qeveria se tyre.

Tashmë Shkodra po shkon drejt normalitetit, kur dihet se ka pasur dëme të konsiderueshme dhe efekti i tyre kërkon kohë të eliminohet. Për këtë kjo seancë është një transparencë e qeverisjes eficiente, për të mbrojtur nga katastrofat natyrore çdo jetë njerëzore, dhe ajo i ruajti. Shqipëria dhe shqiptarët kanë nevojë për politikë konstruktive, për ndershmëri dhe transparencë në qeverisje, për një opozitë jo dezinformuese. Informimi i drejtë bëhet nga foltorja e shenjtë e këtij Kuvendi, beteja është e ndershme kur ajo bëhet në vendin e duhur dhe jo pas kulisave.

Në vitin 2010 Shqipëria demokratike nuk e pranon dezinformimin. Një situatë të tillë ne kishim edhe në komunën Qukës të rrethit të Librazhdit, kur shirat e shumta bënë përmbytën katër-pesë hektarëve tokë dhe nxorën jashtë përdorimit shtëpitë e rreth 50 banorëve. Por as cuca shqiptare dhe as ministri i Jashtëm i Librazhdit nuk arritën të shkojnë në komunë, sepse nuk i pranuan. Nga organet vendore dhe qendrore u morën masa të menjëhershme për stabilizimin e gjendjes, njerëzit janë stabilizuar dhe unë u premtoj të gjithë atyre banorëve se Qeveria, siç do të dëmshpërblejë e stabilizojë zonën e Shkodrës, ashtu do të dëmshpërblejë edhe banorët e zonës së Qukësit.

Kërkoj që edhe ky rast të trajtohet në mënyrë të barabartë me zonën e Shkodrës.

Së fundi, si deputet i qarkut të Elbasanit dhe zonës së Librazhdit, në emër të elektoratit të mrekullueshëm e solidar, dua të falënderoj popullin fisnik të Shkodrës, Qeverinë, Kryeministrin e vendit, zotin Sali Berisha, shtabin e menaxhimit të emergjencës civile dhe Kryetaren e Kuvendit dhe të gjithë deputetët e Shkodrës që kontribuan në këtë situatë të vështirë dhe kritike për Shqipërinë.

Zoti ju bekoftë të gjithëve ju që kontribuat për shpëtimin e jetëve njerëzore!

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Çota!

Zoti Kryeministër, urdhëroni!

Sali Berisha - Falemnderit!

E mora fjalën për t'iu përgjigjur deputetit lidhur me Komunën e Qukësit.

Zoti Çota, do t'i garantosh qytetarët se ata dhe çdo shqiptar që të jetë në fatkeqësi natyrore, do ta ketë Qeverinë në krah të vet. Ky është një ligj i pandryshueshëm. E kemi bërë, do ta bëjmë dhe po e bëjmë për Shkodrën. Ju garantoj se Qeveria do të

përcaktojë detyrime ligjore dhe jo vetëm vullnet, në mënyrë që të ndihmojë çdo shqiptar të prekur në mënyrë të pamerituar nga fatkeqësi natyrore, përmbytje, orteke, tërmete, siç ndodhi në Kavajë dhe në Qukës. Kudo që fatkeqësitë natyrore jetën materiale të qytetarëve shqiptarë. Qeveria do të jetë me ta për rindërtimin sa më të shpejtë të saj. Ne, gradualisht, në kuadër rajonal, por edhe si vend, do të krijojmë një fond krejt të veçantë. Gjer më sot ne i kemi marrë fondet nga buxheti, i kemi marrë nga Fondi Rezervë i Këshillit të Ministrave, por, ju garantoj se, së shpejti, do të krijojmë fondin me të cilin ne do ta ushqejmë mirë atë, do të jemi gjithnjë me para të ndara për raste fatkeqësish natyrore për qytetarët shqiptarë, përfshi këtu edhe thatësirën dhe pasojat shkatërruese në të mbjellat e tyre.

Ky qëndrim buron totalisht nga vetë programi ynë, buron nga kohezioni social i këtij vendi. Ata, të cilët ndajnë lekë nga pensioni dhe i nisin në Shkodër, janë shembull frymëzues. Pra, ka dhe do të ketë një modalitet të madh në qëndrimin e Qeverisë. Në dijeninë time autoritetet qendrore kanë shkuar në zonat e përmbytura. Sapo ka ndodhur fatkeqësia, i kam kërkuar ministrit të Brendshëm të shkojë së bashku me autoritetet vendore dhe ta trajtojë problemin. Ministri më tha se brenda javës do të përfundojë vlerësimi dhe ne do të qëndrojmë pranë çdo familjeje apo individit shqiptar, të cilit forcat madhore i kërcënojnë jetën e tij materiale.

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Kryeministër!

Zoti Patozi, urdhëroni, në emër të grupit!

Pas kësaj do të lexojmë dhe votojmë rezolutën mbi situatën e emergjencës në qarkun e Shkodrës.

Astrit Patozi – Falemnderit, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë!

Do të kishim dashur shumë që këtë sesion ta nisnim ndryshe, pa ngjarje të rënda si ajo që përjetoj qarku i Shkodrës dhe bashkë me të i gjithë vendi, në një unitet dhe solidaritet të admirueshëm. Kjo seancë, pavarësisht se e posaçme, është e pamjaftueshme për të rrëfyer gjithë atë situatë të paimagjinueshme, e cila u dominua me një përkushtim dhe energji të jashtëzakonshme. Por tani që mund të konsiderohet se përmbytja u përballua është më lehtë të kuptosh se me çfarë vullneti të madh u evituan fatkeqësi më të mëdha, se si asnjë jetë njerëzore nuk u cenua, se si u shpëtua gjithçka e vlefshme mund të shpëtohej, me gjithë miliardë metra kub ujë që u derdhën me furi për ditë të tëra me radhë.

Sot është koha dhe vendi i duhur për të falënderuar Qeverinë dhe të gjitha strukturat e specializuara të shtetit që iu gjendën pranë ditën dhe natën çdo qytetari të lënduar nga zemërimi i ujërave. Kanë qenë ditë të vështira për banorët e Shkodrës, por kanë qenë, gjithashtu, ditë të ngarkuara pune të pandërprerë dhe shqetësimi për Kryeministrin, Kryetaren e Parlamentit, ministrat, deputetët, zyrtarët qendrorë e lokalë, forcat e policisë dhe ushtrisë dhe çdo individ tjetër, që u përfshi në operacionin e madh anti-përmbytje.

Sigurisht, një falënderim i madh për suksesin dhe eficiencën e operacionit duhet të shkojë në drejtim të atyre njerëzve fisnikë, banorëve të Qarkut të Shkodrës, të cilët në kushtet traumatike të një fatkeqësie të rëndë, me një sens të admirueshëm realizmi, nuk e humbën për asnjë çast besimin te shteti i tyre, që iu gjend në krah që në sekondat e para të situatës emergjente. Mirënjohja dhe bashkëpunimi i tyre, i palëkundur në asnjë çast prej yshtjeve diabolike për të shpikur dhe trilluar patjetër një “rob” fajtor, kanë qenë elementi më i rëndësishëm i kapërcimit të një katastrofe të mundshme.

Si çdo fatkeqësi tjetër natyrore, përmbytja nuk njehej gjini, moshë, e jo më bindje politike dhe përkatësi partiake. U përmbytën njësoj demokratët, socialistët dhe të tjerët. Por, pavarësisht ndarjeve politike, që janë normale për një vend demokratik, ata përbuzën me neveri çdo përpjekje të pamoralshme për të nxjerrë dhjam politik nga problemi i tyre. Ndaj edhe misioni për t'i ndihmuar ata ishte më i lehtë.

Është e vërtetë se në Shkodër ka çalltisur disa herë edhe Edi Rama me të tijtë. Por, në vend të kurajës dhe ndihmës, ai tentoi pa asnjë sukses t'u fusë në shpirt dyshimin e lig, se fajin e ka pasur Qeveria për ujërat që vinin nga të gjitha anët, nga deti, nga ajri dhe nga toka. Nuk ka gjë më të ulët se të abuzosh me fatkeqësitë natyrore. Edhe Edi Rama ka qenë në Shkodër, por ai ka shkuar atje për t'u thënë njerëzve të dëshpëruar se ajo që u kishte ndodhur atyre nuk ishte gjë fare para faktit që ai nuk arriti të bëhej kryeministër këtu e gjashtë muaj të shkuara. Dhe pikërisht për këtë, fajin për të gjitha e kishte Qeveria. Në kohën kur në Shkodër vërshonin ndihma nga e gjithë Shqipëria, në çastet kur në të katër anët e vendit njësi vendore, biznese, qytetarë të thjeshtë jepnin kontributet e tyre për të prekurit nga përmbytja, njerëzit e Edi Ramës në Bashkinë e Tiranës votuan kundër solidaritetit modest me ta. Kaq kishte në dorë “robi” i Zotit dhe kaq bëri.

Do të kishim dashur shumë, gjithashtu, që sot në këtë sallë opozita të zinte vendet e saj. Ajo nuk ka pasur asnjë arsye për të qëndruar jashtë Parlamentit, por sot kishte një arsye tjetër të madhe për të ardhur. Çfarë pritet të ndodhë më, që Edi Rama t'i lejojë njerëzit e tij për të mbajtur dhe mbrojtur publikisht qëndrimet e tyre në Parlament? A nuk ishin ata që kërkuan vendosjen e gjendjes së jashtëzakonshme në Qarkun e Shkodrës, për shkak të situatës së rëndë atje, gjë që u shmang, sepse operacioni i emergjencës funksionoi në perfeksion dhe katastrofa u dominua, pa qenë nevoja të merrej parasysh propozimi i Majkos?

Është mungesë e madhe përgjegjësie dhe morali që të bësh sikur i qan hallin Shkodrës, të kërkosh një seancë të jashtëzakonshme për të, dhe kur ajo ndodh, të rinisësh pastaj avazin e hapjes së kutive dhe përralla të tjera si këto. Ne e dimë shumë mirë se përse ndodh kështu. Sepse, Parlamenti është vendi ku më tepër se kurrë thuhet të vërtetat dhe kjo e tremb Edi Ramën. Është ndryshe të flasësh nga bahçja e shtëpisë apo e partisë tënde dhe ndryshe në këtë sallë. Sepse këtu gënjeshtrohet dhe merr në kohë reale përgjigjen. Por një politikan, që debatin e parë dhe të fundit të jetës së vet e ka zhvilluar në vitin 2000, sigurisht që e ka të vështirë të pranojë kuvendin e burrave. Ndaj, ai vazhdon të gjuajë me gurë nga oborri i bunkerit të vet, duke lënë pa gojë edhe të tjerët, me shpresën e kotë se kështu dëmton më shumë dhe se ka më pak përgjegjësi.

Tani ne konstatojmë me kënaqësi se normaliteti po kthehet me shpejtësi në zonat e prekura, se e madhja është kapërcyer dhe se Qeveria ka dhënë të gjitha garancitë se çdo qytetar i dëmtuar do të kompensohet për çdo qindarkë të humbur. Por ka një vend në Shqipëri, ku përmbytja vazhdon prej muajsh dhe ende nuk duket në horizont asnjë rreze shprese se ajo mund të ndalet, dhe jo më të përballohet. Dhe të përmbyturit nuk janë as një komunë, as pesë të tilla, ku të lënduarit dhe të prekurit nuk janë as një mijë, as katër mijë njerëz, por më shumë se 600 mijë shqiptarë, të cilët Edi Rama ka qejf t'i quajë popull opozitar. Ata janë prej muajsh të papërfaqësuar, interesat e tyre nuk mbrohen nga të zgjedhurit e vet, sepse edhe këta të fundit janë po ashtu të përmbytur prej dorës së "robit". Fatkeqësia e tyre nuk ka të krahasuar me përmbytjen e madhe të një pjese të Tiranës disa vjet të shkuara, e cila shkaktoi dëme shumë të rënda dhe qytetarët nuk u kompensuan kurrë. Përmbytësi i tyre nuk është anonim, ai është kryetari i Partisë

Socialiste, i cili përgjegjësinë për këtë katastrofë jonatyrore nuk e ndan me askënd tjetër. Për këtë nuk ka nevojë të kërkosh as rregulloren e '88-ës, as statutin e partisë së '41-shit, as Kushtetutën e '74-ës dhe as rezolutën e asamblesë së fundit. Është e qartë si drita e diellit. Dhe kur e keqja të vjen ekskluzivisht prej dorës së "robit", nuk të bën dobi as t'i lutesh Zotit për të shpëtuar prej saj.

E kemi thënë shpesh në këto vite se politika që ushqehet me fatkeqësi dhe viktime nuk të çon larg. Për fat të keq, opozita e Edi Ramës e ka shndërruar në kredo të saj përdorimin e katastrofave dhe tragjedive. Dje, përmbytësi i opozitës bëri sërish paradën e fatkeqësive. Falë Zotit, që Haiti është shumë larg prej këtej, sepse kështu siç e ka nisur zoti Rama, do të akuzonte Qeverinë "Berisha" dhe maxhorancën edhe për tërmetin e atjeshëm. Le të mos i harrojë ato, por të mos ketë asnjë shpresë se mund të përfitojë ndonjë votë prej tyre!

Ai e ka shumë për zemër ta përmendë Gërdecin, por nuk e kam dëgjuar ndonjëherë të thotë që të hapen kutitë atje. Në rast se nuk di të bëjë ndonjë gjë më të mirë, sesa të presë që të ndodhin fatkeqësitë dhe pastaj t'i shfrytëzojë ato, është i mbytur këmbë e krye nga një politikë arkaike që nuk e çon askund. E ka provuar dhe do ta provojë sërish. Populli ynë ka një shprehje të urtë: "I mbyturi të mbyt". Kjo nuk vlen për banorët e Shkodrës, të cilët shpëtuan falë Zotit dhe dorës së "robit" që u kujdes për ta, por për popullin opozitar.

Por a mund të shërbejë për mirë një fatkeqësi apo katastrofë, kur ajo shkakton dëme të mëdha dhe prek dhe lëndon mijëra njerëz? Do të ishte teprim i madh po të thoshe se ajo që ndodhi në Shkodër e la pas një kujtim të mirë. Shqipëria është ende vend i varfër dhe ne kemi përpara shumë probleme për të zgjidhur, por eksperiencia e kësaj përmbytjeje biblike tregoi se ne mund t'ia dalim të kapërcejmë edhe situata të rënda fatkeqësish, të cilat do të vinin në vështirësi edhe shtete shumë më të pasura dhe më të fuqishme se Shqipëria. Këtu nuk ka ndonjë sekret të madh për të treguar. Në finale, është sensi i humanzimit të një qeverie, ai që bën diferencën. Kjo ka vlerë shumë më tepër se zotësia e Shtabit të Emergjencës apo përqendrimi i fuqive të shtetit, pikërisht aty ku ka ndodhur fatkeqësia.

Fati i keq e deshi që të ndodhë në Shkodër, duke vënë në provë vështirësi mijëra qytetarë të këtij qarku, por, pas kësaj, çdo qytetar shqiptar, kudo që ai jeton, në çdo cep të këtij vendi, duhet të ndjehet më i garantuar dhe më i sigurt se nuk do të

mbetet kurrë në mëshirën e forcave të natyrës në rast katastrofash. Këtë siguri ta jep vetëm një qeveri e mirë. Sigurisht, në radhë të parë, ne lutemi të gjithë që ato të mos ndodhin kurrë, sepse ne bëjmë vetëm atë që kemi në dorë. Ndërsa dikush tjetër që ushqehet dhe bën politikë me fatkeqësi është i lirë të bëjë zgjedhjen e vet dhe ai e ka bërë. Edhe tani, që jo vetëm qytetarët e Shkodrës dhe rrethinave të saj, por qytetarët e mbarë vendit janë përqendruar te kjo sallë dhe te ky debat, Edi Rama është duke festuar te restoranti i Fidelit.

Prania e tij atje nxin sot më shumë sesa mungesa e opozitës në këtë sallë.

Ju faleminderit! (*Duartrokijte*)

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Patozi!

Ndërkohë, në mbyllje të kësaj seance të jashtëzakonshme për gjendjen e emergjencës civile në Shkodër, do t'i mbyllim diskutimet me një rezolutë, të cilën do ta lexoj dhe pastaj do të votohet.

Rezolutë e Kuvendit të Shqipërisë, datë 18.01.2010

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, i mbledhur sot, në datën 18.01.2010, në një seancë të posaçme informimi dhe debati për gjendjen e emergjencës në qarkun e Shkodrës, pasi u njoh në detaje me: 1. fatkeqësinë e rëndë natyrore dhe gjendjen e emergjencës së krijuar prej saj të ditëve të fundvitit 2009 dhe ditëve të para të vitit 2010; 2. masat e marra dhe përpjekjet e bëra nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, strukturat ekzekutive dhe ato të pushtetit vendor të qarkut Shkodër për përballimin e përmblyjes dhe normalizimin e situatës; 3. menaxhimin profesional dhe të përkushtuar të situatës hidrike në kaskadën e Drinit nga ana e strukturave të Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare, 4. si dhe me shembujt e çmuar të ndihmës dhe të solidaritetit njerëzor me banorët e zonave të përmblytura, falënderon dhe shpreh mirënjohjen për qytetarët e Shkodrës dhe të Nënshkodrës për kurajën dhe fisnikërinë e treguar gjatë gjithë ditëve të vështira të emergjencës së krijuar nga përmblytja natyrore; vlerëson përpjekjet maksimale të Qeverisë dhe të Komitetit Ndërmintor për Gjendjen e Emergjencës në Shkodër, nivelin e lartë të gatishmërisë së treguar, si dhe koordinimin e shkëlqyer që kanë realizuar; shpreh konsideratën për rolin e rëndësishëm dhe të pazëvendësueshëm që kanë luajtur dhe vazhdojnë të luajnë kryetarët e njësisive të qeverisjes vendore dhe anëtarët e këshillave bashkiakë dhe komunalë në qarkun e Shkodrës; shpreh mirënjohjen e thellë

për ndihmën dhe kontributin e sinqertë në njerëz, pajisje dhe ndihmë monetare që kanë dhënë vendet fqinje dhe mike: Italia, Franca, Austria, Greqia, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Turqia, Sllovakia, Moldavia etj., si dhe organizma ndërkombëtarë, si: NATO-ja, Komisioni Evropian, Banka Botërore, PNUD-i; falënderon qytetarët shqiptarë për solidaritetin njerëzor, komunat dhe bashkitë e Shqipërisë për mbështetjen e pashembullt institucionale, deputetët e Kuvendit, nëpunësit dhe përfaqësuesit e institucioneve dhe enteve të pavarura për kontributin tyre të çmuar, si dhe bashkësitë shqiptare në botë për ndihmën bujare.

Kuvendi i Shqipërisë vendosi:

1. T'i kërkojë Qeverisë që të angazhojë të gjitha burimet financiare dhe njerëzore të saj për kapërcimin sa më të shpejtë të të gjitha pasojave të kësaj fatkeqësie natyrore.

2. T'i kërkojë Qeverisë të ndërmarrë të gjitha masat për vlerësimin real dhe objektiv, si dhe zhdëmtimin e plotë të të gjithë qytetarëve dhe familjeve të prekura dhe të dëmtuara nga përmblytja.

3. Qeveria, ministritë dhe të gjitha agjencitë e vendit të nisin menjëherë punën për rehabilitimin e zonës së prekur, pastrimin mjedisor të saj, normalizimin sa më të shpejtë të jetës së njerëzve dhe veprimtarisë së tyre në këto zona.

4. Qeveria të përparësojë të gjitha projektet që u japin zgjidhje të qëndrueshme dhe afatgjatë parandalimit dhe përballimit të fatkeqësive të ngjashme natyrore.

Të nderuar deputetë, merrni kartat elektronike për të votuar rezolutën!

Po, zoti Gjana.

Jemin Gjana – Zonja Kryetare,

Mendoj se rezoluta është e plotë. Në fakt, rezoluta është për një çështje relativisht të veçantë, siç ishte ajo që ndodhi me Shkodrën, dhe për atë se si e përballuam atë situatë. Duke qenë se seanca e sotme e Kuvendit bëri një anamnezë të plotë të asaj çfarë ndodhi dhe të asaj se si e përballuam situatën, mendoj se mund të kishte vlerë që në fund të kësaj rezolute të shtonim edhe një pikë tjetër, që Kuvendi t'i kërkojë Qeverisë të angazhohet, bazuar dhe në këtë eksperiencë nga më të veçantat, për hartimin e një kuadri të ri ligjor, rregullator, në përputhje me standardet evropiane, për përballimin e situatave emergjente që vijnë si rezultat i fatkeqësive natyrore.

Një prej çështjeve e shtroi këtu Kryeministri, duke thënë se ne synojmë që të krijojmë një fond.

Unë besoj se kuadri rregullator që ne kemi nuk është tërësisht më i riu, më i miri dhe në përputhje me standardet. Në qoftë se Kuvendi do ta shtrojë këtë kërkesë, besoj se është një presion pozitiv mbi Qeverinë, mbi agjencitë e saj për të nisur punën për hartimin e këtij kuadri të ri ligjor, rregullator për këto çështje, të cilat lidhen me atë datë çfarë pritet të ndodhë pas asaj konference që u zhvillua në Kopenhagen, e cila nuk u zhvillua kot së koti, mundet që ne të përballemi me raste të këtyre përmasave.

Falemnderit!

Jozefina Topalli- Falemnderit, zoti Gjana!

Fjalën e ka zoti Kryeministër.

Sali Berisha - Prej shumë muajsh Qeveria shqiptare po bashkëpunon me Bankën Botërore në një projekt rajonal të krijimit të një fondi për fatkeqësitë natyrore. Kryesisht ka qenë cunami që goditi zonat e Azisë, i cili nxiti komunitetin ndërkombëtar të procedohet me krijimin e fondeve të tilla, ku rolin kryesor në organizim, por dhe një kontribut të veçantë me këto fonde do të ketë Banka Botërore. Nxitja nga Parlamenti është veçse pozitive. Një formulim dhe një nxitje e tillë nga Parlamenti është një gjë pozitive.

Por meqë e mora fjalën, do të kërkoja mirëkuptimin tuaj që në falënderimet që keni bërë, dhe nuk ka diskutim se, së pari, duhet të jetë mirënjohja, siç është shprehur edhe në rezolutë, një falënderim i posaçëm duhet t'i adresohet biznesit shqiptar, kompanive vendase dhe të huaja. Unë dua të them se ndihma dhe kontributi i tij thelbësor, qoftë monetar, qoftë në mjete të tjera, në makineri, në njerëz, në mallra, me prodhimet e tyre, në shërbime, ka qenë jashtëzakonisht i çmuar. Biznesi ka treguar një gatishmëri të plotë dhe totale, një disponueshmëri shumë të madhe për të ndihmuar Shkodrën dhe rrethinat e saj.

Në këtë falënderim, ndonëse është shprehur për qytetarët shqiptarë, le të përfshijmë edhe diasporën dhe emigracionin.

Jozefina Topalli – Është vendosur.

Sali Berisha – Më falni, e paskeni shtuar, shumë mirë! Unë ju informova për donacionet që

kanë mbledhur mbrëmë te spitali “Zonja e Këshillit të Mirë”. “Vatra” është mbledhur dhe ka nisur fushatën e ndihmave, si dhe organizata të tjera të emigracionit, por kjo qenka vendosur këtu dhe nuk ka nevojë të shtohet, përveçse biznesit.

Një mirënjohje dhe falënderim nga Parlamenti t'i bëhet biznesit, biznesmenëve shqiptarë për bujarinë, gatishmërinë, impenjimin e madh që kanë treguar në segmente të caktuara, ku mbështetja ka qenë e dobishme.

Jozefina Topalli – Atëherë, duke shtuar mirënjohjen dhe falënderimin për biznesin te faja e parë, ku shprehet mirënjohja, falënderimi, vendosim propozimin shtesë të zotit Gjana dhe një amendament të zotit Ruli në pikën 4, aty ku thuhet “për parandalimin dhe për përballimin”.

Së bashku me amendamentet e shtuara, hapim votimin me elektronikë.

Mbyllim votimin.

Janë 71 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë, datë 18.01.2010 “Për gjendjen e emergjencës civile në qarkun e Shkodrës”.

Unë ju falënderoj për punën, debatet dhe rezolutën!

Para se ta mbyll seancën plenare, ju njoftoj se Konferenca e Kryetarëve ka vendosur për kalendarin dhe programin e punës.

Meqenëse Konferenca e Kryetarëve ka qenë në konsensus të plotë, bazuar te Rregullorja, ka ndonjë gjë për të shtuar? Nuk ka.

Miratohen programi dhe kalendarin.

Ju falënderoj për të gjithë kontributin që keni dhënë gjatë gjithë kësaj periudhe!

Ndërkohë, ditën e enjte, siç ishte parashikuar, do të jetë rendi i ditës për fillimin e sesionit të ri. Komisionet parlamentare që kanë filluar punën e tyre që sot, kanë kalendarin, programin e tyre dhe do të vazhdojnë punën edhe ditën e nesërme.

Falemnderit!

Seanca mbyllet. Natën e mirë!

(Seanca plenare u mbyll në orën 21:45)

E enjte, 21.01.2010
Seanca e pasdites, ora 17:00

Drejton seancën Kryetarja e Kuvendit,
zonja Jozefina Topalli (Çoba)

Rendi i ditës:

1. *Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').*

2. *Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 18.01.2010.*

3. *Projektligj "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Kosovës për bashkëpunimin policor ndërkufitar".*

4. *Projektligj "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për riparimin, rindërtimin dhe mirëmbajtjen e piramidave e të shenjave të tjera kufitare në kufirin shtetëror shqiptaro - malazez".*

5. *Projektligj "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, dhe Qeverisë së Irlandës për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal, për tatimin mbi të ardhurat".*

6. *Projektligj "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7928, datë 27.04.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", të ndryshuar".*

7. *Projektligj "Për detergjentët".*

8. *Projektligj "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9875, datë 14.02.2008 "Për metrologjinë".*

Jozefina Topalli - Të nderuar deputetë, hapim seancën.

(Lexon rendin e ditës.)

Për pikën e parë të rendit të ditës kanë regjistruar emrat për diskutim deputetët: Florian Mima, Spiro Ksera, Osman Metalla, Aldo Bumçi, Igli Cara, Petrit Vasili.

Zoti Mima, urdhëroni!

Florian Mima – E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Dje fondacioni "Heritage" dhe gazeta "Wall Street Journal", publikuan indeksin e lirive ekonomike për vitin 2010. Shqipëria u rendit në vendin e 53-të, mes 183 shteteve, duke shënuar plot 66 pikë, me një progres prej 9 vendesh, krahasuar me një vit më parë dhe plot 2.3 pikë plus.

Përshëndetja e vetme që mund të themi me këtë rast është: "Falemnderit Qeverisë "Berisha"!

Shumëkush mund të pyes se ç'është liria

ekonomike. Përgjigjja është fare e thjeshtë për ata që besojnë te liria: ajo është e drejta më fundamentale e çdo qenieje njerëzore, për të zotëruar punën dhe pasurinë e vet. Në një shoqëri të lirë ekonomisht individët janë të lirë të punojnë, të prodhojnë, të konsumojnë dhe të investojnë në mënyrën që ata e zgjedhin lirisht vetë, në një liri që mbrohet nga shteti dhe që nuk mund të cenohet nga shteti.

Në një shoqëri të lirë ekonomisht qeveritë krijojnë kushte për lëvizjen e lirë të punës, kapitalit e mallrave dhe heqin dorë nga shtrëngimi përtej një caku të caktuar, i cili ka për qëllim të mbrojë lirinë.

Në këtë parim vertebral të lirisë ekonomike nuk besojnë vetëm ata që lirinë e të tjerëve e kanë obsesion dhe që me nostalgjinë e modeleve të gjyshërve apo baballarëve të tyre tentojnë të plagosin herë pas here lirinë, këtë premisë të të gjithë zhvillimit e prosperimit njerëzor.

Po cilat janë benefitet e një lirie të çimentuar ekonomike? Përgjigjja është fare e thjeshtë për ata që besojnë te liria. Studimet demonstrojnë një korrelacion thelbësor midis lirisë ekonomike dhe komponentëve socialë dhe ekonomikë, si: të ardhurat për frymë, shkalla e rritjes ekonomike, zhvillimi human, demokracia, zhdukja e varfërisë, mbrojtja e mjedisit etj. Këto përfitime të provuara në praktikë, nuk i besojnë vetëm ata që e kanë obsesion lirinë dhe që herë pas here tentojnë ta plagosin atë.

Po cilët janë komponentët e lirisë ekonomike? Si maten? Si ka performuar Shqipëria në këto indekse të veçanta? Ato janë 10. Po i citoj:

Liria e biznesit, Shqipëria shënon 68 pikë, mesatarja e botës 64 pikë.

Liria e tregtisë, Shqipëria shënon 85.8 pikë, mesatarja e botës 74.2 pikë.

Liria fiskale, Shqipëria shënon 92.6 pikë, mesatarja e botës është 75.4 pikë.

Shpenzimet qeveritare, Shqipëria shënon 74.2 pikë, mesatarja e botës 65 pikë.

Liria monetare, Shqipëria shënon 78.7 pikë, mesatarja e botës 70.6 pikë.

Liria e të investuarit, Shqipëria shënon 70 pikë, mesatarja e botës 49 pikë.

Liria financiare, Shqipëria shënon 70 pikë, mesatarja e botës 48.5 pikë.

Të drejtat pronësore, Shqipëria shënon 35 pikë,

mesatarja e botës 43 pikë.

Liria nga korrupsioni, Shqipëria shënon 34 pikë, mesatarja e botës 40 pikë.

Liria e punës, Shqipëria shënon 52 pikë, mesatarja e botës 62 pikë.

Ndër të 10 indekset që përmenda, më tërheq vëmendjen liria e biznesit, e cila ndonëse me 68 pikët e shënuara ndodhet mbi mesataren e botës prej 64 pikësh, përsëri merr një minus shumë të madh në komponentin e lejeve, duke shënuar plot 331 ditë për marrjen e një lejeje nga, 218 që është mesatarja e botës.

Të dashur vëllezër e motra,

E dini se për çfarë është fjala? Bëhet fjalë pikërisht për lejet e ndërtimit, të cilave ata që tmerrohen nga liria ua kanë gjetur anën duke u fshehur pas disa frazave pa lidhje rreth autonomisë vendore. Gjykoj se është vendi që Qeveria të iplotojë pa humbur asnjë çast parimin "Silence is consent" edhe në këtë fushë. Nëse përsëri indeksi nuk përmirësohet, atëherë të zbatohet ajo që ndodh në çdo vend të civilizuar, prezantimi i një procedure ligjore, certifikimi nga pushteti qendror për shërbimet të cilat u ofrohen qytetarëve nga pushteti lokal. Nëse nuk e merr klasën, përjashtohesh nga ofrimi i atij shërbimi. Derisa të krijohen premisat që ai shërbim të ofrohet nga pushteti lokal, atë e merr në dorë pushteti qendror, e marrin njerëzit që besojnë te liria dhe jo ata që i gjuajnë asaj me gurë, duke e etiketuar si të keqen e të gjitha të këqijave. Ata nuk kanë faj, sepse ajo ua ka prishur terezinë dhe rehatinë e sundimit, që u dhuruan prindërit dhe gjyshërit e tyre.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Mima!

Zoti Ksera, urdhëroni!

Spiro Ksera – E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Kam kënaqësinë të përshëndes të gjithë qytetarët e komunave të Dropullit, të Pogonit, të Vurgut dhe të Bregdetit për kontributin dhe solidarizimin në ndihmë të familjeve të dëmtuara në zonat e përmbytura.

Dua të shpreh edhe një falënderim të veçantë për të gjithë qytetarët e Gjirokastrës, Tepelenës dhe Përmetit që me përgjegjësi e kulturë qytetare ofruan dorën e bujarisë së tyre, për të ndihmuar të dëmtuarit nga furia dhe mospërmbajtja natyrore e ditëve të para të janarit.

Tradita e solidaritetit njerëzor të banorëve të minoritetit etnik grek, u shpreh qartazi dhe pa mëdyshje. Biznesmenët minoritarë, përfaqësuesit

e zgjedhur lokalë dhe qendrorë, nëpunësit e strukturave shtetërore të zonave të minoritetit, në një përpjekje të koordinuar, reagan me shumë bujari që në çastin e parë. Ata vazhduan punën duke lënë mënjanë çdo individ apo pseudopërfaqësues të tyre, që fsheh pas fjalëve hipokrizinë dhe lutjet që punët e kësaj Qeverie të mos shkojnë mirë.

Minoriteti ishte dhe mbetet koherent në vlerësimin e vet, sepse ka gjithë vëmendjen e duhur qeveritare në realizimin e objektivave madhore të zhvillimit e të integritit të vet dhe të vendit në strukturat euroatlantike. Duhet thënë se Qeveria "Berisha" garanton e mbështet pjesëmarrjen dhe gjithëpërfshirjen e minoritetit grek në të gjitha pozicionet drejtuese dhe do të vazhdojë ta bëjë atë. Pavarësisht zërave dhe pretendimeve, si përfaqësues i tyre e them me bindje se pjesëmarrja e minoritarëve në të gjitha nivelet e administratës publike, është rritur e zgjeruar në tregues sasiorë dhe cilësorë.

Qeveria "Berisha", anëtar i së cilës jam, është e gatshme dhe kontribuon për çdo kërkesë që mbërrin nga minoriteti etnik grek dhe unë, si ministër, u garantoj minoritarëve grekë investime më të mëdha në infrastrukturë dhe projekte zhvillimi, në shprehjen e cilësive të tyre arsimore e kulturore dhe respektimin e Konventës në kuadër të Këshillit të Europës për minoritet etnike.

Një fakt kuptimplot i koherencës së programit qeveritar është edhe iniciimi i takimit të dytë të Komisionit Qendror të Regjistrimit të Popullsisë dhe të Banesave, që do të finalizohet brenda vitit 2011.

Duke falënderuar të gjitha shtetet që ndihmuan qytetarët shqiptarë dhe që morën pjesë në përballimin e situatës emergjente, doja të përcillja një falënderim të veçantë për Qeverinë e Republikës së Greqisë, ekipet e specializuara të emergjencave civile të Greqisë, ekipet e shpëtimit dhe të gjitha mekanizmat e tyre, si dhe të vlerësoj sensibilizimin për të ndihmuar qytetarët tanë në nevojë nga një sërë bashkish të vendit fqinj.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, që në momentet e para, përcaktoi qartë pozicionin dhe rolin e vet gjatë fazës së përmbytjeve. Një grup i përbërë nga titullarët më të lartë të Ministrisë së Punës, strukturat e Drejtorisë së Politikave Sociale dhe të Shërbimit Social Shtetëror, si dhe specialistë, janë gjendur në terren duke marrë kontakte me familjarë dhe banorë të zonave të përmbytura, në koordinim edhe me shtabin e emergjencës.

Situata është ndjekur hapa pas hapi dhe paralelisht me ngritjen e ekipit që operonte në terren, është bërë koordinimi i punës në nivel operacional në ministri, ku kabineti dhe të gjithë drejtorët kanë qenë në kontakt me të gjitha institucionet e varësisë. Janë ndjekur nga afër nevojat e komunitetit dhe të të gjitha qendrave sociale që janë në varësi të Ministrisë apo të atyre në varësi të pushtetit vendor. Në rajonin e Shkodrës, e cila është cilësuar si zona me dëmtime më të mëdha, trajtohen gjithsej 6618 familje me ndihmë ekonomike. Zyrat e institucioneve në varësi të Ministrisë së Punës u kanë qëndruar qytetarëve në krah për çdo kërkesë dhe kanë ofruar ambientet e tyre në rastet e evakuimit.

Grupi i punës i institucionit, në bashkëpunim me zyrën rajonale në Shkodër, u ka ofruar drejtuesve të komunave të dëmtuara nga përmbytjet sistemim dhe asistencë në institucionet e përkujdesit shoqëror për fëmijët në nevojë dhe për personat me aftësi të kufizuar. Në këto zona rezulton se ka të moshuar, fëmijë nën kujdestarinë e gjyshërve, si dhe persona me aftësi të kufizuar, jetesa e të cilëve pas dëmtimit të shtëpive dhe shpërnguljes së tyre, mund të vështirësohet, pasi kjo kategori ka nevojë për trajtime të veçanta, sipas patologjive që paraqiten. Ndaj edhe pranë Shtabit të Emergjencës dhe prefekturës është afruar zyra rajonale në Shkodër, një punonjës social dhe një psikolog, të cilët do të jenë në gatishmëri për të dhënë ndihmën e parë.

Ministria e Punës dhe strukturat e saj do të vazhdojnë të shpërndajnë ndihma ushqimore për familjet në varfëri ekstreme, duke mos lënë periudhë boshë nga trajtimi me ndihmë, nga rezervat dhe kontributet e ndryshme.

Në Shkodër funksionojnë 5 institucione publike: 3 shtëpi fëmije, 1 qendër zhvillimi dhe 1 shtëpi për të moshuarit. Drejtuesit e shërbimit social shtetëror kanë kontaktuar me drejtuesit e qendrave dhe janë siguruar prej tyre që në një periudhë të mëtejshme post-emergjence të kenë përgatitur të gjithë infrastrukturën e nevojshme.

Të gjitha këto dëshmojnë funksionimin normal të strukturave shtetërore në dimension human dhe social. Të gjitha këto tregojnë se vëmendja dhe kujdesi i shtetit vazhdojnë dhe do të vazhdojnë deri në rehabilitimin e plotë të dëmeve që pësuan familjet në rrethin e Shkodrës. Ministria e Punës vazhdon të mbështesë çdo kërkesë për ndihmë ekonomike me anë të trajtimit të familjeve të zonave të përmbytura dhe të njerëzve në nevojë, si dhe çdo kërkesë tjetër specifike të tyre.

Falemnderit!

Jozefina Topalli - Falemnderit, zoti Ksera!
Urdhëroni, zoti Metalla!

Osman Metalla – E nderuar zonja Kryetare,
Të nderuar kolegë,

Jam këtu për të përshëndetur të gjithë qytetarët shkodranë që, ditët e fillimvitet, i kaluan në kushte ekstremalisht të vështira, si rezultat i përmbytjeve dhe reshjeve që zgjatën më shumë se 10 ditë dhe me një intensitet mjaft të lartë, duke rritur në këtë mënyrë nivelin e rezervuarëve të kaskadës së Drinit dhe duke e bërë të pashmangshme hapjen e portave të Fierzës dhe Vaut të Dejës. Këto reshje, që sollën mbi 2,6 miliardë metra kub ujë, sollën edhe rritje tej parashikimeve të liqenit të Shkodrës, ujërat e të cilit dolën si rrallë ndonjëherë në rrugët periferike të qytetit.

Për më tepër, si rrjedhojë e erërave që vijnë nga drejtimi i jugut, edhe niveli i detit pësoi një rritje, duke reduktuar në mënyrë të ndjeshme kapacitetin shkarkues të Bunës, gjë e cila u reflektua edhe në rritjen e vazhdueshme të nivelit të ujërave. Përveç fatkeqësive natyrore, Shkodrës iu desh të përballej edhe me fatkeqësinë njerëzore të këtij vendi, me Edvin Ramën, i cili, në vend që të shkonte dhe të kontribuonte në lehtësimin sadopak të situatës së këtyre njerëzve, shkonte për t'u mbushur mendjen shkodranëve se shiu kishte rënë me urdhër të Sali Berishës e ndaj kishte ndodhur përmbytja. Ndoshta edhe përmbytjet që kishin ndodhur në Itali, në Turqi, ku humbën jetën me dhjetëra njerëz, kishin ndodhur me urdhër të Berishës, sipas Ramës. Ky qe kontributi i Ramës në lehtësimin e pasojave të kësaj katastrofe natyrore.

Megjithatë, tashmë shqiptarët e dinë se kjo opozitë, që komandohet me autoritarizëm nga Rama, deri më sot nuk ka shpallur alternativë tjetër përballë shqiptarëve, përveçse është shfaqur si një opozitë, e cila mundohet të përfitojë. Sa herë që ka fatkeqësi, në vend që të bashkojë forcat me të gjithë faktorët e tjerë në përballimin e situatave, ai mundohet t'i vështirësojë ato. Po të mos ishte treguar një reagim i shpejtë nga ana e Qeverisë, po të mos kishte pasur një bashkëpunim të tillë edhe nga ana e vetë banorëve të Shkodrës dhe të Nënshkodrës, sot do të kishim pasur një tablo tjetër, do të kishim pasur humbje në jetë njerëzish, humbje në gjënë e gjallë dhe humbje më të mëdha materiale. Unë dëshiroj të shpreh mirënjohjen time të thellë për punën e jashtëzakonshme të bërë nga ana e Kryeministrit; Kryetares së Kuvendit, e cila gjatë

gjithë ditëve të krizës, së bashku me deputetët e Shkodrës, ka qenë pranë banorëve në fatkeqësi; ministrit Basha, i cili ka qenë në krye të Shtabit Ndërminstror, si dhe të gjithë ekipit ministror për atë punë të jashtëzakonshme që është bërë në menaxhimin me mjaft kujdes e përgjegjshmëri të situatës; të Forcave të Armatosura, të cilat punuan natë e ditë me përkushtim dhe përgjegjësi, në evakuimin e banorëve, duke bërë që kjo situatë të përballohet me dëmet më minimale të mundshme, dhe çfarë është me e rëndësishmja, pa humbje njerëzore.

Dëshiroj të theksoj se ashtu si të gjithë shqiptarët, brenda dhe jashtë vendit, edhe banorët e Durrësit, Shijakut, Xhafzotajt, Katundit të Ri, Gjepalajt dhe të gjithë qarkut të Durrësit, janë solidarizuar me të gjithë banorët e Shkodrës, duke shprehur gatishmërinë për t'u ndodhur pranë tyre në këto ditë të vështira. Krahas ndihmave në veshje, kam kënaqësinë të them se dy ditë më parë, ne dërguam një sasi të konsiderueshme me ushqime në drejtim të Shkodrës, në emër të banorëve të Shijakut. Janë grumbulluar gjithashtu edhe një sasi të hollash, të cilat janë vënë në dispozicion në numrin e llogarisë që është çelur për këtë qëllim. Kështu, nga ana e Komunës Xhafzotaj dhe Katund i Ri janë vënë në dispozicion, përkatësisht, nga 10 milionë lekë të vjetra dhe natyrshëm që edhe nga ana e njëjësive të tjera vendore të qarkut po ndiqet i njëjti shembull.

Krahas menaxhimit mjaft të mirë të kësaj situatë, mendoj se është koha që ne të jemi të përgatitur jo vetëm në menaxhimin e krizave, kur ato ndodhin, por, njëkohësisht, të punojmë më shumë për parandalimin e këtyre situatave. Tashmë ka filluar puna në thellimin e grykëderdhjes së lumit Buna, si dhe është bërë riparimi i disa argjinaturave. Të gjitha këto janë punime emergjence, por me ndryshimet klimaterike që kanë ndodhur në planetin tonë, dhe si rrjedhojë e ngrohjes globale, fenomene të tilla natyrore kanë gjasa që të përsëriten jo më në intervale pesë apo dhjetëvjeçare, por me një frekuencë më të shpeshtë, për të mos thënë që do të shndërrohen në fenomene të zakonshme.

Faktet, gjithashtu, kanë treguar se ne jemi përballur shpesh me përmytje jo vetëm në zonën e Shkodrës, por edhe në Lezhë, Durrës, Shkumbin, Seman, Gjanicë, Vjosë etj. Mendoj se është koha që Qeveria të fillojë punën për përgatitjen e një strategjie, e cila të përfshijë jo vetëm Shkodrën dhe Nënshkodrën, por të gjitha zonat në të cilat ne kemi

pasur përmytje, ku rreziku është potencial dhe në të ardhmen do të kemi situata të ngjashme hidrike.

Duhet bërë disiplinimi i shtretërve të lumenjve, për të rritur aftësitë shkarkuese të tyre. Duhet punuar për ngritjen e argjinaturave në brigjet e lumenjve dhe veçanërisht në afërsi të qyteteve, për ripyllëzimin e zonave malore, si dhe rritjen e gjelbërimit në tërësi edhe në qytete, për parandalimin e ndërtimeve, të cilat ndodhen në kuota të ulëta dhe që janë subjekt përmytjesh, sidomos ndërtimet mbi kolektorë që kanë dëmtuar ndjeshëm ndërtimin e këtyre të fundit.

Duke përfunduar, dëshiroj të theksoj edhe një herë se shkodoranët vërtet u përballën me këtë fatkeqësi, por desh Zoti që në qeverisje të ishte e djathta, të ishte Berisha. Ata e kanë ndjerë në çdo moment të ditës dhe të natës prezencën dhe mbështetjen e jashtëzakonshme të Qeverisë. Ishin po shkodoranët që u përballën me ujën më 9 janar të 2004-ës, por Qeveria e atëhershme, edhe pse i ndiqte përmes televizionit, nuk shkoi t'i shpëtonte, as ditën e as natën, por i la të mbyteshin në ujërat e ftohta të Jonit 21 djem dhe vajza të reja shkodorane.

Në rastin e përmytjeve jo vetëm që nuk pati asnjë jetë të humbur, por edhe dëmet do të kompensohen 100%.

Ju falemnderit!

Jozefina Topalli - Falemnderit, zoti Metalla!
Zoti Bumçi, urdhëroni!

Aldo Bumçi – Falemnderit, zonja Kryetare!
Të nderuar kolegë deputetë,

Unë do të ndalem në fjalën time në vlerësimin që Heritage Foundation i bën lirisë ekonomike në Shqipëri dhe në të gjithë botën. Është një temë e rëndësishme dhe mendoj se këtu duhet ndalur gjatë. Në vitin 2009 Shqipëria ishte vendi i vetëm në Europën Lindore që përjetoi një rritje të ndjeshme ekonomike. Shëndeti i ekonomisë shqiptare në vitin 2009, pavarësisht krizës financiare dhe krizës në ekonominë reale, që çoi në rënie të ndjeshme ekonomike dhe recesion në të gjithë kontinentin dhe në shumë vende të botës, ishte një nga lajmet më pozitive për vendin tonë në gjithë këto 20 vjet, një lajm që meritonte shumë më tepër vëmendje dhe diskutim sesa iu kushtua.

Mrekullia që ndodhi në Shqipëri ishte se nuk pati krizë financiare, nuk pati banka që falimentuan, nuk pati ulje të ardhurash, por pati rritje pagash dhe pensionesh, nuk pati rënie investimesh publike. Ishte një rastësi, apo produkt i një politike të mirëmenduar? Kjo mrekulli shqiptare është produkt i politikave të djathta, të ndjekura nga Qeveria, të

cilat kanë në themelin e tyre lirinë. Liria ekonomike, krijimi i hapësirave më të mëdha për individin dhe sipërmarrjet, është filozofia që ka udhëhequr dhe frymëzuar reformat e kësaj Qeverie. Treguesi i indeksit të lirisë ekonomike për vitin 2010, i hartuar nga Heritage Foundation, një nga fondacionet më të mëdha dhe më të njohura amerikane, që ka 15 vjet që e kryen këtë vlerësim për të gjitha vendet e botës, e rendit Shqipërinë, në vlerësimin e fundit që përfshin periudhën korrik 2008-qershor 2009, në vendin e 53-të në botë, në krahasim me vendin e 62-të që kishte një vit më parë.

Vlerësimi për lirinë ekonomike përfshin fusha të ndryshme qeverisjeje, siç janë: liria e sipërmarrjes, lehtësia për të marrë licenca për të krijuar biznesin, liria fiskale, niveli i përgjithshëm i taksave, sa lekë u merr shteti bizneseve dhe sa lekë u mbeten bizneseve për të investuar, shpenzimet qeveritare, sa e madhe është qeverisja, sa ndërhyrje Qeveria në ekonominë e vendit, liria monetare, sa është inflacioni, pavarësia e bankës qendrore, liria financiare, sa i hapur dhe transparent është sistemi bankar, e drejta e pronësisë, korrupsioni dhe tregu i punës.

Indeksi i lirisë ekonomike për vitin 2010 tregon shumë qartë se, edhe në një periudhë krize të thellë ekonomike ne vazhduam me reformat tona liberalizuese, çuam përpara lirinë ekonomike, duke krijuar aftësi më të mëdha për individin dhe për sipërmarrësit shqiptarë. Shqipëria lë pas të gjitha vendet e rajonit, renditet e 53-ta në botë apo e 25-ta në kontinentin evropian, ku përfshihen 43 vende në vlerësim. Indeksi i lirisë ekonomike nuk është vetëm një tregues i ngushtë ekonomik. Filozofia dhe parimet e lirisë ekonomike kanë në thelb të tyre individin dhe sipërmarrjen, fuqizimin e individit, krijimin e hapësirave, në mënyrë që një individ i lirë të mund të plotësojë aftësitë dhe potencialin e tij, një qeverisje transparente, që nuk diskriminon sipërmarrësit dhe kufizon ndërhyrjet e saj në ekonomi, si dhe konkurrencë të lirë.

Vendet me lirinë më të madhe ekonomike në botë kanë rezultuar të kenë edhe rritjen më të lartë ekonomike dhe një ulje më të madhe të varfërisë.

Përmirësimi i renditjes së Shqipërisë në indeksin e lirisë ekonomike është treguesi më i qartë i suksesit të reformave që po vazhdojnë. Ky është një tregues se këto arritje nuk ishin aksidentale, por fryt i një filozofie të qartë, që bazohet te liria, fuqizimi i individit, siç kanë qenë politikat që kemi ndërmarrë me taksën e sheshtë, përgjysmimin e

taksave për biznesin e vogël, uljen e kontributit të sigurimeve shoqërore, zvogëlimin e administratës, rritjen e investimeve në infrastrukturë, krijimin e një sporteli të vetëm për regjistrimin e biznesit dhe licencat. Ky realitet, siç vlerësohet nga shqiptarët dhe të huajt, qëndron në kontrast të thellë me tablonë që zoti Rama mundohet t'u pikturojë çdo ditë qytetarëve shqiptarë.

E vërteta nuk është kapja e shtetit, siç u thotë ai shqiptarëve, por është liria ekonomike, krijimi i hapësirave të reja për individët dhe sipërmarrësit. Kjo është e vërteta që po përjetojnë përditë sipërmarrësit e huaj dhe vendas. E vërteta që propagandon çdo ditë zoti Rama, nuk është varfëria ekonomike dhe humbja e shpresave për qytetarët shqiptarë, por është fuqizimi i individit dhe nxjerrja nga varfëria e 200 mijë shqiptarëve, siç e vlerësoi Banka Botërore në raportin e saj dhe siç e deklaroi para pak ditësh në Shqipëri zëvendës-presidenti i Përgjithshëm i Bankës Botërore.

Përmirësimi i renditjes së Shqipërisë është një lajm i shkëlqyer. Liria ekonomike është një nga komponentët më të rëndësishëm të një shoqërie të lirë dhe kjo është filozofia jonë.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Bumçi!

Zoti Cara, urdhëroni!

Igli Cara - Falemnderit, zonja Kryetare!

Të nderuar deputetë,

Dje, në datën 20 janar, është zhvilluar mbledhja e KRT-së në Bashkinë Durrës. Siç jeni të informuar edhe nëpërmjet medias, kjo mbledhje e KRT-së, që është një organ kolegjal, është ndërprerë pikërisht nga kryetari i Bashkisë, zoti Vangjush Dako, në vazhdimësinë e urdhrave politikë të marrë nga kryetari i PS-së, zoti Rama, për të penguar çdo investim të madh dhe të dobishëm për qytetin e Durrësit dhe, pa hezitim do të thosha, edhe në plan kombëtar.

Do t'ju shpjegoj se pse e them këtë. Më shumë se gjysma e anëtarëve të KRT-së, sipas Rregullores, kanë kërkuar që të votohet rendi i ditës, ku një pikë e rëndësishme ishte edhe rinovimi i lejes së sheshit për portin e ri të peshkimit, që ishte paraqitur po nga bashkia më datë 4 dhjetor 2009, me numër protokollit 5404, i ndryshuar me qëllim në mbledhjen e djeshme, në datën 20. Pa dashur të përsëris, do të përmend disa elemente të rëndësishme se pse ky port peshkimi duhet të shqyrtohet. E theksoj, të shqyrtohet dhe të votohet.

Që nga viti 2002, për këtë port janë harxhuar

afro 8 vjet pune, të një grupi pune të ngritur nga specialistë të Ministrisë së Bujqësisë, Transportit, Ekonomisë, Turizmit, Mjedisit, përfaqësues të bashkisë dhe Autoritetit Portual. Pra, 7 institucione të rëndësishme. Për këtë port është marrë edhe vendimi nr. 3, datë 14.08.2004 "Miratim leje sheshi për ndërtim". Po nga vetë KRT-ja e Bashkisë së Durrësit është pajisur me leje mjedisore, ka filluar disbursimi i kredisë që në vitin 2008 dhe deri tani janë harxhuar 1,5 milionë dollarë. Ndërtimi i këtij porti kap vlerën e 5 milionë dollarëve, e cila është kredi e Bankës Islamike, e miratuar në Kuvend me ligjin nr. 9679, datë 22.01.2007 "Për ratifikimin marrëveshjes së huasë ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe Bankës Islamike". Këtu duhet thënë se edhe deputetët socialistë e kanë votuar pro këtë ligj. Kjo kredi është në limitet e kohës për lëvrimin ose djegien e saj. Pra, kemi një investim me vlerë për peshkatarët dhe qytetin, ku vetëm të punësuar në fazën e parë do të jenë 700 persona, që çliron punimet dhe investimet në terminalin e trageteve në Portin e Durrësit. Pra, siç shihet, nuk mungon asgjë nga ana e dokumentacionit ligjor, që projekti të mos shqyrtohej në mbledhjen e KRT-së së Durrësit.

I ndodhur para këtij fakti, duke mos pasur asnjë arsye teknike dhe ligjore dhe nën presionin e komandantit të tij, zotit Rama, për të penguar investimet në qytetin e Durrësit, zoti Dako ka bërë një veprim totalisht të papërgjegjshëm, duke deklaruar se, sa të jem unë kryetar bashkie, ky projekt nuk do të kalojë, duke tërhequr në këtë mënyrë nga mbledhja e KRRT-së të gjithë përfaqësuesit e tij. Pra, bllokoni procesin e votimit, duke goditur jo vetëm rastin në fjalë, por edhe biznesin e ndërtimit.

E turpshme, e papërgjegjshme, nuk kam fjalë tjetër ta përshkruaj këtë veprim. Është rast flagrant dhe i dënueshëm që të dalësh mbi ligjin, mbi organet kolegjiale dhe të mos njohësh institucionin e votës. E thënë shkurt, filozofi e njëjtë me atë të kryetarit të PS-së, zotin Rama: nëse nuk më pëlqen, nuk e njoh asnjë institucion. Rama thotë se, nëse i fitoj zgjedhjet, ato janë të mira, nëse nuk i fitoj, fajin e kanë kutitë dhe dua t'i rihap edhe një herë. Zoti Dako thotë se, nëse fitoj para nga porti i peshkimit, e kaloj në KRRT, nëse u shes beton nga firma ime e kaloj në KRRT, nëse nuk fitoj gjë nuk e kaloj, sikur ta ketë pronë private KRRT-në dhe qytetin e Durrësit, pavarësisht se ky qytet fiton shumë nga kjo.

Kjo filozofi drejtimi për interesa personale është e papranueshme, banale dhe njëkohësisht edhe

kriminale. I bëj thirrje binomit Rama-Daku që të heqin dorë nga bllokimi i investimeve në qytetin e Durrësit. Ta lëmë qytetin të zhvillohet dhe qytetarët të punësohen. Nuk është faji as i peshkut, as i peshkatarëve që ju humbët zgjedhjet më 28 qershor.

Zoti Rama, zoti Dako, çlirojeni këtë investim të madh të qytetit të Durrësit, që e mbani peng për turpin tuaj, për interesa personale dhe politike! Dhëntë Zoti të mos vazhdojnë edhe shumë këto mendje të çmendura!

Falemnderit!

Jozefina Topalli- Falemnderit, zoti Cara!

Fjalën e ka zoti Vasili.

Petrit Vasili – E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar deputetë,

Duke qenë se ende jemi në një fazë emergjence, e cila e ka kaluar momentin e saj më të vështirë dhe më kritik, ndërkohë që po përvijohet me probleme dhe preokupacione të tjera, që duhen ndjekur në mënyrë sistematike dhe rigorozë, do të doja të informoja përsëri Kuvendin lidhur me situatën më të fundit sanitare në zonë. Njëkohësisht dua të informoj edhe opinionin publik për të davaritur çdo lloj hamendje, vlerësim ose karakterizim, sigurisht profesional, qoftë në media ose diku gjetkë që tenton të hidhet në treg.

Situata aktuale, e cila ndiqet në mënyrë paralele nga organet e inspektimit sanitar në Shkodër, të mbështetura në mënyrë të përditshme dhe të vazhdueshme edhe nga Instituti i Shëndetit Publik në Tiranë, si një institucion mjaft i specializuar dhe me kapacitete teknike të plota, për të vlerësuar saktësisht atë, paraqitet e tëra nën kontroll. Kemi një situatë të ujit të pijshëm, jo vetëm në qytetin e Shkodrës, por edhe në të gjithë ujësjellësit e tjerë, të cilët janë vënë plotësisht në funksionim, në gjendje shumë të mirë nga pikëpamja sanitare. Ndërkohë, disa ujësjellës që nuk janë vënë në përdorim po mbahen nën survejim të plotë sanitar, në mënyrë që në momentin që do të vihen në punë të mos ketë asnjë problem për zonat që do të furnizohen me ujë nga këta ujësjellës.

E gjithë ndërhyrja është artikuluar mirë dhe qartë edhe nga pikëpamja profesionale. Plani i koordinuar nga Komiteti Ndërmnistror i Emergjencës, së bashku me Shtabin e Emergjencës që funksionon në Shkodër e që drejtohet nga prefekti, e mban situatën nën një kontroll të plotë dhe është artikuluar mbi disa themele që bëjnë të pamundur çdo lloj surprize, siç janë kujdesi parësor dhe vazhdimi i mbajtjes nën kontroll të plotë të shërbimit 24-orësh

dhe shërbimeve të tjera të karakterit klinik.

Njëkohësisht ky plan vazhdon të mbajë nën një kontroll shumë të rreptë të gjitha elementet e shëndetit publik, qoftë ujin e pijshëm, qoftë monitorimin e shtuar të pikave, qofshin fundore dhe ato të pikave primare, për sa i takon ujit dhe rezervave të tij, mban nën kontroll të plotë të gjitha llojet e furnizimeve të tjera alternative me ujë, mban të impenjuar pushtetin lokal lidhur me informimin që duhet t'i bëjë publikut për këto ujëra.

Njëkohësisht vazhdon monitorimi i ujërave të përdorura, për të evituar të gjitha llojet e mundësive për krijimin e premisave për shkaqe epidemike ose shkaqe për të cilat po tentohet që vazhdimisht të hidhen në treg si të tilla, ndërkohë që nuk ka asnjë premisë profesionale, as edhe sanitare që të mbështesë një ide të tillë, përveçse në disa raste një kuturisje pa mend për të shpikur një situatë të re atje ku nuk ekziston.

Këtu është vendi për të sqaruar njëherë e përgjithmonë se arsyeja e kontrollit të mirë të situatës shëndetësore në këtë rast të veçantë qëndron në faktin se nuk është një kontroll i cili ndodh sot dhe në këtë moment, por i tërë veprimi qeveritar ka qenë artikulluar që në minutën e parë. Pikërisht duke pasur parasysh një situatë të tillë dhe masat e marra që në momentin e parë, u zhdukën të gjitha premisat për të pasur evente të tilla të karakterit epidemik, ndaj dhe nuk raportohen as raste, as shfaqje të shkëputura dhe aq më pak të raportohen shfaqje që prekin komunitete të gjera.

Gjithashtu, ne po vazhdojmë të mbajmë të aktivizuar sistemin e lehtë për sëmundjet ngjitëse të çdo lloji, duke dedektuar çdo gjë në kohë reale, për të pasur mundësinë e një kontrolli efikas, ku deri më sot nuk kemi shënuar qoftë edhe një rast të vetëm, duke siguruar hetimin e shpejtë të vatrave të të gjitha llojeve dhe duke koordinuar më së miri, në mënyrë të veçantë edhe me inspektoratet përkatëse të veterinarisë dhe të ushqimit, për të arritur një kontroll të vazhdueshëm efikas në terren. Për këtë janë përgatitur dhe disa udhëzime lidhur me parandalimin e aksidenteve dhe të dëmtimeve në zonat e përmbytura, në mënyrë që të evitohet dhe disa evente të papëlqyeshme, të cilat mund të rëndonin në mënyrë artificiale shëndetin e banorëve.

Për ta mbyllur këtë ekspozë, ne po vazhdojmë të ruajmë një kujdes spitalor në atë zonë në gjendje alerti, duke predispozuar në mënyrë të plotë konsulta të veçanta për të gjithë banorët e zonave të përmbytura dhe njëkohësisht sigurimin e dhënies

në kohë reale të ndihmës për ta, duke evituar çdo lloj pritshmërie, duke i privilegjuar ata, në kuptimin e mirë të fjalës, në raport me banorët e tjerë të qytetit që nuk janë përballur me fenomene të tilla.

Jozefina Topalli- Falemnderit, zoti Vasili!

Fjalën e ka zoti Tafaj.

Myqerem Tafaj- E nderuar zonja Kryetare, Të nderuar kolegë deputetë,

Sot me kënaqësi dëshiroj t'ju njoftoj se në zonat e përmbytura të qarkut të Shkodrës u hapën edhe dy shkollat e fundit, shkolla 9-vjeçare në Malin e Jushit dhe shkolla fillore në Obot, ku procesi mësimor filloi normalisht. Me këtë rast dëshiroj të falënderoj përzemërsisht të gjithë mësuesit dhe drejtuesit e arsimit në qarkun e Shkodrës, që me një përkushtim të jashtëzakonshëm punuan për të përgatitur shkollat, për të pritur nxënësit, deri në ditën e sotme. Ky është një fakt më shumë që tregon për menaxhimin e shkëlqyer që iu bë situatës së krijuar nga ana e Qeverisë dhe nga pushtetarët lokalë.

Sot pata rastin të takoj kryetarin e Komunës së Bushatit dhe kryetarin e Komunës së Dajçit, ku na u dha rasti të bisedonim për dëmet e shkaktuara, si dhe për shpejtësinë me të cilën duhet të rehabilitonim shkollat. Në fakt prisnim më shumë dëme, por për fat të mirë në 18 shkollat që ndodhen në zonat e përmbytura nga uji dëmet nuk janë aq të mëdha. Grupi i përbashkët i punës së Ministrisë së Arsimit dhe Drejtorisë Arsimore Rajonale të Qarkut të Shkodrës po punon më tutje, sipas një plani të detajuar masash.

Së pari, për asistencën e nxënësve në zonat e përmbytura.

Së dyti, shërbimi social dhe psikologjik i shkollave të qytetit të Shkodrës tani është transferuar në të gjitha shkollat e zonave të përmbytura ku nxënësit kanë një asistencë të përhershme gjatë gjithë kohës së mësimit nga psikologët e shkollave të qytetit të Shkodrës.

Së treti, po evidentohen nevojat për tekste mësimore. Deri më sot nxënësve u janë dërguar 4 mijë e 500 tekste mësimore të reja. Me këtë rast dëshiroj të falënderoj shtëpitë botuese që kanë dhuruar tekste në shkolla, jo vetëm tekste mësimore, por dhe tekste artistike, edhe tekste jashtë klase.

Së katërti, grupet e punës kanë avancuar me evidentimin e dëmeve, jemi drejt përfundimit të këtij procesi dhe mendojmë se i kemi të gjitha mundësitë. Në radhë të parë, do të përdorim fondet e buxhetit të parashikuara për Ministrinë e Arsimit,

për rehabilitimin e të gjitha shkollave në zonat e përmbytura

Nga ana tjetër, Drejtoria Rajonale e Arsimit në Shkodër, së bashku me Drejtorinë e Kurrikulave të ministrisë, po punon për riorganizimin e programit, në mënyrë që të kompensohet çdo boshllëk i krijuar, pa zgjatur asnjë ditë shkollën.

Siç e dini, studentët e Universitetit të Shkodrës dhe nxënësit e shkollave profesionale mësimin e filluan me vonesë, përkatësisht në datën 15 janar studentët dhe më 18 janar nxënësit, sepse konviktet e Shtëpisë së Studentit në Shkodër dhe të shkollave profesionale u vunë në dispozicion të banorëve, një kapacitet i krijuar me rreth 2 mijë veta, që u përdor pjesërisht.

Kjo situatë na tregoi se zona e Shkodrës është një zonë e cila kërkon më shumë studime shkencore, ndërdisiplinore, që do t'i shërbejnë rajonit dhe ekzekutivit për parandalimin dhe përballimin e pasojave të situatave të tilla.

Universiteti "Luigj Gurakuqi" në Shkodër, si një ndër universitetet më të mëdha të Shqipërisë, në strategjinë e zhvillimit të tij ka kthimin në qendër rajonale që kryen studime për zhvillimin e rajonit. Ky pellg hidrik që rrethon Shkodrën është një fushë shumë interesante studimesh për universitetin e Shkodrës. Në këtë universitet kanë filluar studimet e masterit, në bashkëpunim me universitetin e Podgoricës, që në vitin e kaluar, në fushën e mjedisit dhe në këtë drejtim ky universitet duhet të bëjë shumë më tepër.

Nga ana tjetër, kjo situatë tregon se të gjitha qendrat tona kërkimore-shkencore dhe universitetet kanë mundësi që në këtë rajon të orientojnë studimet e tyre ndërdisiplinore, kryesisht në fushën e mjedisit, për të hartuar plane dhe programe të sakta shkencore, me parashikime dhe parametra lehtësisht të monitorueshme dhe të përdorshme nga ekzekutivi.

Kjo situatë e vështirë që kaloi, tregoi mrekullinë shkodrane, tregoi fisnikërinë e popullit të Shkodrës, të zonave të përmbytura. Ne mësuam shumë prej saj dhe i falënderojmë shumë jo vetëm qytetarët, por edhe përfaqësuesit e pushtetit lokal, të cilëve për këtë bashkëpunim të shkëlqyer, të ngushtë, ne përiqeshim t'u jepnim kurajë, por në fakt ata ishin më kurajozë se ne. Kjo është një mrekulli e madhe dhe nga kjo eksperiencë ne fituam shumë.

Falemnderit!

Jozefina Topalli- Falemnderit, zoti Tafaj!

Këtu mbyllet pika e parë e rendit të ditës.

Kalojmë te pika e dytë e rendit të ditës: miratimi i procesverbalit të seancës plenare, datë 18.01.2010. Ka vërejtje? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Kosovës për bashkëpunimin policor ndërkufitar".

Fjalën e ka zonja Trashani, në emër të Komisionit të Ligjeve.

Arenca Trashani – Falemnderit, zonja Kryetare!

Komisioni i Ligjeve, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, mori në shqyrtim në datën 15.12.2009 projektligjin "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Kosovës për bashkëpunimin policor ndërkufitar".

Objekti i kësaj marrëveshjeje është parandalimi i rrezikut dhe sigurimi i rendit publik në zonat kufitare, veçanërisht parandalimi dhe zbulimi i shkeljeve penale që cenojnë sigurinë ndërkufitare. Në marrëveshje parashikohet që palët të informojnë njëra-tjetrën për çështje pune, për parandalimin e krimit ndërkufitar dhe marrjen e masave të rëndësishme për mbrojtjen e kufirit shtetëror, kontrollin e trafikut ndërkufitar, i cili mund të ketë ndikim në interesat e palës tjetër kontraktuese, si dhe caktimin e organeve ose personave bashkërendues.

Në përfundim Komisioni i Ligjeve, duke vlerësuar rëndësinë e kësaj marrëveshjeje për vendin tonë, u shpreh dakord për ratifikimin e saj në seancë plenare. Ky projektligj është në përputhje të plotë me nenin 121 të Kushtetutës.

Falemnderit!

Jozefina Topalli- Falemnderit, zonja Trashani! Në emër të Komisionit të Jashtëm?

(Përfaqësuesi i komisionit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Fjalën e ka zoti Ngresi, në emër të Komisionit për Sigurinë Kombëtare.

Vasillaq Ngresi – Falemnderit, zonja Kryetare!

Komisioni për Sigurinë Kombëtare në mbledhjen e datës 17.12.2009 shqyrtoi projektligjin "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Kosovës për bashkëpunimin policor ndërkufitar". Ky projektligj ka të bëjë me zbatimin e rekomandimeve të Bashkimit Europian për rritjen e sigurisë së kufijve, për parandalimin dhe zbulimin e

krimit dhe të trafikeve në të.

Në këtë marrëveshje parashikohen masa për mbrojtjen e kufijve dhe parandalimin e krimit, si dhe të gjitha llojet e trafikeve. Marrëveshja është në përputhje me Kushtetutën dhe me ligjet në fuqi. Duke parë rëndësinë e saj, komisioni e kaloi atë nen për nen dhe ia sugjeroi Kuvendit për ta miratuar në seancë plenare.

Falemnderit!

Jozefina Topalli- Falemnderit!

Kalojmë në shprehjen e mendimit të grupeve.

Grupi Parlamentar i LSI-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Grupi Parlamentar i PD-së?

(Përfaqësuesi i grupit u shpreh dakord.)

Falemnderit!

Kalojmë te projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për riparimin, rindërtimin dhe mirëmbajtjen e piramidave e të shenjave të tjera kufitare në kufirin shtetëror shqiptaro - malazez".

Në emër të Komisionit për Sigurinë Kombëtare, si komision përgjegjës, zoti Skuqi.

(Zoti Skuqi shprehet dakord.)

Falemnderit!

Në emër të Komisionit të Ligjeve, zoti Halimi.

(Zoti Halimi shprehet dakord.)

Falemnderit!

Në emër të Komisionit të Politikës së Jashtme?

(Përfaqësuesi i komisionit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Ka pyetje? Nuk ka.

Ka diskutime? Nuk ka.

Në emër të grupeve:

Grupi Parlamentar i LSI-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Grupi Parlamentar i PD-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Kalojmë te projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Irlandës për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal për tatimin mbi të ardhurat."

Në emër të Komisionit të Ekonomisë, si komision përgjegjës, zoti Spaho, urdhëroni!

Edmond Spaho – Falemnderit, zonja Kryetare!

Kjo marrëveshje ka dy synime:

Së pari, krijon bazën ligjore për trajtimin fiskal të shtetasve të të dyja vendeve, kur ata ushtrojnë aktivitet ekonomik në vendet respektive. Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje do të bëhet e mundur që shtetasit e këtyre vendeve të paguajnë vetëm një herë tatimin mbi të ardhurat, të cilat realizohen nga aktiviteti ekonomik që kryejnë në vendet respektive.

Së dyti, krijon bazën ligjore për shkëmbimin e informacionit për evitimin e evazionit fiskal në lidhje me pagesën e tatimit mbi të ardhurat.

Marrëveshja u votua nga të gjithë anëtarët e komisionit.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Spaho!

Në emër të Komisionit të Politikës së Jashtme, zonja Pernaska.

(Zonja Pernaska shprehet dakord.)

Falemnderit!

Në emër të Komisionit të Ligjeve, zonja Pavlina Hoti.

Pavlina Hoti – Edhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut e mori në shqyrtim këtë marrëveshje, të nënshkruar në Tiranë më 16 tetor 2009, në mbledhjen e datës 22. Komisioni u njoh, gjithashtu, me bazën ligjore që mbështetet në modelin tashmë të përdorur nga të gjitha vendet e tjera dhe që është modeli standard i OECD-së. Në fakt, marrëveshja mënjanon tatimin e dyfishtë, që do të thotë se një person, individ apo shoqëri, që kryen aktivitet biznesi në territorin e Shqipërisë, mund të zbresë nga detyrimet e paguara në shtetin shqiptar ato që ka paguar në vendin e tij, aty ku ka rezidencën.

Anëtarët e Komisionit të Ligjeve, duke vlerësuar rëndësinë e kësaj marrëveshjeje për shtetin, ishin unanimisht dakord për ratifikimin e saj në seancë plenare. Projektligji është në përputhje me nenin 121 të Kushtetutës.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit!

Në emër të grupeve:

Grupi Parlamentar i LSI-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Grupi Parlamentar i PD-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Kalojmë te projektligji "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", i ndryshuar.

Në emër të Komisionit të Ekonomisë, zoti Florian Mima.

Florian Mima – Falemnderit, zonja Kryetare!

Edhe Komisioni i Ekonomisë, në mbledhjen e datës 19, shqyrtoi projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin bazë të TVSH-së”. Ndryshimet konsistojnë si më poshtë vijon:

Është transferuar kompetenca për përcaktimin e kufirit minimal të qarkullimit nga Parlamenti tek ekzekutivi, pra te Këshilli i Ministrave.

Janë përmirësuar procedurat për regjistrimin dhe çregjistrimin e subjekteve tatimpaguese të TVSH-së, duke i dhënë fund një herë e mirë lojës së zhvilluar deri më sot me hyrje dhe dalje pa kriter në regjimin e TVSH-së. Parimi që sanksionon këtë fundloje është: kur ke hyrë një herë në regjimin e TVSH-së, do të dalësh vetëm kur të plotësohen kushtet për mbylljen e biznesit”.

Është përjashtuar nga TVSH-ja duke filluar nga data 1 tetor 2010, furnizimi i shërbimeve arsimore për të gjitha institucionet arsimore parauniversitare dhe universitare në Republikën e Shqipërisë, qofshin këto publike apo private.

Përjashtohet nga TVSH-ja furnizimi i shërbimeve të kryera nga rezidentë, qoftë shoqëri apo individë, jashtë territorit të Shqipërisë. Deri më sot ky furnizim është trajtuar me 0%. Kalon nën regjimin e përjashtuar.

Është hequr përjashtimi nga TVSH-ja i materialeve ushtarake të importuara nga Forcat e Armatosura, kur këto vijnë si ndihma apo dhurata prej NATO-s apo vende partnere.

Gjithashtu, është plotësuar edhe një boshllëk ligjor mbi furnizimin e mallrave dhe shërbimeve të ndërlydhura me transportin ndërkombëtar të mallrave dhe pasagjerëve, të cilat deri më sot janë trajtuar me 0%. Ligji autorizon Ministrinë e Financave dhe atë të Transporteve për të nxjerrë një udhëzim për të specifikuar se cilat lloje shërbimesh e përfitojnë 0%-shin.

Të gjitha ndryshimet e propozuara i gjejmë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e tjera në fuqi dhe i sugjerojmë seancës ta miratojë projektligjin unanimisht.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Mima!

Ka pyetje? Nuk ka.

Ka diskutime? Nuk ka.

Në emër të grupeve:

Grupi Parlamentar i LSI-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Grupi Parlamentar i PD-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Kalojmë te projektligji “Për detergjentët”

Zoti Bogdani, në emër të Komisionit për Integrimin Europian, urdhëroni!

Gerti Bogdani – Në bazë të Rregullores së Kuvendit, Komisioni për Integrimin Europian, në cilësinë e komisionit që ofron mendim për këtë projektligj, pasi e shqyrtoi në mbledhjen e tij, edhe në prezencën e përfaqësuesve të Ministrisë së Ekonomisë, vëren se ky projektligj është pothuajse plotësisht i përafuar me Rregulloren nr.648 të Këshillit të Parlamentit Europian, të datës 31 mars 2004 “Për detergjentët”.

Si i tillë, duke përcaktuar qartë vetitë dhe kërkesat për efektet e biodegradimit të elementeve të detergjentëve, ai shërben për mbrojtjen e mjedisit. Nga ana tjetër, duke përcaktuar qartë dhe duke publikuar informacionin mbi përmbajtjen e këtyre elementeve, shërben për mbrojtjen e konsumatorit nga efektet anësore që mund të kenë këto elemente. Gjithashtu, standardizimi lehtëson edhe tregtimin e lirë të këtyre detergjentëve.

Vërejtjet e komisionit iu paraqitën edhe komisionit përgjegjës për këtë projektligj dhe duket se janë marrë parasysh. Ne, si komision, e votuam me unanimitet këtë projektligj.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Bogdani!

Në emër të Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, si komision përgjegjës, zoti Metalla.

(Zoti Metalla shprehet dakord.)

Falemnderit!

Ka pyetje? Nuk ka.

Ka diskutime? Nuk ka.

Në emër të grupeve:

Grupi Parlamentar i LSI-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Grupi Parlamentar i PD-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Kalojmë te projektligji “Për metrologjinë”.

Në emër të Komisionit të Veprimtarive Prodhuese, zoti Jemin Gjana.

(Zoti Gjana shprehet dakord.)

Falemnderit!

Është një ligj i rëndësishëm, që është depozituar prej kohësh, mbi të cilin komisionet kanë punuar gjatë.

Ka pyetje? Nuk ka.

Ka diskutime? Nuk ka.
 Në emër të grupeve:
 Grupi Parlamentar i LSI-së?
(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)
 Falemnderit!
 Grupi Parlamentar i PD-së?
(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)
 Falemnderit!
 Atëherë, do të kalojmë në votimin e projektligjeve.
(Seanca ndërpritet për 2 minuta.)

* * *

Jozefina Topalli - Rinisim seancën.
 Hapet votimin për kuorumin.
 Mbyllet votimi.
 73 deputetë janë të pranishëm.
 Fillojmë me votimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunimin policor ndërkufitar”.

Hapet votimi në parim.
 Mbyllet votimi.
 73 pro, s’ka kundër, s’ka abstenime.
 Kuvendi miraton në parim projektligjin.
 Kalojmë në votimin nen për nen.
 Kush është dakord me nenin 1?
 Falemnderit! Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.
 Miratohet.
 Kush është dakord me nenin 2?
 Falemnderit! Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.
 Miratohet.
 Hapet votimin me elektronikë, në tërësi.
 Mbyllet votimi.
 73 pro, s’ka kundër, s’ka abstenim.
 Kuvendi miraton në tërësi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunimin policor ndërkufitar”.

Kalojmë te projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për riparimin, rindërtimin dhe mirëmbajtjen e piramidave dhe të shenjave të tjera kufitare në kufirin shtetëror shqiptaro - malazez”.

Hapet votimi në parim, me elektronikë.
 Mbyllet votimi.
 73 pro, s’ka kundër, s’ka abstenim.

Kuvendi miraton në parim projektligjin.
 Kalojmë te votimi nen për nen, me kartonë.
 Kush është dakord me nenin 1?
 Falemnderit! Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.
 Miratohet.
 Kush është dakord me nenin 2?
 Falemnderit! Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.
 Miratohet.
 Hapet votimin me elektronikë, në tërësi.
 Mbyllet votimi.
 73 pro, s’ka kundër, s’ka abstenim.
 Kuvendi miraton në tërësi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për riparimin, rindërtimin dhe mirëmbajtjen e piramidave dhe të shenjave të tjera kufitare në kufirin shtetëror shqiptaro - malazez”.

Kalojmë te votimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Irlandës për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal për tatimin mbi të ardhurat”.

Hapet votimi në parim, me elektronikë.
 Mbyllet votimi.
 74 pro, s’ka kundër, s’ka abstenim.
 Kuvendi miraton në parim projektligjin.
 Kalojmë te votimi nen për nen.
 Kush është dakord me nenin 1?
 Falemnderit! Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.
 Miratohet.
 Kush është dakord me nenin 2?
 Falemnderit! Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.
 Miratohet.
 Hapet votimin me elektronikë, në tërësi.
 Mbyllet votimi.
 74 pro, s’ka kundër, s’ka abstenim.
 Kuvendi miraton në tërësi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Irlandës për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal për tatimin mbi të ardhurat”.

Kalojmë te projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar”.

Hapet votimi në parim, me elektronikë. Është varianti i Qeverisë, pa ndryshuar asgjë.
 Mbyllet votimi.
 74 pro, s’ka kundër, s’ka abstenim.
 Kuvendi miraton në parim projektligjin.
 Kalojmë te votimi nen për nen.

Kush është dakord me nenin 1?

Falemnderit! Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2?

Falemnderit! Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Kush është dakord me nenin 3?

Falemnderit! Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.
Miratohet.

(Vazhdon e njëjta procedurë votimi nga neni 4 deri te neni 9.)

Hapet votimin me elektronikë, në tërësi.

Mbyllet votimi.

74 pro, s'ka kundër, s'ka abstenim.

Kuvendi miraton në tërësi projektligjin "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7928, datë 27.04.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", të ndryshuar".

Kalojmë te projektligji "Për detergjentët".

Hapet votimi në parim, me elektronikë.

Mbyllet votimi.

74 pro, s'ka kundër, s'ka abstenim.

Kuvendi miraton në parim projektligjin.

Kalojmë te votimi nen për nen, me kartonë, me vërejtjet e bëra nga komisioni përgjegjës që është Komisioni i Veprimtarive Prodhuese, i cili ka marrë parasysh edhe disa sugjerime të Komisionit për Integrimin.

Atëherë, bashkë me vërejtjet e komisionit, kush është dakord me nenin 1?

Falemnderit! Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2?

Falemnderit! Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Kush është dakord me nenin 3?

Falemnderit! Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.
Miratohet.

(Vazhdon e njëjta procedurë votimi nga neni 4 deri te neni 12.)

Urdhëroni, zoti Gjana!

Jemin Gjana – Vetëm që të mos keqkuptohet, nenet 13, 15 dhe 18 janë hequr si nene.

Jozefina Topalli – Po, kjo është shënuar te propozimet e komisionit tuaj dhe rregullimi pastaj bëhet në listimin e tyre.

Kush është dakord me nenin 14?

Falemnderit! Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Për nenin 15 është ajo që thotë zoti Gjana.

Kush është dakord me nenin 16?

Falemnderit! Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Kush është dakord me nenin 17?

Falemnderit! Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Kush është dakord me nenin 18, me vërejtjet e Komisionit të Veprimtarive Prodhuese për ta kaluar si pikë e katërt e nenit 16?

Falemnderit! Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Kush është dakord me nenin 19, me vërejtjet e Komisionit të Veprimtarive Prodhuese për shtim titulli te neni, për riformulim të pikës 1 dhe të pikës 2?

Falemnderit! Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Kush është dakord me nenin 20?

Falemnderit! Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Hapet votimin me elektronikë, në tërësi.

Mbyllet votimi.

74 pro, s'ka kundër, s'ka abstenim.

Kuvendi miraton në tërësi projektligjin "Për detergjentët".

Kalojmë te votimi i projektligjit të fundit "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9875, datë 14.02.2008 "Për Metrologjinë".

Hapet votimi në parim, me elektronikë.

Mbyllet votimi.

74 pro, s'ka kundër, s'ka abstenim.

Kuvendi miraton në parim projektligjin.

Kalojmë te votimi nen për nen, me kartonë, bashkë me vërejtjet e komisionit përgjegjës që është Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Kush është dakord me nenin 1, me vërejtjet e komisionit për zëvendësimin e titullit te neni 61 i ligjit dhe zëvendësimin e fjalëve "komisioni i apelimit" me fjalët "komisioni i ankimit"?

Falemnderit! Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2, me vërejtjet e komisionit?

Falemnderit! Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Kush është dakord me nenin 3, sipas variantit qeveritar?

Falemnderit! Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.
Miratohet.

Hapet votimin me elektronikë, në tërësi.

Mbyllet votimi.

74 pro, s'ka kundër, s'ka abstenim.

Kuvendi miraton në tërësi projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9875, datë 14.02.2008 “Për Metrologjinë”.

Me kaq mbyllim edhe pikën e tetë të rendit të ditës.

Ju falënderoj për bashkëpunimin!
Natën e mirë!

(Seanca u mbyll në orën 19:00)

E enjte, 28.01.2010
Seanca e pasdites, ora 18:00

Drejton seancën Kryetarja e Kuvendit,
zonja Jozefina Topalli (Çoba)

Rendi i ditës:

1. *Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60 minuta).*

2. *Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 21.01.2010.*

3. *Projektligj “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjë-Hercegovinës për ripranimin e personave me qëndrim të parregullt”.*

4. *Projektligj “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën ndërkombëtare për përgjegjësinë civile për dëmet e shkaktuara nga ndotja dhe nga karburanti i depozitave, 2001”.*

5. *Akt normativ nr.10 “Për disa ndryshime në ligjin “Për buxhetin e shtetit të vitit 2009””.*

6. *Projektligj “Për një shtesë dhe ndryshim në ligjin nr.7651, datë 21.12.1992 “Për festat zyrtare dhe ditët përkujtimore”, të ndryshuar”.*

7. *Projektligj “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8366, datë 02.07.1998 “Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar”, të ndryshuar”.*

8. *Projektligj “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”.*

9. *Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”.*

Jozefina Topalli – Zotërinj deputetë, hapim seancën.

(Lexon rendin e ditës.)

Ndërkohë, zotërinj deputetë, më lejoni t’ju vë në dijeni që sapo është miratuar nga Këshilli i Europës rezoluta e reporterëve mbi Shqipërinë.

Më lejoni, në emrin tuaj, ta përshëndes këtë rezolutë.

Kjo rezolutë përmban thirrjen ndaj opozitës për të stopuar bojkotin e Parlamentit. Në diskutimet e kësaj seance plenare të Këshillit të Europës, duke filluar nga e majta ekstreme, për të vazhduar te

socialistët, socialdemokratët, qendra, e djathta dhe e djathta ekstreme, që të gjithë i kërkuan liderit të Partisë Socialiste shqiptare të ndalë bojkotin, sepse bojkoti nuk është mënyra me të cilën mendon Europa, nuk është mënyra me të cilën punon Europa.

Përveç kësaj, dua të falënderoj dy reporterët që bënë vetë dy ndryshime të rëndësishme në këtë rezolutë, në mënyrë të veçantë pranimin e disa prej amendamenteve më thelbësore që ishin paraqitur.

Kështu pra, në emrin tuaj, më lejoni të falënderoj Këshillin e Europës dhe reporterët për këtë rezolutë për Shqipërinë.

Në pikën e parë të rendit të ditës kanë regjistruar emrat deputetët: Edi Paloka, Gent Strazimiri, Tritan Shehu, Gerti Bogdani, Bedri Hoxha, Pavlina Hoti, Gëzim Dibra dhe ministrat Arben Imami dhe Majlinda Bregu.

Zoti Paloka, urdhëroni!

Edi Paloka – Falemnderit, zonja Kryetare!

Edhe një herë tjetër, së fundi, Edvin Rama na ndihmoi me veprimet e tij për të sqaruar edhe ndonjë skeptik të mbetur në mëdyshje mbi qëllimet e tij si kryetar i Partisë Socialiste. Prej shumë kohësh, duke paraqitur fakte, ne u kemi treguar shqiptarëve se Edvin Rama dhe grupi që ai përfaqëson në Partinë Socialiste, për interesat e tyre të ngushta, janë duke punuar kundër interesave të shqiptarëve, të djathtë apo të majtë qofshin ata.

Letra e Partisë Socialiste të Ramës drejtuar Asamblesë së Këshillit të Europës, ku, praktikisht, kërkohej përjashtimi i Shqipërisë nga ky institucion, nuk lë vend për asnjë mëdyshje.

Më parë ne kemi denoncuar përpjekjet pa precedent të Erionëve apo ditëzinjve të Ramës për të penguar anëtarësimin e Shqipërisë në NATO. Ata sot përpiqen të paraqiten si pjesë e suksesit të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, duke paraqitur si argument “bashkëpunimin” që ofruan si opozitë në atë periudhë, por të mos mendojnë se ne nuk i

dimë *e-mail*-et apo letrat që dërgonin Erionët dhe ditëzinjtë te partnerët tanë për t'u mbushur mendjen se Shqipëria nuk e meritonte të ishte anëtare me të drejta të plota në NATO.

Kishte ndodhur edhe një herë tjetër që po ajo parti, me njerëz që sot jo rastësisht janë në krah të Ramës, të kundërshtonte anëtarësimin e Shqipërisë në NATO, atëherë kur Berisha e bëri vendin tonë pjesë të Partneritetit për Paqe të Atlantikut Verior. Atëherë, në fakt, ne nuk na bëri shumë përshtypje, sepse ajo parti sapo kishte ndryshuar nga Partia e Punës, nga partia e baballarëve të atyre që sot drejtojnë Partinë Socialiste.

Por, sot, pas 20 vjetësh, kur Shqipëria është futur plotësisht në rrugën e integritit, sigurisht që ne nuk mund t'i kalojmë lehtë veprimet e tyre. Janë Xhelilët, Sulët e Hamitët e rinj, që ecin hap pas hapi në gjurmët e baballarëve të tyre, që kanë të njëjtat qëllime e interesa, por me forma e mënyra më të maskuara. Baballarët e tyre e izoluan Shqipërinë, sepse vetëm ashtu mund të ruanin pushtetin e tyre diktatorial. Këlyshët po tentojnë ta izolojnë me shpresën se kështu mund të marrin pushtetin.

Dikujt mund t'i duket e ekzagjeruar kjo që sapo thashë, sepse kushdo e di që ajo kohë nuk mund të kthehet më, por kjo nuk do të thotë që Edvini dhe këlyshët e tjerë nuk e ëndërrojnë. Të paktën, veprimet e tyre atje çojnë.

Çfarë shpjegimi tjetër mund t'i jepet bojkotit të Parlamentit nga një njeri që humbi zgjedhjet dhe tani deklaron se do ta marrë pushtetin me dhunë? Çfarë shpjegimi mund t'i jepet faktit që ky njeri nuk nje vendime gjykatash apo institucioneve të tjera demokratike? Çfarë shpjegimi mund t'i jepet faktit që ky njeri del kundër vendimeve dhe qëndrimeve të institucioneve demokratike ndërkombëtare?

Jo më larg se dje, përfaqësuesit e Ramës morën përgjigjen e fundit nga personalitetet e Europës. Nuk po përmend ata që Rama i quan mbështetës të Berishës, se janë të djathtë, por dje u prononcua qartë edhe nënkryetari i Partisë Socialiste Europiane, Svoboda, një nga personalitetet e asaj partie dhe një nga mbështetësit më të flaktë të Partisë Socialiste Shqiptare. Ai dje deklaroi qartë për të gjithë shqiptarët se bojkoti i Ramës nuk sjell përjashtim të Shqipërisë, por mund të sjellë vetëpërjashtim të partisë së Ramës, sepse bojkoti nuk bën pjesë në konceptet demokratike të Europës. E si u përgjigjet Rama këtyre? Duke deklaruar se ai nuk heq dorë nga bojkoti e se do të marrë pushtetin nga rruga. Çfarë kanë bërë ndryshe baballarët e tyre?

Edhe ata e morën pushtetin me dhunë, e izoluan Shqipërinë dhe shpallën armiq në të gjithë botën, të djathtë e të majtë.

Kjo ka ndodhur një herë dhe nuk do të ndodhë më, sepse ne nuk do ta lejojmë (kur them që nuk do ta lejojmë, nuk e kam fjalën për marrjen e pushtetit me dhunë, se kjo është një ëndërr e Ramës, që i kthehet në një makth të tmerrshëm, sepse gjithë jetën e tij e ka kaluar mes maktheve), por e kam fjalën për tentativat që po bën Rama për të ngadalësuar integritimin e Shqipërisë dhe liberalizmin e vizave për shqiptarët.

Jemi ne që e anëtarësuar Shqipërinë në Këshillin e Europës; jemi ne që e bëmë Shqipërinë partneren e parë të NATO-s nga Europa ish-komuniste; jemi ne që nënshkuam Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit me BE-në dhe realizuam ratifikimin e saj; jemi ne që patëm fatin të dëgjonim nga goja e Presidentit të SHBA-së deklaratën se pavarësia e Kosovës dhe integritimi i Shqipërisë janë të pakthyeshme; jemi ne që e anëtarësuar Shqipërinë në NATO; jemi ne që po e bëjmë vendin tonë kandidat për në BE; jemi ne që do të liberalizojmë vizat për shqiptarët e, me sa duket, do të jemi po ne që do ta anëtarësojmë Shqipërinë në BE, sepse Partia Socialiste me Edvin Ramën në krye ka pak ose aspak shanse për të ardhur në pushtet.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Paloka!

Zoti Strazimiri, urdhëroni!

Gent Strazimiri – Falemnderit, zonja Kryetare!

Të nderuar zotërinj ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Gjatë 48 orëve të fundit, Shqipëria është përfshirë në një betejë, pa dëshirën e saj, në Strasburg, në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Europës, ku zyrtarisht janë sfiduar kredencialet, pra, besueshmëria e delegacionit të saj dhe jo prej partisë së Sllobodan Milosheviçit, as prej asaj të Vojislav Sheshelit, por prej partisë së Enver Hoxhës, që sot drejtohet nga Evdin Kristaq Rama.

Nëpërmjet një letre të firmosur prej shoqes Arta, ai denoncoi Kuvendin e Shqipërisë, pra ne, se nuk paskemi respektuar proporcionalitetin duke u përfaqësuar me më pak shokë e shoqe nga ç'na takon.

Për rreth 18 orë ata festuan në mediat simotra të "Zërit të Popullit", derisa më në fund, erdhi përgjigjja zyrtare nga Komisioni i Rregullores dhe i Mandateve, i cili unanimisht vendosi se nuk ka

mungesë balance në delegacionin shqiptar, se Kuvendi i Shqipërisë nuk i ka shkelur kërkesat e Rregullores së Asamblesë Parlamentare. Pra, kredencialet e delegacionit të Shqipërisë ratifikohen.

Menjëherë pas kësaj, për shkak të këtij vendimi, i gjori Këshilli i Europës u akuzua nga një Artë tjetër e Partisë së Punës për sharlatanizëm politik. Argumenti është se Shqipëria ka të drejtën të përfaqësohet vetëm duke pyetur grupin parlamentar të shokëve dhe të shoqeve, i cili nuk ekziston, apo të autoriteteve të tij, që dikush duhet ta dijë se ku ndodhet, por në fakt kanë kaluar që të gjithë në ilegalitet. Në këto momente që po flasim, në Strasburg sapo përfundoi debati i një dokumenti për Shqipërinë, që duhej miratuar nga seanca, të cilin disa shokë e shoqe u përpoqën ta nxijnë duke deklaruar mes të tjerash se zgjedhjet u vodhën nga komisionerët socialistë të korruptuar, argument ky që nuk e kanë artikulluar kurrë ndonjëherë më parë. Nuk kisha dyshim që sot Strasburgu do ta dënonte bojkotin, do të kërkonte pranimin e sistemit dhe rregullat demokratike nga opozita si herët e tjera dhe thirrje për dialog politik. Për më tepër, Strasburgu u shpreh qartë, njësoj si maxhoranca, se hetimi, nëse do të ndodhë, nuk mund të thyejë Kushtetutën dhe ligjet apo vendimet e gjykatave.

Problemi është se shokët dhe shoqet nuk kërkojnë dialog për një, dy a më shumë çështje parimore, që lidhen me funksionimin më të mirë të demokracisë në këtë vend. Ata kërkojnë të pamundurën, kërkojnë simbiozën e shtetit të së drejtës me pushtetin e Xhelilëve, të Aranitëve, të Kristaqëve, të Hamitëve, domethënë të bandës së kohës, të Zanë Çaushëve të periudhës 1945-1990, mbështetur mbi të njëjtin legjitimitet, me ndryshimin e vetëm se “Republika e Zanit” në Vlorë zgjati rreth një vit, ndërsa republika e këtyre zgjati 45 vjet.

Këtë e dëshmuam më së miri edhe gjatë ditëve të përmbytjes në Shkodër dhe në rrethinat e saj. Në momentin kur në çdo fshat dhe qytet të Shqipërisë, në çdo organizëm ndërkombëtar dhe shoqatë, të gjithë u mblodhën për të lehtësuar vështirësitë që derdhi për dy javë rresht tërbimi i natyrës, u mblodhën edhe ata. Por çfarë bënë? Demaskuan grupin armiqësor energjetik. Gjyqi, sipas zakonit, u mbajt në kinema, pjesëmarrës ishte i gjithë aparati i plenumit të Komitetit Qendror të Partisë së Punës, avokat ishte caktuar ai që e gjakosi për herë të fundit Shkodrën, Gramoz Ruçi, pretenca u dha nga shoku Braçe, zbërthimi ideologjik nga shoku Beqja, në fund vendimi u dha nga

sekretari i parë i Komitetit Qendror, shoku Edvin Kristaq Rama, përfundimi i njëzëshëm sipas zakonit: “Kriminelët në litar!”

Të nderuar kolegë,

Nuk e kisha besuar se do të më jepej përsëri rasti në këtë jetë të përjetoja kronikat që na i rikujton Pandi Laço në emisionin “Histori me zhurmues”. Kjo nuk është për të qeshur, por është dramatike. Të kompleksuar që i lindi dreqi, jo Zoti, 60 vjet më parë, kur në seanca kinemash të merrte jetën Aranit Çela, sot këta prokurorë të mbetur në tentativë bëjnë politikë sipas të vetmit model që njohin dhe që u del natyrshëm, atij të baballarëve të tyre.

Të nderuar zotërinj ministra,

Të nderuar kolegë,

Ashtu sikurse të gjithë ata banorë të prekur nga tërbimi i natyrës, edhe unë besoj se të dëmtuarit do të dëmshpërblehen apo do të ndihmohen, sipas rastit, deri në qindarkën e fundit, siç është premtuar.

Shqetësimi im shkon në një dëmshpërblim tjetër, të cilin as ju, as ne nuk e kemi premtuar dhe që kjo Qeveri po bën ç’është e mundur ta shlyejë, megjithëse është një borxh që nuk e ka marrë kjo Qeveri; megjithëse është një dëm që nuk e ka shkaktuar kjo Qeveri. E kam fjalën për borxhin ndaj qytetarëve të dëmtuar, të vrarë pa gjyq apo me gjyq kinemaje. Ky është një dëm shkaktuar këtij populli për 45 vjet nga Kristaqët, Xhelilët, Hamitët, Gramozët, Sulejmanët dhe Aranitët, që nuk mund të lahet, pasi as Avzi Nelën, as Gencin, as Vilsonin, as patër Meshkallën, as hafiz Ali Korçën, as Visarjon Xhuvanin apo Musine Kokalarin nuk i kthejmë dot më në jetë e t’i nderojmë siç e meritojnë. Por dëmin moral dhe financiar shkaktuar të njëjtëve njerëz nga ky shtet, po e paguajmë ende sot.

Në fakt, duhet ta paguajnë ata që e shkaktuan, një më një, deri në qindarkën e fundit. Por zinxhiri i drejtësisë diku është këputur dhe nuk po ngjitet dot. Një gjë është e qartë si kristali: ata që shkaktuan këtë dëm, kanë para me shumicë dhe nuk i kanë të tyret. Ato janë para të konvertuara në pallate, në rrugë, në kulla, në restorante, në studio, në shtëpi plazhi e mali, në makina luksi, që shokët proletarë i kanë fituar me djersë, duke vrarë popullin që aq shumë e donin.

Procesi që e ndoqëm *live* nga salla e kinemasë përmbledh tragjikisht një të vërtetë shumë të madhe, të lënë si një amanet nga Bertolt Breht në dramën “Arturo Ui”: “Kujdes, sepse barku nga ata dolën, ende nuk është shterpëzuar!” Në fakt, nuk ka sesi, pasi ne, edhe një vendim gjykate që i dënoi, nuk e

kemi më në regjistër. Nuk kemi një datë apo një vend, ndryshe nga hebrenjtë që të paktën kanë ditën e kujtesës, gjermanët që kanë Nurembergun, italianët që, sado jashtë natyrës së tyre, kanë Piazzale Loreto-n. Për këtë arsye, ndoshta, ende na sfidohen kredencialet prej tyre në Tiranë, në Strasburg, në Bruksel dhe kudo që ndodhen. Për këtë arsye sfidohen çdo ditë institucionet, ligjet, gjykatat, sistemi demokratik, në themelin e tij. Ndoshta nga këtu vjen edhe zgjidhja, duhet të kapim fillin atje ku është këputur disa vite më parë.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Strazimiri! Zonja Bregu, urdhëroni!

Majlinda Bregu – E nderuar zonja Kryetare, Të nderuar kolegë,

Ajo çka të gjithë kemi kërkuar për muaj me radhë në këtë sallë dhe jashtë saj, miq, dashamirës, ndoshta asnjëherë miq të Shqipërisë, por njerëz të ndërgjegjshëm politikisht, se opozita s'ka të drejtë të hetojë mbi gjithçka, por të hetojë mbi çdo gjë brenda ligjit e Kushtetutës, u miratua me 86 vota pro në Strasburg. Rezoluta e Këshillit të Europës i tha "Stop" bojkotit dhe ky është refreni i përbashkët i njerëzve të ndërgjegjshëm politikë. Besoj se asgjë më shumë se kaq dhe asgjë më pak se kaq nuk kemi kërkuar në të gjithë këta muaj të ftesës dhe të përpjekjes sonë, deri diku ndoshta edhe absurde, sepse duket sikur kemi folur me murin, për të sjellë në këtë sallë ata të cilët janë mandatuar nga populli për të qenë prezentë këtu.

Të nderuar kolegë,

Ajo çka ndodhi dhe i parapriu kësaj rezolute të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës ishte e paparë dhe e padëgjuar për 15 vjet. Pas vlerësimit të përfaqësuesve të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës dhe reporterëve të tjerë të zgjedhjeve parlamentare në Shqipëri si më të arrirat në përbushjen e standardeve, një letërlajthitjeje, me tone sikur po i shpallte luftë Europës, ishte mënyra e hakmarrjes, e përbuzjes së lidershipit VIP të politikës së re të Partisë Socialiste, ndaj kontinentit të vjetër. Edvin Rama, me qëndrimin e tij cinik dhe me firmën e zonjës Dade, sfidoi kredencialet e Shqipërisë në Këshillin e Europës, si reagim halucinant ndaj europianëve që "guxuan", pa lejen e Ramës, t'i quajnë të mira zgjedhjet në Shqipëri, ndërsa Edi Ramën dhe bojkotin e tij si risinë e fundit të absurdit politik në kontinent.

Kushdo që nuk i mban ison Ramës, qoftë ky individ apo institucion, u dashka sfiduar, qoftë

Parlamenti shqiptar apo Këshilli i Europës. Në besnikëri të plotë ndaj parimeve bolshevike, institucionet e pavarura nga partia e origjinës së Ramës, janë reaksionare, ndaj, po sipas tij, duhen sfiduar. Ky është rreziku më i madh. Taktika komuniste e përbuzjes së institucioneve, të gjithkujt e gjithçkaje, po bëhet parim në Partinë Socialiste. Frymëzuesi e urdhëruesi i këtij parimi është Edvin Rama. Këtë parim të tijin e të disa komunistëve *junior*, që për 20 vjet nuk e kanë pranuar dot kurrë që rregullat e demokracisë nuk janë ato të diktaturës komuniste, Rama e përdor sot për sfidë ndaj Shqipërisë dhe Europës. Kështu, e gjithë trajektorja e tij paszgjedhore e merr një shpjegim.

Rama bojkotoi Parlamentin shqiptar me ndërgjegje të plotë, se kështu do të bojkotonte çdo log tjetër ku duhet të jetë. Institucione si Parlamenti janë ngritur për t'u dhënë të drejtën qytetarëve të ushtrojnë të drejtat e tyre politike, nëpërmjet të zgjedhurve, që përfaqësojnë bindjet e tyre politike. Bojkoti i Parlamentit është bojkoti ndaj qytetarëve që i kanë zgjedhur për të ushtruar këtë të drejtë.

Ky zotëri zgjodhi taktikën e hapjes së kutive dhe parimin e përbuzjes së institucioneve shtetërore si një anarkist i denjë politik. Kot jemi munduar të flasim për lidhje mes personale e politikës së tij, sepse duket se me kaq kemi ngecur vetëm te shpjegimi i taktikës së tij të gabuar. Rama është rëndë jo se ka zgjedhur taktikën e gabuar, por sepse përbuzjen e moralit, familjes, normave, ligjit, Kushtetutës, institucioneve, e ka parim të jetës së tij.

Rama flet me një oratori dogmatike për shtet dhe e minon atë në ilegalitet. Asnjë shqiptar, përfshi ata që i kanë votuar ose jo të zgjedhurit e tij, nuk pret nga një lider politik që t'i bëjë atentat vendit. Asnjë shqiptar që, prej 20 vjetësh, bart në vete ëndrrën më të madhe, atë të të qenit si gjithë Europa, nuk e dëshiron prishjen e kësaj ëndrre, pikërisht në prag të realizimit të saj. Aq më shumë kur cenimi i kësaj ëndrre bëhet jo për arsye madhore, por për teka personale, të sëmura, pushteti. Asnjë zyrtar dhe politikan europian, që ka ndjekur në këto 20 vjet përpjekjet, sakrificat, ngecjen dhe zhvillimin e demokracisë në Shqipëri, as edhe skeptiku më i keq ndaj këtij vendi, nuk do ta besonte se do të vinte një ditë, kur në Shqipëri do të shfaqej një Don Kishot militant bojkoti politik, kryetar i partisë më të madhe opozitare pa meritë, që të sfidonte vendin që i takon vendit të tij në Europë.

Edi Rama e konsideron Këshillin e Europës si

këshill bashkiak, ku mund të përjashtojë dhe të afrojë kë dëshiron ai; Komisionin e Mandateve si KRRT-në e bashkisë, që i jep leje kujt do ai; Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Europës si Asamblenë e Partisë Socialiste, që duhet të dëgjojë vetëm ç'thotë ai.

Në të vërtetë, Perëndimi ka vlera dhe standarde pikërisht sepse secili është në vendin e vet dhe institucionet funksionojnë mbi bazën e pjesëmarrjes dhe respektit të ndërsjellë dhe jo përmes bojkotit e përjashtimit.

Ky ishte akti që çuditi përfundimisht Europën, sepse ne, ata që s'mendojmë si ai politikisht, ata që e justifikojnë në këtë çmenduri, ata që e kundërshtojnë së brendshmi e gjithë ata që e përqeshin së jashtmi, kemi 6 muaj që japim e marrim që të kuptojmë gjithë çartjet e tij të marra. Duam të kuptojmë se ç'do ky zotëri, që nuk njeh më as limit e as turp. Që do të bëhet kryeministër, këtë e kuptojmë, por s'po dimë si ta ndihmojmë të shpëtojë nga ky fiksion për atë "pak pushtet", sepse ata që e kishin në dorë për ta bërë nuk e zgjodhën, por e përbuzën.

Zonja e zotërinj, ky që guxon të na përbaltë, denigrojë, të shumëzohet me zero përpjekjet e ne të gjithëve, është përfaqësuesi i denjë i "Hakmarrjes për Drejtësi". Ka vendosur të hakmerret ndaj popullit që nuk e bëri kryeministër.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zonja Bregu!
Zoti Imami, urdhëroni!

Arben Imami – E nderuar zonja Kryetare,
Të nderuar kolegë,

Sikurse dihet tashmë, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës miratoi një rezolutë për Shqipërinë, e cila shpresojmë të ndikojë te deputetët e opozitës që t'i kthehen jetës normale politike e t'i thonë stop bojkotit.

Përpjekja e fundit e kryetarit të opozitës për të pezulluar të drejtën e votës në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Europës, në analizë të fundit, ishte një përpjekje për të pezulluar anëtarësinë prej 15 vjetësh në këtë organizëm të lartë të demokracisë parlamentare europiane, të arritur me shumë mundim, gjak e përpjekje, të këtij populli.

Kjo përpjekje, në fakt, ishte në vazhden e tentativave për ta paraqitur Shqipërinë në sytë e komunitetit ndërkombëtar si një vend anormal, pa demokraci funksionale dhe ku nuk zhvillohen zgjedhje të lira. Por, Shqipëria është një vend

normal, me demokraci që funksionon, me Parlament që funksionon dhe me një koalicion qeverisës funksional. Krizë do të kishte nëse do të kishim një manipulim të zgjedhjeve, por këtë nuk e thotë askush, madje, as PS-ja dhe as vetë kryetari i saj. Kështu që nuk mund të kemi dhe nuk kemi një krizë politike. E vetmja krizë që ka ky vend është kriza e PS-së; kriza që ka të bëjë me lidhshëpin e saj; kriza që është shkaktuar nga humbja e zgjedhjeve të PS-së në 28 qershor.

Edvin Rama po përpjeket që këtë krizë të partisë së tij, të vetes së tij, t'ia transmetojë shoqërisë në tërësi. Reagimi i Asamblesë ndaj kërkesës së kryetarit të PS-së ishte, gjithashtu, një kujtesë për opozitën, që ajo të dalë nga kjo krizë, të mos shkaktojë dëme me pasoja në trajektoren e integritetit të Shqipërisë në BE. Kjo ishte një thirrje për t'i thënë stop bojkotit.

Siç vërehet në rezolutën e Asamblesë së Këshillit të Europës, krijimi i tensioneve, bojkotimi i Parlamentit, mospjesëmarrja e opozitës në institucione, janë përpjekje për të penguar procesin e integritetit të vendit dhe kjo nuk gjen e nuk mund të gjejë mbështetje nga askush, sepse, në thelb, bojkotit është hedhja poshtë dhe mospranimi i zgjedhjeve, mospranimi i rregullave të lojës dhe i fitimitarit që fiton me këto rregulla.

Në fakt, në analizë të fundit, kjo është hedhja poshtë e zgjedhjeve më të mira që janë zhvilluar ndonjëherë në këtë vend, zgjedhje të certifikuar nga të gjitha institucionet ndërkombëtare. Maxhoranca, ndërkohë, ka treguar moderacion dhe gatishmëri për bashkëpunim dhe ka paraqitur nëpërmjet Kryeministrit, që në ditët e para të pretendimeve të kësaj opozite, mundësinë e krijimit dhe drejtimit të një komisioni parlamentar investigativ, pavarësisht se, në fakt, kjo kërkesë është absurde, pa themel dhe e pambështetur në prova e fakte.

PS-ja e ka pasur gjithë kohën dhe mundësinë për të reflektuar dhe për t'iu kthyer institucioneve dhe ligjit, për t'iu kthyer bashkëpunimit dhe debatit në shërbim të interesave të larta të vendit, që lidhen me integritimin europian. Por, në fakt, ajo ka bërë të kundërtën e asaj që arsyëja e shëndoshë do të thoshte se duhej bërë. Në fakt, ne arritëm të zhvillojmë dy palë zgjedhje të certifikuar: në 2007-ën dhe në 2009-ën dhe kjo është një fitore e madhe e të gjithëve; është një fitore e madhe jo vetëm e kësaj maxhorance, por është fitore e demokracisë; është shenjë e qartë dhe përfundimtare e afrimit të

Shqipërisë me BE-në.

Këto zgjedhje nuk mund të hidhen poshtë me deklarata, sepse nuk ka as prova, as fakte dhe as dyshime. Nuk mund të mbahet peng integrimi i vendit se dikush paska dyshime, edhe pse këto zgjedhje kanë marrë certifikimin më të gjerë ndërkombëtar. Duke sulmuar zgjedhjet e lira, PS-ja dhe kryetari i saj po u tregojnë qytetarëve shqiptarë se mbi interesat kombëtare ata vendosin interesa krejtësisht meskine. Sa më e gjatë të jetë mungesa e opozitës në Parlament, aq më shumë faktohet se kjo aventurë e PS-së kundër interesave më të larta të vendit është e nxitur nga interesat personale të kryetarit të kësaj partie dhe duhet të marrë fund.

Edhe një herë, i themi PS-së, kryetarit të saj, zotit Rama: "Stop bojkotit!". Gjatë gjithë kësaj kohe deputetët e opozitës, në fakt, janë ndërgjegjësuar për këtë dhe e kanë shprehur qartë se thelbi i bojkotit lidhet me krizën e liderit të partisë. Por, kjo rezolutë do t'i inkurajojë ata, si deputetë, të vlerësojnë mesazhin e Asamblesë së Këshillit të Europës. Në fund të fundit, një deputet ka përgjegjësi të mëdha përpara partisë dhe elektoratit të tij, por ka përgjegjësi edhe përpara ligjit, përpara së drejtës, përpara vendit, ndërgjegjes së tij, komunitetit ndërkombëtar dhe asaj pjese të këtij komuniteti, ku ne duam të jemi pjesë. Ndaj, detyrimi i çdo deputeti përpara vendit dhe kombit në këtë moment është kontributi i tij për të çuar më tej reformat e mëdha, në mënyrë që anëtarësimi i vendit në BE të realizohet sa më shpejt.

Falemnderit!

Jozefina Topalli - Falemnderit, zoti Imami!

Zoti Shehu, urdhëroni!

Tritan Shehu – Falemnderit, zonja Kryetare!

Pa dyshim, dita e sotme është një ditë e rëndësishme për demokracinë shqiptare. Është një ditë e rëndësishme, sepse sot Këshilli i Europës, Strasburgu, Perëndimi, demokracia evropiane, i dhanë një përgjigje të qartë dhe të prerë bojkotit, luftës revolucionare, tentativave për ta futur Shqipërinë në një vorbull absurde, për ta larguar nga rruga e saj demokratike dhe nga integrimi evropian. Ne sot duhet të falënderojmë përsëri Perëndimin për këtë ndihmë dhe mbështetje që po i jep vendit tonë. Ne duhet t'u themi qartësisht atyre, që tentuan ditët e fundit të krijojnë një ngjarje sa komike, aq edhe tragjike, se dështuan, se nuk mund të ndodhte ndryshe, pasi Shqipëria tashmë është pjesë e Perëndimit, ajo ka hyrë qartësisht në rrugën e integritit dhe nuk mund të kthehet mbrapa as me

komedi e as me tragjedi.

Kjo ngjarje është komike, sepse ajo që ata tentuan të krijojnë i bëri njerëzit të qeshin me atë skenar grotesk dhe me ata aktorë qesharakë, jo më shumë se 24 orë më tej. Është edhe tragjike, sepse u tentua të luhej jo vetëm me interesat e vendit, jo vetëm me imazhin e tij, por edhe me institucionet e rëndësishme demokratike evropiane; u tentua të keqpërdoreshin ato; u tentua të fyheshin rregullat e shenjta të funksionimit të tyre. Por, përgjigja e sotme tregoi se ajo, që u tentua të ishte një bombë kundër demokracisë shqiptare, shpërtheu si një bombë kundër lëvizjes revolucionare, kundër bojkotit, kundër anarkizmit, kundër tentativave për ta larguar Shqipërinë nga rruga e zhvillimit dhe e integritit.

Sidoqoftë, një gjë është e qartë: kjo nuk ishte një ngjarje e vetmuar, nuk ishte rrufe në qiell të pastër. Kjo që ndodhi është pasojë e një politike aventureske, anarkiste, bojkotuese, në shërbim të një apo dy njerëzve, larg interesave jo vetëm të vendit, por edhe të PS-së, të së majtës; është një aventurë, e cila ka në bazën e saj antidemokracinë dhe antinacionalizmin. Kjo që ndodhi tregon se zoti Rama jo vetëm që nuk respekton dhe nuk do të njohë institucionet shqiptare, por kërkon të mos njohë dhe respektojë edhe institucionet evropiane. Ai kërkon t'i njollosë ato, kërkon t'i dëmtojë.

Kjo që ndodhi tregon, pa dyshim, se ne patëm rastin të shohim përshkallëzimin e një politike antiinstitucionale, për ta kaluar këtë politikë nga Tirana në Bruksel, nga Tirana në Strasburg. Pra, patëm një tentativë krejtësisht aventureske, që i përkon psikologjisë dhe mentalitetit të kaluar, e cila nuk mund të përfundonte ndryshe nga ç'përfundoi sot në Strasburg.

Mendoj se nga ajo që ndodhi duhet të fyhen të gjithë, në radhë të parë anëtarët dhe simpatizantët e PS-së, deputetët dhe politikanët e saj. Por, i fyer është edhe i gjithë populli shqiptar, Strasburgu, dhe kjo na bën ne, politikanët shqiptarë, të jemi krejtësisht të qartë. Kjo e obligon politikën e majtë, deputetët e PS-së, të jenë të qartë në vendimet e tyre, të kuptojnë se ka ardhur koha për t'i dhënë përgjigje asaj që po ndodh me anë të forcës politike. Kjo tregoi se çdo luftë zapatiste është e destinuar të dështojë, sepse nuk gjen përkrahje, sepse ne jemi sot një vend institucional, një vend demokratik, një vend i zhvilluar.

Kjo që ndodhi tregoi dhe diçka tjetër, se PS-ja është e fragmentarizuar, se brenda saj po piqet dhe

po rritet një zë i fuqishëm kundër aventurizmit, kundër anarkizmit, një zë i cili kërkon gjithmonë e më tepër ta zhvendosë atë në pozicionin e drejtë. Kjo u dallua dhe u përshëndet edhe nga vetë anëtarët e KE-së në diskutimet e tyre. Unë mendoj se sot bojkoti dhe aventurizmi politik morën një përgjigje të qartë, një përgjigje të sigurt, e cila tregoi se sa i drejtë dhe sa konstruktiv është pozicioni ynë, pozicioni i PD-së.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Shehu!
Urdhëroni, zoti Bogdani!

Gerti Bogdani – Falemnderit, zonja Kryetare!
Të nderuar kolegë,

Pas një rrugëtimi të gjatë dhe të vështirë në diktaturën më të egër që ka parë Europa, të izoluar totalisht nga Perëndimi, shqiptarët dhe Shqipëria, më në fund, i lanë pas kujtimet e këqija, i lanë në shekullin e kaluar dhe janë në rrugën e duhur. Por, megjithëse sot jemi anëtarë të NATO-s, megjithëse sot jemi duke plotësuar pyetësorin për t'u bërë vend anëtar i BE-së dhe jemi në rrugën e duhur drejt integritimit europian, disa liderë politikë të papërgjegjshëm duan t'u kujtojnë shqiptarëve vitet e errëta të vetmisë. E kam fjalën këtu për kërkesën e PS-së për të ngrirë kredencialet e delegacionit shqiptar në Asamblenë e Këshillit të Europës. Një letër e tillë, nëse nuk do të kishte datën të shënuar mbi të, do të dukej fare mirë si një dokument i marrë nga arkivat e kohës së monizmit.

Por, nëse në Shqipërinë komuniste letrat anonime ishin të mjaftueshme për të internuar apo dënuar qytetarët e pafajshëm shqiptarë, sot ato nuk kanë vlerë, mbi të gjitha, kur u drejtohen institucioneve europiane, të cilat janë themeluar mbi parimet e lirisë dhe demokracisë; kur i drejtohen KE-së, tempullit të demokracisë europiane. Ky veprim nuk është thjesht i papërgjegjshëm politikisht, por, mbi të gjitha, është antikombëtar, sepse kërkon *de facto* përjashtimin e Shqipërisë nga Këshilli i Europës. Ky akt është një tregues i qartë i metamorfozës ku zoti Rama po e çon PS-në, duke e kthyer atë në një OJF, por duke marrë shembullin e gabuar të OJF-ve tashmë të falimentuara, të cilat dëmtonin imazhin e Shqipërisë dhe hidhnin baltë mbi vendin, vetëm për të marrë disa fonde më shumë.

Të nderuar kolegë, jam i sigurt se ky fenomen i përket vetëm një grupi të vogël të PS-së, pasi nuk besoj se ka qytetar shqiptar, qoftë edhe votues i PS-së, që ta dëshirojë një gjë të tillë për vendin e tij

dhe të hedhë baltë mbi Shqipërinë. Zoti Rama duhet të dëgjojë zërin e arsyes dhe t'i japë fund këtij rrugëtimi pa krye ku është drejtuar. Këtë duhet ta bëjë, jo se e thotë Brukseli apo Strasburgu, jo se e thonë përfaqësuesit ndërkombëtarë, të majtë dhe të djathtë së bashku, por sepse nuk është në të mirën e Shqipërisë dhe shqiptarëve.

Bojkoti nuk është mënyra me të cilën punon Europa, nuk është mënyra me të cilën punon Perëndimi. Ne sot, pas vitesh të tëra mundimi dhe peripecish në ndërtim të shtetit ligjor dhe konsolidimit të demokracisë, jemi më pranë se kurrë realizimit të ëndrrës së kahershme të integritimit europian. Sot më shumë se kurrë jemi pranë lëvizjes së lirë në hapësirën e përbashkët europiane. Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm në këtë drejtim dhe po përmbush të gjitha detyrimet që lëvizja e lirë e qytetarëve shqiptarë të bëhet realitet. Një gjë të tillë e faktin edhe deklarata e fundit e ministrit të Punëve të Jashtme të Italisë, Franko Fratini, se nga fillimi i kësaj vere Shqipëria do të jetë gati për t'iu bashkuar vendeve të tjera në rregjimin e udhëtimit pa viza.

Shqiptarët do të lëvizin të lirë në Europë, ndaj është koha që opozita të zërë vendin e saj në Parlament dhe të japë kontributin e saj në proceset integruese, sepse në asnjë kohë nuk duhet harruar që vota e çdo qytetari shqiptar është votë për përfaqësim në këtë Kuvend.

Ju falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Bogdani!
Fjalën e ka zoti Hoxha.

Bedri Hoxha – E nderuar zonja Kryetare,
Të nderuar kolegë deputetë,

Jam sot këtu për të shprehur këtë indinjatë dhe për të dënuar manovrën e fundit të Partisë Socialiste në Këshillin e Europës se Shqipëria dhe Parlamenti i saj nuk paskan respektuar procedurat dhe raportet e përfaqësimit në këtë organizëm europian.

Pas dështimit me Shkodrën, për fatkeqësinë natyrore që sapo kaloi, ku gjej rastin të falënderoj Qeverinë shqiptare për menaxhimin e shkëlqyer të kësaj emergjence dhe qytetarët për mirëkuptimin në përballimin e kësaj fatkeqësie natyrore, Partia Socialiste ditët e fundit vendosi të përmbytë Strasburgun, pra Këshillin e Europës, jo me ujë, por me një mal me gënjeshtër, akuza, trillime në drejtim të Parlamentit dhe të Qeverisë shqiptare. Pa kaluar 24 orë, Partia Socialiste merr të njëjtën shuplakë si në Shkodër dhe në Strasburg, ku 46 vendet anëtare të organizatës më të vjetër politike

në Europë rrëzuan në mënyrë unanime kërkesën e Partisë Socialiste për ngrirjen e kredencialeve të delegacionit shqiptar në Strasburg. Shqipëria dhe Kuvendi i saj morën vlerësime pozitive nga të gjitha grupimet politike për respektimin e të gjitha rregullave dhe procedurave të përfaqësimit në këtë organizatë. Komiteti për Rregulloren, pasi shqyrtoi objeksionet e palëve, doli në përfundimin se delegacioni ishte caktuar në përputhje me rregullat dhe procedurat, si dhe me kërkesën e vazhdueshme për pjesëmarrjen e Partisë Socialiste në Parlament dhe për pasojë një formatim më i plotë i delegacionit tonë në Asambleenë Parlamentare të Këshillit të Europës.

Kjo është alibia e fundit e Edi Ramës, ky është qëndrimi i turpshëm i Partisë Socialiste dhe tashmë ata nuk njohin jo vetëm Parlamentin shqiptar, por as Këshillin e Europës. Jam i bindur se asnjë opozitë në botë nuk do të mbante një qëndrim të tillë në dëm të interesave të kombit të tij. Tashmë shqiptarët e kanë kuptuar më së miri se çfarë përfaqëson një pjesë e konsiderueshme e deputetëve socialistë dhe Edi Rama.

Për të mos u zgjatur më tej me këtë temë, më poshtë në fjalën time do të ngre disa probleme të qarkut të Dibrës, veçanërisht të rrethit të Matit, përfaqësues i të cilëve jam në Parlament. Këto janë probleme të cilat mund të merren në konsideratë nga Qeveria dhe një pjesë e tyre mund të zgjidhen me shpejtësi.

Megjithëse Qeveria shqiptare ka bërë të mundur furnizimin me energji për 24 orë në të gjithë vendin, 5 njësi vendore në rrethin e Matit, Komuna Xibër, Bashkia Klos, komunat Gurrë, Lis dhe Suç vazhdojnë të kenë kufizime të vazhdueshme të energjisë prej më shumë se 3 vjetësh dhe kjo se OSSH-ja, tashmë ÇEZ-i, nuk është në gjendje që të zëvendësojë një transformator në nënstacionin e Suçit, një transformator me fuqi prej 5,6 megavolt amper, ndërkohë kur duhet një transformator me fuqi më të madhe. Pra, janë mbi 30 mijë banorë që vuajnë pasojat e këtyre kufizimeve. Ka raste të tjera ku, për shkak të dëmtimeve të transformatorëve në fshatra, banorët kanë qëndruar pa energji gati 2 javë, ku mund të përmend rastet në fshatrat Lis dhe Xibër. Po të shohim nivelin e investimeve në sistemin elektrik nga ÇEZ, pothuajse janë në shifra zero. Mendoj se kjo situatë e furnizimit me energji është e papranueshme, prandaj kërkoj ndërhyrjen e ministrit Prifti për zgjidhjen e situatës.

Shqetësim tjetër në qarkun e Dibrës, veçanërisht

në rrethin e Matit, është rruga nacionale nga Skurraj deri në afërsi të Qafës së Buallit. Ky aks nacional, me një gjatësi prej 60 kilometrash, që përshkon të gjithë Matin, është tejet i amortizuar dhe për pasojë e vështirëson së tepërmi lëvizjen e autoveturave dhe të kamionëve të mallrave për rrethet Dibër, Bulqizë dhe Mat. Në këta 3-4 vjetët e fundit, në segmentin e lartpërmendur, nga DPR-ja është ndërhyrë me investime të pjesshme, por në shumicën e rasteve punimet janë kryer pa cilësi. I njëjti fenomen konstatohet edhe në segmentin rrugor në ndërtim, Ura e Matit-Lis-Murrë, investim i Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve, ku pa u dorëzuar ende objekti ka filluar të shkatërrohet. Prandaj, zoti Olldashi, ju kërkoj të bëni verifikimin e këtyre punimeve dhe marrjen e masave sipas ligjit. Duhet të hartohet projekti i rehabilitimit të segmentit Skurraj-Burrel me gjatësi 30 kilometër, i cili ditaditës po bëhet i pakalueshëm.

Të nderuar kolegë,

Meqenëse dhe koha në dispozicion mbaroi, të gjithë ju nga kjo foltore e keni ftuar opozitën të zërë vendet e saj në Parlament, që të ushtrojë detyrimet e saj kushtetuese në institucione, të luajë rolin e saj në një vend demokratik normal. Por ajo vazhdon të bojkotojë, sepse kërkon të bëhet pengesë në procesin integruar të vendit. Liberalizimi i vizave e tmerron zotin Rama, pasi do t'i servirë atij kohë të gjatë në opozitë dhe për pasojë largimin e tij nga kreu i Partisë Socialiste. Një pjesë e mirë e tyre nuk do të vijin deri më 7 mars, jo se vendi nuk ka nevojë për opozitën, por sepse kjo pjesë nuk ka lidhje me Partinë Socialiste. Ata janë thjesht oborrtarë të zotit Rama dhe lidhja e vetme mes tyre janë interesat ekonomike me njëri-tjetrin në kurriz të shqiptarëve. Ata do të vijin jo për të bërë opozitë, por për t'u mandatuar, pasi humbja e mandateve do t'u hiqte mantelin mbrojtës të shumë punëve të zeza të tipit "Rama".

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Hoxha!

Fjalën e ka zoti Olldashi.

Sokol Olldashi – Falemnderit, zonja Kryetare!

Po e marr fjalën vetëm për një minutë, në sqarim të shqetësimeve që ngriti deputeti Hoxha.

Për sa i përket rrugës që lidh Murrën me Urën e Matit, ajo është një rrugë në ndërtim e sipër, pra është ende herët për të thënë nëse është punuar me cilësi ose jo, ndërkohë që qëndron vërejtja e zotit Hoxha për sa u përket riparimeve të pjesshme që iu bë rrugës nacionale 2 vjet më parë. Por duhet

të kemi parasysh se kemi bërë vetëm riparime, meremetime pjesore me një fond emergjence, pikërisht për të shmangur atë situatë të keqe në të cilën ishte rruga.

Çfarë po bëhet realisht? Realisht, në qarkun që përfaqësohet nga zoti Hoxha në Parlament, ka mbaruar loti i parë i rrugës së Arbrit, ka filluar rruga nga Maqellara drejt Peshkopisë, ka përfunduar projekti që lidh Klosin me Rrëshenin, ku dhe do të fillojë realizimi. Ky është një nga qarqet ku ne jemi përqendruar më shumë për të zgjidhur problemet emergjente që ka pasur qarkullimi dhe transporti. Gjendja është e pakënaqshme, jam dakord me ju, por ndërkohë ne jemi duke punuar shumë për këtë qark dhe brenda një periudhe dyvjeçare ai do të jetë një nga qarqet me sistemet më të mira rrugore në vend. Kështu që, duke i hequr pjesën e parë të shqetësimeve që ngriti zoti Hoxha, që ka të bëjë me një rrugë ende të papërfunduar, për të cilën nuk mund të flitet për cilësi, pasi rruga ka procedurat e veta sesi merret në dorëzim. Pasi të merret në dorëzim, ajo ka periudhën e vet të garancisë dhe vetëm atëherë mund të flasim nëse rruga është bërë mirë ose keq. Pra, një rrugë që është në ndërtim e sipër sigurisht që nuk është në një gjendje të mirë.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Olldashi! Fjalën e ka zonja Hoti.

Pavlina Hoti – Falemnderit, zonja Kryetare! Të nderuar kolegë,

Që nga fillimi i kësaj legjislature, maxhoranca, duke qenë e vetëdijshme se dialogu dhe komunikimi janë elemente përbërëse të procesit të zhvillimit demokratik të vendit, ka qenë e hapur për dialog politik me opozitën. Megjithatë, ajo çfarë vazhdon të bëjë lideri i saj nuk sjell asgjë në shprehjen e vullnetit të opozitës për dialog politik, por thellon hendekun në detyrën e saj opozitare, hendekun e saj mes zgjedhësve, duke u distancuar akoma më shumë prej tyre. Edhe partnerët tanë ndërkombëtarë në raste të ndryshme kanë kujtuar nevojën e dialogut me qëllim mirëfunksionimin institucional dhe politik, por opozita jonë këto ditë tregoi se nuk është në lartësinë e duhur për të pasur misionin opozitar të qeverisjes, tregoi se nuk meriton besimin që zgjedhësit e saj i kanë dhënë në mbrojtje të interesave të tyre dhe të vendit. Edhe pse nuk është hera e parë që në momentet historike të vendit, në këta 20 vjet demokraci, opozita del kundër interesave të vendit, kësaj radhe qëndrimi antishqiptar i saj nuk gjen asnjë justifikim.

Reagimi i opozitës për përfaqësinë e Parlamentit tonë në Asamblenë e Këshillit të Europës është i pavend, i pagjykuar dhe historikisht i gabuar. Po kufizohem ta quaj vetëm të gabuar, edhe pse është shumë më i rëndë, më i turpshëm, më i pafalshëm në sytë e atyre që ne përfaqësojmë. Për interesa më shumë personale sesa partiake nuk mundesh, kurrsesi, zoti Rama, të justifikosh përpara popullit një veprim që përbalt imazhin e Shqipërisë në arenën ndërkombëtare, nuk mund të pretendosh se u bë për interes të kombit, nuk mund të heshtësh përpara ndërgjegjes kombëtare të të gjithë atyre që na dhanë votën. Papjekuria jote politike po shprehet në të gjitha format dhe në të gjitha mënyrat.

Ndërkohë që ne jemi në këtë seancë plenare, me keqardhje shohim se opozita nuk vendos t'i thotë stop bojkotit. Në Strasburg, në Asamblenë e Këshillit të Europës në të njëjtën kohë sapo u miratua rezoluta për Shqipërinë, lidhur me funksionimin e institucioneve demokratike në Shqipëri, në kuadër të respektimit të detyrimeve dhe angazhimeve të shteteve palë në Këshillin e Europës. Dhe në vend që të jetë pjesë e delegacionit shqiptar për të bërë avokatin e funksionimit institucional në Shqipëri, siç e do logjika e të mirës kombëtare, opozita, ose më saktë lideri i saj, zgjodhi të bëjë avokatin e interesave të kundërta dhe të përbaltë hapat e mundimshëm të progresit të këtij vendi.

Do të dëshiroja që të zgjedhurit e Partisë Socialiste të reflektojnë pas kësaj rezolute dhe pas kësaj gjendjeje. Edhe ata besoj se i vret ndërgjegjja për këtë ngërç të sajuar nga kryetari i tyre, edhe ata e dëgjojnë mosmiratimin e heshtur ose të shprehur të zgjedhësve të tyre.

Opozita u mundua të pengojë kredencialet e delegacionit shqiptar. Në fakt, nëpërmjet zotit Gross ajo kontestoi përbërjen e delegacionit për arsye formale, siç thuhet në procesverbalin e Asamblesë, por Komisioni i Rregullores dhe Mandateve nuk i gjeti të bazuara pretendimet e tyre dhe konfirmoi kredencialet e delegacionit shqiptar. Opozita u përpoq të pengojë kredencialet e delegacionit shqiptar, por ka harruar se kredencialet e Shqipërisë nuk mbështeten në përbërjen e një delegacioni. Kredencialet e Shqipërisë kanë për bazë progresin e vazhdueshëm të vendit, reformat e shumta dhe vullnetin e Qeverisë për t'i zbatuar ato, kanë për bazë pranimin e institucioneve euroatlantike si konfirmim të tyre. Kredencialet e Shqipërisë kanë për bazë certifikimin e zgjedhjeve nga ndërkombëtarët, kanë për bazë pranimin e

Shqipërisë si kandidate potenciale për anëtarësim në Bashkimin Europian. Kredencialet e Shqipërisë bazohen në fqinjësinë e mirë dhe në bashkëjetesën fetare, por para së gjithash bazohen në kulturën e një vendi që ka luftuar historikisht për të qenë pjesë e komunitetit ndërkombëtar me të drejta të barabarta si të gjitha vendet e tjera. Po, për të qenë e barabartë mes të barabartëve, ne të gjithë, maxhorancë dhe opozitë, duhet të kontribuojmë detyrimisht për këtë.

Falemnderit!

Jozefina Topalli- Falemnderit, zonja Hoti!

Fjalën e ka zoti Gëzim Dibra.

Gëzim Dibra – Falemnderit, zonja Kryetare!

Të nderuar zotërinj ministra,

Të nderuar kolegë,

Ngjarjet më të fundit lidhur me pranimin e kredencialeve të delegacionit shqiptar pranë Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës dhe sidomos votimi i pak orëve më parë treguan qartazi se kushdo që kërkon të dëmtojë imazhin e Shqipërisë, ose ta izolojë atë nga Europa, të njollojë institucionet e saj, ose të ekzekutojë përfaqësimin e saj, ndëshkimi dhe vetëm ndëshkimi i Europës e pret. Europa foli dhe e tha fjalën e saj, duke u dhënë përgjigjen e kërkuar e të merituar akuzatorëve, intrigatorë të shëmtuar po aq sa dhe krimi që deshën të kryejnë ndaj Shqipërisë, duke kërkuar përjashtimin e saj. Me përbuzje ndaj letrës së turpshme për pezullimin e Shqipërisë nga Këshilli i Europës, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës dëshmoi se nuk mund të binte pre e një manipulatore të quajtur art. Socialistët europianë treguan se dinë t'i japin ndëshkimin e pritshëm kastës manipuluese në krye të PS-së.

Shqipëria tashmë ka vendin e vet të nderuar të fituar me përpjekje të pareshtura për të përmbushur standardet dhe për të përballuar sfidat e botës demokratike, për të ecur përpara e për të kapur atë kohë të humbur nga izolimi gati gjysmëshekullor, vepër e etërve të kastës që sot drejton Partinë Socialiste. Jo vetëm kaq, liderët europianë edhe një herë i tërhoqën veshin kastës edviniane dhe i dhanë një shuplakë të radhës bojkotistit Edvin. Ata i dhanë mësimin se në demokraci nuk ka rrugë tjetër përveç njohjes së institucioneve, se në demokraci bojkoti nuk është vetëm antivlerë, por dhe një kauzë e humbur ose *“morta e sepolta”*, dhe kjo në mënyrë të veçantë për një Shqipëri që aspirojnë Europën dhe lëvizjen e lirë.

Socialistët shqiptarë nuk meritojnë të udhëhiqen nga një pervers i pandreqshëm as majtas dhe as

djathtas, që vret shpresat e shqiptarëve për hir të makiavelizmit të vet, që shet interesat e shqiptarëve për hir të perversitetit të vet, që shkel me këmbë institucionet për hir të antivlerave të tij. Socialistët nuk meritojnë të kenë zëdhënës të tyre në organizmat demokratikë të Europës gojëligën art, që për turpin e vet nuk rresht së kërkuari izolimin e Shqipërisë. Ata nuk e kanë për hak idhtaren, mjeranen art të bojkotit Edvin, që nuk rresht së akuzuari institucionet shqiptare. Europa nuk bie kurrë pre dhe nuk do të bjerë, sado hire ala art të përmbajnë akuzat e kastës edviniane ndaj Shqipërisë e personaliteteve të saj.

Së fundi, unë i bashkohem apelit të liderëve europianë me thirrjen time ndaj jush dhe shokëve socialistë në drejtim të PS-së. Dëgjojeni zërin e Europës, se është familja ku ne shqiptarët si komb e shoqëri po kërkojmë të integrohemi; dëgjojeni këshillat e Europës, se janë vlera të cilave ne po kërkojmë t'u rikthehemi; dëgjojeni rekomandimet e Europës, se shprehin dëshirat e miqve që Shqipëria të përshpejtojë integrimin dhe lëvizjen e lirë të qytetarëve të saj.

Falemnderit!

Jozefina Topalli- Falemnderit, zoti Dibra!

Kam një kërkesë për 5 minuta pushim. Pra, e ndërpresim seancën, për të filluar pas 5 minutash pushim.

(Pas pushimit)

Jozefina Topalli – Zotërinj deputetë, rifillojmë seancën.

Do të vazhdojmë me shqyrtimin e pikave të tjera të rendit të ditës.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës: miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 21.01.2010.

Ka vërejtje? Nuk ka. Falemnderit!

Miratohet!

Kalojmë te projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjë-Hercegovinës për ripranimin e personave me qëndrim të parregull”.

Zoti Lefter Maliqi, në emër të Komisionit për Sigurinë Kombëtare.

(Zoti Maliqi shprehet dakord.)

Falemnderit!

Në emër të Komisionit të Çështjeve Ligjore, zoti Strazimiri.

(Zoti Strazimiri shprehet dakord.)

Falemnderit!

Në emër të Komisionit të Politikës së Jashtme, zoti Oketa.

(Zoti Oketa shprehet dakord.)

Falemnderit!

Në emër të grupeve:

Grupi Parlamentar i LSI-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Grupi Parlamentar i PD-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Kalojmë te projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën ndërkombëtare për përgjegjësinë civile për dëmet e shkaktuara nga ndotja dhe nga karburanti i deponitave, 2001”.

Në emër të Komisionit të Veprimtarisë Prodhuese, zoti Gëzim Dibra?

(Zoti Dibra shprehet dakord.)

Falemnderit!

Në emër të Komisionit të Çështjeve Ligjore, zoti Lama?

(Zoti Lama shprehet dakord.)

Falemnderit!

Në emër të Komisionit të Politikës së Jashtme, zoti Beja.

(Zoti Beja shprehet dakord.)

Falemnderit!

Në emër të grupeve:

Grupi Parlamentar i LSI-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Grupi Parlamentar i PD-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Kalojmë te akti normativ nr.10 “Për disa ndryshime në ligjin “Për buxhetin e shtetit të vitit 2009””.

Në emër të Komisionit të Ekonomisë, zoti Spaho, urdhëroni!

Edmond Spaho – Falemnderit, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë,

Komisioni për Ekonominë dhe Financat shqyrtoi aktin normativ të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në ligjin “Për buxhetin e shtetit të vitit 2009””. Ndryshimi i buxhetit të vitit 2009 u bë i nevojshëm për të mundësuar rialokimin e fondeve të papërdorura nga ministritë dhe institucionet buxhetore, si dhe për të reflektuar në treguesit e

planifikuar pritshmërinë e realizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve vjetore, si rezultat i zhvillimeve të ekonomisë së vendit dhe asaj botërore.

Ndryshimet kryesore të parashikuara në aktin normativ janë:

Rriten me rreth 390 milionë lekë shpenzimet për asistencën sociale, si rrjedhojë e financimit të paketës së ndihmës për personat me aftësi të kufizuara.

Rriten me 245 milionë lekë shpenzimet e personelit për arsimtarët dhe policinë e burgjeve.

Reduktohen me rreth 215 milionë lekë shpenzimet për mbrojtjen sociale.

Rriten me rreth 3 miliardë lekë investimet me financim të huaj dhe reduktohen me rreth 3,2 miliardë lekë investimet me financim të brendshëm.

Reduktohen me rreth 6,9 miliardë lekë të ardhurat tatimore. Reduktimi i të ardhurave vjen si rrjedhojë i ndikimit të zhvillimeve ekonomike rajonale botërore.

Rritet me rreth 3,7 miliardë lekë transferata e buxhetit të shtetit për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Rritet me rreth 2,9 miliardë lekë financimi i deficitit me burime të brendshme dhe me rreth 3,9 miliardë lekë financimi i deficitit me burime të huaja, për të siguruar mbështetjen e investimeve, si dhe për të reflektuar performancën shumë të mirë të investimeve me financim të huaj.

Komisioni është i mendimit se ndryshimet e parashikuara në aktin normativ janë plotësisht të argumentuara dhe të nevojshme. Ato mbështesin përdorimin e pjesës së papërdorur të fondit të kontingjencës, si dhe rialokimin e fondeve të papërdorura nga ministritë dhe institucionet buxhetore, praktika të njohura dhe të aplikuara për rritjen e efektivitetit të përdorimit të fondeve publike.

Komisioni gjykon se akti normativ reflekton gjendjen dhe zhvillimin e ekonomisë shqiptare gjatë vitit 2009, si dhe ndikimin e krizës ekonomike botërore në të. Pavarësisht krizës së rëndë që përfshiu ekonominë botërore gjatë vitit 2009, ekonomia shqiptare ishte nga të paktat në Europë që pati rritje ekonomike pozitive, madje në nivel mjaft të kënaqshëm. Vendet e tjera patën rritje ekonomike negative dhe vendi më afër Shqipërisë pati rritje prej vetëm 1% të prodhimit të brendshëm.

Komisioni vlerëson jo vetëm menaxhimin efektiv nga Qeveria për ruajtjen e ritmeve pozitive të zhvillimit ekonomik të vendit, por edhe mbajtjen e deficitit buxhetor brenda kufijve të planifikuar. Viti 2009 tregoi

se deficitet buxhetor dhe borxhi në tërësi u kthyen në probleme mjaft serioze për ekonomitë e vendeve europiane dhe më gjerë.

Deficitet buxhetor i shumicës së vendeve europiane, përfshirë edhe ato të zhvilluara, i kapërceu kufijtë e lejuar, madje në shumë raste u dyfishua. Borxhet e këtyre vendeve u rritën me shifra astronomike, për të përballuar shpenzimet dhe për të mbështetur sistemin bankar dhe atë financiar.

Vendi ynë arriti të mbahet në kufirin e planifikuar prej 6,4% të deficitit buxhetor, si dhe ta mbajë borxhin nën kriterin e Bashkimit Europian prej 60% në raport me prodhimin e brendshëm.

Komisioni vlerëson mbështetjen që akti normativ i jep sistemit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në vendin tonë. Për shkak të krizës ekonomike botërore mjaft vende në rajon ulën pagat dhe pensionet, madje patën vështirësi për t'i paguar ato në kohë. Në të kundërt, në vendin tonë gjatë vitit 2009 u shënuar rritja më e madhe e pagave dhe pensione gjatë gjithë periudhës së tranzicionit. Akti normativ garanton qëndrueshmëri dhe funksion normal të sistemit të pagave, pensione dhe ndihmës ekonomike për të gjitha kategoritë e qytetarëve, sot dhe të ardhmen.

Mbështetur në argumentet e mësipërm, komisioni e miratoi aktin normativ me të gjitha votat e anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Spaho!

Zoti Ministër, urdhëroni!

Ridvan Bode – E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Akti normativ që miratojmë sot në Kuvend i referohet një vendimi të Këshillit të Ministrave të datës 25 dhjetor 2009, që ka të bëjë me rialokimin e fondeve buxhetore, për t'i përputhur ato me situatën, sikurse edhe për të mundësuar përdorimin më efektiv të fondeve të mbetura pa përdorur, sipas titujve dhe kapitujve të buxhetit, në institucionet dhe ministritë e linjës.

Akti normativ tashmë është bërë një praktikë e përvitshme dhe mendoj se dëshmon miradministrimin e buxhetit dhe të fondeve publike, si dhe nevojën për t'i përdorur ato në mënyrë sa më efektive, në përputhje me zhvillimet konkrete që kanë financat publike në vitin përkatës. Nga kjo pikëpamje ky akt normativ nuk përbën lajm.

E reja që sjell ky akt normativ në kontekstin e zhvillimeve ekonomike të krizës globale të vitit 2009 ka të bëjë me përmbajtjen e tij. Në thelb, akti

normativ nuk reflekton ndryshime të mëdha në krahasim me përvijimet kryesore, autorizimet kryesore, që ky Kuvend i bëri Qeverisë përmes ligjit të buxhetit të vitit 2009, sikurse edhe ndryshimeve të bëra në muajin korrik të po këtij viti.

Akti normativ ka në vetvete reflektimet më të fundit të zhvillimeve ekonomike, buxhetore dhe fiskale të vitit 2009. Viti 2009, si viti i krizës më të thellë të ekonomisë globale, ardhur pas një krizë të thellë financiare, pati presionet e veta edhe në ekonominë shqiptare. Kjo ekonomi u përball me një tkurrje për shkak të pasojave dhe efekteve negative të krizës ekonomike globale, por përsëri ekonomia shqiptare reagoi dhe performoi në mënyrë më pozitive.

Konsiderohet se në vitin 2009 ekonomia shqiptare do të mundësojë një rritje në parametrat 3,5-4% të GDP-së në krahasim me vitin 2008. Kjo shifër përbën rritjen më të madhe ekonomike në të gjithë kontinentin europian.

Nga ana tjetër, inflacioni është dhe mbetet i moderuar, brenda parametrave dhe objektivave të Bankës së Shqipërisë dhe autorizimeve të këtij Kuvendi, me një rritje mesatare vjetore prej rreth 2,2%.

Ritmi pozitiv i ekonomisë sonë përballë presioneve të mëdha të krizës ekonomike globale në vitin 2009 u mundësua përmes ruajtjes të fundamenteve të stabilitetit tonë makroekonomik, duke marrë në konsideratë edhe parametrat që lidhen si me kursin e këmbimit, ashtu dhe me deficitin e borxhin publik.

Viti 2009, i cili në shumë vende të rajonit dhe të botës ishte viti i ndryshimit, i përqendërimit, i uljes së kreditimit, për shkak të presioneve të krizës globale, i shoqëruar jo vetëm me një rënie ekonomike, por edhe me një rritje të konsiderueshme të borxhit publik e deficiteve, në ekonominë shqiptare nuk u manifestua si i tillë. Ai ishte një vit me probleme, po jo me shkatërrim të themeleve të stabilitetit makroekonomik të Shqipërisë.

Kjo qëndrueshmëri e treguesve kryesorë makroekonomikë të vendit dhe rritja pozitive që demonstroi ekonomia përballë presioneve të krizës u mundësua përmes një koordinimi të suksesshëm të politikave fiskale me ato monetare dhe e ka bazën në tërësinë e masave të ndërmarra nga Qeveria dhe nga institucionet e vendit për t'i shërbyer periudhës së krizës me stimujt më të fuqishëm fiskalë dhe monetarë.

Viti 2009 është viti kur Qeveria, përmes

autorizimit të këtij Kuvendi, përdori rreth 250 milionë euro të ardhura nga privatizimet, të krijuara edhe gjatë vitit 2008, për të nxitur kërkesën konsumatore, për të mbështetur një program ambicioz të investimeve publike, të cilat në vitin 2009 arrinin në maksimumin historik të vendit, jo vetëm nga vlera në total, por edhe në raport me prodhimin e brendshëm bruto, duke arritur rreth 10% të tij ose 1/3-tën e buxhetit të destinuar për këtë zë. Pra, pati investime publike në infrastrukturën rrugore, në ujësjellës-kanalizime, në spitale, në shkolla dhe në të gjitha aktivitetet e tjera publike që ushtron Qeveria dhe përdoruesit e buxhetit.

Nga ana tjetër, qëndrueshmëria e demonstruar në vitin 2009 dëshmon për suksesin e reformave të thella të ndërmarra nga Qeveria në harkun e katër vjetëve, të cilat përmirësuan klimën e biznesit, ambientin ekonomik dhe mundësuan që rritja e madhe ekonomike e vitit 2008 dhe shpresa për një rritje edhe më të madhe në vijimësi, të paktën, të mos kthehej në një dështim, në një rënie të plotë të ekonomisë dhe në përfshirjen e saj në vorbullën e krizës, sikurse u përfshinë ekonomitë e vendeve të rajonit tonë, me të cilat Shqipëria ka edhe shkëmbimet më të fuqishme ekonomike dhe tregtare, siç janë edhe dy vende të Bashkimit Europian, Greqia dhe Italia.

Në këto kushte, Qeveria, duke reflektuar mbi situatën, duke marrë në konsideratë presionet e krizës financiare globale dhe zhvillimet në financat publike, formuloi këtë akt normativ, i cili në thelbin e tij ruan stabilitetin makroekonomik, ruan parametrat kryesorë të themeleve të këtij stabiliteti, si dhe mundëson përdorimin më efikas të fondeve.

Pa u ndalur në zërat analitikë, të cilët i përmendi zoti Spaho, do të dëshiroja të thosha se thelbi i ndryshimit konsiston vetëm në një rritje të deficitit vjetor me 6,2 miliardë lekë, nga të cilat 3,2 miliardë lekë vijnë nga avancimi më shpejt i punimeve të financimeve të huaja në objektet që janë financuar nga bankat e zhvillimit dhe që janë kredi të buta, pra demonstroi një rritje të performancës në përdorimin e fondeve të huaja dhe pjesërisht në kompensimin e fondit të pensioneve, pra fondit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe që merr në konsideratë shpërblimet e fundvitit, si dhe zhvillimet jo aq pozitive në tregun e punës gjatë 6-mujorit të dytë të vitit 2009.

Në këto kushte, unë jam i bindur se akti normativ që do të miratojë sot Kuvendi i Shqipërisë përbën një dokument të qëndrueshmërisë ekonomike dhe

fiskale përballë pasojave të krizës dhe presioneve të saj në ekonominë shqiptare. Sikurse e thashë, vlera e tyre është vetëm 6,2 miliardë lekë.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Bode!

Ka pyetje? Nuk ka.

Ka diskutime? Nuk ka.

Në emër të grupeve:

Grupi Parlamentar i LSI-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Grupi Parlamentar i PD-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Kalojmë në projektligjin “Për një shtesë dhe ndryshim në ligjin nr.7651, datë 21.12.1992 “Për festat zyrtare dhe ditët përkujtimore”, të ndryshuar”.

Në emër të Komisionit të Çështjeve Ligjore, zoti Gumi, urdhëroni!

Viktor Gumi – Falemnderit, zonja Kryetare!

Sikundër ishte parashikuar në kalendarin e punimeve të Kuvendit, si komision përgjegjës për këtë projektligj ishte caktuar Komisioni i Ligjeve, i cili e mori atë në shqyrtim në datën 20 janar.

Thelbi i këtij ligji ka të bëjë me një shtesë dhe një ndryshim. Shtesa ka të bëjë me një shtesë në listën e festave zyrtare, të datës 8 dhjetor, nën emërtesën “Dita Kombëtare e Rinisë”. Ndërsa elementi i dytë i këtij projektligji ka të bëjë me një shfuqizim të paragrafit 2 të nenit 1 të këtij ligji.

Natyrisht, komisioni i miratoi me unanimitet këto shtesa që janë bërë në këtë projektligj dhe e konsideron plotësisht të justifikuar dhe të legjitimuar nismën e Qeverisë.

Natyrisht, për sa i përket pjesës së parë, është një pjesë, e cila është dhënë si premtim. Për mendimin e komisionit, dita 8 dhjetor është plotësisht legjitime dhe e justifikuar, sepse shpall në listën e festave zyrtare dhe ditëve zyrtare një nga datat që ka qenë dhe do të mbetet monumentale në historinë e Shqipërisë. Është pikërisht kjo datë që përbën simbolin e madh të ndarjes njëherë e përgjithmonë dhe të çrrënjësjes së komunizmit, si dhe fillimin e një epoke të re demokratike në historinë e popullit shqiptar.

8 dhjetori i 19 vjetëve më parë përbën simbolin e reagimit të madh të përbashkët midis popullit dhe studentëve liberatorë, të cilët vërshuan në rrugët dhe sheshet e qytetit të Tiranës në kërkim të lirisë, demokracisë, pluralizmit dhe të një Shqipërie europiane.

Për të gjitha këto arsye, nisma që përmban ky projektligj nuk është vetëm një e drejtë e ekzekutivit e më pas e Parlamentit, për të përcaktuar thjesht një datë, është njëkohësisht një detyrim madhor që duhet të mbahet për të përjetësuar, për të treguar mirënjohje, respekt dhe njëkohësisht për të festuar këtë datë madhore, që me simbolikën e saj tregon shumë.

Gjithashtu, projektligji në fjalë shfuqizon edhe një pjesë të paragrafit të dytë të nenit 1 të këtij projektligji. Në vetvete, edhe kjo është një nismë plotësisht legjitime, e parë në përputhje me Kushtetutën dhe me Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë, sepse, së pari, ligji përcakton katalogun e festave zyrtare dhe nuk ka si objekt për të rregulluar pasojat juridike të punës, që lindin në rast se festat zyrtare bien në ditën e shtunë ose të dielën. Nëse një nismë e tillë ishte e justifikuar që nga data e miratimit të këtij ligji, në dhjetor të vitit 1992, deri në gusht të vitit 1995, kur kjo gjë nuk ishte rregulluar me Kodin e Punës, pas gushtit të vitit 1995, kjo marrëdhënie juridike rregullohet me Kodin e Punës. Për pasojë ligji duhet të mbetet në qëllimin e tij primar, në paraqitjen e katalogut të festave zyrtare dhe të ditëve përkujtimore.

Nga ana tjetër, komisioni e konsideron njëkohësisht edhe reagim nga një situatë *de facto* me një situatë *de jure*, për t'u plotësuar ky projektligj edhe në kuptimin formal e juridik, sepse vetë neni 208 i Kodit të Punës ka shfuqizuar çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj. Për pasojë, për sa kohë kjo marrëdhënie juridike rregullohet në nenin 86 të Kodit të Punës, është e panevojshme që të përsëritet një rregullim i tillë apo të rregullohet ndryshe në ligjin për festat zyrtare.

Në përfundim, komisioni e gjeti projektligjin në përputhje me Kushtetutën dhe ai nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë të legjislacionit që rregullon marrëdhëniet e punës, posaçërisht me Kodin e Punës, si dhe përmban kriteret e hartimit të një akti normativ. Ndaj, njëzëri, propozojmë miratimin e tij në seancë plenare.

Ne në komision u bëmë të ditur edhe përfaqësuesve të Qeverisë një rekomandim të Komisionit të Ligjeve dhe mendojmë ta përsërisim edhe në seancë, përpara ekzekutivit, ku sipas mendimit të Komisionit të Ligjeve, tashmë është koha për të nisur një punë për hartimin e një projektligji të plotë në përputhje me praktikën më të mira për ditët përkujtimore dhe festat zyrtare.

Besojmë se praktikës së një ligji, i cili daton që

nga viti 1992 dhe gjatë gjithë kësaj kohe ka pasur amendime për hir të disa rasteve edhe të sforcuara, tashmë duhet t'i jepet fund duke hartuar një ligj të ri, të plotë, në përputhje me praktikën më të mira edhe në këtë aspekt.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Gumi!

Ka pyetje? Nuk ka. Diskutime? Nuk ka.

Kalojmë në shprehjen e grupeve parlamentare. Grupi Parlamentar i LSI-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Kalojmë te projektligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8366, datë 2.07.1998 "Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH)", të ndryshuar".

Në emër të Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin?

Zoti Bano, urdhëroni!

Ilir Bano – Falemnderit, zonja Kryetare!

Këto shtesa dhe ndryshime në ligjin që rregullon veprimtarinë e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar përshtatin objektin dhe detyrat e tij në përputhje me riorganizimin që iu bë institucioneve shkencore të vendit në vitin 2008, si dhe pasqyrojnë më drejt faktin e të qenit institucion buxhetor në mënyrën e menaxhimit dhe të drejtimit të tij.

Në vitin 2008, me vendim qeverie, është ngritur dhe funksionon Instituti i Gjeoshkencës, i cili do të merret me aspektin shkencor në këtë fushë. Për këtë arsye në të gjitha nenet e projektligjit që po diskutojmë fjala "studim" zëvendësohet me fjalët "vrojtim, shërbime dhe monitorime", si dhe shtohet në objektin e punës promovimi i perspektivës së mineraleve të dobishme, përfshirë naftën dhe gazin.

Në nenin 2 saktësohet roli i shërbimit gjeologjik: së pari, për kontrollin e aspekteve gjeologjike të shfrytëzimit të lëndëve të para dhe, së dyti, për oponencën dhe monitorimin e lejeve të kërkimit që i japin institucionet e përcaktuara në ligj. Një nga funksionet e shërbimit gjeologjik ka qenë dhe mbetet menaxhimi i arkivit qendror të gjeologjisë.

Në këtë projektligj shtohet edhe detyrimi i subjekteve private, krahas atyre shtetërore, për të depozituar në këtë arkiv të gjithë dokumentacionin faktik të punimeve gjeologjike, inxhinierike, të kryera, duke përmirësuar kështu bazën e të dhënave për qëllime të mëtejshme studimore dhe përgjithësuese.

Në drejtimin e institucionit risia që sjell ky projektligj ka të bëjë me shfuqizimin e neneve për ngritjen, përbërjen dhe detyrat e këshillit drejtues, si një hallkë e tepërt për një institucion buxhetor.

Së fundi, riformulohen nenet për shërbimet që kryhen ndaj të tretëve, mënyra e përcaktimit të tarifave dhe e përdorimit të të ardhurave nga to, të cilat, me miratimin e ministrit, do të përdoren për përmirësimin e teknikës, kualifikimit dhe shpërblimit të personelit.

Në tërësinë e tyre këto shtesa dhe ndryshime i shërbejnë reformës për një funksionim më të mirë të këtij shërbimi dhe rrisin vetëveprimin e tij si një institucion i rëndësishëm këshillimor teknik dhe shkencor i shtetit. Për këtë arsye, komisioni ynë i miratoi ato së bashku me amendamentet që i bashkëngjiten raportit përkatës.

Me këtë rast, dua të theksoj se me reformën që është bërë dhe vazhdon të bëhet në sektorin e gjerë të burimeve minerare, përfshirë ato energjetike dhe të baseneve ujëmbledhës, krahas shërbimit gjeologjik janë ngritur dhe funksionojnë një sërë institucioneve buxhetore, si: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Agjencia e Ujit dhe e Basenit, Instituti i Gjeoshkencës etj. Këto institucione, ndonëse kanë detyra të përcaktuara me akte të tjera ligjore dhe nënligjore, kanë edhe ndërveprim dhe bashkëveprim me njëra-tjetrën, si dhe me Shërbimin Gjeologjik Shqiptar.

Në këtë kuptim, ndoshta në të ardhmen ka vend për një rakordim më të mirë ligjor e institucional midis tyre, për një harmonizim më të mirë të funksioneve dhe detyrave, në përshtatje me stadin aktual dhe perspektiv të zhvillimit të vendit.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Bano!

Ka pyetje? Nuk ka. Diskutime? Nuk ka.

Kalojmë në shprehjen e grupeve parlamentare.

Grupi Parlamentar i LSI-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Kalojmë në projektligjin “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”.

Në emër të Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin?

Zoti Metalla, urdhëroni!

Osman Metalla – Falemnderit, zonja Kryetare!
Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë

dhe Mjedisin në mbledhjen e tij të datës 21 dhe 25 janar shqyrtoi projektligjin “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”. Objekti kryesor i këtij projektligji ka si qëllim zbatimin e të gjithë legjislacionit evropian në fushën e transportit ajror. Ky detyrim i ka lindur Republikës së Shqipërisë me ligjin nr. 9658, të vitit 2006, i cili ka ratifikuar marrëveshjen shumëpalëshe EKA për krijimin e një zone të përbashkët evropiane në këtë aviacion civil.

Ky projektligj, i cili rregullon një fushë mjaft të rëndësishme, ka si synim zhvillimin dhe modernizimin e aviacionit civil, duke siguruar një organizim dhe funksionim sipas parametrave bashkëkohorë.

Hartimi i këtij projektligji është, gjithashtu, në zbatim të ligjit nr. 1040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, ku nenet 6, 8 dhe 9 përcaktojnë Autoritetin e Aviacionit Civil si një nga autoritetet kompetente për krijimin dhe përgjegjësitë e tij.

Në të njëjtën kohë kodi përcakton si detyrim të këtij projektligji organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil, si dhe përcaktimin e tarifave për shërbimet që ofron ky autoritet, administrimin e të ardhurave në këto shërbime dhe mënyrën e llogaritjes së tyre.

Gjatë diskutimeve që deputetët patën për këtë projektligj, ata u shprehën dakord në lidhje me nevojën e këtij autoriteti, si për plotësimin e sistemit ligjor në fushën e transportit ajror, ashtu edhe për forcimin e kapaciteteve administrative për zbatimin e këtij legjislacioni.

Në përfundim, komisioni, duke e konsideruar të rëndësishëm projektligjin “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, u shpreh dakord për kalimin dhe miratimin e tij në seancë plenare. Njëkohësisht, gjatë shqyrtimit nën për nen të projektligjit, komisioni ka paraqitur një sërë propozimesh që do të kalohen gjatë miratimit nën për nen.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Metalla!

Ka pyetje? Nuk ka. Diskutime? Nuk ka.

Kalojmë në shprehjen e grupeve parlamentare.

Grupi Parlamentar i LSI-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Kalojmë te projektligji i fundit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998

“Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”.

Zoti Florian Mima, në emër të Komisionit të Ekonomisë.

(Zoti Mima shprehet dakord.)

Falemnderit!

Ka pyetje? Nuk ka. Diskutime? Nuk ka.

Kalojmë në shprehjen e grupeve parlamentare.

Grupi Parlamentar i LSI-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Kjo ishte pika e fundit e rendit të ditës.

Përpara se të mbyllim seancën plenare, ju kërkoj të mbajmë një minutë heshtje për ndarjen nga jeta të futbollistit të shquar Panajot Pano.

(Deputetët ngrihen në këmbë dhe qëndrojnë një minutë në heshtje.)

I përjetshëm goftë kujtimi i tij!

Me kaq seanca mbyllet.

Natën e mirë!

(Seanca u mbyll në orën 20:00)

E enjte, 04.02.2010
Seanca e pasdites, ora 17:00

Drejton seancën Kryetarja e Kuvendit,
zonja Jozefina Topalli (Çoba)

Rendi i ditës:

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60’).

2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare, datë 28.01.2010.

3. Miratimi i kalendarit 3-javor të punimeve të Kuvendit (8 shkurt-25 shkurt 2010).

4. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9363, datë 24.03.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”.

5. Projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar”.

6. Projektligji “Për shpalljen e moratoriumit për mjetet motorike lundruese të Republikës së Shqipërisë”.

7. Projektligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

8. Projektligji “Për miratimin e kontratës së lidhur ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqërisë “EUROCOPTER” për furnizimin me 5 helikopterë të mesëm shumërolësh”.

Për votim:

1. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës për ripranimin e personave me qëndrim të parregullt”.

2. Projektligji “Për aderimin e Republikës së

Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare për përgjegjësinë civile për dëmet e shkaktuara nga ndotja, nga karburanti i depozitave të vitit 2001”.

3. Akti normativ nr. 10, datë 23.12.2009 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, të ndryshuar”.

4. Projektligji “Për një shtesë dhe ndryshim në ligjin nr. 7651, datë 21.12.1992 “Për festat zyrtare e ditët përkujtimore”, të ndryshuar”.

5. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8366, datë 02.07.1998 “Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH)”, të ndryshuar”.

6. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”.

7. Interpelancë me Zëvendëskryemministrit dhe ministrin e Punëve të Jashtme, kërkuar nga deputeti Paulin Sterkaj.

Jozefina Topalli – Zotërinj deputetë, mirëmbërëma!

Hapim seancën.

Sot në rendin e ditës kemi 8 pika për të diskutuar dhe 6 pika të tjera plus për votim.

(Lexon rendin e ditës.)

Në fakt, janë dy deputetë që kanë kërkuar të njëjtën interpelancë me zotin Meta në lidhje me sensibilitetin më të lartë që është liberalizimi i vizave. Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës: diskutime për çështje jashtë rendit të ditës.

Është depozituar lista me emrat që kërkojnë të diskutojnë: Arenca Trashani, Mesila Doda, Flamur

Noka, Adriana Gjonaj, Besnik Dushaj dhe ministri Pollo.

Fjalën e ka zonja Trashani.

Arenca Trashani – Falemnderit, zonja Kryetare!

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Ka kaluar vetëm një javë kur Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës adoptoi rezolutën e saj për funksionimin e institucioneve demokratike në Shqipëri. Kam pasur nderin, por mbi të gjitha përgjegjësinë e madhe qytetare dhe politike të jem pjesë e delegacionit shqiptar në këtë asamble. Në fakt, nuk dua të ndalem në përpjekjet e shëmtuara të të gjithë atyre njerëzve, brenda dhe jashtë Shqipërisë, që në mënyrë të turpshme u përpoqën të heqin kredencialet e Shqipërisë në këtë asamble. E turpshme, e paparë tentativa e zënies së organizatës “Drejtësi dhe Hakmarrje”, e cila nën urdhra direkt të Edvin Ramës u përpoq madje edhe me letër zyrtare për arritjen e këtij qëllimi. Por ata harruan një gjë, harruan se kjo asamble nuk ishte asambleja e Partisë Socialiste të Shqipërisë, ku çdo gjë bëhet siç do shefi, por ajo ishte asambleja e Europës së lirë, e fjalës dhe e mendimit të lirë, e funksionimit të ligjit dhe të demokracisë.

Që nga momenti i bërjes publike të draftrezolutës, e më pas të rezolutës, kam dëgjuar opinionistë, politikanë, të cilët e kanë përfolur shumë shpesh këtë rezolutë, e kanë përfolur shpeshherë shumë keq. Dua të vazhdoj të mendoj se shumica e ka bërë nga padija dhe jo nga keqdashja. Ideatori i tërë këtij keqinformimi ka qenë dhe mbetet lideri i opozitës. Edvin Rama ndërtoi me të gjithë forcën e tij të njëjtën gjë që përdor për lejet e ndërtimit: strategjinë destabilizuese, duke arritur të dërgojë në sallën e asamblesë një alibi për një frikë për destabilizimin e vendit, duke na kujtuar madje edhe 1997-ën. Ajo çka mori si përgjigje ishte pikërisht kundërvënja kundrejt kësaj strategjie destabilizuese, që si mjet të saj ka bojkotin.

Asambleja Parlamentare në seancë plenare, në punime komisionesh, në mënyrë unanime dhe pa asnjë hezitim i tha jo dhe jo bojkotit të Edvin Ramës. Të gjithë deputetët, të majtë e të djathtë, u shprehën kundër bojkotit të opozitës, duke shpjeguar se ka ikur koha e bërjes opozitë në rrugë dhe është koha e dialogut dhe e debatit brenda sallës së Parlamentit, dhe kjo gjë është jo vetëm një e drejtë, por mbi të gjitha është një detyrim ndaj atyre që na kanë votuar.

Rezoluta e 28 janarit ishte e një rëndësie historike, sepse u dha fund njëherë e përgjithmonë

mendjeve të trazuar të Edvinit me shoqe dhe me shokë se mund të shkelin mbi Kushtetutën e këtij vendi, mbi ligjet dhe mbi vendimet e Gjykatës Kushtetuese e, mbi të gjitha, të ngrenë komisione alla partizançe, duke paragjykuar dhe shkelur jurisprudencën e këtij vendi. Rezoluta u kërkon autoriteteve shqiptare të krijojnë një komision hetimor për zgjedhjet e qershorit 2009, por duke respektuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese të datës 14 maj të vitit 2003.

Në lidhje me komisionet hetimore, vendimi i Gjykatës Kushtetuese është krejtësisht i qartë kur thotë se vendimet gjyqësore nuk mund të shqyrtohen dhe të ndryshohen, vetëm nga një autoritet tjetër gjyqësor më i lartë. Duke e vënë theksin në parimin e ndarjes së pushteteve, ky vendim përjashton çdo formë tjetër kontrolli mbi aktivitetin juridiksional të gjykatave, qoftë kjo edhe nëpërmjet raporteve të komisioneve hetimore parlamentare.

Gjatë tërë kësaj kohe Edvin Rama ka folur për transparencë, por në fakt ka abuzuar dhe e ka shkatërruar këtë koncept, duke mos bërë gjë tjetër veçse duke ua kundërvënë atë institucioneve të shtetit. Ai ka abuzuar me institucionet shtetërore duke iu kundërvënë atyre, madje edhe me kërcënime serioze vetëm për një qëllim: për të çuar deri në fund strategjinë e tij destabilizuese. Ai foli për bojkot, foli për komisione hetimore sipas dëshirave të tij, për hapje e mbyllje kutish, për vjedhje votash, madje duke fyer zyrtarisht edhe jashtë kufijve të Shqipërisë ata 20 mijë komisionerë socialistë, të cilët treguan shumë më tepër maturi dhe burrëri sesa ai vetë, dhe i bënë këto vetëm për një qëllim të vetëm final, për të penguar atë proces shumë të dëshiruar nga të gjithë shqiptarët, pa dallim ngjyrimi politik, integrimin evropian.

Rezoluta jo më kot përmend vendimin jashtëzakonisht të rëndësishëm për gjithsecilin prej nesh, atë të 16 nëntorit të vitit të kaluar, si një arritje të të gjithë shqiptarëve. Nuk ka dhe nuk ka për të pasur asnjëherë kthim mbrapa të një procesi të tillë, pavarësisht lojës së dyfishtë të Ramës, që nga njëra anë thotë se jam pro procesit dhe nga ana tjetër përdor të gjitha mënyrat, deri dhe ato antiligjore dhe antishqiptare, për ta stopuar atë, vetëm e vetëm për interesat e tij personale, pasi nuk është ai në krye të maxhorancës. Por ai harron një gjë, se për të arritur këtu është dashur vullneti i fortë politik, punë dhe këmbëngulje, tolerancë dhe debat konstruktiv, karakteristika të cilat ai ka dëshmuar se nuk i ka.

Demokracia jonë tashmë ka arritur moshën e pjekurisë. Ajo ka dashur mund, sakrificë dhe kompromise të mëdha. Më në fund ne arritëm të bëjmë zgjedhje të lira dhe të ndershme, e thënë kjo pa përjashtim nga të gjitha institucionet më prestigjioze ndërkombëtare, duke plotësuar pothuajse të gjitha standardet e kërkuara. Ne arritëm ta sjellim vendin këtu ku jemi dhe përpara kemi shumë punë për të bërë, ku kontributi i gjithsecilit prej aktorëve politikë është i mirëpritur, por ama konform Kushtetutës dhe ligjeve të këtij vendi, si dhe me hapa konkretë. Kjo rezolutë është leksioni më i mirë i funksionimit dhe ecjes përpara të kësaj demokracie.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zonja Trashani! Fjalën e ka zonja Doda.

Mesila Doda - E nderuara zonja Kryetare, Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Gjykata Kushtetuese javën që kaloi dha verdiktin mbi ligjin “Për pastërtinë e figurës së zyrtarit”, i njohur publikisht si ligji i dosjeve. Gjykata e quajti ligjin si të papranueshëm dhe që bie ndesh me dispozitat kushtetuese të vendit. Kësisoj iu dha legjitimitet individëve që deri dje kanë dhënë vendime internimesh, dëbimesh, vrasjesh dhe varjesh. Këta individë sot mund t’i gjesh gjithkund; në politikë, në drejtësi, në prokurori dhe janë me tepri edhe në vetë institucionin që e shpalli si herezi ligjin “Për pastërtinë e figurës së zyrtarit”.

Të nderuar kolegë,

Ende në këtë vend është herezi të mendosh se njerëzit që kanë dënuar e vrarë në emër të komunizmit nuk meritojnë të dënojnë dhe të gjykojnë. Ende në këtë vend xhelatët vazhdojnë të pohojnë se e kanë bërë këtë në emër të ligjit dhe se fajin e kishin ligjet, por jo ata vetë. Nisur nga kjo logjikë do të na duhet t’i quajmë jo disidentë, por kriminelë e shkelës ligji të gjithë ata të persekutuar që janë me faj se mendonin dhe punonin për një rend të ri, demokratik, dhe jo për t’i dhënë pushtet krimit të luftës së klasave, që ishte i sanksionuar e i mbrojtur me ligj.

Të nderuar zonja e zotërinj,

Sot ne po marrim pjesë në një ridënim masiv të të gjithë atyre të burgosurve dhe të vrarëve, të cilët, në respekt të bindjeve të tyre demokrate dhe shpirtit të tyre të lirë, kanë punuar dhe kanë vuajtur. Sot fëmijët tanë mund të marrin mësimin më të shëmtuar në historinë e këtyre viteve. Ata mund të kuptojnë se, po të rrish drejt me pushtetin, qoftë ky

dhe kriminal, nuk mund të të gjejë asnjë gjë e keqe. Sot ne mund të deduktojmë se të mbrojturit e të llastuarit e fatit dhe të pushtetit ashtu do të mbeten gjithë jetën, si dje në komunizëm dhe sot në demokraci, të llastuar.

Të nderuar kolegë,

Sot ne duhet të lëvizim në mbrojtje të idealeve tona, në mbrojtje të demokracisë në vend. Ne nuk mund të lëmë dot në vetmi dhe padrejtësi ata mijëra fatkeq që jo vetëm nuk kursehen të na besojnë e të na japin votat sa herë që neve na duhen, por sot kërkojnë legjitimitetin e cinguar nga vendime të mbrapshta dhe nga njerëz të mbrapshtë. Janë disa mënyra dhe rrugë që mund të kërkojmë e të gjejmë së bashku. Sigurisht që do të ishte më e udhës që së bashku me opozitarët e kësaj salle të shkruanim dhe të votonim një ligj të ri. Por socialistët e rinj, ashtu si punistët e vjetër, nuk do të japin kurrë miratimin që fara e tyre biologjike e politike të zhduket nga drejtimi i këtij vendi, nuk do të pranojnë kurrë që së bashku t’i japim kuptim e drejtësi shoqërisë sonë ekzistuese. Të flasësh për opozitë në Kuvend, dhe për më tepër bashkëpunuese, sot neve mund të na duket më shumë se kurrë si një shprehje virtuale. Kësisoj, sipas mendimit tim, do të na duhet që të konsiderojmë me shumë seriozitet opsionin e referendumit, për të marrë nga shtetasit shqiptarë verdiktin e tyre për dosjet. Përfundimisht prej tyre mund të mësojmë nëse shoqëria shqiptare dëshiron të ketë të njëjtën klasë drejtuese, të njëjtët njerëz në politikë, në drejtësi dhe ekonomi. Vetëm kështu ne do të mund të rikthejmë legjitimitetin e politikës dhe drejtësisë, do të mund të rikthejmë legjitimitetin e organit të akuzës dhe të institucioneve kushtetuese në vend. Mbi të gjitha, ne do të mund të kthejmë drejtësi dhe dinjitet për mijëra të persekutuar, për dhjetëra jetë të humbura, për të burgosurit dhe të internuarit e dikurshëm.

Gjatë këtyre ditëve kanë qenë të shumtë njerëzit që më kanë takuar dhe kanë shprehur solidaritetin e tyre me këtë nismë. Janë njerëz të letrave, të mediave, të librit, të kinemasë, janë njerëz të persekutuar.

Unë sot do t’ju ftoj, të nderuar kolegë, që edhe ju të bëheni pjesë e një nisme që do të zgjidhë njëherë e mirë këtë plagë të shoqërisë sonë. Do të gjejmë së bashku rrugën më të mirë dhe më rezultative për të spastruar përfundimisht shoqërinë shqiptare nga njerëzit që kanë mbi vete krime.

Ju ftoj të gjithëve që të bëheni pjesë e kësaj zgjidhjeje.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zonja Doda!
Zoti Ministër, urdhëroni!

Genc Pollo – Falemnderit, zonja Kryetare!
Të nderuar kolegë deputetë,

Do të doja që në fjalën time në orën e diskutimeve të lira t'ju sqaroja për një veprim shumë të rëndësishëm që Qeveria planifikon ta kryejë vitin e ardhshëm, regjistrimin e popullsisë dhe banesave, një proces që çdo vend i përparuar e kryen periodikisht, si rregull në çdo 10 vjet, dhe që është i rëndësishëm për shtetin dhe shoqërinë. Ky është një veprim i cili do të na japë një panoramë të plotë të realitetit social dhe ekonomik shqiptar, do të na bëjë më të ndërgjegjshëm për atë që jemi, për rrugën e bërë deri këtu dhe, më e rëndësishme akoma, për rrugën drejt së ardhmes, duke saktësuar strategjitë tona dhe sidomos buxhetimin tonë me synim miradministrimin e parasë publike. Besoj se me këtë bien të gjithë dakord, edhe ata që, ndoshta, për gjëra të tjera, nuk bien dakord me ne.

Por ndoshta nuk është bërë e qartë sa duhet që, krahasuar me 10 vjet më parë, kur u krye REPOBA në vitin 2001, regjistrimi i popullsisë në vitin e ardhshëm do të jetë shumë më kompleks, do të vjelë një informacion shumë herë më të madh e më të detajuar dhe do të kryhet në mënyrë shumë të dixhitalizuar (teknologjia dixhitale zë afro 1/3 e buxhetit të këtij ushtrimi të vitit të ardhshëm), kurse totali i buxhetit është 15 milionë euro, 1/3 nga buxheti i shtetit dhe pjesa tjetër nga donatorët.

Por tema sensitive që ka ngjallur debat, dhe kjo është e kuptueshme, ka të bëjë me përfshirjen në REPOBA-n e vitit të ardhshëm edhe të pyetjeve që kanë të bëjnë me përkatësinë etnike dhe fetare. Janë ngritur shumë kundërshti që meritojnë të sqarohen sepse një pjesë e tyre, ndoshta jo pjesa më e madhe, mund të jenë të sinqerta. Ka një pikëpamje sipas së cilës informacioni për përkatësinë etnike dhe atë fetare nuk na nevojitet. Unë nuk mendoj kështu. Mendoj që çdo shoqëri duhet të njohë vetveten ashtu siç është në mënyrë objektive dhe me metoda profesionale, sepse përkatësia etnike është thelbësore në qënien tonë komunitare, ndërsa përkatësia fetare, sidoqoftë ajo, edhe pas periudhës së vështirë të ateizmit të imponuar nga komunizmi, është e rëndësishme për qënien tonë private, por edhe për qënien tonë komunitare. Shpresoj që të paktën rreth këtij pohimi mund të mblidhemi të gjithë.

Por, në qoftë se ky pohim nuk do të ishte i mjaftueshëm për të bindur dikë, kemi dy referenca

të mundshme: si ka ndodhur në të shkuarën dhe si e bëjnë vendet e tjera. Për të rifreskuar të shkuarën tonë historike do të kujtoja që regjistrimi i parë, pak a shumë primitiv, i popullsisë, më tepër një numërim i saj, është bërë nga qeveria shqiptare në vitin 1923 dhe përmbante edhe të dhëna për etninë dhe fenë. Regjistrimi tjetër më i plotë, më i organizuar ka qenë ai i bërë nga mbreti Zog në vitin 1930, që është edhe baza e parë që kemi. U vazhdua pas luftës me këto pyetje deri në vitin 1967, pas të cilit për regjimin nuk ekzistonte besimi, por vazhdoi regjistrimi për përkatësinë etnike me metodologjinë e asaj kohe dhe hera e fundit ishte në vitin 1989.

Do të ishte e kuptueshme që në periudhën e vështirë të fillimit të viteve '90, kur shoqëria ishte e demoralizuar, ashtu siç doli nga komunizmi, në mënyrë poshtëruese, e varfër, manipulimi mund të ishte diçka që mund të ndodhte. Por nga ajo periudhë kanë kaluar afro 20 vjet dhe unë mendoj që kjo është një pyetje që, në radhë të parë, duhet të marrë përgjigje nga politikanët. Do të diskutojnë edhe sociologët, ekspertët e statistikave, por, në fund të fundit, ju jeni në këtë sallë dhe keni pasur e keni kontakt me njerëzit që ju kanë zgjedhur, mund të gjykojmë nëse shqiptarët e sotëm janë shqiptarë që kanë besim te vetvetja, janë shqiptarë që janë më të qetë dhe sovranë, sepse, në fund të fundit, situata jonë mund të mos jetë ajo e Zvicrës, por është krejt e ndryshme nga ajo e vitit 1991, kur njerëzit dyndeshin kapicë në bordet e anijeve në Durrës, për të vajtur 60 apo 80 kilometra më tej.

Në këtë situatë më të qetë, kur vendi dhe kombi është në ngjitje, kur ne jemi kualifikuar edhe nga organizmat ndërkombëtare jo më si vend me të ardhura të ulëta, por si vend me të ardhura të mesme dhe ku zhvillimi ekonomik është i pamohueshëm, kur Shqipëria është bërë anëtare e Aleancës së Atlantikut dhe po përparon me shpejtësi drejt Bashkimit Europian, kur situata në rajon ka ndryshuar, ne kemi në ndërgjegjen e gjithsecilit, edhe në atë komunitare, një situatë tjetër, që mendoj se çdokujt i jep mundësinë të deklarohet ai që është dhe jo ndryshe, edhe sikur hipotetikusht të ketë përpjekje për ta ndryshuar këtë.

Do të doja të theksoja se ky nuk është një detyrim nga Bashkimi Europian, madje nuk është as një rekomandim i Eurostatit, organi që ndihmon të gjitha vendet, përfshi ne, me asistencë teknike për të mbajtur një census modern. Ky është një vendim i Qeverisë shqiptare dhe i Komisionit Qendror të Regjistrimit, të cilin kam nderin ta kryesoj. Mendoj

se është vendimi i duhur, sepse, në qoftë se u referohemi vendeve të tjera, pothuajse të gjitha vendet e Bashkimit Europian pyesin për përkatësinë fetare dhe etnike, madje Anglia pyet edhe për racën, por kuptohet që këto pyetje janë opsionale. Pra, e drejta kushtetuese e gjithsecilit për të refuzuar që t'i përgjigjet kësaj pyetjeje është e garantuar dhe kjo është e përfshirë në pyetësor. Ky është një informacion që duhet ta dinë të gjithë.

Frika se një numër i madh shqiptarësh që kanë emigruar në Greqi dhe kanë ndryshuar të dhënat e tyre kthehen dhe ndryshojnë balancat etnike është, gjithashtu, pa bazë. Nuk e di se si do të deklarohen ata, por ka një fakt konkret që duhet të jetë i qartë: regjistrimi i popullsisë dhe banesave bëhet për të gjithë ata që janë fizikisht prezentë në Republikën e Shqipërisë dhe kanë jetuar në Republikën e Shqipërisë gjatë 12 muajve të fundit.

Do t'ju jap një shembull konkret: para dy javësh, i menaxhuar nga Qeveria Federale, ka filluar censusi në Shtetet e Bashkuara. Ata amerikanë që janë në Shqipëri: diplomatë, ushtarakë, biznesmenë privatë, nuk mund të përfshihen në të. E njëjta gjë ndodh edhe me shqiptarët që jetojnë në Greqi, Itali, Amerikë, Gjermani apo Angli. Është normale që censusi mund të veprojë vetëm në territorin e Republikës sonë, ne s'mund të ndërmarrim veprime në territore me juridiksion tjetër. E them këtë sepse kam marrë sms dhe e-maille nga përfaqësues të emigrantëve që kërkojnë të përfshihen në regjistrim. Kjo, realisht, nuk është e mundur dhe ne nuk mund të presim që ata të kthehen, sepse kjo do të ishte jorealiste. Ashtu siç mbajmë zgjedhje parlamentare çdo katër vjet dhe kushdo mund të vijë për të votuar për një parti apo për një tjetër, po kështu duhet të bëjmë regjistrimin çdo 10 vjet me ata që ndodhen në Shqipëri. Në qoftë se një emigrant ndodhet rastësisht në Shqipëri, ai pyetet nëse është rezident dhe në qoftë se nuk është, futet në një kategori të veçantë.

Këto që po aplikojmë janë praktika ndërkombëtare dhe mendoj se janë të rëndësishme për të sqaruar publikun, përfshirë edhe ata që janë të shqetësuar. Kjo është një praktikë që nuk besoj se mund të ketë pasoja negative dhe ne do të kemi kujdes për ta ndjekur hap pas hapi në mënyrë që regjistrimin e popullsisë dhe banesave ta bëjmë në mënyrë profesionale dhe objektive dhe, sigurisht, pa të dhëna të shtrembëruara në rezultatin përfundimtar.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Pollo!

Fjalën e ka zoti Noka.

Flamur Noka – Falemnderit, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Për të paktën 3 ditë me radhë gjatë javës së kaluar kryetari i Partisë Socialiste, Edvin Rama, kërkoi që të nxinte imazhin e Shqipërisë në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Europës. Në një rast të paprecedent dërgata informale e një partie kërkoi heqjen e kredencialeve të përfaqësimit për vendin e vet në Këshillin e Europës ose e thënë më shkoqur, përjashtimin e Shqipërisë nga ky institucion i rëndësishëm ndërkombëtar.

Nuk ka ndodhur kurrë më parë në historinë e këtij organizmi prestigjioz ajo që ngjau gjatë atyre 3 ditëve në Strasburg, ku avokatë më të mirë të vendit tonë u bënë eurodeputetë e të gjitha grupeve politike, që nga e majta ekstreme e deri tek e djathta konservatore, ndërsa armiku i Shqipërisë dhe i proceseve integruese të saj ishte Edvin Kristaq Rama dhe sekt i tij politik.

Në fakt, ky ishte një vetëdemaskim historik, sepse ndodhi në një kuvend europian, ku jo vetëm të gjithë të pranishmit, por edhe të gjithë shqiptarët, përmes medias, patën rastin të shohin se çfarë përfaqëson në të vërtetë Edvin Rama dhe dishepujt e tij të keqpërdorur mizorisht nga ai për qëllimet e tij të errëta.

Pas gjithë asaj shuplake që Strasburgu i dha lëvizjes së rrugës dhe filozofisë së turpshme të bojkotit, cilido lider politik sadopak i përgjegjshëm do të ndërmerre si hap të parë plotësimin e kërkesave të rezolutës së miratuar. Ky dokument kishte si pikë thelbësore dhënien fund të bojkotit dhe futjen në Parlament të forcës së tij politike, në mënyrë që Partia Socialiste të ishte kontribuuese në zhvillimet integruese të vendit.

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës nuk ka la asnjë shteg për interpretime alla Edvinçe, sepse bojkoti është një nocion që për europianët dhe perëndimorët në përgjithësi, ekziston vetëm në fjalorët gjuhësorë.

Por çfarë po ndodh që nga e enjta e kaluar, kur u miratua rezoluta tepër korrekte dhe realiste nga Stasburgu? Edi Rama dhe të tijët nuk kanë hedhur as edhe një hap të vetëm përpara, pasi ne po shohim që ata po përdorin të njëjtën gjuhë, po bëjnë të njëjtat veprime dhe po mbajnë të njëjtat qëndrime. Me sa kuptohet Edvin Rama nuk po e lexon rezolutën as në shqip dhe as në anglisht, por në një gjuhë që vetëm ai e njeh, atë të anarkisë dhe të mosarsyes.

Po me këtë gjuhë vazhdon të flasë për krizën shumëdimensionale që, sipas tij, po përjeton vendi.

Në fakt, ka vetëm një krizë shumëdimensionale. Kjo është kriza që ka mbërthyer prej 6 muajsh vetë Edvin Ramën, është kriza që ai i ka injektuar plotësisht Partisë Socialiste, duke e shndërruar atë nga një parti parlamentare, e cila dikur ka qeverisur vendin, në një OJF rrugësh dhe sokakësh, të cilën, kështu siç e ka katandisur, dëshiron ta nxjerrë jashtë sistemit politik shqiptar.

E gjitha kjo ka vetëm një shpjegim: Paraja dhe pushteti qëndrojnë për Edvin Kristaq Ramën dhe sektin e vet mafioz mbi çdo interes tjetër, qoftë edhe kombëtar. Mbi këtë bazë, duke shkëlluar çdo normë morale apo politike ai po imagjinojnë çdo ditë ose një tryezë ku rrëmben apo grabit gjithçka, ose finalizimin e lëvizjes së tij haxhiqamilliste.

Por ai duhet t'i harrojë të dyja këto alternativa të perealizueshme, sepse as Shqipëria nuk është më në atë fazë dhe as demokracia nuk funksionon si mendja e tij e sëmurë, sepse sistemi që ne kemi ndërtuar ka rregulla dhe mekanizma normalë funksionimi. Edvin Rama duhet të kujtojë se atë që nuk e ka marrë nga vota e lirë e qytetarëve shqiptarë, nuk mund ta zhvasë në asnjë tryezë, katrore apo e rrumbullakët qoftë ajo.

Partia Demokratike dhe maxhoranca në përgjithësi e ka bërë të qartë me kohë se është gati të krijojë një komision hetimor për zgjedhjet, por ky komision duhet të jetë parlamentar, sepse është Kuvendi institucioni që mund të hetojë sipas ligjit dhe Kushtetutës.

Edvin Rama ta harrojë se ky komision do t'i japë mundësinë të bëjë hetuesin dhe prokurorin për aleatët të tij të vjetër dhe të rinj: Skënder Gjinushin, Spartak Ngjelën, Erion Veliajn, Nard Ndokën apo çdo sharlatan tjetër politik, që shqiptarët me votë i hodhën në oborrin e bashkisë si mbetje, radioaktivitetin e të cilave po e vuan dhe do ta vuajë Partia Socialiste.

Sot për çdo shqiptar është më se e qartë se Edvin Rama nuk ka hall hapjen e kutive, sepse ai e di mirë që aty, sado të gërmojë, qenin e ngordhur do të gjejë, por, në zemërimin dhe mllëfin e pamundësisë për të kapur karrigen kryeministore, ai po kërkon të fusë vendin në një spirale të pafundme destabiliteti. Ai po kërkon që në çdo palë zgjedhje Shqipëria të vuajë nga sindroma e tij e mospranimit të zgjedhjeve dhe që kaosi e paqëndrueshmëria të mbisundojë në këtë vend. Por këtë nuk ia kemi borxh as ne, as shqiptarët. Këtë

nuk ia ka borxh askush në Shqipëri Edvin Ramës. E gjithë kjo që po ndodh, po u tregon shqiptarëve dhe ndërkombëtarëve se nuk kemi të bëjmë me një drejtues normal të një partie politike serioze. Edhe vetë Rama e ka pranuar se nuk është politikan. Ai thotë se është me mision. Ndaj ne duhet t'u themi me zë të lartë qytetarëve shqiptarë dhe të huajve se misioni i tij është një dhe vetëm një, mbrojtja e interesave të klanit të vet mafiozo-punist, që rrethon dhe drejton në vendimarrjen politike qoftë edhe duke sakrifikuar interesat e vendit të vet. I vënë prej vitesh në drejtim të këtij klani, ai ka pasur dhe ka si bosht lëvizës të tij politike e dëmtimit të proceseve integruese të vendit.

Është i vetmi politikan shqiptar që u ka ulëritur mediave dhe gazetarëve se nuk pyet për ndërkombëtarët, se nuk i duhet integrimi i vendit, se Shqipëria mund të ecë edhe pa pasur mbështetjen e tyre.

Edvin Ramës me të vërtetë nuk i duhen ndërkombëtarët dhe integrimi i vendit, sepse në një Shqipëri me mbështetjen e tyre, me përparime në integrim, mafia e tij e ka dhe do ta ketë gjithnjë më të vështirë të mbijetojë dhe të shtrijë perandorinë e saj të kimit në këtë territor.

Të nderuara zonja e zotërinj,

A nuk ishte Edvin Rama që vetëm 24 orë pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, urdhëroi deputetët e tij të bllokoni punimet e Parlamentit me rënie borish dhe bilbilash? A nuk ishte ai që në prag të marrjes së ftesës për anëtarësim në NATO, deklaronte se nuk i kemi plotësuar kushtet dhe nisi protestat duke synuar bllokimin e rrugëve nacionale? A nuk ishte po ky keqbërës politik që në ditën e anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, organizoi një tubim proteste në bulevardin "Dëshmorët e Kombit"? A nuk ishte ky njeri që me një sms dërgoi lajmin e turpshëm se shqiptarët janë hajdutë dhe se ata i vodhën orën Presidentit të Shteteve të Bashkuara? A nuk ishte po ky misionar i interesave mafioze që i bëri thirrje të hapur BE-së që të mos hapte negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në BE, madje dërgoi edhe njerëz në Bruksel për këtë qëllim njësoj, siç bëri radhën e fundit në Strasburg?

I kujtova këto episode të shëmtuara, pa pretenduar se i kam thënë të gjitha, për të shpjeguar edhe një herë se pas kërkesës së tij për hapjen e kutive dhe bojkotit absurd të Parlamentit, fshihet strategjia politike e Edvin Ramës për të shkaktuar krizë dhe destabilitet në Shqipëri. Është një taktikë

sa marksiste, aq edhe mafioze, e cila nuk ka të ardhme dhe nuk ka për t'u shpërblyer kurrë nga shqiptarët, pasi, për vite me radhë, ai ka marrë peng Partinë Socialiste anijes të së cilës ka nisur t'i hyjë uji nga të gjitha anët. Përmes lëvizjeve të fundit ai po kërkon një barkë shpëtimi për vete. Në fakt, PS-ja i ka të gjitha mundësitë për të shpëtuar nga lundërthyeri i pandreqshëm Edvin Rama.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Noka!

Zonja Gjonaj, urdhëroni!

Adriana Gjonaj – Falemnderit, zonja Kryetare! Zotërinj deputetë,

Evolucioni i shoqërisë shqiptare, progresi ekonomik dhe perspektiva jonë europiane në këta muaj kanë qenë pre e një agresioni të paimagjineshëm politik, për fat të keq, nga liderhipi i partisë më të madhe opozitare.

Me formulat demagogjike të një hipokrizie të pashoqe, që të sjellin ndërmend historinë tonë famëkeqe të pas 1944-ës, lideri i Partisë Socialiste ka pasur në qendër të këtij agresioni kolonat e demokracisë sonë liberale, Parlamentin dhe zgjedhjet e lira, që i sheh si pengesa për ndërtimin e një shoqërie me drejtim totalitar anarkist. Kjo është një ëndërr e vjetër e kultivuar në kohë dhe e frymëzuar nga ambicet për pushtet absolut, treguar qartë në drejtimin e Qeverisë së vogël të tij në kryeqytet. Kundër demokracisë së përfaqësimit dhe vetë zgjedhjeve të lira, ka qenë gjithë furia e liderhipit të Partisë Socialiste, që bashkon natyrshëm edhe nostalgjik të diktaturës, pinjollë të rinj të ish-kastës komuniste e përfaqësues të biznesit lidhur me ta.

Zotërinj deputetë, në këto dy dekada, Shqipëria, shoqëria shqiptare, në rrugën e saj si demokraci e re, ka bërë përpjekje të mëdha dhe të vështira për krijimin dhe konsolidimin e demokracisë parlamentare të përfaqësimit. Për garantimin e të gjithë parametrevë për procesin e zgjedhjeve të fundit elektorale ne investuam jashtëzakonisht shumë.

Më lejoni të sjell edhe një herë në vëmendjen tuaj, shkurtimisht, përpjekjet gjigante që bëmë për përgatitjen e zgjedhjeve nëpërmjet sistemit krejtësisht dixhital të identifikimit. Kjo është një fitore e madhe dhe një hap përpara si shtet modern me synim rinovimin dhe përmirësimin e të gjithë sistemit elektorale, ku u bënë ndryshime në legjislacionin përkatës, përfshi edhe Kushtetutën. Për zgjedhjet u krijua një strukturë dhe mjete nga më komplekset, mbështetje me burime të mëdha njerëzore dhe

materiale, një proces tejet transparent, i hapur, mjaft lehtë i kontrollueshëm me skaner dhe ekrane, i mirëgarantuar dhe i mbrojtur nga ndërhyrjet e çdo natyre.

Procesi u drejtua me pjesëmarrjen e balancuar të dy forcave të mëdha politike. Ne pranuar sakrificën ekonomike të përfshirjes së dhjetëra mijëra njerëzve si personel zgjedhor i përfaqësimit politik, të pajisur me status ligjor, nivele të plota të gjykimit dhe ankimit të të gjitha organizmave dhe individëve, sipas kodit elektorale, me përfaqësim të njëjtë në drejtim dhe pjesëmarrje nga të dyja polet politike.

Në ndihmë të tyre dhe në mbështetje të sistemit u përfshi aparati i administratës vendore që bëri asistencën e nevojshme të infrastrukturës dhe rrjetit të të dhënave civile. Dhe këtu të mos harrojmë që shumica e kësaj administrate ka qenë në drejtimin e opozitës.

Gjithashtu, kolegë të nderuar, nuk mund të neglizhojmë pjesëmarrjen e mijërave vëzhguesve si ekspertë të zgjedhjeve vendas e të huaj, si dhe mundësitë maksimale të informimit të publikut që ofruan dhjetëra media e qindra gazetarë që ndiqnin procesin në çdo vend. Kjo strukturë kaq e plotë dhe ky rrjet gjigant që, vetëm në burime njerëzore të angazhuara u afrohet shifrave të dhjetëra e mijëra njerëzve, u bënë garant të ligjit, për të realizuar zgjedhje të lira dhe korrekte. Të gjithë këta njerëz ishin gjithashtu nën kontroll tepër të rreptë militant të shumë njerëzve.

Kolegë deputetë, me sakrificë jo të vogël ekonomike ky shtet bëri investime dhe shpenzime aspak proporcionale me mundësitë e ekonomisë sonë. Asnjë shërbim tjetër i këtij vendi, ai i arsimit, i shëndetësisë, i mbrojtjes etj. nuk i kanë këto avantazhe si sistemi i zgjedhjeve të 28 qershorit. Krahasuar me vendet e tjera të mëdha, këto shpenzime kanë qenë me diferencë esenciale deri në disa herë, në ndihmë absolute të sistemit tonë zgjedhor dhe korrektesës së tij. Por pasi sistemi e kaloi me sukses provën e tij, duke u certifikuar nga të gjitha strukturat ligjore vendase dhe të huaja, kreu socialist dhe një grusht njerëzish të lidhur me të me interesa ekonomiko-klanore, që nuk mund të pranin humbjen qoftë dhe për investimin e madh financiar që bënë, në muajt që pasuan tentuan të ndryshojnë rrjedhën natyrale të ngjarjes, duke ndërmarrë një sërë aksionesh manipuluese, duke folur për anomali të procesit dhe mungesë transparence, me synimin e vetëm përmbysjen e legjitimitetit të zgjedhjeve.

Këto aksione, nisur krejtësisht nga interesa personale, synuan vendosjen e precedentit, që dobëson një kusht thelbësor të qeverisjes demokratike: parlamentarizmin. Duke mos qenë me dashje parlamentar, kryepozitari ynë nuk respekton Parlamentin, ai, haptazi, e konsideron atë të pavlefshëm dhe kërkon ta zëvendësojë me logjikën e rrugës.

Të bojkotosh Parlamentin do të thotë të luash me politikën dhe jo ta krijosh atë; do të thotë të tentosh modele që prodhojnë një atmosferë autoritare. Vetëm anarkistët e kundërshtojnë parlamentarizmin. Me bojkotin parlamentar dhe situatën paszgjedhore të krijuar prej tij, kryepozitari që nuk pyet për interesat e Shqipërisë dhe të shqiptarëve arriti të mbetet në fronin e kryetarit dhe të kalërojë përsëri Partinë Socialiste.

Fjalori i tij, veçanërisht pas miratimit të rezolutës së KE-së, po zhvillohet me demagogji dhe hipokrizi, madje herë-herë me trajta komike. Megjithëse kryebashkiaku ynë nuk ua zhdruk dot nga mendja sidomos tiranasve, nga mendja masakrën e orkestruar prej tij me listat e votuesve në zgjedhjet vendore të vitit 2007, ai luan çdo ditë nëpër media rolin e kampionit të standardeve dhe të transparencës.

Me pamjen e të shenjtit transparenco-standard, zoti Rama kërkon t'u mbushë mendjen shqiptarëve se edhe sikur ai vetë dhe Partia Socialiste të kishin fituar në zgjedhjet e 28 qershorit, ai përsëri do t'i binte këmbës e nuk do të futej në Parlament, derisa të rihapeshin të gjitha kutitë dhe të vërtetohej katërçipërisht se nuk ishte vjedhur asnjë votë e nuk ishte shpallur gabimisht fitues. Të nderuar deputetë, e besoni ju këtë përrallë?

Duke përfunduar, i bëj thirrje zotit Rama, grupit parlamentar socialist dhe të gjithë socialistëve të ndershëm që në ngjarjet e ditëve që vijnë të marrin përgjegjësitë e tyre dhe vendimin për t'i kthyer vendit opozitën reale në institucionin ku ajo e ka vendin në këto momente historike për të gjithë shqiptarët.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zonja Gjonaj!
Zoti Dushaj, urdhëroni!

Besnik Dushaj – E nderuar zonja Kryetare,
Të nderuar kolegë deputetë,

E mora fjalën në këtë seancë të Kuvendit të Shqipërisë për të shprehur indinjatën time të thellë dhe të mijëra e mijëra familjeve të përndjekura politikisht në mbarë vendin nga regjimi komunist për dënimin e dytë që u bëri Gjykata Kushtetuese, jo e

Serbisë, jo e Rusisë, por e Shqipërisë, me vendimin që mori, për të shpallur si antikushtetues ligjin e lustracionit ose siç quhet ndryshe "ligji i dosjeve".

Ky ligj ishte miratuar nga maxhoranca qeverisëse në mandatin e kaluar dhe përmbushte një detyrim moral që Parlamenti, institucionet e tjera të vendit dhe mbarë shoqëria shqiptare kanë për të zbardhur të vërtetën e trishtueshme të shtypjes, persekutimit dhe ekzekutimit të mijëra individëve e familjeve nga diktatura gjatë regjimit komunist. Ky ligj synonte të ndante shoqërinë tonë nga e kaluara komuniste, duke u prerë rrugën ish-funksionarëve të lartë të diktaturës dhe ish-bashkëpunëtorëve të Sigurimit të Shtetit, të cilët ishin pjesë e institucioneve demokratike të vendit tonë.

Të nderuar deputetë, disa vende të Europës kanë përjetuar diktatura komuniste, junta ushtarake e fashiste, por regjimi i Enver Hoxhës, për 45 vjet, si asnjë regjim tjetër, i privoi totalisht shqiptarët nga të drejtat dhe liritë themelore, ua ndaloi ato me Kushtetutë, i privoi ata nga fjala e lirë, lëvizja e lirë, besimi te Zoti, i privoi nga pronat e tyre, ekzekutoi pa gjyqe apo me farsa gjyqësore politike dhjetëra e mijëra shqiptarë të pafajshëm, vetëm e vetëm për fjalën e lirë dhe prirjet properëndimore të tyre, burgosi e internoi qindra e mijëra të tjerë, kurse shumicën tjetër të popullatës e shndërroi në skllëvër të vërtetë. Të burgosurit dhe të përndjekurit politikë, bashkë me familjet e tyre, përbëjnë rreth 30% të popullsisë së Shqipërisë.

Të gjithë shqiptarët në përgjithësi, por sidomos të burgosurit dhe të përndjekurit politikë, kanë provuar dhe janë përballur me diktaturën më të egër dhe më kriminale në të gjithë Europën Lindore. Sipas statistikave të Ministrisë së Drejtësisë dhe Institutit të të Përndjekurve Politikë, gjatë regjimit sllavo-komunist, në Shqipëri janë ekzekutuar 5577 burra dhe 450 gra. Për motive politike janë dënuar 26768 burra dhe 7368 gra; kanë vdekur në burgjet politike 1065 vetë; kanë vdekur në internime 7022 vetë; çdo tri ditë është ekzekutuar pa gjyq apo me gjyqe farse një person për motive politike. Çdo dy javë një i burgosur politik vdiste në burg, çdo dy ditë janë internuar tri shqiptarë për motive politike; çdo dy muaj një i burgosur politik është gjymtuar për shkak të keqtrajtimit shtazarake në hetuesi apo në burje.

Duke u njohur me vendimin e Gjykatës Kushtetuese më vjen në mendje 11 gushti i vitit 1988, kur një poet i njohur u lëkund në trekëmbësh

për tri ditë rresht në qytetin e Kukësit. Po të ishte gjallë, poeti Havzi Nela do të festonte 77-vjetorin e lindjes së tij. Ai është një kampion alarmi që ende vazhdon të bjerë për politikën dhe shoqërinë shqiptare.

Të shtiresh sikur nuk po e dëgjon këtë kampion do të thotë të shkelësh me këmbë lirinë e Shqipërisë dhe të shqiptarëve. Paradoksi është se gjykatësi që urdhëroi varjen e poetit Havzi Nela, sot, në Gjykatën Kushtetuese, së bashku me kolegët e tij, në konflikt të hapur interesi, vendosën, si 20 vjet më parë, të mbrojnë dhe të fshehin krimet monstruoze që kanë kryer.

Varja në litar e poetit Havzi Nela është një apel për pastrimin e institucioneve shtetërore nga xhelatët e diktaturës komuniste. Aktualisht, në Prokurorinë e Përgjithshme, prokuroritë e rrethve gjyqësore, gjykatat e të gjitha niveleve, institucionet kushtetuese, duke filluar nga Gjykata Kushtetuese, deri tek Avokati i Popullit, si dhe në disa institucione të tjera publike, gjyqtarët, prokurorët, si dhe zyrtarë të lartë kanë marrë pjesë aktive në gjurmimin, arrestimin, hetimin, torturimin, gjykimin, dënimin dhe ekzekutimin e të dënuarve me vdekje gjatë regjimit komunist.

Në mungesë të ligjit, unë mendoj se aktualisht ka filtra që ne mund t'i përdorim për të penguar emërimin e këtyre xhelatëve në institucione. I pari është Presidenti i Republikës, duke përzgjedhur me kujdes kandidatët për në Gjykatën e Lartë, në Gjykatën Kushtetuese, si dhe në drejtimin e institucioneve të tjera shtetërore. I dyti, ky Kuvend i nderuar, duke mos votuar asnjë person që ka marrë pjesë në gjurmimin, arrestimin, hetimin, dënimin dhe ekzekutimin e shqiptarëve të pafajshëm për motive politike.

Është rasti t'ju kujtoj, të nderuar deputetë, që sa më parë të përmbushim detyrimet që rrjedhin prej miratimit që Kuvendi i Shqipërisë i ka bërë në vitin 2006 një rezolute të Këshillit të Europës për dënimin e krimeve të komunizmit. Kjo rezolute parashikon një sërë procesesh, si: dënimin e krimeve të komunizmit, dënimin e figurës së Enver Hoxhës, ngritjen e institutit të posaçëm për rehabilitimin e viktimave, madje dhe një fond të veçantë për gjetjen dhe identifikimin e eshtrave të të zhdukurve gjatë regjimit komunist, që në Shqipëri numërohen me mijëra. Unë mendoj se, me gjithë pengesat artificiale që janë krijuar, është detyrim moral dhe ligjor për klasën politike shqiptare dhe sidomos për këtë maxhorancë që qeveris sot, të

respektojë dhe të bëjë çdo përpjekje për të realizuar në praktikë të drejtën njerëzore të viktimave të komunizmit, që u ekzekutuan barbarisht, pa gjyqe apo me gjyqe false, natën, nëpër errësirë, vetëm për fjalën dhe mendimin e lirë.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit!

Mbyllim pikën e parë të rendit të ditës.

Duke marrë shkas nga diskutimi i fundit, unë do të ftoja deputetët Mark Marku, Florian Mima dhe Adriana Gjonaj, meqenëse në Byronë e Kuvendit është marrë një vendim që Kuvendi i Shqipërisë të japë çmimin “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut” dhe meqë para një jave ka vdekur Pashko Gjeçi, përkthyesi më i madh i kombit tonë, i Iliadës, i Dantes, i Gëtes dhe i të tjerëve, të përgatiten për t'i dhënë këtë çmim, jo vetëm si përkthyes, për vlerat e tij të mëdha, por edhe për faktin se ishte kaq i madh dhe kaloi vite të tëra të jetës në burgjet e diktaturës. Ky çmim u është kërkuar nga Kuvendi dy herë institucioneve përkatëse, por nuk i është dhënë, ndaj Kuvendi do ta japë vetë kësaj radhe këtë çmim.

Kalojmë te pika e dytë e rendit të ditës: miratimi i procesverbalit të seancës plenare, datë 28.01.2010. Ka ndokush ndonjë vërejtje? Nuk ka. Miratohet.

Kalojmë te pika e tretë e rendit të ditës: miratimi i kalendarit 3-javor të punimeve të Kuvendit (8-25 shkurt 2010). Sot është bërë mbledhja e Konferencës së Kryetarëve, e cila e ka miratuar këtë kalendar në unanimitet, ndaj, bazuar në Rregulloren e Kuvendit, unë ju vë në dijeni.

Ka ndokush ndonjë shtesë? Nuk ka. Falemnderit! Miratohet.

Kalojmë te pika e katërt: projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9363, datë 24.03.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”.

Në emër të Komisionit të Sigurisë Kombëtare, zoti Maliqi, urdhëroni!

Lefter Maliqi - Falemnderit, zonja Kryetare!

Komisioni për Sigurinë Kombëtare shqyrtoi projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9363, datë 24.03.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”.

Në mbledhjen e Komisionit të Sigurisë mori pjesë edhe ministri i Mbrojtjes, Arben Imami. Në këtë projektligj autoritetet kompetente për dërgimin e njësisive ushtarake në operacionet jashtë vendit

duhet të përcaktojnë misionin dhe mandatin e këtyre forcave si dhe rregullat dhe angazhimet e tyre. Këtë përcaktim duhet ta bëjë Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë. Vendimi për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në veprimtaritë ushtarake jashtë vendit, në kuadrin e NATO-s apo BE-së, merret, deri në nivel kompanie, nga ministri i Mbrojtjes dhe mbi nivel kompanie me vendim të Këshillit të Ministrave.

Për organizimin dhe pjesëmarrjen e forcave ushtarake të huaja në stërvitjet e përbashkëta, të organizuara dhe të drejtuara nga NATO-ja, BE-ja apo vende të tjera, në territorin e Republikës së Shqipërisë, projektligji parashikon që për njësi ushtarake deri në 500 veta, pranimit bëhet me vendim të ministrit të Mbrojtjes, për njësi ushtarake nga 500-1000 veta, me vendim të Këshillit të Ministrave, kurse mbi 1000 veta me ligj nga Kuvendi. Ky ndryshim është propozuar për të lehtësuar procedurat e vendimmarrjes për stërvitjen e forcave të huaja ushtarake në stërvitje të përbashkëta ndërkombëtare dhe në veprimtaritë e organizuara ose të drejtuara nga NATO-ja, BE-ja apo vende të tjera në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Të gjitha ndryshimet në këtë projektligj parashikojnë një lehtësim të procedurave të vendimmarrjes së autoriteteve kompetente të Republikës së Shqipërisë për dërgimin e trupave ushtarake shqiptare në operacione e veprimtari të ndryshme ushtarake, si dhe për pjesëmarrjen e forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Komisioni, duke vlerësuar rëndësinë e madhe që ka ky projektligj në kuadrin e përafrimit me legjislacionin e vendeve të NATO-s, në përfundim të mbledhjes vendosi ta miratojë atë në parim dhe nen për nen, duke saktësuar që në bazën ligjore të projektligjit, krahas neneve 78 dhe 83, pika 1, të shtohet edhe neni 12, pika 3, i Kushtetutës. Me këtë saktësim komisioni u shpreh dakord që projektligji të kalojë për miratim në seancë plenare.

Zonja Kryetare, po ju kërkoj leje për një shtesë të vogël.

Meqenëse kohët e fundit spikerët e PS-së, konkretisht "Gjinua", servili i kryetarit të radhës së PS-së, i cili mezi numëron kokrrat e fikut, ka filluar kohët e fundit dhe bën llogaritë e buxhetit të qeverisjes së PD-së, duke treguar nëpër media shpenzimet për emërimin e disa zëvendësministrave në të gjitha ministritë, duke i krahasuar ato me miellin, qumështin, vajin, fiqtë, e me radhë, unë

doja t'i thosha këtij "Coli të tartarukave" se PD-ja, në krahasim me forcën e tij politike, i zbaton të gjitha rregullat e lojës brenda forcave politike të koalicionit, kurse forca e tij ka treguar, jo vetëm brenda llojit, por edhe me forcat e tjera të majta, pabesinë ndaj forcave në bashkëpunim. Ai harron që ne, si deputetë të Kuvendit Popullor, para ca kohësh kaluam edhe disa ndryshime, ku na u hoqën shumë të drejta për të mirën e votuesve tanë, duke filluar që nga shpenzimet për shoferë, për sekretare nëpër zona dhe me radhë. Unë do ta ftoj këto deputet dhe të tjerët të vijnë këtu, si herët e para. Le të vijë me fizarmonikë, me pipëza, le të vijë me copa buke, le të vijë të përballet dhe të flasë për interesat e vendit dhe të heqë dorë nga shpifjet monstruoze. Të vijë dhe të përballet për të gjitha gjërat, duke filluar që nga zakoni i tij i vjetër në qytetin e Beratit, në moshën e vogël e deri tani dhe të tregojë se çfarë ka bërë për banorët e Beratit. Le që duhet të kthejë edhe makinën, se po bredh akoma me makinën e Kuvendit.

Jozefina Topalli – Falemnderit!

Ka pyetje për projektligjin? Nuk ka. Diskutime? Nuk ka.

Kalojmë në shprehjen e grupeve.

Në emër të grupit të LSI-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Në emër të grupit të PD-së.

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Kalojmë te projektligji "Për disa shtesa në ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" të ndryshuar".

Në emër të komisionit përgjegjës, zoti Ilir Bano, urdhëroni!

Ilir Bano – Falemnderit, zonja Kryetare!

Miratimi i ligjit "Për disa shtesa në ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar" dhe kryerja e një pune voluminoze në zbatimin e tij ka qenë një nga arritjet e shënuara të Qeverisë dhe shumicës parlamentare në legjislaturën e kaluar. Në vazhdimësi, duke pasur parasysh rëndësinë dhe ndjeshmërinë që ky proces ka për shoqërinë shqiptare, në programin elektorale për zgjedhjet e 28 qershorit u premtua se pagesa për kthimin në pronësi dhe për legalizim, sado e vogël që ishte parashikuar, të bëhej në një pjesë të konsiderueshme të saj me bono ose lekë

privatizimi.

Kjo masë jo vetëm do të lehtësonte financiarisht familjet që kishin ndërtuar banesa pa leje, pra të përfshira drejtpërsëdrejti në këtë proces, por, së pari, do të shpejtonte vënien në eficiencë në tregun legal të kësaj pasurie të madhe kombëtare. Së dyti, do të ndikonte pozitivisht në rritjen e vlerës së bonove dhe të lekëve të privatizimit, që ende dhjetëra mijëra persona në vend nuk kanë gjetur mundësinë për t'i vënë në përdorim, për arsye të ndryshme.

Faza e parë e këtij premtimi u zbatua me shtesat dhe ndryshimet në ligjin e legalizimeve që u bënë nëpërmjet ligjit 1169, datë 22 tetor 2009. Ky ligj rregullon kryesisht mënyrën e pagesës, nëpërmjet përdorimit të bonove të privatizimit deri në 50%, në rastet kur parcela ndërtimore është mbi limitet e përcaktuara për çdo rast në nenet 19,20,21 të ligjit bazë dhe duhej paguar me çmimin e tregut, si edhe përdorimin e të ardhurave nga transferimi i pasurisë.

Projektligji që na ka ardhur për shqyrtim i bën zgjidhje të plotë premtimit elektoral që thashë pak më lart. Kjo mënyrë pagese, pra, deri në 50% të vlerës me bono privatizimi, shtrihet edhe për parcelat ndërtimore jashtë vijave të verdha, me sipërfaqe deri në 500 metra katrorë, pikat a,b,c, ç, d të nenit 19, dhe për parcelat ndërtimore të vendbanimeve e ndërtimeve informale brenda vijave të verdha, me sipërfaqe deri në 300 metra katrorë, pikat a, b dhe c të nenit 20 të ligjit bazë.

Përveç sa më sipër, ne shtruan në komision edhe një çështje tjetër që lidhet me këtë projektligj. Në ligjin që cituam në fillim, ligjin 1069, datë 22 tetor 2009, u përfshinë në skemën e pagesës me bono privatizimi deri në masën 50% edhe sipërfaqet e trojeve të zëna me shtesa anësore pa leje, në ndërtimet me leje, kur sipërfaqja e tyre ishte mbi 100 metra katrorë dhe duhej paguar sipas vlerës së tregut, pika ç e nenit 21 të ligjit bazë.

Në projektligjin e sotëm, që na ka ardhur nga Qeveria, nuk përfshihej shtrirja e kësaj skeme edhe për rastet e tjera të parashikuara në nenin 21, kur sipërfaqja e truallit është nën 100 metra katrorë, pikat a, b dhe c të nenit 21. Pas diskutimit dhe rënies dakord edhe të përfaqësuesve të Qeverisë, që ishin prezentë në komisionin tonë, propozojmë amendimet përkatëse në përputhje me frymën e ligjit, sipas premtimit të bërë dhe sipas asaj që është bërë në rastet e parashikuara më lart, në nenet 19 dhe 20.

Ne propozojmë që ligji të kalojë për miratim me ndryshimet e bëra.

Ju falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Bano!

Në emër të Komisionit të Ekonomisë, urdhëroni, zoti Spaho!

Edmond Spaho – Falemnderit, zonja Kryetare!

Komisioni i Ekonomisë dhe Financave, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi projektligjin “Për disa shtesa në ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar”, paraqitur nga Këshilli i Ministrave.

Projektligji i paraqitur për shqyrtim në komision vjen në vazhdimësi të ndryshimeve të bëra në këtë ligj në tetor të vitit 2009. Komisioni gjykon se projektligji i propozuar do të ketë një impakt pozitiv në ecurinë e procesit të legalizimit, urbanizimit dhe integritimit të ndërtimeve pa leje, prandaj e miratoi atë me të gjitha votat e anëtarëve të pranishëm në mbledhje, duke propozuar edhe ndryshimet e mëposhtme për ndërtimet jashtë vijës së verdhë:

1. Për të gjitha segmentet nga 0-500 metër katror, pagesa e tarifës të bëhet deri në masën 70% me letra me vlerë dhe 30% me para në dorë. Për sipërfaqet mbi 500 metër katror, pagesa të bëhet sipas çmimit të tregut, me para në dorë.

2. Për ndërtimet brenda vijës së verdhë, ku kufiri ndarës është 300 metër katror, për të gjitha segmentet deri në 300 metër katror, pagesa të bëhet deri në masën 70% me letra me vlerë dhe 30% me para në dorë. Për sipërfaqen mbi 300 metër katror, komisioni mendon që të vazhdojë të jetë i vlefshëm përcaktimi i deritanishëm në ligj, duke likuiduar 50% të tarifës me letra me vlerë dhe 50% me para.

Një ndryshim i tretë është ai që vjen në formën e një amendamenti në nenin 21 për shtesat e pallateve, për sipërfaqet mbi 100 m² pagesa të bëhet me çmimin e tregut, me para në dorë.

Ndryshimi i fundit është ndryshimi në dispozitën kalimtare, sipas së cilës përfitimet e këtyre ndryshimeve do t'i gëzojnë edhe ata të cilët e kanë mbyllur procesin e legalizimit para hyrjes së ndryshimeve të propozuara në fuqi.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Spaho!

Ka pyetje? Nuk ka. Diskutime? Nuk ka.

Në emër të Grupit Parlamentar të LSI-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të PD-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Urdhëroni zoti Igli Cara, për procedurë!

Igli Cara – Do të më falni që i kthehem edhe një herë këtij projektligji, por do të thosha që këta të zgjedhur që flasin në emër të ligjit dhe të Kushtetutës para fasadës së PS-së është mirë të zbatonjë ligjin dhe të dorëzojnë automjetet e tyre, që i mbajnë në mënyrë të parregullt që nga data 20 nëntor e vitit 2009. Pra, e kam fjalën për deputetët që i mbajnë automjetet në mënyrë të paligjshme, si: Arta Dade, Ermelinda Meksi apo Erion Braçe. Ne kërkojmë që ligji të zbatohet nga qytetarët e thjeshtë e jo më nga ata që janë të zgjedhur nga populli.

Jozefina Topalli – Keni shumë të drejtë, sepse mbajtja e makinave nga ata që s'janë deputetë është vjedhje e pronës publike. Atyre u është dërguar një letër dhe, në fakt, do të merren masa të tjera sipas ligjit.

Kalojmë te projektligji tjetër "Për shpalljen e moratoriumit për mjetet motorike lundruese të Republikës së Shqipërisë".

Urdhëroni, zoti Ngresi, në emër të komisionit përgjegjës, që në këtë rast është Komisionit për Sigurinë Kombëtare!

Vasillaq Ngresi – Falemnderit, zonja Kryetare!

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, në mbledhjen e datës 26 janar 2010, shqyrtoi projektligjin "Për shpalljen e moratoriumit për mjetet motorike lundruese të Republikës së Shqipërisë", moratorium që është i domosdoshëm dhe lind për efekt të mbarimit të efekteve ligjore të moratoriumit të mëparshëm 3-vjeçar, njëkohësisht bazuar edhe në logjistikën dhe në infrastrukturën që ka Policia Kufitare Detare.

Të gjithë deputetët vunë në pah efektet pozitive të moratoriumit të mëparshëm për parandalimin dhe zbulimin e trafikeve të paligjshme, të qenieve njerëzore, të drogave apo të armëve. Njëkohësisht, komisioni e diskutoi dhe është dakord me kreu projektligjin e paraqitur nga Këshilli i Ministrave, por u kërkon deputetëve të seancës t'i kushtojnë një vëmendje më të madhe nenit të parë, paragrafi i dytë, sepse aty përjashtohen mjetet lundruese turistike dhe mjetet e sporteve të ujit.

Jozefina Topalli – Falemnderit!

Kur të vijmë te neni 1, do të ndalemi dhe do të diskutojmë.

Ka pyetje të tjera? Nuk ka. Diskutime? Nuk ka. Kalojmë në mendimin e grupeve.

Në emër të Grupit Parlamentar të LSI-së?
(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të PD-së?
(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Kalojmë te projektligji "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

Urdhëroni, zoti Shehu!

Tritan Shehu – Falemnderit, zonja Kryetare!

Komisioni ynë shqyrtoi projektligjin "Për mbrojtjen nga diskriminimi", ligj i paraqitur nga një grup deputetësh dhe dëgjoi mendimet e grupeve të tjera të interesit, të Avokatit të Popullit, të dikastereve përkatëse, të shoqatave të ndryshme që merren me të drejtat e njeriut dhe mendon se ky është një ligj mjaft i rëndësishëm, i cili, realisht, është brenda kuadrit të Kushtetutës sonë, është brenda kuadrit të legjislacionit tonë dhe tenton të rikonfirmojë dhe të institucionalizojë mbrojtjen nga çdo lloj diskriminimi të popullatës shqiptare dhe të atyre që janë rezidentë në Shqipëri.

Ky ligj synon të garantojë mbrojtjen nga diskriminimet e përgjithshme raciale, shëndetësore, seksuale, të moshës, të gjinisë, të kombësisë, të kulturës e të tjera, pra duke rikonfirmuar elemente të tjera që ne i gjejmë të vendosura në Kushtetutë apo në institucionin tonë.

Ky ligj është i rëndësishëm, sepse është në përputhje të plotë me akte të ndryshme ndërkombëtare, veçanërisht me Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut, që është akti më i rëndësishëm në këtë drejtim, sepse edhe Kushtetuta shqiptare i referohet pikërisht këtij akti.

Ky ligj, i cili u diskutua me shumë seriozitet, gjeti miratim të plotë nga komisioni, gjeti mirëkuptim të plotë nga ata me të cilët u konsultuam dhe komisioni vendosi njëzëri që të krijohet institucioni i inspektoratit shtetëror që merret dhe kontrollin në këtë drejtim.

Ky ishte një element që pati diskutime dhe që realisht kërkon buxhet shtesë dhe me mbështetjen e Këshillit të Ministrave u vendos që të vendoset kjo formë kontrolli për zbatimin e këtij ligji, e ngjashme me atë të Avokatit të Popullit.

Nga ana tjetër, materiali ynë dhe mendimet tona si komision janë të njëjta dhe përputhen edhe me mendimet e vërejtjet që ka bërë Komisioni për Integrimin në dy pika ku ka pasur diskordancë. Pak më parë unë diskutova me kryetarin Komisionit për Integrimin dhe ramë dakord të pranojmë variantin e Komisionit për Çështjet Sociale. Prandaj vërejtjet që Komisioni për Çështjet Sociale ka paraqitur janë

të njëjta me vërejtjet e Komisionit për Integrimin.

Kështu që unë i ftoj deputetët ta votojnë këtë ligj dhe ta miratojnë së bashku me vërejtjet e paraqitura nga Komisioni për Çështjet Sociale.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Shehu!

Në emër të Komisionit për Integrimin, zoti Kadilli, urdhëroni!

Fatbardh Kadilli – Falemnderit, zonja Kryetare!

Komisioni për Integrimin, në cilësinë e komisionit përgjegjës, mori në shqyrtim projektligjin. Në mbledhjet e komisionit kanë asistuar përfaqësues të shoqërisë civile, të misionit EURALIUS, të Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe pas shqyrtimit nen për nen, vërejtjet për nenet i janë bërë prezente komisionit përgjegjës.

Komisioni për Integrimin Europian është i mendimit se ky ligj është në përputhje të plotë me legjislacionin parësor europian, me konventat kryesore, si dhe me legjislacionin dytësor dhe direktivat që kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë të individëve të të gjitha llojeve tek të cilët mendohet se mund të ushtrohet diskriminim (nuk po lexoj një listë të tyre).

Ky është një projektligj që ka për qëllim të parandalojë të gjitha format e diskriminimit dhe në të njëjtën kohë nuk është se ndalon çdo lloj trajtimi të ndryshëm për sa kohë ekzistojnë arsye të forta objektive për një gjë të tillë. Projektligji propozon, gjithashtu, komisionerin, i cili është instrument i fuqishëm efektiv për të realizuar garancitë e nevojshme për mbrojtjen e individëve apo grupeve të cilat perceptojnë diskriminim.

Nga ana tjetër, doja të shtoja se neve, si shoqëri, një projektligj i tillë na bën nder, pasi jemi një popull, jemi një shoqëri që kemi në memorien tonë forma të ndryshme diskriminimi. Jo më larg se 100 vjet më parë diskriminoheshim për gjuhën, diskriminoheshim për identitetin kombëtar, jemi diskriminuar për rreth 50 vjet për arsye politike dhe të besimit fetar, ndaj është në nderin tonë që sot t'i japim të drejtën dhe të mbrojmë këdo nga praktikat diskriminuese, pavarësisht se çfarë orientimi ka.

Shpreh keqardhjen që opozita përsëri nuk është në Parlament, megjithëse është një ligj, i cili, më tepër se maxhorancën, mbron opozitën. Kujtoj që edhe në vitin 1993, kur është kaluar paketa kushtetuese për të drejtat e njeriut, opozita ka munguar dhe nuk ka tentuar të marrë në mbrojtje vetveten dhe individët e saj.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Kadilli!

Ka diskutime të tjera? Nuk ka.

Kalojmë në mendimin e grupeve.

Në emër të Grupit Parlamentar të LSI-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të PD-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Kalojmë te projektligji “Për miratimin e kontratës së lidhur ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqërisë “EUROCOPTER” për furnizimin me 5 helikopterë të mesëm shumërolësh”.

Zoti Skuqi, urdhëroni në emër të komisionit përgjegjës, që është Komisioni për Sigurinë Kombëtare.

Luan Skuqi – Falemnderit, zonja Kryetare!

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, në mbledhjen e datës 2 shkurt 2010, shqyrtoi projektligjin “Për miratimin e kontratës së lidhur ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqërisë “EUROCOPTER” për furnizimin me 5 helikopterë të mesëm shumërolësh”. Në këtë mbledhje kishte ardhur stafi përgjegjës i Ministrisë së Mbrojtjes dhe vetë ministri, zoti Imami, të cilët shpjeguan nevojën dhe domosdoshmërinë që kishte Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat tona të Armatosura, në kuadër të modernizimit, për blerjen e këtyre helikopterëve, të cilët kanë një rol shumëplanësh si në transportin e forcave të Armatosura, si mjete shpëtimi në raste emergjencash dhe ndihme mjekësore, ashtu edhe për transportin e personave VIP.

Gjithashtu, nevoja e blerjes së këtyre helikopterëve ishte e domosdoshme për arsye se helikopterët që disponon tani Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat tona të Armatosura janë të viteve '65-'70 dhe nuk janë të aftë për të ndërvepruar me njësitë ushtarake të NATO-s, ç'ka bën që në kushtet kur jemi anëtarë me të drejta të plota në NATO, ata të dalin jashtë funksionit.

Komisioni vërejtë se procedurat e prokurimit të ndjekura nga strukturat përkatëse të Ministrisë së Mbrojtjes janë në përputhje me ligjin dhe me vendimin nr.1403 të Këshillit të Ministrave për rastin e blerjeve të veçanta që bën Ministria e Mbrojtjes.

Gjithashtu, vumë në dukje se për realizimin e këtij prokurimi është marrë edhe ekspertiza e NAMS-as, një organizëm i specializuar pranë NATO-s, që jep ndihmë dhe ekspertizë për blerjet e

ndryshme në vendet që janë anëtare të NATO-s.

Gjithashtu, pranë Komisionit të Prokurimeve ka qëndruar edhe Avokati i Shtetit.

Komisioni, duke parë që prokurimi është bërë me transparencë dhe në zbatim të ligjit dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave, si dhe duke parë nevojën e domosdoshme për modernizimin e ushtrisë shqiptare, vendosi që ta aprovojë projektligjin dhe ta kalojë në seancë plenare.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit!

Dëshiron ndonjë tjetër të shtojë diçka për këtë projektligj? Ka pyetje? Nuk ka. Diskutime? Nuk ka.

Kalojmë në mendimin e grupeve.

Në emër të Grupit Parlamentar të LSI-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të PD-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Tani do ta ndërpresim seancën për 5 minuta.

(Pas pushimit)

Jozefina Topalli - Rihapim seancën.

Hapim votimin për kuorumin.

Mbyllim votimin.

Janë 72 deputetë të pranishëm.

Kalojmë te votimi i projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9363, datë 24.03.2005 "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit".

Hapim votimin në parim me elektronikë.

Mbyllim votimin.

Janë 72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton në parim projektligjin.

Kalojmë te votimi nen për nen, sipas variantit të Qeverisë.

Kush është dakord me nenin 1? Falemnderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2? Falemnderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 3? Falemnderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 4? Falemnderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 5? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 6? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 7? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 8? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 9? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 10? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 11? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Hapim votimin në tërësi me elektronikë.

Mbyllim votimin.

Janë 72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton edhe në tërësi projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9363 datë 24.03.2005 "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit".

Kalojmë te votimi i projektligjit "Për disa shtesa në ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar".

Hapim votimin në parim me elektronikë.

Mbyllim votimin.

Janë 72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton në parim projektligjin.

Kalojmë te votimi nen për nen.

Urdhëroni, zoti Spaho!

Edmond Spaho – Zonja Kryetare, ne kemi rënë dakord me Komisionin për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, si dhe me Ministrinë e Financave që projektligji të votohet me propozimet e Komisionit të Ekonomisë dhe me amendamentin që është paraqitur.

Jozefina Topalli - Po, më janë paraqitur propozimet dhe i kam në dosje.

Atëherë, do ta votojmë projektligjin nen për nen me karton, sipas propozimit të Komisionit të

Ekonomisë.

Kush është dakord me nenin 1? Falemnderit!
Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2? Falemnderit!
Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 3? Falemnderit!
Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Hapim votimin në tërësi me elektronikë.

Mbyllim votimin.

Janë 72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton edhe në tërësi projektligjin "Për disa shtesa në ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar".

Kalojmë te votimi i projektligjit "Për shpalljen e moratoriumit për mjetet motorike lundruese të Republikës së Shqipërisë". Në këtë projektligj kishte një propozim në nenin 3.

Hapim votimin në parim me elektronikë.

Mbyllim votimin.

Janë 72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton në parim projektligjin.

Kalojmë te votimi nen për nen.

Kush është dakord me nenin 1? Falemnderit!
Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2? Falemnderit!
Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Fjalën e ka zoti Metalla për nenin 3.

Osman Metalla – Zonja Kryetare, në nenin 3 kemi propozuar të shtohet edhe pika "d", me anë të së cilës bëjmë edhe përjashtimin e motorëve të ujit nga ky moratorium.

Jozefina Topalli- Atëherë, kush është dakord me nenin 3, me amendamentin e propozuar? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 4? Urdhëroni, zoti Basha!

Lulzim Basha – E mora fjalën vetëm për një sqarim. Kjo pikë është pranuar, pasi kemi rënë dakord me logjikën që motorët e ujit për nga kapaciteti dhe forca e tyre nuk përbëjnë subjekt të drejtpërdrejtë të këtij ligji. Natyrisht që mbetet një çështje shqetësuese për sa i përket regjimit të lëvizjes së tyre, për të cilën do të propozojmë masa të tjera rregulluese. Pra, shqetësimi i ligjshëm për

rregullimin e lëvizjes së motorëve të ujit, veçanërisht gjatë sezonit turistik, do të trajtohet në një masë tjetër që do të propozohet nga Qeveria.

Falemnderit!

Jozefina Topalli- Kush është dakord me nenin 4? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 5? Falemnderit!
Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 6? Falemnderit!
Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 7? Falemnderit!
Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Hapim votimin në tërësi me elektronikë.

Mbyllim votimin.

Janë 72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton edhe në tërësi projektligjin "Për shpalljen e moratoriumit për mjetet motorike lundruese të Republikës së Shqipërisë".

Kalojmë te votimi i projektligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

Hapim votimin në parim me elektronikë.

Mbyllim votimin.

Janë 70 vota pro, asnjë kundër, 1 abstenim.

Kuvendi miraton në parim projektligjin.

Kalojmë te votimi nen për nen

Kush është dakord me nenin 1, bashkë me vërejtjet e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë për zëvendësim fjalësh dhe vërejtjesh të Komisionit të Integritimit?

Urdhëroni, zoti Shehu!

Tritan Shehu – Falemnderit, zonja Kryetare!

Për nenin 1 kemi rënë dakord me Komisionin e Integritimit që do të merren parasysh vetëm vërejtjet e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë. Për nenet e tjera janë vërejtjet e dy komisioneve. Edhe për nenin 24, gjithashtu, është vetëm vërejtja e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

Jozefina Topalli- Po, e kuptova. Atëherë do të votojmë nen për nen, bashkë me vërejtjet e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

Kush është dakord me nenin 1? Falemnderit!
Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2? Falemnderit!
Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.
Kush është dakord me nenin 3? Falemnderit!
Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.
Kush është dakord me nenin 4? Falemnderit!
Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.
Kush është dakord me nenin 5? Falemnderit!
Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.
Kush është dakord me nenin 6? Falemnderit!
Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.
Kush është dakord me nenin 7? Falemnderit!
Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.
Kush është dakord me nenin 8? Falemnderit!
Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.
Kush është dakord me nenin 9? Falemnderit!
Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.
Kush është dakord me nenin 10? Falemnderit!
Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.
(Vazhdon e njëjta procedurë miratimi nga neni 11 -19.)
Kush është dakord me nenin 20, sipas variantit të komisionit? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.
Kush është dakord me nenin 21? Falemnderit!
Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.
Kush është dakord me nenin 22? Falemnderit!
Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.
Kush është dakord me nenin 23? Falemnderit!
Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.
Kush është dakord me nenin 24 sipas variantit të komisionit? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.
Kush është dakord me nenin 25? Falemnderit!
Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.
(Vazhdon e njëjta procedurë miratimi nga neni 26-38.)
Kush është dakord me nenin 39, te dispozitat kalimtare? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim?

Nuk ka.
Miratohet.
Kush është dakord me nenin 40? Falemnderit!
Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.
Kush është dakord me nenin 41? Falemnderit!
Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.
Kush është dakord me nenin 42? Falemnderit!
Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.
Hapim votimin në tërësi me elektronikë.
Mbyllim votimin.
Janë 71 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.
Kuvendi miraton edhe në tërësi projektligjin "Për mbrojtjen nga diskriminimi".
Kalojmë te votimi i projektligjit "Për miratimin e kontratës së lidhur ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqërisë "EUROCOPTER" për furnizimin me 5 helikopterë të mesëm shumërolësh".
Hapim votimin në parim me elektronikë.
Mbyllim votimin.
Janë 72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.
Kuvendi miraton në parim projektligjin.
Kalojmë te votimi nen për nen me karton.
Kush është dakord me nenin 1? Falemnderit!
Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.
Kush është dakord me nenin 2? Falemnderit!
Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.
Kush është dakord me nenin 3? Falemnderit!
Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.
Kush është dakord me nenin 4? Falemnderit!
Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.
Hapim votimin në tërësi me elektronikë.
Mbyllim votimin.
Janë 72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.
Kuvendi miraton edhe në tërësi projektligjin "Për miratimin e kontratës së lidhur ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqërisë "EUROCOPTER" për furnizimin me 5 helikopterë të mesëm shumërolësh".
Tani do të kalojmë te dosja tjetër e votimit të projektligjeve të seancës së kaluar.
Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjës

dhe Hercegovinës për ripranimin e personave me qëndrim të parregullt”.

Hapim votimin në parim me elektronikë.

Mbylлим votimin.

Janë 72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton në parim projektligjin.

Kalojmë te votimi nen për nen me karton.

Kush është dakord me nenin 1? Falemnderit!
Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2? Falemnderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Hapim votimin në tërësi me elektronikë.

Mbylлим votimin.

Janë 72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton edhe në tërësi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës për ripranimin e personave me qëndrim të parregullt”.

Kalojmë te votimi i projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare për përgjegjësinë civile për dëmet e shkaktuara nga ndotja, nga karburanti i depozitave të vitit 2001”.

Hapim votimin në parim me elektronikë.

Mbylлим votimin.

Janë 72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton në parim projektligjin.

Kalojmë te votimi nen për nen me karton.

Kush është dakord me nenin 1? Falemnderit!
Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2? Falemnderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Hapet votimi me elektronikë, në tërësi.

Mbylлет votimi.

72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton në tërësi projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën ndërkombëtare për përgjegjësinë civile për dëmet e shkaktuara nga ndotja”.

Kalojmë te votimi i aktit normativ nr. 10, datë 23.12.2009 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10, datë 27.11.2008, “Për buxhetin e vitit 2009”, të ndryshuar.”

Këtu ka vetëm një votim.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbylлет votimi.

72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton me 72 vota aktin normativ “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10, datë 27.11.2008, “Për buxhetin e vitit 2009”, të ndryshuar.”

Kalojmë te votimi i projektligjit “Për festat zyrtare dhe ditët përkujtimore”, të ndryshuar.”

Hapet votimi me elektronikë, në parim.

Mbylлет votimi.

72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton në parim projektligjin.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Kush është dakord me nenin 1? Falemnderit!
Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2? Falemnderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Hapet votimi me elektronikë, në tërësi.

Mbylлет votimi.

72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton në tërësi projektligjin “Për festat zyrtare dhe ditët përkujtimore”, të ndryshuar.”

Kalojmë te projektligji “Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar”, të ndryshuar.”

Hapet votimi me elektronikë, në parim.

Mbylлет votimi.

72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton në parim projektligjin.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Kush është dakord me nenin 1? Falemnderit!
Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2? Falemnderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 3? Falemnderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 4? Falemnderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 5? Falemnderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 6? Falemnderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

(Nga neni 7 deri në nenin 13 ndiqet e njëjta procedurë e votimit.)

Hapet votimi me elektronikë, në tërësi.

Mbylлет votimi.

72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton edhe në tërësi projektligjin “Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar”, të ndryshuar.”

Kalojmë te projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”.

Hapet votimi me elektronikë, në parim.

Mbyllet votimi.

72 vota pro. Nuk ka kundër. Nuk ka abstenim.

Kuvendi e miraton në parim këtë projektligj. Kalojmë te votimi nen për nen, bashkë me ndryshimet e bëra nga Komisioni i Ekonomisë.

Kush është dakord me nenin 1? Falemnderit! Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2? Falemnderit! Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka. Miratohet.

Kush është dakord me nenin 3? Falemnderit! Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 4? Falemnderit! Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 5? Falemnderit! Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 6? Falemnderit! Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Hapim votimin me elektronikë, në tërësi.

Mbyllet votimi.

72 vota pro. Nuk ka kundër. Nuk ka Abstenim.

Kuvendi e miraton në parim këtë projektligj.

Kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës: kërkesë për interpelancë me Zëvendëskryeminstriin dhe ministriin e Punëve të Jashtme, zotin Ilir Meta, kërkuar nga 2 deputetë.

Bazuar në Rregulloren e Kuvendit, deputeti parashtron interpelancën deri në 7 minuta. Anëtari i Këshillit të Ministrave ka 20 minuta kohë, deputeti ka përsëri 15 minuta kohë në dispozicion dhe, më vonë, nëse dëshirojnë të dyja palët, mund të përdorin edhe nga 3 minuta të tjera.

Kërkesa është bazuar në nenin 96, pikat 1 dhe 3 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, ku kërkohet që zoti Zëvendëskryeminstër të paraqitet në interpelancë në Kuvend për të sqaruar disa çështje që kanë të bëjnë me informimin për problemin e liberalizimit të vizave.

Zoti Sterkaj, urdhëroni!

Paulin Sterkaj – Falemnderit, zonja Kryetare! I nderuar zoti Kryeminstër,

Të nderuar deputetë,

Mbështetur në nenin 96, pikat 1, dhe 3 të Rregullores së Kuvendit, kërkoj nga zoti Ilir Meta, Zëvendëskryeminstër dhe ministër i Punëve të Jashtme, të paraqitet në interpelancë në Kuvend për të sqaruar disa çështje që kanë të bëjnë me informimin për liberalizimin e vizave. Shqipëria ka bërë progres të konsiderueshëm për plotësimin e kriterëve themelore për integrimin në BE. Duke u bazuar në kriteret e Kopenhagenit për aspektet politike, juridike, institucionale dhe ekonomike, Shqipëria tashmë është në prag të marrjes së statusit të vendit kandidat për në BE. Ndonëse procesi i integritimit në BE nuk është tërësisht i lidhur me regjimin “Shengen” të vizave, sërish të dyja këto procese janë plotësuese dhe u shërbejnë aspiratave demokratike, europiane të qytetarëve tanë.

Unë kam ndjekur nga afër punën e bërë nga ministriat respektivë, si për pajisjen e qytetarëve me karta identiteti dhe pasaporta biometrike, ashtu edhe për kontrollin e integruar të kufijve tanë.

Në këto aspekte teknike mendoj se janë fare pranë ratifikimit përfundimtar kriteret për liberalizimin e vizave. Ndaj unë bëj pyetje thjesht teknike. Këtu kam parasysh që në pyetjet e mia të shfaq shqetësimet e elektoratit tim dhe të mbarë qytetarëve në vendin tonë.

Pyetjet janë:

1. Zoti Meta, pse Shqipëria nuk u përfshi në listën e vendeve, të cilat përfituan liberalizimin e vizave në dhjetorin e vitit 2009, bashkë me Serbinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi?

2. Zoti Meta, a mund të na thoni progresin e bërë në lidhje me procesin e liberalizimit të vizave në kuadër të plotësimit të kriterëve të udhërrëfyesit të BE-së?

3. Çfarë mbetet akoma për t’u bërë deri në finalizimin e procesit dhe, në terma praktike, çfarë beneficesh do të sjellë liberalizimi i vizave për qytetarët shqiptarë?

Falemnderit!

(Ndërkohë, drejtimin e seancës e ka marrë zoti Nasip Naço.)

Nasip Naço – Falemnderit, zoti Sterkaj!

Fjalën e ka zoti Meta.

Ilir Meta – Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar zoti Sterkaj,

Duke ju falënderuar për pyetjet që paraqitët, do të doja t’u përgjigjesha të triave me radhë.

Lidhur me pyetjen tuaj se përse Shqipëria nuk u përfshi në listën e tri vendeve që përfituan nga

raundi i parë për liberalizimin e vizave, si: Serbia, Mali i Zi dhe Maqedonia, dua, në radhë të parë, t'ju parashtroj në praktikë dy aspekte të cilat do t'ju ndihmojnë edhe ju, por edhe opinionin publik, për të mirëkuptuar pikërisht arsyet pse ne ndodhemi në këtë situatë, e cila është jashtëzakonisht pozitive për momentin.

Sikurse dihet, Komisioni Europian, përmes udhërrëfyesit të tij, ka përcaktuar të gjitha kriteret që duhet të plotësojë çdo vend i Ballkanit Perëndimor për të përfitur nga liberalizimi i vizave. Dihet që janë mjaft kritere, por, absolutisht, pajisja e qytetarëve me pasaporta biometrike është një parakusht për liberalizimin e vizave, pasi çdo qytetar i çdo vendi që përfiton liberalizimin e vizave nuk mundet ta gëzojë këtë të drejtë pa pasur në duart e tij një pasaportë biometrike. Ndaj, në raundin e vlerësimeve të para, në maj të vitit 2009, Komisioni Europian konsideroi se Shqipëria kishte bërë progres, ashtu jemi të gjithë të ndërgjegjshëm që, për shkak të zgjedhjeve të 28 qershorit, vëmendja e gjithë administratës edhe në këtë aspekt ishte përqendruar vetëm në një çështje, që kishte të bënte me kredibilitetin e zgjedhjeve të 28 qershorit, pra në prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit, që do të thotë se e gjithë infrastruktura, deri në mesin e vitit të kaluar, ishte në shërbim të plotë të kartave të identitetit, për të arritur mbulimin e të gjithë shtetasve që kishin të drejtë vote, por që nuk kishin pasaportë të vlefshme. Prandaj, deri në këtë kohë, dhe deri në 15 korrik të vitit 2009, pra dy javë pas zgjedhjeve të 28 qershorit, kur Komisioni Europian bëri propozimin zyrtar për heqjen e regjimit të vizave për Maqedoninë, Serbinë dhe Malin e Zi, ne pothuajse nuk kishim prodhuar asnjë pasaportë biometrike, sepse e gjithë vëmendja, të gjitha energjitë ishin përqendruar vetëm te çështja e kartave të identitetit. Kështu që nuk do të kishte qenë realiste sipas vetë udhërrëfyesit të Komisionit Europian që të bëhej një propozim i tillë për Shqipërinë, pasi ishte i parakohshëm qoftë edhe për këtë standard të domosdoshëm.

Së dyti, në një plan më të përgjithshëm politik, duke pasur parasysh edhe përvojat e ndryshme të vendeve tona, pavarësisht se udhërrëfyesi është i njëjtë për të gjitha vendet, pavarësisht se kriteret janë të njëjta për të gjitha vendet, starti për t'i arritur këto ka qenë dhe është i ndryshëm. Askush nga ne nuk duhet të harrojë se qytetarët e Maqedonisë, të Serbisë apo të Malit të Zi, dikur si pjesë e Federatës së Jugosllavisë, lëviznin lirshëm në të gjithë Europën

dhe në shumë vende të tjera të zhvilluara, pa viza, madje edhe punësoheshin atje, kurse shqiptarët e Jugosllavisë kishin një ëndërr, të vinin të vizitonin Tiranën.

Ndaj unë dua t'ju siguroj se pavarësisht nga ky start krejtësisht i ndryshëm, Shqipëria ka bërë një progres spektakolar në katër-pesë muajt e fundit duke plotësuar pothuajse të gjitha kërkesat dhe kriteret që kërkon udhërrëfyesi i Komisionit Europian për liberalizimin e vizave.

Lidhur me pyetjen tuaj për progresin e bërë në kuadër të plotësimit të kriterëve të udhërrëfyesit të BE-së, mund t'ju them se ky udhërrëfyes, i cili përbëhet nga 4 blloqe: siguria e dokumenteve, migrimi e menaxhimi i kufirit, ripranimi, rendi publik dhe siguria, si dhe marrëdhëniet me jashtë dhe të drejtat themelore, ka shënuar gjatë kësaj kohe një progres të jashtëzakonshëm në të katër komponentët e tij dhe ka pasur vëmendjen e të gjithë neve, që nga Parlamenti, Qeveria dhe institucionet e tjera që kanë qenë të përqendruara për t'i plotësuar të gjitha detyrimet.

Në këtë drejtim, unë dua të theksoj se siguria e dokumenteve ka një progres spektakolar, të vlerësuar shumë pozitivisht nga të gjithë, jo vetëm për sa u takon kartave të identitetit, nga të cilat janë prodhuar deri tani 1 milion e 900 mijë, por edhe për sa i takon numrit të pasaportave biometrike, numri i të cilave brenda 4-5 muajve ka arritur gati në 466 mijë dhe vijon rritjen me intensitet të lartë.

Ka një kapërcim galopant nga regjistrat e vjetër manual, në një sistem të kompjuterizuar dhe të sigurt të dhënash, nga seriali i certifikatave, në karta identiteti multifunksionale. Falë këtij sistemi modern, të shpejtë dhe efikas, ritmi i shpërndarjes së pasaportave biometrike sot është më i larti në rajon dhe tejkalon çdo parashikim, edhe tonin, edhe të ekspertëve të komisionit. Njëkohësisht, shumë të rëndësishme janë në këtë drejtim edhe aspektet e sigurisë së vetë dokumenteve dhe qendrës së personalizimit, programet antikorupsion, përpunimi i menjëhershëm i të dhënave të pasaportave të humbura, të cilat mbyllin plotësimin e të gjitha detyrimeve për këtë bllok. Nga 14-17 dhjetor 2009 u zhvillua raundi i dytë i misionit të ekspertëve për bllokun e parë, në përfundim të të cilit u konkludua se pala jonë i ka përmbushur të gjitha çështjet e mbetura që nga vizita e fundit e ekspertëve për këto çështje në mars të vitit 2009.

Lidhur me bllokun e dytë, migrimin, menaxhimin e kufirit dhe ripranimin, puna është përqendruar në

menaxhimin e kufirit, ku ka pasur përmirësime substanciale nëpërmjet vënies në funksionim të teknologjive të reja, nga më të avancuarat në Europë, për menaxhimin e integruar të kufijve. Arritja më domethënëse është instalimi dhe funksionimi i plotë i sistemit TIMS në të 26 pikat e kalimit kufitar. Së fundi, me mbështetjen e ICITAP-it ka përfunduar edhe krijimi i moduleve për l-viza dhe leje qëndrimi, të cilat janë instaluar në sistemin TIMS dhe aktualisht janë në proces testimi nga strukturat e Ministrisë së Brendshme dhe shërbimet konsullore të Ministrisë së Jashtme, të cilave u është mundësuar akses i në këtë sistem.

Po punohet për hartimin e një banke të dhënash kombëtare për regjistrimin e të huajve, është unifikuar sistemi i kontrollit në pikat e kalimit kufitar sipas parimit *One Stop Shop*, që përfshin kontrollin e dokumentacionit doganor dhe fitosanitar, si dhe është ngritur Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare për kontrollin e kufirit detar. Janë miratuar të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore për kontrollin dhe survejimin e kufirit, të cilat janë tashmë në zbatim, si dhe strategjia dhe plani i veprimit për menaxhimin e integruar të kufirit. Gjithashtu, progres është shënuar për sa i përket miratimit të të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore për zbatimin e ligjit mbi azilin dhe plan-veprimit për zbatimin e ligjit për të huajt në vendin tonë.

Ka përfunduar instalimi i 63 lexuesve të rinj optikë për kontrollin dhe leximin e pasaportave biometrike në 25 pikat e kalimit kufitar. Në 11 drejtori e policisë në qarqe dhe në 8 drejtoritë rajonale të kufirit dhe migracionit funksionon plotësisht sistemi i analizës së informacionit MEMEX.

Në të gjitha pikat e kalimit kufitar ka një lidhje në kohë reale, mbi bazën e të dhënave të Interpolit. Është përfunduar procesi i instalimit të pajisjeve për leximin automatik të targave të makinave dhe është mundësuar lidhja me bazën e të dhënave për automjetet e vjedhura, në tri pikat e kalimit kufitar dhe është duke përfunduar instalimi në një tjetër. Është instaluar sistemi i monitorimit me kamera në 7 pikat e kalimit kufitar dhe vazhdon në dy të tjera. Njëkohësisht, blerja e 4 pajisjeve për kontrollin e drogave, videoskopi në dy drejtime, leximi në pikat e kalimit kufitar të Kapshticës, në Portin e Vlorës dhe të Durrësit, do të rrisin aftësitë e policisë për detektimin e substancave narkotike.

Në shkurt 2010 pritet të përfundojë ndërtimi i dhjetë pikave të reja të kalimit kufitar dhe rikonstruksioni i 20 ambienteve për monitorimin e

kufirit, të realizuara edhe me mbështetjen financiare të BE-së.

Blloku i tretë, rendi publik dhe siguria, është blloku më kompleks i udhërrëfyesit, pasi çështjet që trajtohen në këtë bllok janë më pak të matshme dhe kërkojnë një punë dhe angazhim afatgjatë. Këtu është parë me prioritet zbatimi i strategjisë kundër krimit të organizuar, trafikëve dhe terrorizmit, sipas plan-veprimit për çdo institucion, sipas një kalendarit të qartë.

Në vijim të miratimit dhe hyrjes në fuqi të ligjit të ri kundër krimit të organizuar, apo njohur ndryshe si ligji antimafia, zbatimi i tij, i strategjisë dhe i plan-veprimit, do të monitorohen në harmoni dhe në mënyrë integrale me rigorozitetin më të madh e në mënyrë sistematike, nga komiteti ndërinstitucional për masat kundër krimit të organizuar, trafikëve dhe terrorizimit.

Gjithashtu, angazhimi i Qeverisë për rinovimin e moratoriumit për mjetet e fuqishme lundruese do të ketë efektet e duhura dhe do të jetë në funksion të luftës kundër krimit të organizuar. Për sa u përket rezultateve të përgjithshme lidhur me masat kundër krimit financiar, vetëm gjatë vitit 2009 janë konfiskuar mbi 3 milionë e 700 mijë euro në llogari bankare dhe tashmë, pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri kundër krimit të organizuar, pritet që këto rezultate të njohin një rritje substanciale. Gjithashtu, deri në janar të vitit 2010 është raportuar evidentimi i 383 veprave penale, me 84 autorë të arrestuar dhe 15 të shpallur në kërkim.

Në luftën kundër trafikimit të drogës është në zbatim strategjia dhe plan-veprimi përkatës. Vetëm për periudhën 15 nëntor 2009 – 22 janar 2010 janë evidentuar 77 raste me 101 autorë të identifikuar, 82 persona të arrestuar, 16 në ndjekje penale dhe 3 të tjerë në kërkim. Bazuar në informacionin e siguruar nga akses i në sistemin MEMEX është kryer për herë të parë nga Drejtoria e Analizimit të Informacionit Kriminal vlerësimi mbi rrezikun e aktivitetit të grupeve kriminale për vitin 2008 dhe 2009.

Lufta kundër korrupsionit është përqendruar si në parandalimin e tij, nëpërmjet masave rregullatore, si shërbimet *One Stop Shop*, shërbimet *online* etj.; ashtu edhe në bashkëpunimin ndërmjet agjencive, për identifikimin kapjen dhe dënimin e të gjitha akteve korruptive.

Gjatë periudhës nëntor 2009- janar 2010 janë identifikuar 35 vepra penale, që kanë të bëjnë me korrupsionin dhe shpërdorimin e detyrës, me 59

autorë, nga të cilët 26 janë të arrestuar, 31 janë në ndjekje penale në gjendje të lirë dhe 2 në kërkim.

Njëkohësisht, në 15 dhjetor të vitit të kaluar në Tiranë filloi zbatimi i projektit të përbashkët 3-vjeçar të ndihmës teknike të BE-së dhe KE-së për të mbështetur Qeverinë shqiptare në zbatimin e strategjisë ndërsektoriale për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit dhe për qeverisje transparente. Me një fond prej 2 milionë e 130 mijë eurosh, bashkëfinancim i BE-së dhe KE-së, projekti është një nga 24 projektet prioritare të Qeverisë shqiptare në kuadrin e instrumentit për asistencën e paraantarësimit 2008, IPA.

Për sa u përket rekomandimeve të grupit GRECO, nga 13 rekomandime janë plotësuar 11 dhe 2 të tjerat janë duke u ndjekur me prioritet. Në kuadër të bashkëpunimit gjyqësor, miratimi në dhjetor i ligjit për bashkëpunimin gjyqësor me autoritetet e huaja në çështjet penale dhe fillimin e negociatave për nënshkrimin e marrëveshjes me Eurojust, për bashkëpunimin gjyqësor gjatë këtij viti, pritet të sjellë një përmasë të re bashkëpunimi ndërkombëtar me partnerët tanë.

Është duke u zbatuar me rigozitet strategjia kombëtare për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe të fëmijëve. Sipas plan-veprimeve përkatëse tashmë janë miratuar një sërë masash të ndërmarra në këtë kuadër, të cilat kanë çuar në heqjen nga listat të Shqipërisë si vend transit për trafikimin e qenieve njerëzore dhe menaxhimin më të kujdesshëm të këtij fenomeni në vend.

Gjatë vitit 2009 ka vazhduar puna e agjencive të zbatimit të ligjit për hetimin e akteve kriminale të trafikimit dhe ndjekjen penale të personave përgjegjës për kryerjen e këtyre krimeve. Janë organizuar tri operacione të policisë kundër trafikimit të grave dhe 8 operacione kundër përdorimit të tyre për prostitucion dhe gjatë këtyre operacioneve janë arrestuar 29 persona.

Janë organizuar operacione kundër lypjes së lëmshës në qarkun e Tiranës dhe nga dhjetori i vitit 2009 është duke u zbatuar nga policia plani operativ kundër shfrytëzimit të fëmijëve. Gjatë 3 muajve të fundit të vitit 2009 ka pasur përmirësime thelbësore të kuadrit ligjor në këtë drejtim, veçanërisht për sa u përket masave në drejtim të mbrojtjes së viktimave të trafikimit. Kalimi së fundi në Qeveri i projektligjit "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", krijon mundësitë për përmirësimin e ndihmës financiare që do të përfitojnë viktimat e trafikimit gjatë dhe pas largimit nga institucionet e

asistencës sociale, deri në punësimin dhe integrimin e tyre të plotë në shoqëri.

Gjithashtu, ligji i ri për parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë, parashikon krijimin e një fondi të veçantë për parandalimin e kriminalitetit, që do të shërbejë për të rritur shërbimet për viktimat dhe kompensimin e tyre. Në vitin 2010 ka pasur një rritje të fondeve për Qendrën Kombëtare të Pritjes me 25% më shumë sesa një vit më parë.

Gjatë vitit 2009, 82 viktima të trafikimit janë riintegruar dhe 38 janë trajnuar profesionalisht pa pagesë nga zyrat rajonale të punës. Janë ndërtuar mjaft qendra për mbrojtjen e fëmijëve në nivel bashkiak, të cilat janë përgjegjëse për identifikimin, mbrojtjen, ndihmën dhe integrimin e kësaj kategorie tepër të ndjeshme për të gjithë. Numri i fëmijëve të trajtuar në këto qendra, në Tiranë, Korçë, Elbasan, Berat arrin në mbi 1300 vetë. Komitetet rajonale antitrafik kanë vazhduar në mënyrë sistematike mbledhjet e tyre me komunitetet ku ato veprojnë për të diskutuar rastet konkrete të shfrytëzimit të tyre, si dhe për të asistuar personat në nevojë.

Në bashkëpunim me OSBE-në janë organizuar trajnime të anëtarëve të këtyre komiteteve në 12 qarqe, ku numri i të trajnuarve rezulton mbi 200. Gjithashtu, vazhdon marrja e masave për parandalimin e këtij fenomeni nëpërmjet organizimit të fushatave ndërgjegjësuese, edukimit, punësimit, regjistrimit dhe ndërtimit të sistemit, për të parandaluar punën dhe shfrytëzimin e fëmijëve.

Gjatë vitit 2009 janë trajnuar 270 veta, personel policor i niveleve dhe strukturave të ndryshme, 200 gjyqtarë, prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore dhe është duke u punuar në drejtim të përmirësimit të procedurave të raportimit për identifikimin e rasteve të trafikimit. Funksionimi dhe menaxhimi i bazës së të dhënave për viktimat e trafikimit do të shërbejë për të pasur një vizion më të qartë lidhur me situatën e trafikimit në Shqipëri dhe identifikimin e formave të shfrytëzimit të viktimave të trafikimit. Për vitin 2009 janë identifikuar, referuar dhe kanë marrë ndihmë në këto qendra apo pranë familjes 94 viktima të trafikimit, nga të cilët 22 fëmijë.

Blloku i katërt është ai i marrëdhënieve me jashtë dhe i të drejtave themelore i cili, tashmë, me strategjinë kombëtare dhe planin e veprimit në kuadër të dekadës së romëve dhe, njëkohësisht, edhe me ligjin antidiskriminim, konsiderohet pothuajse i mbyllur nga ne, por edhe nga përfaqësuesit e Komisionit Europian.

Njëkohësisht, do të doja të ndalesha edhe në dialogun shumë të rëndësishëm të Shqipërisë me BE-në, të institucioneve tona dhe të Qeverisë me institucionet, me Komisionin Europian dhe me vendet anëtare të tij, për të siguruar mbështetjen politike në këtë proces, i cili kulmon me miratimin me shumicë dërrmuese në Parlamentin Europian në 12 nëntor të vitit të kaluar të rezolutës së quajtur "Fajon", sipas emrit të eurodeputetes Tanja Fajon, që e inicioi, si dhe deklarata politike që iu bashkëngjijt kësaj rezolute, ku Parlamenti Europian dhe Këshilli angazhohen për një trajtim urgjent të propozimit për liberalizimin e vizave me Shqipërinë, sapo komisioni të vlerësojë se ne kemi përmbushur detyrimet e mbetura nga udhërrëfyesi, duke u dhënë një mesazh të qartë të gjitha këtyre institucioneve në mbështetje të liberalizimit të vizave për Shqipërinë.

Njëkohësisht, mesazhe shumë të rëndësishme kanë përçuar gjatë vizitës së tyre në Tiranë ministri i Brendshëm italian Maroni dhe shumë personalitete të tjera, ku do të veçoja letrën e përbashkët të ministrit të Jashtëm të Italisë, zotit Fratini dhe atij sloven, zotit Sbogër, drejtuar Presidencës së kaluar suedeze, për trajtimin me prioritet të kësaj çështjeje nga komisioni, si edhe qëndrimin e fundit të ministrit të Jashtëm të Austrisë dhe atij plotësues për Punët e Jashtme të Greqisë, përkatësisht zotit Spienderleger dhe zotit Drucos, drejtuar përfaqësueses së lartë të BE-së për Politikën e Jashtme dhe Sigurinë, Katrin Eshtum, për përsheptimin dhe përfundimin e këtij procesi brenda vitit 2010.

Së fundi, dua t'ju siguroj edhe një herë tjetër,

pas kësaj ekspozije shumë të gjatë dhe të detajuar, të cilën e bëra më shumë për të kuptuar të gjithë se ky është një proces kompleks dhe i gjithanshëm, se jo vetëm që është bërë një punë e jashtëzakonshme dhe Shqipëria pothuajse i ka plotësuar të gjitha standardet. Por unë dua të shpreh bindjen tonë se Shqipëria do ta fitojë këtë sfidë të jashtëzakonshme dhe shqiptarët brenda këtij viti do të kenë mundësi të udhëtojnë si të gjithë qytetarët e tjerë të BE-së.

Me këtë rast, duke falënderuar të gjithë ata që kanë punuar (se ju, edhe nga ekspozija, jam i bindur që u ndërgjegjësuat akoma më tej që beteja për liberalizimin e vizave është një betejë që përfshin jo vetëm Qeverinë, jo vetëm institucionet, jo vetëm shoqërinë civile, por edhe të gjithë shoqërinë tonë), dua të falënderoj edhe Kryetaren e Kuvendit për prioritetin që i ka dhënë kësaj çështjeje jo vetëm në axhendën e Parlamentit, por, njëkohësisht, edhe në aktivitetet ndërkombëtare.

Falemnderit!

(Ndërkohë, drejtimin e seancës e ka marrë zonja Topalli.)

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Zëvendëskryeministër!

Dëshiron njeri të shtojë ndonjë gjë?

Falemnderit!

Atëherë, kjo ishte pika e fundit të rendit të ditës.

Me kaq seanca mbyllet.

Falemnderit!

Natën e mirë!

(Seanca u mbyll në orën 19:30)

E enjte, 11.02.2010
Seanca e pasdites, ora 17:00

Drejton seancën Kryetarja e Kuvendit,
zonja Jozefina Topalli (Çoba)

Rendi i ditës:

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').

2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 04.02.2010.

3. Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes me shkëmbim notash ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Japonisë për financimin e projektit për përmirësimin e pajisjeve mjekësore të Qendrave Rajonale të Emergjencës në Republikën e Shqipërisë".

4. Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas dhe të financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Kreditanstalt fur Wiederaufbau (KfW), Frankfurt am Main dhe Fondacionit "FEFAD" për projektin "Promovimi i SME-ve".

5. Projektligji "Për ratifikimin e statutit të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë së Rinovueshme (IRENA)".

6. Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Saudit për Zhvillim për financimin e projektit "Ndërtimi i rrugës së mbikalimit të Durrësit".

7. Projektligji "Për Autoritetin e Aviacionit Civil".
(Për votim)

8. Interpelancë me ministren e Integritetit,
kërkuar nga deputetja Albana Vokshi.

(Është ftuar të përshëndesë Kuvendin, Kryetari i Parlamentit të Malit të Zi, Ranko Krivokapiç.

Deputetët presin me duartrokitje hyrjen në sallën e Kuvendit të zotit Krivokapiç.)

Jozefina Topalli - I nderuar zoti Krivokapiç,
Të nderuar shkëlqesi ambasadorë,
Zonja dhe zotërinj parlamentarë,
Për mua dhe për deputetët e Kuvendit të Shqipërisë është nder dhe kënaqësi t'ju mirëpresim në sallën e seancave plenare, në tempullin e demokracisë shqiptare.

Shqipëria dhe Mali i Zi, të cilët ndajnë një histori të përbashkët shumëshekullore, sot ofrojnë një model të shkëlqyer të marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë. Marrëdhëniet, që deri para një dekade kanë qenë inekzistente, kanë arritur një nivel shumë të lartë e dinamik, bazuar jo vetëm në parimet e standardeve të fqinjësisë së mirë, por edhe në ato të synimeve të përbashkëta të integritetit evropian.

Sot ne i kemi të gjitha motivet dhe nxitjen për të bashkëpunuar për një të ardhme evropiane të popujve tanë dhe të rajonit në tërësi; kemi vullnetin për të kontribuar dhe marrë pjesë aktivisht në integrimin rajonal dhe atë euroatlantik, si dhe perceptimin e drejtë për një rajon të stabilizuar, të zhvilluar ekonomikisht dhe në harmoni marrëdhëniesh në një hapësirë tashmë demokratike.

Prania juaj këtu, i nderuar Kryetar, është shprehje e konfirmimit të vullnetit të mirë politik nga të dyja palët për intensifikimin dhe çuarjen më tej të një bashkëpunimi afatgjatë dhe në të gjitha fushat me interes të ndërsjellë për Shqipërinë dhe Malin e Zi.

Unë sot nuk mund të lë pa falënderuar dhe shprehur mirënjohjen time për njohjen nga Qeveria e Malit të Zi të Republikës së Kosovës dhe vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me të. Unë e vlerësoj këtë si një hap të rëndësishëm dhe të përgjegjshëm që u bë në kohën dhe në drejtimin e duhur.

Rajoni ynë ka nevojë për paqe e stabilitet dhe ne ia kemi arritur e së bashku po shkojmë drejt BE-së.

Më lejoni, të nderuar pjesëmarrës, t'ia jap fjalën Kryetarit të Kuvendit të Malit të Zi, zotit Ranko Krivokapiç.

Urdhëroni, zoti Kryetar!

Ranko Krivokapiç (Kryetar i Parlamentit të Malit të Zi)

E nderuar Kryetare Topalli,
Zonja e zotërinj deputetë të Parlamentit të Republikës së Shqipërisë,
Shkëlqesitë Tuaja,
Nderin historik që më keni dhënë me mundësinë për t'ju drejtuar, e përjetoj si shprehje të miqësisë së madhe dhe të sinqertë ndaj shtetit tim, Malit të Zi. Ngado që të nisemi në histori, nga ilirët deri te qytetarët e Bashkimit Europian, gjithmonë do të takohemi me rrënjët e gërshetuara të shteteve dhe qytetarëve tanë.

Së bashku jemi të vendosur në një hapësirë, ku, në dimensionin historik dhe gjeografik, takohen pandërprerë, përshkohen ose konfliktohen civilizimet, kulturat, religjionet; ku takoheshin ose ndaheshin Perandoria Romake perëndimore dhe lindore-krishtërimi katolik dhe ortodoks, krishtërimi dhe islami; ku filloi një luftë botërore dhe porsa përfundoi e fundit në tokën evropiane.

Të gjitha këto dhe vazhdimësia e mijëvjeçarit na kanë mësuar që secila kohë ka sfidat e veta, por edhe sfidat e vjetra kërkojnë përgjigje të reja. Në fillim, dua të theksoj se përgjigjja shqiptaro-malazeze dhe besojmë edhe ajo rajonale, është e përbashkët dhe e qartë: Aleanca e Atlantikut të Veriut dhe Bashkimi Europian.

Zonja dhe zotërinj,

Për herë të parë, që nga ndarja e Perandorisë Romake në atë perëndimore dhe lindore e deri te rënia e Murit të Berlinit, në Ballkan po krijohen mundësi historike që t'i takojmë një koncepti të njëjtë politik dhe ekonomik. Bashkimi Europian është model pa precedent historik, pikërisht për faktin se na ofron fuqinë e vlerave demokratike e jo imponim të forcës. Ne jemi pa ndjenjë inferioriteti, pjesë e pandarë e ekzistencës evropiane.

Pjesë e kësaj përgjegjësie të re rajonale ballkanike të Malit të Zi është edhe nisma jonë shumëvjeçare burimore e Forumit Parlamentar të Cetinës. Vërtetojmë se mundemi të zhvillojmë modelet tona të bashkëpunimit parlamentar pa mentorë.

Përgjegjësi rajonale e re është edhe pranimi i Republikës së Kosovës. E përjetojmë si pjesë të procesit tonë të integritetit euro-atlantik dhe të kontributit afatgjatë të stabilitetit në rajon. Udhëheqim politikën e fqinjësisë së mirë, por jo edhe kënaqje keqkuptimesh. Vendimin e kuptojmë edhe

si ndihmë të të gjithëve në rajon, që të drejtohen nga e ardhmja.

Mali i Zi dëshiron të mbetet shembull i suksesshëm në rajon dhe për këtë jemi të gatshëm për statusin kandidat për në BE deri në fund të këtij viti. Kemi realizuar të drejtën e një regjimi pa viza, por gëzimi ynë është zvogëluar për mosrealizimin e kësaj të drejte për Shqipërinë dhe fqinjët e tjerë. Ne ndajmë vetëdijen e përbashkët se përgjegjësia e bashkimit në BE qëndron mbi ne dhe se BE-ja tashmë na ndihmon zemërgjerësisht në përmbushjen e qëllimeve demokratike. BE-ja për Malin e Zi është, para së gjithash, bashkësi e vlerave dhe jo një donator bamirës.

Mali i Zi e di se lundrimi pwr të cilin aftësojmë njerëzit tanë të drejtojnë anijen shtetërore, është më i rëndësishëm sesa arritja në portin e quajtur "Bashkimi European". Qëllimi është të arrijë i gatshëm kurdo që të ndodhë kjo. Për këtë arsye, parimi i regatave nga Selaniku është njësisia matëse e drejtë e progresit për secilin prej nesh.

Të nderuar kolegë,

Në Shqipëri dhe në Malin e Zi forcohet bindja se parlamenti është tempulli i demokracisë, me rolin përherë në rritje në shoqërinë tonë bashkëkohore. Parlamenti është institucioni bazë për zgjidhjen me dialog të kontradiktave në shoqëri. Kjo është zakonisht mënyra më e ngadaltë, por edhe mënyra më e mirë për secilin shtet. Veçanërisht, shoqëritë tona, pa një traditë të madhe demokratike, nëpërmjet parlamentit krijojnë besim në institucione dhe përgjegjësinë e individit. Krijojnë ndërgjegjen se institucionet janë rojtaret e stabilitetit dhe të paqes dhe jo individët pa gabime.

Funksioni kontrollues i Parlamentit është një mjet i fuqishëm për arritjen e sundimit të drejtësisë dhe, bazuar në të, për jetë më të mirë të qytetarëve. Malazetët kanë një fjalë të urtë që nënkupton: "Nuk më vjen keq për një pjesë të vogël, por për pjesën e shtrembër".

Të nderuar kolegë,

Dy dekadat e fundit në Ballkanin Jugperëndimor kanë qenë kohë të trazirave të mëdha. Rënia e sistemit të vlerave është zëvendësuar me një sërë luftërash brutale. Tranzicioni i gjatë dhe, sipas rregullit, i vështirë, e ka shndërruar Ballkanin Perëndimor në një hapësirë, që në botë ka shkaktuar kryesisht lajme tragjike dhe shqetësuese. Në vend të kolonave krijuese, nëpër Ballkan kanë lëvizur ato të refugjatëve. Në vend të njerëzve që punojnë, hapësira ka qenë e mbushur me të

pashpresë. Ballkani Perëndimor është dukur si rajon i të dëshpëruarve.

Për një kohë të gjatë Ballkani Jugperëndimor ka qenë problem i Europës. Para nesh është koha e përpjekjeve dhe e të provuarit që kriminelët e luftës nuk do t'i zëvendësojë krimi i organizuar dhe korrupsioni. Ne jemi të gatshëm të ndërtojmë shoqëri me sundim të drejtësisë dhe kohezion social nëpërmjet solidaritetit, të prodhojmë të mira materiale dhe shpirtërore në ndërlidhjen reciproke.

Të nderuar kolegë,

Popujt tanë kanë mbijetuar edhe për shkak të vlerave universale, të cilat i kanë mbrojtur me guxim. Gatishmëria për të mbrojtur lirinë dhe drejtësinë ka zhvilluar një kod të përbashkët të burrisë dhe trimërisë, të cilat na kanë afruar historikisht.

Në shkrimet tona përmendet një çerek shekulli i luftës së përbashkët të Gjergj Kastrioti Skënderbeut dhe Stefan Crnojeviçit kundër dominimit osman. Në luftën e Krujës malazetët kanë ndihmuar fitoren e madhe shqiptare. Ndaj, Gjergj Kastrioti Skënderbeu është bërë daja i Ivan Crnojeviçit, shenjtit të kishës ortodokse malazeze dhe themeluesit të kryeqytetit mbretëror të Cetinës.

Kryebashkiaku i parë i kryeqytetit tonë, Podgoricës, Mark Milan Popoviçi, ka folur shqip shkëlqyeshëm dhe ka shkruajtur "Shembujt e burrisë dhe trimërisë" dhe "Jeta dhe zakonet e shqiptarëve".

Kalorësia na ka lidhur në çdo periudhë të historisë. Për mua, një prej vendimeve më të mëdha në mijëvjeçarin e vazhdimësisë së Malit të Zi ishte kur mbreti ynë i fundit, Nikolla i Parë, bëri çmos për ruajtjen e multiethnicitetit të Malit të Zi.

Në gjysmën e dytë të shekullit XIX ai i luti shqiptarët të qëndrojnë në shtetin e tij tashmë të zgjeruar, iu la njësitë ushtarake shqiptare si dhe komandimin e tyre, e, në dekadat e para, edhe Sheriatin, si ligj suprem. Ajo mençuri dhe besimi i kahmoçëm, të cilin disa nuk e kishin as në shekullin XX, edhe sot e kësaj dite, ruan Malin e Zi dhe qytetarët e tij në kohët më të vështira.

Bazamenti i popujve tanë në ndjeshmërinë për të drejtën i ka shërbyer Valtazar Bogishiçit për të koduar më 1888 ligjin më të mirë civil në këto hapësira, i cili, ka bartur edhe gjurmë të Kanunit të Lekë Dukagjinit. Japonezët, duke dashur të kodojnë ligjin e vet zakonor, kanë studiuar ligjin malazet të pronësisë.

Të nderuar kolegë,

Shumë herë është vërtetuar se vlerat e mëdha i

bëjnë edhe popujt e vegjël, siç janë shqiptarët dhe malazezët. Edhe lufta që mbaroi para pak kohësh në Ballkan ka treguar se shkatërrimi i shpirtit të njeriut nxjerr te disa më të keqen, e te disa më të mirën. Malazezët kanë ruajtur etikën e vet të trimërisë dhe guximit dhe kanë mbrojtur mbi 100.000 refugjatë nga Kosova, si te Kanuni i Lekë Dukagjinit: “Njeriun që ikën, kur të hyjë në oborin tënd, duhet ta mbrosh duke mos kursyer as jetën tënde”.

Mali i Zi i tillë është mbatur, pa përjashtim, edhe me votat e shqiptarëve, në kthimin në mes të shteteve të lira në 2006. Besimi që u ndërtua me shekuj ka mbrojtur Malin e Zi multi-etnik, multifetar, Malin e Zi të qytetarëve. Gjuha shqipe me Kushtetutë përdoret lirisht, si edhe serbishtja, kroatishtja, boshnjakishtja. Edhe më shumë se kaq: ne flasim me gjuhën e shoqërisë civile, të tolerancës dhe krijimit të vlerave të reja në të gjitha sferat e jetës.

Të nderuar anëtarë të Parlamentit të Republikës së Shqipërisë,

E kaluara për popullin malazez dhe shqiptar ruan leksione të rëndësishme, me të cilat politika e ndërgjegjshme nuk robëron, por edhe nuk i harron. Që nesër Mali i Zi dhe Shqipëria do të jenë partnerë në BE. Shqipëria tashmë është anëtare e NATO-s e Mali i Zi është anëtar i parë i radhës. Zhvillimi i demokracisë dhe shoqërisë të së drejtës, si edhe zhvillimi ekonomik afatgjatë janë detyrë e gjeneratës sonë.

Sfidat që qëndrojnë para shteteve tona dhe rajonit janë të ndryshme nga të kaluarat, por jo edhe më pak vendimtare. Bashkëpunimi ndërshtetëror i Malit të Zi dhe Shqipërisë, jam i bindur, është në vazhden e urtësisë së të parëve tanë.

Për një kohë të gjatë këto hapësira kanë prodhuar tepricë historie, qoftë vetëm, apo me ndihmën e të tjerëve. Padrejtësitë historike kanë qenë për shumë kohë arsye për aplikimin e padrejtësive të reja. E vërteta është se në mënyrën si e interpretojmë të kaluarën, para së gjithash tregohen synimet tona.

Duhet të mësojmë edhe për gabimet tona, jo vetëm për fitoret.

Shpresojmë se jemi duke u sjellë komunitetit të popujve europianë, por edhe komunitetit të popujve mesdhetarë, më tepër nga çfarë mund të shprehet me shifra. Jemi duke sjelle spiritualitetin e ndërthurur të Lindjes dhe Perëndimit, të cilit koha i ka dhënë një rëndësi edhe më të madhe.

Ju falënderoj, të nderuar deputetë!

(Duartrokitje)

Jozefina Topalli – Zotërinj deputetë,

Më lejoni që në emrin tuaj të falënderoj Kryetarin e Parlamentit të Malit të Zi, zotin Krivokapiç. Ashtu siç tha ai, historia e popujve të vegjël ndonjëherë është një histori shumë e madhe, është po aq e vërtetë, sa e gjithë fjala e tij, e rëndësishme dhe e sinqertë. Sot, ndryshe nga pak vite më parë, Ballkani nuk është më vendi i të dëshpëruarve, por është vendi i perspektivës, vendi që rend drejt Bashkimit Europian. Dhe në këtë garë të madhe e të përbashkët jemi bashkë me Malin e Zi, si dhe me vendet e tjera.

Falënderoj zotin Krivokapiç për fjalën, për vizitën e tij dhe për bashkëpunimin e jashtëzakonshëm që ka treguar si Kryetar i Parlamentit të Malit të Zi, së bashku me deputetët e tjerë, me Qeverinë e vendit të tij, me vendin tonë dhe me vendet e tjera.

I uroj suksese Kryetarit të Parlamentit të Malit të Zi, vendit të tij!

Falemnderit!

Më lejoni që ta shoqëroj Kryetarin e Parlamentit, zotin Krivokapiç.

(Duartrokitje)

(Pas pushimit)

Jozefina Topalli - Nisim seancën.

(Lexon rendin e ditës.)

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës: diskutime për çështje jashtë rendit të ditës. Kanë regjistruar emrin deputetët: Aldo Bumçi, Sybi Hida, Paulina Hoti, Luçiano Boçi, si dhe ministrat Ferdinand Xhaferri dhe Petrit Vasili.

Fjalën e ka zoti Bumçi.

Aldo Bumçi – E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komunizmi është regjimi më mizor që shoqëria njerëzore ka krijuar në të gjithë historinë e saj. Për fatin tonë të keq, shqiptarët brenda këtij sistemi përjetuan formën e tij më të egër, më çnjerëzore. Nëse pas vdekjes së Stalinit në vitin 1953, në të gjitha vendet e Europës Lindore dhuna shtetërore filloi të zbutej ndjeshëm, u ulën dënimet me vdekje, dënimet me burgim nuk i kalonin 5 vjet, në Shqipëri stalinizmi vazhdoi në mënyrë të pamposhtur deri në fund të viteve 1980. Ai ishte një regjim çnjerëzor, që zgjati gati gjysmë shekulli në një popullsi të vogël dhe pa dyshim që ka lënë një plagë të madhe, një trashëgimi të dhimbshme, pasojat e së cilës ne i vuajmë sot në mënyra të ndryshme në jetën tonë të përditshme.

Zbulimi i eshtrave rrëzë malit të Dajtit ka kthyer në kujtesën tonë kolektive këtë trashëgimi të dhunshme. Unë e vlerësoj vendimin e Qeverisë për të ngritur një grup pune për gjetjen e eshtrave të të ekzekutuarve nga diktatura, një ndihmë që u jepet familjeve, por dhe të gjithëve ne për t'i nderuar ata. Unë dëshiroj të theksoj me forcë se kjo nuk është një histori të vdekurish, nuk është një histori eshtrash, nuk është një histori ku ne duhet të kufizohemi duke thënë për të njëmiliontën herë se sa mizor ishte regjimi i Enver Hoxhës. Kjo nuk është një histori të vdekurish, por një histori të gjallësh. Kjo nuk është një ngjarje që lidhet me të kaluarën, por më shumë lidhet me të sotmen, kur sot shoqëria shqiptare, institucionet shtetërore përballen me trashëgiminë e diktaturës.

Në ç'fazë është procesi i dekomunistizimit të shoqërisë? Trashëgimia e një diktature 50-vjeçare nuk mund të fshihet shpejt. Por ne kemi detyrimin madhor, jo vetëm në respekt të atyre që vuajtën, por edhe për hir të shpirtit tonë, për hir të ekuilibrit të një shoqërie të tërë, të mos lëmë në harresë trashëgiminë e krimit komunist.

Në vitet '90 askush nuk e ka besuar se pas 20 vjetësh trashëgimia e diktaturës do të vazhdonte të ishte e gjatë në institucionet më të larta të drejtësisë shqiptare. Përmasat e persekutimit komunist kanë qenë të tilla që ne kemi besuar se një pjesë e tyre do të dënoheshin dhe pjesa tjetër do të tërhiqeshin në jetën private, sepse morali shoqëror nuk e pranonte që ata të ishin në mesin tonë, jo më në krye të shoqërisë. Pse në organet e drejtësisë shqiptare, në prokurori, në gjykata vazhdojnë të jenë mbetje të diktaturës? Pse qenkan të pazëvendësueshëm njerëzit që kanë marrë pjesë drejtpërdrejt në krimet e komunizmit?

Kjo gjendje e sotme nuk e ka burimin thjesht të diktatura 50-vjeçare, por dhe në vitin e mbrapshtë 1997 që zhbëri një pjesë të mirë të procesit të dekomunistizimit të shoqërisë, që kishte ndodhur nga viti 1992 deri në vitin 1997. Pas ardhjes në pushtet të Partisë Socialiste në vitin 1997 u zhbë, u degradua ligji "Për pastërtinë e figurës", i kaluar në vitin 1995. Askush nuk e ka besuar se Partia Socialiste e drejtuar nga Edi Rama në vitin 2010 nuk do të ishte të paktën në nivelin e Partisë Socialiste të vitit 1997. Megjithëse e degraduan ligjin, Partia Socialiste e vitit 1997 e la atë në fuqi deri në vitin 1998. Ligji qëndroi në fuqi deri në vitin 2001. Partia Socialiste e Edi Ramës nuk u ngrit dot as në nivelin e Partisë Socialiste që erdhi me revolucion

të armatosur në vitin '97. Zbulimi i eshtrave duhet të na nxisë të jemi më të ndjeshëm ndaj vuajtjes së njerëzve në regjimin komunist. Shqipëria është një vend me shumë vuajtje, ku duhet të përmirësojmë rrugët, shkollat, spitalet; ku duhet të rrisim rrogat, pensionet; ku duhet të kompensohen pronarët historikë dhe këto nuk arrihen dot të gjitha, se është një buxhet i kufizuar. Dëmshpërblimi i ish të përndjekurve politikë nuk duhet të shikohet si një barrë për vendin.

Ne nuk mund të kthejmë vitet e jetës së humbur të njerëzve të pushkatuar, por dëmshpërblimi duhet të shërbejë për të zbutur vështirësitë e jetës dhe si nevojë për të njohur vuajtjet e diktaturës. Në të njëjtën kohë, janë ata të përndjekur që kanë ndërtuar një listë të madhe veprash për komunizmin, ku janë detyruar të punojnë si skllëvër në miniera, tharje kënetash dhe hapje kanalesh. Tarracat e Jugut nuk janë ndërtuar nga rinia, siç mburrej regjimi, ato i kanë ndërtuar kryesisht të përndjekurit politikë. Dëmshpërblimi është një borxh që shoqëria shqiptare ua ka këtyre shtresave në të gjitha këndvështrimet.

Përsëritës vendimin e Qeverisë për ngritjen e Institutit për Studimin e Krimeve të Regjimit Komunist. Në mënyrë urgjente ne duhet të instalojmë në kujtesën kombëtare të gjitha vuajtjet që kanë kaluar të burgosurit në diktaturë. Do të ishte e pafalshme që të gjitha këto vuajtje të harrohen.

Gjetja e eshtrave është një kampanë kujtese për ne, jo thjesht për të kujtuar ata që vuajtën dhe që nuk jetojnë më, por më shumë, për të shenjtëruar ato vlera pa të cilat një shoqëri nuk është njerëzore.

Falemnderit!

(Ndërkohë, drejtimin e seancës e ka marrë zoti Turku.)

Ardian Turku – Falemnderit, zoti Bumçi!

Zoti Spaho, urdhëroni!

Edmond Spaho – Falemnderit, zoti drejtues i seancës!

Para disa ditësh të gjithë u bëmë dëshmitarë të një prove tjetër të krimeve të regjimit komunist. Në periferi të Tiranës u gjet një varr i përbashkët i rreth 20 viktimave të shkatuara nga regjimi komunist. Ata ishin njerëz të ndershëm dhe të pafajshëm, të cilët regjimi i Enver Hoxhës i bëri tradhtarë dhe i pushkatoi.

Ngjarje të tilla, edhe pse kanë kaluar 20 vjet nga rënia e diktaturës, mbeten të rënda, si moralisht, edhe psikologjikisht. Të gjithë ata që kanë jetuar në atë periudhë, përpiqen të kuptojnë shkallën e terrorit.

Nga ngjarjet e ditëve të fundit, bie në sy qëndrimi fisnik i familjarëve të ish të përndjekurve, të cilët nuk kërkojnë hakmarrje, nuk kërkojnë gjyqe të personave që kanë marrë pjesë në pushkatime. Familjarët e viktimave të sistemit komunist as mendojnë të jenë pjesë e debateve për ligjin e lustracionit, sepse po ta bëjnë këtë duket sikur i imponohen shoqërisë me vuajtjet e tyre. Kërkesa e vetme e familjarëve të viktimave të komunizmit është të ndihmohen, të gjenden eshtrat e të pushkatuarve nga ky regjim.

Në diskutimet që pasuan zbulimin e varrezave masive, vura re se, pas 20 vjetëve, ndonjë zyrtar i kohës, që rrethanat e bënë kriminel, ka filluar të preket në ndërgjegje dhe të japë informacion se ku gjenden trupat e atyre që u pushkatuan. Kjo është gjysma e të keqes, se disa të tjerë, po t'u jepej kjo mundësi, do të fillonin të vrisnin nga e para.

Unë po jap një shembull, vrasjen e Liri Gegës. Gjatë kërkimeve për gjetjen e trupit të saj, të afërmve u ishte ofruar informacion nga një pjesëtar i togës së ekzekutimit, informacioni ishte mjaft i përafërt dhe zonja e justifikoi pjesëtarin e togës së pushkatimit, duke thënë se ofrojnë informacion me përafërsi, se nuk dëshirojnë të duken që kanë qenë pjesë e ekzekutimeve.

Për varrin e zbuluar ditë e fundit foli edhe Partia Socialiste. Ajo nuk mund të rrinte pa folur, për të treguar se nuk ka lidhje me të shkuarën dhe nuk është trashëgimtare e Partisë së Punës, nga gjaku i së cilës ka lindur. Gjuha që përdori PS-ja ishte standard. Ata fajësuan Partinë Demokratike dhe Sali Berishën për të vrarët e regjimit komunist, madje u shpreh keqardhje për të përndjekurit se nuk është bërë aq sa duhet, pavarësisht se etërit e atyre që janë sot në PS, dje jepnin dënime dhe pushkatonin njerëz të pafajshëm.

Nuk më habiti gjuha me të cilën foli PS-ja, por zonjusha që doli e foli si pinjolle e diktaturës prej nga i rrjedh në të vërtetë gjysma e origjinës. Po ky nuk është faji i saj. Nëse ka njerëz që duhen të ndihen të revoltuar ndaj atij regjimi kur zbulohet një varr i përbashkët i të vrarëve nga komunizmi, njëra nga ata duhet të ishte edhe zonjusha e PS-së, ngaqë është përfaqësuese e një brezi politikanësh të së majtës, të cilët nuk kanë lidhje me komunizmin dhe krimet e tij. Por ajo dhe disa nga kolegët e saj nuk ngurojnë të shkelin mbi çdo parim dhe normë morali për karrierën e tyre politike.

Zonjusha nuk duhet të pranonte të dilte e të fliste në emër të PS-së, sepse gjysma tjetër e saj është

e lidhur, qoftë edhe pa dëshirë, me një njeri të nderuar, të cilit diktatura jo vetëm i mori jetën, por ende nuk i janë gjetur eshtrat, si nuk u ishin gjetur 20 viktimave në varrin e sapozbuluar në periferi të Tiranës.

Ti zonjushë nuk duhet të flisje me gjuhën me të cilën fole, pavarësisht se je deputete e PS-së! Ti duhet të bashkosh zërin tënd me ne, për të gjetur edhe eshtrat e Vangjel Xhaçkës, familja e të cilit ka qenë më e persektuara në fshat, pasi duke u gjetur eshtrat e tij mbase qetësohet shpirtërisht njëri nga prindërit e tu! Nëse nuk e bën dot këtë, pasi nuk të lë ëndrra për karrige politike, së paku mbyll gojën dhe hesht! Ti nuk zgjodhe të heshtje, por fole me gjuhën e Edit. Turp për ty, pavarësisht se çfarë the dje! I afërmi yt mbetet njeri i nderuar në të gjithë Devollin, që komunizmi e vrau pa pasur faj.

Falemnderit!

Ardian Turku – Falemnderit, zoti Spaho!

Zoti Xhaferri, urdhëroni!

Ferdinand Xhaferri – Falemnderit, zoti drejtues i seancës!

Të nderuar kolegë deputetë,

Dje, në mbledhjen e Këshillit të Ministrave, Kryeministri i vendit shpalli vitin 2010 si viti i Nënë Terezës. Për të qenë më të qartë dhe më të saktë, Kryeministri do të theksonte se 100-vjetori i Nënë Terezës është kryengjarja e kombit shqiptar për vitin 2010.

Mendoj se ky është një lajm i mbarë për të gjithë shqiptarët kudo që ata jetojnë. Themi kështu, sepse Nënë Tereza ishte dhe është shqiptarja më e shquar e të gjitha kohërave. Nënë Tereza ishte dhe është shqiptarja më e madhe që ka njohur njerëzimi, për sa i takon numrit të atyre që e kanë pranuar dhe nderuar.

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë që po na ndiqni,

Në vitin 1979 Nënë Tereza do të merrte çmimin Nobel për Paqe dhe atëherë e gjithë bota mësoi se Nënë Tereza ishte shqiptare, por Shqipëria e asaj kohe heshtte. Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë nuk i kishte dhënë vizë Nënë Terezës që ajo të vinte të vizitonte nënën e saj këtu në Tiranë. Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë nuk i dha vizë Nënë Terezës as për të marrë pjesë në varrimin e nënës së saj në vitin 1974. Fshehja e imazhit, emrit dhe veprës së Nënë Terezës nga komunizmi dhe socializmi i atëhershëm shqiptar ishte po aq barbar, sa varrezat famëkeqe që u zbuluan ditë më parë në malin e Dajtit.

Pra, 100-vjetori i Nënë Terezës është edhe një mundësi për një reflektim dhe për një pendesë të thellë, sikurse mësonte edhe vetë Nënë Tereza.

Nënë Tereza ishte dhe është një krenari e ligjshme e Kalkutës, vendi ku ajo jetoi dhe punoi, nga ku mori edhe emrin e njohur “Nënë Tereza e Kalkutës”. Por mbi të gjitha Nënë Tereza ishte dhe është një krenari shqiptare, ajo simbolizon vetitë më të mira dhe më të arrira të gjenit shqiptar. Ajo është imazhi i vërtetë i shqiptarëve, pasaporta e tyre anembanë botës. Nënë Tereza është kryevepra më e madhe që shqiptarët i kanë dhënë njerëzimit dhe qytetërimit mbarëbotëror.

Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë edh Sporteve ka projektuar një gamë të gjerë aktiviteteve me rastin e 100-vjetorit të lindjes së saj. Këto aktivitete do të zhvillohen jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Kosovë, Maqedoni dhe në mbarë hapësirën ku jetojnë shqiptarët. Krahas memorialit që do të ngrihet në Tiranë, janë menduar aktivitete që do të zhvillohen çdo muaj.

Në muajin prill, kori dhe orkestra e Teatrit të Operës dhe Baletit do të japë një koncert në Katedralen e Tiranës dhe më pas në Prishtinë e Shkup. Në ambientet e Bibliotekës Kombëtare do të shfaqet një ekspozitë me dokumente për Nënë Terezën.

Në muajin maj do të jepet një shfaqje poetike në Teatrin Kombëtar, ku është menduar edhe një konferencë shkencore për figurën e Nënë Terezës.

Muaji qershor do të vazhdojë me një film kushtuar Nënë Terezës dhe me një ekspozitë pikturore. Në muajt korrik dhe gusht do të vijohet me Maratonën e Paqes, e cila do të ndjekë rrugëtimin Prishtinë - Shkup - Tiranë dhe do të ketë një panair libri me librat që i janë kushtuar figurës së Nënë Terezës.

Në ditën e 100-vjetorit të lindjes, më 26 gusht do të organizohet përurimi i shtatores së re të Nënë Terezës dhe do të ketë një koncert me muzikë klasike, ku do të ndahen çmime “Nënë Tereza” për të gjitha gjinitë e artit.

Kjo është vetëm një miniaturë e veprimtarive që janë menduar deri tani, sepse programi do të diskutohet dhe do të pasurohet më tej në mënyrë të vazhdueshme nga komisioni i posaçëm, nga bashkëpunimi me institucionet fetare, si edhe nga bashkëpunimi i ngushtë që do të vendosë me Prishtinën dhe me shqiptarët e diasporës.

Të nderuar kolegë,

Nënë Tereza ishte një figurë e madhe bashkuese dhe bashkëpunuese. Ne i ftojme të gjithë shqiptarët

të mendojmë së bashku për kremtimin sa më dinjitoz të këtij përvjetori të shenjtë të Nënë Terezës. Ftojme pushtetin lokal për një bashkëpunim sa më të ngushtë dhe frytdhënës.

Këtu dua ta mbyll me një thënie të Nënë Terezës: “E djeshmja iku, e nesërmja akoma s’ka ardhur, kemi vetëm të tashmen. Le t’ia fillojmë!”

Falemnderit!

(Ndërkohë, drejtimin e seancës e ka marrë zonja Topalli.)

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Xhaferri!

Zonja Paulina Hoti, urdhëroni!

Paulina Hoti – E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Fjalën time dua t’ua kushtoj atyre që vdiqën si njerëz; atyre që qëndruan si njerëz gjatë asaj periudhe të vështirë, në të cilën njeriu u shndërrua në kafshë pune. At Zef Pllumbi e titullon librin e tij “Rrno vetëm me tregue”, ai, i cili vetëm këtë qëllim i gjeti vetes për të jetuar, pasi pa dhjetëra e dhjetëra shokë të tij të dënuar me pushkatim, pasi pa dhe dëgjoi, ndjeu dhe pësoi vetë torturat e paimagjinueshme dhe të pamëshirshme.

Bashkë me të dua të bëj edhe unë këtë pyetje: Si është e mundur që njeriu i shekullit të 20-të, në kulmin e qytetërimit material, ishte aq barbar, sa një pjesë shqiptarësh u bënë viktime të një pjesë tjetër shqiptarësh? Si është e mundur që pjesa tjetër e shqiptarëve nuk u prek nga dhimbja, nga mundimet dhe nga qëndresa e vëllezërve të tyre?

Zbulimi i varrit masiv në afërsi të Dajtit është sa tronditës e lëndues, aq edhe alarmant e kërkues ndaj secilit prej nesh. Ka kaluar shumë kohë. 20 vjet janë shumë për të kërkuar e për të mos gjetur ende eshtrat e atyre që patën një shpirt të mbushur me vlera njerëzore. Është shumë për familjarët që i kërkojnë; është shumë për një komb që ende nuk e di se ku prehen rreth 6 mijë të ekzekutuar nga bashkëvëllezërit e tyre.

Të nderuar kolegë,

Ngjarja e fundit ka tronditur shumë prej nesh dhe ndërkohë që mundohemi të japim një shpjegim pse jemi kaq të vonuar, ndërkohë që hedhim ide dhe ndërmarrim iniciativa për të qetësuar veten dhe të tjerët në shlyerjen e një detyrimi madhor që i kemi këtij vendi, nuk mund të hesht kur shoh sesi Partia Socialiste ia lejon vetes të ngrejë gishtin e fajësisimit, pikërisht në këto momente të zbulimit të një fakti të pamohueshëm për të gjithë.

Nëpërmjet një deputeteje dhe jo me një qëndrim

të sajn, prandaj s'ka sesi të merret si *mea culpa*, Partia Socialiste në deklaratë për shtyp fajëson maxhorancën se po përdor kauzën e të përndjekurve politikë. Jo. Nuk është ky qëndrimi që presim nga Partia Socialiste. Nuk ka sens.

A thua nuk i mjaftuan 20 vjet Partisë Socialiste të ndërgjegjësohet dhe të pranojë pozicionin e saj në kalvarin e gjatë që i shkaktuan etërit e saj këtë popull? Më thoni ju, a nuk janë shumë 20 vjet?

Desha t'i kujtoj këtu zonjës Xhaçka se ndoshta e kishte harruar para se të dilte dje në konferencë për shtyp, se Partia Socialiste pati kurajën dhe paturpësinë të heshtë për sa kohë ishte në pushtet. Dhe heshtja nënkupton shumë.

Partia Socialiste, zonja Xhaçka, pati kurajën dhe paturpësinë të mos votojë rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë, më 30 tetor 2006, për dënimin e krimeve të kryera nga regjimi komunist në Shqipëri. Në kundërshtim me rezolutat e Këshillit të Europës, të asaj 1096 "Masat për të çrrënjësuar trashëgiminë e sistemeve totalitare komuniste" dhe asaj 1481 "Domosdoshmëria për dënimin ndërkombëtar të krimeve të regjimeve totalitare komuniste", Partia Socialiste pati kurajën dhe paturpësinë të kundërshtojë ligjin e lustracionit.

Ju, zonja Xhaçka, dhe kolegët tuaj keni kurajën dhe paturpësinë edhe sot të përshëndesni një vendim të padrejtë të Gjykatës Kushtetuese që lidhet me të përndjekurit politikë dhe më pas dilni në mbrojtje të kauzës së tyre.

A e kuptoni deri ku shkon hipokrizia juaj? Ç'domethënie ka heshtja juaj përballë rezolutave të Këshillit të Europës? Si i përktheni ju këto detyrime të Shqipërisë? Pse nuk bëni një reflektim publik si pasardhës të atyre që e shkaktuan këtë tragjedi njerëzore, në vend që të merreni me maxhorancën?

Fakti që ju guxonin të deklaroni kauzën e të përndjekurve politikë, kur plagët janë rihapur nga zbulimi i varrit masiv, a thua është fillimi i një kërkese faljeje publike në emër të prindërve tuaj biologjikë dhe partiakë?

Një pjesë e mirë e atyre që ne përfaqësojmë, kërkojnë t'i jepet fund situatës me kuptimet ndryshe të termave "hapje dosjesh", "pastrim figurash" e të tjera. Mjaft më me aludime dhe me interpretime që përveç se dëshmojnë një nivel të ulët moral, intelektual dhe njerëzor, fyejnë dhe cenojnë dinjitetin e atyre që dhanë jetën dhe vuajtën mizorinë e diktaturës komuniste. Politikanë, gazetarë, intelektualë, njerëz të thjeshtë dhe të gjithë ju që shprehni mendime rreth një periudhe që bart vuajtje

dhe jetë njerëzish të marra kot, është koha të dënojmë krimet e komunizmit!

Të nderuar kolegë,

Forca politike të cilës i përkasim është e vetmja forcë politike në vend që e ka luftuar deri më sot në mënyra të ndryshme kultin e harresës, mohimin e së kaluarës. Me iniciativën e Qeverisë, javës që vjen, do të ngrihet grupi i punës që do të merret me kërkimin dhe gjetjen e eshtrave të atyre që u ekzekutuan në mënyrë çnjerëzore. Kjo është një përbushje kërkese dhe premtimi ndaj asaj shtrese që na ka besuar rehabilitimin e saj moral.

Nga ana tjetër, deputetët e PD-së po punojnë me projektligjin për krijimin e Institutit të Kujtesës Kombëtare. Nëpërmjet këtij projektligji të paraqitur nga Këshilli i Ministrave ndihet detyrimi i shtetit për të siguruar akses publik maksimal për veprimtarinë sekrete të organeve të sigurisë së shtetit të regjimit komunist, si një shprehje e bindjes së plotë se veprimet antiligjore të çdo regjimi totalitar ndaj qytetarëve nuk mund të mbrohen nëpërmjet fshehjes, mbajtjes sekret apo harresës. Iniciativa të tjera ligjore të nevojshme do të ndërmerren për të kujtuar dhe respektuar shpirtin e rezistencës së qytetarëve shqiptarë në përpjekje për të mbrojtur të drejtat e njeriut dhe dinjitetin e tij.

Të nderuar kolegë,

Jemi i vetmi vend në Europë që njohëm një regjim të tillë barbar, jemi i vetmi vend të Europë që ende edhe sot nuk i kemi rehabilituar moralisht ata që e pësuan nga regjimi barbar. Nuk mund të ndërtohet një demokraci mbi harresën. Demokracia në Shqipëri nuk mund të ngrihet mbi varre masive, mbi varre të paidentifikuara, mbi varre të ekzekutuarish, vetëm e vetëm pse ata njerëz donin fjalën e lirë, pse besonin te Zoti, pse ëndërronin për vendin e tyre. Demokracia ka nevojë për një pajtim kombëtar dhe pajtimi kombëtar nuk mund të arrihet pa dënimin e krimeve të komunizmit.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit!

Urdhëroni, zoti Boçi!

Luçiano Boçi – E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar deputetë,

Jeta politike e këtyre muajve parlamentarë, krahas realiteteve optimiste të ofruara me maturi dhe mençuri nga koalicioni qeverisës, ka pasur vazhdimisht në qendër të saj një lajtmotiv tepër vanitoz, i cili ka lëvizur midis dy fjalëve me vlerë shumë relative, që janë Edvin Rama dhe kutitë.

I gjithë ky dualitet, i stisur me kujdes dhe i ofruar

si rastësor nga mjeshtrit e vjetër të propagandës, brenda të cilit çdo vlerë është kthyer me kokë poshtë dhe xhelati ka marrë pozicionin e viktimës, fsheh në vetvete një strategji dhe një qëllim aspak për t'u neglizhuar. Të mbyllur hermetikisht brenda këtij qëllimi, ata nuk kanë as veshë e as mend të dëgjojnë thirrjet tona të vazhdueshme për ardhjen në Parlament, as thirrjet e botës mbarë dhe as Kushtetutën e këtij vendi për lënien mënjanë të bojkotit, jo se ne dhe bota nuk bërtasim fort, por, sepse ato i kanë mbyllur veshët dhe mendjet, sepse ata nuk duan, sepse brenda tyre ka shumë "sepse".

Duke e servirur këtë artificë para opinionit publik si një luftë parimore për vlera të munguara, përfaqësuesit e këtij dueti janë munduar të marrin para opinionit pozën dhe rolin e kalorësve të demokracisë, duke u ngatërruar në këtë mënyrë me veten e tyre dhe me vetë historinë dhe duke harruar se janë kopja më e shëmtuar e kalorësve të vërtetë të viteve '90. Pamjes së vrerosur të tyre dhe qëllimeve të mbrapshta që bartin, më shumë se çdo përkufizim tjetër do t'u shkonte përcaktimi i thjeshtë "kalorës të apokalipsit".

Përtej asaj lumnafe fjalësh që ata servirin çdo ditë, herë me ngjyrat e ylberit dhe herë me intonacione të pafundme, që i ngajë më shumë se çdo gjëje tjetër britmës, e gjithë kjo stisje është munduar dhe mundohet të mbajë gjallë dhe të ruajë pozitën superiore të një kaste të caktuar në jetën politike shqiptare, të lartësojë antivlerat individuale, t'i thurë himne anarkisë, të hedhë baltë mbi gjithçka të bukur dhe të vërtetë, të bjerrë çdo pasion kombëtar, të mbysë çdo tendencë progresiste dhe zhvilluese.

E gjitha kjo është një përpjekje për të mbajtur gjallë atë që për shumë vjet ne, si shoqëri, si popull, jemi munduar ta besojmë se nuk ekziston, se është zhdukur, se është larguar nga ne, se nuk mund të vijë midis nesh, atë që Lamsberg, Kryeministri i Lituaniës, në vitin e afërt '91 e shprehu me fjalët goditëse "Komunizmi vdiq, por kufomën askush nuk ia ka parë". Të dehur nga liria, ne jo vetëm që nuk e pamë kufomën, por edhe e harruam, madje e lejuam që ajo të hedhë shtat dhe sot të shëtisë lirshëm midis nesh, duke na ofruar pa u turpëruar edhe leksione të pafundme demokracie. Dhe ligji dhe jo vetëm kaq, por ajo mundohet të ngjallë e të risjellë brenda nesh psikologjinë e ndeshjes dhe të luftës, të shkatërrimit dhe të përplasjes, duke u përpjekur të na ndajë në dy kampe absurde: në popull opozitar dhe popull pozitar, duke ndërtuar me kujdes

formacione vullnetare dhe fronte famëkeqe, duke u çjerrë për beteja finale, duke u betuar për moskthim prapa e duke mbledhur përreth vetes atë kastë politikanësh që për para nuk e kanë aspak vështirë të shesin edhe të atin.

U deshën 19 kufoma njerëzore që të gjithë ne si shqiptarë, dhe jo vetëm ne, të trandemi dhe të konturojmë dhe një herë në horizont ekzistencën e kësaj kufome ideologe, në formën e një rreziku permanent të përmbledhur qartë në fjalët alarm të Kryeministrit se demokracia nuk mund të flejë mbi varre.

Të nderuar deputetë,

Refleksioni që lind pas kësaj na shtyn natyrshëm përsëri drejt atyre iniciativave deri tani të penguara dhe të anatemuara. Domsdoshmërisht, në këtë rast shoqëria dhe politika e ka për detyrë të reagojë. Ky reagim, sigurisht, nuk mund dhe nuk duhet të jetë në formën e shfaqjes së një antikomunizmi sipërfaqësor, i cili barazon thjesht të qenit i persekutuar ose të qenit demokrat me të qenit antikomunist. Ai duhet të jetë saktësisht legal dhe social ose nëpërmjet formës së ligjit të dosjeve, ose nëpërmjet institucioneve përkatëse të propozuara këto ditë edhe nga Kryeministri. Kjo rrugë ligjore dhe e domosdoshme jo vetëm vë në vend një të drejtë historike, por njëkohësisht hedh dritë mbi veprime të sotme që e gjejnë bazën e frymëzimit të tyre në pellgjet e një antishqiptarizmi të kultivuar me ngulm nga grupe dhe individë famëkeq në të kaluarën. Vetëm kështu ne do të arrijmë të zhdukim nga horizonti kufomën penguese ideologe, e cila, pavarësisht kostumit të bukur me të cilin na paraqitet, mundohet me të gjitha mënyrat të devijojë rrugëtimin tonë drejt destinacionit të merituar. Vetëm kështu ne do të arrijmë të çmontojmë moralin aktual majtist, sipas së cilit shkatërrimi i mandateve, thënë ndryshe bojkoti, i shërben shkatërrimit të së ardhmes së këtij vendi dhe të montojmë atë moral që secili nga ne e aplikon çdo moment, sipas së cilit puna dhe kontributi ynë i përbashkët i shërben së ardhmes së këtij vendi.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Boçi!

Kalojmë te pika e dytë e rendit të ditës. Ka ndonjëri vërejtje për procesverbalin? Nuk ka. Falemnderit! Miratohet.

Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës: projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes me shkëmbim notash ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Japonisë për financimin

e projektit për përmirësimin e pajisjeve mjekësore të qendrave rajonale të emergjencës në Republikën e Shqipërisë”.

Urdhëroni, zoti Shehu, në emër të Komisionit të Shëndetësisë!

Tritan Shehu – Kjo është një marrëveshje e rëndësishme, sepse kërkon të përmirësojë shërbimin e urgjencës lëvizëse në territorin e Shqipërisë, në 14 rajone kryesore. Është një marrëveshje e rëndësishme, sepse koïncidon, gjithashtu, me reformat dhe ndryshimet e tjera të sistemit shëndetësor në fushën e urgjencës, pikërisht për të afruar shërbimin veçanërisht me të sëmurët në kushte urgjente.

E marrë bashkë me një marrëveshje të bërë me Qeverinë italiane për asetet teknike për shërbimet e urgjencës, marrëveshja në fjalë shërben për të modernizuar tërësisht këtë shërbim, i cili, për momentin lë shumë për të dëshiruar, por që kështu kërkon t'i afrohet standardeve europiane në shërbimin ndaj popullsisë.

Unë mendoj se të gjithë bashkë do ta votojmë këtë projektligj për të ratifikuar marrëveshjen.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Shehu!

Në emër të Komisionit të Ligjeve, zonja Trashani?

(Zonja Trashani shprehet dakord.)

Falemnderit!

Në emër të Komisionit të Politikës së Jashtme, zoti Oketa?

(Zoti Oketa shprehet dakord.)

Falemnderit!

Atëherë, kalojmë në mendimin e grupeve.

Në emër të Grupit Parlamentar të LSI-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të PD-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Kalojmë te projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas dhe të financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Kreditanstalt fur Wiederaufbau (KfW), Frankfurt am Main dhe Fondacionit “FEFAD” për projektin “Promovimi i SME-ve”.

Në emër të Komisionit të Ekonomisë, zonja Vokshi.

Albana Vokshi – Falemnderit, zonja Kryetare!

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas dhe të financimit ndërmjet Republikës së

Shqipërisë, Kreditanstalt fur Wiederaufbau (KfW), Frankfurt am Main dhe Fondacionit “FEFAD” për projektin “Promovimi i SME-ve”, bazohet në marrëveshjen qeveritare të ratifikuar me anë të ligjit nr. 9672, datë 29.12.2006 midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë.

Që nga viti '98, vit në të cilin filluan marrëdhëniet midis dy vendeve, Gjermania ka dhënë rreth 800 milionë euro për Shqipërinë dhe më shumë se 50% e tyre implemntohen nga KfW. Sektorët kryesorë në të cilët orientohet kjo asistencë janë furnizimi me ujë të pijshëm, menaxhimi i ujërave të zeza, rrugët rurale, mbrojtja e mjedisit, energjetika etj.

Një nga projektet më të rëndësishme të këtij bashkëpunimi është edhe ai, marrëveshja e të cilit po shqyrtohet sot, me vlerë monetare prej 6 milionë euro në total, 2,6 milionë euro në fazën e parë dhe 3,4 milionë euro në fazën e dytë. Kjo kredi shoqërohet me një grant prej 210 mijë eurosh që do të përdoret për këshillim dhe asistencë teknike. Qeveria gjermane i jep kështu Qeverisë shqiptare një kredi të butë me një afat 40 vjet, periudhë falas 10 vjet dhe më një interes 7,5% në vit, e cila do t'i nënhuazohet agjencisë zbatuese me terma po kaq të buta. Kjo kredi do të përdoret për rëfinancimin e huave të dhëna ndërmarrjeve shumë të vogla, të vogla dhe të mesme. Fondet që kthehen në agjencinë e zbatimit si pagesë e nënhuave do të përdoren në mënyrë qarkulluese.

Arsyeja pse fondi prej 2,6 milionë euro ende nuk është implementuar është se ai kaloi nga Fondi Europian për Europën Juglindore, EFSE dhe u kanalizua përmes ProCredit Bankës. Fillimisht, ky fond ishte i orientuar vetëm në sektorin e eficiencës së energjisë, në mënyrë që të promovoheshin masa për kursimin e energjisë, si dhe projektet e energjisë së rinovueshme. Ndërkohë, në protokollin e fundit, me kërkesë të palës shqiptare, bazuar në prioritet e vendit, mund të financohen edhe SME-të në sektorin bujqësor dhe agrobiznes. KfW-ja ka aplikuar në mënyrë të suksesshme linja të tilla krediti në disa vende të Ballkanit. Përderisa kjo marrëveshje është në një linjë me prioritet e Qeverisë për sektorin e energjisë, të bujqësisë dhe të sektorit rural, unë do t'ju kërkoja që kjo marrëveshje të miratohej.

Falemnderit!

Jozefina Topalli - Falemnderit!

Atëherë kalojmë në mendimin e grupeve.

Në emër të Grupit Parlamentar të LSI-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të PD-së?
(*Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.*)
Falemnderit!

Kalojmë te projektligji tjetër “Për ratifikimin e statutit të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë së Rinovueshme, IRENA”.

Në emër Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, zoti Bano, urdhëroni!

Ilir Bano – Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë së Rinovueshme u themelua në janar të vitit 2009, në një mbledhje ku morën pjesë më shumë se 200 vende anëtare të OKB-së dhe ku u miratua edhe statuti i saj. Kjo agjenci ka si objekt këshillimin dhe mbështetjen e vendeve në zhvillim dhe atyre të industrializuara, në kuadër të zgjerimit të përdorimit të energjisë së rinovueshme si edhe krijimin e një rrjeti të një bashkëpunimi të qëndrueshëm të të gjitha organizatave qeveritare ose jo, të cilat veprojnë në fushën e energjisë. Kjo agjenci synon nxitjen e zbatimit të gjerë dhe intensiv, si edhe përdorimin e qëndrueshëm të të gjitha formave të energjisë së rinovueshme. Gjithashtu, në kuadër të debatit për klimën dhe energjinë, IRENA synon të japë ekspertizë ndërkombëtare për promovimin e energjisë së rinovueshme, të cilat, sikurse dihet, janë energji të pastra për mjedisin.

Në statutin e kësaj energjie janë përcaktuar qartë përgjegjësitë dhe kompetencat e saj, si: krijimi i sistemit institucional ndërkombëtar në fushën e politikës për energjinë, krijimi i politikës energjetike, studimi i teknologjisë së energjive të rinovueshme studimi i konteksteve kombëtare dhe ndërkombëtare specifike, i problemeve financiare etj. Në statut janë përcaktuar edhe organet kryesore të agjencisë, si asambleja, këshilli dhe sekretariati i saj.

Deputetët e Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, duke siguruar mbështetjen për çdo nismë që ka të bëjë me promovimin e energjive të rinovueshme, të cilat, sikurse e thashë më lart, janë miqësore ndaj mjedisit, u shprehën dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

Ju falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Bano!

Zoti Gumi, në emër të Komisionit të Ligjeve, urdhëroni!

Viktor Gumi - Falemnderit, zonja Kryetare!

Në përputhje me kalendarin e punimeve të Kuvendit, edhe Komisioni për Çështjet Ligjore mori në shqyrtim projektligjin e datës 07.12.2009.

Projektligji që paraqitet për shqyrtim dhe miratim

në seancë plenare është në përputhje me Kushtetutën, si dhe respekton detyrimet e ligjit “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”.

Në përfundim, Komisioni i Ligjeve vendosi unanimisht t’i propozojë seancës plenare miratimin e tij, pa ndryshime.

Falemnderit!

Jozefina Topalli - Falemnderit!

Zoti Oketa, urdhëroni!

Gazmend Oketa - Falemnderit, zonja Kryetare!

Edhe Komisioni për Politikën e Jashtme, në mbledhjen e tij të datës 23 nëntor 2009, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e statutit të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë së Rinovueshme”.

Shqipëria e ka nënshkruar këtë marrëveshje në qershor të 2009-ës në Gjermani dhe objektivi kryesor i IRENA-s (që është emri i agjencisë dhe jo ndonjë emër tjetër) është sigurimi i këshillave praktike dhe mbështetja për vendet në zhvillim dhe vendet e industrializuara.

Në përfundim të mbledhjes dhe shqyrtimit të këtij projektligji, të gjithë anëtarët e komisionit u shprehën dakord për miratimin e tij dhe besoj se do të miratohet edhe në seancë plenare.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Oketa!

Në emër të grupit parlamentar të LSI-së?

(*Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.*)

Në emër të grupit parlamentar të PD-së?

(*Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.*)

Kalojmë te projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Saudit për Zhvillim, për financimin e projektit “Ndërtimi i rrugës së mbikalimit të Durrësit.”

Në emër të Komisionit të Ekonomisë?

(*Përfaqësuesi i komisionit shprehet dakord.*)

Në emër të Komisionit të Ligjeve?

Urdhëroni, zoti Halimi.

Eduard Halimi – Falemnderit, zonja Kryetare!

Komisioni i Ligjeve mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Saudit për Zhvillim, për financimin e projektit “Ndërtimi i rrugës së mbikalimit të Durrësit” dhe pasi e pa atë në përputhje me nenin 121 të Kushtetutës, ia kalon seancës plenare për miratim, pa asnjë vërejtje.

Jozefina Topalli - Në emër të Komisionit të Politikës së Jashtme?

(*Përfaqësuesi i komisionit shprehet dakord.*)

Falemnderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LSI-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Në emër të Grupit Parlamentar të PD-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Meqenëse në emër të Grupit Parlamentar të PD-së më është kërkuar pushim, do të bëjmë një ndërprerje prej pesë minutash.

(Pas pushimit)

Jozefina Topalli - Zotërinj deputetë, rifillojmë seancën.

Hapim votimin për prezencën.

Mbyllim votimin.

Janë 72 deputetë të pranishëm.

Kalojmë te votimi i projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes me shkëmbim notash ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Japonisë për financimin e projektit për përmirësimin e pajisjeve mjekësore të Qendrave Rajonale të Emergjencës në Republikën e Shqipërisë".

Hapim votimin në parim me elektronikë.

Mbyllim votimin.

Janë 72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton në parim projektligjin.

Kalojmë te votimi nen për nen me karton.

Kush është dakord me nenin 1? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2? Falemnderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Hapim votimin në tërësi me elektronikë.

Mbyllim votimin.

Janë 72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miratoi edhe në tërësi projektligjin "Për ratifikimin e marrëveshjes me shkëmbim notash ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Japonisë për financimin e projektit për përmirësimin e pajisjeve mjekësore të Qendrave Rajonale të Emergjencës në Republikën e Shqipërisë".

Kalojmë te votimi i projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë dhe të financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Kreditanstalt fur Wiederaufbau (KfW), Frankfurt am Main dhe Fondacionit FEFAD për projektin "Promovimi i SME-ve".

Hapim votimin në parim me elektronikë.

Mbyllim votimin.

Janë 72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton në parim projektligjin.

Kalojmë te votimi nen për nen me karton.

Kush është dakord me nenin 1? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2? Falemnderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Hapim votimin në tërësi me elektronikë.

Mbyllim votimin.

Janë 72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton edhe në tërësi projektligjin "Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë dhe të financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Kreditanstalt fur Wiederaufbau (KfW), Frankfurt am Main dhe Fondacionit FEFAD për projektin "Promovimi i SME-ve".

Kalojmë te votimi i projektligjit "Për ratifikimin e statutit të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë së Rinovueshme (IRENA)".

Hapim votimin në parim me elektronikë.

Mbyllim votimin.

Janë 72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton në parim projektligjin.

Kalojmë te votimi nen për nen me karton.

Kush është dakord me nenin 1? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2? Falemnderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Hapim votimin në tërësi me elektronikë.

Mbyllim votimin.

Janë 72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton edhe në tërësi projektligjin "Për ratifikimin e statutit të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë së Rinovueshme (IRENA)".

Kalojmë te votimi i projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Saudit për Zhvillim për financimin e projektit "Ndërtimi i rrugës së mbikalimit të Durrësit".

Hapim votimin në parim me elektronikë.

Mbyllim votimin.

Janë 72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton në parim projektligjin.

Kalojmë te votimi nen për nen me karton.

Kush është dakord për nenin 1? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord për nenin 2? Falemnderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Hapim votimin në tërësi me elektronikë.

Mbyllim votimin.

Janë 72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton edhe në tërësi projektligjin "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Saudit për Zhvillim për financimin e projektit "Ndërtimi i rrugës së mbikalimit të Durrësit".

Kalojmë te votimi i projektligjit të seancës së kaluar: "Për Autoritetin e Aviacionit Civil".

Hapim votimin në parim me elektronikë.

Mbyllim votimin.

Janë 72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton në parim projektligjin.

Kalojmë te votimi nen për nen me karton, duke marrë parasysh vërejtjet dhe amendimet e sjella nga Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Kush është dakord me nenin 1? Falemnderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2? Falemnderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 3? Falemnderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 4? Po, zoti Metalla.

Osman Metalla – E mora fjalën për të bërë unifikimin e termave në përputhje me Kodin Ajror të Republikës së Shqipërisë. Pra, nëse në nenin 4 të ligjit thuhet se autoriteti është person juridik publik, sipas Kodit Ajror të Republikës së Shqipërisë përcaktohet që autoriteti është ent publik. Pra, fjalët "person juridik publik" të zëvendësohet me fjalët "ent publik", në përputhje me ligjin nr.10040, datë 22.12.2008 "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë".

Falemnderit!

Jozefina Topalli - Falemnderit!

Po, zoti Gjana.

Jemin Gjana – Natyrisht që mund të bëhet një përputhje me kodin, sepse pa qenë i përputhur me të nuk ka ku të shkojë, sepse ligji është rrjedhojë e kodit, megjithatë edhe varianti që ka ardhur është "ent publik jobuxhetor". Kështu është e shkruar tek ai projektligj që ka paraqitur Këshilli i Ministrave dhe ne kemi mbajtur po të njëjtin qëndrim. Në qoftë se qëndrimi duhet të ndryshojë, për t'i vënë atë emërtim që është *mot- a- mot* te Kodi Ajror, le të mbetet ai

që është te Kodi Ajror.

Jozefina Topalli - Falemnderit, zoti Gjana!

Urdhëroni, zoti Bode!

Ridvan Bode – Kjo është një çështje juridike dhe nuk ka të bëjë me diskutimet e kësaj natyre. Besoj se edhe juristët mund ta shohin. Statusin juridik të shoqërive tregtare e përcakton ligji "Për shoqëritë tregtare". Në atë ligj nuk ka ent publik, por person juridik publik dhe ashtu është e shënuar në ligjin e tanishëm, atë që po miratojmë, pra e përcakton si person juridik publik, nuk ka ente publike dhe ente private.

Jozefina Topalli – Kështu është e shkruar.

Ridvan Bode – Po. Unë mendoj se është korrekt ashtu siç është shkruar në ligj.

Jozefina Topalli - Pra, jeni dakord me zotin Gjana.

Urdhëroni, zoti Olldashi!

Sokol Olldashi – Falemnderit, zonja Kryetare!

Pa dashur të hyj në anën teknike të diskutimit, problemi është se ne kemi zgjedhur një ligj që përputhet me Kodin Ajror dhe ky kod njih këtë togfjalësh. Unë bie dakord me variantin që propozohet nga kryetari i Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin që të jetë ent publik dhe jo buxhetor, por neve na duhet përputhshmëria me Kodin Ajror. Kodi Ajror, pavarësisht se ka një ligj "Për shoqëritë tregtare", që njih personin juridik, ka një definicion tashmë të miratuar dhe njih entin publik. Neve na duhet të përputhemi me kodin, nuk na duhet të përputhemi me shoqëritë tregtare.

Jozefina Topalli - Pra, do ta lëmë kështu siç është. Nuk e kuptoj pse e keni hequr paragrafin e dytë.

Zoti Ministër, jeni dakord me heqjen e paragrafit të dytë që i është bërë nenit 4? Dakord.

Jeni dakord me nenin 4, bashkë me vërejtjet e Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord për nenin 5? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord për nenin 6? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord për nenin 7? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

(Vazhdon e njëjta procedurë votimi për nenet 8-13)

Kush është dakord për nenin 14, sipas variantit të Qeverisë? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord për nenin 15, bashkë me vërejtjet e komisionit? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord për nenin 16, sipas variantit të Qeverisë? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord për nenin 17, bashkë me vërejtjet e komisionit? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 18? Falemnderit! Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 19, bashkë me vërejtjet e komisionit? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 20, sipas variantit të Qeverisë? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 21? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 22? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

(Vazhdon e njëjta procedurë votimi për nenet 23-27)

Kush është dakord me nenin 28? Urdhëroni, zoti Metalla!

Osman Metalla - Në pikën 3 të nenit 28, thuhet: "Nëpunësit e DPAC-së që nuk rekrutohen nga autoriteti dhe nuk sistemohen në një punë tjetër për 2 vjet përfitojnë pagën mujore sipas funksionit që kanë kryer vitin e fundit." Ne propozojmë të riformulohet në këtë mënyrë: "Punonjësve të DPAC-së, të cilët nuk rekrutohen nga Autoriteti i Aviacionit Civil për shkak të papërshtatshmërisë me pozicionin e punës ose nuk pranojnë pozicionin e ri të punës sipas strukturës së Autoritetit të Aviacionit Civil, do t'u zgjidhet kontrata e punës në përputhje me Kodin e Punës".

Jozefina Topalli - Për cilën pikë e keni fjalën? **Osman Metalla** – Për nenin 28, pika 3.

Jozefina Topalli - Dakord. Këshilltarët i kanë mbajtur shënim ndryshimet? Falemnderit!

Zoti Gjana? *(Shprehet dakord)* Falemnderit!

Atëherë, kush është dakord me nenin 28? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 29? Falemnderit! Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 30? Falemnderit! Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 31? Falemnderit! Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Hapim votimin në tërësi me elektronikë.

Mbyllim votimin.

Falemnderit!

72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton edhe në tërësi projektligjin "Për Autoritetin e Aviacionit Civil."

Kalojmë te pika e fundit e rendit të ditës: interpelancë me ministren e Integritit, kërkuar nga deputetja Albana Vokshi.

Zonja Vokshi, urdhëroni!

Albana Vokshi – Falemnderit, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Integrimi në BE jo vetëm për ne që ndodhemi sot në këtë sallë Parlamenti, por për rreth 96% të shqiptarëve përbën modelin më të mirë, synimin dhe destinacionin final të Shqipërisë. Suksesi i demokracive të vendeve të Europës Perëndimore vazhdon të mbetet një frymëzim për arritjen e vlerave dhe standardeve më të mira dhe për një zhvillim progresiv të shpejtë më cilësor dhe më tërësor.

Për këtë arsye jo vetëm Qeveria, por të gjithë ne, duhet të jemi të angazhuar për ecjen me hapa të sigurt dhe ritme të përshpejtuara të proceseve integruese, me synimin e përgatitjes për anëtarësim të Shqipërisë brenda mandatit 4-vjeçar të kësaj qeverisjeje dhe sigurimin e lëvizjes së lirë të shqiptarëve në hapësirën Shengen brenda vitit të parë të mandatit.

Në rrugën e gjatë të integritit janë bërë shumë hapa të rëndësishëm, por mbetet edhe shumë për të bërë. Kështu, më 1 prill 2009 hyri në fuqi Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, pika e orientimit për reformat që do të ndërmerren në katër vjetët e ardhshme të qeverisjes. Më 28 prill 2009 Shqipëria

depozitoni në Pragë aplikimin për anëtarësim pranë Presidencës çeke, kërkesë e shoqëruar me një sërë arritjesh dhe rezultatesh që dëshmojnë se procesi i integritetit është i pandalshëm dhe se shqiptarët janë të vendosur për të respektuar të gjitha angazhimet për anëtarësim. Më 16 nëntor 2009 Këshilli i Ministrave të BE-së shqyrtoi kërkesën e Shqipërisë për statusin e kandidatit për vend anëtar dhe e miratoi atë në mënyrë unanime në bazë të nenit 49 të Traktatit të BE-së dhe ia kaloi këtë kërkesë KE-së për përgatitjen e pyetësorit për autoritetet shqiptare.

Ky vendim unanim i ministrave të jashtëm është vendimi historik më i rëndësishëm për Shqipërinë dhe vlerësimi më i madh që i është bërë demokracisë shqiptare. Ky vendim vërtetoi edhe një herë se në zgjedhjet e 28 qershorit u kapërcye me sukses prova për përkushtimin ndaj vlerës së votës së lirë, që mandatoi vazhdimin e reformave të procesit në rrugën e integritetit.

Më 16 dhjetor 2009 Shqipërisë iu dorëzua zyrtarisht pyetësori për të vlerësuar aplikimin e vendit dhe për t'u anëtarësuar në BE. Ky është ushtrimi më i rëndësishëm në procesin e integritetit, pasi nevojitet për të përcaktuar sa e gatshme është Shqipëria për të përmbushur detyrimet e anëtarësimit në BE. Përgjigjet shërbejnë si bazë për opinionin që Këshilli Europian do të përgatisë mbi aplikimin për anëtarësim që iu dorëzua në datën 28 prill 2009 dhe është përcaktuar si detyra më e vështirë që kërkon përkushtimin e të gjitha segmenteve të administratës publike.

Në këtë fazë çdo institucioni i kërkohet të raportojë rregullisht e mbi të gjitha me vërtetësi, përgjegjësi dhe saktësi për çdo detyrim të plotësuar ose që është në proces. Plotësimi i pyetësorit të KE-së është një sfidë e vërtetë për administratën shqiptare. Për koordinimin e punës së kësaj faze, Ministria e Integritetit Europian ka rolin kryesor dhe vendimtar. Për këtë arsye kam kërkuar këtë interpelancë me zonjën Majlinda Bregu, ministre e Integritetit Europian, për të na dhënë informacion mbi ecurinë e procesit të plotësimit së pyetësorit, si edhe për disa çështje të tjera të cilat mendoj se janë të rëndësishme për t'u trajtuar.

Pyetësori do të japë informacione për gatishmërinë e Shqipërisë për të adaptuar të ashtuquajturat *acqui communautaire*, për të cilat është rënë dakord. Ato nuk janë të negociueshme, por duhen plotësuar përgjigjet, që të jenë të gatshme në mars të vitit 2010. Do të ishte me interes që të

informoheshin në lidhje me gjendjen e këtij procesi. Si po organizohet puna? Cilat janë strukturat drejtuese të procesit? Sa janë të involvuar ministrat e linjës në këtë proces, për të siguruar cilësinë dhe saktësinë e tyre? Sa kapituj janë përfunduar dhe sa janë në proces? A do të arrihet afati i premtuar prej 3 muajsh? Si do të arrihet saktësia dhe cilësia sa më e lartë e pyetjeve? Cili do të jetë forumi më i lartë, i cili do të shqyrtojë, sigurojë cilësinë e përgjigjeve dhe do të miratojë pyetësorin para se të dorëzohet?

Çështja e dytë. Shqipëria, duke qenë një vend kandidat potencial që aspron për t'u anëtarësuar në BE, përfiton vetëm nga dy komponentët e parë të asistencës së BE-së. Ndërkohë që në tre komponentët e tjerë: zhvillimin rajonal, zhvillimin e burimeve njerëzore dhe zhvillimin rural, do të ketë akses vetëm kur të jepet statusi i vendit kandidat. Ajo që duhet theksuar është që me aksesin në këta komponentët të IPA-s, asistencë e BE-së për Shqipërinë do të rritet ndjeshëm, prandaj Shqipëria duhet të përgatitet për këta komponentë. Do të ishte me interes të dinim disa nga konkluzionet dhe rekomandimet e misionit të lartë që vizitoi vendin tonë në datat 18 dhe 19 janar, cilat qenë rekomandimet e tij, në mënyrë që Shqipëria të jetë e gatshme për të përfituar dhe absorbuar sa më shumë fonde.

Për t'u përgatitur për absorbimin e fondeve të IPA-s, disa vende kanë hartuar dhe dokumentin e planifikimit strategjik, i cili do të sigurojë një kuadër reference për programet operacionale, nënkomponentët e zhvillimit rajonal dhe zhvillimit të burimeve njerëzore. Në shumë raste ky dokument është quajtur "Kuadri Kombëtar Strategjik" dhe është një dokument i qeverisë, i cili nuk ka nevojë të miratohet nga Komisioni Europian, por që përgatitja e tij mund të jetë një nga kushtet për fillimin e negociatave.

Në këto kushte: A do të fillojë përgatitja e këtij dokumenti të rëndësishëm nga ana e Qeverisë shqiptare? A është përcaktuar se cili do të jetë koordinatori strategjik dhe institucioni koordinues për përgatitjen e tij? A është e gatshme Shqipëria që Qeveria të përgatisë brenda një kohe të shkurtër këtë kuadër strategjik? Cilat do të jenë ministratë e linjës që do të përbëjnë strukturat operuese në secilin komponent, apo institucionet e specializuara që duhen konsideruar për implementimin e projekteve?

Çështja e katërt. Cili është statusi i strukturës

përkatëse në Ministrinë e Financave, e cila pritet të akreditohet, që është një tjetër kusht për hapjen e negociatave? Qëllimi i këtij procesi, siç e dimë, është rritja e nivelit të zotërimit të pronësisë dhe secili vend kandidat potencial t'i përdorë vetë fondet e BE-së.

Çështja e pestë. Procesi i integritit europian kërkon një administratë të konsoliduar, profesionale, efikase dhe të aftë për të përballuar presionin e axhendës ambicioze. Nga eksperiencia e vendeve të tjera duket se kompleksiteti dhe nevojat për staf, sasi dhe cilësi, zakonisht, nënvlerësohen nga ana e qeverive të këtyre vendeve. Në këtë kuadër: A e ka marrë parasysh Qeveria shqiptare këtë kosto apo faturë relativisht të madhe financiare? Cila do të jetë strategjia e saj që stafi, i cili trajnohet, të rrijë në vend? A ka donatorë që po kontribuojnë në këtë drejtim? A do të përdoren fonde nga komponenti i parë i IPA-ës për këtë qëllim?

Çështja e gjashtë është ajo e përgatitjes së projekteve të gatshme për financim në kuadër të projekteve të ndryshme të IPA-s, në mënyrë që projektet të financohen duke u siguruar cilësia e tyre. Pra, duhen përmbushur standardet e kërkuara. Po ashtu përputhja me *acqui relevante* zakonisht është e vështirë dhe përgatitja e projekteve merr një kohë relativisht të gjatë. Në këtë kuadër do të ishte me interes të dinim nëse Qeveria ka projekte apo mundësi përgatitje për projekte të faturuara.

Në fund, sipas mendimit tuaj, cilat do të ishin elementet kyç të suksesit apo të mospjesëmërisë të këtij procesi kaq të rëndësishëm?

Falemnderit!

(Ndërkohë, drejtimin e seancës e ka marrë zoti Turku.)

Ardian Turku – Falemnderit, zonja Vokshi!

Zonja Bregu, urdhëroni!

Majlinda Bregu – I nderuar zoti drejtues i seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

E nderuar zonja Vokshi,

Falemnderit për mundësinë e kësaj interpelance, e cila besoj që është një moment i vlerësimit dhe i transparencës së plotë për momentin në të cilin ndodhet procesi i integritit dhe për të gjitha sfidat tona të përbashkëta, në të cilat kërkohet kontributi i të gjithëve, edhe kontributi i opozitës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Tashmë është një fakt i njohur që, pas zgjedhjeve parlamentare të 28 qershorit, të cilat konsideroheshin si kushti kryesor për të vazhduar

me reformat integruese të vendit drejt BE-së, në momentin kur këto zgjedhje u certifikuan si zgjedhjet më të mira dhe në përmbushje të standardeve ndërkombëtare, vendet anëtare të BE-së, në mënyrë unanime, vendosën t'i hapnin rrugën dhe dritën jeshile marrjes në shqyrtim të aplikimit të Shqipërisë për anëtarësim, i cili u krye në prill të këtij viti.

Kështu, në datën 16 nëntor 2009, Këshilli i BE-së vendosi të merrte parasysh kërkesën e Shqipërisë për anëtarësim në BE, duke i kërkuar KE-së të përgatiste instrumentin zyrtar me të cilin certifikohet ecuria e një vendi në proces, që është pyetësi, me anë të të cilit vlerësohen reformat e ndërmarra të një vendi, gatishmëria e tij për të përballuar reformat e tjera dhe njëkohësisht për të përballuar detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi. Në fund të të gjithë këtij procesi, mendimi, apo ajo që njihet në gjuhën e Brukselit *avi-a*, bën të mundur që vendi të kalojë dhe të procedojë më tej në fazën e marrjes së statusit të vendit kandidat dhe më pas në hapjen e negociatave për anëtarësim. Në parantezë më duhet të them, për të mos e përsëritur më pas, ne shpresojmë që marrja e statusit të vendit kandidat për Shqipërinë të mos ketë vonesë.

Për sa i përket pjesës së përgatitjeve dhe fazës në të cilën ndodhet Ministria e Integritit, njëkohësisht edhe të gjitha institucionet shqiptare, ju e dini që në datën 16 dhjetor 2009 ka mbërritur një material voluminoz prej 2280 pyetjesh nga Komisioni Europian, të cilat në 35 kapituj të tyre kërkojnë informacion të detajuar mbi kriteret politike, ekonomike, standardet europiane, të drejtat e njeriut, respektimin e lirisë së medias dhe një sërë çështjesh të tjera.

Në fakt, puna për të përmbushur këtë detyrim të rëndësishëm, i cili është i pari (asnjëherë nuk ka ndodhur që administrata shqiptare të përfshihet në një proces të tillë të detajuar të vlerësimit të atyre se çfarë ka bërë, por edhe se çfarë pret dhe çfarë iniciativash e nismash do të marrë në të ardhmen), është paraprirë dhe ka nisur jo në vitin 2009, në momentin kur mbërriti pyetësi, por një vit më parë, në vitin 2008, kur Ministria e Integritit u angazhua në trajnime dhe informim të stafit të administratës, nëpunësve civilë për procesin e pyetësorit, trajnime të cilat u kryen gjatë vitit 2008, gjatë vitit 2009, duke theksuar trajnimet e herëpashershme të administratës publike, të cilat krijuan database-in kryesor të nëpunësve civilë të përfshirë në proces. Në shtatorin e vitit 2009, në fazën parapërgatitore, kur e gjithë administrata shqiptare u prezantua me

një model të pyetësorit të BE-së dërguar njërit prej vendeve fqinje, trajnimet u intensifikuan dhe mënyra e organizimit filloi të ishte edhe më intensive.

Gjatë gjithë kësaj faze u identifikuan nëpunësit civilë, nga të cilët 411 kishin qenë pjesëmarrës në trajnimet intensive të administratës publike. Dhe në fund, deri në muajin dhjetor, u identifikuan 800 nëpunësit civilë të cilët do të ishin përgjegjësit kryesor për përgjigjen e pyetjeve të pyetësorit të BE-së.

Sot, në muajin shkurt, ne kemi 1200 nëpunës të administratës shqiptare, përdorues apo *users* në portalin elektronik të përgjigjes së pyetjeve të pyetësorit, të cilët janë të angazhuar në këtë proces. Po gjatë fazës parapërgatitore u përgatitën një sërë materialesh, u identifikuan 52 përkthyesit shqiptarë më të mirë dhe njëkohësisht u pajisën me një sërë dokumentesh, të cilat do të ishin bazë për punën e tyre, sikurse ishte fjalori dhe termat bazë të përcaktuara dhe në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit.

Sot, numri i përkthyesve nga 52 është 67, të cilët janë duke punuar të ndarë sipas institucioneve, në bazë të ekspertizës së tyre dhe, sigurisht, nga ta pritët që të përkthejnë minimumi jo më pak sesa 12 mijë apo 13 mijë faqe, përgjigje bashkë me shtojca.

Njëkohësisht, në këtë proces, në mënyrë që të gjithë të kishim përgjigje unanime, të paktën në formatin e tyre, Ministria e Integritimit përcaktoi një metodologji të punës nisur dhe bazuar në eksperiencat e vendeve fqinje, të cilat e kanë kaluar këtë proces para nesh dhe njëkohësisht u përcaktua dhe e gjithë baza ligjore që nga urdhrat e Kryeministrit dhe mendimet të cilat përcaktuan modalitetet e shqyrtimit të përgjigjeve të këtyre pyetjeve dhe mënyrën institucionale të funksionimit në këtë proces. Sot janë 60 institucione të identifikuar, të cilat kanë punuar në dhënien e përgjigjeve të pyetjeve të pyetësorit.

Në muajin shtator të gjitha institucioneve iu kërkua që, përpara se të paraqisnin buxhetin e tyre vjetor, të buxhetonin shpenzimet që do t'u duheshin qoftë për shpenzime shtesë apo për stafin. Unë kam raportuar edhe në seancën e buxhetit se Ministria e Integritimit mori nga buxheti një shumë prej 300 mijë eurosh për procesin e përkthimit të pyetësorit dhe, njëkohësisht, fondi që u përlogarit në bashkëpunim me Ministrinë e Financave u akordua pranë institucionit.

Kanë qenë të përfshirë në këtë proces 28

ekspertë të huaj nga vendet anëtare të BE-së, të cilët kanë ndihmuar në fazën e parë të parapërgatitjes, të trajnimit të stafit, identifikimit të nëpunësve dhe, njëkohësisht, të ndarjes së pyetjeve. Sot i gjithë procesi është i kontrolluar në mënyrë elektronike nëpërmjet portalit, i cili u ngrit dhe u ndërtua nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, AKSHI, kontributi i së cilës për të lënë gjurmën dhe rekordin *online* të procesit, sigurisht që është për t'u vlerësuar.

Për sa i përket fazës në të cilën ndodhemi tani, grupet ndërinstitucionale të punës kanë zhvilluar mbi 150 takime dhe për momentin ne kemi vetëm 15 përgjigje, të cilat janë në fazë rishikimi. Pra, nga 2280 pyetje, më shumë se 90%, janë depozituar në Ministrinë e Integritimit. Në fakt, kalendari që ne kishim përcaktuar është respektuar në pjesën më të madhe. Kjo nuk do të thotë se kjo është një fazë në të cilën ne kemi kryer të gjithë procesin, por është faza më e rëndësishme, pasi është faza e rishikimit.

Në përgjithësi, të gjitha institucionet kanë respektuar metodologjinë e hartuar dhe ka përgjigje në proces të cilat kanë pasur vështirësi në hartimin e tyre ose pyetje që kanë pasur përgjigje më të vështira për t'u hartuar, sepse i gjithë seti i pyetjeve dhe përgjigjeve ndahet në tri kategori:

- Përgjigje të cilat kërkojnë informacion mbi pikësynime afatgjata të Qeverisë shqiptare, të cilat kërkojnë edhe ndërtimin e një ministritë, siç janë për shembull pyetjet mbi perspektivën dhe mënyrën e liberalizimit të mëtejshëm të tregjeve financiare në Shqipëri.

Ka pyetje dhe përgjigje ku ka një informacion statistikor dhe të dhënat e fundit janë duke u përditësuar me ato të vitit 2009 dhe përgjigje të cilat janë përditësuar dhe do të vazhdojnë të përditësohen me zhvillimet legjislativë apo me ligje të cilat mund të miratohen deri në momentin kur ne do të dorëzojmë pyetësorin.

Më duhet të theksoj se parimi kryesor gjatë gjithë kësaj pune, sikurse edhe për proceset e tjera, ka qenë: cilësia përpara shpejtësisë. Besoj se kjo është e rëndësishme për t'u thënë, sepse Qeveria shqiptare nuk e ka konsideruar procesin e integritimit të Shqipërisë në BE si një proces ngushtësisht kalendariq, si një proces datash, por si një proces në të cilin ne kemi vendosur që ta meritojmë këtë anëtarësim dhe, sigurisht, duke vendosur cilësinë në plan të parë. Kjo nuk do të thotë që datat e përcaktuara, orientuese, nuk janë data të cilat do

të respektohen, por edhe një herë më duhet të theksoj se kjo është kërkesa e BE-së, ky është edhe synimi ynë, që procesi të jetë sa më cilësor.

Për momentin ne kemi shqyrtuar dhe rivlerësuar përfundimisht 18 kapituj në mbledhjet e grupeve ndërinstucionale të punës, të cilat kanë marrë miratimin për të kaluar në formatin e Këshillit Ndërmintor të Integritit, pra, në formatin e Këshillit të Ministrave dhe më pas të kalojnë në përkthim. Pas procesit të përkthimit, faza e cila siguron cilësinë ose ajo që quhet "quality check", që bën vlerësimin e cilësisë, është një përshkrim, një lexim në mënyrë narrative i të gjithë materialit nga folës që kanë gjuhë amtare anglishten, të cilët janë identifikuar.

Pra, duke iu referuar gjithë këtij procesi dhe masave të marra, unë besoj se nuk ka asnjë shqetësim, pavarësisht problematikave që ne mund të kemi hasur, por më duhet të falënderoj angazhimin maksimal të të gjithë administratës shqiptare. Sikurse ju thashë, janë më shumë se 1200 nëpunës civilë të cilët kanë punuar çdo ditë, kanë rishikuar përgjigjet, kanë qenë të gatshëm për të diskutuar, sigurisht, jo duke pasur një kohë të gjatë në dispozicion. Ata e kanë vlerësuar këtë moment si një moment të rëndësishëm jo vetëm teknik, por njëkohësisht si një moment shumë të rëndësishëm politik, i cili i jep mundësinë Shqipërisë që të adresojë dhe të marrë vlerësimin për të gjitha iniciativat që ka plotësuar në kuadër të integritit të vendit në BE.

Sigurisht që procesi nuk ngel, nuk ngushtohet dhe nuk mbaron me dhënien e përgjigjeve të pyetjeve të pyetësorit. Besoj se kushdo që ka pasur eksperiencë në proceset integruese dhe i njëjti proceset integruese të vendeve të tjera, e di mjaft mirë që ne tani duhet të përfshihemi, sikurse ka ndodhur, në procesin e identifikimit të atyre të cilët do të jenë anëtarë të ekipit negociator. Në fakt, ka eksperiencë të vendeve që e kanë përmbyllur këtë proces, sikurse Shqipëria, kur ekipi i negociuar është shpallur menjëherë pasi është dorëzuar përgjigja, siç ndodhi me Islandën. Pasi janë dorëzuar përgjigjet e pyetësorit në BE, ne kemi kërkuar nga projekti i asistencës teknike, që ndodhet pranë Ministrisë së Integritit, një plan veprimi dhe një orientim, pra një *policy paper* për krijimin e kësaj strukture negociatore, por, njëkohësisht, edhe për rolin që do të luajë kjo strukturë.

Dua të falënderoj kontributin e të gjitha vendeve në këtë proces, duke u nisur nga ato që janë më

afër nesh, vendeve fqinje, duke vendosur në radhë të parë kontributin e vendeve anëtare të BE-së, të Komisionit Europian, por edhe të vendeve si Kroacia, të cilat na kanë asistuar me trajnime, me ekspertizë dhe janë të gatshme që të marrin pjesë në procesin e identifikimit sa më të mirë dhe më të saktë të grupit të negociatorëve për të kaluar në pikën tjetër të asistencës dhe, njëkohësisht, të jenë këshilltarë në procesin e decentralizimit të fondeve të BE-së dhe në këtë proces të rëndësishëm, i cili, për të ardhur te pjesa e dytë e interpelancës suaj, sikurse e dini, deri tani menaxhohet dhe është i centralizuar kryesisht nga delegacioni.

Shqipëria, duke qenë në statusin aktual të vendit kandidat potencial, përfiton vetëm nga dy komponentë të IPA-s. Fare shkurt, për publikun, që ndoshta nuk është mësuar me këtë terminologji tonën të përditshme, IPA, e thënë thjesht, është instrumenti i paraaderimit, pra është ndihma financiare që BE-ja i akordon një vendi për të përmbushur detyrimet që ka në kuadër të anëtarësisë.

Duke filluar nga viti 2005, kjo ndihmë për tre komponentët e parë në të cilët fiton Shqipëria: asistencë e tranzicionit, mbështetja institucionale dhe komponenti i bashkëpunimit ndërkufitar, është rritur me rreth 10 milionë euro çdo vit. Njëkohësisht, projektet e prezantuara nga Qeveria shqiptare janë miratuar në 99% të tyre pa ndryshime, në këtë proces të identifikimit të prioritetëve të përgatitjes së projektfishive, i cili monitorohet dhe koordinohet nga Ministria e Integritit, por në partneritet me Ministrinë e Financave, me Departamentin e Bashkërendimit të Strategjive në Këshillin e Ministrave dhe, njëkohësisht, me ministrinë e linjës dhe të gjitha institucionet e tjera qendrore, që janë subjekt i përzgjedhjes për projekte të ndryshme.

Për sa i përket pjesës së decentralizimit të fondeve të IPA-s, në të gjithë komponentët, për të gjithë qytetarët, në momentin që Shqipëria përfiton statusin e vendit kandidat, fondet të cilat BE-ja ia akordon një vendi në statusin e vendit kandidat, dhe ky është përkthimi i përfitimit të parë imediat, dyfishohen. Pra, në qoftë se tani Shqipëria merr 80 milionë euro në vit, në momentin që ka statusin e vendit kandidat, pra në fillim të viti 2011, do të marrë 160 milionë euro dhe në momentin që është vend anëtar i BE-së, sigurisht, që këto fonde rriten. Por për të mbërritur deri këtu duhen një sërë përgatitjesh.

Unë mund t'ju them se ky është një vit kyç edhe për sa i përket procesit të decentralizimit, sepse në

momentin kur ne bëhemi vend kandidat do të përftojmë nga tre komponentë të tjerë të rëndësishëm që janë komponenti i zhvillimit rajonal, komponenti i burimit njerëzor dhe komponenti i zhvillimit rural, komponentë bazë në të cilët fondet strukturore të BE-së i akordohen një vendi që kërkon të anëtarësohet.

Janë caktuar tani në këtë proces decentralizmi institucionet kryesore, aktorët dhe përgjegjësit. Pranë Ministrisë së Financave janë caktuar zyrtarët e lartë dhe rolet e tyre respektive në kuadër të IPA-s: ministri i Financave; zëvendësministri i Financave, si koordinatori dhe autoriteti kryesor për fondet e IPA-s; drejtori i përgjithshëm i njësisë së financimit dhe kontraktimit, në rolin e zyrtarit të autorizuar të programit; autoriteti auditues, ku rolet dhe përgjegjësitë e tyre janë të gjitha në bazë të rregullores së IPA-s.

Në bazë të formatit të zgjedhur nga Qeveria shqiptare, Ministria e Integritimit dhe ministri i Integritimit duhet të jetë koordinatori kombëtar, pra programues i fondeve. E thënë thjesht, në Ministrinë e Integritimit programohen fondet, në Ministrinë e Financave do të tenderohen dhe kontraktohen të gjitha projektet nga komunat, bashkitë, institucionet qendrore, të cilat kanë interes dhe do të prezantojnë projekte të faturuara.

Njëkohësisht, është ngritur edhe fondi kombëtar, drejtori që do të shërbejë si strukturë qendrore thesari në përputhje me kërkesat e IPA-s. Në qoftë se deri tani në Ministrinë e Integritimit është kryer vetëm pjesa e monitorimit, në pjesën tjetër, atë të decentralizimit, koordinatori kombëtar i IPA-s, që është Ministri i Integritimit, bashkë me ata të cilët janë emëruar në institucionet e linjës si përgjegjës apo SPO-të, do të kryejnë monitorimin dhe vlerësimin e fondeve të BE-së.

Për sa i përket pjesës së zhvillimit rajonal, është e vërtetë që në janar të këtij viti ne kemi pasur misionin nga BE-ja, i cili në dy ditë dialogu dhe konsultimesh me Qeverinë shqiptare ka diskutuar masat që duhet të merren urgjentisht deri në fund të vitit 2010. Kjo, sigurisht, jo se ne nuk kemi dashur t'i marrim më parë, por sepse tani jemi introduktuar dhe na është kërkuar përfshirja e vullshme. Gjithsesi, pjesa e decentralizimit ka funksionuar për komponentin parë dhe të dytë të IPA-s dhe kjo është 90% e punës për tre komponentët e tjerë.

Ne presim në këto momente një *policy paper* apo një qëndrim nga Komisioni Europian për të na udhëzuar të vendosim për modelin më të mirë,

bazuar edhe në eksperiencat e vendeve të tjera për strukturën koordinuese, për komponentin e tretë të zhvillimit rajonal, i cili do të jetë komponenti më i rëndësishëm. Ky komponent ka tre akse kryesore: aksin e politikave të transportit, të politikave të mjedisit dhe të konkurrencës rajonale, që do të mbulohen nga ministri dhe struktura të cilat do t'i menaxhojnë këto fonde, si: Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Për sa i përket menaxhimit të komponentit të katërt të zhvillimit të burimeve njerëzore, i cili mbulon fusha, si: punësimi, arsimit, formimi profesional, përfshirja e grupeve sociale në tregun e punës, institucionet përgjegjëse do të jenë Ministria e Arsimit dhe e Shkencës dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe e Shanseve të Barabarta.

Është diçka më përpara komponenti i pestë, ai i zhvillimit rural, pasi përgatitjet për të kanë filluar prej një viti. Sigurisht që ai do të jetë një nga komponentët më kryesorë dhe të rëndësishëm. Politikat më të ndjeshme në BE sot janë politikat bujqësore, të mjedisit dhe sigurisë ushqimore. Për sa i përket pjesës së zhvillimit rural, është përgatitur kuadri ligjor rregullues dhe është ngritur aktualisht Agjencia e Pagesave për Bujqësinë dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Financave po ngrihen edhe strukturat e tjera.

Çfarë ka ndodhur dhe çfarë masash kemi marrë për t'i bërë të mundura të gjitha këto?

Në programin e IPA 2009 është financuar një projekt për të përgatitur Qeverinë e Shqipërisë që të ndërmarrë hapat e nevojshme deri në momentin e aplikimit dhe për të marrë akreditimin për sistemin e decentralizuar, që është momenti më i rëndësishëm. Ka një projekt i cili nëpërmjet fondeve të CARDS 2005 dhe PNUD-it ka parashikuar që deri në maj të vitit 2010 të zbatohen politika për ngritjen e strukturave menaxhuese, për të zbatuar komponentin e tretë. Deri në tetor 2010 duhet të mbarojë adaptimi dhe miratimi i ligjit për zhvillimin rajonal, i cili do të jetë kuadri bazë ligjor që përcakton strukturat përkatëse që do të ngrihen deri në dhjetor të vitit 2011, forcimi institucional i strukturave që do të përcaktohen për menaxhimin e këtij komponenti dhe deri në dhjetor të vitit 2012 përgatitja e 10 projekteve në infrastrukturë dhe në zhvillim rajonal.

Ka një projekt tjetër të IPA-s 2010, projekti i zhvillimit të burimeve njerëzore, ku Shqipëria kërkon dhe ka marrë asistencë për komponentin e katërt

të IPA-s. Janë 4 milionë euro, por gjatë zbatimit të këtij projekti dhe për decentralizimin e fondeve në këto instrumente, do të hartohen edhe dokumente të tjera strategjike të nevojshme, si kuadri koherent strategjik, i cili është ai dokument që përcakton në një kornizë të vetme referimin për programet operacionale nën komponentët e zhvillimit rajonal dhe të zhvillimit të burimeve njerëzore të IPA-s.

Ju e dini që një pjesë e strategjive sektoriale janë pjesë e programimit dhe e ndërtimit të këtij kuadri dhe të këtij dokumenti. Unë besoj se konsultimi ka qenë i gjerë me të gjitha grupet e interesit dhe me strukturat përkatëse. Por, njëkohësisht, edhe projektet e IPA-s, të cilat janë të alokuara pothuajse në çdo ministri i kanë ndihmuar ato të identifikojnë problematikat e tyre. Ky projekt u jep njohuri punonjësve në komuna, në bashki, por edhe në institucionet qendrore të vendit se si të përgatisin më mirë projektfishat, pra si të dinë të shkruajnë më mirë një projekt, në mënyrë që të përfitojnë maksimumin e atyre fondeve të cilat kërkojnë. Ai është edhe pranë Ministrisë së Integritimit dhe besoj se për të gjithë ky vit do të jetë një vit i cili nuk do të mbarojë në fund të marsit dhe vullti nuk do të ndalet në fund të marsit, por do të duhet një punë e të gjithëve, shumë e vrullshme nga pikëpamja e ndërtimit të të gjithë kësaj strukture, edhe gjatë vitit 2011.

Falemnderit!

Ardian Turku – Falemnderit, zonja Bregu!

Zonja Vokshi, urdhëroni!

Albana Vokshi – Falemnderit, zonja Ministre!

Në radhë të parë më lejoni t'ju falënderoj për informacionin shumë të detajuar dhe konciz, që mendoj se ishte i vlefshëm jo vetëm për ne që jemi në sallë, por për të gjithë ata që na kanë ndjekur.

Së dyti, do të doja t'ju përshëndesja ju personalisht, ministrinë që ju drejtoni dhe të gjitha ministrinë e linjës, 1200 nëpunësit civilë dhe çdokënd që ka qenë i angazhuar në këtë proces të rëndësishëm të integritimit të Shqipërisë në familjen europiane.

Ashtu siç e përmendët edhe ju, kjo nuk është punë e një dite, nuk është punë e një muaji dhe një viti, por është një proces i gjatë dhe i vështirë. Faktori politik është i vendosur të ndjekë të gjitha hapat për përbushjen e të gjitha obligimeve dhe standardeve. Dhe, së fundi, doja të theksoja se raporti dhe bashkëpunimi midis Qeverisë dhe Parlamentit në muajt që vijnë do të jetë shumë i rëndësishëm, për të miratuar të gjitha ato ligje që kërkojnë në procesin e integritimit.

Ju falënderoj edhe një herë për informacionin!

Ardian Turku – Falemnderit, zonja Vokshi!

Ju falemnderit të gjithëve!

Seanca mbyllet.

Mirupafshim të enjten e ardhshme!

(Seanca u mbyll në orën 20:00)

E enjte, 18.02.2010
Seanca e pasdites, ora 17:30

Drejton seancën Zëvendëskryetari i Kuvendit,
zoti Ardian Turku

Rendi i ditës:

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60 minuta).

2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 11.02.2010.

3. Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin “Për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare në Mesdhe” të Konventës së Barcelonës “Për mbrojtjen e mjedisit detar dhe të rajoneve bregdetare të Mesdheut””.

4. Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në traktatin ndërkombëtar për burimet gjenetike të bimëve, për bujqësinë dhe ushqimin”.

5. Projektligji “Për marrjen në kontroll të shoqërive publike”.

6. Projektligji “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”.

7. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9616, datë 27.09.2006 “Për librin në Republikën e Shqipërisë””.

Ardian Turku - Mirëmbërëma!

Çelim seancën për ditën e sotme.

(Lexon rendin e ditës.)

Siç dihet, pika e parë është diskutime për çështje jashtë rendit të ditës. Në këtë pikë kanë kërkuar fjalën deputetët: Edi Paloka, Mesila Doda, Gjokë Uldedaj, Leonard Demi, Eduard Halimi, Ledina Aliolli, Rrahim Çota, si dhe ministrat Ridvan Bode dhe Fatmir Mediu.

Zoti Paloka, keni fjalën.

Edi Paloka – Falemnderit, zoti drejtues i seancës!

Që në fillim të fjalës sime dua të theksoj se edhe unë, si çdo njeri normal e politikan normal, nuk mund të jem kundër dialogut apo tryezës së bisedimeve me opozitën, me Partinë Socialiste, madje edhe me Edvin Ramën. Vetëm se dua të them që, për mendimin tim, edhe ne, edhe ndërkombëtarët, gjithmonë jemi duke gabuar diku me Edvin Ramën.

Pse e them këtë? Miqtë tanë europianë kanë kaq kohë që i bëjnë të qartë zotit Rama se bojktoi është i papranueshëm për ta. Së fundi, jo një herë, por me dhjetëra herë, po i theksojnë se bojkoti i Partisë Socialiste dhe ngërçi që është krijuar prej këtij bojkoti dëmtojnë rëndë interesat e Shqipërisë dhe të shqiptarëve në idealin e tyre për integrimin e Shqipërisë në Europë.

Sigurisht, kur i bëjnë këtë thirrje Ramës për t'u futur në Parlament, ata mendojnë se i drejtohen një njeriu normal, një politikani të përgjegjshëm, siç duhet të jetë në fakt kryetari i partisë së dytë më të madhe në vend, siç duhet të jetë çdo politikan që ka përparësi interesat e vendit të tij. Por, pikërisht këtu ata gabojnë, sepse duke i thënë Ramës që me bojkotin tënd ti u prish punë Shqipërisë dhe shqiptarëve, në vend që ta frenojnë, ata e nxisin më tepër në rrugën e tij të bojkotit. Ky, mendoj unë, është gabimi.

Ky zotëri e ka treguar me kohë se jo e mira, por e keqja është ajo që e orienton në rrugën e tij. Pra këtij njeriu sa më shumë t'i thuash se je duke bërë keq, aq më këmbëngulës bëhet në rrugën e tij, mjafton që kjo e keqe t'u bëhet të tjerëve dhe jo atij, t'u bëhet atyre që nuk e votuan, atyre që nuk e deshën dhe që nuk e lanë të bëhet kryeministër.

Vetëm disa ditë më parë i ka thënë në zyrë njërit prej të tijve (unë po e them emrin, ndonëse nesër jam i sigurt që ai do ta mohojë), Artan Lames, që i ka vajtur në zyrë për t'i kërkuar të tërhiqet nga bojkoti se po i merr të gjithë në qafë: "Nënat t'u bëhen të gjithëve derisa të mos jem unë kryeministër". Ky është Edi Rama. Vetëm këtë filozofi ka ky njeri.

Prandaj, duke i kërkuar këtij njeriu, flas gjithnjë për ndërkombëtarët, që të bëhet i përgjegjshëm e të lërë bojkotin, veçse gabojmë.

Nëse në rast të fatkeqësive natyrore ky zotëri u mjaftua duke fërkuar duart, se nuk kishte në dorë më tepër se aq, ai thjesht gëzonte se shqiptarët ranë në fatkeqësi dhe uronte më të keqen, në këtë rast ai mendon se ka në dorë t'u shkaktojë fatkeqësi

shqiptarëve, pasi ne po i krijojmë idenë se ka në dorë integrimin e Shqipërisë dhe me këtë pozitë ai mendon se ka në dorë t'u shkaktojë një fatkeqësi tjetër shqiptarëve, të ndalojë, të frenojë integrimin e tyre.

Ja përse ai kërcënon një popull të tërë. Ja përse të nesërmen e tryezës së Presidentit ky zotëri, në vend që të reflektonte, mbledhi tryezën e tij dhe kërcënoi prapë me protesta, duke ndjekur teorinë tako-saksone se marrëveshjet bëhen nën presion, sepse vetëm ashtu fitohen.

Në vendet demokratike ka një rregull parimor: nuk bëhet kompromis as me terroristët, as me pengmarrësit, çfarëdo çmimi që të jetë në lojë. Kjo e ka një arsye, sepse një herë po të biesh pre e presionit të pengmarrësve dhe t'u plotësosh kushtet nën presion, e vetmja gjë që do të realizosh është t'u hapësh rrugën pengmarrjeve dhe pengmarrësve të tjerë.

E thashë edhe më lart, unë nuk jam absolutisht kundër tryezave e sidomos nuk jam kundër dialogut, qoftë edhe me Edvin Ramën, por duhet të kemi parasysh një fakt, se në këtë rast ne jemi duke biseduar me një pengmarrës, ose më mirë, ai e sheh veten e tij në pozicionin e pengmarrësit. Nuk jemi ne që e vëmë në atë pozicion, por atij i pëlqen ta shohë veten e tij në pozicionin e pengmarrësit.

Edvin Rama nuk u ul në tryezë për dialog e për të diskutuar zgjidhje sipas së drejtës, sepse në fakt, në këtë rast, ai ka vetëm një "të drejtë", të drejtën që ka çdo pengmarrës.

Shqiptarët votuan, por Rama nuk e njeht votën e tyre. Gjykatat vendosën, por Rama nuk i njeht vendimet e tyre. Rama nuk njeht as ata që prej kohësh i thonë se bojkoti është antidemokratik e kundër shqiptarëve. Edvini i sfidon të gjithë dhe kërcënon: "Po nuk më dhatë pushtet, unë do të vras pengun!", i bindur që integrimin e shqiptarëve tashmë e mban peng ai. Por këtij pupaci të mjerë duhet t'i bëhet e qartë nga të gjithë se nuk mund të mbajë peng asgjë, e ca më shumë fatin e shqiptarëve.

Pas dy ditësh është 20 shkurti, dita kur shqiptarët tërhoqën zvarrë, të më falni, po i bënë edhe shurrën, atij që i mbajti peng për 50 vjet.

Falemnderit!

Ardian Turku – Falemnderit, zoti Paloka!

Zonja Mesila Doda, keni fjalën.

Mesila Doda – Falemnderit, zoti drejtues i seancës!

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Këto ditë kam pasur rastin të kem në duar një

material të pazakontë, janë procesverbalet e dënimit me vdekje të disa të dënuarve të revoltës së Qafës së Barit. Sot po sjell para jush fjalët e fundit të një të dënuari me vdekje para ekzekutimit, Sokol Sokolit, 32 vjeç, i dënuar me vdekje dhe me heqje të së drejtës së zgjedhjes për 5 vjet (marrëzia shkon deri aty sa pas vdekjes i heqin edhe të drejtën e zgjedhjes). Ai deklaroi: “Mos më vrisni pas shpine. Gropën e hap vet. Mirë bëtë që nuk na e falët jetën. Nuk i kemi bërë gjë kujt”. Ndërsa Tom Ndoja, po 32 vjeç, vdes duke deklaruar: “Të rrojë drejtësia!”

Është një prej dokumenteve të shumta, dëshmi e krimeve që shteti komunist ka bërë përgjatë viteve në këtë vend. Qëllimi im nuk është aspak të përdor retorikë për të rizgjuar ngjarjen e krimit shtetëror të 25 vjetëve më parë, por t’ju bëj me dije, të nderuar ligjvënës, që ende sot ne po jetojmë brenda një padrejtësie të madhe sociale, ku xhelatit i vishet lëkura e parimorit, ndërsa viktimat vazhdon të mbetet e mallkuara e përjetshme.

Të nderuar zotërinj ligjvënës,

Ende sot shumë prej këtyre qenieve njerëzore që ua mori jetën shteti i tyre vazhdojnë të quhen terroristë dhe shumë prej tyre, për këtë shkak, nuk mund të marrin edhe dëmshpërblimin. Ende sot xhelatët i gjen në majën e piramidës të së drejtës. Xhelatët sot i gjen të konfirmuar dhe herë i sheh si gjykatës që caktojnë të drejtat e mëdha në këtë vend dhe herë si avokatët më të zjarrtë të drejtave të viktimave dhe, jo rrallë, si ligjvënës.

Kjo është padrejtësia e madhe shoqërore, që ende merr frymë në këtë shtet dhe që ne nuk kemi fuqi ta shkulum. Kjo është padrejtësia që sa herë guxojmë ta përmbysim, na rikthehet si bishë e plagosur dhe na tregon parimet e së drejtës moderne.

E bëra këtë hyrje për një qëllim konkret. Ne së shpejti do të miratojmë ligjin për ngritjen e Institutit të Memories Historike. Institucioni duhet të zbardhë makabritetet dhe të vërë gishtin mbi të drejtat njerëzore që komunizmi u mohoi shqiptarëve për gjysmë shekulli. Një prej detyrimeve madhore të tij do të ishte krijimi i librit të zi të komunizmit.

Krahas kësaj, ne sot duhet të veprojmë dhe të ndryshojmë praktikat e deritanishme. Në këtë optikë mendoj se, së pari, duhet të ndërmarrim të gjitha hapat për të respektuar të vrarët tanë. Nëse sot quajmë dëshmorë luftëtarët e Luftës II Botërore, nuk ka asnjë shkak pse të mos quhen dëshmorë mijëra të vrarë për demokracinë. Klerikët, ish-deputetët, shkrimtarët, poetët, inxhinierët, luftëtarët e lirisë që

shqiptuan qartazi mosaprovimin e tyre dhe madje luftuan sistemin e krimit, duhet të shpallen dëshmorë të atdheut.

Unë, personalisht, do të kërkoj që, në bashkëpunim me shoqatat e të persektuarve, të ndërmarrim ndryshimet e nevojshme që statusin e dëshmorit ta marrin, rast pas rasti, të gjithë të vrarët e ndërgjegjes, të gjithë ata që u flijuan në emër të parimeve të demokracisë.

Në këtë optikë ngritja e një varreze shtetërore, ose edhe mundësia e dërgimit të eshtrave të tyre pranë varrezave të dëshmorëve do të plotësonte detyrimin tonë të parë në nderim të viktimave të terrorit të kuq.

Nga ish të dënuarit kemi mësuar përgjatë këtyre ditëve se njihen disa nga vendet e ekzekutimit të dikurshme, Mali me Gropa, i cili në të vërtetë nuk ka vetëm gropa, por ka edhe trupa njerëzish, Antenat në Shkodër, Pylli i Sodës, pra vende të tilla duhet të rrethohen dhe të krijohen skuadra të specializuara në gërmimet për gjetjen e eshtrave dhe identifikimin e tyre.

Do të ishte e nevojshme ngritja e memorialeve në të tilla vende për të mbajtur gjallë kujtesën historike të shqiptarëve të sotëm, por edhe për brezat që do të vijnë.

Të nderuar zotërinj,

Një hap tjetër shumë i rëndësishëm do të ishte përjashtimi përfundimtar dhe moszgjedhja nga ana jonë e asnjë figure që ka kryer krime dhe që ka dënuar e vrarë njerëz. Unë do t’u bëj thirrje të gjithëve që të vendosim të mos japim më votën tonë në asnjë rast për individë që kanë kryer krime, si në rastet e gjykatësve, Avokatit të Popullit apo krerëve të institucioneve të pavarura. Të njëjtën vëmendje ndaj këtyre individëve do ta kërkoja edhe nga ana e Presidentit të shtetit në emërimet që bën në institucionet më të rëndësishme dhe në drejtësi. Ky do të ishte fillimi i një rruge të gjatë për pastrimin përfundimtar të shtetit tonë nga krimi, por është një hap i domosdoshëm.

Falemnderit!

Ardian Turku – Falemnderit, zonja Doda!

Zoti Gjokë Uldedaj, urdhëroni!

Gjokë Uldedaj – I nderuar drejtues i seancës, Të nderuar kolegë deputetë,

E kërkoja fjalën në këtë seancë për të trajtuar edhe një herë problemet dhe masat që po merren mbas përmbajtjeve në zonën e Shkodrës. Duke qenë deputet që vij nga kjo zonë, më është dashur që gjatë gjithë kohës të jem në ndjekje të shqetësimeve

dhe vlerësimit të situatës pas fatkeqësisë natyrore.

Gjatë kësaj periudhe, krahas shqetësimeve të banorëve, kam marrë edhe falënderimet e tyre për punën që kanë bërë atje të gjitha organet e pushtetit qendror dhe vendor. Për këtë arsye, mendova se do të ishte me vlerë që e gjithë kjo punë të bëhej prezente në këtë Kuvend të nderuar, ashtu siç është e nevojshme të trajtojmë po këtu edhe idetë lidhur me një program afatgjatë ndërhyrjesh. Dje, në qarkun e Shkodrës, komisionet e vlerësimit të dëmeve e kanë mbyllur me sukses të plotë fazën e parë të vlerësimit, e cila është edhe më e rëndësishmja.

E gjithë kjo punë kolosale është kryer në një kohë rekord nga grupet e vlerësimit, të cilat kanë punuar me një ndjenjë të lartë përgjegjësie shtetërore e qytetare, në bashkëpunim dhe koordinim të plotë me pushtetin vendor. Falënderimi për ta është më se i merituar, ashtu siç nuk mund të mos vlerësohet edhe fakti tjetër se e gjithë kjo punë kolosale u bë e mundur të realizohet falë mbështetjes së pakufishme dhe interesit të jashtëzakonshëm që tregoi Qeveria, posaçërisht kryeministri Berisha, kabineti ndërministror dhe zonja Topalli, të cilët në të gjitha ditët e fatkeqësisë, por edhe më pas, kanë spikatur për angazhimin dhe përkushtimin e lartë në të gjithë zonën. Më duhet të theksoj se mirënjohja dhe falënderimi im janë një pjesë shumë e vogël e asaj që më kanë përcjellë të gjithë banorët e asaj zone pa përjashtim.

Është shumë e rëndësishme që të vlerësohet dhe të theksohet edhe një fakt tjetër, që ka të bëjë me suksesin e vlerësimeve. Gjatë gjithë procesit të zhvillimit të tij derë më derë, në javët e fundit nuk ka pasur asnjë kontestim, çka tregon punë me një ndjenjë të lartë përgjegjësie, por edhe objektivitet dhe bashkëpunim nga të dyja palët në proces: vlerësuesit dhe banorët.

Ndërkohë, vlen të përmendet edhe garancia e dhënë. Një punë voluminoze është ndërmarrë edhe nga autoritetet vendore, të cilat kanë qenë pjesë e rëndësishme e procesit dhe kanë mundësuar t'u pritët rruga abuzimeve dhe keqinterpretimeve.

Rasti i përmbajtjeve në Shkodër vlen që të shihet në një optikë më të gjerë. Ajo që është realizuar në këto javë është treguesi më i mirë jo vetëm i angazhimit, por edhe i forcës dhe bashkërendimit e koordinimit mes pushtetit qendror dhe atij lokal, me të cilën ato iu adresuan problemeve dhe i vunë në rrugën e zgjidhjes. E gjithë kjo i bën akoma më të mjera se në ditët e fatkeqësisë thirrjet pa kuptim të

opozitës, e cila, sipas meje, po vazhdon të humbasë shansin dhe kohën për të qenë në nivelin që i takon, falë votave dhe mandateve që i ka dhënë edhe populli i kësaj zone.

Opozita duhet të kuptojë më në fund se kjo është përgjegjësia më e drejtë që ne mbajmë, me fakte, me shifra dhe duke i kthyer në realitet ato çfarë u premtuan nga Qeveria dhe Kryeministri Berisha që në ditët e para të janarit. Shifrat që kanë dalë deri tani, flasin për një vlerësim të hollësishëm dhe korrekt të dëmeve për 4213 familje, për 1280 ha tokë, prej të cilave gjysma e sipërfaqes rezultojnë të ketë qenë e mbjellë në kultura bujqësore. Po ashtu, referuar këtyre shifrave, rezultojnë që dëmet në gjënë e gjallë të jenë si më poshtë: 22 krerë gjedhë, 126 krerë të imëta, 96 krerë derra, 16 njëhundrakë dhe 3200 shpendë. Kjo gjuhë shifrash është treguesi më i mirë i evidentimit të gjithanshëm dhe të hollësishëm të situatës. Ndërkohë, nga ana tjetër, Ministria e Bujqësisë, që ka mbajtur edhe peshën më kryesore në evidentimin dhe rehabilitimin e dëmeve të shkaktuara, ka marrë dhe po merr të gjitha masat e nevojshme për minimizimin e efekteve që jep paspërmbytja.

Është i lavdërueshëm përqendrimi i punës kryesisht në furnizimin me bazë ushqimore për blegtorinë. Deri më tani kanë shkuar në zonë më shumë se 900 tonë koncentrat dhe rreth 200 tonë bazë ushqimore silazh. Po ashtu, janë dezinfektuar dhe janë kthyer në gjendje normale 2576 stalla dhe ambiente të mbarështimit të bagëtive dhe shpendëve në gjitha komunat e prekura. Në vijim të monitorimit të situatës pas përmbytjes, janë bërë, gjithashtu, mbi 100 analiza mikrobiologjike dhe mbi 20 të tilla biokimike për të pasur një kontroll të saktë mbi ujin e pijshëm dhe mbi prodhimin e bazës ushqimore.

Kjo punë, për të cilën nuk ka pse të mos shpreh vlerësimet maksimale dhe mirënjohjen time të plotë, e ka vënë situatën nën kontroll. Por, pikërisht kjo njohje e situatës na ka çuar në përfundimin se ajo çka është bërë, është vetëm baza dhe fillimi i përballimit të një sfide të re e më të madhe. Ndaj, përballimi evidenton faktin se nevojitet një punë e mirëstudiuar dhe e integruar në të gjitha hallkat dhe nivelet.

Tashmë, siç është njoftuar, janë në proces e sipër ndërhyrjet e tjera që përfshijnë disa drejtime. Shifrat e deritanishme të vlerësimit të dëmeve do të bëhen më të plota me realizimin e gjithë kësaj pune të nisur, ndërkohë që janë në proces përfundimi ndërtimi i argjinaturave dhe pritave të reja, pastrimi i

kolektorëve dhe kanaleve kulluese, ndërtimi i rrugëve rurale të dëmtuara, ndërhyrjet në hidrovore dhe rehabilitimi i shkollave dhe qendrave shëndetësore etj. U është kushtuar vëmendje edhe furnizimit me bazë ushqimore për blegtorinë dhe vlerësimeve të pakryera të dëmeve për sipërfaqet prej rreth 900 ha, të cilat janë akoma të përmbytura. Një situatë e tillë vijon ende në Velipojë, Ças, Luarz, Baks Rrjoll, me një sipërfaqe të përmbytur aktuale prej 750 ha, në Bushat dhe Malin e Jushit, me një sipërfaqe prej 100 ha dhe në Dajç me një sipërfaqe prej 50 ha.

Procesi do të plotësohet në vijim me vlerësimin e dëmeve që ka shkaktuar përmbytja për bizneset, veçanërisht për ato që lidhen me bimët dekorative, ku paraprakisht, referuar edhe të dhënave të Drejtorisë së Bujqësisë, vlerësohet të jenë dëmtuar rreth 10% e 1700 mijë fidanëve. Tanimë përmbytja ka bërë të domosdoshme që shteti të marrë në konsideratë faktin që familjet me toka të përmbytura, por veçanërisht ato që i kanë edhe tokat të përmbytura e që vazhdimisht përmbyten, të kenë një trajtim të veçantë, nëpërmjet një asistence të specifikuar për trajtimin e problemit.

Vlen të thuhet se kjo kërkesë, që është e përsëritur në vite nga banorët e këtyre fshatrave, bëhet më e theksuar edhe për faktin se këta banorë i kanë plotësisht të kufizuara mundësitë për të marrë prodhim të garantuar nga këto sipërfaqe toke që disponojnë.

Të nderuar kolegë deputetë, qarku i Shkodrës është njëra prej zonave kryesore bujqësore e blegtorale të vendit, një hambar prodhimi, ndaj është me leverdi ekonomike që kjo zonë e spikatur të mbështetet me politika dhe strategji zhvillimi. Janë të gjitha mundësitë që me angazhimin e të gjithëve ne, duke e konsideruar bujqësinë si një sektor prioritar, të ndërtohet një bujqësi e zhvilluar dhe e gërshetuar edhe me potencialet e kësaj treve për turizëm dhe për biznese të tjera. Kjo do të ishte një sfidë vërtet e madhe dhe realizimi i saj është shumë i mirëpritur nga banorët punëdashës të Shkodrës dhe Nënshkodrës, të cilët asnjëherë nuk kanë nguruar të japin mbështetjen e tyre.

Falemnderit!

Ardian Turku – Falemnderit, zoti Uldedaj!

Fjalën e ka ministri i Mjedisit, zoti Mediu.

Fatmir Mediu – Falemnderit, zoti drejtues i seancës!

Të nderuar kolegë,

Duke marrë shkas edhe nga fjala e kolegut Uldedaj, por edhe nga shqetësimi i ngritur prej tij,

duhet të sjellim në vëmendjen tonë një nga problemet më të mëdha, me të cilat tashmë është e ngarkuar e gjithë axhenda e debateve, diskutimeve dhe studimeve, pikërisht problemet mjedisore, të cilat, nëse nuk trajtohen siç duhet, patjetër që sjellin risqe dhe kosto të mëdha. Konferenca e Kopenhagenit përcaktoi qartë rreziqet që mbart një zhvillim jo i konceptuar drejt dhe Shqipëria është në momentet e zhvillimit të saj intensiv, ku duhet patjetër të ndërtojë balanca ndërmjet zhvillimit ekonomik dhe një mjedisi të qëndrueshëm, për të garantuar një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm të vendit.

Këto ditë u deklarua se Shqipëria ka bërë progres në fushën e mjedisit, sipas raportit të indeksit të performancës mjedisore për vitin 2010, publikuar në Bazel të Zvicrës, ku Shqipëria renditet në vendin e 23-të, e vlerësuar me 71,4 pikë, nga 100 të mundshme mes 163 vendeve të monitoruara. Monitorimi, vlerësimi, hartimi dhe publikimi i raportit është bërë nga 4 qendra të mirënjohura, të specializuara dhe prestigjioze ndërkombëtare për mjedisin, siç është Universiteti i Jellit, Qendra për Politikën dhe Legjislacionin Mjedisor, Universiteti Columbia, Qendra e Rrjetit Informatik Ndërkombëtar për Shkencën e Tokës në SHBA, Qendra Kërkimore e Përbashkët e KE-së, në Ispra, Itali dhe Forumi Ekonomik Botëror në Zvicrës.

Ky fakt bëhet edhe më domethënës kur krahasohet me renditjen që kemi pasur në vitin 2006, pasi Shqipëria ngjiti 32 shkallë, duke kaluar nga vendi i 57-të në të 25-in, në 2008-n dhe sot në të 23-in. Monitorimi ka përfshirë 163 vende dhe dhjetëra politika, si: mjedisi i shëndetshëm, cilësia e ajrit, menaxhimi i burimeve ujore, biodiversiteti, habitatet etj.

Me gjithë këtë vlerësim pozitiv, ne jemi të vetëdijshëm për problemet tona mjedisore dhe duhet t'i shohim ato me vëmendjen e duhur, si qytetarë, si politikanë dhe si vendimmarrës. Le të fillojmë nga ato që ndeshim përditë në jetën tonë, që kanë të bëjnë me shëndetin tonë dhe të fëmijëve tanë, me kulturën tonë të jetesës për sot dhe për të ardhmen. Mbetjet e ngurta, ato që dalin nga shtëpitë tona, mbetjet urbane, ato kimike dhe spitalore, në veçanti, janë një rrezik konstant për të gjithë ne, për jetën dhe shëndetin tonë.

Menaxhimi i tyre përfshin shumë aktorë, duke filluar nga ne, si qytetarë, por sidomos pushtetin lokal dhe strukturat e tij, që kanë përgjegjësinë dhe detyrën kryesore për grumbullimin dhe menaxhimin e tyre. Në këtë kuadër, gjykoj se do të ishte tërësisht e gabuar ideja e groposjes pa kryer më parë trajtimin

e tyre, duke mundësuar një proces të plotë zinxhir në respektim të direktivës europiane për mbetjet. Në të kundërt, nuk do të bëjmë gjë tjetër, veçse do të krijojmë bomba ekologjike me pasoja shumë të mëdha për shëndetin dhe jetën, të cilat, po ashtu, do të paraqesin në kohë kosto shumë të mëdha financiare për t'i menaxhuar.

Së bashku me ndihmën e vazhdueshme që BE-ja i jep Shqipërisë, delegacioni i Komisionit Europian po asiston Ministrinë e Mjedisit në ndërtimin e një plani kombëtar dhe rajonal për menaxhimin e mbetjeve, në përputhje me direktivat, të cilat në implementimin e tyre do të kenë një kosto prej miliarda dollarësh. Por, kjo kosto do të jetë më e vogël, nëse ne do të fillojmë të përpiqemi t'i implementojmë direktivat që tani. Në mënyrë të veçantë, ne duhet të kemi vëmendje për trajtimin e mbetjeve, sidomos të spitaleve dhe klinikave shtetërore, si atyre private, duke kërkuar trajtimin e mbetjeve sipas standardeve.

Ajri që thithim është një problem i madh, por një problem i krijuar prej nesh, nga trafiku i dendur dhe sidomos edhe nga problemet e mëdha që vijnë për shkak të mungesës së planeve urbane, të zhvillimit të territorit dhe zonave të gjelbra, të detyrimeve që kanë kryetarët e bashkive dhe pushtetit lokal për t'i miratuar ato dhe për të bërë një zhvillim të qëndrueshëm të qendrave urbane. Ne nuk mund të duket të ngelemi në dorë të dëshirës apo ideve të individëve të ndryshëm, qofshin këta edhe drejtues të pushtetit lokal, por të rregullit dhe zbatimit të ligjit.

Një problem tjetër gjatë verës, sidomos në Tiranë, Durrës dhe në zonat bregdetare, është ndotja nga zhurmat në lokalet dhe baret e natës, që janë kthyer në një makth për shumë familje dhe kjo situatë patjetër që duhet të marrë fund. Ministria e Mjedisit ka bërë ndërhyrjet e saj në mënyrë të vazhdueshme, çdo natë, por kjo kërkon një bashkëpunim serioz me Policinë e Rendit dhe me Policinë Bashkiake, sidomos mbas vendimmarrjeve, një veprim të përbashkët për të hequr të drejtën e aktivitetit, nëse shkeljet vazhdojnë të përsëriten.

Pyjet janë një pasuri natyrore me një vlerë ekonomike të konsiderueshme, por mbi të gjitha me një vlerë të pakrahasueshme ekonomike dhe ekologjike. Ne i kemi transferuar pushtetit lokal një sasi të konsiderueshme pyjesh, rreth 50-60% dhe do të vazhdojmë transferimin e tyre në pronësi të komunave, jo vetëm në konceptin e dhënies së sipërfaqeve, por edhe të përgjegjësive, me

kapacitetet e nevojshme menaxhuese dhe mbrojtëse, ashtu sikurse jemi angazhuar edhe me Bankën Botërore për asistimin që duhet t'i bëjmë pushtetit lokal për të ndërtuar planet e menaxhimit dhe për kualitetin e administrimit të këtyre pyjeve.

Situata në Shkodër, siç e përmendi kolegu Uldedaj, tregoi qartë se përmbytjet e ndodhura krijojnë dëme të pazakonta dhe shumë të mëdha në dëm të interesave të qytetarëve jo vetëm të asaj zone, por të të gjithë qytetarëve shqiptarë. Kjo është e lidhur me shumë faktorë, pa dyshim me faktorë të rëndësishëm në fenomene të tilla, siç janë: shpyllëzimet, erozioni, shfrytëzimi pa kriter i lumenjve, pra probleme që kontribuojnë në situata të tilla negative.

Task Force e drejtuar nga prefekti, ku gjej rastin që t'u bëj edhe një herë thirrje, duhet të marrin urgjentisht masat për frenimin e veprimtarive të paligjshme në shtretërit e lumenjve. Ne tashmë kemi ndërtuar një kontroll intensiv permanent në të gjitha basenet ujore për të ndaluar dhe rishikuar shfrytëzimin e paligjshëm dhe pa kriter të lumenjve, duke gjobitur dhe pezulluar në çdo rast aktivitete të evidentuara. Por, pa veprimin e përbashkët të të gjitha institucioneve, veprimi i Ministrisë së Mjedisit do të ishte i pavlefshëm dhe i përkohshëm. Çështje të tilla pa dyshim që kërkojnë studime dhe një nivel tjetër të kuptimit, studime të integruara për të arritur në një situatë të re, të një vendimmarrjeje të re dhe gjykimi i Ministrisë së Mjedisit është që për një periudhë kohe shfrytëzimi i lumenjve duhet të frenohet, sepse erozionet, devijimet e ujërave, shmangiet e ujërave nëntokësore, përmbytjet, shumë herë kanë kosto më të madhe sesa përfitimi që bëhet nga shfrytëzimi i tyre. Nëse natyra është treguar bujare me ne, ne nuk mund ta masakrojmë atë, sepse do të duhen qindra vjet për ta ribërë atë që shkatërrohet në pak ditë.

Po kështu, gjej rastin t'ju adresohem si kolegë deputetë, me të drejtën tuaj kushtetuese mbi kontrollin e ekzekutivit, që ta konsideroni këtë problem, në mënyrë të veçantë efektshmërinë e veprimit të strukturave të Ministrisë së Mjedisit në të gjithë gamën që ajo përfaqëson. Bujarinë që na ka falur Zoti le ta kthejmë në përgjegjësi, duke menduar jo vetëm për sot, por edhe për nesër.

Falemnderit!

Ardian Turku – Falemnderit, zoti Mediu!

Fjalën e ka zoti Demi.

Leonard Demi – Zoti Turku, unë e kërkoja fjalën për të informuar Parlamentin në lidhje me dy

aktivitete mjaft të rëndësishme.

Së pari, në datën 15 shkurt unë kam marrë pjesë në mbledhjen e Komitetit Drejtues të Aleancës Parlamentare të NATO-s, të zhvilluar me Këshillin e Atlantikut të Veriut, i cili është forumi më i lartë vendimmarrës i aleancës. Në këtë forum unë i kërkova aleancës që të mos i përgjysmojë trupat në mënyrë drastike në Kosovë. Të gjithë e dimë se aleanca ka qenë plotësisht e suksesshme në Ballkan. Ajo u dha fund luftërave dhe siguroi paqe për të gjithë ne. Nga procesi i dezintegritimit, NATO-ja na ofroi të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor mundësinë e integritimit euroatlantik dhe në Kosovë i dha fund genocidit, pastrimit etnik. Me anë të KFOR-it ajo mbështeti ndërtimin e institucioneve demokratike, shtetin ligjor, duke ofruar një mundësi për një jetë politike dhe ekonomike të mëvetësishme, si dhe të denjë për të gjithë shqiptarët që jetojnë në atë trevë. Kësisoj shteti më i ri në Europë dita-ditës po konsolidohet drejt një të ardhmeje euroatlantike.

NATO-ja ka vendosur të kalojë KFOR-in në nivelin dy, që do të thotë të pakësojë trupat dy herë. Sot NATO-ja ka në Kosovë 10 mijë e pesëqind trupa; niveli dy do të thotë rreth 5 mijë e pesëqind trupa. Mirëpo kemi vënë re, dhe ky është një problem që ka rritur tensione të jashtëzakonshme, se serbët po ndërtojnë institucione paralele në pjesën veriore të vendit dhe se një pjesë e qytetarëve serbë kohët e fundit nuk u lejuan të marrin pjesë në votime dhe u shtynë për në muajin maj. Prandaj, në këto kushte të tensionuara, po nuk u menaxhuan si deri tani, mund të kemi ngjarje shumë të pakëndshme. Kështu, unë i kërkova Këshillit të Atlantikut të Veriut në nivelin e ambasadorëve që NATO-ja të largohet duke u bazuar në kushtet e terrenit, ushtarët të pakësohen kur ta lejojë situata. Në këtë qëndrim pata përkrahjen e plotë të përfaqësuesve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Gjermanisë. Qëndrim përkrahës shprehu edhe ambasadori italian, ndërsa ambasadori gjerman Ulrich Brandenburg tha: "Ne kemi vajtur bashkë në Kosovë dhe do të largohemi po bashkë". Është e vërtetë se disa prej nesh, anëtarë të NATO-s, janë të paduruar dhe duan të largohen menjëherë, por ne do të kalojmë në nivele të tjera kur ta lejojë situata në terren.

Së dyti, dua të njoftoj Kuvendin se një grup deputetësh të Kuvendit të Shqipërisë, me ftesë të misionit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në NATO dhe të ambasadës amerikane në Tiranë bënë një vizitë disaditore, ku u pritën në nivelet më të

larta të aleancës dhe shkëmbyen mendime me ta për sigurinë në rajon, duke shprehur edhe mëvetësinë e ideve të veta. Unë dua të veçoj se interlekutor i delegacionit shqiptar ka qenë ambasadori i Shteteve të Bashkuara në NATO, Ivo Daalder, që është një nga personalitetet më të larta të aleancës sot, zëvendëskomandanti i Përgjithshëm i Komandës Operacionale në Europë, gjenerali Sir John Mc Coll si edhe përfaqësuesi ushtarak i Shteteve të Bashkuara në NATO. Kësisoj, unë dua të tërheq vëmendjen që autoriteti ynë vazhdon duke u rritur dhe unë i sigurova që ne do të punojmë që ushtria dhe Forcat tona të Armatosura në drejtimin civil të jenë plotësisht të integruara në aleancë.

Falemnderit!

Ardian Turku – Falemnderit, zoti Demi!

Fjalën e ka zoti Halimi.

Eduard Halimi - I nderuar drejtues i seancës, Të nderuar zotërinj ministra, Të nderuar kolegë,

Sot do të doja të flisja për një çështje shumë të rëndësishme, që pret të zgjidhet në zonën time elektorale, e cila përfshihet në Bashkinë e Durrësit. Ky është një problem i cili prek jo pak, por mbi 400 familje që ndodhen në zonën e plazhit, ku pjesa më madhe e tyre janë ish të burgosur politikë të vendosur dhe të strehuar, me vendim të ish-komiteteve pluraliste, në godina që dikur kanë shërbyer si kabina plazhi. Nuk e kam fjalën as për baraka dhe as për llamarinë, por për godina 2-katëshe deri në 5-katëshe, në kushte që janë vërtet të mjerueshme, familje që jetojnë në sipërfaqe prej 30 metër katror, diku dhe me një banjë të përbashkët, pra, janë në kushte të mjera, për të cilat ata kanë paguar edhe qira për më shumë se 15 vjet në pushtetin lokal dhe që nuk mund t'i përmirësojnë ato kushte për aq kohë sa nuk janë pronë e tyre. Pronari i tyre është Bashkia e Durrësit, e cila nuk ka ndërmend të bëjë as dhe një hap, përfshirë këtu dhe muajt në fund të mandatit të saj. Por Qeveria ka marrë një vendim, të paktën 2 vjet më parë, në janar të vitit 2008, duke e detyruar pushtetin lokal që ndërtesat të cilat e kanë humbur funksionin që kanë pasur para vitit 1990 duhet t'i nënshtrohen procesit të privatizimit, sipas procedurave përkatëse, nga organet e pushtetit lokal. Për 2 vjet kryetari i Bashkisë së Durrësit nuk e bën një veprim të tillë.

Unë sot këtu nuk dua të shtroj një çështje morale, edhe pse çështja morale ekziston si një gur i themeltë në një politikë të mirë dhe në politikanë

të mirë. Është më se e qartë se kjo çështje morale për këtë shtresë shoqërore nuk ekziston për Bashkinë e Durrësit, e cila fatkeqësisht drejtohet nga një parti që në themel të politikës së saj ka agresionin ndaj kësaj shtrese. Por sot do të shtroj para jush një çështje jo morali, por një çështje ligji, e cila duhet t'i japë fund çdo tentative për korrupsion publik dhe konfliktualitet.

Prej 4 muajsh stafi im i zyrës politike, juristë dhe topografë kanë hartuar të gjithë dokumentacionin ligjor për një pjesë të mirë të këtyre godinave dhe ia kanë kaluar për miratim Këshillit Bashkiak të Durrësit. Këshilli Bashkiak i Durrësit me vendimin e tij ka miratuar kalimin në pronësi të këtyre banesave në favor të poseduesve, sipas procedurave ligjore dhe akteve nënligjore, duke autorizuar Bashkinë e Durrësit për të lidhur kontrata. Kjo procedurë është refuzuar të kryhet me shkrim nga ana e kryetarit të Bashkisë. Kjo, të nderuar deputetë, është tërësisht e papranueshme, është njësoj sikur Qeveria të refuzonte të zbatonte vendimet e Kuvendit. Si një njeri i ligjit që jam, kam pritur që ky njeri t'i thërriste logjikës, të linte mënjanë interesat e tij për të ndërtuar në atë zonë, të linte mënjanë betonierët, sekserët që shkojnë në emër të tij, si dhe deputetët e tij të ndërtimit, t'i linte jashtë të gjithë ndaj kësaj çështjeje njerëzore, por mbi të gjitha për një çështje ligjore. Kjo ka qenë detyrë e bashkiakut të Durrësit, të zhvillonte procedura dhe t'u jepte këtyre banorëve aktin e pronësisë, sipas ligjeve të këtij vendi, detyrë që ai ka refuzuar ta kryejë për 2 vjet.

Ndaj dhe sot i bëj thirrje kryetarit të Bashkisë së Durrësit që t'i japë rrugë vendimit të Këshillit Bashkiak, të zgjidhë konfliktin e krijuar prej tij, sepse ndryshe mbi të do të veprojë ligji me të gjithë forcën e tij, nga kallëzimi penal për moskryerje të detyrave shtetërore, deri në procedurat e mirëfillta për shkarkimin e tij.

Ndaj sot zgjodha të flas për këtë çështje para jush, për t'i garantuar 400 familjet e ish të përndjekurve politikë që banojnë në këto ndërtesa se procesi i nisur nga Qeveria do të shkojë deri në fund, por dhe për t'ju bërë me dije fillimin e një aksioni të plotë ligjor për zgjidhjen e këtij konflikti mes Këshillit Bashkiak të Durrësit dhe kryetarit të kësaj bashkie, aksion ligjor kundër cilitdo që guxon të shkelë ligjet e këtij vendi dhe të injorojë institucionet vendimmarrëse, dhe për këtë radhën e ka kryetari i Bashkisë së Durrësit.

Falemnderit!

Ardian Turku – Falemnderit, zoti Halimi!

Fjalën e ka zoti Bode, ministër i Financave.

Ridvan Bode - I nderuar zoti drejtues i seancës, Të nderuar kolegë deputetë,

Jam sot para jush për të njoftuar rreth mbylljes së raportimit financiar për vitin 2009, mbylljes së buxhetit të shtetit, si dhe konsideratave për zhvillimet ekonomike e shoqërore që kanë të bëjnë me ekonominë shqiptare përgjatë vitit 2009.

Duhet thënë se viti 2009 është viti i krizës më të thellë që ka njohur bota në 60 vjetët e fundit dhe, si e tillë, kjo krizë nuk la pa influencuar edhe në ekonominë shqiptare, në ritmet e zhvillimit të saj, pa prekur dot trendin kryesor të zhvillimit të ekonomisë sonë dhe pa mundur të tërheqë ekonominë shqiptare në vorbullën e saj.

Viti 2009 ishte viti kur ekonomitë e vendeve të konsoliduara, ekonomitë e rajonit, ekonomitë e eurozonës patën një rënie të fuqishme, vit i cili denaturoi në tërësi punën e disa dekadave për stabilitetin financiar publik të një sërë vendesh. Ky ishte viti kur u përdorën fonde të përmasave të paimagjinueshme për të stabilizuar zhvillimet në sektorin financiar dhe për të shpëtuar sektorin financiar në perspektivë, viti kur niveli i papunësisë njohu një rritje të madhe, kur vëllimi i eksporteve të vendeve po ashtu, ku rënia ekonomike u shoqërua me rënie të fuqisë blerëse dhe me rritje të nivelit të varfërisë në një pjesë të mirë të vendeve të prekura ose pjesërisht të rrezikuara nga kjo epidemi.

Ekonomia shqiptare në vitin 2009 mundësoi që të ketë një zhvillim pozitiv, një rritje e vlerësuar në 3% deri në 3,5%, duke qenë kështu ekonomia me rritjen më të lartë në të gjithë Europën dhe nga të paktat ekonomi që performuan pozitivisht për vitin 2009, përjashtuar Poloninë, e cila pati një rritje rreth 1%, ndërsa ekonomia shqiptare me mbi 3%, qëndron dukshëm në krye të vendeve të rajonit dhe të vendeve të Europës. Një rezultat i tillë i ekonomisë shqiptare dhe mbetja e saj jashtë vorbullës së krizës u dedikohen disa faktorëve:

Së pari, reformave strukturore të suksesshme të ndërmarra nga Qeveria në mandatin e saj të shkurt, të cilat mundësuan që ekonomia shqiptare, në vitin 2008, të arrinte rritjen më të madhe në 10 vjetët e fundit duke hedhur hapa të sigurt që edhe në perspektivë të mbetemi në ritme më të larta të rritjes dhe të zhvillimit në të gjithë rajonin dhe Europën.

Së dyti, viti 2009 u karakterizua nga një rol aktiv i Qeverisë dhe i financave publike në mbështetje dhe në zhvillim të ekonomisë reale, duke përdorur

stimuj të fuqishëm fiskalë. Për vitin 2009 në hapësirën e eurozonës, fondet e përdorura nga buxheti i shtetit mundësuan një ritmikë tërësisht pozitive. Duke sfazuar ciklin e ekonomisë shqiptare me atë të rajonit e të eurozonës dhe më gjerë, ne krijuam një faktor plus për të mundësuar daljen e shpejtë nga kriza. Përmes stimujve fiskalë ne arritëm të marrim masa dhe të bëjmë politika për uljen e taksave të drejtpërdrejta mbi biznesin, sidomos taksave të punës. Përgjatë vitit 2009, ne mundësuar përdorimin e të ardhurave të qenësishme nga privatizimet e dy vjetëve të fundit në funksion dhe në mbështetje të zhvillimit të ekonomisë, duke destinuar fonde më se të mjaftueshme në investimet publike, si dhe duke mundësuar që 1/3 e buxhetit të shtetit ose 10% e GDP-së të alokohej për investimet në infrastrukturë, në arsim, në shëndetësi, në ujësjellës etj.

Së treti, viti 2009 është produkt i masave eficiente të ndërmarra në politikën dhe në sferën monetare, për të mbështetur sistemin tonë financiar me likuiditet të kërcënuar nga rënia e depozitave, për shkak të panikut të përhapur nga opozita dhe njëkohësisht për të mbështetur kursin e këmbimit të lekut në raport me valutat ndërkombëtare, përmes marrjes së një kredie prej rreth 200 milionë euro, në një kohë tërësisht të papërshtatshme, kur shumë vendeve iu refuzua për ta përdorur si instrument të mbështetjes së programit të investimeve, të kryerjes së shpenzimeve në euro, që ka pasur Qeveria shqiptare në programin e saj të investimeve.

Këto tri masa të koordinuara me njëra-tjetrën mundësuan atë rezultat që tashmë dihet. Ekonomia shqiptare nuk u përfshi në vorbullën e krizës rajonale dhe globale. Sistemi financiar shqiptar doli nga kjo krizë pa pasoja, në sajë të marrjes së masave antikrizë përgjatë një viti tepër të vështirë. Gjatë vitit 2009 jo vetëm rritja ekonomike, por një sërë treguesish të tjerë makroekonomikë, dëshmojnë për performancën pozitive të ekonomisë shqiptare.

Niveli i inflacionit është niveli më i ulët i 10 vjetëve të fundit, duke u mbajtur në parametrat 2,2%, si inflacion mesatar. Bilanci i pagesave të Shqipërisë është po ashtu në terma pozitivë, përtej ndërhyrjeve dhe veprimeve të Bankës së Shqipërisë, për të mbajtur një sistem financiar, një sistem bankar tërësisht likuid.

Gjatë vitit 2009, në përputhje me zhvillimet në ekonominë reale dhe në treguesit kryesorë makroekonomikë, financat e shtetit performuan pozitivisht. Ne mundësuar që në fund të vitit 2009

të realizojmë 95% të programit tonë të të ardhurave të autorizuara nga Kuvendi i Shqipërisë, me një rritje rreth 3% në krahasim me një vit më parë, kur dihet që vëllimi i rritjes ekonomike ishte rreth 8%. Ka qenë kryesisht administrata qendrore ajo që ka mbajtur tempin dhe barrën jo vetëm në volum, por edhe në ritmikën e realizimit të të ardhurave fiskale.

Shpenzimet e buxhetit të shtetit u rritën rreth 7% në krahasim me vitin 2008, duke kapur nivelin e 377 miliardë lekëve. Nëse do të shikojmë në mënyrë analitike, shpenzimet e buxhetit janë destinuar tërësisht për t'u ballafaquar dhe për t'u përballur me pasojat e krizës ekonomike globale dhe asaj financiare. Rritjen më të madhe në këtë buxhet e kanë investimet publike, të zgjedhura si instrument për të nxjerrë ekonominë nga pasiviteti dhe goditja që mund t'i jepte rënia e kërkesës në tregjet ekonomike globale dhe rajonale, të papërshtatshme në këtë kohë për ekonominë shqiptare. Por rritja më e madhe ka qenë pikërisht në treguesit socialë, në mënyrë që buxheti i shtetit të suportonte ato pasoja negative që erdhën nga tronditja ekonomike, nga ngushtimi i vendeve të punës apo nga rënia e të ardhurave të grupeve të ndryshme shoqërore. Pikërisht gjatë vitit 2009, shpenzimet sociale u rritën me 26,9%, shpenzimet për papunësinë, për ndihmën ekonomike dhe kompensimet e tjera, u rritën me rreth 20% në krahasim me një vit më parë.

Përdorimi i buxhetit të shtetit në këtë formë, si instrument antikrizë jo vetëm për të mbështetur investimet, por edhe problemet sociale, mundësoi që goditjet e krizës globale të jenë tërësisht të limituara në ekonominë shqiptare, që ajo të ndodhet në një fazë shprese në zhvillimin e saj të shpejtë.

Në buxhetin e shtetit të vitit 2009, nëse do të shohim mënyrën e financimit të aktiviteteve, nga 32% në raport me GDP-në që është vëllimi total i shpenzimeve, 26,1% janë të ardhura të mbledhura nga administrata tatimore dhe doganore. Pra, janë të ardhurat e vitit, ndërkohë që investimet publike, sikurse e thashë, shkojnë në parametrat mbi 9%. Pra, nuk bëhet fjalë për deficit primar, por për deficit primar. Të gjithë ata që thonë se në vitin 2009 janë marrë borxhe për shpenzimet koherente mashtrjnë.

Në vitin 2009 buxheti ka pasur një tepërcë pozitive prej 3,5% të GDP-së nga të ardhurat dhe nga përdorimi i fondeve të privatizimit për investimet publike. Të ardhurat e privatizimit kanë qenë me 2,4% të GDP-së dhe huamarrja e re, gjatë vitit 2009, ka qenë konform programit dhe autorizimit që

Kuvendi i Shqipërisë i ka dhënë Qeverisë. Pra, deficitin ka qenë vetëm 4,5% e GDP-së.

Duke hedhur poshtë të gjitha akuzat dhe hamendjet, të gjitha shpifjet se përmes aktit normativ u bë tejkalmimi apo thyerja e parametrave të deklaruar nga Qeveria, unë, edhe një herë, konfirmoj se zhvillimet në financat publike, në vitin 2009, janë tërësisht pozitive. Në këtë vit, kur niveli i deficiteve, i huamarrjeve të reja në shumë vende të rajonit është mbi 6%, ekonomia shqiptare e ka pasur vetëm 4,5% ose 0,6% më pak sesa në vitin 2008, që ka qenë një vit tërësisht pozitiv.

Veç faktit që ne vijojmë të jemi një vend me suficit primar, filluar nga viti 2005 dhe i pathyer në gjithë këtë periudhë 5-vjeçare të qeverisjes sonë, unë mund t'ju rikujtoj se deficitin primar ka qenë prezent gjatë gjithë kohës së qeverisjeve të mëparshme dhe ka qenë vetëm periudha e fundit, kur ne vijojmë të performojmë në mënyrë pozitive dhe çdo huamarrje që bën, buxheti i shtetit e përdor vetëm për investime.

Borxhi publik në vitin 2009 shënoi një rritje të moderuar. Kjo rritje u kushtëzua nga 2 faktorë:

Së pari, nga fakti që GDP-ja nuk u konfirmua në nivelin e programuar.

Së dyti, nga fakti i rritjes së kursit të këmbimit të lekut në raport me euron, që çoi në një rritje konvencionale të nivelit të borxhit tonë publik.

Mund t'ju konfirmoj se kostoja e shërbimit të borxhit publik vijon të mbetet e ulët në të gjithë rajonin tonë. Në vitin 2009 ajo arriti në masën 3,2% e GDP-së. Kjo dëshmon nivelin më të ulët të të gjitha qeverisjeve të mëparshme, me një rritje të lehtë prej 0.2%, në krahasim me një vit më parë, e ardhur tërësisht nga koniunktura e tregjeve financiare.

Këto zhvillime dëshiroj t'i krahasoj me zhvillimet e vendeve të tjera. Në vitin 2009 GDP-ja në Shqipëri rritet mbi 3%, eurozona e ka -4% rënie ekonomike në të gjithë hapësirën e saj.

Deficiti buxhetor. Gjatë vitit 2009 eurozona ka pasur një deficit buxhetor prej 6,9%, kurse ne kemi një huamarrje prej 4,5%. Në fund të periudhës 2009, Shqipëria ka një nivel borxhi publik rreth 59% të GDP-së, eurozona 84% të GDP-së.

Rritja e borxhit publik në Shqipëri, në harkun e periudhës së krizës të dy-tri vjetëve të fundit, është rritur me 5 pikë përqindje në raport me GDP-në, në eurozonë 22,2%. Sikurse e thashë, shpenzimet për interesa vijojnë të mbeten më të ulëta nga ato të eurozonës, ndërkohë që niveli i të ardhurave për shkak të taksave të ulëta që përdorim, është më i ulët.

Zonja dhe zotërinj,

Gjatë vitit 2009 roli aktiv që luajti buxheti, politika fiskale dhe ajo monetare në Shqipëri, dha shenja të një përmirësimi edhe në ekonominë shqiptare. Në muajt e fundit të tremujorit të kaluar u krijuan kushte që e gjithë ekonomia globale të fillojë të dalë nga kriza, duke performuar pozitivisht në rritjen ekonomike dhe duke iu adresuar një ambienti të ri ekonomik. Edhe në ekonominë shqiptare, pas një periudhe të rënies së eksporteve disamujore, që filloi më dhjetorin e vitit 2008 dhe përfundoi në tetor të vitit 2009, vërehet një rritje e vëllimit të eksporteve në tre muajt e fundit, që është shpresëdhënëse.

Në këto kushte të krijuara niveli i depozitave në sistemin bankar ka arritur nivelin maksimal. Që në fillim të vjeshtës së vitit 2008 patëm shenja të ringritjes ekonomike në nivel rajonal dhe global. Ekonomia shqiptare po përafrohet me shpejtësi për t'u adoptuar me kushtet e ambientit të ri ekonomik, ndaj Qeveria shqiptare ka vendosur të ndërmarrë një politikë, e cila përputhet me fazën e zhvillimit të ekonomisë së vendit dhe të ndihmojë rritjen e shpejtë të saj.

Kjo politikë konsiston në dy drejtime:

Së pari, për t'ia lënë protagonizmin ekonomisë reale, duke ulur kërkesën e Qeverisë për paranë në tregun e brendshëm dhe duke mundësuar që e gjithë rritja e depozitave në sistemin bankar të mund të alokohet në kredi për sektorin privat. Kreditimi i sektorit privat përbën një nevojë, që do të gjejë mbështetjen totale të Qeverisë, e cila ka vendosur që nevojat për financim të mos vijnë nga tregu i brendshëm, por t'i adresohen tregut financiar global, duke përfituar nga pozita tërësisht pozitive e ekonomisë shqiptare dhe imazhi pozitiv që ajo ka në tregjet financiare globale.

Prej disa javësh kemi filluar procedurat për nxjerrjen e vendit tonë në tregjet financiare ndërkombëtare për emetimin e një prekjeje eurobondi me mbi 300 milionë euro, i cili do të mundësojë financimin e veprimtarive vjetore të Qeverisë për nevojat që ka ajo në monedhë euro, duke ndihmuar kështu në stabilitetin e kursit të këmbimit dhe shlyerjen e kredisë së vitit të kaluar, e cila, sigurisht, reflekton normat e interesit të tregut në atë kohë, duke ulur koston e borxhit publik edhe për vitin 2009 e në perspektivë.

Së dyti, nëpërmjet kësaj politike aktive të sferës monetare dhe të sistemit financiar, që konsiston, sikurse thashë, në rritjen e kapaciteteve kredituese për ekonominë reale, Qeveria ka vendosur të tërhiqet,

duke mundësuar uljen e lehtë të vëllimit të shpenzimeve, uljen e deficitit, uljen e borxhit publik, për t'i krijuar më shumë hapësirë ekonomisë private. Kjo ulje konsiston në një zvogëlim të buxhetit të shtetit prej 5% të vëllimit total të shpenzimeve, ulje e cila tashmë është adresuar në të gjitha ministrinë e linjës, në të gjithë përdoruesit e buxhetit. Ulja në fjalë prej 5% nuk do të prekë aspak politikën e deklaruar nga Qeveria, programin e saj politik të miratuar në Parlament për rritjen e pagave dhe të pensioneve, nuk do të prekë aspak mbështetjen për sektorët prioritarë në fusha të ndryshme të ekonomisë dhe në sektorët shoqërorë, siç janë arsimiti, shëndetësia dhe mbrojtja dhe nuk do të prekë aspak veprat e mëdha të infrastrukturës tashmë të deklaruar dhe të bëra pjesë e programit tonë politik të votuar në Parlament.

Edhe një herë, duke ju siguruar se zhvillimet në fushën e financave publike dhe atë të ekonomisë reale do të jenë pozitive, ju ftoj të gjithëve të jemi sa më aktivë në mbështetjen e ndryshimeve që po ndërmerr Qeveria, të cilat kanë të bëjnë jo thjesht me një shkurtim shpenzimesh, por me ndryshime në thelb, për reforma strukturore në të gjithë administratën dhe në të gjithë sektorët e jetës publike, të cilat do të mundësojnë një qeverisje më eficiente.

Falemnderit!

Ardian Turku – Falemnderit, zoti Bode!

Urdhëroni, zonja Aliolli!

Ledina Aliolli - I nderuar zoti drejtues i seancës,

Të nderuar zotërinj ministra,

Të nderuar deputetë,

Jam sot këtu për një çështje madhore të shoqërisë sonë që është mësimi nga e kaluara e dhimbshme e diktaturës komuniste.

Kanë kaluar 20 vjet nga rënia e Murit të Berlinit dhe po aq nga rënia e diktaturës komuniste në Shqipëri. Ajo çka trashëgojmë ne sot nga një sistem mizor 45-vjeçar është një tablo tragjike e statistikave të krimit komunist, gati në kufijtë e gjenocidit njerëzor. Sekretet që ende mbulojnë misterin e varrezave në Shqipëri edhe 20 vjet pas rënies së komunizmit, më sjellin në kujtesë tregimin e një ish të dënuari politik në qarkun e Korçës, i cili thoshte se në vitin 1946, kur filluan punimet për tharjen e kënetës së Maliqit, gjithë ditën dëgjohej një klithmë ogurzezë. Një zog i padukshëm, që populli e quajti "kau i kënetës", lëshonte një "Uuu!" vajtimtare të zgjatur. "Kau i kënetës" sinjalizonte për fatkeqësitë

e masakrat që ndodhën në ato vite. Ish i dënuari më pyeti: Edhe sa kohë do ta dëgjojmë "kaun e kënetës"?

Unë vij nga një qytet, i cili, edhe pse është konsideruar si tempull i civilizimit, kulturës dhe arsimit të kombit shqiptar, nuk u kursye nga terrori komunist. Mjafton të përmendim faktin se nga viti '45 deri në vitin '49 në Korçë kanë ekzistuar 7 burgje, midis të cilave përmendim: Burgu i Vjetër, Shtëpia e Rrapos, një pjesë e Metropolisë apo hotel "Manastir", ku janë torturuar me qindra qytetarë të pafajshëm të Korçës dhe kanë vuajtur kalvarin e gjatë të burgimit intelektualët: Foto Bala, Lluka Biba, Nazif Bababi e të tjerë. Në dënime të rënda politike u përfshinë edhe deputetë të Korçës, si: Kristo Kirka, Dhimitër Fulli, Xhavit Leskoviku e të tjerë. Varre masive, ku janë grupur disa qindra të persekutuar dhe të vdekur në burgjet e Korçës mund të përmendim: kampin famëkeq të punës në Maliq, në përroin e Shpiskës dhe në afërsi të kishës së Vithkuqit.

Të nderuar deputetë,

Këto fakte nuk janë thjesht historike e politike, por janë pikë së pari çështje morale, të cilat rëndojnë kujtesën e shoqërisë sonë, e cila më tepër se kurrë më parë thërret sot për ndërgjegjësim. Kujtesa e shoqërisë, kujtesa e një populli dhe ndërgjegjia kombëtare nuk mund të kuptohen si një program kompjuteri që mund ta fshih me një të shtypur butoni. Sot kërkohet katarsis, pastrimi i shpirtit, që njerëzimi e njeri si proces që në krijimin e tij. Ky pastrim i shërben të sotmes dhe të nesërtes. Gjenocidi e krimi nuk janë kategori abstrakte, por veprime konkrete të kryera nga njerëz të cilët sot, për ironi të fatit, diktojnë moralin e njerit prej pushteteve kyç të demokracisë, moralin e gjyqësorit. Janë rënkimet e nacionalistëve dhe të demokratëve të vërtetë, të mbytur në tortura çnjerëzore që na orientojnë për domosdoshmërinë e ndëshkimit të kriminelëve përmes hapjes së dosjeve dhe ligjit të lustracionit.

Kriminalët e vërtetë ende po konsiderohen pa faj, kurse të pafajshmit po mbajnë mbi supë peshën e dhimbjes njerëzore. Krimi duhet të ndëshkohet në çdo kohë, përndryshe ai të ndëshkon, sidomos kur ngrihet në sistem dhe pranohet. Pajtimi social, vënia në paqe e çekuilibrit njerëzor, ndërgjegjia e vuarë e popullit tonë, krahas shfaqjes së pendimit dhe të ndjesës, duhet të ketë edhe veprimin e institucionit të drejtësisë, i cili duhet të drejtpeshojë veprimet kriminale. Ligji i lustracionit është ai i cili

vë në vendin e merituar ngjarjet, njerëzit dhe shëron plagët. E vërteta duhet të dalë. Të gjithë kemi detyrimin hyjnor dhe njerëzor kundrejt të afërmeve të masakruar e të denigruar padrejtësisht, të lënë pa shenjë e pa varr nga shteti polico- komunist.

Maxhoranca jonë ka ndërmarrë iniciativa ligjore për të nxjerrë të vërtetën si një detyrim shtetëror. Unë bëj thirrje nga kjo foltore: Fajtorë, falja lidhet me evidentimin, njohjen e fajësisë dhe me pendimin, i shprehur ky në forma të ndryshme. Shfaqeni atë në mënyrë të natyrshme e të ndërgjegjshme, duke krijuar një klimë sa më optimale, humane e civilizuese, një besim të vërtetë, sepse pendesa ju rivlerëson e ju ridimensionon, lartëson shpirtin, falja është shprehja më e lartë e humanizmit! Le të shpresojmë që errësira e shpirtit të persekutorëve të zbardhet sa më shpejt nga drita e pendesës. Ky moment ka ardhur, ndaj mos e lini të shkojë, se harresa nuk e shëron shpirtin dhe ndërgjegjen!

Falemnderit!

Ardian Turku – Falemnderit, zonja Aliolli!

Urdhëroni, zoti Çota!

Rrahim Çota – I nderuar zoti drejtues i seancës,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në këtë prononcim timin mora shkas nga vendimet e fundit të Qeverisë shqiptare për caktimin e datës 20 shkurt si Dita e Kujtesë së Viktimave të Komunizmit, ngritjen e Muzeut për Viktimat e Komunizmit dhe ngritjen e Institutit të Kujtesës, si dhe një sërë vendimesh të tjera që lidhen me këtë ngjarje.

Me këtë rast dua të falënderoj Qeverinë shqiptare dhe Kryeministrin Berisha për kujdesin dhe vëmendjen që i kushtohen këtij problemi. Që ditën e parë, kur u njoftua se në periferinë e Tiranës është gjetur një varrezë masive, në qindra familje shqiptare, kujtesa për njerëzit e tyre të dashur, të cilët nuk kanë akoma një varr, u kthye në një sensibilitet të ri, në një dhimbje të re për të përndjekurit politikë. Ndërsa për persekutorët e tyre dhe për të gjithë strukturën e krimin, në kushtet e një shoqërie demokratike, ky moment u kthye në apel për të treguar ku janë varrë ata që ende sot nuk kanë një varr.

Të gjitha qëndrimet dhe qëllimet konvergojnë në një synim, që për mijëra njerëz të persekutuuar, të varrë e të zhdukur, për të cilët nuk është dhënë asnjë njoftim, të jepet informacion, të kenë edhe ata një varr për t'i respektuar, për t'i kujtuar, ashtu siç bëhet

me të vdekurit.

Kjo do të ishte zgjidhja e njerit prej ngërçeve të akumuluar jo nga vitet '90-të, por nga 50 vjetët e sundimit diktatorial në Shqipëri, e cila kërkon t'i zbardhë një nga misteret e kobshme të diktaturës. Kushdo që i është rrëmbyer në mesnatë babai, vëllai, bashkëshorti apo njeriu i tij i dashur, kërkon të dijë ku ka dhënë frymën e fundit, ku është ekzekutuar, ku ka lënë eshtrat e tij. Eshtrat e të vrrarit dhe të vdekurit janë një prej kolonave më të qëndrueshme të raportit që shqiptari ka pasur me vdekjen, me kanunin, me faljen, që lidhen me të drejtën dhe efektin e saj në të gjithë hierarkinë e marrëdhënieve shoqërore.

Kur u njoftua se në periferi të Tiranës u gjet një varrezë masive (dhe për çudi ky term na u duk i freskët, pasi në kujtesën tonë akoma nuk është shuar mënyra sesi makina e shovinizmit serb veptoi me vëllezërit tanë në Kosovë dhe në trojet etnike shqiptare gjatë viteve '90–'99), Kryeministri i vendit, zoti Sali Berisha, vendosi ta shpërblente atë që kishte njoftuar dhe kishte treguar vendin se ku ndodhej varreza masive. Kjo tregoi se ndodheshim të gjithë përpara një situatë të komplikuar dhe të ndjeshme, e cila duhej të stimulohej, që të vrrarët dhe të mbeturit pa nam dhe pa nishan që nga vitet '40 e deri sot, të mund të zbulohen.

Jo vetëm në Kanunin e Lekë Dukagjinit dhe atë të Skënderbeut, por në të gjithë të Drejtën Zakonore Shqiptare, çështja më problematike dhe më e kujdesshme është ajo e raportit me vdekjen. Çdo kanun dhe e drejtë zakonore, madje edhe e drejta në kushtet e shoqërisë moderne të çdo vendi të botës, e dënon të fshehurit e vendit ku ekzekutohet i dënuari, qoftë me të drejtë apo pa të drejtë. Kufoma as nuk fshihet, as dënohet me burg.

Ka kaq informacion për të gjithë atë që ka ndodhur në Shqipëri tash 40 e ca vjet, sa nuk është e vështirë për të mundësuar që e fshehta e dhunshme dhe barbaria e diktaturës të dalin mbi tokë. Ekzekutimet me gjyq dhe pa gjyq komunizmi i pati shndërruar në fushata propagande dhe demonstrimi të forcës. Dënimet me vdekje ishin formulimi i parë dhe formula e parë e cilitdo propagandues dhe njeriu të ligjit apo të forcës së sistemit, si pjesë e doktrinës së ideologjia komuniste do ta sundonte shoqërinë njerëzore. Në Shqipëri vazhdon të ketë një vakuum dhe gjendje hutimi te çdo familje që ka humbur një apo më shumë njerëz në diktaturë. Kanë kaluar 20 vjet dhe makina e heshtjes dhe e mosrrefimit e strukturës së tmerrit

diktatorial hesht. Ish-diktatura nuk jepet, qoftë për instinktin e saj, qoftë për zakonin e saj, qoftë për vullnetin e saj njerëngrënës.

Unë sot, si përfaqësues i trevës së Librazhdit, kam arsye të di ku është vlarë dhe varrosur Hajdar Balla nga Babja, vëllezërit Nezir, Kadri, Sadik dhe Qerim Muzhaqi nga Polis-Vilani, Ali Cekani dhe Rexhep Kasa nga Polis-Gurshpata, Halim Hasa nga Qarrishta apo im gjysh, Hysen Korani, nga Velçani, e shumë të tjerë në të gjithë Shqipërinë.

Persekutorët e totalitarizmit kanë pasur një hierarki të çuditshme për vdekjen, sa ajo me të drejtë i ka ngjarë një labirinti dhe duhet të konsiderohet e tillë. Diktatura e ka besuar gjithmonë veprën e vet, e ka besuar fshehtësinë e saj. Ajo u besohej njerëzve të saj.

Apeli për t'i nxjerrë nga humbëtira mijëra të vlarë është një nga apelet më qytetare që ka bërë Kryeministri i vendit, zoti Sali Berisha dhe Qeveria e tij. Ende janë gjallë, madje edhe aktivë, rojtarët e varrezave të fshehta, varrhapësit, njerëzit që derdhën plumbat mbi trupat e të dënuarve. Deri sot janë fshehur me qindra varre, me qindra trupa njerëzore. Diktatura zbatoi fshehjen e varreve, zakonin më barbar në historinë njerëzore. Në traditën e lashtë shqiptare, të cilën e ka sjellë deri në ditët tonë Kodi Zakonor, kodi burrëror i shqiptarëve nuk e lejonte dhunimin e kufomës të të vlarit për hasmëni dhe jo më të fshihej trupit i tij, të varrosej dhe të humbte.

Fshehja e varreve duket se ka qenë dhe mbetet një nga veprat më të kobshme të diktaturës dhe mekanizmave të saj, e ngjashme me maninë dhe mekanizmin e pushtesit dhe zakonin barbar të serbëve. Asnjë tokë ballkanase, asnjë tokë europiane, asnjë tokë në kohët e hershme, qoftë në ato të vona nuk është mbjellë me varre masive, si në rastin e shqiptarëve. Në Kosovë ato i ka praktikuar një pushtet kolonial dhe në Shqipëri diktatura komuniste. Si në njërin rast, edhe në tjetrin viktimat kanë qenë shqiptarët.

Nëse dje u morën jetën, u morën dritën e syve, u shkatërruan familjet dhe u bënë ç'patën mundësi, ata që dje shpërbleheshin dhe ndiheshin krenarë për krimet, sot duhet të tregojnë ku ndodhen eshtrat e viktimave, gjërat më të më të shenjta që shqiptarët i kanë respektuar edhe në kohët pagane.

Sindromi i paepshmërisë jo vetëm për krimet, jo vetëm për dhunën e barbarinë, duket se vazhdon të mbetet aktiv në Shqipëri. Ai është përcjellë si një stafetë te bijtë e etërve të krimin, të cilët nuk kanë pranuar asnjëherë të dënohen krimet e komunizmit

në Shqipëri.

S'ka kaluar shumë kohë kur e veja e ish-diktatorit, si të ishte në ditët e saj më të mira, nuk e pranonte pendesën, por shpallte një protagonizëm të verbër, çka tregon se zgjatimet e diktaturës janë aktive edhe sot në Shqipëri, janë në politikë e deri në tempullin e drejtësisë dhe të vendit ku bëhet politikë.

Eshtrat e të vlarëve dhe të të humburve duhet të kthehen. Njerëzit që i kanë fshehur dhe vazhdojnë t'i fshehin varret, janë gjallë. Ata duhet të rrëfejnë, madje Qeveria e sotme ka vendosur t'i shpërblejë.

Ato nuk janë varre faraonësh, por janë varre njerëzish të pafajshëm, të cilët kanë nevojë për nderimin e një shoqërie të emancipuar, që kanë nevojë për njerëzit e tyre të dashur, që duhet të pastrojnë ndërgjegjen njerëzore. Në varret e tyre nuk fshihen thesare, por është mbuluar me gurë e me dhé, me harresën e diktatit të një shteti që ishte kundër njerëzve të tij, njëra nga pafajësitë më të mëdha të shoqërisë njerëzore, nevoja për liri. Viktimat kanë nevojë për një varr, ashtu siç është kodi i përjetshëm i njerëzimit dhe të gjithë ata që kanë mundësi ta bëjnë këtë duhet ta bëjnë. Apeli im qytetar dhe parlamentar është: Ju që fshihni varret, tregojini ato se jo të gjithë jeni me faj!

Falemnderit!

Ardian Turku – Falemnderit, zoti Çota!

Me diskutimin e zotit Çota mbyllet edhe pika e parë e rendit të ditës.

Kalojmë në pikën e dytë, miratimin e procesverbalit të seancës plenare të datës 11.02.2010.

Ka vërejtje? Nuk ka.

Miratohet.

Sipas rendit të ditës të miratuar, kalojmë në diskutimin e projektligjit "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin "Për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare në Mesdhe të Konventës së Barcelonës "Për mbrojtjen e mjedisit detar dhe të rajoneve bregdetare të Mesdheut".

Ky projektligj ka kaluar në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit, si komision përgjegjës dhe në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, si edhe në Komisionin për Politikën e Jashtme, për dhënie mendimi.

Ka pyetje? Nuk ka.

Atëherë, ia japim fjalën zotit Besnik Dushaj, si relator në emër të Komisionit të Veprimtarive Prodhuese.

Besnik Dushaj – Falemnderit zoti drejtues i seancës!

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në mbledhjen e tij të datës 28 janar 2010 mori në shqyrtim projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare në Mesdhe të Konventës së Barcelonës për mbrojtjen e mjedisit detar dhe të rajoneve bregdetare të Mesdheut”.

Konventa ka si qëllim bashkëpunimin ndërkombëtar dhe një trajtim të koordinuar për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit detar dhe të rajonit bregdetar në zonën e Mesdheut. Në kuadër të kësaj konvente vendi ynë ka ratifikuar katër protokolle shoqëruese.

Aderimi në protokollin për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare në Mesdhe synon të ruajë dhe të përdorë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm zonat bregdetare të Detit Mesdhe, si natyrë e përbashkët dhe me trashëgimi kulturore. Gjithashtu, ky protokoll kërkon një kuadër të përbashkët instrumentesh të organeve qendrore e të qeverisjes vendore përkatëse për menaxhimin e kësaj zone.

Komisioni gjatë diskutimit të projektligjit, i kushtoi vëmendje të veçantë mbrojtjes së mjedisit detar dhe bashkëpunimit të ndërsjellë rajonal në këtë fushë.

Në përfundim të diskutimeve komisioni u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

Falemnderit!

Ardian Turku – Falemnderit, zoti Dushaj!

Zonja Trashani, në emër të Komisionit për Çështjet Ligjore?

(Zonja Trashani shprehet dakord.)

Falemnderit!

Në emër të Komisionit për Politikën e Jashtme?

(Përfaqësuesi i komisionit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Ka pyetje? Nuk ka.

Ka diskutime? Nuk ka.

Në emër të grupeve:

Grupi Parlamentar i LSI-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Grupi Parlamentar i PD-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Kalojmë në projektligjin e dytë “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në traktatin ndërkombëtar për burimet gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin”.

Në emër të Komisionit të Veprimtarive Prodhuese, si komisioni përgjegjës, zoti Gjana.

Jemin Gjana – Falemnderit zoti drejtues i seancës!

Projektligji është parë nga Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, i cili çmon se ratifikimi i këtij traktati për Shqipërinë është i rëndësishëm, pasi është një traktat i depozituar nga FAO. Shqipëria është ndër vendet më të vjetra anëtare të kësaj organizate të rëndësishme të bujqësisë dhe të ushqimit në botë.

Ndërkohë, duke pasur në konsideratë se Shqipëria është një vend mesdhetar me një diversitet jashtëzakonisht të madh të florës dhe faunës, ruajtja e biodiversitetit, e burimeve gjenetike, e specieve të florës dhe faunës shqiptare, shumë prej të cilave, për efekt të ndërhyrjeve të rënda që kanë ndodhur në ekosistemet e vendit tonë, kanë shkuar drejt pakësimit dhe, në ndonjë rast, edhe drejt rrezikimit për zhdukje, e bëjnë këtë traktat shumë të rëndësishëm. Anëtarësimi ynë në këtë traktat bën që Shqipëria jo vetëm t’u nënshtrohet detyrimeve për mbrojtjen e biodiversitetit, por të përfitojë nga programet e projektet që vijnë nga FAO, nga donatorë të tjerë të mëdhenj dhe nga organizma të ndryshme ndërkombëtare në mbrojtje të biodiversitetit.

Falemnderit!

Ardian Turku – Falemnderit, zoti Gjana!

Në emër të Komisionit për Çështjet Ligjore, zoti Sula.

Dashnor Sula – Falemnderit zoti drejtues i seancës!

Edhe Komisioni i Ligjeve e ka shqyrtuar projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në traktatin ndërkombëtar për burimet gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin”, nismë kjo e Këshillit të Ministrave.

Depozituese e këtij traktati është FAO, organizatë në të cilën bën pjesë edhe Shqipëria. Ky traktat nuk ka efekte anësore për legjislacionin shqiptar dhe, për më tepër, nuk ka as efekte financiare. Pjesëmarrja e Shqipërisë në të si shtet anëtar i FAO-s dhe prioriteti që kanë burimet gjenetike kanë një rëndësi të madhe.

Për këtë arsye ky projektligji i është paraqitur për miratim seancës plenare dhe anëtarët e Komisionit të Ligjeve, duke vlerësuar rëndësinë e

këtij traktati ndërkombëtar për rëndësinë e burimeve gjenetike për shtetin shqiptar, u shprehën unanimisht dakord për ratifikimin e tij.

Falemnderit!

Ardian Turku – Falemnderit, zoti Sula!

Në emër të Komisionit për Politikën e Jashtme?
(*Përfaqësuesi i komisionit shprehet dakord.*)

Falemnderit!

Ka pyetje? Nuk ka.

Ka diskutime? Nuk ka.

Në emër të grupeve:

Grupi Parlamentar i LSI-së?

(*Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.*)

Falemnderit!

Grupi Parlamentar i PD-së?

(*Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.*)

Falemnderit!

Kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës, projektligji “Për marrjen në kontroll të shoqërive publike”.

Ka pyetje? Nuk ka.

Ministri nismëtar? Nuk ka.

Në emër të Komisionit për Ekonominë dhe Financat, zoti Selami Xhepa.

Selami Xhepa – Falemnderit zoti drejtues i seancës!

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në mbledhjet e datës 27 janar dhe 1 shkurt mori në shqyrtim projektligjin “Për marrjen në kontroll të shoqërive publike”, të propozuar nga Këshilli i Ministrave.

Hartimi i një projektligji për marrjen në kontroll të shoqërive me ofertë publike është një hap i mëtejshëm për realizimin e një prej reformave të rëndësishme të ndërmarra nga Qeveria shqiptare në fushën e sigurimit të investimeve.

Projektligji ka për qëllim përcaktimin e rregullave që lidhen me kushtet dhe procedurat për marrjen në kontroll të shoqërive me ofertë publike, duke plotësuar një vakuum ligjor që kemi në legjislacionin përkatës.

Të rejtat që sjell projektligji janë:

Përcaktimi i parimeve të përgjithshme për marrjen në kontroll të shoqërive me ofertë publike, të cilat mbështeten në konceptet dhe eksperiencat më të mira ndërkombëtare dhe janë të nevojshme për administrimin me efektivitet të *tipeve* të ofruara nga një shoqëri publike.

Përmban dispozita të veçanta për mbrojtjen e zotëruesve të titujve të mbetur në minorancë.

Përcakton parimet bazë që garantojnë barazinë

e aksionerëve në raport me ofertat për të marrë në kontroll shoqërinë.

Garanton transparencë në shpërndarjen e informacionit, duke vendosur detyrimin ligjor për të publikuar të gjitha informacionet e nevojshme për zotëruesit e titujve të shoqërisë, objekt i ofertës publike.

Parashikon hartimin e politikave të investimit të shoqërisë administruese në përputhje me parimet e krijimit dhe funksionimit të tregjeve sekondare të letrave me vlerë, duke ndaluar krijimin e tregjeve të rreme që do të shtrembëronin funksionimin normal të tregut.

Forcon rolin e autoritetit mbikëqyrës financiar në drejtim të monitorimit dhe të mbikëqyrjes së procesit të marrjes në kontroll të shoqërive me ofertë publike dhe të ndërhyrjes në të gjitha rastet kur procesi bie ndesh me dispozitat ligjore.

Dispozitat e projektligjit janë hartuar në përputhje me standardet europiane dhe në veçanti me direktivat përkatëse të Bashkimit Europian për marrjen në kontroll të shoqërive.

Duke qenë se projektligji plotëson një boshllëk ligjor për funksionimin e tregut sekondar të letrave me vlerë, komisioni e miratoi me të gjitha votat e anëtarëve prezentë në mbledhje, duke paraqitur njëkohësisht edhe një sërë ndryshimesh që i janë bashkëlidhur relacionit përkatës.

Falemnderit!

Ardian Turku – Falemnderit, zoti Xhepa!

Në emër të Komisionit për Integrimin Europian, zoti Kadilli.

Fatbardh Kadilli – Komisioni e gjen atë të përputhur plotësisht me *acqui-communitaire* dhe legjislacionin sekondar të Bashkimit Europian.

Projektligji përfaqëson plotësisht legjislacionin tonë me legjislacionin parësor, me Traktatin e Lisbonës, më konkretisht me nenin 50, pika 2, shkronja “g” e këtij traktati dhe, njëkohësisht, me legjislacionin dytësor që ka të bëjë me direktivën e Parlamentit Europian dhe të Këshillit për marrjen në kontroll të shoqërive.

Parimet e këtij ligji sapo u shpjeguan shumë mirë nga kolegu Xhepa. Komentet dhe sugjerimet për ndryshime në nene i janë paraqitur komisionit përgjegjës dhe besoj se janë përfshirë në relacionin përkatës.

Falemnderit!

Ardian Turku – Falemnderit, zoti Kadilli!

Ka diskutime? Nuk ka.

Në emër të grupeve:

Grupi Parlamentar i LSI-së?
(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)
Falemnderit!

Grupi Parlamentar i PD-së?
(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)
Falemnderit!

Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës, projektligji “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”.

Ka pyetje? Nuk ka.

Zoti Ministër.

Spiro Ksera – I nderuar drejtues i seancës,
I nderuar zoti Kryeministër,
Të nderuar kolegë deputetë,

Qeveria, duke parë me prioritet plotësimin e kuadrit ligjor, mori iniciativën e shkrimit të Dokumentit të Politikave për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave për strategjinë sektoriale të punësisimit dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj.

Në kuadrin e implementimit të këtij dokumenti politikash, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta ka ndërmarrë për herë të parë nismën e hartimit të ligjit “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i cili sot po diskutohet në Parlament.

Projektligji, në nene të veçanta, synon përfshirjen dhe zbatimin e angazhimeve të ndërmarra nga Qeveria në kuadrin e Planit Kombëtar të Përafërimit të Legjislacionit dhe të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Shqipëria ka ratifikuar, gjithashtu, Kartën Sociale Europiane të rishikuar, instrument ky i rëndësishëm ku përcaktohet ushtrimi efektiv i së drejtës për kushte të sigurt dhe të shëndetshme në punë.

Plotësimi i këtyre standardeve bën të domosdoshëm edhe këtë projektligj dhe është dëshmi e seriozitetit të përmbushjes së detyrimeve të Qeverisë shqiptare në rrugën e saj integruese drejt Bashkimit Europian.

Projektligji përmbush rreth 30 pyetje të pyetësorit dhe pikërisht të kapitullit 19-të për politikën sociale. Gjithashtu, në projektligjin e paraqitur janë pasqyruar edhe dispozitat e *acqui-communitaire* në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, rekomandimet e fundit të BE-së, sidomos direktivës kuadër të Komisionit Europian. Ky projektligj plotëson angazhimet ndaj Organizatës Ndërkombëtare të Punës, me ratifikimin e konventës mbi sigurinë dhe shëndetin e punonjësve në mjedisin e punës, duke marrë parasysh edhe përvojat pozitive të legjislacionit të disa shteteve europiane, si:

Maqedonia, Rumania dhe Spanja. Miratimi i këtij projektligji është i nevojshëm për t'i dhënë fund mungesës së një vizioni në politikën e parandalimit të rreziqeve në punë, si pasojë e një mosgrupimi të normativave në fuqi, shumë prej të cilave të shpallura para hartimit të Kodit të Punës. Në hartimin e projektligjit, ministria e linjës ka pasur përfaqësues që kanë marrë pjesë në mbledhjet e grupit të punës dhe kanë rënë dakord për përmbajtjen e neneve të tij. Projektligji ka pasur, gjithashtu, asistencën e Organizatës Ndërkombëtare të Punës dhe UNIFEM-it.

Për herë të parë, me anë të këtij ligji futet detyrimi i punëdhënësit për vlerësimin e rreziqeve që burojnë nga ushtrimi i aktivitetit, që në fazën e hartimit të projektit të ndërmarrjes dhe marrjen e masave parandaluese në përshtatje me natyrën e rreziqeve të lindura gjatë punës. Risia e këtij ligji është detyrimi i punëdhënësve për të hartuar dokumentin e vlerësimit dhe parandalimit të rrezikut, i cili përmban masat me karakter teknik, organizativ, higjieno-sanitar, të cilat do të zbatohen sipas kushteve specifike të vendeve të punës së aktivitetit. Gjithashtu, është parashikuar ngritja dhe funksionimi i shërbimeve të mbrojtjes dhe parandalimit, si dhe e Këshillit të Sigurisë dhe Shëndetit në nivel ndërmarrjeje.

Risi tjetër e projektligjit është futja e nocionit të shërbimeve të specializuara jashtë ndërmarrjes, të kualifikuara për t'u kthyer në shërbime mbrojtjeje dhe parandalimi në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kontrolli i shëndetit përmbledh masat për të siguruar kontrollin dhe shëndetin e punëmarrësit në funksion të rreziqeve që kanë lidhje me sigurinë dhe shëndetin në punë. Çdo punëdhënës i një subjekti publik apo privat, vendas apo i huaj, fizik apo juridik, është i detyruar të sigurojë shërbimin mjekësor në punë, nëpërmjet mjekut të punës. Hetimi i aksidenteve në punë është risi, si edhe klasifikimi në katër shkallë i aksidenteve, duke u bazuar në pasojat që shkakton aksidenti dhe në numrin e personave të dëmtuar.

Projektligji parashikon grupet që janë të ndjeshme ndaj rrezikut, konkretisht mbrojtjen e veçantë të grave shtatzëna, grave me fëmijë në gj, të miturve, si dhe personave me aftësi të kufizuara, si dhe masat e veçanta që duhet të marrë punëdhënësi; përcakton autoritetet shtetërore përgjegjëse, duke parashikuar ngritjen e një këshilli ndërmintor për çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë, i cili është organ këshillimor dhe ngrihet me urdhër të Kryeministrit.

Gjithashtu, janë parashikuar edhe të drejtat dhe detyrimet që kanë autoritetet përgjegjëse shtetërore në zbatim të këtij projektligji. Në kapitullin përkatës parashikohen edhe sanksionet, ku Inspektorati Shtetëror i Punës është institucion përgjegjës. Të gjitha sa thashë më sipër janë dëshmi e përkujdesjes sociale nga ana e Qeverisë aktuale dhe një premtim i mbajtur mbi vëmendjen e vazhdueshme të Kryeministrit për të drejtat e njeriut dhe zbatimin e tyre në çdo aspekt të aplikueshëm kontraktual dhe ligjor.

Të nderuar deputetë,

Ju ftoj të gjithëve ta votoni këtë projektligj!

Falemnderit!

Ardian Turku – Falemnderit, zoti Ministër!

Në emër të Komisionit të Punës, zoti Paluca, urdhëroni!

Ndue Paluca - Falemnderit, zoti drejtues i seancës!

Komisioni i Punës dhe Çështjeve Sociale, si komision përgjegjës, mori në shqyrtim nismën e Qeverisë shqiptare për hartimin e projektligjit "Për sigurinë dhe shëndetin në punë". Kjo nismë e ndërmarrë nga Qeveria shqiptare synon përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të BE-së, sidomos direktivës kuadër të Komisionit Europian lidhur me zbatimin e masave që synojnë të nxisin përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit në punë, si dhe për të rregulluar me ligj problemet që kanë dalë në kushtet e reja të zhvillimit ekonomik e social të vendit për sigurinë dhe shëndetin.

Ky projektligj ka për objekt garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit të punëmarrësve dhe përcakton saktë përgjegjësitë e punëdhënësve për të arritur një nivel të përshtatshëm të mbrojtjes së shëndetit të punonjësve, duke marrë masat e duhura dhe efikase për parandalimin e rreziqeve në punë.

Përveç përgjegjësive, projektligji përcakton edhe detyrimet e punëdhënësve për sigurinë e mbrojtjes së punëmarrësve në të gjitha aspektet që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë. Në projektligj është rregulluar edhe fusha e zbatimit të tij, e cila gjen zbatim si për punonjës të kryejnë punë fizike, ashtu edhe për personelin civil që ka marrëdhënie punë me karakter administrativ. Në morinë e detyrimeve që janë të përcaktuara në këtë projektligj për punëdhënësin, si: informimi dhe këshillimi i punëmarrësve, rreziqet në punë etj., shumë të rëndësishme janë detyrimet për ngritjen e Këshillit të Sigurisë dhe Shëndetit, po ashtu, edhe kontrolli i shëndetit në punë.

Këshilli i Sigurisë është një organ partneriteti dhe në përbërjen e tij ka përfaqësues të punëdhënësve dhe të punëmarrësve në mënyrë të barabartë. Qëllimi i tij është këshillimi i rregullt dhe periodik i veprimtarisë së ndërmarrjes për parandalimin e rreziqeve në punë. Çdo punëdhënës është i detyruar të mbulojë me shërbim mjekësor nëpërmjet mjekut të punës kontrollin e vazhdueshëm të shëndetit të punëmarrësve dhe rreziqet që paraqet vendi i punës. Po kështu, është detyrim i punëdhënësve hartimi i dokumentit të vlerësimit dhe parandalimit të rrezikut, i cili përmban masat me karakter teknik, organizativ, higjieno-sanitar, të cilat do të zbatohen gjatë kushteve specifike të vendit të punës. Momenti i ecurisë së jetës ekonomike, sociale dhe politike është i tillë që sjell një këndvështrim më të plotë sa i përket sigurisë në punë, për grupe të veçanta që janë të ndjeshme ndaj rrezikut, duke parashikuar këtu mbrojtjen e veçantë të grave shtatzëna, të të miturve dhe personave me aftësi të kufizuara.

Projektligji përcakton edhe masat e veçanta që duhet të marrë punëdhënësi për të përshtatur vendin e punës për këtë kategori punonjësish, me qëllim parandalimin e rreziqeve që rrjedhin nga puna. Domosdoshmëria e miratimit të këtij projektligji dhe zbatimi i tij pas hyrjes në fuqi do t'i japë fund mungesës së një vizioni në parandalimin e rreziqeve në punë. Mbrojtja dhe siguri i shëndetit në punë të punonjësve lidhet edhe me zhvillimet e reja, të cilat kërkojnë një përshtatje të vazhdueshme të ligjeve me transformimet e thella që kanë ndodhur vitet e fundit në vendin tonë.

Gjatë diskutimit të projektligjit, komisioni ka dëgjuar dhe ka marrë në konsideratë të gjitha vërejtjet dhe propozimet e përfaqësuesve të ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale dhe përfaqësuesve të sindikatave të ndryshme, që ishin të interesuara për përmbajtjen e këtij ligji.

Në përfundim, komisioni ra dakord me përmbajtjen e këtij projektligji dhe vendosi ta kalojë unanimisht për shqyrtim në seancë plenare, me vërejtjet e dy komisioneve: Komisionit të Punës dhe atij të Integritimit Vërejtjet gjenden në raportin bashkangjitur këtij projektligji.

Ju falemnderit!

Ardian Turku – Falemnderit, zoti Paluca!

Në emër të Komisionit për Integritimin Europian?

Zoti Kadilli, urdhëroni!

Fatbardh Kadilli – Komisioni për Integritimin Europian, në cilësinë e komisionit që jep mendim,

mori në shqyrtim projektligjin. Ky projektligj është në përputhje të plotë me Acquis Communautaire dhe, më konkretisht për afron legjislacionin tonë me legjislacionin dytësor të BE-së, direktivën nr.391 të vitit 1989 që synon nxitjen e përmirësimit të sigurisë dhe shëndetit në punë, dhe me direktivën e vitit 1994, nr. 33, po të këshillit, "Për mbrojtjen e të miturve në punë".

Të gjitha komentet, mbas shqyrtimit nen për nen, janë përfshirë në raportin që shoqëron projektligjin. Jemi dakord me të gjitha vërejtjet.

Falemnderit!

Ardian Turku – Falemnderit!

Kalojmë në shprehjen e grupeve.

Në emër të Grupit të LSI-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Në emër të Grupit të PD-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Pika e fundit e rendit të ditës: Projektligji për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr 9616, datë 27.09.2006 "Për librin në Republikën e Shqipërisë".

Në emër të komisionit përgjegjës, zoti Mark Marku, urdhëroni!

Mark Marku – Falemnderit, zoti drejtues i seancës!

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, në mbledhjet e datave 27, 28 tetor dhe 3 nëntor 2009, shqyrtoi projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9616, datë 27.09. 2006 "Për librin në Republikën e Shqipërisë".

Ky ligj është propozim i Këshillit të Ministrave. Komisioni, pasi u njoh me përmbajtjen e projektligjit organizoi një seancë dëgjimore me aktorë të interesit, si: Bibliotekën Kombëtare, Shoqatën e Botuesve Shqiptarë, Shoqatën e Botuesve "Aleanca për Librin", si dhe Zyrën e Mbrojtjes së të Drejtave të Autorit. Në aspektin procedural projektligji vjen si nismë legjislative e Këshillit të Ministrave. Ai është depozituar në Kuvend dhe u është nënshkruar rregullave procedurale të shqyrtimit dhe miratimit të projektligjeve, sipas Rregullores së Kuvendit. Nisma për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin ekzistues për librin është rrjedhojë e dinamikës që ka pësuar vetë realiteti i ri shqiptar në fushën e botimeve.

Kjo nismë është në të njëjtën gjatësi vale me tërë impenjimin e Qeverisë shqiptare për të përafuar legjislacionin tonë me modelet më të përparuara të vendeve të zhvilluara europiane. Në aspektin juridik projektligji është konform Kushtetutës, neni 81, pika

1. Në përmbajtjen e dispozitave të këtij projektligji nuk ka formulime që vijnë në kundërshtim me këto dispozita. Projektligji fokusohet kryesisht në përmirësimin e atyre neneve, të cilat nuk kanë gjetur zbatim në ligjin aktual.

Projektligji synon krijimin e frymës së partneritetit ndërmjet shtetit, shkrimtarëve, studiuesve dhe botuesve, kudo ku ata ushtrojnë veprimtarinë e tyre. Njëkohësisht, ai ka për qëllim nxitjen e mëtejshme të informimit dhe formimit të qytetarëve shqiptarë përmes librit dhe ndërtimin e një politike sa më efikase në fushën e botimeve, prodhimeve dhe shpërndarjes së librit, duke mundësuar një zhvillim sa më harmonik të iniciativave private dhe duke lejuar një konkurrencë të ndershme në këtë drejtim.

Projektligji synon vendosjen e një ekuilibri sa më të plotë në mes librit, si produkt i mirëfilltë kulturor, ndaj të cilit shteti duhet të ketë një përkujdesje të veçantë, dhe si mall, produkt industrial, pra objekt i një biznesi privat. Ndërhyrjet në ligj i shërbejnë mbrojtjes së të drejtës kushtetuese të qytetarëve të Republikës së Shqipërisë për informim nëpërmjet librit dhe kulturës tjetër të shkruar, vënies në eficiencë të plotë të mekanizmave që veprojnë në fushën e menaxhimit të vlerave të kulturës së shkruar dhe të luftës ndaj piraterisë së botimeve.

Me mjaft interes në projektligj është planifikimi i mbështetjes dhe botimit të një literature nga fondi kombëtar i librit, duke financuar botime të posaçme për grupe të veçanta të shoqërisë, si: personat me aftësi të kufizuar, fëmijët, minoritetet etj. Gjithashtu, në dobi të këtij procesi janë përmirësimet e bëra në mënyrën e licencimit të shtëpive botuese, për lehtësimin e procedurave përkatëse e administrative në këtë fushë.

Komisioni, duke qenë parimisht dakord për të gjitha propozimet e bëra në këtë projektligj, vendosi kalimin e tij për miratim në seancën plenare dhe i kërkon seancës ta miratojë me të gjitha ndryshimet e bëra në komision. Projektligji e ka kaluar gjithë fazën e duhur dhe ka pasur oponencën e duhur teknike dhe profesionale dhe ne mendojmë se janë cilësore ndryshimet që i bëhen.

Falemnderit!

Ardian Turku – Falemnderit, zoti Marku!

Kalojmë në shprehjen e grupeve.

Në emër të Grupit të LSI-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Në emër të Grupit të PD-së?
(*Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.*)
Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Kryeministër.

Sali Berisha – Zotërinj deputetë,

Sot, në Asamblesë Parlamentare të OSBE-së ka pasur diskutime të gjëra lidhur me bojkotin që opozita shqiptare i ka bërë Parlamentit pas zgjedhjeve të 28 qershorit dhe kërkesat e saj për t'i dhënë fund bojkotit. Parlamentarët e kësaj asambleje, e cila përveç Europës përfshin Euroazinë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Kanadanë, kanë rikonfirmuar vlerësimet e tyre për zgjedhjet në Shqipëri si zgjedhje të lira dhe të ndershme. Ata i kanë bërë thirrje opozitës shqiptare që të zërë vendet e saj, brenda afatit kushtetues, në Parlament.

Në këtë pasdite ka pasur një deklaratë nga Presidenti i Asamblesë Parlamentare të OSBE-së, zoti Soares, personalitet i shquar, që tregoi një interes të veçantë për zhvillimin e zgjedhjeve në Shqipëri. Ai vizitoi vendin tonë para zgjedhjeve, për t'i prekur vetë të gjitha përgatitjet serioze që po bëheshin për zgjedhjet, dhe bëri vlerësimin e tij objektiv në mbledhjen e Komitetit të Përhershëm të Asamblesë Parlamentare të OSBE-së në Athinë.

Në deklaratën e tij, për të cilën unë dua ta falënderoj përzemërsisht, Presidenti Soares u referohet gjerësisht konkluzioneve të raportit përfundimtar të OSBE-ODIHR-it për zgjedhjet në Shqipëri. Presidenti Soares, në mënyrë të përsëritur, i bën thirrje opozitës shqiptare që t'i japë fund menjëherë bojkotit dhe të zërë vendet në Parlament, sikundër mirëpriti vullnetin e maxhorancës dhe të opozitës për ngritjen e një komisioni hetimor parlamentar për hetimin e plotë të zgjedhjeve, në respekt të plotë të Kushtetutës së vendit dhe të vendimeve të rëndësishme të Gjykatës Kushtetuese.

Unë jam këtu për të garantuar Asamblesë Parlamentare të OSBE-së dhe Presidentin Soares për vullnetin e plotë të maxhorancës për t'u angazhuar në reforma të thella dhe të gjithanshme me opozitën, për të respektuar plotësisht të drejtën e saj, sepse këtu nuk i bëhet asnjë lëshim opozitës, ajo e ka të drejtën kushtetuese për komisionin hetimor parlamentar dhe për të hetuar çdo gjë tjetër, përveç atyre problemeve mbi të cilat kanë vendosur gjykatat dhe për të cilat Kushtetuta e vendit, vendimet e Gjykatës Kushtetuese nuk autorizojnë as maxhorancën dhe as opozitën që të ndër marrin

ndonjë hap në këtë drejtim.

Ky dokument i ri, i lëshuar sot nga Kryetari i Asamblesë Parlamentare të OSBE-së, një personalitet i shquar, me përkatësi partiake socialiste, të cilin unë e vlerësoj, është në interesin më të mirë të vendit, është një nxitje tjetër për suksesin e tryezës, nga e cila me të vërtetë mund të dilet, në bindjen time më të thellë, me rezultate plotësisht të prekshme, me rezultate të cilat bëjnë të mundur kthimin e opozitës në Parlament.

Ndonëse raporti nuk kërkon që në komisionin hetimor parlamentar maxhoranca t'i japë shumicën pakicës, unë e kam bërë këtë zotim dhe e mbaj. Garantoj opozitën se ne i qëndrojmë premtimit tonë, t'i krijojmë asaj mundësi reale që në çdo votim të jetë shumicë, si dëshmi e një vullneti të hekurt, për t'u dhënë përgjigjen më të mirë shqetësimeve të saj.

Më duhet të theksoj se në të gjithë këtë debat që zhvillohet, koncesioni më madhor, i vërtetë, është që ne e bëjmë për hir të ardhjes së opozitës në Parlament. Në qoftë se lexoni dokumentet ndërkombëtare, nuk ekziston as edhe një i vetëm ku të thuhet që në një komision parlamentar opozita të ketë shumicën. Jo! Kjo nuk i kërkohet kurrë një shumice të dalë nga procesi zgjedhor i lirë dhe i ndershëm. Por këtë koncesion, në interesin më të mirë të vendit, e bën plotësisht maxhoranca jonë për t'i dhënë opozitës të gjitha garancitë se do të mund të ushtrojë hetimin e saj të plotë, natyrisht në respekt të Kushtetutës dhe të vendimeve kryesore të Gjykatës Kushtetuese. Këtu dua të theksoj se në të gjitha debatet, ajo që ka spikatur, ka qenë vlerësimi absolut dhe total i opozitës për Gjykatën Kushtetuese, vlerësim që nuk mbahet nga maxhoranca.

Më vjen mirë që faktori ndërkombëtar përdor si referencë pikërisht vendimet e Gjykatës Kushtetuese, ndaj së cilës opozita është shprehur besimplotë. Kështu që edhe ky dokument shton shanset reale të suksesit të procesit të negociatave, i cili është normale që mund të jetë me konfidencialitet, mund të jetë i hapur, por zgjedhja është e atij që thërret tryezën dhe ne e respektojmë.

Uroj dhe shpreh dëshirën time që kjo deklaratë solide, e cila përfill plotësisht opozitën, Qeverinë, zgjedhjet, Shqipërinë, të jetë një dokument frymëzues, në mënyrë që deputetët e opozitës më 4 mars të zënë vendet e tyre, në dinjitet të plotë, aty ku i kanë votuar qytetarët shqiptarë.

Falemnderit!

(Duartrokitje)

Ardian Turku – Falemnderit, zoti Kryeministër!

Para se të kalojmë te votimi i projektligjeve, hapim votimin për prezencën me elektronikë.

Mbylлим votimin.

Janë 72 deputetë të pranishëm.

Kalojmë te votimi i projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin “Për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare në Mesdhe” të Konventës së Barcelonës “Për mbrojtjen e mjedisit detar dhe të rajoneve bregdetare të Mesdheut””.

Hapim votimin në parim me elektronikë.

Mbylлим votimin.

Janë 72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton në parim projektligjin.

Kalojmë te votimi nen për nen me karton.

Kush është dakord me nenin 1? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Hapim votimin në tërësi me elektronikë.

Mbylлим votimin.

Janë 71 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton edhe në tërësi projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin “Për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare në Mesdhe” të Konventës së Barcelonës “Për mbrojtjen e mjedisit detar dhe të rajoneve bregdetare të Mesdheut””.

Kalojmë te votimi i projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në traktatin ndërkombëtar për burimet gjenetike të bimëve për bujqësinë dhe ushqimin”.

Hapim votimin në parim me elektronikë.

Mbylлим votimin.

72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton projektligjin në parim.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Kush është dakord me nenin 1? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Hapet votimi me elektronikë, në tërësi.

Mbylлим votimi.

72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton edhe në tërësi projektligjin “Për

aderimin e Republikës së Shqipërisë në Traktatin Ndërkombëtar për Burimet Gjenetike të Bimëve, për bujqësinë dhe ushqimin”.

Kalojmë në votimin e projektligjit “Për marrjen në kontroll të shoqërive publike.”

Hapet votimi me elektronikë, në parim.

Mbylлет votimi.

72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton në parim projektligjin.

Kalojmë në votimin nen për nen, bashkë me vërejtjet e komisionit.

Kush është dakord me nenin 1? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 3? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 4? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 5? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 6? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

(Nga neni 7 deri në nenin 38 ndiqet e njëjta procedurë e miratimit të neneve.)

Hapet votimi me elektronikë, në tërësi.

Mbylлет votimi.

72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton edhe në tërësi projektligjin “Për marrjen në kontroll të shoqërive publike.”

Kalojmë në votimin e projektligjit “Për sigurinë dhe shëndetin në punë.”

Hapet votimi me elektronikë, në parim.

Mbylлет votimi.

72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton në parim projektligjin.

Zoti Shehu, urdhëroni!

Tritan Shehu – Duhet të kalojmë me vërejtjet e të dy komisioneve, të Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë dhe Komisionit për Integrimin European. Të dyja komisionet kanë vërejtje paralele.

Falemnderit!

Ardian Turku – Nuk e keni parë draftin përfundimtar, pasi ka kaluar në komision?

Tritan Shehu – Të dyja komisionet kanë vërejtjet e tyre.

Ardian Turku – Drafti i dorëzuar këtu është në rregull?

Tritan Shehu – Po, çdo gjë është në rregull.

Ardian Turku – Dakord. Do të hidhen në votim nen për nen, sipas vërejtjeve të pasqyruara nga të dy komisionet përkatëse.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Kush është dakord me nenin 1? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 3? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 4? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 5? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 6? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

(Nga neni 7 deri në nenin 45 ndiqet e njëjta procedurë e miratimit të neneve.)

Kalojmë te votimi në tërësi, me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

72 vota pro. Miratohet në tërësi ky projektligj.

Së fundi, kemi projektligjin "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9616, datë 27.09.2006 "Për librin në Republikën e Shqipërisë".

Kalojmë në votimin në parim, me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

72 vota pro.

Kalojmë në votimin nen për nen, me kartonë.

Kush është dakord me nenin 1, bashkë me vërejtjet e komisionit përgjegjës, Komisionit të Edukimit dhe të Mjeteve të Informimit Publik?

Falemnderit! Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2, sipas variantit të Qeverisë?

Falemnderit! Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 3, sipas variantit të Qeverisë?

Falemnderit! Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 4, sipas variantit të parë?

Falemnderit! Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Shtohet një nen i ri, neni 4/a, për shfuqizimin e shkronjës "g" të nenit 21 të ligjit bazë. Pra, kush është dakord me nenin shtesë 4/a, sipas vërejtjeve të komisionit?

Falemnderit! Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Gjithashtu, shtohet neni 4/b, sipas vërejtjeve të komisionit.

Kush është dakord me nenin 4/b?

Falemnderit! Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 5?

Falemnderit! Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 6?

Falemnderit! Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 6/a, si shtesë nga vërejtjet e komisionit?

Falemnderit! Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 7?

Falemnderit! Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi, me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

72 vota pro.

Miratohet projektligji në tërësi.

Me miratimin e këtij projektligji seanca mbyllet.

Ju falemnderit të gjithëve!

Mirupafshim të enjten e ardhshme!

(Seanca u mbyll në orën 19:30)

E enjte, 25.02.2010
Seanca e pasdites, ora 17:00

Drejton seancën Kryetarja e Kuvendit,
zonja Jozefina Topalli (Çoba)

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 18.02.2010.

2. Miratimi i programit të punës për periudhën 1 mars-26 prill 2010.

3. Miratimi i kalendarit 3 javor të punimeve të Kuvendit (1-18 mars 2010).

4. Projektligji “Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave”.

5. Projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr.9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”.

6. Projektligji “Për krijimin e Institutit të Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri”.

7. Interpelancë me ministrin e Shëndetësisë, kërkuar nga deputetja Lajla Përnaska.

(Në sallë janë të pranishëm, për herë të parë në këtë legjislaturë, edhe deputetët e Grupit Parlamentar të PS-së.)

Jozefina Topalli – I nderuar zoti Kryeministër,
Të nderuar shkëlqesi ambasadorë,
Të dashur deputetë dhe deputete,

Po e çel këtë seancë duke përshëndetur përzemërsisht hyrjen në Parlament të opozitës shqiptare e duke shprehur vlerësimin tim më të mirë për vendimin që opozita mori dje në grupin e saj parlamentar për të ndërprerë bojkotin e për të marrë pjesë në punimet e Kuvendit.

Si Kryetare e Kuvendit dua të përsëris edhe një herë se ju do të gjeni të gjitha hapësirat që i takojnë një opozite, si çdo opozite tjetër në botë, bazuar në Kushtetutën e Shqipërisë.

Te Kryetarja e Kuvendit do të gjeni njeriun i cili ka ditur të përkushtohet gjatë tërë kohës që ajo ka qenë në opozitë, një opozitë e gjatë 8-vjeçare, të punojë me pasion e me përkushtim dhe të dijë të kuptojë opozitën sot në Shqipëri.

Bazuar në nenin 4, pika 4, të Rregullores së Kuvendit, deputetët që mungojnë në seancë kur kryhet betimi, betohen në seancën më të parë në të cilën marrin pjesë.

Unë si Kryetare e Kuvendit do të lexoj formulën e betimit, pastaj secili prej deputetëve, individualisht, do të bëjë betimin, do të ngrihet në këmbë dhe do

të thotë “Betohe”.

“Betohe me nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën si deputet i popullit në Kuvend. Do të përfaqësoj denjësisht popullin, do t’i bindem Kushtetutës dhe ligjeve, do të mbroj lirinë dhe pavarësinë e Shqipërisë, do të respektoj e do të mbroj të drejtat dhe liritë e shtetasve dhe do të përpiqem me të gjitha fuqitë e mia për përparimin e atdheut dhe mirëqenien e popullit tim.”

Agim Sali Leka – Betohe!

Jozefina Topalli – Falemnderit!

Albert Nikolla Çaçi – Betohe!

Jozefina Topalli – Falemnderit!

Alfred Maliq Dalipi - Betohe!

Jozefina Topalli - Falemnderit!

Andis Xhevdet Harasani - Betohe!

Jozefina Topalli – Falemnderit!

Arben Astrit Isaraj – Mungon

Arben Kristaq Çuko - Betohe!

Jozefina Topalli – Falemnderit!

Arben Nevruz Ahmetaj – Betohe!

Jozefina Topalli – Falemnderit!

Arben Qamil Malaj – Betohe!

Jozefina Topalli – Falemnderit!

Armando Ndue Prenga – Betohe!

Jozefina Topalli – Falemnderit!

Armando Nikolla Subashi – Betohe!

Jozefina Topalli – Falemnderit!

Arta Agim Dade – Betohe!

Jozefina Topalli – Falemnderit!

Artan Ilia Gaçi – Betohe!

Jozefina Topalli – Falemnderit!

Asllan Shaban Dogjani – Betohe!

Jozefina Topalli – Falemnderit!

Astrit Skënder Beci – Betohe!

Jozefina Topalli – Falemnderit!

Bashkim Muhamet Fino – Betohe!

Jozefina Topalli – Falemnderit!

Ben Kristaq Blushi – Betohe!

Jozefina Topalli – Falemnderit!

Besnik Mitat Baraj – Betohe!

Jozefina Topalli – Falemnderit!

Blendi Pëllumb Klosi – Betohe!

Jozefina Topalli – Falemnderit!

Damian Lek Gjijnuri – Betohe!

Jozefina Topalli – Falemnderit!

Dashamir Myslym Peza – Betohem!
Jozefina Topalli – Falemnderit!
 Ditmir Sulejman Bushati – Betohem!
Jozefina Topalli – Falemnderit!
 Eduard Pajtim Shalsi – Betohem!
Jozefina Topalli – Falemnderit!
 Eglantina Muharrem Gjermani – Betohem!
Jozefina Topalli – Falemnderit!
 Eltar Tofik Deda – Betohem!
Jozefina Topalli – Falemnderit!
 Enkelejda Hamit Shkreli – Betohem!
Jozefina Topalli – Falemnderit!
 Erion Mirdash Braçe – Betohem!
Jozefina Topalli – Falemnderit!
 Ermelinda Ahmet Meksi – Betohem!
Jozefina Topalli – Falemnderit!
 Ermonela Koço Felaj – Betohem!
Jozefina Topalli – Falemnderit!
 Ervin Agim Koçi – Betohem!
Jozefina Topalli – Falemnderit!
 Ethem Novruz Ruka – Betohem!
Jozefina Topalli – Falemnderit!
 Fatmir Avni Toçi – Betohem!
Jozefina Topalli – Falemnderit!
 Fatmir Sezai Xhafaj – Betohem!
Jozefina Topalli – Falemnderit!
 Fatos Banush Tushe – Betohem!
Jozefina Topalli – Falemnderit!
 Fidel Bahir Ylli – Betohem!
Jozefina Topalli – Falemnderit!
 Gazmir Halo Bizhga – Betohem!
Jozefina Topalli – Falemnderit!
 Gjok Llesh Jaku – Betohem!
Jozefina Topalli – Falemnderit!
 Gjovalin Pjetër Kadeli – Betohem!
Jozefina Topalli – Falemnderit!
 Gramoz Kaso Ruçi – Betohem!
Jozefina Topalli – Falemnderit!
 Hazir Sadri Gashi – Betohem!
Jozefina Topalli – Falemnderit!
 Ilir Hamid Beqja – Betohem!
Jozefina Topalli – Falemnderit!
 Ilir Tomorr Bejtja – Betohem!
Jozefina Topalli – Falemnderit!
 Ilir Xhelil Gjoni – Betohem!
Jozefina Topalli – Falemnderit!
 Kastriot Selman Islami – Betohem!
Jozefina Topalli – Falemnderit!
 Klodiana Fatmir Spahiu – Betohem!
Jozefina Topalli – Falemnderit!
 Luiza Mihal Xhuvani – Betohem!

Jozefina Topalli – Falemnderit!
 Marko Naum Bello – Betohem!
Jozefina Topalli – Falemnderit!
 Mimi Pjerin Kodheli – Betohem!
Jozefina Topalli – Falemnderit!
 Namik Hamza Dokle – Betohem!
Jozefina Topalli – Falemnderit!
 Ndue Marash Kola – Betohem!
Jozefina Topalli – Falemnderit!
 Olta Sotir Xhaçka – Betohem!
Jozefina Topalli – Falemnderit!
 Pandeli Sotir Majko – Betohem!
Jozefina Topalli – Falemnderit!
 Pirro Dano Lutaj – Betohem!
Jozefina Topalli – Falemnderit!
 Qemal Tahir Minxhozi – Betohem!
Jozefina Topalli – Falemnderit!
 Rudina Ibrahim Seseri – Betohem!
Jozefina Topalli – Falemnderit!
 Sadri Ismail Abazi – Betohem!
Jozefina Topalli – Falemnderit!
 Sajmir Bashkim Tahiri - Betohem!
Jozefina Topalli – Falemnderit!
 Shegush Osman Ligori – Betohem!
Jozefina Topalli – Falemnderit!
 Skënder Adem Hasa – Betohem!
Jozefina Topalli – Falemnderit!
 Taulant Kasem Balla – Betohem!
Jozefina Topalli – Falemnderit!
 Tom Gjek Doshi – Betohem!
Jozefina Topalli – Falemnderit!
 Valentina Abedin Leskaj – Betohem!
Jozefina Topalli – Falemnderit!
 Vangjel Llambi Tavo – Betohem!
Jozefina Topalli – Falemnderit!
 Vasilika Llambi Hysi – Betohem!
Jozefina Topalli – Falemnderit!
 Xhemal Myslym Qefalia – Betohem!
Jozefina Topalli – Falemnderit!
 Ju uroj punë të mbarë në Kuvendin e Shqipërisë!
(Duartrokjetje)

Në dosjen përpara keni deklaratën, në të cilën do të plotësoni pjesëmarrjen në grupin tuaj parlamentar, e cila më pas do të dorëzohet në sekretari.

Urdhëroni, zoti Ruçi, keni fjalën!

Gramoz Ruçi – Zonja Kryetare,
Zonja dhe zotërinj deputetë,

Ky Parlament ka një konflikt për të zgjidhur me popullin opozitar dhe populli opozitar ka një konflikt të pazgjidhur me këtë Parlament. Kemi ardhur t'i

japim një shans këtij Parlamenti që të zgjidhë këtë konflikt me popullin, përpara se populli ta marrë vetë në dorë zgjidhjen e këtij konflikti. Ky nuk është një konflikt për pushtet, por një konflikt i pastër interesi mes një pushteti që pengon transparencën e zgjedhjeve nga ka dalë dhe, nga ana tjetër, popullit që kërkon transparencën e votës që ka dhënë.

Ne nuk kemi ardhur sot këtu të marrim pushtetin përmes këtij hetimi të zgjedhjeve, por për të kërkuar të mos na mohoni të drejtën kushtetuese për të hetuar zgjedhjet plotësisht duke hapur kutitë e 28 qershorit. Nuk kemi ardhur të betohemi dhe të largohemi, por u betuam për Kushtetutën që ky pushtet e ka shkëlur 20 herë. Ne nuk kemi ardhur as të rrimë bashkë me ju në këtë sallë duke i kthyer kurrizin popullit opozitar dhe të mbyllim sytë para së vërtetës. Sot populli kërkon të drejtën sovranë për transparencën e kutive.

Ne jemi këtu në emër të çdo shqiptari që prej 6 muajsh proteston bashkë me ne për këtë të drejtë dhe do të qëndrojmë në këtë Parlament vetëm nëse ju dëshironi dhe keni vullnetin e mirë politik për ta zgjidhur këtë krizë politike, vetëm nëse ju do të çlirohemi nga konflikti i interesit që ju detyron të shkëlmi prej 6 muajsh Kushtetutën, për të mos lejuar hetimin kushtetues dhe ligjor të këtyre zgjedhjeve.

Shqipëria është në një krizë të thellë të demokracisë, është në një krizë të shtetit të së drejtës dhe njëherësh është në krizë ekonomike. Pushteti juaj e ka të pamundur t'u ofrojë shqiptarëve zgjidhje për faturën e jetesës që i mblidhet lak në fytyrë çdo familjeje shqiptare. E keni të pamundur t'u jepni shqiptarëve shkollim normal për fëmijët e kujdes të denjë shëndetësor për të sëmurët. E keni të pamundur t'u jepni shqiptarëve frymëmarrje për biznesin privat që po lëngon apo nëpunësve të shtetit që janë bërë çerdhe shërbëtorësh të pushtetit. E keni njëherësh të pamundur t'u jepni shqiptarëve integrimin e shumënderuar evropian. Në këtë drejtim nuk ju ndihmon as propaganda e turpshme kundër opozitës, edhe nga kjo foltore, të cilën, pavarësisht mungesës sonë, keni vazhduar ta keqpërdorni si kënd shpifjesh e sharjesh për ne, për të justifikuar betejën e përsëritur ose mbetjen në klasë për liberalizimin e vizave, që është vetëm paaftësia juaj shembullore. Por mos e bëni të pamundur transparencën kushtetuese të zgjedhjeve, sepse do të jetë e pamundur që ta mbani pushtetin e punëve tuaja përpara zemërimit të popullit të papunë dhe të papërfillur njëherësh edhe në këtë të drejtë elementare për transparencën.

E vratë dhe e shkatërruat popullin nëpërmjet Gërdecit me babëzinë dhe pangopësinë tuaj dhe të pangopurit i keni ende sot në krye, sepse nuk ka ende drejtësi në këtë vend, pasi janë kapur gjykatat. E shembët investimin e parave në Rrugën e Kombit përsëri me babëzinë tuaj dhe të pangopurit i keni përsëri në krye, sepse nuk ka drejtësi në Shqipëri, ku prokuroria ka ikur në drejtim të paditur. E mbyttët Shkodrën për herë të dytë, përsëri me babëzinë tuaj të Fierzës dhe të pangopurit i keni përsëri në krye, sepse në vendin tonë nuk ka drejtësi, sepse ka rënë shteti i së drejtës dhe ka fituar pushteti i votës së vjedhur. Një pushtet që vjedh votat është një pushtet që vjedh çdo gjë, sepse nuk ka nevojë t'i bindë njerëzit për votën që duan apo jo, ua merr me pahir.

Sot ne nuk ju kërkojmë pushtetin që nuk na i ka dhënë populli, por hapjen e kutive ku populli ka dhënë vendimin e tij për pushtetin, jo për të ndryshuar këtë herë rezultatin, por për të ndryshuar një herë e mirë rregullat e lojës që ju ka nxjerrë fitues juve pa pëlqimin e popullit. Nëse ju do ta lini popullin të shohë se çfarë ka në këto kuti, Shqipërisë dhe demokracisë së saj do t'i bëni shërbimin që nuk ia bëtë më 28 qershor, duke futur duart babëzisht në kutitë e votimit. E futët vendin në këtë krizë të rëndë, e cila nuk zgjidhet nëpërmjet një pazari, por vetëm nëpërmjet një parimi: ose qeverisni duke lejuar transparencën, ose largohuni për t'i ridhënë popullit të drejtën sovranë të vendimmarrjes së tij.

Zoti Berisha, më njihni mirë dhe po kaq mirë ju njoh edhe unë juve. Nuk dyshoj se pavarësisht atyre që ju thoni, për hesapin tuaj, ndaj meje, brenda vetes koha ju ka krijuar një bindje se unë jam një shqiptar tradicional që gënjeshtren e përçmoj dhe shpifjen e kam neveri. Gjithë këtë kohë ju kam dëgjuar, si të gjithë shqiptarët, të vajtoni mandatin që thoni se e keni humbur në qarkun e Fierit. Duke vajtuar apo duke bërë sikur po vajtoni, pretendoni se gjykata ka dhënë një vendim të gabuar lidhur me qendrën e votimit në Ruzhdië, por ju e respektoni, prandaj kërkon edhe nga ne që të respektojmë vendimet e gjykatës duke mos kërkuar hapjen e kutive të 28 qershorit. E kemi thënë çdo ditë, në këto 6 muaj se ne nuk kemi punë me vendimet e gjykatës. Të drejtën tonë kushtetuese të hetimit parlamentar nuk e ndalon as gjykata dhe ne nuk kërkojmë ta përdorim atë kundër gjykatave.

Megjithatë, zoti Berisha, unë kam një propozim dhe një sfidë publike për ju, jo vetëm në emrin tim personal, por edhe në emër të 8 kolegëve të tjerë të qarkut të Fierit; dhe jo vetëm të tyre, por në emër të

Partisë Socialiste dhe grupit të saj parlamentar, në emër të kryetarit të Partisë Socialiste: neve si socialistë na mjafton vetëm transparenca e kutive së Ruzhdies për t'u tërhequr nga fusha e kësaj beteje, nëse nga verifikimi i dokumentacionit zgjedhor të kësaj kutie nuk del qartë në sytë e popullit mekanizmi i korrupsionit elektoral. Ashtu siç mjafton vullneti i këtij Parlamenti, që sot ta sjellim dhe ta hapim këtu në Parlamentin shqiptar, në këtë sallë, para syve të popullit, vetëm kutinë e Ruzhdies, për të vendosur për më tej. Në qoftë se bindja jonë se zgjedhjet në Shqipëri janë të kërcënuara shumë seriozisht nga një mekanizëm grabitjeje përmes korrupsionit të komisionerëve nuk vërtetohet plotësisht para syve të të gjithë shqiptarëve dhe komunitetit ndërkombëtar, unë, personalisht, jo vetëm që ju kërkoj ndjesë publike, por jap dorëheqjen nga gjithë skena politike dhe shkoj në shtëpi së bashku me 8 deputetët e qarkut të Fierit. Në të kundërtën, juve, zoti Berisha, do t'ju duhet t'i hapni rrugën transparencës së plotë e të pakushtëzuar duke lejuar shqiptarët dhe botën mbarë të shohin të vërtetën e krimin elektoral që mbajnë brenda ato kuti.

Ne jemi gati për këtë sfidë dhe refuzimin tuaj në këtë rast do ta merrja si provën më të qartë për vërtetësinë e krimin që fle në ato kuti dhe të faktit se ju, zoti Berisha, e dini fare mirë se çfarë kanë brenda kutitë, prandaj ju trembeni, siç thotë populli, si "djalli nga temjani".

Ku ka shqiptar, përfshirë edhe ju vetë, që ta besojë se ju, zoti Berisha i 20 shkëlqeve kushtetuese; ju, zoti Berisha i hetimeve antikushtetuese parlamentare që nxorët në publik sekretet e mbrojtura nga ligji për të lançuar Prokurorinë e Përgjithshme; ju, zoti Berisha që, së fundi, edhe ndryshimet e buxhetit nuk i kaloni më në Parlament sipas Kushtetutës, ju penguaka ndërgjegjja juridike për të bërë një transparencë kushtetuese, që zgjidh edhe një krizë të njohur jo vetëm në Shqipëri, por në të gjitha kancelaritë e partnerëve tanë ndërkombëtarë, një krizë politike! Jo, zoti Berisha! Transparençën e kutive të 28 qershorit nuk e pengon ndërgjegjja juaj inekzistente juridike. Atë e pengon e vërteta që ju ka njoollur ndërgjegjen e 28 qershorit dhe, fatkeqësisht, ju errëson përditë e më shumë shikimin përpara një populli të tërë, që kërkon një të drejtë të tijën, jo një favor tuajin.

Nuk besoj se do t'ju shkaktonin nostalgji, zoti Berisha, shumë nga betejat e panevojshme që kemi bërë në këtë sallë, pothuajse në dy dekada, brenda apo jashtë Parlamentit, sepse, shpeshherë, i kemi

lodhur pa arsye shqiptarët, u kemi mërzhitur vazhdimisht shpirtin me *gërr-vërret* që kanë qenë larg halleve të vërteta të tyre. Kemi lënë të rritet në Shqipëri një klasë politike me pak fisnikëri dhe me shumë vese. Megjithatë, shumë gjëra do t'i marrë koha me vete. Të tjerat nesër, mbase, do të justifikohen me mungesën e traditës demokratike të vetë shoqërisë shqiptare. Ne mund t'ia falim vetë njëri-tjetrit duke gjetur justifikime për veten kur të merremi, si pensionistë, me gabimet e më të rinjve. Por një gjë nuk doja që brezi ynë ta lërë pa zgjidhur.

Zoti Berisha, sa jemi ende në jetën aktive politike, ju, unë dhe tërë kolegët e brezit tonë, lirinë dhe ndershmërinë në zgjedhje nuk do të doja kurrë që brezi ynë të mos ua linte dot as pas 20 vjetësh, të rejave dhe të rinjve që kanë lindur në vitin e fitores së demokracisë, mundësinë për të zgjedhur dhe për të zhvilluar zgjedhje si gjithë Europa, pa kuti të mbushura nga një dorë, pa lista të manipuluar votuesish, pa procesverbale konsensuale e komisionerë të korruptuar me paranë e zezë të pushtetit të bërë njësh me shtetin. Ja, pse jam unë në këtë betejë dhe Partia Socialiste, grupi i saj parlamentar dhe kryetari i saj Edi Rama dhe jo vetëm këta, por i gjithë populli, jo vetëm i majtë, por tashmë edhe ai i djathtë. Ne nuk do të tërhiqemi kurrë nga fusha e kësaj beteje që kërkon fundin e kësaj tradite të shëmtuar zgjedhjesh si askund tjetër në Europë, madje as si në Kosovë, ku, edhe pse ka dy vjet shtet, kutitë hapen dhe rihapen; votimet bëhen dhe ribëhen dhe askujt nuk i shkon në mendje të pengojë transparencën demokratike për asnjë palë. S'dua të përmend këtu Afganistanin e largët ku kemi çuar djemtë tanë për të ruajtur demokracinë e brishtë nga rreziku i fundamentalizmit, ku kutitë hapen pavarësisht se nuk do i pari i vendit. Nuk ka ku të shkojë e s'ka ku të rrijë kjo punë, ndaj edhe ne s'do të ndalemi pa e vënë në vend këtë punë.

Bojkoti ynë, i kritikuar shpesh në këta muaj, që pasqyra që nxori një fakt të qartë në sytë e të gjithëve: krizën e lirisë së zgjedhjeve në Shqipëri. Ne nuk e zgjidhim dot këtë krizë duke hequr qafe pasqyrën e Parlamentit gjysmak, zoti Berisha, por vetëm duke i bashkuar dy gjysmat për t'i dhënë fund kësaj krize me burrëri; për t'i dhënë fund kësaj krize me vullnet; për t'i dhënë fund kësaj krize me kurajë, për ta parë në sy të vërtetën e zgjedhjeve të shkuara, që në të ardhmen të mos ketë kurrë më zgjedhje si të shkuarat.

Falë bojkotit tonë dhe protestës popullore kjo është bërë tashmë jo vetëm çështja e çdo shtëpie

shqiptare, por edhe e çdo tryeze ndërkombëtare kur flitet për Shqipërinë.

Ne kemi ardhur t'ju dorëzojmë çelësin që hap derën e kthimit tonë përfundimtar në Parlament. U takon tashmë juve, shumicës në këtë sallë, të vendosni nëse e doni edhe opozitën në sallë apo e doni bashkë me popullin në rrugë. Me mandatet e popullit opozitar, deputetët e Partisë Socialiste duan të bëjnë hetimin e plotë dhe të pakushtëzuar të zgjedhjeve deri në zbardhjen e plotë të këtij krimi elektoral. Nëse nuk doni të dëgjoni zërin e së drejtës, ne do të jemi në krye të këtyre protestave pa ndalim, për të çliruar zgjedhjet nga duart e krimit elektoral.

Oferta jonë për zgjidhjen e kësaj krize dhe qëndrimi i grupit tonë parlamentar janë këto propozime që ju kemi sjellë sot këtu: amendimet e ligjit për komisionet hetimore dhe projektvendimi për ngritjen e menjëhershme të komisionit hetimor. Kjo ofertë vlen për këdo që thotë sot dhe nesër se nuk do të preken zgjedhjet, sot për ne që jemi në opozitë dhe nesër për ju që ta keni me vete kur të jeni në opozitë. Pra, ligjet i bën ky Parlament. Duke kthyer në ligj me konsensus këtë ofertë nuk ka asnjë pengesë as sot, as kurrë, as për pozitën e sotme dhe as për opozitën e nesërme. Vetëm kështu zgjedhjet në Shqipëri bëhen transparente, përmes kontrollit parlamentar dhe ata që administrojnë zgjedhjet, nga komisioneri i fshatit më të largët e deri te kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të mos mendojnë kurrë më se duke mbushur kutitë apo mbyllur kutitë, mund të jetojnë të patruar nga forca ndëshkuese e ligjit.

Edhe diçka në fund për ju, zonja Kryetare e Parlamentit.

Zonjë e nderuar, u informuam nga Asambleja Parlamentare e OSBE-së se pikërisht sot, ditën që ne vijmë për t'i dhënë një shans këtij Parlamenti për zgjidhjen e krizës, ju u keni thënë se opozita do të vijë vetëm për një formalitet betimi. Ndoshta ju vetëm këtë meritoni. Por ne nuk erdhëm këtu për këtë gjë, por për të dhënë kontribut konkret për zgjidhjen e një krize që nuk e kemi shkaktuar ne.

Do t'ju lutesha mos ta shpërdoroni këtë kontribut, siç shpërdoroni detyrën. Ju dhe kushdo që mendon si ju, harrojeni se Partia Socialiste mund të lodhet, mund të dorëzohet apo mund të përçahet nga presionet dhe diversionet tuaja.

Përfundimisht, topi është në fushën tuaj, zoti Berisha. Ne jemi këtu për të pritur reagimin tuaj. Sigurisht, edhe ne nuk pretendojmë që mund të jepet një përgjigje në moment. Megjithatë, koha

duhet të punojë dhe apeli ynë është që kjo kohë duhet të punojë për zgjidhjen e kësaj krize sa më shpejt.

Falemnderit!

(Duartrokitje)

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Ruçi!

Personalisht, kam pasur gjithnjë besim dhe bindje se kolegët e mi socialistë, në emër të interesit më të mirë të qytetarëve që përfaqësojnë dhe të forcës politike që i përkasin, do të merrnin vendimin që morën mbrëmë për të ndalur bojkotin dhe për të ndjekur punimet e Kuvendit, jo vetëm në respekt të mandatit të tyre, por edhe si rruga më e mirë për të dhënë kontributin e pazëvendësueshëm në proceset integruese të vendit.

Zoti Patozi, keni fjalën, urdhëroni!

Astrit Patozi – Falemnderit, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë,

Fillimisht, do t'ju kërkoj ndjesë për mospërmendjen e fjalës "kuti" gjatë gjithë fjalës sime më poshtë.

Së pari, do të desha t'u uroja mirëseardhjen deputetëve të opozitës, duke përshëndetur dhe vlerësuar pozitivisht vendimin e Partisë Socialiste për t'i dhënë fund bojkotit dhe për të zënë vendet e saj në Parlament. Ky është një urim që nuk niset kurrsesi nga pozita e të zotit të shtëpisë, pasi në këtë godinë apo tempull jemi njësoj bujtës dhe bashkëpronarë dhe kështu do të jetë gjithmonë.

Sot, në fakt, është një ditë e zakonshme për ne, por shumë e veçantë për ju, kolegë të opozitës. Sigurisht që jeni të mirëpritur, por jo edhe aq të mezipritur prej nesh sesa prej atyre mijëra zgjedhësve që ju kanë dhënë votën dhe besimin më 28 qershor për interesat më të mira të vendit dhe në funksion të aspiratave të Shqipërisë për t'u integruar plotësisht në familjen europiane.

Pavarësisht se kundërshtarë politikë, ne jemi shqiptarë dhe kjo nuk e përjashton mundësinë për t'i kërkuar e bërë edhe favore njëri-tjetrit. Por e vetmja gjë jashtë çdo logjike dhe diskutimi është që të vijmë apo të ikim prej kësaj sale për nder apo për inat të njëri-tjetrit.

Ndaj edhe vendimi i Partisë Socialiste për të ndërprerë bojkotin, në radhë të parë, është respekt për ata që kanë votuar kundër Qeverisë dhe maxhorancës së saj më 28 qershor, të cilët për gjashtë muaj me radhë kanë qenë pothuajse të papërfaqësuar. Por pavarësisht se i mirëpritur në të gjitha aspektet, ne nuk mund të themi se kthimi i Partisë Socialiste në Parlament nuk ishte i vonuar.

Gjatë gjithë kohës së mungesës së opozitës, ky Parlament ka punuar me kapacitet të plotë, por edhe me sforcimin e panevojshëm për të ruajtur numrat për çdo seancë. Për ta aktualizuar pak me ngjarjet e ditës, i bie si të jesh në gjendje emergjence pa pasur përmbajtje apo fatkeqësi tjetër natyrore.

Por ndërkohë ne jemi krenarë si maxhorancë se ky përqendrim energjish ia ka vlejtur, se në këta gjashtë muaj me një eficiencë të admirueshme, si asnjëherë tjetër në këto 19 vjet, janë miratuar shumë ligje dhe vendime të rëndësishme. Shumë prej tyre kanë pasur një vlerë të madhe në procesin e pakthyeshmë të liberalizimit të vizave dhe në hapat e mëtejshëm integrujes të Shqipërisë drejt Bashkimit European.

Duke mos qenë pjesë e kësaj vendimmarrjeje, Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste është më shumë se për çdo gjë tjetër debitor me zgjedhësit e vet, të cilët, të paktën në këto pika, nuk kanë asnjë dallim me votuesit e maxhorancës. Por ndoshta është më mirë që të mos qajmë e vajtojmë për atë që tashmë ka kaluar.

Siç e dimë të gjithë, vendi është përfshirë në procese të pandalshme zhvillimi, për të cilat nuk mund të jetë kurrë vonë për të kontribuar. Para nesh ka sfida të reja, ka reforma dhe ligje që kërkojnë shumicë të thjeshtë apo të cilësuar, të cilat presin jo vetëm bashkëpunimin, por edhe kritikën, jo vetëm dialogun, por edhe debatin e ashpër, jo vetëm votën, por edhe përmirësimin e mëtejshëm që mund dhe duhet të vijë nga përfshirja e opozitës, roli i së cilës është i pazëvendësueshëm për çdo shoqëri të lirë dhe demokratike.

Të nderuar kolegë të opozitës,

Linja jonë politike nuk është personale, madje as partiake, ajo është kombëtare dhe ne duam ta ndajmë me ju këtë filozofi, pa pasur asnjë kompleks që të ruajmë paketën kontrolluese apo *copyright*-in në këtë sipërmarrje të madhe.

Ndërkohë, na duhet të theksojmë sërish dhe pa asnjë hezitim se jemi krenarë me procesin zgjedhor më të mirë që Shqipëria ka zhvilluar ndonjëherë, proces i denjë për një vend anëtar të NATO-s dhe aspirant për në Bashkimin European, dhe për faktin se ato zgjedhje prodhuan Parlamentin dhe qeverisjen më legjitime që ky vend ka pasur ndonjëherë në të gjithë historinë e vet, pjesë e të cilave u bëtë edhe ju sot.

Por kjo bindje e jona që mbështetet në prova të pakontestueshme, që nga rezultati final i votuar 7-0 në të gjitha nivelet e deri te raportet, rezolutat dhe

deklaratat e pafundme, deri të një dite më parë, nuk na pengon që të trajtojmë me respekt dhe seriozitet çdo pretendim të opozitës për zgjedhjet që kaluan dhe sidomos shqetësimin e saj për proceset e ardhshme elektorale, sepse ne nuk e kemi çuar ndonjëherë nëpër mend që t'i imponojmë opozitës bindjen tonë në çdo rrethanë, madje edhe në rastin kur mungojnë plotësisht jo vetëm provat, por edhe argumentet.

Jeni në të drejtën tuaj të dyshoni, të kontrolloni dhe të kërkonti garanci për të sotmen dhe për të ardhmen, por është po kaq e vërtetë se nuk mund të na kërkonti neve një borxh që nuk jua kemi. Në funksion të lëvizjes suaj politike, që ju e paraqisni sikur ka për qëllim transparencën dhe zgjedhje më të mira në të ardhmen, mos lini gur pa lëvizur dhe aksion pa ndërmarrë, por gjithmonë në respekt të Kushtetutës, ligjeve të vendit dhe rregullave të shtetit ligjor. Ne jemi gati t'ju ndjekim, edhe pse nuk kemi as dilemën më të vogël se e gjitha kjo është një përpjekje për të nxjerrë vendin dhe institucionet e tij nga shinat e normalitetit.

Duhet të sqarojmë njëherë e përgjithmonë publikun se në të gjithë globin zhvillohen zgjedhjet një ditë, që pastaj të qeveriset për katër vjet. Në Shqipëri prej jush po kërkohet që të qeveriset një ditë për të pasur zgjedhje katër vjet me radhë. Ky absurd duhet të marrë fund njëherë e mirë. Sot mund të ishte dita e duhur e marrjes së përgjegjësisë.

Të nderuar kolegë,

Gjatë këtyre gjashtë muajve Partia Socialiste, apo më mirë të themi kryetari i saj, është përpjekur të mbajë me serum dhe oksigjen një kauzë të vdekur, apo më mirë të themi një çështje që nuk ekziston. Gjithçka ka nisur dhe është vërtitur më pas rreth një spekulimi me një fragment të raportit të OSBE-ODIHR-it, të cilin ne e kemi pranuar dhe mbështetur plotësisht, por jo duke i shkëputur fjali nga konteksti, sepse pas frazës "në 1/3-tën e rasteve numërimi ishte i keq", vinte konkluzioni se "nuk pati asnjë provë për manipulim dhe deformim të rezultatit". Kaq do t'i mjaftonte çdo force politike në botë që të linte mënjanë çdo ankesë dhe të përvishte llërët për zgjedhjet e ardhshme.

Pas krijimit të kësaj vorbulle artificiale për muaj me radhë janë lexuar keq dhe shumë keq Kushtetuta, ligjet më themelore të vendit, të gjitha rezolutat dhe deklaratat e njëpasnjëshme të institucioneve ndërkombëtare dhe, mbi të gjitha, oferta serioze dhe e sinqertë e maxhorancës për dialog dhe për zgjidhje të çdo mosmarrëveshjeje mes palëve, a thua se

ligjet dhe rezolutat ishin poezi hermetike, të cilat secili mund t'i lexojë dhe interpretojë si të dojë, në përputhje me shijet dhe me formimin e tij, dhe jo dokumente me detyra të qarta për t'u zbatuar.

Aq shumë u ekzagjerua me këtë fenomen, sa që u krijua ideja se gjuha, e cila ka lindur si mjet komunikimi që njerëzit të merren vesh midis tyre, ishte kthyer në të kundërtën e qëllimit të ekzistencës së vet.

Por pavarësisht asaj që ka ndodhur, sot e kemi një lajm të mirë: me ndërprerjen e bojkotit mund të themi se ka nisur leximi i mbarë i Kushtetutës dhe i rregullave të shtetit ligjor në këtë vend, të paktën për sa i përket mandatit të deputetit, dhe ne urojmë që stina e leximeve të këqija dhe shumë të këqija të ligjeve, raporteve dhe rezolutave të marrë fund sa më shpejt, sepse ajo nuk të çon kund. Kjo, në radhë të parë, do të jetë në interesin e vetë opozitës, të përfaqësimit të saj dinjitoz, i cili nuk mund të kuptohet pa praninë dhe debatin politik në këtë sallë.

Nga ana jonë, ne jemi të hapur dhe të gatshëm të debatojmë dhe të trajtojmë gjithçka me opozitën, sepse Parlamenti është tempulli i dialogut të politikës për çdo vend demokratik. Mirëpresim çdo ballafaqim apo diskutim për qeverisjen, buxhetin e shtetit, institucionet, reformat, për çdo ligj e vendim, madje çdo debat për të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen e këtij vendi.

Ne mund të debatojmë me njëri-tjetrin edhe për shiun e tërmetet, për Tanzimatën dhe Luftën Nacionalçlirimtare, madje edhe për rolin e Skënderbeut në historinë tonë kombëtare apo origjinën e lashtë të shqiptarëve, por ka një debat që nuk mund ta zhvillojmë dot kurrë, është ai për sistemin e vlerave, që të gjithë e kemi pranuar këtu e 19 vjet të shkuara, ose që në krye të herës (po përdor një shprehje që e ka shumë për zemër zoti Rama), i cili përcakton qartë disa principe, pa të cilat demokracia nuk mund të ekzistojë e jo më të funksionojë.

Sado të madh ta kemi hallin, ne nuk mund t'ia lejojmë vetes, as teorikisht, që të kapërcejmë muret që ndajnë pushtetet në një republikë parlamentare. Sado të prekur në dëshirat apo interesat tona, ne si ligjvënës nuk duhet as ta mendojmë që të marrim dhe, aq më pak, të ushtrojmëtribute që Kushtetuta dhe ligjet ia japin një pushteti tjetër. Askush në këtë vend dhe, aq më pak në këtë sallë, nuk duhet të ketë iluzionin se mund të ketë arsye apo rrethana të veçanta që mund të na shtyjnë të kapërdijmë vetveten dhe të shkelim mbi kolonat e shtetit ligjor

dhe rregullat e lojës për një vend demokratik. Natyrisht që jemi të gatshëm të ofrojmë të gjithë vullnetin tonë për të dëgjuar, trajtuar dhe zgjidhur çdo kërkesë dhe pretendim të opozitës, që nuk del jashtë këtyre principeve fundamentale dhe ky nuk është kusht, por thjesht një detyrim i të gjithëve këtu.

Sot është hedhur një hap i rëndësishëm, që ne sërish e përshëndesim, ai i thyerjes së bojkotit. Do të urojmë shumë që rikthimi i arsyes, që sado i vonuar qoftë, është në të gjitha rastet i mirëpritur, të mos jetë një moment i vetëm dhe i shkëputur pragmatist. Sigurisht, ne as ndikojmë dhe, aq më pak, nuk ndërhyjmë në vendimet e opozitës, të cilat ajo i merr në sovranitet të plotë, por, në rast se nga kjo sallë dilet menjëherë për të nisur sërish të njëjtën telenovelë në oborret e partive dhe kafenetë e Tiranës, sigurisht që neve nuk na mbetet gjë tjetër veçse të shprehim paraprakisht keqardhjen tonë të thellë. E uroj me gjithë shpirt që kjo të mos ju ndodhë, sepse përndryshe, të nderuar kolegë të opozitës, sot do të ishit shumë më të pabesueshëm se dje dhe nesër shumë më të pabesueshëm se sot.

Së fundi, dua ta mbyll këtë fjalë me një ftesë të hapur: Shqipëria europiane është vërtet deviza jonë politike, por ajo nuk është personale, nuk është partiake, është një linjë kombëtare. Ne nuk duam të kemi asnjë arsye për të menduar se ajo nuk është edhe kauza juaj, ndaj ju ftojme sinqerisht që të rrugëtojmë bashkë në këtë autostradë me sens unik, sepse Shqipëria është shtëpia jonë e përbashkët, njësoj si edhe kjo sallë e nderuar.

Falemnderit!

(Duartrokite)

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Patozi!

Fjalën e ka Kryeministri, zoti Berisha.

Sali Berisha – Zonja Kryetare,

Zotërinj ministra,

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Dola këtu për të përshëndetur vendimin e opozitës shqiptare, grupit të saj parlamentar, për të ardhur sot në Kuvend, për të marrë të gjitha përgjegjësitë kushtetuese që deputeti ka përpara atyre që e kanë votuar dhe e kanë sjellë në Parlament.

Gjithashtu, jam këtu për të garantuar opozitën për vendosmërinë time të palëkundur për të bashkëpunuar ngushtë me të, duke respektuar të drejtat e saj, pushtetin e saj, autoritetin e saj moral.

Kohërat janë shumë të veçanta për Shqipërinë

dhe shqiptarët, janë kohërat e një procesi jetik dhe vendimtar për këtë komb për të kapur të ardhmen e tij dhe shqiptarët, më shumë se çdo komb tjetër, edhe sot, të ardhme më të mirë konsiderojnë të ardhmen në BE. Janë reforma të shumta e të gjithanshme, të cilat presin kontributin e opozitës, presin kritikën e opozitës, vështrimin e saj kritik, oponencën e saj, por edhe mbështetjen e saj.

Me opozitën, në mandatin që shkoi, pavarësisht nga lufta normale politike, është proceduar me reformat më të thella të cilat bënë të mundur arrijten më madhore të Shqipërisë dhe të shqiptarëve pas Pavarësisë, anëtarësimin në NATO. Unë kam bindjen se së bashku ne do t'ia dalim që të meritojmë vlerësimet pozitive për të gjitha etapat e procesit të integritit në BE, statusin e kandidatit dhe etapat e tjera të këtij procesi.

Ka një kundërshti, të cilën unë dhe askush nuk mund ta injorojë, dhe kjo kundërshti ka të bëjë me një perceptim të ndryshëm të një realiteti, por ka të bëjë edhe me një të drejtë të padiskutueshme të opozitës, që të kërkojë garancitë më të mëdha për një proces zgjedhor. Duke qenë i vetëdijshëm se kjo është një e drejtë legjitime, më legjitimja e një opozite, në katër vitet që shkuan ata, të cilët bashkëpunuan në procesin elektoral, e dinë se Sali Berisha nuk ka lënë koncesion pa bërë, në mënyrë absolute çdo koncesion. Unë nuk jam nisur asnjëherë t'i diktoj opozitës vullnetin tim. Pse s'e kam pranuar këtë? Sepse e kam konsideruar detyrë time më kryesore t'i jap asaj garanci të plota dhe prandaj kemi arritur në një reformë zgjedhore shumë të rëndësishme.

Jam këtu sërish për të garantuar opozitën se do të ketë jo vetëm veto, por do të jetë përcaktuese në të gjithë kuadrin elektoral. Në rast se dëshiron, edhe sistemin le ta ndërrojë, në rast se dëshiron, le të përdorim teknologjitë më të larta, ndonëse, besoj, se me procesin e numërimit e zgjedhjeve të fundit, ne realizuam një gjë të përcaktuar deri më sot. Besoj se është e domosdoshme që opozicionet të afrohen. Le të përpiqemi të afrojmë perceptimin e realitetit, sepse nuk ka asgjë më të rëndësishme për të arritur në konkluzione të drejta sesa të prekësh realitetin, të përpiqesh të bësh Shën Thomanë.

Por, do t'u lutem për mirëkuptim, në rast se zoti Ruçi paraqet këtu Ruzhdien. Cila është Ruzhdia? Ajo është një qendër elektorale, në të cilën tre komisionerë të PS-së u larguan që në mëngjes, morën vulën dhe ikën. Unë po ju them juve, të nderuar zotërinj, se simetrizmi i komisioneve është një nga

shtyllat më kryesore të sistemit tonë për transparencën dhe mbi këtë bazë kemi rënë dakord. Në 50% të Shqipërisë jeni ju maxhoritarë dhe 50% të pjesës tjetër jemi ne maxhoritarë. Pra, jemi ndarë *fifty-fifty*. Por, në qoftë se tre komisionerë porositen të largohen, unë, të jeni të sigurt, duke shprehur respektin më të madh për komisionerët, asnjëherë nuk mund të zotohem për integritet. Megjithatë, atë qendër, ishte Gjykata e Apelit që e hodhi poshtë. Nuk urdhëroi përsëritje zgjedhesh. E hodhi poshtë dhe nga Sali Berisha nuk keni pasur dhe nuk do të keni asnjë akuzë. Problemi është me gjykatën. Me ju, jo, asgjë.

Së dyti, realitetet duhet të përpiqemi t'i perceptojmë siç janë. Ju dëgjoj në mënyrë të përsëritur të citoni një vendim të gjykatës, por, zonja dhe zotërinj deputetë, të dashur qytetare dhe qytetare shqiptarë, tre muaj më parë Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë i tha legjislativit shqiptar se ti nuk mund të hetosh pushtetin dhe qeverinë vendore, nuk mund të hetosh, sepse cenon autonominë e tyre, pavarësisht se ai hetim bazohej mbi fakte dhe dokumente dhe këtë vendim të dyja palët nuk e kemi vendosur në diskutim. Për shqiptarët, për ne të gjithë ka një pavarësi tjetër, që është më e rëndësishme se pavarësia e pushtetit vendor, dhe kjo është pavarësia e pushtetit gjyqësor.

Atëherë, nëse neve na imponohet nga një pushtet tjetër, që të respektojmë autonominë e pushtetit vendor, unë, absolutisht, nuk kam objeksion. Besoj se ndarja madhore janë tri pushtetet: legjislativi, ekzekutivi dhe gjyqësori. Pra, Gjykata Kushtetuese ndërhyri edhe brenda degës së pushtetit ekzekutiv. Besoj se edhe kultura juaj parlamentare (sepse shumë prej jush keni disa legjislatura në Kuvend), është e mjaftueshme të na bëjë ne të gjithëve ta perceptojmë njëllë realitetin dhe jo në dy mënyra të ndryshme dhe pastaj të mbetemi me slogane që nuk na shërbejnë për asgjë.

Zoti Ruçi, ju e mbyllët fjalën tuaj duke më thënë se topi është në fushën time. Do të më lejosh të bëj një shpjegim. Në fëmijërinë time të hershme, në fshatin tim nuk kishte top. Po unë kisha kalë dhe që nga fëmijëria e deri më sot unë kam mbetur kavalier. Çfarë t'i bëj unë topit, i dashur?

Jozefina Topalli - Falemnderit, zoti Kryeministër!

Zoti Ruçi, urdhëroni!

Gramoz Ruçi – Falemnderit!

Më falni që u ngrita për herë të dytë!

Dëgjova si përfaqësuesin e maxhorancës dhe

kryeparlamentaren, ashtu edhe Kryeministrin.

Më lejoni të shpreh qëndrimin e grupit tim parlamentar lidhur me qëndrimin e kryetarit të grupit tuaj parlamentar, të cilin do ta konsideroja me dy fjalë një fyerje dhe provokim për grupin parlamentar të PS-së, në një kohë që ne jemi këtu për të pritur reflektim. Pra, ndërsa ne prisnim reflektimin, ju, me fjalën tuaj, jo vetëm që na fyet, por edhe na provokuat. Megjithatë, kjo është puna juaj.

Së dyti, ju zoti Kryeministër, me përvojën e gjatë që keni, filluat të na përkëdhelni. Opozita e një vendi nuk është që të joshet pas përkëdheljeve të Kryeministrit. Ne nuk erdhëm sot që të na përkëdhelni ju. Ne erdhëm sot këtu që bashkë me ju të bëjmë zgjidhjen. Ju në fjalën tuaj përdorët justifikime të ndryshme. Ne nuk erdhëm për justifikimet që i kemi dëgjuar edhe herë tjetër. Erdhëm dhe hodhëm një hap për të gjetur zgjidhjen e kësaj krize.

E treta, ju erdhët këtu duke na bërë edhe koncesione neve si opozitë, se gjasme do të na lini shumë hapësirë e do të na krijoni shumë mundësi. Nuk i duam. Ne duam ato që na takojnë dhe nuk i presim hapësirat tona nga ju, as si Kryeministër. Opozita e një vendi nuk është që të funksionojë mbi hapësirat që do t'i lejojë ky Kryeministër. Keni filozofi dhe koncept të gabuar. Ne erdhëm që, së bashku me ju, t'i japim një shans zgjidhjes së krizës.

Sa i përket topit dhe kalit, gjetja s'është e gjetur. Nëse unë përdora fjalën top, opozita hodhi sot një hap. E hodhi një hap këtu në Parlament. E hodhi këtë hap me një propozim konkret, të cilin ende nuk e keni lexuar dhe pa e lexuar fare dhatë përgjigjen që as doni ta lexoni. Unë në fjalën time thashë se nuk e pres këtë përgjigje sot, por t'i japim kohë njëri-tjetrit, me qetësi dhe maturi, jashtë kësaj salle dhe brenda në këtë sallë, për të zgjidhur krizën. Ju thatë se jeni kavalier i hipur në kalë. Zoti Berisha, mirë kur e ke kalin, por këtu bëhet fjalë se ka ngordhur kali. Si mund të jesh kavalier, kur vendi është në një krizë politike, në një krizë institucionale dhe ekonomike? Ja pse kemi ardhur ne, zoti Berisha, jo për kavalierin, por për kalin.

Prandaj, edhe një herë i bëj apel qetësisë, maturisë dhe përvojës suaj politike, ta mbyllim këtu këtë seancë, t'i japim njëri-tjetrit kohë. S'kemi orë për të humbur, por, nëse na duhet një ditë, dy, tri, katër, pesë a një javë, të zgjidhim krizën, që të shërojmë kalin, jo kavalierin.

Falemnderit!

Opozita është e detyruar të largohet nga sala.

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Ruçi!

Atëherë, çdo propozim që ka opozita, siç e biseduam edhe me zotin Ruçi, do të depozitohet sipas Kushtetutës, ligjeve të vendit dhe Rregullores së Parlamentit.

(Deputetët e PS-së largohen nga sala.)

Më vjen keq, kisha dashur shumë të kisha gabuar në parashikimin tim.

Propozoj të bëjmë 5 minuta pushim.

(Pas pushimit)

Jozefina Topalli – Zotërinj deputetë, rihapim seancën. *(Lexon rendin e ditës.)*

Kalojmë te miratimi i procesverbalit të seancës plenare, datë 18.02.2010.

Ka vërejtje për procesverbalin? Nuk ka. Falemnderit! Miratohet.

Kalojmë te miratimi i programit të punës për periudhën 1 mars - 26 prill 2010. Konferenca e Kryetarëve ka qenë në unanimitet të plotë, bazuar dhe te Rregullorja, dhe i bëhet me dije edhe seancës plenare.

Votimi do të bëhet me karton. Jeni dakord? Falemnderit! Miratohet.

Kalojmë te miratimi i kalendarit trejavor të punimeve të Kuvendit për periudhën 1 mars - 18 mars. Për këtë Konferenca e Kryetarëve ka rënë në konsensus të plotë dhe i bëhet me dije edhe seancës plenare.

Jeni dakord? Falemnderit! Miratohet.

Kalojmë te projektligji "Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave".

Fjalën e ka zonja Ledina Alolli, në emër të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave.

Ledina Aliolli – Falemnderit, zonja Kryetare!

Komisioni për Ekonominë dhe Financat në mbledhjen e datës 16.02.2010 shqyrtoi projektligjin "Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave", propozuar nga Këshilli i Ministrave. Në mbledhje diskutuan përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë dhe të Ministrisë së Financave. Të rejtat që sjell projektligji janë:

Së pari, projektligji rrit më tej burimet e fondit të kompensimit. Përveç burimeve të përcaktuara në nenin 23 të ligjit "Për kthimin dhe kompensimin e pronave", projektligji parashikon edhe burime të tjera si: të ardhurat nga transferimi i pronësisë së parcelës ndërtime, sipas ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ardhurat nga veprimtaria turistike, sipas

ligjit nr.9734, datë 14.05.2007 "Për turizmin", si dhe të ardhurat e tjera të krijuara me ligje të veçanta ose akte nënligjore.

Së dyti, projektligji përmirëson më tej administrimin e fondit special të kompensimit të pronave. Administrimi i të gjitha të ardhurave të lartpërmendura do të bëhet në mënyrë të përqendruar nga Agjencia e Kthimit dhe e Kompensimit të Pronave. Fondi special do të arkëtohet dhe do të administrohet nga sistemi i thesarit.

Së treti, projektligji zgjat mandatin e kryerjes së shpenzimeve për kompensimin e pronave përtej vitit buxhetor. Ai krijon të drejtën për mbartjen gjatë vitit të ardhshëm buxhetor të gjendjes së mjeteve monetare të papërdorura të fondit të kompensimit të pronave.

Së katërti, projektligji zgjeron rrethin e subjekteve përfituese nga kompensimi i pronave. Nga ky kompensim do të përfitojnë të gjitha subjektet e shpronësuara që kanë fituar të drejtën për kompensim sipas ligjeve "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", "Për turizmin", si dhe subjekte të tjera që përfitojnë sipas ligjeve që mund të miratohen në të ardhmen.

Komisioni gjykon se zbatimi i dispozitave të këtij projektligji do të ndikojë në përshejtimin e procesit të kompensimit financiar të subjekteve të shpronësuara, që është një ndër detyrimet kryesore të reformës së pronësisë në vendin tonë. Ai e konsideron të nevojshëm projektligjin për shkak të risive që sjell, harmonizimit që realizon me legjislacionin aktual, si dhe efekteve pozitive, sociale e ekonomike. Për këto arsye komisioni e miratoi projektligjin në tërësi me të gjitha votat e anëtarëve të pranishëm.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zonja Alolli!

Fjalën e ka zoti Eduard Halimi, në emër të Komisionit të Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut.

Eduard Halimi - Falemnderit, zonja Kryetare!

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, organizoi dy mbledhje në lidhje me projektligjin "Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave". Në të dyja seancat komisioni e trajtoi me shumë përgjegjësi dhe seriozitet të gjithë projektligjin, duke bërë edhe sugjerime dhe reformulime të neneve, që i janë

bashkuar relacionit që ka ardhur nga komisioni përgjegjës, që është Komisioni për Ekonominë dhe Financat. Në aspektin ligjor projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin. Komisioni, me votat e të gjithë anëtarëve, në përputhje edhe me Rregulloren e Kuvendit, e kaloi atë për miratim, së bashku me vërejtjet dhe reformulimet.

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Halimi!

Ka pyetje për projektligjin? Nuk ka. Ka diskutime?

Po, zoti Ministër!

Bujar Nishani – Falemnderit, zonja Kryetare!

Ashtu siç e thanë dhe kolegët e dy komisioneve, projektligji përbën një rëndësi shumë të madhe në adresim të reformës së pronësisë, por kryesisht dhe në respekt të një procesi që ka të bëjë me kompensimin fizik të pronarëve shqiptarë. Tashmë, përmes një ligji të veçantë, fiksohet krijimi i një fondi, i cili do të jetë në dispozicion të drejtpërdrejtë të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për t'u përdorur në mënyrë autonome prej saj, një fond për të cilin përcaktohet se cilat do të jenë edhe burimet me të cilin ky fond do të ushqehet.

Deri tani është përdorur kryesisht një fond nga buxheti i shtetit, i cili është përcaktuar, në bazë të procedurave dhe rregullave, nga Ministria e Financave dhe i është vënë në dispozicion agjencisë përkatëse. Tashmë, me një ligj të veçantë, buxheti i shtetit çdo vit alokon një shumë të caktuar në këtë fond special. Pra, çdo qeveri tashmë është e detyruar të alokojë fonde nga buxheti i shtetit në këtë fond special.

Së dyti, një nga burimet e tjera të financimit të këtij fondi vjen nga privatizimet e pasurive ose asetëve publike që Qeveria kryen gjatë mandatit të saj.

Së treti, furnizohet me fonde financiare nga procesi i legalizimit që në mënyrë automatike i kalon të ardhurat e tij në këtë fond special, ashtu si dhe nga të ardhurat e tjera nga veprimtari të ndryshme që Qeveria shqiptare ose entet e saj kryejnë gjatë ankandit ose privatizimit të asetëve të tjera publike.

Është një risi tjetër që pasqyrohet në këtë ligj të veçantë, i cili jep mundësinë e kalimit të fondit të papërdorur nga njëri vit në fondin e vitit të ardhshëm, çka bën rritjen e mëtejshme të të ardhurave në fondin përkatës.

Pra, tashmë pronarët shqiptarë që përfitojnë nga kompensimi financiar kanë në dispozicion një fond konkret, dhe ligji detyron furnizimin e tij financiarisht

çdo vit, nga të gjitha aktivitetet publike me përfitime financiare që kryen Qeveria shqiptare.

Nisur nga praktika e konsoliduar (unë e kam përmendur edhe herë të tjera gjatë fjalimit tim në Parlament, vetëm gjatë vitit të kaluar Qeveria shqiptare arriti të dyfishonte fondin e parashikuar në buxhet, për kompensimin financiar dhe në të gjitha planifikimet e tjera qoftë ato afatmesme, qoftë në ato strategjike), Qeveria shqiptare ka hartuar dhe miratuar tashmë fondet për kompensimin financiar të pronarëve shqiptarë, të cilët janë parashikuar me rritje, sepse procesi gati dyfishohet nga viti në vit.

Edhe një herë gjej rastin të falënderoj mbështetjen që ka ardhur nga rekomandimet e komisioneve përkatëse, që janë pasqyruar në këtë projektligj. Gjithashtu, gjej rastin, njëkohësisht, të kërkoj mbështetjen e kolegëve deputetë për ta votuar këtë projektligj.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Ministër!

Ka pyetje? Nuk ka. Ka diskutime? Nuk ka.

Kalojmë në shprehjen e grupeve.

Në emër të Grupit Parlamentar të LSI-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Kalojmë në projektligjin “Për disa shtesa në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”.

Në emër të Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin?

Zotërinjtë Ardian Turku dhe Gëzim Dibra janë relatorët. Kush dëshiron të flasë?

Zoti Turku, urdhëroni!

Ardian Turku – Falemnderit, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë,

Tashmë për të gjithë ne është e qartë se në vite, madje gjatë tërë periudhës pas vitit '90 e deri më sot, menaxhimi i territorit ka qenë dhe vazhdon të mbetet një sfidë, sidomos në kuptimin e planifikimit të kontrollit dhe disiplinimit të ndërtimeve të reja.

Për hir të së vërtetës duhet të themi se vetë ekzistenca e zonave informale dhe e ndërtimeve informale të bëra në zona urbane, suburbane, në bregdet e në zona të tjera turistike, në tokat bujqësore dhe në terriore të trashëgimisë kulturore, tregojnë se problemi është kompleks, i lidhur sa

me kushtet ekonomike-sociale, aq edhe me mentalitetin; sa me mungesën e kuadrit ligjor, aq edhe me dobësinë e shtetit dhe të pushtetit lokal; sa me dëshirën për t'i dhënë zgjidhje, aq edhe me mungesën e përvojës.

Pikërisht me dëshirën dhe vullnetin për t'u dhënë rrugën e zgjidhjes një morie problemesh që paraqet menaxhimi i territorit, vetëm gjatë mandatit të kaluar qeverisës janë ndërmarrë disa nisma ligjore që po i përmendim shkarazi si më poshtë:

Ligji i ri “Për urbanistikën”, që në thelb ka synuar nga njëra anë decentralizimin në kuptimin e forcimit të kompetencave të pushtetit vendor dhe të rritjes së përgjegjësisë së tij për planifikimin urban dhe nga ana tjetër lehtësimin e procedurave ndaj biznesit.

Ligji i ri “Për legalizimin e zonave dhe ndërtimeve informale”, i cili synon t'i japë zgjidhje përfundimtare kaotizmit në ndërtim dhe formalizimit të këtij tregu.

Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”, i cili e zëvendësoi atë me Policinë Ndërtimore, duke i transferuar kompetenca të plota pushtetit lokal e njëkohësisht duke ruajtur Inspektoratin Kombëtar Ndërtimor si një nivel me kompetenca të caktuara e të harmonizuara me ato lokale. Mendojmë se ky hap decentralizues, vullnet i atëhershëm i po kësaj maxhorance të sotme, ka qenë në drejtimin e duhur, megjithëse që në inicim ka pasur pikëpyetjet e veta. Ka qenë në drejtimin e duhur, pasi jo vetëm që ky funksion parësisht duhet t'i takonte pushtetit vendor, por edhe se Policia Ndërtimore e dikurshme, që vepronte e pavarur nga pushteti vendor, por në terrioret e tij, pati krijuar një hendek të thellë në vend të bashkëpunimit. Ndërsa pikëpyetjet lidheshin me kapacitetet vendore, jetësore e logjistike për t'u përballur jo vetëm me ndërtimet pa leje të vogla e sporadike, por edhe me investime madhore strategjike që duhet të kontrolloheshin në zbatim e sipër. Për hir të së vërtetës, këto kapacitete ndryshonin dhe ndryshojnë edhe sot në mënyrë drastike, duke filluar nga komunat më të vogla, deri te bashkitë më të mëdha.

Nga ana tjetër, sektori i ndërtimit duke qenë një sektor motor i zhvillimit ekonomik në Shqipëri, i nxitur natyrshëm drejt fitimit maksimal, ka ushtruar presion ndaj pushtetit lokal duke mos qenë shumë i interesuar për zhvillimin harmonik të qendrave urbane, të zonave turistike apo për mirëmenaxhimin e tokave bujqësore.

Pikërisht evidentimi i këtyre elementeve ndikuese me kompleksitetin e ndërthurjes së tyre

na detyron të rishikojmë qëndrimet dhe të bëjmë korrigjimet e nevojshme. Në këtë logjikë, projektligjin e sotëm "Për disa shtesa në ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për Inspektimin e Ndërtimit", e konsiderojmë si një përpjekje të mirë për të eliminuar disa problematika që janë shfaqur në menaxhimin e territorit e që burojnë sa nga ndonjë mangësi që në origjinë, domethënë që në hartimin e ligjit bazë, aq edhe në mangësi që praktika e mëvonshme ka evidentuar.

Le t'i analizojmë elementet kryesorë të këtij projektligji:

Në ligj ndërhyhet me shtesa pas nenit 10, me nenin 10/1. Në thelb, i jepet kompetencë Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar për të ndërhyrë në territoret e pushtetit lokal, por vetëm në tri raste të kufizuara. Konkretisht: kur Inspektorati Ndërtimor Urbanistik i bashkisë ose i komunës, apo i qarkut, nuk e ka inspektuar këtë territor ose nuk është shprehur me vendim për këtë ndërtim, kjo do të thotë mungesë kapacitetesh ose mungesë vullneti në kryerjen e detyrës dhe ndërhyrja do të thotë forçimi i kontrollit mbi menaxhimin e territorit.

Së dyti, kur vendimi i Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik të bashkisë, komunës, qarkut, për prishje të ndërtimit të kundërligjshëm nuk është ekzekutuar, kjo tregon mungesë kapacitetesh logjistike etj., dhe ndërhyrja konsiderohet nga ne si ndihmë për pushtetin lokal. Në rastin më të keq është lënie me qëllim.

Së treti, kur subjektet qendrore që gëzojnë të drejta të ligjshme mbi pronën publike ose shtetërore të zëna nga ndërtimet e kundërligjshme, kërkojnë rikthimin e ligjshmërisë, sigurisht edhe në këtë rast forcohet kontrolli dhe zbatimi i ligjshmërisë nga një instancë plotësisht kompetente.

Siç shihet, zgjerimi i përgjegjësive të Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar përbën një instrument ligjor që i shërben kryesisht zhvillimit të territoreve në rastet kur organet e qeverisjes vendore nuk ushtrojnë kontroll për shkak të mungesës së kapaciteteve të tyre ose për arsye ndikimesh nga grupe të ndryshme interesi, apo që marrin vendime formale, por që nuk i ekzekutojnë kurrë.

Në thelb, dhënia e kësaj përgjegjësie është konceptuar si e drejtë që organi mund të ushtrojë për të treguar apo dëshmuar rikthimin e ligjshmërisë në vend, për shembull, në përfundim të kontrolleve të parashikuara nga ligji në inspektoratet vendore e jo si detyrim që ka si institucion në varësi të

institucioneve qendrore, për të sjellë rregull në territorin që administron pushteti vendor.

Kjo ndërhyrje në territore të zakonshme, me vendim për prishje, propozohet të kryhet vetëm në raste të veçanta, kur objekti është i kundërligjshëm sipas një procedure të mirëpërcaktuar qartë dhe pa ekuivoqe.

Për më tej, ndryshimet e propozuara parashikojnë qartë se Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar nuk mund të ndërhyjë me veprime për prishje objektsh të kundërligjshme në asnjë rast kur inspektorati vendor ka ushtruar përgjegjësitë e tij.

Së dyti, ndërhyrja në ligj me shtesën në vijim, neni 10/2, i korrespondon rastit kur ligji i mëparshëm ka pasur probleme në ushtrimin e inspektimit për shkak të së ashtuquajturës kompetencë e papërcaktuar mirë në kantiere dhe në mjedise ujore.

Në fakt, bazuar në Kushtetutë, në ligjin nr. 8743, datë 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", juridiksioni mbi mjedisin ujor të Republikës së Shqipërisë dhe vijën bregdetare është ekskluziv i shtetit shqiptar, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave. Mjaft i mprehtë bëhet ky problem në rastet e koncesioneve në relacionin sgarues të Këshillit të Ministrave, si dhe mjaft shembuj e argumente që flasin në favor të kësaj ndërhyrjeje.

Në thelb, kjo ndërhyrje nuk ka të bëjë me shkeljet e autonomisë lokale pasi edhe në ligjin ekzistues, siç e thamë edhe më sipër, edhe në tërë kuadrin ligjor ekzistues *de jure* pushteti lokal nuk e ka pasur këtë të drejtë. Pra, shtesa e propozuar vetëm sa saktëson, pasi vetë ligji në vitin 2007 ka kapërcyer tagrin që kanë organet e qeverisjes vendore në këto mjedise dhe e ka lënë çështjen e kontrollit në një situatë kritike. Në fakt, në këto territore nuk ka kontrolle.

Së treti, neni 10/3 si ndërhyrje, përcakton procedurat e ushtrimit të përgjegjësive që rrjedhin nga nenet 10/1 dhe 10/2 dhe tendenca është përputhja e tyre me procedurat e parashikuara në nenet 12,13 dhe 14 në ligjin bazë.

Së katërti, neni 2 i këtij projektligji ka të bëjë me shtimin e pikës 7 të nenit 15 në ligjin bazë e pikërisht me të konsideruarit si titull ekzekutiv të gjobave, parashikuar nga pika 17 e nenit 15 në ligjin bazë, e pikërisht me të konsideruarit si titull ekzekutiv të gjobave parashikuar nga pika 1, deri

në pikën 6 të po këtij neni. Për ekzekutim ngarkohet shërbimi përmbartimor.

Në relacionin shoqërues kjo argumentohet me faktin se deri tani Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar, mbështetur në mënyrën e zakonshme të njohur nga ligji, nuk ka pasur dhe nuk ka mundësi të arkëtojë qoftë edhe një gjobë të vetme. Në këto kushte ndëshkimi i kundërvajtësit mbetet ushtrim përgjegjësish i karakterit deklarativ dhe gjoba humbet qëllimin e parashikuar. Në këto kushte neni 2 do të mundësonte arritjen e vetëqëllimit të ligjit.

Përtej interpretimeve të mësipërme, në parim, për të tria nenet që përmban projektligji i propozuar "Për disa shtesa në ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për Inspektimin e Ndërtimit", mbështetur dhe në disa komente të prezencës së OSBE-së në Shqipëri, por edhe në mendimet e mëtejshme të paraqitura nga ministria përkatëse, komisioni diskutoi nen për nen duke bërë vërejtje, duke sugjeruar disa rregullime, që i paraqiten sot kësaj seance për miratim.

Mendojmë se këto shtesa synojnë përmirësimin e ushtrimit të kontrollit mbi territorin. Forcimi i vërtetë i këtij kontrolli kërkon bashkëpunim real mes Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar dhe bashkive, komunave e qarqeve.

Një vështrim i kujdesshëm i projektligjit dhe rregullimeve të sugjeruara nga komisioni evidenton që nuk kemi të bëjmë me shkelje të autonomisë vendore, madje ai përshkohet nga kujdesi për të shmangur keqkuptimet në terminologji dhe mbivendosjet gjatë ushtrimit të kompetencave.

Shqyrtimi në komision, në parim dhe nen për nen, me vërejtjet e paraqitura sot përpara jush, e ka gjetur këtë projektligj korrekt, të nevojshëm e të dobishëm për forcimin e kontrollit mbi territorin.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Turku!

Ka pyetje? Nuk ka.

Zoti Ministër, urdhëroni!

Sokol Ollidashi – Falemnderit, zonja Kryetare!

Ndryshimet që ne kemi sjellë në projektligjin "Për inspektimin e punimeve të ndërtimit", kanë të bëjnë me përmirësimin e ndjeshme që u përmendën edhe nga zoti Turku. Unë do të doja të citoja thjesht pse Ministria e Punëve Publike u detyrua të sjellë këtë nismë në Parlament.

Do ta nis duke ju dhënë disa shembuj konkretë:

Kemi pasur rastin e Gjirokastrës ku me një procedurë të ligjshme në standardet e bashkisë u dha një leje ndërtimi që shkaktoi shembjen e një

pallati ngjitur dhe ku Inspektorati Ndërtimor Kombëtar e kishte të pamundur të hynte për shkak të mungesës së kompetencës.

Kemi pasur situatën simetrike të Shkodrës dhe të Tiranës ku me investimet nga Ministria e Punëve Publike prej miliona eurosh janë bërë stacionet e ujit të pijshëm dhe në mënyrë të paligjshme 10 metra larg këtyre stacioneve u vendosën godina banimi, të cilat grumbullojnë ujërat e përdorura në gropat septike dhe ne nuk kemi ndërhyrë dot deri më sot, sepse jemi jashtë kompetencës së Inspektoratit Ndërtimor Kombëtar.

Kemi rastin e një ndërtimi të paligjshëm në Durrës ku, vetëm për hir të moskompetencës territoriale, ne kemi ndenjur dhe kemi parë të ndërtohen 9 kate pa leje në një pallat gjithsej nëntëkatësh. Pra, kemi parë një dyfishim të pallatit dhe nuk kishim se çfarë të bënim përpara këtij fakti, për shkak të moskompetencës territoriale.

Të gjitha këto arsye që unë i përmenda mbi shembuj konkretë, na detyruan të sjellim këtë ndryshim ligjor, i cili në asnjë rrethanë dhe në asnjë mënyrë nuk rrëmben, as nuk i merr kompetencat e pushtetit vendor, por vendoset si një siguresë e dytë ndaj çdo paligjshmërie që mund të haset me territorin.

Pse nuk i rrëmben? Sepse asnjë kompetencë thelbësore e pushtetit vendor dhe e inspektorateve vendore urbanistike nuk preket, por në raste të caktuara, siç janë rastet që përmenda më lart, i jepet kjo kompetencë edhe Inspektoratit Urbanistik Kombëtar. Për të siguruar përsëri pavarësinë e pushtetit vendor dhe inspektorateve lokale, ne kemi marrë një masë tjetër. Kjo masë është: Inspektoratit Kombëtar nuk i lejohet të ndërhyjë në rastet kur Inspektorati Lokal ka nisur një procedurë aty, apo është duke bërë një verifikim. Pra, Inspektorati mund të veprojë vetëm në rastet kur Inspektorati Lokal nuk e ka konstatuar situatën ose nuk ka marrë një vendim. Në rastet e tjera Inspektorati Kombëtar nuk ndërhy.

Për sa u përket vendimeve apo gjobave të vendosura nga Inspektorati Urbanistik Kombëtar, ajo që kemi bërë është pak a shumë një skemë që i shkon për shtat logjikës që ndjek kodi administrativ, pra, shndërrimin e këtyre vendimeve të inspektiveve të Inspektoratit Kombëtar në masa administrative të zbatueshme menjëherë, duke ruajtur për ankimesit të drejtën që t'i drejtohen gjykatës dhe të kundërshtojnë veprimin dhe jo vendimin e Inspektoratit Urbanistik Kombëtar.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Olldashi!
Ka pyetje? Po, zoti Bode, urdhëroni!

Ridvan Bode – Unë e përshëndes ligjin. Ai është një nismë shumë e mirë për të forcuar rregullin dhe respektimin e urbanistikës në të gjithë territorin e vendit. Veçse ekzekutimi i gjobave dhe dënimeve që jepen nga inspektorati mendoj se nuk është e përshtatshme që t'i lihet Zyrës së Përmbarrimit.

Ne jemi duke bërë një ligj për inspektoratet, ku të gjitha gjobat e lëshuara nga inspektoratet, të të gjitha kategorive, do të konsiderohen tituj ekzekutivë. Po ashtu, jemi duke bërë një procedurë ligjore shumë strikte, për të krijuar mundësinë që të gjitha inspektoratet t'i nxjerrin vetë detyrimet.

Do të mendoja që edhe në këtë ligj të jetë Inspektorati që të nxjerrë detyrimet dhe jo Zyra e Përmbarrimit.

Mendoj se me ligjin që po përgatisim (i cili shumë shpejt do të vijë në Parlament), inspektoratet do të kenë të gjitha instrumentet ligjore të përshtatshme për të vjelë detyrimet që vendosin me gjobat e tyre. Mendoj se, në qoftë se do t'i lihet Zyrës së Përmbarrimit vjelja e detyrimeve, kjo nuk do të ishte efiçente.

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Bode!
Zoti Olldashi, urdhëroni!

Sokol Olldashi – Falemnderit, zonja Kryetare!

Sigurisht, në qoftë se do të bëhen ndryshimet ligjore, siç thotë zoti Bode, në një kohë optimale, kjo do të ishte e panevojshme, por, për momentin, Inspektorati Urbanistik Kombëtar nuk i ka mekanizmat e duhur ligjorë për të vjelë taksat. Kjo gjë mund të bëhet përmes Zyrës së Përmbarrimit, që është institucion i ngritur për këtë punë. Por ne si ministri nuk do të kishim asnjë kundërshtim në qoftë se kjo do të kalonte nëpërmjet organeve të tatimeve.

Jozefina Topalli – Falemnderit!
Zoti Gjana, urdhëroni!

Jemin Gjana – Besoj se u thanë shumë argumente, por unë dëshiroj të tërheq vëmendjen në dy çështje që lidhen me këtë projektligj.

Së pari, dua të sjell në vëmendje se ky ligj është në mënyrë të drejtpërdrejtë i lidhur me ligjin e legalizimeve, ligji bazë dhe me ndryshimet që bëjmë sot. Për gati dy dekada në Shqipëri ka pasur një shpërthim të pamatë të ndërtimeve informale, madje, siç ka dalë nga studimet dhe nga përcaktimet e ALUIZNI-t, ndërtime pa leje kanë rezultuar edhe para viteve '90.

Ka qenë kjo maxhorancë e cila pas ardhjes në pushtet bëri realitet një ligj për legalizimet në Shqipëri, megjithëse edhe kolegët që sapo u larguan kanë qenë shprehur me fjalë se Shqipëria ka nevojë për një ligj të legalizimeve.

Unë dua të tërheq vëmendjen për një çështje. Në ligjin e legalizimeve dhe në filmimin satelitor që kemi bërë, besoj se kemi evidentuar të gjitha ndërtimet informale në vend deri në një datë të caktuar. Jam i bindur se dhe pas kësaj date ndërtimet informale do të vazhdojnë, por nuk besoj se do të ketë në të ardhmen vullnet politik, të njërit apo tjetrit krah, që të bëjë një ligj të ri për legalizimet në Shqipëri, çka do të thotë se do të jenë disa qindra milionë dollarë apo euro që do të investohen pa gjetur vullnetin politik për t'i legalizuar.

Në këtë pikëpamje mosforcimi i Inspektoratit të Ndërtimit, i cili është kamxhiku që ka në dorë pushteti lokal dhe qendror për t'u thënë "Stop" jo me gjoba, por me prishje ndërtimeve informale pas asaj date që kemi vendosur në ligj, do të jetë një dëm shumë i madh që do të shkaktojë për të ardhmen.

Së dyti, i vetmi institucion që reagoi pasi ky projektligj u depozitua në Kuvend ka qenë Bashkia e Tiranës dhe kryetari i saj, me shqetësimin se ligji prekte kompetencat e të zgjedhurve vendorë dhe të pushtetit lokal. Në fakt, Komisioni i Veprimtarive Prodhuese, në dy mbledhjet e tij, e diskutoi projektligjin dhe e miratoi ashtu siç kishte ardhur nga Qeveria. Por, nisur nga shqetësimet e zotit Rama, zyra e OSBE-së në Tiranë paraqiti në Kuvend dhe në komisionin parlamentar disa shqetësime dhe disa korrektive, të cilat ajo gjykonte se bënin të mundur mosprekjen e asnjë kompetence të pushtetit vendor, që janë në legjislacionin e sotëm shqiptar. Komisioni, duke bashkëpunuar edhe me strukturat teknike të ministrisë, ka marrë në konsideratë të gjitha vërejtjet e OSBE-së dhe i ka parashtruar në ligj në formën e amendamenteve që janë paraqitur sot.

Desha t'i sqaroj këto dy momente sepse besoj se janë të lidhura me thelbin e projektligjit që është paraqitur për shqyrtim.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Gjana!

Ka pyetje? Nuk ka. Ka diskutime? Nuk ka.

Në emër të grupeve:

Grupi Parlamentar i LSI-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Grupi Parlamentar i PD-së?
(*Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.*)
Falemnderit!

Kalojmë te projektligji “Për simbolet e përkujtimit të viktimitave dhe të krimeve të komunizmit në Shqipëri”.

Në emër të Komisionit të Ligjeve, si komision përgjegjës, zoti Strazimiri, urdhëroni!

Gent Strazimiri – Falemnderit, zonja Kryetare!

Me propozim të Kryeministrit, Qeveria ka paraqitur projektligjin “Për simbolet e përkujtimit të viktimitave dhe të krimeve të komunizmit në Shqipëri”. Ligji, që ka si qëllim kryesor përcaktimin e disa simboleve të përhershme për të përkujtuar viktimat e shkaktuara nga regjimi komunist, ka propozuar ngritjen e një muzeu dhe të një obelisku në nderim të këtyre viktimitave, si dhe në nenin 3 kërkon që data 20 shkurt të shpallet si dita e përkujtimit publik në nderim të viktimitave të krimeve të shkaktuara nga regjimi komunist.

Ne si komision, por edhe unë personalisht, këtë projektligj e shohim si një hap të mëtejshëm për ngritjen e simboleve për përkujtimin e viktimitave dhe krimeve të regjimit komunist në Shqipëri nga 29 nëntori 1944 deri në vitin 1992, kur ky i fundit ra plotësisht.

Projektligji përcakton krijimin e disa simboleve për të përkujtuar viktimat dhe krimet e shkaktuara nga regjimi, si edhe disa objekte si muzeu e obelisku në përkujtim të tyre. Vendosja e datës 20 shkurt, për mendimin tim, është një datë e gjetur, një datë simbolike, shumë e rëndësishme në historinë e popullit shqiptar, është data kur shqiptarët, të bashkuar, u mbledhën në Sheshin “Skënderbej” dhe rrëzuan simbolin e diktaturës, monumentin e diktatorit.

Besoj se është një datë e rëndësishme që u shtohet datave të tjera të përkujtimit të asaj periudhe, siç është data 8 dhjetor, dita e fillimit të lëvizjes studentore apo data 21 maj, dita e përkujtimit të Revoltës së Spaçit.

Më lejoni të theksoj se ka qenë dhe do të jetë gjithnjë bindja ime se ne nuk do të jemi kurrë evropianë të mirë, nuk do të jemi kurrë shqiptarë të mirë, madje do të jemi qenie njerëzore të cinguara në qoftë se nuk do të dimë të kujtojmë dhe të nderojmë ata që u viktimizuan në emër të lirisë dhe demokracisë, në qoftë se nuk do të dimë dhe nuk do të duam të respektojmë vetveten, duke respektuar njerëzit të cilët sot kanë mbetur pa varr në emër të disa parimeve shumë të shenjta universale që çdo

qenieje njerëzore në këtë botë ia ka dhënë Zoti që ditën kur ka lindur.

Njëri prej parafolësve në këtë seancë iu referua brezit të ri, pikërisht atyre që kanë lindur në vitin 1991 (emrin nuk po ia përmend, sepse së bashku me shokët e shoqet la sallën vetëm pak minuta pasi kishte hyrë në të). Për fatin tonë të mirë, e ardhmja e demokracisë, e ardhmja e Shqipërisë është në dorën e tyre, pra të këtij brezi që sot janë 19-20 vjeç dhe jo më në dorë të atyre mëkatarëve që sot tentojnë të japin leksione demokracie me veprime krejtësisht antidemokratike. Është e shkuara ajo që ne duhet t’u qartësojmë atyre.

Shumë prej tyre dinë me saktësi krimet e nazizmit, njohin kriminelët, që nga më i rëndësishmi e deri te komandanti i Mathauzenit, Aushvicit, Treblinkës etj. Dinë dhe dënojnë krimet e kryera ndaj hebrenjve, holokaustin. Meditojnë seriozisht në përshtypje ditën e përkujtimit të *shoah*-ut. Por më ka bërë përshtypje fakti që asnjëri prej tyre nuk e di emrin e komandantit të burgut të Spaçit, të burgut të Burrelit, të Qafë Barit, të Ballshit, ku u flijuan dhe u fikën padrejtësisht jetët e mijëra shqiptarëve, jo nga duart e kriminelëve nazistë e fashistë, por nga duart e kriminelëve shqiptarë komunistë, një pjesë e të cilëve ende sot vazhdon me forcë të kërkojë të ketë ndikim në këtë sistem që ne po e quajmë demokraci.

Besoj që ky është kontributi kryesor që jep ligji. Besoj se ky mënyrë të strukturuar dhe seriozisht Qeveria dhe Parlamenti po u krijon mundësinë arsimtarëve dhe të gjithë sistemit arsimor në Shqipëri të japin informacionin e nevojshëm për këtë brez, që ata të dinë dhe të jenë të ndërgjegjshëm se nga vijnë, pavarësisht se është një periudhë që nuk e kanë jetuar, që të jenë më të qartë se ku duhet të shkojnë dhe të mos humbasin rrugën nga demagogët, të cilët në fakt janë përfaqësues të së shkuarës dhe aspak të së ardhmes.

Për sa i përket anës teknike, në aspektin ligjor projektligji është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionin që ka lidhje me fushën. Në aspektin procedural ky projektligj është në përputhje me Rregulloren e Kuvendit. Komisioni i Ligjeve ka bërë disa ndryshime aspak thelbësore në terminologjinë e tij.

Së fundi, ju bëj thirrje që ta votojmë unanimisht. Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Strazimiri!
Ka diskutime?

Zonja Paulina Hoti, urdhëroni!

Paulina Hoti – Falemnderit, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë,

Nuk mund të mos e përshëndes këtë iniciativë të Qeverisë, pasi me të maxhoranca shpall sot disa simbole, të cilat shërbejnë për një përkujtim publik të viktimave, krimeve dhe pasojave që ka sjellë regjimi komunist në Shqipëri, simbole të cilat shërbejnë dhe ndihmojnë për të shkruar historinë e dhimbshme të një gjysmë shekulli të vendit tonë. Që të gjithë jemi të vetëdijshëm se ky është një shërbim që i bëhet mbarë kombit dhe jo vetëm atyre që e pësuan në mënyrën më çnjerëzore nga regjimi komunist.

Që sot 20 shkurti do të marrë një kuptim historik, do të jetë data që do të përmbledhë në vetvete të gjitha kryengritjet dhe lëvizjet kundër vendosjes së komunizmit në Shqipëri, duke filluar me ato të Kelmendit dhe Postribës, menjëherë pas çlirimit të vendit dhe deri te qëndresa e fundit e armatosur kundër komunizmit, ajo e Bushneshit, më 5 maj 1952.

Kjo është një datë e cila përmbledh në vetvete të gjitha revoltat e të dënuarve politikë, si atë të 21 majit 1973 në burgun e Spaçit, ashtu dhe atë të 20 majit 1984 në burgun e Qafë Barit. Është datë që do të përkujtojë çdo rrahje, torturë, izolim, internim, masakrim e burgim, dënim me vdekje e pushkatim, si dhe çdo formë tjetër të cenimit të të drejtave të njeriut.

Para së gjithash, ajo është datë kundër kultit të harresës, por është edhe datë kur secili prej nesh (sipas zonave), do të kujtojë me nderim e respekt në mënyrë të veçantë ata familjarë të pushkatuar, të dënuar e të internuar të zgjedhësve tanë, por dhe të gjithë ata zgjedhës të përndjekur ose pasardhës të tyre, të cilët na kanë mbështetur, inkurajuar dhe na kanë besuar me votën e tyre. Unë si pasardhëse e kësaj shtrese, si bashkëqytetare e një zone ndër më të persekutuarat në të gjithë vendin, Kurbinit, përfitoj të kujtoj këtu shumë të pushkatuar, të dënuar e të internuar të kësaj zone.

Më lejoni të përmend ato fise që kanë humbur më shumë jetë gjatë komunizmit: Miraj, Përvukaj, Piroli, Ndoja, Përvizi, Rika, Tota, Uci, Lalaj, Matusha, si dhe fise e dyer të tjera që qenë dhe mbetën të ndershëm edhe duke humbur jetën ose duke vuajtur dënimet më çnjerëzore. U kërkoj ndjesë të gjithë atyre që nuk po ua përmend emrin për arsye kohe, por besoj se të gjithëve do t'u vijë mirë po të përmend këtu Dom Shtjefën Kurtin, Dom Mark Dushin e Dom Zef Visin, të cilët u shërbyen me

dashuri e dinjitet njerëzve dhe vendit të tyre, duke dhënë edhe jetën për ta.

Të nderuar kolegë,

Shpallja e disa simboleve në përkujtim të viktimave dhe të krimeve të komunizmit në Shqipëri synon të përmbushë detyrimin që ka shteti për të informuar qytetarët, veçanërisht brezat që nuk e kanë përjetuar periudhën e diktaturës komuniste, për viktimat, krimet dhe pasojat që i shkaktoi vendit dhe qytetarëve shqiptarë regjimi komunist.

Muzeu Kombëtar, obelisku dhe monumentet e tjera përkujtimore do të mund t'u dëshmojnë brezave që vijnë një pjesë tjetër të hidhur të historisë së kombit tonë.

Dua të falënderoj këtu Qeverinë dhe në mënyrë të veçantë Kryeministrin, i cili me këtë iniciativë dhe më të tjera që e pasojnë, dëshmon vëmendjen dhe seriozitetin që i ka kushtuar kësaj çështjeje, premtimeve të tij dhe shërbimit konkret ndaj së vërtetës historike të këtij vendi.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zonja Hoti!

Ka pyetje? Nuk ka.

Në emër të grupeve:

Grupi Parlamentar i LSI-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Grupi Parlamentar i PD-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Kalojmë në projektligjin "Për krijimin e Institutit të Studimeve të Krimeve dhe të Pasojave të Komunizmit në Shqipëri".

Në emër të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, si komision përgjegjës, zonja Arenca Trashani, urdhëroni!

Arenca Trashani – E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Ky është një projektligj që vjen si një iniciativë e Këshillit të Ministrave, por në të njëjtën kohë është edhe një detyrim ligjor që ky shtet ka ndaj gjithë kësaj shtrese të vlarësh, të persekutuarish, të internuarish, të burgosurish në 50 vjetët më makabër të historisë së Shqipërisë. Ne sot, 20 vjet pas rënies së Murit të Berlinit, pranojmë të flasim, të diskutojmë, madje dhe të ngremë një institut të mirëfilltë, i cili do të hedhë dritë mbi vuajtjet e jashtëzakonshme, marrjen e jetëve të mijëra e mijëra qytetarëve shqiptarë, vetëm se kishin mendime proeuropiane, mbi krimet më makabre, burgimet dhe

internimet e qindra mijëra të tjerëve nga sistemet famëkeq komunist 50-vjeçar në Shqipëri, ky regjim, i cili është cilësuar si më i egri në Europën Lindore komuniste, madje shihet si një regjim, që konkurroi denjësisht (në thonjëza) edhe matanë kufijve europianë për nga egërsia e tij.

Zonja Kryetare, do të më lejoni që në fillim të falënderoj Këshillin e Ministrave për këtë iniciativë, në radhë të parë, shumë njerëzore, por edhe të domosdoshme, për të ndërmarrë më në fund një punë për të sistemuar dhe dokumentuar atë sistem makabër komunist, pasojat e të cilit akoma edhe sot i vuan shoqëria shqiptare. Ky projektligj vjen si një detyrim ligjor i shtetit dhe i Qeverisë për të ruajtur në memorie dhe për të analizuar veprimtarinë e atij sistemi.

Së dyti, si relatores e këtij projektligji do të doja t'i falënderoja të gjithë deputetët e maxhorancës, anëtarë të komisionit të ligjeve, të cilët punuan me një përkushtim dhe seriozitet të madh me këtë projektligj, duke i bërë rregullimet dhe sugjerimet par ta sjellë atë në formën më të mirë të mundshme. Përveçse një detyrim moral e ligjor, ngritja e një instituti të tillë ka gjetur mbështetjen e tij të plotë edhe nga rezolutat e Këshillit të Europës, si dhe nga rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë e vitit 2006.

Duke u nisur nga nevoja për të dokumentuar numrin e madh të viktimave dhe pasojat e rënda të diktaturës komuniste që kanë përjetuar qytetarët shqiptarë, shpirtin e rezistencës kundër totalitarizmit të atij sistemi, detyrimin e shtetit për të lejuar akses publik maksimal për veprimtaritë sekrete të organeve të diktaturës, si dhe për të shkruar në një linjë me procedimin e fondit të dëmshpërblimit të ish të përndjekurve politikë, do të thosha se e gjej absolutisht me vend diskutimin dhe miratimin e këtij projektligji në seancë plenare.

Misioni i këtij projektligji është ngritja e një instituti publik, buxhetor dhe të pavarur, organet drejtuese të të cilit do të jenë bordi dhe drejtori ekzekutiv. Anëtarët e bordit do të emërohen nga Kuvendi i Shqipërisë, ndërsa përzgjedhja e tyre do të bëhet nga Instituti i të Përndjekurve Politikë, Konferenca e Rektorëve, si dhe nga Shoqëria Civile. Detyrat kryesore të këtij instituti janë të karakterit kërkimor, akademik dhe edukativ. Instituti do të ndihmojë shoqërinë shqiptare për ruajtjen në kujtesë të njëjës prej të këqijave më të mëdha që i ka ndodhur këtij kombi prej diktaturës komuniste. Ai do të krijojë gjithë bazën arkivore, studimore dhe materialet e tij do të shërbejnë si referencë për

Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës në përgatitjen e programeve mësimore për brezat, në mënyrë që ata të njohin historinë e atyre viteve.

Instituti do t'i raportojë Kuvendit të Shqipërisë në lidhje me veprimtarinë dhe aktivitetin e tij, gjithashtu, edhe të Këshillit të Ministrave. Asnjë anëtar i bordit nuk do të jetë anëtar i ndonjë force politike. Kjo është shumë e rëndësishme, sepse heq jo vetëm çdo dyshim që mund të ketë qoftë për vendimmarrjen e këtij instituti, qoftë për veprimtarinë e tij, por e bën këtë institut mjaft të rëndësishëm edhe për një çështje tjetër, çështjen e të shkruarit të historisë.

Do të jetë një mënyrë e re për të shkruar të dhënat e historisë për këtë periudhë të zezë të Shqipërisë. Një element shumë i rëndësishëm është mbledhja e të dhënave, e të gjithë dokumentacionit në një dorë dhe ajo që është shumë e rëndësishme, bëra publike e këtyre të dhënave, por, gjithmonë, ashtu siç është thënë dhe në projektligj, duke mbrojtur të dhënat personale, duke respektuar ato parime që kanë të bëjnë me parimin e mbrojtjes së të dhënave.

Ky është misioni i madh i këtij instituti: shkruarja e historisë ashtu siç ka qenë, ashtu siç tregohet e bazuar në fakte konkrete jo për t'u hakmarrë e as për të kërkuar shpagim. Thjesht për t'u treguar brezave të sotëm dhe atyre të ardhshëm për të gjithë ata burra, gra, të rinj e të reja që u flijuan, sepse nuk iu bindën diktatorit, por besuan deri në flimj në mrekullinë e lirisë, në lirinë e fjalës, në demokraci dhe në shtetin ligjor. Ka pasur shumë nga ata, të cilët kanë thënë se ç'na duhet një ligj i tillë pas 20 vjetësh. Është kapitulli i mbyllur.

Është e vërtetë, kanë kaluar 20 vjet dhe akoma bijtë e denjë të "nënës Parti" nuk e duan një gjë të tillë, pavarësisht se sot na japin leksione demokracie dhe integrimi, madje dhe na mësojnë si të sillemi me perëndimorët, kur, për vete, sot, përpara një ore, humbën shansin për t'u treguar shqiptarëve se dinë të sillen si politikanë të Europës së shekullit të 21-të.

Një gjë është e qartë: pa kujtuar, studiuar dhe komentuar atë çka ka kaluar ky popull në 50 vjet, është e pamundur të ecësh përpara. Nuk them ecje përpara me kokën prapa, por ecje përpara duke njohur e duke mësuar nga e kaluara për të mos rënë në gabime të tilla si ajo e sjelljes diktatoriale apo në shkelje dhe në kundërvënien ndaj institucioneve të këtij shteti. Është makabre që sot, pas 20 vjetësh, akoma shumë prej këtyre martirëve nuk u dihet as varri dhe as vuajtjet e tyre dhe të qindra mijërave që

i mbijetuan diktaturës. Por është akoma më makabre kur dëgjon komente të tipit “kohë e shkuar”, “kapitull i mbyllur”, madje edhe nga njerëz të veshur me pushtet.

Ka ardhur momenti që më në fund ne ta shkruajmë këtë periudhë të zezë të historisë sonë me fakte konkrete dhe me dokumente, pavarësisht dëshirës së ndokujt për ta kaluar në heshtje dhe madje duke u përpjekur të na tregojë se s’ka qenë edhe aq keq. Historia shqiptare është e tëra histori përpjekjesh dhe luftërash, por më e vështira, pa dyshim, ngelet kjo periudhë. Ngelet kjo periudhë, sepse akoma kemi njerëz të lidhur pazgjidhshmërisht me atë kohë, pavarësisht se nuk mbajnë më kostumet e stofit të Beratit, por i kanë zëvendësuar me kostume firmato perëndimore. Brenda vetes mbajnë të njëjtin mentalitet punist që s’ka lidhje fare me Shqipërinë anëtare të NATO-s dhe që hedh hapa të sigurt drejt integritetit evropian.

Nga pikëpamja e teknikës legjislative, do të thosha se në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionin tjetër që ka lidhje me këtë fushë. Në aspektin procedural, ai është në përputhje me Rregulloren e Kuvendit, ndërsa gjatë shqyrtimit nen për nen, Komisioni i Ligjeve, në mirëkuptim të plotë me përfaqësuesin e Këshillit të Ministrave dhe në konsultim me Ministrinë e Financave, ka bërë edhe vërejtje dhe riformulime, e thashë edhe njëherë më përpara, në mënyrë shumë serioze dhe me përkushtimin më të madh, për të sjellë në sallën e Kuvendit projektligjin më të mirë të mundshëm.

Ju ftoj që ta votoni atë.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zonja Trashani!
Zoti Ministër, urdhëroni!

Myqerem Tafaj – E nderuar zonja Kryetare,
Zonja dhe zotërinj deputetë,

Ligji që po diskutojmë dhe miratojmë sot “Për krijimin e Institutit të Studimeve të Krimeve e Pasojava të Komunizmit në Shqipëri” është vërtet disi i vonuar. Në dekadën e fundit shumë vende ish-komuniste kanë ndërmarrë hapa seriozë për krijimin e institucioneve të tilla, për të ndriçuar historinë e gjysmë shekullit të fundit. Në Shqipëri neve na mungonte një institut i tillë.

Duke parë modelet e vendeve të tjera, më kujtohet historia e krijimit të një instituti të ngjashëm dhe Muzeut të Krimeve të Komunizmit në Çeki dhe ishte pikërisht i biri i një disidenti që kishte shkuar

përpara 3-4 dekadash në SHBA, që kthehet në Pragë dhe sheh që askush nuk fliste më për krimet e shkaktuara nga komunizmi në atë vend. Dhe ku? Në Çeki, ku komunizmi i atij vendi ishte i pakrahasueshëm me atë në vendin tonë. Ai, në asnjë rast, nuk mund të krahasohej me komunizmin, me përmasat e totalitarizmit dhe diktaturës komuniste në Shqipëri.

Duke parë modelet e vendeve të tjera, në mënyrë të veçantë të Rumanisë, pa shkuar te Polonia apo Birtler-Autoriteti (Behörde) në Gjermani, instituti që krijohet, në bazë të këtij ligji, është një institut i mirëfilltë kërkimor, me qëllim të mirëfilltë akademik.

Unë dëshiroj të theksoj rëndësinë që paraqet ky institut, në mënyrë të veçantë për brezin e ri. Brezi i ri, nxënësit dhe studentët nuk e njohin sot atë që vuajtën shqiptarët për 50 vjet; atë diktaturë të egër që provoi ky vend. Shpesh, në tekste dhe programe ngurohet të ndriçohet kjo histori dhe ky është fakt. Krijimi i këtij instituti me dy njësi kryesore të tij: njësia e mirëfilltë kërkimore dhe njësia tjetër e arkivit dhe botimeve është shans dhe një rast mjaft i mirë për të gjithë studiuesit shqiptarë, të cilët deri më sot e kishin shumë të vështirë të sillnin veprat e tyre në dritë. Shumë studiues janë përpjekur të ndriçojnë historinë, kanë botuar, por kanë qenë përgjithësisht iniciativa individuale. Me krijimin e këtij instituti, Qeveria krijon mundësi të plotë për të gjithë studiuesit që kanë vepra ende të pabotuara, të mbështeten për t’i botuar.

Instituti drejtohet nga një bord, që nga përbërja e tij jep mesazhin e plotë të pavarësisë së tij. Ky është institucion publik, që nuk ka të bëjë fare me ekzekutivin. Përbërja e bordit, me përfaqësues të të përndjekurve politikë, të botës akademike, si edhe Këshilli Shkencor që thirret nga ky bord i përbërë vetëm nga studiues, vetëm nga akademikë, vetëm nga vuajtës të drejtpërdrejtë të pasojave të diktaturës dhe nga përfaqësues të shoqërisë civile, krijon hapësirën e plotë që ky institut, në pavarësi të plotë dhe në zbatim të lirisë së mirëfilltë të kërkimit dhe lirisë akademike, të sjellë përpara shqiptarëve vepra ku ndriçohet historia e vërtetë e Shqipërisë në 50 vjetët e diktaturës komuniste. Kjo është shumë e rëndësishme, mbi të gjitha, për shkollat, për nxënësit dhe studentët.

Ne nuk mund të pretendojmë të jemi të sigurt në ndërtimin e demokracisë dhe të një shteti modern, pa njohur mirë të kaluarën tonë dhe pa njohur krimet dhe pasojat që shkaktoi diktatura

komuniste. Këto krime dhe pasoja nuk mund të mbulohen më.

Deputetët e opozitës, që fatkeqësisht e braktisën sallën, do të kishin bërë mirë që të qëndronin edhe në shqyrtimin e këtij ligji, të dënonin krimet e komunizmit, por edhe ta kritikonin ligjin. Unë e përshtes këto iniciativë dhe ju ftoj ta miratojmë këtë ligj.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Ministër!
Zoti Bumçi, urdhëroni!

Aldo Bumçi – Falemnderit, zonja Kryetare!

Sot Kuvendi i Shqipërisë po miraton dy projektligje shumë të rëndësishme mbi identitetin tonë kombëtar. Komunizmi ka përshkuar gjysmën e jetës së shtetit shqiptar. Komunizmi në Shqipëri nuk erdhi nga Ushtria e Kuqe, por u ndërta nga një pjesë e shqiptarëve dhe ne duhet të studiojmë këtë histori, sesi një pjesë e jona, ashtu si një pjesë e kombeve të tjera të Europës ndërtuan sistemin më monstruoz. Është në nderin tonë t'i kalojmë sot këto dy projektligje. Me të drejtë, shumë mund të thonë se jemi të vonuar. Por nuk jemi dhe aq të vonuar. Të përndjekurit politikë kanë qenë dhe janë monumente të gjalla mes nesh.

Nevoja për monumente dhe simbole vjen kur koha bën të vetën dhe ai brez që vuajti nuk është më mes nesh. Prandaj, ne nuk jemi vonë. Të përndjekurit janë mes nesh. Këto simbole dhe këto institute ngrihen për brezat e ardhshëm, për ata që sot nuk kanë kujtesën e tyre nga vuajtjet e komunizmit, se janë fëmijë, për ata që do të lindin nesër. Trashëgimia e vuajtjes dhe qëndresës njerëzore në diktaturë është e vetmja trashëgimi e vlefshme nga ai regjim monstruoz që ne duhet t'ua lëmë brezave.

Me Institutin e Krimeve të Komunizmit, me Institutin e Kujtesës Kombëtare ne e kryejmë plotësisht detyrimin tonë. Ky institut ka një mision shumë të madh dhe personalitetet që do të punojnë në këtë institut do të zgjidhen të tillë, që do të kryejnë më së miri misionin që do t'u ngarkohet.

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Bumçi!
Zonja Vokshi, urdhëroni!

Albana Vokshi – Falemnderit, zonja Kryetare!
Të nderuar kolegë deputetë,

Para se të ndalesha në propozimet konkrete që ka bërë Komisioni i Ekonomisë për këtë projektligj, në radhë të parë, do të doja të falënderoja Këshillin e Ministrave dhe të gjitha ato institucione të përfshira në këtë iniciativë për krijimin e këtij institucioni kaq

të rëndësishëm për shoqërinë dhe vendin. Do të doja të ndalesha edhe në rëndësinë e këtij projektligji, duke e parë atë nga disa këndvështrime:

Së pari, edhe unë, duke u bashkuar me mendimin e ministrit Tafaj, mendoj se është një akt i vonuar, duke pasur parasysh që institucione të tjera të ngjashme në vendet ish-komuniste si në Çeki, Hungari, janë krijuar që nga viti 1995 dhe, së fundi, në Rumani në vitin 2005. Mendoj se është detyrë e të gjitha forcave politike të një vendi, që të vënë në vend drejtësinë dhe dinjitetin e qytetarëve, aq më tepër që deri tani asnjë qeveri nuk ka mundur të dëmshpërblejë plotësisht mundin dhe sakrificat e të gjithë atyre që janë vrarë, persekutuar dhe torturuar nga regjimi komunist.

Pa dashur të ndalem në arsyet e kësaj vonese, ky akt tashmë vjen me motivin e lartë për të vënë në vend respektin dhe dinjitetin e viktimave të komunizmit, si dhe për të rritur ndërgjegjësimin e të gjithë shoqërisë shqiptare, dhe jo vetëm të saj, ndaj krimeve të tmerrshme të totalitarizmit komunist.

Objektivi kryesor i institutit do të jetë të ngrejë vëllon që kishte mbuluar krimet e komunizmit dhe abuzimet e sistemit, po ashtu të informojë publikun mbi krimet dhe abuzimet e ndërmarra në emër të "luftës së klasave" nga njerëzit në pushtet brenda sistemit komunist, duke marrë kështu vlera edukative të mëdha për brezat e rinj dhe për ata që do të vijnë më pas. Pa njohur të kaluarën nuk mund të ndërtohet e tashmja dhe e ardhmja.

Instituti do të studiojë në substancë regjimin totalitar gjatë periudhës së komunizmit nëpërmjet dëshmive, si dhe me ndihmën e burimeve historike. Ai do të ekzaminojë fenomenin që shoqëroi regjimet totalitare, do të ndërtojë një "mozaik" nga kujtimet e çdo dëshmitari, duke krijuar atë që mund të quajmë "kujtesë kombëtare".

Së dyti, duke iu referuar Konventës Universale të të Drejtave të Njeriut, si dhe duke përmendur disa prej neneve të saj, do të doja të kujtoja se pothuajse të gjitha nenet e kësaj konvente universale janë cenuar gjatë periudhës së komunizmit.

Duke iu referuar nenit 3 dhe nenit 5, në Shqipëri janë cenuar këto nene, pasi gjatë periudhës së komunizmit, sipas të dhënave nga Ministria e Brendshme, janë gjykuar për "krime" si bashkëpunëtorë të pushtuesit, tradhtit ndaj atdheut nëpërmjet arratisjes, agjitacionit dhe propagandës, përmbysjes me dhunë të pushtetit dhe spiunazhit, rreth 25 mijë persona.

Duke cenuar nenin 9 dhe nenin 10, nga gjykatat

janë ekzekutuar me vendim të formës së prerë rreth 1 mijë persona.

Duke cenuar nenin 4 dhe nenin 5, kanë vdekur në burg, janë vrarë në kufi, janë vrarë në përpjekje me forcat komuniste rreth 4 mijë e 500 persona.

Duke cenuar nenin 1 dhe nenin 2, të gjithë shqiptarët, përveçse funksionarëve të lartë të partisë në pushtet, nuk kanë pasur të drejtën që të gëzojnë këto liri e të drejta.

Duke cenuar nenin 17, u bë nacionalizimi dhe vjedhja e pronës.

Duke cenuar nenin 18, u shkatërruan kishat, xhamitë dhe të gjitha objektet e tjera fetare, si dhe u persekutuan të gjithë ata persona që guxonin të besonin në diçka tjetër, përveç partisë dhe diktatorit.

Duke cenuar nenin 19 dhe 20, u bë ndalimi i lirisë së fjalës, udhëtimeve, grumbullimeve, u vendos diktatura e një partie të vetme, u ndalua e drejta pasive e votës, u ndaluan aktivitetet e tjera politike.

Po ashtu, duke e parë nga një këndvështrim tjetër, iniciativa për krijimin e këtij instituti shkon në një linjë me iniciativat e fundme europiane në lidhje me këtë çështje.

Vitet e fundit dhe sidomos me Presidencën çeke është iniciuar një nismë për “ndërgjegjësimin” e Europës ndaj krimeve të kryera nga sistemet totalitare. Kështu janë organizuar një sërë konferencash dhe *public hiring* në Parlamentin European.

Europa e shekullit të 20-të ka shënuar disa prej ngjarjeve më të rënda të njerëzimit, por në kushtet kur për krimet e nazizmit është folur dhe vazhdohet të flitet gjatë, për krimet e bëra gjatë periudhave totalitare, kur demokracia e Luftës së Dytë Botërore u ndoq nga gjysmë shekulli skllavëri, për gjysmën e Europës Lindore flitet jo shpesh dhe kjo pjesë e historisë nuk njihet aq shumë nga vendet e Europës Perëndimore dhe më gjerë.

Në poemën e Kavafisit “Zoti abandonon Antonin”, një prej vargjeve thotë: “Don’t say it was a dream” (*Mos më thuaj që ishte një ëndërr.*)

Ngjarjet e fillimit të viteve ‘90, që sollën dhe rrëzimin e sistemit socialist, nuk ishin një ëndërr, por një realitet i mrekullueshëm dhe kjo nuk ishte ndalesa finale.

Disa europarlamentarë nga Hungaria, Çekia, Rumania, Estonia etj. kanë sugjeruar që paralelisht me zgjerimin ekonomik dhe politik, Europa duhet të zgjerojë edhe ndërgjegjësimin për krimet e tmerrshme të bëra nga regjimet totalitare të shekullit të 20-të. Ata thonë se për të “kompletuar” shtëpinë

europiane të përbashkët duhet të krijohet një perceptim i balancuar dhe i integruar i historisë sonë. Kjo do të përbënte një garanci që këto krime të mos përsëriten më kurrë. Ata madje sugjerojnë që vetë e majta e ish -vendeve komuniste duhet të bëjë një skanim të detajuar të së kaluarës, përndryshe ajo do t’i lejonte vetes të jetonte në një të kaluar false, që lë jashtë të gjitha aktet e dhimbshme të njerëzimit.

Në fjalimin e tij, mbajtur në mars të vitit 2009, zoti Vidal Quadras, Zëvendësprezidenti i Parlamentit European, theksoi: “Por, pavarësisht thënies së Francis Fukuyama, kjo do të shënonte fundin e historisë e nuk do të mbeteshin konkurrues ideologjikë seriozë për demokracinë liberale. Rrëzimi i komunizmit nuk ishte fundi i historisë, por vetëm një “*coffee break*” në luftën për liri dhe demokraci”. Më tej ai vazhdon: “Ne jemi krenarë për projektin e integritimit european dhe me fisnikërinë e asaj që ndodhi dy dekada më parë, që ndryshoi Europën, ne themi: gjithnjë armiq të e shoqërisë së hapur do të na gjejnë ne, qytetarët e Europës së bashku, nga veriu në jug, nga lindja në perëndim dhe askush e asgjë nuk do të mund të na ndajë”.

Me këtë rast do të doja të përmendja dhe një paragraf të rezolutës së 18 marsit të vitit 2009 të Parlamentit European, ku thuhet:

“Ne përfaqësuesit e institucioneve të Bashkimit European, vendeve anëtare të Bashkimit European, si dhe organizatave joqeveritare jemi të bindur se e kaluara totalitare e shumë vendeve europiane përbën një pjesë integrale të historisë së përbashkët. Përkujtimi i kësaj periudhe të historisë është një mjet i rëndësishëm edukativ për promovimin e dinjitetit dhe të drejtave humane, lirive themelore dhe vlerave të tjera, mbi të cilat bazohet Europa”. Më tej kjo rezolutë kërkon krijimin e një platforme të ndërgjegjësimit, rritjen e instrumenteve financiare, si dhe caktimin e datës 23 gusht, si ditë e përbashkët në kujtim të viktimave të nazizmit dhe komunizmit totalitar, në përkujtim të paktit Molotov – Ribentrop.

Duke pasur parasysh që e ardhmja e Shqipërisë është në familjen europiane, duke pasur parasysh se fenomeni i komunizmit dhe i krimeve të këtij sistemi i kalon kufijtë e Shqipërisë, do të propozoja që edhe ne t’i bashkohemi kësaj nisme ndërgjegjësimi europiane. Kështu, do t’ju ftoja të gjithëve që ta votojmë këtë projektligj.

Para se ta mbyllja fjalën time, do të doja të përmendja se Komisioni i Ekonomisë në mbledhjen

e radhës shqyrtoi projektligjin dhe propozoi disa ndryshime. Përveç nenit 3, për të cilin u ra dakord me Komisionin e Ligjeve që të miratohet me ndryshimet e propozuara nga Komisioni i Ekonomisë, për të gjitha nenet e tjera është rënë dakord që të miratohet së bashku me ndryshimet e Komisionit të Ligjeve.

Falemnderit!

Ardian Turku – Falemnderit, zonja Vokshi!

Fjalën e ka zoti Sherefedin Shehu.

Sherefedin Shehu – Falemnderit, zoti drejtues i seancës!

Krahas të gjithë kolegëve parafolës, unë do të theksoja se me këtë projektligj na jepet rasti që të dokumentojmë të persekutuarit, por edhe persekutorët. Njëkohësisht, do ta shfrytëzoja këtë rast për të rikonsideruar atë që ka filluar me zbutjen e dhimbjes nëpërmjet kompensimit të tyre financiar. Mendoj se procesi ka filluar, shumë kanë përfituar, por përsëri ka një proces që duhet rregulluar. Me këtë rast le t'i shikojmë gjërat në kompleks dhe të kontribuojmë në zbutjen reale të dhimbjes së kësaj shtrese shoqërore.

Unë do të propozoja që të ketë një agjenci të posaçme, e cila të zgjidhë njëherë e mirë si problemim e listave të tyre, ashtu dhe atë të kompensimit të tyre financiar.

Falemnderit!

(Ndërkohë, drejtimin e seancës e ka marrë zoti Turku.)

Ardian Turku – Falemnderit, zoti Shehu!

Kalojmë në shprehjen e mendimit të grupeve.

Grupi Parlamentar i LSI-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Grupi Parlamentar i PD-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Kalojmë të pika e fundit e rendit të ditës: interpelancë me ministrin e Shëndetësisë, kërkuar nga deputetja Lajla Përnaska, bazuar në nenin 96 të Rregullores së Kuvendit.

Fjalën e ka zonja Lajla Përnaska.

Lajla Përnaska – Falemnderit, zoti drejtues i seancës!

Të nderuar kolegë deputetë,

E gjykova të nevojshme organizimin e kësaj interpelance me ministrin e Shëndetësisë, zotin Petrit Vasili, në kuadrin e impenjimit dhe angazhimit të tij, por dhe të dikasterit që ai drejton, për reformën në shëndetësi, për t'i dhënë një dinamikë të re kësaj

reformë dhe për të zbatuar prioritetet e përmirësimit të sistemit të përkujdesjes shëndetësore, bazuar edhe në strategjinë kombëtare të organizimit të sistemit të përkujdesjes shëndetësore.

Sigurisht që reforma në shëndetësi është një nga reformat më të vështira, jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për vendet e tjera me një ekonomi në tranzicion dhe, jo vetëm kaq, por edhe për vende me një sistem shumë më të zhvilluar social-ekonomik. Kjo reformë ka prioritetet e saj, ka objektivat e saj strategjike dhe kërkon një seriozitet dhe shumë energji për t'u zbatuar me efikasitetin e duhur dhe për të arritur përmbushjen e objektivave të duhur.

Por, në mënyrë të veçantë në këtë stad të ecurisë së kësaj reforme, unë do të doja të ndalesha pak më gjatë në hapat më të fundit që Ministria e Shëndetësisë dhe drejtuesi i kësaj ministrie, zoti Vasili, ka ndërmarrë pikërisht në kuadër të përsheptimit dhe të ecurisë së reformës së sistemit shëndetësor.

Më konkretisht nga zoti ministër do të doja të dëgjonim një sqarim disi më të detajuar lidhur me një ndërhyrje që ka filluar të realizohet vetëm para pak kohësh nga ana e ministrisë për sa i përket çështjes së edukimit në vazhdim për të gjithë profesionistët e shëndetësisë, si një bazë kjo themelore e reformës në shëndetësi, për të njohur më nga afër se cilat janë sfidat dhe cila është ecuria e këtij procesi, funksionimi i të cilit përbën një nga aspektet më të rëndësishme të reformës në sistemin shëndetësor.

Gjithashtu, do të doja të theksoja se në bazë të objektivit për një kohezion më të madh social dhe solidaritet, kriteri kryesor për të gjykuar suksesin e reformës së sistemit shëndetësor mbetet një akses i efektshëm në kujdesin shëndetësor për të gjithë, pa diskriminim, si një e drejtë njerëzore themelore.

Gjithashtu, duhet qartësuar se jo vetëm Shqipëria, por të gjitha vendet e Europës Qendrore dhe Lindore kanë hasur një sfidë të madhe për arritjen e një sistemi të kujdesit shëndetësor të barabartë, të balancuar, por dhe të qëndrueshëm në kontekstin e një ekonomie në tranzicion. Krahas këtij impenjimi dhe angazhimi, që unë e gjykoj mjaft serioz, i gjithë personeli shëndetësor, në veçanti drejtuesit e institucioneve të sistemit shëndetësor, herë pas here duhet të përballen edhe me situata më specifike që lidhen me gjendje epidemie, pandemie ose endemie, qofshin këto stinore ose të llojeve të tjera. Ndër këto, e njohur mirë, jo vetëm

brenda kufijve të Shqipërisë, por në një nivel të gjerë botëror është edhe pandemia më e fundit e shkaktuar nga virusi AH1N1. Gripi AH1N1 është përcaktuar si një pandemi e shkaktuar nga virusi i influencës A. Por, që në datën 11 qershor të vitit 2009, Organizata Botërore e Shëndetësisë e klasifikoi atë si një kërcënim të nivelit të gjashtë, jo aq për gravitetin e sëmundjes së shkaktuar nga virusi, por së pari, për shtrirjen gjeografike të saj.

Fillimisht shkalla e rasteve fatale ishte më e lartë dhe në vazhdimësi, në sajë të masave të ndërmarra dhe trajtimit, ajo pësoi një ulje graduale.

Edhe rajoni ynë, përfshirë Shqipërinë, u kërcënua nga përhapja e shpejtë e këtij virusi, prandaj e gjykova të nevojshme sqarimin nga ana e ministrit Vasili për ecurinë e situatës në vendin tonë në lidhje me këtë pandemi: Sa është bërë strukturimi i përballjes të kësaj pandemie dhe sa efikase ka qenë ky strukturim? Sa ka ndikuar kjo pandemi në parametrat e shëndetit të popullatës shqiptare në lidhje me sëmundjen si edhe me vdekshmërinë në grupmosha të ndryshme apo në kategori të veçanta të popullatës sonë?

Falemnderit!

Ardian Turku – Falemnderit, zonja Përnaska!
Zoti Ministër, urdhëroni!

Petrit Vasili – Të nderuar deputetë,
I nderuar zoti drejtues i seancës,

Në mënyrë të drejtpërdrejtë po u përgjigjem dy pyetjeve të zonjës Përnaska.

Pyetja e partë ka të bëjë me reformën e edukimit të vazhduar, e cila është një nga shtyllat absolute të reformës. Sigurisht, është një reformë relativisht e munguar. Përfundimisht, sistemi shëndetësor është në rrugën e reformimit dhe përmirësimit të tij të vazhdueshëm teknologjik. Një nga pikat e tij më delikate është ruajtja e performancës profesionale të nivelit të lartë, gjë që është e pamundur në rast se kjo bëhet pa u certifikuar dhe aq më keq duke ia lënë atë spontanitetit. Deri më sot, lidhur me këtë çështje ka pasur një lloj spontaniteti, sepse në mënyrë të natyrshme disa prioritetet të tjera siç ishin infrastruktura mjekësore, por edhe elementet e tjera të teknologjisë mjekësore e kanë bërë atë që në një farë mënyre të jetë një prioritet i shprehur, por jo i realizuar në praktikë.

Në të gjithë periudhën e tre muajve të fundit të vitit 2009 është plotësuar i gjithë kuadri ligjor, kuadri rregullator dhe të gjitha elementet e tjera të infrastrukturës për startimin e këtij procesi. Nga janari i gjithë sistemi shëndetësor është futur në

sistemin e edukimit të vazhduar. Tashmë kjo çështje nuk është më një gjë fakultative, por një detyrim. Detyrimi i mjekëve për të mbledhur 150 kredite brenda 5 vjetëve të para, duke qenë kredite promovuese dhe 250 në 5 vjetshin e dytë, tashmë është një detyrim ligjor. Në këtë proces përfshihen rreth 8 mijë mjekë të të gjitha niveleve, të cilët në fund të një procesi të tillë do të përfshihen në programin e ricertifikimit të tyre.

Njëkohësisht prerogativa kryesore për ta realizuar në mënyrë sa më profesionale do të jetë regjistrimi i të gjithë profesionistëve në një regjistër elektronik kombëtar, i cili do të dokumentohet në mënyrë të vazhdueshme për gjithë pjesëmarrjen e tyre në të gjitha aktivitetet e akredituara, ku edhe akreditimi është një element shumë i rëndësishëm i edukimit të vazhduar dhe që kryhet nga Qendra Kombëtare e Edukimit të Vazhduar.

Së dyti, do të jetë akreditimi i aktiviteteve të edukimit të vazhdim, për të cilin është miratuar i gjithë kuadri rregullator duke pasur një hapësirë shumë të gjerë akreditimi për të gjitha aktivitetet që zhvillohen në sistemin publik edhe në atë privat, duke akredituar edhe konferenca apo trajnime, të cilat zhvillohen edhe jashtë vendit, duke stimuluar kështoj një pjesëmarrje intensive në to, por edhe motivim të mjekëve për t'i ndjekur e për t'i mbështetur ato.

Njëkohësisht, po ndiqet një politikë e orientimit të burimeve të nevojshme edhe financiare minimalisht të domosdoshme, për ta aktivizuar sistemin e akreditimit në mënyrë të veçantë për kategoritë prioritare siç janë mjekët e familjes të cilët përballojnë në këtë moment një ngarkesë të shtuar dhe njëkohësisht njohja intensive e të gjithë profesionistëve me kërkesat e reja të sistemit të akreditimit dhe certifikimit. Është ngritur dhe funksionon edhe Bordi Kombëtar i Certifikimit, i cili përfshin të gjithë aktorët në proces dhe jo vetëm Ministrinë e Shëndetësisë që është vetëm njëri prej aktorëve, por edhe urdhrat përkatëse, të cilat funksionojnë në Shqipëri dhe sipas plotësimit të krediteve ricertifikon të gjithë mjekët që kanë ushtruar procesin.

Një nga momentet kyçe është që ky certifikim do të përfshihet në kontratat e punës së mjekëve dhe do të jetë një kusht i panegociueshëm për vazhdimin apo jo të mbajtjes së pozicionit të tyre në rast se plotësimi i këtyre krediteve që plotësojnë në kuadër të formimit profesional të plotë nuk do të arrihet.

Ky proces është tashmë një proces pa kthim.

Mekanizmat dhe instrumentet janë të gjitha në dorë. Të gjithë drejtuesit tashmë e njohin procesin dhe po e mbështesin atë dhe në këtë mënyrë merret një përgjigje shumë e madhe, sepse procesi i akreditimit nuk parashikon vetëm përfundimin e ngushtë të dijeve mjekësore, por edhe elementet që janë të karakterit të menaxhimit mjekësor dhe elemente të tjera, të cilat bëjnë të mundur formimin e figurave profesionale gjithmonë e më komplekse, për të mundur edhe një administrim më të mirë të strukturave mjekësore të të gjitha niveleve parësore, sekondare apo terciare.

Gjithë parimet e standardet janë mbështetur sipas një projekti zviceran, i cili ka garantuar me shumë profesionalizëm një nivel mjaft të lartë të këtij procesi, duke e bërë atë plotësisht të ngjashëm me këtë proces edhe në vendet fqinje e kudo gjetkë, duke ruajtur një standard tërësisht evropian të edukimit në vazhdim.

Konsekuenca në ndjekjen e këtij procesi konsolidon në një nga shtyllat kyç të reformës dhe na bën të mundur që niveli i arritur të jetë i standardizuar dhe i unifikuar.

Kalojmë në përgjigjen e pyetjes së dytë. Problemi i pandemisë AH1N1 është një problem, i cili interesoi të gjithë rruzullin. Arsyeja e konsiderimit pandemik të saj në mënyrë të pavarur nga numrat që u afruan në praktikë u vlerësua si i tillë nga Organizata Botërore e Shëndetësisë për arsye të një gjeografie shumë të shpërndarë të përhapjes. Ne u përballëm si të gjitha vendet e tjera, e cila ka qenë mjaft profesionale.

Katër momentet kyçe, në mënyrë që publiku të jetë i qartë, për të përballuar ish-in:

Së pari, krijimi i laboratorit i cili mundësonte në kohë reale, me cilësinë e duhur dhe në mënyrë të certifikuar, ekzaminimin e të gjitha rasteve të dyshuara me AH1N1, gjë e cila nuk ishte bërë më parë dhe për të cilat ishim të detyruar që shumica e ekzaminimeve të shkonin në laboratorët e referencës në Bukuresht apo gjetkë, duke zgjatur kohën e përgjigjeve e duke humbur, në raste të caktuara, edhe lidhjen shkak-pasojë, si dhe kurimin në kohën e duhur të pacientëve.

Së dyti, ishte përgatitja e një reaminacioni polivalent të një standardi tërësisht bashkëkohor në Spitalin Infektiv të Tiranës, gjë e cila është realizuar.

Së treti, sigurimi në mënyrë të plotë i gjithë sasisë së duhur të preparatit tamiflu, ku sasia e tij ishte më se prej 30 mijë doza për të përballuar gjithë pandeminë

Së katërti, sigurimi i vaksinës së domosdoshme.

Të katërta këto etapa janë realizuar duke përdorur në të gjitha rastet burime financiare që kanë pasur të bëjnë me projektet të cilat janë dhuruar në mënyrë të veçantë nga Banka Botërore dhe nga OBSH, duke mos mobilizuar fonde publike nga financat e shtetit në asnjë rast.

Laboratori ka kushtuar rreth 700 mijë dollarë dhe është mbuluar nga gripi i mëparshëm, gripi i shpendëve. Po kështu edhe një sasi e tamiflusë si edhe reaminacioni i spitalit infektiv. Për sa i takon çështjes së vaksinës, duke bërë një vlerësim shumë të kujdesshëm të përdorimit të aksesit të saj dhe pranueshmërisë nga publiku dhe duke parë eksperiencën e mjaft vendeve të tjera europiane, të cilat u ngutën në blerjen e sasive shumë të mëdha të vaksinave, kur pati një përdorim shumë të pakët, ndonëse sasia e planifikuar në momentin e parë ishte mjaft e lartë, ne blemë një sasi shumë të vogël duke vlerësuar edhe rastet që kishim, gjithsej 457 raste deri tani dhe 12 vdekje, duke qenë vendi me vdekshmëri më të ulët në të gjithë Ballkanin, më të ulët se në Kosovë e Maqedoni.

Pra, blemë një sasi minimale vaksinash dhe kjo u bë falë fondeve të ofruara nga projekti i gripit të shpendëve, me një financim mjaft të vogël dhe njëkohësisht duke vlerësuar mënyrën e përdorimit të saj. E arritur në kohë, sasia e vaksinës është përdorur pjesërisht. Për fat të mirë, nuk kemi pasur asnjë lloj komplikacioni, sepse ju e dini që në Maqedoninë fqinje e gjetkë ka pasur komplikacione mjaft të rënda dhe praktikisht në tërë kompleksitetin e vet, pandemia mund të konsiderohet tashmë e përballuar me sukses.

Ne bëjmë pjesë në një rajon të Europës, të cilin Organizata Botërore e Shëndetësisë e vlerësoi si një rajon, ku pandemia është në kalim dhe është përballuar me sukses. Pasojat e saj mund të konsiderohet minimale. Organizata Botërore e Shëndetësisë po e trajton si të tillë dhe sistemi shëndetësor shqiptar po merret në konsideratë nga OBSH-ja si një rast i veçantë dhe po trajtohet si i tillë si një eksperiencë pozitive edhe për vendet e tjera të rajonit. Përdorimi me shumë efikasitet i fondeve dhe përballimi i pandemisë me fonde pothuajse minimale dhe me një shtrirje kapilare të informacionit shëndetësor deri në sistemin parësor, bënë të mundur detektimin e hershëm dhe trajtimin me profesionalizëm të sëmundjes.

Dua të kujtoj këtu dhe të përgëzoj edhe mjaft

mjekë dhe reaminatorë, të cilët kanë nxjerrë nga gjendja e vështirë me dhjetëra pacientë dhe me një trajtim tepër profesional kanë bërë që jeta e të sëmurëve të shpëtohet dhe vdekshmëria të jetë minimale.

Falemnderit!

(Ndërkohë, drejtimin e seancës e ka marrë zonja Topalli.)

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Ministër!
Zonja Përnaska, urdhëroni!

Lajla Përnaska - Edhe një herë doja të falënderoja zotin Ministër për sqarimet e detajuara që ai na përcolli, si dhe të përshëndes punën e bërë edhe nga dikasteri i drejtuar prej tij, lidhur me përballimin me sukses të pandemisë së virusit AH1N1, ku Shqipëria, ashtu siç u citua edhe nga ministri, edhe nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, është listuar tashmë si një nga modelet pozitive në mënyrën e organizimit dhe strukturimit të të gjithë punës për përballjen e kësaj pandemie.

Duke iu rikthyer edhe elementit tjetër të prezantuar dhe sqaruar nga ministri, çështjes kardinale të sistemit të kujdesit shëndetësor, burimeve njerëzore, do të theksoja se kjo nismë më e fundit e Ministrisë së Shëndetësisë gjykohet dhe vlerësohet edhe nga partnerët ndërkombëtarë, veçanërisht nga Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe nga Banka Botërore si një ndërhyrje tejte e domosdoshme që pritet të japë efektin e duhur në dy vjetët e ardhshme.

Kështu që në këtë kontekst edhe një herë dua të falënderoj zotin Ministër për sqarimet dhe t'i uroj punë të mbarë në impenjimin dhe përkushtimin tepër serioz në zbatim të reformës të sistemit shëndetësor.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zonja Përnaska!

Hapet votimi për prezencën.

Mbyllet votimi.

Gjithsej janë 72 deputetë të pranishëm.

Kalojmë në votimin e projektligjit “Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave”.

Hapet votimi me elektronikë, në parim.

Mbyllet votimi.

72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton në parim projektligjin.

Kalojmë në votimin nen për nen, bashkë me vërejtjet e komisionit.

Kush është dakord me nenin 1? Falemnderit!
Kundër? 1 votë kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2? Falemnderit!
Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 3? Falemnderit!
Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 4? Falemnderit!
Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

(Nga neni 5 deri në neni 10 ndiqet e njëjta procedurë e miratimit të neneve.)

Hapet votimi me elektronikë, në tërësi.

Mbyllet votimi.

72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton edhe në tërësi projektligjin “Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave”.

Kalojmë në votimin e projektligjit “Për disa shtesa në ligjin “Për Inspektimin e Ndërtimit”.

Hapet votimi në parim, me elektronikë.

Mbyllet votimi.

72 vota pro. Nuk ka kundër. Nuk ka abstenime.

Kuvendi miraton në parim projektligjin.

Kalojmë te votimi nen për nen, bashkë me vërejtjet dhe propozimet e Komisionit për Vepërimtaritë Prodhuese të nenet 1, 2, 3 dhe 4.

Neni 1. Kush është dakord? Falemnderit!
Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka. Miratohet.

Për nenin 2, zoti Ministër, urdhëroni!

Sokol Ollidashi – Te neni 2, meqenëse pati një kërkesë edhe nga Ministria e Financave, duhet të bëjmë një reformulim që ezauron edhe nevojat tona, edhe nevojat e Ministrisë së Financave. Pra, neni 2 të mbetet i tillë: “Në nenin 15, pas pikës 6, të shtohet pika 7 me këtë përmbajtje: “Gjobat sipas pikave 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të këtij neni, përbëjnë titull ekzekutiv””.

Jozefina Topalli – Falemnderit!

Kush është dakord me nenin 2? Falemnderit!
Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka. Miratohet.

Neni 3. Kush është dakord? Falemnderit!
Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka. Miratohet.

Neni 4. Kush është dakord? Falemnderit!
Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka. Miratohet.

Hapet votimi në tërësi, me elektronikë.

Mbyllet votimi.

72 vota pro. S'ka kundër. S'ka abstenime.

Kuvendi miraton në tërësi projektligjin.

Kalojmë te projektligji “Për simbolet e përkujtimit të viktimitave dhe të krimeve të komunizmit në Shqipëri”.

Hapet votimi në parim, me elektronikë.

Mbyllet votimi.

72 vota pro. Nuk ka kundër. Nuk ka abstenime.

Kuvendi miraton në parim projektligjin.

Kalojmë te votimi në parim, me propozimet e komisionit përgjegjës.

Neni 1. Kush është dakord? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka. Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka. Miratohet.

Neni 3. Kush është dakord? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka. Miratohet.

Neni 4. Kush është dakord? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka. Miratohet.

Neni 5. Kush është dakord? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka. Miratohet.

Neni 6. Kush është dakord? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka. Miratohet.

Neni 7. Kush është dakord? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka. Miratohet.

Hapet votimi në tërësi, me elektronikë.

Mbyllet votimi.

71 vota pro. Nuk ka kundër. Nuk ka abstenime.

Kuvendi miraton në tërësi projektligjin.

Kalojmë te votimi i projektligjit "Për krijimin e institutit të studimeve të krimeve dhe të pasojave të komunizmit në Shqipëri".

Hapet votimi në parim, me elektronikë.

Mbyllet votimi.

71 vota pro. Nuk ka kundër. Nuk ka abstenime.

Kuvendi miraton në parim projektligjin.

Kalojmë në votimin në parim.

Urdhëroni, zonja Trashani!

Arenca Trashani – Zonja Kryetare,

Është bërë një amendament nga Komisioni i Ligjeve për titullin e projektligjit: "Për krijimin e Institutit të Studimeve të Krimeve dhe të Pasojave të Krimeve të Komunizmit në Shqipëri".

Jozefina Topalli – Keni të drejtë.

Që të dy projektligjet janë hartuar me propozim të Kryeministrit të Shqipërisë, pastaj i ka miratuar Qeveria.

Neni 1. Kush është dakord? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka. Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka. Miratohet.

Neni 3. Kush është dakord? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka. Miratohet.

Neni 4. Kush është dakord? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka. Miratohet.

Neni 5. Kush është dakord? Falemnderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka. Miratohet.

Neni 6. Kush është dakord? Falemnderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka. Miratohet.

Neni 7. Kush është dakord? Falemnderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka. Miratohet.

Neni 8. Kush është dakord? Falemnderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka. Miratohet.

Neni 9. Kush është dakord? Falemnderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka. Miratohet.

Neni 10. Kush është dakord? Falemnderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka. Miratohet.

Neni 11? Urdhëroni, zoti Rusmali!

Ilir Rusmali – Për të eliminuar çdo lloj përplasjeje mes propozimeve të Komisionit të Ligjeve dhe atyre të Komisionit të Ekonomisë, është rënë dakord midis dy komisioneve që amendamenti i Komisionit të Ekonomisë për nenin 8 të bjerë, si edhe amendamenti i Komisionit të Ekonomisë për nenin 19. Të gjitha amendamentet e tjera mund të përputhen me njëri-tjetrin, por këta të dy duhet të bien.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Sigurisht.

Atëherë, kush është dakord me nenin 11? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka. Miratohet.

Neni 12. Kush është dakord? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka. Miratohet.

Neni 12/1. Kush është dakord? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka. Miratohet.

Neni 13. Kush është dakord? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka. Miratohet.

Neni 14. Kush është dakord? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka. Miratohet.

Neni 15. Kush është dakord? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka. Miratohet.

Neni 16. Kush është dakord? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka. Miratohet.

Neni 17. Kush është dakord? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka. Miratohet.

Neni 18. Kush është dakord? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka. Miratohet.

Neni 19. Kush është dakord? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka. Miratohet.

Neni 20. Kush është dakord? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka. Miratohet.

Hapet votimi në tërësi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

72 vota pro. Nuk ka kundër. Nuk ka abstenime.

Kuvendi miraton në tërësi projektligjin "Për krijimin e Institutit të Studimeve të Krimeve dhe të Pasojave të Krimeve të Komunizmit në Shqipëri".

Zotërinj deputetë, këto projektligje vijnë pas shumë drafteve dhe përpjekjeve të bëra nga deputetët në disa legjislatura.

Me kaq seanca mbyllet.

Ju falënderoj për bashkëpunimin!
Natën e mirë!

(*Seanca u mbyll në orën 20:30.*)

E enjte, 04.03.2010
Seanca e pasdites, ora 17:00

Drejton seancën Kryetarja e Kuvendit,
zonja Jozefina Topalli (Çoba)

Rendi i ditës:

1. *Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri në 60 minuta).*

2. *Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 25.02.2010.*

3. *Projektligji "Për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative dhe organizimin e drejtësisë administrative".*

4. *Projektligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut për sigurinë e informacionit".*

5. *Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Sllovakisë për mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar".*

6. *Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Letonisë për mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar".*

7. *Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Çekisë për shkëmbimin dhe mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar".*

8. *Projektligji "Për kornizën shqiptare të kualifikimeve".*

9. *Projektvendimi "Për shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar të projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8891, datë 02.05.2002 "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit".*

Jozefina Topalli – Zotërinj deputetë, hapim seancën.

(*Lexon rendin e ditës.*)

Përpara se të fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, i uroj zotit Isaraj mirëseardhjen në

Parlamentin e Shqipërisë!

Mbështetur në nenin 4, pika 4 të Rregullores së Kuvendit, deputetët që mungojnë në seancën kur kryhet betimi, betohen në seancën më të parë në të cilin marrin pjesë.

Zoti Isaraj është i pranishëm në seancën e sotme plenare.

Unë do të lexoj tekstin e betimit dhe pasi të përfundoj leximin e tij, ju do të thoni "Beto hem".

"Beto hem me nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën si deputet i popullit në Kuvend. Do të përfaqësoj denjësisht popullin, do t'i bindem Kushtetutës dhe ligjeve, do të mbroj lirinë dhe pavarësinë e Shqipërisë, do të respektoj dhe do të mbroj të drejtat dhe liritë e shtetasve dhe do të përpiqem me të gjitha fuqitë e mia për përparimin e Atdheut dhe mirëqenien e popullit tim."

Arben Isaraj – Beto hem!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Isaraj! Urime!

(*Duartrokitje në sallë*)

Për pikën e parë të rendit të ditës kanë depozituar emrat: Edi Paloka, Gjokë Uldedaj, Gjergji Papa, Gerti Bogdani, Nasip Naço, si dhe ministrat Genc Ruli dhe Dritan Prifti.

Fjalën e ka zoti Edi Paloka.

Edi Paloka – Falemnderit, zonja Kryetare!

Në fakt, unë prisja që sot të ishin edhe deputetët e opozitës, sepse kisha përgatitur për t'u thënë diçka edhe atyre, por sidoqoftë ne do të vazhdojmë seancën për qejfin tonë. (*Qesh*)

Pavarësisht se fjalën time e nisa me humor, unë doja të thosha se këto ditë dhe seanca e një jave më parë vërtetuan edhe një herë ato që ne kemi deklaruar prej kohësh, se Edvin Rama është i vendosur në rrugën e bojkotit, jo për qëllime parimore, të cilat gjoja ai shpall se mbron, por për interesa krejt të tjera, që ne ia kemi thënë dhe rithënë.

Unë do të falënderoja miqtë tanë ndërkombëtarë që i detyruan deputetët e Partisë Socialiste të hyjnë në Parlament. Unë do t'i falënderoja ata edhe për

deklaratën që kanë bërë jo më larg se dje, duke ia bërë të qartë Edvin Ramës se nuk mban dot peng asgjë e jo më integrimin e Shqipërisë. Ai mund të mbajë peng partinë e tij dhe, siç po tregon, ka ndërmend ta mbajë peng, por asgjë tjetër përveç partisë së tij nuk mund të mbajë peng, dhe këtë gjë ia bënë të qartë dje edhe partitë popullore europiane, se as integrimi i Shqipërisë dhe as liberalizimi i vizave nuk varen nga sjelljet e Edvin Ramës. Kjo ishte një deklaratë që mendoj se duhej bërë me kohë, sepse atij njeriu sa më shumë t'i thoshe se je duke i prishur punë Shqipërisë, aq më këmbëngulës bëhej në rrugën e tij.

Sidoqoftë, le të kthehemi në realitetin e këtyre ditëve. Një javë më parë partia e Edvin Ramës depozitoi një projektligj në Parlament, me të cilin ne jemi njohur pak a shumë më tepër nëpërmjet mediave, por që është kuptuar që kemi të bëjmë me një projektligj nëpërmjet të cilit kërkohet hapja e kutive të votimit. Çfarë do të thotë kjo? Kjo do të thotë se e gjithë demagogjia e deritanishme, e gjithë propaganda e këtij zotërie ka qenë një hiç, sepse deri më sot ata kanë deklaruar që ka qenë ligji që u jepte të drejtën atyre për të hapur kutitë dhe në bazë të këtij ligji ata kanë kërkuar me këmbëngulje që të hapen kutitë, pra të zbatohet ligji. Ndërkohë, neve na kanë sjellë një ligj për të hapur kutitë e votimit, gjë që vërteton se edhe ata kanë qenë shumë të qartë dhe shumë të bindur që gjatë gjithë kohës kanë vepruar në kundërshtim me ligjin. Pra, ky është një paradoks që ata e kanë krijuar vetë. Deri dje ata kanë kërkuar në emër të ligjit që të hapen kutitë, sot na sjellin një projektligj, dhe ai antikushetues, për ta miratuar, ku kërkohet që ne ta miratojmë këtu për të hapur kutitë. Siç e thashë dhe më sipër, ky projektligj që ata kanë sjellë është antikushetues, megjithatë ne le të zbatojmë procedurat e ta diskutojmë.

Edhe një herë dua të përsëris atë që kam thënë. Edvin Rama nuk ka asnjë synim tjetër, vetëm të ruajë karrigen e tij. Ai e di mirë se pas një viti do të humbë edhe karrigen e bashkisë dhe e di shumë mirë se duke e humbur atë do t'i humbë të gjitha pozitave që ka, edhe në partinë e tij, dhe për këtë synon vetëm një gjë: të mos hyjë as në zgjedhjet lokale, duke u justifikuar si deri më sot se Partia Demokratike po i shkelka rregullat dhe se nuk po zbatoka ligjet. Dhe duke mos hyrë në zgjedhjet lokale, prapë do t'i thotë partisë së tij se unë nuk humba, por ishte Berisha që nuk më la të hyja në zgjedhje, kështu që unë prapë do të rri në krye të

partisë. Sigurisht, ne nuk jemi shumë të shqetësuar se kush rri në krye të Partisë Socialiste, ai është problemi i tyre, le ta zgjidhin me Edvin Ramën, ne do të vazhdojmë punën tonë.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Paloka!

Përpara se t'i jap fjalën deputetit të dytë për të diskutuar për çështje jashtë rendit të ditës, dëshiroj të jap disa shpjegime në lidhje me zhvillimet e fundit dhe një përgjigje të sotme, meqenëse ka pasur një reagim nga Partia Socialiste. Do të doja që ky komunikim të bëhet kryesisht për të sqaruar shqiptarët.

Kam 15 vjet që jam në politikë, kam kaluar disa procese zgjedhore politike, disa procese zgjedhore lokale. Në të gjitha vitet jashtëzakonisht të vështira, kur kemi qenë në opozitë dhe pastaj gjatë viteve pas 2005-ës, ndoshta është rasti i parë që përballim me një situatë që është vetëm absurde, ku nuk funksionon logjika, ku nuk ekziston racionaliteti dhe ku ke përballë një sjellje, të cilën natyrisht unë e kam parë me formë të dhunës në vitet e opozitës, por të paimagjinueshme se mund të ndodhë edhe në 2010-n. E them këtë, sepse nuk kam dëgjuar kurrë ndonjëherë në ndonjë vend të botës që, kur për herë të parë ndodhin zgjedhje të lira dhe të ndershme, kur për herë të parë këto zgjedhje përcaktohen si zgjedhje që përmbushin standardet kryesore të OSBE-ODIHR-it, të turren kundër zgjedhjeve, të turren kundër institucioneve shqiptare, KQZ-së, gjykatës, komisionerëve socialistë, komisionerëve të tjerë, të turren kundër Parlamentit të dalë nga zgjedhjet e ligjshme, të turren kundër jush, të turren kundër raportit të OSBE-ODIHR-it, të turren kundër raportit të Këshillit të Europës, kundër rezolutës së Parlamentit Europian, dhe nuk po vazhdoj më tutje të them se cilat nga institucionet e tjera kanë mbetur pa i turrur dhe pa i sulmuar.

Është hera e parë që duhet të mendohet se si mund të veprohet në një situatë absurde, ku përballë ke një njeri që thotë: s'e kam maxhorancën, njoh rezultatin tuaj, por unë kam fituar zgjedhjet, që thotë se unë njoh procesin legal, por zgjedhjet kanë qenë kriminale, dhe i bie që secili prej jush, si dhe shumica e shqiptarëve që kanë marrë pjesë në mënyrë paqësore në votim të kenë kryer akte kriminale. Natyrisht, në njëfarë mënyre akuzon edhe OSBE-ODIHR-in, si dhe institucione të tjera.

Kemi qenë me ju për 6 muaj, bashkë me të gjithë shqiptarët që dëgjojnë nga tribuna të ndryshme, në qytete të ndryshme, megjithëse me

një pjesëmarrje krejt të reduktuar, ku ai akuzon Parlamentin, maxhorancën dhe u thotë që pse nuk ngrini një komision hetimor për të hetuar zgjedhjet e 28 qershorit dhe pas 6 muajsh më dorëzohen dy dokumente në zyrat e Kryesisë së Kuvendit, njëra prej të cilave është një kërkesë për ngritjen e komisionit hetimor, që thotë se ky komision të ngrihet mbi një draft.

Zotërinj, nuk është nevoja të jesh as deputet dhe as jurist, keni dëgjuar ju ndonjëherë se mund të bëhet kërkesë në Parlament për të ngritur një trupë të bazuar mbi një draft? Ndodh ndonjëherë? Dhe pastaj të thotë: jo zonjë, ec paralel, ke edhe një draft tjetër, ta ndryshosh pak atë ligjin ashtu siç më duhet mua.

Si Kryetare e Kuvendit, unë kisha mundësi, bazuar te Rregullorja dhe duke parë që të dyja draftet janë antikushtetuese, t'i refuzoja, t'i thosha: merre mbrapsht, zotëri, kërkesën për ngritjen e komisionit hetimor, por përpara kësaj, unë kam për detyrë t'u them shqiptarëve, në mënyrë të veçantë socialistëve, se ju ka gënjer të gjithëve, gjashtë muaj rresht, duke thënë se Sali Berisha dhe Parlamenti nuk pranojnë te ngrenë komision hetimor për të hetuar zgjedhjet, sepse vetëm një javë më parë, më 26 shkurt, na tha të gjithëve se nuk kishte ligj për të hetuar zgjedhjet, siç dëshiron zotëria e tij. Nuk kishte fare ligj dhe ai dorëzoi ligjin e tij, ku tregohej se si duheshin bërë ndryshime, për të bërë të mundur që të hetohen zgjedhjet sipas mënyrës që ai mendon.

Thashë që po lëvizim në fushën e absurdit. Por shqiptarët duhet ta dinë. Natyrisht, nuk është detyra e tyre të njohin shkronjë për shkronjë e presje për presje Kushtetutën, as vendimet e Gjykatës Kushtetuese, sepse edhe ne që i lexojmë, nuk jemi të gjithë njohës të doktrinës konstitucionaliste, për ta kuptuar në çdo shkronjë se çfarë thotë vendimi nr.18 dhe ai nr.20. Natyrisht, është një grup i vogël që njeh parlamentarizmin prej shumë vjetësh apo juristë shumë të mirë që e kuptojnë dhe e zbërthejnë se çfarë thotë ai vendim. Por ajo që është më e çuditshme në gjithë këtë absurd, thjesht për axhendën personale të një personi, është fakti se gjatë gjithë kësaj periudhe, ndërkohë që Sali Berisha i bënte koncesione njërin pas tjetrit, ai e bënte më ekstrem qëndrimin e tij.

Në tetor i tha Kryeministrit se do të ngremë komisionin hetimor në përputhje me vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Ky nuk ishte koncesion. Është e drejta e opozitës për të ngritur komision

hetimor, me të vetmin kusht që të jetë në përputhshmëri me vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Por pas koncesionit të parë ai i tha se pranonte me kusht që në këtë komision hetimor të kishte shumicën, ndryshe do të tërhiqte të dy anëtarët e tij. Ata, natyrisht, do ta kenë emrin e tyre, por unë do t'u them largohuni nga komisioni derisa komisioni të avancojë me punimet e tij.

Në cilin vend të botës Kryeministri thotë: "Bëji përsëri amendimet e Kodit Elektorale?" I tha bëji me rekomandimet e OSBE-ODIHR-it, sepse raporti i tyre është raporti mbi të cilin është gjykuar. Ato janë certifikuesi i këtyre zgjedhjeve dhe nuk janë as Jozefina, as PD-ja, as militantët tanë, por janë institucionet ndërkombëtare. Merri të gjitha amendamentet dhe bëji ti! Natyrisht, pas marrjes së mendimit të OSBE-ODIHR-it dhe të specialistëve, vepra siç dëshiron ti. Ky qe koncesioni i dytë.

Pastaj erdhën të huajt. Shkuan tek Edi Rama dhe Sali Berisha. Sali Berisha u tha: "Megjithëse kanë kaluar afatet e prokurorisë për të hetuar, në çdo rast, kur ka fakte dhe prova, ata të hapin procesin, të shkojnë të hapin kutitë dhe t'i rinumërojnë votat". Ai përsëri tha: "Jo".

Mbërriti Këshilli i Europës, Komiteti Presidencial dhe Sali Berisha bëri koncesionin e tretë, i tha: "Drejtoju Gjykatës Kushtetuese! Nëse ajo pranon, unë përsëri jam gati për t'iu drejtuar Komisionit të Venecias". Përgjigja ishte përsëri: "Jo, nuk pranoj unë të diskutoj dhe të interpretoj vendimin e Gjykatës Kushtetuese, se di ta lexoj vetë. Nuk e çoj unë në Komisionin e Venecias, çojeni ju po të doni, se unë nuk kam nevojë për të".

Pastaj, në takimin me Komitetin e Këshillit të Europës, si Kryetare e Kuvendit, bëra koncesionin tjetër, të katërtin: le të marrin drejtimin e të tria komisioneve parlamentare. Ne jemi maxhoranca dhe parimi i maxhorancës është themelor në funksionimin e Parlamentit, megjithatë merrini kryesitë e të tria komisioneve parlamentare. Përsëri asgjë.

Erdhi 26 shkurti dhe depozituan dy kërkesat. U bë koncesioni tjetër: është futur në axhendë votimi i kërkesave për komisionin hetimor, bazuar në draft, jo në ligj. Si Kryetare e Kuvendit duhet ta kisha kthyer mbrapsht dhe duhet t'i kisha thënë: zoti Ruçi, merreni mbrapsht! Po të kalojë ligji, atëherë mund të sillni kërkesën për të ngritur komisionin hetimor. Por nuk fola. Nuk fola as kur sollli projektligjin për ndryshimet që dëshironte të bënte, megjithëse janë kokë e këmbë antikushtetuese.

Në këtë projektligj kërkohet, së pari, që hetimi i procesit zgjedhor të zgjasë 12 muaj. Por 12 muaj janë baras me destabilitet.

Në këtë draft kërkohet, së dyti, që maxhoranca të kthehet në minorancë me ligj, për të hetuar zgjedhjet politike apo lokale. Vetëm në diktaturë mund të kërkohen gjëra të tilla.

Në draft kërkohet, së treti, që komisioni të jetë i pakushtëzuar dhe nuk lexojnë vendimet numër 18 dhe 20 të Gjykatës Kushtetuese që janë obligative, ku thuhet që "Komisionet hetimore nuk kanë kompetenca të pakufizuara."

Sot, sipas vendimit të Konferencës së Kryetarëve, ne do të votojmë datën për iniciativën e përshpejtuar për draftin që ka ardhur. Natyrisht, Komisioni i Ligjeve do të shikojë se sa ai është në përputhje me kushtetutshmërinë, është apo jo në përputhje. Në draftin që ju do të shikoni dhe që do të votohet, është vendosur që data e votimit do të jetë data 18 mars, por puna në Komisionin e Ligjeve do të fillojë menjëherë, javën tjetër. Përsëri gënjejnë kur thonë që është data 16. Jo. Deri më 16 Komisioni i Ligjeve do të përfundojë të gjitha ndryshimet. Data 11 është afati i fundit i paraqitjes së amendimeve. Komisionet fillojnë punën javën e ardhshme.

I thashë të gjitha këto, sepse po lëvizim pa fund vetëm në absurd. Kemi të gjithë vullnetin e madh për t'u dhënë atyre shansin që të dalin nga absurditeti, për t'u thënë dilni nga kutia. Ajo që ndodhi sot, mospranimi i tyre për të votuar ligjin "Për Gjykatën Administrative" është shumë i rëndë. Ky është kusht për shqiptarët, kusht për liberalizimin e vizave dhe për marrjen e opinionit pozitiv, kurse ata mungojnë.

Mendoj se është detyra jonë, e gjithsecilit prej nesh, për të thënë atë që unë e kam thënë disa muaj më parë, se nuk ka dëshirë më të madhe për të se sa të pengojë dhe të bëjë të mundur që shqiptarëve të mos u hiqen vizat. Sot karriget e tyre janë bosh. Është dëshira, vullneti dhe vendimi i tij për të mundësuar, nëse do t'ia arrinte, për të penguar heqjen e vizave.

Sot, ne duhet të kishim votuar një ligj që na kërkohet dhe na përsëritet vazhdimisht. Është kaluar në komisionet parlamentare, është dhënë okeji nga grupet parlamentare, por kemi ngecur vetëm se ata nuk duan të shtypin një buton.

Megjithatë, unë nuk mendoj se axhenda e një njeriu të vetëm mund të bëhet axhenda e gjithë kombit. Ne kemi axhendën tonë, atë që kemi vendosur në Konferencën e Kryetarëve dhe i

qëndrojmë pikë për pikë. Do të votojmë datën 18 mars. E sqaroj edhe një herë, megjithëse jam e sigurt se ata e dinë mirë se komisioni parlamentar do të fillojë punë javën e ardhshme, se Kushtetuta dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese do të respektohen deri në një, sepse shteti ligjor është themelor për një vend që tenton dhe po i afrohet gjithnjë e më shumë BE-së.

Falemnderit!

Zoti Uldedaj, urdhëroni!

Gjokë Uldedaj – E nderuar zonja Kryetare,
Të nderuar kolegë deputetë,

E kërkova fjalën për të evidentuar dhe theksuar ecurinë e stabilizuar të rritjes së eksporteve shqiptare, duke e konsideruar këtë si një tregues kryesor për zhvillimin ekonomik të vendit. Sipas të dhënave zyrtare, viti 2010 ka filluar i mbarë për eksportuesit shqiptarë. Janë 5 muaj radhas, duke filluar nga tetori i vitit 2009 dhe, së fundi, muaji shkurt i vitit 2010, që eksportet shqiptare kanë njohur një rritje të konsiderueshme dhe optimiste, krahasuar me një vit më parë. Pas rënies së njëpasnjëshme të eksporteve nga muaji janar i vitit 2009, ku sipas shifrave, rënia ishte në intervalet nga 7,7% deri në 23%, shenjë e parë të rritjes pozitive të vitit e dha muaji tetor 2009.

Siç duket, kjo rritje ishte shenja e parë që ekonomia shqiptare po fillonte të rigjallërohej dhe politikat qeverisëse kishin filluar të bëheshin efikase për stimulimin e eksporteve. Pra, këto 5 muaj eksportet shqiptare kanë qenë mjaft domethënëse dhe optimiste për ekonominë shqiptare, duke i dhënë shpresë biznesit të vendit për rritje edhe në muajt në vazhdim, ndryshe nga nëntëmujori i parë i vitit 2009, ku eksportet shqiptare në terma vjetore ranë me 9%.

Ky frenim i eksporteve nuk ka qenë krizë e Shqipërisë, por e vendeve ku ne eksportojmë. Rënia e kërkesës së brendshme në vendet fqinje dhe më gjerë, ku ne kemi marrëdhënie tregtare dhe eksportojmë më së shumti, solli për pasojë rënie e eksporteve tona drejt tyre. Siç duket, disa nga partnerët tanë si Italia, po e rimarrin veten. Në këto 5 muaj radhas, kjo ka sjellë një ecuri pozitive për eksportet dhe riekportet tona drejt tyre, gjë që evidentohet nga shifrat e INSTAT-it. Por më kryesorja është se rritja e eksporteve gjatë kësaj periudhe ka ardhur, në radhë të parë, si shkak i rimëkëmbjes dhe i zhvillimit të disa industrive vendase, të cilat kanë rritur aktivitetin e tyre.

Si rezultat, është ndër rritja e eksporteve për

disa grupe, siç janë: metalet, produktet kimike e plastike, makineri dhe pajisje këmbimi tekstile, këpucë etj. Kjo tregon se rritja e eksporteve është jo thjesht një rritje efektive, por një realitet i stabilizuar dhe premtues. Vetëm në janar të vitit 2010 eksporti i grupit të produkteve kimike dhe plastike u rrit me 17,9% , eksporti i makinerive dhe pajisjeve pjesë këmbimi u rrit me 11,5% dhe eksporti i tekstileve dhe i këpucëve u rrit me 5,6%. Muaji shkurt ka një përmirësim të ndjeshëm në të gjithë treguesit ku vetëm rieksperti është rritur me 27%.

Përmirësimet e këtij realiteti janë të lidhura edhe me efektet reformuese dhe me politikat nxitëse të Qeverisë, duke stimuluar këtë sektor nëpërmjet granteve dhe sistemeve të kreditimit të biznesit, ku midis projekteve të ndryshme është edhe ai SME-ve, prej 30 milionë eurosh.

Të nderuar deputetë,

Do të doja të theksoja dhe të sillja në vëmendjen tuaj e të publikut se një nga sektorët më të rëndësishëm dhe më potencialë për rritjen e eksportit është bujqësia dhe agroindustria, të cilat vazhdojnë të mos jenë performante kur është fjala për defekte evidente, strukturore dhe reforma fundamentale. Ky është një problem i trashëguar në vite dhe që duhet të zgjidhet me prioritet. Paqartësia me titujt e pronësisë ka ndikuar si në tregun e tokës bujqësore, ashtu edhe në zhvillimin e bujqësisë në tërësi. Në qoftë se këto probleme penguese zgjidhen me prioritet, atëherë problemi i koncentrimin të tokës në ferma të mëdha është një problem që do të vijë automatikisht dhe si rezultat sektori i bujqësisë do të zërë vendin që i takon, për të kontribuar si në rritjen e eksporteve, ashtu edhe në uljen e importeve.

E bëra këtë koment duke marrë shkas nga shqetësimet kryesore të disa banorëve të zonës së Nënshkodrës. Shifrat zyrtare të cituara më lart vërtetojnë deklarinimin se Shqipëria është ndër të paktat vende në rajon që raporton ende rritje ekonomike dhe ku fjala "krizë" realisht nuk mund të përdoret në nocionin e saj tipik, pasi efektet e krizës globale sigurisht janë ndier edhe në vendin tonë me rënien e eksporteve gjatë 9- muajit të parë të vitit 2009, por tashmë, siç po tregon realiteti, ky cikël ka kaluar.

Eksportet po rriten me hapa gjigantë, shifrat janë më kokëfortë sesa deklarinimet e opozitës, e cila kërkon të paraqesë si realitet një krizë që nuk ekziston.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Uldedaj!

Zoti Gjergji Papa, urdhëroni!

Gjergji Papa – Falemnderit, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Para disa ditësh katër deputetë të Partisë Socialiste të qarkut të Korçës u shfaqën për herë të parë në rrethin e Korçës që prej zgjedhjeve të 28 qershorit të vitit të kaluar. Të shoqëruar vetëm nga disa kryetarë komunash dhe bashkish të Partisë Socialiste, të braktisur nga banorët e zonës, ata bënë show-un e radhës, duke dashur të quajnë prezente fatkeqësitë natyrore vetëm në 5 minuta, në një dalje para kamerave, duke sharë e sulmuar me shpifje krejtësisht të pabazuara Qeverinë dhe deputetët e Partisë Demokratike të qarkut të Korçës.

Krejtësisht i painformuar për situatën dhe masat e marra, zoti Alfred Dalipi kërkoi ndihmë për banorët e zonës, ndërkohë që ishin marrë të gjitha masat edhe më parë, atëherë kur po ndodhte fatkeqësia. Por, deputetët socialistë nuk kanë sesi ta dinë këtë, pasi ata u shfaqën në ditë me diell, disa ditë më vonë, atëherë kur çdo gjë po shkonte drejt normalizimit.

Zoti Dalipi dhe deputetët e tjerë të Partisë Socialiste nuk mund të shohin nga Tirana punën që bëjnë deputetët e Partisë Demokratike, të cilët jetojnë dhe punojnë vazhdimisht në Korçë dhe janë prezentë në hallet dhe shqetësimet e banorëve të zonës, si në situata normale, ashtu edhe në situata emergjente.

Zoti Dalipi dhe deputetët e tjerë të Partisë Socialiste nuk mund të shohin as nga Tirana dhe as nga vendi ku u shfaqën para mediave, punën që bëjnë në terren, në mes të baltës, atje ku punojnë ekskavatorët, deputetët e Partisë Demokratike, ministri i Bujqësisë dhe specialistët e tij, shtabi i emergjencave të prefekturës, Drejtoria e Bujqësisë dhe Bordi i Kullimit.

Deputetët e Partisë Socialiste nuk kanë dalë në rrethin e Korçës as një minutë të vetme në më shumë se tetë muaj, por u shfaqën vetëm pas fatkeqësive natyrore sikur të kenë lutur Zotin për të sjellë përmbytje. Në fakt, fatkeqësia e vërtetë për Korçën janë këta deputetë, sepse Dalipi, Ahmetaj dhe Kodheli as e kanë idenë e rrethit të Korçës dhe problematikës që ai bart. Do të ishte më mirë që para mediave të prononcohej zoti Pandeli Majko, i cili, para se të akuzonte Qeverinë e sotme, të thoshte se çfarë bëri ai si Kryeministër dhe Qeveria socialiste për tetë vjet për të përmirësuar situatën në atë zonë.

I them zotit Dalipi se banorët e asaj zone më kanë parë dhe kanë komunikuar me mua jo vetëm

këto ditë, por për 30 vjet me radhë si specialist bujqësie në atë zonë, si studiues dhe kërkues për zgjidhjen e problemit të përmytjes së tokave torfike të fushës së Maliqit dhe më vonë si politikan dhe deputet.

Pa dashur të bëj krahasime me deputetët e Shkodrës, do t'u thosha deputetëve socialistë se deputetët e Partisë Demokratike të Shkodrës, Korçës dhe të të gjithë Shqipërisë kanë një tipar të përbashkët: ndodhen afër njerëzve në situata të fatkeqësive natyrore.

Problemi i përmytjes të tokave torfike të fushës së Maliqit është i përvitshëm, si rezultat i rënies së nivelit të tokës nga proceset natyrore të mineralizimit dhe dekompozimit të këtyre tokave. Ulja maksimale e kuotës absolute të tokës është 1,5 metra krahasuar me vitin 1978 dhe 5 metra krahasuar me vitin 1947. Për pasojë, në pjesën më të ulët, në vitet me reshje normale, krijohet një zonë ekspansioni nga uji prej rreth 1500 hektarë dhe këtë vit të jashtëzakonshëm, kur vetëm në 3 muaj në Korçë kanë rënë mbi 800 milimetra shi e borë, më shumë se mesatarja shumëvjeçare vjetore, zona e ekspansionit nga uji shkoi në rreth 3000 hektarë.

Duke qenë se jeni të painformuar për punën që po bën Qeveria demokratike dhe strukturat e saj në atë zonë, ju vë në dijeni se është akorduar një fond emergjence prej 10 milionë lekësh të reja për të forcuar argjinaturat dhe për të bërë kullimin e shpejtë të zonës. Si rezultat i punës së bërë sipërfaqja e mbuluar nga uji është ulur nga 3000 hektarë në 1700 hektarë. Gjithashtu, Qeveria për këtë vit ka akorduar një fond prej 50 milionë lekësh të reja, që do të jetë paketa e parë e investimit të madh për zgjidhjen përfundimtare të përmytjes së kësaj zone.

Dua t'u them kolegëve socialistë: mirë se erdhët në Parlament, në qoftë se do të vazhdoni të vini, sepse atë që po bëni dhe po e kërkoni sot mund ta kishit bërë që në muajin shtator dhe të mos e tradhtonit elektoratin për 6 muaj rresht. Fakti që tani po kërkoni ndryshime ligjore tregon se sa e paligjshme ka qenë kërkesa juaj për një periudhë 6-mujore.

Së fundi, dua t'u them kolegëve socialistë: mirë se erdhët jo vetëm në Parlament, por edhe pranë halleve dhe problemeve që kanë shqiptarët dhe në veçanti banorët e zonës së Korçës! Nuk zgjidhen problemet me një deklaratë me shpifje apo trillime, as me dy fjali përpara kamerave, as edhe duke ndenjur vetëm 5 minuta me banorët e zonës dhe 5 orë për turizëm në Korçë.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Papa!
Fjalën e ka zoti Ruli, 5 minuta.

Genc Ruli – Falemnderit, zonja Kryetare!
Të nderuar deputetë,

E kërkova fjalën për t'ju vënë në dijeni mbi problemet që janë shfaqur për shkak të situatës së krijuar nga reshjet e shumta dhe nga moti gjatë kësaj periudhe, si dhe për të prezantuar fenomenet shoqërore të tyre.

Sigurisht që jeni në dijeni se situatë me reshje të shumta, të paparashikueshme, mbi mesataren statistikore të prurjeve për këtë periudhë të dimrit, kemi pasur në mjaft vende të rajonit dhe të Europës, madje shoqëruar me katastrofa natyrore dhe deri me humbje jetësh njerëzore në disa nga këto vende.

Te ne situata e pazakontë me reshje të mëdha dhe të vazhdueshme, pothuajse në të gjithë territorin e vendit, bëri që niveli i ujërave në rezervuarë, në lumenj, në përrenj, në tërë infrastrukturën e kullimit, të kishte një rritje të konsiderueshme. Reshjet e rëna për periudhën janar-shkurt përbëjnë statistikiisht rreth 60-70% të mesatares vjetore të reshjeve dhe në zonën e Shkodrës janë regjistruar gjatë kësaj periudhe 1430 milimetra shi, duke konsideruar që mesatarja vjetore nuk është kurrë mbi 2000 milimetra.

Gjithashtu, temperaturat e larta dhe variacioni i temperaturave nga një javë në tjetrën, nga temperatura minimale deri në temperatura të larta prej 23 gradësh celsius, kanë favorizuar një shkrirje të menjëhershme të dëborës së rënë vetëm pak javë më parë në zonat e larta, ku në disa prej tyre trashësia e borës arriti deri në 1 metër.

Edhe sot paraqitet e njëjta situatë, me reshje të shumta dhe me temperatura të larta. Janë regjistruar, gjithashtu, rritje ekstreme të niveleve të ujit, pothuajse në të gjithë lumenjtë dhe përrenjtë malorë dhe rastet më tipike kanë qenë së fundmi lumi i Devollit dhe ai i Osumit.

Për rrjedhojë janë evidentuar probleme të shumta si përmytje të tokave bujqësore, rrëshqitje të pjesshme të digave në rezervuarë, dëmtime të shkarkuesve të emergjencës së këtyre rezervuarëve, prishje të argjinaturave lumore, gërryerje masive të tokës bujqësore në brigjet e lumenjve, si dhe është shfaqur ndjeshëm fenomeni i rrëshqitjes së tokës pranë zonave të banuara apo edhe në segmentet rrugore kombëtare.

Përmytjet

Duke filluar nga data 23 shkurt, rritja e

shkarkimeve në të gjithë pellgun e Drinit dhe në lumenjtë Kir dhe Gjadër rikthyen përmbytjet në zonën e Shkodrës, të cilat, në disa momente, përfshinë deri në 6000 hektarë tokë. Aktualisht, situata po përmirësohet, megjithëse shkarkimet, sidomos nga kaskada e Drinit, vazhdojnë të jenë ende të larta, rreth 1000-1200 metra kub në sekondë.

Nga të dhënat e ditës së sotme sipërfaqet e përmbytura në këtë rreth arrijnë në rreth 5000 hektarë. Në vazhdimësi janë marrë masa dhe po punohet për riparimin gjatë periudhës së përmbytjes të argjinaturave mbrojtëse në zonat më të rrezikuara. Argjinatura e Shalsit, në ndryshim nga përmbytja e janarit, në sajë të rehabilitimit të pjesshëm dhe të shpejtë që iu bë gjatë javëve të kaluara, ka bërë të mundur mbrojtjen e fushës së Shalsit prej rreth 1500 hektarësh, e cila po vazhdon të kullohet nga uji i përmbytjes së janarit, për të bërë të mundur vënien në shfrytëzim në sezonin e pranverës.

Hidrovorët e zonës kanë punuar dhe vazhdojnë të punojnë me kapacitet të plotë dhe në zonën e Nënshkodrës po punohet për pastrimin e kanaleve kulluese, ku është mobilizuar e gjithë baza mekanike e bordeve të kullimit Shkodër, Lezhë dhe Tiranë.

Ndërkohë, nga prurjet e mëdha të lumit Devoll mbi nivelin kritik, në afërsi të fshatit Sheqeras një segment i argjinaturës mbrojtëse pranë këtij lumi u dëmtua në një gjatësi prej rreth 20 metrash linearë. Vërshimet e ujit shkaktuan përmbytjen e rreth 3000 hektarëve tokë, një pjesë e së cilës është përmbytur në mënyrë të vazhdueshme dhe në vitet e mëparshme për arsye se është zonë depresive, ish zona e kënetës. Aktualisht, me ndërhyrjet e bëra me mekanikën e bordit të kullimit Korçë çarja e argjinaturës është bllokuar dhe niveli në tokën e përmbytur ka filluar të ulet.

Për të përmirësuar kullimin e fushës së Maliqit në Korçë do të fillojë implementimi i një projekti kompleks. Pjesë e këtij projekti është edhe investimi paraprak prej 50 milionë lekësh, i parashikuar të realizohet për thellimin e shtratit të lumit Devoll, duke filluar nga Ura e Maliqit deri në një gjatësi rreth 4 kilometra.

Përmbytje të lokalizuara ka pasur edhe përgjatë lumit Drin i Zi, në Dibër. Gjithashtu, kemi pasur përmbytje edhe në zonën depresive të Torovicës.

Erozioni

Rritja e nivelit të lumenjve dhe përrënjeve ka intensifikuar ndjeshëm gërryerjen e tokës bujqësore në zonat e pambrojtura apo ka shkaktuar dëmtime dhe në vetë sistemin mbrojtës të argjinaturave anës

lumenjve. Në agravimin e situatës ka ndikuar negativisht sidomos marrja e zhavorreve pa kriter nga shtretërit e lumenjve. Edhe shpyllëzimet masive të ndodhura përgjatë dy dekadave të fundit e kanë rritur ndjeshëm dhe e kanë bërë shqetësues fenomenin e erozionit.

Në zonën e Ashtës në Shkodër ka pasur gërryerje të tokës bujqësore përgjatë lumit Drin, duke rrezikuar njëkohësisht edhe mjaft shtëpi banimi në atë zonë. Për këtë qëllim është bërë një ndërhyrje provizore dhe nëpërmjet bordit të kullimit Shkodër do të realizohet në javët që vjen një ndërhyrje më e qëndrueshme për devijimin e ujit të lumit në mënyrë që të shpëtohet nga erozioni i mëtejshëm kjo zonë.

Në zonën e Kuçovës prurjet e mëdha të lumit Devoll kanë gërryer një pjesë të konsiderueshme të tokës bujqësore dhe po rrezikohet edhe stacioni i ujit të pijshëm të fshatit Kozarë, pranë digës së Frashikut. Për shmangien e mëtejshme të gërryerjes së tokës bujqësore do të fillojë së shpejti ndërtimi i argjinaturës mbrojtëse në këtë segment, me një vlerë prej rreth 15 milionë lekësh.

Gjithashtu, dëmtime kemi pasur edhe në Dibër, në Vlorë, në Kavajë, në Fier dhe në Elbasan.

Siguria e digave ka qenë një problem tjetër shqetësues, i ndjekur me shumë vëmendje nga ministria jonë dhe nga të gjitha strukturat tona të bordeve të kullimit. Me gjithë masat e marra në vazhdimësi për të mbajtur ujin në rezervuarë në nivele sa më të ulëta (janë urdhra që i kemi lëshuar që në muajin nëntor të vitit të kaluar), prurjet e mëdha të ujit kanë cenuar seriozisht sigurinë në digat e rezervuarëve ujëmbledhës të vaditjes.

Problemet kryesore të shfaqura edhe më parë, siç kanë qenë rrëshqitja e skarpateve, dëmtimet e veshjeve dhe të filtrimeve në trupin e digave të këtyre rezervuarëve, apo dëmtimet në sistemin e shkarkuesve dhe të ujëlëshuesve të tyre, u bënë akoma më evidente në këtë periudhë të reshjeve të mëdha. Kjo situatë është më komplekse po të mbajmë parasysh se në disa raste poshtë digave janë ndërtuar objekte banimi apo objekte të tjera ekonomike informale, që, në fazën e projektimit, nuk kanë qenë të parashikuara dhe nuk kanë qenë të vendosura aty.

Siguria e digave cenohet gjithashtu dhe nga veprimet e papërgjegjshme të individëve që banojnë rreth digave, të cilët shpesh kanë ndërhyrë në bllokimin e ujëlëshuesve, në hedhjen e mbeturinave apo kalimin me mjete mbi këto diga.

Problematik është cenimi i sigurisë së digave

të rezervuarëve të vaditjes nga ushtrimi i aktivitetit të peshkimit nga peshkatarë që shpesh dëmtojnë qëllimisht shkarkuesin e këtyre digave në mënyrë që të ruajnë nivelin e ujit në rezervuar jashtë kriterëve për të cilat ne i përdorim këta rezervuarë, në funksion të vaditjes.

Shqetësimet më të mëdha janë krijuar në digat e rezervuarëve në disa qarqe: në Berat rezervuari i Prishtës, në Gjirokastrë rezervuari i Kajcës dhe i Vinokashit, në Lezhë rezervuari Trojë e Malaj, në Dibër rezervuarët Lis, Bejn 1 dhe Bejn 2, në Korçë rezervuari i Koshnicës dhe në Tiranë rezervuari i Paskuqanit.

Fenomenet e rrëshqitjes së tokës

Reshjet e pandërprera kanë nxitur edhe fenomenet masive të rrëshqitjes së tokave këtë dimër. Krahas riaktivizimit të rrëshqitjeve të vjetra, janë shfaqur edhe rrëshqitje të reja, çka e bën edhe më shqetësuese situatën. Kjo dukuri ka filluar kryesisht në akset rrugore, me rënien e skarpateve të rrugëve, por në disa raste edhe në qendrat e banuara dhe në tokat bujqësore. Mjaft nga rrugët nacionale gjatë këtij muaji u janë nënshtruar rrëshqitjeve të shumta që nganjëherë kanë dëmtuar edhe vetë shtratin e rrugës. Faktikisht, kemi pasur rrëshqitje dhe bllokime në rrugën Burrel-Klos, Tepelenë-Gjirokastrë, Tepelenë-Memaliaj, Vlorë-Sarandë, Vlorë-Selenicë, Fier-Fratar, Berat-Skrapar, Fushë- Arrëz-Fierzë, Fushë- Arrëz-Iballë, Qafë Pllaçë, Elbasan-Gramsh, Rrëshen-Kurbnesh.

Sigurisht, gatishmëria dhe ndërhyrjet e shpejta të Drejtorisë Qendrore të Rrugëve dhe drejtorive rajonale kanë bërë që, të paktën, komunikimi të ndërpritet vetëm disa orë, ose në rastet më të këqija mund të ketë qenë problemi i një apo dy ditëve.

Rrëshqitje kemi pasur në zonat e banuara. Edhe këto janë ndjekur me shumë vëmendje, edhe për shkak të rrezikshmërisë që paraqisnin. Në Berat, në lagjen "Partizani", rrëshqitjet kanë bllokuar dhe rrezikuar rrugët, madje edhe disa shtëpi banimi. Raste të tilla kemi pasur në Skrapar, në Korçë në disa komuna: Gorë, Maliq, Udenisht, në Pogradec, në Vlorë sidomos në komunat Novoselë, Vllahinë dhe Armen, në Fier në komunat Frakull, Kurian, Cakran, Portëz, Libofshë, në Elbasan komunat: Shejzë, Labinot Mal e Shushicë, në Dibër në komunën Bazë.

Organet e pushtetit vendor kanë qenë tepër bashkëpunuese me ne në evidentimin e këtyre dëmeve, por procesi i vlerësimit të dëmeve për shkak të rrëshqitjeve ende nuk ka përfunduar.

Natyrisht që është e nevojshme dhe do të kërkohet (duke dhënë edhe fondet përkatëse) nga Shërbimi Gjeologjik që të kryejë studime dhe të nxjerrë përfundime të sakta mbi ndërhyrjet që duhet të bëjmë për të shmangur këto fenomene shqetësuese të erozionit dhe të rrëshqitjeve.

Ju falemnderit!

(Ndërkohë, drejtimin e seancës e ka marrë zoti Turku.)

Ardian Turku – Falemnderit, zoti Ruli!

Fjalën e ka zoti Prifti.

Dritan Prifti – Përshëndetje, kolegë deputetë!

Ne kemi pasur në 2 muajt e fundit dy herë përmbytje në zonën e Shkodrës dhe të Nënshkodrës. Herën e parë i ftova kolegët socialistë që të dilnin në një debat me mua, për të diskutuar në lidhje me menaxhimin e situatës. Askush nga ata nuk pati guximin të dilte në debat, por parapëlqyen monologun për të dalë dhe për të bërë akuza.

Për fat të mirë, në përmbytjen e dytë ata nuk bënë më akuza, sepse u bindën se kjo nuk ishte çështje menaxhimi, por ishte çështja e reshjeve të shumta. Për fat të keq, përsëri nuk janë në Parlament, që të bënim ndonjë debat, nëse do të ishte e nevojshme.

Unë dëshiroj të informoj Kuvendin dhe publikun në lidhje me situatën energjetike që kemi sot dhe me parashikimet për ditët e ardhshme. Sot dhe në momentin që flasim, në pellgun ujëmbledhës të Drinit vazhdon të ketë reshje. Ne vazhdojmë të kemi një ekip të tërë dhe gjithë Sekretariatit Teknik që ndjek minutë pas minute situatën në të gjithë kaskadën e Drinit dhe në të gjithë sistemin tonë energjetik dhe, në fakt, në aspektin energjetik situata është e përballeshme dhe e menaxhueshme. Rezerva jonë energjetike ka shkuar pothuajse 1,4 miliardë kilovat, pra sot liqenet e hidrocentraleve tona kanë rreth 1,4 miliardë kilovat rezervë, për shkak edhe të situatës së reshjeve të kohëve të fundit. Por, për shkak të kësaj situatë, ne kemi dhe nivele të rritura të nivelit në kaskadën e Drinit dhe nga të dhënat e orës 17:00, që unë kam marrë nga Sekretariati Teknik, nivelin e kemi 293,85 m. Në këtë situatë të vitit, niveli i lejuar është 296 m. Pra, kemi akoma rreth 2 metër ujë. Në Koman niveli në orën 5 pasdite është 171,81 m. Kemi pasur një rritje në 24 orët e fundit edhe 24 cm në Koman. Në Fierzë rritja ka qenë vetëm 6 cm. Në Vaun e Dejës e kemi 74,44 m, kur niveli maksimal është 76 m dhe kemi pasur një rritje prej 48 cm në 24 orët e fundit.

Ne, sigurisht, po qëndrojmë me një prodhim maksimal. Prodhimi i djeshëm ka qenë 24,3 milionë kilovat, kur konsumi në vend ka ulje dhe është rreth 21 milionë kilovat. Ne, në 24 orët e fundit, kemi eksportuar 9,5 milionë kw dhe sot kemi përfunduar edhe një procedurë tjetër ankandi për shitje dhe e gjithë situata e eksportit, që do të ndodhë gjatë muajit mars, është 430 milionë kilovat, pothuajse e barabartë me konsumin mujor të një muaji, siç është prilli apo maji. Pra, e gjithë Korporata Elektroenergjetike është duke e menaxhuar situatën.

Situata ka pjesën negative, të cilën zoti Ruli e sqaroi shumë mirë, që është pjesa e përmbajtjeve, rrëshqitjeve dhe problematikës që krijojnë reshjet e shumta, por në aspektin energjetik, sigurisht që ka favorët e veta, sepse vetëm rezerva e sotme energjetike është të paktën katër muaj konsum që ka vendi në muajt që vijnë. Sekretariati Teknik, i cili menaxhon dhe ka detyrë të menaxhojë në mënyrë të përhershme rregulloren e shkarkimit të përhershëm, rregulloren e shkarkimit të kuotave në kaskadën e Drinit, mbliidhet afërsisht 2 herë në ditë, në ndonjë ditë më shpesh e në ndonjë ditë më pak, për të vendosur regjimin e prodhimit të kaskadës dhe sesi duhet manovruar me të gjithë treguesit e kaskadës.

Ne kemi bërë shkarkime të disiplinuar nga tunelet e shkarkimit në të tre hidrocentralet e kaskadës së Drinit. Sigurisht që disa ditë më parë ato kanë qenë edhe më të larta, sepse prurjet maksimale të paktën në 10 ditët e fundit kanë shkuar deri në 3 mijë metër kub në sekondë, pra, shumë më të larta sesa kur në Shkodër prurjet ishin më të mëdha, shkuan deri në 2 mijë metër kub në sekondë dhe zgjatën vetëm disa ditë. Pa dashur të zgjatem, unë jap garanci se në kaskadën e Drinit, çdo gjë që ka të bëjë me menaxhimin e saj, do të jetë perfekte, korrekte dhe profesionale. Jap garanci se nuk do të kemi asnjë problem të sigurisë së digave apo të sigurisë publike nga kaskada e Drinit as në të ardhmen.

Ju falemnderit!

(Ndërkohë, drejtimin e seancës e ka marrë zonja Topalli.)

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Prifti!

Zoti Bogdani, urdhëroni!

Gerti Bogdani – Falemnderit, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Me keqardhje marr shkas për këtë diskutim nga deklarata e krerëve lokalë të PS-së, bërë dje, duke paralajmëruar rikthimin në protesta, në lidhje me

autonominë vendore. Kjo deklaratë u bë nga Shoqata për Autonominë Vendore, një grupim i krijuar rishtas nga kryetari i opozitës dhe që përfaqëson vetëm drejtues të pushtetit vendor të PS-së. Por çështja e kërkesave të vendorëve socialistë nuk duhet parë vetëm në mënyrë të njëanshme. Duhet parë edhe në një aspekt tjetër, p.sh., nga këndvështrimi i qytetarëve shqiptarë apo i biznesit shqiptar, që duhet të përmbushë detyrimet dhe duhet të paguajë taksat pranë bashkive përkatëse dhe, njëkohësisht, duhet të përfitojë shërbime nga këto bashki, nga këndvështrimi i qytetarit dhe biznesit, të cilëve drejtuesit lokalë kanë për detyrë dhe mision t'u shërbejnë.

Së pari, kjo shoqatë vendore e majtë kërkon të kthejë mbrapsht amendamentin e ligjit për sistemin e taksave vendore, të ndryshuar, duke deklaruar se nëpërmjet këtij amendamenti ndërhyhet në autonominë vendore dhe në tarifatat e kufijtë maksimalë të taksave vendore. Ndryshimet në lidhje me kufijtë maksimalë vendosen nga Parlamenti, me vullnetin e kësaj Qeverie, që bazohet në liberalizim. Ky veprim është marrë për të penguar keqpërdorimin e parave të paguara nga taksapaguesit shqiptarë, të cilat shpeshherë nuk shkojnë në destinacionet ku duhet, të cilat shpeshherë nuk shkojnë në shërbim të qytetarit, por abuzohen nga drejtuesit e bashkive lokale. Ky shqetësim i grupit të vendorëve socialistë nuk lidhet drejtpërdrejt me ndihmën dhe përmirësimin e shërbimit ndaj qytetarëve, por, përkundrazi, pengon transparencën ndaj tyre.

Së dyti, vendorët socialistë kërkojnë kompensimin e të ardhurave të munguara nga përgjysmimi arbitrar i taksës së biznesit në vitin 2005.

Duhet sqaruar se politika e kësaj Qeverie është ajo e taksave të ulëta, është ajo e stimulimit të lirisë individuale dhe ky veprim i ndërmarrë nga pushteti qendror, jo vetëm ka lehtësuar biznesin, por, mbi të gjitha, ka rritur bazën e tatimpaguesve nga rreth 40 mijë në rreth 100 mijë, duke luftuar në mënyrë shumë efikase informalitetin. Ndërkohë, nga ana tjetër, Bashkia e Tiranës këto katër vjet ka mbidfyfishuar taksat, si taksa e pastrimit, e gjelbërimit, e tabelës apo të tjera. Për më tepër, kjo bashki ka kundërshtuar fuqishëm uljen e disa prej taksave të propozuara nga Qeveria, duke marrë shembull këtu taksën për tabelën, e bërë tashmë një euro, ndërkohë që bashkia kërkon ta rëndojë më tepër biznesin. E bëmë 1 euro, duke mbajtur kështu një premtim elektoral të PD-së në zgjedhjet

e 28 qershorit.

Kryetari i Bashkisë së Tiranës dhe drejtuesit vendorë socialistë, në të mirë të gjithë qytetarëve që përfaqësojnë, duhet të bashkëpunojnë me qeverinë vendore dhe atë qendrore, kur bëhet fjalë për të lehtësuar biznesin dhe jo të pengojnë zhvillimin e tij, duke mbingarkuar me taksa apo detyrime të ndryshme, duke përfshirë këtu edhe subjekte, edhe OJF-të, të cilat, fatkeqësisht, janë në të njëjtën ngarkesë fiskale të taksave vendore, si të ishin biznese.

Së treti, vendorët socialistë kërkojnë t'u jepet fund praktikave të ashtuquajtura joeuropiane dhe klienteliste, të granteve konkurruese. Për hir të së vërtetës, kjo procedurë, një nga nismat më të reja të Qeverisë së maxhorancës së djathtë, ka treguar të jetë deri tani nga praktikat me impakt më pozitiv kur vjen puna për pushtetin lokal dhe qeverisjen vendore, gjithmonë në të mirë të qytetarit dhe të ardhmes së tij. Vetë termi "grant konkurrues" bart në vetvete praktikën e konkurrimit me projekte serioze dhe të realizimit sa më të mirë të tyre në shërbim të qytetarëve shqiptarë, duke treguar, mbi të gjitha, vlera europiane dhe aspak klienteliste.

Në bazë të statistikave, kjo praktikë ka çuar pranë qytetarëve shqiptarë në mbarë Shqipërinë jo pak, por 955 rrugë, 668 shkolla dhe 548 ujësjellës ose, në total, 12 herë më shumë investime se gjatë kohës së qeverisjes socialiste. Kryetari i Bashkisë së Tiranës dhe drejtuesit socialistë vendorë, që janë në krye të institucioneve të cilat duhet të jenë në shërbim të qytetareve dhe të komunitetit, nuk duhet të humbasin kohë me protesta, por të punojnë për të zgjidhur problemet serioze që kanë bashkitë e tyre, për më tepër, kur kërkesat mbi të cilat kërkojnë të bazojnë protestat e tyre nuk janë aspak në të mirë të qytetareve apo komuniteteve të tyre, përkundrazi i dëmtojnë ata.

Në fakt, decentralizimi dhe autonomia vendore, të cilat janë të mirëzhvilluara në rang kombëtar, duhet të implementohen edhe në kryeqytet, ku 11 njësi bashkiake funksionojnë pothuajse pa asnjë autonomi apo kompetencë, tashmë prej disa vitesh, duke pasur pengesa të jashtëzakonshme për t'u dhënë zgjidhje problemeve të qytetarëve të tyre e për të qenë në shërbim të komunitetit.

Ju falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Bogdani!
Zoti Patozi, urdhëroni!

Astrit Patozi – Falemnderit, zonja Kryetare!
E kërkoja fjalën për procedurë.

Në bazë të nenit 31 të Rregullores së Kuvendit, kërkoj që të futet në rendin e sotëm të ditës propozimi i Grupit Parlamentar të PS-së për shpërndarjen e deputetëve në komisionet e përhershme të Kuvendit dhe, gjithashtu, do të doja të futeshin në rendin e ditës sot edhe propozimet për ndryshime të Grupit Parlamentar të PD-së.

Po në këtë funksion, pra të përfaqësimit politik të Kuvendit, të futet në rendin e ditës edhe propozimi i Grupit Parlamentar të PD-së për një ndryshim në Rregulloren e Kuvendit. Është një dokument që është depozituar prej kohësh në Sekretarinë e Kuvendit, madje ai ka marrë edhe vërejtjet dhe sugjerimet e Këshillit të Rregullores, ashtu siç e kërkojnë rregullat në fuqi. Është një akt që ne mund ta kishim ndërmarrë shumë kohë më parë, por nuk e kemi bërë këtë pasi kemi pritur me durim edhe mbërritjen e deputetëve të opozitës në Parlament. Propozimi ka parasysh kryesisht ndryshimin e sistemit zgjedhor në Shqipëri, po aq sa edhe traditën dhe përvojën më të mirë të vendeve anëtare të BE-së.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Patozi!

Është e vërtetë që sot Grupi Parlamentar i PS-së ka sjellë listën e shpërndarjes së deputetëve të grupit në komisione dhe në trupat e tjera. Në të njëjtën kohë, mua më kanë depozituar, pas propozimit tuaj, edhe raportin nga Këshilli i Rregullores, i cili ka 2 pika kryesore. E para ka të bëjë me përshtatjen e Rregullores për zëvendëskryetarin e tretë të Parlamentit. Është e vërtetë që kemi një vendim, ku janë emëruar zoti Turku dhe zoti Nasip Naço, po kjo duhet të shprehet edhe në Rregullore, sepse zëvendëskryetari tjetër i takon opozitës. Po kështu, në funksion edhe të asaj që u tha, kanë ardhur propozimet për respektimin e parimit të shumicës në komisionet parlamentare. Mirëpo, për ta futur këtë në rendin e ditës duhen 3/5 e deputetëve të pranishëm, kështu që ju lutem sekretareve të thërrasin deputetët.

Hapet votimin për kuorumin.

Mbyllet votimi.

Janë 72 deputetë të pranishëm.

Votojmë kërkesën e kryetarit të Grupit të PD-së për futjen në rendin e ditës të dy kërkesave: e para, votimi i emrave të zgjedhur nga Grupi i PS-së për komisionet; e dyta, propozimi për ndryshimet në Rregullore në lidhje me zëvendëskryetarin e Parlamentit që i takon opozitës dhe parimin e shumicës.

Kush është dakord me propozimin e zotit Patozi?

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

72 pro, s'ka kundër, s'ka abstenim.

Kuvendi miraton propozimin e zotit Patozi.

Kush do të paraqesë propozimin e zotit Patozi?
Urdhëroni, zoti Gumi!

Viktor Gumi – Falemnderit, zonja Kryetare e Kuvendit!

Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetet, në mbledhjen e tij të datës 2.03.2010, shqyrtoi propozimin e bërë nga Grupi Parlamentar i PD-së “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.166, datë 16.12.2004 “Për Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Në këtë mbledhje u diskutua mbi propozimet e bëra si nevojë për amendamentet e Rregullores së Kuvendit pas ndryshimeve kushtetuese, si dhe respektimin e parimit kushtetues të shumicës parlamentare në nivelin e seancës plenare dhe të komisioneve të përhershme të Kuvendit.

Natyrisht, një iniciativë e tillë për ndryshimin e dy neneve të Rregullores së Kuvendit bart si referencë një sërë praktikash të vendeve të tjera perëndimore. Më konkretisht: nenin 33 të Rregullores së Parlamentit hungarez, nenin 9 të Rregullores së Parlamentit finlandez, nenin 57 të Rregullores së Bundestagut gjerman, nenin 19 të Dhomës së Deputetëve të Italisë, nenin 19 të Parlamentit bullgar, nenin 40 të Rregullores së Parlamentit rumun, nenin 30 të Rregullores së Parlamentit portugez, nenin 33 të Rregullores së Parlamentit të Republikës Çeke dhe nenin 38 të Rregullores së Parlamentit të Republikës Sllovaqe. Gjithashtu, është marrë parasysh edhe Rregullorja e Parlamentit European, ku të dy dokumentet kryesorë: Rregullorja e Bundestagut gjerman dhe Rregullorja e Parlamentit European, kanë shërbyer për hartimin e Rregullores së vitit 2004 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetet, në mënyrë unanime, gjykoi se çdo ndërhyrje që bëhet në kompozimin e komisioneve kërkon një kujdes të veçantë. Kjo rrjedh drejtpërdrejt nga roli i tyre i rëndësishëm dhe i pazëvendësueshëm në pushtetin legjislativ, ku komisionet mundësojnë që legjislaturat të shqyrtojnë dhe analizojnë me hollësi projektligjet që paraqiten, të kontrollojnë zbatimin e programit qeverisës, si dhe të paraqesin njëkohësisht mundësi reale që opinionin publik të marrë pjesë në procesin legjislativ.

Kompozimi politik i komisioneve të përhershme

të Parlamentit, si rregull, reflekton forcën e partive të ndryshme politike të përfaqësuara në të. Ky parim shpërndarës i anëtarësisë së fuqisë politike në komisione mbizotëron, sikundër e përmendëm, në komisionet e Bundestagut gjerman dhe shkon paralelisht, për aq sa mundet, me fuqinë e grupeve parlamentare në seancën plenare. Ky rregull, pra kompozimi i komisioneve parlamentare që t'i korrespondojë fuqisë elektorale të partisë, mbizotëron edhe në kompozimin e komisioneve të vendeve të tjera, si në: Bullgari, Hungari, Kanada, Mbretëri e Bashkuar, SHBA dhe të tjerë.

Një parashikim i tillë, madje, nuk është vetëm në normën e Rregullores së Kuvendit, por njëkohësisht ka marrë edhe statusin e jurisprudencës kushtetuese, posaçërisht me një vendim të Gjykatës Kushtetuese të Gjermanisë, të nxjerrë në dhjetor të vitit 2004, pikërisht për kompozimin e komisioneve, sipas fuqisë politike në Parlament.

Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetet, gjithashtu, diskutoi krahas këtij amendamenti edhe një pjesë tjetër të Rregullores, një shprehje arkaike që kishte ngelur në Rregulloren e Kuvendit në nenin 8, përmendja e fjalës “dy zëvendëskryetarë”.

Natyrisht që është traditë në Parlamentin shqiptar dhe patjetër ka qenë edhe një premtim që në fillim të kësaj legjislature që edhe opozita do të ketë përfaqësimin e saj jo vetëm në Byronë e Kuvendi, jo vetëm në grupet parlamentare, jo vetëm në sekretariatet, por njëkohësisht edhe në kompozimin e lidershit politik të Parlamentit dhe, natyrisht, asaj iu rezervua posti i zëvendëskryetarit, një traditë më se 40-vjeçare në Parlamentin shqiptar.

Aktualisht, përbërja e Byrosë së Kuvendit e shprehur me fjalët vetëm “dy zëvendëskryetarë” ishte një rudiment, i cili ishte i bartur nga Rregullorja e vitit 2004 dhe me amendimin e paraqitur nga Grupi Parlamentar i PD-së, posaçërisht me heqjen e fjalëve “dy zëvendëskryetarë”, ne bëjmë të mundur jo vetëm *de facto*, por tashmë edhe *de jure* të krijojmë mundësinë që edhe opozita, sipas përfaqësimit që ajo zgjedh, të marrë vendin përkatës të zëvendëskryetarit të Kuvendit.

Këto janë dy amendamentet të cilat Grupi Parlamentar i PD-së i paraqet për miratim në seancë plenare. Duke diskutuar me përgjegjësi në lidhje me përmbajtjen e tyre të plotë dhe në përputhje me praktikën më të mira, por njëkohësisht edhe me dispozitat e tjera të Rregullores, Këshilli për

Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetet i propozon seancës plenare, konkretisht, miratimin e këtyre dy neneve:

Neni 1: Në nenin 8, pika 2, fjalët “dy zëvendëskryetarë” zëvendësohen me fjalën “zëvendëskryetarë” dhe i lihet zakoni parlamentar për të përcaktuar numrin e zëvendëskryetarëve, sipas përbërjes politike të Kuvendit.

Neni 2 i amendamentit të paraqitur: Në nenin 20, pika 2 riformulohet: “Si rregull, deputeti mund të jetë anëtar vetëm i një komisioni të përhershëm. Në respektim të raporteve shumicë parlamentare-opozitë, deputetë të caktuar mund të jenë anëtarë të jo më shumë se dy komisioneve të përhershme. Deputeti mund të marrë pjesë në mbledhjet e komisioneve të tjera pa të drejtë vote.

Neni 3: Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Në këto kushte, Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetet i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë propozon njëzëri miratimin e këtyre amendamenteve në seancë.

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Gumi!

Ka pyetje. S’ka. Diskutime? S’ka.

Kalojmë në mendimin e grupeve.

Në emër të Grupit Parlamentar të LSI-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të PD-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës: miratimi i procesverbalit të seancës së datës 25.02.2010. Ka vërejtje? S’ka. Miratohet. Falemnderit!

Po e spondoj diskutimin e projektligjit “Për Gjykatën Administrative”, se po ta hedhim në votë, ai nuk votohet më, duke uruar që deputetët socialistë të mos ndryshojnë mendje.

Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës: projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut për sigurinë e informacionit”.

Në emër të komisionit përgjegjës, që është Komisioni i Sigurisë, zoti Skuqi, urdhëroni!

Luan Skuqi – Falemnderit, zonja Kryetare!

Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut për sigurinë e informacionit” u shqyrtua nga komisioni në datën 2.03.2010. Anëtarësimi i vendit tonë në këtë traktat është si detyrim i anëtarësimit tonë me të drejta të plota në NATO. Kjo ka të bëjë me sigurinë e

informacionit të klasifikuar, që është një detyrim për të gjitha vendet anëtare të NATO-s, ndërmjet tyre dhe me këtë organizatë politiko-ushtarake.

Komisioni e gjykoi se duhet të kalojë në seancë plenare.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit!

Në emër të Komisionit të Ligjeve, urdhëroni, zoti Sula!

Dashnor Sula – Falemnderit, zonja Kryetare!

Komisioni i Ligjeve ka shqyrtuar në mbledhjen e tij projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut për sigurinë e informacionit”. Aderimi në këtë marrëveshje përbush një detyrim të vendit tonë, pas anëtarësimit në NATO, si dhe bën të mundur arritjen e objektivave në fushën e bashkëpunimit politik dhe ushtarak të kësaj organizate. Shtetet palë në këtë marrëveshje angazhohen që informacioni i klasifikuar, i siguruar nga NATO-ja, të sigurojë, në kushte të tilla, shmangien, ekspozimin dhe njohjen e tyre nga persona të paautorizuar. Shtetet anëtare, nëpërmjet institucioneve të tyre, do të sigurojnë që informacioni i klasifikuar i NATO-s të ruhet sipas standardeve të kërkuara nga legjislati ynë dhe aktet ligjore në fuqi për informacionin e klasifikuar.

Në përfundim, Komisioni i Ligjeve u shpreh unanimisht dakord për ratifikimin në seancë plenare të këtij projektligji.

Falemnderit!

Jozefina Topalli - Falemnderit!

Ka pyetje? S’ka. Diskutime? S’ka.

Kalojmë në mendimin e grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të LSI-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të PD-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Kalojmë te projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Sllovakisë për mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar”.

Në emër të Komisionit të Sigurisë, zoti Demi, urdhëroni!

Leonard Demi – Dakord.

Jozefina Topalli - Falemnderit!

Në emër të Komisionit të Ligjeve, urdhëroni, zoti Lama!

Ylli Lama – Falemnderit, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë,

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në mbledhjen e datës 28.10.2009, shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Sllovakisë për mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar”.

Me anëtarësimin e vendit tonë në strukturat euroatlantike dhe në kuadër të nismave të shumta rajonale dhe ndërkombëtare, që vendi ynë ka ndërmarrë në fusha të ndryshme në rrugën e integritit evropian, është përgjegjësi dhe detyrim i shtetit tonë që informacionin e klasifikuar të shteteve dhe organizatave ndërkombëtare ta ruajë sipas standardeve të kërkuara. Për këtë qëllim, ndërmjet Qeverisë shqiptare dhe asaj sllovaqe, në datën 18.06.2009, në Tiranë, është nënshkruar marrëveshja për mbrojtjen e ndërsjellë të informacioneve të klasifikuar. Në dispozitat e kësaj marrëveshjeje parashikohen masat e nevojshme që duhet të marrin palët kontraktuese, në përputhje me legjislacionet e brendshme, në mënyrë që të sigurojnë mbrojtje të përshtatshme të informacionit të klasifikuar dhe kushte të tilla që të shmangët ekspozimi dhe njohja e tij nga persona të paautorizuar.

Gjithashtu, në marrëveshje përcaktohen masat e sigurisë gjatë shkëmbimit të informacionit të klasifikuar, autoritetet kompetente të sigurisë, klasifikimet e sigurisë, përkthimi, riprodhimi dhe asgjësimi i informacionit të klasifikuar, transmetimi i tij, vizitat reciproke dhe mënyra e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve që mund të lindin midis palëve.

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, duke vlerësuar rëndësinë e kësaj marrëveshjeje, u shpreh unanimisht dakord për miratimin e saj në seancë plenare.

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën, me nenin 121 të saj.

Falemnderit!

Jozefina Topalli- Falemnderit, zoti Lama!

Në emër të Komisionit të Jashtëm, zoti Oketa?

(Zoti Oketa shprehet dakord.)

Falemnderit!

Ka pyetje? Nuk ka. Ka diskutime? Nuk ka.

Kalojmë në shprehjen e grupeve.

Në emër të Grupit Parlamentar të LSI-së, zoti Koka?

(Zoti Koka shprehet dakord.)

Falemnderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të PD-së, zoti Patozi?

(Zoti Patozi shprehet dakord.)

Falemnderit!

Kalojmë te projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Letonisë për mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar”.

Pra, siç e shihni, janë rreth katër projektligje për marrëveshjet me Çekinë, Sllovakinë dhe Letoninë. Të gjitha këto marrëveshje janë shumë të rëndësishme për lehtësimin e heqjes së vizave.

Në emër të Komisionit të Sigurisë Kombëtare, zoti Maliqi?

(Zoti Maliqi shprehet dakord.)

Falemnderit!

Në emër të Komisionit të Ligeve, zoti Lama?

Ylli Lama – Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në mbledhjen e datës 9 shkurt mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Letonisë për mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar”.

Në mbledhjen e komisionit, të ftuar ishin edhe përfaqësues nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar pranë Këshillit të Ministrave. Kjo marrëveshje është nënshkruar në dhjetor të vitit 2009. Ajo është një marrëveshje kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe asaj letoneze. Objekti i saj është informacioni i klasifikuar i një natyre të veçantë që shkëmbet ndërmjet Republikës së Shqipërisë, ministrive, institucioneve qendrore të vendit tonë dhe homologëve të tyre letonezë.

Ky informacion kërkon një mbrojtje të caktuar, sipas disa standardeve që përcaktohen në ligje dhe në disa akte nënligjore, të cilat janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Nënshkrimi i këtyre marrëveshjeve është një detyrim për vetë faktin se Republika e Shqipërisë është vend anëtar i NATO-s, si dhe nga sugjerimet që janë bërë nga vetë ky organizëm.

Anëtarët e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi u njohën me përmbajtjen e marrëveshjes, u shprehën unanimisht dakord, meqenëse dhe marrëveshja është në përputhje me Kushtetutën, me nenin 121 të saj.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Lama!

Në emër të Komisionit për Politikën e Jashtme, zoti Oketa?

(Zoti Oketa shprehet dakord.)

Falemnderit!

Ka pyetje? Nuk ka. Ka diskutime? Nuk ka.

Në emër të Grupit Parlamentar të LSI-së, zoti Koka?

(Zoti Koka shprehet dakord.)

Falemnderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të PD-së, zoti Patozi?

(Zoti Patozi shprehet dakord.)

Falemnderit!

Kalojmë te projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Çekisë për shkëmbimin dhe mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar”.

Në emër të Komisionit të Sigurisë, zoti Ngresi?

(Zoti Ngresi shprehet dakord.)

Falemnderit!

Në emër të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, fjalën e ka zonja Paulina Hoti.

Paulina Hoti – Edhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut mori në shqyrtim nismën e Këshillit të Ministrave për projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Çekisë për shkëmbimin dhe mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar”.

Objekti i kësaj marrëveshjeje është informacioni i klasifikuar i një natyre të veçantë, që kërkon ruajtjen dhe mbrojtjen e tij sipas standardeve të përcaktuara në ligjet e brendshme.

Anëtarët e këtij komisioni, pasi u njohën me përmbajtjen e marrëveshjes dhe dëgjuan shpjegimet e dhëna nga specialistët, kanë vlerësuar rëndësinë e miratimit të saj për shtetin shqiptar dhe janë shprehur unanimisht dakord për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje në Kuvend, pasi është në përputhje me nenin 121 të Kushtetutës.

Falemnderit!

Jozefina Topalli - Falemnderit!

Në emër të Komisionit për Politikën e Jashtme, zoti Oketa?

(Zoti Oketa shprehet dakord.)

Falemnderit!

Ka pyetje? Nuk ka. Ka diskutime? Nuk ka.

Falemnderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LSI-së, zoti Koka?

(Zoti Koka shprehet dakord.)

Falemnderit!

Grupi Parlamentar i PD-së, zoti Patozi?

(Zoti Patozi shprehet dakord.)

Falemnderit!

Kalojmë te projektligji “Për kornizën shqiptare të kualifikimeve”.

Fjalën e ka zonja Adriana Gjonaj, relatorja, në emër Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

Adriana Gjonaj – Falemnderit!

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik në disa mbledhje të tij ka diskutuar projektligjin “Për kornizën shqiptare të kualifikimeve”.

Duke parë rëndësinë e këtij projektligji, komisioni organizoi seanca dëgjimore me aktorë të interesit, si përfaqësues të Ministrisë së Arsimit dhe ministrive të tjera të angazhuar në hartimin e projektligjit, të arsimit parauniversitar të përgjithshëm dhe profesional, të Konferencës së Rektorëve, të Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës, të grupit shqiptar për ndjekjen e procesit të Bolonjës, të shoqatave të punëdhënësve, të sindikatave dhe të projektit CARD-s që ka mbështetur hartimin e projektligjit.

Gjatë diskutimit të këtij projektligji, komisioni shqyrtoi me vëmendje raportin e paraqitur nga Komisioni për Integrimin Europian dhe sugjerimet e bëra prej tij. Pas diskutimit në parim të projektligjit, komisioni vlerëson se në aspektin ligjor projektligji është konform Kushtetutës, neni 81 pika 1. Në përmbajtjen e dispozitave të këtij projektligji nuk ka formulime që vijnë në kundërshtim me dispozitat kushtetuese.

Në aspektin procedural, projektligji vjen si një nismë legislative e Këshillit të Ministrave, është depozituar në Kuvend dhe u është nënshtruar rregullave procedurale të shqyrtimit dhe miratimit të projektligjeve, sipas Rregullores së Kuvendit. Projektligji i paraqitur shënon një hap të rëndësishëm në kuadër të reformimit të sistemit tonë arsimor, veçanërisht atij profesional, në drejtim të njëjtë me zhvillimet respektive europiane.

Korniza shqiptare e kualifikimeve që krijohet me këtë projektligj përfaqëson një klasifikim të qartë në nivel kombëtar të sistemit arsimor, që të kuptohet lehtësisht dhe ndërkombëtarisht. Ajo bën një

përshkrim sistematik të të gjitha niveleve dhe tipeve të kualifikimeve brenda sistemit, të bazuar në arritjet e të mësuarit, shprehur në standarde të njohurive, aftësive dhe kompetencave.

Në projektligjin e paraqitur, konteksti ndërkombëtar ka pasur një ndikim të konsiderueshëm, sidomos axhenda e Lisbonës, procesi i Bolonjës dhe procesi i Kopenhagenit, që janë dhe iniciativat më të rëndësishme europiane në fushën e arsimimit dhe të trajnimeve. Arkitektura bazë e kornizës me 8 nivele dhe përcaktimi i standardeve të njohurive, aftësive dhe kompetencave, si përshkrues për çdo nivel të saj, janë mbështetur në rekomandimet e kornizës europiane të kualifikimeve dhe dokumenteve të tjera që lidhen me të. Sigurimi i standardeve të cilësisë në arsimim dhe trajnim është një nga vlerat dhe parimet fundamentale mbi të cilat është bazuar korniza shqiptare e kualifikimeve, pasi korniza duhet të përmbajë, promovojë dhe certifikojë cilësinë si një parakusht për bashkëpunimin, partneritetin dhe besimin reciprok midis mbështetësve në nivele dhe funksione të ndryshme të saj.

Gjithashtu, projektligji promovon kulturën e të mësuarit gjatë gjithë jetës për një përditësim dhe rinovim të vazhdueshëm të njohurive, aftësive dhe kompetencave më të gjera, diktuar kjo nga ndryshimet e shpejta sociale, teknologjike dhe ekonomike, si dhe në përputhje me projektin më të madh europian sot në fushën e arsimit dhe të trajnimeve. Korniza shqiptare e kualifikimeve lidh në mënyrë logjike dhe transparente, kualifikimet me njëri-tjetrin, si dhe përcakton raportin ndërmjet tyre, duke ofruar shtigje fleksibël ndërmjet kualifikimeve.

Përcaktimi në zbatim i bazave për akumulimin, shkëmbimin dhe transferimin e krediteve për njohjen kombëtare dhe ndërkombëtare të kualifikimeve, njohjen ligjërisht dhe për pasojë vlerësimin e të gjitha llojeve të përfitimit individual të dijeve, qofshin ato formale, joformale ose informale do të lehtësojë progresin e individit brenda sistemit të kualifikimeve, transferimin dhe njohjen e kualifikimeve individuale nga një sektor në tjetrin ose ndërmjet vendeve të ndryshme dhe sistemeve të tyre të kualifikimit.

Me krijimin dhe zbatimin e kornizës shqiptare të kualifikimeve sipas këtij projektligji, gjithashtu synohet kalimi i kualifikimeve të ndryshme të projektuar në funksion të ofertës, në një projektim të ri në funksion të kërkesës, pasi nxitet promovimi i kooperimit të institucioneve arsimore, trajnuese me industrinë dhe biznesin, si dhe mundësohet që

kërkesat e këtyre të fundit të gjejnë pasqyrim në politikat dhe objektivat kombëtare arsimore.

Gjithashtu, në projektligj përcaktohen autoriteti drejtues i kornizës, misioni e funksionet e tij, si dhe institucionet e ndryshme zbatuese dhe roli i tyre.

Në përfundim, pas shqyrtimit të projektligjit në tërësi dhe diskutimit nen për nen të dispozitave të tij, duke marrë në konsideratë edhe propozimet e sugjeruara nga Komisioni për Integrimin Europian ose të administruara gjatë seancave dëgjimore, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik vendosi që projektligji të kalojë për miratim në seancë plenare me ndryshimet e komisionit.

Falemnderit!

Jozefina Topalli - Falemnderit, zonja Gjonaj!
Urdhëroni, zoti Ministër!

Myqerem Tafaj – Zonja Kryetare,
Të nderuar kolegë deputetë,

Shqipëria sot ka arritur të përmbushë objektivin kryesor politik për rritjen e aksesit të nxënësve dhe të studentëve në të gjitha nivelet e arsimit. Ne po ecim të sigurt në përmbushjen e këtij objekti, për të arritur treguesin europian për pjesëmarrjen në arsimin e mesëm. Siç e dini, arsimit i lartë tashmë është i liberalizuar.

Së pari, këto arritje që janë realizuar, janë falë shkallës së lartë prioritare që i dha Qeveria "Berisha" në mandatin e parë arsimit, çka vijon edhe në mandatin e dytë dhe kjo është një karakteristikë thelbësore e një partie të qendrës së djathtë, investimi për zhvillimin e shpejtë të burimeve njerëzore si faktor determinant për prosperitetin ekonomik dhe shoqëror të një vendi.

Së dyti, si rezultat i reformës së thellë në të gjitha nivelet e arsimit për modernizimin e tij.

Së treti, si rezultat i investimeve të shumëfishuara për ndërtimin dhe rikonstrukcionin, pra për krijimin e infrastrukturës adekuate në shkollat nga të katër anët e vendit.

Së fundi, çka është dhe shumë e rëndësishme, si rezultat i investimit unikal që bëri Qeveria "Berisha" në mandatin e parë, dhe që po vazhdon edhe në mandatin e dytë, për rritjen e pagave të mësuesve dhe i mbështetjes së tyre në mënyrë të veçantë për kualifikim.

Cilësia e shkollimit është një sfidë afatgjatë e sistemit tonë arsimor. Ajo, në fund të fundit, do të përcaktojë shanset reale që do të kenë të rinjtë shqiptarë që përfundojnë të gjitha nivelet e arsimit në tregun e punës.

Sfida tjetër, po aq e rëndësishme, është orientimi

i shkollimit tonë në të gjitha nivelet ndaj tregut të punës. Produkti i arsimit të mesëm dhe të lartë shqiptar duhet t'u përgjigjet plotësisht kërkesave të tregut të punës. Ky treg nuk duhet kuptuar vetëm si treg i vendit, por si një treg rajonal dhe madje global i punës. Kjo do të thotë se produkti i shkollës sonë, të mesme dhe të lartë, duhet të jetë kompetitiv edhe në tregun global të punës. Shqipëria po pret liberalizimin e vizave dhe kjo do të ndodhë së shpejti. Kjo do të thotë se në një të ardhme të afërt të rinjtë tanë duhet të kenë të gjitha kualifikimet, kualitetet dhe aftësitë e nevojshme profesionale për të konkurruar me dinjtet në tregun e punës me bashkëmoshatarët e tyre të kualifikuar edhe jashtë Shqipërisë. Thjesht dhe përmbledhtazi, të rinjve shqiptarë u duhen aftësi dhe kualifikime europiane, prandaj objektivi ynë në këtë mandat është thellimi i reformave në të gjitha nivelet e arsimit për ta çuar atë drejt standardeve europiane.

Projektligji "Për kornizën shqiptare të kualifikimeve" është një hap shumë i rëndësishëm drejt institucionalizimit të krahasueshmërisë së niveleve të sistemit tonë arsimor, të arsimit të përgjithshëm dhe atij profesional, si dhe të produktit të tij me standardet e Bashkimit Europian.

Korniza shqiptare e kualifikimeve karakterizohet nga disa elemente kryesorë:

Së pari, ajo përmban 8 nivele, të cilat janë krejtësisht në përputhje me kornizën europiane të kualifikimeve.

Së dyti, ajo mbështetet në një sistem kreditesh, i cili mundëson lëvizjen brenda niveleve horizontale dhe vertikale të sistemit tonë arsimor, të arsimit të përgjithshëm, të arsimit profesional dhe të formimit profesional, si dhe transferimin e krediteve jashtë vendit, çka është shumë e rëndësishme për të garantuar mobilitet, jo vetëm studentëve, por edhe nxënësve.

Korniza shqiptare e kualifikimeve garanton të mësuarit gjatë gjithë jetës, objektiv ky përcaktues për përshtatjen ose adaptimin e aftësive dhe të kualifikimeve në përputhje me kërkesat e tregut të punës, që ndryshojnë jo vetëm çdo vit, pra nga viti në vit, por madje nga muaji në muaj.

Korniza shqiptare e kualifikimeve për herë të parë mundëson edhe njohjen e të gjitha kualifikimeve të mëparshme, pra, përfshirjen, përllogaritjen ose konsiderimin e tyre në tri kolonat e sistemit të arsimit të përgjithshëm e akademik, sistemit të arsimit profesional dhe sistemit të formimit profesional.

Ky projektligj është një bazë e sigurt për arritjen e objektivit tonë të cilësisë, në të gjitha nivelet e arsimit, sepse përmes këtij projektligji dhe strukturave që e drejojnë kornizën shqiptare të kualifikimeve, përkatësisht Këshillit Kombëtar të kornizës së kualifikimeve dhe njësisë së sekretariatit mbështetës të tij, bëhet e mundur që të gjitha kualifikimet të certifikohen e të vlerësohen paraprakisht.

Nga ana tjetër, ky projektligj vendos një hierarki të re, në të cilën përfshihen të gjitha agjencitë tona ekzistuese, Agjencia e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Këshilli i Akreditimit të Arsimit të Lartë, Agjencia e Arsimit dhe e Formimit Profesional, Instituti i Zhvillimit të Arsimit dhe strukturat e ministrisë, që e kanë për detyrë zhvillimin dhe sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet e arsimit.

Nga ana tjetër, kjo kornizë mundëson edhe akreditimin ose rritjen e cilësisë së akreditimit të të gjitha institucioneve që veprojnë ose që ofrojnë arsim dhe kualifikim të vazhduar brenda sistemit të arsimit të përgjithshëm, arsimit profesional dhe formimit profesional. Kjo kornizë do të përbëjë një shtysë për rritjen e ambicies sonë në zhvillimin e shpejtë të arsimit dhe të formimit profesional, e cila është një shinë e sistemit që është ende relativisht e prapambetur në krahasim me arsimin e përgjithshëm.

Siç e shihni, në shtojcën e kornizës definohe, përkufizohen qartë të gjitha certifikatat dhe diplomatat që fitohen në të gjitha nivelet e sistemit. Ju e shihni që shkolla e mesme e përgjithshme në Shqipëri do të përfundojë me diplomë të maturës shtetërore, e cila është një standard i vendeve të BE- së. Ky model i implementuar me sukses të plotë në vitin 2006 në Shqipëri jo vetëm që goditi korrupsionin e pranimeve në shkollat e larta, por është bërë një faktor determinant i rritjes së cilësisë në arsimin e mesëm dhe për më tepër është bërë një bazë e shkëlqyer për vlerësimin e sistemit. Në vitin 2010 ne presim të kemi një vlerësim të sistemit parauniversitar me vlerësimin e njohur ndërkombëtar *Pizëm*.

Korniza shqiptare e kualifikimeve është plotësisht në linjë me kornizën europiane të kualifikimeve, e cila mbështetet në akumulimin dhe transferimin e krediteve në arsimin e lartë dhe në arsimin profesional, si dhe në formimin profesional. Në këtë mënyrë të rinjtë shqiptarë me zbatimin e kësaj kornize do të kenë diploma dhe certifikata, që do t'i përdorin jo vetëm në Shqipëri, por edhe jashtë saj.

Projektligji është një produkt i konsultimeve intensive që kanë bërë institucionet tona me të gjitha grupet e interesit dhe jo vetëm me to, por edhe me partnerë të huaj. Projektligji është produkt i një projekti të BE-së në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe me agjencitë tona, i cili ka zgjatur katër vjet.

Në përfundim, unë dëshiroj të falënderoj përzemësisht anëtarët e Komisionit të Edukimit dhe të Mediave për një punë jashtëzakonisht intensive dhe të shkëlqyer që bënë në bashkëpunim me stafin tonë, për të bërë të gjitha përmirësimet e duhura në draftin që paraqitet sot në seancë.

Unë ju ftoj që ta miratojmë këtë projektligj.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Ministër!

Ka pyetje? Nuk ka.

Kalojmë në shprehjen e komisioneve.

Në emër të Komisionit për Integrimin Europian? *(Përfaqësuesi i komisionit shprehet dakord.)*

Falemnderit!

Ka diskutime? Nuk ka.

Kalojmë në shprehjen e grupeve.

Grupi Parlamentar i LSI-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Kalojmë në votimin e projektvendimit "Për ndryshimin e vendimit të Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004 për Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë", të ndryshuar".

Neni 1. Në nenin 8, pika 2 fjala "dy zëvendëskryetarët" zëvendësohet me fjalën "zëvendëskryetarët".

Neni 2. Në nenin 20, pika 2 riformulohet: "Si rregull, deputeti mund të jetë anëtar vetëm i një komisioni të përhershëm. Në respektim të raporteve të shumicës parlamentare, opozitë, deputetë të caktuar mund të jenë anëtarë të jo më shumë se dy komisioneve të përhershme. Deputetët mund të marrin pjesë në mbledhjen e komisioneve të tjera, por pa të drejtë vote".

Neni 3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Meqenëse është projektvendim votohet vetëm një herë.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

73 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton projektvendimin "Për

ndryshimin e vendimit të Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004 për Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë", të ndryshuar".

Kalojmë te votimi i projektligjit "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut, për sigurinë e informacionit".

Hapet votimi me elektronikë, në parim.

Mbyllet votimi.

73 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton në parim projektligjin.

Kush është dakord me nenin 1? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Hapet votimi me elektronikë, në tërësi.

Mbyllet votimi.

73 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton edhe në tërësi projektligjin "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut, për sigurinë e informacionit".

Kalojmë në votimin e projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Sllovakisë, për mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar".

Hapet votimi me elektronikë, në parim.

Mbyllet votimi.

73 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton në parim projektligjin.

Kush është dakord me nenin 1? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Hapet votimi me elektronikë, në tërësi.

Mbyllet votimi.

73 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton edhe në tërësi projektligjin "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Sllovakisë, për mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar".

Kalojmë në votimin e projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Letonisë, për mbrojtjen e ndërsjellë

të informacionit të klasifikuar”.

Hapet votimi me elektronikë, në parim.

Mbyllet votimi.

73 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton në parim projektligjin.

Kush është dakord me nenin 1? Falemnderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2? Falemnderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Hapet votimi me elektronikë, në tërësi.

Mbyllet votimi.

73 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton edhe në tërësi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Letonisë, për mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar”.

Kalojmë në votimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Çekisë, për shkëmbimin dhe mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar”.

Hapet votimi me elektronikë, në parim.

Mbyllet votimi.

73 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton në parim projektligjin.

Kush është dakord me nenin 1? Falemnderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2? Falemnderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Hapet votimi me elektronikë, në tërësi.

Mbyllet votimi.

73 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim .

Kuvendi miraton edhe në tërësi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Çekisë, për shkëmbimin dhe mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar”.

Kalojmë në votimin e projektligjit “Për kornizën shqiptare të kualifikimeve”.

Hapet votimi me elektronikë, në parim.

Mbyllet votimi.

73 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton në parim projektligjin.

Kush është dakord me nenin 1? Falemnderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2? Falemnderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 3? Falemnderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 4? Falemnderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 5? Falemnderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

(Nga neni 6 deri në nenin 17 ndiqet e njëjta procedurë e miratimit të neneve.)

Kush është dakord me shtojcën 1, bashkë me vërejtjet e Ministrisë së Arsimit? Falemnderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me shtojcën 2? Falemnderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Hapet votimi me elektronikë, në tërësi.

Mbyllet votimi.

73 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton edhe në tërësi projektligjin “Për kornizën shqiptare të kualifikimeve”.

Kërkoj 5 minuta pushim.

Falemnderit!

(Pas pushimit)

Jozefina Topalli - Zotërinj deputetë, rinisim seancën.

Përpara se të kalojmë te pika e fundit e rendit të ditës për shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar të projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8891, datë 02.05.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, ju vë në dijeni se zoti Gramoz Ruçi, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, më ka paraqitur emrat e deputetëve të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste që do të jenë anëtarë në komisionet parlamentare.

Ndërkohë, zoti Patozi ka sjellë po ashtu emrat e deputetëve të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

Bazuar në Rregulloren e Kuvendit, kur Kryetarja bie dakord me kryetarët e grupeve parlamentare për emrat e deputetëve - anëtarë të komisioneve parlamentare, ato i bëhen të ditura Kuvendit.

Po fillojmë me kërkesën e zotit Patozi.

Në Komisionin e Ligjeve, përveç atyre që janë, propozohen si anëtarë deputetët: Mesila Doda, Aldo Bumçi, Fatos Hoxha, Edi Paloka; zëvendësues propozohen deputetët Lajla Përnaska dhe Rajmonda Bulku.

Në Komisionin e Ekonomisë propozohen për anëtarë deputetët: Flamur Noga, Adriana Gjonaj, Luan Skuqi; zëvendësues deputeti Bedri Hoxha.

Në Komisionin e Sigurisë propozohen për anëtarë deputetët: Gazmend Oketa, Ardian Turku, Osman Metalla.

Në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese propozohen për anëtarë deputetët: Sybi Hida, Selami Xhepa, Ismail Hoxha, Kreshnik Çipi, Rrahim Çota; zëvendësues propozohen deputetët Aldo Bumçi dhe Arenca Trashani.

Në Komisionin e Medias propozohen për anëtarë deputetët: Gent Strazimiri, Gerti Bogdani, Fatbardh Kadilli; zëvendësues Eduard Halimi.

Në Komisionin e Integritit propozohen për anëtarë shtesë deputetët: Sherefedin Shehu dhe Mesila Doda; zëvendësues Arenca Trashani dhe Albana Vokshi.

Në Komisionin e Shëndetësisë propozohen për anëtarë deputetët: Besnik Dushaj dhe Albana Vokshi; zëvendësues Lajla Përnaska dhe Sybi Hida.

Në Komisionin e Jashtëm propozohet për anëtar deputeti Florian Mima; zëvendësues deputetët Gerti Bogdani dhe Paulina Hoti.

Ka ndonjë kundërshtim?

Falemnderit! Miratohen.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste:

Në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut: Arben Isaraj, Armando Subashi, Bashkim Fino, Damian Gjikhuri, Dashmir Peza, Ermonela Felaj, Fatmir Xhafaj, Pandeli Majko, Saimir Tahiri, Shëgushe Ligori, Tom Doshi, Vasilika Hysi.

Në Komisionin për Ekonominë dhe Financat: Albert Çaçi, Andis Harasani, Arben Ahmetaj, Arben Malaj, Erion Braçe, Ervin Koçi, Gjovalin Kadeli, Ilir Beqja, Mimi Kodheli, Rudina Seseri.

Në Komisionin për Politikën e Jashtme: Arta Dade, Ilir Gjoni, Olta Xhaçka, Qemal Minxhozi.

Në Komisionin për Integritimin Europian: Ditmir Bushati, Ermelinda Meksi, Gramoz Ruçi, Taulant Balla.

Në Komisionin për Sigurinë Kombëtare: Arben Çuko, Armando Prenga, Asllan Dogjani, Ben Blushi, Gazmir Bizhga, Piro Lutaj, Skënder Hasa, Xhemal Qefalia.

Në Komisionin e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësinë: Astrit Beci, Eglantina Gjermeni, Eltar Deda, Et'hem Ruka, Klodiana Spahiu, Vangjel Tavo.

Në Komisionin për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin: Artan Gaci, Besnik Baraj, Blendi Klosi, Eduard Shalsi, Fatos Tushe, Gjokë Jaku, Hazir Gashi, Ilir Beqja, Namik Dokle, Ndue Kola, Sadri Abazi.

Në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik: Agim Leka, Alfred Dalipi, Enkelejda Shkrelly, Fatmir Toçi, Fidel Ylli, Kastriot Islami, Luiza Xhuvani, Marko Bello, Valentina Leskaj.

Jeni dakord? Miratohen.

Punë të mbarë!

Kalojmë te kërkesa për shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar të projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8891, datë 02.05.2002 "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit".

Kuvendi në projektvendim ka përcaktuar:

1. Të shqyrtojë me procedurë të përshpejtuar projektligjin "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8891, datë 02.05.2002 "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit".

2. Shqyrtimi i projektligjit në komisionin përgjegjës, Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut të bëhet brenda datës 16.03.2010.

3. Paraqitja e amendamenteve pranë komisionit përgjegjës, Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut të bëhet deri në datën 11.03.2010.

4. Shqyrtimi në seancë plenare të bëhet ditën e enjte, datë 18.03.2010.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Zoti Ruçi, urdhëroni!

Gramoz Ruçi – Zonja Kryetare,

Zonja deputete,

Zotërinj deputetë,

Javën e kaluar opozita bëri një hap për të dhënë një kontribut konkret për zgjidhjen e krizës politike shqiptare, që nuk e kemi shkaktuar ne. Ne dhamë kontributin tonë nëpërmjet depozitimit të dy nismave ligjore, për të cilat paraqitët sot një projektvendim për miratim në Parlament.

Në një kohë që të gjithë ne prisnim që edhe maxhoranca të jepte kontributin e saj, për fat të keq, po konstatojmë se po e shpërdoroni besimin tonë, për të mos thënë që edhe nismën tonë po e shpërfillni, duke e anatemuar atë edhe sot kur po diskutojmë miratimin e këtij projektvendimi.

Më lejoni t'ju them, të nderuar deputetë,
Më lejoni t'ju them, e nderuara Kryetare,
Më lejoni t'ju kujtoj, zoti Kryeministër dhe lider i
Partisë Demokratike,

Së pari, kjo është një krizë politike dhe si çdo krizë politike kërkon zgjidhje me rrugë dhe mjete politike dhe jo me procedura të ashtuquajtura parlamentare, as me zvarritje, me paragjykime dhe, aq më pak, me anatemi.

Së dyti, megjithëse keni një emergjencë dhe ne kërkuam të diskutohet për miratim me një procedurë të përsheptuar, keni vendosur ta lexoni atë pas një jave dhe sot, me projektvendimin e paraqitur, keni vendosur që komisioni përgjegjës të merret fiks pas dy javëve e dy ditëve nga dita që është paraqitur. Sot, me këtë projektvendim, vendosim ta diskutojmë pas 3 javësh, pra në datën 18 mars.

Ky është lajmi më i keq që kjo maxhorancë po i jep opinionit publik shqiptar, duke humbur kështu shansin që opozita e këtij vendi po i jep kësaj maxhorance. Mos e humbni këtë shans, pasi opinionit publik shqiptar kërkon që kriza të zgjidhet me rrugë dhe mjete politike, jo në rrugë dhe as nga vetë populli! Atëherë do të jetë shumë vonë dhe jashtëzakonisht keq për vendin.

Ky është një lajm shumë i keq edhe për partnerët tanë europianë, të cilët mezi presin që Shqipëria të kryejë detyrat e saj të shtëpisë, kurse ju, me këtë projektvendim që po paraqisni sot, po i thoni Bashkimit Europian (jo më larg, por në datën 12 mars, mbledhet për herë të parë këtu në Tiranë Komiteti i Stabilizim-Asociimit për Shqipërinë): ju keni axhendën tuaj për ne, ju na merrni në provim në datën 12 mars, kurse ne nuk paraqitemi se kemi axhendën tonë, komisioni e ka në datën 16 mars, kurse Parlamenti e ka në datën 18 mars.

Pra, me një fjalë, ju u thoni atyre: ose ndryshojeni ju axhendën tuaj, ose në daç na kaloni, në daç na ngelni në provim. Po merrni një përgjegjësi jashtëzakonisht të madhe para partnerëve tanë ndërkombëtarë dhe para fatit të shqiptarëve. Këtë përgjegjësi do ta mbani ju. Mos kërkonin nesër t'ia faturoni edhe opozitës shqiptare.

Një javë më parë unë ju premtova se do të tërhiqemi nga kauza e transparencës nëse ju do të verifikoni këtu në Parlament dokumentacionin e një qendre të vetme votimi, atë të Ruzhdies, ku del qartë mekanizmi i korrupsionit elektoral. Mirëpo që nga dita e këtij propozimi politik për një qendër të vetme votimi, jeni vërdallosur me deklarata të ndryshme

shtypi sikur minoranca ju ka vjedhur një mandat. Jo zotërinj! Me 529 vota të asaj qendre, pa vendimin e Kolegjit Zgjedhor, por vetëm me vendimin e KQZ-së, mandatin e Fierit ju e keni të humbur, edhe sikur ato 400 vota që pretendoni ju të jenë të vlefshme. Nuk dua të zgjatem me këtë, por dua të them se rasti "Ruzhdie" nuk është një rast i izoluar.

Më lejoni që edhe në këtë seancë t'ju paraqes juve dhe opinionit publik shqiptar një provë tjetër për mekanizmin e manipulimit. Kam në xhep disa karta identiteti, të cilat janë marrë si model arritjeje në këto zgjedhje, si karta identiteti me standarde jashtëzakonisht të larta. Shikoni këtu! Keni dy karta identiteti false të një zonje nga Tropoja, e cila i ka përdorur ato për të votuar në këto zgjedhje. (*Tregon kartat.*)

Jozefina Topalli – Shkoni çojini në prokurori, zoti Ruçi!

Gramoz Ruçi – E lëmë këtë zonjë, për të vajtur te ky zotëri. Urdhëroni, i njëjti njeri në Tiranë ka dy karta identiteti me emra të ndryshëm!

Urdhëroni edhe këtë zotëri me dy karta identiteti në Dibër!

Nuk mjaftojnë dy. Shikoni këtë zotërinë tjetër me tri karta identiteti. Të tria janë false. Shikojini!

Shikoni edhe këtë zotërinë tjetër me dy karta identiteti! Shikojeni këtë zonjë, me dy! Shikojeni këtë zonjën tjetër, me dy!

(I drejtohet një deputeti të maxhorancës.)

Atëherë, meqë e ke merak, i dashur, se ke qenë zëvendësministër i Brendshëm, po të nxjerr një që e ke këtu në Tiranë, që dy herë është në Korçë e dy herë është në Tiranë, i njëjti njeri, me katër. E pra, ky është mekanizmi, meqë keni thënë se s'kemi prova.

Të nderuar pjesëmarrës të maxhorancës,

I nderuar Kryeministër,

E nderuar Kryetare e Parlamentit,

Ne jemi këtu për ta zgjidhur këtë problem. Ne jemi këtu për ta zgjidhur këtë konflikt. Ne jemi këtu për ta bërë këtë transparencë, ne jemi këtu për të vendosur këtë standard të vërtetë për zgjedhje të lira dhe të ndershme, ne jemi këtu për të plotësuar të gjithë ato parametra, që BE-ja kërkon nga ne. Ne do të jemi këtu për ta zgjidhur këtë krizë, nëse do të ekzistojë vullneti juaj. Nëse ky vullnet do të mungojë dhe ju nuk dëshironi ta zgjidhni këtë krizë, sigurisht, ne nuk do të jemi këtu dhe përgjegjësia politike do të bjerë vetëm mbi ju.

Falemnderit!

(Duartrokitje nga opozita)

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Ruçi!

Meqë zoti Ruçi foli për detyrat e shtëpisë, kam lënë pikërisht për këtë moment votimin e ligjit “Për Gjykatën Administrative”. Zotërinj deputetë, do të votojmë projektligjin “Për Gjykatën Administrative”, detyrat e shtëpisë të Parlamentit European dhe të Bashkimit European.

Projektligjin e keni përpara. Ka kaluar në komision dhe sot do ta votojmë. Të shohim se kush është për liberalizimin e vizave dhe detyrat e shtëpisë. Ka qenë në rendin e ditës së sotme.

Zoti Kryeministër, urdhëroni!

Sali Berisha – Zonja dhe zotërinj deputetë,

Të dashur qytetare dhe qytetarë shqiptarë,

Jam sot sërish këtu për t’i bërë thirrje opozitës që të përkushtohet në projektet e paraqitura, në mënyrë që të arrihet ai rezultat i nevojshëm, në mënyrë që në një diskutim të hapur, intensiv dhe 2-javor, të mund të konkretizohen rezultatet.

Të nderuar deputetë, negociatat, marrëveshjet kanë një kusht dhe ky kusht është themelor. Palët që negociojnë përpiqen të afrojnë qëndrimet e tyre në interesin më të mirë. Në rastin konkret dua të garantoj qytetarët shqiptarë se që nga shtatori i këtij viti e deri më sot, ndonëse të përballur me kërcënimet më të egra, me trillimet më të mëdha, me pretendimet më absurde, kemi injoruar çdo gjë dhe jemi përpjekur në interesin më të mirë, të ofrojmë elemente parësore të një kompromisi, sepse kompromisi në demokraci është një kusht i dialogut dhe i funksionimit të saj. Në këtë kontekst ka qenë oferta jonë, unike në historinë e një parlamenti, unike në historinë e parlamentarizmit të një vendi të lirë, që opozitës t’i ofrohet shumica në komisionin hetimor parlamentar.

Ata që e kanë interpretuar këtë si shenjë dobësie, kanë mashtruar veten e tyre. E kemi bërë këtë si një gjest njerëzillëku dhe mirëkuptimi ndaj opozitës, e cila humbi zgjedhjet dhe për t’i dëshmuar asaj se nuk do të ishte revanshi i fitimtarit ai që do të karakterizonte qëndrimin tonë. Por nuk e kemi bërë kurrë atë për t’iu nënshtruar konceptit se ndonjëherë një pakicë mund të sundojë. Shqipërisë, për katër dekada me radhë, pakica i bëri gjëmën. Asnjë vend në Europë nuk ka pësuar ato që pësoi Shqipëria nga sundimi i pakicës. Histori që nuk përsëritet kurrë më. Parlamentarizmi dhe parimet kushtetuese kërkojnë që të qeverisë shumica. Por ne bëmë një përjashtim madhor, të cilin më është dashur ta shpjegoj dhe e shpjegoj në mënyrat më të përsëritura me bashkëbiseduesit dhe miqtë e mi

ndërkombëtarë, se pse po e bëj. Do t’ju jap vetëm një shembull. Sepse qytetarët shqiptarë duhet t’i njohin gjerat.

Në të gjitha këto qëndrime, cila ka qenë platforma jonë? Kam përshëndetur qëndrimin e BE-së. Kjo është një çështje që duhet ta zgjidhin shqiptarët dhe e deklaroj këtu se ky është qëndrimi më dinjitoz, më i përgjegjshëm dhe më i duhur. Por, nga ana tjetër, duhet ta dini se kam pranuar çdo ofertë për ndërmjetësim. Nuk kam refuzuar as edhe një ofertë të vetme për ndërmjetësim dhe nuk do ta refuzoj. Pse? Sepse qëllimi im është që këto zonja e këta zotërinj të jenë të pranishëm në Parlament.

Në një rast të caktuar, kur një ndërmjetës i një profili të konsiderueshëm erdhi te ky paragraf, më thotë: “Unë nuk e shkruaj këtë. Nuk mund të shkruhet që shumica i jepet pakicës.” Unë i them: “Zotëri, meqë nuk kërkon ta marrësh vetë këtë tagër, ma atribuoa mua, dhe unë po të jap skemën.”. “Jo zotëri, ti mund të më thuash mua ta shkruaj, por unë nuk e shkruaj, se kjo nuk mund shkruhet”, më tha.

Megjithatë, as në atë moment e as tani unë nuk u tërhoqa nga ai propozim, që ne opozitës të mos i ofrojmë revanshin e fitimtarit, por t’i shtrijmë dorën e vlerësimit dhe të respektit dhe t’i ofrojmë shumicën në një komision hetimor parlamentar. Opozita, në të drejtën e saj më të madhe, është dhe duhet të jetë e interesuar për një zgjidhje të lirë dhe të ndershme. Me gjithë konsensusin e plotë dhe total që karakterizoi reformën zgjedhore, përfshi ndryshimet kushtetuese, sërish i kam ofruar dhe i ofroj opozitës të drejtën e hartimit të të gjitha amendamenteve për të adresuar rekomandimet e OSBE-ODIHR-it dhe Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës, me kushtin e vetëm që ato të dërgohen në njërin nga institucionet që merren me doktrinën elektorale, në Komisionin e Venecias apo tek OSBE-ODIHR-i dhe ne do t’i votojmë këtu, qoftë edhe duke përfshirë, në rast se dëshirojnë, ndryshimin e sistemit. Në këtë sens, në këtë aspekt, pra, me vullnetin për kompromis, i kemi ofruar opozitës që çdo provë, përfshi edhe stilolapsat me bateri dhe patentat që dolën këtu, t’i marrë dhe t’i çojë në prokurori.

Është e vlerësueshme puna e institucioneve gjyqësore ne rastin e Rruzhdies, por është e habitshme se si pranohet vendimi i Rruzhdies dhe nuk pranohet vendimi për rinumërimin; pranohet vendimi që na intereson dhe aty s’bëhet fjalë për korrupsion dhe nuk pranohet vendimi që nuk na

intereson dhe aty bëhet fjalë për korrupsion. Unë mendoj se kjo nuk është interesi i opozitës, e kundërta është e vërtetë.

Nga Komiteti Presidencial i Këshillit të Europës m'u shtrua pyetja: A do të pranoni ju, zoti Berisha, që në rast se PS-ja ka prova, t'ia paraqesë ato prokurorisë dhe ajo të veprojë pa kufizim? Absolutisht po, pavarësisht se nuk është koha, se ka një kohë në çdo gjë, iu përgjigja. Është më mirë t'i dëgjoni këto, se të jeni të bindur që ofertat janë të singërta. Mendimet e tjera i keni gabim,. Ta dini mirë.

Tryezën me Komitetin Presidencial të KE-së dhe me Presidentin e Republikës unë e pranova. Për farsë, kryetari socialist e hodhi poshtë. U sugjerua varianti që vendimi i Gjykatës Kushtetuese t'i paraqitej Komisionit të Venecias. Kjo u bë sepse një vendim gjykatë thotë se objekti i komisionit hetimor parlamentar nuk mund të cenojë parimet themelore të Kushtetutës, parimin e ndarjes së pushteteve, nuk mund të ndërhyjnë në juridiksionin e veprimtarisë së gjykatave e të tjera, e të tjera. Por të mos hymjë te vendimi 20 i Gjykatës Kushtetuese, i cili përcakton tagra edhe më të qarta për komisionet hetimore. Pra, u shtrua pyetja: A do të pranoni që gjykata t'i drejtohej Komisionit të Venecias? Unë rashë dakord vetëm me dëshirën më të mirë që të mund t'i shoh këta zotërinj në Parlament dhe jo jashtë tij.

Kryetari i tyre e hodhi poshtë këtë kërkesë. Tani unë pashë zotin Ruçi i cili nxori disa karta. A ishin patenta apo ishin nga ato kartat e sigurisë që merren nëpër konferenca, ku të japin një për t'u futur në sallë? Apo ishin falsifikime të kartave të identitetit? Unë ju ftoj, zoti Ruçi, të mos e bëni këtë, se ju përfaqësoni Grupin Parlamentar të PS-së. Të gjitha këto i paraqisni në prokurori.

Sistemi i identifikimit të qytetarëve është një nga reformat më themelore të këtij vendi, është një nga sistemet më të sigurta. Por të paraqesësh pseudofakte këtu, në një kohë kur Shqipëria vlerësohet për viza, kjo ka një qëllim fare të mbrapshtë, ka si qëllim të nxijë një sistem që sot është i teknologjisë më të lartë në Europë. Është e thjeshtë: kur shëtit vetë me pasaportë diplomatike, mund t'i bësh këto. Por duhet të mendosh se janë me qindra e mijëra shqiptarë të cilët lindin, vdesin, kanë nevojë të takohen me njëri-tjetrin dhe s'marrin dot vizën. Nuk duhet luajtur në asnjë mënyrë dhe në asnjë rast me problemin e vizave. Se ndryshe, çfarë donte të thoshte ajo, se paska pasur një me katër, një me tre karta?

Zotëri i nderuar, mundësisht, dorëzoji kartat në prokurori për të faktuar se nuk ke qëllim jashtëzakonisht të mbrapshtë, që të nxish integritetin e një sistemi për të cilin ky vend është përgjegjës para Komisionit Europian dhe qytetarëve shqiptarë në procesin e marrjes së vizave. Përlllogaritjet janë *sui generis*. Për takimin që u bë dje në Parlament dhe shpalli datën 18 si datë diskutimi, unë prisja vërtet një falënderim për mirëkuptimin e treguar. A e kuptoni ju, zotërinj, se cili është veprimi? Keni 6 muaj të ngujuar në kuti duke u thënë shqiptarëve duam komisionin për të dalë nga kutia dhe pas 6 muajsh sillni ligjin për krijimin e këtij komisioni. A mund t'u thoni qytetarëve shqiptarë se kur ishit të vërtetë ju, kur kërkonit me Maliq komisionin apo tani që e kërkonin me ligj komisionin? Cila ishte arsyeja? A është e drejtë kjo për një grup parlamentar dhe një parti që ka qeverisur vendin për 8 vjet? Sa është normale kjo? Po çfarë keni sjellë? A ekziston në historinë e botës që të silltet ligji dhe komisioni njëkohësisht? Megjithatë, ne në një vendim i pranuar siç i sollët, i pranuar pavarësisht se nuk duheshin pranuar kurrë të dyja së bashku.

Keni kërkuar 6 muaj komisionin, tani sillni ligjin për komisionin. Po atëherë, kush ju shtyu ju që të miratohet ligji pastaj të hyjë në fuqi ligji? Digjej koha e komisionit? Ky s'është faji ynë, por i asaj praktike që ndiqni ju, se njëqind herë më mirë të vinit këtu e të bëheshin të gjitha këto debate. Çfarë do t'u thoni ju sot qytetarëve shqiptarëve? Çfarë do t'u thoni ju ditën që do të diskutohet edhe projektvendimi, edhe ligji? Po bëjmë ligjin për këtë komision? Ka prej jush që janë deputetë që nga viti '91. E gjitha kjo ndodh, sepse ne besojmë që gradualisht perceptimi i realitetit do të mbizotërojë. Absolutisht, i gjithë qëndrimi ynë ka një sens: që ju të merrni vendet tuaja në Parlament. Por e fundit në botë që mund të ecë kundër kësaj shumice është gjuha e forcës. Mos mendoni kurrë se një protestues natyral i lindur si Sali Berisha mund ta impresiononi me protesta. Më ftoni po të doni dhe ua tregoj unë ju si bëhet protesta. *(Ka ndërhyrje nga deputetët e PS-së.)*

Unë e kam faktuar këtë dhe ju s'keni pse e diskutoni më. Hajde, urdhëroni, të ulemi! Ju përgëzoj për përzgjedhjen e komisionit ligjor! Të ulemi ta përpunojmë atë ligj! E prutë në komision ashtu siç e prutë, pa e bërë ligjin, dakord, e kaluam.

Prandaj edhe një herë ju ftoj sonte që të votojmë një ligj që biznesi ka 8 muaj që e pret. I ftoj edhe biznesmenët e grupit tuaj ta votojnë këtë ligj në emër

të kolegëve të tyre në këtë sallë, jashtë kësaj salle e kudo në Shqipëri.

Falemnderit!
(*Duartrokitje*)

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Kryeministër!

Urdhëroni, zoti Ruçi!

Gramoz Ruçi – Më lejo, zoti Berisha, të të përgjigjem lidhur me 4-5 probleme që shtrova në adresë të opozitës.

Ajo që kemi kërkuar ne është e qartë dhe shumëkush mund të mos ta ketë të qartë këtu, por ju jo, ju e keni shumë të qartë. Ne kërkojmë të bëhet një transparencë e mbi bazën e saj të bëhet ajo që ju trumbetuat këtu dhe që keni trumbetuar në të gjitha daljet tuaja publike, që do të thotë përmirësimi i Kodit Elektorale. Pra, s'ka përmirësim të Kodit Elektorale pa parë se ku janë defektet dhe ku janë shkeljet. Në këtë vend nuk e kanë fajin rregullat e lojës, kodet elektorale, fajin e ka njësimi i pushtetit me shtetin dhe, mbi të gjitha, shkelja e rregullave të lojës nga lojtarët në lojë. Ne duam të dimë ku janë bërë këto shkelje loje, kush i ka bërë këto shkelje loje dhe të vihen përpara përgjegjësisë këta shkelës.

Së dyti, ajo që kërkojmë në ligj nuk është që të bëjmë një amendament thjesht dhe vetëm për zgjedhjet e 2009-ës. Jo, zotërinj. Ajo që kërkojmë ne është që të vendosim një standard, si për sot që jemi ne në opozitë, edhe nesër që do të jeni ju në opozitë. Mos bëni gabimin që kemi bërë ne që mendonim se do të ishim tërë jetën në pushtet dhe i bënim ligjet dhe i mbanim qëndrimet sikur do të ishim një jetë në pushtet. Po bëni të njëjtën gjë. Mendojeni një ditë veten në opozitë dhe unë kam bindjen që ju do të gjykoni njësoj si ne, se s'ka rëndësi se kush është pozitë dhe opozitë, ka rëndësi që në këtë vend, pas 20 vjetësh, të mbyllet kapitulli i etheve të zgjedhjeve të manipuluar, të mbyllet kapitulli i mendimit se s'ka rëndësi se kush voton e si voton, ka rëndësi se kush numëron. Ky është parim stalinist dhe unë e ti e dimë mirë, meqë e kemi studiuar Stalinin e famshëm.

E treta, ne, thoni ju, ia falim opozitës. Jo, zotëri. Ta thashë radhën e parë e po ta them edhe kësaj radhe: ne duam shumicën me ligj, që edhe ti nesër ta kesh me ligj këtë shumicë dhe jo me dëshira dhe vullnete politike.

Së katërti, na akuzuat ne për vizat, kur, në të vërtetë duhet të përgjigjeni ju për problemin e liberalizimit të vizave dhe duhet t'u jepni llogari shqiptarëve se përse shqiptarët sot e kësaj dite janë

akoma pa viza. Ju duhet t'u jepni llogari shqiptarëve pse Serbisë së porsadalë nga lufta, që sot e kësaj dite vazhdon gjykimin në Gjykatën e Hagës, i liberalizohen vizat, se përse Maqedonisë, një shteti sa dy gishtat e dorës, i liberalizuan vizat, kurse shqiptarëve jo. Ju duhet të jepni llogari se përse qytetarëve të Malit të Zi, që ka sa gishtat e dorës shtet, iu liberalizuan vizat, kurse shqiptarëve jo. Ju duhet të jepni llogari për deklaratat e partnerëve tanë ndërkombëtarë se në qoftë se Shqipëria, në qoftë se politika shqiptare nuk zgjidh krizën politike, vonohen të gjitha gjërat, stopohen të gjitha gjërat dhe për këtë, ua thashë në fillim, po ua them prapë, që përgjegjësinë do ta mbani ju dhe aspak minoranca.

E pra, ju na drejtoni në prokurori. Po, iu drejtuan komisionerët tanë prokurorisë. Unë të thashë pak më parë, se me siguri këtë javë e keni zbuluar edhe ju se cilat janë rezultatet e Ruzhdijes. Por Ruzhdija nuk është rast i izoluar. Ruzhdije është e gjithë Shqipëria. Ato që paraqita unë nuk janë patenta, zoti Berisha, janë karta identiteti dhe ju e dini mirë se karta e identitet nga patenta ndryshojnë dhe unë që të flas, ashtu sikurse të fola me garanci, duke të premtuar në emër të PS-së se ne tërhiqemi nga kauza jonë për transparencën e zgjedhjeve në qoftë se pretendimet tona nuk vërtetohen vetëm në një kuti të vetme, siç është Ruzhdija, të vura në dispozicion mandatin tim moral dhe politik. Pse nuk e bëni? Unë që i kam këto karta, i kam vërtetuar se cilët janë këta qytetarë, por për të ruajtur lirinë e tyre nuk po ua them emrat, as figurën...

(*Ka reagime nga deputetët e maxhorancës.*)

Këto janë qytetarë dhe qytetare shqiptare që s'kanë asnjë faj. Atëherë, po u them një gjë se këto që ju thashë dhe këto fytyra që paraqita e që kanë votuar nga dy-tri herë, janë në listën e zgjedhësve, janë qytetarë të afishuar kudo atje ku janë dhe janë votuesit tuaj.

Jozefina Topalli – Pse i detyruat që të iknin komisionerët?

Gramoz Ruçi – Hajde të ngremë një komision dhe t'i vërtetoj unë të gjitha këto.

Zoti Berisha, pas gjithë atyre që shtrova, ju bëj apel edhe një herë: kriza është e thellë, kriza është në politikë. Ajo duhet zgjidhur domosdoshmërisht. Ajo nuk zgjidhet me anë të anatemiëve, me mllafe, me procedura të zvarritura, ajo zgjidhet me vullnet politik, me mjete politike. Përvoja dhe eksperiencia nuk ju mungon. Në qoftë se ju mungon vullneti dhe dëshira, përsëri kjo përgjegjësi morale, politike,

institucionale do të bjerë mbi ju dhe vetëm mbi ju.

Falemnderit!

Jozefina Topalli- Falemnderit, zoti Ruçi!

Urdhëroni, zoti Kryeministër!

Sali Berisha – Zonja Kryetare,

Në retorikën e tij, zoti Ruçi shtroi shumë herë pyetjen: pse Serbia i mori vizat? Sepse kur Serbia arrestonte Legiat, Aldo Baret bënin ligjin në Shqipëri, sepse kur këto vende shkatërronin klanet, Nehati bënte ligjin në Veriun e Tiranës, e të tjerë dhe nuk po hyj në histori.

Së dyti, Shqipëria ka pasur një vonesë me dokumentet e identitetit, një reformë që ju nuk e bëtë dot në 8 vjet, ne e bëmë brenda 4 vjetëve.

Së treti, Serbia dhe serbët, maqedonasit dhe malazezët, kur shqiptarët vriteshin në kufijtë e tyre, lëviznin pa viza në të gjithë Europën. Europa e ka një memorie. Dokumentet që ju paraqitët këtu nuk kishin asnjë lloj intensioni tjetër vetëm të sulmonin integritetin e sistemit të lëshimit të kartave të identitetit. Një mesazh më thotë se ato janë fletë-hyrje për në kazinonë "Regency". Unë nuk e di se nuk kam qenë ndonjëherë në atë kazino. Ky person që më thotë, ta mbajë për vete nëse është ose nuk është. E rëndësishme është se çfarëdo fakti që të keni, zotëri, çojeni në prokurori që të bëjnë hetime. Mos u ktheni në partinë e Ruzhdies, se ju jeni Partia Socialiste? Zotëri, çfarë do të thotë kjo? Keni larguar komisionerët në mëngjes nga votimi duke e ditur se në vitin 2003, kur keni qenë në pushtet dhe keni pasur shumicën, rezultati ka qenë 366 vota për PD-në, 43 vota për PS-në. Në vitin 2005 ka qenë 345 vota për PD-në, 56 për PS-në. Në vitin 2007, në zgjedhjet vendore, ka qenë 469 vota për PD-në, 31 vota për PS-në. Edhe një herë u bëj thirrje autoriteteve gjyqësore, prokurorisë, që të hetojnë me seriozitetin më të madh çdo denoncim që kanë bërë forcat politike dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, sepse ju i larguat komisionerët pikërisht duke e ditur rezultatin. Unë mund t'ju them edhe skenarë të tjerë që ishin përgatitur mbi bazën e kësaj platforme, por komisionerët tuaj nuk i zbatuan urdhrat. Ka ekzistuar një skenar në të gjitha zonat e Tiranës, ku Partia Demokratike ishte në avantazh të madh, që të përsëritej Ruzhdija.

Të nderuar zotërinj, transparenca, integriteti i procesit të votimit është i bazuar në komisionet simetrike bipartizane. Megjithatë, ne nuk kemi përmendur kurrë se e morët mandatin nga Ruzhdija. Mandatin e caktoi gjykata, e cila nuk urdhëroi përsëritjet e zgjedhjeve si minimum, por zhvlerësoi

512 vota, duke bërë që një mandat të koalicionit tonë ta merrte njëri nga deputetët tuaj. Dhe nuk kemi bërë asnjë fjalë për këtë. Ky ishte vendimi i gjykatës.

I nderuar zotëri, më mirë merrni kartat e Regency-s dhe stilolapsat me videokamera dhe çoji në prokurori që të bëhet hetimi për to! Mos të bëjmë ne edhe ligjin, edhe vendimin. Unë nuk e di se çfarë do t'u thoni ju zgjedhësve që i keni sjellë para Kryeministrit për të protestuar për hapjen e kutive, kur nuk keni pasur një ligj. Ju mendoni se shqiptarët nuk kanë kulturë ligjore ose nuk kanë kulturë politike. Kultura e parë e tyre është politika. Dhe ta kesh të qartë se edhe ata që po më dëgjojnë mua, në Tomoricë, në Lekbibaj ose në Frashër, kudo që janë, janë me mua në këtë moment, pavarësisht nga bindjet partiake. Ju i keni ftuar me mijëra herë nëpër protesta, i keni sjellë përpara meje, përpara të tjerëve, pa ligj. Nuk bëhet kështu. Këto propozime t'i trajtojmë në Komisionin Ligjor, në përputhje me Kushtetutën, me vendimet e gjykatës, si dhe të tregojmë një vullnet të mirë e të ecim përpara.

Jozefina Topalli – Atëherë, do të votojmë në parim projektligjin "Për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative dhe organizimin e drejtësisë administrative". Do të votojmë edhe projektligjin tuaj, ne e mbajmë fjalën.

Po, zoti Ruçi.

Gramoz Ruçi – Ky është shembulli më i keq që po jepni edhe sot me këtë provokacioni që i bëni opozitës. Shiheni pak tabelën! Sapo e ndryshove. Deri tani unë dhe zoti Berisha paskemi rrahur ujë në havan për sa i takon diskutimit. Ne po diskutonim për tjetër gjë, pikërisht për atë që do të votonim, për atë me të cilën ramë dakord. Pra, po të them që mos bëj provokacione të tilla në seancën e Parlamentit se këto nuk të shkojnë. Ne e dimë fort mirë se ç'është thotë miratimi i atij projektligji dhe jo vetëm i tij, por edhe i shumë projektligjeve të tjera. Dhe kur themi krizë, një nga arsyet është pikërisht edhe kjo. Krizën dhe përgjegjësinë tuaj mos kërkon ta transferoni para publikut shqiptar tek opozita. Po ju bëj apel: miratoni projektvendimin! Në qoftë se nuk e votoni, vazhdoni seancën, mos na thërrisni këtu sipas marrëveshjes që bëmë! Ne po ju kërkojmë pushim. Kur të vijë radha e atij projektvendimi, ne jemi në sallë.

Jozefina Topalli - Zoti Ruçi, jua thashë edhe më parë se projektligji juaj do të votohet. Kemi vendosur në Konferencën e Kryetarëve që projektligji do të votohet. Nuk doni të votoni projektvendimin që keni propozuar?

Zoti Ruçi edhe një herë, unë nuk i ndryshoj fjalët. Ajo që është vendosur në Konferencën e Kryetarëve do të zbatohet dhe projektvendimi do të votohet.

(Flet nga vendi zoti Dokle.)

Zoti Dokle, nuk jam duke folur me ju. Uroj që t'ju kem zëvendëskryetar të Parlamentit, që të punojmë së bashku.

Zoti Ruçi më përmend çështje procedurale. Te pika 2 është shënuar që shqyrtimi i projektligjit në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën, Publike dhe të Drejtat e Njeriut të bëhet brenda datës 16.03.2010. Dëshiron të shkruhet që puna fillon nga dita e hënë, se data 16 mars nënkupton zbatimin e Rregullores 48 orë përpara futjes në seancë plenare? Se duhet të jemi korrektë. Të mos abuzojmë me një gjë për të cilën janë kapërcyer të gjithë kufijtë në koncesione. Doni të caktojme datën 8 mars?

Fjalën e ka zoti Rusmali.

Ilir Rusmali – Zonja Kryetare, ky vendim e parashikon fillimin e punës nga dita e hënë, sepse seanca e parë që kemi është ajo e ditës së hënë. Nuk besoj se ka ndonjë pretendim komisioni që të na kërkojë të punojmë ditën e diel.

Jozefina Topalli – Unë e kuptoj, por meqenëse e shtruan, nuk kam asnjë ngurrim për të vendosur datën 8 mars. Unë kam vendosur të pranoj një kërkesë mbi draftin. E kuptoni? Kërkesë mbi draft! E paimagjinueshme!

Urdhëroni, zoti Ruçi!

Gramoz Ruçi - Të mos bëjmë sikur nuk i kuptojmë dhe sikur nuk i dëgjojmë pretendimet ose justifikimet e njëri-tjetrit. Data 16 mars është një procedurë që e përcakton Rregullorja, që 48 orë përpara komisioni përgjegjës duhet t'ua dorëzojë deputetëve. Kjo është për një rast të zakonshëm, për një ligj të zakonshëm, për një procedurë të zakonshme. Kjo nuk është një situatë e zakonshme, është një emergjencë, është një procedurë e përshpejtuar. Ky Parlament nuk e ka për herë të parë procedurën e përshpejtuar, por një gjë e ka për herë të parë për procedurën e përshpejtuar: nga procedurë e përshpejtuar bëhet procedurë e thjeshtë, duke kaluar 3 javë. Nga procedura e përshpejtuar kërkohen amendamente për amendamentin e procedurës së përshpejtuar. Nga procedura e përshpejtuar i kërkohet mendim Komisionit të Ligjeve që, ke kohë ta bësh apo nuk ke kohë. Ky është vullneti i Parlamentit. Në qoftë se Parlamenti vendos, e pezullon të gjithë programin e komisionit ose të Parlamentit dhe e diskuton këtë.

Ky është vullneti i Parlamentit, kjo është Rregullorja dhe në Rregullore thuhet sesi operohet. Ajo thotë: "Procedurë e përshpejtuar, por jo më pak se një javë". Kurse ju komisionin e çoni në 2 javë, nga dy ditë. Seancën e çoni tri javë, kur unë në Konferencën e Kryetarëve dhe këtu në seancë ju kërkova që t'i fusnim sot dhe të enjten që vjen t'i diskutonim.

Jozefina Topalli – Dakord.

Po, zoti Rusmali, urdhëroni!

Ilir Rusmali – Zonja Kryetare,

Ne nuk kemi pse të luajmë me Rregulloren. Ai është vullneti më i madh se çdo lloj kompromisi, është vullneti afatgjatë i Parlamentit dhe qëndron në kohë më shumë sesa një legjislaturë. Kur thuhet që Rregullorja përcakton një minimum të mundshëm, pra, një javë për të shqyrtuar çështjen, do të thotë se komisioni nuk mund ta kalojë atë pa një javë. Ajo do kohën e vet të domosdoshme për ta trajtuar çështjen. Çdo gjë tjetër është në kundërshtim me Rregulloren, sepse jo vetëm që është e padrejtë, por është edhe manipulative. Projektligji nuk imponohet. Projektligji i jepet komisionit që ta shqyrtojë dhe ta debattojë atë.

Komisioni ka një javë në dispozicion, jo më shumë. Madje ta çojmë edhe më pak, sepse në kushtet e punës së vet normale ka vetëm tri seanca në dispozicion për të shqyrtuar dhe për të debatuar një projektligj që nuk është i thjeshtë dhe i parëndësishëm. Kështu që seanca plenare e radhës është seanca e datës 18 dhe nuk ka mundësi që të zhvillohet ndryshe.

Projektvendimi është shumë korrekt dhe i respektin pikë për pikë afatet e domosdoshme minimale që përcakton Rregullorja e Kuvendit. Të mos e shkelim Rregulloren e Kuvendit me vullnet politik, sepse nuk është shembulli më i mirë që mund të japim dhe nuk është shembulli i mirë për seancën e parë të debatit në këtë legjislaturë për opozitën.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Rusmali!

Natyrisht, nuk më shkon në mendje të shkel Kushtetutën, për t'u mohuar deputetëve të drejtën e tyre për paraqitjen e amendamenteve. Ajo është një e drejtë kushtetuese, jo vetëm e Rregullores. Meqenëse u shtrua çështja e procedurave, unë dua t'ju bëj të ditur se në Konferencën e Kryetarëve, kur u paraqit kërkesa për ngritjen e komisionit hetimor, i kam kërkuar zotit Ruçi që të votohet sot në këtë seancë parlamentare dhe zoti Ruçi më tha: "Jo, zonjë". Në fakt, unë mbeta e befaspur dhe nuk po

kuptoja më asgjë. Kishin 6 muaj që kërkonin ngritjen e komisionit hetimor dhe kur u thamë po, sot në datën 4 mars, do ta votojmë ngritjen e komisionit hetimor, ai më thotë: “Jo, komisionin hetimor do ta ngremë pasi të ndryshohet ligji, sepse nuk ka ligj për komision hetimor”. Ndaj është mirë që të jemi të ndershëm dhe t’i themi gjërat ashtu siç janë. Në qoftë se në pikën 2 kërkon të shtohet që ditën e hënë të fillojë shqyrtimin e këtij projektligji komisioni, jemi dakord të bëhet deri në datën 16, në mënyrë që të mos abuzohet.

Po, zoti Patozi, urdhëroni!

Astrit Patozi – Falemnderit, zonja Kryetare!

Unë po përpiqem që t’i jap një koncesion tjetër opozitës dhe do të propozoj që ta heqim datën e shqyrtimit në komision, pra, të mos jetë data 16. Por përsëri me datë 18 do ta shqyrtojmë, sepse kështu ka vendosur Konferenca e Kryetarëve.

Unë mendoj se i gjithë ky debat është absurd, sepse ne sot duhet të diskutonim vetëm për procedurën dhe jo për thelbin apo përmbajtjen e projektligjit që ka prezantuar Partia Socialiste. Por meqenëse zoti Ruçi e hapi debatin, sigurisht që ne do t’i përgjigjemi. Është e vërtetë se në Konferencën e Kryetarëve kemi rënë dakord për datën 18; është e vërtetë që kemi kërkuar menjëherë që sot të trajtojmë ngritjen e komisionit hetimor, e cila ishte një kërkesë gjashtëmujore e opozitës dhe ka qenë këmbëngulja e panegociueshme e zotit Ruçi që na shtyu që të gjejmë datën më të afërt për trajtimin e projektligjit dhe pastaj të projektvendimit për ngritjen e komisionit hetimor.

Pra, edhe në rast se ne do ta heqim fare datën e shqyrtimit në komision, Rregullorja kërkon kohën e vet për shqyrtimin e çdo projektligji dhe të çdo projektvendimi, por për t’ju hequr çdo lloj merak, po ju themi se nuk kemi aspak ndër mend ta zvarrisim, madje kemi qenë të prirur për t’i trajtuar që sot nismat ligjore të Partisë Socialiste.

Pra, unë do të ftoj edhe një herë Grupin Parlamentar të Partisë Socialiste që të pranonte debatin, dialogun dhe komunikimin për ta përmirësuar projektligjin dhe projektvendimin që ka sjellë në Parlament, duke pasur parasysh që ne mund të lëshojmë kudo, por jo te Kushtetuta, te vendimet e gjykatave dhe te rregullat e shtetit ligjor.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Patozi!

Zoti Rusmali, urdhëroni!

Ilir Rusmali – Zonja Kryetare,

Elementet përbërës të këtij projektvendimi që

janë këtu, janë elemente që përcaktohen nga Rregullorja. Rregullorja kërkon që të përcaktohet jo vetëm afati për shqyrtim në seancë plenare, por edhe afatet për përcaktimin e komisioneve përgjegjëse, afatet për shqyrtim në komision dhe afatet për paraqitjen e amendamentit.

Në qoftë se kolegët kanë konsensusin e nevojshëm, ne mund ta riformulojmë pikën 2 duke thënë që shqyrtimi në komisionin përgjegjës, që është Komisioni i Ligjeve, fillon jo më vonë se ditën e hënë dhe mund ta mbyllim me kompromis këtë gjë. Pjesa tjetër është pikë për pikë e Rregullores dhe nuk ka vend për të debatuar.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Rusmali!

Unë jam plotësisht dakord, sepse mënyra sesi është shkruar nënkupton që ditën e hënë Komisioni i Ligjeve fillon diskutimin e saj. Pra, le ta vendosim datën e caktuar. Nga data 16, ditën e hënë deri më datë 18, i bie 48 orë, Komisioni i Ligjeve do të përfundojë të gjitha ndryshimet. Data 18 është e vendosur dhe nuk ndryshon, pavarësisht nga përmbajtja. Kjo është vetëm ana procedurale, sepse përmbajtja është çështje tjetër.

Po, zoti Ruçi, urdhëroni!

Gramoz Ruçi – Do të kërkoja që të mos i shtrembërojmë ato që kemi diskutuar, ose më mirë gjithsecili le të paraqesë mendimet e veta. Ajo që kam deklaruar në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve ka qenë kjo: “Dy nismat tona (në esencë nuk janë dy, por një), nuk kanë boshllëk ligjor”. Jo. Shtrohet pyetja: Po pse bëhet? Për dy arsye:

E para, me që ka interpretime të ndryshme nga palët, le të vendoset një standard për të gjitha llojet e zgjedhjeve, në të gjitha kohërat.

E dyta, ajo që thuhet politikisht (që të jepet shumica), të jepet me ligj si për sot, edhe për nesër. Pra, ajo që kam kërkuar në Konferencën e Kryetarëve dhe që parashtrij këtu është që nisma, amendimi i ligjit organik për komisionet hetimor është kompromentuar me vendimin, me kërkesën, me projektvendimin për ngritjen e komisionit hetimor. Ajo që kam kërkuar është që si sot një javë të diskutoheshin amendimet dhe pas një jave, që i binte data 18, të ngrihej komisioni hetimor. Pra, unë jam brenda Rregullores dhe jo siç thuhet këtu që nuk ka hapësira Rregullorja.

Procedura e përsheptuar thotë fjalë për fjalë: “Të gjitha hapësirat janë brenda javës, por jo më pak se një javë”. E përcakton dyshtemenë jo më pak se një javë. Tavanin mund ta lësh.

Pra, ju nuk kishit predispozicionin as në konferencë dhe as këtu, sot, që ta diskutoni të enjten tjetër, që do të thotë se komisionet duhet të nisnin punën me emergjencë dhe në seancën tjetër, ditën e enjte, të diskutohet ky problem po të keni vullnetin e preokupimit për ta zgjidhur këtë krizë. Por, sigurisht nuk e keni.

Unë përsëri ju bëj apel. Nuk është punë procedurash, as datash, por është punë vullneti, është punë dëshire. Zgjidheni, sepse, në radhë të parë, do t'i bëni shërbimin vendit e në radhë të dytë edhe vetes! Në qoftë se jo, do t'i bëni shërbim më të keq vendit dhe po kaq keq edhe vetes suaj.

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Ruçi!

Konferencën e Kryetarëve e kam drejtuar unë dhe është e vërtetë që ju kështu keni thënë siç thoni sot, vetëm se keni gjetur një fjalë të bukur, thoni fjalën “procedurë” dhe nuk thoni fjalën “Kushtetutë”. Në fakt, kjo ka lidhje me Kushtetutën, sepse ju e dini që një kërkesë për ngritjen e komisionit hetimor bazohet në një ligj. Por jo një ligj që mund të bëhet pas një jave apo pas dy javësh. Ju keni 20 vjet deputet, ka edhe të tjerë që kanë po kaq vite, unë kam 15 vjet që jam në Parlament, ndaj më thoni një rast kur është bërë një kërkesë për ngritje komisioni në një ligj që nuk ekziston! Këtë më thoni! Përndryshe, do ta kishim ngritur që sot komisionin hetimor.

Unë ju thashë: “bazuar në ligjin ekzistues nr. 8891 për komisionet hetimore, projektligji hyn në fuqi menjëherë. Ju më thoni: jo, s’ka ligj.

Po pse keni protestuar 6 muaj rresht, kur nuk ka ligj dhe Kushtetutë, që të pranoni atë kërkesë? A mendoni për ata socialistë që i keni gënjyer 6 muaj rresht? Ju nuk mund t’u keni kërkuar kurrë të falur, zotëri, por ka një ndërgjegje shoqërore dhe politike. A e kuptoni këtë? 6 muaj rresht keni gënjyer. Sillni kërkesën për komisionin hetimor sipas ligjit ekzistues, është e drejta e pakicës, do ta votojmë sot. Ja ku jemi të gjithë. E votojmë sot, sipas ligjit ekzistues. Por ju thoni: jo, se nuk ka ligj.

Zoti Ruçi, ne e kemi vendosur. Kam thënë “po”, duke shkelur mbi Rregulloren që më lejonte ta ktheja mbrapsht dhe t’u thosha: merreni mbrapsht kërkesën, edhe në qoftë se do të ndryshohej ligji, sepse kështu bëhet. *(Ndërhyrje nga salla)* Po, pra,

do ta shtyni ju, jo unë, sepse ju e keni sjellë, me 35 firma. Po ju nuk jeni në gjendje të më thoni nëse ka ndodhur ndonjëherë kjo në 20 vjet. Më thoni vetëm një rast!

Atëherë, me ndryshimin që tha zoti Rusmali, duke vendosur datën 16 si datën e fundit, ku data e fillimit do të jetë data 8, kalojmë në votimin e projektvendimit “Për shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8891, datë 2.05.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”.

Në mbështetje të neneve 78 pika 1, 83, pika 2 të Kushtetutës dhe nenit 28 pikat 1, 3, 4 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë vendosi:

1. Të shqyrtojë me procedurë të përshpejtuar projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8891, datë 2.05.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”.

2. Shqyrtimi i projektligjit në komisioni përgjegjës, në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, të bëhet duke filluar nga data 8 mars deri në datën e fundit 16 mars.

3. Paraqitja e amendamenteve pranë komisionit përgjegjës të bëhet deri në datë 11 mars, shqyrtimi në seancë plenare të bëhet ditën e enjte, datë 18.03.2010.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

125 vota pro. Nuk ka kundër. 3 abstenime. 6 deputetë nuk morën pjesë në votim.

Kuvendi miraton projektvendimin “Për shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar të projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8891, datë 02.05.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, ku caktohet data 18.03.2010 për diskutimin e tij në seancë plenare.

Falemnderit për bashkëpunimin!

Natën e mirë!

Mirupafshim!

(Seanca u mbyll në orën 21:00.)

E enjte, 11.03.2010
Seanca e pasdites, ora 17:00

Drejton seancën Kryetarja e Kuvendit,
zonja Jozefina Topalli (Çoba)

Rendi i ditës:

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').

2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare datë 04.03.2010.

3. Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Operatorit të Sistemit të Transmetimit, sh.a., si agjencia e zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt am Mein për financimin e projektit "Linja e transmetimit 400 kw Shqipëri-Kosovë (Tiranë-Prishtinë), nëpërmjet një huaje prej 42.000.000 eurosh".

4. Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Operatorit të Sistemit të Transmetimit, sh.a., si agjencia e zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt am Mein për financimin e projektit "Linja unazore 110 kw e Shqipërisë së Jugut", nëpërmjet një huaje prej 37.750.000 eurosh".

5. Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Operatorit të Sistemit të Transmetimit, sh.a., si agjencia e zbatimit të projektit, dhe KfW për financimin e projektit "Linja unazore 110 kw e Shqipërisë së Jugut", nëpërmjet një huaje prej 10.750.000 eurosh".

6. Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Operatorit të Sistemit të Transmetimit, sh.a., si agjencia e zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt am Mein për financimin e projektit "Linja unazore 110 kw e Shqipërisë së Jugut", nëpërmjet një huaje prej 500 000 eurosh".

7. Projektligji "Për disa shtesa në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore".

8. Projektligji "Për gjuetinë".

9. Projektligji "Për shtyrjen e afatit të qëndrimit të kompanisë së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në misionin "MINURCAT" të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në

Republikën e Çadit dhe në Republikën e Afrikës Qendrore".

10. Projektrezolutë "Për liberalizimin e vizave me Bashkimin Europian".

Jozefina Topalli – Hapim seancën.

(Pasi lexon rendin e ditës)

Zoti Nishani, urdhëroni!

Bujar Nishani – Falemnderit, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kërkova të marr fjalën në këtë kohë diskutimesh, për të prezantuar përpara jush një rezultat të rëndësishëm të implementimit të njërit prej hapave të rëndësishëm të reformës së ndërmarrë nga Qeveria shqiptare në fushën e drejtësisë. Një nga prioritetet e kësaj Qeverie në këtë fushë ka qenë reforma në sistemin penitenciar, i cili është fokusuar si në aspektin e rritjes së sigurisë, ashtu edhe në atë të respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut. Në këtë objektiv, prej kohësh ka nisur zbatimi i shërbimit të provës përmes dënimeve alternative, implementimi i të cilave ka sjellë një risi në shërbimin penitenciar, duke krijuar standarde europiane në procesin e riintegritimit në shoqëri të personave të dënuar, por edhe në uljen e mbipopullimit në burgjet tona, duke lejuar kështu përmirësimin e mëtejshëm të kushteve të jetesës së atyre që vuajnë dënimin brenda institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale.

Të nderuar kolegë deputetë, dëshiroj t'ju informoj se për periudhën qershor 2009-shkurt 2010 kanë përfutuar dënime alternative nën mbikëqyrjen e shërbimit të provës 1053 të dënuar. Për secilin prej tyre zbatohet një program individual i mbikëqyrjes. Implementimi i dënimeve alternative është i natyrave të ndryshme. Kështu, 852 persona kanë marrë pezullimin e dënimit me burgim nga gjykatat, duke qenë gjatë gjithë kohës nën kontrollin e shërbimit të provës pranë familjeve të tyre; 78 persona kanë përfutuar pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burg dhe detyrimin të kryejnë një punë me interes publik; 107 persona kanë përfutuar lirimim me kusht; 15 persona kanë përfutuar largimin nga qendra e vuajtjes së dënimit dhe vazhdimin e dënimit me qëndrim në shtëpi, si dhe një person vazhdimin e vuajtjes së dënimit me gjysmë lirie.

Natyrisht, kjo i takon kategorisë që e lejon ligji,

që do të thotë se nuk janë persona të dënuar për vepra të rënda, apo edhe të atyre personave që e kanë kryer pjesën më të madhe të dënimit. Mbikëqyrja nga shërbimi i provës për këto kontingjente varion nga 18 muaj deri në 5 vjet. Nga ana tjetër, ky proces ka krijuar uljen e numrit të të dënuarve në burgje, duke lejuar më shumë hapësira në infrastrukturën që ne kemi në dispozicion të pjesës që vazhdon vuajtjen e dënimit në burgjet shqiptare.

Solla një shembull të implementimit të suksesshëm të shumë hapave reformues, që janë marrë gjatë viteve të fundit në fushën e drejtësisë; solla një shembull që tregon suksesin e implementimit të një vullneti politik, të vullnetit të kësaj maxhorance qeverisëse për të sjellë standardin e institucioneve tona në standardet evropiane, vullnet politik, i cili ka bërë që ky vend të ndryshojë dita-ditës, vullnet i cili nuk mund të futet në kolaps nga interesa individësh politikë me synim të qartë obstruksionist, vullnet politik që nuk do të mundet të bllokohet nga asnjë sjellje parapolitike dhe ekstremiste, vullnet politik për të cilin kam bindjen se do të vazhdojë të jetë triumfues, për sa kohë që qytetarët shqiptarë do të vazhdojnë të mbështesin fort këtë vullnet politik, për sa kohë do të shohin te produkti i këtij vullneti politik jetësimin e kërkesave dhe pretendimeve të tyre për jetën.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Nishani! Fjalën e ka zoti Osman Metalla.

Osman Metalla - E nderuar zonja Kryetare, Të nderuar kolegë deputetë,

Me gjithë vështirësitë e mëdha financiare që kaloi e gjithë bota, në veçanti vendet evropiane gjatë vitit 2009, vendi ynë vazhdoi të kishte një stabilitet të qëndrueshëm makroekonomik, i cili u reflektua edhe në atë rritje ekonomike, që, së paku sipas vlerësimeve të FMN-së, ka qenë me një rritje prej 3%, rritja më e lartë në të gjitha vendet e rajonit.

Delegacioni i Fondit Monetar Ndërkombëtar u shpreh optimist edhe për periudhën në vazhdim, duke theksuar së gjatë vitit 2010 vendi ynë pritet të vazhdojë të ketë rritje ekonomike në nivele të kënaqshme.

Dje Kryeministri Berisha, në mbledhjen e Qeverisë deklaroi se kjo qeverisje do të vazhdojë të ngrrejë pagat, duke shkuar në këtë mënyrë drejt përmbushjes së atij premtimi që kjo maxhorancë u bëri qytetarëve shqiptarë në fushatën elektorale të vitit të kaluar. Pavarësisht faktit se gjatë qeverisjes

kjo maxhorancë është përballur më probleme jo të pakta, siç është kriza ekonomike botërore, e cila pa dyshim nuk është se nuk ka pasur asnjë pasojë në ekonominë shqiptare, përmbytjet e mëdha që patëm në zonën e Nënshkodrës dhe në zona të tjera, ose rrëshqitjet e dheut në zonën e Kavajës, Librazhdit etj; përsëri kjo qeverisje i është gjendur pranë çdo qytetari dhe i është përgjigjur, si dhe ka përballuar me shumë përkushtim të gjitha këto probleme. Për më tepër, kjo qeverisje që në ditën e parë të punës së mandatit të dytë të saj ka punuar duke përballuar edhe shkopinjtë që zoti Rama është munduar t'i vendosë nën rrota kësaj Qeverie, duke mos qenë aspak bashkëpunues, por duke e mbajtur vendin peng të kutive.

Kanë kaluar 8 muaj nga zgjedhjet e vitit të kaluar dhe opozita shqiptare, e kryesuar nga zoti Rama, kryefjalë të saj ka pasur vetëm kuditë. Ka 8 muaj që opozita jonë e nderuar ecën duke e mbajtur kokën prapa. Por a mund të ecet me kokën pas? Natyrisht që po, por në çdo hap rrezikon gremisjen dhe kjo është ajo që zoti Rama po i bën sot opozitës, po e gremis, kjo është ajo që zoti Rama po i bën pothuaj gjysmës së shqiptarëve që votuan për të, po u mohon arbitrarisht të drejtën më esenciale të demokracisë, atë të përfaqësimit të tyre në Kuvendin e Shqipërisë. Kjo u duk shumë qartë edhe në seancën e javës së kaluar, kur opozita solli amendimet për ndryshimin në ligjin "Për komisionet hetimore". Qytetarët shqiptarë e kuptuan se zoti Rama e paska pasur të qartë se nuk kishte asnjë të drejtë ligjore të kërkonte hapjen e kutive dhe se deri tani ai është tallur me ndjenjat e qytetarëve shqiptarë, për gjoja transparencë të zgjedhjeve, pasi fakti që kërkon të krijojë tani këtë hapësirë ligjore do të thotë se gjithçka që ai ka bërë deri tani ka qenë e paligjshme, ka qenë e padrejtë, ka qenë e pandershme. Ai mendoj se do të merrte peng Kuvendin me bojkotin e tij të paligjshëm, por në fakt gaboi. Ai mendoj se me bojkotin e tij do të ndikonte në reformat integruese të vendit, por gaboi.

Në fakt, zoti Rama bëri të pamundurën që qytetarët shqiptarë të mos përfitonin liberalizimin e vizave dhe a e dini përse? Sepse ai u trembet zgjedhjeve, ai ka frikë të përballët me votën e qytetarëve. Ai e demonstroi këtë fobi në zgjedhjet vendore, duke kërcënuar me bojkot, duke bërë në këtë mënyrë shtyrjen e zgjedhjeve vendore të tetorit 2006 për në shkurt të vitit 2007. Të njëjtën fobi nga zgjedhjet zoti Rama e shfaqti edhe në zgjedhjet e vitit 2009, ku përsëri kërcënoi me bojkot.

Në të njëjtën kohë, një vit më parë, zoti Rama ngriti shqetësimin e kartave. Në një kohë kur Qeveria u bënte thirrje qytetarëve shqiptarë të pajiseshin me karta, zoti Rama nuk e bëri qoftë dhe një herë të vetme një gjë të tillë, duke fërkuar duart dhe shpresuar që ky proces të dështonte. Por nuk ndodhi, procesi eci mjaft mirë dhe qytetarët u pajisën me karta dhe zgjedhjet, si asnjëherë tjetër, u zhvilluan me infrastrukturën më të mirë që ne kemi pasur ndonjëherë.

Tani që qytetarët shqiptarë po pajisen masivisht me karta dhe njëkohësisht me pasaporta biometrike, na vjen turpi i radhës. Thuhet se kartat e identitetit janë falsifikuar. Asnjë qëllim nuk kanë të gjithë këto trillime, përveç njërit; pengimit të procesit të liberalizimit që zotit Rama i është transformuar në fobi nga zgjedhjet. Janë pikërisht këto dokumente të identifikimit, si kartat e identitetit, pasaportat biometrike, si dhe standardet e tjera: forcimi i kontrollit në pikat e kalimit të kufirit, lufta kundër trafikëve etj., që po e çojnë vendin drejt liberalizimit të vizave, proces që me sa shihet është në rrugë të mbarë.

Një pjesë të opozitës, veçanërisht zotin Rama, i tmerron vendimi për liberalizimin e vizave, pasi në filozofinë e tyre ata e kanë të qartë se këtë popull baballarët e tyre arritën ta mbajnë nën tutelë për 50 vjet, vetëm duke e mbajtur të izoluar, duke e mbajtur në terr, prandaj kanë bërë çdo përpjekje për ta penguar këtë proces. Tani që ky proces po ndodh, ata ndihen më të humbur se kurrë. Por jam i sigurt se qytetarët shqiptarë nuk do t'ia falin një gjë të tillë zotit Rama, nuk do t'ia falin që për një vit i tërë potenciali politik i tij u shkarkua vetëm për të nxirë çdo realitet shqiptar, për ta paraqitur vendin tonë në sytë e ndërkombëtarëve si një vend me demokraci jofunksionale, vetëm e vetëm që këto procese integruese të bllokoheshin, duke u munduar që zgjedhjet e 28 qershorit t'i paraqiste si zgjedhje me probleme të mëdha, kur në fakt nuk kanë qenë të tilla.

Unë do të doja ta pyes zotin Rama: kur ndonjëherë janë zhvilluar zgjedhje më të mira në Shqipëri se këto zgjedhje? Mos vallë ishin zgjedhjet më të mira ato të vitit 2000 apo zgjedhjet politike të vitit 2001? Mos ishin më të mira zgjedhjet e vitit 2003 apo zgjedhjet e vitit 2005? Me cilat zgjedhje mund të krahasohen këto zgjedhje, të cilat me të vërtetë ishin ashtu siç i certifikoi dhe raporti i OSBE-ODIHR-it, si zgjedhjet më të mira të zhvilluara në vend?

Opozita nuk bëhet duke nxirë, por duke kontribuar, demokracia nuk ndërtohet me bojkot, por me pjesëmarrje. Nëse vërtet kërkohet të vendoset një gur tjetër në ngritjen e ngrehinës së demokracisë, ja ku është vendi për të ndërtuar. Nëse jo, të gjitha veprimet e tjera të zotit Rama dhe të opozitës së tij janë veprime dështake, të cilat i paraprijnë dhe dështimit të madh në zgjedhjet e ardhshme.

Falemnderit!

Jozefina Topalli- Falemnderit, zoti Metalla! Fjalën e ka zoti Genc Pollo.

Genc Pollo – Falemnderit, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Projekti dhe premtimi i madh i maxhorancës është që të ndërtojmë gjithandej në vend rrugë që lidhin qytetet me qytetet, qytetet me fshatrat, fshatrat me fshatrat, me rrugë kombëtare të mëdha e dytësore, që i përshkojnë të gjitha krahinat e vendit, dhe kjo ka qenë arritja e madhe gjatë 4 vjetëve të shkuar. Çdo shqiptar që ka dalë nga shtëpia e tij dhe ka udhëtuar për në qytetin më të afërt, ose për në Tiranë është dëshmitar i kësaj arritjeje dhe ka ndjerë leverdinë në kohë, por dhe në xhepin e tij. Kjo është normale se me atë që na la regjimi i kaluar, që nuk ndërtonte autostrada nga frika e uljes së avionëve armiq, mbetet jashtëzakonisht shumë për të bërë, pavarësisht se është bërë punë, në mënyrë të veçantë në 4 vjetët e fundit.

Vizita e Kryeministrit të Republikës sot në Elbasan, prezantimi i projektit të rrugës që lidh kryeqytetin me Elbasanin, segmenti i parë i boshtit të Jugut, është një tjetër dëshmi për këtë. Unë nuk doja të flisja për rrugët kombëtare, por për rrugët dytësore dhe lokale, të cilat, përveçse me grantin konkurrues që e administrojnë qarqet, bashkitë dhe komunat, gjithashtu i ndërton edhe një organ autonom i ngritur nga Qeveria 17 vjet më parë, pra nga Qeveria e parë e Partisë Demokratike, organ quajtur Fondi Shqiptar i Zhvillimit, i cili vitet e fundit ka qenë jashtëzakonisht i suksesshëm. Përveç investimeve nga buxheti i shtetit, ka marrë financime nga donatorë të shumtë falë një pune të mirë, përgatitje teknike cilësore, konsultim të vazhdueshëm me pushtetin vendor, plane afatgjata, sidomos përgatitje në avancë, përgatitje që përpara të projekteve të detajuara cilësore inxhinierike, çka të gjithë donatorët e kanë një kusht *sine qua non* për financimet e tyre, grante ose kredi të buta. Bashkëpunimi i mirë i Fondit me pushtetin vendor ka qenë gjithashtu kyç në suksesin e tij.

Në administratën e Fondit kanë një database të plotë të 3 mijë e 500 kilometrave rrugë me të dhënat tekniko-ekonomike që shërbejnë për të përcaktuar mirë prioritetet e investimeve.

Financimi i parë që është drejt përfundimit, gjithmonë për projektin rrugë dytësore dhe lokale kap vlerën 107 milionë dollarë dhe iu dha Qeverisë shqiptare në formë granti dhe huajeje të butë.

Financimi i dytë, i cili është miratuar nga Qeveria (shpresoj që javën e ardhshme të ratifikohet në këtë sallë), është me vlerë 180 milionë dollarë.

Financimi tjetër, i tretë, që është negociuar dhe pritet të formalizohet, kap vlerën prej 420 milionë dollarësh. Pra, në këtë mënyrë po realizojmë programin tonë që parasheh ndërtimin e 1 mijë e 500 kilometrave rrugë rajonale dhe lokale, kostoja e të cilit është afro 400 milionë dollarë.

Të nderuar kolegë,

Do të doja të lexoja listën e rrugëve që është realizuar ose po realizohet me financimin e parë. Kjo është një listë që dikujt mund t'i tingëllojë e mërzitshme, por jo deputetëve që janë votuar me një mandat për të zhvilluar infrastrukturën rrugore. Unë besoj se edhe për komunitetin, publikun që na ndjek, një listë e tillë është me interes, aq më tepër kur do të vijojnë dy të tjera, përkatësisht me financimin e dytë dhe të tretë. Po të ishte edhe opozita në sallë, besoj se edhe ajo do të ishte e interesuar për këto, të paktën do të arrinte të kuptonte dallimin midis të bërit punë dhe të bërit llafe.

Atëherë, po filloj me qarkun e Beratit për arsye alfabetike, jo për ndonjë favor, dhe po përmend rrugën e Goricës- fshati Mbreshtan me 7,8 kilometër, dhe rikonstruksioni i rrugës Mbreshtan- Sinjë 10.1 kilometër.

Në qarkun e Durrësit kemi rrugën Shijak-Maminas 5 kilometër, Bupq- Ishëm 13,4 kilometër, Xhafzotaj-bregdet 10,6 kilometër.

Në qarkun e Dibrës kemi rrugën Gryka e Gobanit-Përroi i Kapsit 9,8 kilometër, Përroi i Kapsit-Vleshë 12 kilometër dhe Vleshë-Vasie 12,5 kilometër, si dhe ura e qytetit-Zerqan 6,3 kilometër.

Në qarkun Elbasan: rruga Belsh-Fierzë 9,2 kilometër, rruga Fierzë-Kosovë 6,5 kilometër, rruga Urak-Golikë 8,6 kilometër.

Në qarkun Fier: rruga Strum-Qafë e Marinzës 12,6 kilometër, Sheq-Marinzë 15,7 kilometër, Ballsh-Aranitas 6,7 kilometër.

Në qarkun Gjirokastrë kemi rrugët Valare-Erind 5,3 kilometër, Erind-Çajup 10,1 kilometër dhe Asim

Zeneli-Antigonea 7,5 kilometër.

Në qarkun Kukës kemi dy rrugë, rrugët Domaj-Ura e Lapave 11,5 kilometër dhe Ura e Lapave-Bushtricë 7,2 kilometër.

Në qarkun e Korçës kemi rrugët Koritë-Liqenas 10 kilometër dhe Podgorie-Koritë 10.5 kilometër.

Në qarkun e Lezhës kemi rrugët Lezhë-Kallmet 12,8 kilometër, Kallmet-Nenshat 8,7 kilometër dhe rrugën Lezhë-Rrilë 4,6 kilometër.

Në qarkun e Shkodrës bëhet fjalë për rrugët Vermosh-Doganë 7,7 kilometër, Vau i Dejës-Nenshat 11,8 kilometër.

Ndërsa në qarkun e Tiranës kemi dy rrugë nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, rrugët Farkë-qendër e fshatit Farkë 6,5 kilometër dhe Qendër-Mustafa Koçaj 8,4 kilometër.

Rruga nacionale deri në Prezë prej 3,2 kilometër është projekti i tretë.

Në qarkun e fundit, atë të Vlorës janë rrugët Xarë-fshati Pllakë 10,9 km në rrethin e Sarandës dhe rruga e fshatit Pllakë-Çukë 11,5 km, në të njëjtin rreth, si dhe në rrethin e Vlorës rruga nga Sevasteri-Kalivaç 9,4 kilometër.

Falemnderit!

Jozefina Topalli - Falemnderit!

Fjalën e ka zoti Selami Xhepa.

Selami Xhepa – Falemnderit, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Doja ta merrja fjalën për dy-tri zhvillime në fushën e ekonomisë që kanë ndodhur ditët e fundit dhe që besoj se kanë tërhequr edhe vëmendjen e opinionit publik shqiptar.

Së pari, diskutimet që lidhen me autoritetet e FMN-së, të cilët edhe një herë konfirmuan faktin se Shqipëria ishte ndër të paktat vende që ruajtën rritjen pozitive ekonomike dhe një perspektivë e tillë do të ruhet edhe për vitet në vazhdim. Vizitat e FMN-së në vendet anëtare këto kohët e fundit janë shpeshtuar. Programet masive antikrizë me shkurtime taksash dhe me rritje të investimeve publike sigurisht që i zbutën efektet negative të krizës në prodhim dhe në punësim. Por këto programe i çuan deficitet fiskale dhe borxhet publike në nivele të papara ndonjëherë, duke rrezikuar një dështim serioz në aftësinë paguese të qeverive.

Rreziku më eminent i botës sot është kriza e borxheve qeveritare dhe në veçanti ky është një rrezik serioz për fqinjin tonë të Jugut, Greqinë, me një borxh prej 110% të prodhimit të brendshëm kombëtar dhe me deficit fiskal rreth 13%. Nevoja për korrektim imediat të pozicionit fiskal përhap frikë në tregjet

botërore dhe në ato europiane, si dhe ringjalli zemërim brenda vendit.

E bëra këtë parashtesë jo vetëm për t'u shprehur solidaritet autoriteteve greke, por në mënyrë të posaçme për dy arsye:

Së pari, thëniet e përhapjes së kësaj krize në Shqipëri nuk duket se kanë bazë të fortë reale, veçanërisht kur bëhet fjalë për sistemin bankar. Asnjë nga bankat në Shqipëri nuk ka ekspozim të borxheve publike greke dhe, për më tepër, siç e kemi ndjekur ditët e fundit, Qeveria greke arriti të shiste në treg obligacione afatgjata, duke siguruar financime të nevojshme për të paguar detyrime dhe interesa të maturuara.

Së dyti, korrektimet fiskale ishin fokusi kryesor i këshillave dashamirëse të FMN-së. Objektivi për të reduktuar deficitin fiskal në 3% të GDP-së dhe borxhin publik në 50%, në një periudhë afatmesme, janë plotësisht të mundshme të arrihen, pa krijuar kosto të mëdha sociale.

Vendimet e bëra publike kohë më parë nga Qeveria për të shkurtuar shpenzimet qeveritare, bëhet fjalë kryesisht për ato operative, për të ruajtur dhe konsoliduar disiplinën fiskale, dëshmojnë se kemi të njëjtat këndvështrime me Fondin. Në këto rrethana besoj se edhe Parlamenti qëndron përkrah Qeverisë, në përkrahje të programit të korrektiveve buxhetore në varësi të zhvillimeve ekonomike.

Çështja e dytë që doja të cek në fjalën time janë zhvillimet në çmime. Publikimi i treguesit të inflacionit po dëshmon se ka një tendencë të rritjes së tyre. Por, siç nënvizoi Banka e Shqipërisë, ai është një fenomen i përkohshëm dhe nuk cenon aspak arritjen e objektivit thelbësor për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve në nivelin 3%. Ndaj më duket e padrejtë kur dëgjoj në konferenca shtypi ekzagjerime të tipit se "ç'është kjo Qeveri që i lejon çmimet të livadhisin si duan". Qeveria nuk ka kërkuar medalje edhe kur inflacioni ishte më i ulët sesa objektivi, ashtu sikurse nuk duhet të blasfemohet kur ai kapërcen pragun e tij. Në një ekonomi të hapur, çmimet nuk i përcakton Komisioni i Planit, por forcat e tregut.

Qeveria ka indeksuar pagat e pensionet që të ruajë dhe të rrisë fuqinë blerëse të qytetarëve dhe këtë ka premtuar ta bëjë sërish, edhe pse mund të justifikohet me atë se çfarë po ndodh aktualisht në vendet fqinje dhe në veçanti në kontinentin europian.

Dua ta mbyll fjalën time me një mesazh për sindikalistët, për punëtorët e nëntokës dhe për minatorët. Edhe unë kam mbajtur kasketë, jam

varur në ashensor drejt galerive, jo për të kënduar dhe as për të dhënë konferenca shtypi me motivacion politik.

Si ish-këshilltar i Kryeministrit Berisha, jam marrë seriozisht me kërkesat e minatorëve dhe vetëm në sajë të këmbënguljes së Kryeministrit, për herë të parë, është marrë seriozisht në konsideratë përmirësimi i kushteve sociale-ekonomike të punonjësve të nëntokës. Investimet e firmës në minierë po ndiqen në mënyrë rigorozë. U përmirësua sistemi i pagave dhe i shpërblimeve dhe me uljen me 5 vjet të moshës së pensionit dhe të vjetërsisë në punë, mendoj se për punonjësit e nëntokës dhe për minatorët është dhënë realisht statusi që meritojnë.

Për hir të së vërtetës, dua të kujtoj se kur Parlamenti rriti moshën e tyre të pensionit, në vitin 2000 ose 2003, nuk e mbaj mend, nuk pati asnjë protestë, ndërsa kur ulim moshën e pensionit, jo për t'u bërë favor, por për të vendosur drejtësi, sindikalistët vazhdojnë protestat.

Sigurisht, ata janë në të drejtën e tyre. Ata janë, ndoshta, ndër të vetmit që meritojnë të trajtohen të favorizuar në këtë botë, sepse pjesën më të madhe të jetës së tyre e kalojnë në errësirën e galerive. Por mirënjohja e shoqërisë duhet të kërkohet brenda asaj që vetë shoqëria është e përgatitur t'u ofrojë atyre. Mendoj se minatorët duhet të shqetësohen edhe për jetesën e qytezave, në të cilat ata banojnë. Nga shfrytëzimi i minierave është ndërtuar mirëqenia e shoqërisë, por, fatkeqësisht, duke i varfëruar dhe rrënuar këto qyteza, shumë prej të cilave ngjajnë si fantazma të mbuluar me grumbuj gurësh.

Kryeministri Berisha është i angazhuar që t'i jepet fund një gjendjeje të tillë. Këto qytete do të kenë të drejtën të kërkojnë transparencë të plotë për shfrytëzimin e burimeve dhe të marrin një pjesë të ardhurash të krijuara, për të përmirësuar jetesën e tyre dhe për të ndryshuar fytyrën e këtyre qytezave.

Mendoj se kjo është një kauzë e drejtë, që meriton solidaritet, dhe unë do t'i bashkohesha asaj. Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Xhepa!

Zoti Demi, urdhëroni!

Leonard Demi – Falemnderit, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë,

E kërkova fjalën për të folur për një problem të rëndësishëm që ka të bëjë me forcimin e mëtejshëm të institucioneve të rrethit të Sarandës dhe Delvinës, të cilat janë dy rrethe që njihen për tradita të hershme

kulturore, të cilat sot dëshmohen në parqe dhe qendra kombëtare natyrore dhe arkeologjike. Veç kësaj, falë kujdesit të vazhdueshëm që po tregon Qeveria dhe Kryeministri, Saranda sot është një rreth me një zhvillim turistik gjithnjë e në rritje, me frekuentim tepër të lartë. Vitin e kaluar Saranda ka pritur rreth 420 mijë turistë, nga 3 milionë gjithsej, të cilët kanë sjellë një të ardhur prej rreth 40 milionë euro. Nga 420 mijë turistë, 168 mijë kanë qenë turistë të huaj. Po ta krahasojmë me një vit më parë, kemi një rritje prej 100 mijë vetash.

Po kështu, po rritet me shpejtësi prodhimi bujqësor, si: prodhimi i misrit, bostanit, perimeve etj., të cilat shkojnë në dhjetëra e mijëra tonë. Në dy-tre vjetët e fundit dallojmë një rritje të ndjeshme të prodhimit të ullinjve, agrumeve e pemëve të tjera frutore. Kësisoj, me mbështetjen e drejtpërdrejtë të Kryeministrit Berisha, Saranda përfitoi statusin e prefekturës me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 168, datë 2 tetor 2008.

Drejtuesit vendorë kërkojnë një vëmendje më të madhe për forcimin e institucioneve të rretheve, në kuptimin që ato të mos varen dhe të drejtohen nga institucionet analoge me qendër në Vlorë, e cila është jo pak, por 130 kilometra larg. Fjala është kryesisht për katër syresh: Drejtoria e Mirëmbajtjes së Rrugëve Nacionale, Drejtoria e Bujqësisë, Bordi i Kullimit dhe Shërbimi pyjor.

Drejtoria e Mirëmbajtjes së Rrugëve Nacionale e këtyre dy rretheve ka një rrjet rrugor nacional prej 198 kilometrash, kundrejt 160 kilometrave që ka Vlora, dhe për më tepër po rritet dita-ditës, pa futur këtu edhe aeroportin, i cili është planifikuar për t'u ndërtuar së shpejti. Shtojmë që nga viti 2007 kjo drejtori u transferua dhe shkoi në Vlorë. Në mirëmbajtjen e rrugëve Saranda nuk ka marrë asnjë mbështetje nga qarku i Vlorës.

Drejtoria e Bujqësisë e Sarandës dhe e Delvinës ka rreth 27 mijë hektarë tokë të punueshme, por të gjitha shërbimet, si: certifikim produktesh, leje tekniko-teknologjike, dëmshpërblimi, etj. kryhen të gjitha në Vlorë.

Unë përfitoj nga rasti që ministri është këtu, t'i kërkoj atij që t'i kushtojë një vëmendje më të madhe këtij problemi.

Po përgatitet të transferohet në Vlorë Bordi i Kullimit, i cili mban nën kontroll 27 mijë hektarë tokë bujqësore, 15 rezervuarë me 26 milionë m³ ujë, të cilat ndodhen 60 kilometra larg qytetit të Sarandës; 300 kilometra kanale kulluese, 2 hidrovore, 120 kilometra argjinaturë dhe 5 lumenj.

Veç kësaj, të dy rrethet përgatiten të dyfishojnë prodhimin bujqësor e blegtoral dhe të shumëfishojnë mbjelljen e ullinjve, të agrumeve dhe të pemëve frutore. Disa plantacione të reja mandarinash po japin një prodhim të paparë ndonjëherë në vendin tonë. Po kështu po përgatitet të transferohet në Vlorë edhe Shërbimi Pyjor, i cili ndihmon 400 blegtorë.

Zonja Kryetare,

Në programin e reformave të mëdha Qeveria ka ndryshuar mënyrën tradicionale të drejtimit, mënyrën e realizimit të objektivave, mënyrën e organizimit të strukturave vendore dhe të atyre në rang kombëtar. Prandaj unë gjej rastin t'u bëj thirrje të dy ministrive, në emër të zgjedhësve të mi të rrethit të Sarandës dhe të Delvinës, që t'u kushtojnë një vëmendje më të madhe këtyre problemeve dhe të veprojnë që këto institucione të forcohen dhe jo të transferohen, duke dëmtuar prodhimin dhe të ardhmen ekonomike.

Falemnderit!

(Ndërkohë, drejtimin e seancës e ka marrë zoti Ardian Turku.)

Ardian Turku – Falemnderit, zoti Demi!

Zoti Boçi, urdhëroni!

Luçiano Boçi – Falemnderit, zoti drejtues i seancës!

Të nderuar deputetë,

Sot, në ndryshim nga herët e tjera, kam dalë jo për t'i bërë thirrje opozitës, as për të dhënë opinione, por thjesht për të përcjellë midis jush falënderimet që qytetarët e qarkut të Elbasanit i adresojnë Kryeministrit, dhe Qeverisë së tij, ministrave, punës dhe përkushtimit të tyre, dëshirës për progres dhe vullnetit për të përmbushur qëllimin final evropian nëpërmjet realizimeve perspektive dhe reale.

Në formën më modeste të mundshme dhe më konkrete, sot, para tërë opinionit, u lançua një nga projektet më të dëshiruara e më të diskutuara dhe me impakte të padiskutueshme sociale-ekonomike, ai i autostradës Tiranë-Elbasan. E konsideruar si ëndrra e shumë brezave, ajo na u zbulua e plotë me tërë potencialin e saj kohor dhe hapësinor. Kjo rrugë do të bëjë të mundur ndërfutjen e Elbasanit në një trekëndësh ekonomik tepër potent, që do t'i japë tonalitetin dhe impulsin kryesor ekonomisë shqiptare, trekëndëshin Tiranë-Durrës-Elbasan. Si i tillë, Elbasani merr një rëndësi strategjike investuese të dorës së parë, gjë që do të ndikojë në thithjen e projekteve në fusha të ndryshme. Interesi i biznesit vendas dhe të huaj do të jetë gjithnjë në rritje.

Impaktet pozitive do të prekin dukshëm vlerat e

pasurive të paluajtshme dhe do t'i krijojnë zhvillimit rajonal bujqësor hapësirën dhe kërkesën e pritshme, që ky i fundit të futet në një hulli europianizuese, gjë që fermeri shqiptar dhe produktet e tij e kanë merituar prej kohësh.

Krahas kësaj, Elbasani bëhet qendër kryesore e boshtit juglindor, si pika më e afërt e lidhjes me trekëndëshin ekonomik të përmendur. Njëkohësisht kjo rrugë, e harmonizuar me segmentet e tjera nacionale, që vijojnë të ndërtohen në zonën e Belshit, do të bëjë të mundur që Elbasani të jetë qendra transitore e të gjitha lëvizjeve që vijnë nga shumë drejtime dhe kanë destinacion final kryeqytetin.

Përveç tij, përfitues të drejtpërdrejtë të kësaj rruge do të jenë edhe Peqini, Gramshi, Librazhdi e më tej Korça e Pogradeci, ekonomia e të cilave do të ndiejë një frymëmarrje më të gjerë. Ndikimet në jetën sociale do të jenë tërësore. Kërkesat e tregut për punësim do të pësojnë një rritje galopante, ku vlera e punës së realizuar financiarisht do të marrë një hov sasior. I gjithë ky rivlerësim do të ketë ndikim në përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve. Për pasojë, Elbasanit do t'i krijohet mundësia që të mos mbesë më qyteti që prodhon dhe eksporton të rinj dhe mëndje brilante drejt tregjeve më efektive të punës si Tirana, Durrësi apo më tej, diku në Perëndim, por të bëhet qyteti i të rinjve, qyteti ku bashkëqytetarët i kthejnë kontributet e ambientit shoqëror në shërbime ndaj familjes dhe këtij komuniteti.

Kjo rrugë do të realizojë një lloj hapeje ndaj tregut të vlerave shpirtërore dhe sociale, duke bërë të mundur konkurrencën e këtyre vlerave dhe për rryedhje evidentimin e më të mirave dhe përmirësimin e tyre; një lloj përplasjeje të tradicionales me modernen, ku secila prej tyre do të ndjejë nevojën për integritet, për evolucion dhe, në fund të fundit, për t'u atashuar si pjesë progresiste e zhvillimit të shoqërisë.

Politikisht, arritja e këtij qëllimi përbën një sukses me përmasa të mëdha dhe nuk mund të jetë thjesht përmbushja e njërit prej premtimeve elektorale, të cilat Partia Demokratike dhe kryetari i saj kanë treguar se dinë t'i mbajnë. Në vetvete kjo arritje e Qeverisë "Berisha" është shenjë e seriozitetit dhe e shkallës së madhe reaguese të saj ndaj kërkesave të qytetarëve. Ky është një mesazh i qartë se synimi i saj themelor mbetet shërbesa jo ndaj gjysmës së popullsisë që e votëbesoi, por ndaj të gjithë shqiptarëve, shoqërisë dhe kombit. Të gjitha këto legjitimojnë natyrshëm falënderimet e

qytetarëve dhe tonat, si grup i deputetëve të qarkut të Elbasanit.

Të nderuar deputetë,

Sot është një nga ato ditët e zakonshme e të parëndësishme, por që bëhen pararendëse të momenteve të mëdha, të cilat ndihmojnë të shkruhet historia dhe si e tillë ajo duhet lëvdur. Brenda saj, ajo ka një falënderim të singertë, falënderim që ne të gjithë kërkojmë ta korrim nga ata që na kanë votuar dhe ata që nuk na kanë votuar. Ky është një falënderim siç është vetë populli, falënderim as opozitar dhe as pozitar. Pavarësisht se me të nuk është bashkuar ende publikisht dhe falënderimi i deputetëve të majtë të qarkut të Elbasanit, por me sigurinë që ne e kemi bekimin e tyre, ai mbetet një falënderim zemre dhe domethënës.

Falemnderit!

Ardian Turku – Falemnderit, zoti Boçi!

Zoti Kryeministër, urdhëroni!

Sali Berisha – Zoti drejtues i seancës,

Zonja deputete,

Zotërinj deputetë,

E mora fjalën për t'u bërë një thirrje mbarë qytetarëve shqiptarë: të bëjnë disponibël letrat me vlerë që kanë marrë. Ligji për përdorimin e gjerë të tyre është plotësisht në fuqi. Në bazë të këtij ligji letrat me vlerë do të përdoren për pagesën e 70% të detyrimeve për legalizimin e sipërfaqeve deri në 300 metra katrorë dhe për pagesën e 50% të detyrimeve për sipërfaqet e tjera, siç është parashikuar në ligj. Gjithashtu, ligji njeh të drejtën e pronarëve për të parashtrë me letra me vlerë.

Në totalin e tyre vlera e letrave me vlerë është rreth 820 milionë dollarë. Ato nuk u emetuan si obligacione. Qytetarët shqiptarë i morën ato gratis nga Qeveria e asaj kohe, Qeveria e Partisë Demokratike, si një vullnet për t'u dhënë atyre mundësinë për të marrë pjesë në blerjen e aksioneve në privatizim. Por, morali është moral. Ndaj Qeveria ime vendosi t'i njohë ato përsëri si të vlefshme, ndonëse për kaq vjet mbetën jashtë përdorimit, në interesin më të mirë të qytetarëve shqiptarë, bartës të këtyre letrave. Tregu i hapur për këto letra është një ndër tregjet më të fuqishme, disa herë më i madh sesa tregu i paracaktuar për to në kohën e emetimit. Në këtë mënyrë, nga vënia në përdorim e tyre, të parët që përfitojnë janë qytetarët shqiptarë posedues të këtyre letrave. Natyrisht, përfitojnë edhe ata të cilët do të blejnë me këto letra. Ndaj edhe do të bëja këtu një thirrje miqësore për të gjithë qytetarët që i disponojnë ato, t'i përdorin, ashtu sikundër

Ministria e Financave do të marrë të gjitha masat që ato letra me vlerë që janë grumbulluar, t'u rishpërndahen atyre që u takojnë dhe të mund të përdoren gjerësisht nga poseduesit e tyre.

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Krahas këtij detyrimi ndaj qytetarëve shqiptarë, që njohu Qeveria jonë, ne nisim një proces të ri, sipas të cilit çdo vit do të njohim detyrimet ndaj çdo qytetari shqiptar për taksat që ai paguan më tepër. Sot në dyqanet e vendit, në magazinat e tij blejnë me të njëjtin çmim si ata që kanë dhe ata që s'kanë, si ata që lahen në vaska floriri dhe ata që numërojnë kafshatat e gojës, sepse nuk është vendosur një sistem i domosdoshëm që bën të qartë evidentimin e të ardhurave të gjithsecilit. Kështu, detyrimisht, Qeveria, në fund, do të detyrohet të paguajë mbarë qytetarët, t'ua kthejë në buxhetin e tyre tepricën e taksave që ata kanë paguar në raport me të ardhurat, sepse të gjithë blejnë me 20% TVSH, edhe ai që ka, edhe ai që s'ka. Ky është edhe një standard evropian i domosdoshëm, i cili synon të lubrifikojë kohezionin social, synon të shmangë barazinë midis të pabarabartëve, e cila thellon varfërinë.

Ministria e Financave po punon me seriozitetin më të madh dhe po përzgjedh modelet me të mira që me instalimin e tij ne të përgatitemi t'u kthejmë qytetarëve shqiptarë tepricën që ata paguajnë padrejtësisht si taksë në buxhetin e shtetit. Mendoj se me këtë akt shoqëria shqiptare bëhet më e drejtë, më transparente, por mendoj, gjithashtu, se në përpjekjen tonë në luftën kundër varfërisë kjo përbën një levë të fuqishme, sikundër duhet t'ju informoj se Qeveria po përgatitet për një reformë të sistemit të ndihmës ekonomike për të çrrënjësuar tërësisht varfërinë ekstreme. Nuk mund të them se do të mund të çrrënjësuar tërësisht varfërinë, por varfërinë ekstreme ky vend do ta çrrënjësuar tërësisht.

Po përgatitemi për regjistrin elektronik të të gjitha familjeve në varfëri dhe në varfëri ekstreme. Me Bankën Botërore po punojmë për amendimet dhe rindërtimin e ligjit për ndihmën ekonomike. Përfundimi i dixhitalizimit do të na krijojë mundësinë e plotë të identifikojmë se cilat familje shqiptare janë në nivelin e 1,25 dollarëve për frymë dhe pas identifikimit nuk do të ketë as edhe një të vetme në këtë nivel, sepse shteti do t'i nxjerrë nga ai status.

Falemnderit!

(Ndërkohë, drejtimin e seancës e ka marrë zonja Topalli.)

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti

Kryeministër!

Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës.

Ka ndonjë vërejtje për procesverbalin e seancës së kaluar? Nuk ka. Miratohet. Falemnderit!

Kalojmë te projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a., si agjencia e zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt am Main për financimin e projektit "Linja e transmetimit 400 kilovolt Shqipëri-Kosovë (Tiranë-Prishtinë)" nëpërmjet një huaje prej 42 milionë eurosh".

Në emër të komisionit përgjegjës, Komisionit të Ekonomisë, zoti Subi Hida.

Subi Hida – Falemnderit, zonja Kryetare!

Komisioni për Ekonominë dhe Financat në mbledhjen e tij të datës 2 mars 2010 shqyrtoi projektligjin "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a., si agjencia e zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt am Main për financimin e projektit "Linja e transmetimit 400 kilovolt Shqipëri-Kosovë (Tiranë-Prishtinë)" nëpërmjet një huaje prej 42 milionë eurosh".

Ky projekt, i propozuar nga Këshilli i Ministrave, bën fjalë për një financim prej rreth 42 milionë eurosh, kredi e cila do të përdoret për implementimin e linjës Kosovë-Shqipëri, pjesë e një projekti të madh, i cili ka filluar që prej disa vjetësh dhe do të zbatohet gjatë kësaj periudhe.

Po ashtu, Komisioni i Ekonomisë dhe Financave, po në këtë mbledhje, miratoi edhe projektligjin "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a., si agjencia e zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt am Main për financimin e projektit "Linja unazore 110 kilovolt e Shqipërisë së Jugut" nëpërmjet një huaje prej 37,750,000 eurosh".

Gjithashtu, u miratua edhe projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a., si agjencia e zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt am Main për financimin e projektit "Linja unazore 110 kilovolt e Shqipërisë së Jugut" nëpërmjet një huaje prej 10,750,000 eurosh", si dhe projektligji "Për ratifikimin e

marrëveshjes së huas dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a., si agjencia e zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt am Main për financimin e projektit “Linja unazore 110 kilovolt e Shqipërisë së Jugut” nëpërmjet një huaje prej 500,000 eurosh”.

Të gjitha këto projektligje, të cilat bëjnë fjalë për një hua prej rreth 91 milionë eurosh, do të përdoren për zhvillimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike. Kjo është një hua me terma të butë, si për sa i përket normës së interesit, ashtu edhe shlyerjes së kredisë, që varion nga 14 vjet në 39 vjet.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Hida!

Në emër të Komisionit të Çështjeve Ligjore, zoti Sula.

Dashnor Sula – Falemnderit, zonja Kryetare!

Edhe Komisioni i Ligjeve shqyrtoi me mjaft interes katër marrëveshjet kryesore të ardhura në formën e projektligjeve.

Projektligji i parë ishte ai për ratifikimin e marrëveshjes së linjës së transmetimit 400 kilovolt Shqipëri-Kosovë, Tiranë-Prishtinë, nëpërmjet një huaje prej 42 milionë eurosh.

Anëtarët e komisionit u njohën me përmbajtjen e kësaj marrëveshjeje, e cila ka për qëllim kryesor fuqizimin e rrjetit shqiptar të transmetimit dhe hyrjen e tij në rrjetin e transmetimit evropian, si dhe rritjen e aftësive importuese dhe eksportuese të sistemit tonë elektroenergjetik. Krijimi i një tregu të tillë do të lejojë si konsumatorët, ashtu dhe prodhuesit e ardhshëm potencialë të shkëmbejnë energji elektrike pa kufizime, si rrjedhim do të jetë e mundshme ulja e çmimeve të tregut, duke sjellë një përmirësim të kostos së importit në vend.

Si rrjedhojë e operimit të përbashkët të dy sistemeve, Kosova do të ketë akses në burimet gjeneruese hidrike në Shqipëri dhe Shqipëria do të ketë akses te burimet termike të energjisë së Kosovës, duke njësuar diversifikimin e burimeve gjeneruese të të dy vendeve.

Do të më lejoni, zonja Kryetare, që të përmbledh edhe tre marrëveshjet e tjera, të cilat janë kaluar në Komisionin e Ligjeve dhe që janë në plan për t’u miratuar në seancë plenare: projektligjin ku bëhet fjalë për një shumë prej 37 milionë e 750 mijë eurosh për linjën unazore 110 kilovolt të Shqipërisë së Jugut, projektligji tjetër për ratifikimin e marrëveshjen për linjën unazore të Shqipërisë së Jugut me një shumë

prej 10 milionë e 750 mijë urosh, si dhe projekt marrëveshja e fundit, e cila kap shifrën e 500 mijë eurove, nismë kjo e Këshillit të Ministrave për linjën unazore të Shqipërisë së Jugut.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Sula!

Në emër të Komisionit të Jashtëm, zoti Oketa.

Gazmend Oketa – Falemnderit, zonja Kryetare!

Po flas për të katër projektligjet në emër të komisionit.

Komisioni i Politikës së Jashtme në mbledhjen e datës 08.03.2010 mori në shqyrtim të katra këto projektligje që kanë të bëjnë me ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe KfW Frankfurt mbi Majn.

Sigurisht, duke marrë në konsideratë edhe raportin e Komisionit të Ekonomisë, Komisioni i Politikës së Jashtme shprehet dakord për miratimin e të katër këtyre projektligjeve që kanë të bëjnë me këtë hua për sektorin e energjetikës.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Oketa!

Ka pyetje? Nuk ka. Diskutime? Nuk ka.

Kalojmë në mendimin e grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të LSI-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të PD-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Kalojmë te projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Operatorit të Sistemit të Transmetimit, sh.a., si agjencia e zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt am Main për financimin e projektit “Linja unazore 110 kilovolt e Shqipërisë së Jugut” nëpërmjet një huaje prej 37 750 000 eurosh”.

Në emër të Komisionit të Ekonomisë, zoti Hida.

Subi Hida – Dakord.

Jozefina Topalli - Falemnderit!

Komisioni i Ligjeve dhe Komisioni i Jashtëm janë shprehur dakord, siç e parathanë.

Ka pyetje? Nuk ka. Diskutime? Nuk ka.

Kalojmë në mendimin e grupeve.

Në emër të Grupit Parlamentar të LSI-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të PD-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

E njëjta procedurë është edhe për projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Operatorit të Sistemit të Transmetimit, sh.a., si agjencia e zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt am Main për financimin e projektit “Linja unazore 110 kilovolt e Shqipërisë së Jugut” nëpërmjet një huaje prej 10 750 000 eurosh”.

Në emër të Komisionit të Ligjeve?

(Përfaqësuesi i komisionit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Në emër të Komisionit të Ekonomisë?

(Përfaqësuesi i komisionit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Në emër të Komisionit të Jashtëm?

(Përfaqësuesi i komisionit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Ka pyetje? Diskutime?

Urdhëroni, zoti Bode!

Ridvan Bode – Unë doja të tërhiqja edhe një herë vëmendjen e opinionit lidhur me këto katër projekte që ne miratojmë sot, projekte kreditimi përmes Bankës Gjermane KfW.

Kjo është paketa më e madhe që është ndërmarrë ndonjëherë për modernizimin e sistemit energjetik. Janë rreth 100 milionë euro, përmes katër akteve që ne sot miratojmë, të cilët synojnë modernizimin e sistemit dhe rritjen e kapaciteteve të transmetimit, përmirësimin e furnizimit me energji elektrike të gjitha pjesëve të vendit. Kjo është linjë që do të lidhet me Kosovën, me një sistem energjetik të dëshiruar mes dy vendeve, për të balancuar ato burime aq të çmuara të energjisë që kemi, kaskadën e lumit Drin me prodhimin e termocentraleve me qymyr të Kosovës.

Por më i rëndësishëm është përmirësimi thelbësor i furnizimit me energji elektrike në unazën e Jugut, çka do të thotë rritja e cilësisë së furnizimit, fuqisë që transmetohet pranë çdo familjeje dhe konsumatori, duke mënjanuar dhe duke i dhënë fund epokës së mosfurnizimit me kapacitetin e nevojshëm të këtyre konsumatorëve për shkak të potencialeve më të vogla që ka pasur furnizimi me energji elektrike në këto zona dhe për shkak të rritjes shumë të shpejtë të konsumatorëve dhe të fuqisë së instalimit në çdo konsumator.

Mendoj se kjo paketë kaq e fuqishme prej rreth 110 milionë eurosh, që do të fillojë nga sot

implementimin përmes investitorëve, kryesisht nga OST-ja, Operatori i Sistemit të Transmetimit, por përmbledh në vetvete edhe nënstacione të cilat nuk janë të OST-së, do të bëhet përmirësim i dukshëm i furnizimit me energji elektrike dhe do të përmirësohet ndjeshëm kapaciteti i sistemit energjetik në raport edhe me fqinjët, edhe me tregun europian.

Falemnderit!

Jozefina Topalli - Falemnderit!

Ka diskutime të tjera? Nuk ka.

Kalojmë në mendimin e grupeve.

Në emër të Grupit Parlamentar të LSI-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të PD-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Kalojmë te projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Operatorit të Sistemit të Transmetimit, sh.a., si agjencia e zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt am Main për financimin e projektit, linja unazore 110 kilovolt e Shqipërisë së Jugut nëpërmjet një huaje prej 500 000 eurosh”.

Në emër të Komisionit të Ekonomisë?

(Përfaqësuesi i komisionit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Në emër të Komisionit të Ligjeve ?

(Përfaqësuesi i komisionit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Në emër të Komisionit të Jashtëm?

(Përfaqësuesi i komisionit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Ka pyetje? Nuk ka. Diskutime? Nuk ka.

Kalojmë në mendimin e grupeve.

Në emër të Grupit Parlamentar të LSI-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të PD-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Këtu mbyllet shqyrtimi i paketës prej mbi 110 milionë eurosh investime në sistemin e energjetikës.

Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës: projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore””.

Në emër të Komisionit për Punën dhe Çështjet Sociale, zoti Paluca, urdhëroni!

Ndue Paluca – Komisioni për Punën dhe

Çështjet Sociale, në mbledhjen e datave 18 dhe 22 shkurt 2010, shqyrtoi projektligjin "Për disa shtesa në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore"", nismë kjo e Këshillit të Ministrave. Në këtë mbledhje morën pjesë përfaqësues të dy ministrive, Ministrisë së Punës dhe Ministrisë së Brendshme, dhe u diskutua gjerësisht ky projektligj, synimi i të cilit ka të bëjë me zgjerimin e grupeve përfituese, me sigurimin e përfshirjes sociale dhe mosdiskriminimin e viktimave të trafikimit, me përcaktimin e fondeve qendrore buxhetore dhe transferimin e tyre në njësi të qeverisjes vendore për mbështetjen e shërbimeve sociale që ofrohen për viktimat e trafikimit.

Për këtë qëllim në projektligj shtohet një përkufizim i ri për viktimat e trafikimit dhe këto viktimat trajtohen si një kategori e re përfituesish të ndihmës ekonomike.

Projektligji parashikon fonde qendrore buxhetore për financimin e shërbimeve për kujdesin shoqëror, për viktimat e trafikimit, fonde të cilat u transferohen organeve të qeverisjes vendore ku funksionojnë këto shërbime.

Në këtë projektligj financimi i qendrave do të kushtëzohet me ekzistencën e një marrëveshjeje tripalëshe ndërmjet vetë shërbimit të kujdesit shoqëror, që mund të jetë për shembull një qendër shërbimit social shtetëror dhe njësisë së qeverisjes vendore ku ofrohet shërbimi.

Në marrëveshje trajtohen të drejtat dhe detyrimet e palëve, si dhe struktura e qendrës që do të mbikëqyrë administrimin. Efektet financiare do të përballohen nga fondet e programuara në projektbuxhetin afatmesëm 2010-2012.

Komisioni ra dakord me përmbajtjen e projektligjit dhe në unanimitet vendosi ta kalojë për shqyrtim në seancë plenare, me disa vërejtje, të cilat janë të paraqitura edhe në këtë raport.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Paluca!

Në emër të Komisionit të Ekonomisë, zoti Hida, urdhëroni!

Subi Hida – Edhe Komisioni i Ekonomisë e shqyrtoi projektligjin dhe bëri ndryshimin e mëposhtëm në lidhje me nenin 3, ku paragrafi i parë duhet të riformulohet si më poshtë: "Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta parashikon në buxhetin e vet fonde për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror për viktimat e trafikimit, të cilat u transferohen organeve të qeverisjes vendore ku funksionojnë këto qendra".

Falemnderit!

Jozefina Topalli - Falemnderit!

Urdhëroni, zoti Ministër!

Spiro Ksera – E nderuar zonja Kryetare, Të nderuar kolegë deputetë,

Rritja e mirëqenies së qytetarëve nëpërmjet rritjes së mbështetjes ekonomike sociale, veçanërisht të shtresave në nevojë, mbetet prioritet i kësaj Qeverie. Pikërisht këtij objektivi madhor i shërbejnë edhe ndryshime e propozuara për miratimin në Kuvend të ligjit "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore".

Në kuadër të përmbushjes së objektivave dhe njëkohësisht të përmbushjes së detyrimeve për liberalizimin e vizave, Qeveria shqiptare miratoi pak kohë më parë ndryshime ligjore të cilat parashikojnë përfshirjen për herë të parë në skemën e përfitimit të ndihmës ekonomike edhe të një kategorie të re, asaj të viktimave të trafikimit.

Miratimi sot i ndryshimeve ligjore që parashikon projektligji për ndihmën dhe shërbimet shoqërore i hap rrugën mbështetjes me pagesa të viktimave të trafikut pas daljes së tyre nga qendrat rezidenciale të shërbimeve të kujdesit social. Në thelb të ndryshimeve të paraqitura për miratim qëndron përmirësimi i legjislationit ekzistues, nëpërmjet zgjerimit të grupeve përfituese dhe sigurimit të përfshirjes sociale dhe mosdiskriminimit të viktimave të trafikimit.

Një risi tjetër e ndryshimeve të propozuara është se për herë të parë Qeveria merr përsipër që me fonde buxhetore të mbështesë qendrat rezidenciale jopublike që ofrojnë shërbime për viktimat e trafikimit. Financimi i qendrave rezidenciale të viktimave të trafikimit do të bëhet nëpërmjet transferimit të fondeve buxhetore qendrore në organet e qeverisjes vendore dhe prej tyre në qendrën ku do të ofrohet shërbimi.

Gjithashtu, projektligji parashikon krijimin e një njësie për mbikëqyrjen e administrimit të qendrës e cila do të jetë pjesë e strukturës së shërbimit social shtetëror dhe do të funksionojë pranë qendrës rezidenciale të trajtimit të viktimave të trafikimit.

Ftoj të gjithë deputetët ta votojnë këtë projektligj, jo vetëm për të mbështetur këtë kategori, por për të përmbushur dhe detyrimet e fundit që ka Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta në prag të liberalizimit të vizave.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Ministër!

Ka pyetje? Nuk ka. Diskutime? Urdhëroni, zoti Sula!

Dashnor Sula – Falemnderit, zonja Kryetare!

Do të më lejoni të them dy fjalë për këtë projektligj mjaft të rëndësishëm, duke e ndërë si obligim nga përvoja ime 15- vjeçare në organet e drejtësisë.

Trafikimi i qenieve njerëzore, duke filluar nga fëmijët, femrat dhe disa kategori të tjera shoqërore, ka qenë një fenomen mjaft shqetësues në Shqipëri, të paktën deri në vitin 2005. Ai ka qenë burim përfitimi për mjaft banda kriminale të cilat, qoftë në Greqi, qoftë në Itali, bënë të mundur thithjen e fitimeve përrallore nga ky trafikim.

Unë gjej fjalët më të mira për Ministrinë e Brendshme e cila është treguar mjaft e kujdesshme në ngritjen e mjaft qendrave, duke filluar nga Qendra e Rehabilitimit të Viktimave në qytetin e Vlorës dhe disa qendra të tjera në territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilat bënë të mundur rehabilitimin viktimit të trafikimit. Kjo përkujdesje e Qeverisë është mjaft e rëndësishme, sepse jo vetëm tregon kujdes për rehabilitim moral të këtyre viktimit, por edhe po i përfshin në skemën e përfitimit të sigurimeve.

Unë gjykoj se ky është një projektligj mjaft i rëndësishëm dhe kjo përkujdesje që tregon Qeveria "Berisha" është, gjithashtu, mjaft e madhe.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Sula!

Ka diskutime të tjera? Nuk ka.

Në fakt, ky është ndër ligjet kryesore që vjen pas ratifikimit të Konventës së Këshillit të Europës nga Parlamenti për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore, një temë shumë e rëndësishme, shumë e dhimbshme. Ky është një veprim konkret që merret në mbrojtje të viktimit dhe që cakton fonde për ngritjen e strehëzave të tjera, në bashkëpunim me pushtetin vendor, ndaj dhe është një nga ligjet më të rëndësishme që Parlamenti shqiptar do të votojë sot.

Kalojmë në shprehjen e grupeve.

Në emër të Grupit Parlamentar të LSI-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të PD-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Kalojmë të projektligji "Për gjuetinë".

Relator për komisionin përgjegjës, zoti Bedri Hoxha, urdhëroni!

Bedri Hoxha – Falemnderit, zonja Kryetare!

Komisioni i Veprimtarisë Prodhuese shqyrtoi

projektligjin "Për gjuetinë" në datat 3, 8, 15, 22, 24, 25 shkurt. Komisioni zhvilloi disa mbledhje për projektligjin në fjalë dhe u njoh me mendimet e grupeve të interesit, duke zhvilluar një seancë të veçantë për dëgjimin e tyre.

Në këtë mbledhje morën pjesë përfaqësues të Federatës së Shoqatave të Gjuetarëve dhe të Shoqatës së Gjuetisë Turistike për të huajt në Shqipëri, të cilët shprehën rëndësinë e këtij projektligji për veprimtarinë që zhvillon, si dhe paraqitën mendimet e tyre për disa ndryshime në projektligj, me qëllim që ai të ishte sa më i plotë. Komisioni u njoh me shqetësimet dhe vërejtjet e tyre dhe i mori në konsideratë ato gjatë shqyrtimit nen për nen.

Projektligji bën përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit vendas me direktivën europiane për ruajtjen e shpendëve të egër. Kjo direktivë siguroi një strukturë për ruajtjen e menaxhimit dhe ndërveprimin njerëzor me zogjtë e egër në Europë. Ajo vendosi objektiva për një gamë më të gjerë aktivitetesh, ku bën pjesë edhe gjuetia, megjithëse mekanizmat ligjorë precizë për arritjen e tyre janë të zgjedhja e secilit vend anëtar. Gjithashtu, projektligji përmbush detyrimet ndaj konventave të fushës së mbrojtjes së natyrës, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.

Deri vonë mbrojtja e faunës së egër dhe ushtrimi i gjuetisë janë trajtuar në një ligj, por, në kuadër të përafrimit me legjislacionin e BE-së, u pa i nevojshëm trajtimi i tyre në ligje të veçanta. Mbrojtja e faunës së egër bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 1006, datë 23.10.2008 "Për mbrojtjen e faunës së egër", ndërsa projektligji në fjalë synon përcaktimin e saktë të rregullave dhe kërkesave për zhvillimin e gjuetisë, si një veprimtari tradicionale sportive dhe turistike, menaxhimin e qëndrueshëm të gjuetisë, duke e cilësuar faunën e egër si pasuri kombëtare me interes të përgjithshëm dhe që gëzon mbrojtje të veçantë.

Në projektligj gjuetia përkufizohet si një mënyrë e specializuar e shfrytëzimit të faunës së egër, që ka të bëjë me kapjen dhe vrasjen e kafshëve që janë objekt gjuetie. Projektligji sjell disa risi, si ajo që ka të bëjë me listat e llojeve objekt gjuetie, përjashtimet nga këto lista, përcaktimin e zonave të gjuetisë dhe menaxhimin e tyre, zhvillimin e veprimtarisë së gjuetisë mbi parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, pa cenuar mbijetesën e objekteve dhe llojeve të gjuetisë.

Disa nga çështjet më të debatueshme gjatë

diskutimeve në komision kishin të bënin me pronarin privat që zotëron pyje ose tokë, i cili nuk duhet të ndalojë gjuetinë në tokën e tij, me përjashtim të rasteve kur toka është shpallur rezervat nga dikasteri përkatës, me faktin se sado të arrijë ky ligj të vërë nën kontroll këtë pasuri kombëtare duke shmangur gjuetinë abuzive etj.

Për sa u përket shqetësimeve të grupeve të interesit, komisioni mendon se shoqatat e gjuetarëve, të cilat janë të shumta në numër, duhet të deklarojnë nëse janë fitimprurëse apo jo. Shoqatat jofitimprurëse gjejnë mjaftueshëm hapësirë në këtë ligj, ndërsa shoqatat fitimprurëse do të kenë më pak vend dhe ato do të jenë konkurrenca për të fituar një zonë të caktuar gjuetie.

Në përfundim të diskutimeve, komisioni e konsideroi projektligjin shumë të rëndësishëm në menaxhimin e faunës së egër dhe u shpreh dakord për kalimin e tij në seancë plenare.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Hoxha!

Në emër të Komisionit për Integrimin Europian, zoti Kadilli, urdhëroni!

Fatbardh Kadilli – Komisioni për Integrimin Europian, në mbledhjen e datës 22 shkurt, në cilësinë e komisionit që jep mendim, mori në shqyrtim projektligjin dhe e gjen atë në përputhje me legjislacionin dytësor të BE-së, mbas ligjit nr. 1006 të datës 23.10.2008 “Për ruajtjen e faunës së egër”, që siguroi hapin e parë të përafrimit të legjislacionit në këtë fushë. Ky ligj bën një përafrim të mëtejshëm, i cili, për të thënë të vërtetën, duhet të plotësohet me legjislacionin dytësor shqiptar, me vendimet e Qeverisë, për të realizuar përafrimin e plotë të detyrimeve që rrjedhin nga MSA-ja.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit!

Urdhëroni, zoti Mediu!

Fatmir Mediu – E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji “Për gjuetinë” që po diskutojmë sot përbën një akt ligjor të rëndësishëm në fushën e mjedisit dhe veçanërisht në atë të biodiversitetit. Së bashku me ligjin “Për mbrojtjen e faunës së egër”, i miratuar nga Kuvendi në vitin 2008, ky ligj plotëson kuadrin e mbrojtjes dhe menaxhimit të faunës së egër në Shqipëri, në përputhje me kërkesat dhe standardet europiane. Projektligji është në zbatim të planit kombëtar për zbatimin e MSA-së dhe të objektivave të programit të Qeverisë për përafrimin e legjislacionit me atë të BE-së.

Ky projektligj synon zhvillimin e gjuetisë si një veprimtari tradicionale, veprimtari sportive dhe turistike, mbi bazën e një menaxhimi të qëndrueshëm, duke vlerësuar faunën e egër si pasuri natyrore kombëtare. Puna për hartimin e këtij projektligji është bazuar në tri drejtime kryesore: në legjislacionin europian, ndërkombëtar, dhe në marrëveshjet ku ne jemi pjesë në legjislacionin aktual të vendit. Por ai mbështetet edhe në konsultimet me institucionet dhe grupet e interesit, sidomos në një diskutim intensiv që është bërë në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese, ku janë bërë edhe shumë amendime të ligjit, në dakordësi të plotë me ministrinë.

Ky projektligj synon frenimin e paligjshmërisë në ushtrimin e gjuetisë si dhe zhvillimin e ushtrimit të gjuetisë mbi kritere rigorozë, duke mundësuar mbarështimin e faunës së egër dhe sidomos të shpendëve dhe kafshëve, ndërtimin e zonave të gjuetisë dhe rezervateve të gjuetisë, për të mundësuar të gjithë veprimtarinë dhe ushtrimin e gjuetisë në bazë të ligjit dhe, pse jo, duke parë në të ardhmen interesin ekonomik në këtë proces.

Projektligji siguron përafrimin e mëtejshëm të direktivës së 2 prillit 1979, të BE-së “Për ruajtjen e shpendëve të egër”, si një ndër direktivat më të rëndësishme në fushën e ruajtjes së natyrës. Ai është hartuar edhe mbi bazën e principeve të konventave të fushës së mbrojtjes së natyrës, mes të cilave do të përmendja Konventën e Bernës “Për ruajtjen e jetës së egër dhe habitateve natyrore europiane” dhe Konventën e Bonit, në të cilën Republika e Shqipërisë është palë dhe ka detyrimet e saj. Gjithashtu, projektligji është mbështetur edhe në parimet e Kartës Europiane për Gjuetinë dhe Biodiversitetin, të vitit 2007, e Këshillit të Europës, dhe në udhëzuesin “Për gjuetinë e qëndrueshme”, sipas direktivës së Komisionit Europian të vitit 2008.

Projektligji merr në konsideratë legjislacionin vendas, përafruar me direktivat europiane, si ligjin që kemi tashmë “Për zonat e mbrojtura”, ligjin “Për mbrojtjen e faunës së egër”, ai merr në konsideratë llojet e mbrojtura të faunës së egër, llojet migratore, si dhe llojet që bëjnë pjesë në librin e kuq të faunës shqiptare, duke përcaktuar edhe dispozitat mbrojtëse.

Procesi i hartimit të projektligjit, siç e thashë, iu nënshtrua diskutimeve të gjëra me aktorë dhe grupe interesit, që u përmendën edhe nga parafolësit, kolegët deputetë. Në këtë proces janë vlerësuar dhe pranuar për t’u përfshirë në projektligj mendimet e

federatës së gjuetarëve të Shqipërisë, pra, konsultimet me të gjitha grupet e interesit që kanë të bëjnë me këtë fushë, shoqata të tjera dhe padyshim edhe mendimi i Fakultetit të Shkencave të Natyrës.

Në projektligj janë marrë në konsideratë mendimet e ministrive të linjës, siç janë: Ministria e Drejtësisë, Financave, Integritit, Bujqësisë. Do të theksoja se një diskutim i gjerë dhe profesional u zhvillua në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese, ku pati një sërë mendimesh, të cilat e sjellin projektligjin në përputhje me realitetin shqiptar dhe në përputhje me kërkesat që ka parashtruar BE-ja.

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji realizohet një përafrim i mëtejshëm i direktivës për ruajtjen e shpendëve të egër në masën 80% dhe përafrimi i plotë i direktivës së shpendëve do të realizohet deri në 2012-n, siç është parashikuar përmes akteve nënligjore dhe akteve të tjera normative, që do të hartohen, mbështetur në këtë ligj.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit!

Kalojmë në shprehjen e grupeve.

Në emër të Grupit Parlamentar të LSI-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të PD-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Kalojmë në projektligjin “Për shtyrjen e afatit të qëndrimit të kompanisë së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në misionin “MINURCAT” të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Republikën e Çadit dhe në Republikën e Afrikës Qendrore”.

Zoti Skuqi, në emër të Komisionit për Sigurinë Kombëtare, urdhëroni!

Luan Skuqi - Falemnderit, zonja Kryetare!

Komisioni për Sigurinë Kombëtare në mbledhjen e datës 10.03.2010 mori në shqyrtim projektligjin për shtyrjen e afatit të qëndrimit të kompanisë së Forcave të Armatosura në Republikën e Çadit dhe atë të Afrikës Qendrore. Në këtë mbledhje komisioni analizozi dhe arsyetoi nën dritën e shpjegimeve të ekspertëve mjaft të përgatitur të Ministrisë së Mbrojtjes.

Republika e Shqipërisë kontribuon në Republikë e Çadit dhe atë të Afrikës Qendrore me një kompani prej 63 vetash. Afati i këtij misioni në këto republika mbaron më 15 mars të këtij viti. Meqenëse afati i misionit të OKB-së në ndihmë të ruajtjes së paqes

dhe sigurisë në Republikën e Çadit dhe të Afrikës Qendrore është më 30 qershor, është sjellë kërkesa për shtyrjen e afatit të misionit tonë në Republikën e Çadit, nga data 15 mars deri në datën 30 qershor. OKB-ja do të sigurojë transportin strategjik Shqipëri-Çad, si dhe shpenzimet logjistike që lidhen me sigurimet shëndetësore dhe me ribursimin e shpenzimeve të pajisjeve të përdorimit.

Komisioni, për arsye të afateve, në mirëkuptim me specialistët e Ministrisë së Mbrojtjes, kërkon ndryshimet e nenit 5, që ai të bëhet si vijon: “Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në numrin e parë të Fletores Zyrtare”.

Komisioni autorizon që ky ligj të kalojë në seancë plenare.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Skuqi!

Kalojmë në shprehjen e grupeve.

Në emër të Grupit Parlamentar të LSI-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të PD-së?

(Përfaqësuesi i grupit shprehet dakord.)

Falemnderit!

Zoti Imami, urdhëroni!

Arben Imami – Zonja Kryetare,

Zotërinj deputetë,

Forcat e Armatosura të Shqipërisë janë të angazhuara në ruajtje të paqes dhe sigurisë globale në kuadër të NATO-s, BE-së dhe OKB-së. Në këtë kuadër, ne kemi të angazhuara prej datës 18 korrik 2008, me rotacion 6-mujor, 63 ushtarakë në misionin paqeruajtës në Çad, për shkak të gjendjes së pasigurisë dhe krizës humanitare në atë vend. Aktualisht kemi në Çad kontingjentin e tretë, mandati i së cilit përfundon në mesin e marsit. OKB-ja ka vendosur ta shtyjë më tej qëndrimin me mision në këtë vend dhe për këtë arsye ne kërkojmë miratimin e Parlamentit për të shtyrë qëndrimin e ushtarakëve tanë deri në 15 qershor, për shkak edhe të vlerësimeve të pasigurisë në Çad.

Situata atje është e paqartë dhe, madje, ekziston edhe rreziku i përshkallëzimit. Ka përplasje midis ushtrisë dhe grupeve rebele. Terroristët janë aktivë në vendet kufitare me Çadin, forcat rebele kanë armatim dhe municione të shumëllojshme, ndaj, për të gjitha këto arsye angazhimi i OKB-së atje është i domosdoshëm. Efektivët tanë në Çad kryejnë kryesisht detyra ruajtjeje për komandën dhe shtabin e OKB-së në Nxhamena, ruajtjen e sigurisë së aeroportit, patrullim për sigurinë e rendit, shoqërim

kolonash, ruajtje dhe sigurim personalitetesh, objektsh etj.

Sikurse dhe u tha, autoritetin e drejtimit të kontingjentit tonë në Çad e ka OKB-ja, kurse mbështetjen logjistike e mbulon pala franceze, me të cilën kemi pasur një bashkëpunim të shkëlqyer dhe të vijueshëm. Angazhimi ynë në Çad tregon gatishmërinë e vendit tonë për të kontribuar për paqen, stabilitetin global, gatishmërinë e RSH-së për pjesëmarrje aktive në politikën e sigurisë dhe të mbrojtjes, si dhe rritjen e kapaciteteve për plotësimin e standardeve për të ndërvepruar me Forcat Shumëkombëshe.

Për arsyet e sipërpërmendura, besoj se Parlamenti do ta miratojë projektin e paraqitur.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Ministër! Hapim votimin për prezencën.

Mbyllim votimin. 71 deputetë të pranishëm.

Fillojmë me votimin në parim të projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Operatorit të Sistemit të Transmetimit, sh.a, si agjencia e zbatimit të projektit, dhe KfW-së Frankfurt am MAIN për financimin e projektit “Linja e transmetimit 400 kilovolt Shqipëri-Kosovë (Tiranë-Prishtinë) nëpërmjet një huaje prej 42.000.000 eurosh”.

Hapim votimin në parim me elektronikë.

Mbyllim votimin.

Janë 71 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton në parim projektligjin.

Kalojmë të votimi nen për nen.

Kush është dakord me nenin 1? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Hapim votimin në tërësi me elektronikë.

Mbyllim votimin.

Janë 72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton edhe në tërësi projektligjin e parë të paketës “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Operatorit të Sistemit të Transmetimit, sh.a, si agjencia e zbatimit të projektit, dhe KfW-së Frankfurt am Main, për financimin e projektit “Linja e transmetimit 400 kilovolt Shqipëri-Kosovë (Tiranë-Prishtinë) nëpërmjet një huaje prej 42.000.000

eurosh”.

Kalojmë te projektligji i dytë i paketës “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Operatorit të Sistemit të Transmetimit, sh.a, si agjencia e zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt am Main për financimin e projektit “Linja unazore 110 kilovolt e Shqipërisë së Jugut” nëpërmjet një huaje prej 37.750.000 eurosh”.

Hapim votimin në parim me elektronikë.

Mbyllim votimin.

Janë 72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton në parim projektligjin.

Kalojmë të votimi nen për nen.

Kush është dakord me nenin 1? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Hapim votimin në tërësi me elektronikë.

Mbyllim votimin.

Janë 72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton edhe në tërësi projektligjin e dytë të paketës “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Operatorit të Sistemit të Transmetimit, sh.a, si agjencia e zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt am Main për financimin e projektit “Linja unazore 110 kilovolt e Shqipërisë së Jugut” nëpërmjet një huaje prej 37.750.000 eurosh”.

Kalojmë te projektligji i tretë i kësaj pakete “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave e Operatorit të Sistemit të Transmetimit, sh.a, si agjencia e zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt am Main për financimin e projektit “Linja unazore 110 kilovolt e Shqipërisë së Jugut” nëpërmjet një huaje prej 10.750.000 eurosh”.

Hapim votimin në parim me elektronikë.

Mbyllim votimin.

Janë 72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton në parim projektligjin.

Kalojmë të votimi nen për nen.

Kush është dakord me nenin 1? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2? Falemnderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Hapim votimin në tërësi me elektronikë.

Mbyllim votimin.

Janë 72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton edhe në tërësi projektligjin e tretë të kësaj pakete "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Operatorit të Sistemit të Transmetimit, sh.a, si agjencia e zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt am Main për financimin e projektit "Linja unazore 110 kilovolt e Shqipërisë së Jugut" nëpërmjet një huaje prej 10.750.000 eurosh".

Kalojmë te projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Operatorit të Sistemit të Transmetimit, sh.a, si agjencia e zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt am Main për financimin e projektit "Linja unazore 110 kilovolt e Shqipërisë së Jugut" nëpërmjet një huaje prej 500 000 eurosh".

Hapim votimin në parim me elektronikë.

Mbyllim votimin.

Janë 72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton në parim projektligjin.

Kalojmë te votimi nen për nen.

Kush është dakord me nenin 1? Falemnderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2? Falemnderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Hapim votimin në tërësi me elektronikë.

Mbyllim votimin.

Janë 72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton edhe në tërësi projektligjin e fundit të paketës "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Operatorit të Sistemit të Transmetimit, sh.a, si agjencia e zbatimit të projektit, dhe KfW-së Frankfurt am Main për financimin e projektit "Linja unazore 110 kilovolt e Shqipërisë së Jugut" nëpërmjet një huaje prej 500 000 eurosh".

Kalojmë te votimi i projektligjit "Për disa shtesa në ligjin nr. 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore".

Hapim votimin në parim me elektronikë.

Mbyllim votimin.

Janë 72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton në parim projektligjin.

Kalojmë te votimi nen për nen, bashkë me amendamentet e nenit 17, pika 1 e këtij ligji, si dhe nenet 3 dhe 4.

Kush është dakord me nenin 1? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Pas nenit 2 ka një nen të ri. Kush është dakord me nenin e ri? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Kush është dakord me nenin 3? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Kush është dakord me nenin 4? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Hapim votimin në tërësi me elektronikë.

Mbyllim votimin.

Janë 72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton edhe në tërësi projektligjin "Për disa shtesa në ligjin nr. 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore".

Kalojmë te votimi i projektligjit "Për gjuetinë".

Hapim votimin në parim me elektronikë.

Mbyllim votimin.

Janë 72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miratoi në parim projektligjin.

Kalojmë te votimi nen për nen së bashku me vërejtjet e Komisionit për Veprihtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Kush është dakord me nenin 1? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Kush është dakord me nenin 3? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Kush është dakord me nenin 4? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Kush është dakord me nenin 5? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

(Nga neni 6 deri në nenin 56 ndiqet e njëjta procedurë miratimi.)

Kush është dakord me nenin 57, bashkë me vërejtjet e Komisionit për Integrimin European? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Kush është dakord me nenin 58, bashkë me vërejtjet e Komisionit për Integrimin European? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Kush është dakord me nenin 59, bashkë me vërejtjet e Komisionit për Integrimin European? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk

ka. Miratohet.

(Nga neni 60 deri në nenin 65 ndiqet e njëjta procedurë miratimi.)

Kush është dakord me nenin 66, bashkë me vërejtjet e Komisionit për Integrimin Europian? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

(Nga neni 67 deri në nenin 75 ndiqet e njëjta procedurë miratimi.)

Kush është dakord me nenin 76, bashkë me vërejtjet e komisionit përkatës? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Kush është dakord me nenin 77? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Kush është dakord me nenin 78? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Hapim votimin në tërësi me elektronikë.

Mbyllim votimin.

Janë 72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton edhe në tërësi projektligjin "Për gjuetinë".

Kalojmë te votimi i projektligjit të fundit: "Për shtyrjen e afatit të qëndrimit të kompanisë së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në misionin "MINURCAT" të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Republikën e Çadit dhe në Republikën e Afrikës Qendrore".

Hapim votimin në parim me elektronikë.

Mbyllim votimin.

Janë 72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton në parim projektligjin.

Kalojmë te votimi nen për nen.

Në bazë të nenit 84, pika 4 e Kushtetutës, projektligji të neni nr. 5 kërkon 71 vota.

Kalojmë te votimi nen për nen.

Kush është dakord me nenin 1? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Kush është dakord me nenin 3? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Kush është dakord me nenin 4? Falemnderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Kush është dakord me nenin 5?

Hapim votimin me elektronikë. Janë 72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim. Miratohet.

Hapim votimin në tërësi me elektronikë.

Mbyllim votimin.

Janë 72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton edhe në tërësi projektligjin "Për shtyrjen e afatit të qëndrimit të kompanisë së Forcave

të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në misionin "MINURCAT" të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Republikën e Çadit dhe në Republikën e Afrikës Qendrore".

Kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës, projektrezoluta "Për liberalizimin e vizave në BE".

Unë do të lexoj rezolutën, pastaj do të paraqitet raporti në emër të Komisionit të Jashtëm.

Projektrezolutë "Për liberalizimin e vizave me Bashkimin Europian":

Në përmbushje të misionit të Kuvendit dhe si përfaqësues të zgjedhur me dëshirën dhe vullnetin e lirë të qytetarëve shqiptarë, në respekt të plotë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe synimeve madhore të shqiptarëve për të qenë pjesë me të drejta të plota në familjen europiane, të vendosur për të zbatuar detyrimet, që rrjedhin gjatë procesit të integritimit të Republikës së Shqipërisë me BE-në, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. i mbledhur sot, më 11.03.2010, me bindjen se lëvizja e lirë e njerëzve çon në forcimin e lidhjeve njerëzore, ekonomike, kulturore dhe shkencore mes Shqipërisë dhe BE-së, duke u bërë kësaj mbështetje për një Shqipëri që përparon nëpërmjet forcimit të demokracisë, ekonomisë së tregut e vlerave të shtetit të së drejtës, në dobi të qytetarëve; duke çmuar dialogun me BE-në për liberalizimin e vizave si mbështetje për plotësimin e detyrimeve dhe si një proces të bazuar në përmbushjen e kushteve të vendosura në udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave; duke vlerësuar angazhimin e Parlamentit dhe të Këshillit të Bashkimit Europian për liberalizimin e vizave me Shqipërinë sa më shpejt që të jetë e mundur, të shprehur në deklaratën e përbashkët të Këshillit dhe të Parlamentit më 12 nëntor 2009, i bindur se liberalizimi i regjimit të vizave është pjesë e procesit të integritimit europian të Shqipërisë; duke konsideruar se ky proces është në dobi të zhvillimit dhe stabilitetit të rajonit të Ballkanit Perëndimor, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë konfirmon mbështetjen e të gjitha forcave politike të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për liberalizimin e shpejtë të vizave dhe e mbështet me vendosmëri lëvizjen e lirë të shtetasve shqiptarë në hapësirën Shengen;

Çmon arritjet e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë në përmbushjen e detyrimeve të procesit të liberalizimit të vizave dhe mbështet përpjekjet e saj për të konsoliduar më tej përparimin e dukshëm, të vlerësuar tashmë edhe nga institucionet e BE-së;

Vlerëson rezolutën e datës 26 nëntor 2009 të

Parlamentit European, në të cilën shprehet mbështetja që liberalizimi i vizave të mund të realizohet deri në korrik të vitit 2010;

Shpreh njëherazi kënaqësinë për përfundimin e misioneve të ekspertëve të Komisionit European dhe besimin se komisioni do të realizojë përgatitjen e raportit vlerësues në fillim të pranverës 2010, për t'i hapur rrugën marrjes së vendimit nga Këshilli i Bashkimit European për liberalizimin e vizave para muajit korrik të vitit 2010;

Mirëpret që Parlamenti European, vendet anëtare dhe Komisioni European të marrin në konsideratë përmbushjen e detyrimeve të udhërrëfyesit nga Shqipëria, si dhe konsensusin që ekziston mes të gjitha forcave politike të Republikës së Shqipërisë, për të arritur udhëtimin pa viza të qytetarëve shqiptarë në hapësirën Shengen, si pjesë e aspiratës së tyre për lirinë e lëvizjes.

Në emër të Komisionit të Jashtëm?

Zoti Beja, urdhëroni!

Fatos Beja – Falemnderit, zonja Kryetare!

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Në mbledhjet e tyre të datës 9 mars 2010, Komisioni për Politikën e Jashtme dhe Komisioni për Integrimin European morën në shqyrtim projektrezolutën e paraqitur nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, lidhur me lëvizjen e lirë dhe liberalizimin e vizave për shtetasit shqiptarë në hapësirën Shengen.

Shqyrtimi i kësaj projektrezolute u bë duke mbajtur parasysh qëllimin e rezolutës dhe realizimin e objektivit madhor për lëvizjen e lirë të qytetarëve shqiptarë në vendet e hapësirës Shengen.

Deputetët e të dy komisioneve treguan kujdes për saktësimin e disa aspekteve që lidhen me opinionin e Parlamentit European të datës 12 nëntor 2009, deklaratën e përbashkët të Parlamentit European dhe të Këshillit European, si dhe rezolutën e Parlamentit European të datës 26 nëntor 2009. Veç kësaj deputetët e të dy komisioneve trajtuan edhe aspektet e plotësimit të detyrimeve të kushteve të udhërrëfyesit nga Shqipëria, si dhe bashkëpunimin midis Qeverisë shqiptare dhe Komisionit European në muajt e fundit.

Komisioni për Politikën e Jashtme dhe Komisioni për Integrimin European vlerësuan gatishmërinë dhe përpjekjet e institucioneve komunitare europiane, për të realizuar sa më shpejt heqjen e regjimit të vizave për hapësirën Shengen pas përmbushjes së kushteve të nevojshme nga Shqipëria.

Deputetët e të dy komisioneve vlerësuan

angazhimin dhe mbështetjen e veçantë të Parlamentit European dhe të shumë europarlamentarëve të shquar, deklaratimet mbështetëse publike ose në Këshill të disa ministrave të Jashtëm të vendeve mike, si dhe angazhimin e Komisionit European si në deklaratën e përbashkët me Parlamentin European, ashtu edhe në bashkëpunimin me autoritetet shqiptare.

Të dy komisionet vlerësuan gjithashtu përparimin shumë të shpejtë dhe deçiziv që është bërë muajt e fundit nga Qeveria për plotësimin e të gjitha kushteve të udhërrëfyesit, për të përfutur heqjen e vizave për shqiptarët që udhëtojnë në vendet e hapësirës Shengen.

Ky përparim i konsiderueshëm krijon të gjitha mundësitë që ëndrra e vjetër e shqiptarëve për lëvizjen e lirë në Europë të mund të realizohet në muajt e ardhshëm.

Të dy komisionet mbështetën unanimisht nismën e Grupit të Partisë Demokratike si një domosdoshmëri që të gjitha grupet politike të Kuvendit të Shqipërisë të bashkojnë zërin e tyre me deputetët e Parlamentit European për të mbështetur heqjen sa më shpejt që të jetë e mundur të vizave për qarkullimin e lirë të qytetarëve shqiptarë në hapësirën Shengen.

Realizimi i këtij objekti madhor ka një rëndësi të drejtpërdrejtë për të gjitha familjet shqiptare dhe për konsolidimin e demokracisë në Shqipëri.

Komisioni për Politikën e Jashtme dhe Komisioni për Integrimin European, në diskutimet përkatëse, bënë edhe disa sugjerime, të cilat u mirëkuptuan edhe nga deputetët nismëtarë të Grupit të Partisë Demokratike.

Sot në seancën plenare ne paraqesim një variant të integruar të projektrezolutës, ku ftojme deputetët e të gjitha grupeve ta miratojnë dhe ta votojnë.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Beja!

Në emër të forcave politike, kush e dëshiron fjalën?

Po, zonja Dade, urdhëroni!

Arta Dade – Të nderuar kolegë deputetë,

Një projektrezolutë që lidhet me shprehjen e vullnetit për integrimin e Shqipërisë në familjen europiane sjell gjithmonë me vete frymën e konsensusit në Parlamentin e këtij vendi. Ndryshe nga tërësia e çështjeve të tjera që natyrshëm kanë shkaktuar e do të shkaktojnë kundërshti mes palëve, edhe pse shumë më tepër mund të kishim bërë për kulturën tonë ende primitive politike, çështja e

integritit të vendit në familjen e demokracive funksionale ka gjetur dhe do të gjejë gjithmonë gatishmërinë tonë për të kontribuar pa asnjë rezervë, me zemrën e mendjen pranë qytetarëve që aspirojnë këtë integritim, prej 20 vjetësh tanimë.

Partia Socialiste e ka parë kurdoherë me sytë e të gjithë shqiptarëve, pa dallim, ëndrrën e madhe të integritit europian të vendit dhe është angazhuar përgjatë këtyre dy dekadave, në qeveri apo opozitë, si bartëse dhe promotore e vullnetit të palëkundur mbarëkombëtar për Shqipërinë në NATO e në Bashkimin Europian. Historia e dëshmon këtë pa asnjë ekuivok.

Edhe prania jonë sot në këtë Kuvend, me të cilin kemi ende një problem madhor të pazgjidhur, pikërisht në lidhje me nevojën e patjetërsueshme për standarde europiane në themelin e jetës demokratike, e provon këtë pa asnjë fije dyshimi.

Sot është dita për ta përfaqësuar njëzëri ëndrrën e vjetër të të gjithë shqiptarëve, pavarësisht përkatësisë së tyre partiake, për të lëvizur më në fund lirisht në Europën e mrekullive të kulturës, dijes dhe lirive të njeriut. Partia Socialiste është këtu për ta bërë këtë.

Sot është dita për të shprehur njëzëri dëshirën e madhe të të rinjve dhe të rejave të Shqipërisë për të shëtitur pa asnjë pengesë në Europën e bukurive të rralla të artit, zbulimeve të magjishme të shkencës e kryqëzimit të mahnitshëm të kulturave. Partia Socialiste është këtu për ta bërë këtë.

Sot është dita për ta kërkuar njëzëri të drejtën e shumëprivuar të qindra e mijëra prindërve, motrave, vëllezërve e fëmijëve për të kapërcyer lirisht kufirin që i ndan prej 20 vjetësh nga njerëzit e tyre të zemrës dhe ata që janë në emigracion, duke shkuar e ardhur në Greqi, Itali e gjetkë po aq lehtësisht sa brenda Shqipërisë. Partia Socialiste është këtu për ta bërë këtë.

Sot është dita për të thënë të gjithë bashkë se Shqipërisë duhet t'i hiqen vizat përpara verës dhe se, pavarësisht të gjitha problemeve të mëdha të demokracisë dhe mangësive funksionale të shtetit tonë, shqiptarët, njerëzit e thjeshtë e të ndershëm të këtij vendi, nuk duhen të lihen më në radhë përpara dyerve të mbyllura të Europës për një vizë. Vizat duhet të hiqen edhe për ta, njësoj si për të gjithë të tjerët në rajon, pa prituri të kalojë edhe një vit apo edhe një verë, madje brenda kësaj vere. Partia Socialiste është këtu për ta bërë këtë.

Jemi këtu për të bërë gjënë e duhur për vendin, për interesat e njerëzve tanë, për vlerat e parimet e

forcës sonë politike, e cila sot ka ardhur të shprehë të njëjtin vullnet të pandryshuar që ka karakterizuar çdo qëndrim të saj kur ka qenë fjala për aspiratën e madhe të integritit.

Pa asnjë lëkundje e pa asnjë kompleks kemi qenë gjithnjë në anën e duhur të historisë në këto dy dekada lirie dhe në këtë drejtim do të jemi gjithnjë të gatshëm; të gatshëm siç ishim kur i propozuam Kuvendit të mëparshëm rezolutën për anëtarësimin në NATO apo kur ndërmorëm reformat përkatëse, duke marrë duartrokitjet e forta edhe të partnerëve ndërkombëtare; të gatshëm siç kemi qenë që në fillimet e këtij procesi, kur kemi propozuar dhe miratuar si maxhorancë masat që çuan në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit dhe hapën rrugën drejt statusit të vendit kandidat, i cili, fatkeqësisht, po vonon për shkak të keqqeverisjes; të gatshëm siç kemi qenë më parë edhe si opozitë, kur kemi dhënë konsensus për të gjithë bazën ligjore të domosdoshme për hapjen e liberalizimit të vizave, i cili, fatkeqësisht, është vonuar tej çdo mase, përsëri për shkak të keqqeverisjes.

Kolegë dhe kolege të grupit tjetër parlamentar, E quaj të udhës t'ju them shkoqur në emër të opozitës se ne kemi ardhur këtu për gjitha sa thashë më lart dhe aspak për të ngritur automatikisht dorën për një projektrezolutë, ku në thelb Partia Demokratike lavdëron punën e Partisë Demokratike dhe i kërkon përsëri Partisë Demokratike që të çojë më tej punën e Partisë Demokratike për të mirën e vendit.

E mira e vendit e do sot që ne të jemi shumë seriozë përballë sfidës aspak të lehtë të liberalizimit të vizave përpara kësaj vere dhe të mos biem nën nivelin që kërkon kjo sfidë. Lojërat politike të ditës nuk duhet të hyjnë në këtë fushë të aspiratës së madhe e të përbashkët të të gjithë bashkëqytetarëve tanë. Problemi i liberalizimit të vizave nuk mund të kthehet në një lojë politike me shqiptarët, të cilëve as duhet t'u tregoni, si gjithë këto kohë, gënjeshtërën e turpshme për opozitën që penguaka heqjen e vizave dhe as duhet t'u ofroni sot shfaqjen jodinjitoze të radhës për të larë gojën me shqiptarët në prag të një tjetër dështimi të mundshëm.

Prandaj le të biem dakord sot që të mos luajmë as me njerëzit dhe as me interesin e përbashkët të liberalizimit të vizave dhe të heqim nga projektrezoluta e propozuar prej jush elementet e propagandës suaj partiake, të cilat as e përshpejtojnë heqjen e vizave dhe as e bëjnë konsensual një dokument që vlerë të vetme ka

pikërisht konsensusin.

Në rast se futja e kësaj projektrezolute në rendin e ditës nuk është pjesë e lojës politike të ditës, por thjesht një lëvizje taktike për ta pasur opozitën në Kuvend, edhe jashtë axhendës sonë të vetme parlamentare, që është hetimi i zgjedhjeve, apo në të kundërt, për të vazhduar sulmin ndaj opozitës si pengesë për liberalizimin e vizave, atëherë tregojeni këtë duke pranuar vërejtjet tona, të cilat nuk cenojnë, por e forcojnë përmbajtjen e dokumentit në raport me çështjen e interesit të përbashkët, që është liberalizimi i vizave dhe, natyrisht, garantojnë konsensusin e Parlamentit në votimin e rezolutës, duke i dhënë kështu këtij dokumenti vlerën simbolike që i nevojitet në sytë e shqiptarëve e të gjithë komunitetit ndërkombëtar.

Ne nuk pranojmë që rezoluta të jetë një fletë-lavdërimi për Qeverinë, as nuk kërkojmë që në rezolutë të futen kritikata tona për Qeverinë. Qëllimi i kësaj rezolute nuk ka të bëjë as me njërin dhe as me tjetrën anë të debatit tonë për këtë proces, ku, sipas jush, Qeveria ka bërë mrekullira, ndërsa, sipas nesh, kjo Qeveri është fajtorja e vetme pse shqiptarët sot nuk lëvizin pa viza si maqedonasit, malazezët apo serbët. Prandaj le të ndajmë qartë përmbajtjen e rezolutës nga opinionet tona të papajtueshme për mënyrën sesi është qeverisur procesi drejt liberalizimit të vizave. Kjo rezolutë mund dhe duhet të jetë vetëm shprehje e asaj përmbajtjeje aspiratash e interesash që na bashkojnë në këtë proces si përfaqësues të një populli që në çështjen e integritetit nuk ka asnjë ndasi prej 20 vjetësh. Për këtë ka ardhur sot në sallë opozita dhe këtë kërkojnë sot shqiptarët prej nesh. Prandaj, në emër të grupit tonë parlamentar, ju kërkoj që, me konsensus, t'u japim këtë shqiptarëve sot në dokumentin e rezolutës.

Po në emër të grupit, dua të shpreh me këtë rast disa konsiderata të rëndësishme për vonesën e pajustificuar të Shqipërisë në këtë proces, që ju nga kjo foltore e jo vetëm nga kjo, e keni justifikuar në mënyrën më pak dinjitoze të mundshme, duke sharë opozitën, duke shpifur për të dhe për liderin e saj, duke trilluar shkaqe sa të paqena, aq edhe qesharake.

E kam dëgjuar vazhdimisht zotin Berisha t'u thotë shqiptarëve (edhe në seancën e kaluar) plot nga këto shkaqe të trilluara që zotëria i nxjerr nga thesi i tij i madh i gënjeshtreve, duke i lidhur si gjithnjë dështimet e tij me fajet që ua sajton dhe ua vë në kurriz socialistëve.

Po a nuk e premtoi zoti Berisha me tam-tamet

e zhurmshe të fushatës së tij të fundit elektorale liberalizimin e vizave që në korrikun e vitit 2009? Çfarë e pengoi Europën t'ia jepte Shqipërisë në korrik atë që zotëria e premtoi në qershor, vetëm e vetëm për t'u marrë votat, duke gënjyer si gjithnjë me të gjitha mjetet? Po vendimi i Bashkimit Europian i fundvitit 2009 pse nuk e përfshiu Shqipërinë në listën e vendeve përfituese nga heqja e regjimit të vizave, ku hynë Serbia, Mali i Zi dhe Maqedonia?

Duke u tallur me shqiptarët, zoti Berisha e lidhi edhe këtë dështim të Qeverisë së tij me socialistët dhe me kryetarin e Partisë Socialiste, ndërkohë që e vërteta është e thjeshtë: Bashkimi Europian është një organizëm serioz i nivelit më të lartë dhe merret me kriteret e trupëzuara në udhërrëfyesin e liberalizimit të vizave, shoqëruar këto me një proces rigoroz me objektiva e afate dhe jo me shpifje, sharje e thashetheme që konsumohen në debatin politik shqiptar nga Qeveria. Ai e la Shqipërinë të fundit në këtë proces të lidhur drejtpërdrejt me keqqeverisjen.

Standardet e udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave kanë të bëjnë me zbatimin e reformave më të rëndësishme në fusha të tilla, si: forcimi i shtetit të së drejtës, lufta kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe emigracionit të paligjshëm, forcimi i kapaciteteve administrative në kontrollin kufitar dhe siguria e dokumenteve. Është dështimi në mënyrë të përsëritur i qeverive të zotit Berisha në kryerjen e reformave në fushat e sipërpërmendura që i ka lënë shqiptarët ende në radhë pas dyerve të konsullatave dhe jo opozita shqiptare që ka dhënë konsensus e vetëm konsensus për të gjithë bazën ligjore te integritetit.

Presidenca suedeze e BE-së e ka rikonfirmuar në disa raste se: "Shqipërisë dhe Bosnje-Hercegovinës u janë dhënë të njëjtat kriteret kryesore, i njëjti udhërrëfyes, sikurse edhe Serbisë, Malit të Zi dhe të tjerëve. Këto vende do të duhej t'i bënin këto reforma, por ekspertët e komisionit ishin atje dhe ata nuk i kishin kryer". Flitet për reformat dhe për kriteret që duhet të zbatohet Qeveria, jo për llafe rrugësh që kryetari i Qeverisë i sjell deri në foltoren e Parlamentit për të justifikuar dështimin e pajustificueshëm në këtë proces.

Në kontrast me fqinjët tanë, të cilët e filluan pas nesh këtë proces, shqiptarët që nga viti 2005 kanë dëgjuar vetëm zotin Berisha t'u premtojë heqjen e vizave brenda gjashtë muajve pasardhës dhe megjithëse kanë kaluar plot 6-mujorë, ja, ku jemi, pas gjithë të tjerëve, në 6-mujorin e radhës, por sot me sytë nga Bashkimi Europian dhe jo më nga

Qeveria e Shqipërisë.

Ne socialistët e shprehim sot me forcë që Bashkimi Europian nuk duhet ta lërë më Shqipërinë prapa dyerve të konsullatave të tij, vizat duhet të hiqen përpara verës. Opozita socialiste nuk mund të akuzohet sot për asnjë nga përgjegjësitë e Qeverisë në vonesën e dukshme që ka Shqipëria në procesin e integritimit evropian dhe liberalizimit të vizave. Por as populli shqiptar nuk mund të lihet më në radhën 20-vjeçare për vizë, që të mund të lëvizë lirisht në Europë.

Nuk është faji i opozitës dhe, aq më pak, i njerëzve të thjeshtë të këtij vendi në zemër të Europës që Qeveria e zotit Berisha na ka lënë në fundin e listës së pritjes së pafund, kur të tjera vende rreth nesh, përfshi dhe ato që dikur shkaktonin luftëra dhe tragjedi në këtë rajon, sot i gëzohen lëvizjes së lirë dhe bëhen gati të gëzojnë statusin e tyre të ri në tryezën e Brukselit.

Në një kor të dëshpëruar, pala që qeveris sot vendin mbi kutitë e mbyllura të Ruzhdieve të shumta të 28 qershorit, ka bërë dhe bën këta muajt e fundit një përpjekje të dëshpëruar dhe të dështuar për të lidhur qëndrimin parimor të opozitës së bashkuar për transparencën e zgjedhjeve me vonesat e papranueshme në procesin e integritimit evropian.

Sa keq që shqiptarëve u ofrohet gënjeshtër si forcë qeverisëse dhe u fshihet e vërteta e krizës së procesit të integritimit, njësoj siç u fshihet edhe e vërteta e një krize ekonomike që po ha përditë themelet e stabilitetit social të vendit!

Sa keq që shqiptarëve u jepen me pahir përmes makinerisë mediatike, të vajisur përditë me paratë e klientelizmit, arsye për t'u ndarë e urryer, duke e treguar përditë me gisht opozitën siç tregohej dikur në regjimin e vjetër komunist armiku i brendshëm!

Sa keq që nuk e kuptoni, të dashur kundërshtarë dhe jo armiq, se nxitja e ndasisë dhe e urrejtjes për opozitën jo vetëm nuk është një vlerë integruese, por nuk është as një mënyrë për të na zbrapsur nga lufta jonë për një vlerë të madhe integruese siç është transparenca e zgjedhjeve!

Opozita ka qenë dhe mbetet e angazhuar për çdo hap që realisht e çon vendin drejt Europës. Por ashtu si deri më sot, do të na keni përballë, të vendosur, kundër çdo devijimi antidemokratik e abuzimi me detyrën madhore të qeverisjes së vendit për interesat tuaja aspak të mëdha. Të tilla devijime e abuzime, për fat të keq, keni bërë dhe po bëni çdo ditë e më shumë. Gënjeshtër nuk do t'ju mbajë edhe shumë kohë në këmbë. Kambanat po bien

përditë e më fort në veshët e shqiptarëve për ju.

Raportet e Departamentit Amerikan të Shtetit, të Transparency International, të Komisionit Europian dhe të agjencive të tjera me emër e reputacion të padiskutueshëm, kanë konstatuar se jetojmë në një demokraci të korruptuar, në një stabilitet të brishtë dhe jashtë standardeve të njohura demokratike. Këto raporte pasqyrojnë njëkohësisht edhe perceptimin popullor e qytetar për ditë e më të gjerë.

Shprehja hapur e pakënaqësisë popullore për një qeverisje klienteliste, të politizuar dhe të përfshirë nga korrupsioni e tarafet nuk mund të pengohet gjatë as me propagandën e ekraneve e gazetave të ushqyera me paratë e klientelizmit korruptiv dhe as me kërcënimet mafioze të pushtetit ndaj shtypit që nuk rreshtohet në anën e Qeverisë.

Nuk është faji i opozitës që Qeveria e zotit Berisha rrënjosi kulturën e pandëshkueshmërisë (sipas progresraportit 2009) dhe zgjodhi të integrojë brenda vetes aktorë dhe faktorë të të gjitha krimeve të bujshme shtetërore, që nga tragjedia e Gërdecit, korrupsioni në rrugën Durrës-Kukës, shembja e tunelit të Kalimashit, përmbytjet katastrofike në Shkodër, pa numëruar këtu padrejtësisë e përditshme të një pushteti që e ul Shqipërinë poshtë Ruandës e Ugandës në listën e vendeve më të korruptuara të planetit.

Nuk është faji i opozitës që Qeveria ndjek politika pa asnjë lidhje me standardin evropian, duke hedhur në rrugë prej vitesh ekspertët dhe duke afruar në administratë hyzmeqarët e oborrit qeveritar, duke shpërfillur ligjet e shërbimit civil, duke krijuar një qeverisje ngastrash, ku partitë zhvatin shtetin me përbindje dhe bëjnë tendera për çdo vend pune. Po bëhet gojëdhënë kombëtare zhvatja e organizuar që një partizë e vogël e koalicionit të korrupsionit e të rryshfetit qeveritar po kryen në ngastrën e vet. Nuk është faji i opozitës që Gjykata Kushtetuese e ka gjetur këtë shumicë parlamentare të sajuar më shumë se 20 herë në kundërshtim me Kushtetutën, ndërkohë që ne s'kemi pasur kohë fizike e mundësi t'i denoncojmë në gjykatë të gjitha shkeljet tuaja që e kanë kaluar numrin 30.

Më 4 shkurt 2010, pra vetëm para shumë pak kohësh, ju keni kryer një tjetër akt në kundërvënien të Kushtetutës dhe në kundërshtim me çdo standard evropian, keni bekuar aktin normativ nr.10 të Këshillit të Ministrave "Për buxhetin e shtetit 2009", 35 ditë pasi kishte mbaruar viti financiar. Janë tuajat këto breshëri antikushtetuese, jo të opozitës, zotërinj

të pushtetit, dhe opozita jo vetëm nuk gabon, por e ka për detyrë t'ju thotë se po vjen dita kur do të mbyteni në atë që vetë keni gatuar.

Nuk është faji ynë që ethet e pushtetit kanë denaturuar logjikën e qeverisjes, revanshi e babëzia kanë zënë vendin e arsyes së shëndoshë, lista e nevojave të klientëve partiakë ka dalë mbi listën e kërkesën e partnerëve evropianë për një shtet ligjor në shërbim të qytetarit.

Nuk është aspak faji i opozitës që ju sot po uzurponi të gjitha institucionet e shtetit, që nga shërbimet sekrete, entet e komunikacionit, televizionin kombëtar e deri te institucionet e drejtësisë, mbi të cilat bëmat e kësaj Qeverie janë traumatike dhe të kritikuar në mënyrë të përsëritur nga organizmat ndërkombëtarë dhe nuk do të jetë faji i opozitës nëse populli nuk do t'jua falë të gjitha këto, në rast se ju nuk do të hiqni dorë nga fshehja e gjurmëve të krimit elektoral të 28 qershorit, nga fshehja e shifrave të rrënimt ekonomik që i pret shqiptarët, nga kapja e shërbimit sekret për të kthyer kohën e zezë të viteve të sundimit të Saliut të parë.

Nuk është faji i opozitës që kutitë e Ruzhdijeve nëpër Shqipëri mbajnë brenda vota njerëzish që ditën e votimit kanë qenë qindra dhe mijëra kilometra larg fshatit të tyre, ashtu siç mbajnë, të paktën, 70 mijë identitete të rreme votuesish që, pa qenë fare, u janë shkruar numra të gënjeshtërt të kartave të identitetit e të pasaportave dhe u janë ngjitur pas emrit në shkrimet e bëra nga duart e përfaqësuesve të korrupsionit elektoral.

Nuk është faji i opozitës që e vetmja kuti e hapur deri më sot, nga 4700 të tilla në rang vendi, e cila ka habitur e revoltuar opinionin publik, mban gjurmën e thellë të një krimi të kryer nga njerëz të pushtetit që vazhdojnë të përdorin dhunë të hapur edhe sot, 9 muaj pas zgjedhjeve, mbi ata banorë që guxojnë të tregojnë hapur përjetimin e keq të ditës së votimit.

Opozita ka deklaruar hapur dhe pa asnjë mëdyshje se do t'i përmbahet parimit të saj se pa transparencën e zgjedhjeve dhe ushtrimin e të drejtës së hetimit të tyre nga Parlamenti, ky Parlament nuk ka legjitimitetin që i duhet për të bërë ligje për shqiptarët dhe Qeveria e dalë prej tij duhet të largohet nëse këmbëngul në shkeljen forcërisht të së drejtës së popullit për transparencë bashkë me të drejtën e opozitës për hetim parlamentar.

Paketa që kemi propozuar për zgjidhjen e kësaj krize, e cila që do të votohet javën e ardhshme, është një kontribut i drejtpërdrejtë për kauzën e zgjedhjeve të ndershme në Shqipëri, por edhe për

afrimin konkret të vendit me BE-në, përmes përmbushjes së standardeve me të cilat BE-ja na ka gjykuar dha na gjykon.

Edhe sot ju kërkojmë reflektim dhe lëvizje nga qëndrimi i shprehur në Komisionin e Ligjeve. Mos bëni gabimin të mendoni se do të rri mbi kutitë e Ruzhdijeve dhe do të keqqeverisni këtë vend edhe për shumë kohë, nëse nuk lejoni zbardhjen e krimit që ju mban në pushtet! Ne ju kemi ofruar tri herë kompromis, megjithëse ju zgjedhjet nuk i fituat në popull, por në kutitë e mbushura si në Ruzhdije dhe në tryezën e numërimit të vlerësuar "keq" dhe "shumë keq" të një të tretës së kutive.

Kemi njohur rezultatin e zgjedhjeve, kemi deklaruar se nuk do të kërkojmë ndryshimin e tij në tavolinë, edhe sikur hetimi të tregojë se ju nuk i keni votat për të qeverisur dhe jemi kthyer në Parlament në funksion të zgjidhjes së krizës me mjete parlamentare. Kurse ju nuk keni treguar asgjë tjetër veç kokëfortësisë për të mbajtur mbuluar atë që s'kemi kurajë ta shihni në dritën e diellit, të vërtetën e kutive ku rri mbyllur një nga veprat më të rënda korruptive që është bërë në këtë vend. Ne urojmë që ju bonsensin tonë të mos e lexoni gabim, duke e marrë si dobësi dhe të gjeni forcën për të treguar se doni një zgjidhje të qëndrueshme, jo një paqëndrueshmëri, por zgjidhje. Është në të mirën e vendit ta bëni. Është në të mirë tuaj ta bëni. Është në logjikën e gjërave ta bëni.

Zoti Berisha duhet ta ketë mësuar nga eksperiencia e tij e dikurshme si President se kokëfortësia në kundërshtim me të drejtën e popullit sovran ka kosto të lartë, ashtu siç duhet të ketë mësuar edhe nga eksperiencia e tij e dikurshme si kryepozitar se opozita është kauzë e jo numra. Ne vërtet urojmë që kauzën tonë ta bëni tuajën dhe që të bëhemi dy gjysma që punojmë për të njëjtin qëllim, duke e bërë transparencën jo për pushtetin e njëri-tjetrit sot, por për të mirën e Shqipërisë e të shqiptarëve nesër.

Dje, përfaqësuesja e lartë e BE-së për politikën e jashtme dhe sigurinë, Ketrin Eshtën, u shpreh se Bashkimi Europian duhet të kërkojë implementimin dhe realizimin e plotë të reformave për liberalizimin e vizave me këto vende, pra edhe me Shqipërinë, të cilën BE-ja e vlerëson, pa dyshim, edhe nga mënyra se si ne zgjidhim problemet tona.

Ne jemi këtu sot për të bërë në mënyrë evropiane një hap drejt Europës, duke votuar një rezolutë që nuk na ndan, por na bashkon me qëllimin e përbashkët të të gjithë shqiptarëve, liberalizimin e

vizave; një rezolutë në emër të të gjithë shqiptarëve, pa notat tuaja vetëlavdëruese dhe pa notat tona kritike për keqqeverisjen tuaj; një dokument konsensual që t'ia drejtojmë Europës ku duam të lëvizim lirisht një orë e më parë dhe jo njëri-tjetrit. Prandaj, ne e votojmë këtë projektrezolutë siç është, duke hequr në krye të preambulës së saj pjesën ku thuhet se "si përfaqësues të zgjedhur me dëshirën dhe me vullnetin e lirë të qytetarëve shqiptarë", si edhe duke hequr paragrafin e dytë ku flitet për arritje e suksese të Qeverisë, me të cilat ne nuk biem dakord dhe pa të cilat nuk cenohet aspak përmbajtja e rezolutës. Po ashtu, sugjerojmë që, për hir të seriozitetit të Parlamentit e të korrektesës ndaj partnerëve evropianë, të riformulohet pika 4, pasi Kuvendi nuk ka tagër t'i kërkojë Komisionit Evropian respektimin e një kalendari kohor. Komisioni Evropian është përgjegjës vetëm përpara Parlamentit Evropian.

Kolegë dhe kolegë deputetë, ne bëmë më të mirën, presim që ta bëni edhe ju që sot, që rezoluta të miratohet si rezolutë e të gjithë shqiptarëve për lëvizjen e lirë në Europë dhe jo si rezolutë e një partie që nuk lëviz nga qëndrimi i saj edhe kur asgjë e mirë nuk vjen nga kjo.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zonja Dade!
Urdhëroni, zoti Kryeministër!

Sali Berisha – Zonja Kryetare,
Të nderuara zonja deputete,
Zotërinj deputetë,

Të dashur qytetare dhe qytetarë shqiptarë,

Mora fjalën për të falënderuar shumë përzemërsisht zonjën Arta Dade, pavarësisht se rreshtoi një zinxhir kilometrik të pavërtetash, por ishte në rolin e opozitares dhe në vendin që ka opozita. Në këtë kontekst nuk dua të bëj asnjë koment nga ato që zonja e nderuar rreshtoi këtu, por e kam një keqardhje dhe këtë keqardhje shpresoj të ma pranojë zonjë Dade si keqardhje private.

Ju e dini, të nderuar deputete dhe deputetë, se çdo ditë, kur hapni shtypin, gjeni me germa kapitale këto dhe ato për Sali Berishën. Por a e dini ju se mua më bëhet qejfi? Pse? Sepse janë familje të tëra që marrin rrogat, që mbahen me ata tituj kapitalë. Ju keni dëgjuar të ashtuquajturit analistë apo pseudoanalistë që çdo ditë mbushin orë të tëra në mediat elektronike. Mua më bëhet qejfi, sepse paguhen aq majmërisht për të shpifur, por tek e fundit familjet e tyre jetojnë mirë dhe ky është qëllimi im. Shumë prej tyre përfitojnë aq shumë, sa ju garantoj

që marrin një rrogë 3-4 herë më të madhe se të Kryeministrit të vendit. Ta gëzojnë!

Mirëpo, keqardhja ime private është se ligjërata jote nuk të ndihmoi. Në qoftë se ka njeri në këtë sallë që nuk ka përfituar nga antiberishizmi je ti, e nderuar zonja Dade, dhe këtë gjeje se e ke aty, nuk e ke nga unë. Edhe këta politikanë që ndërtojnë karrierën mbi trillimet ndaj meje më bëjnë qejfin shumë, kur shkojnë e lartësohen e lartësohen. Por kur e bëjnë këtë punë dhe shkojnë poshtë, këtu ndiej dhimbje, ndaj dhe kjo ishte e vetmja keqardhje private që kisha për ligjëratinë. Por si politikë, unë të përgëzoj për fjalën që mbajte.

Jozefina Topalli - Falemnderit!

Ka kërkuar fjalën në emër të Grupit Parlamentar të LSI-së zoti Nasip Naço. Urdhëroni!

Nasip Naço – Falemnderit, zonja Kryetare!

Të nderuar zotërinj deputetë,

Marr shkas që në fjalën time të uroj deputetët e opozitës që erdhën në Parlament dhe t'u uroj atyre punë të mbarë.

Seanca e sotme ka një rëndësi të veçantë për vendin tonë dhe për bashkëqytetarët tanë. Ne sot jemi të gatshëm të hedhim një nga hapat më të rëndësishëm jo si një vend i veçantë i Ballkanit, por si një vend evropian. Duke miratuar rezolutën për liberalizimin e vizave shteti shqiptar tregon qartë se ai ka kryer shumicën e detyrimeve ndaj familjes europiane dhe sot i drejtohet Europës në emër të të gjithë shqiptarëve për realizimin e ëndrrës së hershme për të mos mbetur të izoluar në mes të Europës apo më thjesht, heqjes së regjimit të vizave me BE-në.

Të nderuar kolegë, për Shqipërinë dhe shqiptarët liberalizimi i vizave vlen më shumë se një post, vlen më shumë se një mandat, vlen edhe më shumë se pushteti i kujt do qoftë, qoftë ky edhe kryetar partie. Prandaj asnjë prej nesh, as si parti apo si individ, asnjë kryetar partie, nuk ka të drejtë qoftë dhe ta mendojë të shtyjë për më tutje afatin e këtij vendimi. Pritshmëria e shqiptarëve është e lartë, po ashtu edhe padurimi, pasi janë dhjetëra vjet që ata mbështeten mureve të ambasadave, madje edhe përbuzen jo pak herë nga zyrtarë të veckël ambasadash, me vetëm një ëndërr: të jenë të lirë të udhëtojnë në Europë. E përsëris edhe një herë se këtë ëndërr nuk ka të drejtë ta prishë askush, qoftë ky kryetar partie apo lidhësi i saj, qoftë kjo edhe një parti e tërë, sepse nuk është e moralshme që për hir të interesave të ngushta të një njeriu të vetëm apo të disa njerëzve, heqja e regjimit të vizave të

ribëhet sërish një mollë e ndaluar për Shqipërinë dhe shqiptarët. Deri më sot një pjesë e kolegëve tanë opozitarë e kanë parë heqjen e regjimit të vizave si një kështjellë e cila nuk duhet pushtuar apo më mirë të pushtohet sa më mirë të jetë e mundur dhe vetëm kur këta misionarë të jenë në qeverisjen e vendit.

Në këtë kontekst unë kam vërejtur edhe mospjesëmarrjen e tyre në punët e Komisionit të Integritimit pak ditë më parë, ku u diskutua për këtë rezolutë. Me dyshim shoh edhe vendimin e Grupit Parlamentar të PS-së për hyrjen në Kuvend vetëm për projektrezolutën, sepse natyrshëm e kuptoj se nuk mund të dalin kaq hapur kundër heqjes së vizave përpara anëtarëve dhe simpatizantë të tyre, por edhe të të gjithë shqiptarëve, si brenda dhe jashtë vendit.

Sot, gazeta e opozitës hapej me shkronja kapitale dhe i bëhej thirrje Europës nëpërmjet kryetarit të opozitës për liberalizimin e vizave për të gjithë shqiptarët dhe hipokrizia qëndronte se pak më poshtë, me shkronja pak më të vogla, flitej për kartat e falsifikuara që u përdorën në zgjedhjet e 28 qershorit.

Në vitet e para të demokracisë, midis të tjerave, në memorien time është fiksuar edhe një debat politik, ku një nga përfaqësuesit tuaj, që edhe sot është në këtë sallë dhe i përket gardës së vjetër të PS-së, midis të tjerave ka deklaruar se demokracia është një tortë e mirë, por nuk e ruan shijen nëse i hedhim disa pika vajguri. (Më falni, nëse nuk e kam cituar saktë!)

Të nderuar deputetë të opozitës, kësaj torte të mirë të demokracisë për liberalizimin e vizave, që shqiptarët po e presin me padurim, ju nuk po i hidhni disa pika vajguri, por të gjitha depozitat e mundshme të vajgurit që ju kanë mbetur mbas zgjedhjeve të 28 qershorit. Këtë sasi vajguri, të derdhur mbi këtë tortë të demokracisë për liberalizimin e vizave, unë e shikoj edhe në deklaratat dhe veprimet e kreut të opozitës, të cilat ushqejnë me zor opinionin publik vendas dhe të huaj, se janë falsifikuar dhe manipuluar zgjedhjet e 28 qershorit, se klasa politike në Shqipëri është në krizë.

Po, zotërinj deputetë, është e vërtetë se në Shqipëri ka një krizë. Kjo krizë është në lidhshëm me PS-së. Të flasësh ndryshe dhe të vepros ndryshe, kjo nuk është gjë tjetër veçse hipokrizi përballë shqiptarëve. Nëse kryetari i opozitës do vërtet një Shqipëri europiane dhe i do vërtet shqiptarët më pranë Europës e që të lëvizin lirisht në Europë, duhet

të veprojnë dhe punojnë si europian, sepse asnjë udhëheqës europian nuk përpiqet që nëpërmjet bojkotit të bllokojë prej 8 muajsh institucionet e vendit dhe krizën e tij politike të 28 qershorit ta transferojë edhe në jetën politike të vendit.

Të nderuar kolegë,

Duhet të jemi të vetëdijshëm se liberalizimi i vizave për Shqipërinë nuk do të thotë se ne do të bëhemi pjesë e BE-së menjëherë. Duhet të jemi të vetëdijshëm se, pas kësaj, të gjitha reformat e ndërmarra nga Qeveria shqiptare dhe të gjitha arritjet e saj, duhen mbajtur dhe duhen thelluar duke treguar qartë se vendi ynë është serioz në kërkesat e tij dhe po aq serioz është dhe në premtimet dhe angazhimet e tij. Edhe opozita duhet të jetë po aq serioze në premtimet, veprimet dhe angazhimet e saj në të mirë të Shqipërisë dhe shqiptarëve.

Unë besoj dhe shpresoj se, me votimin e rezolutës së sotme, ne tregojmë qartë vullnetin e të gjithë shqiptarëve për të qenë qytetarë europianë, por bashkë me vullnetin e tyre ne duhet të tregojmë edhe vullnetin tonë, vullnetin e klasës politike, se jemi në shërbim të shqiptarëve, si brenda dhe jashtë vendit.

Të nderuar kolegë, nga miratimi i kësaj rezolute nuk ka për të përfituar kapital politik as PD-ja, as PS-ja, as LSI-ja, por të gjithë shqiptarët, si brenda, edhe jashtë vendit. Shërbimi më i mirë që ne u bëjmë sot shqiptarëve është të mos ua vrasim ëndrrën në asnjë lloj mënyre, pasi janë dhjetëra vjet që ata mbështeten mureve të ambasadave, madje dhe përmbeten për të vetmen ëndërr: të jenë të lirë të udhëtojnë në Europë.

Grupi Parlamentar i LSI-së do të votojë pro kësaj rezolute.

Ju falemnderit!

Jozefina Topalli- Falemnderit, zoti Naço!

Zoti Dule, urdhëroni!

Vangjel Dule – E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë,

E mora fjalën për të shprehur pa as më të voglin ekuivok mbështetjen e PPDNJ-së për përshpejtimin dhe realizimin sa më shpejt të jetë e mundur të liberalizimit të vizave për qytetarët shqiptarë. Duhet, në fakt, ta kishim arritur. Qytetari shqiptar e meriton, pasi ai përpiqet për ditë të ngrejë për vete, për familjen, për fëmijët e tij të ardhmen europiane. E meriton komuniteti shqiptar që përpiqet të ngrejë përditë jetën mbi terma europiane, prandaj, duhet, të gjithë, me përkushtim, të investojmë të gjitha kapitalet tona politike për realizimin kësaj ëndrre

dhe objektivave historike për qytetarët dhe shoqërinë tonë.

Më lejoni ta thjeshtëzoj pak mesazhin e këtij debati. Çfarë është liberalizimi i vizave? Është lidhja e një marrëveshjeje dhe implementimi mes dy palëve. Cilat janë këto dy palë? Është BE-ja dhe Republika e Shqipërisë. Shikojmë dhe e pohojmë se manifestohet përditë që njëra palë, BE-ja, në të gjitha nivelet e veta: Parlamenti, Komisioni, vendet anëtare, i shërbejnë kësaj marrëveshjeje me korrektësi absolute dhe, nëse do të ishte për palën europiane, kjo nuk do të mbetej sot një ëndërr, por do të ishte realitet.

Nëse sot e kësaj ditë mbetet ende ëndërr, përgjegjësia rëndon vetëm mbi njërin palë dhe nuk duhet ta kërkojmë shumë larg. Kjo përgjegjësi rëndon mbi Qeverinë, mbi çdo qeveri, mbi Parlamentin. Këtu, në këtë sallë, janë përgjegjësitë dhe këtë nuk e them për demagogji. Na takon edhe neve si PBDNJ një pjesë e përgjegjësive, si pjesëmarrës në Parlament apo edhe në qeveritë e mëparshme. Nëse duam që ky mesazh të jetë një mesazh i besueshëm për pranuesit e tij, për BE-në dhe instancat e tij, duhet të pranojmë me përgjegjshmëri të gjitha ato mosrealizime që janë evidente në këtë proces. Duhet që, krahas marrjes përsipër të këtyre përgjegjësive, të angazhohemi, se të gjithë do të punojmë së bashku, për të realizuar një orë e më parë të gjitha detyrimet.

Më lejoni t'ju them se nuk është vendi që në një rezolutë të tillë të ofrojmë dafina. Dafina? Përse? Për ato që nuk realizuam dot? Ndaj, së bashku me këto vlerësime, doja të konkludoja edhe me një propozim: pasi ta kemi rishkruar këtë rezolutë në frymën europiane, në frymën përfaqësuese të të gjitha forcave politike, duke hequr ujërat e tepërta dhe autologjizmat që i thurin lavde veprimtarisë së njëres apo tjetres parti, apo qeverisë, t'i mësojmë mesazhit të fortë se ne, shoqëria, politika, Qeveria dhe Parlamenti, jemi të gatshëm për të realizuar në një kohë sa më të afërt maksimalisht të gjitha detyrimet tona. Së bashku me këtë rezolutë, për shkak të mosfunksionalitetit të shumë komisioneve parlamentare, le të ngremë sot edhe një grup *ad hoc* nga të gjitha partitë, i cili do ta bëjë më të besueshme këtë rezolutë në dyert e të gjitha kancelarive europiane. Vetëm kështu do t'i shërbejmë në të vërtetë realizimit, deri në muajin qershor-korrik të këtij viti, të kësaj ëndrre të çdo qytetari shqiptar.

Çdo ditë e humbur, në kuadër të mesazheve të

gabuar, do të rëndojnë në realizimin e këtij objektiv dhe nuk kemi kohë për të humbur. Nuk duhet në asnjë mënyrë që shansin e qershor-korrikut ta humbasim kësaj radhe.

Ju falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderi, zoti Dule!

Zoti Basha, urdhëroni!

Lulzim Basha – Falemnderi, zonja Kryetare, Të nderuar kolegë deputetë,

Lëvizja pa viza e qytetarëve shqiptarë drejt hapësirës Shengen është projekti kryesor dhe prioriteti më i madh imediat i Qeverisë dhe maxhorancës. Konteksti i ndryshëm historik dhe përvoja e veçantë e Shqipërisë, në raport me vendet e tjera të rajonit në drejtim të lëvizjes që qytetarëve drejt vendeve të Europës Perëndimore dëshmon pikënisjet e ndryshme që ne patëm në këtë proces me dimension rajonal.

Shqipëria ka përjetuar izolimin më të thellë dhe më të gjatë nga të gjitha vendet e tjera të bllokut lindor, duke ofruar në këtë këndvështrim një rast unik. Ndërkohë, një tablo krejt tjetër ekzistonte për vendet e tjera të rajonit, qytetarët e të cilëve mund të vizitonin lirisht vendet e Europës Perëndimore, madje edhe mund të punësoheshin atje, ndërkohë që në Shqipëri viktima të panumërta linin kokën dhe jetën e tyre në klonin e rrethuar me tela me gjemba.

Njëkohësisht, ne u gjendëm përpara rrethanave të reja, kur rreth 1/3 e qytetarëve shqiptarë emigruan jashtë vendit dhe ndërtuan atje jetë të tjera.

Duke njohur të gjitha këto zhvillime në Shqipëri dhe në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, BE-ja vendosi të ndërtojë një proces të qartë, të matshëm dhe konkret për liberalizimin e regjimit të vizave me vendet tona. Për këtë u hartua një udhërrëfyes, i cili iu dorëzua Shqipërisë zyrtarisht në qershor të vitit 2008. Udhërrëfyesi është i ndërtuar në katër blloqe detyrimesh. Blloku i parë, siguria e dokumenteve. I dyti, migrimi, menaxhimi i kufirit dhe ripranimi; i treti, rendi publik dhe siguria; i katërti, marrëdhëniet me jashtë dhe të drejtat themelore. Gjatë gjithë kësaj kohe ka pasur një proces intensiv ndërveprimi me Komisionin Europian, ku pala shqiptare ka dorëzuar informacion të përditësuar për shkallën e përbushjes së kriterëve të udhërrëfyesit.

Të dhënat e paraqitura nga pala shqiptare janë verifikuar nga grupe ekspertësh të BE-së, të cilët kanë zhvilluar inspektime në terren, kanë ballafaquar vërtetësinë e të dhënave dhe japin rekomandime për përmirësime të mëtejshme. Në raundin e vlerësimeve të para, në mars-maj 2009, KE-ja konsideroi se

Shqipëria kish bërë progres të dukshëm. Por, gjithashtu, evidentoi disa sektorë ku nevojitej përpunimi i mëtejshëm.

Një nga detyrimet kyçe për t'u plotësuar ishte prodhimi dhe shpërndarja e pasaportave biometrike, proces i cili filloi relativisht vonë, për shkak të periudhës së zgjedhjeve të përgjithshme në vend, ku e gjithë vëmendja u përqendrua në prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit.

Në periudhën janar-qershor 2009, prioriteti nr.1 i shtetit shqiptar ishte përgatitja e infrastrukturës zgjedhore, si parakusht për evoluimin e mëtejshëm të marrëdhënieve Shqipëri- BE, test i cili u kalua me sukses të plotë. Ndaj, pritshmëritë tona për vlerësimin e Komisionit Europian në 15 korrik 2009 për liberalizimin e vizave ishin realiste, edhe kur u bë propozimi zyrtar për heqjen e regjimit të vizave me Maqedoninë, Serbinë dhe Malin e Zi, të cilat përfituan nga lëvizja e lirë më 19 dhjetor të vitit që shkoi. Nga shtatori 2009, për vetë ndjeshmërinë dhe rëndësinë historike që ka ky proces për qytetarët tanë, e gjithë vëmendja, energjitë dhe angazhimi u përqendruan në etapat e fundit të këtij procesi, i cili po zhvillohet njëkohësisht në disa drejtime. Së pari, në përfundimin e të gjitha detyrimeve që përmban udhërrëfyesi. Së dyti, në dialogun me strukturat e BE-së, Komisionin, Këshillin dhe Parlamentin Europian. Së treti, në dialogun me vendet anëtare, të cilave, gjithashtu, iu bënë me dije të gjitha arritjet tona në këtë kuadër.

Ju informoj shkurtimisht për zbatimin e detyrimeve për çdo bllok.

Blloku i parë - siguria e dokumenteve.

Pasaportat biometrike janë një nga detyrimet kyçe të udhërrëfyesit, pasi vetëm qytetarët e pajisur me pasaporta biometrike do të kenë të drejtën të udhëtojnë pa viza drejt hapësirës Shengen. Ashtu sikurse është konstatuar nga të gjithë ne, Shqipëria ka shënuar një revolucion të vërtetë në dokumentet biometrike, si kartat e identitetit, ashtu edhe pasaportat. Ka një kapërcim galopant nga regjistrat e vjetër manualë, në një sistem të kompjuterizuar dhe të sigurt të dhënash, nga seriali i pafund i certifikatave në karta identiteti multifunksionale.

Falë këtij sistemi modern, të sigurt dhe efikas, ritmi i shpërndarjes së pasaportave biometrike rezulton të jetë më i larti në rajon dhe tejkalon çdo parashikim tonin apo të BE-së. Numri i pasaportave biometrike ka arritur në 510 mijë dhe i kartave të identitetit në 2 milionë. Të rëndësishme janë edhe aspektet e sigurisë së dokumenteve të Qendrës së

Personalizimit, programet e suksesshme antikorupsion, procedimi i menjëhershëm i të dhënave të pasaportave të humbura, të cilat mbyllin plotësimin e të gjithë detyrimeve për këtë bllok. Nga 14-17 dhjetor 2009 u zhvillua raundi i dytë i misionit të ekspertëve të BE-së për këtë bllok, në përfundim të të cilit u konkludua se pala jonë i ka përmbushur të gjitha çështjet e mbetura, që nga vizita e fundit e ekspertëve në mars 2009.

Blloku i dytë - migrimi, menaxhimi i kufirit dhe ripranimi.

Në këtë bllok ka pasur përmirësime themelore nëpërmjet vënies në funksionim të teknologjive të reja, nga më të avancuarat në Europë, për menaxhimin e integruar të kufijve. Arritja më domethënëse është instalimi dhe funksionimi i plotë i sistemit *TIMS* në të 24 pikat e kalimit kufitar.

Së fundi, ka përfunduar, me mbështetjen e ICITAP-it, krijimi i moduleve për elektronik-vizën dhe elektronik-leje-qëndrimin, të cilat janë instaluar në sistemin *TIMS* dhe janë aktualisht në funksion dhe përdorim nga policia kufitare dhe strukturat e Ministrisë së Brendshme, zyrat e punës dhe shërbimet konsullore të Ministrisë së Jashtme, të cilave u është mundësuar aksesimi në këtë sistem. Ka përfunduar dhe është vënë në funksion të plotë regjistri elektronik i të huajve me qëndrim të rregullt në Shqipëri.

Shqipëria po implementon me sukses të plotë dhe pa asnjë vërejtje të gjitha marrëveshjet e ripranimit me BE-në. Është unifikuar sistemi i kontrollit në pikat e kalimit kufitar sipas parimit *one stop shop*, që përfshin kontrollin e dokumentacionit doganor dhe fitosanitar; është ngritur dhe funksionon Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare për kontrollin kufirit detar; janë miratuar dhe janë tashmë në zbatim të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore për kontrollin dhe survejimin e kufirit mbi bazën e strategjisë dhe planit të veprimit për menaxhimin e integruar të kufirit. Gjithashtu, janë miratuar të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore për zbatimin e ligjit mbi azilin dhe planin e veprimit për zbatimin e ligjit "Për të huajt".

Para dy javësh ka nisur puna në qendrën e re me parametra europianë, për pritjen dhe qëndrimin e emigrantëve me qëndrim të paligjshëm në vendin tonë. Ka përfunduar instalimi i 63 lexuesve të rinj optikë për kontrollin dhe leximin e pasaportave biometrike në të 24 pikat e kalimit kufitar. Funksionon plotësisht në 12 drejtori të policisë në qarqe dhe në 8 drejtoritë rajonale të kufijve të

migracionit sistemi i analizës së informacionit kriminal *MEMEX* dhe në të gjitha pikat e kalimit kufitar ka një lidhje në kohë reale me bazën e të dhënave në Interpol.

Të gjitha të dhënat e mësipërme kanë qenë objekt i verifikimi në terren të ekipit të ekspertëve të BE-së javën e fundit të shkurtit. Në bazë të informacioneve paraprake, nga konsultimet me këta ekspertë, kemi bindjen e plotë se në konkluzionet e tyre do të konstatohet se pala shqiptare i ka përmbushur të gjitha çështjet e mbetura që nga vizita e fundit e ekspertëve të bllokut në 2 mars të vitit 2009. Por, Qeveria shqiptare nuk është mjaftuar vetëm me plotësimin e këtyre kritereve. Në përputhje me objektivat e programit të Qeverisë, ne i kemi tejkualuar këto kërkesa të Bashkimit Europian. Kështu, ka përfunduar procesi i instalimit të pajisjeve për leximin automatik të targave të automjeteve dhe është mundësuar lidhja me bazën e të dhënave për automjetet e vjedhura në 4 pikat e kalimit kufitar, si dhe po përfundon dhe një e pestë. Është instaluar sistemi i monitorimit me kamera në 9 pika të kalimit kufitar dhe po vazhdon puna në 10 pika të tjera. Blerja e 4 pajisjeve për kontrollin e drogave "Videoscope" me 2 drejtime leximi në pikën e kalimit kufitar të Kapshticës, në portin e Vlorës dhe në atë të Durrësit, do të rrisin aftësitë e policisë për detektimin e substancave narkotike. Këtë muaj pritet të përfundojë ndërtimi i 10 pikave të reja të kalimit kufitar dhe rikonstruksioni i 20 ambienteve për monitorimin e kufirit, të realizuara me mbështetjen financiare të BE-së.

Në Aeroportin e Rinasit funksionon një sistem ultramodern i identifikimit dhe analizës automatike të të dhënave biometrike të imazhit facial. Ndërsa në Tiranë funksionon dhoma operationale e Policisë Kufitare dhe Migracionit që ndërlidhet në kohë reale, me imazhe dhe të dhëna elektronike, me të gjitha instalimet e Policisë Kufitare dhe agjencive të tjera që operojnë në kufi anembanë Shqipërisë.

Blloku i tretë - Rendi publik dhe siguria

Ky është blloku më kompleks i udhërrëfyesit, pasi çështjet që trajtohen në këtë bllok janë më pak të matshme dhe kërkojnë një punë dhe angazhim afatgjatë. Prioritet i rëndësishëm ka qenë dhe mbetet zbatimi i strategjisë kundër krimit të organizuar, trafiqeve dhe terrorizmit, sipas planveprimit me masat për çdo institucion sipas një kalendarit të qartë, që në thelb sigurojnë ndërtimin dhe funksionimin e mekanizmave të nevojshëm. Në vijim të miratimit dhe hyrjes në fuqi të ligjit të ri

kundër krimit të organizuar, të njohura si amendamentet antimafia, zbatimi i tij, strategjia dhe planveprimi monitorohen me rigorozitetin më të madh dhe në mënyrë sistematike nga Komiteti Ndërinstitucional për Masat kundër Krimit të Organizuar, Trafiqeve dhe Terrorizimit.

Para disa javësh Kuvendi i Shqipërisë rinovoi moratoriumin për mjetet e shpejta lundruese, çka garanton në vazhdimësi efektet e duhura në luftën kundër krimit të organizuar.

Për sa u përket rezultateve të përgjithshme lidhur me masat kundër krimit financiar, vetëm gjatë vitit 2009 janë konfiskuar 3,8 milionë euro në llogari bankare dhe tashmë pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri kundër krimit të organizuar pritet që këto rezultate të njohin ngritje substanciale.

Gjithashtu, deri në janar 2010 janë identifikuar 383 veprave penale me 84 autorë të arrestuar dhe 15 të shpallur në kërkim, ndërsa numri i rasteve të raportuara në agjencitë e zbatimit të ligjit gjatë vitit 2009 është 194.

Janë organizuar 10 operacione të policisë ndaj 113 autorëve, nga të cilët 47 janë ndaluar dhe arrestuar, 67 ndiqen në gjendje të lirë dhe 2 janë shpallur në kërkim.

Në luftën kundër trafikimit të drogës është në zbatim strategjia dhe planveprimi përkatës. Vetëm për periudhën 15 nëntor 2009 -22 janar 2010 janë evidentuar 77 raste me 101 autorë të identifikuar, 82 persona të arrestuar, 16 në ndjekje penale, në gjendje të lirë, dhe 3 në kërkim.

Siç evidenton qartë edhe raporti i Departamenti Amerikan të Shtetit, Shqipëria nuk është më rrugë tranziti e preferuar e drogës. Në raport thuhet se si rezultat i masave të marra nga Qeveria shqiptare, trafiku i heroinës ka pësuar rënie të ndjeshme vit pas viti. Raporti konstaton se policia shqiptare ka arritur nga viti në vit të sekuestrojë sasi të mëdha të heroinës dhe se sasia e heroinës afgane që mbërrin në brigjet italiane është minimale. Objektiviteti i këtij raporti konfirmon edhe një herë se Shqipëria vit pas viti po përmirëson indikatorët dhe përmbush objektivat e saj për të qenë vendi më armiqësor ndaj këtij trafiku në rajonin e Ballkanit.

Policia shqiptare ka ndërmarrë me sukses të plotë një numër operacionesh të përbashkëta me policitë e vendeve fqinje dhe me ato të Bashkimit Europian dhe konsiderohet sot publikisht një partner i besueshëm dhe i përkushtuar në mes tyre.

Përdorimi i teknikave speciale të hetimit ka njohur një bum të vërtetë. Si gjatë vitit 2009 në tërësi,

dhe në veçanti në periudhën shtator 2009 - shkurt 2010, përdorimi i këtyre teknikave, pra i hetimit aktiv ka qenë pesëfish më i lartë se hetimi reaktiv. Në të 12 qarqet e vendit është instaluar dhe funksionon sistemi MEMEX i analizës së informacionit kriminal dhe janë trajnuar afro 300 oficerë policie për ta operuar atë. Bazuar në informacionin e siguruar nga aksesit në sistemin MEMEX është kryer për herë të parë nga Drejtoria e Analizës së Informacionit Kriminal vlerësimi mbi rrezikun e aktivitetit të grupeve kriminale për vitin 2008 dhe për vitin 2009.

Lufta kundër korrupsionit është përqendruar si në parandalimin e tij, nëpërmjet masave rregullatore, si: shërbimet *one-stop-shop*, shërbimet online etj; ashtu edhe në bashkëpunimin ndërmjet agjencive për identifikimin, kapjen dhe dënimin e të gjithë autorëve të akteve korruptive.

Vazhdon zbatimi i strategjisë dhe planveprimit të integruar antikorrupsion. Gjatë periudhës nëntor 2009-janar 2010 janë identifikuar 35 vepra penale që kanë të bëjnë me korrupsionin dhe shpërdorimin e detyrës, me 59 autorë, nga të cilët 26 janë arrestuar, 31 janë në ndjekje penale në gjendje të lirë dhe 2 në kërkim. Në total, gjatë periudhës shtator 2009 - shkurt 2010, janë arrestuar 55 zyrtarë me akuzën e korrupsionit dhe shpërdorimit të detyrës.

Në datën 15 dhjetor 2009 në Tiranë filloi zbatimi i projektit të përbashkët 3-vjeçar të ndihmës teknike të Bashkimit Europian dhe Këshillit të Europës për të mbështetur Qeverinë shqiptare në zbatimin e strategjisë ndërsektoriale për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit dhe për qeverisje transparente, me një fond prej 2 milionë eurosh, bashkëfinancim i Bashkimit Europian dhe Këshillit të Europës. Ky është një nga 24 projektet prioritare të Qeverisë shqiptare në kuadrin e Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimi 2008 (IPA).

Në kuadër të bashkëpunimit gjyqësor, miratimi në dhjetor i ligjit për bashkëpunimin gjyqësor me autoritetet e huaja në çështjet penale dhe fillimi i negociatave për nënshkrimin e marrëveshjes me EUROJUST për bashkëpunimin gjyqësor, pritet të sjellin gjatë këtij viti një përmasë të re bashkëpunimi ndërkombëtar me partnerët tanë. Është duke u zbatuar me rigorozitet strategjia kombëtare për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe fëmijëve, sipas planveprimeve përkatëse tashmë të miratuara. Janë një sërë masash të ndërmarra në këtë kuadër, të cilat kanë çuar në heqjen nga lista të Shqipërisë si vend tranzit për trafikimin e qenieve njerëzore dhe në menaxhimin më rigoroz të këtij fenomeni në vend.

Gjatë vitit 2009 ka vazhduar puna e agjencive të zbatimit të ligjit për hetimin e akteve kriminale të trafikimit dhe ndjekjen penale të personave përgjegjës për kryerjen e këtyre krimeve. Janë organizuar 13 operacione të policisë për trafikimin e grave dhe 8 operacione kundër përdorimit për prostitucion, ushtrimit të prostitucionit dhe posedimit të lokaleve për prostitucion, gjatë të cilëve janë arrestuar 29 persona. Janë organizuar operacione kundër lypjes në qarqet e Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit dhe që nga dhjetori i vitit 2009 është duke u zbatuar nga policia plani operativ kundër lypjes dhe shfrytëzimit të fëmijëve.

Gjatë 3 muajve të fundit të vitit 2009 ka pasur përmirësime të kuadrit ligjor në këtë drejtim, veçanërisht për sa u përket masave në drejtim të mbrojtjes për viktimat e trafikimit.

Miratimi sot nga Kuvendi i ligjit "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" përmirëson ndihmën financiare që viktimat e trafikimit përfitojnë gjatë dhe pas largimit nga institucionet e asistencës sociale deri në punësimin e tyre. Gjithashtu, ligji i ri për parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikimit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë parashikon krijimin e një fondi të veçantë për parandalimin e kriminalitetit, që do të shërbejë për të rritur shërbimet për viktimat dhe kompensimin e tyre.

Këtë vit ka pasur një rritje të fondeve për Qendrën Kombëtare të Pritjes me 24%, krahasuar me vitin 2009. Ndërkohë, Qeveria ka miratuar një paketë të veçantë financiare për të ndihmuar strehëzat e koalicionit antitrafik të shoqërisë civile, bashkëpunimi me të cilat ka shënuar rezultate të dukshme gjatë kësaj kohe.

Gjatë vitit 2009, 82 viktima të trafikut të qenieve njerëzore janë riintegruar dhe 38 janë trajnuar profesionalisht, pa pagesë, nga zyrat rajonale të punës. Janë ndërtuar njësi për mbrojtjen e fëmijëve në nivel bashkiak, të cilat janë përgjegjëse për identifikimin, mbrojtjen, ndihmën dhe integrimin e kësaj kategorie të fëmijëve. Numri i fëmijëve të trajtuar në këto qendra në Tiranë, Korçë, Elbasan, Berat arrin në 1394. Komitetet rajonale antitrafik kanë vazhduar në mënyrë sistematike mbledhjet e tyre në komunitetet ku ato veprojnë për të diskutuar raste konkrete të shfrytëzimit, ose për të asistuar persona në nevojë. Në bashkëpunim me OSBE-në janë organizuar trajnime të anëtarëve të këtyre komiteteve, ku numri i të trajnuarve është mbi 300 vetë. Gjithashtu, vazhdon marrja e masave për

parandalimin e këtij fenomeni nëpërmjet organizimit sistematik të fushatave ndërgjegjësuere, edukimit, punësimit, regjistrimit dhe ndërtimit të një sistemi për të parandaluar punën e fëmijëve. Gjatë vitit 2009 janë trajnuar 270 personelë policorë të niveleve dhe strukturave të ndryshme, 200 gjyqtarë, prokurorë dhe oficerë të Policisë Gjyqësore. Është punuar intensivisht në drejtim të përmirësimit të procedurave të raportimit për identifikimin e rasteve të trafikimit. Funksionimi dhe menaxhimi i bazës së të dhënave për viktimat e trafikimit do të shërbejë për të pasur një vizion më të qartë lidhur me situatën e trafikimit në Shqipëri dhe identifikimin e formave të shfrytëzimit të viktimave të trafikimit. Për vitin 2009 janë identifikuar, referuar dhe kanë marrë ndihmë 94 viktima të trafikut, nga të cilët 22 janë fëmijë dhe 72 janë të rritur.

Blloku i katërt - marrëdhëniet me jashtë dhe të drejtat themelore.

Dy detyrimet e mbetura nga ky bllok përfshinin angazhimin tonë në kuadër të Dekadës së Romëve, si dhe ligjin e ri "Për antidiskriminimin". Për të parën, tashmë janë adoptuar si strategjia kombëtare ashtu edhe planveprimi, dhe ky është një projekt afatgjatë. Ndërsa ligji "Për antidiskriminimin" u miratua në Kuvend më 4 shkurt të këtij viti. Edhe detyrimet e përshkruara nga ky bllok konsiderohen të mbyllura nga ne.

Këto janë arritjet e Shqipërisë në katër blloqe. Për përfaqësuesin e opozitës kjo është prapambetje, për ne ky është rikuperim nga koha kur krerët e bandave shëtisnin me makinat zyrtare, kur ata që prisnin kokat e qytetarëve gëzonin imunitetin e plotë të zyrës. Për ju është prapambetje, por për BE-në, SHBA-në dhe partnerët tanë ky cilësohet progres i dukshëm dhe i qëndrueshëm. Mohimi i këtij realiteti nga aktorë në këtë Kuvend, sikur të kenë ardhur këtu për herë të parë nga një fluturim nga ndonjë ishull i Paqësorit dhe jo sikur të jenë ata bashkëpërgjegjës për tetë vjet keqeverisje dhe bashkëqeverisje me krimin, është i pamoralshëm.

Autoritetet e vendit janë në komunikim konstant me të gjitha strukturat e BE-së për të marrë çdo vlerësim dhe rekomandim të tyre, duke ndjekur deri në përmbushje zbatimin e këtyre detyrimeve. Qeveria ka paraqitur një seri raportimesh me shkrim pranë Komisionit Europian, si dhe janë zhvilluar takimet e dialogut të drejtpërdrejtë, duke përcjellë me vërtetësi, seriozitet dhe në cilësinë e duhur të gjitha rezultatet e përmbushjes së detyrimeve të udhërrëfyesit. Të njëjtën përjasje kemi pasur edhe

me vendet e Bashkimit Europian, të cilat po kështu kanë ndjekur hap pas hapi këtë proces, duke shkëmbyer vizita të ndërsjella me qëllim njohjen sa më të thellë dhe realiste të arritjeve tona. Më lejoni të veçoj këtu mbështetjen, përkrahjen dhe inkurajimin e strukturave komunitare, si miratimin me shumicë dërrmuese në Parlamentin Europian të rezolutës dhe deklaratës së përbashkët, ku Parlamenti Europian dhe Këshilli angazhohen për një trajtim urgjent të propozimit për liberalizimin e vizave me Shqipërinë, menjëherë sapo Komisioni të vlerësojë përmbushjen e detyrimeve të mbetura nga udhërrëfyesi.

Mesazhe të fuqishme politike në drejtim të përmbylljes brenda afateve të përcaktuara të këtij procesi kanë vijuar nga përfaqësues të lartë të vendeve anëtare. Në mënyrë të veçantë, qëndrimi përkrahës i vendeve fqinje, anëtare të BE-së, për përshejtimin e këtij procesi dhe përmbylljen e tij pa vonesa, përforcojnë bindjen dhe angazhimin tonë për përfundimin me sukses të këtij procesi. Po përmend këtu mbështetjen e fuqishme të ofruar nga ministri i Brendshëm italian, Maroni, gjatë vizitës së tij në Shqipëri, përkrahjen e ofruar nga ministri i Brendshëm i Spanjës, Rubalcana, në cilësinë e kryetarit të radhës të Këshillit Europian për Punët e Brendshme dhe Drejtësinë, letrën e përbashkët të ministrit të Jashtëm italian, Frattini, dhe atij slloven, Zbogar, drejtuar Presidencës suedeze të Bashkimit Europian për trajtimin me prioritet të kësaj çështjeje nga Komisioni, si dhe qëndrimin mbështetës të Austrisë dhe Greqisë në letrën e përbashkët të ministrave të Jashtëm drejtuar përfaqësueses së lartë të BE-së për politikën e jashtme dhe sigurinë, Catherine Ashton, për përshejtimin dhe përfundimin e procesit brenda vitit 2010.

Së fundi, deklaratat e ministrave të Brendshëm të Europës Juglindore të mbledhur në Tiranë i bën thirrje Bashkimit Europian të njohë progresin e arritur nga Shqipëria dhe Bosnjë-Hercegovina në përmbushje të detyrimeve të udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave dhe të përshejtojë procesin e vendimmarrjes, për të garantuar lëvizjen e lirë të qytetarëve të dy vendeve sa më parë të jetë e mundur.

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Më 26 shkurt u përmbyllën të gjitha misionet e vëzhgimit për bllokun 2 dhe 3. Në mars pritet hartimi dhe dorëzimi në Komisioni i raporteve të ekspertëve. Pas kësaj, Komisioni pritet të hartojë raportin, i cili më pas do të diskutohet në Këshill nga grupi i punës për vizat. Paralel me këtë, pra në të njëjtën kohë,

do të hartohet propozimi për ndryshimin e Rregullores 539/2001 për regjimin e vizave, i cili do të kalojë për miratim në Këshill dhe në Parlamentin Europian. Koha e vendimmarrjes nga institucionet e ndryshme europiane do të jetë përcaktuese për shpejtësinë e procesit.

Vetëm gjatë këtyre ditëve kanë ardhur mesazhe nxitëse në këtë drejtim nga Iniciativa Europiane për Stabilitet, rapoterja për procesin e liberalizimit të vizave në Parlamentin Europian, Tania Fajon, dhe kryetari i Komisionit të Parlamentit Europian për Punët e Brendshme, Lopez Anguillar, ku Komisionit Europian i kërkohet të paraqesë raportin përfundimtar për konsultim brenda dy javëve të para të prillit me qëllim që Parlamenti Europian të jetë në gjendje ta marrë në shqyrtim propozimin legjislativ për heqjen e vizave para pushimeve të verës.

Në këtë kuadër, projektrezoluta e paraqitur nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, që do të miratohet sot në Kuvend, është një sinjal i qartë dhe i fortë i mbështetjes pa rezerva që ky Kuvend, maxhoranca dhe minoranca i japin këtij procesi jetik për të gjithë qytetarët shqiptarë, pa dallim bindjeje politike.

Përparimi i Shqipërisë në këtë proces është i dukshëm, konkret, i qartë dhe i gjithëpranuar. Në të njëjtën kohë, ne do të vazhdojmë të ruajmë ritmet e angazhimit tonë deri në përmbylljen e plotë të tij, heqjen e vizave me BE-në për qytetarët tanë.

Ju ftoj ta votojmë.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit!

Zoti Ruçi, urdhëroni!

Gramoz Ruçi – Zonja Kryetare,

Të nderuar deputetë,

E mora fjalën për procedurë, meqë jemi duke diskutuar për projektrezolutën, përpara se të trajtoja mendimin lidhur me sugjerimet që bëri zonja Dade. Meqë u nis me një keqardhje private nga Kryeministri, edhe unë desha ta nisja me një keqardhje private.

Zonja Dade nuk foli në emër të saj, por në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, në emër të popullit opozitar. Ajo nuk foli anti-berishizëm, por tha opsionet, sugjerimet, vërejtjet, këndvështrimin e opozitës për këtë problem dhe jo vetëm të opozitës, por edhe të Departamentit të Shtetit, BE-së dhe Këshillit të Europës dhe mjaft institucione ndërkombëtare.

Pra, meqë ishte fjala për keqardhje private, edhe unë ndiej një keqardhje private.

Zoti Berisha, rruga e vetme që gjetët për t'u përballur me ato që tha kolegja jonë, ishte përpjekja për të thyer mendimin dhe fjalën e saj, dhe jo vetëm të sajën, por edhe të shoqërisë civile dhe analistëve, që ju paskan ngelur merak dhe gjetët këtë moment për t'i anatemuar edhe ata. Në vend që të nxirrni përgjegjësinë, ju iu shmangët kësaj përgjegjësie. Megjithatë, këtu nuk merremi me keqardhje private dhe ne si opozitë sot nuk jemi për këtë.

Sot ne kemi ardhur këtu për përgjegjësitë kolektive dhe është gjë e mirë që kjo përgjegjësi kolektive u shpreh qartë në mbështetjen e të gjitha forcave politike parlamentare për liberalizimin e vizave. Kjo është shumë esenciale. Njëherësh, u bënë edhe dy propozime. Një propozim maksimal u bë nga zoti Dule, i cili kërkoi të riformulohet e gjithë rezoluta dhe një propozim minimal u bë nga zonja Dade në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, ku kërkohet të hiqej paragrafi provokativ lidhur me atë çështje shumë të debatueshme, këtu e 6 muaj, që kemi pozitë-opozitë, ku flitet dhe perfrazohet apo konfirmohet vota e lirë apo vullneti i lirë i qytetarëve shqiptarë, e cila nuk prek thelbin e rezolutës, megjithëse kemi diferencë e këndvështrime të ndryshme për këtë çështje.

Në fjalën e saj në emër të Grupit tonë Parlamentar, zonja Dade theksoi që pika 2 nuk e prek thelbin e rezolutës. Pra, ashtu sikurse nuk duhet që në këtë rezolutë të gjejmë vend vërejtjet që kemi ne për ju, po ashtu s'ka vend në rezolutë për vetëlavdërimet tuaja, në një rezolutë ku shprehet vullneti politik.

Pra, thelbi i rezolutës nuk preket, por konfirmohet ajo që na bashkon të gjithëve. Prandaj, sugjerimi dhe propozimi ynë është që të dyja forcat politike të shprehemi me votën tonë për vullnetin politik që na bashkon dhe këto dy gjëra të rregullohen në draftin përfundimtar të rezolutës.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Ruçi!

Zoti Kryeministër, urdhëroni!

Sali Berisha – Dua të theksoj se kërkesa për të fshirë arritjet është një kërkesë bizare, sepse në rast se nuk do të kishte arritje, nuk besoj që ne do të bënim hipokrizinë e votimit të kësaj rezolute.

Unë mund t'ju them, zoti Ruçi, se në këtë proces dhe në këtë problem, në plotësimin e udhërrëfyesit për heqjen e vizave, ka një kontribut të jo më pak se 40 institucioneve dhe agjencive të këtij vendi.

Në gjithë komponentët që ministri Basha paraqiti këtu përpara jush është munda, djersa, përkushtimi

i qindra e mijëra punonjësve të institucioneve shtetërore të këtij vendi. Pra, të gjitha institucionet dhe agjencitë kanë dhënë kontributin e tyre. Procesi i kërkesës për heqjen e vizave është një proces i bazuar tërësisht mbi meritën dhe jo mbi mëshirën. Absolutisht! Ky është një proces i bazuar mbi performancën dhe masat konkrete dhe nuk është asnjëherë ndryshe dhe nuk mund të jetë ndryshe.

Nuk mund ta imagjinoj që Parlamenti të kërkojë heqjen e vizave pa shprehur një vlerësim për një punë *enorme* që është bërë, për reformat e thella që janë ndërmarrë, për praktikën e reja që janë vendosur, për kostot e mëdha që janë përballuar nga taksapaguesit. E vetmja gjë që mund të pranoj me kënaqësi si kompromis është të mos themi “çmoj arritjet e Qeverisë”, por të autoriteteve shtetërore shqiptare, ato të institucioneve shqiptare. Jam plotësisht dakord. Por pse duhet të votojmë një rezolutë në të thatë? Në qoftë se nuk janë bërë gjërat, le t'i themi. Ja, ku jemi.

Arritje janë, zotërinj, sepse sot keni pasaportat biometrike më moderne dhe më të avancuara në Europë. Këtë nuk e them unë, ma kanë thënë disa kolegë të mi europianë. Dhe këto po i paguajnë qytetarët shqiptarë. Nuk mund ta thoshim këtë, në qoftë se në çdo pikë kufitare nuk do të ishte vendosur sistemi TIMS. Por ky sistem, është vendosur, sepse është i domosdoshëm për kontrollin e kufijve, është një kërkesë e prerë, është investim, dhe taksapaguesit shqiptar kanë paguar për këtë. Gjithashtu, është sistemi MEMEX, apo një seri reformash të tjera.

Të nderuar zotërinj,

Heqja e vizave për Shqipërinë dhe shqiptarët vjen duke vlerësuar një realitet të ri të krijuar në këtë vend, në identifikimin, në kontrollin e tij. Ndaj kompromisi këtu mund të bëhet duke e zgjeruar spektrin me institucionet apo autoritetet shtetërore. Si të doni! Kjo është. Por që ne të heqim një vlerësim për këtë punë, është e pakuptimtë.

Unë do ta formuloj në këtë mënyrë (se kanë

frikën e vullnetit, e heqim vullnetin, zotërinj): “Në përmbushje të misionit të Kuvendit, si përfaqësues të zgjedhur të qytetarëve shqiptar”. Jeni dakord? Kaq.

Ja, pra që e kisha private keqardhjen unë, i nderuar zoti Ruçi. E dini vetë ju, sepse unë nuk përtoj, sepse e kam gjysmën opozitare, gjysmën qeveritare. Unë kam zor ta frenoj. Por e kisha private, e dinë ata.

Jozefina Topalli – Atëherë e hedhim në votim rezolutën bashkë me këtë kompromis.

Po, zoti Ruçi, urdhëroni!

Gramoz Ruçi – Zonja Kryetare,

Ky Parlament nuk e ka për herë të parë miratimin e rezolutave, që kanë të bëjnë me integrimin e Shqipërisë si në BE, edhe në NATO. Është e disata herë që ka pasur një vullnet të mirë midis palëve për këto çështje. Dhe për të disatën herë kemi proceduar: pasi kemi shprehur mendimet edhe këtu në sallë, kemi rënë dakord në parim dhe kemi ngarkuar dy kolegë nga një krah dhe dy kolegë nga krahun tjetër për të rregulluar gjërat për të cilat diskutuam dhe nuk është nevoja që të bëjmë debate.

Jozefina Topalli – Falemnderit!

Atëherë, votojmë projektrezolutën “Për liberalizimin e vizave në BE”.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

127 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi miraton projektrezolutën “Për liberalizimin e vizave në BE”.

Urimet më të mira!

Falënderoj të gjitha grupet parlamentare për votimin e projektrezolutës “Për liberalizimin e vizave në BE”.

Me kaq mbyllet seanca.

Natën e mirë!

Mirupafshim!

(Seanca u mbyll në orën 21:00)

E enjte, 18.03.2010
Seanca e pasdites, ora 17:00

Drejton seancën Kryetarja e Kuvendit,
zonja Jozefina Topalli (Çoba)

Rendi i ditës:

1. *Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit"*.

2. *Projektvendimi për ngritjen e Komisionit Hetimor për zgjedhjet e 28 qershorit 2009.*

Jozefina Topalli – Hapim seancën.

Për sot në rendin e ditës kemi pasur disa pika, por në Konferencën e Kryetarëve kemi vendosur që ato të hiqen të gjitha, qoftë projektligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën ndërkombëtare për nxjerrjen e anijeve të mbytura", qoftë projektligji "Për hapësirat urbanistike", qoftë projektligji për SHISH-in dhe çdo gjë tjetër. Është hequr edhe 60-minutëshi dhe sot në rendin e ditës do të kemi vetëm diskutimin dhe shqyrtimin e projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit", paraqitur nga Partia Socialiste, si dhe kërkesën për ngritjen e komisionit hetimor për hetimin e shkeljeve të ligjit në përgatitjen dhe zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në qershor 2009.

Atëherë hapen diskutimet. Në bazë të Rregullores, grupi që ka paraqitur kërkesat e merr fjalën i pari.

Kush dëshiron të flasë nga Grupi i Partisë Socialiste?

Zoti Xhafaj.

Fatmir Xhafaj – Të nderuar kolegë deputetë,

Në respekt të shtetit të së drejtës, të pavarësisë të pushtetit gjyqësor, të rregullave të lojës dhe për hir të interesave afatshkurtër dhe afatgjatë të vendit, Partia Socialiste ka njohur vendimet ligjore që kanë prodhuar rezultatin legal të zgjedhjeve të 28 qershorit. E kemi bërë një gjë të tillë pavarësisht kontestimeve që kemi bërë ndaj tyre në procesin e ankimimit legal dhe rezervave që kemi shprehur politikisht dhe juridikisht.

Por fakti që kemi pranuar si përfundimtar dhe të pakthyeshëm vendimin e organeve shtetërore të ngarkuara me administrimin dhe vlerësimin e zgjedhjeve nuk do të thotë në asnjë mënyrë se nuk kemi të drejtë të kërkojmë të bëjmë transparencë, të kërkojmë të mësojmë se cila është e vërteta e

rezultatit që qëndron i kyçur në kutitë e zgjedhjeve, se cili është vullneti real i shqiptarëve.

Kontestimet tona për administrimin e procesit dhe nxjerrjen e rezultatit zgjedhor janë bërë publike. Kontestime shumë konkrete janë bërë, gjithashtu, edhe në raportin e arbitrit. Sot, edhe 8 muaj pas ditës së zgjedhjeve, provat dhe faktet e reja që po dalin në dritë nuk ofrojnë gjë tjetër veçse edhe më shumë bindje për cilindo se qeverisja e djeshme e siguroi qeverisjen e sotme jo mbi vullnetin e shprehur dhe të lexuar qartë të qytetarit shqiptar, por mbi deformimin dramatik të vullnetit të zgjedhësve dhe të vetë ligjit të miratuar konsensualisht.

Ka një pikë ku ne konvergojmë me Kryeministrin e sotëm. Ai ankohet për humbje të mandateve për partinë e tij, çka në thelb presupozon në mënyrë identike të njëjtin shqetësim që kemi ngritur edhe ne prej kohësh. Ne jemi të gatshëm të dëgjojmë, të hetojmë dhe t'u japim të drejtë pretendimeve të Kryeministrit, nëse kjo e drejtë ekziston, madje dhe të kërkojmë ndjesë dhe të heqim dorë nga mandatet. Për ne e vërteta e asaj që ka ndodhur dje është më e rëndësishme nga çdo mandat. Do të mjaftonte qoftë edhe ky detaj për të mos diskutuar më gjatë për nevojën e ngritjes së komisionit hetimor parlamentar dhe domosdoshmërinë e hetimit pa kushte dhe transparent të asaj çfarë ka ndodhur në të shkuarën, për të mos u përsëritur në të ardhmen.

Ajo që ne kërkojmë është thjesht dhe vetëm të verifikohet si është zbatuar ligji i miratuar nga Kuvendi prej disa organeve administrative, të prodhuara, gjithashtu, nga vendimmarrja e këtij Kuvendi dhe për të cilin ai ka detyrimin kushtetues dhe ligjor të kontrollit dhe veprimit, si dhe të analizojë ecurinë e një procesi si kusht për nxjerrë problematikat dhe nevojat për përmirësimin e ligjit ekzistues. Më qartë se kaq nuk mund të thuhet dhe nuk mund të bëhet. Kjo veprimtari është konform Kushtetutës dhe të gjitha vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, vendime të cilat deri dje keni qenë po ju që i keni përgojuar dhe sulmuar.

Projektligji që ne kemi paraqitur në vlerësim të asaj që ka ndodhur me interpretimin e gabuar të ligjit zgjedhor dhe të eksperiencave joefektive të komisioneve të mëparshme hetimore, synon të detajojë ligjin ekzistues për të shmangur çdo paqartësi në zbatimin e tij për sa i përket mjeteve

dhe provave të hetimit.

Në vlerësimin tonë nuk mund të ketë hetim parlamentar për zgjedhjet pa këqyrur dhe vlerësuar atë çfarë përbën thelbin e vetë procesit zgjedhor: kutitë zgjedhore. Gjithçka tjetër do të ishte një akt formal, një ngjarje e paralajmëruar, hetim i dështuar i radhës. Pretendimi për moshapjen e kutive zgjedhore nga komisioni hetimor parlamentar do të qëndronte vetëm nëse këtë ndalim do ta urdhëronte një normë juridike ose një vendim gjyqësor i formës së prerë.

Për rastin në fjalën mungon si njëra, ashtu edhe tjetra. Nuk ka asnjë normë juridike që të ketë në përmbajtjen e vet një urdhërim të tillë, nuk ka asnjë normë të tillë që të ndalojë komisionin hetimor të Kuvendit të këqyrë materialin zgjedhor që gjendet në kutitë e votimit, përkundrazi. Nuk ka asnjë vendim gjyqësor që në përmbajtjen urdhëruese apo në përmbajtjen në tërësi të tij të urdhërojë një ndalim të tillë, përkundrazi.

Për më shumë, ky komision hetimor parlamentar nuk parasheh dhe nuk synon të marrë të pandehur askënd; nuk parasheh dhe nuk synon të ngrëjë akuza penale ndaj ndokujt; nuk parasheh dhe as nuk synon të kontrollojë apo edhe të vlerësojë bazueshmërinë në ligj dhe rregullsinë e vendimeve gjyqësore apo të prokurorit. Ai nuk synon dhe nuk ka të drejtë të rishikojë vendimet që ka marrë Kolegji Zgjedhor. Komisioni hetimor parlamentar, gjithashtu, nuk merr dhe nuk ushtron asnjë prej kompetencave të mësipërme, nuk bën atë për të cilën janë ngarkuar gjykatat, pra administrimin e drejtësisë. Komisioni hetimor parlamentar synon të kryejë të gjitha veprimet procedurale që janë të domosdoshme për t'u informuar për mënyrën e zbatimit të ligjeve gjatë procesit zgjedhor, nxjerrjen e përgjegjësive institucionale, parandalimin e fenomeneve negative për të ardhmen, si dhe amendimin e ligjeve përkatëse.

Veç mungesës së argumentit ligjor, refuzimit tuaj për hapjen e kutive zgjedhore, sa kohë që pranoi se objekti i hetimit parlamentar mund të jetë edhe aspekti administrativ i nxjerrjes së rezultatit, i mungon edhe shkaku logjik për refuzim. Si mundet të hetohet nga komisioni përkatës parlamentar edhe aspekti zgjedhor që ka të bëjë me nxjerrjen e rezultatit të zgjedhjeve nëse nuk bëhet krahas këqyrjes së tabelave të rezultateve edhe këqyrja e fletëve të votimit që janë në kutitë e votimit. Absurdi i arsytimit shkon deri te moskëqyrja e atyre fletëve të votimit apo materialeve zgjedhore që nuk janë

bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor. Pretendimi i kolegëve të mi të maxhorancës për moshapjen e kutive për shkak të një vendimi gjyqësor, do të mund të konstatohej si lehtësisht i pabazuar, edhe në rast se do të arsyetonim brenda logjikës së përdorur prej tyre.

Do të kërkoja vëmendjen tuaj, të nderuar kolegë, dhe në mënyrë të veçantë të Kryeministrit, i cili e ka trajtuar gjerësisht në fjalimet e tij publike këtë çështje, për dy arsyetimet ligjore të mëposhtme:

Së pari, duke iu referuar saktësisht dispozitave të Kodit Zgjedhor rezulton se ka dy lloj kutish, kutia e votimit me fletët e votimit dhe kutia me materialet e votimit. Edhe nëse arsyetohet sipas pretendimit tuaj se hapjen e kutive nuk e lejojnë vendimet gjyqësore, një gjë e tillë do të rezultonte tërësisht e pasaktë për shkak se mosmarrëveshja juridike në gjykatë ka qenë e lidhur me të drejtën procedurale për rinumërimin dhe rivlerësimin e fletëve të votimit dhe jo me kutitë e materialeve të votimit. Duke vijuar me këtë lloj arsytimi, atëherë sipas kësaj logjike nuk do të rezultonte asnjë pengesë, të paktën për të hapur kutitë e materialeve zgjedhore përderisa nuk ka një vendim gjyqësor që të jetë shprehur për këto kuti.

Së dyti, marrim të mirëqenë logjikën e përdorur, sipas nesh sigurisht të gabuar, por gjithsesi është arsytimi juaj, se vendimi i kolegjit eventualisht interpretohet si shkak ndalues për hapjen e kutive në njësitë zgjedhore objekt shqyrtimi. Pyetja shtrohet se cili vendim gjyqësor, edhe sipas këtij arsytimi, ndalon hapjen e kutive që u përkasin njësitë të tjera zgjedhore që nuk kanë qenë objekt i shqyrtimit gjyqësor. Vendimet e Kolegjit Zgjedhor janë për tri zona të caktuara dhe ato kanë fuqi të lidhur me mosmarrëveshjen për objektin e caktuar të gjykuar nga ky kolegji. Asnjë vendim gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, përveç vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, kur gjykon mbi kushtetutshmërinë e akteve normative nuk ka fuqi me efekt të përgjithshëm. Përderisa në gjykimin e zakonshëm vendimet gjyqësore nuk kanë efekt të përgjithshëm, por vetëm efekt midis palëve dhe vetëm për palët, ato nuk e shtrijnë efektin e tyre në zonat zgjedhore që nuk i janë nënshtruar gjykimit gjyqësor. Edhe nga kjo pikëpamje, duke arsyetuar gjithmonë brenda logjikës së argumentit tuaj, rrëzohet pseudoargumenti i paraqitur për të kufizuar mjetet e hetimit për shkak të vendimeve të gjyqësorit, sidomos në zonat e tjera që nuk i janë nënshtruar shqyrtimit gjyqësor.

Debati i gjerë në Komisionin e Ligjeve kishte një vlerë të rëndësishme sepse saktësoi shumë gjëra, një pjesë edhe të panjohura për opinionin publik. Kolegët e mi socialistë prezantuan në komisione dy opinione ligjore shumë të çmuara të Komisionit të Venecias, që argumentojnë qartazi se objekti, mjetet dhe provat e hetimit të kërkuara nga minoranca nuk mund të kufizohen. Ky ishte, gjithashtu, një tjetër argument në favor të faktit se përpjekjet politike për ta futur këtë proces në rrugë pa krye, duke kërkuar komente mbi komentet dhe interpretime mbi interpretime, do të ishin, pa dyshim, marrëzija politike e radhës.

Prezantuar, gjithashtu, një precedent të qartë, të hapjes së kutive zgjedhore pas mbylljes së procesit zgjedhor dhe daljes së rezultatit përfundimtar nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Kolegjit Zgjedhor. Precedenti është i vitit 2005, kur KQZ-ja e asaj periudhe vendosi dhe organizoi hapjen e kutive zgjedhore me kërkesë të komisionit hetimor parlamentar të asaj kohe. Natyrisht, ka një ndryshim: në vitin 2005 kutitë u hapën se kontrolloheshin zgjedhjet parlamentare, në të cilat përgjegjëse ishte Qeveria socialiste, ndërsa në 2009-n, kutitë nuk mund të hapen, se kontrollohen zgjedhjet tuaja.

Prezantuar, gjithashtu, precedentë të ngjashëm për hapjen e kutive zgjedhore pas shpalljes së rezultatit përfundimtar nga parlamenti dhe organizata të vendeve të tjera demokratike, si rasti i SHBA-së, Irlandës, etj., argumentuar me shembuj konkretë trajtime të ngjashme nga legjislatoni në disa vende demokratike evropiane me përvojë shumë të konsoliduar në këtë fushë, si: Britania, Gjermani, Italia, etj. për të drejtën e opozitës për moskufizimin në objekt, në mjetet dhe provat e marra nga komisioni hetimor etj.

Tashmë, pas kësaj paraqitjeje gjithçka është e qartë. Në mbrojtje të iniciativës dhe kërkesës sonë është Kushtetuta, ligji dhe vendimet interpretuese të Gjykatës Kushtetuese, janë komentet ligjore të Komisionit të Venecias. Këtë standard mbështesin precedentët shqiptarë dhe ndërkombëtarë për hapjen e kutive. Pra, gjithçka është e qartë si drita e diellit. S'ka asnjë lloj kufizimi ligjor e procedural, por vetëm një shkak, dhe ai është politik: mungesa e vullnetit politik për të bërë transparencën e zgjedhjeve të shkuara dhe kryesorja, për të garantuar ndershmërinë e zgjedhjeve të nesërme. Kjo është arsyeja pse ne kemi thënë dhe vazhdojmë të theksojmë se zgjidhja e krizës është politike dhe

politika duhet të marrë përgjegjësitë që i takojnë, duke i dhënë zgjidhje kësaj krize. Kjo është e vërtetë e thjeshtë politikisht.

Të nderuar kolegë, për PS-në dhe opozitën në tërësi është e papranueshme që rezultati i zgjedhjeve të ardhshme të jetë produkt i sistemit elektoral që ka minuar tradicionalisht standardet e proceseve zgjedhore në Shqipëri dhe që qëndron në themel të krizës politike në vend. Ky proces hetimi parlamentar nuk është në asnjë mënyrë një betejë për marrjen e pushtetit në tavolinë, por është mundësia e vetme që tavolina e nesërme e pushtetit të mos jetë e helmuar nga dyshimi, nga vjedhja dhe deformimi i vullnetit të votuesit shqiptar.

Projekti ynë është një mundësi për zgjidhjen e krizës, një mundësi për bashkëpunimin e palëve; projekti ynë është një propozim me hapësira konkrete për ta gjetur rrugën e bashkëpunimit jo për ta mbyllur atë. Qëndrimi ndaj iniciativës sonë për hetimin e plotë përfundimtar dhe pa kushte të zgjedhjeve të trukuara të 28 qershorit është vija që ndan 2 botë, të shkuarën tonë problematike dhe të nesërmen e garantuar.

Rrëzimi i këtij projekti do të ishte një hap mbrapa dhe me pasoja. Nëse ju merrni këtë vendim, çështja nuk shtrohet më se çfarë ndodhi me zgjedhjet e qershorit, por se çfarë do të ndodhë me zgjedhjet e pritshme. Pas kësaj, do të duhet të themi me zë shumë më të lartë, do të duhet të reagojmë shumë më fuqimisht, sepse zgjedhjet e ardhshme janë në rrezik, liria e votës mbetet e dhunuar, demokracia mbetet seriozisht e kërcënuar.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Xhafaj!

Zoti Gumi, urdhëroni!

Viktor Gumi – Falemnderit, zonja Kryetare!

Të nderuar anëtarë të kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, me vendimin e Kuvendit nr. 24, datë 04.03.2010 është caktuar komision përgjegjës për projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8891, datë 02.05.2002 "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit", nismë ligjvënëse e deputetëve të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në mbledhjen e datës 8 mars 2010 caktoi si relatorë të projektligjit anëtarët e tij, zotin Viktor Gumi dhe zotin Saimir Tahiri. Në këtë mbledhje u bë prezantimi i projektligjit nga

deputeti Damian Gjijnuri.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në mbledhjet e tij të datave 9, 11, 15 dhe 16 mars 2010 zhvilloi procedurat për shqyrtimin në parim dhe nen për nen të projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8891, datë 2.05.2002 "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit".

Pas relatimit të paraqitur nga relatorët, u zhvillua seanca e pyetje-përgjigjeve për përmbajtjen e projektligjit dhe çështjet e shtruar nga dy relatorët si dhe diskutimi në parim.

Tema për të cilën diskutohet dhe kërkohet vendimmarrje është një nga çështjet më të debatueshme, e parë kjo jo vetëm në kuadrin e jurisprudencës kushtetuese shqiptare, por edhe më gjerë, atë europiane. Shpesh, tema e komisioneve hetimore shkakton kontraversitet të lartë politik, kjo për hir të ngarkesës së pashmangshme që mbart natyra e kësaj kërkesë për komision hetimor. Por edhe vetëkufizmet, veçanërisht të Kuvendit, si institucion themelor në respektimin e shtetit të së drejtës, ndarjes së pushteteve si dhe të drejtave dhe lirive të mbrojtura me Kushtetutë.

Sikundër edhe kushtetutat e tjera të demokracive të reja, Kushtetuta shqiptare njeh dhe mbron në nivelin maksimal kërkesat e minorancës në Parlament, si një element i domosdoshëm i demokracisë pluraliste në një vend, duke pozicionuar në të njëjtën kohë në minimum kërkesat përkatëse të maxhorancës ndaj një hetimi parlamentar. Testi kushtetues që duhet të kalojnë të dyja anët është i lartë dhe i njëkohshëm: maxhoranca të pranojë dhe të mos hedhë në votim kërkesën e një të katërtës së anëtarëve të Parlamentit për ngritjen e komisionit parlamentar dhe minoranca e kualifikuar si më lart, të respektojë në objektin hetimor të kërkuar parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës, ndarjes së pushteteve dhe lirive themelore të individit.

Më tej po citoj disa vendime të jurisprudencës kushtetuese të Republikës së Shqipërisë në lidhje me fushën e komisionit hetimor.

Dispozitivi i vendimit nr. 18, datë 14.05.2003

"Interpretimi përfundimtar i nenit 77, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në këtë mënyrë:

1. Komisionet hetimore janë mjet efektiv kontrolli që veprojnë vetëm brenda hapësirës kontrolluese të Parlamentit, të cilat ngrihen për çështje të veçanta, të lidhura në mënyrë funksionale me pushtetin e

ligjvënësit.

2. Ngritja e komisioneve hetimore parlamentare, kur kërkohet nga një e katërta e deputetëve, është e detyrueshme. Objekti dhe fusha e veprimit të komisioneve hetimore duhet të respektojnë parimet kushtetuese dhe normat e gjithëpranuara të së Drejtës Ndërkombëtare, duke mos cenuar pavarësinë dhe duke mos penguar veprimtarinë e organeve të pushteteve të tjera.

3. Parimet kushtetuese, veçanërisht, parimi i ndarjes e balancimit ndërmjet pushteteve, i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, i prezumimit të pafajsisë, i paanshmërisë, i respektimit të jetës private të individit përbëjnë standarde kushtetuese, mbi të cilat ngrihen dhe funksionojnë komisionet hetimore parlamentare.

4. Çështjet e veçanta që përbëjnë thelbin e objektit të veprimtarisë së komisioneve hetimore parlamentare, të cilat e përmbajnë në vetvete interesin publik, janë ato që hetohen në aspektin e kontrollit dhe të zbatimit të ligjeve, të njohjes e verifikimit në thellësi të një fenomeni, ngjarjeje, a veprimtarie dhe që nxisin iniciativat për propozime, amendime apo miratime ligjesh, me qëllim parandalimin e fenomeneve negative për shoqërinë, shtetin dhe nxjerrjen e përgjegjësiwe institucionale.

Vendimi nr. 26, datë 04.12.2006

Një nga drejtimitet e veprimtarisë së komisionit hetimor është edhe kontrolli mbi vendimet e mosfillimit të çështjeve penale, të pushimit të hetimeve apo pezullimit të tyre. Kështu, komisioni ka marrë përsipër të kontrollojë dhe të vlerësojë bazueshmërinë në ligj dhe rregullsinë e këtyre vendimeve. Mirëpo, vështruar në aspektin funksional, këto janë kompetenca të organit të prokurorisë dhe që nuk i përkasin veprimtarisë kontrolluese të ligjvënësit. Është prokurori më i lartë autoriteti që ka të drejtë të vendosë ndryshimin ose shfuqizimin e vendimeve të marra nga prokurori më i ulët.

Ky parim i rëndësishëm i organizimit dhe funksionimit të prokurorisë, si organ i përqendruar që i nënshtrohet Kushtetutës dhe ligjit shpreh kërkesën se kontrolli i bazueshmërisë në ligj të vendimeve të prokurorëve dhe vlerësimi e shfuqizimi i tyre përbën atribut të vetë prokurorisë ose të organeve të caktuara me ligj, siç janë gjykatat.

Vendimi nr. 20, datë 04.05.2007

Duke e krahasuar objektin e hetimit parlamentar me objektin e disa ligjeve të posaçme, që veprojnë në fushën e kontrollit të deklarimit të pasurive dhe të parandalimit të konfliktit të interesave të të

zgjedhurve dhe të disa funksionarëve publikë, Gjykata Kushtetuese nuk konstaton ndonjë dallim cilësor ndërmjet veprimtarisë së komisionit hetimor parlamentar dhe veprimtarisë së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Pasurive.

Në këtë mënyrë, objekti i hetimit, sipas vendimit të sipërcituar të Kuvendit, nuk e ndalon dublimin dhe as shmangien e një institucioni shtetëror të pavarur, siç është ky Inspektorat në ushtrimin e kompetencave ligjore të tij nga një instrument i një pushteti tjetër. Për rrjedhojë, një hetim i tillë e deformon natyrën kushtetuese të funksionit të kontrollit parlamentar.

Analiza ligjore e përmbajtjes së projektligjit e paraqitur nga relatorët:

Relatori i Partisë Socialiste, ndër të tjera, bëri këtë analizë:

Neni 1 i projektligjit ndryshon pikën 5 të nenin 4 të ligjit bazë “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve Hetimore të Kuvendit”, duke përcaktuar më mirë dobinë parlamentare dhe publike të komisioneve hetimore dhe të vetë funksionit kontrollues të Kuvendit, ashtu si dhe ndarjen e prerë ndërmjet veprimtarisë hetimore të Kuvendit dhe veprimtarisë kushtetuese të institucioneve të pavarura.

Dispozita e propozuar, në mënyrë të kujdesshme sanksionon detyrimin e komisionit hetimor për t’i dërguar organit të prokurorisë gjetjet e veprimtarisë hetimore, por, gjithashtu, përcakton autonominë dhe pavarësinë e prokurorisë që, sipas procedurave ligjore, ajo vetë të vlerësojë nisjen ose jo të ndjekjes penale, në rast se ka elemente të saj.

Neni 2 i projektligjit shton pas pikës 6 të nenit 4 të ligjit ekzistues edhe një dispozitë tjetër (6/a), e cila përveçse formalizon në ligj konceptin e hetimit të zgjedhjeve, përmban dhe afate më të detajuara në rastet kur objekt i hetimit parlamentar janë zgjedhjet.

Nëpërmjet kësaj dispozite materializohet vullneti ynë si nismëtarë të këtij projektligji, për të konsideruar zgjedhjet e përgjithshme apo ato lokale, si një çështje të veçantë që mbart interesin më të lartë publik, pra si një çështje specifike, që meriton të trajtohet shprehimisht nga ligji “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore”.

Neni 3 i projektligjit amendon nenin 9 të ligjit ekzistues, duke shtuar, pas pikës 3, një dispozitë tjetër (3/a), e cila parashikon një modifikim të përbërjes së komisionit hetimor, duke i njohur të

drejtën partisë më të madhe të opozitës të ketë shumicën e komisionit hetimor, në rastet kur objekt i hetimit parlamentar janë zgjedhjet e përgjithshme dhe ato lokale.

Neni 9, pika 2, nuk përcakton detyrimin e përputhjes absolute të maxhorancës parlamentare me shumicën e komisionit hetimor parlamentar, por duket se e ka lënë këtë çështje në vendimarrjen e nismëtarëve dhe Kuvendit. Parashikimi që propozojmë me dispozitën e re, sipas të cilit shumica e komisionit hetimor i përket partisë më të madhe të opozitës, në rastet kur objekt hetimi janë zgjedhjet, përfshihet brenda konceptit që ka adoptuar ligji ekzistues për “raporte sa më të afërta përfaqësimi ndërmjet pozitës dhe opozitës”.

Neni 4 i projektligjit ndryshon nenin 17 të ligjit ekzistues, duke parashikuar në mënyrë më të shtjelluar mjetet dhe instrumentet hetimore në dispozicion të komisionit hetimor parlamentar, veçanërisht në rastin kur objekt i hetimit parlamentar janë zgjedhjet.

Qëllimi i mjeteve të parashikuara në këtë dispozitë nuk është këqyrja e materialeve dhe fletëve të votimit për vlerësim dhe numërim, proces që i paraprin tabulimit dhe shpalljes së rezultatit zgjedhor, por këqyrja e këtyre materialeve në cilësinë e provës, për të evidentuar parregullsitë gjatë procesit zgjedhor në të gjitha fazat e tij.

Përdorimi i këtyre mjeteve hetimore nga komisioni parlamentar nuk sjell rivlerësimin, ndryshimin apo modifikimin e asnjë vendimi administrativ apo gjyqësor për cilëndo çështje që mund të përbëjë objekt të komisionit hetimor. Pra, veprimtaria e hetimit parlamentar me objekt hetimin e zgjedhjeve, duke pasur në dispozicion mjete të tilla hetimore, nuk mbivendoset, nuk cenon dhe nuk merr atributet e asnjë organi të pavarur kushtetues, parim ky i afirmuar dhe konsoliduar në të paktën tre vendime të Gjykatës Kushtetuese.

Neni 5 i projektligjit parashikon një moment të dytë për hyrjen në fuqi të pikës 1 të nenit 6a të ndryshuar, duke parashikuar që për zgjedhjet e 28 qershorit 2009, afati i parashikuar në këtë dispozitë të fillojë nga momenti i hyrjes në fuqi të vetë projektligjit.

Sa i takon analizës dhe propozimit të relatorit të caktuar të Partisë Demokratike, u parashtruan këto argumente:

Në parim biem dakord me përmbajtjen e nenit 1 të projektligjit.

Për nenin 2 është e pranueshme që të ketë një

afat kohor për ngritjen dhe më pas për funksionimin e komisionit hetimor parlamentar. Në këtë pikë, në vend të fjalisë "...komisionit hetimor për hetimin e çështjeve që lidhen me zgjedhjet e përgjithshme dhe ato të qeverisjes vendore..." të shikohet mundësia e zëvendësimit të saj me referencë të brendshme, domethënë "ngritjen e komisionit hetimor sipas nenit 17 të këtij ligji...(në rast se ai do të qëndrojë, por i riformuluar), ose duke vendosur çështjet përjashtimore të cilat komisioni hetimor nuk mund t'i hetojë. Po ashtu, duhet të unifikohet periudha kohore për komisionet në të dy rastet e zgjedhjeve.

Nga ana tjetër, për sa kohë kemi të bëjmë me komisione hetimore të Kuvendit, afati të nisë nga mbledhja e parë e konstituimit të Kuvendit, duke lënë gjithashtu si afat kohor një periudhë më të shkurtër për ngritjen e tij, për shembull, 60 ditë, dhe si afat përfundimtar për ushtrimin e veprimtarisë hetimore jo më shumë se tre muaj.

Neni 3. Ky nen mund të hiqet fare.

Së pari, është një parim shumë i rëndësishëm që ka lidhje me parimin kushtetutës të shumicës parlamentare, e aplikuar në të gjitha nivelet e jetës parlamentare, si në nivelin e jetës parlamentare në komisione, ashtu edhe në nivelin e jetës parlamentare në seancë plenare.

Së dyti, një parim i tillë i ndërtimit të komisionit hetimor nuk shfaqet në asnjë prej legjislacioneve të vendeve të Europës Lindore ose asaj Perëndimore. Në secilin prej këtyre legjislacioneve shfaqet kompozimi i njëjtë i komisionit hetimor në përputhje me parimin e shumicës parlamentare dhe përfaqësimin e të gjitha grupeve parlamentare në Kuvend.

Për më tepër, nuk duket bindës argumentimi se, pse vetëm në këtë rast opozita parlamentare është "e interesuara e parë" dhe "parakusht i suksesit të hetimit" dhe jo në rastet e tjera të ngritjes së komisioneve hetimore për çështje me një natyrë tjetër. Garancitë e ngritjes dhe më pas të funksionalitetit të një komisioni hetimor nuk mund të lidhen thjesht dhe vetëm me epërsinë numerike të anëtarësisë në një komision. E drejta e ngritjes së një komisioni hetimor është detyruese për Kuvendin kur kërkohet nga jo më pak se 1/4 e deputetëve, me kushtin e të qenit në objekt dhe në qëllim në përputhje me Kushtetutën dhe parimet që ajo bart. Edhe doktrina jonë kushtetuese dhe jurisprudenca kushtetuese e vendeve perëndimore, siç është, për shembull, rasti i Gjermanisë, jep garancitë e operativitetit të një komisioni hetimor të

Parlamentit, edhe duke qenë shumica shumicë në përbërjen e tij.

Neni 4, pika 3. Mbi bazën e praktikës kushtetuese shqiptare dhe të asaj ndërkombëtare të cituar më lart, kjo pikë ka nevojë të riformulohet, sepse është në kundërshtim me Kushtetutën. Aktivitetet e komisioneve hetimore të Kuvendit nuk duhet të zëvendësojnë dhe as të marrin kompetencat e organeve, të cilat për shkak të ligjit (Kushtetutës), janë të detyruara të realizojnë kompetenca të këtylla.

Komisionet, duke qenë organizma të brendshëm të Kuvendit, nuk duhet të vendosen në pozicionin e një "superorgani", superior mbi organet e tjera të autoritetit publik. Në vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, nr. 20, datë 04.05.2007, thuhet: "Qëndrimet, tashmë të konsoliduara, që ka mbajtur jurisprudenca kushtetuese shqiptare për domosdoshmërinë e respektimit të parimeve dhe koncepteve kushtetuese gjatë kryerjes së hetimeve parlamentare, janë fokusuar drejt argumentit se funksioni kontrollues i Kuvendit nuk mund të qëndrojë jashtë natyrës së tij ligjvënëse. Ushtrimi i funksionit të hetimit parlamentar nuk mund të realizohet duke ndërhyrë në veprimtarinë e organeve të pavarura.

Natyra e hetimit parlamentar nuk është e njëjlojtë dhe nuk mund të barazohet me hetimin që realizojnë në bazë të ligjit organet e tjera të pavarura apo të specializuara për kryerjen e një funksioni të tillë. Nuk mund të konsiderohet se është në përputhje me parimet kushtetuese një hetim i iniciuar që nuk i përket veprimtarisë së legjislativit dhe qëllime të saj. Ky instrument i rëndësishëm nuk mund të përdoret në mënyrë abuzive dhe tej hapësirës kontrolluese që Kushtetuta i njeh Kuvendit."

Hetimi parlamentar, për të qenë kushtetues, nuk duhet të jetë i gjerë, por i fokusuar ngushtësisht në ato çështje që janë subjekt kontrolli parlamentar, nuk prekin kompetencat e organeve të tjera të krijuara me ligj dhe që lidhen me funksionin ligjvënës. Hetime të një natyre të tillë deformojnë natyrën kushtetuese të funksionit të kontrollit parlamentar. Objekti i hetimit të komisionit parlamentar është fokusimi në një çështje të veçantë dhe jo në një çështje të përgjithshme; komisioni hetimor parlamentar ngrihet kur ekziston, në fakt, çështja e veçantë dhe jo për të parë nëse mund të zbulohet ose të gjendet ndonjë e tillë në të ardhmen.

Gjithashtu, edhe po të lexohet me kujdes, konkludohet se është një paragraf që nuk mund të qëndrojë në strukturën e këtij neni, sepse nuk është

në përshtatje me titullin dhe përmbajtjen e pikave të tjera të tij. Në të flitet për administrim dokumentesh dhe vetëm për këtë çështje dhe në këtë pikë flitet për metodologji të hetimit. Në këtë kuptim, pyetja e parë që shtrohet është: kur objekti i hetimit është i ndryshëm nga zgjedhjet, cila do të jetë metodologjia që do të ndiqet? Pse në këtë rast nuk duhet të parashikohet një gjë e tillë në ligj dhe a kemi ne mundësi të bëjmë listë ezauruese metodologjish hetimi? Sikundër ligji nuk bëhet për çastin, por për më larg se dita e sotme, sikundër ligji nuk bëhet për sjelljen e një personi, por për të normuar sjelljen e të gjithë shoqërisë, sikundër ligji nuk duhet të vendosë në të njëjtat situata juridike zgjidhje të ndryshme, vlerësoj se edhe në këndvështrimin teknik kjo pikë nuk mund të qëndrojë në strukturën e këtij neni.

Ndërsa në lidhje me nenin 5 dhe 6, komisionit iu propozua të shprehet dakord me përmbajtjen e tyre.

Komisioni i Ligjeve në mbledhjen e tij të datës 15 mars 2010, pas diskutimeve të shumta nga pjesa më e madhe e anëtarëve të komisionit, vendosi me unanimitet miratimin në parim të projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit".

Në përputhje me vendimin e Kuvendit nr. 24, datë 04.03.2010, si dhe me nenin 71 të Rregullores së Kuvendit, në Komisionin e Ligjeve u depozituan amendamente për projektligjin në lidhje me përmbajtjen e tij nga deputetët e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike. Thelbi i amandamenteve të paraqitura ishte konfigurimi i projektligjit në fjalë në aksin kushtetues, si qëllim primar i ndërhyrjes me amendamente dhe njëkohësisht pasurimi i tekstit të dispozitave të tij me elementë të rinj që gjatë këtyre viteve kërkojnë reflektim në normë ligjore, si pasojë vetëm dhe vetëm e jurisprudencës voluminoze që ka zhvilluar këto vite Gjykata Kushtetuese për këtë subjekt të veprimtarisë së Kuvendit.

Nëpërmjet ndërmarrjes dhe finalizimit të kësaj nisme, Kuvendi ka realizuar detyrën e tij kushtetuese, si në nivel komisioni, ashtu edhe në nivel seance plenare, sikundër po shqyrtohet aktualisht. Shtrati kushtetues i çdo ligji është dhe mbetet parim pune i Kuvendit dhe madje reflektimi në ligj i përcaktimeve kushtetuese, veçanërisht kur këto kanë të bëjnë me interpretime kushtetuese, siç është rasti i interpretimit të nenit 77 pika 2, është

detyrë parësore e Kuvendit.

Amendamentet e paraqitura janë një përfaqje normative e kujdesshme, e bërë duke shndërruar tekstin e vendimeve gjyqësore kushtetuese në fushën e hetimit parlamentar në gjuhën e ligjit. Është bërë përpjekje për t'i qëndruar besnik konceptit dhe parimit të shtjelluar në tekstet e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, si elemente më të rëndësishme të orientimit perspektiv të veprimtarisë legjislative.

Sot, aktualisht, kjo mund të quhet si punë e kryer. Në çdo fjali të këtyre amandamenteve manifestohen deri në detaje edhe efektet konkrete ligjore të vendimeve përkatëse, gjë e cila bën çdo kundërargument të pavlerë juridikisht.

Këto amendamente synojnë përmirësimin e ligjit ekzistues në fuqi në fushën e hetimit parlamentar, ligj, i cili ka kaluar disa herë testin e të qenit kushtetues, me luksin e kohës relativisht të gjatë, me tekstin integral të këtyre vendimeve, pavarësisht se Kuvendi në gjithë këto vite posedon dhe ka materializuar si në nivel parlamentar, ashtu edhe teknik një përvojë të çmuar në përmirësimin e punës së hetimit parlamentar. Komisioni në këtë çështje ka qenë i kursyer, sepse teksti i amandamenteve huazon dhe transponon vetëm formulime të bëra nga ana e Gjykatës Kushtetuese, i trajton ato në një këndvështrim thjesht teknik dhe mundëson eliminimin, qoftë edhe sado pak, të manipulimit të mirëfilltë politik të procesit ligjvënës.

Qëllimi primar, madje detyra primare e komisionit, ka qenë sjellja në shtratin kushtetues të projektligjit dhe më pas përmirësimi i tij me maksimumin e argumentit kushtetues në fuqi dhe minimumin e fantazisë dhe stilit të draftimit të tekstit të dispozitës.

Në mbledhjen e datës 16 mars 2010, Komisioni i Ligjeve zhvilloi diskutimin nën për nen të projektligjit së bashku me amendamentet e paraqitura nga anëtarët e komisionit: Eduard Halimi, Gent Strazimiri dhe Edi Paloka.

Anëtarët e opozitës në komision, që në fillim të mbledhjes dhe pasi u njohën me amendamentet e depozituara, kërkuar që diskutimi nën për nen të fillonte nga neni 4 i projektligjit, duke u konsideruar si thelbi politik dhe juridik i nismës ligjore të grupit parlamentar të Partisë Socialiste, meqenëse amendamentet propozonin heqjen e këtij neni. Anëtarët e opozitës vendosën si kusht të qëndrimit në mbledhjen e komisionit votimin paraprakisht të nenit 4 të projektligjit.

Duke qenë se kjo kërkesë e tyre ishte në kundërshtim me procedurën normale të shqyrtimit dhe miratimit të projektligjit në komision, të përcaktuar në Rregulloren e Kuvendit, nuk u pranua që të bëhej një shqyrtim selektiv nen për nen i projektligjit. Anëtarët e opozitës në komision u larguan nga mbledhja e komisionit, duke mos pranuar shqyrtimin nen për nen të projektligjit dhe të amendamenteve të propozuara.

Duke qenë se kuorumi i komisionit ishte i pranishëm, mbledhja e komisionit vijoi me shqyrtimin nen për nen. Prezantimin nen për nen të amendamenteve të propozuara në komision e bëri deputeti Eduard Halimi.

Në lidhje me amendamentin e propozuar në nenin 1 të projektligjit :

Amendamenti i paraqitur për nenin 1 bën fjalë për detyrimin që Gjykata Kushtetuese i ka përcaktuar Parlamentit për objektin e hetimit. Teksti i këtij neni formohet nga fjalitë, që janë përshkruar në vendimin nr. 18 të vitit 2003 të kësaj gjykate, parime që janë të qarta, që janë për ndarjen e pushteteve, për balancimin e tyre, për të drejtën dhe detyrimin e padiskutueshëm të Parlamentit për të respektuar balancën ndërmjet pushteteve. Është e qartë që Parlamentit nuk mund të hetojë një çështje, ndërkohë që për të ndiqet një hetim penal nga prokuroria.

Një komision hetimor parlamentar nuk mund të hetojë materiale apo prova që kanë qenë nën juridiksionin e gjykatave, sepse do të shkelet neni nr. 7 i Kushtetutës dhe parimi i ndarjes së pushteteve. "Urdhri" që vjen nga ky nen është i prerë: "Kuvendi nuk mund të kryejë hetime paralele, nëse një fakt apo kompleks faktesh janë hetuar një herë nga prokuroria, sepse ndryshe do të kthehej në një organ që bën hetime paralele apo hetime mbi hetime".

Në lidhje me amendamentin e propozuar në nenin 2 të projektligjit:

Amendamenti i dytë ka të bëjë me përfshirjen në objektin e hetimit edhe të hetimit të zgjedhjeve. Është në traditën e komisioneve hetimore parlamentare kohëzgjatja e tyre jo më tepër se tre muaj. Kjo, duke i shërbyer në mënyrë tërësore edhe stabilitetit të vendit. Çdo lloj opozite, cilado që të jetë ajo, në çfarëdoqë momentin, pas proceseve zgjedhore, qoftë ato qendrore, qoftë ato vendore, mund të kërkojë hetimin e zgjedhjeve, sipas parimeve dhe standardeve kushtetuese dhe ky hetim nuk mund të zgjatet më tepër se tre muaj. Është një afat logjik, normal dhe i mjaftueshëm për të hetuar

mbi të gjitha ato prova dhe fakte që ata kanë.

Amendimi përcakton, në radhë të parë, lejimin e Kuvendit që të ngrejë një komision hetimor për të hetuar zgjedhjet, qofshin ato qendrore apo lokale, si dhe përcakton periudhën e komisionit, me një afat deri në tre muaj, ndryshe nga ajo që kanë paraqitur socialistët, deri në dy vjet.

Në lidhje me amendamentin e propozuar në nenin 3 të projektligjit:

Neni 3 i projektligjit kishte të bënte me një shtesë në ligjin aktual. Në nenin 9 të tij thuhej që, në rast se do të kishim hetim të zgjedhjeve, ashtu siç u përcaktua më lart, në të gjitha rastet opozita do të kishte të drejtën e shumicës në komisionin hetimor parlamentar. Nuk u paraqit asnjë argument se përse një përcaktim i tillë duhet të ishte i vendosur në ligj. Argumenti i vetëm i paraqitur nga Partia Socialiste, se përse ata kishin vendosur ta kishin në ligj këtë përcaktim, ishte se i ishte premtuar kjo gjë nga maxhoranca.

Opozita ka vendin e saj ashtu siç përcaktohet në Kushtetutë dhe ka rolin e saj të pakicës, të cilin e luan gjatë gjithë mandatit të saj, të dalë qoftë nga zgjedhjet qendrore, qoftë nga ato vendore. Prandaj, përcaktimi i një të drejte të tillë të përhershme të opozitës në ligj, sepse ligji është më jetëgjatë, parashikohet të jetë për një kohë shumë herë më të gjatë se ky mandat qeverisës, do të ishte krejt i panevojshëm, për aq kohë sa ligji nuk bën fjalë vetëm për këto zgjedhje, por bën fjalë për të gjitha zgjedhjet në përgjithësi.

Në lidhje me amendamentin e propozuar për një shtesë pas nenit 3 të projektligjit:

Ajo që është synuar me amendamentet e propozuara është vendosja e urdhërimeve që ka përcaktuar Gjykata Kushtetuese nëpërmjet vendimeve të saj. Urdhërimi që është propozuar për t'u vendosur në pikën 1 të nenit 5 të ligjit aktual, ka të bëjë me objektin e hetimit parlamentar, objekt që sipas vendimit nr. 18 të vitit 2003 të Gjykatës Kushtetuese, duhet të jetë i argumentuar dhe duhet të përmbajë fakte ose kompleks faktesh, të cilat duhet të tregojnë qartë se për çfarë po hetohet. Vendosja e këtij paragrafi në këtë ligj ka të bëjë me faktin se një komision hetimor parlamentar nuk mund të hetojë vetëm mbi dyshime apo vetëm mbi fakte imagjinare, por objekti i këtij komisioni hetimor, ashtu siç përcaktohet në rastin kur duhet të hetohen zgjedhjet, duhet të jetë i argumentuar qartë dhe duhet të përmbajë fakte dhe kompleks faktesh, të cilat duhet të tregojnë qartë objektin e hetimit.

Në mënyrë eksplicite, fjalë pas fjale, shkronjë pas shkronje, kjo është ajo që përcakton vendimi i Gjykatës Kushtetuese, për të cilin është rënë dakord që të implementohet në projektligj.

Në lidhje me amendamentin e propozuar për nenin 4 të projektligjit:

Është propozuar që nenin 4 të mos jetë në ligjin aktual, të hiqet. Pse? Sepse neni 4 nuk mund të qëndrojë bashkërisht me nenin 1. Neni 1, ku u përcaktua parimi kryesor, parimi kushtetues për ndarjen dhe balancimin e pushteteve, nuk mund të rrijë bashkë me nenin 4 që Partia Socialiste ka paraqitur. Kjo është arsyeja e diskutimit të nenit 4 para nenit 1, të pretenduar nga anëtarët e opozitës në komision. Askush nuk do të kishte guximin qoftë në rrafshin profesional, qoftë në kuadrin politik, të thoshte se nuk respektojmë vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Askush nuk mund të shprehet për të respektuar ndarjen dhe balancimin e pushteteve; asnjëri nuk mund të thotë se komisioni hetimor parlamentar duhet të marrë e të hetojë çështje, të cilat i ka hetuar gjykata, duhet të marrë e të hetojë çështje, të cilat i ka hetuar prokuroria; asnjëri nuk mund të thotë që ato çështje apo kompleks çështjesh, të cilat i ka hetuar apo po i heton prokuroria, për të cilat është regjistruar një kallëzim penal, do t'i marrim dhe do t'i hetojmë ne, pra, do të bëjmë një hetim paralel.

Është neni 7, neni 132 dhe neni 138 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili saktëson ndarjen dhe funksionimin në juridiksione të Parlamentit, të gjykatave dhe të prokurorisë. Por te neni 4 marrja e provave është nën shqyrtimin dhe juridiksionin e gjykatave, ato nuk mund të merren nga komisioni hetimor parlamentar, sepse do të sillte kolaps. Kjo ishte arsyeja pse kërkonin që të diskutonin nenin 4 jashtë parimeve, jashtë standardeve kushtetuese, jashtë ndarjes së pushteteve, sepse në nenin 4, në përcaktimin që kanë bërë, kanë injoruar, parimin kryesor, që është parimi i ndarjes së pushteteve, kanë injoruar hetimin që bën organi, i cili ka ekskluzivitetin e hetimit, prokurorinë.

Anëtarët e Komisionit, gjatë votimit në tërësi të projektligjit, me shumicë votash, vlerësuan se me amendamentet e miratuara projektligji vjen në përputhje me Kushtetutën.

Projektligji përfundimtar përbën një arritje tjetër dhe një standard të ri normativ, midis fushave të tjera edhe në këtë fushë për Parlamentin, por njëkohësisht mbart edhe një mesazh të fortë për

shoqërinë shqiptare, sidomos për respektimin e influencës parlamentare dhe të parimit të mirënjohur të pavarësisë së gjykatave apo të organeve të tjera që e kanë një pavarësi të tillë.

Projektligji në fjalë jo vetëm reflekton, por kërkon edhe të edukojë, në radhë të parë, trupën ligjvënëse për caqet e hetimit parlamentar, duke respektuar minorancën dhe të drejtat e saj kushtetuese. Edhe në këtë rast, për hir të një qëllim madhor dhe që shkon përtej efekteve të ditës, ligji që propozojmë të miratojmë është i ftohtë në logjikën e vet. Ai saktëson në detaje një proces hetimor kushtetues, që si kudo në Europë nuk ka si të mos ketë caqe, nuk ka si të mos ketë formë dhe nuk ka si të mos ketë edhe përmbajtje kushtetuese.

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar deputetë,

Më poshtë është teksti i amendamenteve, të cilat janë miratuar në Komisionin e Ligjeve dhe që propozohen në emër të Komisionit të Ligjeve për miratim në seancë plenare.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Gumi!

Në bazë të nenit 42, tani që fillon diskutimi në parim, çdo diskutues, me përjashtim të rasteve kur në Rregulloren parashikohet ndryshe, ka të drejtë të flasë jo më shumë se 10 minuta. Diskutuesi nuk mund të flasë më shumë se një herë për thelbin e së njëjtës çështje dhe nuk mund të marrë nga koha e një diskutuesi tjetër.

Urdhëroni, zoti Dokle!

Namik Dokle – Kolegë të respektuar,

Jemi sot të gjithë përpara një sfide dhe një dileme. Kërkohej hapja e një porte evropiane për lirinë e votës si bazë e të gjitha lirive, për të drejtën e votës si çelësi i të gjitha të drejtave, për të vërtetën e votës si armike e të gjitha gënjeshtreve dhe manipulimeve.

Mund të mbajmë këtu fjalime kilometrike me citime politikanësh apo ligjvënësish, me paragrafë traktatesh apo rezolutash, por njerëzit e thjeshtë me ndjesi të qartë evropiane, pa hyrë në labirintet dhe grackat tona, bëjnë sintezën e asaj që ndodhi më 28 qershor 2009: kush të vjedh votën, të vjedh edhe lopën; kush të fsheh kutinë, të grabit dhe të djeg edhe shtëpinë.

Sot është dita të zgjedhim midis dritës evropiane të transparencës dhe territ elektoral. Sot është dita të zgjedhim midis demokracisë evropiane dhe masakrës elektorale. Sot, sepse nesër do të jetë vonë. Akoma dua të besoj në arsyen dhe dëshirën

e mirë të të gjithëve për ta bërë Shqipërinë si Europën, por besimi i njerëzve tronditet nga ngjarje dhe reagime që nuk mbajnë aromë europe, por erën e rëndë të mykut të shpellave.

Në ditën që Komisioni Parlamentar i Ligjeve filloi shqyrtimin e projektligjit të opozitës për transparencë të plotë dhe të pakufizuar të zgjedhjeve, në fshatin Ruzhdije të Fierit përfaqësuesi zgjedhor i PD-së përdori dhunën kundër përfaqësuesit zgjedhor të PS-së. Kjo ishte simbolika e masakrës elektorale të Qeverisë, e dhunës dhe e krimit kundër votës së lirë që maxhoranaca ka përdorur dhe vazhdon të përdorë sot e gjithë ditën, e presionit mediatik dhe e presionit për bukën e fëmijëve ndaj opozitarëve, e veprimeve dhe e mashtrimeve antikushtetuese dhe antidemokratike.

Rasti i Ruzhdijes është vetëm një pjesë e vogël e krimit elektorale tashmë të vërtetuar katërçipërisht jo vetëm në atë qendër votimi. Të zhytur në terrin elektorale, Kryeministri, Qeveria dhe tellallët brenda dhe përreth saj nuk e pranojnë dritën e transparencës, nuk e pranojnë hapjen e kutive, sepse e dinë mirë çfarë kanë ato. Ai që akuzohet për vjedhje kur është i ndershëm nxjerr xhepat, kurse ne e kërkojmë transparencën dhe hapjen e kutive që masakra elektorale të mos përsëritet më.

Një parlamentar europian e quajti të frikshme atë që ka ndodhur në Ruzhdije, por harta e krimit elektorale është shumë më e gjerë, shumë më e tmerrshme. Në Ruzhdije 94 persona, që kurrë nuk kanë pasur pasaportë, rezultojnë sikur kanë votuar me pasaportë. Po kështu, kanë votuar edhe mijëra të tjerë në Kamëz, Shkodër, Kukës, Elbasan, Durrës etj. Në Ruzhdije 173 persona që nuk kanë aplikuar kurrë për kartë identiteti rezultojnë sikur kanë votuar me kartë identiteti, me mijëra të tillë rezultojnë në Bathore, Dibër, Mirditë, Kavajë, Malësi e Madhe, Devoll etj. Në Ruzhdije 80 hajdutë votash votuan në vend të emigrantëve që nuk kishin ardhur fare në Shqipëri. Kështu ndodhi edhe në Paskuqan, Lezhë, Laç, Shijak, Librazhd, Pogradec etj. Në Ruzhdije u bënë falsifikime me regjistrat e votimit që ndryshojnë nga regjistri civil dhe u shpërndanë votuesit e një familjeje në dy dhe tri qendra votimi. Katër pjesëtarë të një familjeje në Bathore u degëdisën në katër regjistra.

Në Ruzhdije komisionerët e PD-së dhe manipulatorët të tjerë të vullnetit të lirë të zgjedhësve falsifikuan 376 firma dhe mbushën kutitë me vota. Si guxuan? Ku e morën kurajën? Nuk do të guxonte kurrë kryetari i Komisionit në Ruzhdije të falsifikonte

32 herë firmat e zgjedhësve, po të mos kishte licencën e Qeverisë. Nuk do të guxonin ta bënin këtë edhe qindra të tjerë në të gjithë vendin po të mos e dinin se kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve do të vinte në dyshim dhe do të hidhte në votim atë që Parlamenti e kishte votuar në Kodin Zgjedhor për hapjen e kutive, kur këtë e kërkojnë qoftë edhe dy komisionerë. Kështu ndodh kur nuk i bindesh Kushtetutës, por e lexon atë në ish-kinemanë "17 Nëntori".

Shqiptarët e dinë shumë mirë tashmë se çfarë ndodhi me 28 qershor. Çdo ditë e më shumë po e kuptojnë edhe ndërkombehtarët që po bashkohen me kauzën tonë për transparencë. Edhe më mirë e dinë ata që e menduan, e projektuan dhe e zbatuan krimin elektorale, duke filluar me Kryeministrin, ministrat, deputetët dhe duke përfunduar në gjithfarë vagabondësh elektorale. Prandaj të gjithë në një kor bërtasin dhe nuk e pranojnë hapjen e kutive, shkelin vetë apo edhe me thundrat e kalit mbi të drejtën dhe lirinë e votës dhe të gjithë kanë një slogan: "Nuk na lejon Kushtetuta". Aspak e vërtetë.

Objekti i hetimit parlamentar të kërkuar nga PS-ja është krejt i ndryshëm nga objekti i shqyrtimit gjyqësor të Kolegjit Zgjedhor. Ky objekt ka të bëjë me transparencën si element kyç i demokracisë dhe mbështetet në përvojat demokratike në SHBA, në Itali, në Rumani dhe së fundi edhe në Kosovën motër.

E vërteta juaj nuk ka të bëjë me Kushtetutën. Terri elektorale që përpiqeni të impononi është pjesë e përdorimit okult të të gjithë pushtetit, kudo dhe për gjithçka.

Ju e përdorni pushtetin mbi shtetin dhe shkelni në kompetencat e drejtësisë, prokurorisë, madje edhe të vetë Presidentit që keni zgjedhur. Ju përdorni pushtetin për të grabitur pronat e shqiptarëve, që nga Gjiri i Lalzit apo Lalës e deri në brigjet e Orikumit e të Jalës. Ju e përdorni pushtetin për të fshehur të vërtetat tragjike të shpërthimit në Gërdec dhe të shembjes së tunelit në Kalimash. Ju e përdorni pushtetin për të varfëruar shqiptarët me fatura të frikshme për ushqime, drita, karburant, shëndet e arsim. Ju e përdorni pushtetin për t'u vënë lakun biznesmenëve, punën e nderuar të të cilëve për ndërtimin e Shqipërisë e keni kthyer në punë skllavëruese të papaguar. Ju e përdorni pushtetin për të komanduar mediat, për t'ju bërë festë juve dhe për t'u servirur shqiptarëve broçkulla pa llogari, derisa një ditë arriti TVSH-ja të na thotë se janë zhdukur edhe gjurmët e shpërthimit në Gërdec. O

temporal, o mores! Janë zhdukur gjurmët e 27 të vrarëve? Janë zhdukur plagët e pleqve e të nuseve të djegura, është zhdukur tmerrri i fëmijëve që ende ngrihen në mesnatë të frikësuar? Atë tmerr që edhe dielli ndali për ta parë, nuk e shikon televizioni që paguhet nga varfëria e shqiptarëve dhe që nuk do të trazojë pasurinë dhe zullumet e pushtetarëve. Dhe zullumet në përdorimin e pushtetit janë bërë aq të mëdha, aq të paskrupullta, sa ju duket se do të qëndroni përgjithnjë hipur mbi kalë. Por ka një rregull demokracia: ata që mendojnë se ia kanë hipur përjetësisht kalit, shumë shpejt populli i dërgon të mbajnë bishtin e gomarit.

Jozefina Topalli – Urdhëroni, zoti Kryeministër për replikë!

Sali Berisha – Zonja Kryetare,

Të nderuara deputete dhe deputetë,

Të dashur qytetare dhe qytetarë shqiptarë,

Kemi ardhur këtu me vullnetin më të mirë për t'i dhënë një përgjigje legjitime kushtetuese kërkesës së opozitës për transparencë. Unë i bëj thirrje opozitës të mos përdorë terrin për të kërkuar transparencën. I bëj thirrje opozitës të lërë retorikën e akuzave monstruoze ndaj 20 mijë komisionerëve të saj. Nuk ka gjë më të rëndë se sa të shndërrojnë këtë seancë në një gjyq publik për ata 20 mijë burra e gra socialistë dhe të tjerë (të tjerët po i konsiderojnë si kundërshtarë), të cilët përmbushën me ndërgjegje të lartë shoqërore, me përgjegjësi të lartë ligjore detyrën e tyre para programit të partisë së tyre, Kushtetutës dhe ligjeve të vendit.

Në qoftë se këtë doni ta shndërroni në një gjyq publik dhe të flisni për krim elektoral për fajin e vetëm se ata firmosën dokumentet e procesit më transparent në historinë e vendit, nëse doni të na ktheni në avokatë të tyre, në këtë mënyrë shkelet jo një herë, jo njëqind, jo një mijë, por 20 mijë herë neni 7 i kësaj Kushtetute, neni i prezumimit të pafajësisë. Në rast se merrni përsipër të flisni këtu për krim elektoral, ju veçse na kujtoni persekutorët e kohërave më të zeza të këtij vendi, sepse zgjedhjet kanë pasur gardianët e vet të ligjit, përfaqësuesit tuaj, përfaqësuesin tonë dhe të mbarë forcave politike që morën pjesë në këto zgjedhje. Nuk është në interes të kësaj seance të lëshojmë shashka të tilla, të përdorim këtu lopë dhe dele apo edhe jashtëqitje për të nxirë komisionerët e PS-së, vetëm e vetëm se ai që udhëhoqi s'i fitoi dot zgjedhjet.

Të nderuar zotërinj,

Kemi ardhur këtu me vullnet për të dialoguar dhe jo për të negociuar me ju, po në qoftë se ju

vërsuleni me krim elektoral, kriminelë elektoralë dhe kriminelë zgjedhorë, të jeni të bindur se bëni një gabim shumë të madh, shumë të rëndë, se faktet janë fakte, janë të rrënjosura, sepse ju bëni këtu gjykimin, ju bëni ndjekjen penale të 20 mijë të pafajshmëve, për të cilët nuk jeni në gjendje të paraqisni edhe një dokument të vetëm.

Ju keni paraqitur këtu karta bixhozi të fabrikuara tek "Tajvani" ku kaloni kohën, keni paraqitur çdo lloj falsifikimi, por s'keni nxjerrë dot një komisioner të vetëm që të thotë se "Po, më korruptoi filani". Cili? Përkundrazi, shqiptarët kanë dëgjuar dhe kanë lexuar me dhjetëra letra dhe deklarata komisionerësh tuaj, duke ju akuzuar juve, sepse i sulmoni në mënyrë të pamoralshme për vepra që ata nuk i kanë kryer.

Zotërinj, a mendoni ju se do të ketë zgjedhje shumë shpejt? A e dini ju se s'do gjeni kund komisionerë e do të detyrohemi t'i importoni, po të veproni në këtë mënyrë? Çfarë janë ata që rrinë 24 orë në këmbë dhe ju i quani kriminelë?

(Reagim nga deputetë të opozitës.)

Ju lutem, mos më ndërprisni! Unë ju dëgjova me vëmendje. Çfarë bëni ju me krimin elektoral? Ju përfshitë ligjin ndërkombëtar. Ta pastroni fjalorin nga gjëra të tilla, se këto zgjedhje *(Reagim nga deputetë të opozitës.)*

Lëri punët e marrëdhënieve të mia se ato i ndërtoj unë siç i kam ndërtuar në çdo kohë dhe do t'i ndërtoj vetë, por këto zgjedhje janë vëzhguar nga 510 vëzhgues nga mbarë Europa dhe bota, kongresmenë, parlamentarë, funksionarë të lartë, ambasadorë etj. Çfarë kanë konkluduar? Konkludimi i tyre për zgjedhjet është ligji ndërkombëtar i zgjedhjeve. Kur flet gjykatësi ndërkombëtar, të gjithë të tjerët binden, pra ka folur gjykatësi ndërkombëtar, ka deklaruar se komisionerët tuaj kanë qenë gardianët më të vendosur të votës, sepse nuk ka pasur asnjë provë për manipulim. Si more i sulmoni kështu, si i vini përpara ata të cilët ju shërbyen juve me aq devocion? Si merreni me Ruzhdien, ku i porositët komisionerët të largohen, që në mëngjes? Si e bëni këtë? Po bëheni partia e Ruzhdies. Po s'bëheni dot kurrë, sepse Ruzhdia është dhe mbetet e djathtë. Ka pasur parregullsi. Prokuroria po heton, po Ruzhdie s'bëheni dot kurrë.

Ju lutem, ta lëmë retorikën! Nuk jeni parti e Ruzhdies ju! Mos e bëni! Jeni parti kryesore e opozitës. Si ka mundësi more që besoni gënjeshtër që i krijoni vetë? Kemi ardhur këtu për të bërë *dealing*. Kemi ardhur këtu për të zgjidhur problemin. Kemi ardhur këtu jo për të shpallur krim elektoral,

sepse atë nuk e bëj kurrë unë. Nuk i akuzoj kurrë komisionerët tuaj për kriminelë. As e kam bërë dhe as nuk e bëj ndonjëherë. Jo zotërinj, e keni gabim!

Edhe kur kanë kryer krim njerëzit tuaj, nëse i është dhënë ngjyrë politike, është bërë në gjaknxehtësi, siç ndodhi rasti në Katundin e Ri, kur u ekzekutua një njeri.

Mos mendoni se duke recituar në këtë mënyrë mbronin atë që ka humbur zgjedhjet. Përkundrazi, ia nxini edhe më shumë humbjen. Hajdeni zotërinj, të bëjmë komisionin! Jam plotësisht dakord. Doni shumicën? S'ka ndodhur ndonjëherë në histori që shumica t'i japë pakicës shumicën. Këtë e bëj unë, e bëjmë ne, e bën kjo shumicë, sepse duam t'u japim një rrugëdalje për të qenë këtu në vendin ku ju kanë prurë zgjedhësit.

Të kthehem së bashku në vitin 2001, kur kemi votuar së bashku kundër hapjes së kutive, kur të tjerët e kanë kërkuar këtë. Po pse? Jo se nuk kemi pasur kureshtje. Kemi pasur kureshtje dhe në atë kohë kemi pasur edhe fakte. Në vitin 2001 arbitri ndërkombëtar kërkoi që Parlamenti të hetojë: *"to investigate dhe inquire the election"*. Po nuk e bëmë me kutitë. Jo se nuk donim, por nuk e bëmë sepse që të dyja palët ishim të detyruara t'i përmbaheshim shtetit ligjor e të mos merrnim në dorë atë pushtet që nuk na përkiste.

Edhe në vitin 2005, kur LSI-ja propozoi për të hapur kutitë, bashkërisht, ne dhe ju, votuam për të mos i hapur. More zotërinj, si mund të veprohet në këtë mënyrë?! A e kuptoni që ju në vend që të krijoni transparencë, veçse lyeni me bojë të zezë kërkesën tuaj?!

Prandaj, unë jam i përgatitur të rri këtu deri nesër në orën 9 e gjysmë të darkës, sepse në atë orë nisem me shërbim. Po të doni, rrimë e vazhdojmë. Por, më mirë të ulemi këtu, të ndërtojmë komisionin, i cili, të nderuar zotërinj, do të ketë mundësi të plotë, në përputhje me Kushtetutën e vendit, në përputhje me parimet themelore të ndërtimit të një demokracie, të funksionimit të republikës parlamentare, të bëjë hetimin e plotë.

Natyrisht, çdo votë mund të numërohet, por sipas procedurës kushtetuese. Nuk mund të bëjmë ne atë që ka ndaluar gjykata. Atë e bën dikush tjetër. Në qoftë se ju keni fakte për këta kriminelë elektoralë, urdhëroni, zotërinj, t'i çojmë në prokurori. Në qoftë se ju keni fakte për këta kriminelë elektoralë, urdhëroni, zotërinj, ne mund të bëjmë këtu çdo ligj dhe çdo amendim të Kushtetutës, mund të mobilizojmë 300 prokurorë të tjerë, t'i investojmë

si prokurorë dhe të bëjmë procedurat kushtetuese. Por asnjëri prej nesh, në asnjë rrethanë nuk mund të marrë atributet e prokurorit apo gjykatësit, se pastaj kjo godinë shembet, godina e demokracisë në këtë vend nuk ekziston më.

Prandaj, zotërinj, le të bëhemi të arsyeshëm! Doni ju t'i ndryshojmë gjërat?! Unë ia kam thënë edhe kryetarit tuaj dhe ia them prapë: Urdhëro t'i ndryshojmë gjërat, por jo parimet themelore. Ato nuk mund të ndryshohen kurrë, sepse kjo është republikë parlamentare, kjo është republikë që bazohet në ndarjen e pushteteve si çdo demokraci. Doni ju t'i hetoni zgjedhjet? Ky shtet, aq i konsoliduar sa është, i ka të gjitha instrumentet për hetimin e plotë të tyre. Por a e dini pse nuk e doni ju këtë? Jo se jeni naivë dhe jo se nuk e dini, por sepse nuk keni as edhe një fakt të vetëm.

A e dini se ç'botojnë ata që shkruajnë fjalimet tuaja me 200 euro, apo jo? Ata kanë humbur çdo moral. Merrini dhe lexoni botimet e tyre! Japin 30 qendra si Ruzhdia. Shkoni dhe shihni rezultatin si është! Ata gënjejnë, njëlloj si një ish-deputet i yni fatkeq, i cili doli e tha: "Në qendrën time pata vetëm votën time". Është shkruar në një nga gazetatat më të mëdha të botës. Ai akuzonte gruan e tij këtu, se të shkosh me bashkëshorten dhe të mos votojë grua, iku ajo punë. Në qoftë se nuk bind gruan tënde, nuk bind kënd në botë.

Çfarë doni zotërinj të dashur? Kryetari juaj i nderuar i kishte thënë gazetarit të "Eashington Post", i cili shkoi në KQZ dhe gjeti në qendrën e këtij deputetit tim të nderuar 13 vota pro. Pra, jo vetëm bashkëshortja, por edhe ilakaja kishte votuar pro ish-deputetit tim. Edhe një nga ata që u shkruajnë fjalimet juve kishte votuar për disa qendra ku PS-ja kishte zero vota dhe PD-ja x vota. Kërkoj informacion në komision, është krejt e kundërta.

Prandaj, ju them edhe një herë, hajde t'i lëmë këto, ta krijojmë komisionin, ku ju absolutisht në çdo votim, nga i pari tek i fundit, do të jeni shumicë. Nuk e ndryshojmë ligjin, komisioni do të jetë sa e keni kërkuar ju, me 15 veta, 7 me 8, por Partia Demokratike do t'i tërheqë 2 anëtarë, do të jetë pra 7 me 6 në çdo votim.

Jo, nuk jua hedh unë juve, zotërinj! Unë jam këtu për ta zgjidhur çështjen, se po të kisha dashur s'kisha premtuar kurrë shumicë dhe s'do të kishte njeri mbi këtë planet që të më kërkonte mua shumicën. Shumicën e kam ofruar unë dhe e kam ofruar me ndërgjegje të plotë. Pse? Sepse ai që ka fituar duhet të bëjë një lëshim. Është normale të

bëjë një lëshim.

Shiko si është problemi: Ju jeni jurist dhe e dini që disa veprime mbeten njollë në histori po i bëre. Kështu që unë jap këtu fjalën para çdo shqiptari dhe e firmos vetë, po ligj nuk e bëj. Parlamentin dhe maxhorancën nuk e shtyj kurrë ta bëjë, që ju të jeni shumicë në çdo votim.

Çfarë kërkon tjetër ju? Keni hall ju se vonon prokuroria? Në qoftë se keni fakte dhe dokumente, ne bëjmë një ligj me të cilin i themi Parlamentit: do të paguash 100 prokurorë për ta shpejtuar procesin, mjafton që ju të keni dokumente.

Po ju keni kaq vendime, unë s'po i citoj, të Gjykatës Kushtetuese, të cilat thonë me të drejtë se Parlamenti s'mund ta bëjë këtë. Kjo është normale, se jo të gjitha pushtetet mund t'i ketë Parlamenti. Por Parlamenti ka fuqi të pakrahasueshme me askënd tjetër. Cila është? Urdhëroni, komisionin! Keni fakte, keni prova, keni kompleks faktesh, siç u shpreh Gjykata Kushtetuese, çojani prokurorisë! Por, do të thoni ju se prokurorisë i duhet kaq kohë. Hajde të paguajmë njerëz, jo 2, jo 3, por 100 prokurorë. Hajde, urdhëroni, ta zgjidhim problemin, por deputetët nuk mund të bëhen prokurorë.

Zotërinj, ju bëj thirrje, mos bëni retorikë këtu, se e vërteta është që ne këtu nuk kemi retorikë, por kemi aq shumë fakte, aq shumë gjëra për t'u paraqitur shqiptarëve, aq mundësi për të paraqitur sot vizionin e kësaj Qeverie, por nuk besoj se është ky rasti. Rasti është të krijojmë atë komision. Po të doni po rrimë deri nesër në orën 9 e gjysmë të darkës. S'kam kundërshtim. Po të doni e zgjidhim më shpejt. Të bëjmë komisionin, mbi të cilin ne nuk do të shkruajmë qoftë edhe një presje të vetme, një fjalë të vetme që të mos jetë në dokumentet themelore kushtetuese të këtij vendi. A doni ju kështu?

Po, a mund të them se interpretimin e Gjykatës Kushtetuese e bëj unë? Mund të doja, por s'mund ta bëj kurrë. Ky është problemi. Shumë prej jush jeni deputetë prej 20 vjetësh, shumë prej jush kanë qenë ministra, kanë drejtuar dikastere, kanë drejtuar qeveri. Atëherë po të doni ta zgjidhim, zgjidhja është absolutisht e mundshme.

A jeni ju opozitë e interesuar për një proces zgjedhor më të mirë të mundshëm? Jeni sigurisht! Atëherë, sillni të gjitha amendamentet, përveç asaj që thashë. Bëni të gjitha amendamentet për të adresuar të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet e OSBE-ODIHR-it dhe Këshillit të Europës. Mjafton të merrni

një mendim të ODIHR-it ose të Komisionit të Venecias dhe ne, në shenjë kompromisi të plotë, do t'i votojmë të gjitha këtu. Do t'i votojmë pavarësisht se ato janë nga e para tek e fundit projekti i pakicës.

Oferta jonë është e absolutisht sinqertë. Është e sinqertë dhe bazohet në dëshirën e madhe që ju të zini vendet tuaja në Parlament dhe t'u përgjigjeni zgjedhësve.

Si mund të flitet për krim elektoral! Çfarë bëhet kështu?! E dini ç'bëjmë ne me këtë apo jo? Ne u zhbëjmë me përgjegjësi të madhe ligjore qytetarëve shqiptarë një qëndrim kushtetues, një besim që është vendimtar që ata të përmbushin detyrat. Mos më bëni edhe një herë të bëhem avokat unë, se s'kanë nevojë ata për avokatinë time, kanë partinë e tyre për të cilën ata janë përkushtuar.

Ata kanë investuar, kanë bërë sakrificat më të mëdha, pavarësisht se çfarë rezultati kanë parë me sytë e tyre. Në shumë e shumë qendra do të kenë dashur ndonjë rezultat krejt të kundërt, por kanë pasur dinjitetin dhe integritetin për të firmosur, për ta pranuar. Mos të hapemi në mënyrë të tillë, Ja ku jeni. Të biem në ujd. Oferta është shumë e ndershme dhe e sinqertë. Nuk jua kam kërkuar kurrë një gjë të tillë në 8 vjet opozitë. Kurrë s'kam kërkuar të kem shumicën. Zoti Majko, ti e di mirë, ti dhe secili nga ju, që nuk kam menduar kurrë të kërkoj shumicën, përkundrazi, çdo hap që është bërë drejt balancimit e kam vlerësuar. Nuk them që nuk kam bërë protesta, por po them se cili ka qenë qëndrimi im ndaj Kushtetutës dhe ligjit. Pra, nuk kam kërkuar asnjëherë shumicë. Tani e bëj, sepse më takon ta bëj dhe e gjykoj se më takon ta bëj. Mos i akuzoni për krim elektoral djemtë, vajzat, gratë, burrat!

Unë, zonja Kryetare, edhe njëherë po e mbyll fjalën time duke u premtuar deputetëve po opozitës me sinqeritetin më të madh vullnetin e plotë për një komision hetimor parlamentar, ku opozita në çdo votim të tij të jetë shumicë, vullnetin e plotë për të ndryshuar ligjet e nevojshme, por duke respektuar Kushtetutën, në mënyrë që çdo provë dhe fakt të mund të hetohet me shpejtësi deri në fund nga organet kushtetuese të vendit. Se kur të bëhemi ne prokurorë dhe gjykatës, atëherë, demokracia e re shqiptare avullon, zhduket.

Ju falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Kryeministër!

Fjalën e ka zoti Saimir Tahiri.

Saimir Tahiri – Të nderuar kolegë,

Jemi këtu për të denoncuar me forcë një krim elektoral, si dhe përpjekjet tinëzore të Qeverisë së zotit Berisha dhe të PD-së, që ofrojnë vetëm pengesë për hapjen e kutive të votimit, sepse i tmerron krimi që ndodhet aty. Është një krim, i cili u ka mohuar votën qytetarëve shqiptarë. Duket qartë se PD-ja dhe përfaqësuesit e saj janë pengesa kryesore për hapjen e kutive dhe për zbardhjen e këtij krimi. Këto fjalë, që sapo lexova, zoti Kryeministër, nuk janë fjalët e mia, por janë fjalët e zotit Ilir Meta, në atë kohë kryetar i LSI-së, sot shoqëruesi juaj i parë, që kërkonte hetimin e zgjedhjeve të 3 korrikut të vitit 2005 dhe hapjen e kutive për të bërë transparencë mbi manipulimin e zgjedhjeve. Janë fjalë që rrinë më mirë sot, edhe pse nuk është më zoti Meta ai që i thotë, sepse është pjesë e të njëjtës maxhorancë që doli nga këto zgjedhje më shumë se problematike.

Që publiku të kuptojë diçka më shumë përtej tymnajës që kjo maxhorancë ka ngritur gjatë këtyre muajve mbi të drejtën tonë dhe të Parlamentit për të hetuar duke hapur kutitë, po risjell në vëmendje vendimin e votuar në këtë Kuvend dhe të firmosur nga Kryetarja e Kuvendit të atëhershëm e të sotëm, zonja Topalli, për ngritjen e komisionit hetimor që do të hetonte zgjedhjet e 3 korrikut 2005.

Ky Parlament ka hetuar manipulimin e zgjedhjeve të vitit 2005 me të njëjtin objekt hetimor thujse identik si komisioni hetimor që kërkon prej më shumë se 6 muajsh Partia Socialiste. Pra, ky Parlament, më 2005 ka hetuar zbatimin e dispozitave të ligjit zgjedhor të asaj kohe për votimin në qendrat e votimit, për numërimin në qendrat e numërimit, për përdorimin e certifikatave, atëherë, sot kartat e identitetit, për dublimet dhe heqjet e votuesve nga listat e zgjedhësve, për përdorimin e administratës publike, për keqpërdorimin e financave publike, madje, edhe për bandat e armatosura në shërbim të Partisë Demokratike në disa zona të caktuar zgjedhore. Pra, është pikërisht ajo që kërkojmë ne sot. Në atë kohë, Partia Demokratike, kishte në atë komision zotin Nishani, sot ministër i Drejtësisë dhe zotin Patozi, sot kryetar i Grupit Parlamentar të PD-së. Komisioni hetimor për zgjedhjet e 2005-ës, të nderuar kolegë, përveç të tjerave, vendosi pikërisht atë që sot kjo maxhorancë e ndalon me dhunën e kartonëve. Ai komision hetimor urdhëroi hapjen e kutive edhe me miratimin e zotit Patozi dhe zotit Nishani, pa asnjë debat a sherr.

Madje, për saktësim historik, i vetmi sherr në komisionin e atëhershëm hetimor ishte ai i zotit

Nishani dhe zotit Ceka për vendin ku do hapeshin kutitë, e jo nëse do hapeshin apo jo kutitë, sepse kjo as që vihej në diskutim. Kam këtu vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që pas urdhrat të komisionit hetimor vendosi të hapë kutitë e materialeve zgjedhore në 22 zona zgjedhore, nga 100 gjithsej ose, e thënë ndryshe, në rreth 1000 qendra votimi nga 4000 e ca që ishin gjithsej. Dhe për të hequr çdo hije dyshimi, po ju tregoj edhe procesverbalin e mbylljes së kutive nga KQZ-ja, pas hapjes me urdhër të komisionit hetimor të atëhershëm. Dhe, meqë jemi këtu, zonja Kryetare, jo vetëm KQZ-ja ka hapur kutitë me urdhër të komisionit hetimor, jo vetëm ka administruar materialet zgjedhore nga hapja e kutive, por, po ju bëj me dije se këto materiale zgjedhore nuk i janë kthyer kurrë KQZ-së në arkiv, pra i keni ende ju në zyrat e Kuvendit.

Me fjalë të thjeshta, kutitë janë hapur në 2005-n, atëherë kur zgjedhjet nuk i realizoi kjo maxhorancë, prej të cilave doli e fituar. Ndërkohë, tani që kjo maxhorancë mban përgjegjësi për organizimin e zgjedhjeve të 28 qershorit, prej të cilave ndoshta edhe nuk ka dalë e fituar, refuzon në mënyrë kapriçoze të bëjë transparencë të procesit zgjedhor. Në vitin 2005 zoti Berisha deklaroi se ndihej i fyer që fitoi nga zgjedhje jo plotësisht të rregullta, megjithëse nuk i organizoi ai. Po sot, që i madh e i vogël e di se zgjedhjet e 28 qershorit ishin shumë larg së qenit të rregullta, për më tepër të organizuara prej jush, zoti Kryeministër, keni arsye jo vetëm për t'u ndjerë i fyer, por edhe i turpëruar para qytetarëve shqiptarë dhe komunitetit ndërkombëtar. Jo se jeni prapë maxhorancë nga zgjedhje të manipuluar, por sepse nuk arritët dot të jeni një herë të vetme në historinë e këtij vendi plotësisht i ligjshëm në atë karrige ku nuk ju kanë ulur shqiptarët, por paratë, muskujt, keqpërdorimi i administratës publike, i mësuesve, nxënësve, i buxhetit të shtetit, dhe i ca komisionerëve e numërues hileqarë me në krye piratët në KQZ.

U bënë muaj që kërkojmë një gjë fare elementare, të hetojmë zgjedhjet e 28 qershorit, sepse nuk është Kushtetuta ajo që e pengon maxhorancën të lejojë hapjen e kutive, por vullneti politik për të mos lejuar transparencën. Është kompleksi i fajtorit, i atij që pikërisht pse bën gabimin e fsheh dorën, ndërton një gënjeshtër të fortë për të fshehur një të vërtetë të dobët. Zoti Kryeministër, keni përmendur Kushtetutën në këta muaj, po aq sa e keni përdhosur atëherë kur u miratua. Nuk ju

beson njeri kur fshiheni pas shkronjave dhe neneve të Kushtetutës, sepse jo vetëm si maxhorancë, sot mbani rekordin më të zi në Europë për 21 nismat antikushtetuese, por edhe sepse, ju personalisht për gjykatat keni po aq respekt sa ç'mund të ketë një i dënuar me burgim të përjetshëm. Prandaj, jeni i vetmi politikan që ende sot, nuk jeni paraqitur kurrë përpara një gjykate si dëshmitar apo si i akuzuar. Ja pra pse thirrjet tuaja për kushtetutshmërinë dhe gjykatat janë vetëm pretekste për të fshehur me sa mundeni qëllimin tuaj të vërtetë. Ju, thjesht, nuk doni të lejoni Parlamentin dhe opozitën, të zbulojnë manipulimin e zgjedhjeve të 28 qershorit.

Është raporti i OSBE-ODIHR-it që tregon dështimin e zgjedhjeve. Dhe raporti i vëzhguesve ndërkombëtarë pasqyron vetëm fakte dhe të dhëna, jo arsye. Prandaj i takon Parlamentit dhe, konkretisht, komisionit hetimor të kërkuar nga opozita, të gjejë arsyet pse dështuan zgjedhjet e 28 qershorit. Është e drejtë e Parlamentit të hetojë pse numërimi ishte i keq ose shumë i keq në 22 nga 66 qendrat e numërimit, pse nuk funksionoi sistemi i monitorimit me video kamera, pse numërimi nuk ishte transparent në 11 nga 66 qendra numërimi, pse nuk u lejuan vëzhguesit e partive politike, vëzhguesit e pavarur të organizatave monitoruese, pse nuk u lejuan edhe numëruesit e opozitës, që të ankimonin procesin e numërimit apo të shënonin vërejtjet e tyre në librin e protokollit dhe të hetojë mbi problemet e hasura nga votuesit me fletën e votimit, shënjimimin me bojë matrikulluese apo me fshehtësinë e votës; të hetojë pse u lejuan dhe sa i përhapur ka qenë votimi familjar, votimi me delegim, apo votimi i komisionarëve. Është e drejta e Parlamentit të hetojë impaktin e këtyre fenomeneve në rezultatin elektoral. Parlamenti nuk rrëzon as vendimet e KQZ-së, as vendimet e Kolegjit Zgjedhor dhe as rrëzon maxhorancën legale, por rrëzon vetëm pretendimet tuaja për gjoja zgjedhje të lira e të ndershme e, po kështu, rrëzon dhe planin tuaj për të manipuluar dhe zgjedhjet e ardhshme.

Zoti Kryeministër, kemi kërkuar të hetojmë përdorimin e administratës publike. Nuk keni asnjë kundërshtim, as për qëllimin, as për objektin dhe as për mjetet. Pra, jeni gati të na lejoni të hetojmë për përdorimin e administratës publike, pa pasur asnjë pretendim për mënyrën sesi do të hetojmë. Kemi kërkuar të hetojmë edhe keqpërdorimin e financave publike dhe lirimimin e kundërligjshëm të të burgosurve, që më pas i keni përdorur për manipulimin e zgjedhjeve. Përsëri nuk keni asnjë

kundërshtim, as për qëllimin, as për objektin dhe as për mjetet. Jeni gati të na lejoni të hetojmë edhe për lirimimin e të burgosurve, pa pasur asnjë pretendim për mënyrën sesi do hetojmë.

Pas kërkesave tona të përsëritura dhe kërkesave të drejtpërdrejta të partnerëve ndërkombëtarë, keni pranuar të na lejoni të hetojmë edhe zgjedhjet e 28 qershorit në lidhje me zbatimin e dispozitave për votimin, numërimin dhe pasqyrimin e rezultatit përfundimtar, por me kushtin që kutitë të mos hapen. Pra, keni pranuar objektin e hetimit të komisionit, hetimin e zgjedhjeve, por, ndërkohë, hapjen e kutive si mjet të hetimit, të cilin si të tillë, nuk mund të na e kufizoni ju me diktatin e kartonëve, nuk doni ta lejoni, sepse, në të vërtetë, nuk doni që ne të hetojmë pikërisht këtë pjesë të zgjedhjeve. Ka një arsye pse ju na lejoni të hetojmë për administratën, financat publike, të burgosurit, por nuk na lejoni të hetojmë për këtë aspekt të zgjedhjeve, duke hapur kutitë, sepse ju, zoti Berisha, nuk keni më frikë se mos zgjedhjet rezultojnë të manipuluar. Këtë tashmë e dini ju vetë, e dimë ne, e dinë shqiptarët brenda dhe jashtë vendit, por e dinë edhe partnerët tanë ndërkombëtarë. Frika juaj e vetme është zbulimi i shkallës së manipulimit, masa dhe përhapja e tij, gjë që mund të zbulohet vetëm nga hapja e kutive. Pra, e thënë ndryshe, keni frikë se pas këtij hetimi, do zbulohet në dritën e diellit se ju nuk keni fituar, por se jeni maxhorancë me vota të vjedhura njëjloj si ato në Ruzhdie. Kjo është arsyeja pse na lejoni të hetojmë mbi gjithçka e me gjithçka, përveç kutive.

Në qoftë se i akuzuari lejohet t'i tregojë e diktojë prokurorisë si të hetojë, atëherë, për analogji, edhe Qeveria dhe maxhoranca mund të lejohen të diktojnë opozitën kur, ku dhe si të hetojë zgjedhjet e kaluara. Por, as e para dhe as e dyta nuk ndodh në asnjë vend demokratik, ku mbizotëron shteti ligjor. Nuk ka asnjë dispozitë ligjore në fuqi që ndalon hapjen e kutive për efekt të transparencës dhe hetimit parlamentar. Dhe kjo vlen si për kutitë e materialeve zgjedhore, ashtu edhe për kutitë e votimit, sepse kërkesa e PS-së është tërësisht kushtetuese në qëllim, objekt dhe mjete dhe, si e tillë, duhet miratuar detyrimisht nga ky Parlament.

Keni gënijer vazhdimisht jo vetëm shqiptarët, por edhe partnerët ndërkombëtarë me gjoja vullnetin tuaj për të lejuar opozitën të hetojë zgjedhjet. Ju, në të vërtetë, nuk doni që këto zgjedhje të zbardhen, po aq sa nuk doni që edhe zgjedhjet e ardhshme të jenë të rregullta. Madje, edhe vetë ligjin e SHISH-it

e bëtë çorap, me kosto të lartë, duke vënë në rrezik marrëdhëniet me partnerët ndërkombëtarë, vetëm e vetëm që të largonit vëmendjen publike nga hetimi i zgjedhjeve të 28 qershorit.

Të nderuar kolegë,

Sot nuk shtrohet vetëm pyetja nëse do të pranojë kjo maxhorancë kërkesën e Partisë Socialiste për hetimin e zgjedhjeve të 28 qershorit nëpërmjet hapjes së kutive...

Jozefina Topalli – Ju mbaroi koha.

Falemnderit!

Zoti Nishani, për replikë, urdhëroni!

Bujar Nishani – Meqenëse parafolësi iu drejtua emrit tim për një rast konkret, më duhet të sqaroj, së pari, kolegët deputetë dhe opinionin publik, duke përgënjeshtuar një pretendim të tillë, krejt të pabazuar dhe të pavërtetë. Gjithsesi, aktivitetet dhe veprimtaria e atij komisioni në vitin 2005 është reflektuar në procesverbale konkrete, është regjistruar, prandaj autorizoj gjithkënd që të shkojë dhe të verifikojë këtë veprimtari që nuk është bazuar në asnjë rast në asnjë hapje të asnjë lloj kutie.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Nishani!

Zoti Paloka, urdhëroni!

Edi Paloka – Falemnderit, zonja Kryetare!

Unë, në fakt, nuk pretendoj as të jem më i mençur dhe as më largpamës se kolegët e tjerë, por jam nga ata që, që në fillim, kam qenë skeptik dhe sot jam i bindur që Edvin Rama, asnjëherë, në asnjë moment nuk ka kërkuar transparencë të zgjedhjeve, nuk ka kërkuar të zgjidhë problemet dhe defektet që mund të ketë Kodi Zgjedhor, për të pasur zgjedhje të tjera me të ardhme më të mirë. Pse e them këtë? Në fakt, i kthej përgjigje edhe zotit Berisha, jo se ai nuk e kupton, por unë e kuptoj atë kur vazhdon të tregohet tolerant deri në fund me socialistët. Ata nuk e duan transparencën. Edhe sot do t'i shohim, do t'i dëgjojmë fjalimet që ua kanë përgatitur, ku do të thonë të njëjtat gjëra. Të gjithë shqiptarët do ta kuptojnë se këta asnjëherë nuk kanë dashur transparencë. Pse? Le ta shohim historikun e këtyre muajve të fundit për çështjen që po diskutojmë.

Pavarësisht nga arsyet, sepse i kemi thënë më parë, u krijua një zhurmë e madhe para kongresit të Partisë Socialiste, por edhe pas tij, për hapjen e kutive. U deklarua që qenka shkelur ligji, sepse me ligj PS-ja kishte të drejtë të rinumëronte kutitë e votimit. U çuan njerëzit nëpër protesta. Nuk ka rëndësi sesi u morën nëpër to, por këta njerëz u

gënjen, u mashtruan për caq kohë duke iu thënë se po kërkohet një e drejtë që i takon me ligj PS-së.

Pastaj erdhi dita kur u digjeshin mandatet. Nuk janë futur prej kërkesave të përditshme dhe të vazhdueshme të ndërkombëtarëve, por janë futur sepse Edi Rama e dinte që një pjesë e deputetëve të tij nuk do t'i dignin mandatet dhe do të hynin në Parlament. Vetëm për këtë arsye u detyrua t'i lejonte që të vinin e të bënin betimin.

Edhe pse hynë në Parlament, vazhduan lojën. Paraqitën dy nisma. Që në fillim, në shkelje të të gjitha procedurave dhe të ligjit, paraqitën një projektligj dhe një kërkesë për ngritjen e një komisioni hetimor mbi këtë projektligj që nuk ishte bërë ligj ende. Megjithatë, ne e kaluam.

Projektligji që u paraqit për amendimin e ligjit mbi komisionin hetimor ishte antikushtetues dhe ata e dinin shumë mirë. Neni 4 që ne e diskutojmë prej caq kohësh ishte në kundërshtim të hapur me Kushtetutën dhe me vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Që ditën e parë kur foli kryetari i grupit të tyre parlamentar, tha: "Le t'i lëmë procedurat. Le t'i lëmë ligjet. Hajde të zgjidhim një krizë politike. Kjo është një çështje politike. Të mos i shohim as ligjet, as Kushtetutën, asgjë." Të njëjtin qëndrim mbajtën edhe në Komisionin e Ligjeve. Që në ditët e para, megjithëse për hipokrizi u përpoqën të gjenin justifikime ligjore, në fund të gjitha fjalët e tyre mbylleshin: "Kjo është krizë politike dhe duhet zgjidhur me mjete politike." Pra, ta hedhim Kushtetutën dhe të gjitha procedurat. Hajde t'i japim zgjidhje krizës politike." Cilës krize politike? Atë që kanë krijuar ata? Në qoftë se duan ta zgjidhin, le të hyjnë në Parlament dhe "kriza politike" është zgjidhur.

Si vazhdoi historia? U bënë amendamentet tona. Përsëri u tha se kishte shkelje procedurash. Nuk u pritej zotërinjve të diskutonim dy- tri nene, para se të arrinim te neni 4. Kjo për një arsye të thjeshtë, sepse që në nenin e parë, ne, duke cituar vendimin e Gjykatës Kushtetuese, u thoshim që komisioni hetimor nuk mund të hetojë vendimet e gjykatave. Këtë e kanë deklaruar vetë vazhdimisht edhe në Komisionin e Ligjit. Vetëm prej këtij amendamenti u çuan dhe ikën nga mbledhja.

Pra, të gjitha këto veprime, kërkesa për të shkelur në vazhdimësi Kushtetutën me justifikimin se duhet të zgjidhim një krizë politikisht dhe jo ligjërisht, nuk ka qenë gjë tjetër veçse synimi që ne t'u thoshim jo. Ne nuk mund të pranojmë ligje antikushtetuese, ne nuk mund të pranojmë të ngremë

një komision hetimor që të shkelë mbi ligjet dhe mbi Kushtetutën. Pra, që në fillim ata kanë dashur përgjigjen tonë negative dhe jo zgjidhjen e problemit dhe transparencën.

Çfarë do të ndodhte në qoftë se ne, për një moment (sepse i kanë marrë të gjitha masat, diabolizmi i tyre ka arritur deri në detaje, nuk e di kush paska qenë kaq i mençur, se nuk besoj të ketë qenë Edvini, por kanë llogaritur çdo gjë), do të prananim të shkëlqim Kushtetutën (po e supozojmë), edhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese, do të prananim projektligjin e tyre? Çfarë thoshte projektligji i tyre?

E para, në këtë komision kërkohej shumica nga PS-ja.

E dyta kërkohej që kjo shumicë të kishte të drejtën që në çdo moment të kërkonte hapjen e kutive.

E treta, që ky komision mund të zgjasë 24 muaj, pra 2 vjet.

Kjo do të thotë, sikur ne ta prananim këtë nismë, që këta zotërinj të ulëshin në një zyrë dhe për dy vjet rresht të hapnin kutitë, gjenin apo jo pak rëndësi kishte, dhe këtu të mos kishte as shtet, as Qeveri, ndërkohë që ne presim të liberalizojmë vizat e shqiptarëve, këtë vit presim që të integrohemi.

Në qoftë se do të hapeshin kutitë, kishin marrë edhe masën tjetër. Në qoftë se e mbani mend, para disa kohësh, nuk e di se kush u tha se mund të hapen kutitë, Rama lëshoi menjëherë disa nga të tijtë, që i nxjerr sa herë që do nëpër konferenca shtypi, që thanë: "Berisha po fut duart në kuti". Pra, edhe në qoftë se do të hapeshin kutitë dhe nuk do të gjenin gjë, justifikimi ishte gati: "I ka manipuluar Berisha, ka futur duart, prandaj nuk ka gjë në kuti." Pra, në çdo moment kanë menduar vetëm e vetëm si të gjejnë justifikimin për të vazhduar bojkotin.

Kanë përmendur Ruzhdien. Unë nuk arrij ta kuptoj se si një njeri me logjikë normale mund ta përmendë Ruzhdien në favor të vet. Ruzhdia është argumenti kundër tyre, sepse pa dijeninë tonë dhe të tyre një komisioner i tyre bëri një denoncim në prokurori dhe ajo e hapi kutinë për të parë nëse ishin manipuluar votat. Këtë do ta zgjidhi prokuroria, por krimi ka filluar kur komisionerët socialistë janë urdhëruar të largohen nga komisioni. Kjo nuk është një histori e panjohur për ne. Çfarë prisni ju? Unë nuk paragjykoj dhe nuk gjykoj a kanë futur duart komisionerët e PD-së apo jo, por pse janë bërë komisionet dypartizanë? Sikur ne të kishim kaq besim te njëri-tjetri, linim një grup të numëronte votat

dhe çështja ishte zgjidhur.

Pra, ky është argument kundër jush dhe nuk mund të merret shembull Ruzhdia për të treguar që qenkan manipuluar zgjedhjet në të gjithë Shqipërinë. Atëherë gjeni fakte të tjera dhe çojini në prokurori që të veprojnë siç ka vepruar me Ruzhdien. Por ju nuk e bëni këtë, sepse nuk ju leverdis.

Në këtë podium u nxorën disa karta identiteti, gjithmonë në vazhdën e propagandës dhe të demagogjisë që njerëzit mund të hanë çdo gjë që iu serviret.

Së pari, unë nuk e di se çfarë janë ato karta. Gjithmonë është prokuroria që merret me atë çështje dhe Gramoz Ruçi duhet të shkojë në prokurori jo si dëshmitar, jo si denoncues, por si i pandehur. Unë them mendimin tim. Të shkojë në prokurori dhe të japë llogari atje dhe ta zgjidhë prokuroria.

Meqë koha e diskutimit mbaroi, dua të them fjalinë e fundit. Raporti i OSBE-ODIHR-it është një konstatim i tyre, nuk ka nevojë për hetim. Hajdeni të ulemi dhe sipas raportit të bëjmë rregullimet që duhen. Por ju edhe këtë nuk e doni. Edi Rama kërkon të mbajë peng Shqipërinë. Ai kujton se po na mban peng, duke kërcënuar në qoftë se ju nuk më jepni atë që dua, atëherë unë nuk ju lë të hyni në Europë. Nuk mban peng asgjë. Kot e ka!

Ai e di që zgjedhjet i ka të humbura, se i provoi, edhe ju i keni provuar, keni tentuar të bëni gjithçka në këto zgjedhje. Ju, jo ne. Ai e di këtë dhe ka bindjen që kur nuk fitoi edhe këtë herë, nuk do të fitojë kurrë zgjedhje. Prandaj e do fitoren në tavolinë, por nuk mban dot peng njeri dhe nuk ka për të fituar ndonjëherë.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Paloka!
Zoti Majko, urdhëroni!

Pandeli Majko – Të nderuar kolegë,

Sot mendoj se seanca ka një ngarkesë të vetën jo për mënyrën sesi ne do të tregojmë ndarjet karshi njëri-tjetrit. Kjo ka një histori tepër të veçantë në këtë drejtim edhe përballë publikut. Mendoj se sot të gjithë së bashku, qoftë e majta, qoftë e djathta, ndodhemi përballë një numërimi të mbrapshtë, përballë kërkesës së ndërkombëtarëve, të cilët sot asetin më të çmuar përballë asaj që shikojnë si zhvillim në Shqipëri dhe me shqiptarët është bashkëpunimi, gjetja e kompromisit.

Në Parlamentin Europian nuk janë veç të majtët, por është edhe grupi liberal, ai, i cili po ju thotë hapur juve dhe neve se transparenca e zgjedhjeve, hetimi i zgjedhjeve duhet të jetë i plotë.

Unë mendoj se këtu nuk është fjala për të bërë lojë me deklaratat e një politikani të majtë të huaj me një politikan të djathtë. Ne e dimë shumë mirë se ku na pikon çatia. Sinqerisht, mendoj se pritshmëria për këtë seancë të sotme (që vjen nga të gjithë kolegët e mi) është gjetja e një konsensusi, kompromisi, i cili duhet të garantojë mirëbesimin për zgjedhjet që vijnë. Hetimi i zgjedhjeve të kaluara është baza e mirëbesimit se në Shqipëri do të funksionojë një sistem zgjedhor, ku nuk do të preket më e drejta e votës.

Shqetësimi që kanë kolegët është se mos Partia Socialiste duke kërkuar këtë hetim parlamentar do të vërë në diskutim vendimin e Kolegjit Zgjedhor, pra vendimin e pushtetit gjyqësor, do të vërë në diskutim vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Nëse do të ishte e vërteta kështu, atëherë unë po ju them se kjo do të ishte një kërkesë antikushtetuese. Nëse ne do të vinim në diskutim vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nëse ne do të vinim në diskutim vendimet e Kolegjit Zgjedhor nëpërmjet kërkesës sonë hetimore, atëherë ne do të shkelnim Kushtetutën, sepse do të diskutohet legaliteti i këtij Parlamenti. Legaliteti i Parlamentit është i pakthyeshëm, i pahetueshëm. Ne këtë gjë e dimë shumë mirë.

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese e ka thënë qartazi. Megjithëse në fjalorin e gjuhës shqipe ekziston fjala hetim, hetimi parlamentar nuk është i barasvlershëm me hetimin e prokurorisë. Të dyja janë njëllloj, hetim quhet njëra, hetim quhet edhe tjetra. Heton edhe Kontrolli i Shtetit, heton edhe kontrolli administrativ, por hetimi nga hetimi ka ndryshim. Hetimi parlamentar në esencën e vet është një proces verifikimi i nevojshëm për Parlamentin, për konkluzionet e veta.

Në Komisionin e Ligjeve u diskutua edhe për iniciativën më të fundit, për diskutimin e një reforme zgjedhore. Por si mund të fillojmë me një reformë zgjedhore nëse nuk do të kemi konkluzione të qarta të një hetimi të plotë dhe transparent?

Kolegët e Partisë Demokratike, duke filluar që nga Kryeministri, jam i bindur që janë të orientuar të mendojnë se çështja e rinumërimit është kontestimi i rezultatit të zgjedhjeve. Jo. Nëse do të kishim të bënim me një kontestim të rezultatit të zgjedhjeve, e cila është shprehur që në fillim nga ne si një parim bazë që ne nuk po kërkojmë të hetojmë rezultatit e zgjedhjeve, kemi të bëjmë me dy gjëra krejtësisht të ndryshme. Të verifikosh dhe të rinumërosh në kuptimin ligjor të fjalës janë dy gjëra

të ndryshme. Por kam përshtypjen se në këtë lojë teknikash, me të cilat kemi lodhur edhe publikun, ne po përpiqemi të lidhim procesin e hetimit dhe të verifikimit të Parlamentit me logjikën se ky komision hetimor do të marrë rolin e prokurorisë, rolin e gjykatës dhe gjithçka në këtë vend do të bëhet rrëmujë.

E zëmë, zoti Kryeministër, se na e dhatë kompromisin dhe do të hapen kutitë dhe do të ndodhë ajo më e keqja, ajo që ju keni më frikë, që ne do të vijmë këtu me një vendim, i cili do të thotë se ky Parlament nuk është legjitim. Në thelb, kush do ta votojë konkluzionin përfundimtar? A nuk është ky Parlament, a nuk është kjo shumicë, a nuk ka një Gjykatë Kushtetuese që do të vërtetojë këtë vendim të këtij komisioni hetimor? Ajo që sot është e qartë në një mënyrë apo tjetër, është e transparencës e zgjedhjeve, miqtë e mi, është e nevojshme si një bazë sigurie dhe mirëbesimi. Është prekur fondamenti i mirëbesimit të përbashkët për të bërë rolin e pozitës dhe opozitës në Shqipëri. Faktori ndërkombëtar këtë e ka kuptuar shumë mirë.

Ju kërkoni që ne të vijmë më Parlament, të na numërohen interpelancat, pyetjet, të vijë Kryeministri të bëjë ndonjë batutë dhe kështu të themi që historia e demokracisë po vazhdon. Në fakt, zoti Berisha tha se ju po kërkon të penalizoni 20 mijë komisionerë. Jo, zotërinj. S'duam të penalizojmë kurrkënd ne. Procesi i hetimit parlamentar, i verifikimit parlamentar, s'ka të bëjë me baltosjen e askujt, s'ka të bëjë me çuarjen në prokurori të askujt, sepse ky është dallimi: ne nuk jemi prokurori. Komisioni hetimor nuk është gjykatë. Ajo që po ndodh pak a shumë këtu, tifozët e futbollit në Shqipëri e dinë mirë, është si goli me dorë që ka bërë Maradona. U zbulua që e bëri me dorë. Çfarë ndodhi? U anulua rezultati? Jo. Problemi është që sindromi i Maradonës të mos ndjekë zgjedhjet tona. E bëtë një herë golin me dorë, mos vazhdoni ta bëni edhe në vazhdim.

Zgjedhjet e kaluara ne i dimë shumë mirë se si kanë qenë. Ne e dimë se si kanë qenë, edhe kur kemi qenë ne në pushtet, edhe kur keni qenë ju në opozitë. Vjedhjet e votave në Shqipëri kanë qenë një rezultante e të gjitha zgjedhjeve dhe ne, për fat të keq, nuk kemi ngritur një teknikë mirëbesimi midis njëri-tjetrit. Më thoni, ju lutem, si do t'i përgjigjemi ne një procesi zgjedhor ku rezultati del 300 me 0 dhe nuk ka asnjë vërejtje të asnjë komisioneri në asnjë dokument? Në bazë të sistemit legal që ne kemi ndërtuar, gjithçka funksionon në rregull. S'ka

asnjë provë, rezultati 300 me 0. Jeni të bindur se këto janë rezultate të lira e të ndershme?

Pra, miqtë e mi, unë mendoj se ka shumë gjera sot të cilat ne duhet të na bëjnë të reflektojmë jo për mënyrën sesi të gjejmë arsye për t'u ndarë. Sot po diskutojmë fundamentin e fundamenteve për mënyrën sesi ndikojmë përballë njëri-tjetrit. Duhet mbyllur përfundimisht kjo histori. Kompromisi, i nderuar zoti Kryeministër, është një gjë shumë thelbësore. Nuk është pamja e njërit hipur në kalë, të cilit opozita i mban kapistallin. Hiqeni nga mendja këtë! Kanë ndryshuar kohërat.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Majko!

Urdhëroni, zoti Kryeministër!

Sali Berisha – I nderuar zoti Majko,

Edhe një herë ju bëj thirrje ta vlerësoni ofertën e ndershme, qëllimtarë dhe të drejtë që po bëj. Zoti Majko, nuk mundet që të përdoret, është mëkat të përdorësh fjalën "transparencë" për ta lyer atë me bojë të zezë. Pse e them këtë? Unisoni që komisionerët e të gjitha forcave politike kanë dëshmuar në zgjedhjet e 28 qershorit rrjedh sigurisht nga integriteti moral i tyre, por rrjedh edhe nga një ligj unik në doktrinën elektorale, ligji i vetos për çdo të pranishëm. Ligji i vetos që vendosëm ne, duke hequr shumicën dhe votën e saj, i dha mundësi çdo përfaqësuesi politik të forcave tona, i dha mundësi çdo vëzhguesi, të cilitdo kandidat, i dha mundësi çdo të pranishmi që të bllokojë procesin me një akt të vetëm, ngritje dore.

I nderuar zotëri, neni 116 është edhe neni i artë i transparencës më ekstreme që mund të jetë bërë në një proces zgjedhor në historinë e vendit tonë dhe të vendeve të tjera. Nuk ekziston kod elektorale ku ngritja e dorës të secilit të pranishëm aty, për secilin proces, të krijojë bllokimin dhe ta kthejë nga e para. Në qoftë se gjatë numërimit krijohej dyshimi më i vogël, mjaftonte një ngritje dore për ta kthyer jo një herë, por dy herë, tri herë nga e para rinumërimin. Kjo ishte e drejta e kundërshtisë mbi të cilën u bazua kjo transparencë. Pse kanë firmosur të gjithë? Kanë firmosur të gjithë se secili prej tyre, në qoftë se ngrinte dorën një herë dhe thoshte se kjo fletë votimi është e pavlefshme, shqiptarët e merrnin vesh se ajo fletë votimi ishte e pavlefshme. Ai që e kryesonte atë komision, demokrat apo socialist qoftë (se e keni pasur gjysmë për gjysmë në kryesi), detyrohej ...

(Reagim nga deputetë të opozitës)

Ju e dini ç'keni bërë atje, por ato që janë marrë

vesh sipër, s'i dini, se kishte një marrëveshje eprore, ju e zbatoni atë. Pra, mjafton të ngrihej dora, zoti Majko, dhe fleta, pavarësisht se 9 vetë aty thoshin se është e vlefshme, do të vendosej në zarf të veçantë, do të quhej fletë e kundërshtuar. Po në qoftë se gjatë mbledhjes së rezultateve, i nderuar zotëri, njëri prej të pranishmëve dyshonte se mbledhja ka zvogëluar apo rritur shumën e votave për forcën e tij politike dhe ka favorizuar forcën tjetër, sërish fillonte numërimi nga e para, një herë, dy herë, tri herë.

Përveç kësaj u vendosën ekranet e mëdhenj. Ku kanë qenë në kod këto, ekranet, skanimi, fotografimi, filmimi, transmetimi në kohë reale tek ajo shoqata në hotel "Tirana" dhe në KQZ? Ju lutem zotëri! A ju kujtohet? A kishte parë ndonjëherë vendi një procedurë të tillë? Prandaj, të akuzosh për krim (dhe më erdhi mirë që nuk e përdore atë fjalë ti, se ajo është një abuzim, çka tregove se fjalimin nuk e ke të përgatitur nga ... e di vetë ti se kush), të akuzosh tani për transparencë, kur ky proces ishte më transparent, atëherë do të thotë ta lyesh me bojë të zezë.

Dëgjoni, zotërinj! Po të lexoni Frojdin... (Reagim nga deputetë të opozitës). Mirë, po e lëmë Frojdin mënjatë, por po të lexoni për komplekset, kur mbetesh në kompleksin e Edipit, e di vetë se ç'ke për të vuajtur. Duhet të përipiqesh ta zgjidhësh, të nderuar zotërinj, jo të viktimizohesh nga ai kompleks. Unë u detyrova t'i them një zonje të nderuar këtu se sado që ligjëron, antiterishizmi yt nuk vlen. Po pse thoni ju? Shkaku nuk është se nuk kishte fjalë kundër Sali Berishës aty, nga më të egrat, më të nxirat, kishte, por ato nuk kanë peshë, peshë kanë ato që burojnë nga kompleksi i Edipit. Se një shoqe e saj, një ditë, kur u gjend në orën e mençurisë, tha se Berisha është kalorësi me këmbë të varura. E fitoi, i doli para, i doli para jo një shkallë, por pesë kate, për fatin e vetëm se nuk ishte i njëjti qatip. Qatipi ishte i linjës tjetër.

Prandaj, të nderuar opozitarë, urdhëroni të krijojmë komisionin. Në këtë komision keni mundësi të bëni transparencën më të plotë. Këtë do t'ju them një mijë herë, sepse jam unë më shumë se secili prej jush i interesuar, për transparencë, sepse transparenca është qëllimi i jetës sime.

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Kryeministër!

Zoti Ruçi e ka fjalën.

Gramoz Ruçi – Zonja Kryetare,

Të nderuar deputetë,

E mora fjalën për procedurë. Kanë falur dy kolegë të Grupit Parlamentar të PS-së dhe dy herë Kryeministri duke përdorur foltoren...

(Ndërhyn Kryeministri.)

Ju të rrini dhe të rrini gjatë, sepse keni kohë për të dëgjuar, jo për respekt, por sepse e keni për detyrë. Po të keni respekt dhe po ta keni detyrë, ju lutem jini serioz dhe mos bëni karagjozllëqe! Të mos e kthejmë seancën në shfaqje të keqe, në vend që ta kthejmë në një debat konstruktiv. Unë desha ta besoja sinqerisht që pas tri seancave që Grupi Parlamentar Socialist ka ardhur këtu, tri gjëra që ju kemi bërë apel arritët t'i artikulonim më së fundi:

Fjalja e parë, vullneti i mirë politik që jua kemi thënë që ditën e parë.

Fjalja e dytë, kemi ardhur për të negociuar, kështu thatë dhe këtë jua kemi thënë po prapë që ditën e parë.

Fjalja e tretë, kemi ardhur për të bërë deal. Plotësisht dakord, por pas tri fjalive nuk latë zhargon dhe demagogji pa bërë në ligjëratën tuaj të mëparshme prej gati gjysmë ore dhe në ligjëratën tuaj pasardhëse prej 10 minutash.

Prandaj, ne nuk kemi ardhur këtu të dëgjojmë demagogjinë tuaj, nuk kemi ardhur këtu të dëgjojnë retorikën tuaj dhe nuk kemi ardhur këtu as të provokohemi dhe as të bëjmë një diversion të Grupit Parlamentar Socialist me socialistët, votuesit e tyre dhe komisionerët. Prandaj, zoti Kryeministër, të dua apo të s'të dua unë, të do apo s'të do Grupi Parlamentar i PS-së, ne kemi kulturën politike dhe të drejtohemi si Kryeministër. Këmbët mbaji në tokë, mendjen në kokë, Shqipëria është në krizë dhe kjo përgjegjësi është te ju. Ne jemi këtu pikërisht për të shprehur këtë vullnet. Jua kemi thënë dhe po jua themi për herë të tretë: ne jemi këtu për të negociuar. Lini kolegët të sjellin argumente! I dëgjoni deri në fund! Ju që duhet të flisni i fundit, guxonit të flisni i pari, për t'u mbyllur gojën socialistëve. Ju lutem! Ne kemi ardhur këtu të sjellim argumentet tona me qetësi, me kulturë politike, dëgjojini deri në fund! Në qoftë se keni një ofertë, do të jemi këtu tërë natën, nesër tërë ditën, pasnesër. Jeni ju që duhet të thoni fjalën i fundit, se jeni lider i kësaj maxhorance, jeni lider i vendit, keni përgjegjësinë më të madhe për këtë çështje. Kurse ju kërkonit ta degjeronit dhe ta ktheni në një humor të pëshitur për partnerët tanë ndërkombëtarë dhe për opinionin publik shqiptar. Kurse ne kemi ardhur dhe po rrimë me gjithë seriozitetin dhe preokupimin në këtë sallë, që të sjellim argumentet tona dhe të shprehim

vullnetin tonë. Dhe do të qëndrojmë të shprehim të gjithë arsenalin e argumenteve tona, të kulturës sonë politike, të argumenteve tona juridike, që ky problem ka zgjidhje. Pengesa e moszgjidhjes është vetëm mungesa e seriozitetit dhe e vullnetit tuaj politik.

Prandaj, në qoftë se merrni fjalën për replikë, dy minuta keni të drejtë të bëni replikë me deputetët që ju zënë në gojë, por jo që pas çdo deputeti ju të reviziononi mendimet dhe diskutimin e tij. Në qoftë se keni ndër mend të bëni diskutim si të gjithë të tjerët, merreni fjalën, bëni diskutimin dhe kaq.

Jozeфина Topalli – Zoti Ruçi, po ju bëj të ditur se në bazë të nenit 80 të Kushtetutës, Kryeministri dhe çdo anëtar tjetër i Këshillit të Ministrave është i detyruar dhe ka të drejtë ta marrë fjalën menjëherë, sa e herë e kërkon. Që nga momenti që ka filluar seanca kanë folur deputetët Fatmir Xhafaj, Namik Dokle, Saimir Tahiri, Pandeli Majko, pra katër vetë nga opozita, si dhe dy vetë nga maxhoranca. Në pjesën tjetër të kohës ka ndërhyrë dy herë zoti Kryeministër, sepse ju i jeni drejtuar zotit Kryeministër dhe është e drejta e tij në bazë të Kushtetutës dhe të Rregullores.

Së dyti, kam shkelur përsëri Rregulloren për t'ju dhënë juve mundësinë për të folur. Këtu kam të shënuar 56 emra. Në bazë të Rregullores, unë ju kërkoja në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve, ashtu siç e kemi bërë 15 vjet rresht, të caktohet koha e këtij debati. Nuk pranuat që të caktohet koha dhe unë përsëri bëra një koncesion tjetër, 56 vetë janë regjistruar, të 56-të do të flasim për të shprehur ato që mendojnë.

Fjalën e ka zoja Valentina Leskaj.

Urdhëroni, zonjë, 13 minuta!

Valentina Leskaj – Falemnderit!

Të nderuar kolege dhe kolegë deputetë,

Debati që bëjmë sot, pa dyshim që është shumë i rëndësishëm, do të thosha nga më të rëndësishmit në historinë 20-vjeçare të Parlamentit shqiptar. Është i tillë jo vetëm për shkak të objektit e të rëndësisë që ai ka, sepse ka të bëjë me një të drejtë, me një të drejtë njerëzore, për të cilën Shqipëria sot është në krizë, por edhe për shkak të momentit politik në të cilin ndodhet vendi, për shkak të raporteve me Bashkimin Europian, për shkak të situatës së integritit.

Më duhet t'ju them që në fillim se diferenca që ne kemi në çështjet që diskutojmë janë diferenca që kanë të bëjnë me raportin me të vërtetën, që ju ua keni mohuar shqiptarëve. Përpjekja për t'i zhveshur qytetarët e këtij vendi nga një e drejtë

kushtetuese, siç është e drejta e transparencës, na ka angazhuar ne si opozitë për rreth 8 muaj në një betejë për të vërtetën, sepse ne besojmë se drejtësia e një kauze fillon nga e vërteta, e cila po mbahet peng.

Pa dyshim që ne kemi ardhur këtu me vullnetin e qartë për të kontribuar në një zgjidhje të krizës, në ndryshim nga qëndrimi juaj refraktar dhe përpjekja për ta shpërfillur dhe jo për ta zgjidhur krizën, ne e kemi dhënë me kohë sinjalin e kompromisit. E kemi bërë këtë hap jo vetëm me deklaratat, por me një nismë ligjore konkrete, e cila jep një zgjidhje të qëndrueshme jo për opozitën, por për vendin, duke i dhënë një herë e mirë fund gangrenës së zgjedhjeve të manipuluar në Shqipëri. E kemi bërë këtë ofertë me vullnetin e qartë për zgjidhje të krizës pa komplekse, si një forcë politike konstruktive që ka parësore interesat e vendit, ashtu siç e bëmë edhe përpara këtyre zgjedhjeve me reformën zgjedhore dhe reformën në drejtësi përpara anëtarësimin të Shqipërisë në NATO, gjë që i dha Shqipërisë edhe anëtarësimin. Natyrisht, jo për ta përdorur atë si dekoratë, siç u përdor në zgjedhje, por për ta përdorur për vendin.

Në fakt, përkundër vullnetit dhe përpjekjeve tona për të gjetur një zgjidhje për vendin, përkundër të gjitha deklaratave të partnerëve ndërkombëtarë, qëndrimi i Qeverisë ka mbetur i ngurtësuar. Ne kemi kërkuar transparencë për të gjithë dhe zgjidhje për të ardhmen, jo për të shkuarën dhe kjo është pikërisht ajo që kërkon edhe deklaratat e djeshme e zonjës Tania Fajon, të cilën po e citoj: "Për të siguruar transparencën e zgjedhjeve për të gjitha forcat politike në Parlament çdo herë, pas zgjedhjeve lokale apo parlamentare". Mesazhi është i qartë. Pra, jeni të vendosur të dilni kundër të gjithëve, kundër transparencës me disa arsye që janë rrëzuar me kohë.

Besoj se sot është e tepërt të ndalemi në të gjitha ato argumente, do të thosha shteruese, që opozita ka sjellë në komisionin përgjegjës apo në debatet publike lidhur me përpjekjet e sforcuara që janë bërë për të përdorur si jorgan gjykatën apo Kushtetutën e vendit.

Të gjithë sot janë të bindur se kërkesa e Partisë Socialiste për transparencën e zgjedhjeve është e drejtë kushtetuese, është një e drejtë që mbështetet edhe në vendimin e Gjykatës Kushtetuese të bërë publik, pavarësisht nga leximet e ndryshme që bëhen këtu, është e drejtë e përdorur në vitin 2005 nga i njëjti Parlament. Një gjë që është bërë në vitin

2005 nuk e di se ç'motiv e pengon që të mos bëhet në vitin 2009.

Qëndrimi ynë lidhur me gjykatën është qartësuar me mijëra herë, që respektojmë vendimin përfundimtar, të formës së prerë, me të gjitha efektet juridike që ka dhe se nuk kemi kërkuar rishqyrtim apo rivlerësim të vendimit të Kolegjit Zgjedhor.

Ndërkohë keni dhe 9 qarqe, zotërinj të maxhorancës, që s'kanë pasur punë me gjykatën, që mund të hetohen. Nëse keni vullnet bëjeni! Kudo që t'i hapni materialet zgjedhore, në çdo qark, do të gjeni me dhjetëra Ruzhdie.

Ju mendoni se përfaqësuesit e Bashkimit Europian, të cilët kërkojnë hetim dhe transparencë të plotë të zgjedhjeve, po na shtyjnë ne të shkelim vendimet e gjykatave dhe Kushtetutën? Ju kujtoni se e beson njeri se një Qeveri që ka bërë 20 shkelje kushtetuese, sot ka hallin e Kushtetutës? Jo, zonja dhe zotërinj, këtë nuk e beson askush!

Ne sot kemi diferenca për një çështje themelore të demokracisë, që ka të bëjë me transparencën e zgjedhjeve. Sot ka një palë që kërkon transparencë dhe kjo është opozita dhe një palë tjetër që refuzon transparencën dhe kjo është maxhoranca. Diferencat janë të qarta, por ne kemi ardhur këtu me vullnetin e mirë për të bërë çdo përpjekje për të zgjidhur krizën, pasi kostoja që paguan vendi është shumë e lartë.

Jo vetëm nga opozita, por edhe nga media e pavarur, nga analistë e njerëz të thjeshtë, nga raporte ndërkombëtare, janë evidentuar probleme në procesin e numërimit të votave, përdorim abuziv të pushtetit dhe aseteve publike, ndëshkime politike të punonjësve në administratën publike, që vazhdojnë edhe sot, shkelje me të dënuarit në burgje etj. Ju asnjëherë nuk i keni pranuar këto. Këto janë shkelje skandaloze.

Gjithsesi, kërkesa jonë për hetim ju jep shans për të provuar të kundërtën e asaj që unë thashë, nëse kjo e kundërt ekziston. Shfrytëzoheni, zotërinj, këtë mundësi, duke i hapur rrugë hetimit të plotë të zgjedhjeve.

Të nderuar kolege dhe kolegë deputetë,

Kjo situatë po mban peng Shqipërinë. Zgjedhjet janë jo vetëm derivat, por edhe shkak i krizës që ka vendi. Kriza është jo vetëm politike, ajo është qartazi edhe institucionale, edhe ekonomike. Kush mund të thotë se nuk ka krizë institucionale, për sa kohë që për 6 muaj që ka funksionuar ky Parlament, ka qenë gjysmë parlamenti. Pa opozitën një parlament nuk mund të bëjë reforma të qëndrueshme dhe këtë

ne e dimë të gjithë.

Pa dyshim, kjo ka të bëjë me vullnetin politik, për sa kohë që dy javë përpara u miratuan ndryshimet në Rregulloren e Parlamentit, të një Rregulloreje e cila ishte miratuar me konsensus, por që u ndryshua në mënyrë të njëanshme. Unë besoj që kjo është dëshmia më e qartë e mungesës së vullnetit për konsensus.

Pa dyshim që kriza institucionale shkon përtej institucionit të Parlamentit, për shkak të raporteve të vështira që krijon vetë Kryeministri, me institucionet e pavarura, me përpjekjet për uzurpim dhe nënshtrim të tyre, që nga institucionet e drejtësisë, shërbimet sekrete e deri tek entet rregullatore mediatike, që kanë krijuar probleme të mëdha me pavarësinë dhe pluralitetin e medias. Sot operatori televiziv publik nuk ekziston më. Shqiptarët paguajnë taksën e një televizioni që nuk u shërben atyre.

Këto probleme janë bërë pjesë e çdo raporti ndërkombëtar, përfshirë edhe atë që u paraqit sot nga Sekretari britanik i Shtetit për Politikën e Jashtme, Dejvid Viliband.

Për sa i takon krizës ekonomike nuk ka ndonjë shqiptar besoj, natyrisht përveç Qeverisë, që të mos ndiejë pasojat. Ju kujtoni se duke u thënë shqiptarëve se jemi ndër katër vendet me rritjen më të lartë ekonomike, ata do të bëhen të lumtur. Ky lajm, edhe po të jetë i vërtetë, nuk mjafton. Në qoftë se ju nuk e dini se tani që flasim ka familje që nuk u japin dot racionin e darkës fëmijëve të tyre, që ka fermerë që nuk mbjellin dot tokën, që ka të sëmurë që nuk blejnë dot ilaçet, që njerëzit nuk paguajnë dot faturën e energjisë elektrike apo të ujit të dyfishuara, ky është problemi juaj. Sot që flasim këtu ka familje që janë në qiell të hapur për shkak të rrëshqitjeve dhe pamundësisë së Qeverisë për t'u ofruar një strehë, 17 familje janë vetëm në fshatin Probat të Shpatit.

Zonja dhe zotërinj,

Kriza e zgjedhjeve nuk zgjidhet duke e fshehur, por duke u adresuar. Me kërkesën për hetimin e zgjedhjeve nuk bëhet fjalë për ndonjë lëshim ndaj opozitës, siç u trajtua këtu, por për një të drejtë legjitime. Askush nuk mund t'ia heqë Parlamentit të drejtën e hetimit të zgjedhjeve. Ne kërkojmë, as më pak e as më shumë, që interesat e Shqipërisë dhe të shqiptarëve të vihen mbi interesat tuaja të ngushta.

Të gjitha mesazhet që vijnë nga partnerët tanë ndërkombëtarë kërkojnë të njëjtën gjë. Vetëm dje

janë bërë tri deklarata nga përfaqësues të nivelit të lartë të Bashkimit Europian, që kërkojnë zgjidhje për krizën. Mesazhet e tyre janë shumë të qarta dhe këto na bëjnë të përgjegjshëm të gjithë si politikanë.

Sot të gjithë, shqiptarë e ndërkombëtarë, presin një zgjidhje nga ky Parlament, i kanë sytë nga ky Parlament. Sot qeverisjes i jepet mundësia të dëshmojë përgjegjësi e seriozitet ndaj tyre. Meqenëse ajo që sot quhet maxhorancë, në fakt, për fat të keq, përfaqësohet nga një njeri, dua t'i kërkoj zotit Berisha:

Zoti Berisha ju sot jeni përpara provës së madhe që lidhet me fatet e shqiptarëve. Nëse keni vullnet, dëshmojeni, duke i hapur rrugë transparencës për të mbyllur një herë e mirë kapitullin e zgjedhjeve të manipuluar që e mbajnë peng vendin. Nëse e keni seriozisht integrimin, atëherë respektoni thirrjen e Bashkimit Europian, të bërë dje përmes komisioneres Tania Fajon, që hetimi dhe masat e propozuara nga opozita duhet të arrijnë transparencën e plotë si themeli i përmirësimeve të rëndësishme në mënyrën se si do të zhvillohen zgjedhjet në të ardhmen për të përmbushur standardet ndërkombëtare. Këtë e ka thënë komisionerja dhe jo unë. Pa dyshim që keni rastin të ngriheni mbi interesat e tuaja për të vënë në plan të parë interesat e shqiptarëve.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit!

Urdhëroni, zoti Kryeministër, keni fjalën!

Sali Berisha – E nderuar zonjë,

Zonja deputete,

Zotërinj deputetë,

Të dashur qytetare dhe qytetarë shqiptarë,

Themelore në një qëndrim është raporti i këtij qëndrimi me të vërtetën, raporti i perceptimit të realitetit dhe interpretimit të tij.

Të përpiqeni të paraqisni ashtu sikundër nuk është një realitet të certifikuar si kurrë ndonjëherë në historinë e këtij, në unison të plotë nga përfaqësuesit e të gjitha forcave politike, të përpiqeni të paraqisni ashtu sikundër nuk është një realitet të certifikuar dhe të bërë transparent, të nxjerrë në dritën e diellit nga të gjitha këto media dhe qindra të tjera që nuk janë këtu, ditën e votimit, ditën e numërimit, të përpiqeni të paraqisni ashtu sikundër nuk është një realitet të vlerësuar nga komuniteti ndërkombëtar si një realitet që plotësoi zotimet kryesore të OSBE-së dhe që nuk pati asnjë provë për manipulim të rezultatit apo numërimi të parregullt,

është absolutisht kundërproduktive për qëllimin tuaj.

Të kërkohet transparencë për të nxirë një proces transparent, për ta llyer atë me bojë, të jeni të sigurt se sot mund të lehtësojë dhimbjet e njërit apo tjetrit nga humbja, por nesër, në rast se kjo do të ndodhë, do të kthehet në një bumerang që do të krijojë dhimbje shumë herë më të mëdha.

E nderuar zonjë, ju dëgjova me vëmendje të citoni deklaratat, por më duhet t'ju them se ashtu siç perceptoni realitetin, druaj se interpretoni edhe deklaratat e faktorit ndërkombëtar. Do t'ju jap vetëm një fakt: para se të vinte këtu Komiteti Presidencial, ju personalisht, partia juaj, udhëheqja e partisë suaj, u angazhuan në një propagandë të shfrenuar dhe, në mënyrë të përsëritur, në mënyrën më të sinqertë dhe miqësore ju thashë se ju po i keqinterpretoni qoftë rezolutën, qoftë deklaratat. Çfarë ndodhi? Në Shqipëri erdhi Komiteti Presidencial dhe unë e mirëprita plotësisht. Pse nuk e përmendni ju më Këshillin e Europës? Pse e harruat Rezolutën e Këshillit të Europës? Pse nuk i referoheni asnjëherë më këtij tempulli të zgjedhjeve, pasi është institucioni kryesor i ndërtuar mbi zgjedhjet e lira? E dini pse? Jua them unë. Sepse unë pranova çdo sugjerim të tyre, kurse kryetari juaj nuk pranoi asnjë.

Zonjë, të jeni e bindur, se jam jashtëzakonisht i hapur ndaj komunitetit ndërkombëtar, institucioneve ndërkombëtare. Ndodh që kam edhe kundërshti, por në një shoqëri demokratike dhe në një botë të lirë kundërshtitë zgjidhen. Aty ku ti e ke gabim, ai korrigjohet; aty ku të tjerët e kanë gabim, e korrigjojnë. Ka pasur raste gjatë këtyre muajve që publikisht janë thënë të kundërtat e asaj që mund të ishin thënë disa kohë më parë.

Pra, nuk u shërben të interpretoni sipas oreksit tuaj, sepse në Europë mund të gjendet ndonjë racist antishqiptar që t'ju thotë shqiptarëve shqelmoni Kushtetutën tuaj. Por dhe nuk ka njeri t'ju rekomandojë shqiptarëve të shkelin Kushtetutën. Asnjë. E keni parë ju, zonjë, që edhe Zhaoa Soares, që është në pozicionet më të larta ndërkombëtare si socialist, lëshoi deklaratën që të hetohet plotësisht në përputhje me vendimet e Gjykatës Kushtetuese.

E nderuar, zonjë, edhe ai zotëria, që absolutisht ka ndarë me ju një program, vuri klauzolën. A doni t'ju them një gjë tjetër? Në tryezë me Presidentin e Republikës, kryetari juaj, në mënyrën të përsëritur kërkoi hapjen e kutive dhe rinumërimin. Çfarë i thanë? Jo këta që ishin qendra e djathë apo të djathtë, por ata që ishin tërësisht majtas, madje

më larg sesa socialistë, i thanë: "Zotëri, kjo ka procedurë. Kjo do procedurë kushtetuese, sepse vendimet e gjykatave nuk mund të trajtohen ndryshe. Ndaj, lexojini mirë deklaratat!"

Kur erdhi radha e Rezolutës së Këshillit të Europës, jua thashë në mënyrë të përsëritur se po e keqinterpretoni. Ajo tani u harrua dhe nuk flitet më për Këshillin e Europës në qarqet tuaja eprore.

Zonjë, po them dy fjalë për krizën ekonomike. Bota është në krizë dhe kjo ishte kriza më e rëndë ekonomike që nga vitet '30 të shekullit të kaluar. Fatmirësisht, ky vend nuk ra në krizë dhe këtë nuk e them unë, por e thonë ata që ju para pak muajsh i citonit dhe hapnit gazetatat me deklaratat e tyre. Keni marrë edhe mesazhe për keqpërdorimin e deklaratave, por nuk më interesojnë mua ato. Jua a them me sinqeritet.

Nuk e them vetëm unë, por të gjitha raportet e botës, që Shqipëria, Kina, India, Polonia mbetën me rritje ekonomike. Rritje mund të ketë pasur dhe Afganistani. Nuk i mblidhen të gjitha të këqijat një vendi. Pse e paske kaq merak t'i thuash popullit tënd je në krizë? Mirë para zgjedhjeve se, hajt, po bëjmë propagandë dhe fitojmë ndonjë votë. Para zgjedhjeve ju u thatë shqiptarëve se nuk ka asnjë lek për të paguar rrogat dhe pensionet. Ne bëmë ngritjen më të madhe në histori të rrogave dhe pensioneve. Po të ishte krizë, nuk do të bëhej kurrë. Jo, zonjë, nuk është krizë. Ka këtu ekonomistë, ministra që kanë drejtuar financat e vendit. Le të shkojnë të marrin të dhënat! Nuk mund të flitet për krizë në një ekonomi që i rriten eksportet 102% në dy muaj. More zotërinj, të gjitha janë të botuara!

Juve ju ka mbetur ora te kutia, kurse ora ime është tjetërkund. Ne nuk fshehim asnjë statistikë. Merrini të dhënat e doganave, të eksporteve dhe të importeve! Atje do të gjeni rritje 102% të eksporteve *made in Albania*, do të gjeni rritje 29% në shkurt të 2010-s. Pse bëni kështu? Pse doni të krijoni një realitet që nuk është? Sa ju shërben juve kjo? Nuk them se është viti i artë i ekonomisë, sepse kjo krizë botërore, sigurisht, ngadalëson dhe dekurajon investitorët e huaj për projekte shumë të mëdha. Në vend që të paraqisni një alternativë dhe t'ju thoni shqiptarëve, ju thoni se do të padisni INSTAT-in për fajin e vetëm, sepse jep ndërkombëtarisht statistika të vërteta. Sa produktive është kjo? Por ne nuk jemi mbledhur sot këtu për ekonominë. Jemi mbledhur për të zgjidhur problemin, të krijojnë komisionin, të bëjmë transparencën e plotë. Ta bëjmë në rrugë kushtetuese, duke respektuar dhe duke mos tentuar

kurrë të marrim të gjitha pushtetet në duart tona. Po pse nuk keni besim? Unë qenkam armik i atyre institucioneve, siç e thatë ju vetë këtu, që cenoj institucionet e pavarura? Si paskam unë besim dhe ju nuk keni besim tek ato? Kjo nuk ju shërben juve. Unë ju bëj thirrje ta perceptoni realitetin ashtu siç është, se, absolutisht, nëse ju jeni të interesuar për transparencë, unë jam 100% i interesuar. Doni ju të përcaktojmë një kuadër ligjor për transparencë të përhershme? Jam plotësisht dakord.

Ne jemi vend me institucione. Edhe më nxirrni kundërshtar të institucioneve të pavarura edhe, kur vjen puna, i lyeni me bojë dhe i nxini, sepse nuk keni besim. Si ta zgjidh unë këtë punë? Më thoni! Merreni të sinqertë ofertën time. Ejani të krijojmë komisionin, siç kemi premtuar në mënyrën më të përsëritur! Ka vështirësi ligjore vlen edhe për institucionet kushtetuese për të përmbushur detyrimet e tyre. Urdhëroni, e t'u krijojmë mundësinë atyre!

Jemi këtu 140 vota dhe mund t'ua krijojmë atyre mundësinë. Jemi këtu t'ju krijojmë çdo lloj mundësie atyre. Askush nuk i shmanget Kushtetutës, por nuk mund të bëhemi gjykatës dhe prokurorë. Nuk duhet ta mendojmë kurrë një gjë të tillë, se po e bëmë, qoftë dhe një herë, kjo demokraci nuk ka të ardhme. Sot marrim një proces gjyqësor, nesër vendosim bashkërisht të marrim një dosje tjetër gjyqësore, pasnesër një proces tjetër. Ku shkojmë ne kështu? Jo, zonjë! Jemi të fuqishëm. Jemi ligjberës. Ndryshojmë ligjet. Krijojmë kushte, përcaktojmë fonde, ndryshojmë buxhete, i bëjmë të gjitha në funksion të atyre, por respektojmë procedurat. Jemi Parlament dhe jemi një pushtet. Jemi legjislativ dhe, kur vjen puna, kemi një rregullore që bashkërisht përplasemi në mënyrë të përsëritur për respektimin e saj.

Ndaj, unë ju ftoj që të afrohem në perceptimin e realitetit, të zgjedhim problemin dhe për sa u përket ndërhyrjeve, unë nuk e shfrytëzoj të drejtën. Unë jam këtu në këtë seancë për t'ju dëgjuar juve, të kontribuoj sa të mundem, se jo çdo gjë e kam unë në dorë. Por, nëse këtu del gjithsecili dhe mendon të bëjë gjyqin e Kryeministrit, ai, sigurisht do të bëjë avokatinë e vetes. Kaq kisha.

Jozefina Topalli – Zoti Gjijnuri, urdhëroni!

Damian Gjijnuri – Të nderuar deputetë,

Ajo që ndodhi në Komisionin e Ligjeve, ku argumentet tona juridike dhe profesionale u ndeshën e u përplasën vetëm me murin e ngritur nga pushteti për të ndaluar transparencën, ishte një tjetër provë

e mungesës së vullnetit për t'i hapur kutitë e 28 qershorit.

Fatkeqësisht, po vihet në diskutim dhe po tentohet të bëhet jurisprudencë kushtetuese me çështje që asnjë profesionist, në asnjë vend të botës, nuk i diskuton. Asnjë vendim i Gjykatës Kushtetues nuk i ka trajtuar si dhe asnjë ligj nuk i kufizon. Këtu nuk e kam fjalën për objektin e hetimit, i cili është i qartë, i gjithëpranuar dhe në përputhje me nenin 77 të Kushtetutës. Fjalën e kam për mjetet që i ka dhënë ligji dhe Kushtetuta një komisioni hetimor: të drejtën për t'u njohur me dokumentet zyrtare, që mishërojnë vullnetin e administratës shtetërore në funksion të kontrollit parlamentar.

Ata që janë njohur botërisht për një rekord në shkeljet e Kushtetutës, plot 20 herë në 4 vjet, shkelje që kanë nxitur edhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese, të cilat i tundin sot përditë prej 8 muajsh, nuk qenë në gjendje të citojnë një vendim të vetëm, një fjalë të vetme apo qoftë edhe një nen të ligjit, për atë që po bëjnë prej 8 muajsh dhe që ndalojnë opozitën nga kontrolli i dokumenteve zyrtare.

Ku e gjejnë të drejtën ta kufizojnë hetimin e komisionit hetimor, duke përjashtuar kutitë si mjet hetimi? Askund në ligj, por vetëm te frika që kanë nga e vërteta. Sepse nuk ka asgjëkund, përveçse te frika e pushtetit, kushte të tilla absurde për të drejtën e padiskutueshme të Kuvendit, për t'u njohur me dokumente zyrtare, përfshirë edhe ato që ndodhen në kutitë e votimit.

Pa këtë të drejtë elementare, hetimi parlamentar që kërkohet të bëhet, është i pamundur praktikisht. Është njësoj si t'i kërkosh dikujt të mësojë mësimin pa hapur librin, do të thoshte një filozof i lashtë. Një Parlament që nuk ka mundësi të këqyrë dokumente zyrtare, nuk është më Parlament, por një mashë e rrezikshme në duart e Qeverisë, e kthyer në një kërcënim shoqëror. Ai mund të miratojë gjithçka që i kërkon Qeveria, por nuk mund të kontrollojë asgjë që i prish gjumin Qeverisë. Ky është një Parlament që nuk kontrollon as ekzekutivin dhe nuk bën dot asgjë tjetër.

Ky Parlament ka dy rrugë: ose të largohet, ose të vetëshpërndahet, sepse rruga e tretë, ajo e pranimit të kësaj gjendjeje, duke i kufizuar të drejtën elementare opozitës, na bën që të mos e pranojmë këtë rrugë të tretë. Me çdo kusht, ky Parlament duhet të shpërndahet. Meqenëse në relacionin e dobët dhe pa argumente të palës tjetër u përmendën shembuj nga sejmia polak apo sejmia lituaneze për

objektin e hetimit dhe që s'kanë asnjë lidhje me çështjen që diskutohet, më lejoni t'ju citoj se çfarë thotë jurisprudenca kushtetuese e disa vendeve të tjera model të demokracive perëndimore, ku ne duam të shkojmë. Dhe çfarë thotë për të drejtën për të këqyruar dokumente zyrtare.

E drejta parlamentare britanike thotë: "Komisionet e veçanta kanë një rol kyç në realizimin e llogaridhënies së plotë të ekzekutivit të Parlamentit. Qeveria duhet të jetë e gatshme që të japë çdo lloj informacioni në lidhje me çështjet që hetohen apo kontrollohen nga Parlamentit. Është detyrë e departamenteve të Qeverisë që t'u sigurojë komisioneve të veçanta furnizimin me çdo lloj informacioni, dokumenti që ka lidhje direkte ose indirekte me hetimin parlamentar, pa pasur nevojë për specifikim të veçantë nga komiteti"

E drejta kushtetuese italiane, komisionet hetimore, kanë po ato të drejta si të kishte një gjykatë e republikës, por me të vetmin dallim se vendimet kanë fuqi rekomanduese për Qeverinë dhe Parlamentin. Këto komisione kanë po ato fuqi investigative për çështjet që hetojnë, por me dallimin e vetëm që qëllimi i tyre nuk është penal.

Gjatë hetimit komisionet mund të kërkojnë gjithçka dhe mbi këdo me të vetmin kusht që kërkesa të jetë në përputhje me qëllimin e hetimit. Qeveria dhe çdo autoritet publik ka për detyrë t'i përgjigjet parlamentit duke i vënë çdo informacion në dispozicion dhe në shërbim të hetimit, përfshi edhe paraqitjen e zyrtarëve kudo që ata ndodhen. Meqenëse dëshironi edhe Komisionin e Venecias, ja ç'thotë një memo në lidhje me këtë çështje: "E drejta për hetim parlamentar përfshin edhe të drejtën e pakicës për të përcaktuar objektin e hetimit për marrjen e provave të caktuara dhe të drejtën për të paraqitur një raport të pavarur. Pa këto të drejta të garantuara e drejta e pakicës për hetim nuk do të kishte kuptim praktik në hetimin e veprimtarisë qeveritare."

Le ta thjeshtojmë maksimalisht se çfarë kërkojnë. Ata kërkojnë dokumente zyrtare në dispozicion të hetimit të cilat ndodhen në kutitë e votimit. Pse i kërkojnë? Për të parë sesi është zbatuar ligji nga administrata zgjedhore për të verifikuar nëse ka pasur shkelje për të bërë rekomandimet për parandalimin e tyre në të ardhmen. Dokumentet që kërkojnë janë kopje unikalë dhe i disponon vetëm KQZ-ja. Çfarë parashikon Kodi Zgjedhor për to? Disa dokumente asgjësohen, pra fletët e votimit dhe nuk ka ndonjë

vlerë të mëtejshme publike. Disa të tjera ruhen në arkivat e shtetit, siç janë listat e votimit. E pra, të dyja këto lloj dokumentesh nuk kanë asnjë sekret shtetëror dhe nuk janë pjesë e ndonjë hetimi penal në vazhdim ku nuk hyn dot Kuvendi, megjithëse ky Kuvend e ka bërë zakon që të hyjë dhe të shkelë Kushtetutën sa herë që këtë e kërkon edhe zoti Berisha.

Bëhet fjalë për dokumente të rëndomta zyrtare që gjurmohen punën e administratës zgjedhore dhe si të tilla janë parakusht për suksesin e hetimit për zgjedhjet nga ana e Kuvendit. Kush i ndalon e bën këtë në kundërshtim me çdo liri dhe të drejtë kushtetuese dhe duhet të marrë parasysh të gjitha pasojat, sepse kjo çështje është mirë të zgjidhet këtu. Po nuk u zgjidh këtu, patjetër një zgjidhje do të gjendet.

Pretendimi se ka një vendim gjyqësor që nuk e lejon këtë, është shprehje dembelizmi mendor tipik për pushtetet antidemokratike. Si çdo vendim gjyqësor vendimi i kolegjit zgjedhor ka një çështje konkrete me palë të përcaktuara qartë dhe një bazë ligjore konkrete që nuk ka lidhje fare me hetimin parlamentar.

Kolegji Zgjedhor ka shqyrtuar rregullsinë e vendimit të KQZ-së për refuzimin për rinumërim në tri zona zgjedhore për efekt të tabulimit të rezultatit. Ndërkohë që hetimi parlamentar synon dhe kërkon diçka tjetër, që nuk ka të bëjë fare me tabulimin e rezultatit, por thjesht me ushtrimin e kontrollit kushtetues parlamentar.

Në të gjithë këta muaj në këtë debat nga Komisioni i Ligjeve, deri sot, nuk dëgjova asnjë rast të vetëm shqiptar apo botëror dhe as citim të një fjalie të vetme të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë apo të cilitdo vendi demokratik në botë që tregon se mjeti i hetimit cenon pavarësinë e një pushteti tjetër. Asnjë shembull, asnjë praktikë nuk u përmend se ekziston një kategori dokumentesh zyrtare përveç atyre që janë sekret shtetëror apo që janë në një proces hetimi penal, të cilat nuk mund të hapen publikisht nga Kuvendi. Ju s'keni çfarë të thoni përveç përsëritjes si në jerm të fjalive pa kuptim juridik të autoritetit tuaj suprem, zotit Sali, sepse nuk ka të tilla, nuk mund të gjesh të tilla në asnjë vend demokratik të botës, as këtu te ne. Çdonjëri nga ju, jurist ose jo, e ka shumë të qartë këtë gjë, por ju nuk ju lë diçka tjetër, nuk ju lë zoti Berisha. Ju e mbani këtë pozicion antikushtetues dhe antidemokratik nga frika e së vërtetës dramatike që këto kuti fshehin. Frika se nga hapja e tyre del e

vërteta e hidhur në lidhje me Ruzhdien, i cili nuk është një rast i veçantë, por një metodologji tipike e përhapur në këto zgjedhje.

Hapja e kutive dhe marrja e dokumentacionit për qëllime hetimore nga Parlamenti nuk është asgjë e re për këtë Kuvend. Komisioni hetimor për zgjedhjet e vitit 2005 kërkoi të njëjtën gjë nga administrata zgjedhore e asaj kohe, cila i hapi kutitë dhe i dorëzoi materialet zgjedhore të kërkuara gati të 1 mijë qendrave të votimit pa e diskutuar fare këtë si problem juridik apo kushtetues.

Natyrshëm lind pyetja se përse kjo kërkesë u pranua në atë kohë dhe jo tani? Në fakt këtu qëndron si absurditeti i qëndrimit tuaj sot i cili rreket të përmend gjithfarë argumente juridik gjysmak ashtu edhe shkaku i vërtetë i këtij qëndrimi absurd. Ky shkak ka të bëjë me faktin e thjeshtë se zgjedhjet e vitit 2005 i organizoi Qeveria e Partisë Socialiste ndërsa në vitin 2009 zgjedhjet i organizoi Sali Berisha.

Ky i fundit ashtu siç ka mbyllur kutitë e të vërtetës të 28 qershorit ka mbyllur edhe kutitë e shifrave ekonomike që po lëngon Shqipëria. Ndërsa ai po thotë se Shqipëria po vrapon. Ka mbyllur edhe kutitë e tunelit të Kalimashit që është shembur si piramidat e '97 duke gllabëruar miliarda që i paguajnë shqiptarët në formë borxhesh e që i merr ai për korrupsione e shiritat e pushtetit të tij. Ka mbyllur edhe kutitë e Fierzës duke përmblytur 11 mijë e ca hektarë e për të thënë se Zoti ju mbyti e unë po ju shpëtoj. Ka mbyllur edhe kutitë e administratës publike ku lulëzon injoranca e fanatikëve dhe bakshishi për shërbëtorët e pushtetit. Ka mbyllur edhe kutinë e mirëqenies së zhvillimit duke hapur vetëm vrima në çdo cep të Shqipërisë dhe në çdo gjetkë të shqiptarit ku inauguruan punime ku nuk i paguan dot me paratë e buxhetit. Ka mbyllur edhe kutinë e premtimeve duke lënë hapur vetëm shtigje të rritjes së çmimeve dhe borxheve nga të katërt anët. KA mbyllur edhe kutinë e konkurrencës në treg duke sunduar me monopolet e oborrit të tij. Ka mbyllur edhe kutinë e bashkëpunimit me partnerët tanë të mëdhenj për një nga pikat më nevalgjike dhe më të rëndësishme për interesin kombëtar, siç ishte ai me bashkëpunimin me SHBA-në për një çështje kaq të rëndësishme si shërbimi inteligjent shqiptar.

Sali Berisha kërkon të mbyllë në kutitë gjithë lojën e demokracisë për pjesën e mbetur të jetës së tij dhe të kthejë qeverisjen e këtij vendi në sundimin e një familjeje mbi një shoqëri që po humbi

të drejtën e transparencës së zgjedhjeve ka humbur edhe të drejtën e vetë zgjedhjeve.

Insistimi me çdo kusht për të mos lejuar transparencën më kujton një shprehje të Xheri Adams i cili ka thënë: "Transparenca për dikë mund të jetë turpi për dikë tjetër" por mohimi i transparencës me dikë është vetë turpi që do të mbetet turpi juaj, nëse do të gjeni fuqinë që të kuptoni se turpin e Ruzhdieve të 28 qershorit e keni marrë, ndërkohë që mospranimin e tij për të mbajtur me çdo kusht pushtetin do ta paguani me humbjen e pushtetit duke e futur përfundimisht në histori këtë Parlament si Parlamentin e Ruzhdies".

Falemnderit!

(Ndërkohë, drejtimin e seancës e ka marrë zoti Turku.)

Arrian Turku – Falemnderit, zoti Gjijnuri!

Zoti Alibeaj, urdhëroni!

Enkelejd Alibeaj – Falemnderit, zoti drejtues i seancës!

Të nderuar deputetë,

Kjo e sotmja është një seancë e veçantë, jo vetëm pse, siç ka gjasa të ndodhë, të gjithë ose pothuajse të gjithë deputetët e rinj ose të vjetër të minorancës së Partisë Socialiste do të kenë mundësinë të shijojnë për herë të parë ndjesinë e përgjegjësisë së foltores së nderuar të Kuvendit, jo vetëm se paraqiten për shqyrtim dy iniciativa të rëndësishme ligjore, njëra prej të cilave jo shpesh e eksploruar, siç është ajo e komisionit hetimor, por mbi të gjitha se sot, të paktën ajo që quhet klasë politike, ka një test të fortë për të kaluar në sytë e shqiptarëve. Është pikërisht testi i maturisë dhe i pjekurisë politike. Sigurisht, në këtë test nuk do të përjashtoj asnjë nga pjesëmarrësit, pavarësisht ndarjes politike.

Në përfundim të këtij testi të gjithë ne do të dilnim të nderuar në sytë e shqiptarëve, të pjekur në sytë e ndërkombëtarëve të plotëshpresë për të ardhmen dinjitoze, për detyrimet morale dhe politike që kemi marrë ndaj shoqërisë shqiptare. Është ky një moment që do të shënojë një faqe historie në traditën parlamentare dhe atë politike. E rëndësishme është që ky moment të na rikujtohet më vonë me shijen e mirë se klasa politike shqiptare, pavarësisht debatit dialektik ideologjik apo partiak, di që në momente kryesiale për vendin dhe shoqërinë të qetësohet të reflektojë di të vetëfrenojë veten në maktin e vet për të menaxhuar pushtet, di të ringrihet dhe të rifillojë një etapë të re të debatit politik, së pari, duke e zhvilluar atë këtu

në Parlament në tempullin e debatit dhe në foltoren e arsyes politike dhe së dyti, duke marrë guximin që t'u tregojmë shqiptarëve se cili është vizioni i gjithsecilit, cili është programi ideor i gjithsecilit, për të mirën e vendit. Shqiptarët do të dinë të na vlerësojnë e gjykojnë dhe kur të vijë radha edhe të na votojnë. Pra, është rasti të marrim të gjitha përgjegjësitë tona politike mbi supe.

Kjo që po them nuk është thjesht një listë dëshirash, pavarësisht se duke gjykuar sjelljen tuaj politike apo deklaratat tuaja publike, nuk është shumë e vështirë të deduktosh se cila është strategjia juaj e sjelljes. Megjithatë, kurrë nuk është vonë për ju. Unë e kuptoj fare mirë se deri tani, duke filluar që prej momentit të zgjedhjeve të 28 qershorit, ju jeni futur në një rrugë pa krye, të paarsyeshme, pa ndonjë qëllim të mirëpërcaktuar. Së pari, për të mirën tuaj apo për të mirën e kauzës suaj të opozitarizmit, ju keni në finale qëllimin që në sfidën elektorale të radhës të dilni fitimtar. Por historia juaj e këtyre 9 muajve tregon qartë se ju nuk e keni gëlltatur humbjen e zgjedhjeve, sado e hidhur që ishte ajo. Por nuk duhet të harroni se ai është verdikt i sovranit i cili në një proces zgjedhor të paqtë, të qetë, normal, të mirëvëzhguar nga jashtë dhe brenda, të filmuar dhe të skanuar, të administruar në barazi simetrike forcash, të numëruar dhe rinumëruar, të vlerësuar dhe rivlerësuar, ka nxjerrë një shumëruar të deklaruar si të tillë në unanimitet si nga KQZ-ja, ashtu edhe nga Kolegji Zgjedhor dhe i ka dhënë gjithsecilit hakun. Ju dolët humbës me meritë.

Tashmë është koha që ju të merrni përgjegjësitë tuaja mbi shpatulla, përgjegjësinë e madhe të të bërit opozitë kritike, të sfidoni maxhorancën qeverisëse me idetë dhe vizionin tuaj programatik, nëse i keni, dhe të rikërkoni kredon tuaj politike apo siç e keni zakon të thoni, të kërkoni të fitoni zemrat e shqiptarëve. Kjo është e drejta juaj, por ju nuk jeni duke e bërë këtë. Ju nuk po silleni si ata njerëzit e parazgjedhjeve të 28 qershorit kur ju premtorit shqiptarëve se po të vinit ju në pushtet, do të bënit ç'ishte e mundur për të përmirësuar jetesën e tyre, do ta çonit Shqipërinë më pranë Europës, do të siguronit lëvizjen e shqiptarëve pa viza, përtej së majtës dhe së djathtës. Befas ju harruat gjithçka. Kur kuptuat se shqiptarët nuk u gënjyen prej fjalëve tuaja boshe, kur shqiptarët mbajtën mend prej jush vetëm se kishit një program qeverisës prej një mijë e një faqesh që nuk e pa dritën e diellit dhe duket se ka qenë një program nate, i një mijë e një përrallave dhe se pallati ku flinte Sheherezadja juaj

ishte ngrehina e një ministrie fshati, me sa duket një fshat në periferi të Tiranës, ju hodhët poshtë gjithë maskën tuaj dhe nxorët atë të agrevisitetit politik, të mosnjohjes së realitetit, të bojkotit të institucioneve dhe të protestës së pakuptimtë, duke mbjellë më shumë re të zeza në qiellin e dimrit tuaj politik sesa qielli solli shi këtë dimër.

Tashmë ju treguat fytyrën e vërtetë të sjelljes suaj politike, ju vuani për pushtet aq shumë, sa nuk merrni parasysh se ky vend ka nevojë të tregojë mbi të gjitha se ka shtet, se ka ligj, se ka institucione, se ka tashmë të kristalizuar sensin shoqëror të besimit të publikut në institucionet e veta. Ky është filli inspirues i lëvizjes suaj politike të këtyre 9 muajve.

Mbi këtë bazë ju keni ngritur gjithë lëvizjen tuaj të procesit të hapjes së kutive. Kjo është zgjedhja juaj. Ne nuk mund të bëjmë as më shumë e as më pak sesa t'ju tregojmë se kjo nuk është sjellje e denjë për ju, përderisa ajo cenon imazhin e të gjithëve.

Gjatë gjithë kohës ne kemi qenë shumë të përvuajtur me tekast tuaja, në çdo rast vetëm kemi deklaruar se jemi bashkëpunues dhe kemi marrë seriozisht çfarëdolloj sinjali arsyeje nga ana juaj. Por edhe e kemi shqyrtuar po me këtë seriozitet. Ne nuk kemi besuar se ju në çdo rast jeni duke luajtur blofin, se ju jeni të pasinqertë, se ju nuk jeni seriozë kur predikoni për integritimin e vendit në BE, se ju keni plane orguzeza për të ardhmen e vendit, se ju e mendoni të ngrini lavdinë tuaj mbi fatkeqësinë e vendit. Jo! Nuk e kemi besuar këtë. Mos na zhgënjoni në këtë pikë! Do të ishte tepër e rëndë për ju.

Të jeni të sigurt se te ne do të gjeni gjithmonë këtë frymë bashkëpunimi dhe tolerimi për të mos na zhgënjyer. Është pikërisht kjo frymë me të cilën ne pranuar të shqyrtojmë nismat tuaj ligjore, si atë për komisionin hetimor, duke i dhënë paraprakisht koncesion për shumicën e tyre, por edhe atë për ndryshimin e ligjit. Ne do të bëjmë gjithçka tjetër brenda kufijve të debatit dhe moralitetit politik për t'ju toleruar dhe bashkëpunuar. Por mos na kërkoni të na tërhiqni në mëkatin që, për hir, dhe nën ombrellën e kompromisit politik të paprincipitë, të shkelim atë që është më e çmuar jo vetëm për ne, por për të gjithë shoqërinë shqiptare, që është morali i shtetit ligjor dhe atij të së drejtës, që është ruajtja dhe mbrojtja me fanatizëm e institucioneve ligjore dhe kushtetuese, që është krijimi dhe rritja e besimit të shoqërisë në shtetin e ligjit. Për hir të kompromisit

politik kjo demokraci nuk mund të shndërrohet në tirani parlamentare. Miq, ndryshe kjo quhet diktaturë.

Projektligjin tuaj e shqyrtoam me seriozitetin më të madh, bëmë atë çka është e domosdoshme në këto raste. Vlerësuam se sa në përputhje me Kushtetutën është ky ligj. Nuk bëmë asgjë tjetër, veçse respektuam verdiktet e Gjykatës Kushtetuese. E për sa kohë Gjykata Kushtetuese është goja e Kushtetutës, ju folëm dhe ju flasim vetëm nëpërmjet saj. Shtuam si amendamente, as më shumë e as më pak, por thjesht vargje nga vendimet e Gjykatës Kushtetuese, pa hipokrizi, pa prapamendim, të prirur që të kënaqim kërkesën tuaj e sigurisht ju nuk duhet të keni frikë se në projektligj ne vendosëm thjesht dhe vetëm të shkruajmë atë që në Kushtetutë është shkruar, parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve në funksionimi e komisioneve hetimore, që respektojnë domenin e veprimtarisë së gjykatave, të prokurorisë, të çdo institucioni tjetër të pavarur që ligji e detyron të veprojë në fushën e administrimit të zgjedhjeve. Kjo ishte ajo çka ne sollëm si shtesë në projektligj.

Nga ana tjetër, ne nuk mund të pranojmë ofertën tuaj ligjore. Është mirë që publiku të marrë vesh se çfarë përmbante ajo ofertë. Katër pika janë. Ju kërkonit në projektligjin tuaj që komisionet hetimore për zgjedhjet të mund të ngrihen vetëm deri pas 6 muajsh nga dita e zgjedhjeve, pas 6 muajsh e një ditë për ju nuk lejohen. Çfarë bëmë ne? Ne ju thamë jo vetëm deri në 6 muaj, por edhe një ditë para zgjedhjeve të tjera mund të ngrihet komision hetimor. E kuptoni që ju jeni përkeqësues të standardit ligjor të arritur tashmë?

Së dyti, ju thoni që komisioni hetimor të zgjasë pafundësisht, deri në 2 vjet, duke bërë që edhe interesi publik të bjerë. Ju kërkonit thjesht dhe vetëm shoë. Ne ju themi që në qoftë se ka një çështje për hetim lidhur me zgjedhjet, afati të jetë i tillë që në një kohë sa më të shkurtër të bëhet dritë mbi transparencën e tyre në mënyrë që edhe publiku të ndërgjegjësohet plotësisht. Bëhet fjalë për votën e publikut, është ai drejtpërdrejtë i interesuar për votën.

Së treti, ju kërkonit që gjatë hetimit provat të merren vetëm me shumicën e anëtarëve të komisionit, duke lënë kështu pjesën tjetër të mos ketë të drejtë të marrë prova. Çfarë themi ne? Ligji aktual ia garanton këtë të drejtë të marrë prova, pra mjetet e kërkimit të provës, jo vetëm shumicës, jo vetëm pakicës, por edhe një anëtar të vetëm socialist në komisionin hetimor. E kuptoni pra, që ajo çfarë ne themi është zgjerim dhe ruajtje e standardeve të

arritura me ligj?

Së katërti, ju kërkonit në ligj të numëroni dhe të rinumëroni votat, duke shndërruar komisionin hetimor në grup numëroni, ndërkohë që jo ne, por ligji aktual, pra ai që ne mbrojmë, garanton shumë më tepër se kaq, sepse jep si mjete ato të procedurës penale. Juristët tuaj e dinë fare mirë këtë. Prokuroria, që përdor këto mjete, i ka përdorur ato dhe ka funksionar sistemi. Kështu pra, oferta juaj ligjore për të ndryshuar ligjin e komisioneve hetimore e përkeqëson standardin e arritur nga ky ligj. Ju kujtoj që është një standard i cili është arritur me sforcot e kësaj maxhorance të sotme që dje ishte opozitë.

Po ju them pra se ligji aktual kënaq në optimum të gjitha kërkesat tuaja si për objektin hetimor, ashtu edhe për provat. Nuk besoj se nuk e dini këtë, por besoj se nuk doni të eksploroni, nuk doni të bëni transparencë, nuk doni të përmirësoni Kodin Zgjedhor. Qofsha i gabuar dhe mirë ardhshi në komisionin hetimor!

(Ndërkohë, drejtimin e seancës e ka marrë zonja Topalli.)

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Alibeaj!

Urdhëroni zoti Fino!

Bashkim Fino – Falemnderit, zonja drejtuese e seancës!

Natyrisht, diskutimin tim e kam dialog me Kryeministrin. Jam i bindur se ai gjithmonë, kur flas, më ndjek nga televizioni, ashtu siç jam i bindur që gjatë fjalës sime do të vijë patjetër. *(Ndërkohë, Kryeministri hyn në sallë.)*

Zoti Kryeministër,

Po ju drejtohem direkt dhe personalisht juve, si njeri që ju kam njohur mirë në çastet tuaja të rënda të dobësisë politike, njerëzore dhe morale. Ju drejtohem si njeri që herë pas here dyshon nëse ka bërë mirë që u ka dhënë një dorë për t'u ngritur nga humnera ku rrëzuar gjithë shqiptarët në mesin e viteve '90. Nuk jam penduar, zoti Berisha, për çfarë kam bërë dje, por askush nuk do t'ju japë më sot dorën nëse, njësoj si dje, ju nuk do të dëgjoni zërin e arsyes që ju thotë se jeni përpara një tjetër humnerë dhe këtë herë nuk do të merrni dot me vete Shqipërinë, edhe pse shumë dëme mund t'u keni shkaktuar përsëri shqiptarëve.

Ju, zoti Berisha, jeni burrë inteligjent dhe duhet ta pranojmë ne socialistët, duhet ta pranojmë, sepse fakti që jeni aty në karrigen e Kryeministrit edhe pas 20 vjetësh plot bëma dhe gjëma, rast që në çdo cep të globit do ta kishin dënuar, tregon inteligjencën

tuaj. Moskthimi nuk e nderon shumë politikën shqiptare, po ja që kështu është dhe kjo falë edhe gabimeve të të tjerëve, megjithatë nëse e patët një shans të dytë për t'u ulur në krye të vendit, nuk duhet të bëni për herë të dytë atë që bëtë kur ishit herën e parë në krye, duke luajtur shurdhin ndaj zërit të arsyes apo duke shurdhuar arsyen vetë! Mos e bëni këtë gjë sepse nuk keni më kohë për të larë mëkatin e radhës dhe se as shqiptarët nuk kanë arsye t'ju falin për herë të dytë. Përtej kostumit evropian që po qepim dhe po shqepim këto 20 vjet për t'u ndarë nga prerja e së shkuarës, prania juaj në Kuvend bashkë me këtë krizë absurde të shkaktuar personalisht nga ju, na dëshmon se nuk jemi larg trashëgimisë komuniste që ju keni mëshiruar gjatë 20 vjetëve, si shëmbëlltyrë e thënies së hidhur të disidentit të madh Havel "Komunisti më i keq është komunisti antikomunist".

Unë sot seriozisht dyshoj: Jeni vërtet antikomunist? Megjithatë, ju e dini mirë se në regjimet hibride si ky i sotmi, që falë jush është bërë barrë për Shqipërinë dhe shqiptarët, pushteti të sjell dashurinë e puthadorëve dhe pushtëve politikë, bashkë me adhurimin e fanatikëve të verbuar nga urrejtja që ju ushqeni përditë. Por ai të jep njëkohësisht edhe urrejtjen e të mundurve, të jep njëkohësisht edhe dëshpërimin e të vjedhurve, të jep njëkohësisht edhe neverinë e të gënjyerve nga premtimet e pambajtura.

Në këto 20 vjet, zoti Kryeministër, ju jeni treguar një politikan që natyrisht ngjallni edhe fanatizmin e madh të ndjekësve tuaj, por edhe urrejtjen e madhe kudo në Shqipëri. Kjo është më e keqja për një vend që ka 20 vjet në liri dhe nuk arrin dot të normalizohet në të jetuarin e politikës, të cilën ju e keni kthyer në një arenë lufte përçarëse në mes shqiptarëve, duke mos e lënë të bëhet kurrë një hapësirë ku ballafaqohen programet, idetë, alternativat dhe njerëzit të sillen po prapë si njerëz. Kështu ka qenë edhe dikur, sado që mund të mos na vijë mirë, edhe mua si gjirokastrit, ju të parit dhe pas jush edhe qindra mijëra shqiptarëve të tjerë, që dje donin njësoj si diellin Enver Hoxhën, të vrisnin për shokun Enver, të burgosnin për shokun Enver, të internonin, të detyronin të këndoje e të ngrije edhe dolli për të pikërisht për shkak të pushtetit absolut dhe frikës që ngjallte ai regjim.

Por dashuritë e nxitura nga frika nuk e kanë jetën e pafundme, zoti Berisha, ndaj mos shpresoni shumë në dashurinë afatgjatë dhe jua them si mik këtë. Edhe njerëzit që i keni zgjedhur vetë, lërin

së paku njëherë të flasin, qoftë edhe një herë të vetme, me fytin e tyre, ashtu siç flasin larg kamerave, ku thonë se ju jeni problemi që duhet zgjidhur për të sjellë zgjidhjen, por çdo gjë tjetër mbetet e lidhur me këtë vend.

Zoti Kryeministër, pas kaq vitesh në Kuvend e di që zakoni, tradita, e kërkon t'u drejtohem të gjithë kolegëve të tjerë këtu në sallë, por kësaj radhe nuk dua ta bëj një gjë të tillë. Po veprojmë kështu, sepse kolegët e mi socialistë dhe unë mendojmë njësoj për çështjen që po diskutojmë, ngritjen e një komisioni hetimor parlamentar. Ne, njësoj si gjithë populli opozitar, e dimë se ju jeni arsyeja pse nuk hapen kutitë. Nuk është Kushtetuta, as ligji, as maxhoranca e përbërë nga vartësit tuaj, sepse vartësit tuaj në këtë tavolinën e gjatë që kam këtu pas krahëve apo dhe të këtyre që kam ballë për ballë, nuk arrijnë dot të mendojnë sado pak ndryshe nga ju, edhe pse jashtë sallës mendojnë njësoj si ne. Nëse ju thoni se e zeza është e bardhë, edhe ata të gjithë, si kukullat ruse, me zërin e tyre, me portretin e tuaj, madje edhe me argumentet tuaja, përsëritin në kor që katrani zbardhon, siç thoshte Noli jonë.

Ne sot nuk jemi këtu për të kërkuar votën e tyre për kërkesën tonë, sepse vota e vartësve tuaj është njësoj si vota e Ruzhdijes. Ka muaj të tërë që dëgjoni, zoti Kryeministër, kërkesën e opozitës "Hap kutitë ose largohu!". Sot, unë, pa lejen e kolegëve të mi socialistë, po e riformuloj ndryshe këtë kërkesë: "Hap kutitë që të shpëtosh nga kurthi ku ke rënë!". Politikisht, këtë slogan ka muaj që ta themi në një mënyrë tjetër: nuk kontestojmë rezultatin, nuk kërkojmë të marrim pushtetin duke hetuar mekanizmin ogurzi që ju solli në pushtet me 28 qershor, kërkojmë që nesër asnjë pushtet të mos ngrihet mbi korrupsionin elektoral. Ky është thelbi që kërkojmë ne socialistët.

Zoti Kryeministër, ne, natyrisht, jemi në krizë politike dhe këtë na e thonë veç të tjerëve edhe të gjithë partnerët ndërkombëtarë. Jemi në krizë ekonomike dhe këtë e dëshmojnë xhepat e boshatisur të të gjithë qytetarëve shqiptarë, jemi në krizë të thellë mosbesimi ndaj njëri-tjetrit dhe këtë e ndiejmë të gjithë, ditë pas dite, sidomos në këto 8 muaj të gjatë paszgjedhor.

Qytetari shqiptar, që ka ndjekur debatin e gjatë politik për çështjen e hapjes së kutive të votimit, qytetari shqiptar që ka protestuar në shesh në emër të transparencës dhe të së drejtës së tij kushtetuese për të parë votën e tij, opozita shqiptare që i ka

dhënë fytyrën kësaj kërkese mbarëpopullore, madje edhe shumë nga ju vetë, pra të gjithë, kanë të drejtë të bëjnë një pyetje: Pse kjo frikë për hapjen e kutive? Pse ky tmerr nga e vërteta? Pse ky ankth për hetimin parlamentar, për atë çfarë ka ndodhur në zgjedhje, zoti Berisha? Përgjigjja është shumë e thjeshtë dhe këtë natyrisht na e jep tradita sipas së cilës vrasësi kthehet në vendin e krimit dhe ju i vratë edhe kësaj here zgjedhjet.

Sot Shqipëria po qeveriset nga një parti politike që nuk guxon të tregojë ende xhepat e saj të fryrë nga korrupsioni elektoral, institucional dhe ekonomik. Ajo më saktë po qeveriset nga një Qeveri që ka futur thellë në xhepat kutitë e votave, për të mbushur pastaj xhepat me pasuritë e shqiptarëve. Ju sot, zoti Kryeministër, mund të merrni çfarë vendimi që dëshironi, por ju, më mirë se kushdo tjetër, dhe këtë jua them unë, e dini të vërtetën e madhe se kjo ditë, pra e sotmja, është fillimi i fundit të pakthyeshmë të fatalitetit që na ka ndjekur jo radhë ne shqiptarëve.

Ne jemi të revoltuar si popull opozitar dhe jemi të vendosur të mos lejojmë të qeverisemi nga maskarallëku i veshur me pushtet dhe që përdor pushtetin për të vjedhur përsëri e përsëri qytetarët. Ne kemi shpresë se një ditë ky vend do të ndryshojë, se ky vend do të bëhet fundi i një lagjeje dinjitoze të qytetit të madh evropian me qendër në Bruksel. Ne do ta çojmë përpara këtë betejë për transparencë, mbase edhe deri në largimin tuaj, nëse ju nuk do të hapni kutitë për të bërë së bashku transparencën e këtyre zgjedhjeve. Sa më shumë kohë të vazhdosh të mbash peng votën e lirë, aq më gjatë do të vazhdosh të jesh edhe vetë peng i kurthit që ngrite, peng i vjedhjes së pushtetit. Ka një mënyrë që të shpëtosh nga ky ankth, zoti Berisha: shpëto nga vetvetja! Nëse nuk e bën dot vetë, jam i bindur se populli do ta bëjë për ty.

Falemnderit!

Jozefina Topalli - Falemnderit!

Urdhëroni, zoti Berisha!

Sali Berisha – I nderuar zoti Fino,

Ke mirëkuptimin tim më të madh për fjalën, pasi ti, nga të gjithë këta që janë të ulur në këtë sallë, kohën tëndë më të lavdishme e ke pasur me Presidentin Sali Berisha.

I nderuar zoti Fino, do t'i skanojmë pak etapat tona. '97-a ka qenë një vit i vështirë, një vit kur bandat, shtabet marksiste-leniniste u ngritën në një rebelim. Atë vit, unë që jam këtu, kisha dy vendime, por më vjen keq të them se njëri është unik në histori,

tjetri është pak më ndryshe dhe në qoftë se nuk do të kisha përjetuar 2009-n, nuk do të mund të shprehesh para jush se ky ishte unik në histori. Shpërtheu një krizë financiare për shkak të një sistemi piramidash që u krijua para se të vinim në në pushtet... (Ndërrhyrje nga deputetë të PS-së.)

Ju e dini vetë '97-n. Unë ju dëgjova me shumë vëmendje. Atë krizë financiare u mundova ta zgjidh dhe mora një vendim unik, as nuk bëra *bail out*, as nuk pranova t'u marr para taksapaguesve të ndershëm shqiptarë për t'i futur në gropat e zeza të gangsterëve të piramidave. Kam pasur gjithnjë një lloj pikëpyetjeje me vetën time nëse e kisha të drejtë apo gabim. Shqiptarëve u thashë: një borxh që s'e ka marrë kjo Qeveri, s'mund ta njohë kurrë. Borxhi është i vjetër sa njeriu, një borxh që s'është marrë, nuk mund të njihet.

Por në sunamin financiar botëror jo të paktë qenë ata që adaptuan të kundërtën e kësaj dhe kanë qenë të shumtë që e kanë cituar Qeverinë shqiptare të vitit '97' që nuk pranoi t'u marrë taksapaguesve të vet para për t'ua dhënë gangsterëve të piramidave dhe kjo është unike në botë. Kjo është në dokumentet më themelore të kësaj krize financiare. Në atë periudhë, pas këtij vendimi të ashpër, udhëheqja juaj deklaroi se do t'u kthente çdo qindarkë shqiptarëve.

Edhe si Kryeministër i Qeverisë së Pajtitimit. Tani, i dashur Baçi, meqenëse hyre në ato çështje do të them një gjë: Kur u sulmua Presidenca morën atë që merituan. Kur të sulmuan ty desh ia mbathe, s'të lashë të lëvizje vendit. Edhe këtë e di mirë. Mbrojta shtetin. Mos e zgjat më tutje, se nuk mund të pranoja unë që Kryeministri im t'u thoshte: "*dhos pedhja qe pi the Fino, qe pi the Baçi*".

Jo zotëri, një minutë, sepse po them këtë unë, nuk po hy në disa aspekte të tjera se për fjalimin ke mirëkuptim, se thashë që lavdinë e pate në kohën time. S'e kanë patur këta të tjerët. Ke nga këta që kanë ikur me rroba grash në kohën time nga Shqipëria. I ke këtu. Por ata ishin... Kurse ti e kishe në kohën time lavdinë dhe kurorën. Të vura kurorë. Të bëra dhëndër të demokracisë.

Tani, zotëri, mund të ligjërosh fjalime të shkruara nga qatipët e Xhikes apo të tjetërkujt, por këtu do të them dy gjëra. Fillove të flasësh për urrejtje dhe fanatizëm. Urrejtja dhe fanatizmi janë në genin tënd ideologjik. Përmende Enver Hoxhën. Ke genin e tij. Më vjen keq që flas në këtë mënyrë. Nuk do t'i thosha këto, por ato që i kam bërë unë genit që përmende, për ato jam krenar gjithë jetën time. Kam

një krenari të madhe shumë dhe është një nga trashëgimitë e mëdha të mia. Atë që pësoi komunizmi shqiptar nga Sali Berisha dhe ata që bashkëpunuan, ajo mbetet një nga veprimet më të goditura të Sali Berishës dhe të partisë së tij.

Në qoftë se do të qëndrosh në skemën e urrejtjes dhe fanatizmit, në një kohë kur shtrihet dora e bashkëpunimit, mua nuk më impresionon, se jam i bindur, zotëri, se Kryeministër ishte okazional dhe se i pari që do të bërtasësh “dhos pedhia qe pi the Fino” do të jesh ti. Ndaj edhe “para djem se u vjen Bashkimi mbrapa”. Është e njohur kjo.

Kështu që komisioni që ofrojmë është një komision shumë i ndershëm. Oferta jonë është një ofertë për t’u marrë për bazë. Po në qoftë se qeverisjen e bazoni mbi kërcënimin, duhet të bëni mirë llogaritë, sepse një pushtet të dalë nga vota e lirë, nuk ka asgjë që mund ta lëkundë. Në qoftë se përdorni një gjuhë të tillë, në qoftë se ish-Kryeministri i lejon vetes të kthehet në ordiner, jeni ju dhe të jesh i bindur se do të jetë i pari që do t’ia mbathë, do t’i duhet t’ia mbathë, sepse thashë edhe një herë, në sojin tuaj ka nga ata që kanë ikur me rroba grash nga Shqipëria. Ty të mbajta, nuk ike. E di vetë ti, se desh ia mbathe. Jo e di mirë ti.

Pra, në qoftë se do për urrejtje dhe fanatizëm, Shqipëria nuk mbahet nga urrejtja dhe fanatizmat. Janë klane mafioze dhe klane që i përkasin botës së vjetër që mbeten me urrejtjet dhe fanatizmat. Janë grupe të cilat i kanë duart të lyera me gjak ose të zhytura kokë e këmbë në krimin ekonomik, që sigurisht nuk durojnë dot shtetin ligjor e demokracinë.

Por të mendosh ti se mund të shesësh trillimet e tua dhe t’i shndërrosh ato në platformë, fatmirësisht ty nuk të beson më as grupi yt. Nuk të beson, në fakt. S’të beson njeri në grupin tënd, s’të marrin për serioz ty. Thashë, lavdinë kryesore e pate në kohën time dhe ajo ty nuk të përsëritet me. Ajo s’të përsëritet më. Ditën që dhashë dorëheqjen, ike, të larguan. Ditën e dorëheqjes sime je larguar nga Kryeministër.

Tani, të vijmë te problemi kryesor. Në rast se ju dëshironi të mbronni interesat demokratike, jeni të vendosur për shtetin ligjor, urdhëroni të krijohet komisionin. Në qoftë se mendoni se do ta zgjidhni me konfrontim, keni bërë zgjidhje fatale për veten tuaj, sepse në mënyrë absolute, të gjitha mjetet ligjore do të jenë në mbrojtje të rendin kushtetues dhe të shtetit ligjor. Këtë mos e harroni! Kjo tribunë nuk përdoret për kërcënime. Kjo tribunë nuk përdoret

për të kërcënuar. Ke të bësh një shumicë që ka dalë nga votat e lira dhe jo nga piramidat, siç dole ti me shokë. Ke të bësh me një pushtet që ka dalë nga zgjedhje të lira dhe nuk ka ardhur nga piramidat, siç bëtë ministra mbi ministra, gjeneralë mbi gjeneralë, gangsterët e piramidave dhe prandaj përfunduar në historinë e Europës si regjimi më i inkriminuar, prandaj përfunduar si regjimi i Aldo Bareve, prandaj përfunduar si regjimi i Nehat Kullave, i Xhikeve dhe stër-Xhikeve, prandaj përfunduar të tillë. Historia duhet t’u mësojë.

Të përdorësh ti tribunën këtu në një kohë kur ne po përpiqemi të ofrojmë për të lëshuar.... Jo, nuk është gjuha e kërcënimit, përkundrazi është një përgjigje ndaj një Kryeministri që në kulmin e krizës desh ia mbathi në panikun më të madh dhe u detyrova t’i çoj rojet e mia për ta ndalur. Po, po, në kulmin e krizës desh ia mbathi, duke treguar që s’ka detyra. E mbajta derisa i dorëzova.

Po, po, e thirra unë, po pse e lashë. Pyeteni pse e lashë helikopterin? E thirra unë, po pse e lashë? Mos u tregoni budallenj, po pushtetin jua dhashë unë. Nuk e merrnit kurrë ju pushtetin. Ku merrnin bandat pushtet, more! Po çfarë kujtuat ju! Unë bëra një zgjidhje politike. Po, çfarë ju kisha unë juve, more?! Në qoftë se vërtet ju gënjeu ‘97-ta, provojeni ‘97-ën! Dhe po ju them, zgjidhni këtu! Ne po ofrojmë zgjidhje, po në qoftë se ju gënjen mendja te ‘97-ta, dilni provojeni po të doni që nesër! Muhabete janë këto!

Ish-Kryeministri flet këtu për urrejtje. Gjëra të pakonceptueshme këto. Në 1997-ën ua dhashë pushtetin. Pikë. Dhe ua dhashë për një arsye të vetme. Se merrnit dot kurrë ju pushtetin! Ua dhashë se shqiptarët menduan se vërtet Qeveria kishte prekur paratë e tyre në skemat piramidale. Ja ku jam sot dhe pse jam sot këtu? Sepse shqiptarët e panë që Qeveria nuk kishte prekur paratë në skemat piramidale. Çfarë i kujtoni ju ata? Ata janë njerëzit më të mençur, më inteligjentë, në të gjitha përshkrimet psikologjike. Po panë që kthjelluan. Pas dhimbjes, erdhi kthjelltësia. Ata të cilët erdhën në pushtet shfrytëzuan të gjitha paratë e piramidave për t’u pasuruar. Thanë se ky tjetri s’kishte prekur një qindarkë me partinë dhe qeverinë e tij dhe votuan në vitin 2001 në maxhorancë dhe vodhën mandatet, me dokumente ndërkombëtare dhe komuniteti ndërkombëtar u detyroi juve të mos zgjidhni dot Presidentit e Republikës, u tha që nuk jeni sovran për të zgjidhur Presidentin e Republikës. Kështu janë të vërtetat. Doni t’i nxjerrim?

Me durim, me besim në vlerat demokratike qëndruam derisa arritën në zgjedhje jo krejt të ndershme të fitojmë. Kjo është e vërteta. I dhamë vendit zgjedhjet më të mira në historinë e tij. I dhamë vendit zgjedhje që i bëjnë nder përjetë. I dhamë vendit zgjedhje të lira e të ndershme. I dhamë vendit zgjedhje të cilat u certifikuan si zgjedhje pa asnjë provë për manipulim dhe numërim të parregullt.

Po çfarë kujtoni ju? Po pse besoni marrëzitë e njëri-tjetrit kujtoni se do të na bëni ne të besojmë? Po pse besoni marrëzitë e njëri-tjetrit dhe komplekset e humbjes me njëri-tjetrin, kujtoni se u besojnë shqiptarët? Cila është kjo more!? Dilni nga spirali ku jeni futur! Mos e bëni këtë! Jeni futur në një spiral shumë të gabuar. Gjuhën e kërcënimeve, gjuhën e forcës përdor ti këtu! Po ke, më fal për shprehjen, prapanicë për të folur ti more?! Ç'je ti more? Ku e ke forcën ti more?! Forcë ka ligji këtu! Harroje kohën e Gjolekës apo të Xhikes! Këtë të them unë ty, por jo kërcënime!

Ne u shtrimë dorën e bashkëpunimit. Po të kërcënosh, sigurisht... Çfarë i thashë? Ai foli për urrejtje këtu, more. Ai tha: ty të urrejnë. Po pse më urren një ihtar i Enver Hoxhës, më urrejnë shqiptarët mua? Shqiptarët më duan mua më shumë se këdo tjetër.

More zotëri, më gjeni një shqiptar që të ketë marrë në kurrizin e tij votat e tij sa unë, deri qoftë gjysmën e tyre. Çfarë flet more? Jo, mor jo, s'ka punë Skënderbeu, se nuk votohej në kohë të Skënderbeut!

Edhe thotë të urrejnë... Ku e gjete këtë more? Urren ti, po. Urren edhe ai që është me ty, po, por jo shqiptarët. Shqiptarët më duan, më vlerësojnë, më respektojnë. E kanë faktuar 20 vjet rresht. Një herë ua dhashë pushtetin vetë unë juve. Ku e merrni dot juve, more! Kush u votonte juve?! Po jua dhashë unë pushtetin juve! Sigurisht, nuk e keni kuptuar. Derisa të kuptoni këtë, kurrë nuk keni për të bërë reformë. Kuptojeni mirë! Pushtetin në '97-ën jua dhashë, se shqiptarët nuk ju kanë votuar dhe nuk ju votojnë juve në këtë mënyrë.

Jo zotëri, mos dil këtu e të flasësh për urrejtje ti. Muhabet është kjo? Dhe pas atyre thirrjeve për bashkëpunim, e mbyllim këtë çështje. Kryeministër jam unë këtu, jo ti. Dole këtu jo si kryeministër, por si të ishte nipi i Enver Hoxhës. Fole për urrejtje. Atë gjuhë nuk duhet ta përdorësh më këtu. Parlamenti është tempulli i dialogut, i debatit, i diskutimit. Urrejtjen mbaje në skutat më të errëta të ndërgjegjes tënde.

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Kryeministër!

Zoti Fino, urdhëroni, 2 minuta!

Bashkim Fino – Zoti Kryeministër, natyrisht edhe unë do të shprehja mirëkuptimin tim, pasi edhe në fjalën time ju vlerësova si politikan, por nuk ta jap këtë mirëkuptim, sepse nga fillimi në fund të gjitha ato që thatë ishin shpifje dhe trillime. Unë nuk fola as me gjuhën e urrejtjes dhe as me atë të fanatizmit. Unë fola për një kohë të vështirë që kemi kaluar bashkë dhe e keni po prapë ju në dorë ta zgjidhni këtë situatë për të bërë dialog dhe për të na krijuar mundësinë të shohim se si janë kutitë e votimit dhe çfarë do të bëjmë për zgjedhjet e ardhshme. Nuk kërkon njeri pushtet dhe ky ishte thelbi i gjithë diskutimit tim.

Në fund të fundit, ju këtu më përmendët banda dhe u futët në ca gjëra nga të cilat dilni shumë i humbur me mua në bilancin e asaj pune. Pse dilni i humbur? Ç'punë kishin bandat me mua? Unë erdha nga Jugu Kryeministër, sipas forcave politike që më zgjodhën. Unë ua mora lekët shqiptarëve, unë e rrëzoja dhe shkërmoqa shtetin? Atë e rrëzua dhe shkërmoqët ju, për 24 minuta. Bandat kishin punë me ty dhe jo me mua. Unë s'kisha ku të veja. Ti, po. Kishe mundësi dhe ishe i betonizuar, me antitanke, i mbyllur 24 orë në 24 në Presidencë, si në Big Brother dhe nuk lëvizje nga vendi, jo unë. Unë lëvizja në gjithë Shqipërinë. Ishe ti që më bllokove në fushatën e Shkodrës, sepse u tmerrove nga takimi që bëra unë në Tepelenë dhe Gjirokastrë, ku të gjithë njerëzit donin Kryeministrin e Pajtitimit Kombëtar dhe ministrat e tu. Dhe nuk ishe ti.

Mos më lejo të them edhe gjëra që s'duhet t'i them për etikën time si ish-Kryeministër, sepse unë jam në një forcë politike serioze dhe do të jem kryeministër, ministër sa të kem mundësi. Nuk do të jem asnjëherë ministër i qeverisë apo partisë tënde, sado të thuash ti. Por mua më vjen keq sepse vërtet në ato ditë të vështira të kam ndihmuar, si Presidentin e vendit tim dhe kur ti ishe në kushte të vështira. Kjo është e vërtetë. Edhe kur qaje dhe ta mbante kokën Spartak Ngjela. Por të kam ndihmuar edhe ndaj ministrave të tu, që i ke sot këtu mbrapa, nga Pollo, Imami, Ruli me shokë, dhe mirë kam bërë, zoti Kryeministër, se nuk e kam gjuhën e urrejtjes, por gjuhën e bashkëpunimit dhe pajtimit kombëtar.

(Duartrokite nga opozita)

Jozefina Topalli - Zonja Vasilika Hysi, urdhëroni!

Vasilika Hysi - E nderuar zonja Kryetare,
Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Sot është dita e parë për mua që marr fjalën në këtë foltore të nderuar. Erdhëm këtu falë vullnetit të atyre që na votuan për t'i përfaqësuar, për të qenë modeli i një politike të re dhe për të dhënë zgjidhje të reja për problemet e tyre të vjetra. Por ndihem keq, nga kjo gjuhë shpifjesh dhe trillimesh, nga ky model i keq që ne u ofrojmë të gjithë atyre që na dëgjojnë. Sot ndihem keq edhe për një arsye tjetër, se, pas 20 vjetësh liri për të ndërtuar demokracinë, diskutimin tim të parë në Parlament po e bëj për një çështje që është themeli i demokracisë. Është çka fëmija në klasën e parë fillore e mëson në lëndën "Njohuri për shoqërinë", lidhur pikërisht me transparencën e votës, me të drejtën që ka gjithkush prej nesh të vendosë për ata që do të na qeverisin dhe për votën që duhet të lexohet ashtu si hidhet në kutinë e votimit.

Për më shumë se 8 muaj opozita e bashkuar, e majtë dhe e djathtë, ka kërkuar transparencë të plotë e të pakushtëzuar para publikut për çdo gjë që lidhet me zgjedhjet e 28 qershorit. Jo për të ndryshuar rezultatin, po për të ndryshuar rrjedhën e një historie 20-vjeçare zgjedhjesh, të deformuara e të kontestuara. Jo për të marrë pushtetin përmes hetimit parlamentar, por për të mos lejuar më kurrë që pushteti të merret përmes korrupsionit elektoral.

Kushtëzuar marrëdhënien tonë me Parlamentin, sepse menduam dhe mendojmë se pa hetuar zgjedhjet nga ka dalë, ky Parlament nuk ka legjitimitet për të nxjerrë ligje për qytetarët e grabitur në të drejtën themelore për të vendosur për Parlamentin e tyre. Pasi çështja jonë parimore u ndërkombehtarizua dhe pasi prova e rëndë e Ruzhdies doli në dritë duke tronditur të madh e të vogël, erdhëm t'i japim këtij Parlamenti një shans për të fituar moralin e humbur në zgjedhjet e shkuara.

Si qytetare, por edhe pedagoge e Së Drejtës prej më shumë se çerek shekulli, u ndjeva keq në debatet e Komisionit të Ligjeve, ku nisma e PS-së dhe argumentet tona tërësisht juridike e profesionale, jo vetëm që ranë në vesh të shurdhër, por u komentuan nga kolegët tanë të palës tjetër jo juridikisht, jo profesionalisht, por duke injoruar edhe praktikën që ka Shqipëria në lidhje me hetimin e zgjedhjeve parlamentare. Aty dëgjuam nga juristë se kjo nismë paska të bëjë me probleme të brendshme politike të opozitës, me prirjen e saj që të mos respektojë Kushtetutën, pavarësinë e gjykatave dhe, akoma me keq, me qëllimin që ne

paskemi kundër integritit të Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Për hir të vërtetës, është e kundërta, krejt e kundërta. Ne e duam këtë transparencë, pikërisht sepse respektojmë Kushtetutën, ligjet e vendit, liritë e të drejtat e qytetareve dhe mishërojmë, jo vetëm si individë, por edhe si forcë politike, aspiratën e integritit të familjes shqiptare në Bashkimin Europian.

Ndërkohë, natyrshëm lind pyetja: Në cilën periudhë postkomuniste Gjykata Kushtetuese ka deklaruar brenda një harku kohor 4-vjeçar plot 20 nisma ligjore si antikushtetuese? Në cilën periudhë postkomuniste Gjykata Kushtetuese ka deklaruar në katër raste, objektin e komisionit hetimor parlamentar si antikushtetues? Kush është forca që ka ngritur komisionet hetimi, objekti i të cilave është deklaruar antikushtetues? Pikërisht në katërvjeçarin e kësaj maxhorance, që edhe sot vazhdon të shkelë Kushtetutën, duke penguar transparencën e zgjedhjeve dhe hapjen e kutive të kimit elektoral të 28 qershorit.

Në diskutimin për hetimin e zgjedhjeve, në komision, po edhe këtu në sallë, vazhdoj të ndihem keq, duke dëgjuar se, për hir të faktit që deputeti nuk mban përgjegjësi për ato që thotë gjatë punës së tij dhe në lidhje me detyrën, përfaqësuesit e maxhorancës vazhdojnë të thonë gjëra pa asnjë sens juridik e profesional në raport me ligjin, për të cilat në çdo shkollë, sado modeste të së drejtës, do të mbeteshin në klasë. Këtë qëndrim nuk mund ta motivojë ndërgjegjja profesionale, por vetëm frika. Frika nga e vërteta e atyre kutive, ku janë rrënjët e degradimit të paparë të qeverisjes në gjithë këta muaj.

E vetëdijshme për atë që fshihet në kutitë e Ruzhdies, të 28 qershorit, maxhoranca mohon forcërisht të drejtën kushtetuese të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve nga organet e pushtetit publik. Kuvendit i hiqet mundësia të evidentojë shkaqet e shkeljes së ligjeve dhe i mohohet e drejta që të marrë masa për parandalimin e fenomeneve që kanë ekzistuar këto 20 vjetët e fundit lidhur me zgjedhjet, duke mos lejuar që hetimi parlamentar të bëjë transparencë të plotë e të pakushtëzuar.

Duke injoruar rolin real të komisionit hetimor parlamentar në hetimin e zgjedhjeve të 28 qershorit dhe zgjedhjeve të mëpasshme, mohohet e drejta e kontrollit parlamentar të përfaqësuesve të popullit për mënyrën sesi zbatohen ligjet e votuara në këtë sallë, që është përmbushje e detyrimit themelor

demokratik të transparencës me publikun. Pa këtë kontroll, pushteti ekzekutiv shkon drejt absolutizimit dhe arbitraritetit që shkatërron të gjithë ekuilibrat kushtetues të vendit. Një pushtet i tillë është kosto e rritur për qytetarët në çdo hap, në çdo faturë, në çdo shërbim, krahas koston që i japim mes stresit të këtyre debateve politike.

Shpesh, në debate, maxhoranca abuzon me faktet që janë konstatuar dhe që citohen në raportin e OSBE-ODIHR-it. Madje, shkon edhe më tej, duke thënë se tashmë problemet dihen. Hajdeni, të ulemi dhe të diskutojmë. Nuk ka nevojë për komision hetimor, sepse ato janë thënë në raportin e OSBE-ODIHR-it.

Në fakt, me qëllim ngatërrohet roli i OSBE-ODIHR-it dhe komisionit hetimor parlamentar. OSBE-ODIHR-i është vëzhgues e fotografues i asaj që ka parë dhe bën rekomandime, ndërsa komisioni hetimor parlamentar ka funksione kontrolluese të zbatimit të ligjit dhe rekomandon për zgjidhjen e problemeve dhe, nëse dalin prova që përmbajnë elementë të veprës penale, ato referohen në prokurori.

Shumë fakte që përmenden në raportin e OSBE-ODIHR-it tregojnë "dyshime të arsyeshme" për manipulime të shumta. Sigurisht, provat e manipulimit nuk mund t'i çojë në prokurori OSBE-ODIHR-i. Ato janë në kutitë e votimit dhe janë pjesë e objektit të hetimit parlamentar.

Kolegët e palës tjetër nuk iu përgjigjën dot pyetjes sesi mund të bëhet verifikimi i vërejtjeve, të cituara në raportin e OSBE-ODIHR-it apo i të dhënave dhe dyshimeve të arsyeshme që disponon PS-ja, pa këqyruar dokumentet zgjedhore dhe fletët e votimit. Si mundet, për shembull, që në disa qindra qendra votimi, që në mënyrë të paligjshme Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i vendosi në shtëpitë private të militantëve të pushtetit, të mund të verifikohet shkalla e zbatimit ose moszbatimit të ligjit, përveçse përmes shqyrtimit të dokumenteve zgjedhore që janë në kuti?

Të hetosh nuk do të thotë vetëm të marrësh në pyetje persona, por të këqyrësh dokumente. Dokumentet themelore për hetimin dhe transparencën e 28 qershorit janë të kyçura në kutitë e materialeve zgjedhore dhe ato të fletëve të votimit. Ndonëse, në mënyrë të përsëritur, kërkohet të dihet se cili nen i Kushtetutës ose ligj cenohet kur kërkohet këqyrja e dokumenteve zgjedhore, pala që pengon hetimin nuk citon asnjë nen konkret, por përsërit si një shirit i vënë në lëvizje mekanikisht se kjo kërkesë bie ndesh me Kushtetutën.

Meqenëse ju nuk citoni ndonjë nen që ndalon këqyrjen e dokumenteve zgjedhore, pasi në të vërtetë ai nuk ekziston, unë po ju sjell në vëmendjen tuaj nenin që lejon dhe detyron institucionet të jenë transparente. Informimi është e drejtë e njohur nga neni 23 i Kushtetutës dhe ligji për të drejtën e informimit. Kutitë me materialet zgjedhore dhe fletët e votimit janë në administrim të KQZ-së. Çdo shtetas ka të drejtë të informohet për to, si dokumente zyrtare. Dokumentet zgjedhore nuk janë monopol i asnjë individi ose institucioni, me përjashtim kur ato përbëjnë sekret shtetëror.

Ju lutem, më thoni: A përbëjnë listat e votuesve dhe fletët e votimit sekret shtetëror, që duhet t'i fshihen publikut? Pse votuesit shqiptar i mohohet e drejta për të parë sesi është administruar vota e tij? Pyetje të tilla deri më sot nuk kanë marrë përgjigje dhe, mesa duket, nuk do të marrin dot përgjigje të arsyeshme, juridikisht të vlefshme. Sepse marrja peng e kutive nuk bëhet nga respekti për ligjin, por nga frika prej së vërtetës. Frika e pushtetit dhe jo ligjet e shtetit e pengojnë këtë hetim.

Shpesh, në debatet publike kemi dëgjuar se këqyrja e materialeve zgjedhore dhe fletëve të votimit ndalohet nga vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Në fakt, është e kundërta. Gjykata Kushtetuese thekson se "Kontrolli parlamentar ushtrohet edhe në kontekstin e së drejtës kushtetuese të çdo shtetasi, për të marrë informacion të nevojshëm në lidhje me një çështje me interes publik" dhe se ky kontroll është edhe një detyrim kushtetues.

Po ashtu, askush deri më sot nuk ka nxjerrë numrin e nenit të Kushtetutës, paragrafin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, ku thuhet se KQZ-ja, nuk mund t'i nënshtrohet mbikëqyrjes nga komisioni hetimor parlamentar dhe transparencës së publikut. Arsyeja është shumë e thjeshtë: nuk ka asnjë ndalesë të tillë. KQZ-ja është institucion administrativ, i emëruar nga Kuvendi dhe që kontrollohet prej tij. Komisionet zgjedhore dhe grupet e numërimit, ndonëse veprojnë në mënyrë të përkohshme, drejtohen dhe kontrollohen nga ana e KQZ-së. Prandaj e gjithë veprimtaria administrative dhe rezultatet e punës së tyre janë tërësisht të kontrollueshme.

Aq më pak, mund të pengohet e drejta për informim me argumentet se procesverbalet janë firmosur nga të gjithë komisionerët, përfshirë edhe ata socialistë. Ç'është ky diversion i ulët? Ne nuk po kërkojmë hetim për gjueti shtrigash ndaj

komisionerëve demokratë, por për nxjerrjen e përgjegjësive të përsëritura. Këta pengojnë hetimin, nuk thonë dot se cili nen i Kodit Zgjedhor ndalon KQZ-në dhe Kolegjin Zgjedhor të gjykojë rastet kur janë firmosur nga të gjithë.

Shpesh thuhet se kutitë nuk mund të hapen, sepse vendimet e formës së prerë së gjykatës nuk mund të prishen. Komisioni hetimor parlamentar nuk ka për qëllim të ndryshojë vendimet e gjykatës dhe hetimi ynë nuk ka asnjë lidhje me to. Nga ana tjetër nuk ka asnjë pengesë ligjore që gjithkush nga ne të marrë fotokopjet e vendimeve të materialeve etj.

Në fund dua ta mbyll aty ku e nisa. Ndihej keq si çdo shqiptar që pas 20 vjetësh në Shqipëri nuk ka zgjedhje të lira e të ndershme. Por ndihem më keq akoma si deputete që ky Parlament po pengon me forcë europianizimin e zgjedhjeve, duke i detyruar shqiptarët të ringrihen për lirinë e votës dhe të drejtën që të qeverisen nga ata që i zgjedhin me votë dhe jo nga ata që vendosin zgjedhje në kurriz të tyre, duke mos i lejuar që ata të votojnë lirisht.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zonja Hysi!
Zoti Halimi, urdhëroni!

Eduard Halimi – E nderuar zonja Kryetare,

I uroj kolegjes Hysi që të jetë hera e parë dhe e fundit që dëgjojmë prej saj leksione jo shumë profesionale. Por, gjithsesi, në opozitë është.

Sot ne po diskutojmë dy çështje, dy kërkesa të opozitës që në të vërtetë janë një kërkesë për të bojkotuar Kushtetutën e vendit. Jemi munduar gjatë këtyre javëve të diskutojmë profesionalisht, dhe më vjen mirë që kolegja e riktheu diskutimin profesional mbi kërkesën; të diskutojmë sipas procedurave që ligji dhe Kushtetuta ka parashikuar në të gjitha rastet kur diskutohet një nismë kushtetuese, kur diskutohet një nismë ligjore. “Nuk na duhen procedurat, sepse ne dimë ta lexojmë Kushtetutën. Na duhet konsensusi për të shkelur Kushtetutën”, - tha kryetari i Partisë Socialiste gjatë negociatave. “Nuk na duhen procedurat”, - tha kryetari i grupit të Partisë Socialiste para dy javësh, “Na duhet premtimi që duhet të na japë maxhoranca për të bojkotuar Kushtetutën”. “Nuk na duhen procedurat dhe ligji”, - tha përfaqësuesi i Partisë Socialiste në komisionin e Ligjit para dy ditësh teksa kërkonte të fillonte diskutimin nga neni 4 jo nga neni 1, që e kishte propozuar vetë. -Na duhet bojkoti i ligjit, na duhet bojkoti i Kushtetutës”.

Sot vijmë përsëri para shqiptarëve në Kuvend për të diskutuar të njëjtën çështje, të ndërpresim

bojkotin e opozitës dhe të pranojmë kërkesën e tyre, kërkesën për të bojkotuar ne këtë radhë, jo Parlamentin, por themelin e një republike parlamentare, Kushtetutën e saj. Por ne dhe shqiptarët duhet të tregohemi të qartë, të thjeshtë e të ndershëm. Ata janë të lodhur me diskutimet juridike të tejzgjatura, ata duan që ne të jemi të ndershëm, në mënyrë që të dinë të bëjnë vlerësimin e tyre, që të binden se kanë bërë zgjedhjen e duhur në vitin 2009.

Të nderuar kolegë,

Sot maxhoranca, e cila ka marrë përsipër të qeverisë këtë vend, sot Kryeministri dhe Qeveria e tij, e cila është betuar mbi Kushtetutë teksa merrnin dekretet e Presidentit, është vënë para një kushti të panegociueshëm; të rifillojë edhe një herë të gjitha proceset gjyqësore për rihapjen dhe rinumërimin e kutive, por jo nëpërmjet sistemit gjyqësor, por nëpërmjet deputetëve të Parlamentit. Të bëjë hetimin e çdo akuze që opozita ka ngritur në këtë vend kundër procesit zgjedhor, por jo nëpërmjet prokurorisë që ka caktuar Kushtetuta, por nëpërmjet Kuvendit, se ky është organ suprem.

Ky është kushti i panegociueshëm, i padiskutueshëm pa qenë nevoja e procedurave. Çështja që duhet të dinë sot shqiptarët është e thjeshtë. A do të pranojë maxhoranca të kthejë Parlamentin në një organ që heton, gjykon, riheton dhe rigjykon vetë pa pyetur për ndarje dhe balancim pushtetesh? A do të pranojë kjo maxhorancë, të cilës iu besua qeverisja e këtij vendi që, për hir të presionit të opozitës dhe kërkesave të saj, të shkelë mbi ligjet e vendit, të shkelë mbi parimin qindravjeçar të republikave parlamentare, atë të ndarjes së pushteteve dhe respektimit të gjykatave, apo do të pranojë të bojkotojë Kushtetutën e këtij vendi? Kjo është çështja dhe është shumë e thjeshtë për t'u kuptuar dhe për t'i dhënë përgjigje pa qenë nevoja e ndonjë sondazhi publik.

Ndalemi më poshtë dhe dua të jap opinionin tim po kaq të qartë dhe të thjeshtë. Ne jemi absolutisht pro zgjidhjes së krizës politike, por jemi po ashtu absolutisht të vendosur të mos pranojmë injorimin që do t'i bëhet Kushtetutës së vendit, themelit të demokracisë në një Republikë parlamentare. Ky është leksioni që bëhet ditën e parë në fakultetin juridik, nuk bëhet në klasën e parë. Këtë nuk e themi vetëm ne, por e thonë hapur dhe qartë të gjithë miqtë e Shqipërisë, përfshi këtu edhe deklaratën e Këshillit të Europës për situatën politike në Shqipëri, të cilët theksojnë se hetimi parlamentar duhet të bëhet në

përputhje me Kushtetutën e vendit dhe me vendimet e Gjykatës Kushtetuese.

Gjatë gjithë kësaj kohe të dyja palët teksa diskutonim në parim kemi thënë se do të respektojmë Kushtetutën; kemi thënë se ajo do të jetë alfa dhe omega e këtij procesi. Dhe kemi bërë mirë, sepse para se të ulëshim këtu, demokratë e socialistë, jemi betuar mbi Kushtetutën e këtij vendi. Kemi thënë se ne respektojmë vendimet e Gjykatës Kushtetuese, dhe përsëri kemi bërë mirë, sepse edhe nëse thoshim të kundërtën, nuk do të na lejonte neni 124 i Kushtetutës, sipas të cilës Gjykata Kushtetuese është garant i Kushtetutës. Ky është neni që duhet të mbani shënim, kolegë të nderuar socialistë.

Nuk do të na lejonte as neni 132 i Kushtetutës, i cili saktëson se vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për të gjithë, të nderuar kolegë profesionalë dhe politikë.

Gjykata Kushtetuese i ka tërhequr vëmendjen Kuvendit për parimet që duhen respektuar gjatë fazave të realizimit të qëllimit të hetimit në çastin e formulimit të objektit, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së komisionit dhe në hartimin e konkluzioneve përfundimtare. Këtë gjë nuk e them unë, por e thotë faqja 8 e vendimit nr. 20 të Gjykatës Kushtetuese të vitit 2007, Vetëkufizimi i Parlamentit për hetimin e çështjeve apo kompleksit të çështjeve, i fakteve apo i kompleksit të fakteve që kanë qenë objekt i shqyrtimit gjyqësor apo hetimor, është një detyrim, i cili duhet vendosur domosdoshmërisht në ligjin që ne kemi përpara. Këtë bëmë ne në nenin 1 të projektligjit, as një shkronjë më shumë se ajo që Gjykata Kushtetuese ka urdhëruar.

Unë prita dhe do të pres sërish kolegët e mi socialistë të thonë përpara nesh dhe të gjithë shqiptarëve nëse e duan apo jo këtë nen, e duan apo jo ta pranojnë Kushtetutën e këtij vendi si ligj suprem, duan apo jo të respektojnë nenin 7 të Kushtetutës, parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve. Ky është neni i Kushtetutës që duhet ta respektojnë të gjithë ata profesorë ose jo që kanë diplomën e juridikut.

Unë besoj se kjo është një çështje themelore e këtij projektligji. Kjo është çështje ku ne nuk mund të cedojmë, është çështja e respektimit të Kushtetutës, alfa e këtij procesi. Të na shpjegojnë kolegët e nderuar, se cili është motivi që ne këtë radhë duhet ta shkelim Kushtetutën. Jo, zotërinj kolegë! Kjo që ju po kërkon është antikushtetuese. Ju nuk mund të hetoni mbi gjithçka dhe në gjithçka,

ju nuk mund të merrni çdo provë që dëshironi, madje edhe ato që ka shqyrtuar një herë gjykata.

Ju nuk mund të na kërkon që t'ju lejojmë të rihapni kutitë, të bëni rivlerësimin e rinumërimin e fletëve të votimit kur këtë kërkesë jua ka rrëzuar gjykata me vendim të formës së prerë. Ju thatë këtu pak më parë se nuk ka vendim gjykate për moshapjen e kutive. Thatë se nuk ka vendim gjykate që ka vendosur mosrinumërimin e fletëve të votimit. Nuk ka vendim gjykate që ka vendosur mosrihapjen e kutive.

Ky është vendimi i Gjykatës, i cili ka vendosur mosrihapjen e kutive. Ka vendosur mosrinumërimin e fletëve të votimit, ka vendosur mosrivlerësimin e fletëve të votimit dhe është vendimi nr. 8, i datës 22.07.2009 i Kolegjit Zgjedhor, i cili ka thënë se paditësi Partia Socialiste e Shqipërisë ka pretenduar rinumërimin dhe rivlerësimin e votave të të gjitha qendrave të votimit dhe KZAZ-të me radhë. Çfarë ka vendosur në fund vendimi? Rrëzimin e plotë të kërkesës së Partisë Socialiste. Ky është vendimi që ju ndalon, të nderuar kolegë socialistë. Jo zotërinj, ne nuk jemi shkalla e ankimit dhe e pakënaqësisë që kenë me vendimin e gjykatave. Ne jemi Parlamenti i Shqipërisë, ne respektojmë Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Zotërinj, ka kufij për mjetet që doni të përdorni duke kërkuar të shndërroheni në gjykatës të këtij vendi. Ka kufij kushtetues, zotërinj!

Gjykata Kushtetuese, vendimet e së cilës janë imperative, ka theksuar në vendimin e saj nr. 26 të vitit 2006, citoj, faqja 7: "Kuvendi ose komisionet hetimore nuk kanë tagrin e rishikimit të vendimeve të marra nga gjykata apo prokuroria dhe se mjetet e kontrollit parlamentar nuk mund të përdoren si instrument për të shqyrtuar dhe vlerësuar vendimet e marra nga juridiksioni gjyqësor".

Ja pra, zotërinj që ka kufizim të mjeteve dhe instrumenteve të hetimit dhe këtë nuk ua them unë, por garanti i kushtetutës, Gjykata Kushtetuese e këtij vendi. Parlamenti nuk mund të marrë një dosje të gjykatës dhe të prokurorisë të hetojë provat që ato kanë shqyrtuar dhe pastaj të vlerësojë vendimin e tyre, se ndryshe do të kthehej në vetëgjyqësi dhe do të merrte çdo vendim të formës së prerë dhe do të jepte një vendim tjetër, tashmë në emër të komisionit hetimor parlamentar.

Ju thoni këtu dhe gjatë Komisionit të Ligjeve se duam t'i këqyrim dosjet e gjykatës, duam të shikojmë fletët, nuk duam të hetojmë. Por ne po diskutojmë sot ligjin për komisionin hetimor parlamentar, po

diskutojmë kërkesë për hetimin parlamentar. Nuk jemi këtu për të diskutuar as ligjin për informimin publik, nuk po diskutojmë sot as ligjin për OJF-të dhe për të drejtën që OJF-të kanë për t'u informuar mbi materialet. Jemi duke diskutuar ligjin për komisionin hetimor parlamentar. Provat që kërkohen të merren nga vendimet e gjykatave, merren për të hetuar dhe kjo, siç ju thashë më sipër, ndalohet automatikisht nga Kushtetuta e këtij vendi.

Unë nuk besoj se kjo rrugë do të ishte e njëjtë me atë që kërkon Kushtetuta dhe garanti i saj. Çfarë doni ju sot? Kërkoni që me ligj të hapni derën e ankimit të ri dhe të merrni kompetencat që kjo Kushtetutë i ka dhënë sistemit gjyqësor. Ju keni kërkuar hetimin e shtatë pikave të çështjes për ngritjen e komisionit hetimor, dhe për pjesën më të madhe të tyre jemi dakord t'i diskutojmë për t'ju dhënë mundësinë që t'i hetoni, të ngrini komision hetimor, të hetoni Qeverinë ku të doni dhe si të doni me të gjitha format që keni, por jo të hetoni vendimet e gjykatave.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Halimi!

(I drejtohet deputetit Braçe, i cili flet nga vendi.)

Jam unë këtu Kryetare e Parlamentit, nuk jeni ju. Unë kam një Rregullore. Replikë kundër replikës nuk ka. Bëra një përjashtim. Harrojeni! Nuk bëj më përjashtim.

Zoti Braçe, urdhëroni, nëse dëshironi të flisni!

Erion Braçe – Zonja Kryetare,

Kam përshtypjen se gjërat po ngatërrohen edhe nën kujdesin tuaj. Dua të them që në krye të fjalës ne nuk kemi ardhur këtu as për t'ju fyer, as për t'ju kërcënuar. Ne kemi ardhur këtu për të mos pranuar të na fyeri dhe të na kërcënoni. Ne kemi ardhur këtu në Parlament për të kërkuar zgjidhje ligjore dhe kushtetuese, duke konsumuar deri në fund, pa u lëkundur në asnjë rast, të gjitha instrumentet politike në dorë të një force politike që njeh, respekton sistemin dhe vepron brenda sistemit kushtetues të këtij vendi.

Natyrisht, unë kam respekt për fjalën, por nga ajo që po ndodh këtu, po e përsëris nën kujdesin tuaj, po shoh që fjala pavarësisht se është në Parlament, nuk ka vlerë. Më keq akoma po e merrni fjalën tonë dhe veçanërisht Kryeministri, po e përkthen, po e përpunon dhe po e bën plumb për të na kërcënuar pikërisht ne. Përpara se ju të artikulonit që jeni të gatshëm për kompromis, do të doja t'i drejtohesha zotit Kryeministër, natyrisht jo për ta kërcënuar, se po shoh që është vetëm e tij. Nuk

kemi ardhur të bëjmë pazar. Është vetëm e tij dhe e askujt tjetër në këtë sallë. Referuar grupit të maxhorancës çdo gjë po buron nga ai, prandaj dua t'i drejtohem zotit Kryeministër:

Zoti Kryeministër, përdorët shpesh në hyrje të kësaj seance fjalën "ofertë". Natyrisht, që më herët përdorët, duke huazuar nga anglishtja, fjalën "deal" për të materializuar një proces që karakterizohet nga fjala e bukur turke "pazar". Unë besoj që Kryeministri i vendit e di fort mirë se termi ofertë është term pazari. Natyrisht që zotit Kryeministër i ka leverdisur çdo herë në muajin mars, sa herë kur ka qenë keq apo shumë keq, por sot nuk është ditë pazari.

Zoti Kryeministër, ne nuk kemi ardhur të bëjmë pazar. Ne kemi ardhur të bëjmë ligj në respekt të Kushtetutës dhe themeleve ligjore të këtij vendi. Pra, nuk ka pazar dhe nuk do të ketë pazar. Ne kemi ardhur për të vendosur një standard ndërkombëtar, atë të kutive të hapura në zgjedhje, e drejtë tashmë e vendosur në Kosovë, dy vjet shtet, e drejtë e vendosur dhe e përdorur nga miku i Kryeministrit, zoti Berlusconi në Itali, i cili, pavarësisht se Kryeministri ynë ishte gati t'i shiste edhe gjysmën e vendit, nuk e artikuloi asnjëherë në italisht dëshirën e Kryeministrit për të folur, për t'i mohuar opozitës shqiptare hapjen e kutive, e drejtë e vendosur në Afganistan, ku ne kontribuojmë për të vendosur paqe, liri dhe zgjedhje të lira e të ndershme.

Ne nuk e duam këtë standard për t'i marrë pushtetin zotit Kryeministër. Ne e duam këtë standard për t'u dhënë kuptim zgjedhjeve në Shqipëri, të cilat, më lejoni t'ju them, që qershorin e vitit që shkoi e kanë humbur vlerën e tyre, pra zgjedhjet në këtë vend nuk vlejnë. Është bindje mbarëshqiptare, pra edhe në PD, se Sali Berisha është burrë i zoti, sepse i vjedh zgjedhjet. Pra, dua të them që hetimi i vjedhjes nuk e shpërbën shtetit, por legjitimon shtetin.

Zoti Kryeministër, ti nuk ke më frikë nga populli dhe ky është lajm i keq. Po u merr njerëzve lirinë për të zgjedhur me votë të lirë mënyrën e qeverisjes, por edhe njerëzit që ata duan t'i qeverisin. Pra, zoti Kryeministër, ti po u merr njerëzve lirinë.

Dua t'u drejtohem shqiptarëve, atyre që e ndiejnë të largët pikërisht këtë gjë, për t'u thënë se kur marrin *overdraft* (e përdora në anglisht meqenëse Kryeministri e ka qejf), pra *overdraft* që karakterizon një proces që njihet nga fjala e bukur turke "para me fajde", për të paguar faturën e dritave, natyrisht që duhet të kuptojnë që janë në këtë dërxhe thjesht

dhe vetëm sepse ju kanë mohuar lirinë e tyre për të zgjedhur. Kur marrin para me fajde për paguar faturën e ujit, duhet të kuptojnë se gjithçka buron nga liria të cilën Kryeministri jua ka marrë për të zgjedhur, kur marrin para për të paguar faturën e re dhe të shtrenjtë, kësaj radhë shtetërore të shërbimit shëndetësor, duhet të kuptojnë se janë në atë gjendje se për shkak të lirisë që u ka marrë Sali Berisha për të vjedhur. Kur marrin para për të paguar arsimin publik apo privat, edhe më të shtrenjtë, duhet të dinë se janë në këtë gjendje për shkak të lirisë që u ka marrë Sali Berisha për të zgjedhur; kur marrin para për të paguar ushqimet e shtrenjta e që shtrenjtohen, jo me 4%, 4,4% apo 7,8% po që shtrenjtohen me 30 dhe 40%, duhet të kuptojnë se janë aty për shkak të lirisë që u ka marrë Sali Berisha për të zgjedhur. Kur nuk gjejnë dot punë as atje te Partizani i Panjohur apo i njohur, duhet të kuptojnë se janë në atë gjendje për shkak të lirisë që Sali Berisha u ka marrë për të zgjedhur.

Zoti Kryeministër, lirinë shqiptarëve ua ka dhënë Zoti, jo ti. Ti mund t'i vjedhësh, t'i rrahësh apo t'i vrasësh, siç edhe ka ndodhur në këto kohë, jo se të takon, por sepse e ke vendosur me dhunë pikërisht këtë standard, të marrjes së lirisë së tyre për të zgjedhur të lirisë dhe qeverisësit. Kjo është zgjidhja që ti i ke dhënë kundërshtimit masiv të njerëzve, ti e ndalon atë të kthehet në votë, sepse ti e vjedh votën.

Natyrisht që edhe kjo ka një fund. Pardje, në mënyrë të përsëritur njerëzit dolën në rrugë në drejtim të Vlorës, sot në një tjetër rrugë dolën të tjerë njerëz, nesër do të dalin në rrugë të tjerë njerëz, jo se u thotë opozita, por sepse laku i Qeverisë që i ka marrë lirinë po u merr shpirtin. Herën e fundit kur Kryeministri e bëri këtë, gjeti shpëtim në një pazar, prandaj sot nuk do të ketë më pazar që e shpëton Kryeministrin e vendit. Ka betejë për liri, jo betejë për pushtet. Pushteti legjitimohet edhe me pazar, kurse liria jo, asnjëherë. Prandaj do të doja edhe një herë që t'i bëja thirrje arsyes së Kryeministrit se zgjidhja gjendet vetëm tek ai. Ai po e vonon dhe ai po e mban peng.

Nesër në Tiranë do të jenë përfaqësuesit e BE-së për të vendosur të na pranojnë në familjen e tyre apo jo. Kjo është përgjegjësi direkte e Kryeministrit të vendit. Ne po konsumojmë sot të gjitha rrugët politike që na nje sistemi demokratik në këtë vend. Përtej këtij konsumi nuk ka më asgjë, prandaj përgjegjësia është thellësisht thjesht dhe vetëm e kryeministrit të vendit. Të largohet nga kjo rrugë që

ka nisur, që thjesht dhe vetëm ju kufizon liritë qytetarëve shqiptarë, duka ua bërë jetën më të keqe, duke ua bërë jetën më të vështirë, duke ua hequr të drejtën për të zgjedhur dhe, natyrisht, duke u dhënë të drejtë për ta larguar në cilëndo mënyrë demokratike që parashikon Kushtetuta e vendit.

Falemnderit!

Jozefina Topalli - Falemnderit!

Urdhëroni, zoti Maliqi!

Lefter Maliqi - E nderuar zonja Kryetare,

Siç e shikoni edhe nga lartësia, mandati i tretë i PD-së në qarkun e Beratit qëndron lart. Kështu që, pavarësisht se i katërti i qarkut të Beratit, ai i PS-së, i cili sapo vjen dhe po dobësohet pa pikë turpi, i thotë Kryeministrit ik, ndërkohë që qytetarët e Beratit kanë vite që i thonë atij ik, largohu nga Berati. Foli një fjalë në anglisht *deal*. Jo se e di mirë, por *deal* do të thotë marrëveshje, jo Pazar. Kurse unë po i them a e di ti se ç'do të thotë *pick-poketing*? Thuhet e provove edhe këtë stil në datën 30 qershor kur luajte rolin e komisionerit të PS-së, duke u futur nga prapa Pallatit të Kulturës se kujton se syri i qytetarëve të Beratit nuk të shikonte me tufë letrash duke i bërë presion Krenar Sulkos, socialistit më të ndershëm dhe anëtarëve të tjerë të komisionit që të ngrinin zërin dhe që të bënin pislleqe në një kuti të fundit që ishte kutia e Uznovës, që ajo kuti edhe po ta hapej, përsëri PD-ja mandatin e tretë e kishte të fituar. Si mendoni ju, Qarku i Beratit, bastioni më i majtë në Shqipëri, i vetmi qark i majtë ku PD-ja ka vetëm komunën më të vogël (Berat - Kuçovë, 14 njësi vendore i ka PS-ja), të lënë ata kryetarë bashkie, nënkryetarë, drejtues PS-je të marrësh vota? Jo dhe jo.

Po ky i vogli çfarë bëri? Iku nga Berati, vajti në Kuçovë. Do që të hapen kutitë, sepse ia ka futur Erioni tjetër, 99-shi mund t'i ketë marrë ndonjë votë. Si mendoni ju se kur flitet për Beratin, nuk ua mbush syrin unë? Kam marrë 2000 mijë vota në komunën e Otlakut nga 500 që merre në vite PD-ja dhe të tjerët. Është faji i këtyre të së majtës. Kundër të dhathtës kam luftuar edhe në 2005, edhe në 2007 dhe është faji i tij që sot PS-ja është në minorancë.

Por unë do t'i jap fund Beratit se ai dihet tashëm që pret ndryshime dhe i vogli kishte shpresuar në pazaret për t'u bërë edhe ministër transporti. Imagjinoni, krahasojeni me Oldashin. Pra, një gjë qesharake për të gjithë shqiptarët. Socialistët një urë në komunën Lumalas, ku fshatra të tërë rrinë në dimër pa kaluar lumin, nuk e bëri për 8 vjet. Për një vit apo dy do të bëhet ajo urë nga kjo Qeveri e

kështu me radhë.

Dua të ndalem edhe në disa shprehje dhe fraza që u përdorën këtu. Zonja kryetare e Kuvendit, edhe në seancat e tjera ku PS-ja ka marrë fjalën këtu, që nga zoti Ruçi, Dade dhe të tjerë, unë kam kërkuar fjalën. Pavarësisht nga batutat dua të ndalem në disa fenomene.

Morali politik, tha zonja Dade. Ta shikojnë moralin politik dhe moralet e tjera te Ruzhdiu i tyre që e kanë në krye të PS-së. Qëndrimi në këmbë, thotë i Qeverisë "Berisha". Të jesh e sigurt zonja Dade që Qeveria Berisha do të jetë të paktën deri në 2017-n, sepse me atë që keni në krye të PS-së, që është jashtë Parlamentit dhe më këtë që keni në krye të Grupit Parlamentar i keni dhënë oksigjen kësaj Qeverie edhe për 8 vjet qeverisje. Këtë e dinë edhe njerëzit tuaj të opozitës.

Unë dëgjoja zotin Kryeministër që tha më duket se në '96-ën disa apo ndonjë mund të ketë ikur me rroba grash. Po them se edhe në 2013-n, kur të humbni, mos e përsërisni këtë gjë, por largoni Ruzhdiun nga kreu i PS-së, që ju ka marrë peng dhe hajde të punojmë së bashku.

Tjetër, për kutitë e Ruzhdijes. Qesharake batutat. Do t'ju bëj edhe unë një ofertë. Kam folur me disa deputetë tuaj dhe thonë që jemi dakord me këtë ofertë. Kam folur me deputetë të PD-së dhe ata janë dakord, vetëm s'i kanë marrë mendimin kryetarit të PD-së dhe disa të tjerëve. Po të hapet ajo kuti, do të jeni ju dakord që ajo kuti është me shumë probleme? Po thyet edhe Kushtetutën, po thyet edhe vendimet e gjykatës. Unë jam dakord që të hapet ajo kuti. Është kuti me probleme falsifikuese e me shumë gjera të tjera që edhe po ta hapim këtu, merreni ju vendimin më pas në bazë të Kushtetutës për ta djegur atë kuti, se duhet ta digjini. A e dini ju cila është ajo kuti? Është kutia e mendjes së Edi Ramës. Largojeni sa më shpejt!

Së fundi, a e dini ju që jeni në opozitë që lufta brenda llojit është më e keqe se me kundërshtarin? Por ju e keni brenda vetes suaj, duke filluar nga Ali Demi juaj historik, që disa prej jush që janë këtu, se të tjerët i ka zgjedhur Ruzhdiu tjetër, disa prej jush ai bëri ministra, kryeministra, si pasojë edhe miliarderë në kurriz të lekëve të popullit shqiptar. Dhe ju çfarë i bëtë? I vutë shkelmin edhe atij, por edhe Mejdanit, Pëllumbit. Po çfarë bëtë tjetër? Edhe me LSI-në bëtë të njëjtën gjë. 30 autobusë kam sjellë unë në 2007-n kur kam qenë kundër PD-së. I prura 30 autobusë në Pallatin e Sportit dhe çfarë bën zoti Meta, merr prej dore Baren, jo Baren e

krimit të organizuar, por Baren që e patë aty me punonjësit e bashkisë me plehëra dhe i thotë: mbroje ti gjethen e fikut të Ramës. U bë kryetar bashkie, doli i pabesë, edhe këtu, kur ai ishte në grevë urie, ju nuk i jepnit as dorën. Prandaj, unë dua t'u them të gjithë shqiptarëve dhe banorëve të qarkut të Beratit: Po patët kurajë hajde së bashku në sfidën elektorale dhe unë po premtoj publikisht që Berati nga një komunë do të marrë 5-6 njësi vendore në qarkun e Beratit.

Falemnderit!

(Ndërkohë, drejtimin e seancës e ka marrë zoti Turku).

Ardian Turku – Falemnderit, zoti Lefter!

Fjalën e ka zoti Dule.

Vangjel Dule – Zoti drejtues i seancës, Të nderuar kolegë,

Do të dëshiroja, para se të kaloja në thelbin e debatit të sotëm, të kujtoja disa fraza nga ajo çka tha për vendin tonë Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës para 2-3 javësh, krizë politike, pamundësi për reforma madhore kushtetuese, situatë që dëmton popullin shqiptar dhe pengon ambiciet e integritimit evropian.

Kjo është situata. Ky është kuadri, jo siç e shohim ne që jemi në opozitë, por siç e sheh faktori i cili është në pozitat e të tretit dhe që, pa diskutim, ka një përvojë shumë të gjatë në lojën demokratike dhe respektimit të rregullave të saj.

Ne, në këtë Parlament, gjatë gjithë këtyre viteve një ndër çështjet më të debatueshme që kemi pasur ka qenë Kodi Zgjedhor. Pa dyshim, ligji që është sjellë dhe risjellë më shumë se çdo ligj tjetër në debate në seancën parlamentare. Është ligji që është amenduar pjesërisht apo tërësisht më shumë se çdo ligj tjetër i legjislativitetit të vendit tonë. Ky është një element që nuk duhet ta harrojmë.

Së dyti, duhet të kujtojmë edhe një fakt tjetër. Ndër instrumentet e përdorur nga Parlamenti ynë, instrumenti i komisioneve hetimore ka qenë më i dështuari deri më sot.

I përmend këto dy fakte për të qenë tepër të vëmendshëm në debatin politik dhe në konkluzionet dhe vendimet që do të marrim sot.

Të nderuar kolegë,

Prej nesh sërish dhe shumë shpejt do të kërkohet ndryshimi i Kodit Zgjedhor, pjesërisht apo plotësisht. Ky është një detyrim nga raporti i OSBE-ODIHR-it, që zgjedhjet pavarësisht sesi i cilëson dhe për çfarë arsyesh i cilëson si të tilla në vazhdim, nuk u heq një fakt të pohuar në të gjitha dimensionet:

në një të tretën e qendrave të votimit u numërua keq dhe shumë keq, një ne tre vota vajti në destinacion të ndryshëm nga ai për të cilin e dha sovranin popull.

Por si do ta amendojmë në Kodin Zgjedhor për të shmangur përfundimisht traditën e zgjedhjeve sistematikisht të dështuara në vendin tonë? Zoti Kryeministër, doktor Berisha, si do t'i jepnit juve trajtimin mjekësor të suksesshëm një pacienti pa e vizituar atë? Si do të jemi ne në gjendje të japim një Kod të ri Zgjedhor, i cili do të na shmangë nga proceset e dështuara të së kaluarës, pa parë se ku dhe se si dështuam sërish në zgjedhjet 28 qershorit në shkallën që e pranojnë të gjithë se patëm dështim?

Prandaj për të bërë ekzaminimin e këtyre zgjedhjeve duhet që të jemi shumë të vëmendshëm, duhet të jemi koherentë në qëndrime dhe në bindje, sepse debate të tilla kemi bërë edhe para 4, edhe para 8, edhe para 13 vjetësh. Me sa është bërë e qartë, nuk kërkohet prej askujt ndryshim i rezultatit zgjedhor. Nuk kërkohet prej askujt rinumërim votash, si hallkë e parashikuar nga ligji në procesin zgjedhor. Nuk kërkohet rishpërndarje mandatesh. Nuk kërkohet ndryshim raportesh pozitive-opozitive. Nuk kërkohet të ndikohet në vendimet e gjyqësorit. Janë të dhëna të pranuar, të padiskutueshme prej askujt, sikurse nuk kërkohet që të vlerësohen vendimet e gjykatave.

Çfarë kërkohet? Kërkohet që të shikojmë të gjithë se si, me çfarë mënyre u numërua keq dhe shumë keq. Kërkohet që të shikojmë se në çfarë mënyre u tjetërsua vota e qytetarit shqiptar. Kërkohet të shikohet se në çfarë mënyrash u abuzua dhe si u devijua, në masën që u devijua, vota e sovranit nga destinacioni i saj parësor. Kërkohet që të mësohet se si u hodh vota në emër të një qytetari tjetër, pa dhënë ai praninë në kutinë e votimit. Kërkohet që të mësohet mënyra e regjistrimit fiktiv të numrit të kartës së identitetit apo të pasaportës së një votuesi që nuk mori pjesë në votim. Kërkohet që të shikohet se si regjistrimi i votave të vjetra, qindra, ndoshta dhe mijëra zgjedhësve për tjetërkënd u hodh, për tjetër u numërua, për tjetërkënd u regjistrua në procesverbalet përfundimtare.

Pra, pa i parë të gjitha këto aspekte ne nuk kemi asnjë lloj garancie se do të bëjmë ndërhyrjet e duhura në Kodin Zgjedhor, se do të ndryshojmë mënyrën e administrimit të procesit zgjedhor dhe do të kemi për herë të parë zhvillimin e zgjedhjeve të ndershme, të barabarta, të pranuar, të

pakontestuara, sipas standardeve të gjithë botës së civilizuar.

Midis shumë aspekteve, zoti Kryeministër, Gorbaçovi mbahet për një element shumë të rëndësishëm si figurë e rëndësishme në histori, është Gllasnosti, është transparenca dhe ishte një pikë kthese në ish-republikat sovjetike, pikërisht ky nocion. Çfarë kërkohet? Transparencë. Çfarë e keqe do t'i vijë këtij Parlamenti, kësaj Qeverie nga transparenca?

Thoshte, para 2-3 ditësh një shkrim i Reuters për vendet e Ballkanit dhe ecurinë integruese të tyre. Fliste edhe për vendin tonë. Por lexuam me keqardhje se kohët e fundi vendi ynë shkon me kredenciale të dobësuar për demokracinë në Bruksel. Mund të shkonim me një ekonomi më të dobët, mund të shkonim me korrupsion më të lartë, por me kredenciale demokratike më të dobësuar sesa vjet, sesa parvjet, se para 4 apo 14 vjetësh.

Prandaj, ne do të dëshironim të theksonim se është momenti që me përgjegjësinë e ligjvënësit sot të vendosim atë që e thotë Kushtetuta, atë që edhe kur nuk e pranuar si të mirëqenë, dispozitën kushtetuese, i kërkuam Gjykatës Kushtetuese dhe na e interpretoi. Nuk kemi të drejtë të hetojmë gjykatat, nuk kemi të drejtë të vlerësojmë gjykatat, por asgjë nuk na pengon në misionin tonë të legjislatorit të shfletojmë çdo procesverbal, të hetojmë çdo fletë votimi, të hapim edhe kutinë e qendrës më të largët të votimit, sepse asgjë e keqe, përkundrazi vetëm kontribut do të ketë për proceset zgjedhore në vendin tonë. Na takon neve ta zgjidhim në këtë sallë.

Në qoftë se sot do të ikim pa i dhënë zgjidhjen përfundimtare këtij problemi, në demokraci krahas nesh është edhe qytetari. Problemet që nuk do t'i zgjidhim dot ne, do t'i zgjidhë qytetari që është më i mençur ne veprimet e veta. Por e mira është që ne të kryejmë detyrën tonë dhe të japim zgjidhje. Ndërsa, nuk do të dëshiroja dhe që nga dita e parë kur kolegët e tjerë të opozitës nuk ishin në këtë sallë, i urova punë të mbarë kësaj Qeverie.

Por në qoftë se do të vazhdoni të insistoni me qëndrimet tuaja në një moment që askush nuk hodhi hije mbi legjitimitetin demokratik të kësaj Qeverie, zoti Kryeministër, ju me qëndrimin tuaj për këtë çështje madhore të transparençës së zgjedhjeve, po i hidhni hije legjitimitetit demokratik të kabinetit tuaj.

Falemnderit!

(Ndërkohë, drejtimin e seancës e ka marrë

zonja Topalli.)

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Dule!

Zoti Kryeministër, urdhëroni!

Sali Berisha – I nderuar zoti Dule,

Edhe një herë shfrytëzoj rastin të garantoj qytetarët shqiptarë se kjo maxhorancë është e vendosur për një transparencë të plotë në çdo qelizë, që çdo akt, në çdo proces të zgjedhjeve të 28 qershorit. Për këtë nuk ka as edhe një hezitim. Sikundër mbetemi të vendosur në mënyrën më absolute për një transparencë totale, mbetemi po kaq të vendosur, i nderuar, për një respekt të plotë të Kushtetutës, respekt të plotë të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe të shtetit ligjor. Në qoftë se mendoj se ky Parlament mund të marrë të gjitha atributet, të gjitha pushtetet, kjo do të ishte vërtet një hata e madhe për këtë vend.

Ajo që më çudit mua, në një kohë që ne ofrojmë rrugën e transparencës, unë konstatoj që absolutisht, jo ju zoti Dule, por në tërësi nuk dëshirohet kjo rrugë. Unë konstatoj se është përdorur transparenca vetëm e vetëm si një motiv për të maskuar një qëllim tjetër, i cili nuk ka të bëjë me këtë maxhorancë.

I nderuar zotëri,

Iu referuat Asamblesë Parlamentare, iu referuat Këshilli të Europës, iu referuat përdorimit të krizës. Zotëri, në krizë është partia që bojkoton Parlamentin e zgjedhjeve të lira dhe këtë, i nderuar, nuk ka sot shqiptar, në të katër anët e këtij vendi, nuk ka sot qytetar të lirë në Europë dhe në botë që nuk e njeh këtë fakt. Në krizë është Partia Socialiste, e cila tani sfidon Kushtetutën e vendit, kërkon me çdo kusht të dhunohet Kushtetuta, parimi i ndarjes së pushteteve, kërkon me çdo kusht të dhunohen vendimet e Gjykatës Kushtetuese.

A mund të ndalem një moment vetëm këtu? Ky ligj i komisioneve hetimore është sjellë nga maxhoranca e dikurshme ne vitin 2003. Natyrisht, e them këtu, ka qenë një arritje e madhe. Por, në psikologjinë tonë të përgjithshme u mendua se me këtë ligj parlamentarët morën të gjitha pushtetet dhe filluam të bëjmë hetim kudo. Çfarë ndodhi? Gjykata Kushtetuese lëshoi një seri vendimesh. Nga vendimi i parë i vitit 2003, zoti Dule, deri te vendimi i fundit, që s'e ka zbardhur akoma, i vitit 2009, në të cilën bllokoi komisioni hetimor parlamentar për Edi Ramën. Apo s'është kështu? I tha kësaj maxhorance se nuk mund ta hetosh atë, ndonëse kishte dhënë autorizim përpara disa vjetësh për ta hetuar po të njëjtin, i cili ishte paraqitur në sallën e Kuvendit me

megafon. Pas katër a pesë vjetësh, Gjykata Kushtetuese i thotë Parlamentit se s'mund ta hetojë më. Veprimi drejt a gabim, kjo është tjetër gjë, por një shkak ligjor e kishte. Pse? Ku e kishte? Bashkitë kanë parlamentet e tyre.

Nuk e tha këtë në gjykimin e parë, kur ishim në komision bashkë, e tha në gjykimin e dytë. A është ky gjykim një dackë për Parlamentin, një kufizim për të? Gjykata Kushtetuese ka nxjerrë jashtë hetimit kryetarin e Bashkisë, sepse atë e heton parlamenti i Bashkisë. Këtij Parlamenti, i tha, në respekt të autonomisë lokale, e cila është disa hapa më e vogël sesa pavarësia e gjyqësorit, pra, i tha nuk mund ta hetosh. Në këtë rast, kryetari i koalicionit tuaj është me flatra, është i lumnuar, është i kënaqur dhe doli në konferencë shtypi e shkrehu bateritë kundër meje. Nuk dola në konferencë shtypi unë dhe nuk thashë asnjë fjalë për Gjykatën Kushtetuese. S'ka rëndësi. Rëndësi ka që zotëria e pranoi atë vendim. Kurse vendimin tjetër, që nuk i intereson, jo.

E dini ç'më ndodhi mua, zoti Dule? Në prani të Komitetit Presidential, të Presidentit të Republikës, ai më drejtohej dhe më thoshte: "Gjeje një vendim ku përmendet fjala gjykatë" dhe burrat aty hapnin sytë, nëse ish apo nuk ish e vërtetë që përmendej fjala gjykatë. Unë u detyrova t'i them zotit Spiro Peçi: "Të lutem, zotëri, më jep vendimin e gjykatës dhe t'ia lexoj të gjitha rreshtat, ku përmendet ajo fjalë." Atëherë, të gjitha shikimet u drejtuan ndaj tij, sesi kish mundësi kjo gjë. Pra, zoti Dule, duhet të lemë gjyzlykët partiake, se po të hyjmë me to, akuzën e parë për vjedhje votash ia ke drejtuar Edi Ramës. Më vodhi votat, ke thënë. Kjo është publike.

I nderuar zotëri, nuk është as qëndrimi yt dhe as i ndonjë tjetri ai që përcakton legjitimitetin e kësaj Qeverie. Këtu e kenë gabim. Legjitimitetin e kësaj Qeverie e kanë përcaktuar zgjedhësit shqiptarë dhe e vërteta është se ju e kenë deklaruar atë. Nëse ndërron mendje, kjo është puna jote dhe kjo nuk do të thotë se legjitimiteti mund të diskutohet.

I nderuar zotëri, edhe njëherë, ju doni të hapën kutitë dhe unë, absolutisht, nuk kam asnjë kundërshtim, por, urdhëroni, të respektojmë Kushtetutën, të respektojmë vendimet e Gjykatës Kushtetuese! Shikoni, zoti Dule, të deklaroj se nuk kam asnjë fakt, por më janë korrumpuar komisionet, ky është krim. Nuk është krim ajo që është bërë, por është krim kjo që thuhet. Të akuzosh njerëz të pafajshëm, të cilët janë të pafajshëm tërësisht, sepse nuk ke asnjë provë, sepse në këtë mënyrë

mund të akuzosh çdo shqiptar, për çdo vepër, vetëm e vetëm sepse je parlamentar dhe ke imunitet. A është parë kund kjo? Thashë edhe një herë.

Nxirrini komisionerët të dëshmojnë se cili është i korruptuar! Nxirrini komisionerët të dëshmojnë, se kush u ka dhënë para! Por është mëkat, vetëm e vetëm sepse ata nuk janë këtu, por janë në shtëpitë e tyre, dhe një pjesë e tyre edhe të papunë apo përpëliten me varfërinë dhe akuzohen këtu si të mos ishin qenie njerëzore, duke mos respektuar parimin më bazë të prezumimit të pafajësisë, duke pretenduar për t'u bërë gjykatësit dhe prokurorët e tyre dhe duke folur këtu për krim elektoral.

I nderuar zotëri, iu referove Gorbit. Gorbi e përdori Gllasnostin për të tejshkuar terrin e diktaturës komuniste. Nëse doni transparencë, urdhëroni ta bëjmë sipas kushteve kushtetuese, përndryshe nuk e doni. Ju nuk e doni transparencën, përkundrazi, doni të bojatisni një proces. Ja cili është fakti. Këshilltari kryesor i kryetarit tuaj përmend kutitë me zero vota për opozitën. Po jua lexoj. Pse ju djeg juve? Ku e bazoni të vërtetën tuaj? Qarku i Shkodrës, zona 92, qendra e votimit 0186, PD-ja 93 vota, PS-ja 0 vota.

Të nderuar zotërinj, qarku i Shkodrës, qendra e votimit 186, koalicioni i PD-së, 93 vota dhe ai i PS-së, plus Polin, 5 vota. Vazhdojmë më tutje, me Dibrën. Qendra 1048, koalicioni i PD-së 130 vota dhe ai i PS-së 0 vota. Zotërinj, të vërtetat janë të egra, por duhen respektuar. Koalicioni i PD-së në Dibër 137 vota, koalicioni i PS-së 95 vota. 0 vota e keni këtu, po jua them që të shihni se çfarë të pavërtetash serviri juve.

Vazhdojmë më tutje. Në Korçë qendra 1413, sipas këshilltarit kryesor të kryetarit tuaj, PD-ja 38 vota, PS-ja 0 vota. Ja ku është e vërteta. PD-ja 42 vota, PS-ja 18 vota. Këto janë kutitë që doni të hapni ju. Në Shkodër, në qendrën 0038, sipas këshilltarit kryesor të kryetarit tuaj, PD-ja 153 vota, PS-ja 0 vota. Në të vërtetë, PD-ja 231 vota, PS-ja 159 vota. E keni shpërndarë në të gjithë botën ju këtë. Ka qarkulluar në të gjithë botën kjo. Po them numra qendrash unë. Në Shkodër, qendra 0075, sipas këshilltarit të Edvin Ramës dhe dokumentit të shpërndarë në mbarë botën, PD-ja 11 vota, PS-ja 0. E vërteta është : PD-ja 117 vota dhe PS-ja 37 vota.

Të Tiranë, qendra e votimit 1987, PD-ja 291 vota, sipas këshilltarit. PS-ja 0 vota. More zotërinj, e vërteta është se koalicioni i PD-së ka 390 vota dhe koalicioni i PS-së 355 vota.

Zoti Dule, po t'i them këto, sepse kërkohet

transparenca. Jemi para shqiptarëve. Vazhdojmë më tutje. Do t'i them se kjo më erdhi nga Strasburgu. Prandaj dhe ju morët atë që meritoni nga Strasburgu. Në Tiranë, thotë këshilltari, PD-ja 267 vota, PS-ja 0 vota. E vërteta është që në Tiranë PD-ja kishte 298 dhe PS-ja 262. Vazhdojmë më tutje. Ju, more zotërinj, nuk doni transparencë. Në Tiranë, qendra e votimit 1598. PD-ja 398 vota, PS-ja 0 vota. As komisionari dhe as gruaja e komisionarit nuk kanë votuar, thoni ju! Ju bëni dhe akuza familjare me këto. Por, e vërteta është se PD-ja ka 519 vota, PS-ja 155 vota. Në Vlorë, qendra e votimit 4725, PD-ja 134 vota, 0 PS-ja. As gjysha e komisionarit nuk votoi. Vazhdojmë më tej. Koalicioni i PD-së 134 vota, koalicioni i PS-së 44 vota.

Të nderuar zotërinj, sa serioz është ky realitet që perceptoni?

Në qoftë se ju doni, edhe ti i nderuar zoti Dule, të bëjmë hetim të plotë dhe transparencë të plotë, por ajo do bërë me procedurë kushtetuese, sepse unë jam i bindur që shumë nga ju nuk kanë lidhje me të shkuarën.

Ka prej jush këtu, ndonëse jo të shumtë, por ka, që kanë kontribuar në përmbysjen e atij regjimi. Këto i di. Nuk i mohoj unë. Por, ka edhe nga ata, të cilët janë të lidhur mish e shpirt deri në thua me atë regjim. Ka nga ata dhe ata jua servirin juve këto dhe ju, o burra!

Besojeni ofertën time. Doni transparencë? Urdhëroni, të marrim prokurorë dhe të krijojmë ekipe të tëra, të paguajmë jashtë orarit, të bëjmë çdo gjë që të kemi transparencë. Po a e dini ju pse nuk e doni transparencën? Nuk e doni, sepse ju bazoheni në këto tabela. Për ju, rrofshin këto që të akuzoni Sali Berishën! Po pse more me gënjeshtër do ta akuzoni ju Sali Berishën? Jini të sinqertë! Unë shtrij dorën, ju dilni këtu e thoni urrejtje e gjëra tjera. Jo kështu.

Unë po të dua të flas, them shumë gjëra, por sot kam ardhur t'ju shtrij ju dorën, t'ju them që të ulemi të krijojmë komision. Doni të ndryshojmë ligje të tjera, në mënyrë që të kemi transparencë të plotë, me kushtin e vetëm, që nuk mundet kurrë pse një grup i vogël në krye tuaj, mendon se mund të përqendrohemi në duart të gjitha pushtetet. Atë s'mund ta bëjmë, sepse ishim ne që u ngritëm në dhjetor të '90-s, ishim ne që u ngritëm, që të mos i kemi në dorë të gjitha pushtetet. Nuk u ngritëm për gjë tjetër.

Unë isha mjek, pra ne ishim intelektualë. Ata që nuk janë më, ndjesë pastë, ishin intelektualë

dhe ne u ngritëm, sepse nuk donim që një njeri të kishte të gjitha pushtetet. Kjo është arsyeja. Pse ju keni frikë nga institucionet e pavarura? Ç'është kjo? Pse ju doni vetëm veten. Ju vetë prodhoni broçkulla të tilla. Mos harroni, vetë i prodhoni këto. Kaq kisha unë, zoti Dule.

Jozefina Topalli – Po, zoti Dule.

Vangjel Dule – Falemnderit!

Zonja Kryetare do të dëshiroja të theksoja se transparenca duhet bërë dhe ajo nuk do të bëhet për një palë dhe për palën tjetër. Nëse është PS-ja që ka abuzuar, kjo transparencë do ta provojë që ju nuk e pranoni. Ta provojmë nëse janë ata të cilët kanë vënë dorë në kutinë e votimit. Në qoftë se janë numëruesit e Partisë së Bashkimit për të Drejtat e Njeriut, atëherë fajti do të bjerë mbi ne. Por, hajdeni ta bëjmë këtë transparencë që të mos rrahim ujë në hava, por të tregojmë njëri-tjetrin me gisht në bazë të fakteve.

Së dyti, dëshiroj të theksoj në lidhje me spekulimin që bëhet, se disa kanë qëllime të mbrapshta. Dihet se demokracia është sistemi që iu jep edhe atyre që nuk pajtohen me të, të drejtën për të ushtruar veprimtarinë dhe aktivitetin e tyre demokratik. Ne do të pezullojmë institucionet demokratike se një, dy, tre apo 13 veta kanë qëllime të mbrapshta ndaj vetë demokracisë. Kjo është e papranueshme, zoti Kryeministër dhe me sa duket ndajmë vështrime diametralisht të kundërta. Por mos harrojmë se komisionet hetimore të drejtuara nga Partia Demokratike jo më vonë se legjislatura e kaluar, kanë hapur në çështjen e Prokurorit të Përgjithshëm dosje, të cilat ishin në proces gjyqësor, në kundërshtim flagrant me ligjin e komisioneve hetimore dhe nuk jeni zbrapsur edhe pas vërejtjeve të shumë institucioneve ndërkombëtare prestigjioze në lidhje me të.

Në lidhje me çështjen e demokracisë, më falni, thjesht citova një shkrim të pardjeshëm të Reuters-it. Qeveria mund ta përgënjeshtrojë, sepse edhe unë këtë do të dëshiroja që ta përgënjeshtrojmë, sepse ne nuk pranojmë se jemi me kredenciale dhe nuk duhet të jemi në asnjë mënyrë me kredenciale më të dobëta demokratike.

E fundit, zoti Kryeministër, prisja një përgjigje nëse ju jepni ilaçe, në profesionin tuaj, pa bërë ekzaminimin, hajde të votojmë edhe ne ligje, të amendojmë Kodin Zgjedhor pa bërë transparencë.

Jozefina Topalli – Zoti Kryeministër, urdhëroni!

Sali Berisha – I nderuar zoti Dule,

Të kërkoj ndjesë se e shmanga, por e shmanga,

sepse kur dola te kompleksi i Edipit, më sulmuan të gjithë nga ana profesionale, thanë po përdor profesionin e mjekut. Meqë po më pyesni, po ju përgjigjem si mjek, se tani nuk ma keqkuptojnë dot. Simulanti nuk operohet kurrë i dashur! Po e operove simulantin, ke thyer betimin e Hipokratit.

Jozefina Topalli – Zoti Beqja, urdhëroni!

Ilir Beqja - Zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar zonja e zotërinj deputetë,

Bashkëqytetarëve të Shkodrës, Malësisë dhe të Kukësit, por edhe të gjithë Shqipërisë, në fushatën elektorale u kam premtuar se do të jem zëri juaj dhe nga unë do të dëgjoni gjithmonë vetëm të vërtetën. Sot dua të flas për të vërtetën më të madhe të çdo demokracie moderne. Të vërtetën e vullnetit të popullit, ashtu siç shprehet një herë në katër vjet dhe jo si manipulohet nga pushteti apo tjetërsohet nga paratë e pista.

Javën e kaluar këtu në Kuvend, Sali Berisha na kërkoi që t'i gjenim një burrë Ruzhdies. Unë nuk dëshiroj të ofendoj asnjë shqiptar me toponimin e vendbanimit të tij, por sot botërisht deklaroj se në qarkun e Shkodrës ka plot simotra e sivëllezër të Ruzhdies, burri i të cilave është ky burri që rri pas shpinës sime. Një rast i bërë publik së fundmi është Jubani. Në Juban në 28 qershor, në orën 10 të mëngjesit ishin paraqitur 178 vetë për të votuar dhe në kuti ishin 200 fletë votimi.

Ne kemi sjellë prova edhe për kutitë e Jubicës, Kastelit, Lalait të qytetit Shkodrës, por ankimet për to u refuzuan me urdhër politik. Këto të vërteta i dinë njerëzit në Shkodër. Për Shkodrën janë bërë publike edhe të vërtetata e filmimeve, që nuk përputhen me tabelat e rezultateve, por askush nuk i ka dhënë shpjegime pse opozitës nuk i vihet në dispozicion filmimet për Beratin, për Durrësin, Elbasanin, Peqinin, Fierin, Kukësin, Laçin, Krujën dhe Tiranën.

Qytetarë dhe qytetare të Shqipërisë,

Që prej shtatorit Sali Berisha nuk flet më për mrekullinë ekonomike shqiptare. E shkatërroi ekonominë për 4 vjet. E keqpërdori buxhetin në gjysmën e parë të 2009-ës vetëm në funksion të manipulimit elektorale, manipulim e kisha përgatitur në shkrim, por kur e pashë sot sesi u soll fajtori, mund të them për krimin elektorale. Për ne socialistët këto janë arsyet e vërteta të krizës ekonomike në Shqipëri. Nuk është as kriza globale dhe as situata politike e 7 muajve të fundit. Aq keq duhet ta ketë punën ekonomia jonë, sa Sali Berisha lexon së prapthi edhe parashikimet e Unikredit, kur vlerën e

GDP-së në euro na e shet për rritje ekonomike. Edhe televizioni shtetëror i shifrave, sepse kështu është katandisur INSTAT-i ynë, i ka mbetur ora në shtator të 2009-ës. Nuk na thotë më sa është rritja ekonomike, sa është papunësia, sa është volumi i tregtisë.

Ministria e Financave nuk raporton asgjë prej nëntorit të kaluar. Sali Berisha e mban të mbyllur të vërtetën e ekonomisë shqiptare, sepse pushteti i tij mbahet vetëm mbi kutitë e mbyllura të Ruzhdies, Jubanit dhe të gjithë Shqipërisë.

Në vitin 2009 ekonomia shqiptare edhe nëse u rrit, u rrit 3 herë më pak se çdo vit në dekadën e fundit. Në vitin 2009 për herë të parë në dekadën e fundit bizneset e mëdha fituan më pak. Në vitin 2009, për herë të parë në dekadën e fundit volumi tregtar u ul. Në vitin 2009, për herë të parë, në dekadën e fundit biznesi i vogël bëri xhiron më të vogël. Në vitin 2009, për herë të parë që prej vitit 1997 leku u nënçmua me dy shifra.

Në Shqipërinë e sotme, sipas televizionit shtetëror zyrtar, janë 95 mijë familje, rreth 13% jetojnë me 40 dollarë në muaj ndihmë ekonomike. Minimumi jetik, pra të jetosh vetëm për të mbajtur frymën gjallë, është 2 dollarë në muaj, që do të thotë 240 dollarë në muaj.

Sot Sali Berisha i jep këtyre njerëzve 1/6 të minimumit jetik, e thënë ndryshe u jep mundësinë të jetojnë vetëm 5 ditë në muaj, sepse nga data 6 ata nuk janë më qytetarë të këtij vendi dhe duhet t'i luten Zotit. Vetë Sali Berisha e ka pagën mujore 2400 dollarë, pra sa 60 familje të varfra apo sa 240 shqiptarë të varfër.

40 dollarë ndihmë ekonomike në mars të 2010 mjaftojnë për të paguar energjinë në fashën e parë ujin e pijshëm dhe vetëm gjysmë buke në ditë, mos e dhëntë Zoti që dikush nga të varfrit të sëmuret, se duhet paguajë 15 dollarë për vizitën në spital. Ndërsa Kryeministri e ministrat paguajnë vetëm 15 dollarë në muaj për t'u siguruar nga çdo gjë.

Në këtë sallë kur votëbesoi Qeverinë në shtator 2009, Sali Berisha deklaroi se do të jepte sigurime shëndetësore për të gjithë shqiptarët. Kjo deklaratë nuk është pjesë e programit të zbardhur të Qeverisë. Por unë e kam kasetën filmike, e kam riparë dhe deklaratën kur në nëntor të 2009-ës tarifat e vizitave në spital për të pasiguarit u katër-pesëfishuan.

Kam mbetur i pagojë kur një banor i Koplikut më tregoi se kishte shkuar në spitalin e rrethit të Shkodrës dhe i kishin kërkuar të paguante tarifën 15 dollarë vetëm se në Koplik nuk ka spital. Jam

ende i pagojë para atij banori dhe nuk di si ta shpjegoj pse e shtrenjtoi shëndetësinë një person që ka qenë mjek për 25 vjet, nga të cilët 15 vjet ka qenë mjek në bllok, prandaj nuk e fshehin edhe nostalgjinë për bllokun.

15 dollarë duhet të paguajë edhe një nënë e re për të bërë ekon e shtatzënisë. Janë 20 mijë nëna të reja këtë vit në Shqipëri që janë të pasiguruara dhe për çdo eko duhet të paguajnë 15 dollarë në muaj. Me pagën vjetore të spikeres së Kuvendit do të mund të bënin ekon e shtatzënisë 200 nëna të reja këtë vit.

Dje Sali Berisha na rifoli për mrekullinë energjetike, por nuk pati guxim të kërkojë të falur pse e përmbyti Nënshkodrën. Aq më shumë u tall me atë dëshpërim qesharak.

I kujtoj Sali Berishës se bujqit e Nënshkodrës jo vetëm iu prishën të mbjellat e vjeshtës, por nuk do të mbjellin as të pranverës. As ata nuk kanë shpresë për të ardhurat, por edhe në qytetin e Shkodrës do të mungojnë prodhimet lokale. Në Shkodër po shtohen barsoletat për Qeverinë. Prandaj po i kërkoj këtu Sali Berishës të mos i sjellë më ministrat në Shkodër, pa u bërë provimin e maturës shtetërore, sepse fëmijët në Shkodër tallen me ministrat që nuk e dinë diturinë e natyrës dhe ngatërrojnë volumin e ujit me volumin e borës, apo ministra që nuk e dinë gjeografinë.

Në Shkodër gjithmonë janë treguar barsoletat për Qeverinë. Barsoletat e fundit është vetëm një fjali: "Sali" dhe të gjithë qeshin me të madhe.

Qytetarë e qytetare të Shqipërisë,
Punëtorë, pensionistë e sipërmarrës,

Që prej shtatorit 2009 ju po e mbani me para kavalierin që e ka mbushur moshën e pensionit. E mbani ju të punësuar, sepse ministri i Financave është i lumtur nga taksat që mbledh me importet, sepse leku është nënçmuar 12%, dhe ky është nënçmimi më i madh që prej vitit '97. Drejtori i OSSH-së deklaroi të hënën se po nuk u pagua energjia, përsëri do të rritet çmimi. Borxhliu më i madh është Qeveria me 50 milionë dollarë. Prandaj, ne paguajmë energji të shtrenjtë, sepse Sali Berisha është borxhli i keq.

E mbani ju pensionistë, sepse nëse u rritën pensionet 5%, në 1 maj 2009-ës, në shkurt inflacioni, sipas një vendimi të Qeverisë së Sali Berishës, është 5.8%. E mbani ju sipërmarrës që ju ka 100 milionë euro fatura të papaguara për situacione të pranuar dhe prej 2 muajsh ju gënjejnë. Ka 3 muaj që sipas buletinit të prokurimeve publike, Qeveria

bën tendera vetëm për roje private dhe karburant. Ruan veten, po nuk e kuptojnë nga kush. I duhet karburant, sepse po bëhet gati t'ia mbath, pasi e ndien që populli po bëhet gati ta largojë. Është përherë më e qartë se Sali Berisha nuk do t'i hapë kutitë.

I them sot Sali Berishës dhe kujt do tjetër në këtë sallë që të mos çuditen kur t'i shohin shkodranët në radhët e para të protestës për largimin e tij.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Beqja!

Zoti Olldashi, urdhëroni!

Sokol Olldashi – Falemnderit, zonja Kryetare!

Meqenëse zotëria sapo përmendi pagat dhe meqenëse ka marrë pagën e parë, po e kujtoj që e ka më të lartë se Kryeministri. Merr rreth 3 milionë lekë si deputet. Nuk kam asgjë, por e thashë këtë vetëm për statistikë.

Zonja Kryetare,

Diskutimi i sotëm ka të bëjë me kërkesën e Partisë Socialiste, me amendimin e ligjit për komisionet hetimore të Kuvendit dhe me kërkesën e Partisë Socialiste për hetimin e zgjedhjeve parlamentare të 28 qershorit. Kam pasur mundësinë që qoftë për shkak të angazhimit tim të hershëm në politik, qoftë për shkak të profesionit të gazetarit, të ndjek të gjitha proceset zgjedhore që janë zhvilluar në Shqipëri, duke filluar nga viti '91, kur kam qenë komisioner deri te procesi i fundit. Pa dyshim që mund të them me bindjen më të plotë se këto janë zgjedhjet më të mira që janë zhvilluar ndonjëherë në këtë vend. Janë zgjedhjet më të mira në të gjitha parametrat e tyre.

Të gjithë zotërinjtë që flasin sot për zgjedhjet duhet të kenë parasysh se ne vinim nga një standard krejt tjetër, vinim nga standardi i viteve 2000, 2001 kur morën peng komisionerët dhe u mbajtën me pistoletë të koka dhe nga standardi i 2005, kur të gjitha strukturat edhe të forcës së shtetit u angazhuan për fushatë dhe për të siguruar votën për Partinë Socialiste, gjë që nuk ndodhi këtë radhë, gjë që nuk ndodhi në asnjë element të vetin.

Ky nuk është një përfundim yni është një certifikim ndërkombëtar i dhënë qoftë nga vëzhguesit e ODIHR-it, qoftë nga vëzhguesit e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës, qoftë nga vëzhguesit e trupit diplomatik, qoftë nga ata të Kongresit Amerikan.

Pra, zgjedhjet e këtij viti u konsideruan zgjedhje më të mira, të bëra ndonjëherë në Shqipëri që arritën standarde ndërkombëtare pavarësisht mangësive që

patën. Por, a po themi ne që zgjedhjet nuk kanë pasur mangësi? Në asnjë rrethanë dhe në asnjë ditë nuk e kemi thënë këtë. Të gjitha proceset zgjedhore kanë mangësitë e veta dhe gjithmonë proceset zgjedhore kanë diçka për të përmirësuar, sikurse ka edhe procesi i 28 qershorit që ka qenë më i mirë që kemi zhvilluar ndonjëherë.

Ka pasur probleme në proceset zgjedhore edhe në vende shumë më të zhvilluara demokratike se ne, ka pasur probleme në Itali, ka pasur probleme në tempullin e demokracisë që është Amerika. Por le të marrim rastin e fundit atë që ndodhi në Ukrainë. Pati probleme, kontestime, u mor një vendim gjykatë dhe diskutimi u mbyll. Secila palë njohu rezultatin dhe iu nënshtrua vendimit definitiv të institucioneve zgjedhore apo të gjykatës.

A i cenojnë probleme të tilla sporadike standardet e zgjedhjeve? Në asnjë mënyrë jo, sepse standardet nuk i kemi certifikuar ne, por, në radhë të parë, i kanë certifikuar qytetarët shqiptarë që kanë marrë pjesë në proces dhe i kanë certifikuar ndërkombëtarët që ne ftuam të merrnin pjesë në zgjedhje dhe që patën mundësi t'i monitoronin zgjedhjet.

Atëherë, çfarë kërkohet të hetohet nga PS-ja? Është ngritur dhe është tundur si flamur rasti i Ruzhdijes. Nuk kam dashur kurrë të hyjë në diskutimin banal të kësaj çështjeje, por do të detyrohem ta bëj sot për herë të parë dhe të fundit. Procesi Ruzhdije u prish kur komisionerët e PS-së, në ora 11:30, u larguan. Por ka një gjë që duhet thënë dhe që ju nuk e përmendi kurrë, ata komisionerët të PS-së që u larguan, u treguan dinjitozë, të paktën, sepse nuk bënë kallëzim. Kallëzimi ka ardhur nga subjekti PS dhe jo nga komisionerët tuaj. Ata dorëzuan vultat sipas urdhrorit që u kishit dhënë dhe kaq. Ju më pas e torrët dhe bëtë një histori të gjatë, gjoja kërcënim. Kur u prish balanca e komisionit, sigurisht që procesi u prish.

Por pse të merremi me Ruzhdijen? Ju po thoni se ishin kaq firma të parregullta dhe kaq karta të parregullta. Në kutitë e Ndënjarrasit, ku ju keni fituar 305 me 82, nuk është gjetur asnjë numër karte identiteti, por është shënua vetëm anash nëse ka votuar me kartë dhe me pasaportë, pa asnjë numër identiteti. Në kutinë e fshatit Agim është e njëjta situatë. Keni fituar 333 me 58. Nuk ka pasur asnjë numër identiteti në dokumentet e qendrës së votimit, por në momentin që ne u ankuam në KQZ, ky i fundit mori vendim dhe konstatoi se vullneti i zgjedhësve ishte i shprehur qartë, mori rezultatin

para sysh, e llogariti në dëmin tonë dhe ne mbyllëm gojën, respektuam vendimin e KQZ-së dhe vendimin e Kolegjit Zgjedhor.

Ajo që duhet të kishit bërë edhe ju në rastin e Ruzhdijes, ndërkohë që në rastin e Ruzhdijes ka një të dhënë që ju nuk e përmendni kurrë, që rezultati i nuk është llogaritur në rezultatin final të qarkut Fier, pra është një kuti e shpallur e pavlefshme me vendim të Kolegjit Zgjedhor, gjë që ju bëni sikur harroni gjithmonë ta thoni.

Ndërkohë, keni pasur akuza që i keni harruar dhe tashmë nuk i bëni. Keni thënë që ne kemi përdorur të burgosurit politikë në fushatë. Tani unë do t'ju jap një dokument, sepse përpara se të lëshoni akuza, duhet të keni fakte. Ky është procesverbali i hyrjeve në burgun e Rrogozhinës dhe unë do t'i kërkoj sot zotit Klosi të më sqarojë se pse ky dhe kryetari i PS-së së Shijakut, Indrit Buka, vajtën për vizitë në burgun e Rrogozhinës ditën e zgjedhjeve. Çfarë kërkonin? Njëri është me origjinë boshnjake nga Borakja dhe tjetri është nga Mallakastra. I ke këtu, nuk gënjej unë, ke procesverbalin. Pra, nuk keni vajtuar të takoni kushëririn e përbashkët të atij nga Shijaku dhe tëndin nga Mallakastra. Keni vajtur të takoni njerëz që keni dashur t'i përdorni për vota dhe njerëz që shkaktuan incidente të armatosura në qytet. Në qoftë se doni ta hetojmë, e hetojmë.

Pra, ju e keni të gjithë evidencën e provave, e dini po aq mirë sa ne që këto kanë qenë zgjedhjet më të mira. Ajo që doni të zgjidhni ju është kriza juaj politike. Ju pretendoni të hetoni mbi vendimin e gjykatave, ndërkohë që unë po ju kujtoj një rast tjetër konkret. Një zonjë socialiste, prezente në këtë sallë, ish-ministre e Kulturës, kur unë kam kryesuar komisionin hetimor kundër zotit Rama, i kam vajtur në zyrë dhe në mënyrë korrekte më ka dhënë dosjet që i kam kërkuar me përjashtim të njërës, dosjes së fasadave, sepse më ka thënë se kjo dosje është në shqyrtim në prokurori. I kam thënë faleminderit dhe kam ikur nga zyra me bindjen se kishte respektuar rigorozisht kërkesat e ligjit për komisionet hetimore, ndërkohë që ju këtë nuk e bëni sot.

Çfarë kërkonin të hetojmë? Problemi që keni ju është problem brenda PS-së, është ndarja e grupit tuaj në politikanë dhe biznesmenë. Unë e mirëkuptoj zotin Klosi, pavarësisht se nuk jam dakord me veprimin e tij, sepse si njeri me instinkte politike ka dashur të shfrytëzojë çdo votë, por problemi është që grupi juaj nuk ka vetëm Klos, grupi juaj ka edhe problemin e një ndërtuesi që nuk po ia përmend

emrin dhe që nuk është as socialist, nuk ka as ngjyrë, nuk ka as erë. E vetmja gjë që e lidh me fatin tuaj është kjo sipërfaqja e zezë këtu që është truall shtetëror me të cilin ky zotëria ka ndërtuar me lejen e Edi Ramës. Është shumë i ndryshëm nga Klosi, sepse Klosin të paktën e lidh diçka me PS-në, këtë nuk e lidh asgjë, përveç lejes së ndërtimit me Edi Ramën.

Ky është problemi që keni ju, problemi midis ndarjes së politikanëve të PS-së, atyre që PS-në e kanë në gjak dhe që unë i respektoj dhe atyre që nuk kanë asnjë lidhje me PS-në, me përjashtim të parave të pista që përfitojnë nga Bashkia. Por ky është një problem që nuk ua zgjidhim dot ne. Ky është një problem që ju duhet ta zgjidhni vetë.

Duhet t'ju kujtoj edhe një moment. Shumë nga ju që janë deputetë të vjetër, më të vjetër se unë disa, sepse unë kam tri mandate, ka këtu që kanë nga pesë nga gjashtë, e dinë se kemi pasur në tetë vjetët e opozitës së PD-së momente të vështira. Kemi pasur momente debati, kemi pasur momente tensioni, kemi arritur edhe deri në përleshje individuale më njëri-tjetrin, por ka pasur një pikë që nuk e kemi kaluar kurrë dhe kjo pikë ka qenë përgjegjësia individuale e gjithsecilit që merr përsipër të merret me politikë ndaj fateve të mëdha të këtij vendi dhe të qytetarëve.

Me lejoni t'ju kujtoj që kryetari i partisë suaj po ju tërheq zvarrë përtej kësaj pike dhe kjo është fatale në radhë të parë për PS-në, pastaj për të gjithë skenën politike të Shqipërisë. Kjo është fatale edhe për ne, kundërshtarët tuaj politikë, sepse nuk është në interesin e askujt. Ju e dini fare mirë këtë, e dinë edhe deputetët tuaj të vjetër, e dinë ata që panë të spastrohej gjysma e politikanëve të karrierës dhe që presin radhën në zgjedhjet e tjera të spastrohen ndësoj si Musa Ulqini e Ylli Bufi, që nuk ishin demokratë, por ishin socialistë.

Ky është problemi juaj, por këtë problem nuk ua zgjidhim dot ne. Është absolutisht kriminale përpjekja juaj që krizën brenda PS-së ta shndërroni në një krizë të vendit. T'u thuash komisionerëve të BE-së, t'i kërcënosh me eksod të shqiptarëve në qoftë se liberalizohen vizat, të dalësh gazetë më gazetë për të përhapur panik se bankat në Shqipëri janë jostabël, nuk është asnjë gjë tjetër veçse kriminalitet politik, sikurse është kriminalitet politik të tundësh këtu fotokopje kartash identiteti për të bërë të besojnë njerëzit se ky sistem është i pasaktë. Është kriminalitet politik dhe penalisht i dënueshëm në disa raste.

Ne kemi ardhur këtu sikurse është konfirmuar edhe nga të gjithë ata që kanë folur nga pala e maxhorancës, me dëshirën e mirë për të gjetur një konsensus, për të hetuar ato gjëra që mund të hetohen brenda një kuadri kushtetues, me vetëdijen e plotë që Kushtetuta e vendit dhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese nuk e lejon këtë institucion t'u mbivendoset institucioneve të tjera që kanë sovranitetin e tyre të veprimit. Por kësaj dëshire të mirë ju i përgjigjeni mbrapsht, duke na ftuar të nderim së bashku fitilat e barutit në themelet e shtetit. Por ne nuk do të ndjekim këtë aventurë, kjo është aventura juaj në të cilën ne nuk e kemi ndër mend as t'ju ndjekim, por nuk kemi ndër mend as t'ju lejojmë ta bëni.

Për sa u takon kërcënimeve që lëshon ndonjëri nga ju rrallë e tek po ju them një gjë me bindjen më të thellë: keni qenë për shkak të trashëgimisë suaj, por edhe për shkak të mënyrës se si erdhët në pushtet në '97-n, një parti tigrash. Tani jeni parti gjysmë lepurit dhe nuk trembni dot njeri.

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Olldashi! Urdhëroni, zoti Klosi!

Blendi Klosi – Ky dokument dëshmon edhe një herë mashtrimin e radhës të zotit Olldashi. Data është 1 shtator 2009. Është e vërtetë që kam qenë në një takim, si të gjithë qytetarët e tjerë të Shqipërisë, brenda të gjitha rregullave që ka ky shtet, me të pandehurit.

Zoti Ollashi, vazhdoni të jeni në të njëjtin profil, në profilin e mashtrimit, por unë me këtë nuk do të doja fare të lidhesha, sepse për këto keni marrë një goditje shumë të madhe nga populli i Tiranës dhe mendoj se ky do të jetë mësimi më i madh për të gjithë ata që karrierën nuk e ngrënë mbi politikën, por mbi mashtrimin dhe në qoftë se ke dhe lidhje me atë familje, e vërteta është se unë që kam qenë te ta, dhe ti u ke qenë në shtëpi, ju ke ngrënë edhe bukën. Por ti u solle shumë keq me ta, ndërkohë që për Shijakun vërtetë ne do të duhet të hetojmë, do të duhet të hetojmë se si ai popull u terrorizua tri ditë se ku do të viheshin flamujt, tri ditë luftë e unë dhe deputeti i Shijakut, sepse ti u largove Sokol, nuk kishe mundësi më të shkoje në Shijak. Unë dhe deputetët e Shijakut nuk bënim politikë, por negociuam me njerëzit se ku do të viheshin flamujt, ne negociuam me njerëzit se si do t'u shpëtonim atyre jetën dhe kjo është e gjitha, sepse politika mbi atë popull po punon shumë keq. I ka futur e vazhdon t'i fusë në vëllavrasje.

Ne, në një komunë të caktuar të Shqipërisë, 10

km nga Durrësi e 20 km nga Tirana, nuk bëjmë dot aktivitete politike, se njerëzit tuaj, zoti Olldashi,, nuk na lejojnë e thonë se ky është patrimon i PD-së. U dogjën zyrat atje, zoti Olldashi, dhe ju keni qenë ministër i Qeverisë. U luftua e flamujt janë sot po në atë vend që u vunë atë ditë, sepse populli realisht nuk do t'ia dijë për flamurët politikë, askush nuk e kthen kokën më nga flamurët politikë. Ju duhet të ishit atje dhe të kontribuonit me ne të tjerët për të vendosur konsensus në atë popull, jo të shkonit të hanit bukë e pastaj të vepronit shumë keq me ata njerëz.

Ky është, zoti Olldashi, mësimi që keni marrë ju personalisht, si dhe kryetari juaj, i cili duhet të hapë kutitë ose të largohet. Tregoji se çfarë ka ndodhur në Sallmone, tregoji se çfarë ka ndodhur te Katër Rrugët! Ambasadorja angleze ishte me mua atje dhe e ka parë. Shkoni takojeni atë! Dy ditë pas ditës së votimit më tha: A munde të mbijetosh? Ky është mësimi që morëm ne nga Katër Rrugët e Shijakut, ky është mësimi që morëm ne nga ajo luftë e padrejtë mbi të cilën ju keni ngritur gjithë politikën tuaj.

Prandaj, zoti Olldashi, më erdhi shumë keq ...*(ndërpritet nga zoti Olldashi.)* Po, po, isha dhe prapë gënjet. Nuk kam qenë ditën e zgjedhjeve, kam qenë muaj pas ditës së zgjedhjeve e ndërkohë ky është një ndryshim shumë i madh. Po, ne kemi vajtur, kemi bërë takime, por ti ato takime i bëje jashtë letrave. Nuk e mohoj, kam qenë, por ti shkon dhe i takon jashtë, i nxorët nga burgu, i përdorët, i futët në vëllavrasje, çfarë nuk bëtë që ata njerëz të përdoreshin keq dhe shumë keq, prandaj ky është problem i madh që ju keni edhe me ata njerëz dhe me të gjithë popullin.

Falemnderit!

Jozefina Topalli - Falemnderit!

Urdhëroni, zoti Strazimiri!

Gent Strazimiri – Falemnderit, zonja Kryetare! Të nderuar kolegë,

“Nuk kemi për detyrë të bëjmë negociata, por të shohim kushtetutshmërinë e ligjit. Nuk kemi për qëllim të shkelim Kushtetutën, duke bërë këtë, dhe atë, dhe atë. Nuk kemi ndër mend të kryejmë këtë dhe atë veprim që bie ndesh me vendimet e Gjykatës Kushtetutës”. Janë fjalë të thëna zyrtarisht nga përfaqësuesit e PS-së në Komisionin e Ligjeve dhe të përsëritura pak më parë këtu në sallë. Mrekulli. Ky është konsensusi. Të gjitha këto veprime që nuk kemi ndër mend t'i bëni le t'i hedhim në ligj fjalë për fjalë, siç i ka thënë Gjykata Kushtetuese dhe jo

PD-ja apo Sali Berisha. Le t'i qëndrojmë kësaj dhe jemi në rrugë të mbarë dhe çështja është e zgjidhur.

Problemi është se deri tani tema e fjalimeve të kolegëve të PS-së ka qenë e drejta e iniciativës për të ndërmarrë një hetim parlamentar si garanci e popullit për transparencë, së drejtës për informim etj. dhe për më tepër si kauzë e përhershme e opozitës. Në fakt, e drejta e opozitës për transparencë dhe për hetim parlamentar është një betejë që opozita e ka fituar në vitin 2003, kur PD-ja kërkonte ngritjen e komisionit hetimor dhe PS-ja nuk e lejonte. Më lejoni t'ju kujtoj që kjo kauzë bllokoi punimet e Parlamentit për mbi tre muaj.

Vendimi nr. 18 i Gjykatës Kushtetuese i shumëcituar nga kolegët e opozitës, është pikërisht materializimi i fitores së kauzës së përhershme të opozitës, e fituar nga PD-ja, një betejë që sot ju nuk mund ta luftoni, sepse është tashmë e fituar.

Më lejoni gjithashtu t'ju kujtoj që objekti i hetimit në atë kohë ishte transparenca e zbatimit të ligjshmërisë në Bashkinë e Tiranës, e kryesuar nga zotëria që humbi zgjedhjet e 28 qershorit dhe që është ende titullar i saj dhe në të njëjtën kohë titullar i të ashtuquajturës "kauza opozitare për transparencë", i cili në atë kohë i mbylli derën e Bashkisë komisionit hetimor, domethënë të drejtës së panegociueshme të sovranit për transparencë, e ushtruar kjo nëpërmjet përfaqësuesve të tij. Kjo histori e shkurtër, por intensive e betejës opozitare për institucionalizimin e hetimit parlamentar ka pasur një *happy end* këtu e disa vjet më parë dhe për më tepër ka shërbyer për të zhvilluar një jurisprudencë të vyer interpretimesh shumë të vlefshme mbi kufirin e së drejtës së patjetërsueshme të Kuvendit për të hetuar, kufizime që përfshijnë objektin dhe instrumentin në dispozicion të tij për të përmbushur në mënyrë kushtetuese këtë mision.

Këtu mendoj se duhet të fillojë puna jonë dhe mendoj se diskutimet tona duhet të përqendrohen në pasqyrimin, jo debitimin apo më keq akoma në interpretimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, në mendimet që do të paraqesin. Diskutimet tona duhet të përqendrohen në atë që komisioni hetimor parlamentar, sipas Gjykatës Kushtetuese, nuk mund të bëjë mbivendosje dhe për këtë ka të paktën 4 vendime të kësaj gjykate. Ajo që po ndodh tashmë këtu e 8 muaj është interpretimi i interpretimeve të Kushtetutës, një absurd juridik dhe logjik, i njëjtë dhe identik me absurdin e kauzës së rinumërimit të rinumërimit të votave. A ka hapësirë për vullnet politik mbi një çështje që përfaqëson një

konflikt krejtësisht kushtetues? Natyrisht që jo.

Të nderuar kolegë,

Fakti që Kuvendi e bën vetë ligjin nuk do të thotë që Kuvendi të shndërrohet edhe në ligj, edhe në Maliq. Ligjin Kuvendi e bën, e bën edhe si rezultat i konsensusit politik, por jo në kundërshtim me parimet e Kushtetutës apo të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, të vetmit organ të autorizuar të interpretojë ligjin themelor të shtetit. Kuvendi ka thjesht detyrimin ta zbatojë. Hajde ta bëjmë!

Nëse me hetim parlamentar nënkuptohet asgjësimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Kolegjit Zgjedhor, Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurorisë, madje edhe Gjykatës Kushtetuese, i bie që ky vend të drejtohet jo më nga ligji dhe institucionet, por nga komisioni hetimor i radhës, natyrisht në emër të popullit si dikur. Shtojini kësaj edhe gazin e Degës së Punëve të Brendshme dhe e projektoni këtë vend direkt në vitin 1947, në atë vit kur banorët e Ruzhdies ishin shpallur zyrtarisht prej jush armiq të popullit.

Problemi juaj është se, siç shprehet OSBE/ODIHR-i në raportin përfundimtar, nuk pari asnjë provë të manipulimit apo deformimit të rezultatit. Nëse do t'i kishit, do t'i kishit nxjerrë, do t'i kishit dërguar në Kolegjin Zgjedhor, në prokurori, siç bëmë ne në vitin 2001, ku 1.641 komisionerë të opozitës, vëzhgues, deri dhe kandidatë të Partisë Demokratike u rrahën dhe u arrestuan ditën e zgjedhjeve, në komisionin e votimit, në të pesta raundet e zgjedhjeve, kur kutitë u mbushën në hije të plepit nga policia, i keni këtu të gjitha, dhe jo nga populli e qendrat e votimit, kur drejtori i shërbimit sekret, Fatos Klosi, që sot e nxirrni si mbrojtës të depolitizimit të SHISH-it, merrte pjesë hapur në fushatën elektorale në Mallakastër. E keni këtu.

Të gjitha këto i keni në këtë album, të cilin ne e dërguam në çdo zyrë të Europës dhe ishin prova, filmike dhe fotografike. Mbi bazën e këtyre provave raporti i OSBE/ODIHR-it atëherë la detyrë hetimin e thellë dhe të plotë të zgjedhjeve. Por asnjë prej jush, me sa duket, nuk e kishte gjetur akoma vokacionin e kauzës së panegociueshme të opozitës për transparencë.

Një masakër elektorale nuk mund të ketë ndodhur kur të 20 mijë komisionerët socialiste kanë numëruar, pranuar dhe firmosur rezultatit *live*, në prani të mediave. Quani masakër elektorale zgjedhje në të cilat Kryeministri i vendit e ka marrë vesh rezultatit në të njëjtin kohë me qytetarin më të thjeshtë të Shqipërisë, në të njëjtën sekondë, duke

ndjekur të njëjtat kanale televizive.

Shpallja sërish si armiq të popullit kolektivisht, si në vitin 1947, të komunitetit fisnik të komunës Ruzhdie nuk ju ndihmon. Përkundrazi, i provokuat sërish ata dhe sistemin elektoral që vetë e zgjodhët. Ata dhe sistemi elektoral ua kthyen flakë për flakë, siç i takon një vendi të qytetëruar. Pranoni fakti se komuna Ruzhdie dhe e gjithë Shqipëria ka 20 vjet që është çliruar nga ju! Pranoni faktin që Ruzhdia dhe e gjithë Shqipëria voton me vendosmëri çlirimtarin dhe partinë e tij që i shpëtoi nga ju!

Ndërkohë, gjeni kurajën të bëni betejë të ndershme politike, pa fëlliqur pa asnjë shkak Shqipërinë dhe shqiptarët nëpër botë. Ata nuk ju kanë asnjë faj.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Strazimiri!
Zoti Subashi, keni fjalën.

(Drejtimitin e seancës e ka marrë zoti Turku.)

Armando Subashi – Falemnderit!

Të nderuar deputetë,

Sot Shqipëria po vuan nga një krizë e thellë politike, institucionale, ekonomike, sociale e shtetit të së drejtës dhe zbatimit të ligjit, nga një krizë e thellë besimi dhe shprese te politika dhe shteti. Burimi i kësaj krize të gjithanshme është keqkqeverisja e degraduar deri në shpërdorim, që i ka rrënjët te vjedhja dhe manipulimi i zgjedhjeve të 28 qershorit nga kjo maxhorancë.

Pa asnjë lloj kënaqësie sot jam i detyruar të deklaroj se kjo Qeveri nuk paguan dot në kohë as atë ndihmë qesharake invalidëve dhe shtresave në nevojë. Kjo Qeveri nuk paguan dot në kohë rrogat ndaj gjithë punonjësve të administratës.

Kjo Qeveri është tallur dhe madje u ka fshehur edhe deputetëve të vet kontratën abuzive të privatizimit të OSSH-së, ku çmimi i energjisë elektrike është kthyer në një makth për shqiptarët.

Kjo Qeveri i shpërdoroi lekët e popullit gjatë fushatës, duke hapur një gropë të zezë, ku sot po zhytet përditë ekonomia jonë dhe fitoren e grabitur nga ju po e paguajnë sot familjet që varfërohen çdo ditë e më shumë.

Kjo Qeveri zhyti thellë e më thellë në borxh një numër të madh sipërmarrjesh në punët e fushatës dhe ende sot nuk ka mundësi t'i paguajë, duke i shtyrë drejt falimentimit.

Kjo Qeveri ndryshoi ligjin "Për taksimin e biznesit të vogël" për të mbushur gropën e zezë të buxhetit të shtetit, që vetëm zgjerohet si mallkim i përsëritur nën sundimin tuaj.

Kjo Qeveri ka rritur çdo javë, që prej 28 qershorit, çmimet e jetesës, ka rritur çdo vit papunësinë, duke vështirësuar deri në kufijtë e së pamundurës jetesën e të gjithë familjeve shqiptare.

Kjo Qeveri ka rritur korrupsionin, duke e çuar Shqipërinë poshtë e më poshtë në listën e vendeve më të korruptuara të planetit dhe i gjithë ky degradim që vazhdon përditë e ka zanafillën e vet te korrupsioni elektoral i 28 qershorit.

Në emër të Kushtetutës dhe ligjit na thoni se kutitë nuk mund të hapen, se ka vendime të Kolegjit Zgjedhor, se Parlamenti nuk mund të ndërhyjë në pushtetin gjyqësor e të tjera si këto. Por ne dhe të gjithë shqiptarët kur kujtojmë përpjekjet e hapura për të vënë në diktatin tuaj Presidentin, pushtetin gjyqësor, KLD-në, prokurorinë, median dhe fjalën e lirë, Akademinë e Shkencave, artin dhe sportin, madje historinë dhe gjeografinë e së fundi edhe SHISH-in, e kemi të qartë si dritën e diellit pse ju i mbani peng ato kuti.

Këto ditë e mbarë bota është njohur me rastin Ruzhdie. Ky nuk është një rast i vetëm dhe krim i rastësishëm. Ai tregon më së miri mentalitetin dhe strategjinë në manipulimin e zgjedhjeve, atë që gjendet, për fat të keq, në plot kuti të tjera që ju mbani forcërisht, mekanizmin e korrupsionit elektoral.

Në të gjithë Shqipërinë ka votues që figurojnë sikur kanë votuar atë ditë, edhe pse nuk kanë qenë në Shqipëri. Në të gjithë Shqipërinë ka votues, të cilëve u është falsifikuar firma, numri i kartës së identitetit, numri i pasaportës. Në të gjithë Shqipërinë ka komisionerë, të cilëve ose u është bërë presion, ose u është premtuar shpërblim për t'u palë me ju. Në të gjithë Shqipërinë i është bërë presion administratës për të votuar këtë Qeveri e fotografuar votën, në rast të kundërt do të largoheshin nga puna. Në të gjithë Shqipërinë makineria shtetërore dhe fondet publike u vunë në dispozicion të fushatës suaj me një qëllim të vetëm, marrjen me forcë të fitores, që shqiptarët nuk ua dhanë.

Ja pse Shqipëria meriton të njohë të vërtetën dhe asgjë më shumë sesa të vërtetën. Hetimi i plotë dhe i thellë i zgjedhjeve nga Parlamenti nëpërmjet komisionit hetimor, duke shtuar deri te dokumentacioni zgjedhor brenda kutive, sipas konceptit tonë, duhet bërë në kuadër të dy parimeve shumë të rëndësishme kushtetuese:

1. Në kuadër të së drejtës kushtetuese të çdo individit për t'u informuar për veprimtarinë dhe vendimmarrjen e institucioneve shtetërore, parë kjo

e lidhur ngushtë me detyrimin e tyre për transparencë ndaj publikut.

2. Kontrolli i Kuvendit për zbatimin e ligjit nga organet dhe komisionet zgjedhor me qëllim nxjerrjen e problematikave dhe në këtë kuadër propozimet përkatëse për ndryshime të mundshme ligjore për mospërsëritjen e tyre në të ardhmen.

Gjykata Kushtetuese është shprehur disa herë me vendime të ndryshme lidhur me të drejtën e ngritjes së komisionit hetimor të Kuvendit, qëllimin, përbërjen, fushën e veprimtarisë. Më lejoni të citoj një pjesë të vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr.18, datë 14.05.2003:

“Funksioni i ligjvënësit materializohet nga njëra anë në miratimin e ligjeve dhe nga ana tjetër në ushtrimin e kontrollit mbi pushtetet e tjera, deri në atë masë që ky pushtet zbatohet. Kontrolli parlamentar zbatohet edhe në kuadrin e së drejtës kushtetuese të shtetasve për të marrë informacion në lidhje me çështje të interesit publik. Qëllimi i ngritjes së komisioneve hetimore është për të njohur dhe verifikuar në thellësi një fenomen, ngjarje a veprimtari, me synimin të nxirren përfundime mbi nevojën e miratimit, plotësimit apo korigjimit të ligjeve të veçanta.”

Koncepti ynë është që hetimi të verifikojë problematikën që kanë shoqëruar, veç të tjerash, edhe numërimin e votave, vlerësimin e tyre, mënyrën e pasqyrimin të tyre në procesverbalet përkatëse, përputhshmërinë me numrin e votuesve, respektimin e ligjit në mënyrën e votimit etj. Si mund t'i evidentojmë në këto problematika në rast se nuk hetojmë rreth tyre? Në varësi të tyre komisioni do të bëjë mandje propozimet përkatëse për rregullimet e mundshme ligjore, duke i parë ato edhe në raport me rekomandimet e OSBE-ODIHR-it.

Gjithashtu, komisioni në bazë të ligjit do t'i përcjellë prokurorisë të gjitha të dhënat dhe faktet, do t'i kërkojë ndjekjen e mëtejshme të hetimit në planin penal për çdo individ të përfshirë në krimin elektorale të 28 qershor, që kurrë më të mos ketë komisionerë gangsterë apo që të shtyrë nga mjerimi moral për një grusht parash të firmosin dokumentacion të falsifikuar, që kurrë më të mos ketë numërim të keq dhe shumë të keq në një të tretën e qendrave, që kurrë më të mos ketë shtet të bërë njësh me pushtetin në zgjedhje, siç thotë raporti i OSBE-ODIHR-it, që kurrë më të mos ketë njerëz të trembur, por vetëm njerëz të motivuar për të dhënë votën e tyre.

Nuk ka asnjë pengesë kushtetuese për

miratimin e projektit tonë. Shkaku i vetëm është mungesa e vullnetit politik dhe frika e daljes në dritë të diellit dhe para gjithë opinionit publik e manipulimit të zgjedhjeve të qershorit.

Kërkesa jonë është e rëndësishme për fatet e demokracisë në Shqipëri. Mbajtja e kutive peng në tunelin e errët të krizës së gjithanshme nuk ju shpëton dot nga gjykimi i shqiptarëve, të grabitur në lirinë më elementare. Hapini ato kuti, sepse e vërteta e tyre e gërryen përditë atë tunel që rrezikon të shembet e t'ju zërë brenda bashkë me kutitë! Ky proces do t'i japë fund jo vetëm vjedhjes dhe manipulimit të zgjedhjeve në Shqipëri, por duke vënë politikanët realisht përballë votës popullore do të bëjë të mundur rritjen e përgjegjshmërisë ndaj popullit të klasës politike.

Transparenca e zgjedhjeve në Shqipëri është kthyer tashmë në një domosdoshmëri. Ne jo vetëm e kemi kuptuar këtë, por dhe jemi bërë pjesë e saj. Përvoja njerëzore e largët apo e afërt na kujton se momentin historik nuk mund ta ndalë dot askush. Zgjidhi e merrni! Ose bëhuni bashkë me ne për të ardhmen e vendit, duke hapur kutitë, ose rrinë vetëm bashkë me kutitë e mbyllura.

Falemnderit!

Ardian Turku – Falemnderit, zoti Subashi!

Zoti Nishani, keni fjalën.

Bujar Nishani – Falemnderit, zoti drejtues i seancës!

Në fakt i kam dëgjuar me shumë vëmendje të gjitha diskutimet e kolegëve deputetë, qoftë të maxhorancës, qoftë të opozitës.

E kërkoja fjalën nisur nga një shqetësim, duke konstatuar se sot në Parlamentin shqiptar po tentohet të minohet një çështje fundamentale, një çështje fundamentale e ekzistencës dhe funksionimit të një shoqërie demokratike përmes instrumenteve themelore të përcaktuar në sistemin politik, që ne shqiptarët kemi zgjedhur që pas vitin 1990.

Për fat të keq, sot në Parlamentin shqiptar nga kryetari i opozitës është paraqitur si çështje debati dhënia apo jo e të drejtës së dhunimit të vetë sistemit politik që kemi zgjedhur për shoqërinë tonë. Nga kryetari i Partisë Socialiste sot është përcaktuar si çështje debati në Parlament dhënia e së drejtës se a duhet të kemi në një shtet ligjor apo jo, të debatit se a duhet që shoqëria shqiptare të funksionojë përmes mekanizmit institucional dhe ligjor apo të funksionojë si rezultat i refleksionit të krizës politike të një individi, qoftë ky dhe kryetari i partisë së

opozitës.

Të nderuar kolegë deputetë, ju siguroj që ky rast është i pari dhe i vetmi në tërë historinë e zhvillimit shoqëror të vendeve normale demokratike.

Nuk kam ndër mend aspak që në fjalën time të marr në analizë sesi u zhvilluan zgjedhjet e fundit parlamentare në Shqipëri, sesi u realizuan standardet, se çfarë problematikash u identifikuan, jo vetëm për faktin se si palë interesi unë nuk do të dëshiroja ta bëjë këtë, por më tepër se gjithçka për faktin se vlerësimet, përgjigjet e pyetjeve, konkluzionet dhe rekomandimet mbi atë proces janë paraqitur në raportin përfundimtar të OSBE-ODIHR-it, në raportin e ekipit vëzhgues të Këshillit të Europës, atë të vëzhguesve të Asamblesë Parlamentare të NATO-s dhe në deklaratën e Parlamentit Europian.

Kushdo sot e ka të qartë se kjo nuk është sfida e maxhorancës politike sot. Sfida që ne kemi, dhe besoj e kanë të gjithë shqiptarët, është se a do t'i respektojmë ne si shoqëri, si institucione, si vend, këto institucione të rëndësishme ndërkombëtare, në të cilat shqiptarët janë palë në procesin e funksionimit të shoqërisë së tyre, megjithëse kryetari i partisë së opozitës nuk i njeh dhe i injoron.

Sfida që ne si maxhorancë politike kemi sot është se a do ta konsiderojmë Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë me të njëjtën vlerë dhe rëndësi që ka çdo kushtetutë e çdo vendi demokratik, pavarësisht se kryetari i PS-së imponohet ta dhunojë.

Sfida që ne si maxhorancë politike kemi sot, është se a do t'ia lejojmë vetes ne si menaxherë të hartimit të politikave për funksionimin e shtetit tonë, që shqiptarët të konsiderohen dhe perceptohen si qytetarë jo të njëjtë dhe të barabartë si çdo popull dhe individ i botës normale demokratike, pavarësisht faktit që kryetari i PS-së po përpiqet maksimalisht që ta paraqesë këtë popull si parapolitik, të paaftë dhe jo të gatshëm për shoqërinë e përbashkët evropiane.

Fatkeqësisht, kjo është sfida që zoti Rama përmes kolegëve tanë socialistë na ka hedhur në këtë aulë të debatit politik dhe vendimmarrjes legjislativ. Jam thellësisht i bindur që maxhoranca politike në Shqipëri ka të gjithë pjekurinë, ndien të tërë përgjegjësinë dhe reflekton atë maturi të duhur për të mos lejuar të shkërmoqim atë çka u është dashur shqiptarëve përmes sakrificash të shumta në dekada ta arrijnë. Jam i sigurt se ju kolegë të maxhorancës nuk do ta dorëzoni modelin e shtetit

ligjor tek anarkia.

Ju kolegë të maxhorancës nuk do të lejoni të përkulet modeli kushtetues tek ekstremizmi politik dhe se do të sfidoni çdo imponim të modelit obstruksionist të të bërit politikë përmes vazhdimit të punës sonë të përbashkët për realizimin e reformave për prosperitetin ekonomik të këtij vendi.

Është e vërtetë që sot të gjithë shqiptarët, pavarësisht bindjeve politike dhe qasjes në politikë, kanë një pritshmëri nga kjo maxhorancë politike, nga kjo Qeveri; presin vazhdimin e asaj eksperience të shkëlqyer me modelin tashmë që u kemi prodhuar shqiptarëve në investime të mëtejshme për rrugët, për ujësjellësit, për energjetikën e qyteteve dhe fshatrave të tyre, presin vazhdimin e atij modeli të provuar tashmë të rritjes së pagave dhe pensioneve dhe përkujdesjes sociale, presin realizimin e lëvizjes së lirë, si njerëz të lirë dhe në mënyrë dinjitoze. Presim të konsolidojmë imazhin pozitiv, real që kanë shqiptarët.

Kjo është prova që, fatkeqësisht, përmes një provokimi të motivuar tërësisht nga shkaqe individuale politike të kryetarit të PS-së na është servitur përpos nesh, të gjithë shqiptarëve. Kolegë të nderuar të maxhorancës, nuk është aspak një provë e vështirë, por është një moment të konfirmojmë filozofinë tonë të përparuar mbi modelin e shtetit; të konfirmojmë kulturën tonë politike, ndjesinë dhe përgjegjësinë tonë shtetare, duke krijuar të gjitha hapësirat ligjore dhe demokratike për opozitën, që të ketë maxhorancën e hetimit parlamentar, të ketë maxhorancën, por të mbështetur tërësisht vetëm në përcaktimet kushtetuese dhe, njëkohësisht, duke denoncuar kërcënimin parapolitik dhe obstruksionist të zotit Rama në sy të të gjithë opinionit publik.

Të gjitha procesverbalet e hartuara nga grupet e numërimit të votave ku ju keni pasur anëtarin tuaj, të gjitha tabelat e rezultateve janë përpiluar nga komisioni administrativ i zgjedhjeve. Ju keni pasur anëtarët tuaj mbi 50% dhe maxhorancën në të. Ju kërkuat rinumërim të votave në një zonë të qarkut të Tiranës, duke pretenduar se procesi i rinumërimit ishte i manipuluar për faktin se tavolinat e përdorura në këtë proces rinumërimi ishin të vogla dhe, sipas jush, kjo ishte prova e vetme mbi të cilën ju mbështetët pretendimin tuaj, për të kryer edhe një herë rinumërimi ne votave në këtë qark.

Kaq i vërtetë është ky fakt sa që edhe pas shqyrtimit të ankimeve tuaja edhe në Kolegjin Zgjedhor, KQZ-ja, ku ju keni edhe dy anëtarë që

përfaqësojnë forcën tuaj politike, me të drejtë ka miratuar në mënyrë unanime rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve. Pra, janë komisionerët tuaj, të cilët me votën e tyre kanë certifikuar këtë rezultat, duke legjitimuar përfundimisht procesin e votimit të 28 qershorit, duke i dhënë të drejtën kësaj maxhorance të drejtë vendin edhe për 4 vjet.

Të nderuar deputetë të opozitës,

Fajin e humbjes së zgjedhjeve nuk jua kanë komisionerët. Ndoshta është koha që fajin ta gjeni te vetja dhe te kryetari juaj.

Falemnderit!

(Ndërkohë, drejtimin e seancës e ka marrë zonja Topalli.)

Jozefina Topalli – Ju falemnderit, zoti Nishani! Zoti Naço, urdhëroni!

Nasip Naço – Falemnderit, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Besoj se seanca e sotme duhet të ishte konsumuar rreth 6 muaj më parë, duke i shmangur vendit një krizë artificiale podiumesh dhe sallash, që, gjithsesi, nuk na ka sjellë asnjë përfitim, si maxhorancës ashtu edhe opozitës. Ne sot po diskutojmë për diçka që duhet ta kishim mbyllur kohë më parë dhe duhet të merreshim me atë që aq shumë presin të gjithë shqiptarët, liberalizimin e vizave. E kam të qartë se nga ana e kolegëve të opozitës nuk ka asnjë lloj interesi se çfarë mund të diskutohet sot këtu, në Kuvend, sepse vendimi është marrë pak ditë më parë nga kryetari i opozitës, fjalët e të cilit, në formë kërcënimi, nuk i bëjnë nder as atij e as grupit të tij parlamentar.

Të nderuar deputetë të opozitës, keni disa muaj të luftoni e deklaroni se procesi i votimit të 28 qershorit është i manipuluar, por, mesa duken gjasat edhe këtë radhë përpjekja juaj nuk është e sinqertë, pasi qëllimi i vërtetë i kërkesës së bërë nga ana juaj nuk është hetimi i zgjedhjeve, por të bindni elektoratin tuaj se nuk i keni humbur zgjedhjet e shpallura nga institucionet përgjegjëse për institucioni zgjedhor në Shqipëri dhe të certifikuarat tashmë edhe nga faktori ndërkombëtar.

Ju vetë, zotërinj të opozitës, keni qenë të bindur se që në datën 29 qershor nuk i keni fituar zgjedhjet dhe ju jeni në opozitë deri në vitin 2013, pavarësisht se disa nga ju veshën edhe kostumin e ministrit. Kryetari juaj ishte entuziast pas zgjedhjeve dhe pa dalë akoma rezultati përfundimtar, duke i quajtur ato më të mirat dhe është po ai që i përfoli më pas, duke thënë se nuk i njeh. Ishte po i njëjti kryetar që tha: Bojkot zgjedhjeve të vjedhura, pastaj po ky tha

se ne i njohim zgjedhjet vetëm ligjërisht dhe jo moralisht. Sot, po ai thotë: O bëni atë që dua unë, o vendi do të kalojë në krizë dhe nuk do të ketë stabilitet.

Në këta muaj janë përfolur dhe akuzuar me dhjetëra njerëz, por unë dhe shumë këtu, ndiejmë keqardhje mbi përbaltjen që u është bërë komisionerëve dhe në veçanti atyre socialistë nga vetë kryetari i tyre. Lidhshipi juaj ka mbi 6 muaj që po hedh baltë mbi komisionerët tuaj se gjoja ata kanë qenë shkaktarët e vërtetë të kësaj humbjeje, duke i etiketuar ata si tradhtarë dhe njerëz të shitur dhe të manipuluar, duke rënduar dhe ndërtuar një alibi që edhe shumë prej jush, që hynë rishtas në politikë, nuk e besojnë.

Jo vetëm kaq, por lidhshipi i PS-së ka pasur në dispozicion gjithë kohën e nevojshme për të paraqitur para opinionit publik, qoftë edhe një emër komisioneri, ku të provonte pretendimet e tij për shitje dhe manipulim të rezultatit zgjedhor. Ju garantuat gjithë opinionin publik dhe forcat politike që nuk ishin të përfaqësuara në komisionet që administronin procesin e votimit, ato në koalicion me ju dhe jashtë saj, që komisionerët tuaj do të mbronin jo vetëm votat e PS-së, por edhe të aleatëve të saj, pra edhe të partive që nuk kishin komisionerë, ku bënte pjesë edhe LSI-ja.

Duke qenë dëshmitar okular i procesit të numërimit të votave në qarkun e Beratit, deklaroj me përgjegjësi morale dhe ligjore se do të ishte një nder i madh për mua dhe forcën politike që përfaqësoj, që komisionerët e subjektit tuaj politik të ishin komisionerë të forcës sonë politike, pasi vlerësoj lart përkushtimin, devotshmërinë, integritetin e tyre moral dhe ligjor, të shfaqur në procesin e numërimit të votave në qarkun e Beratit.

Nëse në zgjedhjet e tjera politike ju nuk do t'i merrni këta komisionerë në komisionet e votimit, unë u bëj atyre një ftesë publike, që po e ndiejnë veten të fyer nga politika juaj, duke shprehur gatishmërinë për t'i përfshirë në këto komisione si përfaqësues të LSI-së në qarkun e Beratit.

Të nderuar kolegë, parimisht, LSI-ja është dakord me ngritjen e këtij komisioni hetimor, pasi kërkesën e bërë nga opozita për hetimin e zgjedhjeve e konsideron si një të drejtë kushtetuese të opozitës parlamentare. Por, ajo që ne na ndan në këtë kërkesë të opozitës është e drejta për hetim brenda kuadrit kushtetues dhe në përputhje me vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Lidhur me këtë kërkesë, po ju jap disa opinione.

Në Komisionin e Ligjeve, në disa seanca ne debatuar me ju, zotërinj të opozitës, në lidhje me projektligjin e paraqitur, duke e konsideruar plotësisht të ligjshëm që dhe ne të paraqitnim objeksionet tona në lidhje me kërkesën tuaj. Pas disa seancash debati, ne, përfundimisht, ramë dakord në parim, për ndryshimet e ligjit, të paraqitura nga ana juaj, duke e lënë debatin të hapur, për ta diskutuar atë në seancat e radhës, në diskutimin nen për nen. Por, çfarë ndodhi? Ju, sapo u paraqitët amendamentet nga një grup deputetësh të maxhorancës, u larguat nga Komisioni i Ligjeve, duke vënë kushtin që komisioni të fillonte të diskutonte nga neni 4, një kusht absurd ky, i vendosur nga ju, duke vazhduar e kërcënuar me letrën e hapur të kryetarit tuaj se do të vazhdohet me bojkot e protesta në rast mospranimi të tyre.

Ju nuk kishit kurajën në Komisionin e Ligjeve që të kundërshtonit amendamentin e nenit 1 të paraqitur nga deputetë të maxhorancës, ku kërkohet të sanksionohet se në veprimtarinë e tyre, komisionet hetimore të Kuvendit janë të detyruara të respektojnë parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve, që komisionet nuk mund të kenë objekt dhe as mund të hetojnë çështje të gjykuara nga gjykatat e vendit, nuk mund të kenë objekt dhe as mund të hetojnë çështje, fakte apo kompleks faktesh, për të cilat është regjistruar kallëzim penal në prokurori ose kur këto të jenë në shqyrtim gjyqësor. Këto parashikohen mjaft mirë dhe mjaft qartë në vendimin nr.18, datë 14.05.2003 të Gjykatës Kushtetuese.

Ju nuk kishit kurajë dhe u larguat nga Komisioni i Ligjeve pasi kërkonit që afati i hetimit të jetë 24 muaj. Nëpërmjet kësaj dispozite ju kërkonit që ky komision të funksionojë në një periudhë 24-mujore, pra 2 vjet, që, sipas mendimit tim, kjo është një kërkesë e qartë me paramendim, qëllimi i vetëm i së cilës është gjetja e shkakut për të braktisur Kuvendin, ose në rastin më të keq, mbajtjen nën presion të maxhorancës dhe transferimin e krizës nga lidhshipi juaj në Kuvend e më tutje, e cila mund të ndikojë në procesin e liberalizimit të vizave.

Sipas nenit 2 të paraqitur nga maxhoranca është kërkuar që afati i hetimit të jetë 3 muaj, në përputhje kjo me Kodin e Procedurës Penale, duke e konsideruar këtë afat plotësisht të mjaftueshëm për të bërë transparencën e kërkuar prej jush për zgjedhjet parlamentare dhe duke shpresuar që të mos gjejë zbatim shprehja që qarkullon tashmë: "Nëse do të mbyllet kjo çështje, krijo një komision

hetimor parlamentar dhe zvarrite sa të mundesh, madje dhe 24 muaj".

Ju kërkonit, sipas nenit 3 të projektligjit të paraqitur nga ana juaj, të keni shumicën e anëtarëve të këtij komisioni dhe këtë shumicë ta merrni në tavolinë me vullnetin politik të maxhorancës. Po ju pyes publikisht: A do ta keni ju vullnetin e duhur politik, që grupi juaj parlamentar të votojë që LSI-ja të ketë në këtë komision sekretarin administrativ dhe atë teknik? Kam këtu parasysh faktin e zgjedhjes së sekretarit të komisionit, ku në ligj parashikohet se ai zgjidhet me votim të thjeshtë të të gjithë anëtarëve. Në këtë rast, ndryshe nga ju, të nderuar kolegë socialistë, ne, përveç të drejtës ligjore, kemi edhe të drejtën morale, një kërkesë të tillë, duke sjellë në vëmendje përpjekjet tuaja për ta përjashtuar LSI-në nga procesi i administrimit të zgjedhjeve, ku dhe ajo të kishte anëtarin e vet në komisione.

Natyrshëm, që pika kyçe rreth së cilës silllet prej 6 muajsh kryetari juaj është kërkesa e paraqitur sipas nenit 4 të këtij projektligji, që objekti i punës së këtij komisioni të jetë publikimi i një apo disa dokumenteve zgjedhore. Të nderuar zotërinj deputetë të opozitës, përveç afatit 24- muajsh të ushtrimit të veprimtarisë së komisionit, kërkonit të publikoni një apo disa dokumente zgjedhore dhe ky është dhe qëllimi juaj i vërtetë, sa kohë që kryetari juaj nuk është në Parlament; ky është qëllimi politik që ju kërkonit t'i jepni kryetarit tuaj dhe ushqimi që i mungon, pasi, shpeshherë, disa prej jush i përdor edhe si fasadë në daljen e tij para PS-së që të mbajë nën presion maxhorancën dhe transferimin e krizës nga lidhshipi juaj në Kuvend dhe, mundësisht, të pengojë liberalizimin e vizave. Në nenin 4 të këtij projektligji ju kërkonit që komisionit hetimor t'i jepni me shumicë votash të drejtën për hapjen e një apo disa kutive, duke kryer dhe rinumërim. Nëpërmjet kësaj kërkesë ju kërkonit ta shndërroni komisionin parlamentar në një grup numërimi, duke i dhënë atij atributet, të cilat Kushtetuta dhe Gjykata Kushtetuese, me vendimet e saj, ia njej vetëm institucioneve të pavarura, siç është KQZ-ja dhe Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit, Tiranë.

Të nderuar zotërinj deputetë, ju po kërkonit të përgjithësoni disa probleme të konstatuara nga organi i prokurorisë së rrethit Fier, gjatë hetimit të rezultatit të një qendër votimi, në fshatin Ruzhdie, duke dashur ta konsideroni atë si një fenomen që ka shoqëruar gjithë procesin e votimit. Ne ju bëjmë thirrje, që, nëse keni prova, ku të vërtetoni se

rezultatet dhe në ndonjë qendër tjetër votimi janë të manipuluar, të dërgoni sa më shpejt të jetë e mundur, duke lënë mënjanë retorikat boshe, këto fakte dhe këto prova pranë organit të prokurorisë, si një organ kushtetues i specializuar për proceset hetimore, me qëllim vënien përpara drejtësisë të gjithë atyre komisionerëve që kanë guxuar të hedhin rezultate të manipuluar në procesverbale. Ju nuk e bëni një gjë të tillë, pasi nuk keni asnjë provë që të provoni pretendimin tuaj.

Ju kërkoni hapjen e kutive, duke pretenduar se fletët e votimit të gjendura në kuti janë prova e nevojshme, por unë do t'u thosha se komisionerët tuaj kanë pasur të gjithë të drejtën ligjore për të pasqyruar në tabelat e rezultateve kundërshtimet në lidhje me përmbajtjen e tyre. Ju kërkoni rinumërim të votave edhe në ato zona, ku PS-ja ka pasur maxhorancën e komisionit, si në disa zonat Qarkut të Beratit dhe, për ironi të fatit, këto tabela janë të firmosura unanimisht.

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Naço!

Zonja Shegush Ligori, urdhëroni!

Shegush Ligori – Falemnderit, zonja Kryetare!
Të nderuar kolegë,

Sot nuk ka njeri dyshimin më të vogël se vendi ndodhet në një krizë të thellë dhe të shumëfishtë. Kriza politike e institucionale bashkëshoqërohet nga kriza e rëndë ekonomike që po ndihet në mënyrë dramatike në çdo shtëpi shqiptari. Refuzimi, së fundmi, i vërejtjeve të miqve e partnerëve tanë të mëdhenj të SHBA-së për ligjin e SHISH-it është shprehja kuptimplote e një arrogance qeverisëse në përshkallëzim që e ka burimin te grabitja e votës së shqiptarëve.

E gjithë kjo krizë shumëplanëshe faturash që rriten për familjet shqiptare, vjen prej tronditjes nga themelet e sistemit demokratik të zgjedhjeve përmes këtij mekanizmi korrupsioni që siç gllabëroi votën e shqiptarëve më 28 qershor, po gllabëron Shqipërinë pas 28 qershorit.

Sot është më se e qartë që opozita e hodhi hapin e saj të fundit drejt kompromisit pas njohjes së rezultatit hyrjes së saj në Parlament, paraqitja e amendamenteve në Komisionin e Ligjit dhe vënia jonë në dispozicion të plotë të zgjidhjes ishin detyrimi ynë karshi njerëzve tanë dhe partnerëve ndërkombëtarë.

Ndonëse personalisht pata një lloj mosbesimi për rezultatin final të bisedimeve, shpresa se kompromisi i shumëpritur mund dhe duhej të gjendej, na bëri të punonim shumë seriozisht për

sistemimin e argumenteve ligjore me qëllim që t'i bënim kundërshtarët tanë që zgjidhja të qëndronte e thjeshtë në vullnetin e tyre për të lexuar drejt Kushtetutën dhe ligjet e vendit.

Sot jam e bindur se përmbushim me përkushtim detyrimin tonë me gjithë keqardhjen për pozicionet aspak profesionale, aspak juridike, aspak europianizuese, por vetëm politikisht qorrazi palës tjetër që i frikësohet transparencës si të ishte fundi i botës.

Kush e ka parë se çfarë kanë bërë në Ruzhdie dhe njësoj si në Ruzhdien e Fierit dhe në plotë Ruzhdie të tjera nga Tropoja në Sarandë, e kupton se transparenca në fakt është fundi i një bote të ngritur mbi gënjeshtër, mbi presionet, mbi korrupsionin e përbetimet për luftë ndaj korrupsionit, fundi i botës së një politike të vjetër që sundon shqiptarët me vota të vjedhura e kuti të mbyllura me fjalë të bukura e vepra të ulëta.

Gjatë punimeve të komisionit me shumë durim u përpoqëm të argumentonim se duke kërkuar ngritjen e komisionit hetimor parlamentar për çështjen e veçantë të hetimit të zgjedhjeve, një çështje me interes të dorës së parë për publikun, ne nuk kërkojmë asgjë më tepër se një të drejtë të patjetërsueshme të pakicës në një sistem demokracie e funksionale.

Gjithashtu, theksuam se e drejta jonë për të disponuar lirisht mbi objektin e hetimit pa u kushtëzuar nga shumica është një e drejtë elementare në çdo sistem të ndërtuar mbi sundimin e të drejtës dhe të ligjit. Këto të drejta thelbësore themeli dhe kuptimi i transparencës së domosdoshme, u rrëzuan pa asnjë argument të vetëm profesional e juridik, por vetëm me vijën e partisë.

Argumentuam që, megjithëse vendimet e KQZ-së dhe të Kolegjit Zgjedhor në çdo vend demokratik do të konsideroheshin një turp me T të madhe, ne nuk kemi synimin që të hetojmë aspak drejtësinë apo kundërligjshmërinë e vendimeve të KQZ-së apo të Kolegjit Zgjedhor. Pranuar në mënyrë të qartë se këto vendime na pëlqejnë ose jo, e kanë mbyllur procesin zgjedhor në Shqipëri në kuptimin e ndarjes së mandateve dhe e kanë certifikuar rezultatin zyrtar të zgjedhjeve. Vazhduam të dëgjojmë gjëra që janë të pakonceptueshme për njerëz me diplomën e juristit.

Theksuam se nuk synojmë aspak ushtrimin e kontrollit parlamentar në veprimtarinë juridiksionale të Gjykatës Zgjedhore, pasi jemi pozicionuar qartë

në qëndrimin kushtetues dhe ligjor që vendimet e gjykatave mund të ndryshohen vetëm nga një autoritet më i lartë gjyqësor. Nuk synojmë dhe këtë e përsëritëm qartë as të marrim përsipër atributet prokurorisë, duke ushtruar funksionet që Kushtetuta dhe ligji ia njohin ekskluzivisht organit të akuzës. Absolutisht, është e kotë deri tani.

Nga ana tjetër, nuk ka asnjë vesh profesional për të dëgjuar, por vetëm gojë që përsërisin sharvia e partisë dhe e veja e partisë. Ju vumë me dije se teoria e vendimeve gjyqësore që, gjasme, e ndalojnë administrimin e dokumenteve zgjedhore si provë, është një teori që mund të vijë nga pushteti i partisë, por nuk ka asnjë lidhje me pushtetin e Kushtetutës dhe të ligjit. Nuk ka dhe nuk mund të ketë vendim gjykate që të pengojë organin përfaqësues të pushtetit të popullit, Parlamentin që në emër të transparencës dhe të drejtës kushtetuese për informim, të kontrollojmë mënyrën se si zbatohet në këtë vend ligjet që ai nxjerr duke administruar me cilësinë e provës dokumente zyrtare që ndodhen të kyçura në kutinë e votimit dhe të materialeve zgjedhore. Por frika e madhe që ka prodhuar gjithë këtë teori qesharake jo vetëm anti-juridike, por edhe antidemokratike për të mos hapur kutitë e 28 qershorit nuk u lë shteg kolegëve tanë për dëgjim e reflektim.

Doktoraturat e nihilistëve të palës tjetër ia kanë lënë vendin frikës së madhe, frikës së madhe të pushtetit nga e vërteta e atyre kutive.

Theksuam e ritheksuam se qëllimi i hetimit në komisionet hetimore parlamentare ndahet qartë nga funksionet që kryejnë organet e tjera të pavarura të shtetit. Posaçërisht ju bëmë të qartë se qëllimi i këtij hetimi është të verifikojë zbatimin e ligjshmërisë gjatë procesit zgjedhor të kontestuar më 28 qershor. Identifikimi i problemeve, gjetja dhe propozimi i zgjedhjeve ligjvënëse për të mos lejuar përsëritjen e tyre në proceset e ardhshme zgjedhore, gjetjen dhe ndriçimin e përgjegjësive lidhur me shkeljet mbi natyrat administrative penale dhe dërgimin e tyre për ndjekje të mëtejshme organeve përgjegjëse duke përfshirë edhe prokurorinë.

Çfarë do të realizojë, në fund të fundit, ky proces hetimor parlamentar? Ai do të rivendos autoritetin e Kuvendit si mbajtës i sovranitetit të popullit, për të bërë transparencën e zgjedhjeve duke i hapur rrugë krimit të një precedenti fatlum në mbrojtje të çdo pakice paszgjedhore për të verifikuar pa asnjë paragjykim vullnetin e popullit të mishëruar në vend.

Vetëm ky është ilaçi parandalues që do të fshijë

edhe nga kronikat paszgjedhore të këtij vendi modelin e shëmtuar të Ruzhdies, listat e trukuara të zgjedhjeve, kartat e identitetit të falsifikuara dhe vjedhjen e identitetit të mërgimtarëve. Ky dhe vetëm ky do të ishte ilaçi parandalues që do të paralizonte çdo plan ogurzi të pushtetit, për të lëshuar kriminelët si qentë nga zinxhiri nëpër qendrat e votimit dhe për të kanosur dhe blerë komisionerë me para të qelbura korrupsioni qeveritar.

Si deputete e një qyteti të traditave më të mira shqiptare, si vajzë Elbasani dhe si grua e përfshirë për herë të parë në politikën e politikanëve, jam ndier keq kur kam përjetuar gjithë këto turpe në kurriz të qytetarëve të thjeshtë, për të deformuar me çdo mjet vullnetin e tyre për ndryshimin e një Qeverie të mbytur në korrupsionin që solli Gërdecin, që shembi vepra publike e përmbyti me dhjetëra e mijëra hektarë, që u çon njerëzve fatura tronditëse për drita e ujë dhe që e ka bërë jetesën më të shtrenjtë se kurrë jashtë çdo mundësie për familjet shqiptare.

Transparenca që kërkojmë është ilaçi që asgjëson korrupsionin elektorale dhe bën që kandidatët në fushatat e ardhshme zgjedhore të përqendrohen në temat që shqetësojnë komunitetin dhe jo të humbasin kohën e çmuar elektorale për gjetjen e mjeteve që kontrollojnë e paralizojnë planet kriminale për manipulimin e vullnetit të popullit.

Të gjitha argumentet tona u përplasën me një megafon që përsëriste pa pushim se Kushtetuta dhe ligjet e vendit nuk lejojnë hapjen e kutive të hetimit. Nuk është e vërtetë! Përkundrazi kufizimi i mjeteve të opozitës për të hetuar dhe për të bërë transparencë gjithë procesin zgjedhor është një atentat i pastër kundër Kushtetutës së vendit. Pse? Sepse i madh dhe i vogël sot e ka kuptuar që brenda atyre kutive, prej 6 muajsh, mbajnë fshehur gjurmët e krimit zgjedhor të 28 qershorit. Ndaj mbahet mbyllur edhe rruga e zgjidhjes për të kapërcyer krizën.

Është rasti që të theksoj se llogaritë e këtij pushteti me popullin opozitar mbeten të hapura. Refuzimi këmbëngulës i atyre që grabitën zgjedhjet për të bërë transparencë mekanizimin e grabitjes, nuk mund të pengojnë Shqipërinë të ndahet nga krimi elektorale përmes protestës popullore me qëndrimin tuaj kokëfortë.

Ju të nderuar kolegë, po ndillni erën. E mbollët erën vërtetë, por duke marrë përsipër të mbani fortësisht deri në fund ato kuti, do të merrni përgjegjësinë të korni furtunën e popullit opozitar, që do t'u kundërvihet me dinjitet e forcë të paparë

pushtetit që po e keqpërdorni pa e pasur pëlqimin e tij përmes votës.

Shqipëria nuk mund të paguajë më për një pushtet që ka grabitur votën për të grabitur Shqipërinë. Nëse ju doni të rri në pushtet jo vetëm pa votën e popullit, por edhe duke treguar se doni që ta grabisni atë përsëri, atëherë populli do t'ju heqë të drejtën për ta ushtruar këtë pushtet. Si protagonisti i një historie që kemi jetuar, të gjithë ju duhet të mos keni sot inat me historinë që kërkon fundin e manipulimit të zgjedhjeve në Shqipëri.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zonja Ligorli!
Zoti Basha, urdhëroni!

Lulzim Basha – Falemnderit, zonja Kryetare!
Të nderuar zonja e zotërinj deputetë,

Kemi kaluar mbi 5 orë e gjysmë në këtë debat dhe mendoj se kemi ardhur në pikën e përsëritjes, ripërsëritjes, monotonisë, mërzisë dhe shterimit të plotë të ideve. Ndaj dua të shtroj një pyetje në vend të një fjalimi përsëritës. Për çfarë jemi këtu sot? Vërtet keni ardhur me vullnetin e sinqertë për të gjetur një zgjidhje? Apo keni ardhur për të gjetur alibinë e radhës, sepse nuk i japim një zgjidhje këtij problemi? Nëse keni ardhur për zgjidhje, baza e konsensusit tashmë është dhënë që në shtator nga maxhoranca, nëpërmjet Kryeministrit Berisha, i cili ofroi opozitës shumicën në komisionin hetimor. Është konfirmuar edhe nga Komiteti Presidencial i Këshillit të Europë, ku ju varët shumë shpresa. Ejani, pra, në qoftë se me të vërtetë vini për një zgjidhje, duke pranuar lëshimin e maxhorancës, ose të paktën duke propozuar ato amendime, të cilat sanksionohen edhe nga propozimet e KE-së.

Por a keni ardhur këtu sonte për një zgjidhje? Kjo është një pyetje, të cilës unë në këtë moment nuk mund t'i përgjigjem, sepse folës pas folësi përfaqësuesit e opozitës vazhdojnë të insistojnë për atë që e quajnë krim elektoral.

Cili është krimi elektoral? Sa herë të flisni për krimin elektoral edhe ne nuk do të lodhemi t'ju përsërisim faktet kokëforte që sot i di e gjithë bota. Ku qëndron mungesa e transparencës? Të 20 mijë komisionerët tuaj, ku asnjëri prej të cilëve nuk firmosi asnjë vërejtje të vetme në procesverbalin e 28 qershorit? Të 30 mijë vëzhguesve tuaj, ku asnjëri prej të cilëve nuk depozitoi asnjë ankesë, apo të 140 kandidatëve tuaj, që ashtu sikundër kandidatëve tanë e gdhinë dhe e ngrysën pranë qendrave të votimit?

Ku qëndron krimi elektoral? Si mundet që

OSBE-ODIHR-i e sanksionoi këtë krim elektoral si zgjedhje demokratike, që plotësuan angazhimet kryesore të Shqipërisë përballë OSBE-ODIHR-it. Si mundet që përfaqësuesi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Këshillin e OSBE-së të përgëzonte qytetarët shqiptarë dhe Qeverinë shqiptare për këtë arritje? Si mundet që kjo të sanksionohet nga të gjitha organizmat ndërkombëtarë, euroatlantike, ndërkohë që përbënte një krim elektoral, sipas jush?

Në qoftë se është krim, ku janë provat? Doli kryetari i grupit tuaj këtu dhe paraqiti karta identiteti që pretendoi se ishin false. E ftova dhe e sfidova ti çonte në Prokurori, por nuk i çoi. Tani do të jetë i detyruar t'i çojë dhe të japë llogari se si i mori, kush i prodhoi? Janë me të vërtetë apo jo false?

Ju thoni se keni prova për krim elektoral, kur e vetmja tentativë për krim, natën e zgjedhjeve dhe natën pas saj, ishte tentativa e turpshme e diriguar nga deputetët e sapobetuar që si *hezbollahë* mundonin të eksitonin turmat në Fier për të linçuar dy zonja të nderuara.

Keni ardhur për zgjidhje apo për alibi? Nëse keni ardhur për zgjidhje, ne ju kemi dhënë gjithçka që maxhoranca mund t'ju ofrojë, shumicën dhe vullnetin për të sanksionuar me votën e maxhorancës çdo amendim tuajin që kalon sitën e organizatave ndërkombëtare, që ju vetë i thirrët si arbitër, por i përzutë, pasi nuk pranuat asnjë prej sugjerimeve të tyre.

Frika ime dhe dyshimi im i madh është se sot ju nuk keni ardhur këtu për zgjidhje. E thatë dje, për herë të fundit, por e keni thënë edhe më parë, nuk ka kompromis, nuk ka negociata me këtë Qeveri. Nuk ka negociata pa hapur kutitë, por ju doni diçka që ne nuk e kemi, diçka që ne nuk mund t'ju japim. Nuk mund t'ju japim edhe po të duam t'ju japim, sepse s'na përket ne dhe që t'ju japim ne duhet ta bashkëvendësojmë me ju sovranin, duke shkelur kështu mbi dokumentin themeltar të shtetit. Në këtë mënyrë ju po na ftoni sot që ne së bashku të kryejmë një krim kushtetues. Nëse ky Parlament e bën këtë hap, nëse kjo maxhorancë e pranon këtë propozim, atëherë ky Parlament nuk ka të drejtë të ekzistojë më as edhe një sekondë të vetëm, sepse në këtë mënyrë ky Parlamenti kthehet në kërcënimin më madhor për demokracinë dhe rendin kushtetues të këtij vendi. Ai e meriton të shpërndahet para se ta bëjë këtë ndryshe gjithçka që ky vend ka njohur në këto 20 vjet qëndron përpara një humnere të thellë.

Mënyrat për të arritur zgjidhjen që ju pretendoni se doni të arrini tashmë janë mbi tavolinë, të

sanksionura nga maxhoranca, të sanksionura nga Këshilli i Europës, qoftë kjo nëpërmjet ligjit të mendimet përkatëse, qoftë nëpërmjet ofertës sonë për të çuar në prokurori çdo fakt tjetër që ju dispononi, por thelbi dyshoj, kam frikë, jam i bindur është se ju nuk keni interes në këtë ofertë, se ju nuk kërkon kompromis, se ju nuk kërkon zgjidhje të këtij problemi.

Duke vënë një kusht të cilin ju e dini se ne nuk mund ta realizojmë pa u bërë bashkëfajtorë në një krim kushtetues, duke e ditur këtë, dhe këtë e keni ditur gjithmonë, ju keni ardhur këtu për një alibi tjetër. Ju ndodheni këtu rastësisht dhe pa dëshirën tuaj, sepse e vetmja arsye për të qenë sot në Parlament është konsekuencë e prezencës suaj për të mos djegur mandatin tuaj kushtetues. Kam frikë, kam bindjen se ju tashmë e keni marrë një vendim dhe vendimi është se duke qenë përballë vendimit të një maxhorance për të respektuar Kushtetutën, të bëni gjithçka ç'është e mundur për të shpëtuar Edi Ramën nga katastrofa e zgjedhjeve lokale, katastrofë që e pret në mënyrë të sigurt për shkak të papërgjegjshmërisë së tij politike dhe për shkak të matematikës elektorale që ne dimë ta bëjmë dhe ju dini ta bëni dhe e keni bërë. Ndaj kjo farsë e sotme politike këtu në këtë Parlament nuk është gjë tjetër veçse një harxhim kohe, një provë e nënshtrimit total tuajit dhe papërgjegjshmërisë historike të një individi që ju mban peng.

Qofsha i gabuar për çfarë kam thënë! Më provofshi të gabuar! E uroj këtë me gjithë zemër!

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Basha!
Urdhëroni, zoti Balla!

Taulant Balla - Zonja dhe zotërinj,

Ky që sapo foli u ka kushtuar qytetarëve shqiptarë 230 milionë euro.

Refuzimi i kësaj maxhorance për të hetuar atë çka ka ndodhur më 28 qershor përbën provën më të qartë se Kryeministri nuk është i interesuar në zgjidhjen e krizës së thellë politike dhe institucionale në vend, provon gjithashtu se në ato kuti fshihet një masakër elektorale me përmasa të tmerrshme manipulimi.

Zoti Kavalier, në seancën e parë që ne shkelëm në këtë Parlament, kryetari ynë i grupit parlamentar ju bëri një sfidë të hapur dhe të ndershme, duke kërkuar transparencën vetëm në kutinë e Ruzhdies, tek e cila ju lidhët fatin e shumicës tuaj pa Ilir Metën, pa qenë në dijeni të të dhënave, por me bindjen e plotë se informacionet tona janë tërësisht të sakta,

dhe janë të lidhura me një grabitje me përmasa skandaloze më 28 qershor.

Tashmë që e vërteta e Ruzhdies doli në dritën e diellit, prej saj dolën të dhëna të tmerrshme të grabitjes elektorale. Në Ruzhdie, nga ballafaqimi i numrave të serisë së pasaportave dhe të kartave të identitetit të zgjedhësve të shënuara përbri emrit, rezultoi se ishin shënuar 325 numra identiteti të falsifikuar (nga 525 votues), të cilat nuk përputhen me numrat e pasaportave dhe të kartave të identitetit dhe se një numër zgjedhësish nuk janë të pajisur as me pasaporta dhe as me karta identiteti.

Në Ruzhdie njerëzit tuaj, zoti Kavalier, shënuan 164 numra pasaporte të falsifikuara. Gjithashtu, u shënuan 161 numra kartash identiteti të falsifikuara. Pra, vetëm në një kuti votimi, nga disa mijëra në Shqipëri, rezultoi se 60% e numrave të identifikimit të votuesve janë të falsifikuara. Por si kutia e Ruzhdies ka edhe në qarkun e Elbasanit, sikurse ka në të gjithë Shqipërinë, sepse mekanizmi i korrupsionit implikoi në manipulim komisionerë të varfër, të cilët në qendra të caktuara shitën firmën e tyre përkundrejt parave të korrupsionit të Lulit të Saliut.

Këto raste manipulimi nuk mund të njollosin emrin dhe dinjitetin e atyre qindra komisionerëve të ndershëm socialistë në qarkun e Elbasanit, por është në detyrimin tonë të panegociueshëm që edhe për kutitë e Elbasanit të zbardhet e vërteta e 28 qershorit.

Zonja dhe zotërinj,

Për të gjithë shqiptarët tashmë është e qartë se skema e përdorur në Ruzhdie është një skemë e mirëllogaritur, e parapërgatitur dhe e drejtuar direkt nga Sali Berisha. Sipas kësaj skeme manipulimi janë falsifikuar të paktën 70 mijë numra identifikimi të zgjedhësve. Pra, Sali Berisha ka falsifikuar 70 mijë numra pasaportash dhe kartash identiteti.

Sipas kësaj skeme manipulimi, rezultojnë të kenë votuar në të gjithë Shqipërinë mbi 50 mijë votues emigrantë, të cilët nuk kanë qenë fare në Shqipëri më 28 qershor 2009.

Zoti Kryeministër, është koha t'u tregoni shqiptarëve se përse gjashtë muaj para zgjedhjeve punonjësit e Policisë Kriminale në të gjithë Shqipërinë filluan të bredhin lagje më lagje e derë më derë për të evidentuar emrat e emigrantëve për çdo qendër votimi.

Zoti Kryeministër, a u përdorën këto lista të Policisë Kriminale si votues fiktivë më 28 qershor?

Zoti Kryeministër, është koha të sqaroni lidhjen tuaj direkte me 70 mijë numra identiteti të falsifikuar.

Nëse je i sigurt se në kuti nuk fshihen numra identiteti të falsifikuar, atëherë prano hapjen e kutive. Kjo është mënyra e vetme për të sqaruar shqiptarët, por edhe partnerët ndërkombëtarë të Shqipërisë që sistemi ynë i identifikimit është i saktë dhe i padënueshëm.

Zonja dhe zotërinj,

Në legjislaturën e kaluar ne deputetët e Partisë Socialiste paraqitëm një kërkesë për ngritjen e një komisioni hetimor që do të hetonte pasuritë e familjes tuaj, zoti Kavalier.

Ju dhe partia juaj e refuzuat këtë kërkesë, në shkelje të të drejtave që opozitës ia njeh Kushtetuta dhe ligji. Nuk kishte vendim gjykatë për të hetuar pasuritë tuaja, por ju e mohuat këtë të drejtë të opozitës,

Pra, ju, zoti Kavalier, nuk pranoni as t'ju hetojmë pasurinë dhe as të hetojmë se si e keni marrë pushtetin.

Pse keni frikë? Siç duket kërkesat tona kanë një gjë të përbashkët.

Hapja e kutive do të nxjerrë në dritë jo vetëm mekanizmin e vjedhjes së votave, por njëkohësisht hapja e kutive do të zbardhë sistemin korruptiv të familjes me fazliçët dhe megakompanitë, që kujtuan dhe kujtojnë se vjedhja e pushtetit mund të jetë garancia e vetme e parave dhe pasurive të pista.

Debati për hapjen e kutive ka vënë përballë, familjen e Sali Berishës me familjet e të gjithë shqiptarëve, që vuajnë sot varfërinë dhe efektet e një krize ekonomike të thellë.

Nga njëra anë është një familje që synon të mbrojë pasurinë duke mbajtur me forcë pushtetin, në anën tjetër janë qindra mijëra familje shqiptare që paguajnë direkt faturën e keqkverisjes së familjes kryeministore.

Debati për hapjen e kutive ka vënë përballë një familje të vetme, e përzierë në të gjitha aferat e pislleqet, me familjet e varfra të shqiptarëve që grabiten përditë po nga kjo familje.

Hapja e kutive mban peng të vërteta të mëdha, për krime të tmerrshme. Hapja e kutive do të nxjerrë të vërtetën e lidhjes së familjes me Gërdecin, do të zbardhë urdhrat që vodhën dhe më pas sabotuan tunelin e Kalimashit, do të zbardhë edhe procesverbalet teknikë të hidrocentraleve mbi Drin, ku për hir të qëllimeve të pastra korruptive u ndal prodhimi i energjisë dhe u fry cunami që mbyti Shkodrën, do të zbardhë edhe politikën tënde

hakmarrëse përkundrejt minorëve, ish-ushtarakëve, mësuesve të hedhur në rrugë, sepse nuk votojnë për ty zoti Kavalier.

Hapja e kutive do të zbardhë makutërinë dhe hajdutërinë e tokave, ku në çdo rast del e implikuar familja dhe oborrtarët. Hapja e kutive është e vetmja mënyrë për të çmontuar këtë skemë të tmerrshme korruptive.

Çlirimi i zgjedhjeve nga korrupsioni është çlirimi i zgjidhjeve për shqiptarët. Sot është dita e caktuar dhe momenti i duhur për zgjidhjen e zgjedhjeve, këtu, së bashku, në Kuvendin e Shqipërisë, në vëmendjen e jashtëzakonshme të opinionit publik shqiptar dhe miqve e partnerëve tanë ndërkombëtarë.

Sot duhet të hedhim hapin e madh drejt këtij çlirimi që do të ndikojë fuqishëm kundër fenomenit të korrupsionit në tërësi.

Sot duhet t'u japim të shqiptarëve mundësinë e një eksperience të vërtetë demokracie, duke e bërë transparencën instrumentin e shkuljes së korrupsionit nga procesi zgjedhor dhe duke u dhënë të gjithëve mesazhin shpresëplotë të shpëtimit të lirisë e garantimit të ndershmërisë së zgjedhjeve në Shqipëri.

Fortifikimi i mëtejshëm i pozicionit tuaj të vjetër, me argumente që janë vetëm një alibi e ngritur mbi frikën nga transparenca dhe, për rrjedhojë, refuzimi i transparencës nga ana juaj, do të ishte një gabim, që sot nuk jemi në gjendje t'ia parashikojmë dot pasojat. Një gjë ua them me siguri që në rast se ju do t'i thoni sonte "Jo" kërkesës sonë, bëhuni gati për atë që vjen më pas, sepse ne jemi gati të vazhdojmë të gjitha përpjekjen tona demokratike deri në largimin tuaj.

Në përfundim të fjalës sime, zoti Kavalier, më lejoni t'juaj lë kësaj here, sepse e kishit merak herën e kaluar se nuk lamë fotokopjet e disa prej atyre mijëra kartash identiteti të falsifikuara.

Këto dy karta identiteti u mblodhën gjatë ditës së zgjedhjeve, janë publikuar në një media kombëtare të pavarur, por janë publikuar edhe në shumë media ndërkombëtare si skemë e manipulimit të zgjedhjeve.

Një qytetar me dy identitete, një qytetar me dy numra të ndryshëm identifikimi. Këtë po ua lë ju, këtë tjetrën kur të kemi kohë nëse do të ketë komision hetimor.

Jozefina Topalli – Po shkoje me Gramozin edhe ti në prokurori, më duket, për t'u përgjigjur.

Urdhëroni zoti Bumçi!

Aldo Bumçi – E nderuara zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Transparenca është parimi mbi të cilin opozita ka bazuar të gjithë aksionin e saj politik këto 6 muaj. Kjo fjalë mbart në vetvete një legjitimitet shumë të madh. Nuk ka nevojë që ne të diskutojmë brendësinë e kësaj fjale, sepse mbetet e mirëqenë. Mund të themi që transparenca është një fjalë e magjishme dhe mbi fuqinë e kësaj fjale PS-ja po mundohet të manipulojë debatin dhe opinionin publik. Të gjithë kompleksohemi përballë kërkesës për transparencë. Si mund të jemi kundër transparencës? Nuk ka rëndësi jemi të shkolluar apo jo, jemi juristë apo jo, ne të gjithë përballemi me një pyetje të thjeshtë dhe naive: Pse jeni kundër hapjes së kutive? Pse keni frikë nga transparenca?

PS-ja mendon se njerëzit si në çdo vend tjetër të botës me problemet e tyre të përditshme nuk kanë kohë të lexojmë vendimet e gjykatës kushtetuese, nuk kanë kohë të lexojnë vendimet e kolegjit gjyqësor, parimet e shtetit të së drejtës dhe atëherë versioni socialist i transparencës fiton debatin publik. Ne jemi pro transparencës, por jo për variantin tuaj dhe ka dy variante transparenca dhe këtë e tregon qëndrimi juaj. Transparenca nuk mund të ekzistojë dhe nuk ka kuptim jashtë një rendi kushtetues dhe ligjor. PS-ja nëpërmjet forcës dhe legjitimitetit të këtij parimi kërkon të fshijë çdo institucion që ne kemi ngritura këto 20 vjet. Kjo nuk është as më pak e as më shumë se një filozofi e pastër revolucionare, por për fat nuk jetojmë në kohë revolucionesh dhe ata që janë jashtë kohës bëhen më së paku qesharakë.

Unë do të marr katër shembuj të thjeshtë për të treguar që ka dy variante të transparencës, një ligjor dhe një socialist dhe këtë e tregoni ju kur keni votuar nenin 178 të Kodit Zgjedhor. Çfarë thotë neni 178 i Kodit Zgjedhor? Pas daljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve fletët e votimit digjen.

Të nderuar deputetë të opozitës, pse keni votuar për djegien e fletëve të votimit? Pse keni votuar në nëntor të vitit 2008, pse keni votuar një kod që parashikon djegien e fletëve të votimit? Pse keni votuar një kod që parashikon djegien e fletëve të votimit? Çfarë transparenca keni pasur në mendje, kur keni votuar djegien dhe çfarë transparenca keni sot në mendje kur kërkonit të numëroni fletët të djegura? Kur është hartuar kodi? Kodi nuk është hartuar në ethet e zgjedhjeve, kur nuk kishte konflikt interesi, nuk e dinim se kush ishte fituesi dhe humbësi. Kodi është hartuar me qetësinë e nevojshme kur palët nuk e dinin rezultatin, se kështu

bëhen rregullat e lojës.

Të nderuar qytetarë shqiptarë,

Në mënyrë të veçantë dëshiroj t'u drejtohem anëtarëve të Partisë Socialiste, votuesve të Partisë Socialiste që i thërrisni në mitingje për të numëruar fletët e votimit, për çfarë transparenca ju kërkojnë që të dilni, kur përfaqësuesit tuaj kanë votuar për djegien e fletëve të votimit.

Cili është varianti socialist i transparencës? Versioni i parë që keni votuar për të djegur fletët apo versioni i dytë që kërkonit të numëroni fletët të djegura? E kemi shpikur ne nenin 178 që kërkon djegien e fletëve? Jo, se kodi është hartuar me ndihmën e OSBE/ODIHR-it dhe në të gjitha kodet ekziston djegia e fletëve të votimit.

Pra ka një version kushtetues që është pranuar nga ju, kur ishim të qetë, nuk ishim në ethet e zgjedhjeve, që kur del rezultati përfundimtar, nuk ka më punë njeri me zgjedhjet dhe ky është versioni i parë. Versioni i dytë është ky kur je në konflikt interesi.

Shembulli i parë është shumë i thjeshtë: Pse qytetarët e Shqipërisë dhe çdo vendi demokratik janë kundër kontrollit të policisë pa mandat në shtëpitë e tyre? Nëse i ballafaqojmë me pyetjen naive: Pse jeni kundër transparencës? A fshihni diçka në shtëpi? Pse keni frikë nga kontrolli? Po të njëjtën gjë na thoni edhe juve ne: Pse keni frikë nga kontrolli i kutive? Jeni kundër transparencës? Pse në asnjë vend demokratik sistemi ligjor nuk pranon kontroll në shtëpi pa vendim gjykate? Sepse kjo do të zhbënte shtetin e së drejtës, nuk do të vendoste rend, do të zhbënte rendin, do të zhbënte demokracinë. Pra ka një sistem transparenca në bazë të ligjit që kërkon vendim gjykate dhe prova; ka dhe një sistem tjetër transparenca që është versioni i dytë i Partisë Socialiste.

Shembulli i dytë: vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.20 i vitit 2007, ku pas kërkesës së 30 deputetëve të Partisë Socialiste për të ngritur një komision hetimor për të hetuar pasurinë dhe të ardhurat e zyrtarëve të lartë, Gjykata Kushtetuese e gjykoi atë kërkesë antikushtetuese. Pse? Pse është kundër transparencës Gjykata Kushtetuese? Çfarë po kërkonin 30 deputetë socialistë? Të shqyrtonin transparençën e të ardhurave të zyrtarëve të lartë. Ka ndonjë gjë të keqe këtu? Jo. Çfarë thotë gjykata në vendimin e saj? Ne kemi një institucion të pavarur, Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Pasurive që kryen këtë detyrë. Kuvendi duke dubluar funksionet e një institucioni të pavarur po

shtrembëron e deformon Kushtetutën dhe nuk po krijon asgjë tjetër, por thjesht një superinstitucion që po merr atributet e organeve të tjera. Ku ndryshon KQZ-ja nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Pasurive? KQZ-ja është një institucion i pavarur, Inspektorati i Lartë është një institucion i pavarur. Në këtë rast ju doni të merrni funksionet e një institucioni të pavarur dhe doni të krijoni një superinstitucion. Këtë thotë Gjykata Kushtetuese

Shembulli i katërt dhe i fundit: Ju jeni munduar t'i krijoni qytetarëve shqiptarë një realitet aluçinant për të gjithë këtë kohë, 6 muaj. U thoni që ju kërkoni transparencë, numërimin e votave. A janë numëruar votat? Ku mund të numëroheshin votat, në Sheshin "Skënderbej"? Jo. Do të numëroheshin në komisionet zonale, ku kemi rënë dakord, me komisionet 50% PS – 50% PD, me numërues, me vëzhgues, të cilët duke ngritur dorën mund të kontestojnë fletën e votimit, me kamera që fotografojnë fletën, me kamera ambientale, me vëzhgues të huaj, me vëzhgues ndërkombëtarë. Kështu janë numëruar fletët. Për ju kjo nuk është transparencë, kjo nuk vlen.

A e parashikon kodi transparencën e dytë? Po, e parashikon dhe vendimi i Kolegjit Zgjedhor për Beratin shpjegon sesi dy anëtarë të KQZ-së mund ta ushtrojnë këtë të drejtë. Ju thoni që dy anëtarë të KQZ-së kanë të drejtë të hapin çdo kuti. Kodi flet për vota të caktuara, Kolegji Zgjedhor shpjegon. Po e marrim të mirëqenë interpretimin tuaj: dy anëtarë të KQZ-së mund të hapin çdo kuti. Nëse ne do të humbim zgjedhjet do të kërkonim rinumërim në të gjithë Shqipërinë.

Kanë qenë 400 tavolina numërimi. Numërimi ka kërkuar 4 ditë. Nëse numërimi bëhet në KQZ, sa kohë duhet? 3-4 vjet. Pra, nëse pranojmë versionin tuaj të transparencës, ky vend mbetet pa Parlament, pa qeverisje, sepse për të dalë rezultati mund të duhen 3-4 vjet.

Në fund, dëshiroj të them dy gjëra. Ju jeni këtu pas një aksioni 6-mujor bojkotoi dhe protestash. Jeni këtu duke treguar që njihni rezultatin e zgjedhjeve, njihni Kushtetutën. Ju jeni këtu pas një aksioni politik ndërkombëtar, i cili pas 6 muajsh u tha: asgjë më shumë sesa jep sistemi zgjedhor shqiptar, futuni në Kuvend, ngrini komisionin hetimor, për gjëra që nuk bini dakord shkoni në Gjykatën Kushtetuese, diçka që ka ndodhur në mënyrë të zakonshme gjithë këto kohë. Pse nuk e bëni? Sepse e dini që gjykata do të japë një zgjidhje. Ju nuk doni zgjidhje. Po a ka kuptim ta përsërisim këtë çdo 6 muaj? Unë besoj që aktorët janë racionale dhe kanë një interes të

qartë. Ju nuk do të përsërisni çfarë keni në këto 6 muaj, se e dini rezultatin.

Shqipëria është afër vendimeve shumë të rëndësishme për ëndrrën europiane të qytetarëve shqiptarë. Ju dëshironi të vazhdoni bojkotin politik, krizën që është në fakt e juaja, për të bllokuar këtë ëndërr të qytetarëve shqiptarë.

Në fund, që duket sikur nuk është e lidhur, por në fakt mendoj se është thelbi i çështjes: Në Kuvendin e Shqipërisë nga koalicioni opozitar ka vetëm një kryetar partie që është bërë deputet dhe ky është zoti Dule, i vetmi që ka mandatin e deputetit. Të gjithë kryetarët e shtatë partive të koalicionit opozitar nuk janë deputetë. Ata kanë shumë dëshirë të jenë si ju, por nuk janë dhe kërkojnë që edhe ju të jeni si ata, jashtë Parlamentit. Nëse ky Parlament, kjo tribunë funksionon si sot, nuk do të jenë kryetarët e partive që janë jashtë, nuk do të jetë zoti Rama, zoti Gjinushi, zoti Milo, zoti Veliaj, zoti Ndoka, zoti Ngjela, që do jenë zëdhënësit dhe përfaqësuesit e opozitës, por do të jeni ju. Duke qenë këtu i zhvlerësoni. Ata nuk duan që ju të jeni këtu. Kaq e thjeshtë është.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Bumçi! Urdhëroni, zoti Kryeministër!

Sali Berisha – Të nderuara zonja deputete, Zotërinj deputetë,

E nderuar zonja Kryetare,

Të dashura qytetare dhe qytetarë shqiptarë,

Më duhet të shpreh keqardhjen time më të madhe, sepse në këtë seancë, drejt së cilës janë ngulur sonte sytë e shqiptarëve po spikasin traditat më të zeza të Partisë së Punës së Shqipërisë dhe po paraqesin këtu opozitën shqiptare si parti e armikut të brendshëm, si parti e persekucionit. Nuk mund të pajtohem me kërcënimet për burgosje dhe arrestime të komisionerëve tuaj, pa pasur qoftë edhe një fakt të vetëm. Nuk mund të pajtohem të merrni nëpër këmbë këtu integritetin moral të tyre. Nuk mund të pajtohem të villni vrer ndaj tyre, nga ata të cilët lënë çdo natë në kazino para droge, më shumë se ç'janë shpërblyer ata të gjithë së bashku për procesin zgjedhor. Nuk mund të pajtohem.

Do t'ju bëj një pyetje miqësore e të ndershme secilit prej jush. Na nxirrni cili komisioner juaj ju tradhtoi? Thuajeni emrin këtu! Cili është ai që ju tradhtoi juve? Apo fantazma e armikut të brendshëm qarkullon në labirintet e partisë suaj?

Zotërinj, përfaqësoni këtu nga Kukësi deri në Sarandë. Të dalë një burrë apo grua e vetme e të

thotë se ky komisioner më tradhtoi mua. Po, të dalësh këtu të përdorësh platformën për t'u treguar hekurat atyre. Nuk kemi ardhur këtu për këtë. Ndaj mendoj që ata që ju indoktrinojnë juve këtë

Shiko, po të analizosh Partinë e Punës, pushteti u mbajt vetëm nëpërmjet armikut të brendshëm, se për të jashtëm ishte perdja e hekurt. Çfarë bëhej, more? Gjendeshin grupe armiqësore dhe tani zbritët te komisionerët. E dini ç'më kujton mua kjo? Më kujton historinë e një bashkëfshatari tim, i cili kishte 8 fëmijë dhe një natë po kthehej me një bashkëfshatar tjetër në shtëpinë tij, por duhej të hynte para orës 6 se e kishte te kloni. I thotë bashkëfshatarit: "Sonte, vetëm po t'u ziej opingat se nuk kam ç't'u jap fëmijëve të mi". E futën 8 vjet në burg, sepse kishte tradhtuar socializmin.

Edhe ju tani, humbët zgjedhjet dhe merreni me njerëz të thjeshtë, merreni me 20 mijë komisionerë që punuan me aq përkushtim. Po nxirrjani more këtu emrin njërit! Mos më nxirrni kartat e bixhozit që i prodhoni te "Tajvani". Më nxirrni këtu emrin e një komisioneri tuaj, që ju tradhtoi! Si mund të bazoheni ju te poshtërimi i tyre për të mbrojtur humbjen?! Humbja është një ndodhi e pashmangshme në politikë. Një herë fiton, një herë humbet. Po a ka ndodhur ndonjëherë këta 20 vjet që të jetë bërë akuzë kolektive. Akuza kolektive është trashëgimia juaj.

Po ju tregoj një histori tjetër. Çfarë më thotë mesazhi këtu: "I dashur zoti Kryeministër, jam një socialist nga Lura. Tregoju socialistëve të mi këtë histori: Në vitin 2007 kandiduan së bashku zoti Hysni Buci i Partisë Socialiste, dy herë fitues i zgjedhjeve, zoti Petrit Buci, i majtë, kandidat i Partisë Demokratike, fis i tij, zoti Haki Gjokola – 1400 zgjedhës votuan, Partia Socialiste 0 vota. Nga kreu u partisë deri te i fundit iu vërsulën Hysni Bucit si ta hanin të gjallë, se s'ke votuar as ti. Çfarë ndodhi? Hysni Buci tha: unë votova për kushëririn tim Petrit Buci dhe të gjithë njerëzit e mi votuan për Petrit Bucin, se përndryshe këta po krijonin....

Të frymëzuar nga Hysni Buci dhe Petrit Buci, të cilëve duhet t'u shpreh nderimin tim se s'kam asgjë me ta, krijuat këto lista. Do t'juaj sjell edhe gazetën "Washington Post", ku i thotë Edi Rama gazetarit që: imagjino në Shkodër deputeti i Partisë Socialiste s'ka marrë asnjë votë. Shkova në KQZ – thotë gazetari – dhe e pashë kishte marrë 13 vota.

More zotërinj, e keni mendjen te hekurat, te arrestimet. Demokracia s'është hekura dhe arrest. Demokracia është ligj, zbatim ligji, zbatim

Kushtetute.

Ju lutem, edhe një herë, të bëjmë një marrëveshje, mos i përmendni më komisionerët këtu. Keni emra, thoni emrat! Keni fakte, sillni fakte! Po jo kështu. E di si i thotë populli kësaj, apo jo....

Mund të them kaq, edhe një herë, të vazhdojmë deri nesër në orën 9 të darkës, por komisionerët mos na i sulmoni më.

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Kryeministër!

Zoti Ruçi, keni fjalën.

Gramoz Ruçi – Zonja Kryetare, e mora fjalën për herë të dytë, përsëri për procedurë. Nga krahu i maxhorancës deri tani kanë folur 15 kolegë, prej të cilëve 10 kolegë se njëri ka folur 5 herë. Ky është Kryeministri. Pra, kanë folur 15 vetë, 5 herë ka folur Kryeministri dhe 5 herë në vend që t'u përgjigjet argumenteve apo të shpalesë vullnet, ne e dëgjojmë me respekt, ta marrë edhe 15 herë fjalën, po bëhet e kundërta. Po bëhen përpjekje nga ana e tij për të devijuar diskutimin, për të kompromentuar këtë diskutim, për ta banalizuar këtë debat, po bëhen përpjekje nga ana e tij për të bërë diversione brenda opozitës dhe midis opozitës dhe komisionerëve të saj.

Zoti Berisha, mos u bëni qesharak! Ne nuk kemi ardhur këtu për komisionerët, siç do t'i të bësh diversion. Nëse do të flasim për komisionerët, ta them unë, ka vetëm një hajdut: njësimi i pushtetit me shtetin, me në krye ty.

Ne të akuzojmë drejtpërdrejt ty në krye të pushtetit, se ke vjedhur votat. Bëje transparencën dhe nxirri xhepat jashtë, nëse je i pastër. Vetëm ti je hajdut për ne, asnjë komisioner socialist. Harroje diversionin që bën midis PS-së dhe komisionerëve të saj!

Ne kemi akuzë të drejtpërdrejtë: pushteti yt i njësuar me shtetin, me në krye ty. Kjo është akuza jonë. Dhe nuk kemi akuzë për asnjë emër të përveçëm. Ndaj, ju lutem shumë, ndërpriteni këtë demagogji dhe diversion, ndërpriteni këtë shantazh dhe mungesë serioziteti! Nesër është një ditë e madhe për të gjithë ne, politikanët shqiptarë dhe të gjithë presin lajme nga ne. Ne nuk presim këto lloj diskutimesh. Veçanërisht nga ju, zoti Kryeministër!

Ne jemi shumë seriozë. Kemi ardhur të përgatitur me argumente politike dhe ligjore në këtë sallë. Kemi paraqitur një listë, kurse ju po improvizoni diskutime. Ndaj, edhe ju, zonja Kryetare, ju lutem caktoni një orë! I gjithë opinioni publik, i majtë dhe i djathtë është i interesuar për debatin e

kësaj dite. Sigurisht, nuk do të na ndjekin ne pa kufij. Ne jemi të gatshëm ta gdhijmë, por, ju lutem, për hatër të së vërtetës, të transparencës me publikun dhe me faktorin ndërkombëtar, caktoni një kohë dhe ne jemi të gatshëm të vazhdojmë nesër në normalitet debatin për të gjetur zgjidhje! Nëse kjo mungon, fajin do ta mbani ju!

Jozefina Topalli – Urdhëroni, zoti Kryeministër!

Sali Berisha – I nderuar zotëri,

Oferta e kësaj maxhorance është një ofertë që e refuzojnë vetëm ata që e kanë frikë transparencën. Vetëm ata që ndërtojnë akuzën mbi mashtrimin. Në rast se ju keni frikë nga transparenca, urdhëroni të formojmë komisionin, të shtojmë trupën e prokurorëve, aq sa nevojiten, për ta kompletuar procesin në kohë më të shkurtër. Por, e dini pse nuk i doni ju prokurorët? Ju nuk i doni, sepse nuk jeni në gjendje t'u jepni qoftë edhe faktin më të vogël, përveç listave të tilla. Këtu është problemi. Ju nuk mund t'i pranoni prokurorët, sepse prokurori kërkon fakte. Ju e bazoni atë mbi armikun e brendshëm, në doktrina dhe jo mbi fakte. Kjo është arsyeja që ju nuk e doni transparencën.

Nëse do të donit transparencën, brenda 5 minutave do të ishte e zgjidhur. Ne duam të realizojmë transparencën e plotë dhe totale. Ju keni juristë këtu. Çfarë po them unë? Asgjë tjetër veç asaj që socialisti Bros i tha zotit Edi Rama në Komitetin Presidencial: "Zotëri, duhen procedura kushtetuese për kutitë". Ju keni dhe juristë këtu. Nëse doni që të bëjmë transparencë, ejani, për 5 minuta e kemi gati komisionin. Siç jam zotuar, do të keni shumicën. Jam zotuar që do t'i bëjmë amendamentet si t'i doni dhe do t'ua votojmë. Por ju nuk doni. Zotërinj, unë sot kam ardhur të jap argumente. Por, të jeni të bindur se për fakte dhe epitete të fushave të tjera, do të ketë ndonjë rast tjetër, që mund të dojë edhe tri ditë me radhë, por nuk është sot rasti.

U detyrova të flas pak se pashë që parafolësi shpalli urrejtje dhe bëri një gabim fatal, se këtu nuk jemi për të folur as për urrejtje e as për dashuri, por për dialog. Nëse ti e merr diversion faktin që unë mbroj komisionerët, unë jam Kryeministër, zotëri, dhe për definicion, qytetarët i kam të njëjtë dhe të barabartë përpara ligjit. Nëse nuk doni t'i mbroj komisionerët tuaj, mos i përmendni dhe mos i akuzoni pa emra dhe pa fakte. Mua më akuzo deri nesër.

Zotëri, mua më akuzo deri nesër. Komisionerët nuk mund t'i akuzoni pa fakte. Mua më bëj akuza

politike sa të duash. Ata janë qytetarë të thjeshtë. Nuk është Parlamenti satër politik për komisionerët. Kjo është tribuna e përfaqësuesve të popullit. Fole këtu për mua sa të duash, gjer nesër. Të dëgjoj, të respektoj deri nesër. Për komisionerët, asnjë fjalë. Harrojeni fjalën komisioner këtu. Sa herë t'i përmendni, do t'i mbroj. Ata do të kenë Kryeministrin si avokat. Mos u merrni me komisionerët! Ose, fundi i fundit, thoni për komisionerët e mi, por jo për tuajt. Del tjetri këtu e thotë, të hapim kutitë dhe t'u vëmë hekurat atyre. Çfarë do të thotë kjo? Zotërinj, ofertën e keni të ndershme nga unë. Po ua them edhe një herë. Unë nuk lëviz nga qëndrimet e mia. Kjo nuk është e fisme e as e denjë.

Ndaj, i nderuar zotëri, nuk dua të më thuash se po ndërhyj në partinë tënde. Nuk dua të ndërhyj fare në partinë tënde. Mos përmend komisionerët këtu, që të mos ndërhyj fare. Fillojeni fjalën me Sali Berishën dhe mbylleni me Sali Berishën. Unë nuk lëviz nga oferta ime. Ofertën time e keni të garantuar. Lërin veç komisionerët! Po na dëgjojë gjithë natën ne që kërkojmë ta gjejmë fajin tek ata.

Jo, more zotërinj, nuk është faji tek ata. Kini etikë, të paktën!

Jozefina Topalli – Më falni, të bëj një sqarim!

Në orën pesë e gjysmë kam bërë mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve dhe i kam kërkuar zotit Ruçi që të caktojë një orar. Më tha, nuk ka orar. Normalisht, në të tilla raste ne përcaktojmë gjithmonë orarin e diskutimeve. Unë po respektoj atë që m'u tha. Megjithatë, ne mund ta shohim prapë, por ndërkohë po avancojmë edhe pak. Ka 56 emra nga PS-ja dhe ka gjashtëdhjetë e ca emra nga PD-ja.

Për sqarim dhe transparencë, nga deputetët e opozitës kanë folur, plus zotit Dule, 16 vetë. Po jua fotokopjoj edhe listën. Janë 16 prej jush dhe 9 nga maxhoranca. Si nuk bëjmë ne transparencë? Kryeministri në 7 orë, ka thënë 57 herë fjalën transparencë dhe sa herë e përmend, ju mërzhiteni.

Urdhëroni, zoti Ahmetaj!

Arben Ahmetaj – Zonja Kryetare, të nderuar kolegë deputetë.

Unë jam dakord me Kryeministrin e Shqipërisë, që kriza zgjidhet për 5 minuta. Mjafton që maxhoranca të votojë për transparencën dhe të hapë kutitë. Sot do të ishte në nder të këtij Parlamenti që kjo maxhorancë të miratonte pa asnjë mëdyshje propozimin e PS-së për zgjidhjen e krizës. Sot do të ishte në nder të këtij Parlamenti që maxhoranca të hapte rrugën për transparencë të plotë të asaj që

ka ndodhur më zgjedhjet e 28 qershorit, duke lejuar, mbi të gjitha, hapjen e kutive. Si rrallë herë ky Parlament ka një shans si ky i sotmi, për të ndarë historinë e demokracisë shqiptare në atë para Ruzhdies dhe në historinë post-Ruzhdie.

Ne kemi më shumë se gjashtë muaj që qëndrojmë të bindur për transparencë të plotë. Ju si maxhorancë keni tentuar ta ktheni në një debat juridik dhe procedural. Jo, çështja e transparencës është tërësisht një parim universal i merituar nga qytetarët e këtij vendi. Një parim themel i refuzuar nga kjo maxhorancë. Sot, me qëndrimin që mban kjo maxhorancë përfaqëson një pjesë tepër të vogël të shqiptarëve, ata që nuk duan transparencën e zgjedhjeve.

Pse i keni në makth kutitë? Pse nuk doni t'u tregoni qytetarëve të këtij vendi votën tuaj, votën tonë? Pse nuk doni të nxirrni në dritë sesi i keni numëruar vota e tyre, pasi i keni hedhur në kutitë tuaja të manipulimit?

Kutia e Ruzhdies zgjoi dhe ngjethi dhe më të painteresuarit ndër shqiptarët. Rasti i Ruzhdies u tregoi shqiptarëve sesa të parëndësishëm i keni konsideruar dhe trajtuar pikërisht në të drejtën e tyre themelore të qeverisjes. Rasti i Ruzhdies tregoi që jo vetëm sistemi elektorale është totalisht i korruptuar, por është bazë e të gjitha llojeve të korrupsionit. Sot vendi po përjeton një krizë të shumëfishtë: krizë demokracie, institucionale, ekonomike dhe krizë besimi. Rasti i Ruzhdies nuk është një rast i izoluar dhe ju e dini. Ju jeni të bindur që ka edhe të tjera. Por sikur edhe ajo kuti e vetme të ishte, meritonte transparencë.

Çfarë kemi kërkuar gjithë këto muaj? Vetëm transparencë të plotë të procesit. Kemi pranuar rezultatin; kemi respektuar vendimet e gjykatës, nuk kemi hyrë në diskutim hesapësh të asaj që kaloi. Ne kërkojmë vetëm një raport të ri me të ardhmen e vendit dhe ju keni 6 muaj që e keni mbyllur të vërtetën në ato kuti.

Keni 6 muaj që kërkon t'u vini shqiptarëve përpara fytyrës Kushtetutën. Nuk ka nen, nuk ka fjalë apo fjali në Kushtetutë që t'i heqë të drejtën e transparencës një populli të tërë. Nuk ka fjalë që të mbajë kutitë e së vërtetës larg syve të votuesve dhe të gjithë popullit shqiptar. Argumentet juridike, të thëna nga kolegët parafolës, të panevojshme të ripërsëriten, janë tashmë të ezauruara.

Zgjidhja e kësaj krize nuk vjen as nga procedurat, as nga argumentet apo debat juridik. Kjo është një krizë e vullnetit të maxhorancës, për të çliruar

njëherë e mirë vendin nga kriza e krizave, nga kriza e demokracisë.

Të nderuar kolegë të maxhorancës, fuqia e kartonit mund ta rrëzojë ofertën tonë, por nuk do ta zgjidhë krizën. Fuqia e kartonëve tuaj mund të rrëzojë edhe ofertën tonë për zgjidhjen e krizës, por nuk e zhbën e as nuk e fshin Ruzhdien nga ndërgjegjja juaj, e, për më tepër, nuk e largon atë nga sytë e shqiptarëve dhe të partnerëve ndërkombëtarë.

Mbi të gjitha, ajo që kërkojmë nuk na përket vetëm neve. Nuk është vetëm në interesin tonë. Ajo që ne kërkojmë ka qenë që në fillësë të parlamentarizmit dhe këtë kartoni juaj nuk ka fuqi ta frenojë. E drejta e votës së lirë dhe transparenca për të janë mbi kartonët që sot do t'i përdorni për të refuzuar përkohësisht atë. Kriza e krizave nuk është e vetme në shtëpinë tonë, ajo është ulur këmbëkryq me krizën ekonomike dhe bashkëjeton më varfërinë, papunësinë, çmimet e larta të ushqimeve, ilaçeve, energjisë, ujit etj. Qeveria qëndron përpara nesh si një rreth i mbyllur, pa transparencë dhe vazhdon të shesë në një treg bosh rrënimin ekonomik, si të ishte rritja më e madhe ekonomike në Europë. Sipas jush, zotërinj qeveritarë me këtë zhvillim ekonomik që ju tentoni të shisni pensionistët shqiptar në qytet dhe në fshat, sot do të duhej të ishin duke udhëtuar në vendet e nxehta për pushimet dimërore. Megjithatë, jetojnë në mungesë të plotë të elementeve bazë të jetës.

Vetëm gjatë vitit 2009 nëpërmjet rritjes ose pseudorritjes së pensionit i dhatë 5 lekë dhe nëpërmjet inflacionit dhe keqmenaxhimit u morët 6 lekë mbrapsht. Këtu nuk llogaris zhvlerësimin e lekut.

Sipas jush, zotërinj qeveritarë, me këtë zhvillim ekonomik, individit jeton në siguri të plotë dhe Gërdeci, përmbytjet e Shkodrës, përmbytjet e fushës së Korçës, izolimet e gjata të krahinave të tëra, rrëshqitjet e dheut, tuneli i Kalimashit janë vetëm dashakeqësi jona ose fantashkencë jona. Sipas jush, zotërinj qeveritarë, ky vend ka menaxhimin dhe qeverisjen më të mirë ndoshta edhe në botë. Ka kufijtë më të mirë të kontrolluar, ka dokumentacionin më të sigurt në botë, ka administratën më të depolitizuar e të paparë ndonjëherë. Megjithatë është vendi i fundit në Europë që nuk mund të lëvizë dot pa viza.

Zoti Kryeministër, herën e fundit në këtë sallë ju thatë se liberalizimi i vizave është një meritë dhe jo mëshirë. E pra, shqiptarët kanë vite që e kanë merituar këtë, por Qeveria as nuk e ka merituar, as

nuk është mëshiruar. Sipas jush, zotërinj qeveritarë, me këtë zhvillim ekonomik që keni çdo mëngjes, mijëra e mijëra shqiptarë nisen me bukën me vete në punë, ndërkohë që papunësia është gjendja konstante e mijëra familjeve shqiptare.

Sot Shqipëria ka 800 mijë të papunë e po të marrësh parasysh që rreth 1 milion shqiptarë jetojnë jashtë vendit, papunësia i kalon kufijtë e 50%. Sipas jush, zotërinj qeveritarë, me këtë zhvillim ekonomik do të duhej që shqiptarët të gëzonin çmimet më të ulëta në rajon apo edhe në Europë, në raport me të ardhurat e tyre. Megjithatë, sipas Institutit të Statistikës, shqiptarët paguajnë 46 lekë në 100 lekë për bukë, raport ky më i larti në rajon, paguajnë që nga 1 janari i këtij viti fatura akoma edhe më të rënda të energjisë elektrike, çmime shumë më të larta se tregu botëror për naftën dhe për gazin. Nuk sigurojnë dot të tashmen, le më të sigurojnë të ardhmen e familjes së tyre.

Ngelemi vendi më i varfër në Europë. Megjithatë, sipas jush, jemi vendi për t'u marrë shembull në Europë. Madje rrezikohet të bëhemi superfuqi në ndonjë sektor si ai i energjisë e ndoshta të kushtëzojmë edhe tregun evropian ndonjë ditë.

Prandaj, të nderuar kolegë, transparencja e plotë e zgjedhjeve do të iniciojë zgjidhjen e krizës politike dhe institucionale që do të krijonte një shtrat të sigurt për zgjidhjen e krizave të tjera.

Sot këtu kemi një shans që fenomenin Ruzhdia ta çrrënjësim një herë e mirë dhe kemi mundësi të tregojmë se me gjithë problemet e mëdha ekonomike-politike-shoqërore kemi pjekurinë e mjaftueshme të punojmë për atë që përmendim çdo ditë vend e pa vend për integrimin evropian të vendit.

Transparenca e plotë e zgjedhjeve, hapja e kutive i ka të gjitha shanset që t'i tregojë rrugën e humbur kësaj Qeverie që pas kësaj të qeverisë vendin deri në zgjedhje të tjera duke vënë mbi interesat e individëve brenda saj interesat e qytetarit shqiptar.

Vriteni frikën ndaj kulisë së hapur, të nderuar kolegë, dhe ajo do t'ju tregoj rrugën! Jepini shans të vërtetës dhe do të kemi mundësi që të krenohemi të gjithë me këtë ditë që nuk ka mbaruar ende!

Falemnderit!

(Ndërkohë, drejtimin e seancës e ka marrë zoti Turku.)

Arrian Turku – Falemnderit, zoti Ahmetaj!

Zonja Majlinda Bregu, urdhëroni!

Majlinda Bregu – I nderuar zoti drejtues i seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sigurisht që për shumë shqiptarë seanca e sotme e Parlamentit duhet të ishte një moment shprese për të gjithë ne për t'u kthyer në një debat normal politik dhe sigurisht edhe për të flakur këtë bezdi të këtyre muajve që na ka krijuar kjo situatë e amullt politike.

Në fakt kemi konsumuar për muaj të tërë deklarata e kundërdeklarata, të vërteta dhe të pavërteta që veç pikë nuk i kanë shtuar asnjëri prej nesh në performancën tonë politike. Ka mbi 6 muaj që, ju të nderuar kolegë të opozitës, lozni me nervat tona, por jo vetëm me tonat (për ne kjo është pjesa më e parëndësishme), por ju lozni me nervat e të gjithë qytetarëve shqiptarë, të atyre që prisnin që pas datës 28 qershor, për herë të parë në një palë zgjedhje në 20 vjet të certifikuar në përmbushje të standardeve të vijonin normalisht jetën e tyre, por sigurisht jo në tension nervash që kërkoni të ngrini ju për të plotësuar reformat dhe detyrimet kryesore të vendit në procesin jetik për qytetarët shqiptarë në integrimin e tyre në BE.

Të nderuar zotërinj kolegë deputetë,

Sigurisht që integrimi i Shqipërisë në BE është jo vetëm një proces përgjegjësish i Qeverisë dhe i opozitës, por është edhe aftësi për të dëshmuar se kemi një klasë politike serioze që di të sillet si pjesë e infrastrukturës politike të vendit dhe që di të respektojë institucionet shtetin ligjor, rendin kushtetues dhe qytetarët e saj. Në këtë këndvështrim, serioziteti me të cilën ne si klasë politike dhe deputetët e këtij Parlamenti do të sillemi ndaj shtetit ligjor dhe ndaj mënyrës sesi ne e respektojmë shtetin ligjor, vendimet e gjykatave është testi më i rëndësishëm për kulturën tonë demokratike. Çdo hap që vjen nga një konsensus politik sigurisht që është i mirëpritur, dhe besoj që këtë e keni kërkuar për muaj të tërë, por ndoshta do të keni mundësi deri nga mëngjesi të tërhiqeni, sepse nuk mund të kultivojmë idenë e bashkimit të vullneteve tona politike kundër shtetit, rendit ligjor dhe rendit kushtetues, pasi kjo është në thelb sjellja më antieuropiane e mundshme që mund të demonstrojmë edhe pse këtë mund ta bëjmë me një konsensus të përbashkët. Për këtë arsye ju bëj thirrje të gjithëve që para se të flisni në emër të deklaratave të ndërkombëtarëve të Europës, të Perëndimit silluni pikë së pari ju vetë si evropianë, si perëndimor në institucionet tona me Parlamentin, me gjykatën dhe me Kushtetutën e vendit.

Ne nuk mund të flasim në emër të parimeve

demokratike dhe të sillemi si revolucionarë të *che guevarës* duke mos njohur institucionet tona. Nuk mund të flasim në emër të Perëndimit dhe të mos njohim vendimet e gjykatave tona, sikur të jetojmë në vendet afrikane, të cilat gjithë kohën janë në ethet e revolucioneve permanente të grupeve marksiste. Ne nuk mund të flasim në emër të idealeve tona të përbashkëta me vendet anëtare të BE-së dhe të shkelim Kushtetutën sikur ajo të jetë një letër e pavlerë që mund të ndryshohet sipas ngjyrës së shalleve të liderëve politikë.

Kjo sjellje në thelb është gjëja më antieuropiane që ne mund të bëjmë dhe sigurisht nëse sillemi kështu, nëse tolerojmë mungesën e respektit për shtetin ligjor, mungesë respekti për vendimet e gjykatave, mungesën e respektit për kushtetutën, mungesën e respektit për njëri-tjetrin ne edhe nëse do ta zgjidhim këtë krizë kemi hedhur në erë parimet mbi të cilat duhet të ndërtojmë shtetin tonë ligjor dhe modernizimin e Shqipërisë europiane.

Sigurisht që tani nuk është as ora dhe as vendi për leksione, por duket sikur ju parimet kryesore të demokracisë i keni harruar menjëherë. Demokracia mbi të gjitha është një sistem i bazuar në rregulla të barabarta dhe të përbashkëta loje dhe, nëse pas çdo rezultati të arritur, ne duam të ndryshojmë rregullat e lojës që sapo ka mbaruar, atëherë sigurisht që ne kemi një problem të madh me të pranuarit e këtij sistemi. Nëse kolegët tanë të opozitës kanë realisht probleme me pranimin e këtij sistemi, kjo është një çështje shumë e rëndë, por gjithsesi është çështje e tyre.

Unë besoj se asnjë nga ne do të pranojë të tërhiqet në fatin e tyre të keq e për më tepër se nuk kemi asnjë faj që ju ra këtë radhë meqë e konsiderojnë të keq për të qenë opozitë.

Opozita nuk mund të hedh për diskutim dhe çdo ditë të kërkojë të na testojë me vegimet e saj, por nuk ka pse t'u vijë keq edhe për forcën në numrat e maxhorancës dhe as për atë që ju në një mënyrë jonormale për ta etiketuar e quani forcën e kartonit. Në fund, të fundit maxhoranca është e përbërë nga numrat dhe ato kartonë nuk janë veçse instrumenti më i thjeshtë, për të treguar pikërisht këtë parim fare të thjeshtë. Ju nuk mund të na akuzoni ne për forcën e kartonit, sepse realisht edhe ajo çka ju ofrojmë sot është që duke qenë ne maxhorancë t'u japim mundësinë të shfrytëzoni më shumë kartona sesa kemi ne.

Ju nuk mund të na akuzoni ne për imunitet korruptim, sepse kemi vite për të gjithë ata që kanë

qenë në Parlament dhe në seancën e kaluar që kërkojmë që këtu të votojmë të gjithë së bashku ligjin për kufizimin e imunitetit të deputetëve. Madje unë do t'i propozoj, zonja Kryetare, me gjithë këto rregulla procedurale që kemi shkelur ne gjatë gjithë kësaj kohe me shqyrtim e rishqyrtim, procedurë e përsheptuar, procedurë të nxituar të projektligjeve t'i hidhni për votim ligjin për kufizimin e imunitetit të deputetëve. Janë të gjithë deputetët në sallë dhe le të provojmë sesa e kanë me të vërtetë dhe nuk e kanë për të na hedhur hi syve, sikurse shumë deklarata të bëra gjatë muajve të përsëritura me një ton të mërzitshëm, rutinë edhe sot në këtë seancë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ju po i përdorni zgjedhjet parlamentare për të zgjedhur dhe për të mbajtur gjallë një kryetar, sepse e kishit pa mandat. Ky ishte problemi juaj kryesor. Ju e përdorët bojkotin për të dhunuar verbalisht institucionet demokratike të këtij vendi. Ju i përdorët akuzat pa fakte si trampolinë, për të kërcyer nga një argument te tjetri, sepse ju vetë nuk i besoni asnjërit nga argumentet që nxirri. Ju e përdorni votën e merituar të shqiptarëve që ju la në opozitë si ndëshkim për të gjithë qytetarët.

Ju e përdorni humbjen për t'u kthyer në dhunues të rregullave të lojës dhe ju nuk po përdorni asgjë tjetër, veçse mandatin tuaj politik si një mandat part-time vetëm për zhurmë elektorale dhe retorikë politike.

Të nderuar kolegë,

Njeriu në këtë jetë besoj se nuk ka pushtet, por përgjegjshmëri. Fati keq juaj është se ju keni zgjedhur një komandat të papërgjegjshëm. Por ky nuk është problemi ynë. Ju flisni dhe keni muaj të tërë që diskutoni gjerë e gjatë për transparencën. U ndalët sonte pikërisht në këtë moment, keni ardhur me idenë për të kërkuar transparencë, sigurisht që as nuk doni të dilni nga kjo sallë me transparencë. Por ju nuk jeni në gjendje të na thoni sa transparent e të qëndrueshëm jeni në respekt dhe në zbatim të ligjeve të vendit, për të mos zbatuar një standard të dyfishtë, por për të respektuar ato ligje që i kemi hartuar bashkë.

Ju nuk mund të thoni se a ishit ju ata dhe me propozim të kryetarit tuaj që nenin 116 në Kodi Zgjedhor, për të drejtën e vetos gjatë procesit të numërimit e kërkuat ju dhe ai nen u vendos pikërisht për faktin e thjeshtë që zgjedhjet dhe diskutimi dhe realiteti i dalë pas 28 qershorit të mos përçudnohej kështu siç kërkoni ta bëni ju për më shumë se 7 muaj.

A nuk ishte ky nen i përfshirë në Kodin Zgjedhor një garanci për transparencë, të cilën ju po e shkëlqeni dhe keni muaj që e shkëlqeni me të dyja këmbët? A jeni apo jo transparent kur kërkonin ndarje pushtetesh? Na propozoni sot këtu konsensus mbi paktin e kapitullimit të këtij parimi kryesor për vendin. A jeni ju transparent kur propozoni 24 muaj hetim parlamentar aq mjaftueshëm, sa del dhe tepron për të njollosur paraprakisht e për të penguar zhvillimin e zgjedhjeve lokale në vend.

Të nderuar kolegë deputetë,

Në këtë Kuvend sigurisht që diskutohet dhe duhet të gjendet zgjidhja në një kthim tuajin permanent në Parlament dhe sigurisht që zgjidhja për këtë situatë duhet të vijë brenda kornizës së shtetit ligjor rendit kushtetues dhe rregullave të përcaktuara të arenës elektorale.

Kjo me sa dimë ne deri tani, na ndjeni në qoftë se jeni injorant dhe nuk dini ndonjë gjë më shumë, është e vetmja mënyrë dhe sjellje europiane që mund të demonstrojmë për zgjidhjen e kësaj krize. Çdo përpjekje tjetër për të hequr vetullat e për të nxjerrë sytë do t'i bënte keq Shqipërisë, shumë më keq imazhit tonë në Perëndim dhe do të sanksiononte një rend destabilizues për të ardhmen dhe të demokracisë së shtetit ligjor dhe të ardhmen europiane të shqiptarëve.

Ne nuk duam dhe as kemi qenë e s'kemi për të qenë pjesë me ju në nënshkrimin e këtij kapitullimi të këtyre parimeve.

Falemnderit!

(*Ndërkohë, drejtimin e seancës e ka marrë zonja Topalli.*)

Jozefina Topalli – Falemnderit, zonja Bregu!

Zoti Malaj, urdhëroni!

Arben Malaj – Të nderuar kolegë deputetë, mirëmëngjesi!

Do të shpresoja shumë që diskutimi ynë sot të mos i serviret publikut si një diskutim për disa nene të një projektligji të propozuar nga PS-ja dhe që miratohet me shumicë të thjeshtë. Ky debat sot për të gjithë ne në këtë sallë duhet të ketë vetëm një objektivi: zgjidhjen e krizës politike.

Tani edhe ekspertët e PD-së e pranojnë se kjo krizë politike rrit risqet e një krize ekonomike e sociale. Çdo parti politike e përgjegjshme, në pushtet dhe në opozitë, ka si përgjegjësi kryesore të gjejë rrugët më të mira që lehtësojnë varfërinë e popullit të vet, rrugët që e çojnë vendin drejt një zhvillimi ekonomik e social sa më të mirë dhe të qëndrueshëm.

Kam besuar dhe besoj se edhe klasa jonë politike votohet dhe paguhet jo për t'u kapardisur në podiumin parlamentar dhe ekrane, por për t'u dhënë zgjidhje të matura sfidave të vendit tonë në rrugën drejt përparimit ekonomik e shoqëror.

Qeverisja juaj ka dështuar në reformat që çrrënjosin korrupsionin, që forcojnë institucionet e shtetit të së drejtës që luftojnë varfërinë dhe rrisin kohezionin e shoqërisë shqiptare. Qeverisja juaj dështoi edhe në premtimin për heqjen e vizave.

Paralajmërimet e aleatëve të Shqipërisë për risqet e kontrollit personal të Kryeministrit mbi organet e inteligjencës, paralajmërimet se mosgjetja e zgjidhjes institucionale për krizën aktuale politike do të vonojë integrimin e vendit, janë kambana që po bien çdo ditë e më shumë.

Ngaqë maxhoranca juaj nuk po reagon, komisioneri evropian i Zgjerimit po vjen ta thotë drejtpërdrejt për ju dhe për të gjithë shqiptarët se kriza duhet zgjidhur sa më parë. Këto janë disa kambana që po bien njëkohësisht në Uashington dhe Bruksel. Fatkeqësisht vetë maxhoranca juaj nuk po i dëgjon.

Problemi i vërtetë qëndron në faktin se dështimi juaj si Kryeministër, dështimi i forcës suaj politike dhe i qeverisjes suaj po kthehet në dështimin e vendit tonë që është edhe juaji. E theksova "që është edhe juaji", sepse po krijohet bindja publike që ju dhe të zgjedhurit tuaj në Qeveri e rreth saj, jetoni në një realitet krejt tjetër, në një realitet politik dhe ekonomik të ndryshëm nga ai i të gjithë shqiptarëve.

Si mundet të krenoheni për sukseset tuaja që shpesh Kryeministri i mban si succese personale, kur vetëm dy ditë më parë Autoritetit i Konkurrencës vërtetoi se çmimet e karburanteve janë rritur, sepse nuk ka konkurrencë, çmimet e shërbimeve të telefonave janë më të larta në Europë, fatura e re e energjisë po grabit mijëra familje shqiptare? Po ky institucion, por edhe institucione të tjera, dyshojnë se bankat kanë marrëveshje të fshehta për të rritur kostot e borxhit të Qeverisë dhe kostot e borxhit të kredive për mijëra kredimarrës shqiptarë. Monedha kombëtare po zhvlerësohet përditë. Kreditë e rënda në monedhë të huaj po gërryjnë të ardhurat e mijëra shqiptarëve. Çmimi i karburantit po rritet mbi 130 lekë/litër dhe kjo do të shkatërrojë bujqësinë e mijëra shqiptarëve të varfër.

Politika juaj e negativizimit apo denigrimit të opozitës është strategjia më e keqe, më e prapambetur dhe më e dëmshme për këtë vend.

Kjo fushatë denigruese që ju bëni ndaj opozitës së vendit tuaj, e financuar nga paratë e taksapaguesve shqiptarë, është pjesë e mentalitetit tuaj mesjetar.

Vendi realisht ndodhet në udhëkryq, jo thjesht sepse një demokraci në mes të Europës nuk funksionon, por sepse po rrezikohemi nga një demokraci që tenton të shndërrohet në diktaturë. Një gjë është e qartë, aq më tepër për një vend si Shqipëria: sa më e gjatë kriza jonë politike, aq më e gjatë kriza ekonomike e sociale, aq më e thellë varfëria e lirive politike dhe ekonomike të çdo shqiptari, sa më e thellë kriza jonë politike, aq më shumë militantizmi partiak do të dëmtojë institucionet tona kushtetuese, aq më shumë do të varfërohet administrata jonë publike, aq më i dobët do të behet shteti, aq më të fortë do të ndjehen krimi dhe korrupsioni.

Integrimi në NATO dhe në BE nuk janë formula magjike për të zgjidhur krizat dhe sfidat tona. Rasti i krizës ekonomike në Greqi, Spanjë, Portugali, Irlandë, që edhe pas 30 vjetësh mbeten vendet më të goditura nga kriza, vërteton se vetëm bujaria dhe fondet e BE-së nuk mjaftojnë për të ndërtuar një ekonomi që prodhon rritje dhe lufton varfërinë. Krizat e brendshme politike në disa vende evropiane, shqetësimet për nivelet e larta të korrupsionit në Rumani dhe Bullgari, edhe pasi janë anëtarësuar në NATO dhe në BE, na paralajmërojnë se keqpërdorimi i anëtarësimit në NATO dhe BE thjesht për luftën politike brenda vendit tonë, na i shton krizat dhe na pakëson përfitimet.

Është momenti për ta ndalur këtë krizë, është momenti për të krijuar shpresën tek çdo shqiptar, shpresën e së ardhmes më të mirë për familjet e tyre. Kriza një ditë do të zgjidhet, por sa më shumë ajo zvarritet, aq më pak do të jetë një zgjidhje e qartë, e plotë dhe e qëndrueshme. Ajo nuk duhet t'u ngajë kompromiseve pa transparencë, siç bëtë me ndryshimin e Kushtetutës dhe të sistemit zgjedhor, ndryshime që kanë cenuar jo pak themelet e demokracisë, ndarjen e pushteteve, demokracinë e brendshme të partive politike dhe pavarësinë e institucioneve kushtetuese.

Kolegë deputetë të maxhorancës, mos e keqpërdorni shumicën numerike të votave tuaja për të bllokuar zgjidhjen e krizës. Shumica e votave tuaja duhet përdorur për ta modernizuar shoqërinë dhe për të përshpejtuar zhvillimin ekonomik të vendit tonë, nisur nga besimi se demokracia është një sistem vlerash e jo thjesht një shumicë numerike votash, aq më tepër kur për to mungon edhe

transparenca.

Nën përgjegjësinë e politikanit dhe në mbrojtje të interesave të komunitetit që më ka votuar në katër mandate, kam qenë dhe mbetem kundër bojkotit të Parlamentit nga forca ime politike, jo për të shërbyer si fasadë e dështimeve tuaja, por si përgjegjësi për të imponuar zgjidhjen e krizës politike, pikërisht aty ku ajo është krijuar dhe ku është më e qartë, në kredibilitetin e cenuar të Parlamentit të vendit tim dhe të Qeverisë suaj. Çdo raport ndërkombëtar dhe çdo deklaratë e kancelarive në çdo vend që është shprehur për zgjedhjet e qershorit kanë qartësuar mosarritjen e standardeve evropiane.

Zoti Kryeministër, për sa i përket thelbit të kësaj krize, dështimit për të arritur standardet ndërkombëtare të zgjedhjeve, sfida juaj personale dhe e bujshme ka dështuar. Një gjë duhet ta dalloni qartë, zoti Kryeministër, që të jesh i hipur në kalin e pushtetit në asnjë rast nuk do të thotë se automatikisht jeni edhe kalorës i demokracisë. Këtë kontradiktë të madhe të mentalitetit tuaj ju kurrë nuk keni arritur ta zgjidhni. Ju keni dështuar, zoti Kryeministër, sepse ju nuk arrini dot të bëni zgjedhje me standarde evropiane. Ju keni dështuar, sepse nuk keni guxim të zgjidhni këtë krizë politike, krizën e themeleve të demokracisë, që është kriza e transparencës së votës. Ju keni dështuar, sepse në vend të institucioneve kushtetuese të pavarura, ju synoni shtetarin me pushtet absolut. Ju keni dështuar, sepse me krizat që nuk po zgjidhni ju nuk po kalëroni drejt demokracisë, por drejt diktaturës, duke e vështirësuar aspiratën tonë evropiane.

Zoti Kryeministër,

Të nderuar kolegë të maxhorancës,

Sot është koha e demokracisë, kjo krizë vetëm përkohësisht mund ta deformojë atë. Sot është koha e lirive politike, ku liria e votës është themelore, ju vetëm përkohësisht mund ta kufizoni atë. Sot është koha e zgjidhjeve institucionale dhe jo e konflikteve. Sot është koha e kompromiseve dhe jo e inateve dhe grindjeve tradicionale.

Të nderuar kolegë të maxhorancës,

Sot është koha kur njerëzit duan demokracinë, lirinë dhe paqen sociale, ndaj çdo politikan duhet të përkushtohet për mirëqenien e vendit dhe të popullit, duke mos krijuar asnjë krizë të re politike, ekonomike dhe sociale.

Zoti Kryeministër,

Sot është rasti konkret i përgjegjësive për të arritur zgjidhjen e kësaj krize. Çdo zvarritje dhe

zgjatje e saj do të rëndojë mbi të gjithë shqiptarët. Varfërimi i lirive politike dhe varfërimi i mëtejshëm social i shqiptarëve do të jetë dështimi juaj i ardhshëm.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Malaj!

Urdhëroni, zonja Trashani!

Arenca Trashani – Falemnderit, zonja Kryetare!

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Me 28 qershor 2009 PS-ja humbi zgjedhjet, rezultat ky i certifikuar jo vetëm nga institucionet kombëtare, por edhe nga ato ndërkombëtare.

Të nderuar opozitarë, keni më se 6 muaj që nga konstituimi i këtij Parlamenti, ju me në krye ideatorin e lëvizjes suaj antikushtetuese, kryetarin tuaj Edvin Rama, që dilni rrugë më rrugë gjoja në emër të votës e të transparencës, për të mbrojtur votën e socialistëve, duke harruar se ata socialistë të vërtetë e të ndershëm që ju votuan, ju votuan për të qenë këtu në këtë sallë, nëpërmjet kontributit tuaj në prodhimin e ligjeve në të mirë të tyre, ju votuan për të qenë këtu dhe jo rrugëve, qorrazi, vetëm për të mbrojtur interesat personale të kryetarit tuaj dhe të klanit të tij mafioz që, në fund të fundit, i humbi prapë se prapë zgjedhjet.

Kryeministri Berisha me dhjetëra herë sonte, në më pak se 7 orë, ju ka ofruar transparencë, transparencë të plotë sipas ligjit, por ju nuk e doni atë, ju thjesht po luani shoë-n e radhës, ju po gënjeni ashtu siç gënjyet edhe ditën e zgjedhjeve. Gënjyet ditën e zgjedhjeve ku për hir të “transparencës” ju bletë dhe shpërndatë stilolapsa për të fotografuar fletët e votimit, disa prej të cilave iu kapën Saimir Tahirit në dorë. Por edhe atë ditë ju gënjyet, sepse i kishit pa bateri ato stilolapsa.

Edvin Rama ka shpallur 20 mijë socialistë si hajdutë potencialë dhe kjo në emër të “transparencës”, vetëm e vetëm për të shpëtuar fatin e tij politik. Ky është kurban i madh për mbijetesën e tij politike. u mbetet socialistëve të vërtetë ta gjykojnë këtë përçarje politike. Rama e vonoi 6 muaj këtë seancë, e vonoi 6 muaj duke u mohuar shqiptarëve 6 muaj parlamentarizëm konstruktiv dhe kjo vetëm transparencë nuk mund të jetë. Po për cilën transparencë flisni ju? Normalisht që ne flasim për atë që vendosëm së bashku, si kurrë më parë, në Kodin Zgjedhor për atë që u pa e u tha se ishte më e mira e këtyre viteve të fundit të pluralizmit. Prova më e qartë janë ato elemente të rëndësishme, të cilat gjetën shprehjen e tyre në Kodin Zgjedhor.

Si administratë zgjedhore plotësisht e balancuar politikisht, në raportet 50 me 50, vendimmarrja e rëndësishme në KQZ bëhej edhe me shumicë të cilësuar 5 me 2, të gjitha seancat e KQZ-së dhe të Kolegjit Zgjedhor ishin publike, mundësia e çdo subjekti zgjedhor që të regjistronte vëzhgues në të gjitha nivelet e administratës zgjedhore përfshirë këtu numërimin dhe përfaqësues me të drejtë fjale në KQZ.

Media ka pasur akses të papenguar në të gjitha nivelet e administratës. Numërimi i përqendruar i dha mundësi kontrollit dhe monitorimit të plotë nga ana e KQZ-së, subjekteve zgjedhore, vëzhguesve dhe mediave, pasi u formuan vetëm 66 qendra votimi, në ndryshim nga viti 2005, kur kishte 4750 qendra votimi. U përdor për herë të parë një sistem dixhital për filmimin, fotografimin, regjistrimin dixhital dhe transmetimin në ekrane të mëdhenj për vëzhguesit pranë çdo posti numërimi dhe në kohë reale në KQZ të procesit të numërimit dhe të vlerësimit të çdo vote. U rrit aksesin i subjekteve zgjedhore në proces numërimi. Ky akses i rritur së bashku me balancimin dhe numërimin e përqendruar të monitoruar plotësisht uli në mënyrë drastike mundësinë për manipulim të numërimit apo pretendimeve paszgjedhore të pabazuara. Transparenca e procesit të hartimit të listave të zgjedhësve dhe pajisjes me karta identiteti, të cilat morën miratimin unanimit nga i gjithë faktori ndërkombëtar si më të mirat e mundshme krahasuar këto edhe me shumë vende të BE-së, ishte e plotë. Kjo është transparenca, të nderuar zotërinj opozitarë, kjo është transparenca që patëm në zgjedhjet e fundit, por se ku ju ka humbur gjejeni vetë. Gjejeni vetë për të mirën tuaj dhe përdoren si duhet, jo për t’ia kundërvënë ligjeve dhe institucioneve të këtij shteti! Por ju keni frikë nga transparenca, keni frikë nga transparenca më shumë sesa kryetari juaj, që shumicën prej jush e solli këtu natën e fundit prej listave të tij personale.

Nisma që sollët ju para dy javësh në Kuvendin e Shqipërisë provoi më së miri atë çka maxhoranca dhe i gjithë faktori ndërkombëtar e tha me forcë: nuk ka shkelje, nuk ka dhe nuk do të ketë shkelje të ligjit themeltar të shtetit, në parimin bazë të tij, atë të ndarjes së pushteteve dhe vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, të cilën, midis të tjerash, ju e keni edhe shumë për zemër në qëndrimin e saj të përsëritur në mbrojtje të vendimeve dhe të gjykimeve të bëra nga gjykatat e këtij vendi. Por ju prapë gënjyet, sepse prapë se prapë ju nuk e doni atë. Ju sollët kërkesën për ngritjen e një komisioni hetimor

për zgjedhjet të bazuar në një draft –ligj tërësisht antikushetues dhe kjo në emër të “transparencës”. E nuk kishte si të ndodhte ndryshe, pasi ideatori juaj bazohet vetëm në dëshirën për destabilitet, por ai ka harruar që jemi në vitin 2010 dhe jo në vitet e diktaturës ku partia-shtet bënte edhe ligjin, edhe gjykatën, edhe prokurorin, madje edhe vrasësin.

Shpresojmë që sot lidshipi i PS-së të reflektojë me seriozitet për situatën që ka krijuar dhe të dalë nga kutia ku e ka futur Edvini.

Kam shpresuar shumë dhe vazhdoj të shpresoj akoma se në radhët e PS-së ka akoma njerëz të përgjegjshëm, të cilët, ashtu siç ushtruan presionin e tyre në afatet e fundit të skadencës së mandateve parlamentare, të dinë edhe sot të dalin mbi idetë destabilizuese të kryetarit të tyre. Sforcoja politike dhe tymnaja mediatike e lidshipit të PS-së, gjithnjë në emër të transparencës, për të bindur shqiptarët dhe komunitetin ndërkombëtar se Shqipëria është në krizë, pavarësisht se në krizë ka qenë dhe vazhdon të mbetet kryetari juaj, si dhe përpjekja e tyre mjerane për të deligjitimuar institucionet demokratike e përfaqësues të Shqipërisë, nuk është as më shumë e as më pak, por një tentativë e qartë për të dëmtuar imazhin e Shqipërisë në botë e veçanërisht tek institucionet evropiane, për ta paraqitur Shqipërinë si një vend pa progres në forcimin e demokracisë dhe në ecurinë e reformave. Kjo po ndodh ndërkohë që institucionet evropiane dhe delegacionet e tyre në Shqipëri përshëndesin dhe inkurajojnë reformat e bëra që i kontribuojnë procesit të liberalizimit të vizave dhe shqyrtimit të statusit të vendit kandidat.

Në fakt, ajo çka arriti Edvini me klanin e tij ishte veçse dëmtimi i imazhit të PS-së te partnerët tuaj socialistë. E pafalshme kjo. E pafalshme kjo për një parti serioze që trumbeton me të madhe respektimin e vlerave evropiane në të bërit politikë. E kush e beson tashmë Edvinin? E çfarë rezultati provoi e gjithë kjo furtunë çoroditëse? Asgjë më shumë apo më pak se sa kërkesën e fuqishme të faktorit ndërkombëtar ndaj PS-së për të hyrë në Parlament dhe për të zhvilluar debatin politik e për të bërë kërkesa legjitime në shtëpinë tonë të parlamentarizmit. Një leksion shumë elementar ky për një parti politike që operon politikisht herë në pushtet e herë në opozitë në sistemin tonë demokratik që nga viti 1992.

Të nderuar opozitarë, sonte keni shansin që të mos shkruheni në historinë e parlamentarizmit të Shqipërisë si deputetë të bojkotit. Ngrihuni e

qëndroni mbi interesat destabilizuese të kryetarit tuaj që, për hir të karriges së tij në krye të bashkisë e të partisë, është gati të bëjë çdo gjë në dëm të shqiptarëve. Populli dhe reformat e maxhorancës jua kanë dhënë këtë shans tashmë. Është në ndërgjegjen dhe vendimmarrjen tuaj të bëni zgjedhjen për të mundësuar zgjidhjen e kësaj situatë në bazë të ligjeve të këtij vendi. Ky është Kuvendi i Shqipërisë, tempulli i demokracisë dhe i ligjit dhe jo çifligu i Edvin Ramës. Ky është Parlamenti që prodhoi kartat evropiane të identitetit dhe jo certifikatat false të Evinit. Të ulemi e të diskutojmë bazuar në kuadrin kushtetues e për më tepër edhe në dokument e partnerëve tanë ndërkombëtarë, siç është raporti i OSBE-ODIHR-it, për të bërë të mundur përmirësimet ligjore dhe për t’u ofruar shqiptarëve në një të ardhme jo shumë të largët zgjedhje edhe më të mira sesa ato të vitit të shkuar. E theksoj edhe një herë jo si ato që do kryetari juaj, pasi në fakt ai do t’i bojkotojë ato, sepse e di mirë që nuk do të jetë më kryetar bashkie, por si ata që duan shqiptarët anëtarë të NATO-s dhe shqiptarët që ecin të sigurt drejt rrugës së tyre drejt integritimit evropian.

Jozefina Topalli – Falemnderit, zonja Trashani. Zoti Eduard Shalsi, keni fjalën, urdhëroni!

Eduard Shalsi – Të nderuar kolegë,

Kanë kaluar pothuajse 9 muaj që nga dita e zgjedhjeve dhe vendi është ende në udhëkryq. Pa u mbyllur ende procesi zgjedhor, Partia Socialiste kërkoi të rinumëroheshin disa kuti në disa qarqe, duke u mbështetur në një të drejtë që buronte nga rregullat e shkruara qartësisht në Kodin Zgjedhor që bashkë kishim hartuar dhe miratuar, por që ju, zoti Kryeministër, pabesisht nuk e respektuat.

Kërkesa jonë donte të hidhte dritë mbi të vërtetën e vullnetit të popullit, cilido qoftë ai, në favorin apo disfavorin tonë. E vërteta e përmbajtjes së kutive ishte, është dhe do të jetë qëllimi ynë madhor. Nuk mund të ketë dhe nuk do të ketë kurrë një shtet demokratik, pa zgjedhje demokratike, pa zgjedhje ku askush të mos ketë frikë se mund t’i deformohet vullneti, pa zgjedhje ku të mos shpenzojmë kohën, duke menduar sesi të mbrojmë votën, por ku të shfrytëzojmë kohën sesi të mbrojmë alternativat.

Përgjatë këtyre muajve kërkesës sonë legjitime i jeni përgjigjur me gjithfarsoj pseudoargumentesh, madje dhe me fyerje, sot edhe me një gjuhë primitive. Por e vërteta mund të vonojë, por nuk do të mund të fshihet, mund të pengohet, por nuk do të mund të ndalet.

Ju, Sali Berisha, keni frikë nga e vërteta, që gjendet brenda kutive se mesa duket e dini mirë se ç'keni gatuar brenda në to. Nuk ka dhe nuk mund të ketë asnjë shkak për moshapjen e kutive, përveç panikut tuaj për të vërtetat e llahtarshme që gjenden brenda në to.

Asnjëherë, të nderuar kolegë, në këta 20 vjet nuk kemi arritur të përmbushim angazhimet dhe standardet ndërkombëtare për zgjedhje demokratike. Kjo ishte ajo që ne dhe qytetarët kërkonin që ju sot t'i jepnit përgjigje. Ne vazhdojmë të endemi rreth një cikli vicioz tranzicioni rraskapitës, që e ka vatrën te mekanizmi i korrupsionit elektoral dhe që është burimi i të gjithë sëmundjeve nga të cilat vuan sot Shqipëria. Ky mekanizëm i ka mbyllur rrugën një konkurrence të lirë, vetëm e vetëm që t'i mbajë disa zotërinj të lidhur pazgjidhshmërisht me pushtetin. Këta politikanë i druhen ballafaqimeve dhe kanë frikë nga garat e ndershme, sepse ato do t'i nxjerrin jashtë lojës. Kjo është arsyeja pse kanë frikë nga transparenca dhe e vërteta.

Sfida e transparencës nuk është një sfidë thjesht dhe vetëm e jona. Ajo është një thirrje që vjen nga e gjithë shoqëria shqiptare dhe me bekimin e së cilës ka fituar një forcë të veçantë, sepse është e lidhur me shpresat e shqiptarëve për të ardhmen.

Qëndrimi i Sali Berishës dhe i maxhorancës ndaj kësaj kërkesë të ligjshme ka hedhur dyshime të forta mbi sistemin përfaqësues në Shqipëri, duke minuar rëndë besimin e qytetarëve te politika.

Po legjitimiteti demokratik i një qeverisjeje nuk buron thjesht dhe vetëm nga data e zgjedhjeve. Legjitimiteti demokratik i një qeverisjeje provohet dita-ditës me mënyrën sesi përballon sfidat e zhvillimit dhe me mënyrën sesi zgjidh situatat problematike, të reja dhe të papritura që dalin.

E gjithë sjellja paszgjedhore e asaj që duket të jetë pseudomaxhorancë ka qenë një dëshmi e faktit se ajo ka ditur të menaxhojë interesa të errëta personale larg të mirës publike dhe nevojave të njerëzve.

A mund të jetë e hapur një Qeveri që mbajti të fshehur shembjen e tunelit të Kalimashit dhe ende sot nuk u tregon shqiptarëve koston që duhet për ta ndrequr atë?

A mund të jetë i sigurtë një Kryeministër që u premtonte shqiptarëve se nuk do të rrisë çmimin e energjisë dhe disa muaj më vonë bën krejtësisht të kundërtën?

A mund të jetë në shërbim të popullit një Qeveri

që mbështet jo mbi profesionistët, por mbi militantët që zbatojnë urdhëra partie dhe për pasojë shkaktojnë katastrofa humanitare, si rasti përmytjeve në rrethin e Shkodrës?

A mund të jetë transparent një Kryeministër që televizionin e vetëm publik shtetëror e përdor paturpësisht, do të thosha, për interesa të ngushta, duke dezinformuar shqiptarët?

A mund të kemi një Qeveri transparente kur drejtori *de facto* i Institutit të Statistikave është vetë Kryeministri, që tenton të tregojë sesi jetojnë shqiptarët, ndërkohë që Shqipëria, skamja, papunësia janë ulur këmbëkryq?

Si mund të kemi institucione në shërbim të qytetarëve, kur zelli i papërmbajtur i Sali Berishës për të shtënë në dorë Shërbimin Informativ alarmoi jo vetëm opozitën, por edhe partnerët tanë strategjikë ndërkombëtarë?

Devijimi i vullnetit të popullit ka deformuar thelbin e qeverisjes. Një qeverisje që kërkon të kontrollojë gjithçka pa qenë e kontrolluar, një pushtet nuk mund t'i shërbejë popullit në rast se nuk del nga populli. Kjo është arsyeja pse ajo që duket pseudomaxhorancë po jep prova papërgjegjshmërie ndaj vendit dhe ndaj institucioneve. Kjo është arsyeja, të nderuar kolegë, pse ne po përjetojmë një moment dramatik. Kjo është arsyeja pse ne gjendemi në krizë politike, ekonomike, morale dhe shoqërore.

Ne sot gjendemi përpara një sprove të rëndësishme, një sprovë që ka të bëjë me të ardhmen dhe jo me të shkuarën. Vetëm duke skanuar thellë dhe në mënyrë të plotë zgjedhjet e 28 qershorit ne do të mund të skicojmë dhe të ngremë në këmbë një shtet të qëndrueshëm demokratik. Vetëm duke hapur kutitë dhe duke nxjerrë në dritën e diellit të vërtetën që fshihet në to ne mund të fitojmë besimin e popullit, që pas fakteve rrënqethëse të Ruzhdies është tronditur rëndë. Vetëm duke bërë transparencën e plotë zgjedhjeve ne do të mund të fillojmë një stinë të re politike që do të çlirojë energji pozitive dhe optimizëm, që do të krijojë premisat për një Shqipëri ndryshe, më të sigurt dhe me të begatë, më të drejtë dhe më të ndershme.

Unë jam i ndërgjegjshëm se kemi rrugë të gjatë për të bërë dhe nuk kam iluzione se mund të arrijmë të bëjmë një Shqipëri të vërtetë demokratike brenda natës. Unë kam bindjen, të nderuar deputetë të maxhorancës, se në rast se do të tregoni vullnet, ne mund të ndryshojmë destinacionin brenda natës.

Koha na ka vendosur një përgjegjësi dhe një mision të rëndësishëm dhe urgjent: të çmontojmë një sistem të korruptuar elektoral dhe të instalojmë një sistem, i cili do të gjenerojë një qeverisje që do të shprehë besnikërisht vullnetin e sovranit.

Unë nuk dua të zgjohem një ditë shumë vite më pas dhe të shoh se shqiptarëve u mohohen të drejtat që meritojnë, nga të cilat e drejta për të parë votën e tyre është një e drejtë themelore. Të drejtën për të parë votën mund ta pengoni përkohësisht, zoti Kryeministër, por nuk mund ta pengoni përgjithmonë. Historia e njerëzimit ka provuar se kauzat e drejta nuk mund të dështojnë.

Të nderuar kolegë të maxhorancës,

Është koha të tregojmë se kësaj here jemi gati të bëjmë diçka ndryshe. Është koha të tregojmë se jemi të uritur për një stad të ri të zhvillimit politik. Përgjegjësia që kemi ndaj shqiptarëve është shumë më e madhe nga ajo që kemi kundrejt partive. Ne socialistët, të gatshëm dhe vullnetplotë, e kemi hedhur këtë hap. Keni shansin për të bërë një kompromis të madh historik, për të cilin ua kemi dhënë mundësinë. Mos e shkelmoni këtë mundësi, sepse ndryshe ky vend nuk do të mund të gjejë as siguri dhe as paqe, as prosperitet dhe as begati.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Shalsi!
Urdhëroni, zoti Kryeministër!

Sali Berisha – Të nderuara zonja deputete,
Të nderuar zotërinj deputetë,
Zonja Kryetare,

Të dashur qytetare dhe qytetarë shqiptarë,

Edhe një herë dua t'u bëj thirrje deputetëve të opozitës të trajtojnë me seriozitetin më të madh ofertën e ndershme dhe serioze të kësaj maxhorance për transparencë. Më krijohet bindja dhe përshtypja se dikush ka frikë nga transparenca si djalli nga temjani.

Edhe një herë zotërinj po ju ftoj, në qoftë se jeni seriozë për transparencë, urdhëroni të krijojmë komisionin dhe të bëjmë transparencë në rrugë kushtetuese, të plotë, totale, pa asnjë pengesë.

Absolutisht çdo gjë në rrugë kushtetuese, pa asnjë përjashtim dhe pa asnjë gjë. Po ju nuk e doni, se shoh unë që transparenca është si gracka, ku siç thotë Uilliam Shekspir, "shpirti i mbretit kapet si laraska".

Më thoni mua: doni transparencë? Mund të rrimë deri pasnesër këtu, por ne mund ta zgjidhim këtë punë menjëherë. Ne nuk kemi asnjë pengesë për të bërë transparencën e plotë.

Ju, zoti Shalsi, që sërish folët këtu për korrupsion elektoral, dua të them se të 20 mijë komisionerët socialistë të marrë së bashku nuk kanë as një të pestën e korrupsionit tënd personal. Sa ç'ke vjedhur ti pallate e apartamente në bashki dhe do të vijë koha.... ata të gjorë, ata burra dhe gra, ata djem dhe vajza, të marrë së bashku, të 20 mijtë, nuk kanë as një të pestën këtu.

Prandaj, mbaje gojën, mos përdor fjalën korrupsion për komisionerët. Komisionerët kanë administruar zgjedhjet. Mos i fryni këtu!

Ke parasysh i nderuar zotëri, Shals, të thashë para 3-4 ditësh, unë në fëmijërinë time të hershme kalit i kam hipur me shalë, pa shalë, me samar, pa samar, siç kaq qenë. Prandaj, kujdes, mos u shky shumë...

(Ndërrhyrje nga deputetët socialistë.)

Edhe mbrapsht, në vrap dhe një vrap kali. Prandaj, lëre ato sulmet për komisionerët. E bëmë këtë *deal* me kryetarin e grupit tuaj, të lëmë mënjane komisionerët. Mos u merrni me komisionerët! Më thuaj ç'të duash mua! E ke të lirë! Thuaju ministrave të mi, deputetëve! Komisionerët mos i sulmoni më! Çdo të ndodhë më pas? Do vijnë zgjedhjet dhe s'do t'u dalë asnjë komisioner. Absolutisht nuk do të ketë socialist të pranojë të bëhet komisioner se në memorijen e kombit do të mbetet gjyqi i komisionerëve, seanca do të mbetet si gjyqi i komisionerëve. S'kemi ardhur për këtë këtu!

(Ndërrhyrje nga deputetët socialistë.)

Urdhëroni, të bëjmë zgjidhjen! Ç'të lë! Po, s'po bëj asnjë manipulim! Jo, s'po manipuloj fare, absolutisht! Kërkoni transparencë dhe i largoheni transparencës! Ju hallin e keni te armiku i brendshëm!

(Ndërrhyrje nga deputetët socialistë.)

Të lutem, unë te vetja?! Po, urdhëro, nga mëngjesi deri në darkë më sulmo mua ti! Vazhdo! Lëri komisionerët! Mos flisni për komisionerët! Nuk mund të ndërtohet kriza e një partie mbi komisionerët!

(Ndërrhyrje nga deputetët socialistë.)

Të lutem, zonjë, komisionerët as edhe një të vetëm. Edhe ndonjë që është bërë, e kam kthyer prapë në punë. Me urdhër të prerë janë kthyer në punë.

(Ndërrhyrje nga deputetët socialistë.)

Më jep emrat! M'i dërgo nesër! Po jo t'i sulmoni këtu!

Ku ishe ti, zoti Shalsi, çfarë bëje ti, o gojëtar i votës, me 143 kuti që i vodhe dhe të detyroi gjykata

të përsërisje zgjedhjet? Thuaju pak komisionerëve të tu! Mos u ngatërro me njerëzit e thjeshtë! Kemi ç'kemi, këtu ia themi njëri-tjetrit. Njerëzit e thjeshtë nuk kemi punë as t'i përflasin, as t'i përbalim dhe as t'i përçmojmë. Jo kështu. Ka disa norma dhe standarde, ka një kod. Na doli prapë fjala "korrupsion" tani. Dhe kush e thotë? Njeriu që ka gjithë apartamentet nëpër gjithë Tiranën. Kujdes!

Jozefina Topalli – Për replikë, zoti Shalsi, 2 minuta.

Eduard Shalsi - Më në fund, t'u dha mundësia të më akuzosh edhe mua. Deri tani isha i vetmi që s'e kisha provuar shansin e mungesës së saj.

Zoti Kryeministër, unë e kuptoj frikën tuaj nga të vërtetat, por kini diçka parasysh dhe vëreni mirë vath në vesh. Ju jeni mësuar të ofendoni, të fyeni dhe të nxirrni gjithfarë broçkullash nga goja juaj. Majtas dhe djathtas keni njerëz që i keni akuzuar dhe ju kanë akuzuar për vrasës. Ju nuk keni problem të nxirrni nga goja gjithfarë broçkullash, e theksoj. Por unë nuk jam këtu për t'iu përgjigjur broçkullave me broçkulla.

Jozefina Topalli – Zoti Shalsi, ka një Rregullore dhe broçkullat mbaji në bashkinë tënde! Dakord?

Eduard Shalsi – Unë e kuptoj frikën tuaj nga fjalët.

Jozefina Topalli – Po pse, mor djalë, lexove prapë konferencën e shtypit që e kemi dëgjuar dhjetë herë? Të na thoshe ndonjë fjalë nga vetja jote.

Eduard Shalsi – Edhe për ju, zonjë, që në fakt do të meritoni emrin Ruzhdie, e kuptoj ankthin dhe mungesën e gjakftohtësisë që ju karakterizon, kur ne nxjerrim disa të vërteta në shesh. Po ju sfidoj, zoti Kryeministër, meqë është hera e parë që drejtuar një akuzë kundër meje dhe ju ftoj në prokurori të denonconi çdo lloj prove apo fakti që keni dhe do ta kuptoni se do të shkoni...

Jozefina Topalli – Ju mbaroi koha.

Zonja Kodheli, urdhëroni!

Mimi Kodheli – Falemnderit!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Kisha shpresuar shumë që fjalën time të parë në Kuvendin e Shqipërisë ta mbaja në një atmosferë krejt tjetër nga kjo e sotmja.

E frymëzuar nga aspiratat e prindërve të mi, kisha besuar se në Shqipërinë e 2010-s nuk do të debatonim më për kriza politike dhe mohimin e demokracisë dhe se kryefjala e debatit publik e politik do të ishin demokracia dhe liria e munguar. Por, për fat të keq, edhe sot e kësaj dite, debati

vazhdon të përqendrohet po tek e njëjta sëmundje e pashërueshme e tranzicionit shqiptar, te vjedhja e turpshme e votës së lirë dhe deformimi i vullnetit qytetar, shprehur me anët të votës. Kemi dy dekada që me turp dhe kokën e ulur jetojmë votime nën trusninë e gënjeshtreve elektorale dhe të humbjes së vendit të punës, votim me dhe pa karta, votim me bazë fshati dhe fisi, votim nën abuzim me pushtetin.

Kemi vite që me turp dhe me kokën ulur na duhet të durojmë mungesën e një demokracie funksionale dhe qeverisjeje që sjell veç konflikte, ndasi dhe përçarje të dhimbshme, për shkak të përkatësive dhe bindjeve politike, në vend që të adresojmë problemet reale të këtij vendi, siç janë rritja e analfabetizmit, rritja e numrit të të ngjuarve, mungesa e drejtësisë dhe shtetit ligjor, papunësia, që nuk lëviz nga shifra të frikshme dhe shumë të tjera si këto. Si qytetare dhe si parlamentare, dua të ndaj më të gjithë ju, por dhe me mbarë publikun shqiptar, shqetësimin tim për atë çka është duke ndodhur sot në vend, për atë çka po ndodh me ekonominë, biznesin, inflacionin, varfërinë, papunësinë, shkollimin, shëndetin, sigurinë.

Si qytetare dhe si parlamentare nuk mund të rri pa folur për klientelizmin e kësaj Qeverie, për korrupsionin dhe mungesën e theksuar të transparencës në çdo gjë, duke filluar që nga të dhënat statistikore dhe hektarët e përmytur e duke përfunduar te vendimet abuzive, që nuk bëhen publike. Do të më duhej të flisja për mentalitetin feudal dhe mungesën e profesionalizmit, me të cilin qeveriset sot Shqipëria, i cili, jo vetëm që nuk po na çon në portat e Europës, por as te gardhi i fqinjëve tanë ballkanikë.

Fatkeqësisht, sot nuk mund të merremi me këto probleme, sepse duhet të merremi me një çështje më madhore, me krizën e thellë të demokracisë që ka mbërthyer Shqipërinë, prej ku gjejnë zanafillën e tyre të gjitha problemet dhe hallet me të cilat po përballlet qytetari shqiptar.

Ishte një shans i madh ai që na u dha në 28 qershor. Do të ishte prova e madhe e demokracisë, kur Shqipëria do të ndahej njëherë e mirë nga tradita e mbrapshtë e manipulimit elektorale. Kjo provë, nëse kalohej me sukses, do ta ndante historinë e tranzicionit gri të Shqipërisë nga historia e së ardhmes europiane. Për fat të keq, pavarësisht retorikës dhe pretendimeve politike, kjo provë nuk u kalua dhe ky shans tjetër i humbur do të thotë jo një, por shumë hapa të tjera mbrapa; do të thotë se

do të vazhdojmë të jemi të sakrifikuar, të përjashtuar, të monitoruar, të nëpërkëmbur, të manipuluar dhe të dhunuar në demokracinë dhe lirinë tonë.

Ditët dhe javët e fundit miqtë, vëzhguesit dhe aleatët tanë kanë dhënë sinjale të forta se diçka nuk shkon me demokracinë shqiptare. Kanë dhënë sinjale të forta se kriza politike dhe mungesa e vullnetit politik për ta zgjidhur atë po bëjnë që të bjerë çdo ditë dhe më tepër cilësia e demokracisë në këtë vend dhe të komprometohet çdo ditë dhe më rëndë perspektiva europiane e Shqipërisë dhe për këto duhet të shqetësohemi të gjithë. Për të gjitha këto ne erdhëm këtu në këtë Parlament me kërkesën e qartë për hetimin e plotë të zgjedhjeve të fundit, jo në funksion të ndryshimit të mandateve, por në funksion të transparencës dhe zbardhjes së të gjitha problemeve, që si ne, ashtu edhe ju, e dimë që shoqëruan zgjedhjet e 28 qershorit.

Ky hetim do të na lejojë të arrijmë në përfundime të vlefshme, në mënyrë që Shqipëria, vend anëtar i NATO-s dhe aspirant për në BE, të arrijë të shkëputet njëherë e mira nga abuzimi masiv që bëhet me votën dhe nga vjedhja e turpshme që i bëhet demokracisë. Kjo është një kërkesë më se normale në një vend demokratik dhe në respekt me Kushtetutën. Një qeveri demokratike do të duhej ta bënte vetë një hetim të tillë, nëse edhe vetë do të merrte në dorë një raport ku thuhet se numërimi i votave është bërë keq apo shumë keq. Çdo qeveri demokratike do të duhej ta merrte vetë iniciativën për të hequr çdo hije dyshimi nga procesi zgjedhor, pas publikimit të një rasti flagrant, si ai i manipulimit të Ruzhdies, për të mos dhënë një leksion dhe shembull shumë të keq të mungesës së demokracisë dhe të abuzimit me pushtetin.

Të nderuar kolegë, çështja që po diskutojmë sot është një çështje e vullnetit politik. PS-ja ju ka ofruar tashmë kompromisin e saj, por nuk duhet të mendoni për asnjë moment se do të tërhiqemi nga kërkesa jonë për hapjen e kutive të votimit, sepse ky është një detyrim që ne kemi kundrejt votuesve tanë, por dhe të mbarë shqiptareve, për të garantuar që të kthehet besimi tek vota e lirë. Ligjet dhe Kushtetuta e vendit nuk janë aspak pengesë e përpjekjeve për transparencë, përkundrazi. Thirrjet e partnerëve tanë ndërkombëtarë janë më se të qarta në këmbënguljen për zgjidhjen e krizës përmes transparencës dhe hetimit të zgjedhjeve dhe për koston që do të ketë vendi, nëse kriza nuk zgjidhet. Është përgjegjësia juaj t'i dëgjoni këto kërkesa legjitime për ta nxjerrë vendin një orë e më parë nga

kjo situatë, ashtu si çdo të jetë po e juaja përgjegjësia për koston që do të paguajë vendi, pas refuzimit kokëfortë të së drejtës elementare për transparencë.

Të nderuar kolegë, është momenti të demonstrojmë se Shqipëria mund të jetë ndryshe, se ajo ka rrënjë të thella dhe të vjetra në histori, që e ndihmojnë atë të jetë në gjendje të kontribuojë realisht në rritjen e mirëqenies së qytetarëve të saj dhe në fuqizimin e demokracisë në Europë.

Ju falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zonja Kodheli!
Zoti Imami, urdhëroni!

Arben Imami – E nderuar Kryetare,

Le ta nisim nga presupozimi se e vërteta është më e rëndësishme sesa mandati dhe të bëjmë një provë se këto nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën. Le të themi që mund ta kemi edhe mandatin, edhe të vërtetën. Kjo do të thotë se e vërteta nuk është më e rëndësishme se mandati, aq më tepër kur pranohet rezultati i zgjedhjeve. Pra, mandati është dhe mund të jetë i rëndësishëm, nëpërmjet tij mund të shkohet të transparenca, pra, nëpërmjet hetimit parlamentar, hetim parlamentar, natyrisht, jo i pakufizuar.

Janë 800 vjet histori politike europiane, që nga Magna Karta; janë shkruar libra dhe traktate; janë bërë polemika, luftëra civile; rebelime dhe të gjitha nuk kanë qenë gjë tjetër, veçse përpjekje për të gjetur rrugët dhe institucionet, me qëllim kufizimin e pushtetit absolut të pakufizuar. Gjithë mekanizmat konstitucionalë republikanë për ndarjen e balancës dhe kontrollin e ndërsjellë të pushteteve; kufizimin e tyre nga ligji dhe e drejta janë dizenuar dhe inventar për të kufizuar pushtetin. Për të ardhur te forma aktuale e demokracisë, mendimi politik europian ka krijuar një sërë instrumentesh të balancimit dhe të kontrollit kundrejt pushtetit të pakufizuar për të garantuar liritë politike. Më lejoni të citoj diçka, që, përgjithësisht, përpiqem ta evitoj, thënien lapidare të lordit Akton: "Pushteti korrupton. Pushteti absolut korrupton në mënyrë absolute."

Ky komision me hetim të pakufizuar gjen vetëm një model historik: Komunitetin e të Njëqindtëve të Revolucionit Francez, i cili bashkonte fuqinë, pushtetit legjislativ dhe atë gjyqësor. Besoj se të gjithë jemi të bindur se ky nuk është shembulli më i mirë.

Prandaj, hetimi i pakufizuar nga Kushtetuta dhe ligji, duket absurd. Madje, është një ide që mund t'i shkojë ndërmend veç dikujt që nuk ka shkelur kurrë në këtë sallë. Në fakt, shqetësimi im është sesi mund të propozohet kjo ide nga deputetë që kanë

20 vjet që punojnë në këtë sallë. Madje, edhe hetimi më i zakonshëm ka kufizimet e veta lidhur me kohën, procedurën, ligjshmërinë. Do të ishte anormal një hetim i pakufizuar. Aq më keq kur thuhet: ju keni vjedhur dhe shkoni provoni se nuk keni vjedhur.

Ky është një parim universal. Akuza e ka barrën e provës. Nëse ka prova, shkoni në prokurori! Nëse nuk ka prova, mos akuzoni!

Propozimi që sjell opozita, në thelb, na fton të ndryshojmë në formë dhe substancë konceptin e hetimit parlamentar, pasi opozita e ka deklaruar tashmë që nuk ka prova dhe fakte, por ka veç dyshime. A është e mundur që për dyshimet që lindin në kokën e dikujt të përmbysen 800 vjet histori të filozofisë së mendimit dhe realiteteve politike evropiane?

Jo për të bërë ironi, por, në fakt, nuk shoh ndonjë rrugë tjetër. Ndaj them se, nëse do të duhej të realizohej kjo aspiratë, ka vetëm një rrugë: të abrogojmë Kushtetutën dhe të vendosim një Kushtetutë të re, shumë të thjeshtë me këtë përmbajtje: neni 1 "Komisioni hetimor është i plotfuqishëm. Neni 2 "Kjo Kushtetutë hyn në fuqi menjëherë."

Për këtë, besoj se të gjithë së bashku jemi të mendimit se nuk mund të ndodhë.

Dua të trajtoj edhe një element tjetër të projektligjit në dukje është i parëndësishëm, por që tregon dritëshkurtësi. Çështja e posedimit të shumicës së përhershme të komisionit hetimor nga opozita në jurisprudencë arsyetohet me kazuse.

Le të marrim një kazus. Partia që ishte në opozitë vjen në pushtet dhe ajo që ishte deri në qeverisje me gjithë manipulimin kalon në opozitë. Kush do ta ketë shumicën të akuzuarit apo akuzuesit? Aq më tepër një vend me legjislacion, si ky yni, ku legjislacioni zgjedhor i njeh partitë si administrues të zgjedhjeve dhe ku secila prej tyre mund të ketë në mënyrë të barabartë të drejtën për t'u ankuar.

Ushtrimi është i thjeshtë dhe për një student të juridikut, por i ka shpëtuar hartuesit të draftit, sepse preokupimi i vërtetë nuk ka qenë për transparencën e zgjedhjeve, por për ta bërë propozimin të duket si i paanshëm.

Në përfundim, kur pakica kërkon të miratojë një projekt të saj sigurisht që kërkon konsensusin e shumicës. Pra, mund të ketë konsensus për të shkelur Kushtetutën ligjet apo duhet ta marrim këtë vendim në emër të atij që po quhet tashmë vullneti i të ashtucilësuarit popull opozitar. Në fakt edhe kjo

çështja e vullnetit nuk më sjell gjë tjetër ndërmend përveçse një ide të njohur të ideologut të revolucionit francez Rusos. Besoj se edhe këtu nuk mund të jemi së bashku.

Nëse opozita, ashtu siç po ndodh, do të imponojë vullnetin e saj drejt ngjarjesh të paparashikuara, duhet të ketë parasysh se po e fut vendin në telashe të paarsyeshme në një moment të një rëndësie tejet të veçantë dhe tepër delikat. Vendi ka ecur përpara në procesin e integritimit euroatlantik. Tashmë jemi anëtar të NATO-s, jemi në prag të kandidaturës për në BE. Shumë shpejt pritet që qytetarët shqiptarë të lëviznin lirshëm në hapësirën europiane hapësirë së cilës ata i përkasin. Cenimi i kësaj perspektive të parashikueshme ngarkon me përgjegjësi shkaktarët.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Imami!

Zonja Xhaçka, urdhëroni!

Oltja Xhaçka – Falemnderit zonja Kryetare!

Të nderuar zonja e zotërinj deputetë,

U fol gjatë këtu sot për parimet demokratike dhe evropiane, për rend kushtetues, për sundim të ligjit, ndërkohë në asnjë moment nuk u mohua se prej 20 vjetësh në Shqipëri nuk bëhen dot zgjedhje të lira të ndershme e të pakontestueshme si në çdo vend tjetër në Europë, ku ne synojmë të integrohemi. Në asnjë moment nuk shprehet shqetësim për zgjedhjet që vetëm standarde evropiane nuk përmbushin. Duke u ngushëlluar se edhe këto zgjedhje pas 20 vjetëve të ashtuquajtura demokratike, bën një hap para e dy prapa. Nuk treguar në asnjë moment respekt për veten, por edhe për votuesit. Ndërkohë që apeluar respekt për njëri-tjetrin; nuk treguar respekt për veten dhe për votuesit, sepse nuk folët në asnjë moment për zgjedhjet të standardeve evropiane dhe nuk kemi pse synojmë asgjë më pak për veten dhe për vendin tonë.

Ju e dini shumë mirë se transparenca që kërkohet për zgjedhjet e 28 qershorit nuk synon pushtetin, tavolinën e hetimit, por hetimin e plotë të zgjedhjeve të 28 qershorit, për të mos lejuar deformimin e proceseve të ardhshme zgjedhore e akoma më keq deformimin e vullnetit të zgjedhësve si një forcë e rrezikshme korruptuese për shtetin, por edhe për të gjithë shoqërinë, pasi ju e dini shumë mirë se në kutitë e 28 qershorit nuk ndodhen vetëm vullneti i tjetërsuar i zgjedhësve. Nuk ndodhen vetëm firmat e rreme të komisionarëve, identitete të shumëfishta apo votat e emigrantëve të ndodhur mijëra kilometra larg ditën e votimit. Në kutitë e

votimit që ju sot mbani mbyllur kokëfortësish duke u justifikuar nëpërmjet një interpretimi dizleksik të ligjit themeltar Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë që nuk keni ditur ta lexoni plotë 20 herë e që po e shkëlpi sërish duke mos i hapur kutitë, bashkë në ato kuti fshihen plagët tona të përditshme të shkaktuara nga paaftësia dhe papërgjegjshmëria e shtetit që ju drejtoni në funksion të pushtetit dhe jo në interes të votuesve.

Në ato kuti fshihen shifrat dhe perspektivat e rreme për mirëqenien ekonomike që shqiptarët sot nuk gëzojnë edhe pse jetojnë në një vend të begatë mes Europës. Në ato kuti fshihet rritja eksponenciale e faturës së energjisë elektrike jashtë çdo afati apo tavani të parashikuar në ligj, rritja e çmimeve të produkteve të konsumit të përditshëm, duke ua bërë jetën shumicës së familjeve shqiptare thuajse të pamundur, që mbase ju nuk arrini t'i shikoni nga bollëku i pushtetit që sot gëzoni padrejtësisht.

Në ato kuti fshihen viktimat e Gërdecit që nuk gjejnë drejtësi e që pas dy vjetësh ju me sa duket i keni fshirë nga kujtesa. Në ato kuti fshihen të përmbyturit e Shkodrës nga papërgjegjshmëria e Qeverisë dhe jo nga tekat e Perëndisë që sot nuk po përkraken. Fshihen ata të Maliqit që po u kthehet toka në kënetë, fshihen minatorët e dekoruar pishtarë të demokracisë që nuk gëzojnë dot frytet e punës së një jete nëntokë pasi vdesin nga silikoza para se të përfitojnë pensionin. Fshihen fshatarët e mbytur nga balta që nuk mbjellin dot tokën e nuk shesin dot prodhimet, të persekutuarit që mbetën më të përdorurit e më të diskriminuarit, ish-pronarët që vazhdojnë të sorollaten dyerve të administratës e të gjykatave në kërkim të së drejtave të mohuara, studentët që mbetën viktimat të një reforme pa perspektivë. Fshihen shtresat në nevojë që mbahen nën lëmshë e shumë e shumë të tjerë.

Në ato kuti fshihet arroganca e këtij pushteti që nuk do t'ia dijë fare sesa u dhemb shqiptarëve përditshmëria e tyre në kufi të mbijetesës, sepse nuk e ka të nevojshme votën e tyre për të kaluar pragun e fitores, sepse thjesht mund tua marrë atë me hir a me pahir e për rrjedhojë nuk ka pse qeverisë cilësisht në funksion të interesave të të gjithë qytetarëve përveç në funksion të interesave të ngushta vetjake e klanore.

Transparenca e zgjedhjeve të 28 qershorit kërkohet sot jo vetëm prej Partisë Socialiste jo vetëm prej popullit opozitar, por edhe prej opinionit publik e partnerëve ndërkombëtar, në emër të liberalizimit të vizave e të integritimit evropian. Kjo kërkon

ndërgjegjen tuaj demokratike e vullnetin tuaj politik, kolegë demokratë. Nëse e konsideroni veten vërtet demokrat, vazhdimësia e pushtetit tuaj nuk mund të jetë më pak e rëndësishme se hapësira që duhet t'i krijoni opozitës për të shprehur qëndrimin e saj e për t'u realizuar në funksionin e saj në emër të interesave kombëtare, për t'i dhënë fund një herë e mirë andrallës së zgjedhjeve të manipuluar që po i kthejnë qytetarët shqiptarë çdo ditë e më shumë në spektatorë pasiv të teatrit politik e politikën për fajin tuaj në një ushtrim kokëfortë boshe e të pavlerë krejtësisht të shkëputur nga hallet interesat pse jo dhe nga aspirata e qytetarëve.

Demokrat nuk mund të quhen sot ata që mendojnë e thonë se e vërteta brenda kutive të votimit është ogurzezë. Prandaj, kutitë e votimit dhe transparenca e zgjedhjeve është shumëkërkuar prej nesh është themelore jo për të ndarë se kush ka të drejtë mes nesh, por për të ndarë Shqipërinë nga epoka e ruzhdizimit të proceseve zgjedhore në funksion të riciklimit të pushtetit.

Për të bërë transparencën e plotë dhe të pakushtëzuar të zgjedhjeve, për të vënë interesin e vendit e të popullit në themelin e një marrëveshjeje mes nesh, e cila do të sanksiononte në ligj jo vetëm sot, por përgjithmonë të drejtën e transparencës së zgjedhjeve përmes një hetimi parlamentar që do të ishte garanci për të gjitha forcat politike në çdo kohë.

Nëse nuk ndahemi nga kjo epokë, do të vazhdojmë të zhytemi në batakun e keq-qeverisjes ku ju e keni futur vendin, sepse nuk mund të ndodhë në asnjë rrethanë, zoti Kryeministër, që votat të vidhen, zërat kundërshtarë të ndalohen me vullnet opozitar e të shtypen me synimin për t'i vjedhur sërish votat dhe pas të gjitha këtyre të qeveriset mirë. Jo. Kjo nuk mund të ndodhë. Nuk ka pushtet që mëkaton për të bërë më pas punë të mira në të mirë të së mirës publike. Pushteti i korrupton, e pushteti absolut korrupton, në mënyrë absolute e ju, zoti Kryeministër, keni dëshmuar ndër vite se nuk jeni imun.

Besoje se nuk do t'i vinte keq kujt që ju, zoti Berisha, të mbaheshit mend për guximin e gjetur brenda vetes për të hapur kutitë e votimit, pasi edhe unë jam shumë e interesuar të dijë se kush ka votuar në Korçë, në emër të familjarëve dhe të afërmeve të mi që jetojnë jashtë vendit prej vitesh dhe që sipas dëshmimeve figurojnë pjesëmarrës në votimet e 28 qershorit.

Ky gjest demokratik, pra kurajë për të hapur kutitë mbase do t'ju bënte ju, zoti Kryeministër,

favorin e fundit, duke e larguar paksa vëmendjen nga keqmenaxhimi që ju po i bëni halleve të shqiptarëve e ndoshta do të linte krahasimisht në hije atë që po ndodh me jetën politike që ne jemi të fundit në instalimin e demokracisë përfaqësuese, jemi të fundit në reforma, të fundit në lëvizjen e lirë tej kufijve e të fundit në anëtarësimin e BE-së.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit!

Po, zoti Ruçi, urdhëroni!

Gramoz Ruçi – Ne e vlerësojmë shumë këtë seancë, zonja Kryetare, por mbi të gjitha vlerësojmë transparencën e këtij Parlamenti para publikut, i cili tashmë fle, sepse do të shkojë nesër në punë. Por, njëkohësisht duke vlerësuar rëndësinë e këtij debati, deri tashmë kanë folur, të mos gabohem, 1/3 e atyre që janë regjistruar.

Prandaj, edhe një herë, për herë të dytë, ju propozoj që të ndërpritet seanca dhe ta rifillojmë atë nesër në orën 10:00

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Dakord, e mbyllim seancën për sot. Por, unë kam një propozim: ta rifillojmë seancën nesër në orën 9:00, sepse ka shumë emra dhe nuk ia dalim dot.

Falemnderit!

Natën e mirë!

(*Seanca u mbyll në orën 01:30 të datës 19.03.2010.*)

* * *

(*Seanca rifillon në orën 9:30 të datës 19.03.2010.*)

Jozefina Topalli – Nisim seancën. Vazhdojmë me diskutimet e djeshme.

Fjalën e ka Gazmir Bizhga.

Gazmir Bizhga – Të nderuar kolegë,

Ka më shumë se 6 muaj që vendi ynë është mbërthyer nga një krizë e thellë politike dhe institucionale, burimi i së cilës janë zgjedhjet e grabitura të 28 qershorit, prodhim i së cilës sot është një qeverisje që nuk përfaqëson vullnetin e shumicës së shqiptarëve. Që ato zgjedhje nuk arritën dot standardet e kërkuara për një vend anëtar të NATO-s dhe aspirant për në BE, ky nuk është as faji i votuesve dhe as i opozitës, por i kësaj Qeverie, e cila i gatoi ato në mënyrë të tillë, me të vetmin qëllim për të siguruar vazhdimësinë e saj jashtë vullnetit të shumicës së shqiptarëve, të cilin as nuk e ka pasur dhe as e ka edhe tani në këtë kohë.

Zgjedhjet e 28 qershorit jo vetëm që nuk arritën standardet e kërkuara, por ato në gjithë harkun kohor të zhvillimit të tyre u shoqëruan me dhunë, terror psikologjik, presion nga administrata shtetërore e nga të fortët e Qeverisë, të cilët vërtiteshin ditën për diell nëpër dyqane e biznese si taksidarë e inspektorë të gjithëllojshëm, me dhe pa uniformë, dhe natën nëpër dyert e shtëpive të votuesve të opozitës duke u lëshuar kërcënimin e radhës për të mos ardhur në votim.

Pajisja e votuesve me karta identiteti ishte dhe mbeti një telenovelë zgjedhore, ndërkohë që për ata që votonin për Qeverinë, kuponat qenë gratis si qerasja e radhës nga drejtuesit lokalë të Partisë Demokratike. Ndërkohë që për të tjerët një ditë nuk punonte zyra e aplikimit, një ditë ajo e postës për kuponat, një ditë interneti, një ditë gjendja civile dhe me ditë të tëra mungonte kryetari i komunës apo i bashkisë për të hapur derën. Me sa duket ishte me urdhër politik për të sflitur edhe ata njerëz që donin të votonin, por që nuk votonin për Qeverinë. Për të mos folur më pas për ato komuna e bashki që njihen si maxhorancë votues të majtë, si Nikla, Maminasi apo Bubqi etj., ku procesi ndërpritej me ditë të tëra apo fillonte vetëm pak ditë përpara ditës së zgjedhjeve, siç ishte rasti i komunës së Niklës. Por ky ishte më i vogli problem kur mendon se çfarë ndodhi në fushatë në fshatra e komuna, duke filluar që nga Qepalaj, Katër Rugët e Shijakut e deri në Ishëm, opozitës nuk iu la ambient elektoral duke iu dhunuar zyra elektorale nga të fortët e Qeverisë, që shfaqeshin si hije natën. Nuk iu la asnjë mundësi propagande e shpalosjeje programi. Ndërkohë që ditën u shkonin derë më derë taksidarët e Bashkisë së Sukthit apo të Manzës për të kërcënuar të gjithë ata të gjorë që shprehin hapur mbështetjen për opozitën.

E gjithë kjo panoramë e dhunës verbale që bëhet në sytë e gjithë botës e në mes të ditës, bëhej më e frikshme natën, kur po të njëjtët taksidarë, por tani me veshje civile, shantazonin me letra apo mbishkrime kërcënuese në muret e shtëpive për jetën e tyre dhe të familjarëve të të gjithë aktivistëve të opozitës, nëse ata të nesërmen në mëngjes do të dilnin në krah të saj si në Sukth apo Ishëm, apo më keq kur digjnin zyrat e flamujt elektoralë të Partisë Socialiste, apo zbranznin armë përpara dyerve të drejtuesve lokalë, si në Xhafzotaj, Manzë e Rrushkull dhe Policia e Shtetit, asnjëherë, e pozicionuar haptazi në mbrojtje të interesave zgjedhore të Qeverisë dhe jo të ligjit, nuk dha

përgjigje për autorët, as atëherë dhe as sot që po flasim.

Opozita u pengua të zhvillonte hapur një fushatë elektorale në shumë fshatra nga sejmenë të deleguar të Qeverisë, të cilët terrorizonin banorët për të mos vajtur në takime të opozitës e të mos mbështetnin e shoqëronin kandidatët e saj. E gjithë puna e drejtorisë rajonale arsimore, inspektorëve të saj, drejtorëve politikë të shkollave, nuk ishte qëmtimi i regjistrave për fundvitin shkollor, por qëmtimi i atyre mësuesve, familjarët e të cilëve apo ata vetë ishin votues të opozitës, të cilëve iu dha urdhër i prerë që nëse do të votonin ditën e zgjedhjeve, të hënën do të ishin të pushuar nga puna. Po kështu edhe për mjekët, infermierët, veterinerët apo për të gjithë punonjësit e thjeshtë në fshat apo për administratën vendore, të cilët mezi e mbyllin fundin e muajit me rrogën që kanë.

Qershia mbi tortë e gjithë kësaj komedie zgjedhore ishte blerja e fshehtë e votave lart e poshtë nëpër fshatra, duke luajtur me varfërinë e shqiptarëve e fletoret e pafund të mbushura plot me borxhet e tyre në dyqanet e ushqimeve, ku në krye të listës qëndronte kryekomunari i Ishmit, i cili për dy net rresht, para ditës së zgjedhjeve, i shoqëruar dhe në mbrojtjen e Policisë së Shtetit, dilte natën si njeri i fandaksur për të ndarë paratë për të blerë votat në këtë zonë.

Natyrisht, këto para nuk i buronin as nga kursimat e pagës dhe as nga pronat e tij, por nga aferat e pista me tokat, trojet e lejet e ndërtimit në plazhet e gjirit të Lalzit, brenda së cilës është edhe një pjesë e kësaj maxhorance. Më pas këtij nuk i linin gjë mangët as qeveritarët vendorë e qendrorë rreth e rrotull, por për të mos i ngrënë hakun, ky ishte në top-listë.

Policia e Shtetit me të famshmit inspektorë në fshatra e komuna, si për shembull ai i Maminasit, merrnin gjatë gjithë kohës për këshillim shoqëror simpatizantët dhe kandidatët për komisionerë të qendrave të votimit të opozitës, për t'iu shprehur sugjerimet e tyre për të hequr dorë apo më keq akoma për të bashkëpunuar për fitoren e Qeverisë në kurriz të manipulimit të votave të vetë opozitës.

Në gjithë këtë proces ajo u pozicionua hapur në kundërshtim me ligjin zgjedhor dhe me në krye të detyrës apo dhe të ruajtjes së paanësisë. Qendrat e votimit në shumë fshatra, me gjithë kontestimet e opozitës pranë komisioneve zgjedhore zonale apo pranë KQZ-së, u vendosën qëllimisht në ambiente të papërshtatshme për të siguruarurvejtim të

fshehtë e mbarëvajtje korrekte të punës së komisionerëve të qendrave të votimit, apo më keq akoma në shtëpitë apo lokalet të drejtuesve vendorë dhe administrativë të Partisë Demokratike, siç ishte rasti i qendrës së votimit të fshatit Karrem të komunës së Maminasit, ku u vendos në katin e dytë të shtëpisë së kryetarit të komunës, kur shkolla e fshatit ishte 200 metra larg.

Të gjitha këto fakte janë një grimcë e asaj fushate terrorizuese që u zhvilluan në gjithë qarkun e Durrësit apo më rëndë akoma të asaj që ndodhi ditën e votimit. Thuajse në të gjitha qendrat e votimit në zonat informale të periferisë apo në fshatra u shfaqën në dyert e hyrjes së vendvotimit njerëz që rëndom njihen si kontingjentët e rinj apo të vjetër të policisë apo më keq të burgosur ordinerë, që ishin liruar nga burgu, të cilët kërcënonin, nuk lejonin apo dhunonin me terror psikologjik dhe konfrontim fizik të gjithë votuesit e majtë që shkonin për të votuar. Ndërkohë Policia e Shtetit bënte sehir, sikur nuk po ndodhte asgjë. Mbi komisionerët e opozitës ushtrohej presion për të lejuar votimet familjare jo të fshehta apo edhe më rëndë, për të votuar njëri për të gjithë ata që ai i quante të tijtë.

Ruzhdia nuk është një rast i izoluar. Këto raste që thashë, por edhe plot të tjera tregojnë se të tilla janë të gjitha qendrat e votimit në fshatra të thella apo në periferi. Natyrisht, e gjithë kjo tragjikomedi zgjedhore nuk mund të ishte e plotë pa kujtuar e përmendur organizatorët e saj që nga Qeveria e deri te KQZ-ja. Qeveria i shkeli haptazi të gjitha ligjet për statusin e nëpunësit civil, ato të departizimit dhe të depolitizimit të institucioneve shtetërore, të drejtat dhe liritë e shtetasve të saj. Ajo arriti deri në shakanë e radhës kur për dekorin e sheshit të mitingjeve të Kryeministrit apo dhe tuajin, zonja Kryetare e Kuvendit, u përdorën që nga fëmijët e fillores e deri te punonjësi më i fundit i administratës, për t'iu siguruar me paratë e taksapaguesve shqiptarë komfortin e pjesëmarrjes së takimeve elektorale në mungesë të mbështetjes popullore e qytetare.

Të nderuar kolegë,

Kjo që kam thënë është më e pakta e asaj që përjetova unë dhe të gjithë kolegët opozitës më 28 qershor. Që kjo të mos ngjasë më në të ardhmen, kemi kaq kohë që kërkojmë transparencë, që të mos përsëriten më pamje të tilla në Shqipëri në shekullin e ri, që të mos ketë më manipulatore, që na ndyjnë të drejtën e lirisë dhe të votës në emër të Qeverisë së radhës, që të mos ketë më njerëz të

fortë, të cilët profesion të jetës së tyre kanë manipulimin e zgjedhjeve, ne kërkojmë të zbardhim të vërtetën e 28 qershorit. Që ky kryeministër që kemi sot nuk do të bëjë zgjedhje të lira, kjo është më se e vërtetuar më shumë se një herë në 20 vjetët e historisë sonë moderne, por që ne të kërkojmë të drejtën tonë nuk na ndal dot as ai, as ata që po përpiqen të pengojnë procesin duke tjerë rrjeta në emër të Kushtetutës dhe ligjit.

Po ju sjell një argument të jetuar nga i pari komision hetimor në historinë e këtij Kuvendi, atë për Shërbimin Informativ të Shtetit në vitin 2002, kur me kërkesë të komisionit ky institucion vuri në dispozicion të objektivit të hetimit pranë këtij komisioni dokumente të cilat klasifikoheshin si sekret shtetëror, ku cenohet privatësia dhe mbarëvajtja e punës së institucionit të SHISH-it dhe asgjë nuk ndodhi, përkundrazi, sot nxirren në emër të kushedi se kujt plot pseudoargumente për të penguar hetimin e opozitës, ndërkohë që as fletët e votimit, as listat e votuesve, as procesverbalet nuk përbëjnë sekret shtetëror.

Opozita nuk e do transparencën për veten e saj, sepse ne e dimë që jemi përfaqësues të zgjedhur të më shumë se gjysmës së shumicës së shqiptarëve, as për të ndryshuar rezultatit e ligjëruar, por e duam për hir të së ardhmes sonë të përbashkët e të fëmijëve tanë. E duam edhe për ju kur nesër të jeni në opozitë. Ne nuk po lypim mëshirë, por të drejtën tonë, të cilën, nëse nuk e marrim sot në këtë sallë, atëherë do ta kërkojmë në rrugë e sheshe bashkë me popullin opozitar. Dhe jo vetëm këtë të drejtë, por do të kërkojmë drejtësi për të gjitha padrejtësitë që po i bëhen këtij populli të zënë për fyti nga korrupsioni galopant i kësaj Qeverie, nga nepotizmi, inflacioni, nga çmimet e energjisë dhe bukës së përditshme, nga varfëria e të papunët që shtohen përditë e bizneset që po falimentojnë nga dita në ditë. Vlerësojeni thirrjen e opozitës sa nuk është vonë për të gjithë!

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Bizhga!

Zonja Paulina Hoti, urdhëroni!

Paulina Hoti – Falemnderit, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar zgjedhës që na ndiqni me kaq vëmendje dhe durim.

Opozita ka kërkuar të ngrejë një komision hetimor, i cili do të diskutojë legjitimitetin e Parlamentit. Do të diskutojë legjitimitetin e një institucioni të pavarur si KQZ-ja, e për më tepër edhe

legjitimitetin e një pushteti të pavarur, atë të gjyqësorit. Pse? Sepse zoti Rama nuk pranon se ka humbur zgjedhjet.

Nëpërmjet kësaj iniciative Partia Socialiste paraqiti në Kuvend një projektligj që nuk pasqyronte vendimet e Gjykatës Kushtetuese, por që mund të ishte një hap për zgjidhjen e shumëpritur. Për këtë arsye maxhoranca e pranoi iniciativën. E diskutoi gjerë e gjatë atë, solli ndryshime duke pasqyruar vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe duke respektuar parimin themelor të ndarjes së pushteteve. Megjithatë, ju të nderuar zgjedhës, ishit dëshmitarë dhe patë se si reagoi opozita, se si reagan kolegët tanë socialistë në Komisionin e Ligjeve; se si nuk pranuan të shqyrtohet nen për nen; se si u larguan edhe pse kishin deklaruar më parë se ishin të hapur për ndryshime.

Të gjithë ju besoj se e keni kuptuar qëllimin e vërtetë të tyre, që është thjesht t'ju thonë ju, zgjedhës të dashur, se ne u përpoqëm për kompromis, por maxhoranca nuk pranoi. Por kjo tezë nuk ka asnjë mbështetje morale, as bazë ligjore. Largimi juaj, deputetë të Partisë Socialiste, nga komisioni, në të cilin ligjërisht do të debatoheshin mënyrat e zgjidhjes së çështjes, nuk i shërben transparencës. Ju nuk e doni transparencën.

Largimi juaj nuk i shërben zgjidhjes së çështjes. Largimi juaj nga Komisioni i Ligjeve nuk i shërben kredibilitetit tuaj para zgjedhësve shqiptarë. Kërkohet transparencë, reflektim. Por kjo s'mund të jetë e njëanshme, zotërinj deputetë. Pritet edhe angazhimi juaj, i cili nuk shprehet duke u larguar nga Komisioni i Ligjeve. Vërtet demokracia jonë është e re, por është koha që t'i lëmë qëndrimet fëminore: ose bëni kështu si themi ne, ose ne largohemi. Kjo nuk i shërben as tolerancës dhe as transparencës, të cilën ju e refuzoni me qëndrimin tuaj.

Qëndrimi juaj nuk u shërben proceseve të integritetit evropian. Nuk i shërben liberalizimit të vizave dhe sot, të nderuar kolegë, në këtë pikë ku kanë arritur diskutimet tona, nuk mund të jetë përgjegjës vetëm zoti Rama. Përgjegjës për pengimin e liberalizimit të vizave jeni të gjithë ju, deputetë të Partisë Socialiste, që po bëheni bashkautorë të pengimit të një procesi që lejon realizimin e ëndrrës së kahershme të popullit tonë, ëndrrën e zgjedhësve tanë, të gjithë ju deputetë të Partisë Socialiste që jeni për bojkot.

Gjatë gjithë debateve që kemi pasur në

Komisionin e Ligjeve doli në pah qëllimi i lëvizjes së radhës së liderit të opozitës. Po, zotërinj opozitarë, kësaj radhe zoti Rama ju ka përdorur ju për të bërë lëvizjen e radhës. Ka shfrytëzuar profesionalizmin e disave prej jush për të përgatitur një projektligj, që jo vetëm nuk reflekton vendimet e Gjykatës Kushtetuese, por kufizon të drejtën e çdo anëtarit të komisionit hetimor për të kërkuar automatikisht marrjen e provave duke kërkuar ta kthejnë atë në vendim shumice.

Zoti Rama po luan edhe me ju, jo vetëm me popullin. Ju e konstatuat vetë në diskutimet në Komisionin e Ligjeve. Ratë në kontradiktë me njëri-tjetrin në debate, sepse ndryshe ishin direktivat e tij. Disa thoshin se kishte bazë ligjore, madje na përmendën një mori nenesh, por të tjerët tregonin se nuk ka bazë ligjore dhe e paraqitën këtë projektligj si domosdoshmëri për të krijuar komisionin hetimor. Domethënë qëllimi i lëvizjes së radhës me projektligjin që po diskutojmë, të paktën për ata që janë juristë është thjesht për t'u hedhur pluhur syve zgjedhësve ndërkombëtarëve me refrenin që ne u munduam, por maxhoranca nuk pranoi.

Qëllimi i liderit tuaj kësaj radhe është gjetja e pretekstit për të vazhduar bojkotin. Qëllimi i liderit tuaj është ta kthejë këtë debat në gjyq të komisionerëve. Mjaft më! Komisionerët nuk kanë nevojë t'u bëhet gjyq. Kjo sallë s'mund të kthehet në presidium popullor. Prandaj ju, kolegë socialistë, si bashkautorë, dua t'ju them se po pengoni lëvizjen e lirë të shqiptarëve.

Të nderuar kolegë,

Gjatë gjithë procesit zgjedhor investuam për të arritur standardet më të larta të mundshme dhe ia arritëm. Por gjatë këtij procesi hasëm hap pas hapi pengesa dashakeqëse të aktorëve socialistë, që urdhëroheshin direkt nga zoti Rama. Për të informuar opinionin publik, por edhe juve, zotërinj deputetë të Partisë Socialiste, në KZAZ-në nr.39 të qarkut të Lezhës, në Kurbin, Partia Socialiste i ndërroi disa herë komisionerët, ndërroi disa herë numëruesit, ndërroi dy herë kryetarin e KZAZ-së, edhe pse kishte maxhorancën në atë zonë të administrimit të zgjedhjeve, duke penguar për orë të tëra numërimin. Pyetjes se pse nuk vazhdon numërimi, a e dini se si i përgjigjeshin: Është vendim politik.

Fakti është se ju, zotërinj të Partisë Socialiste, u munduat shumë herë të prodhoni incidente në Laç, pikërisht në bastionin e Partisë Demokratike. Po në fakt nuk ia arritët. Dhe ky është merak juaj, zoti Dokle, kur përmendni Laçin.

Juve, zotërinj opozitarë, laçianët ju thanë: "Stop, duam standarde" dhe si përgjigje ju u dhatë bllokimin e numërimit të 6 kutive. Cilat ishin ato kuti? Ishin ato të zonave më të nxehta demokrate. Ndërsa sot vini e na flisni për transparencë. Sot na paraqiteni si viktimë që ju kanë vjedhur votat. Pasi kërkuar ta bëni transparencën nëpër sheshe, pasi kërkuat ta bëni transparencën me qese mbeturinash, tani bëni gjoja sikur e kërkon me ligj.

Ju zotërinj opozitarë po kërkonin gjilpërën në kashtë për të gjetur prova manipulimesh, por në fakt jeni vetë fajtorë të rezultatit, të cilin një herë thoni e pranojmë e herës tjetër shpreheni se "nuk njohim legjitimitetin e Parlamentit." Jeni ju që nuk pranoni se keni humbur.

Zotërinj opozitarë (disa prej jush mund ta dinë), a e dini se çfarë i tha grupit të punës një politikan i njohur francez kur humbi zgjedhjet për President në Francë?

Fransua Miteran, kur u dha rezultati i zgjedhjeve për president herën e parë, tha: "Zgjedhjet i humbëm, të shpërndahemi në terren, të punojmë dhe të takohemi pas 7 vjetësh në zgjedhjet e ardhshme". Por, në fakt, shembulli juaj, zoti Rama, është shumë larg të qenit një politikan, jo vetëm se politikanin duhet të ketë prioritet interesat kombëtare dhe jo ato personale, sepse ndryshe është i destinuar të dështojë, jo vetëm pse nuk reagoni si ai, por edhe pse ju i trembeni terrenit, i trembeni dhe nuk e besoni elektoratin tuaj. Këtë e treguat gatë zgjedhjeve, e dëshmuat këto 7 muaj me akuzën për korrupsion që u bëtë 20 mijë komisionerëve të Partisë Socialiste, e dëshmoni me mosbesimin ndaj organeve të drejtësisë, e dëshmoni me mosbesimin ndaj të gjithë elektoratit të Partisë Socialiste, dhe zoti Rama e dëshmon edhe ndaj jush, duke ju urdhëruar kur të hyni e kur të dilni në Kuvend, kur të hyni e kur të dilni nga Komisioni i Ligjeve.

Prandaj vetë ju deputetë të Partisë Socialiste, për të vetmen herë pas kaq muajsh, tregohuni transparentë, tregohuni se dini të jeni të ndërgjegjshëm e të përgjegjshëm para zgjedhësve, para mbarë popullit. Dua t'ju them se qëndrimi juaj vazhdues pengues për integrimin e vendit, po jua them me fjalët e rezolutës së Këshillit të Europës, është në dëm të popullit shqiptar. Ju ftoj të reflektoni!

Falemnderit!

(Ndërkohë, drejtimin e seancës e ka marrë zoti Turku.)

Ardian Turku – Zoti Dokle, e kuptova që e ke kërkuar fjalën për replikë, por në Rregullore ka disa

raste kur kërkohet replika, jo thjesht me përmendjen e emrit. Është devijimi i thelbit të çështjes dhe janë disa raste të tjera. Megjithatë, po jua jap fjalën, por nuk është se plotësoni kushtet për replikë.

Namik Dokle – Falemnderit!

Nuk u ngrita të bëj replikë me atë zonjën a zonjushën. Asaj vetëm do t'i uroj 1 qershorin si festë. Dua t'u them deputetëve, jo asaj zonjës, që shumë gjëra ju nuk i dini si kanë ndodhur dhe Don Kishoti ju thotë juve ndonjëherë: "Ku merr vesh ti, o Sanço, nga kalorësia moderne?" Dhe ajo nuk e di se në Fushëkuqen e saj ka votuar, figuron sikur ka votuar, edhe një i burgosur, jo nga ata që liruara nga burgu, por i paliruar nga burgu. Ai ka votuar në Fushëkuq.

Ardian Turku – *(I drejtohet zonjës Hoti.)* Nuk ka replikë mbi replikë, ju lutem!

Atëherë, vazhdojmë me zotin Dashamir Peza.

Dashamir Peza – Zoti drejtues i seancës,

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Kemi 9 muaj që në televizione, në radio, në gazeta, në kafene fshati apo sallone hotelesh luksoze, zyra shteti, seli ambasadash, sheshe protestash, studio televizionesh apo faqe gazetash dëgjojmë dhe diskutojmë është vjedhur apo jo vota, do të hapen apo nuk do të hapen kutitë, është apo nuk është kushtetuese kërkesa e opozitës, duhet apo nuk duhet ligj për të hapur kutitë, do të bjerë apo jo kavaleri nga kali, do të hyjë apo jo opozita në Parlament, do të digjen apo jo mandatet, duke i ardhur vërdallë një të vërtete të madhe, asaj të vërtete që me të gjitha mënyrat, me mediet e shitura, me forcën e pushtetit, me diversione nga më të paskrupulltat, ju të nderuar zotërinj të maxhorancës, jeni munduar ta fshihni, shmangni e deformoni.

E vërteta është e thjeshtë. Beteja jonë nisi si betejë për votat e vjedhura, që ju me forcën e kartonave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Kolegjit Zgjedhor e kthyer nga betejë e votave të vjedhura në betejën për votën e lirë. Ne kërkua zgjidhjen e kësaj dileme kur vendosëm marrëdhëniet e kushtëzuara me Parlamentin, ndërsa ju u lëshuat kundër lidërshiptit të PS-së në mënyrë të pamoralshme. Por kjo e ktheu betejën tonë nga një betejë për votën e lirë në një betejë për demokraci. Ne refuzuam hyrjen në Parlament që ju t'i thërrisnit arsyes, si dhe për t'u treguar të gjithëve se këtu kemi një problem të madh me demokracinë. Ju filluat sulmin jo vetëm mbi përfaqësuesit e opozitës, por edhe mbi mediet që nuk iu nënshtruan. Ajo që arritët ishte që betejën tonë e kthyer edhe në një betejë për fjalën e lirë.

Ne dolëm në protesta dhe populli u bashkua me ne, me qindra e mijëra, në të gjithë Shqipërinë. Këtë e bëmë jo për të treguar forcën e muskujve, por për t'ju bërë të kuptoni që kjo nuk është një betejë me opozitën, as me disa deputetë të saj, por një betejë me popullin.

Ju u përgjigjët duke harxhuar edhe thërrimet e fundit të buxhetit të shqiptarëve në antimitingje të stisura, duke kërcënuar me humbjen e vendeve të punës dhe lista mitingashësh. Edhe kjo nuk e fashiti betejën, por thjesht e ktheu atë edhe në një betejë për Xhevrinë Gjonin, me arsim të lartë në biokimi, e cila u largua nga puna si mësuese dhe u zëvendësua me një militante të PD-së me shkollë nate vetëm pse kishte votuar për Partinë Socialiste; për Lindita Peçin, mësuese definitive, e cila u zëvendësua me një militant të PD-së me arsim të mesëm vetëm se kishte votuar për Partinë Socialiste; apo për Hamit Qoshen, roje shkolle në Stërbeg, i larguar nga puna po për të njëjtën arsye; për Bule Kajën, nënë e katër fëmijëve pa baba, pastruese në komunën e Kryevidhit, e larguar nga puna sepse kishte votuar për Partinë Socialiste.

(Ndërhyrje nga deputetët në sallë.)

Pra, duke e kthyer këtë në një betejë për familjet e të gjithë atyre që sot kanë një rrogë më pak apo kanë mbetur pa të ardhura vetëm sepse votuan për Partinë Socialiste.

Ne u mblodhëm dhe publikisht nga Asambleja Kombëtare u treguam shqiptarëve për humnerën ekonomike, ku, për hir të këtij vendi, u bëmë thirrje publike që të merrnit masa urgjente për shmangien e katastrofës. Ju u përgjigjët duke lëshuar tatimorët mbi biznesin, i majtë apo i djathtë, duke u marrë shpirtin me gjoba dhe taksa, u zutë frymën kompanive shqiptare të ndërtimit të rrugëve, duke u grabitur dhe mbajtur peng me forcë mundin që u takon për punën e kryer, duke e kthyer kështu betejën tonë edhe në një betejë për biznesin e dhunuar.

Ne me protesta në të gjithë Shqipërinë, ju kërkua t'i ktheni sytë e errësuar nga urrejtja për opozitën e të shikoni gjendjen e mjeruar të popullit, të atij që u dha votën dhe atij që nuk ua dha, por gjithsesi ju ua morët, të shikonit familjet shqiptare në fshat e në qytet, që po shtrëngonin përditë rripat duke ulur shpenzimet jetike. Ju u përgjigjët me rritjen e frikshme të çmimit të energjisë elektrike, rritjen e çmimeve të shërbimeve në spitale, me ngritjen e taksave për biznesin e vogël apo ngritje marramendëse çmimesh e kostosh për shkak të

inflacionit.

Kjo përsëri nuk ju shpëtoi, të nderuar kolegë, por e ktheu betejën tonë në betejë për bukën e përditshme të të gjithë shqiptarëve, në betejë për ilaçet e pensionistëve, për veshjen dhe librat e fëmijëve, në betejë për pensionet e minatorëve.

Miq të dhe partnerët e Shqipërisë, të nisur nga dashamirësia dhe të shqetësuar për rrugën që po përshkonte vendi, bënë thirrje për zgjidhjen e krizës, duke nënvizuar tashmë nevojën për hetim dhe transparencë zgjedhjesh. Ne me vullnetin e mirë dhe vetëdijen se në momentet që po kalonte vendi një zgjidhje politike do të ishte zgjidhja më e mirë, u kthyem në Parlament në funksion të një zgjidhjeje institucionale, si dhe në respekt të miqve dhe të partnerëve tanë ndërkombëtarë.

Por ju, zotërinj të nderuar, u përgjigjët me ligjin për uzurpimin e SHISH-it dhe rrëzimin në Komisionin e Ligjeve të propozimeve tona, duke na e bërë faqen e zezë në sytë e partnerëve, të cilët me bujari na futën në NATO. Kjo nuk ua dha zgjidhjen e dëshiruar, thjesht e ktheu betejën tonë në një betejë për demokracinë funksionale.

Zotërinj, kanë kaluar 9 muaj që nga momenti kur ju goditët rëndë gurin e themelit të shtetit dhe demokracisë: votën e lirë, që, për hir të së vërtetës, duhet thënë se ka 20 vjet që goditet pareshtur këtu në Shqipëri.

Kanë kaluar 9 muaj që kur ju jeni përpjekur me çdo formë dhe mjet të shuani zërin dhe betejën tonë, por kjo nuk do të ndodhë. Sot, kolegë të maxhorancës, me arsyan e mosarsyes, me urrejtjen për opozitën, me arrogancën e pushtetit, jo të fituar por të grabitur, me dhunën e medieve të kapura, apo parave të pista, nuk ia keni dalë dot të shuani betejën që nisi për votën e vjedhur, thjesht e keni kthyer atë në një betejë për Shqipërinë europiane.

Sot Shqipëria është në një udhëkryq të madh, ndër më të mëdhenjtë e historisë së saj të re dhe të vjetër: të shkojë në rrugën e demokracisë funksionale apo të vazhdojë në agoninë e këtij tranzicioni sfillitës që nuk po merr fund. Për këtë arsye, zotërinj deputetë, jemi sot në Parlament, jo për mandatet që ju çirreshit se do të na hiqnit, as për bërë iso me ju në një teatër që quhet "opozitar". Po vëllezër, por për të bërë përpjekje, për t'i dhënë shansin e fundit zgjidhjes së kësaj krize, bashkërisht. Sot Shqipëria është në udhëkryq. Prandaj betejën për shpëtimin e saj nuk e ka më dorë politika, por populli. Politika thjesht mund të vendosë të bashkohet me popullin, për ta bërë më

të thjeshtë dhe më të lehtë rrugën e vështirë të ndërtimit të Shqipërisë europiane.

Ne, të nderuar kolegë, kemi vendosur që prej 28 qershorit të bashkohemi me popullin. Sot, duke u ngritur mbi meritë politike, mbi gjuhën e urrejtjes, mbi mlllefet e së shkuarës, me kurajë ju ftojmë të bashkoheni me ne, në këtë rrugë, duke e filluar atje ku nisi kjo betejë: te vota e lirë. Zgjedhja është e juaja. Ne e kemi bërë tonën. Një gjë është e sigurt, me ju ose pa ju, populli do ta zgjidhë këtë çështje. Me ju ose pa ju, shqiptarët do ta fitojnë këtë betejë, pasi kjo është beteja e Shqipërisë europiane.

Falemnderit!

Ardian Turku – Falemnderit, zoti Peza!

Fjalën e ka zoti Gjana.

Jemin Gjana – Falemnderit, zoti Turku!

Kolegë dhe kolege të nderuara,

Besoj se nuk kanë mbetur argumente të tjera të pathënë, por këto ditë kam dëgjuar të thuhet rëndom se 18 marsi është dita e fundit, "është darka e fundit" (apo sot është bërë 19 marsi). Doni t'ia impononi këtë fakt kësaj salle, që së paku ka një histori 20-vjeçare, doni t'i bindni njerëzit se gjërat mund të diskutohen në varësi me periodat e Partisë Socialiste. E kam fjalën për periodat kur keni qenë në pushtet, si dhe për periodat kur jeni jashtë pushtetit, jo për perioda të një natyre tjetër. Ju harroni sesi jeni sjellë në këtë sallë, por kjo sallë ka një kujtesë. Kjo sallë ka një arkiv. Shumë nga ju kanë qenë këtu, të paktën 20 prej jush, 1/3 e grupit, sepse pjesa tjetër, 2/3 përbëjnë skuadriljen luftarake të Edi Ramës. U duket vetja si skuadrilja e Rusolinit në qiellin e Baltikut, por problemi është se as Rama nuk është toger Rusolini dhe as kjo skuadrilje nuk është e përbërë nga patriotët e famshëm të qiellit të Baltikut. Rama u ka ngritur në hava. Ai nuk di t'ju japë objektiva. Për fat të keq, nuk di as t'ju ulë. Do t'ju mbarohet karburanti dhe do të mbeten në hava. Unë e kam fjalën për 20 ose 25 prej jush, me të cilët jemi këtu prej 20 vjetësh radhazi. Nuk dua t'i zë me emra, sepse do të merrja replika prej tyre.

Dua të bëj një historik pak të shkurtër për këtë çështje. Nuk do të shkoj përtej vitit 1998, kur u miratua Kushtetuta, të cilën sot jemi të detyruar ta zbatojmë të gjithë. Në vitin 1999 ishit të detyruar të bënit Kodin Elektorale të miratuar në nëntorin e vitit 1998, bazuar në dispozitat e Kushtetutës. E bëtë Kodin Elektorale, e miratuat jo në vitin 1999, por në maj të vitit 2000. Ne atëherë kemi qenë në opozitë, kemi qenë një grup i vogël dhe ju bëtë të gjitha përpjekjet për të na zvogëluar edhe më shumë,

sepse kishim dalë nga zgjedhjet e viti 1997. Kishim edhe disa parti të vogla aleate, zotin Laço, zotin Bushati të demokristianëve, zotin Metko, të cilin ia morët dy deputetë, një nga Kavaja dhe një nga Pogradeci, dhe ju paraqitëm atëherë dhjetëra amendamente. Nuk morët nga amendamentet e opozitës asnjë rresht, asnjë fjalë, asnjë germë, dhe e bëtë Kodin Elektorale në maj të vitit 2000 siç deshët vetë ju, kolegë të Partisë Socialiste. Shumë prej jush atëherë ishin drejtues të Parlamentit, drejtues të grupit parlamentar, drejtues të rëndësishëm të kryesisë së partisë dhe ministra që sillnin nismat ligjvënëse. E bëtë të tillë Kodin Elektorale sepse u duhej për zgjedhjet e vitit 2001. Nuk mund t'i merrnit përsëri zgjedhjet siç i morët në vitin 1997: me rebelim të armatosur. Ju duhej Kodi që t'i merrnit në një mënyrë tjetër. Ju e dini se si u bënë zgjedhjet e vitit 2001. Këtu po dëgjoj të flitet për polici, për dhunë dhe për terror. Në fakt, nuk ka ndodhur kështu, as në zgjedhjet e vitit 2003, as në ato të 2005-s, as në ato të 2007-s dhe as në zgjedhjet e 2009-s. Askush nuk mund të vërtetojë se policia ka futur duart në zgjedhje. Në këto katër palë zgjedhje, Shqipëria arriti që ta ketë policinë jashtë përzjerjes me procesin zgjedhor. Por këtu ka emra ish-ministrash, dhe nuk harrohet Maqellara. As Klosi, as Koseni dhe Kateshi në Elbasan dhe në Peqin nuk harrohen. As banda e komisarariatit nr. 2 të Lushnjës nuk harrohet. As ajo çfarë bëri ish-kandidati Lakrori me Ramën me një kryekomisar në Devoll nuk harrohet. Ju e dini që në Kod kishit bërë një komision zgjedhor qendror, me të cilin ia latë në qafë Meidanit, shtatë me zero në favorin tuaj. Ju e dini, kolegë të nderuar, se në zgjedhjet e vitit 2001 ndatë zonat elektorale dhe fituat vetëm me ndarjen e zonave. Tetë mandate keni fituar. Kur i keni rindarë zonat për zgjedhjet e vitit 2005, keni pakësuar 4 zona elektorale në qarkun e Beratit dhe në qarkun e Vlorës, dhe i keni shtuar ato, sipas përlllogaritjeve, në Tiranë, në Shkodër, si dhe në vende të tjera.

A e dini ju se në zgjedhjet e vitit 2001 keni bërë ndarje zonash elektorale për Qarkun e Vlorës, ku numri i votuesve ishte më i madh sesa gjithsej numri i popullsisë që kishte ky qark. Ju i keni bërë këto. Megjithatë mbaruan zgjedhjet e vitit 2001, pritet sa doli raporti i OSBE-ODIHR-it dhe u mblodhëm të gjithë së bashku. Janë mbledhur ata që mbrojnë vërtet interesat e Partisë Socialiste. Ne ishim në opozitë dhe ju ishit në pushtet. Atëherë as Edi Rama, as kjo skuadrilla e roselinëve nuk kanë qenë gjëkund, kanë qenë në OJQ. Por një pjesë prej jush

keni qenë këtu kur u bë ndërmjetësimi nga ndërkombëtarët për parimet bazë të Helsinkit dhe pavarësisht se ai që i përfaqësonte këto parime, në emër të OSBE-së apo të ODIHR-it, e kishte emrin Harens, Vaçek, kurse tani Liponen dhe Bosh, ne parimet do t'i zbatojmë njësoj. Më 5 prill të vitit 2002 është nënshkruar marrëveshja politike, që ju e kërkonte edhe sot, ia kërkonte Berishës. Berisha e ka të gatshme marrëveshjen, zotërinj, vetëm mjafton t'i ndryshojë datën e vitit 2002 dhe t'ua sjellë përpara ta firmosni, sepse e ka të firmosur, parimet dhe principet nuk kanë ndryshuar. Ju doni parime dhe principe të tjera kur jeni në pushtet dhe parime e principe të tjera kur jeni në opozitë. Kjo nuk mund të ndodhë. Ajo marrëveshje u nënshkrua nga kryetari i shumicës suaj, ose të paktën i kësaj 1/3-s suaj (jam i sigurt që atë do të vazhdoni ta keni kryetar), Fatos Nano, nga lideri i atëhershëm i opozitës, sot Kryeministri i vendit, Sali Berisha. Në atë marrëveshje ka një çështje që lidhet drejtpërdrejt me këtë që po diskutojmë sot, t'i lemë të tjerat.

Në atë marrëveshje është fiksuar se ç'do të bëhet me listat, me kodin, me gjykatat dhe me gjithçka tjetër. Por ka një pikë 4 në atë marrëveshje, në të cilën është thënë se raporti i OSBE-ODIHR-it i zgjedhjeve të 2001, jo deklaratat, por raporti, kërkonte hetim parlamentar. Shumë nga ju, kur është nënshkruar ai protokoll, kanë qenë kryetarë në Parlament, disa kryetarë në grup dhe disa drejtues të rëndësishëm. Keni qenë rreth e qark dhe e keni duartrokur atë marrëveshje, të cilën ne e kemi pranuar. Berisha e ka pranuar dhe e pranon prapë sot. Pra, hajdeni ta bëni marrëveshjen.

Në pikën 4 të saj, meqenëse edhe çështjet e përkthimit hapnin debat dhe diskutim, janë vënë dy fjalë të huaja në anglisht: "Çështjet që kanë të bëjnë me atë çfarë raporti i ODIHR-it shkruan për termat *"to investigate and to riquare"* do të nënkuptohen, do të perceptohen, si dhe do të zbatohen vetëm sipas pikave 2 dhe 3 të nenit 77 të Kushtetutës". Çfarë kërkonin pikat 2 dhe 3 të nenit 77 të Kushtetutës? Kërkonin hetim parlamentar dhe ngritje komisioni. Por çështja ishte se ne nuk kishim ligj për komisionet hetimore parlamentare dhe nga 5 prilli i vitit 2002, fiks në 2 maj të po këtij viti, ju, kolegë të nderuar, keni miratuar këtu ligjin për komisionet hetimore parlamentare. E keni këtu Kryetarin e Parlamentit, që e ka kaluar atë ligj. Ju e keni bërë ligjin. Ne e pranuan dhe e zbatuan atë për 4 vjet kur ishim në opozitë. E zbatuat edhe ju gjatë 4 vjetve që ishit në opozitë dhe ne në pushtet.

Ka 8 vjet që zbatohet ky ligj.

Tani, meqë ju jeni në opozitë, kërkonti një ligj tjetër. Ligjin që keni bërë vet nuk e pranoni, por ai ligj është për t'u zbatuar dhe nuk mund të ndryshohet sipas periudhave tuaja. Ai ligj mund të ndryshohet dhe përmirësohet vetëm sipas parimeve, kriterëve dhe standardeve të Helsinkit, si dhe standardeve europiane për zgjedhje të lira dhe të drejta. Mos harroni faktin tjetër se të kësaj periudhe janë edhe tri vendime të Gjykatës Kushtetuese: të viteve 2003, 2006 dhe 2007...

Ardian Turku – Zoti Gjana duhet të përfundoni!

Jemin Gjana – ...jo të nxitura nga ne, të nxitura nga ju, të cilat kanë vendosur kriteret përfundimtare se si mund të hetohet dhe deri ku shkon hetimi parlamentar. Këto janë çështje që ju i dini dhe unë nuk e kuptoj se çfarë kërkonti tjetër. Ju jeni duke pritur që të vijë pranvera, që të çelë gjethi, të çelin lulët. Ju garantoj që do të çelë gjethi, kanë çelur thanat, kanë çelur mimozat, do të çelin bajamet, shegët, por kutitë nuk mund të çelen, kolegë të nderuar!

Falemnderit!

Ardian Turku – Falemnderit, zoti Gjana!

Fjalën e ka zonja Ermelinda Meksi.

Ermelinda Meksi – Të nderuar kolegë,

Rrallë ka ndodhur në këta 18 vjet që ky Parlament të ketë një debat politik kaq të rëndësishëm. Prandaj erdha me shpresë në këtë debat se edhe në një shoqëri me plot probleme, si kjo jona, kur ekziston vullneti i palëve, veçanërisht ai i kryetarit të maxhorancës, për ndryshim dhe progres, debati mund të rezultojë me zgjidhje. Aq më tepër që seanca sot zhvillohet në prag të vizitës së Komisionerit të Zgjerimit, ku një mesazh pozitiv për zgjidhjen e krizës politike në vend jo vetëm që do mirëpritëj, por do të kontribuonte për të shtyrë përpara procesin tonë të integrimit.

Nisma jonë politike erdhi në Kuvend si një formë për bashkëpunim mes ngërçit dhe krizës shumëdimensionale që po kalon vendi. Prandaj ne hodhëm në tryezën e bisedimeve draftin tonë dhe pritëm reagimin tuaj konstruktiv. Por, ajo çfarë ndodhi më pas nuk kontribuoi në procesin e mëtejshëm të negociatave për zgjidhjen e krizës. Kjo përbën edhe thelbin e shqetësimit të sotëm ndërkombëtar, prandaj kërkohet sot nga ky Kuvend, veçanërisht nga maxhoranca dhe Kryeministri i saj, pjekuri politike dhe gjakftohtësi në interes jo vetëm për të sotmen, por për të ardhmen e vendit. Hetimi parlamentar që ne kërkojmë është absolutisht i

domosdoshëm dhe kushtetues, si një instrument shumë i rëndësishëm jo vetëm për hetimin e zgjedhjeve që kërkohen sot, por dhe për transparencën e qeverisjes akoma më tepër, sepse "hetim" do të thotë "transparencë".

Të nderuar kolegë,

Megjithëse debati i deritanishëm duket pa rrugëzgjdhje, ne presim që ju të tregoheni të arsyeshëm dhe të dëgjoni më së pari listën gjithnjë e më të gjatë të përfaqësuesve ndërkombëtarë, të cilët kërkojnë jo vetëm kthimin e opozitës në Kuvend, e cila në respekt të kësaj thirrjeje tashmë është në Kuvend, por mbi të gjitha dhënien e së drejtës për hetim transparent dhe të plotë të zgjedhjeve. Ky është praktikisht në momentin aktual pozicioni i të gjitha institucioneve në zë europiane dhe globale. Ky sot është zëri i gjithë mbështetësve socialistë në të gjithë Shqipërinë, në nder dhe interes të të cilëve jemi sot këtu. Por nga kundërshtimi i maxhorancës na lindin natyrisht shumë pyetje. Kush mund ta kufizojë hetimin? Pse vallë dhe në interes të kujt? Kujt nuk i intereson e vërteta dhe kush ka frikë prej saj?

Nga eksperiencia personale në Fier, ku të mbështetur nga komisionerët socialistë dhe populli i këtij qyteti e përreth tij, të cilëve iu përulëm të gjithëve me mirënjohje, mbasi kërkuam me ngulm hapjen e kutive, u vërtetua se në cilën anë qëndronte frika dhe interesi për moshapjen e tyre. Prandaj sot përgjigja e pyetjeve të mësipërme të drejton tek ata që po krijojnë arsyetime pseudologjore dhe virtuale për kushtëzimin e këtij instrumenti ligjor për hetimin.

Me këtë rast, pasi dëgjova përbatimin e Kryeministrit për kujdesin e tij personal ndaj komisionerëve socialistë, do t'i rikujtoja se me gjithë përgjërimin e tij, administrata në varësi të tij i shpërbleu këta zyrtarë shtetërorë, si komisionerë, menjëherë mbas zgjedhjeve me pushim nga puna apo rënie në detyrë.

Zoti Kryeministër, keni rastin të vërtetoni vërtet atë përgjërim që thatë dje, duke i kthyer në vendet e tyre të punës!

Do t'ju jap konkretisht vetëm disa emra nga Mallakastra.

Ju kujtoj se nënkryetari i KZAZ-së në Mallakastër, Naim Hajdëri, mësues në Ballsh, u transferua në një fshat të largët të Greshicës si shpërblim për detyrën e tij.

Robert Shehu, inxhinier në "Albpetrol", si anëtar i grupeve të numërimit, u pushua nga puna, e megjithëse e ka fituar gjyqin, ende nuk është rikthyer

në punë.

Skënder Muharremi, për vite të tëra një nga drejtuesit më të nderuar të arsimit në Ballsh, si komisioner, u ul në detyrën e mësuesit të thjeshtë.

Refat Luka, po njësoj, nga mësues në shkollën e mesme u transferua në një fshat në një shkollë fillore.

Po kështu, Ilir Serani, megjithëse invalid nga këmbët, është transferuar nga fshati i tij në një fshat shumë të largët, ku rruga është shumë e vështirë.

Guri Nuhaj, punonjës në Policinë Bashkiake të Ballshit, si anëtar i KZAZ-së, u pushua menjëherë nga puna. Dhe shumë e shumë të tjerë, që për mungesë kohe, por edhe besimi se ju vërtet mund të bëni ndonjë gjë për ta, nuk po i përmend. E njëjta histori i ka ndjekur komisionerët socialistë në të gjithë Shqipërinë dhe veçanërisht ata të Qarkut të Fierit.

Transparenca, që në parim me fjalë nga ju nuk mohohet qoftë për hapjen e kutive, qoftë për tërësinë e qeverisjes, është jetike për zhvillimin e vendit, në rrugën e atyre standardeve që përshpejtojnë realisht, jashtë retorikës, procesin e integritimit evropian.

Opozita e kërkon këtë transparencë dhe logjika e opinionit të gjerë është me ne. Në të kundërt, mungesa e transparencës po krijon kosto dhe po rëndon në mënyrë të frikshme mbi qytetarët e këtij vendi. Ne mendojmë se mbyllja okulte e problemeve nga maxhoranca është në filozofinë tuaj, e cila nuk tregon fuqinë, por, përkundrazi, dobësinë e saj.

Sot këtu ne na përballen dy koncepte, ai i transparencës, për të gjitha problemet që e prekin këtë vend, që e mbështet opozita dhe e kundërta. Në këtë pikëpamje opozita është në rolin e saj, madje do të thosha kulturalisht shumë më lart se maxhoranca, sepse veçanërisht në kushtet e sotme, kur kriza është shumëdimensionale dhe shumë më e madhe sesa duket në sipërfaqe, transparenca do të ndihmonte për të dalë më me pak dhembje prej saj.

Dalja nga kriza nuk zgjidhet me retorika si deri më sot, por me vullnet politik për kompromis, në vend të sofizmave, që po i artikulojnë shumë nga ju sot. Mungesën e transparencës unë e shoh si filozofi të maxhorancës me një kosto shumë të lartë për shqiptarët. Konkretisht do t'ju theksoj disa aspekte të mungesës së saj në informacionin ekonomik, aq i rëndësishëm për të gjithë ne.

Ne shohim një mungesë të theksuar të transparencës buxhetore për të përballuar krizat e sfidës ekonomike dhe kjo situatë nuk ka nevojë për

koment, sepse, sa herë që Qeveria juaj ka frikë nga realiteti, e shmang informacionin. Mjafton t'ju kujtoj të dhënat e buxhetit të vitit 2009, të cilat përgënjeshtrojnë të gjitha sukseset që shoqëruan deklaratat tuaja në vitin 2009, për të shpjeguar gjithçka që thashë. Ato reflektojnë mosrealizimin flagrant të disiplinës financiare, si dhe rezultatin e mosrealizimit të ndjeshëm të të gjithë treguesve buxhetorë. Mjafton të them se vetëm të hyrat në Buxhetin e Shqipërisë për vitin 2009 përbëjnë një mosrealizim nga 206 në 356 milionë dollarë, në varësi të faktit, nëse do ta krahasoja me buxhetin fillestar të programuar nga ju vjet, me atë fundit që përsëri ju e korrigjuat. Kjo shifër nuk është më shumë apo më pak se sa ai borxh që do të merrni me eurobonde dhe për të cilin po mburreni, por janë shqiptarët që do ta paguajnë në breza me kosto shumë të lartë interesash.

Ka mungesë transparence për rritjen ekonomike, që ju e keni glorifikuar, por që nuk rezultojnë kështu nga të dhënat tuaja. Ndërsa në tremujorin e fundit, rënia e ekonomisë është e evidente.

Nëse vërtet Qeveria pretendon për të kundërtën, na shpjegoni, të nderuar ministra, se, nëse ka rritje ekonomike, pse nuk rriten të ardhurat në buxhet? Apo e thënë ndryshe, kjo vjen nga niveli i lartë i informalitetit dhe i korrupsionit fiskal, për të cilin ju duhet të jepni shpjegime për mungesë reale reformash apo efekt negativ të masave të marra.

Pavarësisht propagandës suaj për rritje ekonomike, treguesit e tjerë ekonomikë përgënjeshtrojnë demagogjinë tuaj. Ne argumentojmë se rënia ekonomike, veç rënies së të ardhurave pasqyrohet në treguesin e aktivitetit tregtar, i cili për vitin 2009 ka rënë si për eksportet, ashtu edhe për importet. Tërheq vëmendjen treguesi i eksporteve, që megjithatë ka një rritje më të lartë seç tha Kryeministri për tremujorin e fundit të vitit 2009, jo 2%, por 13%. Fatkeqësisht, kjo rritje eksportesh nuk reflektohet në rritjen e të ardhurave në Buxhetin e Shtetit, të cilat, përkundrazi, në tetor dhe në nëntor përfaqësojnë një deficit me më shumë se 6 miliardë lekë. Qeveria do të duhej të shpjegonte me transparencë arsytet këtij realiteti fiktiv, në vend të mburrjeve me politikat e saj, të cilat sollën, sipas saj, rritje eksportesh.

Ju lutem, na shpjegoni se cilat janë këto politika? Mburra për rritje eksportesh nuk ka asnjë vlerë, nëse të ardhurat nuk rriten dhe deficit i llogarisë korente nga hyrja e valutës, që duhet të rezultonte nga ky fenomen, nuk është përmirësuar

aspak, por sipas Bankës së Shqipërisë, përkundrazi, është përkeqësuar.

Ç'është kjo rritje ekonomike, që sot nuk e ndiejnë shqiptarët, të cilët, përkundrazi, duhet të përballojnë çmimet e larta nga zhvleftësimi i lekut apo nga rritja e çmimit të energjisë elektrike, që nuk e ndien, për fat të keq, as biznesi, rënia e aktivitetit të të cilit reflektohet nga rënia e të ardhurave në TVSH dhe në akciza që demonstrojnë rezultatet e buxhetit të vitit 2009?

Duke vazhduar me transparencën buxhetore, rezulton se në vitin 2009 kemi pasur një rritje të madhe shpenzimesh, dhe kjo, për fat të keq, vetëm përpara fushatës elektorale, sepse në pjesën e dytë të vitit ka rënë dhe kjo ka shoqëruar edhe rënien e madhe të të ardhurave buxhetore në pjesën e dytë të vitit.

Me këtë politikë shpenzimesh Qeveria nga njëra anë ka mashtruar publikun, por nga ana tjetër ka kryer shpenzime pa efektivitet, për shkak të kostos së lartë të huamarrjes që rezultoi me një deficit buxhetor që në tremujorin e parë të vitit si asnjëherë më parë. Nga ana tjetër, ne kemi dyshime për cilësinë e këtyre punimeve të bëra më nxitim në prag të fushatës elektorale, një pjesë e të cilave ka përfunduar. Mjafton t'ju jap disa shembuj nga Mallakastra për të reflektuar mbi atë çka po ju them. Megjithëse ishte vendosur që rruga e komunës Qendër, Lapulec-Lofkënd, të inaugurohej në tetor të vitit 2009, ka mbetur siç ishte përpara fushatës. Një rrugë tjetër në komunën Fratar, komunë e fituar nga ju, me gjithë propagandën elektorale për rrugë me ndriçim dhe me asfalt, u ndriçua vetëm dy ditë për fushatë elektorale dhe asfalti as sot nuk është hedhur. Në komunën Ngrëshicë, si rrjedhojë e rrëshqitjeve që ka pasur, është bllokuar rruga nacionale deri në fshatin Povël, duke krijuar jo vetëm aksidente në këto ditë, por edhe mungesë të energjisë elektrike për banorët për rreth.

Po të hidhemi në qytetin e Ballshit, do t'i kërkoja ministrave që sot mungojnë dhe, në radhë të parë, Kryeministrit të vendit, vëmendje dhe kujdes, jo vetëm për të gjobitur ato kompani që nuk sigurojnë punëtorët, por vëmendje dhe kujdes edhe ndaj atyre punëtorëve të cilëve po u shtyhet pagesa, nën kërcënimin e falimentimit të një kompanie e cila rezultoi, sipas jush, e suksesshme në privatizimin e saj.

Do të dëshiroja që të më përgënjeshtrojnë për këtë fakt...

Adrian Turku – Ju lutem, përfundoni fjalën!

Ermelinda Meksi – ...sepse është në interes të të gjithë njerëzve që po na dëgjojnë.

Më falni, desha t'ju them, për mungesë kohe, se në këto kushte i kërkojmë Kryeministrit se është në interes të tij të hapë informacionin e kutive për rezultatit e vërtetë të ekonomisë. Me këtë rast i kërkoj Ministrisë së Financave, e cila nuk ka dhënë asnjë të dhënë në lidhje me të dhënat buxhetore të muajve janar, shkurt, mars të vitit 2010, me shqetësimin se viti 2010 do të jetë më shumë probleme, që t'i japë këto të dhëna.

Ne dikur, si socialistë, kishim datën 14 të çdo muaji për t'i dhënë këto rezultate. Ju. Zotërinj. më datën 18 dhe 19 mars...

Adrian Turku – Janë sekonda më shumë, nuk janë pak.

(Diskutojnë në sallë.)

Ermelinda Meksi – Ju lutem, vetëm 10 sekonda!

Adrian Turku – Dakord.

Ermelinda Meksi – Ju falemnderit!

Megjithëse Kryeministri mungon, e di se ai na ndjek nga larg. Doja t'i thosha se INSTAT-i, si një vegël e tij e bindur, jo gjithmonë është në dobi të tij. Po i lë këtu një fakt që INSTAT-i përgënjeshtrohet edhe premtimet e tij, duke mos reflektuar në faqen zyrtare, qoftë edhe ato premtime elektorale për rritjen ekonomike, dhe është akoma me shifrat e vjetra të vitit 2008.

Ju falemnderit!

Adrian Turku – Ju falemnderit, zonja Meksi! Fjalën e ka zoti Ksera.

Spiro Ksera – I nderuar drejtues i seancës, Të nderuar kolegë deputetë,

Duke qenë se kam qenë gjithnjë mbështetës i optimizmit dhe, meqenëse mendova se diskutimet tona dje dhe sot do të ishin të tipit konstruktiv, do t'i sugjeroja opozitës të jetë optimiste. E them këtë sepse, pavarësisht kritikave të shumta dhe të ashpra në adresë të Qeverisë, ajo vetë harron të përmendë faktin se zotëron qeverisjen vendore të një pjese shumë të rëndësishme të vendit. Qytetarët e Tiranës, Durrësit dhe të shumë bashkive e komunave të tjera do të dëshmojnë pas pak kënaqësitë apo pakënaqësitë e tyre mbi ushtrimin e pushtetit vendor nga opozita atje ku ka edhe shumicën. Ndaj dhe të kritikosh pushtetin e tjetrit dhe të mos thuash asnjë fjalë se si e përdor ti vetë atë, është diçka jo shumë e ndershme.

Fatkeqësia e qytetarëve shqiptarë që i besuan votën kryetarit tuaj, mbetja e tij dhe e klanit që ai

përfaqëson në opozitë, sepse ata nuk janë më opozitë reale faktikisht, por mbetja e gjithë së majtës shqiptare në opozicion me logjikën dhe frymën optimiste që duhet të karakterizojë forcat progresiste, xhelozia e zezë dhe e pashoqe që përfaqësuesit opozitarë tregojnë ndaj hapave përpara të vendit dhe ndaj afrimit të datës së heqjes së vizave për qytetarët shqiptarë, është tregues i mangësisë dhe i logjikës demokratike.

Në një periudhë të vështirë ekonomike për të gjithë aktorët apo faktorët institucionale dhe njerëzorë kudo në botë, opozita shqiptare, e zhytur në anakronizmin e vet, ka vetëm një slogan: atë të hapjes së kutive.

I dhashë dimension pushtetit vendor për të treguar se është më mirë të përdorni sloganin: "Mirë do të jetë të mos futemi në zgjedhjet vendore". Unë e di shumë mirë se ju e përdorni hapjen e kutive për të gjetur pretextin e radhës, sepse i trembeni faktit që afrimi i datës së zgjedhjeve vendore ka të bëjë me kuti të tjera dhe, këtë radhë, menaxhimi i kutive nga ana juaj do të jetë shumë i vështirë.

Opozitarët kanë muaj që tregojnë shpikje të tilla dhe barsoleta pa fund, duke u përpjekur dhe duke luftuar çdo ditë të fusin vendin dhe institucionet e tij në krizë, me shpresën e vetme të marrjes në mënyrë jo të ndershme dhe jo të drejtë të asaj që të qytetarët ua mohuan me votën e tyre plebishitare.

Socialistët shqiptarë nuk mund të merren vesh mes tyre, por kjo nuk është një kauzë që u përket qytetarëve tanë. Ata kanë prishur shtëpinë e tyre politike dhe tani kërkojnë të prishin edhe vendin. Por kjo nuk është një kauzë që duhet mbrojtur apo inkurajuar nga kushdo qoftë.

Hyrja e opozitës në Parlament është një përpjekje e lavdërueshme, por është shumë i dënueshëm qëndrimi i saj aspak serioz ndaj ligjit dhe Kushtetutës me kërkesat e pafundme dhe qesharake për të filluar rihapje dhe rinumërim votash nga Parlamenti, ndërkohë që u deshën ditë të tëra që me dhjetëra e mijëra komisionerë të kryenin të njëjtin proces. Interesi i vërtetë i opozitës duhet të jetë vazhdimi i reformave dhe jo pengimi i tyre dhe interpretimi i përpjekjeve qeveritare dhe qytetare për t'i kthyer ato në të tepërta.

Nëse brenda radhëve të socialistëve dhe deputetëve të sotëm ka nostalgji për të keqtrajtuar demokracinë, ky është një problem që duhet ta zgjidhni vetë ju me veten tuaj.

Duke iu rikthyer optimizmit, besoj se rrugët dhe autostradat e reja që po ndërtohen jo vetëm në terren,

por edhe në mendjen e shqiptarëve, janë garanci e integritit tonë të plotë. Lëvizja e lirë për të gjithë ne do të ndodhë përpara pushimeve të verës. Ndërsa ndërtimi, zgjatimi, zgjerimi apo edhe shtimi i akseve kombëtare dhe rurale na ka sjellë më pranë Europës.

Besoj te ky dinamizëm i ekonomisë dhe i njerëzve optimistë në Shqipëri, ashtu siç besoj te çrrënjosja e varfërisë ekstreme dhe te përkujdesja sociale. Besoj në realitetin e pagave dhe pensioneve të rritura, ashtu siç besoj tek taksat e ulëta, siç besoj në goditjen e pa ndërprerë ndaj dhunës në familje dhe shoqëri. Është e vërtetë se nuk ka asgjë më të rëndësishme për ne sesa turravrapin në ekonominë e vendit, në ekonominë e gjithsecilit prej nesh, sesa ulja e shpenzimeve administrative, ulja dhe reduktimi i burokratëve dhe burokracisë, fillimi i veprave të mëdha infrastrukturore dhe energjetike, rritja e ndihmës ekonomike dhe e paaftësisë së kufizuar për shtresat në nevojë. Forcimi i fytyrës sociale të shtetit dhe reformat janë paketa që ofron filozofia e qeverisjes aktuale. Lajmëtarët e Parlamentit European, nëpërmjet Eduard Kukan, shef i delegacionit për Ballkanin, dhanë mesazhin e pranverës për vendin tonë. Mund të ndodhë që ky mesazh të mos jetë marrë seriozisht nga opozita, por sërish ky nuk është më problemi i qytetarëve tanë. Më vjen keq edhe për ndonjë koleg timin, që e kam nga anët e mia. Faktikisht, njëri nuk vjen fare, kurse tjetri na flet për transparencë dhe për leksione se ç'është liberalizimi i vizave. Unë i diktoj: le të bëjë njëherë transparencën në popullin e minoritetit dhe të sqarojë pse e shkërmoqi partinë e vet, pse për herë të parë vendosi të gjente një aleat, kur e dinte fare mirë, (dhe këtë e diktonte Kodi Zgjedhor), që do të ishte i humbur. Mos të na thotë ne dhe minoritarëve të bëjmë transparencën e kutive. Nuk është e rastësishme që faji t'u ngelet kutive dhe një populli siç është minoriteti, që ka mbështetur me vite ideologjinë e majtë dhe ka duruar presionin e PS-së të strukturave të saj. Unë mendoj se rezultatet duhen respektuar. Demokracia na imponon që ta njohim rezultatit. Demokracia në Shqipëri - dhe këtë e kam besim në vetvete - ka arritur në atë fazë që humbësit ta pranojnë dhe t'ia japin dorën fituesit. Për mendimin tim, kjo është zgjidhja e krizës dhe e këtyre debateve që bëjmë këto ditë në Parlament: pranimi i humbjes dhe vazhdimi, edhe nga opozita, i mbështetjes së reformave aq të domosdoshme, që i kërkon vendi në këto ditë historike.

Falemnderit!

Ardian Turku – Falemnderit, zoti Ksera!

Fjalën e ka zoti Ilir Gjoni.

Ilir Gjoni – Të nderuar kolegë,

Seanca që filloi dje dhe po vazhdon edhe sot, në fakt, duhej të ishte një seancë shprese për popullin që i ka kthyer sytë nga Kuvendi. Por, fatkeqësisht, kjo është kthyer në seancën e dëshpërimit. Të dëshpërimit pasi po vritet shpresa për të ndërtuar një Shqipëri ku të mbisundojë shteti ligjor, ku qytetari ta ndiejë veten të lirë e të përfaqësuar denjësisht. Të dëshpërimit pasi dje qytetarët shqiptarë panë se si Kryeministri vazhdon të bëjë sikur nuk e kupton çka kërkon opozita, duke u përpjekur në mënyrë bajate dhe infantile të luajë me kartën e komisionerëve socialistë, të cilët i ka dhunuar, poshtëruar, rrahur, lënë pa punë e nëpërkëmbur jo vetëm në rastin e këtyre zgjedhjeve, por gjithmonë kur i është dhënë mundësia. Po ky Kryeministër, i cili përbetohet se do t'i mbrojë komisionerët socialistë, është i njëjti person që, kur ishte President, urdhëronte falangat e tij të rrihnin e masakronin po këta komisionerë socialistë. Po ashtu, dje, u hodh ideja ogurzezë e krijimit të një prokurorie speciale dhe, si për kohëzgjatje, Kryeministri përmendi shifrën 100, ndërkohë që një ministër i kabinetit të tij, me mjaft erudicion dhe elokuencë, e hodhi poshtë këtë ide, duke iu referuar komitetit të njëqindëve të Revolucionit Francez. Dje, në mënyrë të përsëritur, dëgjua me zoti Berisha dhe zonja Topalli kërkojnë me ngulm faktin. Ne jua kemi thënë dhe jua përsërisim: faktin e keni brenda në kutitë e votimit. Por, çdo e keqe e ka edhe një të mirë: ndonëse dje seanca ishte dëshpëruese, pati edhe një element, do të thosha, pozitiv: dje u formalizua përfundimisht, nga ana e Berishës dhe të tijve, njohja e Kushtetutës së Shqipërisë. Ka qenë ky person dhe gjithë të tjerët që nuk e kanë votuar, e kanë anatemuar dhe e kanë nëpërkëmbur këtë Kushtetutë të hartuar dhe miratuar prej nesh, gjatë më shumë se një dekade. Me sa duket, këtyre u ndizet llamba me vonesë, por më mirë vonë sesa kurrë! Ne socialistët besojmë në faktin se çdo e drejtë nënkupton një përgjegjësi, çdo mundësi një detyrim, çdo posedim një detyrë. Ne besojmë se ligji është bërë për t'u shërbyer qytetarëve dhe qytetarët ligjit, se Qeveria është shërbëtorja e qytetarëve dhe jo padronia e tyre. Ne besojmë se e vërteta dhe drejtësia janë fundamentale për një kohezion shoqëror të qëndrueshëm. Për këto arsye opozita shqiptare sot ndien përgjegjësinë dhe ka detyrë prioritare që t'i kthejë normalitetin jetës së qytetarëve të këtij vendi.

Ju erdhët në pushtet më 28 qershor përmes një procesi të manipuluar, të gatuar në zyrat e pushtetit, që ju e përdorët për interesat tuaja partiake. Manipulimi i zgjedhjeve te ne është kthyer në një sëmundje terminale, për të përdorur termat e "doktorit", e cila nuk do të lejojë kurrë që demokracia të ecë përpara në Shqipëri në atë mënyrë, siç e dëshirojnë të gjithë shqiptarët. Kjo është një sëmundje, të cilën ne si shoqëri duhet ta konsiderojmë po aq të përbindshme, të frikshme e vdekjeprurëse sa edhe terrorizmi, tradhtia, grabitja me armë dhe vrasja, nëse i marrim në konsideratë të gjitha dëmet që i ka shkaktuar ky fenomen Shqipërisë, në këta gati 20 vjet, dhe se si ajo po e hipotekon të ardhmen tonë. Nisur nga kjo premisë ka ardhur edhe reagimi ynë. Ne, ndonëse të bindur në padrejtësinë e rrëmbimit të pushtetit nga ju, e pranua atë për faktin e thjeshtë se nuk dëshironim të dilnim kundër vendimeve të instancave kompetente, të ngarkuara me administrimin dhe gjykimin e procesit, por ne, në asnjë mënyrë, nuk mund dhe nuk duhet t'i lejojmë vetes të mbyllim sytë e ta lëmë fenomenin të fermentohet e të vijojë të na brejë pafundësisht në spiralen e vet të krizave, nisur nga kjo bëmë edhe propozimet tona për ngritjen e komisionit hetimor dhe ndryshimin e ligjit për hetimin e zgjedhjeve.

Zotërinj të pushtetit të pamerituar,

Rrallë ndodh që e vërteta është e ëmbël. Ajo pothuajse, pandryshueshmërisht është e hidhur dhe kjo u provua katërçipërisht dje, duke parë reagimet e paargumentuara dhe demagogjike të vetë Kryeministrit. Mungesa e kurajës për t'u përballur me të vërtetën është tipari kryesor që e karakterizon këtë Qeveri. Këtë gjë e treguat edhe mbrëmë e po vazhdoni edhe sot, por kjo nuk është gjë tjetër veçse simptoma e parë e fillimit të fundit tuaj. Mungesa juaj e kurajës për të hapur kutitë e votimit, për të bërë transparencën e procesit ju bën fajtorë dhe ju ngarkon me përgjegjësi për frenimin e të gjitha proceseve demokratizuese dhe integruese të vendit. Rrjedhojë e këtij pushteti të pamerituar është gjithçka që përjetojnë shqiptarët sot: varfëria, skamja, krijimi i korrupsionit, trafiqet, niveli i mjerueshëm shëndetësor, dhuna politike e policore dhe pasiguria e jetës. Por nuk janë vetëm këto. Në mungesën e dëshirës apo kurajës tuaj për t'u përballur me të vërtetën, qëndron edhe hilja, si një tipar që ju ka karakterizuar gjatë tërë jetës suaj politike. Ju dhe drejtuesit tuaj nuk duan që të hapen kutitë, pasi nuk e duan opozitën në Kuvend. Nuk e duan në

Kuvend, pasi duan dorë të lirë për të bërë zullumet e tyre të pafundme. Ju nuk e doni opozitën, pasi nuk doni kontroll ndaj abuzimit me financat publike, ndaj abuzimit me tunelin e Kalimashit, ndaj abuzimit me energjinë elektrike dhe përmbytjet e shkaktuara nga babëzia. Nuk e doni opozitën, pasi doni që marrëveshjet famëkeqe detare, në dëm të interesave kombëtare, të kalojnë pa u hyrë gjemb në këmbë. Ju nuk e doni opozitën në Kuvend, pasi doni që edhe ligjin “Për Shërbimin Informativ Shtetëror” ta kaloni pa u bezdisur, që buxhetin ta kaloni pa ju dalë lakrat në shesh.

Ju e keni kthyer politikën në një karikaturë obeze, të trashur nga pasuritë e paligjshme, rrëmbyer popullit dhe kjo e mishëruar në një kast tipike, që, i sëmurë nga bulimia, ka infektuar tërë aparatit shtetëror. Një politikë që ka çuar në rrënimin e jetëve të mijëra shqiptarëve, të majtë dhe të djathtë, një politikë vetëvrasëse, pasi është mbërthyer në ciklin e grumbullimit të pushtetit për të grumbulluar më shumë para. Më shumë para për të marrë më shumë pushtet e përsëri më shumë pushtet për të bërë më shumë para. Sot pjesë të rëndësishme të shtetit shqiptar po kalben nga brenda. Korrupsioni sistematik është i pranishëm në të gjitha nivelet. Një numër i madh zyrtarësh të lartë të kësaj Qeverie, përfshirë ministra e familjarë pushtetarësh, janë akuzuar për përfshirje në afëra korruptive. Lirimi nga ana e Berishës i një numri kriminelësh në periudhën zgjedhore ka ngritur pikëpyetje serioze rreth angazhimit të Qeverisë për vendosjen e shtetit ligjor.

Zotërinj të pozitës,

Shteti po ju shembet nën këmbë. Siguria në vend përkeqësohet çdo ditë. Brenda një jave vetëm në qytetin e Shkodrës ka pasur dy tentativa për vrasje me tritol: njëra ishte ndaj një përfaqësuesi të sistemit të drejtësisë dhe tjetra, jo më larg se pardje, ndaj një përfaqësuesi të medias. Këto janë dy pushtetet që ju ende nuk keni mundur t'i akaparoni plotësisht për t'i vënë në funksion të interesave tuaja. Do të ishte e pafalshme të mos kujtonim sot aktin makabër të vrasjes së kolegut tonë, njeriut zemërbardhë e gojëmbël, Fatmir Xhindit, dora vrastare e të cilit ende ka mbetur e pazbuluar, ndonëse ministrat tuaj kanë deklaruar disa herë që kanë identifikuar vrasësit. Trafiket e drogës e të qenieve njerëzore, sipas raporteve më të fundit që vijjnë nga Shtetet e Bashkuara, nga Britania e Madhe, si dhe nga statusraporti i BE-së, ngelen probleme shqetësuese. Lufta kundër krimit të organizuar, po sipas këtyre raporteve, mbetet ende

në fazat fillestare, por, pavarësisht dhe përveç kësaj gjendjeje të rëndë, lidhshipi juaj e ka çuar vendin në një pikë nga ku është shumë e vështirë për t'u kthyer në normalitetin e kulturës qytetare dhe asaj politike. Seanca e djeshme dhe e sotme janë prova të gjalla të kësaj. Arena politike, falë fjalorit banal të drejtuesve tuaj, tashmë ka degraduar në sulme personale dhe do të duhej një përmbyse e madhe për të rikthyer vlerat e rrënuara të standardeve të edukatës politike, që do të lejonin një debat të arsyeshëm mbi çështje të rëndësishme të vendit, siç është edhe çështja që diskutojmë sot. “Opozita, - ka thënë zoti Berisha, - tregoi se është më antishqiptare, më antidemokratike. Këtyre zotërinjve nuk u dridhet dora për të dënuar Shqipërinë!” dhe po aty vijon “I garantoj...”, pra neve na garanton opozitën “...në një bashkëpunim luajal”, ndërkohë që edhe dje na foli për oferta “të sinqerta”. Po kush është ai budalla, kush është ai person që beson Berishën dhe mendon se atij i digjet barku për opozitën?! Dhe këtë e ka provuar me fakte. Është pikërisht ky demagogjizëm populist, që e bën Berishën një kërcënim serioz për demokracinë, sidomos aftësia e tij për të maskuar fanatizmin e tij brutal, pas një fasade konvencionaliteti, kurdo që kjo i nevojitet. Kur e sheh në interes të tij të tërheqë favorët e aktorëve influentë, sidomos partnerëve ndërkombëtarë, ai duket i edukuar, i sjellshëm, madje edhe i gjunjëzuar, ndërkohë që brenda një fjalie ai ka dy qëndrime diametralisht të kundërta, siç ishte rasti i sipërpërmendur.

Për ta mbyllur, po ju kujtoj edhe një herë rastin e “Ruzhdies”. Ju e mbani mend qarkoren e nxjerrë nga drejtori i përgjithshëm i Policisë, më 17 shkurt të vitit të kaluar, kur urdhëronte strukturat e policisë që të bënin verifikimin e shtetasve, kryesisht të atyre që ishin në emigracion. “Ruzhdia” provoi se ai informacion është përdorur pikërisht për këtë gjë. Ne ju bëjmë thirrje që të mendoheni mirë përpara se të ndërmerreni një hap, i cili do të ketë pasoja të mëdha për vendin dhe për ju, si forcë politike. Pushteti juaj ilegjitim do të vazhdojë të prodhojë, përndryshe, veçse ilegjitimitet.

Falemnderit!

(Ndërkohë, drejtimin e seancës e ka marrë zonja Topalli.)

Jozefina Topalli – Zoti Xhaferri, urdhëroni!

Ferdinand Xhaferri – E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

E ndoqa me vëmendje edhe kolegun parafolës

dhe të gjitha diskutimet tuaja politike të nisura që dje. Grupi juaj parlamentar, afro nëntë muaj pas zgjedhjeve të 28 qershorit, pati mundësinë e parë për debat parlamentar. Folën deputetë të rinj, të cilët duken që kanë premisa për t'u bërë politikanë të këtij vendi, sikurse folën edhe deputetë që kanë nga gjashtë apo edhe më shumë mandate në këtë Kuvend. Një gjë më bëri përshtypje: filli i përbashkët ishte modeli i njëjtë i diskutimi: e filluat me fjalinë e parë për zgjidhje dhe transparencë dhe më pas në gjithë retorikën harrohej zgjidhja, harrohej transparenca, kriza ekonomike dhe dështimet e Qeverisë; vijuat me diskutime politike që vetëm zgjidhje dhe transparencë nuk kërkojnë. Ky është një refren që kemi nëntë muaj që po e dëgjojmë dhe kemi detyrimin t'u shpjegojmë shqiptarëve pse. E gjithë retorika juaj politike, e konfirmuar edhe sot, justifikon vetëm një vendim që Edi Rama e ka marrë tashmë: ai ka vendosur t'ju lërë jashtë Parlamentit, ka vendosur t'ju lërë jashtë institucioneve, ka vendosur t'ju lërë jashtë sistemit demokratik.

Folët për krizë ekonomike. Të nderuar zotërinj, do të ishte normale që ne sot të ishim mbërthyer edhe nga një debat për krizën ekonomike. Ajo ndodh sot në çdo parlament. Ajo ndodh në çdo parlament të Europës. Dhe ne ndoshta në qoftë se rënia ekonomike e Shqipërisë do të ishte minus 5% apo 8%, siç ndodh në shumë ekonomi të Europës, mund të ndodheshim në pozicion të vështirë sot.

Ju flisni për krizë ekonomike dhe nuk përmendni rritjen ekonomike të certifikuar nga Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar si një nga ekonomitë e pakta në Europë me rritje ekonomike, dhe kjo është shenjë e mbarë.

Flisni për krizën ekonomike dhe thoni se nuk ka spital në një fshat të Shkodrës apo ndonjë familje në Tepelenë vuan për bukë. Shkoni një herë në katër vjet dhe e keni konstatuar. Jo, more zotërinj, në çdo qytet të Shqipërisë, edhe në Durrës, ka akoma familje që nuk e kanë ndier dorën e Qeverisë dhe mund të jenë në vështirësi ekonomike, por ne kemi kurajën t'u kërkojmë falje atyre familjeve, për të cilat deri më sot nuk kemi bërë aq sa duhet.

Por një gjë duhet pranuar: ecuria e ekonomike e vendit është e mbarë, është shenjë shumë e mirë për ekonominë shqiptare që eksportet në 2 muajt e parë të këtij viti u rritën me 103% dhe, në qoftë se në disa vende të rajonit pagat janë ulur edhe me 8%, Kryeministri konfirmoi se edhe për vitin 2010 do të kemi rritje pagash.

Pra, vendi nuk ka as krizë ekonomike, as krizë

politike, as sociale. Ka vetëm një krizë: Sot në krizë është axhenda personale e Edi Ramës me sistemin demokratik. Pse? Çfarë ka ndodhur? Në qoftë se hedhim një sy mbrapa, ka shumë përkufizime për demokracinë. Përkufizimi më konsensual është ai që thotë se demokracia është një sistem ku partitë konkurrojnë në zgjedhje. Ç'dua të them me këtë? Në qoftë se shohim zgjedhjet e vitit 2007, Edi Rama ka parë që koalicioni i PD-së ka marrë më shumë se 100 mijë vota krahasuar me koalicionin e PS-së. Në qoftë se shohim zgjedhjet politike të vitit 2009, Edi Rama ka parë që koalicioni i PD-së ka marrë më shumë vota se koalicioni i PS-së. Në qoftë se këtu i shtohet edhe aleanca me LSI-në, atëherë Edi Rama ka parë se politikisht është i mbaruar.

Ku është konflikti? Edi Rama e ka kuptuar - sepse është në gjendje të lexojë dhe të lexojë mirë -se me zgjedhje të lira dhe të ndershme nuk e mund dot aleancën PD-LSI. Pra, ai ka kuptuar se me sistem zgjedhjesh të lira e të ndershme nuk mund të vijë dot në pushtet në Shqipëri. Kjo e detyron që si rrugë për të mbijetuar politikisht të zgjedhë atë të daljes jashtë sistemit. Kjo është e vetmja krizë dhe prandaj ka sajuar problemin e kutive, thjesht për të bërë zhurmë dhe për të justifikuar sjelljen e tij jashtë sistemit.

E doni zgjidhjen me transparencë, me konsensus e me dialog? Këtë nuk mund t'ua ofrojë as modeli i ofertës që ofron Sali Berisha, as ai që ofron Edi Rama, por vetëm ai që ka ofruar Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës më 28 janar. Në pikën 7 të rezolutës ajo i kërkon Qeverisë që të ngrejë një komision hetimor parlamentar, i cili do të respektojë vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Nuk ka thënë as *may*, as *can*, ka thënë *ëill*, që është detyruese në anglisht. A nuk e dinin ekspertët e Këshillit të Europës, që është organizata më vjetër në Europë për sa i takon institucioneve demokratike, se ju kishit 6 muaj që kërkonit hapjen e kutive? Pse nuk e kanë shënuar në rezolutë që të ngrejë komisionin hetimor parlamentar që do të synojë hapjen e kutive? Sepse është jolegjitime.

Pra, zgjidhja transparente dhe konsensuale është këtu. Keni 6 muaj që keni kërkuar kutitë. Rezoluta thotë të ngrihet komisioni duke respektuar vendimet e Gjykatës Kushtetuese.

Së fundi, për të përligjur me fakte që ai zotëria kërkon t'ju lërë jashtë sistemit, po ju përmend fjalët e kryetarit të grupit parlamentar socialist, të thëna 9 muaj më parë te BBC-ja: "PS-ja nuk do të bojkotojë Parlamentin, ndonëse e quan Qeverinë pa

mandat politik legjitim”.

Më 29 korrik, jo vetëm kryetari i grupit parlamentar socialist, por shumë nga ju kanë thënë se nuk do ta bojkotoni Kuvendin. Pse e bojkotuat Kuvendin për 9 muaj? Sepse axhenda personale politike e Edi Ramës ju kërkoi jashtë sistemit.

Të nderuar zotërinj,

Kutitë janë thjesht daullet që ai ka zgjedhur për të bërë zhurmë për të justifikuar sjelljen jashtë sistemit. Ka vendosur t’ju lërë jashtë, të endeni bareve të Tiranës. Kjo është zgjedhja juaj, por dijeni mirë se nuk mund të shkoni më shumë se endja jashtë sistemit, se, po kërkuat më shumë, nuk keni hyrë në konflikt as me Sali Berishën, as me maxhorancën, keni hyrë në konflikt me sistemin demokratik në vitin 2010, dhe kjo nuk mund të ndodhë. Pra, ju keni vendosur të endeni jashtë sistemit, ne kemi vendosur të merremi me reformat dhe dhurata më e mirë që do t’u bëjnë shqiptarëve për vitin 2010 është liberalizimi i vizave.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Xhaferri! Fjalën e ka Luiza Xhuvani.

Luiza Xhuvani – Falemnderit, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ndoshta si ne, ashtu si populli që përfaqësojmë, u lodhëm duke e dëgjuar lajtmotivin e logjikshëm, të moralshëm, të ligjshëm: “Hapni kutitë”. Unë do t’ju thosha, të nderuar deputetë të maxhorancës, hapni ndërgjegjen tuaj! Vetëm kështu do ta nxirrni këtë vend nga kulla e ngujimit. Këtu qëndron mëma e së keqes: te mashtrimi i parë, te pabesia e parë. Më pas fillon shurdhëria, miopia juaj, pa dashur të shtoj epitete të tjera, që s’do të doja të ishin të vërteta. A jeni të ndërgjegjshëm se pa transparencën e zgjedhjeve ju po rrezikoni të ardhmen e demokracisë dhe kjo të çon në nëpërkëmbjen, përçudnimin e dinjitetit të qytetarëve shqiptarë, atë dinjitet që regjimi komunist me aq përkushtim e deformoi dhe me aq brishtësi këto vite demokracie po përpiqemi ta ringjallim? Po ta mendosh këtë kthim mbrapa, është shumë e frikshme.

Një shtet i dalë pa vullnetin qind për qind të lirë të popullit të tij, s’ka sesi t’i shërbejë atij. Ai i përngjan asaj gruas shterpë, që nuk e ndien dhimbjen e lindjes dhe dhembshurinë e bijve. Me trishtim dhe me protestë u them qytetarëve shqiptarë se po luhet një shaka e keqe, cinike, fyese.

Ç’ndodhi *post factum* me Gërdecin? Ju nuk kërkuat falje. Ju shpërblyet viktimat, bletë shpirtrat e të vdekurve. Por ka gjëra që nuk blihen kurrë dhe

cinizmi juaj vazhdon jashtë çdo imagjinate. Emërohet ministër i Mjedisit një burokrat, i cili duam apo s’duam ne mban përgjegjësi, të paktën, për ndotjen kimike të atij mjedisi ose vendi krimi. Nga vjen kjo? Nga moshapja e ndërgjegjes, e cila të çon në mosbërjen e katarsisit, të nderuar zotërinj. Dhe gjërat përsëriten. Ç’ndodhi pas përmytjes në ultësirën e Shkodrës? Nuk kërkuat falje, por shpërblyet aq sa mundët dhe cinizmi prapë vazhdon.

Këto tragjedi njerëzore ju i ktheni në fushata plot mburrje e lavdërime, ku i vetmi fajtor na del zotni “Shiu” dhe zonja “Bora”. Ja si prishet dinjiteti i viktimës, i qytetarit, i fshatarit! E për më keq, kjo nuk ndodh vetëm në këto tragjedi të mëdha, por edhe në ditë me diell.

A e dini ç’po ndodh në Sarandë? Dini, po dini vetëm pak, vetëm atë që është botuar në faqet e para të gazetave, që 450 familje do të lihen në rrugë të madhe. Por a keni dijeni edhe për varfërinë ekstreme të shtrirë në të gjithë zonën, për njerëzit që qajnë për bukën e gojës, për komunitete të diferencuara nga pushteti vendor në infrastrukturë, shërbime sociale e deri për genocidin politik, që në emër të reformave në administratë e arsim po pushon nga puna përfaqësues të PS-së deri në nivele kryetarësh? Ky kalvar vazhdon me konfuzionin total të krijuar në lidhje me pronat në bregdet. Ja, përsëri me ndërgjegje të mbyllur! Pse? Se nuk fituat ju në Sarandë, por fituam ne, madje me aq diferencë sa asnjë lloj manipulimi nuk do të funksiononte, por populli ka vetëm një mbiemër: shqiptar.

Nuk e kuptoni që me dashjen apo pa dashjen tuaj, po mbillni urrejtje mes njerëzve të një fshati, të një lagjeje, të një kulmi, që shiu i lag njësoj, që era ua rreh fytyrën njësoj, që fëmijët i edukon njësoj, i njëjti mësues, i mirë apo i keq, i majtë apo i djathtë?

Edhe pse eksperiencia ime si deputete është e paktë, që të ndiesh erën e keqe nuk duhet ndonjë hundë shumë e hollë. Ju të gjithë i dini të vërtetat, edhe gënjeshttrat, më mirë se unë, pasi ato këtu fabrikohen, ose gjetkë dhe këtu marrin stampën “*made in*”. Personalisht unë kostumin e deputetit nuk e shoh si uniformën e një ushtari besnik, pa sy, pa veshë e pa ndërgjegje.

Ndaj do t’ju thosha se nuk është mirë për askënd të lindë pyetja: për kë bien këto kambana? Hapni ndërgjegjen! Thuajini popullit të vërtetën në sy, që në zemrën tuaj të mos këndohen veç psalme.

Pa dyshim mbrëmë si për të gjithë dhe për mua ka qenë një natë e gjatë dhe reflektive. I drejtohem zotit Kryeministër, duke vlerësuar

inteligjencën, energjinë dhe retorikën e tij, duke i thënë me respekt: bukur e perifrastuar kompleksin e Edipit, po ashtu cituat edhe Shekspirin. Kjo më jep shtysën profesionale t'ju them se ju personalisht vuani kompleksin e Akilit. Por ne jemi më të moderuar se antikiteti. Nuk do të ngremë shigjetën. Le ta quajmë thembrën hapjen e kutive.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Zoti Mediu, për replikë.

Fatmir Mediu – Falemnderit, zonja Kryetare,

Desha t'i them deputetes së ardhur në Parlament që natyrisht e vlerësoj hapjen, por mos u hap më shumë se ç'duhet se të bën dëm dhe kostumi i deputetes që do të veshësh nuk të jep seriozitet as me lotët e hipokrizisë dhe as me recitimet e teksteve që të jep kryetari i partisë.

Prandaj, në qoftë se vërtet ke ardhur të bësh rolin e deputetit këtu, është mirë që të kesh atë autoritet që mendon se duhet të kesh, të kesh individualitetin tënd dhe jo recitimet apo, edhe një herë po ta përsëris, lotët e hipokrizisë për ato që ti mendon se janë qëllimet e tua në këtë jetë parlamentare.

E ke filluar pak mbrapsht dhe do të desha që ta filloje mbarë. Nuk ecet mbrapsht.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit!

Zoti Spaho, urdhëroni!

Edmond Spaho – Falemnderit, zonja Kryetare, Të nderuar kolegë,

Prej muajsh Partia Socialiste po bën të gjitha përpjekjet për të diskredituar zgjedhjet e 28 qershorit me pretendimin për manipulime, si dhe kërkon t'i hetojë ato duke hapur kutitë e votimit. E drejta e opozitës për të hetuar është një e drejtë ligjore, por duhet të respektojë Kushtetutën e vendit dhe interpretimet e Gjykatës Kushtetuese, si dhe të jetë e mbështetur në fakte dhe prova.

Për të garantuar transparencën, maxhoranca i ka ofruar opozitës shumicën në komision, si dhe gatishmërinë të miratojë çdo propozim të tyre për përmirësime në Kodin Zgjedhor. Partisë Socialiste, pavarësisht pretendimeve të saj, ju plotësuan të gjitha kërkesat, shumë herë të ekzagjeruara, për zgjedhjet e vitit 2009. Ato u zhvilluan me sistemin zgjedhor që dëshironte opozita. Kodi Zgjedhor u propozua dhe u miratua vetëm sipas formulimeve të Partisë Socialiste. Veç dy partive kryesore e ndonjë aleati të tyre, roli i partive të tjera ishte i kufizuar, sepse kështu deshte Edi Rama.

Shqipëria është i vetmi vend ku OSBE-ja dhe

ODIHR-i vrojton zgjedhjet, që opozitës iu dhanë koncesione të tilla.

Me përfundimin e zgjedhjeve Edi Rama i përshëndeti ato, duke thënë se fitoi demokracia dhe vendi, por kjo deri në çastin kur pa që nuk kishte fituar ai. Sapo Edi Rama e kuptoni që humbi, ka 10 muaj që e dëgjojmë të thotë se zgjedhjet janë manipuluar dhe popullit opozitar i është ndryshuar vota gjatë procesit të numërimit, por pa paraqitur asnjë provë të vetme.

Procesi elektorale i vitit 2009 ka qenë më transparent në historinë e zgjedhjeve, pasi numërimi i votave u bë në mënyrë të përqendruar, në salla të hapura, në prezencë të kujtudo që dëshironte të merrte pjesë, në prezencë të vëzhguesve të të gjitha partive politike e të vëzhguesve ndërkombëtarë, në prezencë dhe në transmetim direkt të medias televizive. Në çdo grup numërimi PS-ja kishte jo më pak se dy anëtarë, të cilët kontrollonin dhe mbledhnin çdo votë, dhe çdonjëri, për çdo votë që dyshonte, kishte të drejtë të ndërpriste procesin, të bënte verifikimin ose të kërkonte numërimin nga e para. Paralelisht fleta e votimit vendosej në skaner dhe dilte në monitor.

Për të garantuar votat, ju ndërmorët edhe një masë sigurie ekstra, duke vendosur përballë çdo monitori një grup prej tre-katër vetash, të cilët mbledhnin votat në favor të PS-së, pavarësisht njëritjetrit dhe i rakordonin në përfundim të numërimit të çdo kutie me rezultatin që ju jepnin numëruesit tuaj zyrtarë. Në çdo sallë ku numëroheshin votat, ishin 2-3 deputetë të PS-së që mbikëqyrnin dhe koordinonin punën mes grupeve të numërimit dhe atyre të vrojtimit. Si është e mundur në këtë rast që rezultati të manipulohet?

Si është e mundur që, madje dhe sot në këtë debat, kur kërkohet ngritja e një komisioni hetimor, të mos paraqitet asnjë fakt, asnjë procesverbal, shënim a kundërshtim, që të provojë këtë përfundim përveç retorikave politike?

Një diskutant socialist u shpreh dje se pati manipulime edhe në Devoll, kurse një zonjushë kërkoi transparencë të dinte se kush ka votuar në Korçë. Zotëria dhe zonjusha janë në kontradiktë me kryetarin e deputetëve të PS-së në qarkun e Korçës, i cili më se një herë ka deklaruar publikisht se në Korçë zgjedhjet kanë qenë të rregullta, nuk ka pasur manipulime dhe nuk u vodhën vota, por vetëm humbi Edi Rama.

Retorikës suaj i përgjigjet raporti i OSBE-ODHIR-it, i cili theksoi se ishin zgjedhjet më të mira

që ka organizuar vendi ynë dhe se pretendimet e opozitës për manipulime nuk mbështeten në asnjë fakt. Opozita kishte shumicën vendimmarrëse në gjysmën e qendrave të numërimit, bashkë me kryetarin dhe asgjë nuk e pengonte jo vetëm të bënte shënime në procesverbale për parregullsitë e pretenduara, por edhe të nxirrte cilëndo kuti të pavlefshme. PS-ja i ka dorëzuar listat e komisionerëve vetëm një ditë përpara mbylljes së fushatës zgjedhore. Listat e numëruesve u dorëzuan vetëm pak orë para se të fillonte procesi i numërimit. Si është e mundur që të gjithë komisionerët dhe numëruesit e PS-së, anëtarët e opozitës në komisionet zonale zgjedhore, vëzhguesit dhe kandidatët për deputetë, prezentë në qendrat e numërimit, të jenë blerë nga PD-ja?

Është vërtet e habitshme që gjithë PS-ja të shitet dhe blihet kaq lehtë. Ky imazh është dëmi më i madh që po i bëni partisë suaj. Manipulimi i zgjedhjeve në vendin e numërimit të votave është e pavërteta më e madhe që është thënë për zgjedhjet e 28 qershorit. Këtë marrëzi e keni kuptuar edhe ju, por, fatkeqësisht, e keni zëvendësuar me marrëzinë tjetër të 70 mijë kartave të identitetit false. Unë nuk mund të kuptoj: Kur 20 mijë komisionerë janë të tillë, pse elita drejtuese e PS-së duhet të jetë me kredibilitet dhe e besueshme? Veç tyre ishin dhe komisionerët e partive të tjera dhe vëzhgues të tjerë. Pse ata nuk i vunë re dhe nuk i shënuan në procesverbale pretendimet për manipulime? Është naive të besohet se PS-ja nuk kishte marrë masat për të ruajtur votat, për të mbikëqyruar njerëzit tuaj, sepse edhe atyre ju nuk u besoni. Ju ngritët grupe të jashtëligjshme në çdo fshat dhe qytet me ish-policë dhe ish-shikas të kohës suaj. Si është e mundur që edhe këtyre u shpëtoi ky manipulim i madh dhe nuk arritën të kapin asnjë provë?

Komisionerët socialistë jo vetëm ishin pajisur me kamera-stilolaps, por ishin instruktuar që në qendrat e votimit, ku votohet thellë për PD-në, të largoheshin dhe braktisnin votimin. Kështu keni vepruar edhe në 2005-n, 2007-n dhe 2009-n. Rruzhdia është produkt i këtyre udhëzimeve dhe ju tentuat të krijonit dhjetëra Rruzhdie anembanë vendit. Mund të sjell shembuj nga zona që mbikëqyra në qershor të 2009-s, ku komisionerët socialistë, sipas urdhrave që morën nga qendra, tentuan të largohen nga fshatrat Leminot, Podgorie, Leshnicë, Zvirinë dhe Alarup, fshatra në të cilat PS-ja humbet gjithmonë thellë. Vetëm ndërhyrja nga KQZ-ja dhe përballja me ligjin i detyroi ata të kthehen.

U pretendua dje se janë 9 qarqe, për të cilat s'ka vendim të Kolegjit Zgjedhor dhe kësaj mund të hetohen në KQZ dhe kolegji. Ju nuk kishit ankesa dhe nuk ankimuat, duke e ezauruar të drejtën e ankimit. Nëse keni fakte, drejtojuni prokurorisë, siç e përcakton ligji, pasi rrugë tjetër ligjore nuk ka. Nëse opozita është e bindur në të drejtën e saj për të hapur kutitë e votimit, pse nuk i drejtohet Gjykatës Kushtetuese dhe Komisionit të Venecias? Gjykata Kushtetuese ka dhënë prova të qarta se, së paku, nuk mban anën e maxhorancës.

Por qëllimi juaj nuk është hetimi dhe transparenca e zgjedhjeve. Pavarësisht nëse hapen apo jo kutitë e votimit, kryetari i opozitës është në krizë. Kërkon të fitojë kohë dhe të evitojë përballjen e ardhshme elektorale për zgjedhjet vendore. Këtë qëllim i shërben kërkesa që hetimi i zgjedhjeve të zgjasë 24 muaj, me shpresë se mos arrini të shtyni zgjedhjet vendore dhe t'i zhvillonin së bashku me zgjedhjet parlamentare.

Për të arritur këtë objektiv, Edi Rama kërkon të destabilizojë vendin, të sabotojë heqjen e regjimit të vizave dhe të pengojë hapjen e negociatave për anëtarësim në BE, pasi interesi i tij personal është më i rëndësishëm sesa interesat e vendit dhe të qytetarëve. Të nderuar kolegë të opozitës, braktiseni qëndrimin obstruksionist të kryetarit tuaj dhe hajdeni të krijonim komisionin hetimor dhe të hetojmë ato probleme që evidentohen në raportin e OSBE-ODHIR-it për të përmirësuar Kodin Zgjedhor! Në këtë mënyrë do t'i shërbeni vendit, zgjedhësve dhe partisë suaj.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Spaho!

Zoti Dalipi, urdhëroni!

Alfred Dalipi – Falemnderit!

Meqë u përmend nga parafolësi një nga çështjet më të debatuar në këtë seancë, pra zgjedhjet e 28 qershorit, dëshiroj t'i kujtoj se me dëshirën dhe vullnetin e tij, kutinë e një qendre votimi prej 1000 votuesish, atë të Sovjanit, duke ngulmuar ai vetë, edhe në prezencën time, e kemi çuar në KQZ me dëshirën që ajo të lexohej pa ngarkesat politike dhe ende sot ata banorë të zonës elektorale të zotit Spaho nuk e dinë cili është rezultati i zgjedhjeve. Kjo sa për kujtesë, meqë përmendi një zotëri dhe një zonjushë që janë votuar në qarkun e Korçës.

Të nderuar deputetë,

Trajektorja politike që iu dha nga Kryeministri seancës dje, ishte pjesë e traditës së akuzave, agresionit verbal, tensionit dhe fyerjeve, një skenar

i tërhequr zvarrë, por që përsëritet prej 20 vjetësh në këtë sallë. Dita kur shqiptarët prisnin heqjen e një barre nga shpina, konfliktin e politikës që ka zbritur në shtëpitë e tyre në formën e greminës ekonomike, panë në orën më të keqe imazhin e Kryeministrit që nuk e kanë votuar, por që sot ndodhet në atë karrige; panë imazhin e Kryeministrit në orën më të keqe, mbase nga mosha apo nga shëndeti, por ata dëgjuan dje nga goja e Kryeministrit të thuhej: “Ti s’ke mendere. Provoje po ta mbajti! Mbylle!” dhe fjalë të tjera, të cilat deputetët e rinj sot këtu duhet t’i lexojnë e t’i pasurojnë edhe me të tjerat e një legjislature të kaluar.

Gjuha e djeshme, të nderuar kolegë, është paraprita që ka gjakosur fort dhe shëmtuar vitin politik 1992; ka gjakosur fort vitin 1996, 1997, 1998, por ashtu ka gjakosur edhe zgjedhjet e 2001-shit, 2005-s dhe 2009-s, dhe kjo ka ndodhur vetëm për pushtet. Ndaj është e rëndësishme që sot në këtë sallë të bëhet retrospektivë dhe histori politike.

Të nderuar kolegë deputetë, të gjithë në këtë sallë, pavarësisht qëllimeve të debatit, jemi produkt i zgjedhjeve të 28 qershorit, që prodhuan një legjislaturë të njëjtë me atë të 26 majit të 1996-s. Më kalimin e viteve, 26 maji është arkivuar si pikënisja e një periudhë të errët në epokën postkomuniste dhe Parlamenti jetëshkurtër u etiketua si “Parlamenti i Sudes”, pasi i trefishi deputetët si në skemën e Sudes. Ato zgjedhje dhe ai parlament piramidash ishin shkëndija që në kalendarin e historisë së Shqipërisë sollën vitin e mbrapshtë 1997, nga i cili humbëm të gjithë, humbëm gjak, energji, para, dinjitet, por mbi të gjitha humbëm kohë. Shkaku që edhe sot ne rrezikojmë të humbim të gjithë është vota, zgjedhjet dhe dëshira për t’i fituar ato edhe kur shqiptarët nuk të votojnë për të qeverisur (për analogji edhe ky parlament mori një epitete, të gjithë, majtas dhe djathtas po përmendim Ruzhien, ndaj pavarësisht nëse duam apo nuk duam ne, do të quhet Parlamenti i Ruzhdies).

Fatkeqësisht apo fatmirësisht, Sudja dhe Ruzhdia, 1996-a dhe 2009-a kanë një burrë: ai që qëndroi dje këtu dhe mbase nuk e ka burrërinë të vazhdojë e të rrijë këtu dhe është mosbesues ndaj deputetëve që ka emëruar vetë dhe u jep përgjigje të gjithë opozitarëve, duke u bërë folklorik. Ndaj kjo seancë sot duhet t’i japë fund kësaj bashkëjetese, që na ka lënë të vetmin vend në Ballkan që për 19 vjet nuk ka bërë zgjedhje të lira dhe të ndershme asnjëherë.

Vjedhja e votës nuk mund të legalizohet me kartonë në këtë sallë. Po të doni, kundërshtojeni. Sot duhet ndëshkuar e keqja që e ka kthyer këtë vend në republikë ambasadorësh dhe dërgatash. Sot duhet ndëshkuar edhe me ligj, por edhe me frymë, e keqja që pengon demokracinë funksionale në këtë vend dhe kushdo që u mohon shqiptarëve një Shqipëri të hapur.

Sot duhet ndëshkuar kushdo që tenton të marrë pushtete të pamerituara, kushdo që u mohon shqiptarëve të zgjedhin atë që duan.

Opozita dhe PS-ja, presin nga kjo seancë, nga kjo qeveri dhe ky kryeministër jo pazarin për të dalë përfundimisht nga refuzimi që i bëhet Parlamentit të Ruzhdies, por krijimin e garancive reciproke, të rritimit të besimit se në këtë vend do të ketë një herë zgjedhje të lira. Nëse kjo seancë i hap rrugë kësaj filozofie do të ndizet një semafor për të gjithë e jo vetëm për këtë sallë, semafori i një kthese të madhe në historinë e Shqipërisë, fillesa e besimit të shteti, ligji dhe politika.

Ne kemi gjykim e renditje qëllimesh jo të njëjta. Duhet pranuar se situata politike nuk është normale. Këtë e thonë edhe majtas edhe djathtas. Pikërisht për këtë nevojitet një hetimi pa kushte, që do të shmangte devijimet e rrezikshme dhe të dëmshme dhe do të ishte pikënisje për një bashkëjetesë parlamentare dhe zgjedhje të lira dhe të ndershme në betejën që na pret.

Ne nuk i fshehim qëllimet tona. Sigurisht, as ju. PS-ja ka si qëllim hapjen e kutive që i sollën humbjen padrejtësisht në 28 qershor. PD-ja ka si qëllim moshapjen e kutive që i dhanë padrejtësisht fitoren në 28 qershor. PS-ja ka për qëllim hapjen e kutive si transparencë për procesin zgjedhor në një demokraci funksionale, duke ruajtur një standard për zhvillimet europiane të Shqipërisë. PD-ja kërkon moshapjen e kutive, si ruajtjen e standardit në respekt të Kushtetutës. PS-ja kërkon hapjen e kutive dhe ndëshkim me ligj të vjedhësve dhe të manipuluesve të votave. PD-ja kërkon moshapjen e kutive, se kjo mund të ndëshkojë vjedhësit dhe bie ndesh me vendimin e gjykatave.

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot debatojmë për dy principe të ndryshme: për të ndëshkuar hajdutin ose për të ruajtur pavarësinë e gjykatave. A mundet? Kjo është një pyetje fare e thjeshtë dhe logjike. A mundet që hajduti që vjedh të ruajë pavarësinë e gjyqarit që pret për ta ndëshkuar? Ndaj, të nderuar kolegë, opozita është e ndarë në gjykim dhe në princip nga kjo

maxhorancë. Kali ynë i betejës dhe i kërkesës për konsensus është vota e lirë dhe e ndershme, zbardhja e asaj çka ndodhur më 28 qershor dhe jo vota e manipuluar e pandershme dhe fshehja e 28 qershorit.

Çdo refuzim që i bëhet këtij principi dhe kësaj oferte për konsensus nuk është ndarje doktrinash apo kampesh politike. Mbajtja larg e opozitës nga Parlamenti ju dha mundësi juve, të nderuar kolegë deputetë, të reflektoni si forcë e përgjegjshme. Ju këtë nuk e bëtë për 6 muaj.

Të nderuar deputetë,

Njëra palë në këtë vend është kapur në flagrancë, më saktë është kapur me Ruzhdien në krevat dhe mbrohet duke thënë se edhe tani Ruzhdia është e virgjër dhe ata që shkuan me të në krevat janë burra të ndershëm.

Sa më shumë të mbrojë Ruzhdien dhe të frymëzojë Ruzhdien, ky Parlament aq më larg do ta mbajë këtë vend.

(Deputetit Alfred Dalipi i ndërpritet fjala, sepse i ka mbaruar koha e diskutimit).

Jozefina Topalli - Urdhëroni, 2 minuta replikë, zoti Spaho!

Edmond Spaho - Alfred, kutia e Sovjanit është shembulli më i mirë i hipokrizisë dhe i faktit që jeni ju që manipuloni dhe vidhni zgjedhjet. Kur u hap kutia, nuk u gjend procesverbal dhe procesverbal ishte në xhepin e komisionerit të PS-së, i cili i kishte ofruar para komisionerit të PSD-së që ta fuste në tavolinë atje kur të numëroheshin votat.

Ju jeni hajdutët që bërtisni: "Kapeni hajdutin"! Sa për atë, e pe se si dole atje në zonë. Të arrita me nja 50% në krahasim me ty në 2005-ën. Po deshe, hajde ta provosh radhën tjetër.

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Spaho!

Zoti Oketa, urdhëroni!

Gazmend Oketa – Falemnderit, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kemi që nga dita e djeshme që diskutojmë dhe është vërtet vështirë të gjesh argumente të reja për sa po diskutojmë, pasi pavarësisht faktit se opozita nuk ka qenë prezente këtu, është një diskutim tashmë 7-mujor.

Megjithatë, unë do të dëshiroja së pari të theksoja faktin tepër pozitiv se tashmë sot vendi ka një opozitë reale. Diskutimi që zhvillohet në këtë sallë që nga dita e djeshme që vazhdon sot, fakti që një pjesë e mirë e deputetëve të opozitës në fjalën e tyre kalojnë edhe në terma të tjera në çështje ekonomike, financiare, çështje përmytjesh, është

një zhvillim pozitiv, pavarësisht faktit se në këtë pikë ne duhet të ishim 7 muaj më parë. 7 muaj më parë opozita duhet të ishte prezente në këtë sallë të Kuvendit jo vetëm thjesht për shkak të kërkesës sonë, por siç thashë vijnë tashmë në atë pikë ku ne duhet të ishim 7 muaj më parë, në atë pikë të cilën e kanë kërkuar edhe disa zëra ndryshe dhe jo cicërima ndryshe dhe brenda vetë Partisë Socialiste.

Së dyti, unë besoj se sot është dita që të gjithë ne duhet t'i përcjellim një falënderim medias shqiptare, e cila me të mirat apo me defektet e saj, me anësinë apo paanësinë e saj ka bërë të mundur që për këta 7 muaj ne të dialogojmë me njëri-tjetrin nëpërmjet medias. Fatkeqësisht në disa raste media ka shërbyer si mjet komunikimi dhe vetë brendapërbrenda Partisë Socialiste. Shumë nga ne kanë ngritur pyetjen pse ndodhi sot në këtë pikë? Ashtu siç shpreha, të gjitha rrugët të çojnë në Romë, fatkeqësisht të gjitha përgjigjet të çojnë te zoti Rama.

Është pak e vështirë që t'u referohesh zotit Rama apo edhe personave të tjerë kur ata nuk janë në këtë sallë, por pikërisht nga mosvënia e emrit në listën e kandidatëve nga vetë zoti Rama, besoj se ka gjeneruar gjithë kjo situatë.

Unë nuk dua të përmend apo të përsëris ato çka thanë kolegët e tjerë, po pikërisht faktin se zoti Rama apo edhe disa kryetarë të partive të tjera të ashtuquajtura "opozitare" që nuk ndodhen në këtë sallë, tentojnë që të tërheqin jashtë kësaj sale gjithë grupin parlamentar, të tërheqin jashtë kësaj sale ku pikërisht zhvillohet debati politik.

E gjithë kjo situatë vjen nga mosnjohja e rezultatit të zgjedhjeve pikërisht nga një person i vetëm, nga zoti Rama. Vjen nga mosbesimi që një person i vetëm si zoti Rama ka përkundrejt 40 mijë komisionerëve, 20 mijë nga të cilët janë përfaqësues të Partisë Socialiste; vjen nga mosbesimi që zoti Rama ka përkundrejt 510 vëzhguesve të huaj; vjen nga mosbesimi që zoti Rama ka përkundrejt institucioneve shqiptare KQZ-së, Kolegjit Zgjedhor; vjen nga mosbesimi që zoti Rama ka përkundrejt institucioneve ndërkombëtare, raportit të OSBE-ODIHR-it.

Mbrëmë u përpoqa të ndjek me shumë vëmendje diskutimet e kolegëve opozitarë, pasi vërtet gjatë këtyre 7 muajve kemi pasur nevojë për diskutime dhe do të doja t'i referohesha të nderuarit kolegut Majko, i cili bëri një krahasim për ta thjeshtësuar bisedën me futbollin. Iu referua golit me dorë të Maradonës. Duke qëndruar brenda këtij krahasimi,

unë do të thosha, zoti Majko, se maxhoranca i dha Partisë Socialiste, opozitës shqiptare, të gjitha mundësitë. Ishit ju ata që caktuat përmasat e fushës, caktuat numrin e lojtarëve, madhësinë e topit, përmasat e portës dhe me logjikën “topi është imi”, penalltinë e gjuajtët ju. Nuk është faji i maxhorancës se lojtari kryesor juaji kërkoi të bënte gol duke qëndruar e duke parë ndeshjen nga tribuna.

Pavarësisht të gjitha këtyre diskutimeve, pavarësisht faktit se në atë tabelë është shkuar votimi në parim i projektligjit pak nga ne po i referohen projektligjit.

Unë do të dëshiroja që për një çast t'i referohesha relacionit që shoqëron nismën ligjore të Partisë Socialiste. Besoj se jo pa qëllim në këtë relacion që shoqëron nismën tuaj hartuesi apo hartuesit që e kanë paraqitur këtë dokument duke ditur faktin se është një dokument zyrtar janë shprehur si më poshtë:

Në paragrafin e tretë thuhet: “Komisioni thjesht do të hetojë, do të mbledhë dëshmi dhe do t'i analizojë ato në dritën e çështjeve, për të cilat ka dyshime të forta dhe jo prova.” Në rast se do të kishit prova do të kishit shkruar prova, dyshime të forta dhe të arsyeshme se janë të rrezikuara.

Më pas vijon me një paragraf, i cili paragjykon tërësisht punën e komisionit hetimor. Ju shpreheni tepër të sigurt se mbi këtë bazë do të evidentohen përgjegjësi ligjore dhe institucionale të subjekteve të përfshira në proces, si dhe për ato do të propozohen masat legjislative administrative etj, për të garantuar në të ardhmen standarde zgjedhore etj., etj. Pra, nuk paraqisni asnjë provë. Keni vetëm thjesht dyshime të forta dhe nga ana tjetër keni paraqyruar tërësisht procesin hetimor.

Ju, të nderuar kolegë të opozitës, dhe kryetari juaj i kërkua Kryeministrit Berisha të ulet në tryezën e Presidentit të Republikës së bashku me përfaqësuesit ndërkombëtarë. Mbrëmë Kryeministri Berisha iu referua kësaj tryeze dhe theksoi faktin se pranonte të gjitha propozimet e hedhura në këtë tryezë. Asnjëri prej jush nuk doli të thoshte të kundërtën; asnjëri prej jush nuk doli të thoshte se opozita shqiptare i pranon ato propozime të hedhura në këtë tryezë, të cilat nuk janë gjë tjetër veçse zgjidhja kushtetuese ligjore e këtij ngërçi, i cili më tepër sesa ngërç është një ngërç politik, është një ngërç i Partisë Socialiste, ngërç të cilin ju po përpiqeni ta transmetoni institucioneve të tjera shqiptare.

Unë besoj se mospranimi i atyre propozimeve

mospranimi i njohjes së vendimeve të Gjykatës Kushtetuese apo zgjidhjeve, të cilat vijnë duke iu referuar këtyre vendimeve të organeve kushtetuese të çon në përfundimin në të cilin, unë sinjerisht nuk do të dëshiroja që të ishte i vërtetë se ju realisht nuk ju intereson transparenca. Në rast se transparenca do t'ju interesonte, oferta jonë është ajo që u theksua edhe mbrëmë të ngremë komisionin hetimor konform ligjeve, Kushtetutës shqiptare dhe brenda një afati kohor të pranueshëm t'i japim zgjidhje këtij ngërçi politik.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Oketa!

Zoti Kadeli, urdhëroni!

Gjovalin Kadeli – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Kurrë nuk kam menduar se për herë të parë në Parlamentin shqiptar do të merrja fjalën dhe të flisja pikërisht për atë që është a-ja e demokracisë: për votën e lirë dhe për deformimin e saj, siç ndodhi më 28 qershor. Pikërisht atëherë kur kërkohen standarde kur vazhdojmë të themi se jemi më afër se kurrë me Europën.

Nuk dua të besoj se Partia Demokratike, kur lindi si parti e parë opozitare në vitin '91, si filozofi të saj kishte demokracinë dhe lirinë e votës dhe sot pas 20 vjetësh vazhdojnë avazin e përhershëm të manipulimit të saj.

Të gjithë besuam asokohe se me lindjen e demokracisë duke pasur besim pikërisht në liritë dhe të drejtat e njeriut që në themel kanë votën e lirë sot shqiptarët janë krejt të zhgënjyer nga kjo sidomos në qeverisjen aktuale ku premtimet janë bërë motoja e kalimit të ditës kur varfëria është ulur këmbëkryq në vatrat e shqiptarëve, të cilët presin para ekraneve premtimin e radhës për të nesërmen.

Si mund të harrojmë premtimet e fushatave elektorale për heqje listash nëpër dyqane për investime marramendëse e shumë të tjera si këto vetëm e vetëm e me çdo kusht, me çdo mjet fitoren, kur vështirësitë ekonomike po rriten çdo ditë dhe sidomos për banorët e qarkut të Lezhës.

Nuk mund të harrojmë faturat abuzive të OSSH-së, ku faturistët e saj sillen si taksambledhësit e kohës së Zogut një muaj me sahat dhe një muaj amorfe dhe në muajin pasardhës i llogarisin edhe vlerën e amorfesë. Nuk ka sesi ndodh ndryshe premtimet boshe të OSSH-së se do t'u kthehej diferenca, por kanë ku të mësojnë për premtime false.

Të nderuar kolegë të maxhorancës,

Kam dëgjuar gjatë kësaj periudhe nga segmentet e maxhorancës të thuhet se zgjedhjet ishin të lira, nuk ka deformim të vullnetit të zgjedhësve dhe mbi të gjitha, opozita nuk ka paraqitur fakte për deformimin e tyre. Kjo nuk është aspak e vërtetë, sepse ka plot fakte, të cilat vazhdojnë të dalin çdo ditë, një e nga një. Por, duke qenë se ju i besoni vetëm drejtësisë, unë ju pyes: a nuk e tha drejtësia fjalën e saj në Ruzhdië? A u besoni këtyre fakteve?

Nga konstatimet tona në atë kohë, të cilat janë të dokumentuara edhe në tabelën e rezultatit në qendrat e votimit, rezultojnë shkelje dhe parregullsi, të cilat ndikojnë direkt në procesin zgjedhor dhe në rezultatin përfundimtar. Më lejoni të jap disa fakte për Qarkun e Lezhës, të cilat janë dërguar në KQZ-ë nga komisionerët tanë, për të cilët kryeministri ynë ka merak se po i shqetësojmë. Janë ata komisionerë që në kohën e duhur kanë ngritur opsionet e tyre, të cilat po i radhis si më poshtë:

Në qendrën e votimit nr. 687 nuk është vendosur numri i identitetit përbri çdo zgjedhësi, që është pasqyruar si votues. Kjo gjë bie ndesh me nenin 105 të Kodit Zgjedhor, pika 1/ac.

Në qendrën e votimit nr. 691, në kutinë e votimit, janë gjetur disa fletë të lidhura së bashku, të cilat tregojnë se këtu është kryer votim kolektiv.

Në qendrën e votimit nr. 695, në listat e zgjedhësve, nuk janë pasqyruar numrat e serisë së dokumenteve të identifikimit për gjysmën e votuesve, gjë që flet për votim në emër të të tjerëve.

Në qendrën e votimit nr. 706, nga procesverballi i mbajtur në këtë qendër, rezulton se ka pasur 104 fletë votimi të papërdorura, të cilat nuk gjenden në kuti, dhe të përdorura 359. Se ku janë përdorur, nga Vermoshi në Konispol, le ta gjejnë?!

Në qendrën e votimit nr. 0722, në listën e votuesve, nuk u gjet i shënuar asnjëlloj dokumenti me numër identifikimi, gjë që bie ndesh me nenin 105 të Kodit Zgjedhor, pika 1/ac.

Në qendrën e votimit nr. 724 të dhënat në procesverballin e KAV-së 08 nuk përshtaten me të dhënat e kësaj tablele, ka një ndryshim midis shifrave, dhe për këtë arsye nuk është pranuar që të nxirret rezultati në formular.

Në qendrën e votimit nr. 742 është konstatuar se në listën e votuesve nuk është shkruar numri i dokumentit të identifikimit për 188 votues dhe nuk përputhet numri i votuesve që kanë marrë pjesë në votim me numrin e fletëve të votimit të gjetura në kuti.

Në qendrën e votimit nr. 748, te burgu i "Shënkollit", nuk janë shënuar në listën e votuesve lloji dhe numri i dokumentit të identifikimit, gjë që bie ndesh me nenin 105 të Kodit Zgjedhor. Në kutinë e votimit nuk janë gjetur kundërfletët e fletëve të votimit, në kutinë e materialeve nuk është numri i duhur i fletëve të papërdorura dhe në listën e votuesve rezultojnë se firmat janë bërë nga e njëjta dorë ose disa duar. Rezultati dihet: 350 me 39 në favor të pushtetit.

Në qendrën e votimit nr. 745/1 në disa raste nuk është shkruar lloji dhe numri i dokumentit të identifikimit të zgjedhësve.

Në qendrën e votimit nr. 747, 195 votues nuk kanë numër identiteti dhe nuk rakordon numri i personave që kanë votuar me atë që është shënuar në procesverbal.

Në qendrën e votimit nr. 0752 numri i fletëve të votimit të papërdorura me numrin e votave nuk rakordon me atë të procesverballit të mbylljes, i cili ka një diferencë prej 390 fletësh votimi. Ku janë përdorur këto fletë votimi?

Në qendrën e votimit nr. 0759 nuk është përcaktuar lloji i dokumentit të identifikimit dhe numri serial identifikues 4-shifror, gjë e cila flet për falsifikim të tyre.

Në qendrën e votimit nr. 763 materialet zgjedhore, listat dhe procesverbalet e gjetura në kutitë e votimit, sipas verifikimeve, nuk rakordojnë me të dhënat e procesverballit të mbylljes.

Në qendrën e votimit nr. 0765 në listën e zgjedhësve, rezultojnë se kanë votuar mbi 50 votues. Aty janë nënshkrimet e tyre, por nuk janë të dhënat e numrit dhe llojit të dokumentit të identifikimit.

Në qendrën e votimit nr. 0768, në dy kutitë e saj nuk janë gjetur as vula e komisionit dhe as e sekretarit të komisionit.

Ka edhe shumë të dhëna të tjera, të cilat na forcojnë bindjen se ky proces zgjedhor vetëm me standarde nuk mund të jetë, prandaj ne kërkojmë hetimin në themel të këtij procesi. Siç e shikoni fenomenin "Ruzhdië" është kudo në Shqipëri, në çdo qendër votimi, ndërsa ju vazhdon të thoni se zgjedhjet ishin të mira dhe i plotësuan të gjitha standardet. Unë po ju them, dhe besoj se çdo shqiptar është i bindur, se në Europë nuk pranohesh me Dushqet e Ruzhdiet që prodhon politika e mbrapsht e këtyre 20 vjetëve.

Të nderuar kolegë,

I nderuar zoti Kryeministër,

Mbajeni fjalën e dhënë se do t'i pranoni kërkesat

e opozitës dhe do t'i jepni shumicën në komisionin hetimor, sepse bëheni më të besueshëm për shqiptarët dhe miqtë tanë ndërkombëtarë!

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit!

Urdhëroni, zoti Mediu,

Fatmir Mediu – E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ndërsa ne sot diskutojmë të ndarë qëndrimet tona për sa i përket procesit zgjedhor, i cili ka 9 muaj që ka mbaruar, Bashkimi Europian nëpërmjet komisionerit për zgjerim vjen dhe diskuton për një Shqipëri që duhet të jetë e bashkuar, për të realizuar ëndrrën dhe qëllimin e saj: anëtarësimin e plotë në Bashkimin Europian, duke filluar me liberalizimin e vizave në gjashtëmujorin e parë të këtij viti.

Ëndrra dhe qëllimet europiane të shqiptarëve u vranë për më shumë se 45 vjet, ku partia ishte mbi gjithçka dhe ku vendoste sekretari i parë se çfarë duhej bërë. Ai ishte gjithçka: edhe qeveritari, edhe gjyqësori. Tani Shqipëria është e të gjithëve. Ëndrra europiane është qëllimi i mbarë shqiptarëve, i popullit opozitar, i popullit maxhoritar dhe atij paparti, i njerëzve socialistë, demokratë, republikanë dhe lësëistë. Kështu që është e rëndësishme të kuptojmë momentin dhe të marrim përgjegjësitë maksimale për të gjetur zgjidhjen dhe për t'u dhënë shqiptarëve atë që meritojnë.

Në zgjedhjet e 28 qershorit, të gjithë, pa dallime politike, votuan për partitë e tyre, por mbi të gjitha votuan që shqiptarët të arrijnë të bëjnë të mundur ëndrrën europiane. Nëse Europa këtu shihet si një diskutim politik apo pozicion partiak, për ata që votuan më 28 qershor Europa ishte shumë më e thjeshtë, së pari, mundësi për të bashkuar familjet e ndara për vite të tëra.

Së dyti, një mundësi më e mirë për të zhvilluar ekonominë e tyre.

Së treti, ajo që është më e rëndësishmja, Shqipëria të marrë vendin që i takon në këtë realitet europian, sepse Zoti e ka përcaktuar në një vend, që gjeografikisht është europian, por edhe politikisht patjetër duhet të jetë i tillë.

Gjithë këto diskutime që po bëjmë, patjetër duhet t'i referohen edhe sfondit politik përpara zgjedhjeve. Në vitet 2007-2008 u diskutua gjatë për reformën zgjedhore, për të realizuar standardet e kërkuara nga OSBE-ODIHR-ri për zgjedhje të lira e demokratike, si një kusht për ta afruar Shqipërinë me Bashkimin Europian, por edhe si një detyrim që kemi përballë qytetarëve tanë, që ata të përcaktojnë

me votën e tyre se cila është qeverisja dhe e ardhmja e tyre. Reforma u zhvillua në mirëkuptim të plotë ndërmjet dy aktorëve kryesorë politikë: Partisë Socialiste e Partisë Demokratike. Unë nuk dua të përsëris kolegun Oketa se Partia Socialiste i vendosi të gjitha kushtet dhe kërkesat e saj për t'u përfshirë në këtë reformë, për të realizuar zgjedhje të lira dhe të ndershme, madje nuk u dëgjua asnjë vërejtje nga partitë e tjera. U ra dakord që kjo reformë, edhe me bekimin e faktorit ndërkombëtar, ishte më e mira për realizimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme. Me këtë konsensus dhe Kod Zgjedhor vajtëm në zgjedhjet e 28 qershorit, në të cilat kishte mijëra komisionerë të të dyja palëve, por edhe të partive të tjera, numërues, vëzhgues vendas. Gjithashtu ishte edhe arbitri ndërkombëtar, që pa dyshim do të certifikonte zgjedhjet. Menjëherë pas këtyre zgjedhjeve, kryetari i partisë suaj dhe faktori ndërkombëtar i vlerësuan zgjedhjet si standard i arritur për ta afruar Shqipërinë me BE-në. Më pas, për çështjet tuaja të brendshme politike, filloi diskutimi i gjerë për çështjen e kutisë, që u kthye në marrëzi, duke kërkuar në mënyrë këmbëngulëse për të dalë mbi atë që është autoriteti i politikës, për t'u vendosur mbi institucionet e Kushtetutën dhe për t'i kthyer ato në një letër pa vlerë. Gjithë këto diskutime që u bënë, pa dyshim kishin një qëllim: demagogjinë e vazhdueshme për të cenuar të ardhmen europiane të vendit. Faktori ndërkombëtar, OSBE-ODIHR-i i vlerësoi zgjedhjet. Të njëjtën gjë bënë: Parlamenti Europian, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Asambleja e Këshillit të Europës. Ishin këta aktorë, të cilët më vonë u futën si ndërmjetës për të gjetur zgjidhjen, në mënyrë që opozita të kthehej në Kuvend, sepse njerëzit votuan që të përfaqësohen në Kuvend, pavarësisht se në opozitë ata kanë vendin e tyre, për të dëgjuar zërin e qytetarëve dhe për të bashkëpunuar për interesat e vendit. Komiteti më i lartë i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës erdhi në Tiranë dhe së bashku me Presidentin e Republikës ofruan zgjidhjen, e cila nuk mund të jetë ndryshe përveçse kushtetuese. Sipas tyre, diferenca që ekziston ndërmjet nesh ka vetëm një zgjidhje: t'i ballafaqojmë idetë dhe mendimet tona në Gjykatën Kushtetuese. Për më tepër ofruan edhe asistencë për të pasur, nëpërmjet Komisionit të Venecias, më tepër nivel në gjykim dhe transparencë më të madhe. Por, për fat të keq, edhe kjo kërkesë e faktorit ndërkombëtar ose ky kompromis nuk u pranua.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne të gjithë kemi detyrimin të respektojmë Kushtetutën dhe sipas saj Kuvendi është i detyruar të mos diskutojë ngritjen e komisionit. Pra, ky komision duhet ngritur, por nga ana tjetër ai i nënshtrohet diskutimit parlamentar për shkallën e respektimit të parimeve kushtetuese në objektin e veprimtarisë së komisionit hetimor. Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese, në vlerësimin që ka bërë për komisionet hetimore, ka theksuar se objekt hetimi janë vetëm çështjet që përfshihen në veprimtarinë kontrolluese të Parlamentit, të cilat nuk sjellin konfondim dhe transferim kompetencash, nuk e vendosin Parlamentin mbi pushtetet e tjera dhe për më tepër mbi atë gjyqësor. Një rëndësi e madhe duhet t'u kushtohet komenteve dhe arsytimit në një paragraf tjetër të vendimit të Gjykatës Kushtetuese: një hetim i iniciuar që nuk lidhet me qëllimin dhe nuk i përket veprimtarisë së Parlamentit, nuk konsiderohet në përputhje me parimet kushtetuese. Këtë ka diskutuar dhe po e diskuton maxhoranca; transparencë dhe hetim deri në fund, nëpërmjet institucioneve dhe detyrimeve kushtetuese që kemi, për t'u kuptuar dhe pranuar nga të gjithë si vend anëtar i NATO-s dhe si vend që do të jetë pjesë e Bashkimit Europian. Për të punuar së bashku për qytetarët shqiptarë, për të realizuar qëllimet e tyre dhe për të mos u kthyer në partinë-shtet, ku kryetari i partisë është pa dyshim, sipas historisë së vjetër, edhe kryeprokuror, edhe kryegjyqtar dhe kryeqeveritar, por që, për fat të keq, sot kërkon të bëhet edhe kryeplaku i komunës së Ruzhdies.

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Mediu!
Zoti Albert Çaci, keni fjalën.

Albert Çaçi – Të nderuar kolegë,

Duke dëgjuar dje dhe sot ndërhyrjet e Kryeministrit dhe përfaqësuesve të tjerë të maxhorancës, shumica e shqiptarëve kuptuan se mundësia për kompromis për zgjidhjen e krizës politike është gati e pamundur. Por, megjithatë ne jemi këtu që të tentojmë deri në fund për kompromis. Më 28 qershor të vitit të kaluar, pasi Shqipëria e kishte kaluar tranzicionin e lodhshëm, kishte mundësinë t'u demonstronte të gjithëve, së pari popullit të vet dhe më pas faktorit ndërkombëtar, se si në një vend të sapopranuar në NATO dhe që sapo kishte bërë kërkesën për anëtarësim në BE, zgjedhjet parlamentare do të ishin të standardeve të BE-së. Por, për fat të keq, nuk ndodhi kështu dhe ja ku jemi në mes të një krize të rëndë politike dhe me pasoja të rënda për vendin. Gjatë këtyre 8

muajve për mosshkelje të Kushtetutës, a thua se në Kushtetutë pas preambulës dhe nenit të parë që Shqipëria është Republikë vjen neni 2, që ndalon hapjen e kutive. Ju e dini mirë se çfarë kërkojmë ne dhe ne e dimë mirë nga se keni frikë. Është e kotë t'i shmangemi me retorika boshe këtij problemi. Ai duhet përballuar direkt në thelbin e tij. Ne nuk kërkojmë me insistim shumicën e komisionit, deligjimitet të këtij Parlamenti. Ne kërkojmë të shikojmë si është zbatuar ligji për administrimin zgjedhor dhe ju e dini më mirë nga ne se kjo gjë nuk mund të bëhet pa hapur kutitë. Do të mjaftonte vetëm rasti i Ruzhdies, që në çdo parlament të botës të kërkohej kjo që ne po kërkojmë prej kohësh. Rasti i kulisë së Ruzhdies nga ana e maxhorancës trajtohet në mënyrë shumë simpliste, se meqenëse ikën komisionerët socialistë, ata që mbetën e kishin të ligjëruar të bënin atë që bëjnë.

Duhet të kuptojmë, zotërinj, se hetimin e kulisë së Ruzhdies nuk e ka bërë Partia Socialiste, por Prokuroria e Republikës dhe është e para herë që ndodh kjo gjë në këta 20 vjet. Prokuroria e ka bërë këtë duke vërtetuar dyshimet e veta me vërtetësinë e provave të ofruara nga vetë organet shtetërore, që janë në varësi të kësaj maxhorance, nga laboratorit i kriminalistikës në Ministrinë e Brendshme, nga TIM dhe nga shoqëria Sagem. E ka bërë këtë duke mos u marrë me kutitë e fletëve të votimit, por me kutinë e materialeve të votimit, pikërisht me atë që ne jemi më shumë të interesuar të verifikojmë.

Sa për saktësim, në kundërshtim me ato që thanë disa deputetë të maxhorancës, KQZ-ja nuk e ka përjashtuar kutinë e Ruzhdies nga numërimi i votave për qarkun e Fierit. Ajo ka përjashtuar vetëm 415 fletët që janë me një vulë, ndërsa fletët e tjera, ato që janë me dy vula janë marrë në konsideratë në numërimin e përgjithshëm për qarkun e Fierit.

Ajo që është më e rëndë në këto momente është se kjo krizë e rëndë politike po rëndon shumë edhe krizën tjetër, shumë problematike për shqiptarët, atë ekonomike. Edhe këtu, zotërinj të maxhorancës, ne shikojmë dy Shqipëri të ndryshme. Ju shikoni një Shqipëri virtuale me rritje ekonomike, me rritje eksportesh, me rritje mirëqenieje, me rritje pagash e pensionesh, një dragua të Orientit në Adriatik. Ndërkohë që ne shikojmë një Shqipëri tjetër, zotërinj, ku fuqia blerëse e shqiptarëve ka rënë në mënyrë të frikshme, ku papunësia është bërë makti i vërtetë i familjeve shqiptare, ku varfëria është ulur këmbëkryq, ku arka e shtetit, për shkak të shpenzimeve pa kriter për qëllime elektorale, nuk ka qenë ndonjëherë më keq.

Ne do të donim që kjo Shqipëri që shikojmë të mos ishte reale, por e vërteta e hidhur është se shumica dërrmuese e shqiptarëve, për fatin e tyre të keq, mendojnë si ne. Në këta 9 vjet si deputet nuk kam parë kaq shumë trishtim në sytë e zgjedhësve të mi sesa në këto momente dhe këtu bëhet fjalë për një nga qytetet me zhvillimin më të madhe ekonomik në vend.

Prandaj, të nderuar kolegë të maxhorancës, është imperative dhe ne e kemi për detyrë që ta zgjidhim menjëherë krizën politike që varet nga ne, që të lehtësojmë sadopak ndikimet devastante që ajo po përcjell në ekonominë shqiptare dhe në jetën e përditshme të njerëzve. Për fat ka akoma kohë për reflektim nga ana e maxhorancës dhe mendoj se tani është koha që kjo maxhorancë ta bëjë atë në mirë të vendit. Ndoshta nesër do të jetë vonë.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Çaçi!

Zoti Demi, urdhëroni.

Leonard Demi – Zonja Kryetare, falemnderit!

Në radhë të parë më lejoni që t'i jap një përgjigje publike artistes së nderuar Xhuvani, e cila është kolegia ime deputete në Sarandë. Së pari, dua ta përgëzoj për rolin e Elektrës. Së dyti, dua të them që Saranda në krahasim me vendet e tjera të Shqipërisë nuk është më e varfra, por është nga më të pasurat.

Zonja Xhuvani, vetëm këtë vit në Sarandë kanë vajtur 460 mijë turistë, 100 mijë më shumë se vitin e kaluar dhe i kanë sjellë këtij rrethi 40 milionë euro me shumë se një vit më parë. Janë prodhuar me dhjetëra mijë tonë prodhime bujqësore më shumë se vitin e kaluar dhe ne po bashkëpunojmë me ministrat që të vëmë nën prodhim 27 mijë hektarë tokë për të dyfishuar dhe trefishuar prodhimin, për të shumëfishuar pemët, agrumet, ullinjat dhe më tej.

Për sa u përket zgjedhjeve të 28 qershorit, të nderuar kolegë, ato janë një proces i certifikuar nga dy institucione: nga institucionet shqiptare dhe nga ato ndërkombëtare të specializuara nga Bashkimi Europian për këtë punë. Është një proces i përgëzuar si më i miri ndonjëherë në Shqipëri.

Në këtë sallë janë shumë kolegë që kanë nga 3-4 legjislatura si deputetë. Dua të sjell në vëmendjen e tyre dhe të atyre që kanë qenë bashkëstudentë me mua jashtë vendit (kemi qenë nga më të përkrahurit në këtë Parlament) se zgjedhjet janë një institucion i patjetërsueshëm, por vetë ato janë të pamjaftueshme për të siguruar që demokracia të

bëhet kusht i përhershëm i jetës së një vendi. Zgjedhjet janë një element i rëndësishëm, për të cilat ka nevojë të madhe vendi, por ato nuk janë as ndonjë kurë që bëhet brenda natës dhe as të garantuara. Asnjë shoqëri nuk mund të transformojë lehtësisht dhe shpejt mënyrën e qeverisjes së vet. Qeverisja demokratike mbështetet në tri kushte themelore: Së pari, në institucione të mira dhe në shtetin ligjor; së dyti, në një shtresë qytetarësh që kuptojnë mirë parimet e demokracisë dhe; së treti, në cilësinë e lartë të lidhshimit, së paku në momentet kritike.

Zotërinj deputetë, kolegë socialistë,

Më vjen keq të pohoj para jush se te ju mungon cilësia e tretë, ajo e lidhshimit që ju drejton. Për këtë arsye ju kërkoni të shkatërroni të parën, institucionet dhe shtetin e së drejtës dhe funksionimin ligjor të shoqërisë dhe qeverisjes së shtetit. Kjo do të thotë, për mendimin tim, të godasësh apo të minosh stabilitetin kombëtar, ekonominë dhe zhvillimin. Kjo do të thotë të godasësh integrimin euroatlantik të Shqipërisë dhe ëndrrën shqiptare dhe ta kthesh vendin në pre të pëshqjellimit, të lulëzimit të kriminit dhe të kriminit të organizuar.

Ne nuk do t'u lëshojmë terren organizatave kriminale të forcojnë strukturat e tyre të goditura apo të shkatërruara nga shteti ynë i së drejtës. Kësisoj ne nuk do t'i ndihmojmë ato të përdorin forcën kundër shtetit dhe përfaqësuesve të tij, duke sfiduar monopolin e tij në përdorimin legal të dhunës. Ne nuk do t'u japim mundësi kriminelëve të rrisin aktivitetin e tyre kundër shoqërisë sonë të re demokratike, që në radhë të parë shënjestrën e tyre e drejtojnë kundër rinisë, kundër vlerave bazë legale dhe politike që përbëjnë elementin lidhës të shoqërisë së sotme shqiptare.

Në strategjinë e sigurimit europian për një Europë të sigurt në një botë më të mirë goditja e shtetit të së drejtës është një kërcënim që i bëhet vetë shtetit dhe është një kërcënim që i bëhet sigurimit europian. Prandaj, ne do të punojmë për ta forcuar atë që të bëhemi shpejt një anëtar i denjë i Komunitetit Europian. Prandaj unë u bëj thirrje të gjithë kolegëve socialistë ta bëjmë së bashku këtë.

Zoti Turku,

Para disa ditësh unë kam takuar një senator francez, që ka vizituar Shqipërinë, zotin Bulu. Ai më tregoi një shembull të të kaluarës politike të Francës, për zgjedhjet presidenciale me kandidatë Miteranin dhe Zhiskar d'Esten. Presidenti Miteran

fitoi në Francë dhe kolegët e tij i bënin thirrje që të shpallte fitoren. Ai priti rezultatin e vendeve jashtë Francës dhe rezultati e ktheu fitoren në favor të kandidatit tjetër. Ai u tha kolegëve të tij: "Unë do të pres vlerësimin e institucioneve kushtetuese franceze". Ato shpallën fitues Valeri Zhiskar d'Esten dhe ai u tha bashkëpunëtorëve të tij: "Mirupafshim në zgjedhjet e vitit 1980!". Kjo është demokracia, ky është shteti i së drejtës.

Zoti drejtues i seancës,

Partia Socialiste e ngre këtë çështje për të krijuar një kauzë që nuk ekziston, por sfida që i bëhet institucioneve të demokracisë shqiptare dhe institucionit themelor të saj, Parlamentit, nuk e justifikon këtë qëndrim dhe njëkohësisht dobëson çdo ditë e më shumë edhe vetë Partinë Socialiste, një nga forcat politike kryesore të popullit shqiptar.

Strategjia e një force politike të caktuar materializohet te përpunimi, organizimi dhe publikimi i të gjitha ideve politike, ekonomike, të sigurisë etj., që kanë si qëllim zhvillimin dhe integrimin e vendit tonë në strukturat euroatlantike dhe nuk kërkojnë që të përmbysin pushtetin demokratik shqiptar të dalë nga vota të lira dhe të drejta me kërcënime, me mitingje, me sfida në mënyra të padrejta. Kjo periudhë ka marrë fund një herë e përgjithmonë.

Të nderuar kolegë,

Në ditët tona burimi i të mirave materiale dhe forcës politike kanë ndryshuar. Sot ato janë rrjedhim i potencialit intelektual dhe unë besoj se ndërmjet jush ka intelektualë dhe politikanë mjaft të zotë, që na japin të drejtë, prandaj ju bëjmë thirrje që bashkërisht të vemi në Europë sa më shpejt që të jetë e mundur.

Falemnderit!

(Ndërkohë, drejtimin e seancës e ka marrë zoti Turku.)

Ardian Turku – Falemnderit, zoti Demi!

Për replikë zonja Xhuvani.

Luiza Xhuvani – Do të doja t'i thosha zotit Demi se jam vërtet një artiste dhe qytetare e përgjegjshme dhe, për më tepër, kam një përgjegjësi absolute, kam marrë përsipër të përfaqësoj njerëzit e mi. Më vjen keq që zoti Demi nuk i njuh hallet e njerëzve që përfaqëson, sepse kështu do të kishte dhënë kontribut më të mirë për ta.

Falemnderit!

Ardian Turku – Falemnderit, zonja Xhuvani!

Fjala është për zonjën Enkelejda Shkreli.

Enkelejda Shkreli – Sikur argumentin në politikën shqiptare ta përcaktonte përpjekja për

progres dhe jo lufta kundër regresit, argumenti im i sotëm natyrisht nuk do të ishin kutitë. Por kam zgjedhur të rreshtohem politikisht krahas progresit dhe, meqë progresin sot e mbajnë peng kutitë e marra peng, nuk kam si të mos flas më së pari për kutitë.

A e dini çfarë e lidh regresin me kutitë? Po jua përshkruaj me dy fjali. 20 vjet më parë unë isha studente dhe hyra me shokët në një grevë urie për të fituar të drejtën e lirisë. Tani 20 vjet më pas më qëllon gati çdo muaj të shoh sërish studentë që dergjen përdhe nëpër greva urie dhe të luftoj tok me ta, për ta, për të fituar jo më lirinë, por mjerisht të drejtën e një kartoni që, së paku, formalisht të quhet diplomë.

Qeverisje më të keqe se ajo e viteve 2005-2009 nuk kishte parë Shqipëria, qeverisje që pas 20 vjetësh e detyron këtë popull që në vlerë sakrifice të barazojë lirinë me kartonin. Po e fjeni në inteligjencë këtë popull, zotërinj, duke ngulur këmbë me të madhe se më 28 qershor vullneti i lirë i shumicës së shqiptarëve paskësh zgjedhur kartonin në vend të lirisë! Duhet hapur kutitë, pra, për t'i çliruar shqiptarët nga kjo fyerje dhe po ashtu për t'i çliruar edhe nga regressi. Ata po jua kërkojnë këtë. Ne, po ashtu, në emër të tyre.

Vijojmë më tej. Sikur mbështetja e forcave politike në Shqipëri të buronte lirish e natyrshëm përmes krahasimit të programeve qeverisëse dhe analizës së rezultateve, sërish po e them se argumenti im nuk do të ishin kutitë. Por përpara se të mbusheshin kutitë gjithkush, shqiptar e ndërkombëtar, u bë dëshmitar për mënyrën sesi mbushët sheshet e mitingjeve, zotërinj. Kjo qe premiera e administrimit zgjedhor. Mësues të marrë me pahir, të kërcënuar me papunësi, të vënë rresht si kope, të shoqëruar nëpër autobusë transporti, sjellë enkas prej jush për mitingjet tuaja elektorale, dhe jo veç mësues, por edhe nxënës, pa kursyer as të vegjlit e fillores dhe pa vënë në hesap as ditët e tyre të pushimit. Nëse mitingu qëllonte të shtunën apo të dielën, e shtuna dhe e diela shndërroheshin në ditë jave, kurse shkollat në kazerma grumbullimi. Jemi hasur bashkë në Lushnjë e në Kavajë, në oborrin e shkollës, kur nuk kishte as nxënës e as mësues, por vetëm dy kamionë të gardës që po mblidhnin e po ngarkonin karriget e Kuvendit, të cilat do t'u duheshin në mitingun e radhës në një shkollë tjetër.

Po ashtu, po i drejtohem zotit Kryeministër që nuk është këtu, por kudo qoftë e di që më dëgjon: Duhet ta mbanit mend, zoti Kryeministër, që atë të

shtunë kur mësuesve dhe fëmijëve u qëlloi ditë shkolle, mësim nuk bënë, se i prisnin autobusët tuaj jashtë, por jo për piknik, zoti Kryeministër.

Atë ditë ju do të inauguronit një aksh fillim punimesh, në filan rrugë dhe ju nevojitej turma, me hir a me pahir. Për muaj me radhë, administrata më e madhe shtetërore, ajo e arsimit, u përdor me pahir, për të mbushur sheshe e mitingjeve tuaja, mësuesit dhe nxënësit. Çdo raport ndërkombëtarësh jua numëron këtë pahir politik dhe shtetëror, këtë njësim të errët që i bëtë shtetit të shqiptarëve me pushtetin tuaj, që pushteti të mbetet me çdo kusht juaji. Përmes këtij njësimi levantin, jo vetëm i detyruat të figuronin në shesh për xhirimet tuaja elektorale, por i detyruat të duartrokisnin skenat me begati e dyfishim pagash të filmit tuaj parazgjedhor. Ja cilat janë hesapet e pagave, që bëjnë vetë mësuesit.

Në vitin 2005 një mësues kishte një rrogë mesatarisht 23 mijë lekë në muaj. Nga kjo rrogë bruto zbriteshin kontributet e detyrueshme dhe tatimi mbi të ardhurat personale dhe paga neto ishte rreth 20 mijë lekë. Mësuesit merrnin edhe një pagë të 13-të, zoti Kryeministër. Kështu, në vitin 2005, një mësues, mbajeni mend shifrën, mori rreth 261 mijë lekë në vit. Pas katër vjetësh, Qeveria pretendon se ua ka dyfishuar pagën mujore. Në korrik 2009 një mësues mori mesatarisht rreth 42 mijë lekë në muaj, por që prej shtatorit 2007, e njëjta Qeveri zbaton taksën e sheshtë për mësuesit kurse pagën e 13-të e fshiu. Ndaj, një mësues pagën neto mujore e ka 33 mijë lekë, ndërsa në vitin 2009, mori rreth 397 mijë lekë. Kjo është shifra, zotërinj, përkundrejt së parës. Është aritmetikë. Domethënë dyfishimi i pagave mbetet pjesë e filmit politik dhe jo e realitetit shqiptar, i cili njohu edhe një rritje tronditëse të çmimeve. Sikur të mos mjaftojë farsa, ajo u dashka edhe duartrokitor?

Ato kuti të mbyllura mbajnë brenda gjithë fyerjen dhe depersonalizimin që u bëtë mësuesve, nxënësve dhe familjeve të tyre. Ata, të parët, kanë të drejtë të kërkojnë hapjen e kutive, që fyerja të mos gjenerojë tjetër fyerje dhe dhuna një dhunë tjetër. Për ata e bashkë me ata, duke zbardhur të djeshmen, që të mos erret sërish e nesërmja, kërkojmë t'i çelet rruga hetimit të plotë të zgjedhjeve. Ky vend nuk meriton që politika të degradojë në dhunë dhe pengmarrje, ndërsa qeverisja në një shartesë të shpërfilljes me paaftësinë. Ndaj edhe sot, tani, kanë mbajtur frymën të gjithë shqiptarët, pavarësisht prirjeve politike.

Ndoshta jam e saktë, po të them se ju nuk e meritoni këtë vend. Shqipëria është në krizë,

institucionet janë të ngrira, pasi nuk burojnë prej lirisë dhe meritokracisë. Kjo që maxhoranca po e trajton me qetësinë e një lojë kungulleshkash, në fakt, është jeta e një kombi. Gjithkush e ka të qartë, pa qenë nevoja të jetë jurist, se çdo justifikim për të mos hapur kutitë nuk ka të bëjë me ligjin, por me antiligjin, përderisa e formulon prepotenca e pushtetit. Vetëm antiligji aplikon formulën tuaj *rex facit legen*, sipas modelit të rrugës despotike dhe jo *lex facit legen*, me rrugë konstitucionale. Ky shteg despotik ka vënë sot në rrezik krejt demokracinë në Shqipëri.

Zoti Kryeministër, për hir të çështjes kombëtare, që tashmë është e gjitha në përgjegjësinë tuaj, për hir të demokracisë, të cilën shqiptarët nuk kanë ndër mend t'ua falin as partive tuaja e askujt, në emër të lirisë dhe progresit, ju bëj thirrje të ngrihen mbi veten dhe të lejoni hetimin e plotë në transparencë të plotë. Kam vënë re, zoti Kryeministër, se keni qejf të citoni figura historike, e madje dhe ta përqasni veten me to.

Në vazhdë të kësaj përqasjeje, po ju drejtohem me fjalët e Lekës së Madh: "Për një prijës është më e denjë të fitojë mbi veten se mbi kundërshtarët." Shqiptarët këtë presin, ngadhënjimin tuaj mbi veten, zoti Kryeministër. Deri më tash, gjatë gjithë karrierës suaj politike, nuk ia keni dalë. Ndoshta ia dilni kësaj here, po qe se kërkesën kombëtare dhe ndërkombëtare për hapjen e kutive arrini ta rrokni edhe si një shans për dinjitet vetjak.

Falemnderit!

Ardian Turku – Falemnderit, zonja Shkreli!

Zoti Beja, urdhëroni!

Fatos Beja – Falemnderit!

Të them të drejtën, nuk e kam ndier veten komod këto dy ditë, përkundrazi, më ka ardhur keq për veten dhe gjithë kolegët, që kemi një debat të gjatë parlamentar, si rrallë ndonjëherë që diskutojmë për hapjen e kutive të hapura. E them këtë, sepse edhe duke i dëgjuar diskutimet dua të shpreh edhe një keqardhje të dytë. Ka pasur shumë hipokrizi dhe propagandë dhe, më e keqja, nga zërat e rinj të opozitës, çka, të them të drejtën, nuk është një vlerë e shtuar për Parlamentin. Unë jam marrë me zgjedhjet që më 1991-shin deri në zgjedhjet e fundit, në të gjitha nivelet, në qendrat e votimit në fshat, në lagje, në nivel komune, qarku, kombëtar dhe t'ju them të drejtën, më vjen keq që ne po bëjmë një debat për dy projekte që kanë ardhur nga grupi i opozitës, të cilat, edhe pse do t'i votoj, se jam pjesë e maxhorancës, nuk meritojnë të kalojnë dhe të miratohen nga Parlamenti.

E para, për ndryshimin e ligjit të komisioneve hetimore. Ligji i komisioneve hetimore është miratuar nga Parlamenti në kohën që ju keni qenë shumicë, por e kemi miratuar bashkërisht. Ligji është model evropian, ai respekton institucionet, përcakton se cila është hapësira që një komision hetues i një Parlamenti mund të përdorë. Ne kemi përvojën tonë, një pjesë e mirë e njerëzve që janë në sallë e dinë fare mirë se, në fund të fundit, çdo komision hetimor që krijohet përfundon me një raport. Ky është modeli. Për fat të keq, në Kuvendin tonë na ka përfunduar disa herë edhe me dy raporte, çka nuk është normale.

Sot kërkohet të ndërhyhet për të prishur modelin. Modeli është evropian, çështja e mundësisë për të hetuar dhe deri ku, është e përcaktuar te modeli. Nëse për një çështje ka dëshirë të hetojë Parlamenti, por kjo çështje hetohet nga institucionet e tjera që nuk varen nga Parlamenti, por nga gjyqësori, ndërpritet hetimi parlamentar. Lexoni ligjin francez!

Edhe nëse ka filluar një hetim parlamentar, nga momenti që një prokuror merr dhe shqyrton çështjen, ndërpritet hetimi parlamentar. Edhe pse ata e kanë më të vështirë se ne, se një hetim parlamentar mund të vazhdojë mes dy legjislativave, pra, edhe po të ketë zgjedhje në mes, hetimi parlamentar vijon. Pra, nuk është një çështje që ndryshohet me ligj, enkas, për një dëshirë të caktuar, në një moment të caktuar, është një çështje modeli. Hetimi parlamentar përfundon gjithmonë me një raport dhe në këtë raport ka vetëm rekomandime dhe objektivi kryesor është ndryshimi i ligjit.

Ky është hetimi parlamentar dhe kjo është hapësira e tij. Pra, nuk do të jetë aspak e mundur që të bëhet një kompromis për çështjen e modelit, se modeli nuk është yni.

E dyta, është propozimi për të hapur apo mos hapur kutitë. Hapja apo moshapja nuk zgjidhen te ligji për komisionet parlamentare, zgjidhen te Kodi Elektorale. Nëse gjykojmë se duhet të ndryshojmë modalitetet e hapjeve të kutive, mund të diskutohet fare mirë te Kodi Elektorale, se aty është vendi për t'u diskutuar, por jo te ligji "Për komisionet hetimore". Është e rëndësishme që problemi i zgjedhjeve nuk janë thjesht kutitë, kutitë janë një nga aspektet, është vetëm një dru në pyllin e zgjedhjeve.

Ka shumë aspekte të tjera dhe fakti që lajtmotivi i të gjitha diskutimeve të opozitës ka qenë "të hapen kutitë", sepse këtu na paska ca gjëra të fshehta e duhet t'i marrim vesh është mashtrues. Pse? Nuk është e vërtetë, siç pretendoni në të gjitha

diskutimet tuaja, se janë manipuluar zgjedhjet dhe ka fituar kjo maxhorancë në kurriz të opozitës socialiste. Nuk është e vërtetë, dhe këtë ju të gjithë e dini fare mirë, e dinë edhe ata 20 mijë komisionerët tuaj, e dinë fare mirë ata qindra mijëra që kanë votuar për ju, dhe të gjithë shqiptarët që kanë marrë pjesë në votime. Nuk do të dalë asgjë e paditur nga hapja e kutive edhe nëse ecet në atë linjë. Nuk ka deformim të rezultatit të votimeve në Shqipëri. Pse? Jua tha kolegu Maliqi dje disa arsye. Të gjithë ata socialistë që janë këshilltarë, kryetar komunash, komisionerë në qarkun e Beratit, të gjithë kundër PS-së na paskan punuar? Nëse ecim me atë që thoni ju, se kjo maxhorancë ka marrë votat tuaja, atëherë, pse nuk mori kjo maxhorancë 71 deputetë, por mori 70? Nuk dinte të merrte 71? Mos thoni gjëra që nuk i beson njeri! Është fatkeqësi që edhe të rinjtë të ecin me këto mentalitete, që nuk i beson kush në Shqipëri. A ka probleme vota në Shqipëri? Sigurisht që ka.

Ndaj, them se nuk ka nevojë fare të ngrihet komision hetimor për votimet, pasi ne e dimë fare mirë se cilat janë problemet e votimeve në Shqipëri. Votimet kanë probleme edhe në Amerikë, edhe në Europë. Procesi i zgjedhjeve në një vend është një proces në përmirësim të vijueshëm, nuk ka dyshim që në votimet e 28 qershorit Shqipëria ka arritur disa standarde që nuk i ka pasur në raport me veten, por edhe disa standarde që nuk i kanë as vendet e tjera europiane, sepse jo të gjitha kanë listat elektronike dhe listat elektorale që dalin mbi bazën e tyre e që kanë qenë një nga problemet më madhore të të gjitha zgjedhjeve të këtij vendi që nga 91-shi deri më sot.

E dyta, identifikimi i personit që voton, pra ID-ja biometrike. Gjashtë muaj luftuat kundër tyre, të gjitha para zgjedhjeve. Ajo u bë dhe ky është një sukses që duhet vlerësuar, sepse është një standard i ri për zgjedhjet në Shqipëri. Pra, iku historia e certifikatave jo me një vullë, jo me dy vulla, jo në dy vende, jo në tri vende, dhe kemi një sistem shumë koherent, i cili nuk manipulohet dot.

E treta, transparencja. Tregimi publik i votës, që ju pretendoni se diçka ka ndodhur atje në kuti, është një standard që nuk e kanë as vendet e tjera të BE-së. Pra, është një standard shumë i mirë dhe absolutisht duhet thënë se transparencja më e madhe jo vetëm që është arritur në Shqipëri, por është një transparencë maksimale në raport me vendet e tjera demokratike dhe të gjitha këto i them për të shprehur se nuk ka pasur marrje të votave nga njëri krah dhe çuarje në krahun tjetër. A ka

probleme? Ne i dimë dhe nuk kemi nevojë fare për komision hetimor për të marrë vesh problemet e zgjedhjeve në Shqipëri.

Deputetët dhe njerëzit që kanë kohë në drejtimin e partive, i dinë fare mirë se cilat janë defektet dhe është fare e thjeshtë të krijojmë një komision hetimor, të marrim rekomandimet e ODIHR-it dhe të bëjmë përmirësimet, për të cilat ka nevojë në Shqipëri. Ju thashë se edhe në Amerikë ka probleme në zgjedhje dhe vetëm rreth 60% e qytetarëve që kanë të drejtën e votës janë në listat elektorale. Ju e dini fare mirë që kanë dy nivele votash: votën popullore dhe votën e përfaqësuesve dhe janë probleme që i ka sistemi i tyre elektorale, siç ka edhe në Europë, siç ka në shumë vende në Europë, që e detyrojnë votuesin të shkojë, ndryshe duhet të paguajë gjobë deri në 300 euro, në disa vende.

Pra, ka gjëra të cilat bashkërisht mund t'i rregullojmë, për të përmirësuar zgjedhjet në të ardhmen, në qoftë se vërtet kenë problemin e zgjedhjeve të ardhshme. Por nuk është ky problemi. Problemi juaj është problemi si të bëjmë të themi që nuk ka humbur PS-ja dhe drejtuesi i PS-së të jetë përsëri drejtues i saj. Por kjo është një çështje që lidhet me atë parti dhe nuk është mirë të baltosen institucionet shqiptare. Nuk është mirë të baltosen zgjedhjet, sepse janë zgjedhje për të cilat kemi pasur jo vetëm certifikim kombëtar dhe ndërkombëtar, por dhe vlerësime nga ekspertë ndërkombëtarë, sidomos nga ekspertë të mirëfilltë zgjedhjesh. Nuk është mirë të baltoset Parlamenti si institucion. Gjashtë muaj opozita nuk vjen në Parlament. Nuk është normale. Nuk është mirë të baltoset institucioni i gjyqësorit dhe të mos keni besim të prokuroria dhe gjykatat. Çojini aty, le ta marrin vesh të gjithë ata shqiptarë, të çfarëdo partie që të jenë, se po shkele ligjin, do të shkosh në prokurori, do të shkosh në gjykatë dhe do të ndëshkohesh, siç e kemi të shkruar në kod.

Pra, unë do t'ju ftoja që të jeni më racionalë, të punojmë bashkërisht, se jemi në një moment shumë të rëndësishëm integrimi. Nuk është produktive të vëmë në dyshim kartat biometrike të shqiptarëve, sepse punojmë kundër vetes, kundër shqiptarëve, kundër socialistëve votues; nuk është mirë të luftojmë kundër Parlamentit, kundër gjykatës, kundër Gjykatës Kushtetuese. Po ju them unë se Ruzhdia, ju e përmendët pothuajse të gjithë, edhe ato 20 vendime të Gjykatës Kushtetuese që shumë nga ju i përmendët, që i kanë kthyer në Parlament, janë shenja që tregojnë se sistemi funksionon. Për sa

kohë që nuk janë marrë në konsideratë votat në Ruzhdië, domethënë që sistemi e kapi. Kjo është pozitive. Në qoftë se Gjykata Kushtetuese e ka kthyer në Parlament vendimin e Parlamentit, tregoi se funksionon ai institucion. Ky është parimi bazë i demokracisë, ku institucionet bashkëveprojnë për të arritur një rezultat publik në të mirë të publikut.

Unë ju falënderoj për vëmendjen.

(Ndërkohë, drejtimin e seancës e ka marrë zonja Jozefina Topalli.)

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Beja!

Zoti Ruka e ka fjalën. Urdhëroni!

Ethem Ruka – Zonja Kryetare,

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Nuk jam absolutisht i befasuar nga shërbesa e sotme parlamentare, as për fillimin dhe as për vazhdimin e këtij debati parlamentar lidhur me një nga çështjet më thelbësore të demokracisë, siç është transparenca e zgjedhjeve. Nuk jam i befasuar as nga zhargoni i rëndomtë i ofertave të bëra, as për joshjet, as për diversionet dhe aq më pak për kërcënimet e bëra nga zoti Berisha, të denja për një nivel të rëndomtë të bareve të periferisë së Tiranës. Besoja seriozisht se do të kishte një përpjekje serioze për ta konsideruar 18 marsin si gurin e fundit kilometrik për zgjidhjen e krizës së rëndë politike, ekonomike, sociale, morale që ka mbërthyer të gjithë vendin. Druaj se guri i fundit kilometrik për të cilin fola rrezik se po shndërrohet në gurin e parë kilometrik të një krize edhe më të rëndë, një krizë që nuk do të jetë pa pasoja në raport me qytetarët shqiptarë, në raport me partnerët tanë të vyer ndërkombëtarë.

Kriza për të cilën po flasim ka në thelb ndriçimin e së vërtetës: transparençën e zgjedhjeve, dhe pa hapur kutitë nuk ka transparençë të zgjedhjeve, ngado që ta vërtitni dhe çfarëdolloj argumenti që të sillni.

Ka njëzet vjet që organizojmë zgjedhje dhe lëngojmë dhe këtë e dimë të gjithë. Është një realitet tragjik në zgjedhjet në Shqipëri. Është një standard që duhet arritur me çdo çmim. Është një vlerë demokratike, është vlera që ngre një shtet demokratik; është vlera që e bën me të vërtetë Shqipërinë evropiane. Kjo situatë zgjedhore në Shqipëri, për fat të keq, është kthyer në normë, është kthyer në një mënyrë të menduar, është kthyer në një mënyrë të jetuar, është kthyer në një kulturë politike që duhet të shkallmohet. Kështu ndodhi edhe në zgjedhjet e fundit të 28 qershorit. Sigurisht, nuk pati dhunë fizike si në vitin 1996. Shumica këtu

janë të rinj dhe nuk i kanë provuar ato zgjedhje. Inteligjenca e manipulimit në këto zgjedhje ishte ekselente: “Manipulo, por zhduk gjurmët!”, veçanërisht për ndërkombëtarët, se çfarë thonë shqiptarët nuk ka asnjë lloj rëndësie. Dhe gjithë kjo kulturë ka vetëm një përgjegjës: zotin Berisha!

Nga ky realitet sigurisht buron një Parlament i kompromentuar, peng i të fortëve, peng i parave të zeza, peng i klientelizmit. Nga një Parlament i tillë buron një qeveri e tillë. Nga ky Parlament dalin organe kushtetuese, rrjedhin pushtetet e tjera, të cilat mbeten të nënshtruara ndaj një pushteti të vetëm, ekzekutivit qendror. Kjo është shoqëria që jetojmë, por, sigurisht, nuk e dëshirojmë për nesër, për veten dhe fëmijët tanë.

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Në konceptin tim debati i këtyre muajve bëri një skenar të plotë të pjekurisë së klasës politike, se sa ajo është e aftë të zgjidhë një krizë, rekomandim i marrë nga i gjithë faktori ndërkombëtar. Skanoi forcën e Presidentit të Republikës dhe mekanizmat e tij për të zgjidhur një krizë; skanoi pavarësinë e pushtetit gjyqësor, vendime të marra nën presion; skanoi vendimmarrjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; skanoi mendimin e medias shqiptare, forcën e analistëve për përpunimin e opinionëve politike në vend, qëndrimin ndaj propozimeve të faktorit ndërkombëtar, dhe mbi të gjitha, forcën e elektoratit të zemëruar për të organizuar tubime madhështore, të cilat do të jenë edhe më të mëdha se ato që janë bërë deri më sot.

Për fat të keq, rezultatet e këtij skanimi nuk janë aspak premtuese dhe shumë larg standardeve të vendeve të tjera të zhvilluara. Dhe ja ku jemi ballë për ballë. Ju kemi bërë një ofertë, në qoftë se doni ta quajmë kështu, dhe na keni bërë një ofertë. Oferta juaj nuk ka përmbajtje. Oferta juaj nuk skanon zgjedhjet. Ajo është vetëm për sy e faqe, vetëm për t'i shpëtuar presionit të opinionit publik, vendas dhe atij të huaj.

Ju propozuam një zgjidhje, me ngritjen e komisionit hetimor, megjithëse, për fat të keq, komisionet hetimore të Parlamentit shqiptar kanë dështuar njëri pas tjetrit. Ju e pranoni këtë komision hetimor, por duke shkallmuar themelet e këtij hetimi, pra thjesht hetim pa objekt hetimi. Pranoni nismën tonë ligjore lidhur me garancitë për zgjedhjet e ardhshme, por e ndryshoni atë me shumicë votash duke dhënë shembullin më të keq, se edhe e nesërmja e zgjedhjeve në Shqipëri nuk do të jetë më e mirë sesa e sotmja.

Besoj se ne kemi dhënë të gjithë argumentet se nisma jonë nuk ka asnjë pengesë ligjore, asnjë kundërshtim në interpretimin e Gjykatës Kushtetuese për objektin e komisioneve hetimore; asnjë kundërshtim me ligjin organik të komisioneve hetimore; asnjë kundërshtim me interpretimin e bërë nga Komisioni i Venecies për këtë çështje; asnjë kundërshtim me Kushtetutën e vendit lidhur me transparencën. Një krizë politike ka vetëm një zgjidhje: zgjidhjen politike, dhe ne jemi të sigurt që kjo zgjidhje politike nuk shkel absolutisht asnjë ligj.

Zotërinj të nderuar,

Qeveritë që ngrihen nga manipulimi i votës, siç është dhe Qeveria juaj, sjellin vetëm krizë. Realiteti në zonat periferike të vendit është migjenian. Le të ngrihet një grup deputetësh dhe të vizitojë fshatrat e çdo rrethi periferik të vendit dhe do të kuptojë se gjendja është më se e mjeruar. Nëse dëshironi mund t'ju shoqëroj në fshatrat e Tepelenës, ku pata rastin dhe nderin të bëja fushatën e këtyre zgjedhjeve. Fshatra pa rrugë, pa ujë, pa shkollë, pa shërbim mjekësor; fshatra dhe fshatarë në kufijtë e mbijetesës. Kjo gjendje nuk është aspak e ndryshme në fshatrat e Skraparit, as të Përmetit, as të Gramshit, as të Hasit, as të Kukësit, as të Pukës, as të Mirditës, as të Librazhdit e të shumë e të shumë rretheve të tjera të vendit.

Zotërinj të nderuar,

Zbardhja e zgjedhjeve dhe vendosja e një standardi të ri për nesër është një sfidë e përbashkët. Nuk është e Partisë Demokratike, është edhe e Partisë Socialiste, është e gjithë shoqërisë shqiptare. Duke mos pranuar këtë nismë, të paktën për mendimin tim, ju keni përligjur manipulimin e zgjedhjeve para opinionit publik vendas dhe atij të huaj. Provoni të kundërtën, t'i hapni kutitë, atëherë të shikojmë në qoftë se pretendimet tona janë të pabaza. Kjo do të kishte një kosto të jashtëzakonshme për forcën politike që përfaqësoj. Unë ju ftoj të reflektoni. Ka ende kohë.

Së fundi, guri i sotëm kilometrik mund të jetë i fundit për të zgjidhur krizën, ose, nëse nuk keni vullnetin ai do të jetë guri i parë kilometrik i një krize të vërtetë edhe më të thellë.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Ruka!

Para se të marrë fjalën zoti Tritan Shehu, do të ndërhyj unë. Nuk kisha ndër mend ta bëja këtë gjë, por pas fjalës së zotit Ruka unë do t'i them dy fjalë.

Zoti Ruka, po ndërhyj pas jush, meqë e di se ju nuk lexoni hartimet e të tjerëve. Ju keni lexuar diçka

që e keni shkruar vetë. Nuk kam ndërhyrë pas fjalës së asnjërit prej parafolësve, se nuk ishin fjalët e tyre. Ju thatë që nuk e prisnit këtë seancë. As unë zoti Ruka. As nuk e prisja, as nuk e doja, as nuk e dëshiroja. Nuk mund ta imagjinoja kurrë që një seancë plenare të kthehej në një gjyq special të komisionerëve socialistë dhe jo të dy vetëve, jo të 20 vetave, por të 20 mijë vetave. Nuk mund ta mendoj kurrë që pas 9 muajsh të mos keni një fakt, një provë asnjëri prej jush. Duhet të mos jesh fare parti që të mos gjesh një emër komisioneri që ju e quani të korruptuar.

Zonja parafolëse tha se, kur era i bie te balli, te faqja, kur loti i derdhet te goja për shkak të korrupsionit, tha shiten dhe blihen. Zonjë, ti s'njeh se çfarë është partia. Çdokush mund të shitet dhe blihet, por kurrë militantët. Kurrë militantë e partisë nuk shiten dhe nuk blihen. Dhe është shumë e rëndë ajo që ke thënë ti sot. Jashtëzakonisht e rëndë. Por duhet të fillosh ta duash militantin e ta respektosh partinë.

Parafolësi tjetër tha se do t'i përmbysim këto vlera. Zoti Gjoni, dhjetë vjet më parë kemi përmbysur babanë tuaj, por unë s'kam asnjë urrejtje për ty, por ti nuk mund të përmbysësh vlerat e NATO-s, zoti Gjoni, as nuk mund të përmbysësh ato vlera që ne arritëm më 28 qershor. E di pse jeni kaq të frustuar që të gjithë? Nuk ju besohet që më 28 qershor ju mund të humbisnit dhe se jeni mësuar gjithmonë me idenë se pushteti është vetëm për ju. Por duhet të thoni të vërtetën, sepse keni 24 orë që gënjeni. Pse ju them që gënjeni? Sepse, kur më sollët dy kërkesat, kishit 7 muaj që thoshit "duam komision hetimor dhe ky është i bazuar në kuadrin ligjor. Ditën që sollët kërkesën për komisionin hetimor, thatë jo, nuk ka ligj. Hajde të ndryshojmë pak ligjin". Gënjet kur thatë se doni transparencë të plotë. Të paktën 70 herë Sali Berisha mbrëmë në 7 orë ju ka ofruar transparencë të plotë sipas ligjit dhe kuadrin ligjor. Ju gënjeni përsëri kur thoni "s'i duam kutitë". Ju, more zotërinj, as nuk doni kutitë, as nuk doni hetimin, as nuk doni transparencën. Ju doni vetëm të transmetoni krizën e Edi Ramës, krizën e PS-së brenda këtij institucioni. Dhe në çfarë momenti? Në momentin më delikat, në momentin më të rëndësishëm për Shqipërinë.

Por ne jemi një popull që 100 vjet kemi qenë të izoluar. Po, ne vërtet kemi pasaporta diplomatike, por shqiptarët e tjerë mezi e presin 1 korrikun. Ju e dini mirë se çfarë do të thotë të dëmtosh procesin e liberalizimit të vizave. Po ku shkon përgjegjësia juaj

si deputetë socialistë? Cili prej socialistëve nuk do avancimin e mëtejshëm të progresit drejt BE-së? Sa është kostoja e dëmtimit të procesit të liberalizimit të vizave?

Zoti Gjoni, ka ikur koha e përmbytjeve dhe përmbysjeve. Janë përmbysur 20 vjet përpara. Harroje ti se përmbys një vend që është anëtar i NATO-s. Harroje! Mund ta dëshirosh ndoshta si babai yt, por harroje se mund ta përmbysësh! Ne jemi këtu me përgjegjësinë e thellë që ky Parlament të funksionojë me maxhorancë dhe opozitë. Doni hetim të plotë sipas ligjit? E keni të shkruar, e keni përpara. Doni transparencë të plotë sipas kuadrin ligjor? E keni në projektvendim mbi secilën prej tavolinave. Nëse ju pyes a e keni lexuar se cili është ky projektvendim, asnjëri prej jush nuk e ka lexuar, sepse ju nuk doni ta votoni ngritjen e komisionit hetimor, nuk doni hapjen e kutive, nuk doni transparencën e plotë, sepse nuk e do as kryetari juaj. Nuk janë zgjedhjet e manipuluar kur humbet.

Zoti Ruka, thatë se ky Parlament është i korruptuar. Gabohemi rëndë. Zgjedhjet e 28 qershorit ishin zgjedhje të certifikuara jo vetëm nga ne, por nga 510 vëzhgues ndërkombëtarë, që thanë se këto ishin zgjedhjet më të mira që plotësuan kriteret kryesore të OSBE-ODIHR-it. Gënjeni, zoti Ruka, kur thoni se janë manipuluar zgjedhjet me 28 qershor. Ju sulmoni OSBE-në dhe ODIHR-in, ju sulmoni Këshillin e Europës. Deklaratat tuaja janë të prera dhe nuk janë deklarata të pamatura e të paverifikuara. Këto ishin zgjedhjet më të mira, por ju nuk pranoni se keni humbur.

U them këtyre deputetëve të rinj, por edhe kolegëve të mi të vjetër, ish- ministra dhe kryeministra, se pas eksperiencës në opozitë, pastaj në pushtet dhe përsëri në opozitë, njëri prej jush më tha se ne jemi kthyer në gardianë të sistemit. Bëjeni, zotërinj! Kthehuni në gardianë të sistemit! Mos pranoni që të shkatërrohet sistemi! Mos e pranoni! Keni qenë ministra edhe kryeministra.

(Durtrokijte)

Urdhëroni, zoti Shehu!

Tritan Shehu – Falemnderit, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë,

(Ndërpritet nga deputetët socialistë.)

Jozefina Topalli – Më falni, zoti Shehu! E ka fjalën zoti Gjoni.

Ilir Gjoni - Zonja Topalli,

Është turp për ju si Kryetare e Kuvendit për këtë qëndrim dhe këtë gjuhë që përdorni. Mua më bëhet

qeji që fjala ime ju paska djegur shumë, juve dhe Kryeministrit tuaj, atij që ka shkatërruar këtë vend, që ka vrrarë njerëz, që bëri '97-n, ai që në '96-n ...

Jozefina Topalli - Ai të përmbysi babën tënd, prandaj e ke këtë urrejtje. Të përmbysi babën dhe ju, bllokmenët e rinj...

Ilir Gjoni - Babai im dhe të gjithë të atij brezi janë të nderuar. Se babai im, po të ishte këtu para 15 vjetësh, do ta kopsiste atë Kryeministrit tënd. Por nuk është si ai...

Jozefina Topalli - Shikojini bllokmenët e rinj, bllokmenët që kërkojnë ta mbajnë Shqipërinë të izoluar tamam si baballarët e tyre! Sa të jemi ne këtu, Ilir Xhelil Gjoni, nuk do të lejojmë që Shqipëria të mos liberalizojë vizat.

Ilir Gjoni – Po, moj Jozefinë Ruzhdia!

Jozefina Topalli - Harroje ti se mund të përmbysësh Qeverinë e dalë nga zgjedhjet e lira e të ndershme! Harroje, zoti Gjoni!

Ilir Gjoni - Ulu ndenjun aty! E paska hequr karrigen? Diku i paske thërrit mendjes. Më shumë do të shkurtohet karrigia, ty me këtë gjuhë që flet. Ti nuk mund të hedhësh dot baltë, zonja Jozefinë, ndaj gjithë atij brezi që ka punuar për këtë vend.

Jozefina Topalli - Për Xhelil Gjonin e ke fjalën ti?

Ilir Gjoni - Ti nuk mund të hedhësh dot baltë...

Jozefina Topalli – Shiko, ka vdekur komunizmi, Ilir Xhelil Gjoni. Nuk kthehet më komunizmi, Ilir Xhelil Gjoni. Ka vdekur koha kur babai yt mbante Shqipërinë të izoluar, e mbante me luftë klasash. Harroje se ka më përmbysje në Shqipëri! Ja tani do të të kujtoj diçka ty. I mjeri ti!

(Pasi deputeti Gjoni përdor fjalën zagar ndaj një deputeti të PD-së.)

Zoti Gjoni, fjalën “zagar” mund ta përdorni në shtëpinë tuaj, në asamblenë tuaj, jo për kolegët. Të tërheq vëmendjen në bazë të nenin 64! Këtu jemi në Parlament. Parlament do të thotë “parlare”, në bazë të Rregullores, të rregullave të etikës parlamentare.

Fjalën e ka zonja Xhuvani.

Luiza Xhuvani - Ju falënderoj për mikpritjen që më bëtë sot në Kuvend! Nuk e dija se fjalimi im do të ishte kokë turku sot. Dhe do t'ju thosha se më akuzuat se nuk e dua elektoratin tim. Do t'ju këshilloja të shkonit ta takonit elektoratin tim dhe ta shihni se çfarë relacioni ka Liza Xhuvani me elektoratin. Ndoshta nuk e keni parë kurrë.

Jozefina Topalli - Urdhëroni, zoti Shehu!

Tritan Shehu – Falemnderit, zonja Kryetare!

Të nderuar deputetë,

Prej disa muajsh Shqipëria po ndeshet me absurditete politike, bojkote institucionesh, gjysmë bojkote, kërkesa jorealiste, strategji krejtësisht absurde, të ideuara nga lidershpi i PS-së. Padyshim, kjo bie ndesh me interesat e vendit, bie ndesh me interesat e politikës shqiptare dhe të PS-së dhe të kolegëve deputetë të kësaj force politike. Megjithatë, fakti që ne sot po diskutojmë në këtë sallë pavarësisht nga argumentet absurde që mbahen nga minoranca, fakti që tani këta deputetë kanë zënë vendin e tyre, kanë bërë betimin dhe janë pjestarë të këtij Parlamenti, është një fakt pozitiv. Ka ardhur koha, të nderuar kolegë, t'i ktheheni racionalitetit, të merrni mbi vete përgjegjësitë dhe atributet e plota të deputetit, funksionet tuaja, të mendoni për të bashkëpunuar, të largoheni nga bojkoti si një element thellësisht antidemokratik, thellësisht në kundërshtim me interesat e vendit dhe këtyre momenteve të rëndësishme që ne kemi sot në Shqipëri. Më mirë se këtu me Rregulloren, me ligjet dhe Kushtetutën shqiptare ne nuk mund t'i shërbejmë Shqipërisë, po edhe vetes sonë dhe forcave tona politike.

Sidoqoftë, për të qenë i qartë dhe për të ndihmuar në kapërcimin e këtij ngërçi, unë mendoj se ka ardhur momenti të flasim hapur dhe t'i themi gjërat ashtu si janë.

Së pari, dua të them se kërkesa juaj për një draft ligjor, në shumë pika të saj është e papranueshme. Me këtë rast dua t'ju pyes: Çfarë modeli keni marrë? Asnjë përgjigje s'ka deri më sot. Çfarë konsulence ndërkombëtare është kërkuar për të realizuar dhe për të përgatitur këtë draft ligjor? A është pyetur OSBE-ja dhe ODIHR-i me të cilët ne kemi bërë Kodin Zgjedhor? Sepse në fakt ky draft godet dhe rolin e OSBE-ODIHR-it në vendin tonë. Ndoshta kjo është një hakmarrje për raportin dhe për certifikimin e zgjedhjeve që OSBE-ja u bëri zgjedhjeve tona para pak muajsh. Sidoqoftë, ky është një model *sui generis*, i pakrahasueshëm, i veçantë, i izoluar, është juaji.

Së dyti, koncepti i rinumërimit të votave pasi procesi zgjedhor është certifikuar dhe është mbyllur, që është edhe koncepti kryesor i draftit, të jemi realistë, nuk mund të jetë i pranueshëm. Kjo do të krijonte në vendin tonë një destabilitet afatgjatë, kjo mohon rregullat universale të përgjithshme të demokracisë. Ju kërkoni më këtë projekt që ne si deputetë të marrim përsipër këtë proces rinumërimi. Ju harroni se ne jemi aktorët dhe jemi në konflikt interesi me rolin që ju kërkoni të na jepni. Ne nuk mund të kthehemi në asnjë çast në gjykatës, as në

gjykatë. Gjykatësit nuk jemi ne. Ne nuk mund të zëvendësojmë pushtetet e tjera dhe as mund të marrim rolin e pushteteve të tjera mbi veten tonë, sepse kjo nuk është demokratike. Në qoftë se ju keni një përfytyrim të tillë për demokracinë, jam i detyruar t'ju them se ky përfytyrim është i përmbysur.

Realisht, maxhoranca, Kryeministri, PD-ja, ju kanë dhënë të gjitha mundësitë dhe hapësirat për një kompromis të mundshëm, për një komision zgjedhor të ndërtuar mbi principet kushtetuese dhe ligjore, për të kaluar këtë moment tuajin të vështirë, por jo për politikën shqiptare të vështirë. Ju e dini mirë se kërkesat tuaja, ato që ju keni paraqitur, nuk mund të ndodhin. Ju i kamufloji këto me kërkesën për transparencë, por kërkesa juaj dhe drafti ligjor nuk ka asgjë të përbashkët me transparencën, sepse transparenca në realitetin e zgjedhjeve të kaluara politike është bërë shumë e qartë. Është bërë nga ju vetë. Është bërë nga 20 mijë komisionerët që ju keni pasur në të gjithë territorin e vendit të cilët, pavarësisht se sot ju i sulmoni, i ofendon, doni t'i dënoni, kanë qenë tuajt, janë tuajt dhe kanë bërë transparencën për ju dhe ju keni bërë transparencën nëpërmjet tyre. Transparenca është bërë nga të gjitha institucionet zgjedhore, komisionet, Komisioni Qendror dhe deri të gjykatat, të cilat janë ato që japin vullën përfundimtare në një proces zgjedhor. Transparenca është bërë nga OSBE-ja, është bërë nga ODIHR-i, është bërë nga Këshilli i Europës, është bërë nga Parlamenti European. Pra, transparenca është bërë.

Ju e dini mirë dhe ne të gjithë e dimë mirë që një proces zgjedhor në të gjithë botën ka një mbarim ligjor dhe askush nuk mund ta kthejë prapa dhe e dimë se ai mbarim ligjor lidhet me vendimin final të drejtësisë. Në të vërtetë duhet të themi atë që është: kërkesa juaj nuk ka të bëjë aspak as me hapjen e kutive, as me transparencën dhe me asgjë tjetër. Kërkesa juaj ka të bëjë me tendencën për të fshehur humbjen, ka të bëjë me tendencën e frikës ndaj zgjedhjeve, ka të bëjë me tendencën për të krijuar në Shqipëri anarki dhe destabilitet, pra unë mendoj se ky është qëllimi i vërtetë i gjithë kësaj loje që po luhet sot në skenën politike shqiptare nga opozita shqiptare.

Ju, të nderuar kolegë, tentoni dhe guxoni të ndani popullin shqiptar në dy pjesë, ju flisni për popull opozitar dhe për një popull tjetër. Nuk e di, gjë më të rrezikshme dhe më absurde nuk mund të ketë. Qëllimi i atyre që ju drejtojnë dhe ju dhe ju kanë futur në këtë rrugë është pikërisht të krijojnë një

krizë artificiale në vend, të bllokojnë institucionet, të rrisin tensionet duke ndarë Shqipërinë në dy kampe dhe e shprehni qartësisht këtë gjë në të gjitha fjalimet tuaja, të ndaloni procesin e liberalizimit të vizave dhe të integritimit evropian të Shqipërisë. Skenar më cinik se ky për vendin nuk mund të ketë. Ju të gjithë kërkonit në këtë mënyrë nëpërmjet anarkisë të merrni atë pushtet që nuk e morët dot dhe që nuk e merrni dot me rrugë demokratike. Ju dëshironi kështu, sot në 2010-n, kur Shqipëria është anëtare e NATO-s, është një hap larg statusit të kandidatit për në BE, të përsërisni skenarët e vjetër të partisë suaj dhe të partisë mëmë nga e cila u konvertuat në një natë në PS. Kërkonit në këtë mënyrë të krijoni përsëri ato elemente të '97-s, kur ju organizuat atë rebelim komunisto-mafioz, kur goditët me armë rendin kushtetues duke i krijuar dëme të paimagjinueshme vendit tonë.

Në 2009-n ju flisni për Ruzhdien. Ju në Ruzhdie u përpoqët të eksperimentoni përsëri atë që bëtë në '96-n me tërheqjen e komisionerëve në të gjithë territorin e vendit, për të prishur procesin zgjedhor. Siç duket, diku po përgatitet një skenar i ri, ndoshta për Tiranën, për ta përdorur në zgjedhjet e ardhshme lokale, në qoftë se nuk do të funksionojë skema e bojkotit të plotë të zgjedhjeve lokale.

Sidoqoftë, për një gjë të jemi të qartë: këto sot nuk funksionojnë më. Shqipëria sot është në një tjetër nivel. Unë besoj dhe shpresoj që edhe ju të jeni në një tjetër nivel për të penguar këto aventura politike, të cilat mund të na sjellin dëm të gjithëve bashkë, në radhë të parë juve. Alternativë tjetër nuk ka. Mospjesëmarrja, largimi, izolimi, padyshim janë rruga më e mirë e përjashtimit politik. Prandaj ka vetëm një rrugë, vetëm një mënyrë: t'i bashkëngjiteni procesit të zhvillimit, të integritimit, të luani rolin e opozitës së vërtetë demokratike, pjesëmarrëse, kontribuese, alternative, kritike në këtë proces zhvillimi që ka vendi sot, duke kontribuar kështu në zhvillimin e vendit, por edhe në rritjen tuaj politike, në konsolidimin tuaj dhe në forcimin e imazhit politik të vendit. Rrugët për të shprehur kontestimet janë të qarta. Mund të shpreheni këtu, mund të shpreheni në gjykata, mund të shpreheni në prokurori, mund të shpreheni në institucionet ndërkombëtare. Ne jemi anëtarë të Këshillit Europës. Është edhe Komisioni i Venecias. Pra, rrugë dhe hapësira demokratike ka. Mjafton të ketë vullnet dhe dëshirë për t'i përdorur ato dhe për të kontribuar kështu në forcimin dhe integrimin e vendit. Kam frikë se disa nuk duan ta përdorin këtë rrugë, por duan të përdorin

të kundërtën. Shpresoj në ndërgjegjen e shumicës për të marrë në dorë përgjegjësitë dhe për të kontribuar në daljen nga ky ngërç i opozitës shqiptare dhe në futjen e saj qartësisht në rrugën e kontributit, të zhvillimit dhe të rritjes.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Shehu!
Zonja Gjermani e ka fjalën.

Eglantina Gjermani – Falemnderit, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë!

Partia Socialiste ka marrë një përgjegjësi historike për t'i dhënë fund historisë së manipulimit të zgjedhjeve dhe mbështetja që gjejmë çdo ditë të njerëzit për këtë qëllim është mbresëlënëse. Hapja e kutive të votimit shihet jo vetëm nga Partia Socialiste dhe mbështetësit e saj, por edhe nga qytetarët shqiptarë, si alternativa e vetme për të siguruar transparencën e plotë dhe të pakushtëzuar të zgjedhjeve të 28 qershorit.

Përmes hapjes së kutive Partia Socialiste do t'i garantojë të gjithë shqiptarët se vullneti i tyre nuk do të deformohet si në Ruzhdien e Fierit apo si në shumë Ruzhdiet e 28 qershorit. Besoj se të gjithë e kemi për detyrë t'u rikthejmë qytetarëve shqiptarë, një herë e përgjithmonë, besimin te vota e lirë dhe te institucionet që burojnë prej saj, sepse vetëm duke mos ua marrë votën qytetarëve edhe kur ata nuk e japin, ashtu siç ndodhi në zgjedhjet e shkuara, Parlamenti dhe Qeveria do të varen nga ajo votë, do të punojnë për atë votë, do të mbajnë premtimet për atë votë, do të sillen në mënyrë të qytetëruar për atë votë.

Qytetarët shqiptarë meritojnë një demokraci europiane, e cila nuk mund të arrihet kurrë duke mbyllur në kuti votat e grabitura dhe duke nxjerrë nga votimet parlament dhe qeveri që nuk shprehin vullnetin e lirë të qytetarëve.

Krijimi, objekti i hetimit dhe puna e komisioneve hetimore të Parlamentit nuk janë lëshime që i ofron Qeveria, por garanci që i ofron demokracia, që i ofron Kushtetuta, që i ofron ligji për të kontrolluar Qeverinë përmes përfaqësuesve të popullit në opozitë. Komisioni hetimor është një mjet që demokracia e vë në dispozicion të opozitës në mënyrë që ajo të realizojë lirisht dhe pa kufizime politike nga Qeveria misionin e saj të kontrollit kushtetues. Pikërisht për këtë arsye puna që bën komisioni, përfundimet e punës së tij, vendimmarrja e tij nuk janë të detyrueshme për gjykatat. Komisionet hetimore nuk akuzojnë dhe as fajësojnë një individ ligjërisht, as

nuk dënojnë dikë ligjërisht, kjo është përgjegjësi e pushtetit gjyqësor. Parlamenti i ngre këto komisione për të hetuar se si zbatohen ligjet që ai voton, se cilat janë aspektet e legjislacionit për një çështje me interes publik që duhen përmirësuar dhe cilat janë përgjegjësitë eventuale ligjore për moszbatimin e tyre. Këto të fundit komisioni ia çon prokurorisë, tamam siç ka ndodhur në rastet e mëparshme kur kemi parë raporte komisionesh të shkojnë në organin e akuzës.

Po përse atëherë Shqipëria, bashkë me komunitetin ndërkombëtar, kanë mbetur në të njëjtën pikë dhe prej muajsh qytetarët e këtij vendi ndalohen të marrin informacionin që ndodhet në kutitë e votimit të 28 qershorit? E drejta për informim, në fakt, është e drejta e çdo qytetari të Republikës së Shqipërisë dhe kjo e drejtë është e sanksionuar në Kushtetutën e saj. Por, fatkeqësisht, këtë herë e drejta për informim pengohet nga vullneti për deformim. Vullneti që deformoi votën e 28 qershorit, deformon sot të vërtetën e thjeshtë se komisioni hetimor nuk kufizohet dot në objektin e veprimtarisë së tij nga shumica qeveritare, sepse një e vërtetë tjetër lidhet me këtë, e vërteta që fshihet në kutitë e votimit. Pa atë të vërtetë nuk shkohet dot përpara, pa atë të vërtetë nuk shpëtojmë dot nga fenomeni i Ruzhdies, pa atë të vërtetë nuk garantohej as e vërteta e faturave të dritës dhe të ujit, as e vërteta e çmimeve që rriten përditë, as e vërteta e investimeve që nisin, por nuk mbarojnë.

Asnjë e vërtetë që ka të bëjë me qeverisjen nuk garantohej dot për qytetarin, nëse Qeveria nuk varet nga vota e qytetarit, por del nga gënjeshtria e fshehur në kuti. Pa të vërtetën e 28 qershorit të shkuar qytetarëve nuk mund t'u ofrohet as nesër një fushatë elektorale, ku secili të gëzojë lirinë e të menduarit dhe të drejtën e qëndrimit të pavarur nga Qeveria, nuk mund të ketë as nesër garanci për identitetin si zgjedhës në listën e votimit, kur bëhesh zgjedhës edhe kur nuk je fare në Shqipëri, nuk mund të ketë as nesër transparencë të shpenzimeve financiare të Qeverisë për fushatën elektorale, nuk mund të ketë as nesër standarde dhe drejtësi në qendrat e numërimit të votave, nuk mund të ketë as nesër drejtësi dhe paanësi në institucionet e administrimit të zgjedhjeve, nuk mund të ketë as nesër siguri që vota nuk do të dekonspirohet dhe mosdhënia e saj për Qeverinë nuk do të shoqërohet me heqjen nga puna, siç po ndodh rëndom.

Shoqëritë si jona, që janë në kërkim të konsolidimit të vlerave të rëndësishme sociale,

politike dhe demokratike e kanë shumë të nevojshme dhe të domosdoshme krijimin e një mendësie të re në trajtimin e problemeve dhe situatave me të cilat përballlet. Që demokracia të jetë efikase, që ajo të mbështesë nevojat, dëshirat dhe interesat e të gjithë qytetarëve, gra dhe burra, që demokracia të jetë e pastër kërkon barazi të drejtash, kërkon transparencë, kërkon garanci për secilin, sepse të gjithë janë të barabartë para ligjit në demokraci.

Shqiptarët kanë kohë që e kërkojnë dhe besoj se e meritojnë më shumë se kurrë këtë gjë. Ata janë gati të protestojnë për ta arritur këtë më shumë se kurrë, sepse e ardhmja e tyre nuk mund të jetë peng i së sotmes.

Hapja e kutive është hapja e rrugës të së ardhmes. Mbatja mbyllur e tyre, është mbatja peng në rrugën e së shkuarës. Ky Parlament duhet të mos e ndalojë hapjen e rrugës së të ardhmes, sepse duke bërë jetë gabim do të mbetet edhe vetë pjesë e së shkuarës, e një të shkuare me të cilën shqiptarët duan dhe do të ndahen.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit!

Zoti Fatos Hoxha e ka fjalën.

Fatos Hoxha – E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë dhe deputete,

Ka ndodhur gjithmonë që gjatë kohës kur në krye të PS-së është Edi Rama, e theksoj në krye të PS-së e jo të opozitës, sepse opozita nuk është një njeri, sepse po të ishte një, ky nuk bën, se ka konflikt interesi, nuk ka qenë asnjë ditë dhe asnjëherë të vetme në opozitë. Ai është një njeri që nuk rri dot asnjë orë të vetme në opozitë. Të gjithë shqiptarët janë dëshmitarë se si ky njeri duke e parandier humbjen në zgjedhjet e përgjithshme të 28 qershorit, pavarësisht faktit të të qenit kryetar partie, nuk pranoi të vinte emrin në listë për deputet.

Pra, ka ndodhur gjithmonë gjatë kësaj periudhe që ky njeri në ngjarje të mëdha ka kërkuar të bëjë dy lajme, ka kërkuar ta zhvendosë vëmendjen nga këto ngjarje të mëdha për shqiptarët. Kështu ndodhi në vitin 2006 kur me urdhër të tij për muaj me radhë Parlamenti u kthye në arenë bilbilash e borish, që u frynin deputetët opozitarë me qëllimin e vetëm për të treguar në opinionin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar se Shqipëria nuk është vend normal, nuk ka stabilitet, që të mos nënshkruhej MSA-ja, por nuk ia arriti qëllimit.

Më 10 qershor 2007 Shqipëria përjetoi një ngjarje të madhe, një ngjarje historike, vizitën e Presidentit

Bush. Nga Tirana Presidenti Bush paratha afrimin e dy ngjarjeve më të mëdha që i kanë ndodhur kombit shqiptar, Kosovën e pavarur dhe anëtarësimin e Shqipërisë në NATO. Mediat e kontrolluara prej tij shpërndanë me ngazëllim shpifjen e radhës, që për fat të keq bëri xhiron e botës, vjedhjen e orës së Presidentit Bush. Megjithëse Shtëpia e Bardhë dhe mediat prestigjioze ndërkombëtare e sqaruan këtë gënjeshtër të shekullit, dëmin e bëri Edi Rama.

Në prill 2009 Shqipëria bëhet anëtare e NATO-s, ditë që është ngulitur në memorien kombëtare si mrekullia e lirisë. Edhe këtë festë të madhe njeriu që nxinte dhe që doli e përshëndeti gati me zor dhe vetëm pas kumtesave të pozitës dhe presionit të medias, kujtoi se do të bënte përsëri lajm këtë radhë duke pasur veten në qendër të vëmendjes. Edhe në këtë rast përgjigjen e mori.

Në prill 2009 Kryeministri Berisha i dorëzoi Presidencës së BE-së kërkesën e Shqipërisë për aplikim dhe anëtarësi në BE. Ajo që do të bënte të mundur pranimin e kësaj kërkesë do të ishte mënyra e zhvillimit dhe sjelljes me zgjedhjet e përgjithshme të 28 qershorit. Ato u zhvilluan dhe u certifikuan nga të gjithë gjyqtarët e brendshëm dhe organizmat ndërkombëtare si zgjedhjet më të mira të zhvilluara ndonjëherë në vendin tonë. Pas kësaj vendim e prisnin ngjarje të mëdha, liberalizimi i vizave dhe pranimi i kërkesës për aplikim për pranim në BE, ëndrra shekullore e shqiptarëve. Por edhe këto festa, ashtu si festat e mëparshme kërkon dhe po punon çdo ditë t'ua prishë shqiptarëve ky njeri me emrin Edvin Rama. Prej muajsh mendja diabolike e këtij njeriu sajton dhe kompozon skandale korrupsioni qeveritar, shitje trojesh shqiptare te fqinjët, sajton rrahje gazetarësh, protesta pas protestash të të gjitha llojeve, duke i paralajmëruar dhe shpërndarë nëpërmjet mediave të kontrolluara prej tij.

Natën e 16 nëntorit ndërsa në Tiranë festohej dhe hidheshin fishekzjarre gëzimi për vendimin e Këshillit të Ministrave të Bashkimit European për pranimin e kërkesës për aplikim për anëtarësim në BE, ky njeri festonte në mënyrën e tij, duke protestuar në një qytet të Shqipërisë dhe duke bërë thirrje për mosnjohjen e Parlamentit dhe rrëzimin e Qeverisë. Në thirrjet e tij për mosnjohjen e Parlamentit të dalë nga zgjedhjet e lira ai nuk ishte vetëm, por shoqërohej nga Spartak Ngjela, Erion Veliaj, Skënder Gjinushi, Paskal Milo, Nard Ndoka, të gjithë jo deputetë.

Por çfarë kërkon ky njeri? Gjithçka ka kërkuar i është dhënë, çka nuk ka ndodhur më parë në jetën

politike shqiptare. Ka kërkuar ndryshimet kushtetuese, ndryshimin e sistemit dhe Kodit Zgjedhor, madje i ka bërë ato vetë. Por të gjitha këto i ka humbur me votën popullore të 28 qershorit. Gjithçka i është ofruar për hetimin e zgjedhjeve nga pozita, si në asnjë rast tjetër në historinë e zgjedhjeve problematike shqiptare, çdo instrument që ka në dorë politika. Por sot ai kërkon të pamundurën, të pakonceptueshmen, të paarritshmen, të paimagjinueshmen, që në shtetin ligjor nuk varet nga ne politikanët. Jo pa qëllim kërkon hapjen e kutive të votimit.

Ç'është ky njeri që nuk ka dëshirë të shohë njeri të gëzuar? Ç'është ky kryetar bashkie që na ka bërë të harrojmë se kemi opozitë? Opozita është lakmushi që mat shkallën e demokracisë. Ku është opozita parlamentare? Ku janë njerëzit që kanë 20 vjet kontribut në politikën shqiptare? Nuk po i shohim dhe dëgjojmë gjëkund. Të zgjedhurit për deputetë të opozitës i shohim nën urdhrat e kryetarit të tyre jo deputet në mitingje të ndryshme të organizuara në shumë qytete të Shqipërisë në kërkim të absurdit, duke u urdhëruar që në mitingun e radhës të sjellin me vete 10 ose 20 mitingashë, sipas rastit. I shohim në përplasje me Policinë e Shtetit, me Gardën e Republikës, në përplasje me të gjitha institucionet e shtetit ligjor, kudo dhe në çdo vend, kudo që i urdhëron kryetari i tyre jo deputet, deri edhe roje të ndërtimeve pa leje në qendër të Tiranës. I shohim në male tek debatojnë dhe përplasen me qytetarë, që për ironi të tyre u thonë të mos shëtisin, por të shkojnë aty ku u takon, në Kuvend, gjë për të cilën i kanë votuar zgjedhësit e tyre.

E shohim në ekrane, në rolin e liderit, kryebashkiakut, kryetarit të partisë, prindit të dashur për fëmijët, në rolin e dëgjuesit të vëmendshëm të halleve të popullit, të njeriut që respekton gratë, madje duke iu servirur edhe ushqimin atyre, në rolin e shpërndarësit të lajmërimeve për mitingun e radhës, deri në rolin e solistit këngëtar shohim vetëm një portret, portretin e Edvin Ramës.

Unë nuk jam mjek, aq më shumë specialist që t'i përgjigje pyetjes së madhe përse nuk feston ky njeri, por si deputet kam të gjithë të drejtën të shtroj pyetjen: Pse ky njeri kërkon t'u prishë festat e mëdha shqiptarëve? Vetëm gjatë këtyre ditëve po të shikoni mediat e kontrolluara prej tij, fabrikojnë lajmin që shqiptarët, ata pak që janë në Maqedoni, meqë u janë liberalizuar vizat po bëhen tmerr i Europës dhe këtë nuk e bën pa qëllim. E bën me qëllim për t'i thirrur Europës, për t'i thënë që mos të liberalizojë

vizat, sepse do të shihni se shqiptarët do ta bëjnë katrahurë Europën. Ky është lajtmotivi i tij dhe ajo që po përgatit ai në mediat që vetë i kontrollon. Ky është lajtmotivi i pasaportave që publikon nën prizmin "të falsifikuara" në mediat e ndërtuesve të kontrolluar nga ai. Unë nuk jam specialist t'i jap përgjigje se pse nuk buzëqesh ndonjëherë ky njeri, por vetëm ngërdheshet. Si qytetar i këtij vendi shqetësohem kur ky njeri ngryset kur shqiptarët vetëm festojnë.

Siç e thashë edhe më lart, nuk jam mjek e as specialist që t'i jap përgjigje nga ana shëndetësore se pse ky njeri feston në fatkeqësi dhe ngryset në festa, por jam i sigurt në fundin e tij. Para disa ditësh, zoti Ruçi, në një media na dha një lajm të madh, se më në fund elektorati i majtë e ndien kryetarin, por akoma më shumë, kryetari, më në fund e ndien bazën socialiste. Ky është vërtet lajm i madh për shqiptarët, por jo për ne. Ne e dinim me kohë. Kjo tregon, zoti Ruçi, se kryetari juaj e fitoi betejën me armikun e brendshëm dhe sot ai ka dy beteja të mëdha, atë të liberalizimit të vizave, të cilën duhet ta fitojë dhe atë të zgjedhjeve të ardhshme, e jo betejën që ju me diskutimet që ai vetë u ka shkruar, mundoheni të thoni. Zgjedhjet e 28 qershorit, e dini shumë mirë, janë certifikuar dhe nuk mund të fshihet vula, por problemi i madh i kryetarit tuaj është që të mos lejojë liberalizimin e vizave të shqiptarëve, sepse kjo i heq karrigen e pushtetit në PS.

Falemnderit!

(Ndërkohë, drejtimin e seancës e ka marrë zoti Turku.)

Ardian Turku – Falemnderit, zoti Hoxha.

Zoti Islami, urdhëroni!

Kastriot Islami – Falemnderit!

Të nderuar kolegë,

Shqipëria është i vetmi vend anëtar i NATO-s në një ngërç politik që kanë pasuar zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të vitit 2009. Kriza ekonomike, e brendshme dhe globale, e çiftuar me ngërçin politik po ndikon çdo ditë në rritjen e vështirësive sociale të shqiptarëve. Për më tepër, po rrezikon edhe çështjen tepër të ndjeshme të liberalizimit të vizave. Viti 2010 duket të jetë një vit i vështirë dhe vështirësisht i parashikueshëm.

Në këtë kontekst, mungesa e një vullneti politik për të zgjidhur krizën, veçse ndikon negativisht në të gjitha aspektet. Po ashtu, më vjen keq të pohoj se imazhi i vendit dhe, veçanërisht, i klasës politike, e mbi të gjitha i lidershit politik, është dëmtuar dhe goditur rëndë në sytë e publikut dhe të

partnerëve ndërkombëtarë.

Për të mos e zgjatur me retorikë pa shumë vlerë dhe as me argumente politiko-juridike, sado racionale qofshin, që duket se nuk ndikojnë më në qëndrimet e palëve, po shtoj në këtë debat të gjatë vetëm dy fjalë. Natyrisht në vijim të të gjithë qëndrimeve koherente që kam mbajtur për zgjedhjet dhe mundësitë e zgjidhjeve të këtij ngërçi politik.

Çështja themelore e të gjithë këtij debati rreth 8-mujor është hapja e kutive të votimit. Por, në thelb, debati bëhet për legjitimitetin e zgjedhjeve të 28 qershorit dhe të Kuvendit e, për rrjedhojë, të Qeverisë aktuale. Qëndrimet politike diametralisht të kundërta tanimë janë të qarta. Edhe argumentet përkatëse, politike dhe juridike, po ashtu. Përpjekjet për gjetjen e zgjidhjes kanë dështuar, sepse secila palë ka konsideruar si zgjidhje realizimin e objektivit të saj politik.

Nëse debati apo zgjidhja do të përqendrohen te legjitimiteti i zgjedhjeve, zgjidhja nuk ekziston as në rrugë ligjore e kushtetuese dhe as në rrugë politike. Ndërkohë që nuk mund të marr në konsideratë dhe refuzoj çdo rrugë tjetër jashtë kushtetuese e politike.

Të nderuar kolegë,

Duke ju referuar përpjekjeve shqiptare dhe ndërkombëtare dhe me vullnetin pozitiv për të mos mbyllur të gjitha shtigjet e gjetjes së zgjidhjes së këtij ngërçi politik po risjell në vëmendje dy mundësi, që mund të shërbenin për tejkalimin e kësaj situate të krizës politike. Natyrisht që zgjidhja varet tërësisht nga vullneti politik për ta futur zgjidhjen në shtratin e shtetit ligjor. Pra, zgjidhja do të ishte politike në kuptimin e vullnetit politik, vetëm nëse ka mirëkuptim për të vendosur zgjidhjen në shtratin e shtetit ligjor. Por, nga ana tjetër, zgjidhja konkrete duhet të jetë në përputhje me kuadrin kushtetues e ligjor në mënyrë që ajo të jetë jo vetëm afatgjatë, por edhe reale dhe mbi këtë bazë do të propozoja:

Fillimisht palët duhet të rikonfirmojnë minimalisht: Pranimin e rezultatit të zgjedhjeve të 28 qershorit 2009, të miratuar me vendim të KQZ-së dhe të deklaruar prej saj në 1 gusht 2009; Pranimin e legjitimitetit të Kuvendit dhe të gjithë institucioneve të dala prej tij; Pranimin e vlerësimeve dhe rekomandimeve të raportit të OSBE/ODHIR-it. Kurse, për të arritur një zgjidhje të pranueshme, palët do të duhet të pranonin: Së pari, nisur nga qëndrimet diametralisht të kundërta për hapjen e kutive, të shoqëruara me qëndrime të papërputhshme, për sa u përket interpretimeve të Kushtetutës dhe të

vendimeve të Gjykatës Kushtetuese për objektin e hetimit të komisioneve hetimore kuvendore, palët t'i drejtoheshin Komisionit të Venecias.

Nëse ekziston vullneti politik për ta referuar këtë interpretim në Komisionin e Venecias dhe pranuar rekomandimin e tij për çështjen e objektivit të hetimit për komisionin hetimor kuvendore në rastin e zgjedhjeve, teknologjia për t'iu drejtuar këtij komisioni gjendet lehtë. E thënë më thjesht, palët duhet të prononcohen për të gjetur mirëkuptim për këtë çështje.

Së dyti, pasi të merrej përgjigjja nga komisioni i Venecias, por edhe në rastin kur kjo rrugë nuk do të ndiqej, nisur edhe nga deklarimi i opozitës se kërkohet hetimi i zgjedhjeve, pa synuar ndryshimin e rezultatit zgjedhor, pra, pa cenuar legjitimitetin e zgjedhjeve, *in ekstremis* të pranohej që hetimi i kutive të votimit të zhvillohej për materialet zgjedhore.

Nëse ky nivel hetimi, pra deri në nivelin e hetimit të materialeve zgjedhore, do të pranohej nga palët, së bashku me pranimin e kushteve të mësipërme për mosndryshimin e rezultatit zgjedhor, pra, për moscenimin e legjitimitetit të zgjedhjeve, atëherë, gjykoj se do të mund të gjendej mekanizmi ligjor për të hetuar zgjedhjet, duke respektuar Kushtetutën, vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe Kodin Zgjedhor. Pra, do të gjendej një zgjidhje në formatin fitues-fitues për të dyja palët, por me sa duket nuk do të ketë zgjedhje brenda kontureve të shtetit ligjor. Po ashtu, fatkeqësisht më duhet të pohoj se edhe përpjekjet për zgjidhjeve politike jashtë këtyre kontureve, gjykoj se do të ishin të dështuara.

Falemnderit!

Ardian Turku - Falemnderit, zoti Islami.

Fjalën e ka zonja Doda.

Mesila Doda – Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Kemi gjashtë muaj që përsërisim e ripërsërisim të njëjtat fraza, për të njëjtat çështje dhe kemi gjashtë muaj që kemi harruar të flasim për shqiptarët. Keni gjashtë muaj që ju kërkoni të na bllokoni në çdo reformë, po kërkoni të na zhysni brenda nocionit krizë, ndërsa ne po mundohemi të neutralizojmë e të zhbëjmë në mendjet e shqiptarëve atë që Edi Rama po tenton të mbjellë.

Normalisht nuk do zija në gojë një njeri që mungon, por fakti është se kryetari juaj është i vetmi aktor protagonist që mungon në këtë sallë, ku gjithë detyra do t'ia donte të ish i ulur ai vetë në vijën e parë të deputetëve.

Në të vërtetë, nuk është aspak habi që Edi Rama mungon. Ka më shumë se 10 vjet që ai mungon në çdo debat publik, pasi nervat nuk i mbajnë ta ketë përballë kundërshtarit, madje, kur gazetarët i bëjnë pyetje të papëlqyera reagon si fëmijë i fyer.

Të nderuara zonja dhe zotërinj të opozitës,

Nuk mundem të mos respektoj, së paku, gatishmërinë tuaj për të qenë në vijën e parë të betejës së partisë suaj, por me keqardhje ju them se ende vazhdoni të mbeteni ushtri pa komandant dhe, pa komandant e pa kurajë, ju e dini që nuk ka kurrë fitore.

Të nderuar zotërinj,

Kemi dy ditë në një seancë boshe. Kemi dy ditë që u ripërsërisim shqiptarëve të njëjtat fjalë. Ne ju vëmë përpara Kushtetutën dhe ligjet e vendit, ju na kërcënoni me dy togfjalëshja: krizë dhe Bashkimi European.

Asnjë ditë e këtyre 6 muajve nuk ka qene në krizë. Ka qenë e trishtueshme, sepse është e trishtueshme kur sheh gjysmat e deputetëve në detyrën për të cilën u votuan dhe gjysmën tjetër peng të liderit të tyre të ri, por nuk ka qenë krizë. Kemi vazhduar të votojmë dhe të miratojmë ligje për shqiptarët. E vetmja seancë që po shkon në verbull e retorikë boshe është kjo e sotmja.

E kuptoj dëshirën e të gjithë kolegëve të opozitës, veçanërisht të të rinjve që kanë hyrë me dëshirën për t'u bërë politikanë të mirë e të denjë për t'u besuar, qe kanë ëndërruar ndoshta për vite të thonë fjalën e tyre dhe të votuesve të tyre në këtë foltore. Por kjo e sotmja nuk është një ditë e mirë për fjalën tuaj të parë, pasi ky është debat shterpë. Ne operojmë kithtas, sepse kur ne ju themi ligj, ju thoni krizë; kur ne themi Kushtetutë, ju na përgjigjeni Edi Rama fitoi; kur ne ju themi rrugë ligjore si zgjidhje, ju na përgjigjeni se s'ka proces integrimi për shqiptarët.

Ky është kodi i mbrapshtë i komunikimit që kemi vendosur. Dhe në mes na rrinë kutitë e votimit, të cilët kanë obseduar fillimisht kryetarin tuaj dhe më pas të gjithë ju. E kemi filluar mbrapsht këtë komunikim që do duhet ta promovojmë për thujse 3 vitet e ardhshme. Komunikimi nuk nis nga kutia, por nga shqiptarët. Kutitë nuk janë tonat, zotërinj. Ato janë nën administrimin e një organi të pavarur, nën vendimin e gjykatave të pavarura, dhe mbi to mund të hetojë, t'i hapë e t'i mbyllë vetëm një tjetër organ i pavarur që është Prokuroria e Republikës. Kjo është rruga reale që ju kemi ofruar. Ky është realiteti i ndodhur në rastin e shumë përmendur të

fshatit Ruzhdie, ky është një nga shembujt që tregojnë se ngërçet zgjidhen me logjikë dhe me respekt të shtetit ligjor, jo me teka absurde.

Meqë kam dëgjuar së fundmi të përmendet kaq shumë për fshatin Ruzhdie, ju ftoj përsëri të jeni seriozë dhe të mos përdorni më demagogji. Keni shkatërruar procesin e votimit në atë fshat, duke tërhequr komisionerët tuaj, vetëm e vetëm sepse e dini që ju në atë fshat nuk kishit vota. Ruzhdia ka 70 vjet që është në opozitë me ju, ka 70 vjet që nuk ju ka pranuar. E keni burgosur, internuar, e keni lënë pa bukë, pa të mbjella, prandaj dhe votën nuk jua jep dhe nuk do t'jua japë kurrë. Ju, zotërinj, jo vetëm shkatërruat procesin në këtë fshat që po zihet në gojë pa fund e pa asnjë lloj stime njerëzore për banorët, por e mashtroni opinionin, kur tregoni skandalet e kulisë dhe nuk thoni që kutia është shpallur e pavlefshme. Është rezultat nul në tabelën e përgjithshme të rezultateve, prandaj mos e harroni herën e ardhshme, kur të zini në gojë këtë fshat.

Thojeni që me këtë skenar nxorëm jashtë loje së paku 300 vota të Partisë Demokratike, të përhershme të dhëna në këtë zonë. Ka vetëm një mësim që mund të nxjerrim nga ky rast. Ky sistem bipartizan që kemi zgjedhur mund të rezultojë tejet i brishtë, nga dëshira, teka apo keqdashja e një rës palë apo palës tjetër të politikës. Këtë ne nuk mund ta lejojmë. Kjo duhet të jetë sfida e ardhshme e sistemit tonë, përveç shumë rregullimeve të tjera, që do të duhet të promovojmë së bashku.

Të nderuar zotërinj!

Kryetari i opozitës deklaroi disa javë më parë se në gjithë sistemin tonë institucional ka vetëm një instancë që ka mundur të përballojë presionin e maxhorancës dhe kjo është Gjykata Kushtetuese. Delegacioni i Presidencës së Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës kërkoi që palët t'i drejtohen kësaj instance dhe Komisionit të Venecias për interpretimin e mundësisë apo jo të hapjes së kutive. Rezultati është përsëri nul, pasi kryetari humbës i opozitës është i bindur se di ta lexojë Kushtetutën më mirë se juristët e Venecias.

Të nderuar zotërinj!

Jemi përballë një sjelljeje absurde! Opozita nuk i beson kolegjit zgjedhor, nuk i beson KQZ-së, nuk i beson Gjykatës Kushtetuese, nuk i beson Komisionit të Venecias, nuk i beson as komisionerëve të vet. I vetmi institucion që beson dhe që duhet të zëvendësojë gjithë të tjerët është komisioni i ngritur prej tyre, i dominuar në maxhorancë prej tyre, i kontrolluar vetëm nga syri

vigjilent i tyre dhe nga hamendjet e kryetarit të tyre. Kjo është kërkesë me një thelb të fortë punist, pasi zhduk çdo institucion për t'i dhënë jetë rolit hegjemon të partisë. Dhe kjo është e papranueshme në një demokraci!

Të nderuar zotërinj!

Prej muajsh, Europa po pret një zgjidhje të situatës. Ky është momenti i shqiptarëve. Këtë aspiratë të madhe ju e keni kthyer në një kërcënim ndaj nesh. Ju kërkoni lëshimet e maxhorancës për të kontrolluar gjithçka, për t'u kthyer ju në prokurori, gjykatë, në Kushtetutë, për t'u kthyer ju në maxhorancë të pavotuar, por të marrë nën kërcënim.

Ju nuk mund ta përdorni kërkesën e Europës si pengmarrje kombëtare, sepse vizat do të merren jo vetëm për demokratët, por për shqiptarët, sepse statusi nuk do të merret për PD-në, por për Shqipërinë. Nëse mendoni se kërcënim i juaj ndaj këtyre aspiratave europiane të shqiptarëve do të na shtrëngojë të shkelim Kushtetutën, ligjin, zgjedhjet tona të lira dhe të ndershme, vullnetin e votës së lirë të shqiptarëve, atëherë mund t'ju pohoj se po jetoni brenda një gënjeshtre të madhe. Ne këtë nuk do ta pranojmë asnjëherë, me asnjë kusht, pa asnjë dyshim!

Ne do të vazhdojmë të respektojmë votën e shqiptarëve, do të vazhdojmë të çojmë përpara reformat në këtë vend dhe të bëjmë ligje edhe më të mira për shqiptarët. Nëse na kërkoni t'i këmbëjmë të gjitha këto në këmbim të heshtjes suaj për të mos minuar procesin e europianizimit në Shqipëri, në përsëri do t'ju themi jo! Në Europë do të hyjmë, sepse e meritojmë, sepse kemi bërë zgjedhjet më të mira në historinë e Shqipërisë, sepse po e çojmë përpara ekonominë e vendit dhe vazhdojmë të zhgënjejmë korin tuaj të kukuvajkave që lut krizën ekonomike, se e kemi nxjerrë Shqipërinë jashtë hartës së trafikeve dhe krimin, sepse e bëmë Shqipërinë vend anëtar të NATO-s dhe realizuam dokumentin më të mirë të identifikimit, sepse ne e shndërruam këtë vend!

Të nderuar zotërinj!

Kam dëgjuar shpesh nga ju të mërmërisni nëpër dhëmbë ditët e fundit vitin e mbrapshtë '97, fundin që na pret, terrorin që do të mund të sjellë e të tjera kësisoj. Lus që ky të jetë një keqkuptim dhe që askush nga ju nuk ka patur qëllim tendencioz të kujtojë kohën më të trishtë të shqiptarëve. Por ju deklaroj publikisht se nëse këto nuk janë lajthitje apo retorika momenti, unë personalisht do të kërkoja nga Prokurorja e Republikës së Shqipërisë të nisë

hetimet për tentativë dhe kërcënim të përmbysjes së rendit kushtetues me dhunë. Dhëntë Zoti dhe kjo përsiatje malinje është veç një keqkuptim, po ju garantoj se nëse do mendoni të realizoni një marrëzi të tillë, do të jeni të parët që do të bini pre e marrëzisë!

Shqiptarët nuk meritojnë më asnjë lloj shqetësimi. Ne të gjithë së bashku kemi sfida ardhmërie dhe nuk do të mbetemi peng tekash që tentojnë të na tërheqin zvarrë.

Falemnderit!

Ardian Turku – Falemnderit, zonja Doda!

Zoti Pirro Lutaj, urdhëroni!

Pirro Lutaj - I nderuar zoti drejtues i seancës,

E ndiej për detyrë që fjalën time të parë nga kjo foltore e lartë ta nis duke shprehur mirënjohjen dhe respektin më të madh për qytetarët e Fierit, Lushnjës dhe Mallakastrës, të cilët më 28 qershor votuan në mënyrë plebishitare për Partinë Socialiste, duke e lënë Partinë Demokratike në minorancë të dukshme. Ishin këta qytetarë të urtë dhe të kulturuar që i treguan një ministri të kabinetit Berisha, i cili edhe mbrëmë bëri cubin, duke i ndarë deputetët e PS-së në tigra dhe në lepuj, se sa lepur në fakt është ai vetë.

Po kështu, nuk mund të largohem nga kjo foltore pa i kujtuar sot Sali Berishës dhe maxhorancës së tij, se qytetarëve të qarkut të Fierit u kanë një detyrim të veçantë, u kanë detyrimin zyrtar, por edhe njerëzor, të flasin një herë dhe t'u thonë atyre se kur do t'i zbulojnë motivet dhe autoret e vrasjes së ish-deputetit të këtij qarku, Fatmir Xhindi.

Zonja e zotërinj deputetë,

Ne kemi ardhur në këtë seancë plenare për t'i dhënë një shans të ri konsensusit politik në vend dhe rikthimit në normalitet. Nëse më parë krizat politike na kanë detyruar të bëjmë marrëveshje për aministi për njerëz dhe me njerëz të padëshiruar, sot jemi këtu për të gërmuar thellë në plagën më të rëndë që ka marrë demokracia shqiptare në këto 20 vjet, atë të korrupsionit elektoral.

Në këtë sallë jemi të gjithë përgjegjës dhe mëkatarë për atë që ka ndodhur për 20 vjet rresht. Pa dyshim, në këtë top-listë nuk mundet askush t'ia zërë vendin e parë Kryeministrit aktual. Jemi përgjegjës që nuk e ndëshkuam korrupsionin elektoral majtas apo djathtas, korrupsion që me vullnetin e disa njerëzve ka frymëzuar herë pas here një ushtri të tërë të administratës zgjedhore të prekin votat e qytetarëve në shkëmbim të fitimeve që burojnë nga pushteti i paligjshëm.

Duke qenë viktimat e fundit të këtij krimi elektoral, ne kërkojmë sot të kapërcejmë mbi fatin tonë të padrejtë dhe të njohim legjitimitetin e këtij Parlamenti, duke kërkuar si kusht të panegociueshëm hetimin e krimit elektoral të 28 qershorit dhe shërimin përfundimtar të demokracisë shqiptare nga kjo plagë.

Ne duam të këqyrim dokumentet për të parë zbatimin e ligjit dhe të gjejmë shkaqet që çuan në moszbatimin e tij. Kërkesa jonë nuk ka të bëjë vetëm me të ardhmen tonë politike, por dhe tuajën. Ajo mbi të gjitha është garanci për qytetarët shqiptarë, të cilët duhet të binden se votat e tyre do të numërohen për atë që qytetarët e kanë hedhur dhe ashtu siç ata e kanë hedhur.

Për çdo qytetar të Shqipërisë sonë të lodhur, por edhe për qytetarët e vendeve perëndimore që dëgjojnë sot këtë debat, është e pakuptimtë se si një shumicë në pushtet, edhe pse kundërshtarët ia kanë njohur mandatin e dyshimtë, heziton të dalë nga korrupsioni elektoral.

Ne ju bëjmë apelin tonë të pakthyeshëm për të dalë nga kjo trashëgimi kriminale elektorale. Vetëm ata njerëz që janë të përfshirë personalisht në këtë krim, mund të kenë kaq frikë sa ç'po reflektoni ju në këtë sallë.

Ju flisni për shtet të së drejtës, i cili në një vend demokratik është shumë, por në këtë paloshtetin tuaj asgjë. Nëse ky shteti juaj do të ishte vërtet i së drejtës, Gërdecit nuk do t'i thoshit nder, por turp, grabitjes së fondeve në rrugën Durrës-Kukës nuk do t'i thoshit meritë, por do t'i vinit emrin që meriton, përmblytjeve në Shkodër nuk do t'u vinit emrin meritë, por detyrim. Sot, të paktën 2 apo 3 nga ministrat që janë ulur në poltronat pas shpinës sime, do t'u bënin shoqëri Gaxhait, Lul Berishës apo Delijorgjit në burgun e Peqinit

Të nderuar zonja e zotërinj,

Në betejën tonë për t'i dhënë fund korrupsionit me votën në Shqipëri, ne kemi përdorur deri tani qëndresën qytetare të këmbënguljes dhe të kërkesës së pakthyeshme. Nëse ju vijoni të shtoni kokëfortësinë dhe jo arsyen, metodat tona politike e demokratike do të bëhen dhe më dëshmuese.

Ne kemi vullnet të plotë ta çojmë deri në fund këtë betejë, ndërkohë që vonesa juaj po i merr kohë çdo shqiptari. Ne kemi ndërgjegjen e madhe të moshumbjes së kohës së shqiptarëve, për këtë arsye këmbëngulim dhe po sakrifikojmë kaq gjatë.

Shqipëria, shtëpia jonë e përbashkët, nuk ka aq fuqi dhe luks të vërtitet nga beteja në betejë, nga

kriza në krizë, nga varfëria në mjerim, nga normaliteti në anarki dhe spontaneitet për llogari të politikantit të krizave me emrin Sali Berisha. Ne të gjithë sa jemi në këtë sallë, duhet t'i japim shansin shtëpisë sonë të përbashkët të qeveriset me rregulla të ndershme loje dhe tua bëjmë më të mirë jetën banorëve të saj. Ne jemi të vendosur ta marrim Shqipërinë europiane nga duart e zullumqarëve për ta bërë shtëpi të çdo qytetari normal, ku do të dominojë ligji dhe institucionalizimi.

Nëse ju si shumicë në pushtet nuk pranoni kërkesën tonë për të hetuar zgjedhjet dhe për të pastruar të ardhmen e tyre nga kjo infrastrukturë mafioze që e ka uzurpuar, atëherë beteja jonë nuk është më për votën, por është betejë kundër mbrojtësve të atyre që e grabisin atë. Dhe mbrojtësit e atyre që grabitën votën e shqiptarëve më 28 qershor, janë Kryeministri Sali Berisha dhe ju, zotërinj ministra dhe deputetë të shumicës.

Beteja jonë me ju pas kësaj nuk ka më kuptim as nga foltorja e këtij Kuvendi dhe as nga sallat e gjykatave, por vetëm në rrugë, bashkë me shqiptarët, me ata shqiptarë që e duan këtë vend dhe nuk dëshirojnë që ai të vdesë pak nga pak, nën peshën e një pushteti që Shqipërinë e quan "kalë" për ta shaluar edhe kur ajo është duke dhënë shpirt.

Ne ju drejtohem ju grabitësve të votës së lirë për herë të fundit nga kjo foltore, se nuk duhet të mendoni që populli shqiptar nuk ua ka llogaritur zullumin tuaj ekonomik ditë pas dite, se nuk ka reshtur së shënuari krimet ekonomike që keni bërë mbi buxhetin, mbi pronat dhe mbi truallin kombëtar në ditët e pushtetzhvatjes suaj. Aritmetika e varfërimit ekonomik të çdo shqiptari në ditët e pushtetzhvatjes suaj nuk mbulohet dot nga aritmetika e rreme e shifrave në mbledhjet e Qeverisë së Saliut me shumë halle.

Sot është dita e fundit kur ne mund t'ju bëjmë apel ju zotërinjve të vetëquajtur shumicë, të mos e çoni me tej këtë betejë, të paktën, këtu brenda në këtë sallë. Jashtë kësaj salle ne kemi lirinë tonë të madhe për ta vazhduar fuqishëm dhe masivisht kauzën tonë për transparencë të plotë të procesit zgjedhor të 28 qershorit.

Prej nesër do të jemi përballë me ju, jo në këtë sallë, por në rrugët e Shqipërisë, atje ku krizat e tjera, në të cilat e keni futur vendin, presin zgjidhje së bashku me krizën politike që ka prodhuar vjedhja e votës nga ana juaj e konfirmuar tashmë.

Neve dhe të gjithë shqiptarëve, do ta keni shumë të vështirë të na rezistoni jo vetëm për hapjen e

kutive, por edhe për fillimin e një gjykimi përfundimtar, për t'i dhënë fund pushtetit tuaj abuzant dhe shpërdorues. Koha që i mbani peng të drejtës sonë, është pengmbajtje për Shqipërinë dhe shqiptarët.

Thirrini ndërgjegjes suaj tani, në këto momente historike, se pas kësaj nuk do të mund të thërrisni për ndihmë askënd. Madje, nuk do të mundet t'ju ofrojë ndihmë ndonjë fisnik dhe i njohur prej të gjithë shqiptarëve si njeri i paqes dhe pajtimit, si Bashkim Fino, me të cilin Kryeministri mbrëmë u tregua i pasjellshëm. Frika që sjell e drejta e dhunuar e qytetarëve në Shqipëri është e madhe. Këtë, së paku, zoti Berisha dhe një pjesë nga ju zotërinj e njihni mirë.

Falemnderit!

Ardian Turku – Falemnderit, zoti Lutaj!

Zoti Lamaj, urdhëroni!

Ylli Lamaj – I nderuar zoti drejtues i seancës, Të nderuar kolegë,

Si anëtar i Komisionit të Ligjeve mendoj se aty është diskutuar gjerë e gjatë për katër seanca rresht projekti i paraqitur nga opozita, gjithashtu edhe kolegë të tjerë kanë diskutuar gjatë e gjerë rreth kësaj.

Ka dy ditë që në këtë sallë debatohen shtesat dhe ndryshimet e projektligjit për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit dhe duket qartë dhe fare haptazi qëllimi juaj, të nderuar kolegë opozitarë, të shfrytëzoni maksimalisht këtë foltore jo për të kërkuar ose për të ofruar zgjidhje, siç jua ofrojmë ne, por për të përfutur sadopak kredon që humbët më 28 qershor nga vota e lirë popullore.

Në Komisionin e Ligjeve u dëgjuan dhe u diskutuan propozimet e paraqitura prej jush me durim dhe tolerancë dhe me dëshirën më të mirë për t'i dhënë një zgjidhje këtij ngërçi. Ju me kokëfortësi vazhdoni të këmbëngulni në kërkesën absurde. Thoni hajdeni që së bashku të shkelim Kushtetutën, hajdeni të shkelim mbi vendimet e Gjykatës Kushtetuese që kanë interpretuar dispozitat përkatëse të Kushtetutës; hajdeni së bashku të shkelim vendimet e KQZ-së dhe të Kolegjit Zgjedhor.

Pra, kërkonin që të votojmë shkërmoqjen e shtetit ligjor që me shumë sakrificë e kemi ngritur gjatë gjithë këtyre viteve. E megjithëse e keni të qartë përgjigjen e prerë të maxhorancës, vazhdoni të këmbëngulni, madje edhe të kërcënoni për destabilizim.

Një seri aktesh të organizmave dhe institucioneve

prestigjioze ndërkombëtare kanë konfirmuar faktin se zgjedhjet e 28 qershorit ishin zgjedhjet më të mira që janë zhvilluar deri më sot në Shqipëri, që kanë plotësuar standardet demokratike dhe si të tilla janë certifikuar prej tyre. Por ju nuk doni t'i pranoni dhe në këtë mënyrë ju po u bëni shërbimin më të keq shqiptarëve të të gjitha ngjyrave politike, që presin me padurim liberalizimin e lëvizjes së lirë në Europë. Uroj që deri në fund të kësaj seance të keni kohë të reflektoni!

Falemnderit!

Ardian Turku – Falemnderit, zoti Lamaj!

Zoti Sadri Abazi, urdhëroni!

Sadri Abazi – Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Sot më shumë se 8 muaj pas përfundimit të zgjedhjeve të 28 qershorit jemi në këtë sallë për të diskutuar sërish për zgjedhjet. Opozita, që ka njohur rezultatin, kërkon transparencë. Qeveria e Ruzhdies ka frikë nga transparenca, partnerët ndërkombëtarë kërkojnë hetim të hollësishëm dhe të detajuar, Qeveria e shartuar ka frikë nga hetimi. Partia Socialiste kërkon zgjidhjen e krizës politike dhe ekonomike që ka mbërthyer Shqipërinë. Maxhoranca e shartuar e do Shqipërinë të zhytur në krizë.

Sot ka një maxhorancë kokëfortë që po mban peng Shqipërinë dhe shqiptarët. Kjo maxhorancë e ka emrin Ruzhdië. Sot shqiptarët e dinë mirë se çfarë ndodhi më 28 qershor. Edhe më mirë e dinë ata që e menduan e projektuan dhe e zbatuan krimin elektorale. Nuk do të guxonte kurrë kryetari i komisionit në Ruzhdië të falsifikonte firmat e zgjedhësve po të mos kishte mbrojtjen e shtetit të bërë një me pushtetin. Kjo është arsyeja dhe prova pse ju nuk pranoni hapjen e kutive, nuk pranoni transparencën, duke shkelur mbi të drejtën dhe lirinë e votës. Gjatë dy javëve të fundit, shqiptarët janë shokuar nga faktet e reja në mbështetje të kërkesës së Partisë Socialiste për hetimin e zgjedhjeve: kanë njohur rastin e Ruzhdies, që është prova më e qartë se zgjedhjet e 28 qershorit u manipuluan, edhe më shumë nga sa u konstatua në raportin e OSBE-ODIHR-it, i cili arriti në përfundimin se një në çdo tri vota është numëruar keq ose shumë më keq. Ruzhdië nuk është rasti i vetëm, i izoluar në qarkun e Fierit, por është një fenomen i pranishëm kudo, në Veri edhe në Jug, pra, në të gjithë Shqipërinë.

Sot, si deputet i qarkut të Dibërës, dëshiroj të prezantoj përpara të gjithë shqiptarëve "Ruzhdiët" e Dibërës. Këto janë akte të reja dhe rrëqethëse, madje më të rënda se ato që keni parë për Ruzhdiën. Janë

prova që tregojnë se procesi i fundit zgjedhor ishte në të vërtetë një masakër zgjedhore me përmasa të paimagjinueshme dhe që vërtetojnë totalisht kërkesën tonë për transparencë dhe për hetim të plotë e të hollësishëm, jo për të ndryshuar rezultatin, por për t'i dhënë fund një herë e mirë korrupsionit elektoral dhe për t'u siguruar që zgjedhjet e ardhshme nuk do të jenë si ato që lamë pas, e përsëris "si ato që lamë pas", por, mbi të gjitha, për t'u dhënë një mësim të mirë të gjithë atyre individëve që janë përgjegjës për procesin zgjedhor, të cilët shkulin ligjin dhe që nuk mbajnë përgjegjësi përpara tij.

Në Ruzhdien e Maqellarës materialet zgjedhore janë plotësuar në datën 27 qershor, sepse vulat dhe fletët e votimit u mbajtën në shtëpitë e komisionerëve të PD-së. Regjistri i votuesve në këtë qendër nuk shënon as edhe një numër të vetëm identifikimi, mbi të gjitha votuesit rezultojnë të paidentifikueshëm. Rast flagrant është fshati Burim i kësaj komune. Në këtë qendër është votuar në shkelje të plotë me ligjin, pasi si mjet identifikimi është shënuar kartoni kufitar. Edhe Kalaja e Dodës është "Ruzhdie", ku është bërë votim familjar dhe pa dokumente identifikimi. Në fshatin Uji i Mirë numri i fletëve të votimit në kufi ishte më i madh sesa numri i votuesve. Po në këtë "Ruzhdie" janë shtuar në regjistrin e veçantë mbi 40 votues, pa u shënuar asnjë vendim gjykate. "Ruzhdie" në qarkun e Dibrës është dhe komuna Zallreç, me 7 qendra votimi, ku shënohet edhe rekordi historik i manipulimeve: janë gjetur kuti vetëm me dy vota për PS-në. "Ruzhdie" tjetër në qarkun e Dibrës është komuna Fushë-Çidhën, ku komisionerët e PS-së janë rrahur dhe janë larguar nga qendrat e votimit, por votimi ka vazhduar përsëri në "Ruzhdie", për ata që nuk ishin dhe për emigrantët. "Ruzhdie" në qarkun e Dibrës më 28 qershor është edhe komuna Zalldardhë, ku, megjithëse asnjë emigrant nuk u kthye për votime në Shqipëri, në listat e votimit rezultojnë të kenë votuar të gjithë emigrantët. "Ruzhdie" në qarkun e Dibrës është komuna Lurë, ku është votuar pa dokument identifikimi dhe kanë votuar të gjithë emigrantët. Votimi ka përfunduar në orën dhjetë të mëngjesit, kur janë mbyllur kutitë. "Ruzhdie" janë edhe qendrat e votimit në Selishtë, në Kastriot dhe në Luzni, ku ka pasur votim pa dokumente identifikimi, me numra të falsifikuar identiteti; votim në emër të emigrantëve, si dhe presione e kërcënime ndaj komisionerëve socialistë. Ajo që ka ndodhur në Dibër është e rëndë. Komisionerët e Partisë Socialiste në KZAZ-në e Dibrës kanë votuar kundër

procesverbalit përfundimtar të zgjedhjeve në këtë zonë, duke qenë të bindur për të gjitha shkeljet që janë kryer në votimet e 28 qershorit. Ky fakt hedh poshtë keqinformimin se komisionerët tanë e kanë pranuar rezultatin. Shihni procesverbalin: dy kanë votuar kundër, një nuk ka firmosur, kurse një tjetër... Për fat të keq, atë ditë, makina e ngarkuar me kutitë e qendrave të votimit ka udhëtuar drejt Shkodrës. "Pse?", do të thoni ju. Atje ishte fshehur një komisioner i cili duhet të firmoste patjetër. Shkoi makina në Shkodër, u gjet ku ishte fshehur komisionari dhe ai firmosi nën presion. Megjithatë, dy kanë firmosur kundër, kurse një nuk ka firmosur fare. Ja ku është procesverbali, ja ku janë edhe vërejtjet, të cilat tregojnë se përse kanë firmosur kundër.

(Ndërrhyrje nga salla.)

A do ta marrësh origjinalin?

Jemin Gjana – Ti ke qenë shofer, vëlla, e di mirë këtë punën e shoferit.

(Replika në sallë pa mikrofon.)

Ardian Turku – Zoti Balla! Zoti Gjana! Ju lutem!

Sadri Abazi – Uluni, zoti Gjana! Qetësohuni, zoti Gjana!

Ardian Turku – Zoti Balla, uluni!

Sadri Abazi – Zoti Gjana, qetësohuni, sepse njiheni si burrë i qetë.

Ardian Turku – Atëherë, vazhdoni, zoti Abazi!

(Ndërrhyrje nga salla.)

Ju lutem, zoti Gjana!

Sadri Abazi – Ky është fakt. A do fakte ti? Edhe unë po të jap një fakt: komisionerët socialistë...

Shiko, ke bërë një gabim, sepse nuk i ke treguar Kryeministrit që kanë firmosur kundër, që ai ta dinte. Pse e gënjen?

Ardian Turku – Zoti Abazi, ju lutem, vazhdoni!

Sadri Abazi – Të lutem, mos më ndërprit! Unë nuk të ndërpres, por të respektoj.

Është e vështirë të flasësh, por është e pamundur të heshtësh. A mund të heshtësh për jetën e vështirë ekonomike të dibranëve dhe të listave të gjata të borxheve që ata kanë?! Ju lutem, kolegë deputetë! A mund të heshtësh për gjendjen e mjeruar të minoriteteve të Bulqizës, kur zëri i tyre thërret nga galeritë e vdekjes për statusin e minoritit?! A mund të heshtësh për emigrantët dibranë dhe për vështirësitë e tyre?! A mund të heshtësh për bizneset që po falimentojnë çdo ditë në Dibër?! A mund të heshtim për rrugën Durrës-Kukës, ku ne dibranëve na u vodh ndërtimi i rrugës së Arbrit?! Jo! As kemi heshtur dhe as do të heshtim. Sot po bërtasim për

“Ruzhdiet” e Dibrës dhe të gjithë Shqipërisë, pasi dibranët dhe shqiptarët mbarë e dinë, tashmë, që në kutitë e “Ruzhdies” fshihet vullneti i tyre.

Duam të bëjmë transparencë përmes një hetimi kuvendor, me të drejtën që i jep Kushtetuta çdo pakice në Kuvend: për të hetuar sesi zbatohen ligjet e këtij Kuvendi në këtë shtet. Prandaj, apeli ynë sot është i qartë: hap kutitë dhe bëj transparencën!

Falemnderit!

Ardian Turku – Falemnderit, zoti Abazi!

Fjalën e ka zoti Bushati.

Astrit Bushati – Falemnderit, zoti drejtues i seancës!

Të nderuar kolegë,

Realisht, nuk është asnjëherë vonë dhe do të ishte për t’u përshëndetur zgjidhja e funksionimit normal të Parlamentit me opozitën në vendin e saj. Sigurisht që e presim një gjë të tillë, ashtu sikurse e presin edhe qytetarët e Shqipërisë.

Ne po kalojmë një situatë paradoksale, ku është ngritur apo fabrikuar një krizë, sigurisht, mbi një element themelor të demokracisë, siç janë zgjedhjet, të cilat janë certifikuar nga të gjithë faktorët vendas dhe ndërkombëtarë, të cilët gjykojnë dhe japin verdiktin për zhvillimin e tyre. E them që është paradoksale, sepse në raportet për zgjedhjet vlerësimet nuk janë vetëm për maxhorancën, por edhe për minorancën, pasi nga rreth 40 mijë komisionerë të të gjitha niveleve, ata kanë pasur gjysmën e tyre.

Ne duhet të krenoheshim me zgjedhjet e zhvilluara, pasi, për herë të parë, u plotësuan standardet bazë të OSBE-së dhe të demokracive të zhvilluara Perëndimore. Për këtë, merita është e të gjithë administratorëve të zgjedhjeve, duke përfshirë edhe gjysmën, ose, ndryshe, rreth 20 mijë komisionerë socialistë. Kjo është për t’u krenuar, jo për t’u turpëruar. Ne dhe ju duhet të krenohemi për hartimin e një Kodi Zgjedhor, i propozuar nga opozita dhe i votuar së bashku, i cili, pothuajse, në tërësinë e tij, sanksionoi transparencën maksimale dhe ndoshta të paprecedent edhe në vendet më të zhvilluara Perëndimore. Prandaj, sigurisht që duhet të krenohemi për këtë. Ne, madje, por edhe ju, duhet të krenohemi me fushatën e qetë dhe pa incidente, e cila u zhvillua si asnjëherë më parë. Ne, ashtu si edhe kryetari juaj, pak çaste pas mbylljes së votimeve, ishim dhe duhet të jemi krenarë për mënyrën e zhvillimit të ditës së votimeve. Ne, së bashku me ju, pas ditës së votimit, zhvilluam procesin më transparent të numërimit të votave, ku

çdo votë numërohej, filmohej, regjistrohej, transmetohej në kohë reale dhe vlerësohej nga grupet e numërimit. Vëzhguesit, të cilët kishin të drejtën e kontestimit të çdo vote në çdo moment, kishin, gjithashtu, edhe të drejtën e vlerësimit të saj veçmas. Për këtë duhet të krenohemi përpara çdo administratori të zgjedhjeve në vendet perëndimore. Çdo shqiptar duhet të ndihet krenar për procesin zgjedhor të zhvilluar në zgjedhjet e fundit, një dëshmi e pjekurisë së arritur nga demokracia shqiptare, sidomos në vitet e fundit.

Sigurisht, duke qenë pjesë aktive e fushatës elektorale, duhet t’u njoh disa, ose, realisht, shumë më shumë, meritën e maxhorancës për kujdesin e treguar gjatë procesit zgjedhor. Dua të falënderoj Qeverinë dhe institucionet e varësisë për përkujdesjen e vazhdueshme në pajisjen e qytetarëve shqiptarë me karta identiteti, si dhe për krijimin e një regjistri themelor të shtetasve e të zgjedhësve pa dyshim. Kjo bëri që gjatë procesit të votimeve të mos kishte ngatërresa apo ankesa për mungesën e emrit në listat e zgjedhësve. Çdo shqiptar, i cili iu drejtua qendrave të votimit, ka pasur mundësinë e votimit, ndryshe nga herët e tjera kur këtë të drejtë nuk e kanë pasur të gjithë. Unë i vlerësoj shumë liderët politikë të maxhorancës që prioritet të gjithë fushatës, deri në daljen e rezultatit përfundimtar, kanë pasur mbarëvajtjen e procesit zgjedhor. Kjo ka qenë primare për ne. Realisht, kanë qenë sforcime të mëdha nga ana jonë, në këto momente po flas për Shkodrën, për të futur në hulli normale procesin zgjedhor, i kërcënuar në çdo moment nga deputeti Doshi.

Deputetin tjetër, i cili foli në emër të Shkodrës, nuk e njihnin as komisionerët e vet, të cilët kërcënonin me largime nga komisionet e votimit, apo me largime me forcë të numëruesve të tyre nga vendnumërimet e votave, siç ka ndodhur në tri VNV-të e Shkodrës. Për hir të së vërtetës, kanë ardhur deputetë të Partisë Socialiste nga qendra për t’i mbushur mendjen zotit Doshi se rezultati nuk do të ndryshonte dhe do të ishte 7 me 4, në mënyrë që procesi të mos pengohej. Për ironi të fatit, pikërisht Shkodra, është zgjedhur nga lideri juaj për t’u kontestuar, kur të gjithë drejtuesit e PS-së dhe komisionerët e saj janë të bindur për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor në qarkun e Shkodrës, përveç problemeve që kanë krijuar ata vetë. Pas gjithë këtyre proceseve të lodhshme dhe të gjatë, jo pa pengesa, por me një përkushtim të madh jo vetëm tonin, por edhe të administratorëve socialistë të zgjedhjeve,

erdhën edhe verdiktet e OSBE-ODIHR-it, Këshillit të Europës, Bashkimit European dhe NATO-s, të cilët i cilësuan si zgjedhjet më të mirat të zhvilluara në historinë e pluralizmit në Shqipëri, duke plotësuar standardet bazë të vendeve anëtare të OSBE-së.

Kjo, realisht, është një ndër fitoret më të mëdha të politikës shqiptare, që i hapi rrugë liberalizmit të vizave dhe pranimit të Shqipërisë si vend kandidat i BE-së. Për çudi të të gjithëve, të vetë socialistëve, por edhe të një pjesë të lidërshiptit të saj, kryetari i opozitës, për të justifikuar humbjen, për të ruajtur çifligun e kryetarit dhe për t'u rikonfirmuar në krye të PS-së, hodhi tezën e manipulimit të zgjedhjeve. Realisht, kjo ishte një rrufe në qiell të pastër për të gjithë. Sot, pikërisht, në këto momente kyçe, integruese të vendit, kur Shqipëria është ndër vendet e vetme në botë me rritje ekonomike, në periudhën e realizimit të ëndrrës së shqiptarëve për të lëvizur pa viza në hapësirën europiane Shengen dhe pranimit të kërkesës për vend kandidat, zoti Rama, si trashëgimtar i denjë i bllokmenëve të fundit, dëshiron të dështojë këtë proces dhe të riizolojë Shqipërinë. Ai u kërkon shqiptarëve që të plotësojnë një tekë të tijën: hapjen e kutive, në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjet shqiptare. Ai kërkon një gjë të tillë në të gjitha institucionet ndërkombëtare, por pa pasur rezultat dhe duke pasur kërkesën ultimative të vazhdueshme të tyre për të zënë vendet tyre në Parlament. Pas ultimatimit të delegacionit të Këshillit të Europës, ai hyn në Parlament me kushte dhe kërkesa antikushtetuese të diskutuara gjatë ditëve të fundit. Disa nga juristët, deputetë të Partisë Socialiste, pas artikullimit fillestar të hapjes së kutive, janë munduar ta kanalizojnë dhe ta interpretojnë ligjërisht kërkesën absurde të liderit të tyre. I vetmi interpretim ligjor, sipas tyre, ka qenë transparencja e dokumenteve publike. Siç e përmenda më lart, transparencja ka qenë lajtmotivi kryesor i gjithë Kodit Zgjedhor të propozuar nga ju dhe të votuar së bashku. Çdo votë është numëruar, filmuar, transmetuar, regjistruar dhe nuk ka pasur asnjë kontestim nga asnjë prej 40 mijë komisionerëve dhe administratorët zgjedhore. Për më tepër, kërkesat tuaja për rinumërim janë hedhur poshtë me vendim gjyqësor të formës së prerë, pikërisht për arsyen e vetme se nuk ka pasur asnjë kontestim nga asnjëra palë.

Përpara disa ditësh një nga paraqitësit e projektligjit të Partisë Socialiste fliste për dobinë publike të një ndërmarrjeje të tillë. Dobia publike është zhvillimi realisht i një procesi zgjedhor të

standardizuar dhe të certifikuar, sa më transparent, siç e përshkrova dhe më lart, me një rezultat të dalë shpejt nga administrata zgjedhore që të lërë mundësinë e formimit të shpejtë të Qeverisë dhe përfundimit të një farë destabiliteti që prodhon çdo proces zgjedhor në të gjitha vendet demokratike. Nuk kemi dobi publike, por kemi dëm publik në rastin e hetimit për një periudhë 2-vjeçare të numërimit dhe rinumërimit të pafund të votave, duke u futur në një spirale që do ta çonte vendin drejt një destabiliteti permanent.

Në përfundim, të nderuar deputetë, ashtu siç kanë marrë shembull edhe deputetët më të vjetër të Parlamentit, ne në Shkodër kemi një shprehje që besoj se nuk e kemi vetëm ne: "Hedh një i marrë një gur në lumë dhe hidhen 100 të tjerë e s'mund ta nxjerrin". Unë nuk do të jem ndër ata që do të shkojnë ta nxjerrin. Uroj që të mos jenë as parlamentarët shqiptarë që do ta bëjnë një gjë të tillë, qofshin ata edhe të majtë.

Falemnderit!

Ardian Turku – Falemnderit, zoti Bushati!

Fjala është për zotin Fatos Tushe.

Fatos Tushe – Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Ndodhemi sot në këtë sallë në vazhdim të seancës së ditës së djeshme, duke shprehur vullnet për të kontribuar në zgjidhjen e krizës institucionale që ka mbërthyer vendin. Partia Socialiste dhe populli opozitar kërkon hetim të plotë e të pakushtëzuar të zgjedhjeve të 28 qershorit, si dhe është i bindur për të garantuar standarde ndërkombëtare të zgjedhjeve në të ardhmen dhe për t'i dhënë fund krizës politike dhe institucionale.

Disa herë gjatë seancës së djeshme është përmendur nga Kryeministri konsensusi për ngritjen e komisionit hetimor parlamentar, si dhe për transparencë të kushtëzuar, duke u justifikuar me mosdaljen mbi vendimin e gjykatave. Çlironi veten, zoti Kryeministër nga makthi i kutive që krizën që kemi në shtëpitë tona ta përballojmë dhe që integrimi i vendit të vijë si një proces i natyrshëm! Por juve ju tremb transparencja e pakushtëzuar e zgjedhjeve, se hapja e kutive do të nxjerrë në dritë të vërtetën pa gjyq, të vërtetën se kush votoi dhe si votoi dhe jo të vërtetën e tjetërsuar të realitetit që ne kërkuam të ndryshonim.

Thellimi i krizës në përgjithësi, edhe pse çdo ditë dalin tregues të përkeqësuar të ekonomisë, e megjithëse Qeveria refuzon ta pranojë, tregon për mosfunksionim të shtetit. Kjo duket në uljen e

ndjeshme të standardit të jetesës të familjeve shqiptare, ku kriza është ulur këmbëkryq, shtimin e numrit të të papunëve, ku një pjesë e njerëzve flasin me vete rrugëve nga hallet ekonomike, rritjen e çmimeve të mallrave të shportës, rritjen e çmimeve të energjisë elektrike dhe pagesa e faturave amorfe, rritjen e çmimeve të faturave spitalore, rritjen e tatimeve ndaj bizneseve, listat e barnave që çdo ditë e më pak po rimburohen.

Populli opozitar e di mirë se brenda kutive që rrinë të ngjuara është prona e tij, vota e tij dhe se ai nuk do të lejojë kurrë që këta pronarë të paligjshëm të votave që përgjërohen pas vendimeve të gjykatave t'i mashtrorin.

Zotërinj, kutitë nuk janë tajfun që do të shkatërrojnë gjithçka. Ato janë e vërteta mbi të cilën ngrihet shteti demokratik, shteti i së drejtës. Por po të hapen kutitë, askush nuk do të pranonte fatin e Ruzhdies, ku në emër të djalit apo të vajzës që jeton me vështirësi në emigracion dhe ku për ta pjesëmarrja në votim kushton kohë e para, ka votuar më i forti i qendrës së votimit, më i besuari i partisë në pushtet, që pa dyshim këto ditë është promovuar në administratën shtetërore, pa diplomë apo duke blerë diplomë diku në ndonjë universitet periferik të akredituar.

Po të hapen kutitë, do t'u rrëshqasë toka nën këmbë shumë personave, madje edhe disa deputetëve marifetçinj kutish, si-ç po rrëshqet për ne e gjithë Shqipëria e gërryer nga erozioni natyror dhe korrupsioni qeveritar.

Populli votën e ka pronë të tijën, ndaj do ta shohë se ku është katandisur nga ky pushtet-shtet, që nuk dallon kufirin e lirisë së tij dhe lirisë së tjetrit, të drejtës së tij dhe të drejtës së tjetrit.

Të nderuar kolegë,

Ne socialistët dhe së bashku me ne edhe populli opozitar besuam se do të kishte edhe për ju një herë të parë që të pranoni se votën e lirë e ka pronë populli dhe se askush tjetër nuk mund ta tjetërsojë. Qytetarët e Lushnjës, të cilët votuan më 28 qershor për Partinë Socialiste dhe të cilëve u përulëm me respekt e mirënjohje, nuk ndihen të qetë nga cinizmi qeveritar që për hir të pushtetit të pamerituar ka njoollur edhe shtetin shqiptar, themelet e të cilit u hodhën në Kongresin e Lushnjës.

Ju dhe Qeveria juaj që përgjëroheni për ligje dhe gjykata, hapni kutitë dhe çlironi Parlamentin dhe të gjithë vendin nga kriza. Meqenëse Shqipëria ndodhet përballë sfidave të mëdha të procesit të liberalizimit të vizave dhe kandidaturës në BE, procese që

kërkojnë reforma të mëdha e të shpejta, si dhe dialog midis Qeverisë dhe opozitës për ta bërë demokracinë funksionale, ju kërkohet të hapni kutitë dhe të bëni transparencën e plotë dhe të pakushtëzuar të zgjedhjeve të 28 qershorit, sepse votën e lirë nuk e zëvendëson asnjë mekanizëm tjetër.

Falemnderit!

Ardian Turku – Falemnderit, zoti Tushe!

Fjala është për zotin Kollozi.

Ardian Kollozi – Falemnderit, zoti Turku!

Të nderuar kolegë deputetë!

Meqenëse u fol këtu për mitologjinë dhe personazhe të saj, për Akilin e të tjerë, do t'ju them zotërinjve të opozitës se e gjykoj si joproduktiv dhe irracional vendimin e marrë nga ata për ta shndërruar këtë Ruzhdie në Helenë të Trojës. Më duket mision i pamundur dhe vendim i gabuar.

Prej disa muajsh jemi duke ndjekur me shqetësim e shpesh edhe me trishtim qëndrimin dhe pozicionin e marrë nga përfaqësuesit e opozitës. Jemi përpjekur të gjithë këtë kohë të parashikojmë e pse jo edhe të parandalojmë se kush do të ishte lëvizja e tyre e radhës, cila do të ishte gjetja, shkaku, artificia, që do të përdorej prej tyre për të justifikuar vendimin e marrë prej tyre e tashmë të qartë për të gjithë shqiptarët, atë marrjes së pushtetit jashtë kornizës kushtetuese, përtej të vetmes mënyrë që përcakton sistemi për realizimin e rotacioneve, votën e qytetarëve.

Në gjithë këta muaj maxhoranca ka treguar maturi, durim e vetëpërmbytje. Jemi përpjekur me shumë përkushtim e ekuilibër që krizën e brendshme të Partisë Socialiste, e nisur fillimisht për rikonfirmimin e lidershipit të vet e më pas për pronësimin e plotë të saj, ta bënim të mbetej atje ku nisi e të mos eksportohej si krizë politike, për të mos dëmtuar interesat e shqiptarëve në një vit ngjarjesh të shumëpritura e të aspiruara gjatë prej tyre. Për këtë me përgjegjshmëri të lartë tejkaluam vetveten dhe rregullat e demokracisë, duke i ofruar opozitës maxhorancën në komisionin hetimor parlamentar. Pranuar të votojmë çdo propozim të saj, si ndryshime në Kodin Zgjedhor për të përmirësuar maksimalisht zgjedhjet e radhës. Kemi ofruar kompromis për çdo çështje që varet nga ne dhe nga raportet bilaterale.

Por qëndrimi i opozitës, i thënë si andej nga jam unë, "nëma se s'ma ke", është absolutisht i papranueshëm dhe i patolerueshëm. Në rastet kur opozita nëpërmjet thirrjeve të rrugës, mosbindjes

civile dhe rrethimit të institucioneve u përpoq të testonte e të improvizonte marrjen e tyre e marrjen e pushtetit, na është dashur t'u shpjegojmë shqiptarëve se i gjithë ky aksion është në shërbim vetëm të kryetarit të Partisë Socialiste e të klanit pranë tij, se personi që po i thërret në këtë aventurë, Edvin Rama, instabilitetin psikik e moral e ka pjesë të së shkuarës së tij dhe, për fat të keq, fiziologjikisht edhe të së ardhmes së tij. Në fakt, reagimi qytetar ka qenë i jashtëzakonshëm e shumë koherent.

Unë jam nga ata persona që besoj se pjesëmarrja e pakrahasueshme me asnjë eveniment në 20 vjetët e fundit, në festimet e 8 dhjetorit, përveç cilësisë dhe rëndësisë së ngjarjes, më së shumti ishte reagim i qytetarëve të Tiranës dhe të gjithë Shqipërisë për të hedhur poshtë skenarë të lodhur e të tejkaluar nga koha e për të parë përpara drejt objektivave të përcaktuar mirë e qartë për të gjithë.

Përpyekjet e opozitës për ta shpërndarë krizën dhe tensionin në çdo qytet të Shqipërisë, banorët e këtyre zonave iu përgjigjën me shpërfillje e indiferencë, mitingjet u tkurrën e u mpakën dhe ai i fundit i zhvilluar në Vlorë kishte fiks 137 vota. Në fakt, vetëm kështu mund të ndodhte, sepse historia nuk njih shembuj dhe raste për beteja të fituara pa kauza të vërteta.

Zotërinj të opozitës,

Ajo që jeni duke kërkuar ju, edhe në qoftë se për ndonjë moment do të besonim se është realisht qëllimi i transparencës së zgjedhjeve, nuk është as më shumë dhe as më pak gjykimi nga Parlamenti i vendimeve të shqyrtuara më parë nga institucionet që i përkasin një pushteti tjetër, kur parimi i ndarjes së pushteteve është themeli dhe skeleti i këtij sistemi. Prandaj ne e konsiderojmë kërkesën tuaj jo vetëm të paligjshme e të pamundur, por dhe një precedent të rrezikshëm e me pasoja të shtrira në kohë.

Të nderuar kolegë,

Unë jam deputet i zgjedhur për herë të dytë dhe këto 5 vjet kam votuar çdo vendim të maxhorancës, pasi ai është konsultuar dhe është bërë si vendim grupi, por më duhet të them që sot qëndrimin tim se jam kundër çdo kompromisi dhe aq më pak të votoj që Parlamenti të kthehet në gjykatë supreme dhe në deputetët në gjykatës të tillë.

Në mbyllje të fjalës sime, ashtu siç kemi bërë në çdo rast kur kemi pasur mundësi, dua të ftoj kolegët e opozitës t'i kthehen jetës normale politike, të fillojnë të ravijëzojnë konturet e para të një

alternative krahasuese, konkurruese me këtë tonën, me maxhorancën, të fillojnë të shkruajnë strategjitë dhe enciklikat e tyre, sepse javët ikin shpejt, muaj gjithashtu dhe nuk do të donim që zgjedhjet e tjera t'u gjenin duke kërkuar programin tuaj të humbur.

Falemnderit!

Ardian Turku – Falemnderit, zoti Kollozi!

Fjalën e ka zoti Eltar Deda.

Eltar Deda – Zonja dhe zotërinj deputetë,

Falënderimet e para nga kjo foltore e Kuvendit të Shqipërisë si deputet i zgjedhur rishtas në këtë legjislaturë i takojnë të gjithë banorëve të qarkut të Vlorës, të cilët edhe këtë radhë, si asnjëherë tjetër votuan në maxhorancë alternativën e Partisë Socialiste. Edhe një herë, mirënjohje dhe respekt për besimin që na keni dhënë dhe ju sigurojmë se puna dhe kontributi ynë do të jetë veçse në drejtim të plotësimit të interesave tuaja dhe pa mëdyshje do të jemi jo vetëm përçues të shqetësimeve dhe problematikave tuaja, por do të luftojmë që ajo çfarë ju kërkoni të jetë pjesë e zgjidhjes sonë të përbashkët.

Ajo çka kërkojmë sot është e lidhur në mënyrë të pazgjidhshme me kauzën tonë dhe në të njëjtën kohë kauzën e të gjithë shqiptarëve, atë të hapjes së kutive, por njëkohësisht me faktin se transparencja e zgjedhjeve të 28 qershorit është çelësi i zgjidhjes së problemeve e halleve, që nuk zgjidhen dot me qeveri që i marrin votat edhe pa ua dhënë populli.

Diskutimi nga ana teknike dhe juridike e kërkesës sonë ka treguar se ne kemi të drejtë, Saliu jo, ne kemi argumente, Saliu jo, ne kemi opinionin me vete, Saliu prapë jo, sepse me ne është e vërteta, me Saliun është vetëm pushteti. Ju, zoti Kryeministër, edhe këto zgjedhje, si çdo radhë tjetër, dolët përpara qytetarëve të qarkut të Vlorës me një thes premtimesh, që e derdhët kudo, aty ku kishit derdhur premtimet e mëparshme, por keni lënë pas vetëm gropa të reja, bishta kazmash dhe dengje plehrash, humbje të ardhurash për familjet e punëtorëve të atyre kantierëve që i hapni me gërshtërit e inaugurimeve dhe i lini në kthetrat e korrupsionit të klanit tuaj. Pas keni lënë edhe shijen e keqe të shpurave të veshura me pushtet, që në vend të prezantimit të programit qeverisës, tregonin forcën e pushtetit nëpërmjet kërcënimeve dhe presioneve mbi qytetarët dhe të drejtën e tyre themelore dhe kushtetuese për të votuar lirisht. Pas keni lënë edhe arsimtarët, edukatorët e kopshteve dhe çerdheve, personelin e sistemit shëndetësor,

punonjësit e shtetit në rang lokal, të flakur nga puna, se nuk ju duan. Megjithëse në Vlorë, tashmë nuk ju duan as ata që ju kanë dashur, sepse ju mbanin për burrë dhe sot ndihen keq kur shohin se si ky burrë ka frikë nga kutitë. Keni lënë pas edhe shumë gjëra të tjera të papëlqyeshme për Vlorën.

Ju, zoti Berisha, të vërtetën e atyre kutive nuk do ta lini dot pas. Edhe sikur sot të mos bëheni burrë e t'i hapni, ato kuti do t'i keni përpara, deri sa t'i hapni, ose të largoheni. Duhet t'i hapni, zotëri, sepse Vlorës dhe gjithë Shqipërisë i ke një borxh të madh: të vërtetën e rrënjëve të pushtetit tuaj. Është vota e popullit, apo dora e Ruzhdies që ju mban aty? Këtë shqiptarët duhet ta mësojnë përpara se kjo faqe të kthehet. Kjo faqe nuk kthehet pa u kthyer ju nga rruga juaj e ruzhdifikimit të zgjedhjeve.

Kutia e qeverisjes së këtij vendi duhet të hapet njëherë e mirë që ky popull të mos qeveriset më nga ju, zoti Berisha, që nxirrni nga kutia për popullin premtime për gjëra që nuk do të ndodhin kurrë, ashtu siç thatë për TEC-in dhe Petroliferën në Vlorë. Duke mos ju mjaftuar makutëria me gënjeshtërën e parë elektorale, tani doni t'u merrni qytetarëve të Vlorës një sipërfaqe edhe më të madhe, prej 478 ha, në Pyllin e Sodës dhe zonat përreth, e konsideruar si mushkëria e Vlorës, gjoja për ta kthyer në zonë të lirë ekonomike dhe për ta shitur me një euro, thjesht dhe vetëm për qëllimet e familjes suaj.

Bëjuani të qartë qytetarëve të Vlorës cili është qëllimi i këtij vendimi qeverie, sepse ne jemi të vendosur për ta kundërshtuar me çdo lloj mjeti demokratik. Nuk do t'ju lejojë populli i Vlorës ta bëni Shqipërinë kutinë tuaj, zoti Berisha dhe as Vlorën pronën tuaj, duke e shtrirë korrupsionin në çdo qoshe të saj. Nuk do t'juja falë Vlora heqjen e asistencës sociale, largimin nga puna të naftëtarëve në emër gjoja të reformës, të arsimitarëve që humbën bukën e gojës, me të vetmin argument se qenë votues dhe komisionerë të PS-së.

Ju ndoqa mbrëmë me vëmendje kur na qanit hallin për komisionerët tanë. M'i kthe në punë komisionerët e mi në Vlorë, zoti Kryeministër! Ndër dhjetra të tillë që ju i keni hequr nga puna, po ju them vetëm një emër: ktheje arsimtaren Zare, që e gjithë Vlora e njeh që është socialiste dhe ti e pushove vetëm e vetëm se është e tillë! Nuk do t'juja falë Vlora ta shkatërroni edhe një herë të dytë. Kriza e rëndë ekonomike që ka mbuluar vendin po rëndon mbi supet e vlonjateëve çdo ditë e më shumë, bizneset e vogla po falimentojnë, duke çuar familje të tëra në varfëri të skajshme.

Prej fillimit të këtij viti jam ndeshur çdo ditë me ankesa të panumërta të qytetarëve për rritjen e çmimit të energjisë. Ju i dini shumë mirë të gjitha, nuk ka fjalë të përshkruajë varfërinë dhe ditët e errëta që po kalojnë fëmijët tanë. Por, fatkeqësia ku e keni zhytur Shqipërinë nuk ju prek as ju e as familjarët tuaj e as këtë Qeveri që e keni rreth vetes suaj. Ju e dini, por nuk e ndieni. Ju e vështroni, por nuk e shihni, e dëgjoni, por nuk doni ta kuptoni se Shqipëria po rënkton nën thundrën e korrupsionit tuaj. Si të mos mjaftonin të gjitha këto, ju, zoti Berisha, keni vendosur të vidhni si kaçak malesh edhe tokën e vlonjatëve. U keni vënë syrin Oriukmit, Novoselës, Konispolit dhe Borshit. Ju, zoti Kryeministër, nuk ju ndal tashmë asgjë. Ju, fjala pronar i ligjshëm i tokës, nuk ju thotë asgjë, përkundrazi, fjala zaptues ju personifikon: zaptues tokash, parash, ëndrrash, zaptues lirie dhe, mbi të gjitha, zaptues i votave.

Ju, zoti Berisha, nuk i kurseni as zyrtarët tuaj shërbëtorë. As kryetarin e Kthimit të Pronave dhe as atë të Zyrës Rajonale të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në Vlorë, të cilët, pasi plotësuan interesat tuaja, përfunduan në pranga dhe u nxorën në gjyqe të stisura, sa për të humbur gjurmët e korrupsionit dhe grabitjes, të kryera më urdhrin tuaj.

Bashkia e Vlorës, një nga bashkitë më të rëndësishme në vend, merr prej vitesh buxhet për investime minimale të planifikuara nga Qeveria juaj. Po ju sjell një shembull të diskriminimit që po i bëni bashkisë dhe qytetarëve të Vlorës: Fondet e akorduara në buxhetin e shtetit për vitin 2008 kanë qenë vetëm 50% e vlerës së vitit 2006. Për vitin 2009 vetëm 30% e së njëjtës vlerë dhe aktualisht jemi në kushtet ku fondet e akorduara për 2010-n janë akoma më keq, vetëm 9% e 2006-s. Gjithashtu, projektet e filluara në 2009-n janë bllokuar për mungesë likuiditeti, pasi Qeveria nuk lëvront fonde për të shlyer firmat zbatuese, të cilat janë të detyruara të pezullojnë punimet.

Zoti Berisha, të gjitha arsyet që rreshtova janë shumë pak krahasuar me gjendjen e mjerueshme në të cilën jeton populli i Vlorës dhe i gjithë Shqipërisë. Zoti Berisha, ju po i merrni frymën çdo shqiptari me kutitë e mbyllura, kuti nga ku buron forca juaj e pushtetit të korruptuar. Shqiptarët e dinë mirë se për sa kohë ju do të jeni të aftë të manipuloni votën e tyre, ju nuk do të jeni i aftë të zgjidhni problemet e tyre të rënda. Hapini kutitë, pasi nesër do të ketë mbaruar koha juaj!

Edhe diçka tjetër për kolegun tim të PD-së, zotin Kollozi. Do të doja që edhe ai të diskutonte në këtë

frymë dhe jo të merrej me numrat në mitingjet tona. Por, meqenëse ai e ka nisur këtë gjë, t'i japë llogari partisë së tij për rezultatin e fundit të zgjedhjeve të 28 qershorit, që është si asnjëherë tjetër, humbës përpara PS-së.

Falemnderit!

Ardian Turku – Falemnderit, zoti Deda!

Zoti Kollozi, për replikë, urdhëroni!

Ardian Kollozi – Falemnderit, zoti Turku!

Meqenëse më dha mundësinë kolegu Deda, për ta sqaruar një herë e mirë këtë punë, tashmë jemi gjashtë përfaqësues të opozitës dhe gjashtë të maxhorancës si deputetë të zgjedhur në qarkun e Vlorës. Në konceptin tim dhe në analizën tonë, PS-ja ka humbur pikërisht në Vlorë dhe qarqet e Jugut, sepse aty ajo nuk realizoi objektivat e saj. Këto janë të vërtetat.

Ardian Turku – Falemnderit, zoti Kollozi!

Zoti Metalla, urdhëroni!

Osman Metalla – Të nderuar deputetë,

Kjo seancë maratonë që po zhvillohet nga dita e djeshme dhe po vazhdon edhe sot, nuk është gjë tjetër veçse lexim i hartimeve që kanë bërë deputetët. Për shumë gjëra u fol këtu, u fol shumë për zgjedhjet, u fol për krizë politike e ekonomike, por shumë pak dëgjova të flitet për atë për të cilën është mbledhur ky Kuvend, për projektligjet e propozuara. Dhe kjo nuk është e rastësishme, por është e qëllimshme, është e qëllimshme sepse: Çfarë mund të thoni ju për nismat ligjore kur e dini fare mirë se ajo që kërkon është përtej asaj çka mund të bëhet në të vërtetë? Ju folët shumë për zgjedhjet, kur, në fakt, këto zgjedhje ishin zgjedhjet më të mira të bëra ndonjëherë në të gjithë këto vite të pluralizmit politik. U bënë tetë muaj që zgjedhjet kanë mbaruar, janë certifikuar nga të gjithë komisionerët tuaj e tanët, nga ana e KQZ-së, përfunduan të gjithë shkallët e ankimeve nëpër gjykata, u certifikuan dhe nga 510 vëzhgues ndërkombëtarë, si dhe nga ana e institucioneve ndërkombëtare. Së fundi, edhe Departamenti Amerikan i Shtetit u shpreh se zgjedhjet në Shqipëri ishin të lira dhe të ndershme, si dhe në respekt të ligjit.

Ju e dini fare mirë se këto ishin zgjedhjet më të mira, dhe pa dyshim, në përmbushjen e standardeve të këtyre zgjedhjeve meritë kishte maxhoranca. Por problemi është se juve ju duhet një justifikim për humbjen tuaj dhe i vetmi justifikim pa diskutim që mbetet nxirja dhe njollosja e këtyre zgjedhjeve. Po a mendoni se çfarë i bëhet vendit me këtë që po bëni, duke u munduar me çdo kusht që të nxihet

realiteti i zgjedhjeve në Shqipëri? E kam thënë dhe e them: të gjithë ata që kanë certifikuar zgjedhjet historikisht në Shqipëri, të paktën këtë herë ishin në një mendim unanim duke i certifikuar këto zgjedhje si më të mirat të bëra ndonjëherë dhe njëkohësisht si zgjedhje që përmbushën standardet.

Ju kërkon me çdo kusht hapjen e kutive kur e dini fare mirë se Kushtetuta nuk e lejon një gjë të tillë. Por, më lejoni t'ju pyes përsëri: A doni ju që të hapen kutitë? Përgjigjja ime është jo. Ju nuk doni hapjen e kutive, pasi, nëse do ta kishit dashur një gjë të tillë, do ta kishit bërë. Por ju nuk keni qëllim as hetimin dhe as transparencën e këtyre zgjedhjeve, por vetëm pengimin e reformave dhe njëkohësisht doni që ky vend, duke u marrë çdo ditë me kutitë, të mos merret me asnjë punë tjetër dhe kjo maxhorancë të dështojë, qytetarët shqiptarë të vazhdojnë të mbeten të izoluar dhe pa viza, dhe, sipas jush, në këtë mënyrë do t'i afroni vetes ditën e ardhjes në pushtet. Por gaboheni thellësisht, pasi në këtë mënyrë vetëm se largoni nga vetja mundësinë e ardhjes në pushtet.

Ju nuk doni hapjen e kutive, se po ta kishit dashur e kishit bërë. Shumë e kemi lakuar Ruzhdijen këtu. A nuk ishte prokuroria ajo që filloi procedurat për hetimin e kësaj qendre votimi dhe e bëri? Pra, paska një rrugë dhe kjo rrugë qenka ligjore. Ju nuk e doni një gjë të tillë duke respektuar ligjin, ju doni që këtë ta bëni duke shkelur ligjin, duke shkelur Kushtetutën. Nëse e doni, bëni atë që bëtë për Ruzhdijen, për të gjitha ato kuti që doni të hapni. Por e dini se të dëmtuarit jeni ju, e dini se të dëmtuarit do të jenë komisionerët tuaj, një pjesë e të cilëve e thyen ligjin me urdhrin tuaj dhe, në fakt, nuk do të ndëshkoheni ju, por ata të gjorët. Këtë u bëtë ju edhe komisionerëve në Shijak, më 11 mars të vitit 2007, duke i urdhëruar të bllokoni procesin dhe këta komisionerë u përballën me ligjin për fajin tuaj. Ju nuk doni hapjen e kutive pasi e dini se nëse hapen, do t'ju dalin deklaratat e turpit që keni bërë duke mashtruar mbarë opinionin kombëtar e ndërkombëtar.

Ju nuk doni madje as hetimin e zgjedhjeve, por thjesht doni të mbani peng këtë Kuvend, Qeverinë, kërkon të mbani peng integritimin dhe këtë e them me bindje, pasi deri tani, ju dhe kryetari juaj që ju dirigjon me sms, nuk ka demonstruar as më të voglin sinjal për zgjidhje të kësaj situatë politike, të cilën ju kërkon ta transformoni në krizë politike dhe ekonomike, duke dashur të bllokoni reformat me bojkotin tuaj.

Më thoni në cilin rast opozita ka demonstruar sadopak dëshirën dhe vullnetin për zhbllokimin e kësaj situate. Në këta tetë muaj në asnjë rast të vetëm nuk dhatë as edhe një mundësi për zgjidhje të këtij ngërçi, pasi në të gjitha rastet ajo që ju keni kërkuar ka qenë përtej të mundurës. Ajo që ju keni kërkuar nuk ka qenë zgjidhje, por vetëm minim i demokracisë. Ka qenë minim i demokracisë, pasi në një shtet demokratik nuk ka se si një pushtet të dalë mbi një tjetër, në një shtet demokratik nuk ka ndodhur që legjislativi apo ekzekutivi të dalë mbi gjyqësorin.

Me thoni një rast kur kjo maxhorancë ka dalë mbi vendimet e gjyqësorit, më thoni një rast kur kjo maxhorancë, edhe kur këto vendime kanë qenë dukshëm në disfavor të saj, nuk i ka zbatuar ato. Për më tepër unë që po flas sot këtu kam sakrifikuar një mandat të plotë deputeti vetëm e vetëm sepse mandati im në vitin 2001 u tjetërsua pikërisht nga një vendim absurd i Gjykatës Kushtetuese.

Megjithëse ky vendim mua personalisht nuk më është dukur absolutisht asnjëherë i drejtë, pasi ka qenë një vendim krejtësisht politik, maxhoranca dhe unë, personalisht, e kemi pranuar në atë kohë dhe kemi respektuar vendimin e gjykatës, pavarësisht se në raportin e OSBE-ODIHR-it në atë kohë thuhej shprehimisht: "Në shumë raste gjykata vendosi përfundimisht mbi rezultatet e zgjedhjeve. Megjithatë, vendimet e gjykatës nuk bazoheshin gjithmonë mbi standarde të përcaktuara qartë ose të zbatuara në mënyrë konsekuente". Dhe më poshtë thuhet: "Fakti se gjykatat nuk arritën të zgjidhnin ankesat e paraqitura përpara raundit të dytë ngrenë dyshime serioze për sa i përket besueshmërisë së procesit". Ne përsëri pranuar zgjedhjet dhe respektuam vendimet e gjykatës.

Çfarë ka ndodhur në zgjedhjet vendore në Tiranë në vitin 2003? Çfarë ndodhi në zgjedhjet e vitit 2007 në Durrës, ku numri i fletëve të votimit të pavlefshme ishte afro tri herë më i madh se diferenca e votave të kandidatit fitues me atë humbës? Përsëri ishte gjykata ajo e cila vendosi se kush do ta mbante mandatin. Dhe ne nuk bëmë as më shumë dhe as më pak, por respektuam vendimin e gjykatës.

U përmendën në disa raste zgjedhjet e parregullta dhe Shijaku. Jo, mor zotërinj, në Shijak janë zhvilluar zgjedhje demokratike, pasi ky qytet ka pasur dhe ka një kulturë të tillë, ka pasur besë e burrëri dhe ka qenë një qytet që ka ditur të respektojë mikun. Pikërisht, këtë ka kërkuar të përdorë pjesa e keqe e politikës, këtë bëri në

zgjedhjet e 2001-it, këtë bëri në zgjedhjet e 2005-s, këtë kërkoi të bënte në zgjedhjet e 2007-s dhe në ato të 2009-s, edhe në bilancin e zgjedhjeve në Shijak, dhe unë u kërkoi ndjesë, të më ndiejnë familjarët e atyre që do të përmend. Sot ne kemi dy komisionerë, një të vdekur dhe një që i shpëtoi vdekjes për mrekulli. Të dy ishin të Partisë Demokratike. Megjithatë, unë mendoj se nuk është kjo seancë ajo që do të bëjë hetimin. Ne jemi këtu për t'i çelur rrugën hetimit. Nëse duam, hajde të votojmë projektligjin.

Në këta 8 muaj ju nuk ofroni zgjidhje, por keni dashur të gjeneroni krizë. Në këta 8 muaj ju qëndruat jashtë këtij Kuvendi pa asnjë argument ligjor dhe këtë e dëshmoi edhe kërkesa juaj për amendimin e ligjit të komisioneve hetimore. Në këta 8 muaj logjika juaj nuk ka funksionuar për të ofruar zgjidhje, por vetëm për të gjetur mënyra për të lidhur nyjën gordiane në politikë. Dhe me atë çka ju kërkon, e keni krijuar një nyje të tillë.

Të gjithë e përshëndetën vendimin tuaj për ndërprerjen e bojkotit, por edhe ky nuk na paskësh qenë veçse një dredhi e radhës për t'u shfaqësuar në sytë e shqiptarëve dhe të ndërkombëtarëve, për t'u thënë atyre ne e bëmë tonën, hymë në Parlament, tani është maxhoranca ajo që nuk lëshon.

Nëse keni hyrë në Parlament për të gjetur zgjidhje, zgjidhja gjendet duke bashkëpunuar, duke komunikuar, duke respektuar ligjet e këtij vendi dhe duke respektuar Gjykatën Kushtetuese. Unë besoj se disa herë gjatë seancës së mbrëmshme, edhe sot, pothuaj të gjithë deputetët e maxhorancës që diskutuan, ofruan vullnetin dhe dëshirën për të gjetur zgjidhjen. Problemi është se të gjitha këto diskutime që ne po bëjmë nuk janë tjetër veçse retorikë. Ofertat janë, hajde të gjejmë zgjidhje. Vetëm kështu mund të kontribuohet në forcimin e demokracisë. Nëse është hyrë për të bërë teatër dhe besoj se seanca e Komisionit të Ligjeve për diskutimin e atyre draft-propozimeve të opozitës ishte një teatër, mendoj se edhe kjo seancë që po bëjmë sot, është vazhdim i atij teatri që u bë në Komisionin e Ligjeve.

Unë mendoj se në këtë formë, me çdo kosto, ju kërkon të mbani peng Parlamentin, reformat, të mbani peng zhvillimin dhe integrimin. Të kërkosht transparencën e zgjedhjeve është gjëja më e mirë. Unë besoj se jam nga ata deputetët në këtë sallë që për hir të asaj çka kam kaluar me zgjedhjet, e mbështes mjaft fuqishëm këtë gjë, por transparenca duhet të jetë në mënyrë të padiskutueshme në kufijtë

e asaj që lejon Kushtetuta. Të shkelësh Kushtetutën, do të thotë të kthehesh në diktaturë, pra, të mos pyesësh më për sovranin. Unë besoj se edhe nëse në këtë sallë mund të ketë akoma nostalgjikë të diktaturës, pjesa më e madhe ka luftuar për rrëzimin e saj.

Ky Kuvend ka demonstruar në momente të ndryshme se ka ditur të gjejë rrugën e duhur. Unë i ftoj kolegët e opozitës që të demonstrojnë më shumë përgjegjshmëri dhe vullnet për të gjetur zgjidhje.

Falemnderit!

Ardian Turku – Falemnderit, zoti Metalla!

Zoti Dogjani, urdhëroni!

Asllan Dogjani – I nderuar zoti drejtues i seancës,

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Përpara se të vija këtu, këtë sallë të Parlamentit e shikoja si tempullin e demokracisë, të lirisë dhe në fakt ashtu duhet të jetë, por sot jam i zhgënjyer kur e shoh nga brenda këtë sallë, kur dëgjoj se pas 20 vjetësh demokraci në tempullin e demokracisë flitet dhe diskutohet për vjedhjen e votës dhe nuk i jepet e drejta opozitës për ngritjen e komisionit hetimor dhe hetimin e plotë të zgjedhjeve, kur shoh e dëgjoj nga Kryeministri i Shqipërisë që nga njëra anë flet për parime kushtetuese, për të drejtat e njeriut, për prezumimin e pafajësisë dhe nga ana tjetër nuk lë gjë pa thënë ndaj atyre deputetëve të opozitës që ngrenë zërin dhe kërkojnë hapjen e kutive të votimit dhe flasin për korrupsionin elektoral.

Praktika ka treguar se po të doni ju, zoti Kryeministër, mund ti hapni kutitë, sepse ju hapët tunelin e Kalimashit dhe e mbajtët hapur për një kohë të gjatë duke shkelur të gjitha rregullat e sigurisë. Kurse tani nuk hapni kutitë e votimit, kur kjo është një kërkesë e bazuar në ligj dhe e argjontuar nga kolegët e mi paraardhës.

Para se të paraqes disa të dhëna dhe fakte se çfarë ka ndodhur në qarkun e Kukësit gjatë zgjedhjeve të 28 qershorit, do të bëja një kërkesë për Kryeministrin, megjithëse ai nuk ndodhet këtu. Zoti Berisha, do të jetë në nderin tuaj që t'u kërkon falje qytetarëve të qarkut të Kukësit, edhe atyre që votuan për Partinë Socialiste, edhe atyre që votuan për ju, si dhe atyre që nuk votuan fare, shqiptarëve të Shqipërisë dhe të Kosovës, për mashtrimin e madh që u bëre me hapjen e tunelit të Kalimashit të papërfunduar, Rrugës së Kombit, tri ditë para zgjedhjeve, vetëm për qëllim elektoral dhe që i mbylle pas zgjedhjeve, ndërsa akoma nuk dihet fati i tyre.

Ja pse e bojkotua Parlamentin dhe kërkojmë hetimin e plotë të zgjedhjeve, për të nxjerrë në dritën e diellit veç të tjerave se kush e dha urdhrin për hapjen e tunelit, për t'u njohur me të vërtetën e shembjes, pse u mbajt hapur në kundërshtim me të gjitha rregullat e sigurisë (Falë Zotit nuk solli tragjedi për qytetarët!), Për të zbardhur dhe hedhur dritë se përse ka filluar rruga të prishet në disa pjesë të saj akoma të papërfunduara.

Shfrytëzoj këtë foltore të Parlamentit për t'ju përsëritur kërkesën e qytetarëve kuksianë që të deklaroni publikisht dhe të na tregoni se a ka përfunduar ndërtimi i rrugës, meqë ju e përruat 3 ditë para zgjedhjeve. Nëse po, sa është vlera e ndërtimit të saj dhe në cilën datë do të hapet rruga?

Kërkesa jonë për transparencën e zgjedhjeve të 28 qershorit ka të bëjë me një detyrim kushtetues, me të drejtën e barazisë para ligjit, kontrollit të legjislativit ndaj ekzekutivit, të informimit publik me një të drejtë të garantuar me ligj, me të drejtën për të garantuar siguri të plotë për të gjithë, me të drejtën për të çrënjësuar praktikën e shëmtuar të krijuar që prej 20 vjetësh se çfarë futet në rutinë e votimit lexohet dhe kutitë nuk rihapen, nuk rinumërohen fletët e votimit, për të mbyllur përfundimisht kapitullin e manipulimit të zgjedhjeve.

Kjo praktikë ju ka çuar deri atje, zoti Kryeministër, sa në Shqipëri të mos realizoni deri më sot zgjedhje të ndershme e të lira dhe të mjaftoheni me disa shprehje standarde, se kemi ecur përpara, kur akoma nuk i kemi plotësuar standardet që kërkohen. Prandaj ne kërkojmë transparencë, për t'i dhënë fund kësaj praktike, për t'i dhënë fund tranzicionit shumëvjeçar dhe korrupsionit elektoral. Kërkesa jonë për transparencën e zgjedhjeve ka të bëjë me të drejtën për të informuar opinionin publik dhe për të parandaluar dhe siguruar garancinë në zgjedhjet e ardhshme.

Po përmend se çfarë ndodhi në qarkun e Kukësit. U larguan nga puna, u transferuan pa shkak për bindje politike, për pjesëmarrjen në mitingje të Partisë Socialiste ose mospjesëmarrjen në mitingjet e Partisë Demokratike, apo pse votuan për PS-në, para, gjatë dhe menjëherë pas zgjedhjeve, mësues, mjekë, deri edhe sanitare.

Fakti që u larguan nga puna, përveç të tjerëve, disa ditë pas zgjedhjeve, Liri Kacengu, edukatore me 15 vjet punë me 4 fëmijë jetimë, tregon sesa i pamëshirshëm është ky pushtet i përfaqësuar nga ju dhe se votimi nuk është i fshehtë, i lirë dhe i ndershëm.

Unë përmenda një rast, por ka shumë raste të tjera që ne i kemi bërë të njohura në mënyrë të vazhdueshme për opinionin publik dhe sot janë në procese gjyqësore. U abuzua në mënyrë të hapur nga pushteti dhe shteti vuri në funksion të zgjedhjeve pothuajse të gjitha burimet njerëzore, mjetet logjistike, asetet publike. Presioni i pushtetit dhe i shtetit arriti deri në heqjen e bukës së gojës dhe ndihmës ekonomike.

Presioni arriti deri aty sa t'u imponohej njerëzve të votonin për ju. U larguan me vendim të KZAZ-së numër 34 në mënyrë të dhunshme nga forcat e policisë dy anëtarët e komisionit të qendrës së votimit numër 652 vetëm pse kërkuan të zbatohet ligji dhe të mos votonin votues që nuk e kishin emrin në listë apo me gabime. U fut në këtë qendër drejtori i ri i policisë së qarkut të Kukësit dhe me prezencën e tij në qendrën e votimit ka bërë presion ndaj komisionerit të mbajtur peng në këtë qendër votimi.

Megjithëse ishte marrë vendim nga KZAZ-ja numër 34 që të mos përfshiheshin në tabelën përfundimtare të rezultatit qendrat e votimit numër 651, 652, edhe sot po të shikosh në këtë tabelë gjenden të shkruar rezultatet.

U konstatuan shkelje në rastet e përcaktimit të votave të pavlefshme në KZAZ-në numër 34, e shprehur edhe në raportin e OSBE-ODIHR-it. U votua në disa qendra votimi në qarkun e Kukësit në emër të emigrantëve të cilët nuk ndodhen në Shqipëri, u votua nga dy herë në Durrës dhe në Kukës, një herë në fshat e një herë në qytet, me lista të dubluara dhe pa dokumente identifikimi. U ushtrua presion mbi punonjësit e administratës, nxënësve të shkollës së mesme në Kukës, për t'i nxjerrë me detyrim në mitingjet e bëra nga ana juaj.

U shtuan rreth 4 mijë votues vetëm në Bashkinë e Kukësit, me gjithë ankesat tona mbetën të dubluar në këtë bashki rreth 350 votues, duke i transferuar nga një qendër në tjetrën apo dhe jashtë rrethit të Kukësit. Ajo që u bë me kartat e identitetit ishte një kaos i madh. Mungonte transparenca, nxirreshin pengesa nga më të ndryshmet ndaj socialistëve, vetëm që t'i sorollatinin e t'i linin pa votuar.

Kërkesa jonë për transparencë ka të bëjë me të drejtën për të hedhur dritë mbi premtimet e pambajtura, të bëra në çdo 4 vjet, për zgjidhjen e problemit të rreth 5700 familjeve të përmbytura nga liqeni i Fierzës, me rreth 1700 hektarë tokë, të cilave u është premtuar gjatë fushatave elektorale se do të kompensohen dhe do të zgjidhet problemi i tyre.

Për të gjitha manipulimet që rendita më lart ju

kërkoj, zoti Kryeministër, të hapni çfarëdo kutie votimi që ju dëshironi në Tropojë, Has apo Kukës dhe do të provohet se mekanizmi i korrupsionit është i njëjtë kudo, me blerje votash, me largime nga puna, me përdorimin e të gjitha aseteve publike dhe përdorimin e shtetit dhe të pushtetit, me heqjen e ndihmës ekonomike, votim në emër të emigrantëve. Kjo do t'ju provojë se Ruzhdia nuk është vetëm në Fier, por edhe në Tropojë, në Kukës. Pra, është një fenomen në të gjithë Shqipërinë.

Moshapja e kutive të votimit do të thotë më shumë korrupsion, më shumë varfëri, më shumë të papunë, më shumë nga ata që nuk janë në gjendje në qarkun e Kukësit të sigurojnë bukën e gojës, të bëjnë një vizitë në spital, të paguajnë ilaçet, më shumë lista borxhesh, më shumë të pastrehë, më shumë të pasigurt.

Ju keni frikë nga transparenca, sepse keni frikë nga e vërteta, nga shifrat e manipuluar, keni frikë nga dalja në dritë e korrupsionit elektorale. Unë do t'ju bëja thirrje të mos keni frikë nga transparenca, sepse e vërteta, sado e hidhur të jetë, është më e mirë se gënjeshtra. Pranoni komisionin hetimor parlamentar për hetimin e plotë të zgjedhjeve se vetëm kështu do të rrënjosisim kulturën e zbatimit të ligjit dhe do të garantojmë një proces të ndershëm elektorale, kthimin e besimit të votuesve të zgjedhjet e lira e të ndershme dhe do t'i bëjmë një shërbim të mirë vendit.

Vetëm pas hapjes së kutive të votimit dhe transparencës së plotë të zgjedhjeve të 28 qershorit ne do të sigurojmë që manipulime të tilla të mos përsëriten më, që vota të mos vidhet dhe politikanët, partitë, të mos guxojnë më të bëjnë premtime boshe sa për fushatat elektorale, sepse do të përballen me reagimin e qytetarëve dhe të botës.

Ne nuk kërkojmë krijimin e gjykatave të posaçme, as emërimin e prokurorëve specialë për hetimin e zgjedhjeve dhe procedimin e komisionerëve. Ne nuk mund të emërojmë prokurorë, sepse nuk është në kompetencën tonë. Por ne kërkojmë një të drejtë themelore, hetimin e plotë të zgjedhjeve, me qëllim sigurimin e zgjedhjeve të ardhshme, për të provuar se kjo maxhorancë ka ardhur nga votat e vjedhura.

Falemnderit!

Ardian Turku – Falemnderit, zoti Dogjani!

(I drejtohet zotit Dokle, i cili flet nga vendi.)

Zoti Dokle, po të doni ju lexoj nenin. Nuk ka replikë, vetëm pse të përmendet emri. Vetëm në rastin kur përdoren terma ofendues dhe në rastin

kur devijohet nga thelbi i diskutimit tënd të mëparshëm, bëhet replikë. Në këto kushte kur ju kërkuat replikën, nuk plotësoni asnjë nga këto kushte.

Po, zoti Noka, dy minuta, urdhëroni!

Flamur Noka - Se kush duhet t'u kërkojë falje qytetarëve të Kukësit, zoti Dogjani, ju e dini mirë përgjigjen, sepse jua dhanë qytetarët e Kukësit në datën 28 qershor.

Partia Demokratike dhe ne, i kemi falënderuar dhe i falënderojmë qytetarët e qarkut të Kukësit dhe ata janë mirënjohës ndaj nesh sepse ne i nxorëm nga harta e mjerimit ku i kishte futur Partia Socialiste dhe kryetari i saj. Për sa u përket gjërave të tjera, që deputeti Dogjani foli, nuk është ndonjë shqetësim i madh, pasi ato nuk i thotë nga vetja, ia ka dhënë kryetari porosi, pasi ai garën, e di shumë mirë, nuk e kishte me Partinë Demokratike, por e kishte me Colin e Alpet-it, që kryetari i tij e futi në garë nga dritarja, si kandidat në emër të partisë së Gjinushit, kur socialistët nuk e lejonin të hynte nga dera. Garën zoti Dogjani nuk e kishte me ne, as konkurrencën te vota nuk e kishte me ne, e kishte me 1 milion eurot e paguara nga kryetari i tij dhe Coli i Alpet-it kundër tij.

Për sa i përket çështjes së rrugëve dhe infrastrukturës që përmendi zoti Dogjani, mund t'ju them se qytetarët e Kukësit janë dëshmitarë të gjallë të masakrës që i bën partia e zotit Dogjani rrugës së vjetër Tiranë-Kukës. Rruga e vjetër u shtrua gjatë nga Partia Socialiste, u vodh treçerëku i fondit, u masakrua për 6 muaj dhe, kur erdhëm në pushtet, e riveshëm dhe e riasfaltuam të gjithën. Ne erdhëm në pushtet dhe ndërtuam rrugën e re, ndërtuam atë tunel që i errëson sytë jo vetëm zotit Dogjani, sepse e pranoi që nuk i thotë nga vetja, po ia kërkon kryetari, por ia errëson sytë kryetarit të tij dhe Partisë Socialiste. Ndaj...

Ardian Turku – Koha për replikë mbaroi. Falemnderit!

Atëherë, si drejtues i seancës, në raste të tjera, qoftë për rastin e zotit Dokle, qoftë edhe për rastin tuaj, nuk do të lejoj më replika në përputhje me Rregulloren.

Zonja Vokshi, mund të merrni fjalën!
(I drejtohet deputetit Dogjani.)

Jo, nuk ka replikë për replikë. Në të dyja rastet nuk kishte kushte për replikë, as në të parin as në të dytin, pavarësisht emrit. Nuk është vetëm emri.

Zonja Vokshi, lejojeni, se ndoshta këtu është edhe shpëtimi i zotërisë, meqenëse e ka merak këtë.

Asllan Dogjani – Falemnderit, zoti drejtues i seancës!

Zoti Flamur i mendon njerëzit të gjithë si vetja, i cili merr porosi nga kryetari i tij dhe është mësuar të marrë porosi kaq kohë duke bërë edhe detyrën e sekretarit, por unë përmenda vetëm ato probleme për të cilat jemi këtu. Pra, kërkova që të bëhet transparenca dhe të dalin edhe Colët edhe ato që kanë bërë vetë me blerje votash, me presione dhe me të gjitha. Pikërisht për këtë dua dhe kërkoj të bëhet transparenca e plotë e zgjedhjeve.

Për sa i përket rrugës Durrës-Kukës apo edhe rrugëve të tjera që janë hapur e sot kanë ngelur gërmadhë dhe nuk punohet, si rruga e Shishtavecit që lidh fshatin e tij me qytetin, apo edhe rruga e Kukësit dhe rrugët e tjera, të shkohet sot në Kukës dhe të shikohet sesi vuajnë njerëzit për ujë, ku ka ujë të rrjedhshëm për të furnizuar gjithë Shqipërinë dhe sot qyteti nuk ka ujë; ku njerëzit sot nuk janë në gjendje të sigurojnë bukën e gojës, dhe nuk kanë mundësi të shkojnë të bëjnë një vizitë në spital. E dini çfarë varfërie ka në Kukës? Por këtu nuk ka pasur njeri për t'i bërë prezent. E dini sa është numri i papunësisë në Kukës? Mbi 50% dhe njerëzit nuk janë në gjendje të sigurojnë bukën e gojës. Me këto momente është e lidhur hapja e kutive të votimit. Në qoftë se vota do të jetë e lirë, ju, zoti Flamur, s'do të guxonin të gënjeni se do të zgjidhim problemin e tokave të përmbytura një herë në 4 vjet.

Ja, pra, pikërisht për këtë duhet ta verifikojmë edhe Colin, të shkojë para përgjegjësisë edhe Coli. Por ju keni frikë nga e vërteta.

Ardian Turku – Atëherë, koha për replikë mbaroi.

Zonja Vokshi keni fjalën!

Albana Vokshi – Falemnderit, zoti drejtues i seancës!

Në fakt, për ironi të fatit, sot për herë të parë kolegët tanë socialistë po flasin për hallet që paska populli, se për 7 muaj ata nuk denjuan të vinin dhe të bënin detyrën e tyre si përfaqësues direkt të popullit në forumin më të lartë, sepse populli për atë ua dha votën.

Sot në fjalën time do të doja të ndalesha në kuptimin e termit "transparenca", në abuzimin dhe spekulimin që po i bëhet këtij termi në emër të popullit dhe për popullin nga ana e opozitës dhe kryesisht nga lideri i saj.

Gati 9 muaj pas zgjedhjeve parlamentare të 28 qershorit, opozita po vazhdon luftën e saj jo institucionale për vazhdimin dhe thellimin e ngërçit,

me qëllim shndërrimin e tij në një ngërç politik dhe institucional. Kërkesa për të bërë transparencë të procesit zgjedhor në emër të popullit, sepse gjoja popullit po i vritet besimi për zgjedhjet, është alibia e fundit e radhës e kryetarit të opozitës. Duke mos pasur asnjëherë guximin të përballet me askënd, zoti Rama publikoi dy ditë më parë një letër të hapur ku, si në një trakt komunist, ai flet përsëri në emër të popullit, për popullin dhe kërkon transparencë të procesit zgjedhor për hir të popullit. Po ashtu si në traktet e dikurshme që bënin thirrje në emër të popullit për rrëzimin e fashizmit, zoti Rama kërcënon sot për rrëzim të pushtetit pa parashikuar dot pasojat, ose kërcënon me mosbindje qytetare apo popullore, siç e quan ai.

Ashtu siç ndodh rëndom në periudha të ndryshme zhvillimi, edhe terminologjia apo fjalori i përditshëm ndryshon, dhe jo vetëm për politikën. Ky nuk është një fenomen shqiptar, por ndërkombëtar. Në Shqipëri, për arsye të caktuara politike, me insistimin e vazhdueshëm të opozitës, fjala më në modë këto ditë është “transparenca”. Flitet për transparencë në Qeveri, prokurori, gjykata dhe në çdo institucion. Flitet për transparencë për çdo proces, për çdo dukuri, te çdo njeri, madje ka filluar të përdoret edhe si terminologji në familje. Po kërkohet transparencë familjare.

Pavarësisht se nuk jam pedagogje e drejtësisë, por, duke hulumtuar në fjalor elektronik ose jo elektronik, kam gjetur përkufizimin e fjalës “transparencë”, të cilin do të doja t’jua lexoja.

Transparenca, në kontekstin human dhe social, përgjithësisht implikon komunikimin dhe përgjegjësinë, është zgjerim metaforik i fjalës objekt transparent, pra që mund të shihet tejprtej.

Procedura transparente përfshin mbledhje të hapura, fatura financiare publike, liri informacioni për legjislacionin, për rishikimet e buxhetit, auditet etj.

Në politikë nocioni i transparencës është futur si një mënyrë për të mbajtur zyrtarët përgjegjës dhe për luftën ndaj korrupsionit.

Për mbledhjet e Qeverisë procedurat, përfshi edhe ato elektorale, janë të hapura ndaj shtypit dhe publikut, kur buxheti dhe faturat financiare mund të shihen nga gjithkush, ku ligjet, rregullat dhe vendimet janë të hapura për diskutim, ato shihen si transparente dhe ka pak mundësi nga autoritetet për abuzim të sistemit për interesa të tyre.

Në Qeveri, politikë, etikë, biznes, menaxhim, legjislacion, ekonomi, sociologji etj. transparenca është e kundërta e privatësisë. Një aktivitet është

transparent nëse i gjithë procesi dhe informacioni rreth tij është i hapur dhe i gatshëm për të gjithë.

Nisur nga këto përkufizime, shpeshherë i kam bërë pyetjen vetes: Çfarë është realisht dhe çfarë nënkupton transparenca që kërkon zoti Rama, sepse nuk bie në asnjërin prej përkufizimeve që ju lexova më lart. Cila hallkë e procesit zgjedhor që nga përgatitja e legjislacionit bazë, e votimit, transportimit, numërimit ka qenë jo transparente, larg syve të Partisë Socialiste apo kryetarit të saj, larg publikut?

Le t’i shqyrtojmë proceset me radhë dhe të kërkojmë mungesën e transparencës që ju pretendoni.

Hartimi dhe përmirësimi i legjislacionit bazë, Kodit Elektorale, është bërë në një frymë tejet transparente. Ishte opozita që zgjodhi dhe përcaktoi formula që u implementuan në procesin parazgjedhor, procesin e votimit, përcaktimin e komisioneve të votimit, të numërimit apo përcaktoi rregullat e ankimeve e rinumërimeve. A mund të quhet ky proces jo transparent?

Le të kujtojmë që procesi i prodhimit të kartave të identitetit dhe i pasaportave biometrike dështoi për qëllime të caktuara për 8 vjet radhazi, kur opozita e tanishme ishte në pushtet. Le të kujtojmë përpjekjet e vazhdueshme për minimin e këtij procesi nga ana e opozitës dhe e kryetarit të saj deri pak ditë para zgjedhjeve të 28 qershorit, këtij procesi kaq të rëndësishëm jo vetëm për procesin zgjedhor, por për liberalizimin e vizave dhe atij të integritimit. Megjithatë, Qeveria me vendosmëri e transparenca maksimale bëri të mundur që shumica e votuesve të pajisin me karta identiteti për ditën e zgjedhjeve.

Në raportin e OSBE-ODIHR-it thuhet se zgjedhjet parlamentare të 28 qershorit shënuan përparim të prekshëm për sa i përket procesit të regjistrimit, identifikimit të votuesve, kornizës ligjore të miratuar në mënyrë konsensuale nga dy partitë kryesore. Po ashtu thuhet se, duke pasur parasysh kufizimet kohore, shpërndarja e kartave të identitetit ishte e suksesshme.

Prodhimi i kartave të identitetit dhe i pasaportave biometrike të një sigurie të lartë, nga më të lartat në botë, është një nga arritjet më të mëdha të kësaj Qeverie, sepse, në radhë të parë, u përmbush një nga kushtet për liberalizimin e vizave, por, në radhë të dytë, qytetarët e këtij vendi për herë të parë morën identitetin që u takonte, atë që opozita e tanishme nuk ua dha për 8 vjet radhazi. Është për të ardhur keq që kjo opozitë po vazhdon përpjekjet e saj për

të hedhur baltë në një nga proceset më të rëndësishme.

“Hartimi i listave të votuesve, një zhvillim i rëndësishëm pozitiv - thotë raporti - ishte fakti që për herë të parë listat e votuesve u nxorën nga regjistri i kompjuterizuar i gjendjes civile dhe se cilësia e listave u përmirësua ndjeshëm krahasuar me ato të vitit 2005.”

Po ç’thotë zoti Rama? Në emër të transparencës, në mënyrë absurde, abuzive dhe spekulative ai po i kërkon tani maxhorancës dhe Qeverisë të verifikojë vetë listat e tij. Pra, komisionerëve socialistë, të cilët u akuzuan si të blerë nga Partia Demokratike, u ka ardhur radha që t’u shtohen, siç duket, dhe të ulen në bankën e të akuzuarve edhe punonjësit e bashkive apo minibashkive të zotit Rama.

Procesi i votimit, i numërimit, ankimimit etj., duke vlerësuar procesin zgjedhor në raportin e OSBE-ODIHR-it, thuhet: “Zgjedhjet parlamentare të 28 qershorit shënuan përparim të prekshëm edhe për sa i përket procesit të votimit, numërimit, zgjidhjes së mosmarrëveshjeve zgjedhore. Dita e zgjedhjeve ishte përgjithësisht e qetë. Vëzhguesit e vlerësuan pozitivisht procesin në 92% të qendrave të votimit të vizituara. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përgatiti dhe administroi zgjedhjet në mënyrë profesionale, si dhe ndërmori hapa për të rritur transparencën e këtij procesi”.

Zoti Meta në mbylljen e procesit të votimit deklaroi se zgjedhjet ishin brenda standardeve europiane dhe se po realizohej një pjesëmarrje historike. Vetëm pak minuta më pas vetë zoti Rama e përshëndeti dhe e vlerësoi procesin zgjedhor, duke theksuar: “Fitoi integriteti evropian i vendit.”. “Dua të theksoj - thotë zoti Rama në prononcimin e tij - se në tërësi u realizua objektivi i garantimit të procesit, i garantimit të qetësisë dhe normaliteti demokratik për qytetarët dhe se qytetarët vërshuan në masë drejt kutisë së fshehtë.”

Procesi zgjedhor u certifikua nga të gjitha organizatat dhe institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare, nga të gjitha mediat kombëtare dhe ndërkombëtare, u certifikua nga OSBE-ODIHR-i, nga 27 vendet anëtare të Bashkimit Europian. Zgjedhjet u certifikuan si më të mirat ndonjëherë në Shqipëri e që përmbushën standardet ndërkombëtare. Por vetëm pak ditë më pas, kur zoti Rama e kuptoi humbjen e tij, që nuk donte ta pranonte kurrësi, deklaroi se do t’i shkojë deri në fund hetimit të asaj që e quan maskaradë zgjedhore, apo më tej, e quan krim elektorale.

Lind pyetja: Cilit zotit Rama duhet t’i besojnë votuesit e majtë, atij që deklaroi se ishin përmbushur standardet e zgjedhjeve, apo atij që flet për maskaradën zgjedhore dhe për krimin elektorale? Atij që flet në emër të votuesve të majtë, të popullit shqiptar, apo atij që kërkon të çojë në burg komisionerët e tij dhe besoj tani edhe punonjësit e minibashkive apo bashkive të tij?

Mosnjohja e rezultatit të zgjedhjeve të certifikuar nga dhjetëra mijëra komisionerë, ndër të cilët mbi 20 mijë ishin socialistë, zgjedhje të vëzhguara, të filmuara, të fotografuara nga dhjetëra e mijëra vëzhgues dhe jo vetëm socialistë, por nga të gjitha partitë politike është dëshmi flagrante e botëkuptimit stalinist, komunist të kreut të opozitës, i cili vetëm transparencën elektorale dhe demokracinë nuk e ka kauzë të saj.

Edi Rama fillimisht hodhi baltë mbi të gjithë komisionerët e tij, hodhi baltë mbi dhjetëra e mijëra vëzhgues të Partisë Socialiste, po hedh baltë mbi kandidatët për deputetë dhe deputetët e Partisë Socialiste që e kanë vëzhguar nga afër numërimin dhe ishin prezentë kur janë firmosur të gjitha procesverbalet nga komisionerët e tyre. Më tej hodhi baltë ndaj KQZ-së e tani po hedh baltë mbi nëpunësit e bashkive dhe minibashkive.

Zoti Klosi, zoti Gashi, zoti Bizhga kemi qenë bashkë në të gjitha qendrat e votimit, kemi qenë bashkë 28 orë, 24 orë, 48 orë gjatë procesit të numërimit dhe nuk kemi pasur asnjë problem. Kemi qenë bashkë kur janë mbyllur kutitë dhe janë firmosur procesverbalet dhe nuk është shënuar asnjë incident.

Më lejoni t’ju them se duke fajësuar komisionerët, vëzhguesit apo numëruesit e Partisë Socialiste, zoti Rama në mënyrë indirekte ju ka akuzuar juve, sepse ju nuk e denoncuat krimin elektorale që po ndodhte apo nuk i detyruat komisionerët tuaj që të denonconin apo të kontestonin e të mos firmosnin të gjitha procesverbalet në të gjitha qendrat e votimit.

Kërkohet transparencë. Transparencë për çfarë, në emër të kujt dhe kujt i vlen kjo? Maxhoranca e ka thënë, stërthënë, ka dëshmuar që është e gatshme të bëjë transparencë, por sipas ligjit dhe Kushtetutës e në emër të parimeve demokratike dhe respektimit të pavarësisë së institucioneve. Po çfarë po diskutojmë ne sot? Po shqyrtojmë prej javësh e ditësh, duke u munduar t’i mbushim mendjen jo vetëm shqiptarëve, por edhe mbarë botës që po gjejmë kompromisin. Çfarë kërkohet nga ne? Të

bëhet transparenca e procesit zgjedhor apo transparenca e fenomeneve brenda Partisë Socialiste dhe sjelljes e reagimit të anëtarëve apo simpatizantëve të saj ndaj këtyre fenomeneve? Apo kolegët tanë të opozitës nën urdhrat e liderit të tyre po sjellin në këtë sallë Kuvendi krizën që ka pushtuar vetë opozitën? Mendoj që në nenet e propozuara nga kreu i Partisë Socialiste, të destinuara për të dështuar pasi janë kërkesa antiligjore, antikushtetuese, vetëm për transparencë zgjedhore nuk bëhet fjalë.

Në grahmat e fundit, në emër të virtyteve e të parimeve të demokracisë, në emër të transparencës, në emër të popullit zoti Rama sjell në këtë sallë kërkesa antikushtetuese, antiligjore, të cilat asnjë parlament në Europë e në botë nuk do t'i pranonte.

Të nderuar kolegë deputetë,

Vendimi unanim i ministrave të jashtëm të Bashkimit European i datës 16 nëntor 2009 për shqyrtimin e kërkesës së Shqipërisë për statusin e vendit kandidat është vendimi historik më i rëndësishëm për Shqipërinë. Ky vendim vërtetoi edhe një herë që zgjedhjet e 28 qershorit ishin prova më e madhe e Shqipërisë, e cila u kapërcye me sukses, prova për përkushtimin ndaj vlerës së votës së lirë që mandatoi vazhdimin e reformave në rrugën e integritimit european.

Faleminderit!

(Ndërkohë, drejtimin e seancës e merr zonja Topalli.)

Jozefina Topalli – Falemnderit, zonja Vokshi. Zoti Ylli e ka fjalën, urdhëroni.

Fidel Ylli – Të nderuar kolegë deputetë,

Secili qytetar shqiptar kur kujton dhe analizon politikën në tërësi dhe proceset zgjedhore në veçanti nga viti 1991 deri më sot, menjëherë e qartazi konkludon se sa herë ato kanë qenë pa standarde demokratike, të parregullta, të manipuluar, thellësisht të grabitura e të vjedhura, gjithmonë kanë pasur vulën "made in Sali Berisha dhe PD".

Edhe para zgjedhjeve të 28 qershorit opozita dhe shqiptarët në tërësi, duke pasur parasysh këtë *background* famëkeq të Berishës dhe të Partisë Demokratike kishin dyshimin e mosbesimin për realizimin e zgjedhjeve të drejta, të ndershme, të lira, demokratike dhe me standarde europiane, megjithëse këtë e kërkonin të gjithë partnerët ndërkombëtarë, vetë qenia jonë anëtarë të NATO-s dhe proceset integruese që synojmë të realizojmë.

Zgjedhjet e qershorit u zhvilluan dhe përfundimi ishte po ashtu si gjithmonë kur ato i realizon pushteti

i Berishës, pa arritur standarde, me parregullsi të mëdha, të manipuluar, të vjedhura, konkluzione këto edhe të OSBE/ODIHR-it. Kështu u përsërit goditja e themeleve të rendit demokratik, që janë zgjedhjet e lira e të drejta dhe për pasojë tronditen e shkatërrohen të gjitha institucionet dhe instrumentet e shtetit që ngrihen mbi to.

Por ju, zoti Berisha, si armiku më i madh i lirisë dhe i së vërtetës, harroni mësimin universal të historisë, që ka në shpirtin e vet dhe populli shqiptar, se liria dhe e vërteta janë vlera thelbësore e njeriut dhe e jetës, madje vetë kuptimi dhe motivi i ekzistencës së tyre.

Pikërisht për këto arsye madhore Partia Socialiste dhe të gjithë forcat e majta e të djathta, që i janë bashkëngjitur asaj menjëherë pas zgjedhjeve të 28 qershorit, duke qenë të ndërgjegjshëm pikërisht për atë katastrofë që ndodhi në zgjedhjet e kësaj dite, e bëri kauzë të saj dhe të të gjithë shqiptarëve lirinë dhe të vërtetën e këtyre zgjedhjeve.

Kërkesa jonë për transparencën e këtyre zgjedhjeve përmes një komisioni hetimor parlamentar, duke hapur kutitë e votimit, është mundësia e vetme për të nxjerrë në dritën e diellit për të gjithë shqiptarët të vërtetën e 28 qershorit, ajo çka është e rëndësishme dhe e domosdoshme për t'i dhënë fund përfundimisht zgjedhjeve pa standarde, të manipuluar, për të garantuar lirinë e tyre të plotë në të ardhmen.

Por ju, zoti Berisha dhe partia që drejtoni, si aktorë të vetëm të manipulimit dhe grabitjes permanente të zgjedhjeve, jo vetëm nuk e dëgjuat këtë zë të arsyes, por qëndruat symbyllur, të shurdhët, mendjvedkur e shpirttharë, duke humbur kështu, siç bëni gjithmonë, një shans për të korrigjuar sadopak zellin armiqtësor që keni për lirinë dhe të vërtetën, për sjelljen demokratike.

Nuk patët arsye as kur e njëjta gjë u kërkua nga partnerët ndërkombëtarë, duke treguar papërgjegjshmëri e duke rrënuar imazhin e vendit tonë në sytë e tyre. Por ju kujtojmë se historia nuk i sjell shanset me shumicë. Ne e dimë mirë dhe s'kemi aspak dyshim se ju dhe partia juaj duke goditur, dobësuar dhe shkatërruar themelet e demokracisë, pra proceset zgjedhore, si një eksperiment makabër, prodhoni ushqimin jetësor të regjimit tuaj autoritar, diktatorial, të korruptuar dhe amoral.

Pikërisht te hedhja në erë e proceseve zgjedhore e kanë zanafillën dhe më pas nën regjimin tuaj

madhërohen të gjitha të këqijat dhe katastrofat për shqiptarët dhe Shqipërinë. Prandaj ju kurrë nuk ndërtoni shtet, por rrëmbeni pushtet, madje në këtë aspekt nuk u gjendet kurrkund shoku. Për këto arsye në vendin tonë nuk funksionojnë, madje po shkatërrohen institucionet, prandaj mohohen dhe shkelen liritë dhe të drejtat e qytetarëve. Për këto arsye nuk zbatohet ligji, prandaj lulëzon krimi e trafik. Për këto arsye ka shpërthyer korrupsioni, ngjarja e Gërdecit, vjedhja e frikshme e rrugës së kombit, përmbytjet e përsëritura të këtyre viteve në Shkodër, Lezhë e kudo dhe tallja me fatura e dëmshpërblimet për to, përkeqësimi me ritme të larta i gjendjes ekonomike të banorëve të fshatrave dhe qyteteve tona, falimentimi i përditshëm i një numri të madh biznesesh, rritja e përditshme e papunësisë, e sjelljes arrogante të strukturave tatimore që të kujton kohën e mesjetës nën regjimin turk, gjendja ekonomike e sociale e banorëve të Zadrimës, të Bregut të Matit, të Mirditës të kujton kohën e Migjenit. Këto janë pasojat e regjimit tuaj. Për këto arsye në gjoksin tuaj do të ndriçojnë medaljet e turpit të të zgjedhurve të Ruzhdies.

Do t'i kërkoja këtij Parlamenti që të hapë kutinë e votimit të burgut të Shënkollit, njëërën prej kutive të votimit të komunës së Zojzit apo të këtyre kutive që kolegu im Kadeli i përmendi këtu. Hapni vetëm njëërën prej tyre! Të jeni të bindur se do të gjeni shumë binjake të Ruzhdies në Lezhë, Mirditë apo në Kurbin.

Fara që mbjell regjimi juaj, zoti Berisha, s'mund të prodhojë tjetër veçse kriza politike dhe ekonomike, varfëri, papunësi, krim, trafik, korrupsion, probleme sociale, pasiguri, pengesë në prosperitetin dhe integrimin e vendit, duke na lënë fatkeqësisht të fundit në Europë.

Kaq mirë e dinë dhe kaq të ndërgjegjshëm janë shqiptarët sa edhe pas shumë vjetësh kur fëmijët tanë të na pyesin se kush e ka drejtuar Shqipërinë e sotme, me buzagaz do të thonë "made in Sali Berisha". Shqiptarët tashmë e dinë mirë të vërtetën që ne po mbrojmë dhe pikë së pari, për t'i dhënë fund kësaj historie të pamerituar, e kanë përqaftuar kauzën tonë, duke e bërë atë më të vlefshme, më të vetëdijshme, më përfaqësuese, më të fortë dhe tepër shpresëdhënëse në rezultatet pozitive që ne do të arrijmë. Këtë ju e keni parë dhe provuar mirë në tubimet tona, të cilat do të jenë më të forta, më të mëdha, më të fuqishme në të ardhmen.

Pasi u tregove dinak e besëprerë në zbatimin e Kodit Zgjedhor ditën e zgjedhjeve përmes ushtarëve

të tu të bindur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, pasi me papërgjegjshmërinë tuaj të njohur dhe me frikën që ju djeg si zjarr nga transparencja e zgjedhjeve të manipuluar, minove çdo rezolutë dhe tryezë, madje dhe me ndërkombëtarët.

Pasi u përbetove për dialog dhe kompromis, vetëm dy ditë nga e sotmja, nga kjo seancë plenare realizove besëthyerjen e radhës, duke mbytur kompromisin, asfiksuar iniciativën tonë ligjore, duke bërë njëkohësisht zgjatjen në kohë të krizës, thellimin e saj dhe pasojat e pakonceptueshme që mund të vijojnë.

Çfarë paraqitet prej jush si argument për të mos lejuar transparencën? Broçkulla, asnjë fjalë tjetër. Nuk e lejon Kushtetuta, nuk e lejojnë vendimet e gjykatës etj.

Është tragjikomike që këto argumente artikuloohen nga kampioni i shkeljes së ligjit, kundërshtari dhe shkatërruesi më i tërbuar i sistemit të organeve të drejtësisë. Megjithatë, në qoftë se këto argumente do të ishin të vërteta, ky mëkatar i ligjit duhet falur bashkë me mëkatet e veta, por nuk është aspak kështu, sepse Kushtetuta dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese nuk e pengojnë transparencën e zgjedhjeve. Partia Socialiste e ka në genin e saj njohjen dhe zbatimin e ligjit, të Kushtetutës, prandaj ajo kurrë nuk do të ngrinte një kauzë jashtëligjore, por pse është pikërisht e kundërta, ajo është më e vendosur se asnjëherë për arritjen e saj.

Është momenti që të ngriheni së paku një herë në nivelin e interesave të popullit. Pranoni të vërtetën dhe së bashku të ecim në drejtimin e duhur për daljen nga kriza! Ky duhet të ishte një apel në momentin e fundit që ju të reflektoni dhe të miratoni iniciativën ligjore që ne kemi paraqitur, që të realizojmë transparencën e plotë të zgjedhjeve e të vijojmë të përballojmë me sukses sfidat që na presin. Në të kundërtën, përgjegjësia dhe pasojat bien mbi ju.

Unë si deputet i ri i Parlamentit shqiptar ndihem i trishtuar që fjalimin tim të parë në vend që ta mbaja për probleme normale, të kërkoja nga kjo foltore përmirësimin e cilësisë së jetës të qytetarëve tanë, për reformat e domosdoshme në vend apo iniciativa integruese të Shqipërisë, e mbaj për parimin elementar të demokracisë, për zgjedhjet e lira e të drejta e për transparencën e tyre. Por kjo njëherazi më bën krenar që jam bashkë me kolegët e mi të Partisë Socialiste dhe qindra e mijëra shqiptarë për promovimin dhe realizimin me fitore të kësaj kauze, sepse jam i bindur se nuk ka kauzë më të shenjtë

se liria, demokracia dhe e vërteta.

Falemnderit!

(Duartrokitje në sallë.)

Jozefina Topalli – Falemnderit!

Fjalën e ka zoti Florian Mima.

Florion Mima - E nderuar zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë!

Po mbushen 9 muaj që kur populli foli dhe tha me gojën plot: Partia Socialiste duhet të rrijë në opozitë. Disa nga shkaqet e kësaj humbjeje, sipas një socialisti të mirë e të ndershëm, ishin: mungesa totale e një programi elektoral të besueshëm, transparent dhe me shanse për t'u materializuar në rast fitoreje; qëndrimi i liderit të PS-së si një gjeneral në shatore dhe kundrimi i betejës nga lart, ndërkohë që ju ndesheshit në fushëbetëje me kundërshtarët tuaj politikë; fushata negativiste, vetëm me sharje, fyerje dhe injorim për të gjithë punën kolosale, reformatore dhe integruese të Qeverisë demokratike në mandatin e saj të parë, mosrealizimi i premtimit paraelektoral për bashkimin e së majtës, madje përçarja edhe më keq e saj. Ka shumë e shumë shkaqe të tjera, por unë u ndala vetëm në këto.

Të dashur vëllezër opozitarë, ju bëni një gabim shumë të madh kur mendoni se ky popull harron shpejt. Jo, ai nuk harron. Madje, nuk i harron as shkrimet e para të liderit tuaj aktual në mediat e para të lira të vendit, për të varur në çdo shtyllë me tel të gjitha kasketat dhe xhaketat e vjetra të këtij vendi.

Zoti Ruçi, me siguri ju ka pasur edhe ju ne mendje, kur ka përmendur termin "xhaketat e vjetra" dhe sot është bërë bashkë me xhaketën e vjetër, zotin Ruçi dhe po tenton të varë në tel demokracinë shqiptare.

Zoti Ruçi, para disa ditësh po lexoja procesverbalet e zbardhura të një amnistie të realizuar në grahamat e fundit të regjimit komunist. Aty citoheni edhe ju në ligjëratë të drejtë, kur keni falur plotësisht, herë pjesërisht e herë keni kundërshtuar faljen e një njeriu, jeta e të cilit varej vetëm nga një fjalë e juaja. Ajo ishte puna ime, do të thoni, dhe e kam bërë mirë. Sigurisht që e keni bërë mirë, por kam bindjen që këtë të dytën, dhënien e leksioneve për demokracinë nëpër televizione po e bëni shumë keq dhe nuk mund të shkëlqeni duke qenë në të njëjtën kohë ministri i fundit i brendshëm i regjimit komunist dhe sot mbrojtësi më i flaktë i parimeve social-demokratike perëndimore.

Në të gjitha takimet me të huajt shprehet keqardhja që edhe ato reforma që nisi zoti Nano për

modernizimin dhe pastrimin nga gjaku të duarve të PS-së, ju i zhbëtë me shpejtësi. Sot të gjithë thonë se, me sa duket, e vetmja reformë që ka rezultuar e suksesshme në partinë tuaj ka qenë ndërrimi i emrit.

Ju nuk keni hallin e zgjedhjeve të kaluara. Ato nuk zhbëhen dot më as me kërcënime dhe as me protesta qesharake, tip pikniku, me bukë me vete. Por e vërteta është se ju rezultatin e zgjedhjeve të kaluara e keni kthyer në një projeksion për zgjedhjet e ardhshme lokale. Rezultati, padyshim, del se PS-ja do të rrijë në opozitë. Atëherë, o burra, ta bëjmë sherrin sherr dhe të mos lëmë gur pa lëvizur që të kthehet kaosi në vend, të stopohen proceset integruese, me shpresën që pakënaqësia popullore të bëjë që balanca të anojë nga PS-ja. Ka edhe një tjetër arsye, sipas meje, është ligji antimafia dhe rezultatet e pritshme të tij. Të gjithë e dimë që në një mjedis të qetë prokuroria do të fillojë të verë dorë mbi pasuritë e krimin, ndaj, o burra, të trembim të gjallë e të vdekur, t'i kërrejme rrënjët vendit, që të vazhdojmë të shijojmë pa fund hotelet dhe motelet, fushat e sportit, pishinat, jahtet dhe helikopterët luksozë.

Sado e zyrtë që duket prognoza politike brenda PS-së, kam bindjen se mendjet e qeta dhe racionale, që jo vetëm nuk mungojnë, por janë cilësore, do të dinë ta kurojnë me kujdes lidërshtipin e PS-së, këtë të sëmurë të skenës politike shqiptare. Pasi ta kenë bërë këtë, sigurisht do të shihemi në zgjedhjet e radhës dhe atëherë do të ndeshemi përsëri, por këtë herë dhe ju do të jeni ndryshe, do të keni programin tuaj dhe ne do të kemi tonin. Ju do të keni liderin tuaj të ri dhe ne do të kemi tradicionalin, tonin. Do t'i japim dorën njëri-tjetrit dhe, më në fund, lideri juaj i ri, do të telefonojë doktor Berishën dhe do t'i urojë fitoren në zgjedhjet e radhës. Ky është civilizim dhe kam bindjen se do të ecim në këtë rrugë.

Në fund të fundit, nuk është fatalitet. 2021-shi nuk është larg. Fiksohuni në këtë ditë dhe punoni që në këtë vit të vini në pushtet, jo për të hequr PD-në nga pushteti, por për t'i shërbyer më mirë popullit. Ju kujtoj se në 2021-shin Shqipëria do të jetë prej të paktën 5-6 vjetësh anëtare e BE-së e ju do të jeni pjesë e Parlamentit të BE-së, do të keni blerë kostume të reja, shumë të ndryshme nga kostumet e vjetra që vishni sot.

Ju falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Mima!

Zoti Toçi, urdhëroni!

Fatmir Toçi - Zonja Kryetare,

Deputetë të nderuar,

Isha përgatitur ta nisja ndryshe këtë fjalë timen për herë të parë nga foltorja e Kuvendit të Shqipërisë, por një numër i pafund mesazhesh që vijnë nga komisionerë të Partisë Socialiste, që duan t'i shprehin mirënjohjen Kryeministrit Berisha për mbrojtjen që po u bën, më detyroi të zgjedh një prej tyre, për t'ju bërë të ditur ndjesinë e këtyre njerëzve që sot janë hedhur në rrugë dhe janë pa punë, pikërisht për shkak të kësaj detyre që kanë kryer ndaj shtetit shqiptar. Do ta përmend edhe emrin, me lejen e tij. Ai vjen nga Selenica e Vlorës, mësuesi Kozma Mitraj, i cili më shkruan: "Zoti Toçi, nëse mundesh, në fund të diskutimit tënd, drejtoju me këtë mesazh në emrin tim Kryeministrit dhe ministrit të Arsimit. "Jam një nga komisionerët e Partisë Socialiste, i cili pas 28 qershorit u shkarkua si nëndrejtor shkollë dhe u largua nga puna. Kam mbaruar Universitetin e Tiranës dhe njoh tri gjuhë të huaja. Zoti Kryeministër, si ta kuptoj keqardhjen tuaj për ne, komisionerët e Partisë Socialiste? Me respekt, Kozma Mitraj, Selenicë".

Zoti Berisha, do të ishte mirë t'ju jepje përgjigje dhe të bëhej replikë me këta njerëz dhe jo me deputetët e PS-së sa herë përmendin emrin tuaj. Dhe jo të përgjigjeni me replika bajate dhe të papërgjegjshme.

Kjo që ka ndodhur me këtë njeri, ka ndodhur në mënyrë masive në arsimin shqiptar, por edhe në nxjerrjen e naftës, administratën shtetërore, shëndetësi dhe kudo. Komisionerët e majtë, drejtues të Partisë Socialiste, madje edhe të afërmit e tyre, pa kursyer edhe të afërmit e deputetëve, deri në brezin e tretë, janë hedhur në rrugë për shkak të bindjeve të tyre.

Unë vij në këtë Kuvend me votat e Qarkut të Vlorës dhe tanimë dihet nga të gjithë se cili ishte vullneti i shumicës së vlonjatëve, sarandjotëve dhe delvinjotëve, por edhe i të gjithë shqiptarëve për qeverisjen e ardhshme.

Sot doja të sillja këtu zërin, problemet dhe shqetësimet e njerëzve që më kanë votuar, gjendjen e tyre të mjeruar social-ekonomike, papunësinë që ka mbërthyer pjesën më të madhe të shqiptarëve, humbjen e vendeve të punës, kryesisht për shkak të diskriminimit politik dhe militantizmit të theksuar në qeverisje, mungesës së theksuar të investimeve në infrastrukturë për të lehtësuar jetën e shqiptarëve, për problemin e pazgjidhur të ligjit mbi tokat dhe përpjekjet e pareshtura për grabitjen e atyre në bregdet, që nga Orikumi e deri në Ksamil, për

politikant antiturizëm ndaj Vlorës e vlonjateve, kur bëhet fjalë për shkatërrimin e Gjirit të Vlorës, mbretëreshës së turizmit shqiptar etj.

Mund të flitej për korrupsionin që ka mbërthyer çdo qelizë të administratës shtetërore dhe të shoqërisë shqiptare, ku këngën e marrin dhe vallen e hedhin jo pak, por një qeveri me 13 dikastere, 35 zëvendësministra, 243 drejtorë drejtorish. Për t'i shpërblyer e për të nderur urtë të gjithë, PD-ja e aleatët e saj ndajnë tortën e qeverisjes. Në kohën e sotme nuk bën më përshtypje përralla e Ali Babës me 40 hajdutë, kur kemi babë Saliun me 300 karrige zëvendësministrash e drejtorësh vetëm brenda Qeverisë. Dhe kjo në një kohë kur bëhet demagogji për qeveri në dietë, për heqje makinash, shoferësh e shkurtrim të shpenzimeve administrative.

Do të doja të flisja për çdo qytetar shqiptar, emër për emër, që sot, 20 vjet pas pluralizmit, është i detyruar të konsiderohet europian i dorës së tretë.

Deformimi i procesit zgjedhor në qershor të vitit të kaluar, angazhimi i gjithë administratës shtetërore në mbështetje të hapur të partisë në pushtet, presionet për pushime nga puna të atyre që nuk do të votonin për të djathtën në pushtet, roli i të burgosurve të liruar si presion psikologjik ndaj votuesve, manipulimi me varfërinë e njerëzve (përfshi edhe komisionerët) në përpjekje për të blerë votën e tyre etj., janë shfaqje që janë ndeshur në çdo hap gjatë fushatës elektorale, veçanërisht në bashkitë e komunat që drejtohen nga e djathta.

Ndaj rasti i manipulimeve dhe i deformimit të zgjedhjeve në Ruzhdië nuk është aspak një rast i veçantë, rastësor dhe i shkëputur i zgjedhjeve të 28 qershorit, por kambana e alarmit për nevojën e domosdoshme të hetimit të të gjithë procesit zgjedhor, dokumentet dhe faktet e të cilit ndodhen brenda kutive të votimit. Refuzimi kategorik dhe arroganca prej më të forti e maxhorancës së sotme vetëm sa e ka vërtetuar dyshimin e çdo shqiptari dhe e ka forcuar bindjen tonë për parregullsitë që mbajnë brenda ato kuti, si shprehje e deformimit të vullnetit të njerëzve që kanë votuar. Rasti i Ruzhdies si shprehje e cilësisë së zgjedhjeve të kaluara tregoi se Shqipëria nuk mundi ta kalojë stekën për ta lënë pas periudhën e tranzicionit që po përfshin një brez njeriu, se në mendësinë e pandryshueshme të drejtuesit të kësaj Qeverie, edhe pse kanë kaluar 20 vjet dhe ka hyrë në start një brez i ri votuesish, që ka lindur pas rënies së komunizmit, edhe pse në mes të Europës, na dëshmon se pushteti merret me dhunë e korrupsion dhe mbahet me vjedhje.

Për ta bërë më të thjeshtë problemin, do të desha t'i bëj një pyetje të thjeshtë çdo shqiptari, që sot po na ndjek gjithë ankth: Çfarë fsheh Kryeministri i vendit, Sali Berisha, në këto kuti? Nëse procesi zgjedhor dhe numërimi i votave ka qenë i rregullt, përse heziton dhe nuk po lë argumente e justifikim pa përdorur për moshapjen e tyre edhe kur këtë e lejon ligji; edhe pse praktikisht nuk ka asnjë kosto; edhe kur morali politik e ka vendosur si një sfidë midis palëve; edhe kur opozita deklaron se nuk kërkon ndryshimin e mandateve, cilido qoftë rezultati i hetimit; edhe kur një veprim i tillë e fut në rrjedhën normale jetën politike në vend dhe e bën opozitën bashkëpunuese; edhe kur partnerët tanë ndërkombëtarë e këshillojnë si një zgjidhje të ngërçit dhe krizës politike; edhe kur Komisioni i Venecias është shprehur vite më parë për raste të tilla të ngjashme?

Për ne, për të gjithë socialistët që kanë votuar në maxhorancë si rrallëherë tjetër, për çdo shtetas të këtij vendi, përgjigjja është e thjeshtë dhe tashmë e qartë: në ato kuti, që janë bërë më të vështira për t'u lëvizur nga vendi sesa bunkerët e komunizmit, mbahet i fshehur çelësi i pushtetit të vjedhur. Kaq e hidhur është e vërteta që mbajnë brenda të fshehur ato kuti, sa kjo Qeveri është e gatshme ta çojë vendin në kolaps dhe të mos pranojë të bëjë transparencën e tyre.

Të nderuar kolegë,

Nëse 13 vjet më parë do t'i thoshe çdo vlonjati se Sali Berisha do të rikthehej në pushtet dhe do të qeveriste Shqipërinë edhe në vitin 2010, me siguri që do të të merrnin për të çmendur. Një komision parlamentar kërkoi të gjejë fajtorët e vitit të mbrapshtë 1997, që solli një tragjedi të paparë njerëzore, si dhe ata të vitit 1996, që solli një tragjedi financiare që i parapriu të dytës. Një vit më pas, më 1998-n, ndodhi e njëjta gjë, duke u sulmuar institucionet e shtetit dhe duke u destabilizuar totalisht vendi.

E bëmë këtë retrospektivë për ngjarje që nuk u analizuan e nuk u gjykuan kurrë dhe kur nuk pati asnjëherë fajtorë dhe të dënuar, për të theksuar se ky individ nuk shkoi kurrë as në prokurori, e as në gjykata, pavarësisht se gishti i gjithë shqiptarëve i drejtohej atij dhe e konsideronin fajtor, qoftë edhe për faktin se ishte kreu i shtetit shqiptar në atë periudhë dhe përgjegjësia kryesore binte mbi të. Ky njeri është shembulli tipik i injorimit të organeve të drejtësisë, prokurorisë dhe gjykatave, gjatë gjithë historisë së tij politike në këto dy dekadat e fundit.

Dhe çfarë ironie të dëgjojmë sot të flitet për respektim dhe pavarësi të gjyqësorit! Argumenti kryesor i maxhorancës së sotme për pengimin e hetimit të zgjedhjeve dhe moshapjen e kutive është se ajo nuk mund të shkelë mbi vendimin e KQZ-së dhe vendimet e gjykatave. Ne jemi shprehur hapur, publikisht, se e njohim këtë rezultat dhe vendimet e këtyre gjykatave, si shenjë e respektimit të pushtetit gjyqësor dhe institucioneve.

Argumenti se maxhoranca e sotme nuk mund të dalë mbi gjykatat është si një mburojë prej llamarine të ndryshkur përballë shpatës së fortë të kërkesës popullore, gjithnjë në rritje dhe të institucioneve ndërkombëtare, gjithnjë e më shumë, për domosdoshmërinë e hetimit të këtyre zgjedhjeve, ligjësimit të hapjes së kutive dhe rinumërimit të votave nga subjektet e interesuara sa herë që kjo do të kërkohet.

Po kush është njeriu që i quan të shenjta vendimet e gjykatave dhe që, sipas tij, nuk guxon të shkelë mbi to?

Janë bërë publike tashmë rastet e pashembullta, kur brenda një periudhe prej 4-vjetësh, jo pak, por 20 vendime të kësaj Qeverie, rrëzohen nga Gjykata Kushtetuese. Berisha është rasti unikal në historinë e gjyqësorit shqiptar, që ka injoruar me arrogancë dhe karshillëk tribal çdo ftesë gjyqësore apo nga prokuroria.

Njeriu që përsërit se respekton dhe deklaron se nuk mund t'i shkelë vendimet e gjykatave, nuk u përgjigjet thirrjeve të tyre kur e kërkojnë të shpjegohet për fyerjet që u bën njerëzve të ndryshëm, gazetarëve dhe pronarëve të mediave, madje edhe deputetëve dhe figurave të njohura të politikës, në konferencat e shtypit, bisedat në studio të ndryshme, para kamerave, publikisht, madje edhe në këtë sallë të Kuvendit të Shqipërisë, duke dhunuar e përdhosur këtë tempull të fjalës së lirë.

Qeveria shqiptare në këto gati 5 vjet qeverisjeje nuk pranon të zbatojë vendimet e gjykatave për kthimin në punë të disa qindra nëpunësve dhe punonjësve të pushuar me pa të drejtë, nuk zbaton vendimet e gjykatave në konfliktet e saj me biznesin ose i zbaton ato në mënyrë selektive; nuk zbaton vendimet e gjykatave për kthimin dhe kompensimin e pronave, subjekteve të shpronësuar etj.

Rast tipik, sa për ta ilustruar, është ai i moszbatimit nga shteti i vendimit të gjykatave të të gjitha shkallëve, i detyrimit prej një 1 milion dollarësh që shteti duhet t'u paguajë rreth 35 subjekteve shqiptare të biznesit për punën e kryer me kontrata

të rregullta për furnizimin me tekste shkollore sipas ministrisë. Shumë prej këtyre subjekteve i janë drejtuar Gjykatës së Strasburgut dhe çështja është drejt zgjidhjes. Turp për shtetin shqiptar, që nuk njeh dhe injoron sistemin e tij gjyqësor.

Duke siguruar se opozita e sotme nuk kërkon ndryshime në rezultatin zgjedhor dhe njeh verdiktin e gjyqësorit në lidhje me këto zgjedhje, ne i bëjmë thirrje maxhorancës dhe kryetarit të saj, i bëjmë thirrje këtij Kuvendi, që ta gjykojë me urtësi kërkesën tonë për domosdoshmërinë e hetimit të zgjedhjeve të qershorit të vitit të kaluar, si një masë e domosdoshme për zbardhjen e së vërtetës, për ato që mbajnë fshehur, që parregullsi dhe deformime të tilla të mos përsëriten më, që vendi t'i kthehet normalitetit parlamentar në politikë; që të bëhen korrigjimet e nevojshme në Kodin Zgjedhor, për t'u shërbyer zgjedhjeve të ardhshme; që Shqipërisë t'i kthehet stabiliteti politik, në mënyrë që të realizojë detyrat e saj për integrimin në Europë; që bashkëpunimi në Kuvendin e Shqipërisë, midis pozitës dhe opozitës t'i shërbejë zgjidhjes së problemeve më imediate që ka vendi dhe njerëzit; që procesi i heqjes së vizave dhe sigurimi i lëvizjes së lirë të njerëzve të mos mbeten peng i kësaj maxhorance dhe i një njeriu të vetëm që ka frikë nga e vërteta. Në të kundërt, siç është shprehur para dy ditësh një përfaqësues i delegacionit të Europës Juglindore, zoti Berisha duhet të jetë i përgatitur për kostot.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit!

Zoti Mark Marku, urdhëroni!

Mark Marku – Falemnderit, zonja Kryetare!

Të nderuar deputetë,

Është shumë e vështirë që pas kaq shumë diskutimesh të thuash diçka të re për problemin e zgjedhjeve. Ajo çfarë më bën përshtypje është që pas gjithë këtyre diskutimeve, kemi mbi 24 orë që diskutojmë, një pjesë hedh baltë mbi zgjedhjet, një pjesë tjetër mbron zgjedhjet, ndërkohë, mendoj që pjesa më e madhe e shqiptarëve kanë rënë dakord, që janë zgjedhjet më të mira të zhvilluara deri në këtë moment në Shqipëri. Minimumi, do të duhej të bënim komplimente në një farë mase për zgjedhjet në Shqipëri. Gjithë opinioni publik pa diskutim që e mendon diçka të tillë, dhe unë nuk kam ndeshur, të paktën gjatë gjithë kësaj periudhe, dikë që të më thotë që ju nuk keni zhvilluar zgjedhje të mira.

Mendoj se ajo çka mund të thuhet në këtë rast është rezultati që ne kemi arritur gjatë gjithë këtij

procesi të deligjitimitit të zgjedhjeve, mendoj që ne e kemi degraduar besueshmërinë në institucionin kryesor të jetës demokratike në Shqipëri, që janë zgjedhjet.

Opozita ka kërkuar dhe nuk i jep kurrfarë besueshmërie asnjërit prej organeve që kanë drejtuar procesin zgjedhor, të dala pas një konsensusi politik. Është mundur të zhbëjë besueshmërinë e Kodit Zgjedhor, të Kolegjit Zgjedhor, të KZAZ-ve, KQZ-ve, pra, të të gjithë sistemit që merret me zgjedhjet dhe kërkon që të ndërtojë një strukturë tjetër, ngritjen e komisionit, që do të merret me hetimin e zgjedhjeve, i cili do të dalë nga një parlament, të cilit opozita nuk ia njeh legjitimitetin dhe këtij komisioni ne pretendojmë t'i caktojmë detyrën që të përcaktojë të vërtetën mbi zgjedhjet. Unë nuk e kuptoj se si ne mund të kemi sot, pas kaq shumë balte që është hedhur mbi institucionet zgjedhore në Shqipëri dhe mbi institucionet demokratike në Shqipëri, se si ne mund të kemi sot, pas një periudhe të tillë, një institucion të vetëm, qoftë ky edhe një komision parlamentar, i cili të na garantojë, të na japë besueshmërinë e një procesi, garanci që nuk na e kanë dhënë të gjitha institucionet e tjera, të cilat ne i kemi ngritur me kohë në muajt që kanë kaluar.

Unë kam dëshirë që të ngrihet komisioni, kam dëshirë që opozita të ketë shumicën etj., etj. dhe procesi të zhblokohet, por unë personalisht dyshoj në suksesin e këtij komisioni pikërisht për këtë shkak. Përderisa ne i kemi deligjitimuar të gjitha institucionet paraprake, të cilat kanë shumë më tepër legjitimitet se sa një komision parlamentar, unë personalisht dyshoj se ne do të kemi rezultatet e duhura që presim nga ky komision parlamentar.

Kam vënë re se gjatë gjithë kësaj periudhe të dyja palët, forca politike ku bëj pjesë unë, por sidomos forca kundërshtarë, diskutojmë mbi të vërteta absolute. Do të thotë që secili njeh një të vërtetë. P.sh., kam dëgjuar këto ditë që është diskutuar shumë problemi i Ruzhdies. Në gjykimin tim problemi i Ruzhdies është gjykim krejt personal; është dëshmi e funksionimit të sistemit zgjedhor.

Ju lutem, ta shpjegoj vetëm dy minuta.

Në Ruzhdië komisionerët socialistë janë larguar nga kutitë e votimit. Do të duhej që komisioni zgjedhor lokal t'i kthente komisionerët ose të caktonte komisionerë të tjerë, duke u dhënë vulën e kutive të votimit. Në këtë zonë janë bërë zgjedhje. Partia Demokratike ka ankimuar, komisioni lokal nuk e ka njohur rezultatin e zgjedhjeve; Partia

Demokratike është ankimuar në një institucion tjetër të zgjedhjeve, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, e ka fituar të drejtën për të numëruar votat e Ruzhdies dhe Partia Socialiste i është drejtuar një instance më të lartë, Kolegjit Zgjedhor, i cili, nga ana e vet, e ka bllokuar numërimin e votave duke i hequr Partisë Demokratike disa vota në atë zonë, duke i hequr një mandat deputeti, të cilin, le ta pranojmë, që është hequr për shkak se ka pasur parregullsi. Por ama ne nuk mund ta përdorim një ngjarje apo ngjarje *par excellence*, që tregon funksionimin e sistemit zgjedhor dhe të rregullshmërisë së zgjedhjeve, si argument dhe ta bëjmë simbolin, mitin e parregullsisë së zgjedhjeve. Unë mendoj dhe jam i bindur që pikërisht duke u nisur nga Ruzhdia ne dëshmojmë që kemi pasur një sistem zgjedhor të rregullt.

Në qoftë se do të niseshim nga dëshira për ta përmirësuar sistemin zgjedhor, mendoj se kemi shumë për të bërë dhe pikërisht, mbi këtë pistë duhet të punonim për të nxjerrë probleme, por mendoj se nuk mund të zgjidhen problemet e ardhshme të zgjedhjeve në qoftë se ne sabotojmë zgjedhjet paraprake. Nuk mund të krijojmë kurrfarë besueshmërie të zgjedhjet e ardhshme në qoftë se ne u heqim besueshmërinë zgjedhjeve më të mira që kemi arritur të organizojmë deri tani.

Në qoftë se do të vazhdojmë në këtë formë ne shumë kollaj do të shkojmë drejt një përplasjeje, një konflikti social, një konflikti politik etj., etj., por e kemi shumë të vështirë dhe unë dysjoj tek vullneti i opozitës për të përmirësuar sistemin zgjedhor. Në qoftë se do të donin të përmirësonin sistemin zgjedhor, mendoj që procedura, metodika e ndjekur, duhet të ishte krejt tjetër. Të gjithë e dimë se të gjitha zgjedhjet në Shqipëri kanë pasur probleme, por unë jam i bindur se asnjë sistem, asnjë shtet, sado demokratik të jetë, nuk i arrin zgjedhjet ideale.

Në qoftë se ne do të ndërtojmë gjithë kritikën mbi zgjedhjet, duke pasur si pika referimi sisteme ideale demokratike dhe sisteme ideale zgjedhjesh, ne nuk do të mundemi kurrë të ndërtojmë një sistem real zgjedhor dhe nuk do të mundemi kurrë që, bashkërisht, të krijojmë besueshmëri, sepse, mendoj, përjashtoj procesin teknik, besueshmëria ka të bëjë shumë, është një nga elementet bazë të procesit zgjedhor. Këtë besueshmëri unë mendoj se ne e kemi dëmtuar. Për një taktikë politike të Partisë Socialiste ne kemi dëmtuar në mënyrë afatgjatë interesat e vendit, për këtë jam i bindur.

Kështu që u bëj thirrje të gjithë kolegëve, pa

përjashtim, të heqin dorë nga të vërtetat absolute dhe të zbresim në realitet, t'i referohemi një sistemi dhe mbi këtë sistem dhe mbi këtë problematikë që kemi të ndërtojmë një platformë të ardhshme, për të pasur zgjedhje edhe më të mira se këto që kemi.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Marku!

Fjalën e ka Ilir Bejtja.

Ilir Bejtja – E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Të nderuar bashkëqytetarë,

Ka kohë tashmë që në jetën tonë të përditshme ka hyrë me forcë ky debat i hapur për votën. Ajo çfarë shohim së fundi është një mur i ngritur me prepotencë ndaj së drejtës sonë të përbashkët qytetare për transparencë, për të parë qartësisht votën tonë, shprehjen tonë të vetme të pushtetit legjitim që na buron nga e drejta për të qenë qytetarë të këtij shteti. Po bëhen tashmë 19 vjet demokraci, edhe pse e brishtë dhe në evoluim, që dëgjojmë gjithnjë shprehjen: “Zgjedhje të përmirësuar, por me legjitimitet të cunuar”. Ky është bërë tashmë një refren i hidhur për të gjithë shqiptarët, një refren që na ka mbyllur dhe vazhdon të na mbyllë dyert në shumë zhvillime ndërkombëtare të rëndësishme për të ardhmen tonë.

A duhet të vazhdojmë me këtë retorikë? A duhet të kënaqemi me përmirësime? Unë them jo. Jo, thonë edhe gjithë shqiptarët. Ka ardhur tashmë koha që ne të ndalojmë seriozisht para vetes. Për ne nuk mund të jetë më retorikë përmirësimi, por realizimi i detyrueshëm i standardeve, për të korrigjuar kolegjin tim parafolës, standarde nuk do të thotë situatë ideale.

Kjo gjendje që përjetojmë ka shkaktuar një ndjenjë të fortë pasigurie ndër njerëz, një ndjenjë mosbesimi, të cilën së fundi gjithnjë e më shumë kanë filluar ta lidhin me origjinën tonë gjenetike. Kemi filluar të bëhemi racistë ndaj vetes, duke ia mohuar sheshit dhe pa hezitim të drejtën vetes për të qenë një shoqëri demokratike, me kuptimin e plotë të saj. Ne po vazhdojmë t'i tregojmë vetes dhe botës që në normat tona kulturore një nga më të rëndësishmet është gënjeshtria dhe vjedhja e votës, por, ç'është më e keqja, të gënjerit e vetvetes.

Qëndrimi i Kryeministrit, sa prepotent aq edhe arrogant; sa vulgar, aq edhe kërcënues; sa qesharak, aq edhe i gënjeshtërt, nuk e zgjidh problemin tonë.

Zonja dhe zotërinj,

Zgjidhja e vetme që na çon drejt një zhvillimi të ri demokratik, drejt një jete me standarde

demokratike, larg diktaturës dhe kinezërive që po mundohet Berisha të instalojë në Shqipëri, është transparenca dhe vendimmarrja demokratike. Hapini, pra, kutitë dhe na bindni ne dhe shqiptarët, që e kemi gabim! Lërimi shqiptarët të vlerësojnë vetë vërtetësinë e votës së tyre! Misioni ynë në këtë proces është e vërteta, është garantimi i lirive të individit; është eliminimi i kërcënimit që vjen nga përkatësia politike në leximin e votës popullore; është ndërtimi i një shoqërie moderne me norma të forta demokratike; është ndërtimi i një shoqërie që na garanton të gjithëve një jetë me standarde të larta dhe respektim të shtetit të së drejtës.

Kryeministri, pushtuesi kryesor edhe i së djathtës shqiptare, është duke bërë mjaft mirë misionin e tij si pinjoll i fundit në pushtetin e fundit të diktaturës së fundit komuniste, duke instaluar forma banditeske të drejtimit të shtetit në funksion të pushtetit. Enverizmi i tij është në shesh për të gjithë ata që kanë sy dhe duan ta shohin. Më shumë se të gjithë ai ka nevojë të integrohet në shoqërinë demokratike dhe në heshtje të ulë kokën për t'i hapur rrugën së resë dhe demokracisë së vërtetë në vendin tonë. Shtrembërimi i votës prej tij ka nisur që herët, shumë më parë së të fillojnë zgjedhjet, nëpërmjet taktikave të tij mafioze të favorizimit të bizneseve qeveritare në dëm të të gjithë ekonomisë shqiptare. Ai nuk mund të durojë që shqiptarët të pasurohen; ai nuk duron që ata të kenë kushte të mira jetese. E dëgjojmë shpesh të bëjë demagogun duke predikuar edhe barazi të tipit komunist: "Shqiptarët nuk duhet të lahen në vaska floriri!". Nuk e di pse në mend më vjen figura e papranueshme e diktatorit Ruhililo.

Kjo ka bërë që në dogana apo atje ku bizneset ushtrojnë aktivitetin e tyre, të jenë subjekt i sulmeve të ulëta nga ana e Qeverisë. Nuk ka më tregues apo elemente të një ekonomie tregu, por të një tregu thellësisht të shtrembëruar dhe të komanduar nga banda qeverisëse. Bizneseve në këtë ditë krize u mohohet e drejta për të punuar në një situatë të tillë, duke mos krijuar për ta kushtet më minimale të daljes nga kriza e rëndë që ka pushtuar vendin. Kush është burimi i kësaj krize? Pa dyshim ai ka vetëm një emër: pushtimi nga ana e Berishës i pushtetit dhe ngritja dhe instalimi i një junte diktatoriale mafiozo-komuniste, nëpërmjet, së pari, montimit të mohimit të së drejtës për të vendosur sovranin dhe më tej nëpërmjet zhytjes së ekonomisë në kolaps total, duke i mbytur pa ndërprerje bizneset tona të brishta, instalimi i monopoleve që duhet të

ushqejnë korrupsionin, që çdo ditë po na thith edhe pikat e fundit të gjakut; shpërdorimi absurd dhe i qëllimshëm i parave të shqiptarëve në investime jo vetëm të pastuduara, por edhe korruptive dhe dhuna ekonomike që e ka çuar tregun shqiptar në një rrëmujë të paparë.

Si mundet ne të pretendojmë për një ekonomi të tregut të lirë kur ligjet për biznesin e dëmtojnë atë çdo ditë? Si mundet ne të flasim për konkurrencë të lirë, të ndershme kur bizneset monopoliste rreth familjes qeverisëse komandojnë çdo gjë në treg. Si mund të flasim ne për pjesëmarrje të tyre në hartimin dhe vendosjen e legjislacionit ekonomik, kur kjo liri nuk ekziston në të drejtën e tyre kushtetuese, atë të votës dhe të qëndrimit për votim? Diktaturat nuk fillojnë ndryshe. Në të njëjtën mënyrë Enver Hoxha dikur sulmoi ekonominë e tregut në Shqipëri dhe instaloi diktaturën më të egër në botë. Mos vallë prisni ta shihni përsëri fizikisht Enverin? Jo, zotërinj, ai është më i zgjuar se kaq, Kryeministri diktaturën po mundohet të na e shesë për demokraci, votën e vjedhur për të lirë, përdorimin e pushtetit si rend, korrupsionin si mekanizëm lëvizës të ekonomisë dhe falimentimin total si suksesin më të madh që keni arritur ndonjëherë.

Tendenca diktatoriale dhe dhunimi i vazhdueshëm i ligjit nuk është i rastit. Qeveria vazhdon të injorojë rregullisht konventat, si dhe dokumentet kryesore dhe vendimtare për instalimin e demokracisë, si karta e decentralizimit të pushtetit, duke sulmuar në mënyrë makute dhe makabër pushtetin lokal, sidomos në zonat ku qeveris opozita.

Maxhoranca flet për arritje në këtë drejtim, por zvogëlimi i kompetencave dhe pakësimi i buxheteve vendore nëpërmjet të ashtuquajturave grante konkurruese, që nuk janë gjë tjetër veçse leva të korrupsionit politik, kanë venë në vështirësi serioze funksionimin e tyre, duke vënë në vështirësi gjithashtu edhe të gjithë qytetarët për shërbimet që ata kanë të drejtë të marrin.

Pseudoinvestimet e planifikuara dhe të propaganduara me megalomani dhe prepotencë janë kthyer në varreza dhe hone vdekjeje për të gjitha bizneset e përfshira në to, por edhe për të gjithë sistemin ekonomik shqiptar, si dhe papunësia e rritur me mbi 5% në të gjithë vendin, tregues këta që fshihen në mënyrë të vazhdueshme nga INSTAT-i, tregojnë për një rrëpirë të rrezikshme, ku ka rrëshqitur totalisht tashmë ekonomia jonë. Por më e keqja është se për këtë situatë nuk ka as fajtor,

as shanse për t'i gjetur, përkundrazi, na thuhet se jemi shumë të lumtur, madje në mënyrë sarkastike, eksponentë të maxhorancës na krahasojnë edhe me ekonomitë e zhvilluara europiane, se si ne ua kemi kaluar të gjithëve me progresin e paparë që kemi. Sa turp dhe sa keq!

Pyetini shqiptarët se ç' mendojnë? Duan të hyjnë në Europë. Por si? Duan të ikin nga Shqipëria përgjithnjë.

Qytetarë shqiptarë, sa keq që në fjalën time të parë në këtë tribunë diskutimi im duhet të jetë kaq i trishtuar. Kam vetëm një qëllim, të kërkoj nga të gjithë ju të zgjoj të keqen që na ka pllakosur e pushtuar, sepse kjo është e vetmja mënyrë për të filluar të ndreqim fajet dhe gabimet, është e vetmja rrugë për të nisur në një mënyrë të re. Të nisim ashtu siç nënkupton demokracia, pra, me të drejta të barabarta konkurrimi, nga ajo më e rëndësishmja, nga hedhja dhe numërimi i votës deri te diskutimi i hapur i halleve dhe i problemeve tona dhe të shkojmë drejt zgjidhjes së kësaj krize totale demokracie, ekonomike dhe pushteti, duke u shkëputur përgjithnjë nga e kaluara jonë e hidhur, që karakterizohet shumë nga ai fenomen, për të cilin gjithë qytetërimi ndërkombëtar modern na tregon me gisht, pra nga ballkanizmi.

Zoti Berisha,

Zonja dhe zotërinj të pozitës, opozita nuk është armiku juaj, por pasqyra juaj për të gjitha aktet dhe veprimet që ndërmerri. Ju jeni në pushtet, por mos harroni se oferta jonë për bashkëpunim për të dalë nga kjo krizë është e ndershme dhe premtom vetëm progres. Sot kemi shansin të tregojmë se gjithë sa themi, apo sa thuhet mund t'i hedhim pas krahëve dhe së bashku ta bëjmë këtë tribunë funksionale dhe premtim e garanci për të gjithë shqiptarët. Mos e shpërdoroni, se vetëm e thelloni krizën totale!

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit!

Fjalën e ka zoti Sherefedin Shehu. Urdhëroni!

Sherefedin Shehu – E nderuar zonja Kryetare, Të nderuar kolegë deputetë,

Të gjithë ne që jemi këtu në këtë sallë kemi qenë drejtues të procesit të votimit, po ashtu edhe të procesit të numërimit, sepse të gjithë ishim të interesuar për një proces të drejtë, po njëkohësisht edhe për një proces transparent për të marrë vota, por edhe për t'i ruajtur ato. Prandaj, jemi ne ata që siç bëmë ditën e përfundimit të numërimit, kur u ndamë në mënyrë miqësore, duke i dhënë dorën njeri-tjetrit, të pohojmë përpara shqiptarëve se për

herë të parë patëm një proces të drejtë, të barabartë dhe transparent.

Ju krejt papritur e ndryshuat kursin, por kishte mospërputhje në kohë dhe kjo, natyrisht, ju bën të dyshimtë, sepse vetëm për interesat e ngushta të kryetarit tuaj, prej më se 7 muajsh po dëgjojmë nga ju, të nderuar kolegë, monologë, skica letrare, vjersha, në të cilat në mënyrë të njëanshme njolloset procesi zgjedhor. Edhe në këtë seancë po dëgjojmë më shumë retorikë dhe demagogji sesa argumente dhe interes për transparencën zgjedhore.

Kolegët opozitarë po rreken me sajime, kalime nga dega në degë dhe më gjëra të tjera, që nuk kanë të bëjnë aspak me transparencën e këtij procesi. Kjo të çon në konkluzionin se kërkesa për transparencë e opozitës është e padrejtë, e pandershme, e pabazuar dhe djallëzore. Them e padrejtë, sepse edhe ju, kolegë opozitarë, publikisht e keni pranuar njohur fituesin dhe humbësin e zgjedhjeve, dhe kryehumbësi është shefi juaj.

Me kërkesën tuaj doni që të deligjitimoni një qeveri të ligjshme. Është e padrejtë, sepse kërkohet transparencë e një procesi nga më transparentët, ku për herë të parë funksionuan ligjet dhe rregullat zgjedhore, u përdor një infrastrukturë që garanton transparencën dhe u arritën standarde, ndonëse jo të nivelit evropian, por që i plotësojnë ato kryesoret e OSBE-së dhe janë më të mirat që ka pasur Shqipëria deri më sot.

Është e padrejtë kërkesa juaj, sepse Shqipëria është në prag të Bashkimit Evropian dhe me këtë histori synoni largimin e saj. Kërkesa juaj është e pandershme, sepse nga njëra anë pranoni publikisht se i njihni rezultatet e zgjedhjeve, por nga ana tjetër thoni se duam të shohim kutitë. Me këtë ju thoni se jeni humbës, por nuk keni humbur.

Kërkesa juaj është e pabazuar, se nuk bazohet në prova dhe fakte, por supozohet se faktet janë në kuti dhe, pas shqyrtimit të kërkesës suaj të formalizuar në një projektligj, rezultojnë se ajo është në konflikt të hapur me Kushtetutën dhe me vendimet e garantit të saj që është Gjykata Kushtetuese.

Kjo kërkesë rezultojnë të ketë edhe qëllime djallëzore. Tonet kërcënuese dhe presionet që e shoqërojnë kërkesën synojnë ardhjen tuaj në pushtet jo me zgjedhje të drejta dhe të ndershme, por duke krijuar pasiguri, destabilizim dhe krizë artificiale.

Të nderuar kolegë opozitarë, meqenëse ju pretendoni se synimet tuaja janë arritja e standardeve europiane, atëherë pse nuk i thoni urime

fituesit dhe të përgatiteni për raundin tjetër? Të dy palët pritëm përfaqësinë e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës, por ende pa përfunduar vizitën përfaqësuesit e Asamblesë, ju e akuzuat atë si të njëanshme. Atëherë, mos vallë është primitive politika europiane, apo e tillë është sjellja antieuropiane e opozitës?

Kolegë opozitarë, është mirë që më parë të respektojmë njëri-tjetrin dhe t'i zgjidhim gjërat midis nesh, por, meqenëse e pranuar arbitrin, duhet ta respektojmë atë. Për të zgjidhur këtë krizë artificiale le të pranojmë dhe të zbatojmë rekomandimet e OSBE-ODIHR-it dhe të presidencës së Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës.

Presidenti Obama thotë që jemi në politikë për t'u shërbyer qytetarëve dhe jo për ambiciet tona, prandaj ne duhet të shohim përtej vetes dhe ju, kolegë opozitarë, mos u viktimizoni për ambiciet e kryetarit tuaj.

Në përfundim dua të sjell në vëmendjen tuaj kolegë opozitarë, faktin se ishit ju dhe partia juaj që bëtë të gjitha përpjekjet për manipulim. Për këtë ju kujtoj: mobilizimin e tipit paramilitar të policëve dhe të ushtarakëve të shkarkuar nga detyra; përdorimin e kontingjenteve të krimi si komisionerë në vendet ku ata nuk ishin banorë; futjen në grupe të njerëzve që nuk plotësonin kushtet, por që premtonin se mund të manipulonin; dërgimin e njerëzve të dyshimtë për të bërë presion gjatë ditës së votimit në qendrat e votimeve.

Të nderuar kolegë, meqenëse kolegu opozitar i qarkut të Dibrës u përpoq që të njollosë dibranët, dua t'ju them se ai ka njollosur veten. Në Dibër nuk ka pasur asnjë problem me zgjedhjet, por ka pasur një problem për ju, sepse kolegu im opozitar ka bërë deklaratat publike që i ka blerë votat, se ka blerë kaq një votues në Lurë, ka blerë kaq një votues në Sohodoll, kaq një votues në Kastriot e kështu me radhë në gjithë fshatrat.

Për sa i përket Maqellarës, ajo ka qenë dhe mbetet djep i demokracisë dhe nuk mund ta njollosë një kandidat, i cili ka ngrënë bukën dhe ka përmbysur kupën. Pra, problemi është se ai as nuk i ka parë me sy ata njerëz dhe jo më t'i respektojë. U ka thënë: "unë ju kam blerë dhe mos më çani kokën". Prandaj ky problem duhet parë, duhet bërë analiza dhe jo të sajojme probleme edhe atje ku nuk ka.

Duke përfunduar, të nderuar kolegë, ju bëj thirrje që ato që bëtë në zgjedhjet e 28 qershorit të mbeten përpjekja juaj e fundit për ta mbajtur peng Shqipërinë. Ju ftoj që të bashkohemi për ta bërë Shqipërinë pjesë

të Europës, sepse asaj i takon!

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Shehu!

Fjalën e ka Besnik Bare. Urdhëroni!

Besnik Bare – Mirëdita të gjithëve!

Të them të drejtën, kur shikon Parlamentin shqiptar nga televizori zhgënjehesh, por kur je brenda zhgënjehesh shumëfish, sepse ky Parlament, ndonëse nga shumë folës thuhet që është tempulli i demokracisë, nuk është as tempull dhe nuk ka as elementin e demokracisë brenda. Unë do të thosha që ky është një teatër, ku në mënyrë konstante ka dhunë verbale. Do të rekomandoja prindërit shqiptarë që fëmijët e tyre nën moshën 15 vjeç të mos i lejojnë të ndjekin Parlamentin shqiptar.

Në fillim të demokracisë, shqiptarët në një pjesë të konsiderueshme ishin ndarë në dy grupime, një grupim që ishte optimist mendonte se Shqipëria do të bëhet një vend normal si Europa pas 5 vjetësh, kurse pesimistët mendonin se kjo gjë do të ndodhte pas 10 vjetësh. Në fakt, kanë kaluar 20 vjet dhe Shqipëria është ende në udhëkryq. Shqiptarët kanë uri të ngjashme si në ato vite, edhe sot, për ta braktisur këtë vend.

Unë mendoj se ka një arsye shumë të thjeshtë që pengon zhvillimin normal të këtij vendi. Në Shqipëri ende nuk është vendosur si duhet ajo që është themelore për një demokraci, zhvillimi i zgjedhjeve të lira, transparente dhe të ndershme, ky element është tharmi rregullator i demokracisë dhe i transparencës së një shoqërie. Ai kondicionon zhvillimin normal të ekonomisë, të kapaciteteve të administratës, të prokurorisë së pavarur, të policisë së pavarur, të Shërbimit Informativ të pavarur, të niveleve akademike plotësisht të pavarura, të mospushimeve nga puna për arsye politike, për fat të keq, të të gjithë shqiptarëve.

Partia Demokratike ka treguar se është e paaftë të kryejë zgjedhje të lira. Është e hidhur dhe ironike, por edhe zgjedhjet e bëra në muajin mars të vitit 1992 rezultojnë më të mirat, nuk i kontestoi asnjë parti.

Në korrik të vitit 1992 Partia Demokratike humbi në zgjedhjet lokale, në referendum përsëri humbi, por zoti Berisha nuk dha dorëheqjen. Këto dy ngjarje shërbyen si fakte të mjaftueshme për Partinë Demokratike dhe për të kuptuar se ata mund të qëndronin në pushtet vetëm nëpërmjet manipulimit. Për këtë arsye u gatua manipulimi skandaloz në muajin maj të vitit 1996. Në mënyrën më të sofistikuar manipulimi vazhdoi edhe në muajin tetor

të vitit 1996, ku kam qenë nënkryetar i Komisionit të Zgjedhjeve dhe e kam parë dhe prekur vetë atë proces.

Në korrik të vitit 1997, edhe pse vendi kalonte situatën më tragjike në historinë moderne, mendohej për manipulim. Aq i sigurt ishte Berisha dhe PD-ja, sa thirrën disa vëzhgues të Bashkimit Europian, të cilëve ju tha se duhet t'i detyrojnë socialistët të njohin zgjedhjet, pasi ata do të humbasin dhe s'do t'i njohin ato. Në fakt, humbi Berisha dhe PD-ja dhe ai që nuk i njohu zgjedhjet ishte vetë Berisha.

Në vitin 2009 është përsëri Partia Demokratike që organizoi zgjedhjet, të cilat deformohen shumë rëndë, por kësaj radhe me shumë kujdes. Vota më 28 qershor ishte plebishitare kundër Partisë Demokratike, por falë deformimit e majta doli barazim me të djathtë.

Në qytetin e Tiranës, pa folur për Kamzën, Paskuqanin, Domjën etj., pavarësisht se si qytet doli mbi 15 mijë vota më shumë se Partia Demokratike, evidencat tona tregojnë qartë se është manipuluar rëndë. Ne arritëm të identifikojmë disa qindra votues, të cilët nuk ishin në qendrat e zakonshme ku ata votonin prej vitesh. A nuk u kap te "Dhura Leka" një votues nga Fushë-Kruja me emër fals?! A nuk shkoi te pallati i sportit një votues tjetër dhe në vend të tij kishte votuar dikush tjetër?! Po te qendra e votimit pranë doganës, në autostradë, a nuk erdhën rreth 300 votues, që komisionerët tanë as i kishin dëgjuar dhe as i kishin parë?! Këto janë vetëm maja e ajsbergut, prandaj ne kërkojmë verifikim të zgjedhjeve edhe për qytetin e Tiranës. Këto fakte i kemi denoncuar në media që ditën e zgjedhjeve, më 28 qershor. Cila është arsyeja që emigrantëve tanë në Britaninë e Madhe u është kërkuar, ditën e votimit, në telefon, nga komisionerët e zonës së Burrelit, të dërgojnë me sms numrin e pasaportave? Moshapja e kutive do të bëjë që emigrantëve shqiptarë t'u vidhet identiteti, gjë e cila nuk është bërë në asnjë regjim. Ju në mendjet tuaja do të thoni se këto janë fantazira. Ka vetëm një mundësi që të na bindni, por mbi të gjitha popullin shqiptar dhe komunitetin ndërkombëtar: transparencë. Në qoftë se e arrini këtë gjë, ne do t'ju kërkojmë ndjesë dhe kokulur do të vijmë në Parlament. Ju nuk e bëni këtë, i mbani kutitë e mbyllura me sofizma ligjorë, në kundërshtim me të gjitha parimet e një demokracie normale. Kur forcës më të madhe politike në vend nuk i lejohet të bëjë këtë verifikim, imagjinoni çfarë do të ndodhte nëse një parti e vogël do të kërkonte këqyrjen e

dokumenteve, veshi do të ishte i shurdhër. Ju me këtë veprim po deformoni rëndë vlerat e demokracisë. Kur një parti politike, më e votuara në Shqipëri, nuk arrin të sigurojë transparencë, imagjinoni nëse mund të ketë drejtësi dhe transparencë për individin, qytetarin apo fshatarin. Sigurisht jo. Atëherë, kjo nuk është demokraci, por dhunë dhe pseudodemokraci. Në këtë mënyrë ju po shkatërroni besimin, atë që Bashkimi Europian na e ofron me shumë bujari, dhe, për më tepër, po përpiqeni ta shisni demokracinë shqiptare të ngjashme me atë europiane, duke krijuar një imazh të deformuar të shqiptarët për demokracinë europiane. Në këtë mënyrë po shkatërrohen raportet shtet-qytetar. Cila është arsyeja që në komisionet e votimit komisionerët e PS-së dhe të PD-së e shohin njëri-tjetrin siç sheh izraeliti palestinezin? Cila është arsyeja që elektorati i majtë është gjithnjë në ankth se do t'i vjedhin votën? Kjo klimë ushqehet nga ju. Kur militantit i thua manipulohet se do të bëhesh punonjës në doganë ose tatime, ai është gati të hidhet në zjarr dhe jo më të dhunojë një komisioner. Manipulo, është mesazhi juaj, sepse kutitë nuk do të hapen dhe ne do t'ju mbrojmë, nuk ju prek as ligji, as prokuroria, aq më pak pretendimi i Partisë Socialiste apo i kujt do force tjetër. Për fat të keq, po krijohet ideja se manipulimin në Shqipëri nuk e shkul dot as faktori ndërkombëtar, i cili po flet çdo ditë. Përfundimi është i qartë, Partia Demokratike dhe lidhshipi i saj nuk bëjnë dot zgjedhje normale me standarde demokratike. Arsyeja është shumë e thjeshtë: një grup njerëzish nga PD-ja janë implikuar në afëra korruptive. Sot ata e dinë që zgjedhje të ndershme do të thotë demaskim i këtij klani. Me zgjedhje të lira do të zbulohen me forma ligjore se kush fshihet prapa "Gërdecit"; kush fshihet prapa abuzimeve të rrugës Durrës-Kukës, apo privatizimeve; kush fshihet prapa vrasjes së Fatmir Xhudit; kush fshihet prapa Fazllit; kush fshihet prapa zhdukjes së Remzi Hoxhës; pse Shqipëria po ndërton fabrika çimentoje sa 10-fishi i nevojave të vendit; pse Shqipëria po kërkon të ndërtojë TEC-e me qymyr, shumëfishin e nevojave të vendit, kur dihet se ato marrin jetë njerëzish dhe asnjë vend në rajon nuk ndërton më shumë se nevojat e veta në këto industri nga më ndotëset në planet; pse në Vlorë duhet të pritet Pylli i Sodës prej 500 hektarësh, ku mendohet të ngrihet një park përbindësh, i cili do të shkatërrojë të gjithë biznesin dhe turizmin; pse Shqipërisë po i rrëshqet toka si në asnjë vend tjetër në Europë?

Zotërinj, pyetni pilotët që fluturojnë në hapësirën ajrore shqiptare dhe ata do t'ju thonë se terreni shqiptar i ngjan një koke të rrjepur. Është e papërgjegjshme kjo gjë dhe papërgjegjshmëria juaj, që mbrohet nga moshapja e kutive, ju bën të qëndroni të qetë në pushtet. Të gjitha këto dhe të tjerat mbrohen vetëm nga kutitë e manipuluar, nga "Ruzhdia dhe Ruzhdiet" në tërë Shqipërinë. Pa transparencën e kutive nuk do të ketë transparencë në të gjitha krimet njerëzore, ekonomike, ekologjike dhe Shqipëria do të vazhdojë të lëngojë. Ne duam të këqyrim kutitë që jo vetëm fëmijët tanë, por të gjithë ne, përfshirë edhe ju, të shohim ditë të bardha në këtë vend. Ne kemi bindjen se Ruzhdia është mbarë Shqipëria, këtë e tregon qartë moslejimi kategorik i hapjes së kutive. Te kutitë është çelësi i zhvillimit të Shqipërisë me një ritëm dhe kulturë tjetër. Socialistët e Shqipërisë nuk do të lejojnë më që të vazhdohet si këto 20 vjet. Ne u ofrojmë shqiptarëve e faktorit ndërkombëtar filozofinë dhe standardin europian. Pa transparencë të përhershme të zgjedhjeve, të zhvillimit ekonomik dhe social jo vetëm për sytë e dy partive të mëdha, por për individin më të thjeshtë, nuk ka demokraci. Që këtu do e nisim ndërtimin e Shqipërisë së re posttranzicion.

Unë doja të bëja një koment në lidhje me arsyetimin që bëri kolegu im Mark Marku, i cili tha që nuk mund të përgjithësohet rasti i Ruzhdies për gjithë Shqipërinë. Në çdo praktikë, pavarësisht nga fusha, aq më tepër në një praktikë ku kërkojmë të japim një përgjigje sa më të drejtë, sa më objektive dhe sa më shkencore, shohim shembujt. Në qoftë se në një bashkësi shumë të madhe, siç janë kutitë e votimit, bëhet vetëm një zgjedhje dhe zgjidhet vetëm Ruzhdia, e cila del se është e deformuar, vërtet mund të mendohet që kutitë e tjera mund të mos jenë kështu, por ka vetëm një rrugë për ta verifikuar këtë gjë: të bëhen prova të tjera, për të parë a është ky një realitet apo është ndryshe.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Baraj!

Fjalën e ka zoti Selami Xhepa.

Selami Xhepa – Falemnderit, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë,

Që nga hapja e kësaj seance dje, vëmendja dhe ndjeshmëria e Shqipërisë dhe shqiptarëve ka qenë e përqendruar në këtë sallë. Është përqendruar vëmendja e atyre që na kanë votuar për t'u zgjidhur problemet dhe jo për t'u shndërruar në një problem më shumë për ta. Janë sot me ne edhe miqtë e

Shqipërisë dhe veçanërisht ata europianë, të cilët, duke apeluar për maturi politike, po ndjekin prej kohësh zhvillimet politike dhe po na gjykojnë nëse jemi të denjë t'i bashkohemi familjes së tyre. Sot janë këtu edhe ata që akoma nuk ardhur në jetë, sepse nga qëndrimet tona sot, do të varet fakti nëse ata do të lindin si qytetarë europianë apo do të vazhdojnë të vuajnë edhe ata pasojat e politikës primitive, që vetëm emrin mund ta ketë "politikë e re". Nëse e ndiejmë me zemër rëndësinë jetike të këtyre momenteve, le të diskutojmë se si t'i gjejmë zgjidhjet e kompromisit dhe jo të mobilizojmë arsenalin e retorikave dhe politikave bajate për të ruajtur llogoret e pozicioneve politike. Pas më shumë se gjashtë muaj bojkoti politik, ia arritët, të nderuar kolegë, të njollosni seriozisht zgjedhjet, institucionin fundamental të demokracisë. Ky është mëkati më i madh ndaj vendit, shumë më i madh se të gjitha parregullsitë dhe mangësitë e procesit zgjedhor, zgjedhje që, në të vërtetë, u vlerësuan në çdo raport të organizatave të vendit dhe ato të huaja.

Si çdo shqiptar, edhe unë e kam ndjekur debatin politik të opozitës, që ditën që shpalli bojkotin dhe nuk kam hasur apo gjetur veçse një hipokrizi politike të pasaktë. Shprehjet "t'i japim fund politikave të korrupsionit zgjedhor" dhe "të ndërtojmë republikën tonë ideale", mund t'i thoshte ndonjë Hegel që nga Europa apo nga ndonjë planet tjetër, por jo politikanë që me shembullin dhe veprën e tyre janë ngjizës të realitetit të kësaj republike ku jetojmë. Zgjedhjet e vitit 2009 i dhanë fund masakrës elektorale dhe maskaradës së proceseve zgjedhore, që ishin rregulli i Shqipërisë postkomuniste. Vetëm pak vite më parë kemi parë që për zgjedhjet në Shqipëri raportoheshin kuti të tëra me fletë votimi të zhdukura nëpër kanale, kandidatë për deputetë që intimidoheshin edhe me armë, qytetarë e votues të frikësuar përpara qendrave të votimit, kosha me certifikata të prodhuara në shpalllografë dhe lista me votues të paqenë. Viti 2009 i zëvendësoi këto praktika me një praktikë europiane, moderne dhe tërësisht transparente. Transparencën, për të cilën po flasim, e garanto vetë procesi zgjedhor, por, duke qëndruar brenda shpellës së Platonit, më duket se neve na pëlqen të shohim objektet-hije, rrezet, siluetat dhe fantazmat e tyre. Vullnetet politike u shprehën në kryerjen e reformës zgjedhore, reformë që ka nevojë ende për përsosje, por vullnetet nuk mund të dalin mbi institucionet.

Të dashur kolegë,

Le të lëmë mënjanë demagogjinë, sepse është

një taktikë politike shumë afatshkurtër. Të lëmë llogaritë politike makiaveliste dhe të kthejmë sytë te njerëzit, të cilët presin nga ne të gjejmë zgjidhje. Gjetja e zgjidhjes do t'i bënte shërbimin më të madh, në radhë të parë, vetë politikës dhe do të rehabilitonte atë imazh të dëmtuar seriozisht për politikanët e karrierës. Sigurisht që qytetarët po paguajnë fatura shumë të mëdha dhe unë i dëgjova me shumë vëmendje edhe poemat e mjerimit që u kënduan shumë shpesh, por mendoj se fatura më e madhe që paguajnë qytetarët është papërgjegjshmëria e bojkotit institucional. Besoj se ka zgjidhje kushtetuese, institucionale, në respekt të shtetit ligjor dhe për këtë duhen dëgjuar edhe ata që janë më ekspertë si në profesion, ashtu edhe në eksperiencat demokratike. Pra, të mos kemi frikë t'i dëgjojmë si Komisionin e Venecias, ashtu edhe institucionet tona të drejtësisë. Nuk mund të përparojë demokracia kur humbet besimi dhe respekti te institucionet dhe njerëzit që qëndrojnë pas partive tona politike, shpeshherë duke paguar edhe një çmim të lartë. Ky mosbesim është përçmues e fyes ndaj tyre dhe e ndan opozitën e partitë politike nga elektorati e baza e vet. Duhet të gjejmë forcë brenda vetes për t'i kapërcyer situata të tilla.

Ju të gjithë thoni se keni ardhur për zgjidhje, por keni mbetur tek ultimatumi i kutisë. Në vend të rrugëzgjdhjeve po lexojmë vetëm retorika, sepse, në fakt, nuk është e nevojshme të hapim kutitë për të provuar akuzat që ju rendisni, që nga administrata, fondet publike etj. Kur jeni të gatshëm të bëni denoncim në prokurori për inflacionin dhe për ata që e fshehin atë, sinjerisht nuk e kuptoj se si nuk mund t'i dërgoni atje edhe hajdutët e votave. Të gjithë me radhë po thoni se zoti Berisha është përgjegjës për këtë situatë, por, që në hyrje të fjalës së vet Kryeministri e shprehu vullnetin e mirë të maxhorancës për kompromis. Fajësoni të tjerët, por vetë besoni se populli nuk e kupton këtë mënyrë bizantine të fajësimit të të tjerëve dhe nuk kuptoni se jeni 50% bashkëfajtorë, për aq sa faje ka vetë procesi zgjedhor, ndërkohë që jeni 100% fajtorë dhe përgjegjës përpara historisë dhe shqiptarëve me qëndrimet që po mbani, duke i rënduar dhe u ngjallur pesimizëm për të ardhmen e tyre. Në 56 diskutime asnjë nuk ofroi rrugëzgjdhje, por vetëm retorika, baltosje, nxirrje dhe nuk u dëgjua asnjë propozim kompromisi. Për hir të së vërtetës, vetëm për fjalimin e zotit Kastriot Islami nuk kam dëgjuar deri tani asnjë lloj reagimi nga diskutantët e PS-së. Që nga

Gërdeci, Kalimashi, Nënshkodra, korrupsionet qeveritare e deri te Ferri i Dantes, që u përmend tani, të gjitha retorikat nuk mendoj se sjellin ndonjë kontribut dhe japin rrugëzgjdhje për këtë situatë. 56 diskutimet duket se janë vetëm për të na thënë fjalën e fundit përpara se të filloni protestën.

Kolegë deputetë,

Shumicat elektorale maten me zgjedhje dhe jo nëpër sheshe e mitingje. Vendi ka nevojë për pjekuri demokratike dhe është detyra jonë për t'i shërbyer.

Falemnderit!

(Ndërkohë, drejtimin e seancës e ka marrë zoti Nasip Naço.)

Nasip Naço – Falemnderit, zoti Xhepa!

Fjalën e ka zoti Qefalia.

Xhemal Qefalia – I nderuar zoti drejtues i seancës,

Si deputet i ri, do të doja ta filloja disi ndryshe diskutimin. Ju kishit kaq kohë që thoshit vazhdimisht se e donit opozitën në Parlament. Ku jeni zotërinj qeveritarë, që gërthisini dhe bërtisni me të madhe që opozita duhet të vijë sa më parë në Parlament? E shikoj se sa shumë e doni! Keni kaq kohë që bërtisni me të madhe duke thënë se mungesa e opozitës ka sjellë mungesën e shumë reformave. Jam këtu për t'ju thënë se kemi më shumë se gjashtë muaj dhe do të jemi gjatë gjithë kohës pranë njerëzve të thjeshtë, pranë hallevë të popullit dhe pranë shqetësimeve që ata kanë.

Ne bindëm këto 6 muaj edhe më skeptikun, madje dhe vetë zotin Berisha, i cili, pas kaq kohësh, arriti të pranojë me kokën ulur përpara kombëtarëve se Shqipëria ka krizë. Ne bindëm atë dhe ndërkombëtarët që votat u vodhën përsëri. Ndërsa herët e tjera ju i keni vjedhur votat duke kërcënuar rojet, këtë radhë i vodhët duke i blerë ata. Këtë herë nuk mjaftoi njëri nga ata, pra rojet, apo as edhe një tjetër që, me anën e komisionerëve të lartë, të kishte mundësi t'i hapte kutitë në tavolinën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke bërë pazarin e pavlerë, sepse ju kishit blerë shefat e rojeve, madje në fund kanosët dhe ato që ishin shpresa e fundit, që shteti, në fund të fundit, të mbetej në lartësinë e të qenit në shumicë. Ushtruat trysni mbi Kolegjin Zgjedhor, i cili tha se të blerët nuk u ankuan dhe ne nuk kemi pse t'i hapim kutitë.

Ju, zotërinj, përmendi Ruzhdien si pengun që gjoja e drejta ua mori dhe si të bindur ndaj kësaj të drejte nuk reaguat, por e pranuat verdiktin e saj. Ruzhdia tregoi më së miri se mekanizmi i fitores suaj ishte presioni, falsifikimi masiv dhe rezultati

olimpik, natyrisht, fiktiv. Të gjitha këto, të përmbledhura, tregojnë se mekanizmi kriminal vazhdon të pjellë përsëri krim. Jeni investuar shumë herë me njerëz të cilët i konsideroni dhe i mbani si zare. Natyrisht, ai është një investim që ju jep sigurinë në babëzinë për të vjedhur votën e shqiptarëve. Në të vërtetë, zotërinj deputetë, ata ju mbajnë ju dhe jo ju ata. Ata vjedhin për ju dhe më pas krijojnë mundësinë të vjedhin edhe për vete. Ajo çka ndodh në këtë vend ju takon juve, zotërinj deputetë të PD-së, sepse, po t'ju thosha "shumica", do të gënjeshta. Mekanizmi juaj frymëzoi aq shumë zbatuesit, sa që gjërat ju dolën jashtë kontrollit, madje edhe përtej dëshirave tuaja. Ju nuk e dëshironit kurrë një rezultat 300 me 0 në Shkodër; ju nuk e dëshironit kurrë një rezultat 760 me 80 në Kamzë; ju nuk do t'i fshinit kurrë ato vota në Paskuqan, por militantët tuaj nuk ju kuptuan mirë këtë radhë. Ata nuk i bënë mirë llogaritë, ndaj edhe ju demaskuan. Kur thoni: "Nuk hapen kutitë", i habisni të gjithë me zellin tuaj. E personalizoni si veprim, pasi nuk keni besim ta lini në dorën e askujt. Kur thoni: "Kutitë nuk hapen", doni ta dëgjojnë të gjithë, nga njerëzit e thjeshtë, vullnetin e të cilëve ju e keni vjedhur, deri në gjykatat e faktorët ndërkombëtarë, të cilët nuk arrijnë ta perceptojnë këtë pengesë. Fjalja juaj: "Opozita, me hapjen e kutive, bën një kërkesë ogurzezë", tregon të vërtetën, sepse ju e dini më mirë se kushdo tjetër se çfarë ka brenda atyre kutive. Nëse kjo e vërtetë merret vesh, për ju është vërtet ogurzezë. Aty tregohet se ju jeni një pakicë që keni manipuluar kudo me listat e votuesve, me numrat e kartave të identitetit, me numrin e fletëve të votimit. Në shumë qendra, kryesisht rurale, është i stërmadh falsifikimi juaj, në raport me njerëzit që ishin për të votuar realisht. Aty tregohet më së miri se sa shumë ju duan atje ku nuk ka njerëz, sepse atje votohet me shumicë, me vota të hedhura nga dy-tri duar, që deri tani numërojnë para tenderësh, të cilat ua jepni si shpërblim për përfaqësimin popullor që bënë në favorin tuaj. Keni 18 vjet që bëni këtë punë, zotëri. Mendoj se, tashmë, kjo gjë duhet të marrë fund. Ky fund nuk është kaq sa ju duket juve. Nuk ka ndonjë ndryshim të madh, matematikë shifrash, ku ju të keni pak më pak dhe ne të kemi pak më shumë se ju, por ka një përmbysje mendësie. Keni 18 vjet që ua keni hequr të drejtën njerëzve të shpresojnë dhe të ndryshojnë këtë vend. Ata duan të kthejnë shpresën, si një mundësi që duhet kapur. Shqiptarët këtë gjë e panë mirë te populli amerikan, të cilët

thënë: "Po, ne mundemi". Ne besojmë se edhe populli ynë mundet. Shqiptarët nuk duan një ministër të cilin shteti i tyre e merr si të pandehur, si fajtor për përvetësim fondesh. Ju i vidhni votat dhe e vendosni aty ku njerëzit nuk e duan. Ata nuk e duan gjyqtarin që e jep apo shet të drejtën në vendin e tij. Ata nuk e duan ministrin i cili një herë ju thotë qytetarëve se do t'ua falë librat, pastaj del që librat janë shitur dhe se do t'ua falë më vonë. Një herë e dyfishoni në mënyrë fiktive pagën e mësuesve, pastaj e përgjysmoni realisht. Ju vidhni votat dhe vendosni për karshillëk ndaj atyre. Ata nuk e duan as INSTAT-in tuaj, që gënjen tmerrësisht, por ju u vodhët votat dhe ata janë të detyruar të dëgjojnë broçkullat tuaja, që i dëgjojnë vetëm bashkëtokësorët e tyre në Bjellorusi, me një ndryshim që Kryeministri ynë flet shqip, kurse ai bjellorus rusisht. Si përfaqësues i rrethit të Tiranës, ndiej detyrimin që, më e pakta, të falënderoj ata mijëra e mijëra banorë të zonave të cilët mposhtën dhunën shtetërore dhe votuan alternativën e PS-së. Ndiej keqardhje si deputet, por edhe si prind, që disa drejtues të pushtetit lokal dhe qendror arritën deri atje sa t'u heqin edhe ndihmën ekonomike, sa që fëmijët e tyre të mbeten edhe pa të. Unë jam këtu për t'ju thënë juve dhe deputetëve të Partisë Demokratike se të varfër janë edhe ata që votuan për ju. Dëshpërimi më i madh për ta është se atyre u ka humbur shpresa për të parë dritë në tunelin ku është futur Shqipëria, i cili po shembet dita-ditës, por kësaj radhe nuk do të humbasin miliona euro si në Kalimash, por ëndrrën europiane.

Kryeministri ynë i nderuar flet vazhdimisht për rritje dyshifrore, ndërkohë që rritje dyshifrore ka vetëm numri i atyre që braktisin familjet, braktisin të afërmit, gratë, fëmijët, por mbi të gjitha jetën, të dorëzuar nga varfëria. Ju sot duhet të ndiheni të turpëruar, sepse ka njerëz që vetëvaren në oborre, që vetëhelmojnë dhe që janë kambana për të gjithë ne për të na kujtuar se ku po jetojmë. Por mos harroni, të nderuar deputetë, që shqiptarëve, të cilëve ju më 28 qershor me Çiljetat, u thatë se Shqipëria po ndryshon. Në fakt, vërtet Shqipëria po ndryshon, por po ndryshon në disa elemente gjeografike. Për shembull, në Gërdec ishte një kodër, të cilën ju e bëtë gropë; Shkodrën e kthyet në Venecie; hartën e Shqipërisë donit ta ndryshonit dhe ta ktheni gjirin e Sarandës si Shën-Naumi.

Të nderuar deputetë,

Sot do të ishte dita, e cila do të shënonte fillimin e një epoke të re në politikën shqiptare, epokën e

kompromisit. Ashtu siç treguam edhe ne në vitin 2008, ku mbi interesin partiak vumë interesin e popullit, duke bërë që Shqipëria të pranohet në NATO, sot jemi në këtë sallë për t'i treguar popullit që përfaqësojmë se përpara interesit personal apo partiak, duhet të vëmë interesat e tyre. Sot jemi këtu për t'i treguar njëri-tjetrit, që edhe pse mendojmë ndryshe politikisht, nuk duhet të mendojmë ndryshe për Shqipërinë europiane. Ne kërkojmë njëherë e mirë që të vendosim rregullat e lojës që njerëzit të votojnë të lirë me besimin që vota e tyre të administrohet dhe të lexohet drejt dhe ju të hiqni dorë nga Ponet dhe AI Kaponet që populli t'ju votojë dhe ju të rriini mbi kalë.

Nasip Naço – Falemnderit, zoti Qefalia!

Xhemal Qefalia – Edhe një sekondë. Ju keni frikë nga fuqia e botës, prandaj e mbani të mbyllur. Ju e dini që e struktur në errësirë nuk ka fuqi, por ne e kemi për mision t'i japim asaj fuqinë që i ka dhënë sovranit, përndryshe...

Nasip Naço – Falemnderit, zoti Qefalia!

Fjalën e ka zoti Kadilli.

Fatbardh Kadilli – I nderuar zoti drejtues i seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe pse deputetët socialistë erdhën në Kuvend në limitet kohore të skadimit të mandatit të tyre, pasi kishin konsumuar për muaj me radhë politikë jashtinstitucionale, pasi kishin konsumuar për muaj me radhë retorikë mediatike, pasi ishin përballur me certifikimin e zgjedhjeve nga ndërkombëtarët, si zgjedhjet më të mira të realizuara në këtë vend, pasi ishin përballur me kërkesat sistematike për të ndjekur hetimin e zgjedhjeve në rrugë kushtetuese dhe ligjore u paraqitën me dy nisma, të cilat reflektojnë pa asnjë ndryshim të njëjtin pozicion që Partia Socialiste dhe kryetari i saj shpalli ditën kur kuptoi se kishte humbur zgjedhjet.

Strategjia e krizës, bojkoti, forca e ngatërrestarit.

Në mënyrë sistematike, maxhoranca ka ofruar të gjitha mundësitë për të hetuar brenda kornizës ligjore. Maxhoranca tregoi gatishmëri maksimale ndaj të gjitha rekomandimeve të ndërkombëtarëve, edhe atyre të OSBE-ODIHR-it, për të hetuar, duke pranuar që interpretimi i qëndrimeve të ndryshme të bëhej nga arbitri ndërkombëtar, nga Komisioni i Venecias.

Por ne e kemi bërë të qartë se nuk mund të kryejmë kurrë dhe të marrim përsipër rolin e institucioneve të tjera kushtetuese, nuk mund të kryejmë dhe të marrim përsipër detyra që i takojnë

prokurorisë; nuk mund të zhbëjmë vendimet e gjykatave; nuk mund të marrim përsipër dhe të ribëjmë një proces që u realizua nga një armatë e tërë njerëzish, procesin zgjedhor; ne nuk mund të marrim përsipër të kryejmë funksionet e KLSH-së apo të çdo institucioni tjetër të këtij shteti.

Bujarisht *shumica* ofroi shumicën në komision për të eliminuar çdo frikë dhe pasiguri në komisionin hetimor për menaxhimin e procesit të hetimit parlamentar. Në fjalimet e disa kolegëve deputetë të majtë, të cilët dëshirojnë të identifikohen me ekspertin e ekonomisë, dëgjova parashikime, gati përgjyruese, për një krizë ekonomike. Duke qenë se provokimi i krizës politike po i shteron mundësitë e veta, dëshira për një krizë ekonomike mbetet shpresa e vetme e Partisë Socialiste sot.

Kriza është kthyer në pasionin tuaj dhe për t'ju perifrastuar një poet avangardist, që e lidh me ju vetëm pasioni dhe iluzioni për revolucionin, do t'ju thosha: "Krizë, krizë, – lusni ju sot, siç lusin kristianët – bukën e përditshme epna Zot."

Kjo tregon qartë që opozita nuk po kërkon marrëveshje, bashkëpunim ose kompromis, por thjesht imponim. Duke parë këtë pozicion ekstrem dhe imponues, shpreh bindjen time se nuk ka mbetur hapësirë për një akt që të reflektojë një marrëveshje dypalëshe të ngritur mbi besimin, mbi mirëkuptimin, një marrëveshje dypalëshe që të ketë sadopak përfitim publik. Opozita nuk mund të fshehtë qëllimin e vërtetë: provokimin e krizës. Nuk mund ta fshehtë këtë qëllim as pas kërkesës për transparencë për zgjedhjet që shkuan. Kryetari i opozitës nuk mund të fshehtë krizat e tij të brendshme të personalitetit dhe ato politike, duke marrë rolin e misionarit për zgjedhje dhe transparencë. Ne e kemi kryer ushtrimin e zgjedhjeve dhe të transparencës, ku secila palë angazhoi njerëzit më të besuar, rreth 20 mijë demokratë dhe rreth 20 mijë socialistë administruan procesin në çdo qendër votimi, në çdo pikë numërimi, shtojmë këtu edhe mijëra vëzhgues. Të dy palët dhanë maksimumin e tyre dhe realizuan zgjedhjet më të mira të njohura ndonjëherë në këtë vend. Për suksesin dhe për mangësitë e zgjedhjeve, të dy palët janë njëloj me meritë dhe me përgjegjësi. Sistemi dypalësh dhe marrëveshja midis PD-së e PS-së dhanë maksimumin e vet, votat u numëruan publikisht, u projektuan publikisht, u panë nga mijëra sy dhe u filmuan, ushtrim *excellent* transparence. Nuk di se ç'mbetet më tepër.

Opozita kërkon një marrëveshje të re për të bërë edhe një herë të njëjtin punë, të njëjtin ushtrim.

Nuk ka asnjë provë që të kërkojë pse dhe ku numërimi nuk qe transparent, nuk ka asnjë provë apo dyshim të arsyeshëm që të na thotë se ku dështuan përfaqësuesit e tyre dhe tanët, nuk mund të paraqesë asnjë provë, as në gjyq dhe as në gjyqin e zgjatur publik që po zhvillohet prej muajsh. Kutia e fshatit Ruzhdie është prova më e mirë që kur gjërat nuk u bënë sipas marrëveshjes dhe ligjit, kur palët dështuan, rezultati nuk u pranua, nuk u mor parasysh dhe nuk u përfshi në numërim. Kjo kuti nuk u mor parasysh.

Kjo është prova se sistemi ndaloi çdo shkelje dhe parandaloi çdo deformim. Nuk ka asnjë dyshim të arsyeshëm. I gjithë sulmi për zgjedhjet dhe transparencën bazohet në akuzën që pala socialiste i bën përfaqësuesve të vet, i akuzon se i kanë shitur zgjedhjet. Secila palë angazhoi rreth 20 përfaqësues në komisione, në numërim dhe vëzhgim, gati gjysmën e anëtarësisë aktive të secilës palë.

Unë nuk i kam dashur, nuk më janë dhimbsur ndonjëherë socialistët dhe nuk kam ndonjë detyrim për ta, pasi i përkas një krahu krejt tjetër, por nuk kam guxuar kurrë t'i fajësoj për atë që po i fajëson sot kryetari i tyre dhe kori që e shoqëron. Mbi këtë akuzë është ngritur i gjithë sulmi politik për zgjedhjet dhe besueshmërinë e institucionit të zgjedhjeve.

Para katër vjetësh ish-ministri juaj i Brendshëm habiti botën me një akuzë qesharake, se policët e tij i kishin vjedhur zgjedhjet, personalisht e kam gjykuar si goditje psikologjike e një politikani të ri, që karrierën politike e ka marrë lehtë, por është e pabesueshme se si sot kryetari i Partisë Socialiste akuzon se i kanë vjedhur votën socialistët e tij, anëtarësia e tij, gjysma e anëtarësisë që e voton për kryetar. Ngjashmëria midis ish-ministrit dhe kryetarit është madhe, por dëmi i kryetarit është shumë më i madh, pasi kryetari i jep linjën, i përcakton qëndrimin dhe fjalimet partisë së tij.

Përfundimisht, unë nuk mendoj se ka nevojë të merremi vesh me socialistët, në mënyrë që kryetari i tyre të mos akuzojë më gjysmën e partisë së tij. Unë nuk mendoj se ka nevojë as për këtë marrëveshje dhe as për të joshur socialistët që të qëndrojnë në Parlament. Socialistët e dinë mirë se rruga europiane e të bërit politikë është në Parlament. Socialistët e dinë mirë që dalja nga Parlamenti dëmton Shqipërinë dhe për këtë janë përgjegjës anëtarësia, deputetët dhe ata që i votojnë. Është zgjedhja e tyre dhe përgjegjësia e tyre se si do ta ndjekin misionin e opozitës. Në fund të fundit, edhe rruga është një mjet demokratik,

po aq sa edhe salla.

Maxhoranca nuk ka pse të futet në kompleksin e të zotit të shtëpisë që shqetësohet në sy të miqve, se një pjesëtar i familjes, qoftë ky edhe adoleshent, krijon trazira. Ne kemi mandatin të qeverisim, opozita ka mandatin të kontribuojë me kritikë, me kundërshti, me alternativë. Është vendimi i saj dhe përgjegjësi e saj të zgjedhë ta kryejë këtë mision në rrugë, në sallë, në Parlament apo edhe në konferenca shtypi.

Në seancën që filloi dje e kishit një gjetje, përsërisnit këngën e kryetarit në 50 interpretime të reja.

Falemnderit!

Nasip Naço – Falemnderit, zoti Kadilli!

Fjalën e ka zoti Beci.

Astrit Beci – I nderuar zoti drejtues i seancës, Të nderuar kolegë,

Në periudhën parazgjedhore maj-qershor 2009 në Shkodër unë i premtova elektoratit tim që në çdo moment do të luftoj për lirinë e votës, lirinë e fjalës dhe shenjtërinë e pronës. Në konceptin tim kjo ka të bëjë me ndërtimin dhe funksionimin e shteti ligjor, bazuar në votën e lirë. Megjithëse kaluan 20 vjet tranzicion, ende ndihet organike nevoja e një demokracie të vërtetë për të gjithë shqiptarët, demokraci e cila fillon me votën e lirë dhe të drejtën e vendimmarrjes nëpërmjet kësaj vote në qeverisje.

Te mosrespektimi i votës së lirë duhet kërkuar shkaku i krizës politike, ashtu siç duhet kërkuar te mosrealizimet, korrupsioni dhe mendjemadhësia për të parë të vërtetën në sy, shkaku i krizës ekonomike.

Në fushatën time elektorale unë u kërkova komisionerëve tanë korrektesë dhe elektoratit i premtova ruajtjen e votës, por përballë korrektesës dhe seriozitetit që treguam së bashku me stafin, u ballafaquam me ndodhi nga më të çuditshmet që mund të ndodhin vetëm te ne.

Do të doja të ndalesha te një fakt, vetëm në listat parazgjedhore. Nga 90 mijë votuesit e Shkodrës, 6 mijë prej tyre ishin spostuar nga listat paraprake në ato definitive, e megjithatë të mrekullueshmit qytetarë shkodranë treguan klasin e tyre gjatë procesit të votimit.

Sa u respektua qytetaria e tyre në këtë proces? 72 orë proces numërimi, 72 orë stres në kërkesë të ruajtjes së votës. Përballë vullnetarëve tanë qëndronin drejtues, shefa dhe punonjës të administratës shtetërore, shumë prej tyre të specializuar në manipulimin e votës.

Evidencat tona tregojnë më së miri manipulimin

e këtyre zgjedhjeve. Në retrospektivë të bënë përshtypje që shumë prej drejtuesve të procesit të numërimit dhe të numëruesve u shpërblyen me poste në administratën shtetërore.

Edhe Shkodra ka pasur Ruzhdiet e saj, ashtu siç ka pasur Ruzhdiet e saj Malësia e Madhe, zona e Vig-Mnelës dhe zona e Nënshkodrës, ndaj kemi të drejtën e Zotit të kërkojmë transparencë, tashmë jo për pushtet, por për dinjitet. Duke bërë transparencë, do të njohim problemet e do të marrim masa që manipulimet dhe deformimet e vullnetit të mos ndodhin më. Ju siguroj se momenti është për t'u vlerësuar, dhe kjo do të zgjidhte jo vetëm krizën politike, por edhe atë ekonomike.

Transparenca është çelësi për ecjen para me reformat për ekonominë, për rendin, për shtetin ligjor. Transparenca, sado e hidhur për ndokënd, do të na bëjë më krenarë, më demokratë dhe më patriotë. Kjo transparencë sa më e plotë të jetë aq më shumë do të na japë dinjitet, pasi ne e kemi paguar transparencën jo transparente. E kemi paguar transparencën jo transparente me Gërdecin, me Kalimashin, me moszbardhjen e vrasjes së deputetit tonë, të ndjerit Fatmir Xhindi, me kriminalitetin e shtuar, varfërinë e papunësinë, me moszbardhjen e sa e sa krimeve, si ajo e Remzi Hoxhës etj. Këtë mostransparencë ne e paguam edhe me përmbytjet e Shkodrës. Mosvendosja e drejtësisë për sa më sipër është kriza e sotme. Transparenca që kërkojmë do të vendosë drejtësi në zgjedhjet që do të vijin. Do të mundësojë dënimin e shkelësve të ligjit dhe do të mundësojë krijimin e bazave të një demokracie të vërtetë të shtetit ligjor të së drejtës.

Të nderuar deputetë, bëhuni pjesë e kësaj transparence që ne kërkojmë! Mos shkelni të drejtat tona kushtetuese, bazuar në nenin 77 pika 2 e Kushtetutës!

Zoti Berisha, mos i bëni 19 shkeljet e Kushtetutës, pasi ne jemi të bindur ta çojmë deri në fund aksionin tonë politik në mbrojtje ligjore të votës së lirë. Mos harroni se beteja jonë është betejë për demokracinë. Ne e kemi treguar vullnetin dhe angazhimin tonë për zgjidhjen e problemit. Është radha juaj, kolegë të Partisë Demokratike, për të treguar që jeni edhe ju për zgjidhjen e problemit, që jeni edhe ju për stabilitet politik, pasi kjo do t'i shërbente ardhmërisë së Shqipërisë. Nuk ka pse shqiptarët të mbajnë kosto të pamerituar. Prandaj ju ftoj që të gjithë së bashku të përpiqemi të bëjmë që në Shqipëri të lulëzojë demokracia e vërtetë dhe të tregojmë se jemi dinjitozë në përpjekjet tona të

integritit, po aq sa edhe europianët e tjerë.

Falemnderit!

(Ndërkohë, drejtimin e seancës e ka marrë zoti Ardian Turku.)

Ardian Turku – Falemnderit, zoti Beci!

Fjalën e ka zoti Boçi.

Luçiano Boçi – I nderuar zoti drejtues i seancës,

Të nderuar deputetë,

Në fakt, dje dhe sot, ne jemi duke bërë kronikën e një qëndrimi të paralajmëruar majtist, pasi askush nga ne të djathtët dhe bashkë me ne shumica e shqiptarëve nuk kishte asnjë dyshim se këtu në këtë sallë do të mund të na ndodhte një telenovelë, në fund të së cilës ata që përgjatë shumë serive jashtë kësaj salle kishin thurur intrigat, para së cilave edhe vetë Jago dhe Ledi Makbeth do të ndjeheshin fillestarë, do të përqafoheshin me ne fitimtarët, në emër të asaj që ne thjesht e kemi quajtur e mira e këtij vendi.

Ajo që na u servir gjatë këtyre ditëve dhe sot nga ju është një farsë e re, por me të njëjtën melodi të vjetër, të cilën kemi kohë që e dëgjojmë nga maestrot e prapaskenave që vijojnë të na i paraqesin idetë e tyre bajate si vlera shpirtërore dhe universale dhe flasin për zgjedhje dhe karta false kur janë vetë simbole të falsitetit.

Është e habitshme, por edhe tejet qesharake të dëgjosh sot krijuesit dhe zbatuesit e skenarëve më kobzinj për këtë vend të ulërijnë dhe të thërrasin për drejtësi, për ligj dhe respekt, kur ne e dimë shumë mirë se ata janë krijuesit e Dushqeve dhe Ruzhdieve. Në këtë rast, meqenëse jam edhe i gjuhës, ka ndryshuar vetëm gjinia, ka kaluar nga mashkullore Dushk në femërore Ruzhdie, rezultante e së cilës është pikërisht kjo politikë e majtë "e re", hermafrodite, dhe si e tillë, ajo është pa funksion, pa vlerë dhe pa të ardhme. E vetmja shenjë dalluese e kësaj politike është misioni për të penguar progresin e këtij vendi nëpërmjet metodave dhe ideologjive që bien ndesh jo vetëm me parimet dhe vlerat e patjetërsueshme morale tonat, por edhe me parimet e funksionimit të demokracisë liberale.

Ajo që kemi parë gjatë këtyre ditëve nga nukli majtist i ngarkuar për të çuar deri në fund detyrën e partisë i ngjan fabulës së hënës, e cila nuk mund të kishte fustan, pasi çdo herë që shkonte te rrobaqepësi paraqitej me një formë të re, të ndryshme, sigurisht pa lëvizur thelbin e saj si hënë. Ajo që ka ndryshuar pikërisht te ju është vetëm forma e paraqitjes, pavarësisht si ia keni vënë emrin, herë

e keni quajtur miting, herë e keni quajtur protestë, apo herë komision dhe ligj hetimor. Ndërsa thelbi është po ai dhe synon thjesht dëmtimin e imazhit të shumëkërkuar të këtij vendi dhe shkatërrimin e atyre vlerave të ndërtaura me mund dhe djersë në sajë të kontributit të të gjithë shqiptarëve.

Të nderuar deputetë të majtë,

Ka ardhur koha të marrim përgjegjësitë që na takojnë për të përbushur atë mision që sovranin na e ka besuar. Të mos harrojmë për asnjë moment se ajo që na ka sjellë në këtë sallë nuk është dëshira e disave që ne të dublojmë institucionet e pavarura të këtij shteti, as të bëhemi prokurorë të prokurorëve apo gjykatës të gjykatësve, por është pikërisht kërkesa për të bashkuar shqiptarët, sepse sot më shumë se kurrë ata hajnisht po përçahen nga një lider socialist, nga Edi Rama, humbësi më i madh i shqiptarëve, sepse më shumë se kurrë ata sot kanë nevojë për njëri-tjetrin, sepse më shumë se kurrë ne duam të jemi më të fortë për të përballuar sfidat e kohës. Është kërkesa për të respektuar fjalën e dhënë dhe për të mbajtur premtimet, sepse ato më shumë se kurrë ndjehen të tradhuara nga një pjesë e opozitës, që po mundohet të minojë aspiratat e lashta dhe të sotme të këtij kombi. Është kërkesa për më shumë moral, sepse, si kurrë më parë, kriza e këtyre vlerave na është veshur me pushtet politik majtist dhe na bën karshillëk, sepse, si kurrë më parë, nevoja për t'i riparuar këto ka arritur pikën kritike dhe kjo pikë kritike është çmenduri, ku shkon deri në sulm të hapur ndaj komisionerëve, të cilët u janë bindur edhe kur i keni urdhëruar të largohen. Është kërkesa për tolerancë dhe komunikim, sepse, si kurrë më parë, intoleranca dhe sektarizmi nuk kanë qenë kaq shumë të shprehura nga krahu ekstrem i majtë dhe kaq shkatërruese; si kurrë më parë nuk ka qenë e nevojshme që të gjitha gratë dhe të gjithë burrat e këtij vendi me vullnet të pastër dhe të lirë të përdornin talentin, inteligjencën dhe idetë e tyre për të imagjinuar dhe ndërtuar të ardhmen dhe jo të ecim në rrugën pa krye të një lideri të pakrye të tipit Arturo Ui. Është kërkesa për siguri dhe mbrojtje, sepse si kurrë më parë nuk ka qenë kaq e nevojshme për të luftuar kundër frikës për të ardhmen europiane, që po minohet me kujdes nga ata që arrijnë e këtij objekti e konsiderojnë si fundin e ekzistencës politike personale dhe për të luftuar kundër idesë së pritjes së Godosë revolucionare është kërkesa për rregull dhe autoritet, sepse shpesh, sikurse sot, ne gjendemi përpara tentativave dëshpëruese për kaos dhe dhunë.

Ajo që na ka sjellë këtu, të nderuar deputetë të majtë, është kërkesa për më shumë drejtësi dhe transparencë, sepse dikushi, që për ne është askushi, nëpërmjet politikave personale, kërkon të venerojë krimin, kërkon të kundërshtojë ligjet antimafia të këtij shteti, kërkon të instalojë diktaturën ekonomike ndërtuese me origjinin korruptive dhe kërkon të çorientojë e manipulojë opinionin publik. Është kërkesa për t'u ndarë me vendosmëri nga e shkuara, e cila me hijet dhe fantazmat e saj kërkon të rikthejë perandorinë e shtypjes sociale dhe asaj shpirtërore, për të hedhur tej pluhurin që dosjet e pahapura shpërndajnë në atmosferën e brishtë të politikës shqiptare, për t'u ndarë me zakonet e ndryshkura të të menduarit dhe konformizmit intelektual, sepse si asnjëherë problemet që kemi përpara kërkojnë përgjegjësi dhe vullnet politik.

Të nderuar kolegë, kur kemi ardhur në këtë sallë kemi bërë të gjithë një betim të thjeshtë, por solemn, prandaj ju ftoj ta respektojmë atë. Të respektojmë, siç thotë ai betim, Kushtetutën dhe ligjin, për t'i shërbyer mirëqenies dhe progresit të këtij vendi dhe jo t'i shkelim, siç keni kërkuar të bëni ju. Duke vazhduar në këtë refren, unë kam frikë se nga Partia Socialiste ju do të bëheni Partia e Kutive, megjithëse në këtë rast shkurtimi PK ju shkon më shumë sesa PS.

Falemnderit!

(Ndërkohë, drejtimin e seancës e ka marrë zoti Nasip Naço.)

Nasip Naço – Falemnderit, zoti Boçi!

Fjalën e ka zoti Leka.

Agim Leka – Të nderuar kolegë deputetë,

Do të dëshiroja që diskutimin e parë në këtë sallë të nderuar të mos e filloja me fjalët "kuti votimi dhe transparencë të zgjedhjeve", por sjellja politike e maxhorancës sonë dhe veçanërisht e Kryeministrit pas 28 qershorit ma imponoi edhe këtë gjë. E pra që në nisje po shtroj pyetjen: pse ka frikë maxhoranca jonë dhe Kryeministri i saj nga hapja e kutive të votimit?

Kjo pyetje e ka përgjigjen pikërisht në kutitë e votimit. Është njëlloj sikur vjedhësi të ketë frikë të tregojë xhepin e tij. Masakra votuese e fshatit Ruzhdie të Fierit, nuk ka ndodhur vetëm atje. Fenomeni i Ruzhdies është njëjtë në shumicën e qendrave të votimit të Qarkut të Elbasanit.

Kutitë e materialeve të votimit, kutitë e fletëve të votimit të Qarkut Elbasan, në shumicën e tyre, kanë brenda listat e dubluara të zgjedhësve, kanë brenda fletët e votimit me të gjitha kundërfletët, kanë

brenda fletët e pavlefshme të votimit, të cilat prodhoheshin në sy të koordinatorëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe numri i tyre shtohet proporcionalisht pikërisht në ato qendra votimi, ku Partia Socialiste, duke u numëruar, dilte fituese. Kutitë kanë brenda një numër të madh votuesish, të cilëve nuk ua regjistronin as numrin e kartës të identitetit, as numrin e pasaportës së tyre. Në shumicën e qendrave të votimit të fshatrave të Qarkut të Elbasanit është votuar rresht nga një njeri për një familje, nga një njeri për fis, dhe për të gjithë emigrantët nga një njeri. Firmat janë dallueshëm të hedhura nga komisionerët e PD-së ose nga njerëz të caktuar. Në ato kuti votimi ishin premtimet e kryetarëve të komunave drejtorëve rajonalë për vende pune.

Ja pse duhet të hapen kutitë e votimit. Kutitë duhet të hapen që zgjedhësve shqiptarë t'u kthehet sovraniteti i tyre. Kutitë duhet të hapen që Qeveria ta ketë frikë zgjedhësin shqiptar. Kutitë duhet të hapen që Kryeministri të mos vijë në Parlamentin e Shqipërisë dhe të flasë në atë lloj mënyre. Kutitë duhen të hapen, sepse opozita është në të drejtën e vet. Ne po kërkojmë hapjen e kutive, po kërkojmë transparencën e zgjedhjeve dhe këtë gjë nuk e duam si një dhuratë që mund të na e japë pozita, Kryeministri ose Kryetarja e Parlamentit. Kjo është një e drejtë e pakontestueshme e çdo demokracie në çdo vend normal europian.

Çdo veprim që reflektohet në këtë sallë të Parlamentit nga ana e maxhorancës bie krejtësisht ndesh me alternativën e Partisë Socialiste. Nuk e kemi kërkuar ne bojkotin, por na e imponuat ju, zotërinj të maxhorancës, me sjelljen tuaj për të penguar në mënyrë absurde hapjen e kutive të votimit, të cilat ne kërkojmë t'i hapim jo për të ndryshuar karriget e qeveritarëve, jo për të ardhur në pushtet nëpërmjet numërimit dhe rinumërimit të votave, megjithëse kjo gjë nuk është ndonjë habi e jashtëzakonshme, por për të respektuar vendimin e gjykatave, të KQZ-së dhe nuk e bëjmë një veprim të tillë, sikundër thuhet në disa media të paguara nga maxhoranca qeveritare.

Ky do të ishte një gabim i pafalshëm nga ana e maxhorancës. Në qoftë se sot nuk bëhet një marrëveshje për t'u realizuar hapja e të gjitha kutive të votimit pa asnjë lloj dallimi që aty të shikojmë të vërtetën që ka ndodhur, kjo do të thotë që ju nuk e keni pasur dhe nuk e keni dëshirën e mirë që opozita shqiptare të kthehet në Parlament.

Ne e bëmë pikërisht për këtë arsye. Ne e kemi

vendin këtu në Parlament dhe në qoftë se këtu do të arrihet një marrëveshje e tillë, ne do të vazhdojmë punën tonë në Parlament, por në qoftë se nuk arrihet një marrëveshje e tillë, atëherë opozita e ka vendin bashkë me popullin opozitar. Ne nuk mund të largohemi nga kërkesa e vazhdueshme e popullit, i cili që nga 29 qershori që kërkon hapjen e kutive të votimit.

Me këtë rast dua t'i drejtohem edhe Kryeministrit, megjithëse ai nuk është që mbrëmë, por kjo gjë ka ndodhur vazhdimisht, u përsërit edhe nga shumë deputetë të tjerë të maxhorancës. Këtu në këtë sallë u tentua të merren në mbrojtje komisionerët e partisë socialiste. Kjo nuk është e vërtetë, është cinike, është e hidhur. Po ju them se kjo nuk ka asnjë vlerë te komisionerët e Partisë Socialiste, tek anëtarët e partisë socialiste, te militantët dhe votuesit që nuk janë militantë, por janë votues në maxhorancë të Partisë Socialiste. Në qoftë se ju dhimbjen me të vërtetë komisionerët, zotërinj qeveritarë, zotërinj deputetë të maxhorancës, bëni një gjë: ju japim listat që disponojnë për të parë sesi i keni pushuar nga puna. Keni hequr nga puna edhe një roje private, atë dhe bashkëshorten e tij, sepse ai e kishte gruan mësuese. Edhe infermierët i keni hequr nga puna dhe e kanë pësuar, sepse kanë qenë komisionerë të PS-së, ndërsa tani Kryeministri i vendit thotë: "Më dhimbjen komisionerët", kur ata sot janë të papunë.

Nuk ka asnjë vlerë, veç cinizmit, dhe nuk i shërben aspak marrëveshjes sonë që duhet të bëhet në këtë Parlament të nderuar. Thashë "të nderuar", sepse dua t'i bëj një kërkesë tjetër Kryeministrit dhe të gjithë deputetëve të maxhorancës. Ne e dimë se çfarë shkeljesh janë bërë në zgjedhjet e 28 qershorit. E dimë fare mirë se çfarë zgjedhesh janë bërë edhe para zgjedhjeve të kësaj date. E dimë se çfarë shkeljesh janë bërë edhe në pajisjen me karta identiteti të qytetarëve nga kryetarët e komunave të PD-së në qytetin e Elbasanit. Të gjithë ne ishim të mobilizuar që kjo situatë të zgjidhej edhe pse pajisja me karta identiteti ka qenë një punë e stërmunduar, sepse u politizua në maksimum nga Partia Demokratike. Kjo dha reflektim edhe ditën e votimit, ku njerëzit votuan me lista, ku emigrantët votuan pa regjistruar kartën e identitetit dhe numrin e pasaportës në votim. E gjithë kjo bie erë mafie elektorale me njerëz të korruptuar, të cilët shiten nga të gjitha anët.

Këtu në Parlament i kërkoj Kryeministrit të vendit që është koha të kthejë besimin te njëri-tjetri. Të

veprojmë në mënyrë të tillë që ne të besojmë vërtet që ju e keni seriozisht zgjidhjen e krizës politike ku është Parlamenti shqiptar dhe e gjithë politika shqiptare. Dhe duhet pranuar se njerëz të caktuar nuk janë komisionerë të PS-së, këtë mund ta përsëris me mijëra herë, nuk janë militantë të PS-së, nuk janë votues të ndershëm ata, por një grup njerëzish, të cilët nuk kanë as identitet partiak, që janë kthyer në mafie elektorale dhe që Partia Demokratike nuk i ka përdorur vetëm në zgjedhjet e 28 qershorit, por sistematikisht në të gjitha fushatat zgjedhore.

Dallimi i rastit të 28 qershorit ishte sepse ishte një rast më i sofistikuar. I gjithë procesi i lëvizjes së këtij grupi njerëzish, është se shiten nga njëri grup në tjetrin dhe kur nuk blihen, mbeten. Pastaj e gjithë qeverisja është peng e këtyre njerëzve të cilët tani kërkojnë vende pune dhe prandaj e pësojnë të gjithë njerëzit socialistët që pushohen nga puna.

Të nderuar zotërinj të maxhorancës, të nderuar qeveritarë është koha të kthejmë besimin në këtë vend, të kthejmë besimin se edhe këtu mund të votohet, të jetohet, të punohet njëllor si në vendet e tjera fqinje, madje më mirë. Koston e përditshme të moshapjes së kutive do ta paguajmë ne, do e paguajnë të gjithë qytetarët shqiptarë. Shqipëria është në një krizë ekonomike. Qyteti i Elbasnit është një ndër qytetet më të varfra, ku papunësia bën kërdinë. Papunësia ka shifra të mëdha, skandaloze. Nuk është kompetencë e kryetarit të bashkisë të...

Nasip Naço – Falemnderit, zoti Leka!

Agim Leka – Hapni kutitë, sepse kjo është zgjidhja më e ndershme që mund të bëni!

Së dyti, do t'i kërkoja Kryetares së Parlamentit të akuzojë...

Nasip Naço – Falemnderit, zoti Leka, por koha juaj ka mbaruar!

(Debat në sallë.)

Më mirëkuptoni, zoti Leka, pasi janë edhe 35 deputetë të tjerë për të folur.

Fjalën e ka zoti Turku.

Ardian Turku – I nderuar zoti drejtues i seancës,

Të nderuar kolegë, të djathtë dhe të majtë të Parlamentit,

Pas dy ditësh pune, po i quaj të plota, sepse dy ditë nga 8 orë quhen ditë pune të plota, me fjalime kolegësh nga të dy krahët, pothuajse janë ezauruar një mori problemesh me përpjekjet apo rrokjet për t'iu përçasar problemit si teknikisht edhe politikisht, por më së shumti politikisht dhe janë përdorur terma

të shumtë. Edhe unë, si gjithë të tjerët, kisha përgatitur një fjalim që besoj se nuk sjell ndonjë gjë shumë të re nga të tjerët, pasi ka plot njerëz këtu, si edhe unë, që dinë t'i kapin problemet, dhe po përsërisim njëri-tjetrin në mënyrë të vazhdueshme.

Në fakt, ato çka janë thënë gjatë këtyre seancave apo gjatë seancës së djeshme dhe të sotme për Qarkun e Elbasanit, më shtyjnë të marr fjalën, sipas edhe radhës që kam, por ta devijoj diskutimin tim, kryesisht, për Qarkun e Elbasanit.

Së pari, në një rrafsh të përgjithshëm, mendoj që orientimet e deputetëve të krahut të majtë, duke marrë për bazë një lloj postulati që nuk qëndron se zgjedhjet kanë qenë të manipuluar, mbi këtë është ngritur gjithçka dhe vazhdimi i diskutimeve në këtë sens më duket fare i paarsyeshëm, sepse është si një godinë shumëkatëshe që ngrihet pa themele. Opozita ose humbësi nuk mund të përcaktojnë kredibilitetin e zgjedhjeve. Kjo është thënë edhe nga të tjerë më përpara, që ka disa rregulla loja. Është një procedurë e tërë që parashikon e ligji, që zgjedhjet, si në çdo vend tjetër demokratik, të kenë një cikël të mbyllur me të gjitha hapat, në të gjitha instancat, të cilat kur mbërrijnë në fund certifikohen dhe nga ky certifikim nuk lëviz më asnjë gjë.

Shumë folës nga e majta na kanë garantuar në mënyrë të vazhdueshme që të mos kemi frikë, sepse ata nuk kërkojnë pushtetin mbi tavolinë etj. Unë do të doja të përgjigjesha që nuk e kemi pasur këtë frikë asnjëherë dhe as nuk e kemi menduar. Pra, mos na garantoni se nuk do të na e merrni pushtetin, sepse ne e kemi të qartë që nuk e merrni dot pushtetin, jo se e duam ne kaq fort, por sepse të tilla janë rregullat e lojës. Nuk mund të merret pushteti në një vend demokratik dhe anëtar të NATO-s, kur i gjithë procesi që parashikon Kodi Zgjedhor është i mbyllur deri në instancën më të fundit. Nuk mund të merret pushteti kur ka pasur një KQZ dhe një Kolegj Zgjedhor, të cilët, në rolin e një gjykate supreme, kanë shqyrtuar të gjitha çështjet. Nuk mund të rrëzohet një maxhorancë e ardhur në pushtet kur vëzhguesit ndërkombëtarë i kanë certifikuar zgjedhjet plotësisht dhe kanë deklaruar që ato kanë arritur standardet kryesore, por kanë edhe defekte që duhen rregulluar. Nuk mund të rrëzohet një maxhorancë që ka ardhur në pushtet nga zgjedhje të bekuara nga përfaqësuesit e NATO-s. Nuk mund të rrëzohet një maxhorancë, e cila merr bekimin nga Kryetarja e Parlamentit nga Kryeministri, nga Presidenti Obama, nga Presidenti Sarkozy, nga Kancelaria Merkel, nga Berlusconi etj.

Është naive që ne të mendojmë se ju do të na e merrni pushtetin në tavolinë. Nuk e kemi menduar dhe nuk do ta mendojmë kurrë për këto arsye që sapo thashë.

Unë do të doja të isha krenar dhe në maksimumin e mundshëm të mos kishte ndodhur kjo që ka ndodhur për të ulur në mënyrë të padrejtë imazhin e Shqipërisë. Do të doja që opozita të ishte këtu jo duke thënë që prezencën e tyre në Kuvend po e bëjnë si koncesion për ne. Jo zotërinj të opozitës, ju jeni këtu, sepse keni vendin tuaj, nuk e bëni fare koncesion për ne. Nuk ua dhuroam ne këtë vend, por ua kanë dhënë zgjedhësit dhe votuesit tuaj. Ky është vendi juaj, ka qenë vendi juaj dhe duhet të ishit këtu që më 7 shtator. Këto diskutime dhe debate që bëjmë tani, duhet t'i kishim bërë që atëherë. Në të kundërt, kam përshtypjen që koncesionet i kemi bërë ne, sepse ju pranuan dy iniciativa, të cilat nga ana ligjore nuk kishin kuptim, sepse kërkesa për ngritjen e një komisioni hetimor ka afat dhe miratohet në seancën e parë të Parlamentit, pas depozitimit të kërkesës, por jo më shumë se dy javë, dhe ne ua kemi shtyrë. Ndërkohë komisioni hetimor do të ngrihet duke pasur një kokë, si të gjitha vendimet e tjera, mbështetur këtu dhe këtu dhe kërkesa juaj është që do të mbështetet këtu dhe këtu, por jo në ligjin bazë për komisionet hetimore, që është në fuqi, por në atë që ne do të miratojmë. Minimalisht, për atë projektligj duhen edhe 20 ditë, që është afati maksimal për dekretim nga Presidenti, si dhe disa ditë të tjera për të hyrë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare. Ne prapë jua lejuam dhe jemi këtu gati. Ky po që është koncesion. Ju flisni për koncesione të tjera sikur na keni bërë ndere të mëdha, por po them se nuk ka koncesione që mund të na i bëni ju. Unë e shoh në diskutimet e këtyre seancave, që edhe nëse një pulë e bën vezën 7 lekëshe apo 8 lekëshe, me çmimet e Enverit, apo 100 dhe 110 lekëshe me çmimet e sotme, fajin e ka maxhoranca, e ka Kryeministri dhe familja kryeministore. Edhe sot që duhet të diskutojmë teknikisht mbi një draft, ne hapemi në të gjitha problemet që ka në vendi dhe nuk fokusohemi për të rënë dakord për atë që duhet të biem dakord. Edhe përse ambasadori Bosh tha dje: "Mirë që jeni ulur aty, por të gjitha palët duhet të lëshojnë nga vetja", unë shoh që nuk kemi lëshuar asgjë.

Me përcaktimin e rrugës, që e keni fokusuar gjithnjë e më mirë, sepse në fillim keni qenë shumë konfuz, ju keni mbërritur dhe keni ngelur vetëm te

kutitë dhe te kutitë. Ndërkohë, unë dëgjoj interpretime nga të dyja palët, edhe nga juristët e të dyja palëve, të cilët i referohen Kushtetutës dhe vendimeve të tjera, por ne që nuk jemi juristë i kuptojmë në parim këto gjëra, sepse ju që jeni juristë, dhe që pretendoni se jeni të tillë, keni interpretime krejt të kundërta. Është e natyrshme të themi se të dyja palët nuk ndajnë të njëjtat interpretime dhe qëndrime për të njëjtin problem. Atëherë gjithmonë ka një zgjidhje për këtë, nëse e ka humbur forcën për të dhënë mendime dhe për të kryer veprime të mëtejshme niveli i gjyqësorit, pasi Kolegji Zgjedhor i ka dhënë fund, ka një instancë që u përgjigjet të gjitha vendeve demokratike dhe jo vetëm Shqipërisë: Gjykata Kushtetuese. Pra kalojeni në Gjykatën Kushtetuese për t'ia përcjellë Komisionit të Venecias. Po tha Komisioni i Venecias që të hapen kutitë, atëherë le të hapen kutitë, po tha që nuk hapen kutitë, nuk hapen.

Ne nuk kemi frikë nga kutitë. Ne kemi frikë ndaj hapjes së rrugës së shkeljeve të kodit dhe të kuadrit ligjor, si dhe hapjes së rrugës që ne të marrim kompetenca përtej pushtetit legjislativ, kjo është e tëra. Nëse Komisioni i Venecias na e heq këtë frikë, hajdeni t'i hapim kutitë.

Po kthehem pak te Elbasani. Më në fund, pas 7-8 muajsh po dëgjoj që Elbasani na qenka bërë më problematiku. Zoti Agim, po i drejtohem me emër që t'i jap edhe të drejtën e replikës, ka ardhur në Elbasan 14 vjeç nga Mamli, nuk ka rëndësi emri i fshatit, sepse për mua janë të nderuar dhe të respektuar, unë jam rritur fshatrave, duke pasur prindërit mësuës. Nga mosha 14 vjeç e deri më sot ju i keni kaluar të gjitha detyrat partiake, jeni nga punëtorët më të mirë të Partisë Socialiste dhe më në fund ne themi shpyr që erdhët edhe ju pas 45 vjetësh në Parlament. Megjithatë, shoh që nuk keni ndryshuar shumë. Dikur, dikur i kam pëlqyer shumë diskutimet tuaja, para viteve 1990, por shoh që në demokraci i bëni më keq se sa i bëni në diktaturë. Ju lutem shumë, zoti Agim, mos e njollosni Elbasanin, sepse keni një jetë të tërë aty dhe fëmijët e tu janë njësoj si fëmijët e mi.

Një tjetër folës i Qarkut të Elbasanit, jo i qytetit, tha që 6 muaj përpara janë dërguar falangat e policisë për të mbledhur emrat e emigrantëve. Po ju deklaroj se, që kur isha kryetar bashkie, para se të fillonin zgjedhjet lokale, emrat e emigrantëve janë me kodin 999 në fund. Nuk ka nevojë të zbresin forcat e policisë, sepse janë në Bashkinë e Elbasanit, i kanë subjektet politike të gjithë emrat e emigrantëve, me

kodin përkatës, në listat e regjistrimit të popullsisë.

Së dyti (zoti Beqja, unë nuk kam ndërprerë asnjë), nuk ka nevojë fare të nxjerrësh policinë në rrugë, sepse të majtë e të djathtë mund t'i gjejnë në listat e bashkisë, të cilat i kanë subjektet zgjedhore. Të gjithë anëtarët partiakë, qoftë të PD-së, qoftë të PS-së janë fqinjë dhe i dinë mirë se cilët janë emigrantë dhe cilët nuk janë emigrantë. Elbasani është shquar për qytetari, jo vetëm qyteti, por edhe fshatrat. Asnjë lloj incidenti nuk ka ndodhur për shumë e shumë zgjedhje me radhë dhe nuk ka pasur asnjë lloj pretendimi.

Mua më vjen keq, por, me sa po kuptoj, nga diskutimet e djeshme dhe të sotme po ravijëzohet diçka që me sa duket do të dalë më vonë, sepse e keni menduar si strategji. Ju thoni që në disa qendra votimi materialet zgjedhore nuk kanë numrat e pasaportave, të kartave të identitetit etj. Dolët mbrëmë me disa lista, ku nga 400 e ca që kishin votuar, 300 e ca i merre Partia Socialiste dhe 100 e ca Partia Demokratike, por nuk kishte fare numra pasaportash dhe kartash identiteti. Sigurisht, nuk besoj se tre komisionerët e PD-së u kanë bërë presion tre komisionerëve të PS-së që të votohet pa pasaporta dhe karta identiteti dhe PS-ja të marrë 300 e ca vota. Por pranoj diçka, sepse e kanë konstatuar edhe të huajt, që ka pasur parregullsi: që është papërgjegjshmëri dhe mungesë përgatitjeje teknike. Ndoshta për inerci, ndoshta edhe për mentalitet, të dyja palët e komisionerëve të PD-së dhe të PS-së kanë lejuar (nga njohjet që kanë nëpër fshatra, nga afërsia) votuesit të votojnë dhe kanë shënuar numra kot. Këto janë të dënueshme nga ligji dhe le të ndiqen. Por nuk mund të thuash se këto janë bërë me karta false të manipuluar dhe të përkthehen si numër kartash të lëshuara nga sistemi i sigurisë. Pra arsyet e parregullsive, që kanë komisionerët tuaj dhe tanët, ju doni t'i faturoni si manipulime të sistemit të prodhimit të kartave të identitetit apo të dokumenteve të tjera të identitetit. Hiqni dorë nga kjo se nuk është korrekte, nuk është e ndershme. E ndershme është që ne t'i caktojmë herët komisionerët. E ndershme është që komisionerët ose trajnuesit e KQZ-së të mos rrinë korridoreve dhe si pasojë as ne si PD dhe as ju si PS nuk i kishin listat. Asnjëra palë nuk mori trajnim për Kodin e ri Zgjedhor dhe shkonin e bënin gafa administrative, të cilat komprometonin procesin. Këto janë të dyanshme. Është mirë që ju të merrni përgjegjësitë tuaja. Nuk jemi të ndarë në engjëj dhe djaj, por kemi përgjegjësi të përbashkëta për pjesën

që u takon komisionerëve dhe strukturave tona dhe këto duhet t'i diskutojmë, sepse problematikat i dimë dhe i njohim edhe pa i hapur fare kutitë. Megjithatë, kutitë le të hapen, unë kam frikë nga shkelja e Kushtetutës. Nëse Komisioni i Venecias thotë "po", le të hapen kutitë dhe hajde t'i shohim, sepse evidentohen më mirë.

E fundit që them teknikisht është se keni një pikë aty në kërkesën ligjore për amendime. Nëse Kryeministri ju ka premtuar se duke qenë në minorancë, ndryshe nga rregulli i përgjithshëm, do t'ju jepet maxhoranca për të votuar për këtë komision hetimor, ju nuk keni pse e shënoni në amendimin e ligjit për komisionet hetimor që maxhoranca në komisionet hetimore të ketë shumicën, sepse kërkonit të merrni shumicën dhe në të gjitha komisionet hetimore që mund të ngrihen në të ardhmen për gjatë gjithë mandatit. Bëni një marrëveshje korrekte dhe t'i mbetemi vetëm këtij komisioni, ndryshe ju nuk mund të bëheni maxhorancë në të gjitha komisionet hetimore. Unë mendoj se duhet të ulemi me qetësi dhe të dalim me një rezultat konkret sonte para të gjithë shqiptarëve.

Falemnderit!

Nasip Naço – Falemnderit, zoti Turku!

Zoti Leka ka të drejtën e replikës.

Agim Leka – Zoti Turku, e para, falemnderit shumë që më thoni se duhej të isha para 45 vjetësh deputet! Por edhe atëherë, me kushtetutën e tyre, ka qenë se duhej të votoheshe mbi moshën 18 vjeç, kështu që nuk mund të bëhesha deputet para kësaj moshe. Falemnderit, sepse kemi kohë që njihemi, kemi punuar bashkë dhe ti më vlerëson pozitivisht.

Ajo historia e origjinës, pastaj, nuk bën pjesë këtu, sepse është pak më e thellë dhe më e ndërlikuar dhe nuk i përket këtij parlamenti.

Për sa u përket marrëdhënieve që keni ju me partinë tuaj, kjo u përket juve. Unë pash një gjë dhe uroj që si nënkryetar i Parlamentit të mos mësosh edhe vesin e keq të fyerjes nga shefat e tu, sepse nuk e ke pasur kur ke qenë në Elbasan, por detyra t'i ndërlikon gjërat. Është çështje jotja që nuk kandidove për kryetar bashkie. Unë kam pasur respekt dhe kemi punuar mirë bashkë.

Për sa i takon fyerjes së qytetit të Elbasanit, Agim Lekës, juve dhe shumë të tjerë, por edhe shumë e shumë të tjerëve jashtë Elbasanit, nuk u shkon ndër mend ta fyejnë Elbasanin, sepse ai është një qytet që ka papunësi të madhe. Kjo nuk është fyerje, por është një detyrim që Qeveria e Sali

Berishës ka ndaj këtij qyteti. Elbasani është i ndotur dhe sa kohë që ishim ne në qeverisje nuk bëmë asgjë për ta hequr ndotjen e tij. Kur erdhi në Qeveri PD-ja, asnjë nuk tha gjë për ndotjen e Elbasanit, sepse tani si duket, nëpërmjet mjeteve të masmedias, kujton se ndotja hiqet me artikuj gazetash. Unë thashë se Elbasani është qytet i varfër, por është popull i ditur, është qendra e kulturës së gjithë Shqipërisë dhe për këtë duhet vëmendja e Qeverisë. Nuk mjafton të vish në Elbasan vetëm për ditë vere.

Nasip Naço – Falemnderit, zoti Leka!

Fjalën e ka zoti Çuko.

Arben Çuko – Të nderuar kolegë deputetë!

Para se të marr fjalën do të dëshiroja që t'i ktheja një përgjigje të vogël një kolegut tonë deputet, që na quajti ne deputetët e rinj të Partisë Socialiste "rosso hinas". Sipas tregimit, ata luftonin kundër pushtuesve dhe mbronin vendin e tyre. Më konkretisht luftonin kundër kapterëve të Gebelsit.

Të nderuar kolegë, po mbushen gati 8 muaj që vendi është futur në një krizë të thellë dhe komplekse: krizë politike, ekonomike, institucionale dhe besimi, e shkaktuar më së shumti nga këmbëngulja dhe fshehja pas artificeve të kësaj maxhorance, të patericuar për të penguar kryerjen e transparencës së zgjedhjeve që sapo lamë pas.

Gjatë fushatës elektorale më ka bërë shumë përshtypje lajtmotivi i vetëm i qindra njerëzve, ishte pyetja: a do t'i mbron dot votat tona? Një shije shumë e hidhur, thua se Shqipëria ishte një vend i rrezikuar nga pushtimi i huaj. Shteti ishte uzurpuar nga një klikë njerëzish që sillëshin dhe sillen si pushtues me popullin e vet, duke e vrarë e sakatuar, duke grabitur pasuritë dhe vjedhur fondet publike, duke shitur trojet shqiptare, duke cenuar të drejtën dhe liritë civile, duke rrëmbyer pavarësinë e institucioneve, duke hequr nga puna njerëzit vetëm pse ishin socialistë dhe, së fundi, duke deformuar votën e popullit. Në ndërgjegjen e popullit ishte akoma e freskët masakra elektorale e vitit 1996. Dhe ai, populli, i parashikonte zgjedhjet e tipit të Ruzhdies. Ai e di mirë po aq sa edhe ju se janë me dhjetëra e qindra Ruzhdie të tjera, që presin të dalin në dritën e diellit.

Kemi kërkuar hapjen e kutive, sepse kemi pasur arsye të forta, dyshime të vërtetuara tashmë për deformimin e kësaj vote. Dhe kur një njeri apo grup njerëzish akuzohen hapur për hajdutë, veprimi i parë që duhet të bëjnë ata për të shpëtuar fytyrën është të tregojnë xhepat. Po kush e pengon këtë

gjë? Vetëm frika juaj, se do të dalin me shumicë Ruzhdie të tjera në të gjitha qarqet e vendit. Fshehja pas Kushtetutës është si fshehja e strucit në rërë dhe shton më tepër dyshimet e bindjen tonë për arsyen e vërtetë të këmbënguljes suaj. Nuk ka kushtetutë demokratike në botë që pengon transparencën dhe sanksionon deformimin e votës. Vota e lirë dhe e fshehtë është baza ku mbështetet legjitimiteti i pushtetit.

Ne kemi pranuar rezultatin e nxjerrë nga institucionet dhe nuk kërkojmë ta ndryshojmë atë. Por transparencën e plotë e zgjedhjeve na duhet si dhe juve për të mos përsëritur kurrë më shkeljet e ligjit zgjedhor, siç ka ndodhur këta 18 vjetët e fundit, për të çuar para drejtësisë të gjithë njerëzit tanë dhe tuajt që kanë shkelur ligjin dhe kanë deformuar votën e popullit, si dhe për të bërë rregullimet e nevojshme për zgjedhjet e ardhshme.

Kam nderin të jem deputet i Partisë Socialiste për rrethin e Lushnjës dhe përfaqësoj zgjedhësit në zonën më të pasur bujqësore në vend. Për herë e më shumë në këtë zonë po ndihen pasojat e krizës ekonomike dhe të varfërisë së tejskajshme, lista ushqimore pa fund, lista të gjata në punimin e tokës me mekanikë bujqësore dhe hektarë të tëra të lëna djerrë. Qeveria e ndihmon fshatin duke akorduar për bujqësinë më pak se 1% të buxhetit të shtetit, duke e detyruar atë me ligj që të punojë tokat. Po me ç'kosto t'i punojë këto toka fshatari? Me çfarë garancie për tregun? Me çfarë masash proteksioniste apo politika stimuluese të shtetit? Me mundin dhe djersën e saj popullsia e fshatit jep 20% të GDP-së, por çfarë merr prej Qeverisë? Nga kjo qeveri, gjysma e popullsisë shqiptare që jeton në fshat duhet të presë vetëm lënien në harresë, rritje të mëtejshme të çmimeve dhe herë pas here përmbajtje. Kriza ekonomike dhe varfëria që ka mbërthyer në darën e saj të mjerimit fshatin është pjesë e asaj krize të thellë dhe komplekse që ka përfshirë gjithë shoqërinë shqiptare, që mund të zgjidhet me masa të thella dhe komplekse politike, institucionale, ekonomike. Kjo gjë fillon nga transparencën e plotë e zgjedhjeve.

Të nderuar deputetë të maxhorancës, në qoftë se vërtet zgjedhjet e 28 qershorit 2009 ishin ashtu siç thoni ju, të lira dhe të ndershme, atëherë çfarë ju pengon që të pranoni transparencën që kërkojmë ne? Të jeni të bindur se në qoftë se nuk do të dalin Ruzhdie të tjera, ne do t'ju urojmë fitoren, do të vijmë në Parlament dhe do të kontribuojmë për reformat që i nevojiten këtij shteti. Ju ftoj që t'i hapni

rrugë hetimit të plotë, siç e kemi propozuar ne, në mënyrë që t'i japim fund një herë e përgjithmonë vjedhjeve, grabitjeve dhe deformimit të votës së popullit.

Ju falemnderit!

Nasip Naço – Falemnderit, zoti Çuko!

Fjalën e ka zoti Bano.

Ilir Bano - I nderuar zoti drejtues i seancës,

Të nderuar deputetë,

Mendoj se ky debat maratonë që po zhvillojmë në këtë seancë plenare ka një gjë shumë pozitive, kjo është pjesëmarrja e opozitës, pjesëmarrje e dëshiruar nga të gjithë ne. Dua të besoj se këtu është edhe fillimi i zbatimit të detyrimeve të saj kushtetuese ndaj zgjedhësve dhe vendit. Fatkeqësisht, frazat e diskutimeve të shumë përfaqësuesve të saj ishin të mbushura me një fjalor të ngurtë dhe të ashpër, mohues pa fakte dhe jashtë realitetit, të cilat të zhgënjnë. Jam dakord me një deputet të nderuar të Partisë Socialiste që e cilësoi këtë si dhunë verbale dhe rekomandoi jo hapjen, por mbylljen e kutive të televizorit për qytetarët shqiptarë që shikojnë këtë debat. Kjo të le shijen se në rastin konkret nuk ekziston predispozicioni juaj për një kompromis të mbështetur në ligjet dhe parimet bazë të shtetit ligjor, ose për qëndrime opozitare konstruktive në të ardhmen. Çështjet që u trajtuan këtu janë trajtuar edhe më parë gjerë e gjatë nga deputetët e shumicës, të bazuara gjithnjë mbi ligjet dhe Kushtetutën e këtij vendi, sikurse edhe nga deputetët tuaj, ku kemi dëgjuar të thuhet nga njëri diskutant te tjetri terma si : hetimi i pakushtëzuar ose që të veprojnë prokuroria, duhet më parë një komision parlamentar hetimi etj, të cilat më së paku mund të cilësohen nonsense juridike.

Në një shtet të së drejtës hetimi dhe jo vetëm ai parlamentar, por edhe ai i institucioneve të tjera që e kanë detyrë kryesore, kushtëzohet nga respektimi i të drejtave kushtetuese dhe i procedurave të kodeve përkatëse. Në një shtet të së drejtës prokuroria vepron sa herë i paraqiten fakte mbi shkeljet ligjore, përfshirë edhe ato mbi legjislacionin zgjedhor dhe nuk ka nevojë që të presë të dhënat e komisioneve hetimore parlamentare.

Zotërinj të opozitës, hetimi dhe veprimet e tjera të pakushtëzuara dhe të pakufizuara nga ligji, janë tipare të regjimeve totalitare dhe kjo kohë për Shqipërinë ka mbaruar. Nga ana tjetër, deputetët e shumicës më se një herë kanë argumentuar që, bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve, si një nga shtyllat themelore të sistemit që po ndërtojmë

së bashku dhe me ju, tash 20 vjet, është e pamundur që të plotësohet kërkesa juaj. Interesat e ngushta të ndonjërit nuk janë shkak i mjaftueshëm për të cenuar sistemin, qoftë edhe kur për arsye të ndryshme këto interesa manipulojnë ose të paktën përcaktojnë qëndrimin e opozitës, ashtu sikurse po ndodh. Ajo që është cilësuar në rezolutën e Këshillit të Europës si krizë politike vetëm dhe për shkak se ju bojkotuat punimet e Parlamentit, nuk zgjidh e nuk mund të shërbejë si pretekst për të anashkaluar dhe shkelur çdo ligj dhe arritje të shtetit demokratik. Nuk mund dhe nuk është e pranueshme të zgjidhet duke krijuar një krizë tjetër akoma më të rëndë, atë të prishjes së balancës midis pushteteve të interferencës së kompetencave të tyre. Në diskutime, njëlloj si në prononcimet tuaja të shumta mediatike, zotërinj të opozitës, është dukur qartë synimi që jo vetëm cilësimi "krizë politike" të nxirret jashtë kontekstit të përdorur për bojkotin tuaj parlamentar, por çuditërisht të shtrihet edhe në të gjitha fushat, përfshirë ato të zhvillimit ekonomik të vendit. Në qoftë se dalim mbi frazeologjinë dhe teknikat e mashtrimit, kjo nuk ka asnjë të vërtetë.

Mungesa e opozitës në Parlament nuk është normale, por sado jo normale që është, sado me ndikim ka qenë dhe është kjo mungesë në vonesën e miratimit të disa ligjeve të rëndësishme për reformat në sistemin gjyqësor, nuk do të arrijë dhe nuk e ka arritur të shtrijë ndikimin e vet në mirëfunksionimin e ekzekutivit dhe të institucioneve të tjera të shtetit shqiptar dhe për pasojë nuk ka patur ndikim në ecurinë e zhvillimit ekonomik të vendit. Me gjithë efektin e pashmangshëm të krizës ekonomike botërore, përfshirë rënien e të ardhurave nga emigracioni, Shqipëria mbetet dhe futet ndër ato pak vende të Europës që ka ritme të kënaqshme të rritjes së ekonomisë, e cila duket edhe në të gjithë treguesit që pasqyrojnë punën e Qeverisë. Ka nga ju që thanë këtu se nuk ka shifra, në një kohë që ju nuk doni t'i shikoni ato. Shifrat janë të botuara, përveç kësaj ju, si deputetë, keni të drejtën si çdo qytetar i këtij vendi të informoheni në organet e ekzekutivit për to. Në qoftë se do të ishit informuar, diskutimet tuaja nuk do të ishin në këtë formë, sepse, ashtu sikurse ritmet e rritjes janë të kënaqshme, edhe të ardhurat në buxhetin e shtetit janë po ashtu në përputhje me këto ritme rritjeje. Krahasuar me vitin 2006, ato patën një rritje prej 30 %. Po kështu edhe shpenzimet në vitin 2009 rezultuan 25,3 miliardë lekë më të larta, ose rreth

7,2% më të larta kundrejt vitit 2008. Më e rëndësishme është se ka vazhduar dhe po vazhdon të mbahet një strukturë e tillë që i shërben zhvillimit afatgjatë të vendit dhe uljes së varfërisë, me synim zhdukjen e afërt të varfërisë ekstreme. Në përputhje me këtë politikë të Qeverisë u arrit që në vitin 2009 të mbahet një nivel investimesh mbi 8,24% të prodhimit të brendshëm bruto, një mesatare që kjo Qeveri e ka mbajtur në të gjithë katër vjeçarët pararendës. Dua t'ju rikujtoj me këtë rast që gjatë 8 vjetve të qeverisjes suaj ky tregues ishte me një mesatare rreth 4% e prodhimit të brendshëm bruto, pa folur këtu për efektivitetin e tyre, ndryshime thelbësore në projekte, procedurat e prokurimeve dhe në kontrollin e zbatimit. Ju kujtuat këtu se ka ende rrugë të pabëra. Po, është e vërtetë, por krahasuar me një vit më parë, në vitin 2009 investimet e brendshme ishin 26,6 miliardë lekë më të larta ose 53 % më shumë. Mund t'ju tregoj të dhënat e ministrisë përkatëse për realizimin e buxhetit të vitit 2009. Ne e dimë se ka ende për të bërë, por vendi është në rrugë të mbarë.

Bujqësia ka 1001 probleme, por nga politika e re e stimulimit të prodhimit bujqësor, në përshtatje me kushtet e vendit, kur toka është e pakët, u shpenzuan jo pak por 10 milionë dollarë në skemat e subvencionimit, në skema nga të cilat përfituan plot 10 mijë fermerë shqiptarë. Është zbatuar një politikë e tërë për bonifikimin e Myzeqesë, që të gjithë e dimë se si ka qenë koha këtë vit, nuk pati asnjë problem përmbajtjeje në këtë zonë, sikurse janë marrë masa për një kontroll më të mirë të kufijve dhe për krijimin e kushteve në treg që prodhimi bujqësor të mos hidhet ashtu si 5 vjet më parë, por të shitet në kushte të leverdisshme për fermerin shqiptar. Dhe këto, zotërinj të opozitës, nuk janë tregues të një vendi që është në krizë, por të një vendi ku zbatohet një strategji realiste dhe pozitive, të një ekonomie që përballon më së mirë influencat e krizës botërore dhe në analizë të fundit, këta janë tregues të një qeverie me vizion, aftësi e përkushtim për t'iu përgjigjur sfidave edhe kur ato janë të papritura dhe me ndikim global.

Pa u zgjatur në analiza më të gjera, me të cilat, në qoftë se ju do të vini këtu në Kuvend, do të kemi rast, dhe kjo është normale, të ballafaqohemi në seanca të tjera parlamentare, shpresoj që edhe për këtë projektligj ju të futeni në hullitë e logjikës së shtetit të së drejtës e të pranoni ofertën dhe propozimet që dha Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike dhe Kryeministri.

Falemnderit!

Nasip Naço – Falemnderit, zoti Bano!

Fjalën e ka zonja Spahiu.

Klodiana Spahiu – I nderuar zoti drejtues i seancës,

Të nderuar kolegë,

Më lejoni që sot nga kjo foltore të flas jo vetëm si deputete, por edhe si grua e nënë shqiptare, pasi janë dhjetëra e mijëra sy dhe zemra që po na ndjekin nëpërmjet ekranit, duke dashur të dinë se çfarë do të bëhet me votën e tyre. A do të vendoset më në fund drejtësia në këtë tempull, që jo vetëm me fjalën, por edhe me veprën tonë të koncentruar në ligje e rregulla të drejta t'u japim atyre shpresën e madhe, shpresën e vonuar për ta bërë realitet demokracinë e shumëkërkuar? Pse kjo vonesë e ngërç i krijuar? Pse kjo varfëri e shpresë e vrarë që ka rënë si mjegull në çdo rrugë e familje shqiptare?

Shumë kohë më parë, në fëmijërinë time kam lexuar se Shqipëria është nga vendet më të vjetra në botë. Pra, aludimi vjen natyrshëm. Pse sot ajo radhitet në rreshtat e fundit të botës dhe rënkton nga dhimbjet e skamjes, e varfërisë sociale dhe politike? Ju lutem, më mirëkuptoni, të dashur kolegë deputetë, edhe ju kolegë të krahut tjetër. Nuk po mundohem të zgjedh fjalët për një elokuencë në veçantë, por po mundohem të flas me zemër të hapur, duke përcjellë këtu shqetësimin e atyre grave dhe nënave që nuk e meritojnë një jetë të tillë të ngarkuar me dhimbje dhe stresse, dhimbje dhe stresse që tashmë ne i dimë pse rrjedhin dhe që janë bërë më të ashpra nga mosfunksionimi i shtetit, nga keq-qeverisja aktuale, që flet për drejtësi dhe progres, por me keqardhje mund të themi se vetëm drejtësia është kthyer në formatin e legjendës te ne. Dhe pse? Për mungesë të transparencës që pushtetarët sot me një kokëfortësi absurde mundohen ta mohojnë bërjen e kësaj transparence, duke e justifikuar me lloj-lloj pretendimesh juridike dhe pseudojuridike.

Kërkesa për bërjen e transparencës jo vetëm që është ligjore dhe kushtetuese, por po ju kujtoj, zotërinj qeveritarë dhe deputetë të së djathtës, se ju flisni shpesh për verdiktin e popullit, por a nuk është populli ai që ka muaj të tërë që po e kërkon këtë transparencë? Me siguri kjo nuk është një pyetje që kërkon përgjigje, sepse përgjigjen dhe legjitimitetin e kësaj transparence tashmë e kanë përligjur mijëra e mijëra qytetarë; e kanë mbështetur e përkrahur shumë forume dhe organizma të botës së qytetëruar, tek e cila pretendojmë të shkojmë. E

pra, ka muaj të tërë që ju qeveritarë dhe kolegë të së djathtës pretendoni të bëni fajtor kryetarin e Partisë Socialiste se po e mban peng partinë jashtë Parlamentit. E keni gabim. Është verdikti i gjithë elektoratit, i Partisë Socialiste që në unitet vendosi t'i jepte fund një herë e përgjithmonë abuzimit dhe vjedhjes së votës, pasi ka ardhur koha që sovranit i vërtetë të jetë populli dhe jo akrobacitë dhe pazaret politike. Nuk mund të krijosh ligje dhe drejtësi nga një parlament që vetë është krijuar nga padrejtësia elektorale. Ndaj ju, kolegë të së djathtës, ngurroni të bëni transparencën, sepse jeni të pasinqertë e të padrejtë edhe me elektoratin tuaj, pasi me keqqeverisjen tuaj keni sjellë tek ata pakënaqësi dhe zhgënjime të mëdha, duke ndier një varfëri të tejskajshme, ndërsa ju pretendoni se po rritet ekonomia dhe mirëqenia sociale. E kush mund ta besojë këtë gjë kur qytetarët e këtij vendi nuk po ngopin barkun me bukë; kur listat e të papunëve dhe e të uriturve, që marrin edhe bukën duke shënuar emrin në listë, po rriten përditë?

Më vjen keq, por askush nuk ju beson më. Prandaj ju keni frikë nga transparenca se jeni të bindur se Ruzhdia nuk ka ndodhur vetëm në Ruzhdië. Ndaj nguroni për transparencën, sepse ajo përfundimisht do t'ju zbulonte intrigat elektorale. Ndaj keni frikë dhe nxitoni që legjislativonin shqiptar ta monopolizoni në një dorë të vetme, gati mbretërore, për të mbuluar krimet elektorale që keni guxuar të bëni në votën e popullit, për të cilin betoheni me fjalë, por me vepra po veproni kundër tij.

Ndaj sot nga kjo foltore, si grua, si nënë, si deputete, ju bëj thirrje: nuk kemi më kohë për të humbur! Është momenti t'i tregojmë mbarë botës se ne shqiptarët mund të vetëqeverisim me standardet e kohës moderne dhe ligjore, që edhe ne, si një vend i hershëm në këtë botë, të radhitemi në demokracinë e vërtetë, me qëllim që ne dhe fëmijët tanë të jetojmë ashtu siç e meritojmë. Padrejtësitë elektorale janë si era që fryn dhe nuk kthehet më. Pushteti, kur merret me verdiktin e sovranit popull është si një diell që të ngroh, ndaj dhe ne sot kemi nevojë për këtë diell demokratik, rrezet e të cilit duhet t'i gëzojnë gjithë shqiptarët e këtij vendi.

Falemnderit!

Nasip Naço – Falemnderit, zonja Spahiu!

Fjalën e ka zoti Sula.

Dashnor Sula – Falemnderit, zoti drejtues i seancës!

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Kemi dy ditë që diskutojmë projektligjin për disa ndryshime në ligjin për komisionet hetimore.

Sigurisht, unë ndihem keq kur dëgjoj të diskutohen disa argumente shterpë, kur dëgjoj të flitet për domate, kastravecë, për faturat e dritave dhe për gjëra të tjera, ndërkohë nuk flitet fare për thelbin e projektligjit për të cilin është mbledhur ky Parlament.

Në Komisionin e Ligjeve, qoftë nga deputetë të mazhorancës, qoftë nga të opozitës, është bërë një diskutim dhe debat me të vërtetë doktrinal për sa u përket diskutimeve dhe argumenteve juridike, pavarësisht argumenteve të tjera politike.

Të nderuar kolegë,

Në qoftë se ne do të diskutojmë dhe do të japim argumentet pro dhe kundër, nëse duhet të bëhet ose jo ndryshimi i projektligjit për komisionet hetimore dhe se çfarë ndryshimesh duhet të bëhen për këto komisione, sigurisht, mendimet janë të ndryshme. Të dyja palët, qoftë Partia Demokratike, qoftë Partia Socialiste, bashkohen në një pikë të përbashkët që është ngritja e komisionit hetimor, por mendimet janë të ndryshme për sa i përket objektit të hetimit.

Të nderuar kolegë,

Unë mendoj se zgjedhjet e 28 qershorit duhet të hetohen. Duhet të hetohen për efekt të transparencës. Por, në qoftë se ne nuk jemi të bindur që transparenca duhet të bëhet brenda kornizave të Kushtetutës, që është akti themeltar i shtetit ligjor të Shqipërisë, të ligjeve të tjera dhe të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, sigurisht që në këtë moment ne dështojmë dhe nuk mund të ngremë një komision hetimor.

Unë u bëj pyetje kolegëve socialistë: A është e mundur ngritja e një komisioni hetimor? A është i mundur hetimi i zgjedhjeve të 28 qershorit? Po, është e mundur ngritja e një komisioni hetimor, pra ne qysh në këtë moment duhet ta ngremë këtë komision hetimor.

Unë kam pasur fatin që të jem deputet edhe në legjislativën e kaluar dhe ligji i komisioneve hetimore, i cili është miratuar në vitin 2002 kur Partia Socialiste ishte në pushtet, përcakton mjaft qartë të gjitha kriteret dhe mënyrën se si ngrihet një komision hetimor. Pra, kjo do të thotë se një komision hetimor i ka të gjitha mundësitë për të hetuar zgjedhjet e 28 qershorit dhe nuk ka asnjë pengesë ligjore që të hetohen zgjedhjet e 28 qershorit. Por objekti që kërkon Partia Socialiste, opozita, është një objekt tejet i zgjeruar. Ne nuk

mund të pranojmë kurrsesi që të kemi një super organ, i cili dublon të gjitha organet e tjera kushtetuese, duke filluar nga gjykatat, prokuroria dhe Gjykata Kushtetuese.

Të nderuar kolegë të opozitës,

Besoj se oferta e Kryeministrit Berisha ka qenë një ofertë tepër e sigurtë për sa i përket kompromisit politik që është ofruar për të hetuar zgjedhjet e 28 qershorit. Me të vërtetë Kryeministri Berisha ju ofroi maxhorancën e komisionit hetimor, çka do të thotë se është hera e parë që në Shqipëri opozita të ketë shumicën në një komision hetimor. Pra, Kryeministri ju ofroi kompromisin, jo vetëm këtë kompromis, por ju ka ofruar edhe kompromise të tjera.

Së pari, si opozitë t'i drejtoheni Gjykatës Kushtetuese, ashtu siç i jeni drejtuar edhe për dhjetëra projektligje të miratuara nga kjo maxhorancë kur nuk keni qenë dakord. Gjykata Kushtetuese ka dhënë interpretimin e saj dhe në disa raste ka qenë në disfavor të maxhorancës. Kjo do të thotë se kjo maxhorancë u është referuar vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. (Një nga vendimet e kësaj Gjykate është edhe vendimi i muajit maj të vitit 2007.)

Në qoftë se ju nuk jeni dakord për objektin që shtroni, atëherë drejtojeni Gjykatës Kushtetuese dhe, në rast se ajo nuk jep përgjigje, drejtojeni për asistencë Komisionit të Venecias, ashtu siç i jeni drejtuar edhe në raste të tjera.

Së dyti, Kryeministri Berisha ju ka ofruar kompromisin që hetimi i zgjedhjeve duhet të bëhet nga prokuroria, organ i cili i ka të gjitha potencialet profesionale për të hetuar zgjedhjet e 28 qershorit, ashtu siç ka hetuar për gati 20 vjet të gjitha proceset apo megaproceset.

Kryeministri Berisha ju ka ofruar këto kompromise, sepse e gjykon që opozita është e rëndësishme dhe duhet të respektohet.

Të nderuar deputetë të opozitës, ju duhet të keni parasysh edhe rastet analoge të hetimeve që janë bërë edhe në vende të tjera të Bashkimit Europian, apo edhe matanë Atlantikut, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Së fundi, një koleg i maxhorancës përmendi zgjedhjet e fundit në Ukrainë. Me të vërtetë kishte ndasi thelbësore midis dy kandidatëve për zgjedhjet presidenciale, por në fund ata iu nënshtruan vendimit të Gjykatës së Lartë të Ukrainës.

Po ju pse nuk pranoni vendimin e Kolegjit Zgjedhor? Pse nuk e pranoni këtë vendim të formës së prerë? Pse nuk pranoni vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve?

Unë doja të kthehesha pak në kohë, duke pasur parasysh jo vetëm situatën pas zgjedhjeve të 28 Qershorit, por edhe përpara zgjedhjeve.

Të nderuar kolegë të maxhorancës dhe të opozitës,

Unë thashë pak më parë se kam pasur fatin të jem deputet i legjislaturës së kaluar, madje kam qenë edhe anëtar i Komisionit të Ligeve, ku është miratuar Kodi Zgjedhor dhe ndryshimet kushtetuese, më 21 prill të vitit 2008. Qysh aty ka qenë fillesa ku ju deputetët e opozitës ngrinin me forcë se sistemi maxhoritar është një sistem i dështuar në Shqipëri; kërkuat që të kishit një sistem tjetër, një sistem proporcional-rajonar dhe iu referuat sistemit proporcional-rajonar spanjoll, duke e mbrojtur me fanatizëm. Po të keni parasysh rastin e Dushkut të zgjedhjeve të vitit 2001, që nxorët, në mos gaboj, 25 deputetë, opozita e asaj kohe, Partia Demokratike, duke dhënë argumente të plota për manipulimin e zgjedhjeve të vitit 2001, i pranoi dhe asnjëherë nuk kërkoi që të bojkotonte zgjedhjet.

Ju, zotërinj, Partia Socialiste dhe lideri i saj, ishit të përgatitur se do t'i fitonit domosdoshmërisht zgjedhjet e 28 qershorit. Kur nuk i fituat këto zgjedhje, filloi beteja jo vetëm politike, por edhe beteja me argumente të tjera, duke kërkuar absurdin në këto kuti votimi.

Unë jam i bindur se, në qoftë se ne ngremë një komision hetimor, sigurisht ekziston mundësia e hetimit të zgjedhjeve. Nuk duhet të kapemi vetëm te gança e hapjes së kutive, sepse komisioni hetimor vepron në bazë të Kodit të Procedurës Penale, që do të thotë se marrin prova të tjera, duke filluar nga pyetja e komisioneve, këqyrja e materialeve e shumë hetime të tjera, që nuk ia përjashton ligji "Për komisionet hetimore". Nëse zgjedhjet e 28 qershorit hetohen, opozita dhe maxhoranca duhet të bëjnë transparencë mbi këto zgjedhje. Por ju nuk kërkonit transparencën e zgjedhjeve të 28 qershorit, ju kapeni pas një nyje, që është hapja e kutive, sepse ju e dini që kutitë nuk mund të hapen, sepse e pengon vendimi i Gjykatës Kushtetuese, Kushtetuta dhe, duke qenë se e dini këtë gjë, atëherë keni gjetur thembrën e Akilit për të krijuar gjithë këtë pësjtjellim. Duke e pasur parasysh që i keni humbur zgjedhjet e 28 qershorit, mund të humbni edhe zgjedhjet e pushtetit vendor dhe të bëni zgjedhjet e vitit 2013.

Më lejoni, zoti zëvendëskryetar, të them edhe dy gjëra.

Unë do t'i referohesha Gjykatës Supreme të

SHBA-ve në zgjedhjet për kandidat për president mes zotit Bush dhe zotit Algor. Gjykata thekson shprehimisht rinumërimin e votave me argumentin se zyrtarët nuk mund të rivlerësojnë fletët e votimit, sepse nuk ka standard kombëtar të vlefshmërisë së fletës së votimit. Është vetëm qëllimi i votuesit. Dhe këtë e gjejmë vetëm te Gjykata Supreme.

Dhe, së fundi, duke iu drejtuar opozitës, do t'i referohesha një gazetari të njohur italian, Indro Montanelli, i cili në vitet '70 në Itali ishte...*(I ndërpritet fjala.)*

Nasip Naço – Falemnderit, zoti Sula, por janë edhe 30 deputetë të tjerë që duan të marrin fjalën.

Po, zoti Minxhozi!

Gemal Minxhozi – Të nderuar kolegë deputetë!

Me sa duket, debati i sotëm shënon fazën e fundit të ballafaqimit politik mes pozitës dhe opozitës, lidhur me zgjidhjen e krizës elektorale. Me gjithë pozicionin e ngurtë që ka treguar Qeveria ndaj vullnetit të PS-së për të hyrë në Kuvend, për t'u bërë pjesë e nismave që përkrahin dhe nxisin procesin e integritetit, si dhe për të paraqitur propozime konkrete në tryezën e bisedimeve, maxhoranca ka preferuar të heshtë, të mos ofrojë asnjë propozim konstruktiv dhe të hedhë poshtë çdo gjë që opozita e ka vënë përpara. Pra, Qeveria ka zgjedhur të mos negociojë, të mos hedhë asnjë hap drejt gjetjes së një kompromisi, duke firmosur vazhdimin e tensionit politik dhe duke detyruar opozitën të vijojë qëndrimin jashtë Parlamentit. Kjo ka qenë mënyra më e keqe për të menaxhuar një krizë që nuk mund të zgjidhet kurrsesi vetëm me angazhimin, vullnetin politik dhe përkushtimin e njëjës palë. Kjo sjellje, e cila ka sjellë reagime të shumta nga kancelaritë evropiane, që kërkojnë hetimin e zgjedhjeve dhe marrjen nga Qeveria të përgjegjësisë përkatëse, shpalos para shqiptarëve të vetmin fajtor të asaj që po ndodh prej 8 muajsh në Shqipëri, pra shumicën e dalë nga votat e kontestuar të 28 qershorit.

Si deputet i qarkut të Dibrës, kam kërkuar, si para, ashtu edhe pas zgjedhjeve, që problemet që ka kjo zonë e varfër të zgjidhen me konsensus sa më të gjera dhe me vullnetin e të gjithë faktorëve politikë e socialë në terren. Si përfaqësues i kësaj zone, kam vënë re atë që shumëkush e ka vënë re me kohë: tensioni politik i Tiranës është transferuar në popull, pra aty ku jemi votuar të gjithë ne. Qeveria e zotit Berisha po thëllon destabilitetin politik e social të vendit në një moment të vështirë krize ekonomike e financiare, si dhe në një periudhë me rëndësi unike

për të ardhmen e procesit të integritetit të Shqipërisë në BE. Kauza e transparencës së zgjedhjeve nuk është më as një luftë private e Edi Ramës dhe as pasqyrimi i një krize të brendshme të opozitës, siç jeni përpjekur ta paraqitni për muaj me radhë ju, të nderuar deputetë të shumicës. Mjafton të ndiqni edicionet informative për të parë se çfarë përmasash ka fituar kjo kauzë, ku pjesa dërrmuese e deputetëve të Parlamentit Europian janë shprehur qartë dhe hapur për nevojën urgjente të një hetimi të plotë të zgjedhjeve të 28 qershorit.

Nga eksperiencia ime në rrethin e Matit, mund të dëshmoj se sindroma "Ruzhdie" është konsumuar në masë të gjerë edhe atje. Votime familjare, blerje votash, financime në dorë, vota të personave që ndodhen jashtë vendit, dhënien e ndihmës ekonomike në prag të zgjedhjeve në të gjitha komunat dhe bashkitë e rrethit. Matjanët ndihen keq për situatën tejte të vështirë ekonomike që po kalon zona e tyre. Një bujqësi e atrofizuar, një mungesë e theksuar investimesh, lista të gjata borxhlinjsh në dyqanet ushqimore të fshatrave dhe qyteteve dhe, mbi të gjitha, një papunësi tepër e lartë. Vetëm në qytetin e Burrelit ajo arrin në masën 35%. Ata revoltohen se, si vëllezërit e tyre minoritarë, trajtohen me shpërfillje totale nga Qeveria, e cila qëndron indiferente ndaj një kategorie që nuk i ka borxh askujt në këtë vend. Përkundrazi, u jemi ne borxhlinj këtyre njerëzve të përkushtuar.

Të nderuar kolegë deputetë, u bënë 20 vjet që jemi në procesin e tranzicionit, një tranzicion i stërzgatur. Natyrisht që vendi, shoqëria kanë bërë hapa përpara edhe klasa politike ka bërë përpjekje për t'u civilizuar, por arritjet kanë qenë të vakëta. Ajo që ka munguar dukshëm, është mungesa e besimit reciprok, e konsensusit politik, i cili ka bërë që të mos jemi në gjendje t'i zgjidhim vetë problemet tona. Gjatë dy dekadave, vetëm në një apo dy raste, maxhoranca dhe opozita kanë arritur t'i zgjidhin vetë problemet, në të gjitha rastet e tjera zgjidhja ka ardhur nga trysnia ndërkombëtare. Kjo nuk na nderon aspak. Terminologjia se këto janë zgjedhjet më të mira, është bajate dhe aspak bindëse. Po të ecim me këtë mendësi dhe këtë ritëm, i bie që zgjedhje me standarde të vërteta evropiane të bëjmë në vitin 2020. Për ta kuptuar se sa larg jemi me Europën, po jap një shembull: Në vitin 2000, pra 10 vjet më parë, një grup deputetësh të Kuvendit, të majtë e të djathtë, zhvilluan një vizitë zyrtare në Parlamentin danez. Një ish-kolegu ynë i pyeti nëse kishte manipulime në zgjedhjet parlamentare në

Danimarkë. Bashkëbiseduesi danez u habit dhe i tha që ta përsëriste pyetjen. Pasi e pyeti përsëri, danezi i tha se nuk ka ndodhur dhe nuk mund të ndodhë kurrë. Më tej, pasi u mendua pak, ai vijoi se i vetmi rast manipulimi ka qenë në vitin 1979, ku një individ u ankua për një parregullsi procedurale në qendrën e votimit. Pasi u hap kutia, panë se çdo gjë ishte në rregull. Shembulli nuk ka nevojë për komente. Për këtë arsye ka ardhur koha që të hedhim një hap serioz, në radhë të parë për shqiptarët dhe pastaj edhe për faktorin ndërkombëtar, i cili këmbëngul që problemet tona t'i zgjidhim vetë. Përfundimisht, duhet të udhëhiqemi nga një filozofi e re dhe sot kemi rastin për ta demonstruar. Propozimet tona, në prag të vizitës së komisionerit për Zgjerim, zotit Fule, janë gjesti i radhës i vullnetit të mirë që PS-ja ofron për arritjen e një kompromisi. Është mirë që këtë kompromis ta arrijmë sot, duke marrë si pikënisje propozimet tona. E keni radhën ju që të hidhni të njëjtin hap. Kjo është në interes të të gjithëve, sidomos të popullit, i cili pret që kriza të marrë fund dhe t'i hapet rruga bashkëpunimit dypalësh, ku të mbizotërojë logjika, mirëkuptimi politik, në dobi të përparimit të vendit. Ky do të ishte një sinjal pozitiv serioziteti ndaj partnerëve tanë ndërkombëtarë.

Ka ende kohë për mendjet e shëndosha.
Falemnderit!

Nasip Naço – Falemnderit, zoti Minxhozi!
Fjalën e ka zoti Noka.

Flamur Noka – Falemnderit, zoti drejtues i seancës!

Të nderuar kolegë, sot, pas më shumë se 8 muaj përpëlitjsh dhe orvatjesh në pellgun e paligjshmërisë, ju, të nderuar kolegë socialistë, jeni futur në Parlament dhe jeni të mirëpritur nga ana jonë, si maxhorancë. Bile edhe nisma juaj për ngritjen e komisionit hetimor do të gjejë mirëkuptimin tonë në parim dhe nuk kemi asgjë kundër. Këto zgjedhje ishin më të mirat, më të lirat, më transparente dhe më demokratiket të zhvilluara ndonjëherë, me zero kontestim nga komisionerët dhe administruesit e tyre, si asnjëherë tjetër në historinë e zgjedhjeve në demokracinë shqiptare dhe që plotësojnë standardet kryesore të OSBE-së. Kjo nuk është konfirmuar nga ne, por nga të gjithë arbitrat ndërkombëtarë njëzëri. Që nga ajo ditë ka kaluar shumë kohë dhe në Shqipëri kanë shkuar e kanë ardhur me dhjetëra delegacione zyrtare të miqve ndërkombëtarë dhe të gjithë ju kanë thënë që të hynit në Parlament, se keni humbur dhe lërin lojërat

ogurzeza që pjell mendja e mbrapshtë e kryetarit tuaj në krizë, se nuk kanë asnjë argument. I vetmi argument që keni është pseudo-argumenti i krizës së kryetarit tuaj humbës për t'u justifikuar dhe për t'u kapur me kthetra pas karriges së kryetarit të partisë dhe të asaj të bashkisë. Disa prej jush kanë thënë se doni të hapni kutitë për të qetësuar shpirtin e trazuar të kryetarit tuaj dhe se Berisha mund ta bëjë këtë gjë, por nuk do. Keni thënë se ligji e detyron Berishën të hapë kutitë.

Kryetari juaj në marrëzinë e tij ju përfshiu, duke ju çuar qytet më qytet, ju rraskapiti rrugëve gjithë vjeshtën dhe dimrin. Ju, pra, dhe militantët tuaj, që ai ka dëshirë t'i quajë "popull opozitar" në emër të së drejtës së tij, të vetëquajtur të ligjshme për të hapur kutitë, ju sjell këtu, jo për të kërkuar ngritje komisioni, por për të mbrojtur alibinë e karriges së tij në krye të partisë. Ai shpreson të kapet me kthetra pas karriges së bashkisë. Është për të ardhur keq që sot po tregoni se nuk doni të diskutoni për komisionin hetimor, por jeni këtu për të vjellë vrer dhe për të mbrojtur, me urdhër të kryetarit tuaj, ato që i quani nisma për ndryshim të ligjit "Për komisionet hetimore", që në fakt janë nisma që i ka hartuar kryetari juaj, jo për të hapur kutitë, por për të futur opozitën në kuti. Këto nisma janë vetëm pretekst për të justifikuar rrugën e politikës që kryetari juaj e ka shumë për zemër dhe, sipas gjasave, aty do të përfundoni. Këto nisma nuk kanë në thelbin e tyre asgjë të përbashkët me atë që kryetari thërret andej-këndej për transparencën e votave dhe as me zgjedhjet. Asgjë që lidhet me fjalën "transparencë". Sepse, të nderuar zotërinj socialistë, ju e dini mirë, pavarësisht se nuk e thoni publikisht, se ai ka fobi nga transparenca si term dhe si proces. Apo nuk e vërtetoi këtë procesi zgjedhor brenda partisë tuaj? Këto nisma, që po përpiqeni t'i trumbetoni si parimet themelore të betejës tuaj, nuk kanë asnjë lidhje me respektin ndaj votës e as ndaj demokracisë, por janë shprehje e veçantë e asaj që kryetari juaj i sëmure, në pamundësi për të marrë pushtet në tavolinë, sajon dhe vë në skenë provokime ndaj institucioneve, pasi në këtë mënyrë ai mendon se mund t'i nënshtrojë dhe deligitimojë ato. Harrojeni! Mund të bridhni sa të doni rrugëve si hebrenjtë nëpër shkretëtirë, por harrojeni pushtetin me protesta dhe me dhunë. Këto nisma janë shprehje e veçantë e asaj që kryetari juaj nuk njeh kufij ligjorë në krijesat e tij. Nuk merr në konsideratë vendime gjykatash apo Kushtetutën, sepse në thelb, ajo që ju kërkoni, janë një shkëlqim ndaj vendimit të

Kolegjit Zgjedhor, të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe Kushtetutës së vendit. Disa prej jush, kolegë socialistë, e dinë mirë qëllimin e këtyre nismave, edhe pse vini këtu për të bërë oratorin, prozatorin, poetin e kutive dhe të kryetarit të kulisë. Në apologjinë e tij, kryetari juaj e ka hallin diku tjetër: te karrigia dhe te votat e humbura.

Sot, ju, të nderuar zotërinj socialistë, jeni bërë pishman, se nuk keni klonuar në vend të 20 mijë komisionerëve, 20 mijë xhelilë. Por e keni prapë gabim se nuk do t'ju besonte. Ai mund të qetësohej vetëm nëse ju do të mund të klononit Edin 18 mijë herë. Dy mijë herë të tjera do t'ju duhej të klononit Takun dhe Nardin, por këtë nuk mund ta bëni, prandaj jeni nën pushtetin dhe makthin e kryetarit tuaj.

Të nderuar kolegë socialistë, ju vini dhe bëni zhurmë jo në emër të parimeve që besoni, por në emër të atyre që kryetari juaj ju ka detyruar t'i quani "parime"; shkurt, të interesave të tij dhe të një grupi interesash brenda jush. Thellë-thellë, ju e dini shumë mirë se këto paligjshmëri dhe marrëzira, që kërkon t'ju imponojë kryetari juaj, nuk i japin askujt asnjë lloj zgjidhjeje, as ju e madje as kryetarit tuaj. Ju, të nderuar kolegë socialistë, jeni të qartë se kryetari juaj nuk e ka hallin tek kutitë, as te hapja e tyre, sepse, siç e kemi thënë edhe më parë, kryetari juaj është shumë i qartë se, po të hapë kutitë, qenin e ngordhur do të gjejë aty.

Por ai e ka gjetur këtë mekanizëm që të fusë vendin në një spirale destabiliteti permanent dhe, siç ua ka shprehur ai vetë disave prej jush dhe si është shprehur nëpër tavolina të tjera, sepse kërkon të hakmerret ndaj shqiptarëve që nuk e votuan. Ai ju ka futur të gjithëve në vorbullën e kutive dhe do të përpiqet vazhdimisht që të ngrrejë mjegullnaja dhe t'ju yshtë në beteja donkishoteske, edhe pse të gjithë ju ditën që sollët këto nisma pranuat se në gjashtë muaj kryetari juaj ju kishte ftuar të luftonit me mullinj të erës, pa ligj, sepse nuk kishit asnjë bazë ligjore për hapjen e kutive.

Edhe sot, pas gjashtë muajsh, jeni të njëjtën situatë, vetëm se jeni më të lodhur, pasi me urdhër të kryetarit tuaj keni harxhuar energji të pafundme për të dëmtuar imazhin e vendit, për të dëmtuar procesin e liberalizimit të vizave dhe për të vonuar integrimin në BE. Pse? Sepse kryetari juaj i papërgjegjshëm nuk arriti të bëhej kryeministër i vendit.

Pra, na thoni, kolegë socialistë: a shkuat pas gjashtë muajsh në hullitë që thoshim ne në fillim?

Shembull tipik i kësaj është ajo që ju keni shumë për zemër: kutia e Ruzhdies. Kur Prokuroria hapi kutinë e Ruzhdies (megjithëse ajo kuti ishte pranuar nga të gjithë si kuti e pavlefshme, e shpallur kjo edhe ligjërisht), ju u ngazëlluat, sepse menduat se u hap kutia e Pandorës.

A e shikoni, të nderuar kolegë, se ka një rrugë ligjore për të shkuar te kutia? Pranojeni dhe thojuni shqiptarëve se i keni gënjer dhe i keni mashtruar për gjashtë muaj rresht! Thojani edhe kryetarit tuaj, se ne ua kishim thënë që në fillim, por ju nuk e pranuat. Si u hap kutia e Ruzhdies? Prokuroria e hapi pasi ia kërkuat ju. Pra, e gjetët një rrugë ligjore për të hapur kutitë, jashtë kompetencave dhe fuqisë së Qeverisë dhe jashtë komisionit hetimor. Ju kërkuat të hapej një kuti dhe ajo u hap. Atëherë, kërkojini Prokurorisë të hapë të gjitha kutitë që doni në të njëjtën mënyrë siç hapët kutinë e Ruzhdies!

Pastaj hajdeni të ngremë komisionin hetimor për të gjitha çështjet e tjera dhe mos i stresoni shqiptarët me broçkullat që formulon kryetari juaj, se nuk ua kanë borxh as ju, as kryetarit tuaj që t'u bëheni pengesë në rrugën e tyre të mbarë drejt Europës. Mjaft i penguat tetë vjet, kur kishit në dorë fatin e tyre. Tani, në qoftë se kryetari juaj nuk do të kontribuojë për të mirën dhe të ardhmen e shqiptarëve, të paktën mos i vini shkopinj të nën rrota trenit shqiptar, që po ecën drejt Europës.

Falemnderit!

Nasip Naço – Falemnderit, zoti Moka!

Fjalën e ka zoti Koci.

Ervin Koçi – Të nderuar kolegë deputetë,

Është hera e parë që më jepet mundësia të diskutoj nga kjo foltore e nderuar dhe ndihem shumë i trishtuar, si të gjithë deputetët e tjerë socialistë. Ndihem i trishtuar sepse pas njëzet vjetësh nga rrëzimi i partisë-shtet, përsëri po luftojmë për themelin e demokracisë: votën e lirë, e cila është dhunuar nga pushteti i sotëm.

Dhunimi i votës së lirë nuk ka asnjë ndryshim nga sistemi i mëparshëm monist, pasi edhe sot, kush nuk voton për partinë në pushtet, që është e njëjtësuar me shtetin, jo vetëm që hiqet nga puna, por edhe kur kërkon të marrë një shërbim nga institucionet shtetërore, për të cilat paguan taksa, përçmohet dhe dhunohet.

Sot ai që vjedh votat, jo vetëm që mbrohet nga shteti, por ka të sigurt një vend pune në administratë për shërbimin që i ka bërë partisë në pushtet. Gjatë të gjithë fushatës të gjithë ata që nuk votonin për partinë në pushtet, hiqeshin nga puna, dhunoheshin

psikologjikisht apo u ndërpritej asistencë sociale. Dhunimi arrinte deri atje sa u ndërpritej edhe uji i pijshëm dhe kërcënoheshin për prishje të ndërtimeve pa leje. U përdor blerja e votës, duke shfrytëzuar varfërinë popullore, që ju e përkeqësuar vetë.

Gjatë ditës së votimit ndaj komisionerëve dhe zgjedhësve në shumë qendra votimi u ushtrua terror psikologjik. Në disa qendra pati edhe dhunë. Në shumë të tjera bëtë çmos t'i binit. Në ditën e numërimit të votave partia në pushtet bëri gjithçka që mundej për të deformuar vullnetin e qytetarëve.

Kryeministri bëri diversion dje për komisionerët tanë. Po shfrytëzoi këtë rast për të falënderuar të gjithë komisionerët e Partisë Socialiste dhe partive aleate në Qarkut e Fierit, që bënë një sakrificë të pashembullt për të mbrojtur votat nga vjedhja e organizuar nga vetë Kryeministri.

Në komisionin e numërimit të votave në ZAZ-në 20, Partia Socialiste kishte shumë gra, disa edhe mbi 50 vjeç, që për gjashtë ditë me radhë nuk lëvizën nga vendi i numërimit të votave. A e di Kryeministri arsyen pse qëndruan ata komisionerë për gjashtë ditë larg familjeve të tyre? Që me shpirtin e tyre demokratik të mbronin votat që Kryeministri të mos u vidhte mandatin e nëntë të Qarkut të Fierit.

Dje një deputet i Partisë Demokratike i Qarkut të Fierit ngriti problemin se në dy qendra në Libofshë, ku kishte fituar Partia Socialiste, nuk ishin shënuar kartat e identitetit. Po, kjo është e vërtetë. Duhet të hapim kutitë së bashku dhe të verifikojmë nëse është një gabim teknik nga mostrajnimi e komisionerëve, apo i bërë me qëllim nga komisionerët. Pra, të nxjerrim problematikën reale dhe jo atë dyshuese.

Të hetojmë kush ka votuar. A ka aty ndonjë person që ka qenë jashtë shtetit atë ditë? A ka firmën e falsifikuar? Dhe mbi çdo gjë tjetër, ku ju dyshoni.

Personalisht ju garantoj me përgjegjësinë maksimale timen, nëse është një gabim teknik. Por unë ftoj të gjithë deputetët të hapin kutitë e qendrës së votimit numër 3193, në fshatin Rreth- Libofshë në komunën Libofshë, ku komisionerët tanë, të cilët Kryeministri ynë i dashka kaq shumë, u dhunuan që në mëngjes. Janë hedhur 120 vota në kuti dhe KZAZ-ja, ku ju kishit shumicën, e quajti të vlefshme, edhe pse në një kuti kishte nga dhjetë fletë të pandara dhe në listën e votimit ishte një person që kishte firmuar për të gjithë këta votues. Të hapen edhe kutitë e tjera të Qarkut të Fierit, edhe kutia e qendrës së votimit numër 3195. Pra, edhe ju si forcë

politike, pasi ky deputet ngriti pretendime për zgjedhjet.

Kjo është një arsye më shumë për të hetuar problematikën e zgjedhjeve në mënyrë të plotë dhe të nxjerrim problematikën reale, në mënyrë që në zgjedhjet e ardhshme të mos përsëriten më këto fenomene, por të jenë zgjedhje të standardeve ndërkombëtare.

Por ju, si pushtet, përdorni çdo mjet dhe mënyrë për të deformuar votën popullore, duke instaluar fenomenin më të keq për një vend me demokraci hibride, të brishtë: korrupsionin elektorale. Maskarada e Ruzhdies e tregoi qartë këtë, por Ruzhdia nuk është një rast i vetëm, është një fenomen, pasi ka shumë qendra të tjera votimi në Qarkun e Fierit, shumë e shumë të tjera në qarqet e tjera, ku vjedhja e votës ka qenë masive.

I gjithë ky mekanizëm i korrupsionit elektorale, i ngritur për të mbajtur me çdo kusht pushtetin, sot ka sjellë pasoja të rënda për vendin, duke ua përkeqësuar çdo ditë e më shumë jetesën shqiptarëve. Të ardhurat për banor në vendin tonë janë më të ulëta në Ballkan dhe më të ulëta e Europës, duke lënë pas vetëm dy shtete ish-sovjetike.

Qeveria e ngritur me votat e vjedhura nga korrupsioni elektorale, ka shkaktuar pasoja të rënda për shoqërinë tonë, duke krijuar një piramidë korruptive të shtrirë në të gjithë hierarkinë shtetërore. Organizatat kompetente ndërkombëtare e vlerësuan Shqipërinë si vendi që ka bërë regres në vitin 2009, ndërsa për sa i përket luftës ndaj korrupsionit, një ndër qeveritë më të korruptuara në Europë.

Në vitin 2009 u premtua se do të mblidheshin 5 miliardë dollarë, edhe pse buxheti ishte miratuar më pak, ndërkohë realisht në vitin 2009 nuk u arkëtuan as 3 miliardë dollarë. Pyetja është e thjeshtë: ku shkuan 2 miliardë dollarë? Përgjigjja është ende më e thjeshtë, për çdo qytetar të Shqipërisë: u vodhën dhe u shpërdoruan nga korrupsioni elektorale.

Për vitin 2010 janë planifikuar të arkëtohen 3.6 miliardë dollarë. Unë nuk e di sa herë të tjera do të ndryshojë buxheti, apo sa do të jetë realizimi deri në fund të vitit. Të ardhurat nga doganat për dymujorin janë realizuar vetëm 92.6 për qind, edhe pse kemi një rritje të ndjeshme të barrës fiskale nëpërmjet çmimit të referencës. Efektet pozitive vijnë si pasojë e vlerësimit të lekut, rritjes së çmimeve të hidrokarbureve në bursën kombëtare, apo si pasojë e efekteve inflacioniste. Po ta krahasojmë me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke zbritur efektet

pozitive që përmendëm më lart, kemi një ulje reale të të ardhurave me 7 për qind. Gjatë periudhës dymujore, krahasuar me një vit më parë, pati një rënie të ndjeshme të volumeve të pothuajse të gjitha produkteve.

Të ardhurat nga tatimet nuk janë realizuar, sipas vetë drejtuesve të këtij institucioni. Por asnjë shifër nuk bëhet publike dhe transparente, pasi kjo qeveri, kur vjedh votat, mund të fsheh gjithçka. Pushteti i ardhur nga votat e deformat, jo vetëm që po keqmenaxhon financat, por edhe po deformon të dhënat financiare në disa drejtime. Shifrat që dalin nga institucionet shtetërore dhe ato që dalin nga INSTAT-i janë krejt kontradiktore dhe nuk kërkohen analiza për të kuptuar manipulimin e të dhënave.

Banka e Shqipërisë, në vrotimin që ka bërë për tendencat e ekonomisë për vitin 2010, paraqet se bizneset raportojnë për një rënie të kërkesës së brendshme dhe të jashtme dhe për një keqdrejtim të nivelit të kontratave porositëse. Pritjet për situatën ekonomike për vitin 2010 nga biznesi deri te konsumatorët janë tejet negative, duke parashikuar një situatë shumë pesimiste.

Qeveria e dalë nga korrupsioni elektoral ka mobilizuar çdo treg, siç është tregu i gazit të lëngshëm, ku, për shkak të monopolit, qytetarët e blejnë me 100 lekë më shtrenjtë kilogramin. Alokimi i të ardhurave sipas rrethëve dhe qarqeve është një korrupsion më vete, me destinacion shqiptarët që kanë vjedhur votat.

Për nga derdhja e detyrimeve, Qarku i Fierit është qarku i dytë pas atij të Tiranës, si në vlerë absolute, ashtu edhe për çdo qytetarë. Për nga niveli i investimeve që jepen nga Buxheti i Shtetit ne jemi qarku i tetë, pasi taksat shkojnë në Qeveri për të bërë shpenzime korruptive ose për të bërë studimin e fizibilitetit.

Energjia elektrike është rritur ndjeshëm me mbi 13 për qind. Një vizitë në sistemin shëndetësor për të pasiguruarit, domethënë të papunët, ka shkuar nga 1 deri në 3 mijë lekë, sipas nivelit të specialistit. Çmimet e produkteve të domosdoshme të konsumit të përditshëm po rriten. Fuqia blerëse është ulur ndjeshëm për çdo familje shqiptare. Investimet publike, edhe eksportet dhe importet, kanë rënë ndjeshëm, duke rritur papunësinë, përveç eksportit të energjisë elektrike që është rritur.

Niveli i borxhit të shtetit të marrë për vitet 2008-2009, duke e krahasuar me atë të viteve të kaluara, është rritur disa herë, duke marrë kredi nga bankat e huaja me numër interesi nga më të lartat në botë.

Por edhe ky borxh u keqpërdor për të qenë pjesë e një korrupsioni elektoral, duke prishur të gjithë treguesit makroekonomikë të vendit. I harruat premtimet që i bëtë fermerëve, që do t'u hiqnin akcizën e karburante. Kjo nuk ka ndodhur dhe nuk ka për të ndodhur asnjëherë për sa kohë ju do të jeni në pushtet me vota të vjedhura. Produktet që prodhojnë fermerët, me ekonomitë e tyre të vogla bujqësore, janë në shtëpitë e tyre ende të pashitura. Tarifat e punimeve dhe çmimet e produkteve bujqësore janë rritur, duke i rrënuar më tej familjet fshatare.

Sot ky pushtet, i siguruar nga korrupsioni elektoral, merr nëpër këmbë të drejtat e çdo qytetari të ndershëm, ashtu siç nëpërkëmbi edhe votën e tyre. Po vazhdon zaptimi i tokave të fermerëve, duke mos i shpronësuar ata, ose përdoren dy standarde vlerësimi për të njëjtat parcela toke.

Sa për dijeni, vetëm në komunën e Frakullës janë 260 familje, po kaq janë edhe në komunën e Stavrit dhe të Levanit, të pashpronësuar, edhe pse ka dy vjet që tokat u janë zaptuar nga shteti. Pas privatizimeve abuzive në energjetikë dhe në hidrokarbure, ky pushtet po çon tashmë drejt falimentit shoqërorinë shtetërore "Albpetrol", për t'ia shitur me një çmim modest klientëve të partisë në pushtet. Skenari i shitjes së çdo prone publike me nxitim dhe në këto kushte të papërshtatshme të tregut, është një tjetër makutëri e kësaj qeverie.

Të gjitha këto problematika që përmenda më sipër ndodhin sepse pushteti që vjedh vota do të kërkojë të grabisë gjithçka. Ky pushtet nuk ndien më për qytetarët e vet.

Të nderuar deputetë,

Ky pushtet i siguruar nga korrupsioni elektoral e ka futur vendin në një krizë të thellë politike, ekonomike, institucionale dhe sociale, që po përkeqësohet çdo ditë e më shumë. Prandaj e gjithë beteja për hetimin e këtyre zgjedhjeve, është një betejë për të bërë transparencën se si qeveriset vendi, pasi një pushtet që vjedh votën, vjedh gjithçka.

Të nderuar deputetë,

Për të mirën e vendit, pushteti i sotëm duhet t' i japë zgjidhje kërkesave tona për të hetuar plotësisht zgjedhjet, si një e drejtë kushtetuese, pasi vendimet e gjykatave, që ju pretendoni, nuk kanë të bëjnë fare me kërkesat tona. Nëse ju nuk na krijoni mundësinë që të hetojmë zgjedhjet, ju do të merrni të gjithë përgjegjësitë dhe kostot që do të vijnë pas kësaj. Protestat tona nuk do të kenë të ndaluar deri në largimin përfundimtar të kësaj qeverie dhunuese

të votës së lirë.

Falemnderit!

Nasip Naço – Falemnderit, zoti Koci!

Fjalën e ka zonja Bulku.

Rajmonda Bulku – Të nderuar deputetë,

Sot u bënë dy ditë që rrimë këtu dhe, pa dyshim, nuk mund të jesh indiferent në një sallë që ka shumë probleme.

Nuk kam marrë përsipër të bëj ndonjë hartim melodramatik, sepse politika e opozitës është shumë e thjeshtë. Shumë e thjeshtë, por shumë e keqe dhe e dëmshme. Sepse akoma opozitës sonë nuk i është mbushur mendja se edhe po nuk fitove zgjedhjet, nuk është mëkat. Nuk do të vdisni, zotërinj! Por duhet të vini këtu dhe të bëni punën tuaj. Atë punë që ju ka besuar elektorati, atë punë për të cilën ju ka votuar dhe të cilën ju keni për detyrë ta bëni.

“Nuk kemi kohë”, - tha dikush nga ju. Vërtet nuk kemi kohë. Shqiptarët nuk kanë më kohë që ne të sjellim një kaos që nuk ka pse të jetë dhe t'i vonojmë qoftë edhe një ditë që ata të udhëtojnë të lirë nëpër botë. E kanë ëndërr të hershme dhe këtë radhë nuk jemi ne ata që po ua pengojmë. Më vjen shumë keq që jeni ju. Edhe sikur një orë, edhe sikur një ditë të vonohet kjo gjë, ju jeni fajtorë, sepse nuk keni asnjë shkak dhe asnjë arsye për të mos qenë këtu.

Hapja e kutive është një gozhdë Nastradini. Këtë ju e dini më shumë dhe më mirë se ne. Dhe e kuptoni mirë se sa keq veproni duke qëndruar jashtë këtij Parlamenti. Keni zgjedhur rrugën. Dakord! Mbase është mirë për ju, por nuk është mirë për shqiptarët. Një parafolës nga ana juaj në diskutimin e tij përmendi termin “krim elektorale”.

Më falni zotërinj, kur flet një femër, ajo mund të mallëngjehet, si nënë, si motër, si grua, por dua të them se fjalët “krim elektorale” nuk ka të bëjë me ne. Nuk ju ka vjedhur njeri votë, se s'ju vidhet juve. Nuk ju ka bërë njeri krim elektorale. Nuk ka bërë njeri gjë të keqe, që ju të rriini në atë rrugë të madhe, pa krye, pa fund, të cilën nuk dini edhe vetë se si do ta përfundoni, sepse e keni filluar si një film serial dhe keni filluar të bëheni personazhe negativë, por nuk dini fundin. Kjo shprehje “krim elektorale” lidhet me një ditë të shëmtuar, mbasi ishin mbyllur zgjedhjet.

Dy ditë mbas zgjedhjeve, ju zotërinj, që jeni të prirë për të qenë dhe për ta bërë vetë krimin, me pafytyrësinë më të madhe, me moralin e kriminelit, keni denjuar që të dirigjoni një turmë njerëzish të irrituar, për të bërë gjithçka mbi dy femra që ishin

duke kaluar, kandidate për deputete, të cilat nuk duhet të cenoheshin. Unë nuk e kuptoj pse duhet të përmendin termin “krimin elektorale” në anën tonë, që nuk e keni parë në asnjë vend. Dhe ne nuk folëm. Nuk folëm jo se ishim naivë apo jo se ishim të fortë, por nuk folëm për një arsye madhore, zotërinj, që ju nuk e përtypni. Ne nuk folëm sepse nuk donim të prishnim imazhin e atij momenti që ishte shumë delikat për Shqipërinë. Nuk doni t'u thoshim të huajve që ne kemi dhe probleme të tilla dhe i përtypëm gjërat, por ju nuk doni të kuptoni. Ju jo vetëm që nuk kërkoni falje, por jeni akuzues edhe për palën tjetër. Ky është morali juaj, zotërinj.

Shqiptarëve dua t'ju them diçka, sepse më vjen për ta thënë. Vetëm për një gjë më vjen keq që jam këtu: edhe mbas 20 vjetësh, të dashur shqiptarë, këtu ka fytyra dhe emra komunistësh, dhe të vjen për të ulëritur: “Poshtë komunizmi!”. Kjo është fatkeqësi shumë e madhe për të gjithë ne.

(Duartrokitje në sallë)

Nasip Naço – Falemnderit, zonja Bulku!

Fjalën e ka zoti Hasa.

Skënder Hasa – Të nderuar kolegë,

Në zgjedhje të lira dhe të ndershme, pra në një garë elektorale konkurrojnë programet, idetë politikëbërëse, si dhe vlerat e subjekteve politike. Në këtë garë gjithmonë ka një fitues, i cili duhet të dalë nga vullneti i lirë dhe nga verdikti i votuesve. Gjithmonë, kur është një proces transparent, i lirë dhe i ndershëm, fituesi duhet të urohet nga të gjithë pjesëmarrësit në garë. Por çfarë ndodhi më 28 qershor? Deformimi i hapur dhe grabitja e vullnetit të votuesve shqiptarë, njëkohësisht deformuan vullnetin që ndodhet brenda në kutitë e votimit. Më 28 qershor kemi një garë të pabarabartë: shkrimi dhe shtetit me pushtetin; presioni ndaj administratës publike për të votuar pushtetin; lëvizje të shumta në administratë për qëllime elektorale në favor të pushtetit; detyrimi i administratës për të marrë pjesë në mitingje të pushtetit; përdorimi i nxënësve dhe i mësuesve të shkollave gjatë orëve të mësimi në takime elektorale të pushtetit; detyrimi i administratës dhe i punonjësve të arsimit për të deklaruar votën në favor të pushtetit; lirimi i të burgosurve nga burgjet e sigurisë së lartë për të bërë presion mbi votuesit për të votuar pushtetin, si dhe shumë forma dhe mënyra jomorale, joligjore në interes të votimit për pushtetin në fuqi. Pra, ditët e qershorit të vitit 2009 kanë qenë jo vetëm të nxehta, por edhe shumë të tensionuara, nën presionin e pushtetarëve për të rimarrë me çdo kusht pushtetin.

Por nuk u mjaftuan me kaq. Ditët e fundit, nëpërmjet medieve, jemi njohur me fenomenin "Ruzhdië", hapja e së cilës dhe zbardhja e dokumentacionit në të, nuk bëri gjë tjetër vetëm se fakti, në mënyrë transparente dhe të pakundërshtueshme, kriminel elektoral që ka ndodhur në të gjithë Shqipërinë më 28 qershor.

Deklaroj në sallën e Kuvendit se kutitë e tipit dhe të fenomenit "Ruzhdië" në rrethin e Peqinit në KZAZ-në nr. 16 janë disa. Në KZAZ-në nr. 16, kemi shumë komisionerë që kanë firmosur për persona të tjerë, pa marrë pjesë në votim. Kemi njerëz që jetojnë jashtë shtetit, por që figurojnë të kenë marrë pjesë në votim ditën e zgjedhjeve dhe në emër të tyre kanë firmosur persona të tjerë. Janë me qindra fletë votimi të pavlefshme, madje edhe qendra votimi të pavlefshme jo nga dora e votuesit, por nga përdorimi në këtë fushatë i parave të pista të korrupsionit qeveritar në Gërdec, i parave të pista të korrupsionit qeveritar të rrugës Durrës-Kukës, para të cilat bënë të mundur që në rrethin e Peqinit të deformohej dukshëm vullneti i votuesve. Dhe kuti të tipit "Ruzhdië" nga transparenca që do t'u bëjmë zgjedhjeve në Shqipëri, do të kemi shumë. Kjo është edhe arsyeja që maxhoranca e sotme, ka frikë nga e vërteta, nga hapja e kutive, sepse kjo e vërtetë shumë e hidhur për ta gjendet brenda në këto kuti.

Është thënë shumë herë dhe përsëri e themi: kutitë duhet të hapen jo për të rinumëruar votat, jo për efekt të ndryshimit të mandateve, por vetëm për transparençën e këtyre zgjedhjeve, për të hetuar dokumentacionin zgjedhor, për të konstatuar shkelje ligjore, shkelje të cilat nuk duhet të përsëriten më. Transparenca e zgjedhjeve të 28 qershorit nuk është vetëm në interes të Partisë të Socialiste dhe të votuesve të majtë, por është në interesin e të gjithë votuesve shqiptarë, të majtë dhe të djathtë.

Sot dhe përditë qytetarët shqiptarë po e kuptojnë se nga manipulimi i zgjedhjeve, nga deformimi i vullnetit të popullit dhe nga shkrirja e shtetit me pushtetin lindin maxhoranca dhe qeveri që në plan të parë nuk kanë qytetarin, administrimin, funksionimin e shtetit ligjor, por veprime korruptive, abuzime me fondet publike, nga ku prodhohet Gërdec, përmbajtje dhe keqmenaxhim. Sot dhe përditë, qytetarët shqiptarë po shikojnë rritje të papunësisë. Shikojmë shumë mosha të reja që janë të pashpresa për të ardhmen e vendit të tyre. Çdo ditë kemi rritje çmimesh, të pranuar këto edhe nga INSAT, të cilat ndikojnë në shtimin e varfërisë së familjeve shqiptare. Kemi shtimin e listave të

borxheve për ushqimet e konsumit të pritshëm. Kemi çdo ditë dhe më tepër pasiguri të qytetarëve për të nesërmen e tyre. Kemi krizë që ka zaptuar vendin, të cilën ju nuk e pranoni, por, po të ecni në rrugë, do të shikoni njerëz që flasin me vete për pasigurinë e tyre, për pamundësinë për të garantuar familjen me ushqime të përditshme, të pasigurt për atë çka do t'u ndodhë nesër.

Biznesi i vogël nga viti në vit ka rënie të xhiros për arsye të mungesës së fuqisë blerëse. Gjithashtu kemi edhe shumë falimentime të këtij biznesi, nga fakti i rritjes së taksave nga qeveria e tyre. Është për të ardhur keq për ndërtuesit shqiptarë, të cilët punojnë pa likuiditet, jo me para në dorë, por me sistemin e kleringut, ku çdo gjë po shkëmbehet, mall me mall, duke u kthyer në mesjetë.

Për të gjitha sa thashë më sipër, opozita është më e vendosur se kurrë: ajo kërkon t'u japë fund një herë e përgjithmonë fenomeneve të jashtëligjshme, të cilat kanë cenuar dhe karakterizuar procesin zgjedhor në Shqipëri prej 20 vjetësh. Sot nga ana e opozitës kërkohet konsensus, i cili ka një qëllim të vetëm: kthimin e besimit të qytetarët shqiptarë të zgjedhjet e lira dhe të ndershme. Duke bërë transparençën e zgjedhjeve, kemi instrumentin e shkuljes së korrupsionit nga procesi zgjedhor. Le ta bëjmë këtë hap me kurajë dhe me besim reciprok sa nuk është vonë.

Falemnderit!

Nasip Naço – Falemnderit, zoti Hasa!

Fjalën e ka zoti Papa.

Gjergji Papa – Falemnderit, zoti drejtues i seancës!

Të nderuar kolegë deputetë,

Shumica e deputetëve socialistë në hartimet e tyre të bukura, të konstruara të gjitha njëllor, po përpiqen të hedhin tymnajën sikur maxhoranca nuk është për transparençë të plotë të zgjedhjeve të 28 qershorit dhe për ngritjen e komisionit hetimor. Deputetët e Partisë Demokratike ofrojnë një zgjidhje konkrete, në përputhje me Kushtetutën, duke respektuar parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve. Për qeverinë e Partisë Demokratike, në mandatin e parë, cilësia e procesit zgjedhor ishte më e rëndësishme se rezultati i zgjedhjeve. Këtë sfidë ne e kaluam me sukses, me procesin zgjedhor, të cilësuar nga të gjithë monitoruesit vendas dhe të huaj, si procesi zgjedhor më i mirë i realizuar ndonjëherë në Shqipëri dhe, për pasojë, e certifikuan atë.

Dua të them dy fjalë për ecurinë e procesit zgjedhor në qytetin e Korçës për ditën e votimit si

dhe për ditët e numërimit të votave. Vlerësoj edukatën qytetare, politike dhe demokratike të kandidatëve për deputetë, të drejtuesve të partive politike, të komisionerëve dhe të numëruesve të të dyja forcave politike, si të Partisë Socialiste, ashtu edhe të Partisë Demokratike. Këtë e kanë dëshmuar publikisht edhe vetë deputetët e arsyeshëm të Partisë Socialiste. Një numërues i PS-së në qytetin Korçës, gjatë numërimit i tha një kolegut të tij demokrat se ishte gati ta mbronte votën e Partisë Socialiste edhe me gjak, po të ishte nevoja.

Më thoni, të nderuar kolegë, deputetë të Partisë Socialiste, a do të lejoni këta numërues të PS-së, të cilët ishin gati të jepnin edhe jetën e tyre, që t'i vidheshin vota Partisë Socialiste? A do të lejonin komisionarët e PS-së që në vend të të afërmeve të koleges sime socialiste, të cilët jetojnë mijëra kilometra larg Shqipërisë, të hidheshin vota për Partinë Demokratike?

Ja, pra, se sa absurde dhe shpifje të ulëta na duken jo vetëm ne deputetëve në këtë sallë, por të gjithë popullit shqiptar shprehje të tilla si: "krim elektoral", "masakër elektorale" dhe "vjedhje e votave". Ju keni ardhur këtu sot të flisni pa mbarim, të përsërisni të njëjtat fjalë, të shpifni dhe të thurni gënjeshtër absurde jo vetëm për çështjet që janë në rendin e ditës, por për gjithçka, duke mos pasur aspak, në të vërtetë, dëshirën për të zgjidhur problemin, si dhe për të gjetur konsensus. Deputetët e Partisë Socialiste vazhdojnë të flasin për krizë politike në vend. Kjo krizë është shkaktuar me ndërjegje të plotët nga ju. Ajo është krizë e Partisë Socialiste. Është krizë e lidershit të Partisë Socialiste. Kjo është humbja e Edi Ramës. Alibia e kutive po përdoret për të justifikuar humbjen në zgjedhjet e 28 qershorit. Le të shpresojmë vërtet që të keni dashamirësinë për të gjetur kompromisin, për të cilin ne jemi totalisht të gatshëm. Unë personalisht jam skeptik, sepse ju vazhdimisht flisni për protesta popullore, për dorëheqje dhe për zgjedhje të parakohshme. Njerëzit nxiten nga ju për të dalë në rrugë, që ju t'i quani protesta mbarë popullore, me shpresën dhe me dëshirën e përmbysjes me dhunë të pushtetit. Ju nuk jeni për transparencë të plotë. Ju nuk jeni për hetim të plotë. Ju jeni vetëm për bojkot. Sot doni të flisni të gjithë, se e keni herën e parë. Le të shpresojmë që të mos e keni herën e fundit.

Të nderuar kolegë të Partisë Socialiste,

Ju ftoj të ndërprisni diskutimet, sepse po përsëritni të gjithë të njëjtat fjalë dhe t'i futemi punës

për të miratuar nenet e projektligjit dhe të projektvendimit për hartimin e komisionit hetimor.

Falemnderit!

Nasip Naço – Falemnderit, zoti Papa!

Fjalën e ka zonja Felaj!

Ermonela Felaj – Zotërinj deputetë, do të kishim dashur që në diskutimet e këtyre dy ditëve të kishim dëgjuar prej maxhorancës fjalë që të shprehnin vullnet për zgjidhjen e krizës. Përkundrazi, dëgjuam diskutime të pacipa, që në fakt tregojnë frikën tuaj të madhe nga hetimi i zgjedhjeve të kaluara. Është e qartë, kur dikush nuk ka argument për t'u mbrojtur, shan e bërtet, madje thotë edhe parulla me shpresën se diçka do të ngelet. Sigurisht që kjo vlen vetëm për mendjet boshe.

Të gjithë e kuptojnë se votimi juaj pro në parim për projektligjin që ju kemi paraqitur është hipokrizia e radhës. Shtireni kur thoni se jeni të gatshëm për hetim parlamentar të zgjedhjeve, pasi amendimet që ju i keni paraqitur Kuvendit, ia heqin këtë të drejtë, madje edhe të drejtën për të hetuar çdo çështje tjetër, duke e shndërruar Kuvendin në një kukull në duart e Qeverisë, të cilën kjo e fundit i sjellë mbarë e prapë si të vijë. Jo, zotërinj. Kuvendi nuk është kukull. Kuvendi është sovran dhe sovran nuk mund të preket dhe as të nëpërkëmbet sikurse kërkoni ju të bëni nga kjo tribunë. Ju nuk e dëshironi hetimin e zgjedhjeve jo sepse ju shqetëson respektimi i parimeve kushtetuese, madje të asaj Kushtetute të cilën ju as nuk e keni votuar, ju tremb e vërteta e kutive të votimit, ju alarmojnë përmasat e krimit elektoral deri atje sa çdo ditë e më shumë po i tregoni gjithë vendit dhe gjithë faktorit ndërkombëtar se sa të papërgjegjshëm jeni, se sa fort ju kanë kapur ethet e pushtetit, të atij pushteti të cilin ju e ngritët mbi gënjeshtërën, mbi falsifikimin e qindra firmave të atyre njerëzve në Ruzhdie dhe sa e sa Ruzhdieve të tjera në të gjithë Shqipërinë.

Ju zotërinj sot talleni me Ruzhdien, madje ju Ruzhdia ju bën të qeshni e të nënqeshni, ju bëjnë për të qeshur komisionerët tuaj që falë militantizmit të verbër të tyre u treguan mjeshtër të vërtetë, por mos harroni se mjeshtëri të tilla herët a vonë të përplasen për fytyrë. Ruzhdia, zotërinj, është dështim i pastër juaji. Ruzhdia, zotërinj, tregon qartë se ju pasi keni humbur besimin se edhe zgjedhësit tuaj tradicionalë do t'ju votojnë, keni nisur të falsifikoni edhe të dhënat e tyre.

Ju, zotërinj të mazhorancës, sigurisht jo nga dëshira, por nga mëkati ku ju nxitën komisionerët tanë falsifikuat të dhënat për 325 votues në Ruzhdie

nga 525 që votuan atje gjithsej. Por kjo nuk përbën problem për ju, meqë edhe Kolegji Zgjedhor i paska shpallur të pavlefshme votat e atjeshme. Sigurisht që nuk ka dhe nuk do të ketë arsytim më naiv se ai që justifikon vjedhjen dhe falsifikimin e votës. E kuptoj shumë mirë se fakti "Ruzhdie" ju bezdis, bezdis më tepër profesionistët tuaj të ligjit, që pasi ju vunë përballë një fakti të pamohueshëm, rendën në dhjetëra citime vendimesh të gjykatave kushtetuese të njohura dhe të panjohura në dhjetëra interpretime pa sens se si kjo Ruzhdia të mos dëgjohej.

Gaboheni zotërinj, nuk është vetëm një Ruzhdie, ka të tilla në gjithë Shqipërinë dhe ju nuk mund t'i pengoni të dalin edhe me artifat tuaja ligjore që një komisioni hetimor parlamentar nuk ia lejojnë këqyrjen dhe administrimin e dokumenteve zgjedhore jo vetëm kur ato janë trajtuar nga gjykata e prokuroria, por dhe në rastin e kundërt, me arsyetimin se nuk paskemi ezauruar rrugët e ankimit në KQZ dhe në Kolegjin Zgjedhor.

E drejta për të ngritur komision parlamentar është veçanërisht e drejta e pakicave në parlament, është mjet në duart e saj për të ushtruar kontroll ndaj ekzekutivit dhe gjithë pushtetmbajtësve për mënyrën se si këto e zbatojnë ligjin. Kjo e drejtë nuk mund të kufizohet nga vullneti juaj si mazhorancë.

Ne kemi të drejtë të hetojmë të gjitha aspektet e zhvillimit të zgjedhjeve, përfshirë këtu procesin e votimit dhe administrimit të tij. Hetimi i kutive të votimit, përmbajtjes së tyre është aspekti me i rëndësishëm i hetimit të zgjedhjeve çka në vetvete i jep kuptimin hetimit që kërkojmë ne si opozitë. Ky lloj hetimi nuk ndërhyt në veprimtarinë e pushteteve të tjera, nuk sjell konfondime apo transferime kompetencash. Parlamenti nuk heton në menyrë identike me prokurorinë. Po i referohem këtij organi i cili hetimin specifikisht e ka në natyrën e vet, por jo të pangjashme, për sa kohë u referohen dhe zbatojnë të njëjtat rregulla, ato të Kodit të Procedurës Penale.

Më thoni, ju lutem, se cili organ tjetër kushtetues apo ligjor merr në pyetje dëshmitarë apo thërret ekspertë, bën ballafaqime, këqyr dhe administron dokumenta zyrtare dhe jozyrtare?

Do t'ju lutesha që sadopak të mos fyenit inteligjencën tuaj dhe të gjithë shqiptarëve, sepse është e qartë si drita e diellit se Parlamenti heton fakte të kundërligjshme, të cilat mund të përbëjnë vepra penale e që për këtë të fundit vihet në lëvizje

organi i prokurorisë.

Nese Parlamenti nuk do të hetonte fakte të tilla, atëherë pse do t'i duhej t'i drejtohej prokurorisë në përfundim të veprimtarisë së vet hetimore? Pse ligji ekzistues nga fillimi në fund i referohet vazhdimisht këtij organi, apo pak më tej pse ligji organik i prokurorisë në nenin 53 të tij e detyron Prokurorin e Përgjithshëm të bashkëpunojë me komisionin hetimor?

A mos vallë Parlamenti nuk e di se me çfare merret Prokuroria?

Kuvendi e ka të nevojshme në funksion të ushtrimit të kontrollit ligjvënës, hetimin. Që ky hetim të mund të ngrihet apo të iniciojë ashtu sikur e ka thënë Gjykata Kushtetuese në nje tjetër vendim të saj, vendimin nr.20/2007 duhet të ekzistojnë të dhëna ose indicie të mjaftueshme që dëshmojnë për ekzistencën e një çështjeje për të cilën është i nevojshëm hetimi".

Zotërinj, çështja ekziston, është e veçantë dhe jo e përgjithshme dhe ka të bëjë me Kuvendin e Shqipërisë. Kjo është çështja e zgjedhjeve që kanë nevojë për transparencë, çështje të cilën ju nuk mund ta mohoni, sepse dilni gënjeshtarë në sytë e publikut dhe opinionit ndërkombëtar.

Kryeministri juaj disa herë radhazi ka shprehur gatishmërinë që zgjedhjet të hetohen dhe shumicën ta ketë opozita, por këtu kjo u mohua haptas me justifikimin se nuk është ligjore. Po ku ishte atëherë Kryeministri ynë kur foli, mos vallë në teatër, apo përballë vendit që ka nevojë urgjente të dalë nga kriza ku ai vetë e ka futur?

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës miratoi rezulotë të posaçme për Shqipërinë në kuadër të zgjidhjes së krizës, duke u shprehur se është i nevojshëm hetimi dëri në detaje i zgjedhjeve, që do të thotë hetim të çdo aspekti, ku më i rëndësishmi pa dyshim është procesi i votimit dhe administrimit të votës në komisionet e QV dhe VNV. Sa për dukje, ju e pranoni këtë që u tha nga ndërkombëtarët, por çfarë bëni në të njëjtën kohë? I hiqni hetimit thelbin e tij, duke mos lejuar asnjë lloj akses në kutitë e votimit.

Tashmë është provuar në mënyrë bindëse dhe të arsyeshme si prej nesh dhe prej raporteve të ndërkombëtarëve se zgjedhjet u shoqëruan nga parregullsi, të cilat nuk realizuan potencialin e Shqipërisë për zgjedhje (raporti i OSBE-ODIHR-it) apo patën mangësi (konkluzionet e Këshillit për zgjerimin datë 7-8 dhjetor 2009).

Raporti i OSBE-së, të cilit ju i jeni referuar si

dokumenti bazë për certifikimin e zgjedhjeve, rendit disa shkelje që flasin hapur për problemet proceduriale që shoqëruan votimin:

- mungesa e shënjesit me bojë në gisht, çka lejon mundësinë për të votuar më shumë se një herë;
- influenza në votim;
- votues të cileve iu kërkua fotografimi i votës me celular;
- ngjashmëria e firmave në listën e votuesve, çka tregon për fallsifikim të tyre;
- problemet me listat, ku shumë votues nuk e gjenin veten në to, apo dublikimet në lista;
- përdorimi i administratës publike dhe asetëve publike për zgjedhje;

Të gjitha sa u përmenden nuk janë fakte të simuluara.

Sigurisht që OSBE-ja dhe kushdo qoftë, nuk mund t'ju tundte dokumente para fytyrës, madje dhe atëherë ju kushedi ç'arsyetim do të kishit bërë.

Komisioni hetimor kërkon të njohë nëpërmjet hetimit, nëpërmjet administrimit të dokumentave, të dhënat e tjera të nevojshme e nëpërmjet këqyrjes së një apo disa kutive të votimit, shtrirjen e manipulimit zgjedhor, shkallën e përhapjes së tij, e gjitha kjo në funksion të ndryshimit të Kodit Zgjedhor apo propozimit të dispozitave të reja ligjore, që do t'u mbyllnin rrugën një herë e përgjithmonë falsifikimit të rezultatit dhe dokumentave zgjedhore, probleme të cilat përfundimisht nuk duhet të degradojnë në diskrecionin e disa komisionerëve apo numëruesve.

Prokuroria, gjykata apo armata e prokurorëve e gjyqtarëve të rinj, që ju, zoti Kryeministër, me shumë bujari kërkon t'ia bashkëngjitni këtij organi në funksion të një qëllimi madhor si ai i transparencës në zgjedhje, nuk mundet ta bëjnë këtë punë që do të bëjë komisioni hetimor parlamentar.

E para, sepse prokuroria vetëm do të gjejë, nëse ju do ta lejoni, vetëm përgjegjësi, se kjo është puna e saj, dhe sigurisht gjykatat, nëse ju gjithmonë do t'i lejoni, do të dënojnë përgjegjësit.

E dyta, dhe më e rëndësishmja desha të di se ku do t'i gjeni këta qindra prokurorë ju, zoti Kryeministër, meqë pranoi se zgjedhjet duhen hetuar, por nga prokurorët. Kam përshtypjen se do t'ju duhet të ndryshoni Kushtetutën, atë kushtetutë që ju dhe të tutë e keni aq merak. Ka ikur koha, zoti Kryeministër dhe ju të nderuar deputetë, kur në Shqipëri bëheshe gjyqtar, prokuror a "plepist" me kurse të përshpejtuara drejtësie.

Uroj, uroj sinqerisht që zoti Kryeministër të heqë dorë nga shpikje të tilla, që i vuajmë dhe sot.

Së fundi, do desha t'u përcillja një mesazh të zgjedhësve tanë në qarkun e Beratit. Nuk do të ketë një herë të dytë që ju të vendosni për hapjen ose jo të kutive të votimit dhe kur ai moment të vijë, sigurisht që ju do të jeni rrëzuar, për të kuptuar përfundimisht se gjërat nuk mund të funksionojnë me kokëfortësinë e kokave prej guri, që kërkojnë të mbajnë peng jo vetëm kuti, por të gjithë vendin.

Falemnderit!

Nasip Naço - Falemnderit!

Fjalën e ka zoti Cara.

Igli Cara – Falemnderit, zoti dretjues i seancës, Të nderuar kolegë deputetë,

Prej dy ditësh në këtë sallë dëgjuam nga kolegët socialistë togfjalëshat "korrupsion elektoral", "korrupsion elektoral", "krim elektoral", "krizë e thellë", "krizë politike".

Jam sot në këtë foltore për të diskutuar pikërisht mbi krizën politike që ka emrin Edi Rama. Ky njeri për interesa tërësish personale për të gjetur një motiv për të qëndruar në krye të partisë socialiste pas humbjeve të zgjedhjeve filli një betejë të pamenduar sa absurde aq edhe kundër interesave reale të Shqipërisë dhe shqiptarëve, një betejë me një mbështjellje parimore në emër të transparencës, por me një thelb që nuk eksiton. E njohim rezultatit e zgjedhjeve tha Edi Rama pas tyre dhe para kërkesës së të vetëve për t'u dorëhequr sipas statutit të bërë prej tij. Kur kuptoi se duhej të ikte, ai shpiku kauzën absurde të kutive, duke e bërë këtë fjalë kërcënim për të ardhmen e integritit të vendit duke e bërë këtë fjalë kërcënim për rendin kushtetues, duke e bërë këtë fjalë kërcënim për lëvizjen e lirë të shqiptarëve. E gjithë kjo për interesa personale të një njeriu i cili mbyllur në kutinë e krizës së vet po e kthen kutinë në krizë të vendit.

Sot të gjitha institucionet europiane i kanë drejtuar sytë në këtë sallë në sallën e debatit dhe të kompromiseve të historisë së re shqiptare të 20 vjetëve të fundit. Miqtë tanë ndërkombëtarë kanë folur, kanë kërkuar të gjendet zgjidhja duke përcaktuar si bazë të nisjes së kompromisit shenjtërinë e Kushtetutës dhe të parimit themelor të demokracisë atë të ndarjes së pushteteve. Çfarë do të bëjë politika shqiptare. Do të bëjë kompromis me parimet e demokracisë në kurriz të kushtetutës, themelit të shtetit do të çedojë para kërcënimit të një njeriu të paarsyeshëm qoftë edhe ky lider i opozitës do të krijojë precedentin e rrezikshme që në të ardhmen çdo parti politike apo më keq akoma çdo individ i pakënaqur nga rezultatet të bllokjës

rezultatit dhe reformat pavarësisht pranimit të rezultatit nga mijëra komisionerë dhe numërues të mijërëve forcave politike nga KQZ-ja në unanimitet nga kolegji zgjedhor e mbi të gjitha nga arbitri ndërkombëtar i gjithëpranur: OSBE-ODIHR-i. Unë besoj se është koha që politika shqiptare të tregojë prjekuri të tregojë se është rritur në nivelin e kërkuar nga institucionet dhe organizatat ku keni aderuar apo kërkojmë të aderojmë, të tregojmë se Shqipëria nuk është më barcaletë e radhës që luan kutiash por është një shtet serioz dhe i gatshëm t'i bashkohet familjes evropiane. Të tregojmë se respektojmë konkluzionet e arbitrit ndërkombëtar për zgjedhjet, të tregojmë se dimë të vlerësojmë rezultate e arritura dhe mos hedhim baltë mbi arritjet e vendit për interesa personale apo partiake duke dëmtuar interesat më të mëdha të vendit dhe të qytetarëve.

Të nderuar kolegë deputetë, jam i bindur se shumë shqiptarë janë mbërthyer sot para televizionit për të parë se çfarë do të bëjmë ne në këtë sallë. Na dëgjojnë të flasim dhe besoj se janë të shqetësuar se nga kjo mbledhje do të preken apo jo interesat e tyre. Janë të shqetësuar nëse nga kjo seancë do të dëmtohet procesi aq i dëshiruar i liberalizimit të vizave dhe i lëvizjes së tyre të lirë. Janë të shqetësuar nëse kjo mbledhje do të çojë përpara apo do të ngadalësojë procesin e integritetit të vendit në BE. Jam gjithashtu i bindur se për ta çështja e kutive nuk është çështje e ditës. Ato votuan në qershor në zgjedhjet më të mira që ky vend ka parë, votuan për mazhorancën dhe presin prej saj të bëjë realitet premtimet e dhëna, presim t'u bëhet jeta më e mirë dhe e konsiderojnë këtë çështje të mbyllur për katër vjetet në vazhdim. Interesat e qytetarëve nuk janë në kuti, janë jashtë kutive.

Do t'u bëja thirrje kolegëve deputetë të PS-së ta lenë Ramën në rutinë e krizës së tij dhe të bëhen pjesë e Parlamentit për të kontribuar të gjithë së bashku në sfidat e mëdha që presin Shqipërinë dhe shqiptarët në rrugën e integritetit. Mos i zhgënjëni shqiptarët, të nderuar kolegë, tregojuni atyre të vërtetën, tregojuni atyre se nuk jemi të gjithë në një mendje me kryetarin tuaj.

Tani kam diçka për kolegun socialist nga Durrësi, i njëjti njeri që dikur në 2001 gjakosi Liri Dibrën në diskutimin e tij përveç të tjerash rreshtoi për turp të tij, të forcës së tij politike e votuesve të opozitës një sërë shpifjes dhe akuzash për procesin zgjedhor në Durrës. Sinqerisht, në diskutimin tim nuk e kisha llogaritur që do të dilte një njeri nga deputetët e

Durrësit për të përbaltur procesin zgjedhor, por me sa duket ora e kolegut socialist paska mbetur në vitin 2001, kur forca e tyre politike bënte presion mbi qytetarët, kur nxirrnin certifikata false për militantët e tyre, përdornin dhunën verbale dhe fizike mbi komisionerët e PD-së, rrihnin njerëzit që vendosnin postera të PD-së (për këtë rast ka edhe një procedim penal), e treguan edhe këtë radhë kur shkuan akoma më larg kur vranë një anëtarë të PD-së, baba të tre fëmijëve. Çfarë t'u rreshtoj më tepër? Qytetarët e Durrësit ia kanë dhënë përgjigjet këtij politikani. Shyqyr që u bë sistemi proporcional që është bërë deputet! Unë kërkoj që të ktheni pak prapa në kohë në vitin 2007, kur ne pranuan rezultatit në bashkinë e Durrësit, pavarësisht se ishte shumë pak 300 vota. Kërkuam në Kolegjin Zgjedhor, apeluam nuk fituam as në KQZ dhe e fituam rezultatit, treguan vullnet që i respektojmë vendimet e gjykatës. Në këtë proces jo vetëm dyshoni pa fakte dhe kjo në fakt është karakteristikë e liderit tuaj, humbësit Rama. Nuk do t'ju dojë zoti Rama, edhe po të shpifni për zgjedhjet në Durrës. Mos i ofendoni qytetarët e Durrësit. Keni respekt për votën e tyre.

Falemnderit!

Nasip Naço - Falemnderit!

(Deputeti Bizhga del në podium dhe kërkon fjalën për replikë.)

Zoti Bizhga, ju thashë se nuk jua ka përmendur njeri emrin dhe nuk keni të drejtë replike. Ju lutem, uluni!

(Zoti Bizhga vazhdon të qëndrojë në podium. Ndërkohë afrohet te podiumi edhe zoti Strazimiri.)

Zoti Strazimiri, ju lutem uluni, se do të zbatohet Rregulloren!

Ju lutem, uluni!

(Të dy deputetët debatojnë me njëri-tjetrin në podium.)

Pesë minuta pushim.

(Pas pushimit)

Jozefina Topalli – Zotërinj deputetë, rinisim seancën.

Urdhëroni, zoti Bizhga, 2 minuta për replikë.

Gazmir Bizhga - Falemnderit, zonja Kryetare e Kuvendit, edhe për qytetarinë që tregoni, por edhe për zbatimin e Rregullores!

Më vjen shumë keq që një nga kolegët e mi të qarkut të Durrësit, meqenëse nuk është prezent në sallë, nuk po ia përmend emrin, për shkak edhe të

një njohjeje njerëzore që kemi pasur para shumë kohësh, iu referua një periudhe kohe kur unë kam qenë deputet, në vitin 2001-2005. Për shkak të njohjes që kemi pasur, më vjen shumë keq që në bisedat shoqërore që kemi konsumuar me njëritjetrin shpeshherë më është shprehur se është i djathtë, por PD-ja nuk vjen kurrë në pushtet sa të jetë kryetar i saj Sali Berisha. E pra, pikërisht këto fjalë kanë dalë nga goja e këtij parafolësi, që sot përbetohet për rregullsinë e zgjedhjeve e të tjera gjëra të kësaj natyre.

Megjithatë, unë e kam për nder që kam qenë dhe jam deputet i Kuvendit të Shqipërisë, përfaqësuesi i zgjedhësve të Shqipërisë dhe natyrisht nuk më ka ardhur kurrë zor për punën dhe detyrën time dhe nuk kam qenë asnjëherë as doganier, as kam pasur agjenci doganore në Portin e Durrësit, natyrisht duke treguar korrektësi në zbatimin e detyrës. Më vjen shumë keq që parafolësi im, i cili sot drejton degën lokale të PD-së, është i prodhuar (dhe nuk e thashë këtë në fjalën time për shkak të mosvëmendjes së kësaj seance për hetimin e zgjedhjeve), nga një klan mafioz, i cili sot ka zënë ekonominë e Durrësit dhe më vjen shumë keq që ai sot nuk është përfaqësues i vetvetes, por është përfaqësues i një grupi të tmerrshëm klanor ekonomik, fijet e të cilit fillojnë në Durrës e përfundojnë në kupolën qeverisëse.

Falemnderit!

Jozefina Topalli - Falemnderit!

(Ndërprihet seanca.)

Jozefina Topalli – Urdhëroni, zonja Dadel!

Arta Dade – Kolegë deputetë,

Kushdo që pa skenat e pak minutave më parë e kupton se nuk jemi në një situatë normale. Pas 8 muajsh të përfundimit të procesit zgjedhor, Shqipëria ndodhet në situatë edhe më të vështirë, edhe më serioze sesa para këtij procesi. Vendi është në krizë politike, në krizën e funksionimit të institucioneve dhe çdo ditë përkeqësohet kriza ekonomike. Ju e dini, por po bëni sikur s'kuptoni. Nuk e shihni dot krizën, sepse atë e keni në krye të grupimit politik që përfaqësoni. Ajo mori udhë dhe sigurisht e shfrenuara të kësaj krize dhe sigurisht nuk ka munguar edhe sot gjatë diskutimeve tuaja.

Kjo maxhorancë vazhdon të sillt sikur vendi është në normalitet politik, social dhe ekonomik dhe dezinformimin e opinionit publik vendas dhe të huaj e ka pjesë të axhendës së saj politike. Sali Berisha e njëj mirë këtë mekanizëm. Shqiptarët dhe partnerët ndërkombëtarë kanë vlerësuar se në këta

5 vjet opozita ka ofruar politikën e konsensusit, të bashkëpunimit dhe konstruktivitetit për reformat madhore të integritit, si dhe për çdo akt ligjor që i ka shërbyer integritit në NATO dhe avancimit të axhendës sonë europaine, vlera demokratike të cilat Kryeministri i ka cenuar rëndë, sepse ai është një individ që mban mbi supe komplekset e së shkuarës së tij të largët dhe të afërt.

PS-ja mori lidhshimin në reformën zgjedhore dhe në hartimin e Kodit Zgjedhor dhe pikërisht neni që garantonte mbrojtjen dhe transparencën e zgjedhjeve u shkel në mënyrë flagrante nga përfaqësuesit e Sali Berishës në KQZ dhe mbi ta rëndon përgjegjësia për zanafillën e krizës politike, e cila vjen duke u rënduar çdo ditë dhe ka ndikime të pashmangshme mbi gjithë jetën politike, sociale dhe institucionale të vendit, si dhe në proceset integruese. Edhe këtë Saliu e di mirë, por sigurisht nuk do ta shohë.

Raporti i OSBE-ODIHR-it, që ju e lexoni sipas mënyrës suaj, ka shprehur qartësisht shqetësime për shkeljen dhe dhunimin e kriterëve të Kartës së Kopenhagës. Ky raport konstaton se në 22 qendra numërimi, nga 66, numërimi është bërë keq dhe shumë keq. Gjithashtu presidenti i Asamblesë Parlamentare të OSBE-së u shpreh se hetimi parlamentar duhet të jetë i plotë dhe në detaje. Pra, këto dy elemente janë në përputhje të plotë me qëndrimin e opozitës, e cila mbi bazën e raportit përfundimtar të OSBE-ODIHR-it u shpreh se e njëj rezultatit e zgjedhjeve, duke ju djegur, të nderuar kolegë të maxhorancës, kartën e akuzës se opozita është kundër raportit të OSBE-ODIHR-it dhe vendimeve të gjykatave.

Duke pranuar rezultatit e zgjedhjeve dhe duke konsideruar betejën ligjore për shkeljen e Kodit Zgjedhor të përfunduar, duke u deklaruar se në përfundim të hetimit parlamentar opozita nuk kërkon ndryshim të rezultatit dhe duke avancuar dy projektligje që vendosën standard demokratik për transparencën e çdo procesi zgjedhor, opozita refuzon fuqishëm sulmet dhe keqinterpretimet se nuk respektojmë kuadrin kushtetues dhe ligjor në vend. Keqinterpretimi i qëllimshëm i Kushtetutës, deformimi i interpretimeve kushtetuese e ka diskretuar këtë maxhorancë, sepse transparenca, që ndonjëra e ka parë edhe në fjalor, por tani me siguri u del punë edhe leksikografëve që ta shtojnë, është një parim themelor në një shoqëri demokratike. Pra, kur partnerët tanë ndërkombëtarë dëgjojnë pseudoargumentet tuaja se Kushtetuta nuk lejon transparencën e zgjedhjeve, ata pa dyshim

arrijnë në konkluzione se paskemi të bëjmë me një problem serioz të Kushtetutës apo me një problem akoma më serioz të kësaj maxhorance, që pengon transparencën, por në asnjë mënyrë me ndonjë problem të opozitës. Por sigurisht që ata na monitorojnë dhe e kanë shumë të qartë se Sali Berisha ka pasur dhe vazhdon të ketë probleme serioze me Kushtetutën, të cilën e ka shkelur në 20 raste të certifikuara në 4 vjet.

Dikush nga parafolësit e mbrëmshëm, një zonjës e europianizuar, na këshilloi që ne të sillemi si europianë. Besoj se edhe për shkak të detyrës që mban, duhet të ketë lexuar përvojat e demokracive të vendeve të zhvilluara. Përvoja britanike e zgjedhjeve të manipuluar dhe të trukuara tregon se që më 1910-n, kur ata që i inspiruan dhe i ekzekutuan trukimin dhe manipulimin e zgjedhjeve u vunë përpara përgjegjësishë ligjore, sigurisht iu dha fund një herë e përgjithmonë manipulimit dhe trukimit të zgjedhjeve dhe pa dyshim që u krijua besimi, të cilin britanikët e kanë edhe sot për zgjedhje të lira dhe të ndershme.

Atë që britanikët e bënë në fillim të shekullit të kaluar ne duam ta bëjmë tani, për t'i dhënë fund korrupsionit elektoral dhe abuzimit me pushtetin, sigurisht duhet filluar me Sali Bersihën, sepse ai është frymëzuesi dhe zbatuesi i këtyre mekanizmave, të cilat ne i pamë edhe pak më parë këtu. Pra, opozitës duhet t'i mbyllet goja, madje edhe të dhunohet fizikisht. Është e vështirë të gjendet një politikan në vendet me demokraci të zhvilluar që të justifikojë kokëfortësinë dhe frikën për të mos bërë transparencën e procesit zgjedhor, gjë e cila duke u shtyrë në kohë, i ka kthyer të gjitha argumentet në favor të kërkesës së opozitës. Nëse 6 muaj më parë flitej vetëm për bojkotin tonë të imponuar nga kjo maxhorancë, tani zëra të fuqishëm vijnë se opozita e ka shprehur angazhimin e saj për zgjidhjen e krizës, ka ofruar kompromise dhe i mbetet maxhorancës të shprehë ajo vullnetin e vet.

Mbështetja për kërkesat e opozitës nga grupe parlamentare jo domosdoshmërisht të të njëjtit orientim politik në Parlamentin Europian, deklarata e nënkryetarit të Parlamentit Europian, ajo e nënkryetarit të Komisionit të Parlamentit Europian për Marrëdhënie me Ballkanin Perëndimor, deklarata e reporteres për liberalizimin e vizave, zonjës Tanja Fajon, kërkojnë qartësisht të shohin hapat konkretë nga kjo maxhorancë, duke vlerësuar kompromiset e ofruara nga opozita. Ata që zoti Berisha mbrëmë

i quajti "antishqiptarë", sepse kështu u shpreh mbrëmë Kryeministri për ata që kërkojnë transparencën, janë antishqiptarë, besoj që kanë qenë partnerët më dinjitozë të Shqipërisë. Bilancet që nga viti 1994 flasin se dëmi më i madh shqiptarëve u është bërë nga një emër, i cili përfaqëson atë që është agonia e grahmave të gatuar në kazanin e totalitarizmit.

Vizita e komisionerit për Zgjerimin, Stefan Fyle, duhet të shërbejë për ndërgjegjësimin e kësaj maxhorance për përgjegjësinë historike për të avancuar procesin e integritimit në BE, i cili sot pa se çfarë ndodh në këtë parlament kur diskutohet për çështjet madhore dhe për interesat kaq madhore të vendit duke ju ofruar kontributin e munguar deri më sot për zgjidhjen e krizës politike. Në të kundërt, sipas rezolutës së Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës, së cilës ne vazhdimisht i jemi referuar dhe e kemi mbështetur, vendi rrezikon të destabilizohet. Kjo është përfshirë në këtë rezolutë.

Dy raportet e fundit, ai i Departamentit amerikan të Shtetit dhe i Mbretërisë së Bashkuar shprehën realisht shqetësimin për problematikën e mprehtë të nivelit të demokracisë në Shqipëri, demokraci e cila nis pikërisht te zgjedhjet e lira dhe të ndershme. Ku e gjeni, zotërinj deputetë të maxhorancës, kurajën dhe guximin që të justifikoni rutinë e Ruzhdijes? Ky qëndrim është tejet kërcënues për demokracinë. Në momentet që flasim, Sali Berisha nuk është në marrëdhënie konfliktuale vetëm me opozitën, por përmasat e marrëdhënieve konfliktuale janë shtrirë edhe në bashkësinë ndërkombëtare për tentativa të autoritarizmit dhe uzurpimit të institucioneve të pavarura, për korrupsion, për mosfunksionim të sundimit të ligjit.

PS-ja është e përcaktuar qartë në qëndrimin e saj: njohja e rezultatit zgjedhor, mosndryshimi i tij në tryezë dhe transparencja e plotë e procesit elektoral duke përfshirë edhe hapjen e kutive. Të vendosur për t'i qëndruar deri në fund këtij përcaktimi dhe për të realizuar kauzën tonë për transparencë të zgjedhjeve, ne ndërprejmë bojkotin parlamentar po për këtë qëllim, për transparencën, në mënyrë që të parandalohet manipulimi i zgjedhjeve në të ardhmen dhe tjetërsimi i vullnetit të votuesve. Kjo do të thotë se opozita shqiptare në bashkëndrim edhe me partnerët e saj lokalë dhe ndërkombëtarë, ka shprehur angazhimin e saj për normalitet në funksionimin e institucioneve në vend. Për fat të keq, me gjithë angazhimin tonë maxhoranca e sajur parlamentare reagoi në mënyrën më të keqe të

mundshme, madje edhe në këtë seancë, duke shpërfillur apelin e institucioneve të rëndësishme ndërkombëtare. Përvoja ka treguar që kur Sali Berisha vjen në këtë pikë, qeverisjes së tij i vjen fundi.

Qëndrimi refraktar ndaj nismave ligjore të opozitës rrit çdo ditë e më shumë koston e zgjidhjes së kësaj krize, rrit çdo ditë e më shumë koston e jetesës së familjeve shqiptare, cenon edhe më tej imazhin e vendit para kancelarive dhe investitorëve të mundshëm. Ftesa dhe apeli ynë për t'i miratuar nismat tona ligjore është dëshmi e seriozitetit tonë, e maturisë së opozitës për t'u kontribuar proceseve integruese dhe zhvillimit të vendit në të mirë të qytetarëve tanë dhe aspiratave tona evropiane. Në emër të këtyre aspiratave në kërkujmë të hetojmë kutitë e masakrës së zgjedhjeve.

Të nderuar kolegë të maxhorancës, ju takon juve sot të ofroni konsensusin për të zgjidhur krizën politike dhe për t'i hapur rrugë reformave të mëtejshme që kërkon vendi. Sa më shpejt të reflektoni, aq më shpejt do të rivendoset bashkëpunimi parlamentar dhe jo vetëm ai. Në të kundërt, opozitës shqiptare i mbetet vetëm një rrugë, të bashkojë forcat me shumicën elektorale opozitare për t'i dhënë fund një qeverisje të ndërtuar mbi votat e grabitura dhe me ne do të bashkohen të gjithë ata që janë braktisur nga kjo Qeveri dhe ata janë shumica e shqiptarëve, votat e të cilëve u numëruan keq dhe shumë keq. Prandaj do të qëndrojnë me ne në betejën tonë për qytetari, për liri kundër zaptimit të pushtetit dhe të shtetit.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zonja Dade!

Zoti Pollo e ka fajlën.

Genc Pollo – Falemnderit, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Meqë zonja parafolëse iu referua komunitetit ndërkombëtar, tha që Kryeministri Berisha duhet të mësojë nga komisioneri Fyle, nuk kam asnjë kundërshtim për sa tha, por do të doja të shtoja se edhe opozita, PS-ja dhe në mënyrë të veçantë kryetari i saj, duhet gjithashtu të mësojnë nga komisioneri Fyle në këtë situatë që jemi, sepse njerëzit flasim me gojën e tyre dhe pa ekuivoqe dhe komisioneri që sot është në vizitë në Tiranë ka thënë në përfundim të takimit me Kryeministrin, me sa di unë e ka thënë edhe në takimet që ka pasur më parë me autoritete të larta të shtetit dhe mendoj se do t'ia thotë sy për sy edhe Kryetarit të PS-së, fjalët që të gjithë shqiptarët i dëgjuan edhe nga media,

që bojkoti është i papërputhshëm dhe në kundërshtim me çdo normë demokratike dhe me integrimin evropian dhe se pjesëmarrja në Parlament është e detyrueshme dhe hetimi mund të bëhet në përputhje me Kushtetutën. Kështu sigurohet edhe transparenca e zgjedhjeve.

Besoje se ky është një numërues i përbashkët drejt të cilit, ndoshta jo sot, megjithëse është e dëshirueshme, do ta shpresoj, por nuk jam optimist me thënë të drejtën, edhe kolegët e opozitës që janë në sallë duhet të shkojnë, mund të bien dakord dhe mund të veprojnë në këtë mënyrë, në mos sot, një javë, një muaj, pak muaj më vonë, por them më e dëshirueshmja do ishte sot.

Tjetra, duke lexuar shtypin, kam hasur shkrime interesante të personazheve të opozitës që kanë qenë të rëndësishëm në pushtetin vendor, qeveritarë, parlamentarë, kandidatë për në Kuvend, të mbështetur edhe nga funksionarë të tjerë të PS-së, gjithashtu kandidatë për në Kuvend, por nuk kanë mundur të bëhen deputetë, mbështetur edhe nga njerëz që njihen si simpatizantë të kryetarit të Bashkisë apo edhe propagandistë, agjitorë të tij, shkrime ku ndeshet një koncept shumë interesant, i shpikur nga kryetari i Bashkisë së Tiranës, e drejta kushtetuese për të ndërtuar. Ajo që interpretohej, m'u duk me të drejtë si një e drejtë që me firmën e kryetarit të Bashkisë i jepet leje kujtdo që kërkon të ndërtojë pranë një shkolle, në oborrin e saj, në një spital a qendër shëndetësore, në një lulishte, në një park e kështu me radhë dhe kjo është diçka që ne në tiranë e kemi hasur këto 10 vjet. Por nuk do ta përmendja këtë, se druaja se mos dilja jashtë kontekstit, në qoftë se nuk do të lexoja në letrën e hapur në stillin më të mirë enverian që kryetari i PS-së i dërgoi Kryeministrit lidhur me kërkesat e tij për hetimin e zgjedhjeve, ku fliste gjithashtu për të drejtën kushtetuese ose ndoshta të drejtën ligjore për të hapur kutitë, një paralele shumë e qartë që besoj se flet vetë dhe që seanca e sotme dhe e djeshme e kanë bërë shumë të qartë. Konceptet e atyre që kuptojnë dhe duan dhe e pranojnë dhe e mbështesin shtetin ligjor me konceptet e atyre që në mentalitet kanë mbetur jakobinë dhe dihet që në histori jakobinët janë prekursorët e komunistëve dhe komunistët përshtaten edhe në kuadrin demokratik, por nganjëherë i shprehin prirjet e tyre dhe shpesh nuk i harrojnë praktikën e tyre.

Është një varfëri e madhe debati që na ka pllakosur këta 6 muaj. Të flasim vetëm për hapjen e kutive, me ligj dhe pa ligj, ndërkohë që ka shumë

gjëra të tjera të rëndësishme në këtë vend. Ka gjëra të rëndësishme që bën Qeveria të cilat janë të rëndësishëm për vendin dhe të ardhmen e tij. Mund të ketë edhe gabime që ndoshta për shkak të kësaj zhurme nuk meritojnë vëmendjen dhe kritikën e duhur, por edhe gjërat që bën Bashkia, si aplikimi *sui generis* i së drejtës kushtetuese për të ndërtuar do të merrte vëmendjen e vet në qoftë se nuk do të kishim debatin shterp dhe bojkotin po aq antidemokratik, siç u tha edhe sot nga përfaqësues të lartë të Komisionit Europian, nga opozita. Por këto janë gjëra që janë trajtuar thellësisht, gjerë e gjatë në debatin që tashmë po përfundon.

Në fakt, nuk doja të përsëritja kolegët që i kanë shtjelluar këto. Dola më tepër për të marrë fjalën e ngacmuar nga një deputet socialist, i cili katër vjetët e shkuar ka luajtur rolin e mistrecit permanent, duke provokuar këdo nga Qeveria apo maxhoranca. Megjithatë, çdo deputet meriton vëmendjen e duhur dhe ky zotëri duke folur dje në fund të fjalës së tij pretendoi që ka përsëri një provë të manipulimit nga Pogradeci. Një person që disponon dy letërnjoftime të fotokopjuara me të cilat supozohet se ka votuar dy herë. Pra, është një provë e manipulimit zgjedhor.

Në fund të fjalës së tij i tha Kryeministrit: “Urdhëroni, zoti Berisha, provat e manipulimit.” Nuk shkoi deri tek ai, por e la tek unë në karrigen pranë. Meqë kam qenë koordinator qeveritar për shpërndarjen e letërnjoftimeve dhe e vazhdoj këtë detyrë me fukate të tjera, natyrisht që më interesoi, thashë që deputeti meriton vëmendje, pavarësisht se kush është dhe konstatova që vërtet është një person i quajtur Erlind Pashollari, me të njëjtin ditëlindje dhe vendlindje, me të njëjtin numër personal identiteti, shumë e rëndësishme kjo. Por numri i kartës është i ndryshëm, sepse aplikimet janë në dy ditë të ndryshme, dita e parë dhe dita e dytë është 9 pas të parës.

Sot në mëngjes, kur na doli gjumi pas seancës që vazhdoi deri në 23:30 mbrëmë, u interesova pranë drejtorisë së përgjithshme të gjendjes civile për të parë se çfarë po ndodh me këtë rast, cilat janë të dhënat. U verifikuan menjëherë dhe ky është avantazh i madh i regjistrit kombëtar civil të kompjuterizuar që personazhi është real, ka këto të dhëna, ka këto gjeneralitete dhe jeton ose është banor i regjistruar në komunën e Çëravës të qarkut të Korçës ose të Pogradecit. U kërkova të hetonin më tepër se si ka mundësi që në këtë afat lëshohen dy karta, gjë që në vetvete nuk mund të jetë provë manipulimi, sepse edhe unë personalisht kam një

letërnjoftim, kam dy pasaporta një diplomatike dhe një të zakonshme, madje kam edhe pasaportën e vjetër të 15-20 vjetëve më parë, por nuk mund të votoj dy herë, sepse e kam emrin në listat e votuesve që kësaj radhe, në 2007 dhe në 2009 janë unike nuk mund siç ndodhte përpara kur qeverisnin të tjerë që votohej në Tiranë votohej edhe Gramsh, votohej në Tiranë, mund të votoje edhe në Kolonjë, votoje në Tiranë, votohej edhe në Maqellarë, sepse të tilla ishin listat dhe e lejonin këtë abuzim.

Kësaj radhe unë shkoj me një nga dokumentet dhe e kam vetëm në qendrën time të votimit emrin dhe nuk mund të shkoj në vend tjetër, edhe sikur të kem një të dytë, një të tretë dhe një të katërt, siç mund t'i ketë pasur ky zotëri.

Megjithatë, kjo nuk ishte e mjaftueshme për mua ta lija hulumtimin në mes dhe kërkova sqarime të mëtejshme që lidheshin me kompaninë koncesionare franko-amerikane. Përgjigjja prej tyre është interesante, do të doja t'jua bëja të njohur: “Niveli menaxherial njofton drejtorinë e gjendjes civile se këtë rast e dimë, nga Çërrava (është në anglisht, por po e përkthej në gjuhën tonë), shkoi direkt në ambasadën amerikane nga një person socialist për të ngatërruar, për të konfuzionuar procesin në fund të majit 2009. Dhe më pas doli në medie dhe në televizion.” Atashuar është kopja e faksti që ne morëm nga ambasada amerikane dhe ky është faksti që kam marrë, sepse ai personi socialist aty e faksoi menjëherë. Shikoj emrin e sekretarit për çështje politike të shënuar me dorë dhe fotokopjet e ngjashme me ato që paraqiti deputeti në fjalë. “Ne hetuam, -vazhdon koncesionari franko-amerikan, - e hetuam këtë çështje edhe me policinë e Çërravës, u interesuam për personin dhe doli se ai kishte riaplikuar sepse kishte humbur kuponin e fletarkëtimit që kishte paguar një herë dhe që e mbante si dokument dhe mendonte se, nëse humbte atë, nuk mund të merrte letërnjoftimin. E pagoi edhe një herë për ta marrë dhe në momentin e lëshimit u mbajt njëra dhe u dorëzua tjetra.”

Gjithsesi, këto janë fotokopjuar dhe kjo i ka mbërritur në dorë, në një mënyrë që unë nuk e di, këtij personi socialist, që gjëja e parë që bëri e faksoi në ambasadën amerikane. Ministria e Brendshme u informua për këtë, edhe zëvendësministri Pone është informuar gjithashtu nga ana jonë nuk pati asnjë çështje serioze meqë dy letërnjoftimet në përmbajtjen e tyre janë *strictly identical*, janë në mënyrë strikte identike dhe nuk ka asnjë problem.

Është një shembull i qartë dhe një shembull i

rëndësisë së vogël e thjeshtë dy letërnjoftime për të dëshmuar sesi mund të montohet, ngarkohet, të fryhet një fushatë e tërë për të deligitimuar zgjedhjet e për t'i ndotur ato pavarësisht se ka qenë më të mirat vetëm e vetëm nga marazi që Edi Rama nuk arriti dot t'i fitonte në mënyrë të ndershme dhe nuk arriti dot të bëhej kryeministër i vendit. Ky është vetëm një shembull, por në shumë e shumë që kemi dëgjuar sot dhe dje nga kolegët socialistë bëhen shumë e shumë shembuj me po kaq vlerë që përmenda.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Pollo!

Zoti Bushati, urdhëroni!

Ditmir Bushati – Falemnderit!

Të nderuar kolegë,

Kjo seancë në asnjë rrethanë nuk duhet përdorur nga eksponentë të maxhorancës si mundësi për të treguar muskujt krahas muskujve të kartonit, pasi e gjithë vëmendja e opinionit publik vendas dhe atij ndërkombëtar është fokusuar me të drejtë mbi mënyrën sesi në mund të dalim nga një situatë ku vendi ka të paktën 9 muaj që ndodhet.

E njëjta gjë vlen edhe për parafolësin, i cili, pavarësisht se është anëtar i kabinetit qeveritar, ia lejoj vetes vetëm pak minuta pasi komisioneri i Zgjerimit lëshoi një deklaratë për opinionin publik ta lexonte sipas mënyrës së tij dhe ta keqinterpretonte, ndërkohë që unë do të doja thjesht ta risillja në vëmendje të opinionit publik që zoti Fyle e tha shumë të qartë se mënyra se si do të zgjidhet kriza në Shqipëri do të duhet të fokusohet mbi dy parime: mbi parimin e kushtetutshmërisë, të cikin Partia Socialiste jo vetëm nuk e ka vënë asnjëherë në dyshim, por ka qenë promotore e këtij parimi dhe është maxhoranca që në disa raste na ka vërtetuar se ka vepruar jashtë këtyre binarëve kushtetues; dhe një parim tjetër shumë i rëndësishëm është e drejta e një transparence të plotë mbi procesin zgjedhor të 28 qershorit. Kjo është e kuptueshme, pasi konkluzioni i raporteve të vëzhguesve vendas dhe ndërkombëtarë na thotë se zgjedhjet e 28 qershorit nuk arritën të mbyllnin kapitullin e zgjedhjeve të deformuara në Shqipëri, në dallim nga të gjitha vendet e rajonit, pavarësisht faktit se Shqipëria është vend anëtar i NATO-s dhe aspirant për në BE.

Kriza e demokracisë dhe e shtetit të së drejtës që përjetojmë prej 9 muajsh i ka rrënjët pikërisht te shkelja e hapur e sistemit të garancive që kemi sanksionuar së bashku në Kodin Zgjedhor e deri të

kokëfortësia e dëshmuar në vijimësi, edhe sot, nga ana e maxhorancës për të mos lejuar një proces hetimi të plotë e transparent mbi kutitë e 28 qershorit 2009, te cenimi i autonomisë vendore, paralizimi i institucioneve kushtetuese, tentativa për kontroll ndaj shërbimit sekret dhe klima shantazuese ndaj medias e sipërmarrjes së lirë, që e ka vënë këtë maxhorancë në konflikt me qytetarët dhe me komunitetin ndërkombëtar.

Mosmiratimi i një sërë reformave që kërkojnë dialog e konsensus me opozitën dhe grupet e tjera të interesit, e ka bërë edhe më prezente krizën institucionale, e cila nuk mund të evitohet dot përveç se me mjete politike.

Megjithëse vend anëtar i NATO-s dhe aspirant për në BE, raportet ndërkombëtare theksojnë se në Shqipëri është instaluar një sistem pandëshkueshmërie, ku të mirat publike janë përqendruar në një grusht njerëzish të lidhur me pushtetin e Kryeministrit, veçori tipike kjo e një maxhorance që nuk e ka legjitimitetin e duhur për të qëndruar në krye të punëve të vendit.

Fshehja pas imunitetit, meqenëse dje na u bë një ftesë për të votuar edhe projektin për imunitetin, dhe zvarritja e procedurave ligjore për imunitarët e kabinetit qeverisës është vetëm njëra prej arsyeve se pse shqiptarët nuk përfituan në kohë, ashtu sikurse fqinjët e tyre, heqjen e regjimit të vizave. Është ky fakti rrëqethës ku kryqëzohen, gjithashtu, raportet e Komisionit Europian, Departamentit të Shtetit, *Foreign Office*-it të Mbretërisë së Bashkuar dhe të *Transparency International*, që e bëjnë Shqipërinë të klasifikohet si një ndër vendet më të korruptuara, me demokraci jofunksionale për shkak të mosplotësimit të standardeve zgjedhore, mosfunksionimit të administratës publike, ku vija ndarëse ndërmjet shtetit dhe pushtetit, publikes dhe privates nuk ekziston më.

Është ky realitet i zymtë, që nuk mund të fshihet as nga *make up*-i i ministrave përgjegjës për organizimin e spektakleve politike, të cilët guxuan të përdorin në kohë krize ekonomike fondin rezervë të buxhetit të shtetit, në vend që të përvishnin mëngët e të përmbushnin me rigorozitet kërkesat që burojnë nga procesi i integritetit europian, duke dëgjuar me mirësjellje nga ana tjetër edhe këshillat dhe kërkesat e Komisionit Europian dhe shteteve anëtare të BE-së, apo sinjalet e qarta të tyre që nga mënyra dhe ceremonia e ndryshme se si iu dorëzua pyetësori i Komisionit Europian Shqipërisë, në dallim nga vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor

e deri tek tematika e diskutimeve të Komitetit të Stabilizim-Asocimit dhe vizitës së sotme të komisionarit Stefan Fyle në kontekstin e një krize politike shumëpërmasore, sikurse kjo që po kalon vendi ynë.

Partnerët tanë ndërkombëtarë njëzëri po apelojnë në mënyrë të sinqertë për zgjidhjen e kësaj krize, pasi, siç tha edhe sot komisioneri i Zgjerimit, ardhmëria europiane e Shqipërisë është vënë seriozisht në pikëpyetje. E gjithë axhenda e integritit europian, zoti ministër që sapo folët, është fokusuar pikërisht te funksionimi i çalë i demokracisë shqiptare dhe jo tek axhenda e zhvillimit dhe transformimit të vendit, sikundër e kanë fqinjët tanë.

Në këtë kontekst lejimi i hetimit parlamentar dhe transparencja e plotë dhe e gjithanshme mbi procesin zgjedhor të 28 qershorit është hapi i parë që do të zhbllokonte krizën politike dhe do të shërbente si pikë kthese për rivendosjen e besimit të ndërsjellë mes nesh.

Partia Socialiste e ka ofruar me kohë kompromisin nga ana e saj duke njohur rezultatin e zgjedhjeve. Tani ju takon juve të dëshmoni gatishmëri dhe përgjegjësi për t'i dhënë zgjidhje krizës në rrugë institucionale.

Zoti Kryeministër ka premtuar se do të mbetet në historinë e Shqipërisë dhe në të vërtetë deri tani ia ka dalë mbanë të sigurojë një vend, ashtu sikurse Neroni në historinë e Romës, veçse me mënyrën se si po e drejton ai vendin kam frikë se do t'ia kalojë edhe Neronit, pasi ai vetëm një herë arriti ta digjte Romën, kurse Kryeministri po bëhet gati, larg qoftë, për ta djegur Shqipërinë për të dytën herë.

Por në dallim nga Kryeministri, misioni ynë historik në funksion të demokracisë dhe sistemit të vlerave që duhet të instalojmë në këtë vend është i ndryshëm. Misioni ynë nuk është ai i një pozite normale kundër maxhorancës së radhës, por misioni i një opozite që përfaqëson një popull kundër sistemit të korruptuar, që ka 20 vjet që është ulur këmbëkryq, duke prodhuar pushtet për një pakicë dhe varfëri e mjerim për shumicën.

Besoj se zotit Kryeministër i kujtohet mirë viti 2008, kur opozita vendosi interesin kombëtar të aderimit në NATO dhe aplikimit për anëtarësi në BE para përfitimeve eventuale që mund të vinin si pasojë e politikës suaj që shkaktoi tragjedinë e Gërdecit. Disa syresh, që sot janë ulur me ju në Qeveri, e quajtnë dobësi apo tradhti bashkëpunimin e opozitës me atë që aso kohe e thërrisnin Sali Gërdeci, por sot është momenti t'ua ripërsërisim

se ishte mençuri e demonstruar nga një forcë politike, e cila në qendër të vëmendjes së saj ka interesat e qytetarëve dhe prosperitetin e vendit.

Pjesëmarrja jonë në seancën plenare të Kuvendit javës që shkoi vetëm për segmentin që kishte të bënte me rezolutën e liberalizimit të vizave ishte një tjetër dëshmi e pakundërshtueshme e faktit që për Partinë Socialiste proceset madhore të integritit euroatlantik me të cilat përballet Shqipëria duhet të mos bëhen pjesë e rivalitetit politik të ditës.

Sot është dita e Kryeministrit për të dëshmuar se ka ende kurajë për të shikuar drejt interesave kombëtare dhe nuk është një arnues problemesh apo më keq, një improvizues i humbur në oborrin e vet. Sot është dita t'i ngajë atij dirigjentit të muzikës klasike, që udhëzon orkestrën e tij në bazë të notave të paracaktuara dhe jo klarinetistit impulsiv e improvizues të muzikës tallava, që nuk di as vetë se ku po e çon këngën.

Jepini fund kësaj historie, të nderuar kolegë të maxhorancës, duke votuar iniciativat tona, pasi Shqipëria ka humbur boll kohë e sot më shumë se kurrë duhet të demonstrojë se është e aftë të kapë trenin europian.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit!

Zonja Gjonaj, urdhëroni!

Adriana Gjonaj – Falemnderit, zonja Kryetare!

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Pas një diktature tmerrësisht të egër dhe të gjatë komuniste dhe pas dy dekadash demokraci shqiptarë janë të ndërgjegjësuar që demokracia u përket atyre dhe ndërtohet prej tyre. Është jashtë konceptit modern të drejtimit të shoqërisë së sotme që garantët e vetëm të demokracisë janë forcat politike si një abuzivizëm i qartë dhe atavizëm i tejkualuar i modelit të partisë-shtet.

Duke dëgjuar kolegët opozitarë të krijohet përshtypja së shqiptarët, burra e gra, djem e vajza, gjyshër e gjyshe, janë pa frymë për problemin e transparencës së zgjedhjeve të gati një viti më parë, të kërkuar nga kryetari Rama që, siç e dimë të gjithë, përfaqëson në vend etalonin e standardit dhe transparencës elektorale, e vërtetuar kjo në vite.

Zotërinj deputetë,

Në vizionin politik është tashmë e qartë se janë zbehur të gjitha dilemat dhe janë shumë të afërta shanset për lëvizjen e lirë dhe integritimin europian. Është kjo një kahje e përbashkët e të gjithë shqiptarëve. Pas zgjedhjeve të 28 qershorit dhe certifikimit të tyre kombëtar e ndërkombëtar sukcesi

ynë është zhvillimi me ritme sa më të shpejta në drejtimin ekonomik, social, arsimor e kulturor i vendit.

Si përfaqësuesit më të lartë të interesave të shqiptarëve, ne kemi edhe përgjegjësinë e madhe për të qenë në pararojë të mbështetjes së këtyre zhvillimeve. Për secilin shqiptar, edhe më të fundit, lëvizja e lirë dhe integrimi evropian janë një ëndërr e madhe në prag të realizimit. Por për çdo shqiptar janë shumë të rëndësishme edhe interesat e tij të drejtpërdrejta, që shoqërojnë këtë progres të linjës politike të integritimit evropian.

Kolegë, unë jam pjesë e grupit të deputetë të qarkut të Elbasanit. Interesat jetike të njerëzve që jetojnë në Elbasan, Librazhd, Peqin, Gramsh, Përrenjas, Belsh, Cërrik janë të shumta.

Vëmendja maksimale e tyre për të ardhmen lidhet me realizimin e programeve qeveritare të zhvillimit të asaj zone, lidhet me rrugën Tiranë-Elbasan, boshtet juglindore të Jugut, me rrjetin e rrugëve rurale. Ata presin nga të ndikojmë që milionat e eurove të caktuara për to të vihen sa më shpejt në eficiencë, se kjo do të ndikojë direkt në mirëqenien e tyre.

Vëmendja e tyre maksimale është në problemet e punësimit, të arsimit sa më të mirë të fëmijëve, përmirësimit të kujdesit shëndetësor. Ata presin nga ne të punojmë për këto qëllime që ndikojnë direkt në jetën e tyre të përditshme, jo vetëm t'i citojmë për shoë.

Ata kanë interes jetik për programet e mbështetjes dhe zhvillimit të bujqësisë e blegtorisë, kanaleve vaditëse e kulluese, subvencionet për kulturat bujqësore. Është në interesin jetik të këtyre banorëve mundësimi i pjesëmarrjes sa më të shpejtë në tregun shqiptar apo rajonal të prodhimeve të zonës, një nga më aktivet në vend.

Vëmendja e tyre është shfrytëzimin e burimeve hidrike të zonës, si burim energjie dhe punësimi. Në mënyrë të ngjashme janë interesat e shqiptarëve të çdo qarku kundrejt zhvillimeve ekonomike e sociale të çfarëdo natyre qofshin, që modernizon dhe përmirëson jetën e tyre.

Për të gjitha këto probleme shqiptarët na votuan. Presin t'u japim bashkërisht garancinë dhe angazhimin tonë maksimal. Qeveria, për përgjegjësinë që ka ndaj tyre me këto projekte shumë ambicioze, po punon për progresin në çdo fushë. Është nevojë e patjetërsueshme oponenca juaj profesionale, kolegë opozitarë, për zgjidhjet më të mira dhe racionale. Ju, të nderuar kolegë, nuk

mund të mbeteni peng vetëm të kutive. Raciononi për to energjitë dhe hapësirën e përshtatshme, se duhet të mendoni edhe për problemet e tjera që përmenda më sipër.

Zotërinj deputetë të opozitës,

Pozimi i problemit të kutive vetëm në rrafsh demagogjik, hipokrit dhe urdhërues është i rëndë për ju, për ne, për demokracinë dhe institucionet shqiptare. Ne si deputetë ishim në zona gjatë votimeve dhe ndoqëm bashkërisht në të njëjtën sallë, pa ndërprerje, procesin e numërimit të votave, bashkë me dhjetëra vëzhgues të zjarrtë partiake, kamera e gazetarë. Si munden sot deputetët e Elbasanit të flasin për krim elektoral, vjedhje të votave dhe rinumërim!? Edhe listat zgjedhore i përgatiti kryetari juaj i bashkisë, që mund t'i printojë prapë e t'u japë sa kopje të doni. Nuk e di për çfarë ju duhen.

Kolegë të opozitës, si ligjvënës nuk mund të kërkonte pas 20 vjetësh demokraci kthimin në partinë-shtet. Ju nuk mund të kërkonte sot me tolerancë zero dhe pa dhënë asnjë kompromis zgjidhje thjesht politike, pavarësisht nëse ajo është kushtetuese e ligjore. Ju nuk mund të kërkonte kthimin e këtij Kuvendi në Kuvendin Popullor të diktaturës së Republikës së Shqipërisë.

Në një publikim të Departamentit të Shtetit thuhet: "Kur themeluesit e republikës amerikane hartuan dhe ratifikuan kushtetutën amerikane në 1787, ata nuk parashikuan ndonjë rol për partitë politike. Ndërkohë ata përcaktuan një sërë masash kushtetuese nëpërmjet ndarjes së pushtetit mes trupit ekzekutiv, legjislativ dhe atij gjyqësor nëpërmjet federalizimit dhe zgjedhjes indirekte të presidentit nga një koleg zgjedhor për të mbrojtur republikën e re nga partitë dhe fraksionet."

Kryetari i maxhorancës dhe çdo deputet i saj ju kërkojnë vetëm respektimin e Kushtetutës në plotësimin e kërkesave tuaja. Askush këtu nga maxhoranca nuk kundërshtoi kërkesën tuaj për transparencën si proces. Ndryshimi mes nesh dhe jush është se si do të kryhet kjo. Ne u ofrojmë rrugën ligjore e kushtetuese, edhe për hapjen e kutive. Ju kërkonte të shkelni Kushtetutën.

Komisioni i Ligjeve ka paraqitur dy drafte, që bazohen në propozimet tuaja, por janë veshur me kornizën kushtetuese. Ju ftoj të reflektoni mbi to dhe mbi propozimin e Berishës, t'i rivlerësoni ato, të gjejnë zgjidhjen e duhur dhe të ecim para në përmbushjen e misionit tonë. Koha nuk pret!

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zonja Gjonaj!

Zoti Klosi e ka fjalën. Të përgatitet zonja Përnaska.

Blendi Klosi – Kemi plot 9 muaj dhe dje e sot mbi 19 orë që po ju dëgjojmë me radhë, ju zoti Kryeministër, ju zonja Kryetare e Parlamentit, ju zotërinj të Qeverisë e të maxhorancës me gjithfarë argumentesh, sofizmash e shprehjesh juridike, fjalë të mëdha e kërcënime të ulëta, që na thonë se kutitë nuk do të hapen.

Na thoni se kutitë nuk do të hapen, por nuk na thoni arsyen e vërtetë. Është frika dhe vetëm frika arsyeja pse ju nuk i hapni kutitë. Frika se përveç etiketimit si zyrtarët më të korruptuar në rajon, do të merrni edhe diplomën e falsifikatorit profesionist të zgjedhjeve. Na thoni se transparenca na qenka shkelje e Kushtetutës dhe e ligjit, se opozita nuk ka fakte për të kërkuar hapjen e kutive, se zgjedhjet ishin shumë të mira, se Partia Socialiste kërkon të sabotojë punën e mrekullueshme të Qeverisë e të Kryeministrit Sali Berisha, se kauza e Partisë Socialiste është kauza e lidërshiptit të saj për të mbrojtur postin në krye të partisë e të tjera si këto.

Po flisni gjatë e më gjatë, duke harruar se po digjni edhe orët e fundit e pa dyshim edhe shansin e fundit të datës 19, datë e cila është shënuar në të gjithë ultimatimet euroatlantike si data në të cilën do të duhej të zgjidhej kriza e të zhblokohet vendi nga një krizë tredimensionale: demokraci, institucione, krizë ekonomike.

Po pse kjo maxhorancë e sajuar me zor e me bashkime ekstreme politike, me lider të së djathtës ekstreme, që nga Balli e Legaliteti e deri te politikanë që kanë mbrojtur për vite me radhë, mbi 20 vjet ekstremin e majtë? Pse kjo maxhorancë deputetësh që kanë ngritur karrierën e tyre si politikanë të fortë fshihen sot pas gishtit të Ruzhdies, fshihen sot nga frika si një xhepist ordiner në linjën e urbanit Shkodër-Tiranë, Berat, Shijak, Kamëz a Paskuqan e kudo gjetkë dhe nuk kanë guxim të tregojnë xhepat e fryrë me votat e vjedhura? Vodhe, u kape, tregojni xhepat, zoti Kryeministër!

Ju zotërinj, që nuk i hapni kutitë jo sepse nuk kemi ne të drejtë në kërkesën tonë, por sepse ju të gjithë e veçanërisht shefi juaj ka frikë nga hapja e kutive. Kjo është e vërteta e thjeshtë. Ju refuzoni transparençën sepse keni frikë, sepse e dini shumë mirë se ç'zullume do të dalin nga këto kuti, frikë nga zbulimi dhe rrëzimi i një sistemi që ju mban juve në pushtet: manipulimi i votave.

Zotërinj të rinj e të vjetër në këtë Parlament, e ju, o njerëz, që na ndiqni e jeni të detyruar të na

ndiqni nëpërmjet ekranit, për të dytën herë me qeverisjen 5-vjeçare të Sali Berishës së Dytë ky Parlament po mbahet i bllokuar me të njëjtin objekt, kutitë e votimit. Mbani mend se si ky Parlament u bllokua për disa muaj për kutitë dhe votimin e fshehtë, ku deputetët e majtë të asaj kohe, ndonjëri sot edhe anëtar i kabinetit qeveritar, me bilbila e bori kërkonin transparençën në votim, sepse ishim atëherë, dhe sot shumë më të bindur se ju dhe Sali Berisha nuk keni asgjë të përbashkët me zgjedhjet e lira. Dhe ja ku ndodhemi sot të gjithë së bashku, një Shqipëri e tërë, me shqiptarët tuaj së bashku, ju kërkoni të hapni kutitë e ju nuk i hapni, sepse keni frikë nga transparenca.

Ju të gjithë thoni se nuk ka fakte, por jo, zoti Kryeministër, ju nuk doni fakte. Ju si një komunist i vjetër e një bej modern nuk e doni opozitën në Parlament të bëjë opozicion, se ju zoti Kryeministër jeni bërë si beu i fshatit që në majë të kalit të korrupsionit i mbledh çdo gjëje të gjallë dhe çdo biznesi në vend 30% të fitimit. Ky është fakti që ju nuk doni që ne të jemi në Parlament e të bëjmë opozitë. Ju thoni s'ka fakte, por çfarë faktesh kërkonte ju zotërinj për konsensus e transparençë? A nuk ju duket i gjithë procesi zgjedhor i Shqipërisë një fakt që duhet hetuar? A nuk ju duket manipulimi dhe blerja e votave në të gjithë Shqipërinë një fakt, a nuk ju duket përdorimi elektoral i parave të kantierëve të hapura e asnjëherë të përfunduara? A nuk ju duket Ruzhdia një fakt, zoti Kryeministër, me 70% të votave të manipuluar nga komisionerët tuaj? A nuk ju duket e gjithë historia e kartave të identitetit të falsifikuara një arsye e mjaftueshme për të hetuar, për të parë se si zyrtarisht mbi 300 mijë shqiptarëve iu mohua e drejta e votave, sepse nuk patën zyrtarisht kartën e identitetit, se si me gjithfarë hilesh të vogla e lojërash të mëdha e zvarritët të gjithë politikën para zgjedhore në përpjekje për të siguruar kartën e identitetit, se si luajtët me fukarallëkun e njerëzve duke bërë blerjen e kartës-garanci për votën blu.

Por ju, në vend që të reflektoni, na nxirrni një zyrtar plotë zullume të Ministrisë së Brendshme, që Prokuroria do të duhet patjetër ta hetojë jo vetëm për abuzimet me kartat në zgjedhjet e në tenderin e 2009-s, por sepse vjedhjen e kartave e ka kthyer në karrierë politike. Na nxirrni një palo zyrtar, i cili zyrtar e strategjisë të decentralizimit, që i lanë socialistët në 2009, u ka shtuar si suvenir vetëm manualin e vjedhjeve të votave. Si paska ky kryestrateg, së bashku me Kryeministrin e kimit elektoral, guxim

të padisë Partinë Socialiste për falsifikime për hapje panikul!

Zotërinj, mos kini frikë nga hapja e kutive për të parë si janë përdorur kartat për të manipuluar zgjedhjet e 28 qershorit. E nëse po shkaktojme panik, zoti Berisha, ky është vetëm paniku juaj dhe i maxhorancës suaj nga transparenca. Populli kërkon hapjen e kutive. Ju pengoni transparencën duke na folur për parimet europiane e për progresin e integritimit europian të vendit. Po na tregoni, ju lutem, për cilat parime e keni fjalën? Europa ka dhjetëra vjet që është larguar nga liderët hileqarë e arrogantë, Europa e bashkuar është ngritur mbi dy parime të mëdha transparencën dhe konsensusin. Po ju, zotërinj të Qeverisë, për integritimin, mbi cilat nga këto parime bazë europiane e keni ngritur ndalimin e hetimit të zgjedhjeve dhe po pengoni zgjidhjen e krizës?

Në emër të transparencës jo e jo, në emër të kompromisit të më shumë se gjysmës së shqiptarëve, të cilët nuk e votuan Sali Berishën për të qenë kryeministri i vendit, pa dyshim që jo e jo, as si respekt për kërkesën e hapjes së kutive nga shumica e europarlamentarëve, që përfaqësojnë shumicën e qytetarëve europianë, pa dyshim që jo e jo. Apo në emër të respektit të Kushtetutës, që ju e shkëlqeni sa herë t'ju vijë mbarë, jo e jo zoti Kryeministër?

Këto janë përralla që mund t'ia tregoni njëri-tjetrit. Por mos harroni se po e tërhiqni shumë për hunde elefantin europian dhe do ta keni të pamundur ta ktheni atë mbrapsht pa ju shtypur me qeverisjen tuaj duke përdorur çdo koncesion politik, do ta keni të vështirë ta ktheni atë mbrapsht duke bërë çdo koncesion për mullinj me erë apo duke privatizuar abuzivisht çdo repart ushtarak.

Ju zotërinj, dhe veçanërisht ju, zoti Berisha, nuk i hapni kutitë jo sepse e ndalon Kushtetuta, por sepse është thjesht një gjë e paqenë, pas së cilës ju keni kapur si i mbyturi pas kashtës. Kompromisi dhe dialogu nuk është pjesë e kulturës suaj politike. Nëse do të kishit minimumin e kulturës demokratike, do ta kishit shfrytëzuar mundësinë e kompromiseve të afuara për të disatën herë nga Partia Socialiste. Por ju zoti Berisha dini shumë mirë një mekanizëm tjetër politik, hilet. Jeni hileqar i madh, zoti Berisha. Edhe kjo seancë e stërzgatur, e pafundme, me ju spiker kryesor, duke qarë e qeshur për hallin e komisionerëve socialistë, është një hile e madhe. Kërkoni t'u hidhni hi syve partnerëve ndërkombëtarë e po ashtu popullit

shqiptar se po ofroni kompromis. Për çfarë kompromisi bëhet fjalë, zoti Kryeministër? Pasi i vetmi kompromis që ju keni është manipulimi i zgjedhjeve. Kjo është e vetmja mundësi për të arritur kompromis me ju, pasi ju keni mungesë të plotë vizioni të qartë për të krijuar një qeverisje të mirë. Keni vendosur t'i bini shkurt në karrierën tuaj politike duke vjedhur vota për të qëndruar në pushtet. Kjo është arsyeja pse ju nuk mund të pranoni kurrësi që hapja e kutive të nxjerrë në shesh të vërtetën e kimit elektoral dhe shembjen e sistemit të vjetër.

Prandaj, mos e ofendoni inteligjencën tonë, duke na u përdëllyer për respektin e madh që paskeni për ligjin. A mos vallë edhe BE-ja na dashka të sabotojmë punën e Qeverisë së Sali Berishës që kërkon të lejojme transparencën?

Ju, zoti Berisha, dhe e gjithë maxhoranca nuk doni ta kuptoni se po luftoni një betejë që tashmë e keni humbur, sepse argumentet retorike e retorika juaj boshe kundër transparencës e konsensusit nuk bindin më askënd, as shqiptarët, as ndërkombëtarët. I keni humbur dhe tashmë e vetmja zgjidhje që ju mbetet është të hapni kutitë apo të largoheni. Zgjidhni dhe merrni! Keni një mundësi tjetër për të gjetur të ardhmen tuaj. Por ju garantoj vetëm për një gjë, zoti Berisha, për Partinë Socialiste hetimi i zgjedhjeve nuk është më një çështje politike, është një kauzë, një mision që ua kemi borxh votuesve tanë dhe të gjithë shqiptarëve. Prandaj harrojeni se do të heqim dorë nga kauza dhe misioni ynë! Ju kujtoj se po ashtu se sot më shumë nga hapja e kutive duhet t'i frikësoheni izolimit tuaj të thellë.

Zotërinj deputetë,

Tashmë u bë një muaj që vras mendjen pse Sali Berisha dhe gjithë të tijtë nuk pranojnë të hapin kutitë dhe nuk kanë asnjë dëshirë për transparencë. Përgjigjen ma dha vetë Sali Berisha në mbledhjen e fundit qeveritare: "Jua them unë ju, se është lakmia që të verbon sytë." Janë ministrat, le ta dëshmojnë këtë. Nga subkoshienca e tij ai nxori arsyen e vërtetë pse e pengon transparencën. Është lakmia për pushtet, lakmia për t'u pasuruar me paratë e shqiptarëve për të dhe oborrin e tij ajo që i ka verbuar sytë dhe po merr me vete një kosto shumë të madhe personale dhe për të gjithë popullin shqiptar.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit!

Zoti Olldashi, urdhëroni!

Sokol Olldashi – Falemnderit, zonja Kryetare!
Pa pasur pretendimin që të përgjigjem në emër

të të gjithë ministrave që u lakuan këtu, do të doja të thosha se kërkesa për transparencë që vjen nga Partia Socialiste, është një kërkesë jo për transparencë, është një kërkesë për të mbrojtur disa interesa shumë specifike, interesat e privatizimeve të bëra nga zonja që është në rreshtin e parë; të 15 mijë pensione ve të paligjshme të bëra nga zotëria që është në rreshtin e parë; të tenderit të skrapit të bërë nga zotëria që është në rreshtin e dytë; të dhjetëra lejeve të ndërtimit të bëra nga zonja në rreshtin e dytë; të kontrabandës, duhanit dhe të hekurit, të bëra nga zotëria në rreshtin e tretë; të interesave të paligjshme të lotove të bëra nga zotëria që është në rreshtin e tretë; të plagosjeve të padenoncuar nga zonja e rreshtit të katërt; për të hyrë me radhë në të gjitha rreshtat e maxhorancës suaj, e shumicës së Partisë Socialiste, që nuk është më socialiste, por është një shumicë socialistësh që nuk kanë asnjë lidhje me PS-në, por vetëm me interesat private të paligjshme ose të ndërtimeve, ose të shkeljeve të ligjit, duke filluar nga rreshti i parë deri te rreshti i fundit.

Në qoftë se doni, unë jam i gatshëm të vazhdojë me rreshtin e pestë, të gjashtë, të shtatë, deri tek interesat e rreshtit të mesit, të fundit nga Partia Socialiste, që janë interesat e fasadave të Bashkisë së Tiranës.

Pra, ajo që mbroni ju nuk është vota e socialistëve, ajo që mbroni ju është paligjshmëria individuale e secilit prej jush. Dhe ne nuk jemi të gatshëm në asnjë rrethanë të japim konsensus për të mbrojtur paligjshmërinë tuaj. Ne jemi të gatshëm në çdo rrethanë të japim konsensus për të hetuar gjithçka që është brenda kuadrit kushtetues dhe ligjor të këtij vendi. Por nuk mundet të japim konsensus për të amnistuar me ligj paligjshmërinë tuaj.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Olldashi!
Zonja Përnaska, urdhëroni!

Lajla Përnaska – Falemnderit, zonja Kryetare!
Të nderuar kolegë deputetë,

Ishin shqiptarët ata që edhe më parë se popujt e tjerë të bllokut ish-komunist shpërthyen fuqishëm për përmbyesjen e një prej diktaturave më famëkeqe që ka njohur njerëzimi. Ishin të rinjtë, që u bënë shpirti, forca, fuqia e pandalshme e shkërmoqjes një herë e përgjithnjë për ngrehinën e diktaturës së ngritur nga pakica, me dhunim me shfrytëzim dhe me persekutim të shumicës, e shkërmoqjes së partisë-shtet, partisë që kontrollonte jo vetëm çdo

qelizë të ngrehinës shtetërore, por kapërcente edhe gardhet e baçeve, muret e shtëpive, qoftë prej qerpiçi, tulle apo parafabrikati, tentonte të vërtitej në vatrë tona duke na dhunuar dhe të drejtat më elementare të ekzistencës sonë.

Ishin qytetarët e këtij vendi që, ndonëse të lodhur nga tejzgjatja e diktaturës, me qytetari e dinjiteti i thanë “stop!” një sistemi dhimbjeje dhe hapën përfundimisht portat e Europës, portat e demokracisë, portat e prekjes së ëndrrës së madhe të disa brezave me radhë. Ishin më shumë se kushdo asokohe brezi i gjyshërve tanë që në momente të tilla historike thoshin me lot gëzimi në sy e me buzët që u dridheshin nga emocionet: “Ia mbërritëm edhe ne kësaj dite, të shijojmë lirinë, të shijojmë demokracinë, Na ka parë Zoti, se asnjë moment s’kemi reshtur së besuari në Zot, edhe në atë kohë kur komunizmi dhunshëm na e mohoi atë”.

Po, zonja e zotërinj, ata që i thanë “po” Europës, “po” të pakthyeshme, “po” të patjetërsueshme, ishin qytetarët e thjeshtë të këtij vendi, ishin studentë, nxënës, intelektualë, punëtorë apo të papunë, fshatarë apo pensionistë, dhe sigurisht nuk ishin aspak bllokmenë të vjetër apo të rinj qofshin, as pjesëtarë e përfaqësues të nomenklaturës së kuqe dhe të falangave të saj.

Portat e Europës janë më të hapura se kurrë sot, të betonuara fort dhe askurrkush, qoftë ky edhe kryetari në detyrë i Partisë Socialiste, nuk ka asnjë lloj shansi ta mbajë peng apo ta cenojë këtë identitet europian të këtij vendi dhe të çdo shtetasi të denjë të tij.

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Të nderuar qytetarë shqiptarë,

Europa nga ana e saj është përpjekur të jetë sa më pranë nesh në asistencën dhe mbështetjen e saj tejet bujare, por pikërisht sot edhe ne nga ana jonë jemi më pranë se kurrë asaj me angazhimin tonë serioz integruës. Këtë e percepton çdo shqiptar kudo që ndodhet. Ishin përsëri qytetarët shqiptarë që edhe një herë më 28 qershor të vitit të kaluar, me shumicë, konfirmuan vazhdimin e ndryshimit të Shqipërisë, vazhdimin e qeverisjes “Berisha”, vazhdimin e integritetit të vendit. Ishin qindra e mijëra qytetarë votues të këtij vendi, që me maturi, me seriozitet dhe me korrektësi u bënë pjesë e një procesi që më së pari u vlerësua nga vetë ata si më i miri i arritur deri më sot dhe më pas nga të gjithë arbitrat ndërkombëtarë që certifikuan të njëjtën gjë, duke bërë edhe përsëritjet përkatëse për këto arritje të këtij procesi në standardet më të mira të

mundshme.

Nga ana tjetër, këtë verdikt nuk gjen ende kurajë ta pranojë humbësi, duke sajuar trille nga më të çuditshmet, nga më të pashoqet, nga më të paqenat. Veçanërisht në harkun kohor të pak muajve të fundit kam qenë dëshmitare e drejtpërdrejtë e skenarëve dhe e përpëlajtjeve të turpshme, të vazhdueshme të dezinformimit dhe të tentativës së keqpërdorimit të komunitetit ndërkombëtar, të firmosura dhe të vulosura këto nga zoti Edi Rama, tentativat të keqpërdorimit të institucioneve të nderuara dhe serioze anëtare, të cilave Shqipëria është bërë edhe para vendeve të tjera rreth saj.

Po ashtu keqpërdorimi edhe i ndonjë anëtari të institucioneve ndërkombëtare për të thënë diku para ndonjë mikrofoni ndonjë fjalë që mundësisht të fillojë me rrokjen "ku" dhe të mbarojë me rrokjen "ti", në mënyrë që të rendië me shpejtësi zoti Rama për ta përdorur në deklaratën e tij të radhës. Këto janë tentativa të paprecedent, por totalisht të dështuara, totalisht të dala boje, totalisht të vjetruara, totalisht ekstrademokratike, ashtu si vetë bojkoti, ashtu si vetë paniku për të pranuar humbjen, ashtu si vetë paradoksi për të akuzuar veten tënde, për të akuzuar përfaqësuesit, për të akuzuar anëtarët, militantët e tu; ashtu si vetë primitivizmi i tentativës së manipulimit të opinionit publik vendas dhe atij ndërkombëtar, me megafon të çoroditur; ashtu si vetë paranoja për të mohuar themelin e demokracisë, për të mohuar ligjin, shtetin ligjor, institucionet e pavarura; ashtu si dikur ata, merhumët e para '90-s, të cilëve sot s'duam t'u dëgjojmë as emrin.

Por me rolin e institucioneve ndërkombëtare mbi opinionin publik shqiptar, të nderuar kolegë, nuk luhej dot as në fillimet e demokracisë në këtë vend e jo më sot, kur pikërisht ky vend është anëtar me të drejta të plota i të gjitha këtyre institucioneve të rëndësishme, që deri në atë kohë as nuk kishte cikor ndonjëherë dhe sot më shumë se kurdo po hedh hapa të sigurt edhe në të bërit pjesë e institucionit më të fundit që na mirëpret në angazhimin tonë integrues, në Bashkimin Europian.

Sot nuk mund të manipulohet opinioni qytetar, sepse edhe nxënësit e shkollave e njohin mirë rolin dhe funksionimin e këtyre institucioneve të rëndësishme. Është sa qesharake aq dhe infantile të luash sot në emër të institucioneve ndërkombëtare, të cilat njëzëri dhe në unison të plotë janë shprehur zyrtarisht qartazi në vazhdimësi për respektimin dhe forcimin e shtetit ligjor në Shqipëri, respektimin e parlamentarizmit, respektimin e

pavarësisë së pushteteve, veçanërisht të atij gjyqësor, respektimin e rregullave të demokracisë e normave e parimeve e vlerave të saj.

Këto janë theksuar qartazi në vazhdimësi që nga Parlamenti Europian me rezolutën e tij, që nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës me rezolutën e saj, që nga Asambleja Parlamentare e OSBE-së me deklaratën e Presidentit të saj, zotit Soares, me deklaratën e Komitetit Presidencial të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës, me deklaratën e Presidentit të tij, zotit Çovushoglu.

Në fakt, kanë qenë mjaft kolegë anëtarë të këtyre institucioneve parlamentare që kanë ndjekur nga afër ecurinë e zhvillimeve politike në Shqipëri, kolegë belgë, francezë, italianë, gjermanë, anglezë, malazezë, turq, grekë apo edhe vendeve të tjera europiane, të cilët kanë njohur nga afër këto zhvillime, kanë saktësuar informacionet e tyre duke marrë konfirmime nga të gjitha palët dhe nga të gjithë aktorët, përfshi edhe kryetarin në detyrë të Partisë Socialiste në komunikim elektronik, telefonik apo të drejtpërdrejtë me të dhe jam befasuar për atë që kam konstatuar, madje jam shushatur nga fakti që kanë hasur në një nonsens, nga fakti që kanë gjetur vetëm nihilizëm, kanë gjetur një lloj hermafroditizmi në qëndrime dhe sjellje politike të këtij kryetari, që nga njëra anë nuk pranon asgjë, por nga ana tjetër nuk prodhon e nuk propozon asgjë.

Pikërisht ky absurd i ka bindur më shumë se kurrë që të vazhdojnë të mbështesin ecurinë tonë, në rrugën tonë integruese, jo vetëm për zhvillimet dhe forcimin e institucioneve demokratike në Shqipëri, por edhe më gjerë në rolin tonë në rajon apo në vendet e tjera si pjesë e këtyre institucioneve ndërkombëtare.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zonja Përnaska!

Do të kalojmë në mbylljen e diskutimeve.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste?

Zoti Ruçi, urdhëroni!

Gramoz Ruçi - Të nderuar qytetarë të Shqipërisë,

Po ju drejtohem për herë të parë në këtë mënyrë nga kjo foltore e Parlamentit, duke mos iu drejtuar kolegëve të mi deputetë në këtë sallë të ligjvënësit pas këtyre orëve të pafundme të dialogut të shurdhët.

Duke e nisur fjalën time, ju kërkoj ndjesë për shumë nga fjalët e marra që keni dëgjuar gjatë këtyre dy ditëve dhe jo vetëm për fjalët e marra, por edhe

nga veprimet po kaq të marra. Në mënyrë të veçantë do t'ju kërkoja ndjesë ju deputetëve të rinj, që e keni për herë të parë uljen në sallë, veçanërisht ju zonjave deputete të Partisë Socialiste, që jeni me të vërtetë zonja dhe e meritoni këtë, që u ulët për herë të parë dhe u ballafaquat në këtë Parlament jo ashtu siç kishit menduar, ëndërruar dhe imagjinuar. Na falni! Ndaj do t'ju lutesha mos u dekurajoni. Kjo është një arsye më shumë që ju të jeni misionare të vendit, të fëmijëve tuaj, të bashkëshortëve tuaj, të vëllezërve e miqve tuaj.

Por çfarë ka ndodhur në këto orë debatesh, në këtë sallë të Kuvendit? Dikur në Shqipërinë e hershme nën otomanët kishte një shprehje që dëshmonte pafuqinë e të dobëtëve. Po e them pak më ndryshe nga ai origjinali: "Kur të dhunon kadiu, s'ka kush ta bën davanë"! Kështu ka qenë atëherë. Por nuk mund të jetë kurrësi sot, në Shqipërinë e sotme që kërkon Brukseli si kryeqytet politik, edhe pse sot Sali Kadiu që dhunoi vullnetin e popullit nuk pranon që e ka humbur davanë, atë dava që ia ka ngritur jo Partia Socialiste dhe grupi i saj parlamentar, por qytetarët shqiptarë, të majtë e të djathtë qofshin ata.

Sot Shqipëria nuk është thjesht në një krizë juridike dhe diskutimet tona nuk synojnë të gjejnë thjesht një shteg në rrugët e pafundme të së drejtës. Kriza, vëllezër e motra, është politike dhe në thelbin e saj ka vetëm një mënyrë për ta zgjidhur, ai është vullneti politik, duke ecur në rrugën e së drejtës. Këtë nuk duan ta kuptojnë kolegët tanë demokratë, që me këtë sjellje po sfidojnë jo vetëm demokracinë, por fatet e vendit dhe partnerët tanë ndërkombëtarë. Juridikisht nuk ka asnjë pengesë që të hetohet në mënyrë të menjëhershme nga Kuvendi se çfarë ndodhi më 28 qershor. Këtë nuk e pengon as Kushtetuta, që e dëgjua me dhjetëra herë edhe në këtë debat. Këtë nuk e pengojnë as vendimet e Gjykatës Kushtetuese; këtë nuk e pengon as e drejta e qytetarit për informim dhe transparencë; këtë nuk e pengojnë as interpretimi dhe këshillat e kahershme të Komisionit të Venecias; këtë nuk e pengon as precedenti parlamentar për zgjedhjet e 2005-s. Këtë e pengon vetëm qëndrimi refraktar i një njeriu, i zotit Berisha. Pse? Sepse ka frikë, sepse i trembet transparencës, i trembet të vërtetës, sepse i druhet dritës që do të hidhet me domosdo në kutitë e mbyllura të votimit.

Çfarë po kërkojmë ne dhe qytetarët shqiptarë prej 8 muajsh? E thënë thjesht: "Zoti Berisha, hap kutitë që ke marrë peng, që të vërtetosh se nuk ke

vjedhur! Në qoftë se është kështu, të qeverisë deri në fund të mandatit dhe ne të gjithë do të shkojmë në shtëpi, duke u kërkuar gjithë popullit ndjesë të thellë dhe duke u vrarë përfundimisht politikisht. Po nëse në kutitë ndodhet vjedhja, atëherë përsëri ne u bëjmë apel të bëjmë kompromisin e madh historik: atë të ringritjes të sistemit të zgjedhjeve, atë mekanizëm besimi dhe detyrimi reciprok dhe kushtetues, që të respektojmë votuesit dhe vullnetin e tyre.

Rruga që kemi zgjedhur verbërisht ka vetëm një faturë të padëshirueshme. Fatura është jo vetëm politike, por këtë faturë do ta paguani ju, por jo vetëm ju, në mos sot dhe tani, nesër kjo faturë do të paguhet.

Të nderuar qytetarë,

Në seancën e betimit të deputetëve socialistë kam bërë një sfidë të parë. Unë hoqa dorë nga mandati që më dhanë qytetarët e Fierit dhe partia që përfaqësoj dhe do të largohesha përfundimisht nga politika në këmbim të hapjes së një kutie. I thashë zotit Berisha: "Hap vetëm njëherë, atë të Ruzhdies! Por kutia e Ruzhdies u hap dhe andej u derdh gjithë lumi i ndotur i manipulimit zgjedhor.

Nga kjo kuti e vetme mësuam jo vetëm ne, por edhe partnerët tanë ndërkombëtarë se kemi pasur shumë të drejtë kur kemi folur për kërcënimin dhe dhunimin e komisionarëve, që në retorikën tuaj, prej dy ditësh, u dhimbshin shumë edhe ata socialistë që i sakatuat dhe i pushuat nga puna për votimin e paqenë të emigrantëve; për përdorimin e kartave të identitetit të falsifikuara; për votimin familjar dhe falsifikimin e firmave të tyre; për falsifikimin e dokumenteve zyrtare etj., etj.

Ka edhe më shumë. Ruzhdia nuk është thjesht një fshat. Ajo është një fenomen, që mund ta gjejmë në të gjitha rrethinat e Tiranës, mund ta gjejmë në Shkodër, në Kukës, në Dibër, në Fier, në Elbasan, në Berat, në Lezhë, në Vlorë, në Durrës. Ruzhdiet janë të mbyllura me kyç në Lundër. Çelësi i tyre mbahet nga një njeri me emrin Sali Berisha.

Në emër të Partisë Socialiste ju përsërita më vonë të njëjtën sfidë: heqim dorë nga kauza jonë për vjedhjen e votës në këmbim të kontrollit të kutive, të materialeve zgjedhore, nëse nuk vërtetohen pretendimet tona. Kavalieri ynë me kalë pushteti pa potkoj heshti përsëri. Nuk ia kanë thënë që në fëmijërinë e tij, që të mos pranosh sfidën në jetë apo në politikë, do të thotë që ke pranuar disfatën.

E sfidova për herë të tretë me kartat e identitetit. U tregova shqiptarëve në këtë sallë të Kuvendit se

si i njëjti qytetar ka pasur më shumë se një kartë identiteti false, për ta përdorur ditën e votimit.

Tani është momenti i sfidës së radhës. Unë po e sfidoj edhe një herë zotin Berisha. Tri ditë më parë ai kishte urdhëruar një palo zëvendësministër që të më padiste mua penalisht për denoncimet që bëra për kartat e identitetit të falsifikuara. Mirë ka bërë, sepse e dimë të gjithë që e ka një hall të madh në këtë marifet. Por, si çdo marifet që ai zë me dorë shtrembër, ishte i shtrembër vetë. Nuk ia vlen të merrem me zëvendësministrin "Al Kapone", për të cilin thonë se ngaqë i fut duart kudo, edhe kur ha paçe, edhe aty kur nuk i takon, edhe po t'i japësh një fushë me hudhra për të ruajtur, i ha të tëra. Prandaj, zoti Berisha, do të mbysin në fyt dhe do të ndotësh dynjanë me erën e tij!

Zoti Berisha, tani, si unë, edhe ju çdo ditë po thinjemi shumë, e kur burri thinjet, bëhet më fisnik, por te ju po ndodh e kundërta. Sa më shumë të zbardhen flokët, aq më katran të bëhet goja, aq më i vogël të bëhet shpirti e aq më i lig e më keq të venë punët. Prandaj, zoti Berisha, po të sfidoj përsëri. Unë e lë imunitetin tim për hetimin për kartat, kurse ti merr masat e tua. Ajo që unë të sfidoj e të propozoj është: që të ketë kuptim kjo sfidë, hajde dhe ti vetë përpara drejtësisë në të njëjtën kohë me mua, por me një dallim: unë akuzën e kam të përcaktuar sipas teje, ty po të bëj një preferencë, akuzën zgjidhe vetë, në daç paratë e Arsedit, në daç naftën e Milosheviçit, në daç piramidat që ndërtove, në daç masakrën e elektoratit të '96-s, në daç tragjedinë e '97-s, në daç grushtin e shtetit të '98-s, në daç dhjetëra vrasje ende pa autor në shumë vjet deri tek i ndjeri, miku dhe pjesëtari i familjes sonë, që u vra në prag të shtëpisë dhe të fushatës elektorale, në daç vrasjet e 26 qytetarëve të pafajshëm në vitin 2008, në daç korrupsionin galopant të rrugës, në daç atë të energjisë elektrike, që përmbyti Shkodrën, në daç koncesionet e panumërta korruptive, në daç papërgjegjshmërinë dhe paaftësinë tënde qeverisëse, në daç atë lumë vreri e shpifjesh që ke bërë këta 20 vjet ndaj ne socialistëve, në daç edhe të fundit: krimin elektorale të vitit 2009. Pastaj, po deshe, mbajti mbyllur kutitë, fshihu në to si në bunker, por as xhamat e blinduar të zyrës tënde dhe as kutitë bunker nuk do të të shpëtojnë dot nga zemërimi dhe përçmimi i historisë.

Prandaj kujdes, zoti Berisha, nuk ke shumë kohë! Mes teje dhe popullit të zemëruar opozitar po qëndron Partia Socialiste, dhe jo vetëm ajo. Qytetari opozitar dhe Partia Socialiste me aleatët e saj të

besimit do ta shkulin një herë e mirë papërgjegjshmërinë tënde nga ky vend. Nesër do të jetë vonë!

Ju mund të kërkoni të mbani peng kutitë e votimit, por nuk mund të mbani peng lirinë dhe të drejtën e një populli të tërë për të zgjedhur lirisht qeverisjen e tij.

Për ta përfunduar, ne erdhëm me qëllimin e mirë për t'i dhënë një zgjidhje krizës politike të ulur këmbëkryq në këtë vend. Ne erdhëm për një dialog serioz parlamentar, duke folur gati të gjithë si grupi parlamentar, por u ndeshëm me demagogjinë, retorikën, diversionin, spekulimin, mashtrimin dhe hermetizmin, pa pasur asnjë ofertë konkrete dhe, aq më pak, të ndershme apo të sinqertë. Por asnjëherë nuk është vonë. "Më mirë vonë se kurrë", - thotë populli. Mirëkuptimi ynë politik para qytetarëve shqiptarë dhe komunitetit ndërkombëtar është çelësi i artë për zgjidhjen e krizës politike.

Edhe një herë, në emër të Partisë Socialiste, të grupit të saj parlamentar, ju bëj apel që të gjeni forcën dhe kurajën për të gjetur mirëkuptimin dhe vullnetin politik, duke votuar dy nismat tona. Nëse ky vullnet do t'ju mungojë edhe sot përpara votimit në parim, ne do të jemi të detyruar të tërheqim nismat tona dhe përgjegjësia le të mbetet mbi ju dhe vetëm mbi ju. Pra, ne si politikanë e bëmë detyrën tonë. Populli t'i dalë për zot fateve të tij. Ne do të jemi bashkë me të.

Falemnderit!

(Duartrokitje nga deputetët socialistë)

Jozefina Topalli – Zoti Patozi, urdhëroni!

Astrit Patozi – Falemnderit, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë,

Do të doja shumë që ajo që dëgjova më parë të mos kishte vlerën e një amaneti apo testamenti politik, sepse unë nuk besoj që sot ne po ndahemi për së gjalli me njëri-tjetrin. Do të kemi prapë rrugë për të bërë bashkë, pavarësisht emocioneve që ju mund të kenë, po që janë momentale. Besoj se, pavarësisht kundërshtive që mund të kemi me njëri-tjetrin, ka një pikë që ne duhet të biem dakord, besoj që po, që Parlamenti i një vendi demokratik nuk mund të marrë në shqyrtim letrat e hapura. Ato na kujtojnë kohëra të errëta, të cilat jo vetëm nuk kemi ndër mend t'i kthejmë, por as na vjen shumë për mbarë që t'i kujtojmë.

Në një kuptim, këto dy ditë na është paraqitur në një formë tjetër letra e hapur e Edi Ramës, ose më saktë konspekti i saj nga përfaqësuesit e Partisë Socialiste dhe kjo do të kishte qenë mirë që të

evitohej.

Ndërkohë, ky Kuvend mund dhe duhet të trajtojë çdo nismë ligjore të opozitës dhe ne kemi treguar të gjithë gatishmërinë dhe respektin e duhur për to. Por asnjë deputet i maxhorancës nuk mund të detyrohet të marrë në konsideratë dhe aq më pak të çohen ndër mend që të votojë ultimatume. Është një keqkuptim i madh të pretendosh se me vendimin për të ndërprerë bojkotin, ju e keni shlyer tashmë detyrimin tuaj dhe na keni futur në borxh.

Në qoftë se keni ardhur në këtë sallë, nuk e keni bërë për ne. Në rastin më të mirë keni respektuar zgjedhësit tuaj. Sigurisht këtu nuk bëjnë pjesë komisionerët, se ata i keni shpallur armiq. Në rastin më të keq, dhe kam frikë se jemi brenda këtij, e keni bërë me një qëllim të vogël pragmatist, për të shpëtuar mandatet tuaja personale. Mirë keni bërë! Por nuk mund t'i kërkon i maxhorancës dëmshpërblim për këtë. As kjo legjislaturë dhe aq më pak historia e Kuvendit të Shqipërisë nuk nis me ditën që një deputet apo një grup deputetësh ka ardhur për të zënë karriget e veta këtu.

Ndaj kthehuni me këmbë në tokë, sepse nuk mund të kushtëzoni qëndrimin tuaj në Parlament me plotësimin e çdo teke apo trilli të një individi, qoftë ky edhe kryetari juaj.

Rreth dy javë të shkuara depozituar nismat tuaja ligjore. Pavarësisht se provokuese, ne nuk u ngutëm t'i hidhnim poshtë si të papranueshme, por me durim dhe maturi pritën gjetjen e një kompromisi, i cili sigurisht që duhet ta gjente formën e vet nëpërmjet shqyrtimit të tyre në Komisionin e Ligjeve.

Por edhe tani që kemi mbërritur në fazën finale të shqyrtimit të tyre është vendi për të theksuar se qytetarët shqiptarë duhet ta dinë se për 6 muaj keni kërkuar diçka të paligjshme, sepse ndryshe nuk do të sillnit projektin për ndryshime në organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore. Qytetarët duhet ta dinë se nuk dhe nuk mund të ketë asnjë rast tjetër në botë kur kërkohet të miratohet një ligj që kapërcen mbi Kushtetutën, siç po ndodh me ju tani. Shqiptarë duhet ta dinë, gjithashtu, se po kërkohet një ligj për t'i bërë proces 20 mijë komisionerëve dhe numëruesve të Partisë Socialiste, të cilët janë shpallur paraprakisht si fajtorë për humbjen.

Por, si mund të implikohet Parlamenti në një pushkatim pa gjyq të disa qytetarëve të përgjegjshëm, të cilët më 28 qershor kryen me devocion detyrimin e tyre ligjor. Disave prej jush nuk u vjen mirë kur hapet kjo temë, se mbase e quajnë

problem të brendshëm të Partisë Socialiste, por të ishte i tillë as ne nuk do ta përmendnim dhe as ju nuk do të sillnit ligjin për t'u bërë gjyqin atyre.

Por ju keni realisht një problem të brendshëm, i cili ju ka tjetërsuar dhe shndërruar nga një parti e madhe dhe vitale që synon pushtetin, në një repart të hallakatur, por i gjithi në mbrojtje të kryetarit. Asnjë forcë serioze politike nuk mund të ndryshojë qëllimin e ekzistencës së vet, siç po ndodh me Partinë Socialiste, aq më tepër kur kryetarit nuk i kanoset ndonjë rrezik, por ai thjesht nuk po kapërdin dot dëshpërimin.

Ne jemi vërtet kundërshtarë politikë dhe mund të mos biem dakord për shumë çështje, por disa vlera ia njohim dhe ia pranojmë njëri-tjetrit. Ne e dimë se midis jush ka politikanë me eksperiencë dhe me personalitet, por më besoni, që kurrë në këtë sallë nuk është parë një prezantim kaq i mefshtë dhe pa ngjyrë i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste. Shpjegimi është i thjeshtë, kur nuk ka kauzë, nuk ka motivim, sepse shumica juaj, për të mos thënë të gjithë, nuk e besoni legjendën e transparencës apo përrallën për të vërtetën që gjoja u fshehka në kuti.

Transparenca është një fjalë e bukur dhe një koncept atraktiv, por që nuk ka asnjë lidhje me lëvizjen apo linjën politike të Edi Ramës. Në fakt, ai po kërkon të kundërtën e saj, turbullirën dhe kaosin, pasi nuk ka pasur gjë më transparente sesa procesi zgjedhor që Shqipëria zhvilloi më 28 qershor, ku gjithçka dhe çdo votë u filmua dhe u shfaq në ekrane, kur mjaftonte një vëzhgues të ngrinte dorën dhe vota e kontestuar të kalonte mënjandë dhe ku u votua pa asnjë incident, 7 me 0 në të gjitha nivelet e komisioneve zgjedhore.

Të nderuar kolegë,

Për fat të keq, ju thoni transparencë për të mos deklaruar publikisht që kërkonit të baltosni dhe të delegjitimoni institucionet e këtij vendi, vetëm se nuk mund të pranoni që i keni humbur zgjedhjet. Ju thoni të hapen kutitë, sepse nuk mund të deklaroni dot se realisht po kërkonit yshtjen e një konflikti dhe përmes tij rrëzimin e Qeverisë legjitime jo me votë, por në rrugë ekstraparlamentare, sepse një gjë të tillë nuk do ta pranonte askush brenda dhe jashtë vendit.

Përmes këtyre nismave që po kërkonit në mënyrë të pabesueshme që të mos u hiqet asnjë presje, Edi Rama ka dëshirë të jetë edhe Prokuror i Përgjithshëm, edhe kryetar i të gjithë shkallëve të gjyqësorit në Shqipëri, madje edhe interpretues i

vetëm i Kushtetutës. Kjo natyrisht që nuk mund të ndodhë dhe nuk mund të pranohet për asnjë çmim.

Që në ditën e thyerjes së bojkotit e deri më sot që po flasim, keni qëndruar gati me pahir në këtë sallë, duke i mbajtur jo vetëm sytë, por edhe njërën këmbë jashtë derës. Slogani "vijmë për të mos qëndruar", që duket si i shkëputur nga kohërat e revolucionit kulturor kinez, ka pasur në thelb një vendim të paracaktuar dhe gjithë koha e gjoja shqyrtimit në Komisionin e Ligjeve të nismës suaj ka qenë thjesht dhe vetëm hipokrizi.

Në rast se ju besoni te zgjidhja, te marrëveshja dhe kompromisi, nuk do të braktisnit çdo komision tjetër dhe çdo pikë tjetër të rendit të ditës të Parlamentit. Në rast se besoni te gjetja e të përbashkëtave, nuk do të linit Komisionin e Ligjeve me pretendimin absurd se shqyrtimi i projektligjit duhet të fillonte nga neni 4. Është njësoj si t'i thuash një brigade konstruktorësh që ndërtimin e një pallati ta nisnin nga kati i katërt dhe jo nga i pari, ndryshe nuk e duam fare pallatin. Të paktën, këtë gjest mund ta kishit kursyer në rast se do të bënit pak kujdes për t'i lënë vetes një shteg të vetëm dhe të ngushtë besueshmërie.

Ju po kërkonin që me ligj të shndërroni pakicën në shumicë, por kjo përveçse është e pamundur, është edhe shumë komprometuese. Të paktën, këtë mund ta kishit shmangur, se nuk ka qoftë edhe një zë të vetëm në glob që t'ju miratojë. Me këtë logjikë i bie që në rast se kryetarit tuaj, larg qoftë, i shkrepet një ditë, mund të thotë se nuk vijmë në Parlament në rast se nuk na jepni Kryeministrin dhe treçerekun e Qeverisë.

Mendoj se kemi mbërritur në një pikë që paragjykimet nuk shërbejnë për asgjë, por ju ato i keni që në ditën e parë kur ngritët pas asnjë fakt dhe provë pretendimet për gjoja probleme me zgjedhjet e 28 qershorit.

Por çfarë kemi bërë ne gjatë kësaj kohe? Gjithçka që i takon një maxhorance të përgjegjshme që kërkon zgjidhje, ndonëse është fare e qartë se ngërçi politik është krijuar artificialisht. Kemi qenë ofertuesit e vetëm dhe kemi pranuar çdo propozim që na është bërë për të arritur një mirëkuptim, që nga dhurimi i maxhorancës në komisionin hetimor, i cili është rast unik, te dakordësia, paradhënie e mendimeve të mundshme të Kodit Elektorale në përputhje me rekomandimet e raportit të OSBE-ODIHR-it, hetimin pa kufizim i institucionit të akuzës kur ka prova dhe fakte për parregullsi, deri te marrja në konsideratë e interpretimit të Komisionit të

Venecias.

Po cili është krimi ynë, për të cilin po akuzohemi sot e gjithë ditën? Sepse kemi guxuar të bëjmë amendamente dhe se kemi një qëndrim që ndryshon nga i juaji për disa nene të projektligjit. Në fakt, para nesh ka vetëm dy alternativa: ose ta lëmë siç është ligjin për komisionet hetimore, ose ta ndryshojmë atë në përputhje me vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Rrugë të tretë nuk ka. Ne pikërisht këtë kemi bërë, e kemi përmirësuar nismën tuaj duke e sinkronizuar me parimin e patjetërsueshëm të ndarjes së pushteteve. Ndërkaq, në mënyrë fare të pakuptimtë, ju po përpiqeni më kot të merrni rolin e viktimës dhe po qëndron pa lëvizur as një centimetër nga llogorja e shndërruar në kuti, apo kutia e shndërruar në llogore.

Por, ndërkaq ky stoicizëm në dukje të parë nuk është se nuk ka pasur evolucionin e vet. Për muaj të tërë nuk keni lënë fjalë pa thënë me pretendimin se rinumërimi ishte një e drejtë që u takonte, por pastaj përgënjeshtrohet vetveten kur depozituar projektligjin. Do të ishte mirë që, të paktën, t'u kërkonit falje zgjedhësve të Partisë Socialiste që i latë pas asnjë shkak për 6 muaj të papërfaqësuar.

Për javë të tëra i dhatë zemër vetes, por edhe garanci votuesve tuaj se mandatet as digjen e as skadojnë, por pastaj një javë para përfundimit të tyre u paraqitët pa shumë krenari dhe jo si heronj për të bërë betimin në Parlament, duke i dëshmuar atyre se zgjidhët hallin e 64 qytetarëve deputetë, por përfaqësimin dinjitoz të mbi 600 mijë zemrave opozitare, siç i pëlqen të thotë Edi Rama.

Po të keni parasysh këto kthesa të forta në këtë histori fare të palavdishme, shpresojmë që mundësisht shumë shpejt t'ju shohim në një tjetër zbritje, në kufijtë e arsyes dhe normalitetit. Uroj me gjithë shpirt që kjo të mos ju harxhojë edhe 6 muaj të tjerë në boshllëk!

Duke përfunduar, do t'ju sugjeroja shumë sinqerisht se nuk është që ju t'i prezantoheni publikut apo më mirë të themi zgjedhësve të partisë suaj sikur axhenda politike dhe parlamentare e Partisë Socialiste ka vetëm një pikë, atë të kutive, sepse ata kanë nevojë, vendi ka nevojë që ju të jeni pjesë e debatit politik për shumë tema të ndjeshme dhe të rëndësishme, sidomos të atyre që kanë lidhje me proceset integruese të Shqipërisë. Por në rast se ju ndiheni mirë të izoluar brenda një të ashtuquajture çështje, ne po ju themi paraprakisht se nuk mund të mbyllim në kuti as Qeverinë, as Parlamentin, madje as edhe njërin prej nesh.

Ndërkohë ne po ju ftojmë edhe një herë seriozisht që të dilni nga kutia dhe t'i ndeshim në dritën e diellit të vërtetat, idetë dhe pikëpamjet tona, duke filluar me këtë projektligj, duke vijuar me ngritjen e komisionit hetimor, që vetë e keni kërkuar me ngulm prej më se 6 muajsh dhe për të cilin ne jemi plotësisht dakord në njërin prej dy versioneve të vetme që kemi në dispozicion. Ju takon të zgjidhni, i keni mbi tavolinë, ne jemi gati që t'i votojmë! Jemi gati që t'u vëmë në dispozicion amendamentet tona dhe emrat tanë dhe që nesër komisionit hetimor të fillojë nga puna sigurisht, duke respektuar deri në një ligjet e këtij vendi, Kushtetutën dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe nuk ka në botë forcë politike serioze që t'i drejtohet me nismë ligjore një parlamenti sovran dhe t'i kërkojë me ultimatum që të mos i prekë asgjë në nismën e vet. Mbrapa kemi anëtarët e Kabinetit, është Qeveria që e kemi mbështetur dhe votuar të gjithë vetë. Nuk ka asnjë rast të vetëm që nismat ligjore që vijnë nga Qeveria jonë të kalojnë në Parlament me ultimatumin "të mos preken në asnjë presje apo në asnjë rresht të tyre". Pra, sigurisht, një gjë që nuk ia lejojmë vetvetes, nuk ia lejojmë askujt tjetër.

Ne jemi këtu që bashkërisht të ecim për të bërë atë që ju e konsideroni transparencë, por për ne sigurisht që është një pretekst për të motivuar një lëvizje politike të paracaktuar dhe që nuk ka për qëllim as transparencën dhe as hapjen e kutive, por atë që ju thashë më sipër: krijimin e kausit, krijimin e një konflikti politik, me shpresën se mund të riktheheni në pushtet jo me votë të lirë, por me rrugë ekstraparlamentare. Sigurisht, kjo është një orvatje e dështuar që në nisjen e saj.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Patozi!
Urdhëroni, zoti Ruçi!

Gramoz Ruçi - Siç e thashë në mbyllje të fjalës sime në emër të Grupit Parlamentar të PS-së, ne erdhëm me qëllimin e mirë për një dialog konstruktiv parlamentar. Kërkuam një ofertë dhe një vullnet të ndershëm dhe të sinqertë, dhamë gjithë mirëkuptimin tonë politik, bëmë apel që të gjenit forcë, bëmë apel që të gjenit vullnet, me qëllim zgjidhjen e krizës politike në vend.

Në respekt edhe të grupit të maxhorancës dhe të kryetarit të saj, zotit Patozi, unë prita fjalën e tij dhe në këto kushte, në këto rrethana, jemi të detyruar, zonja Kryetare, që në mbështetje të nenit 72 të Rregullores, për arsytet që shpjegova në fjalën time, të tërheq nismën tonë si për amendamentet e

bëra për ligjin organik për komisionet hetimore, ashtu edhe kërkesën për ngritjen e komisionit hetimor.

Falemnderit!

Jozefina Topalli - Zoti Ruçi, një orë përpara kishte një shprehje shumë të qartë komisioneri Fyle: "Rruga në vazhdim duhet të udhëhiqet nga dy parime themelore: respekti për Kushtetutën dhe transparencën". Në projektet që keni përpara keni transparencën, për të cilën flisni prej 7 muajsh, keni edhe Kushtetutën. Tani nuk e keni me ne, e keni me Komisionin Europian. Nëse ju do të tërhiqeni nga nisma, ne nuk tërhiqemi nga ajo që kemi premtuar. Ne do ta ngremë komisionin hetimor për të bërë transparencën e zgjedhjeve të 2009-s dhe bazuar në nenin 72 të Rregullores, zoti Ruçi, meqë ato iniciativa nuk kanë ardhur në emër të Grupit, të kryetarit të Grupit Parlamentar, por kanë ardhur në mënyrë individuale, dhe ju nuk i keni paraqitur me shkrim, unë do të vazhdoj procedurat, do të ngremë komisionin hetimor për të bërë transparencën e zgjedhjeve të 28 qershorit 2009. Në qoftë se ju tërhiqeni, ne nuk tërhiqemi. Sot para shqiptarëve, të gjithë do ta kuptojnë kush ishte për transparencën dhe kush nuk donte transparencë, cilët ishin të sinqertë në ofertat e tyre dhe cilët abuzononin me transparencën. Kështu që, zotërinj deputetë, bëhuni gati për të votuar për kuorumin.

Gramoz Ruçi – Së pari, dua të shpjegoj për qytetarët dhe për mediat se neni 72 thotë: Nismëtarët e projektligjit, të amendamentit apo të kërkesës për vendim kanë të drejtë që të tërheqin propozimin e tyre para hedhjes në votim në parim.

E dyta, në qoftë se e doni me shkrim e kam këtu. Sekretaria, ju lutem! Ju nuk tërhiqeni. Për çfarë? Për amendamentet që keni bërë? Amendamentet janë bërë për nismën tonë. Kur tërhiqet nisma, nuk miratohet, nuk shqyrtohet dhe nuk votohen amendamentet për nismën që është tërhequr.

E treta, ngritja e komisionit hetimor është kërkesa jonë. Ju, në qoftë se keni vullnet, ngrini komision hetimor. Bëni kërkesë ju, firmoseni, silleni, sipas rregullave, shqyrtojeni në Konferencë të Kryetarëve, në seancë plenare dhe ngrini komisionin hetimor, por kërkesën tonë dhe nismën tonë ne e tërheqim sipas Rregullores së Parlamentit.

Jozefina Topalli – Urdhëroni, zoti Patozi!

Astrit Patozi – I nderuar zoti Ruçi,

Unë mendoj që nuk është as çasti dhe as dita që ju të fshiheni pas një neni të Rregullores.

Në radhë të parë, pas kësaj tërheqjeje

spektakolare nga nisma juaj ju duhet t'u kërkonti falje të gjithë shqiptarëve që u keni harxhuar kaq shumë energji dhe kaq shumë kohë. Në të gjithë këto muaj duhet t'u kërkonti falje zgjedhësve tuaj, që jo vetëm s'i përfaqësuat, por i gënjetet me pretendimin se ju kërkonti transparencë, kur ju nuk kërkonti transparencë.

Ju sot erdhët për një sebeb, por ne jemi të vendosur që t'jua lemë hapur derën e mundësisë dhe në rast se ju tërhiqeni nga nisma për projektligjin ne biem dakord me ju. Po pse biem dakord? Sepse ne nuk kemi pasur asnjë pretendim për projektligjin, sepse nuk është ligji problemi. Problemi është e ashtuquajtura transparencë apo kutia që ju keni në kokë. Nuk është ligji problemi. Me ligjin aktual të komisioneve hetimore ne kemi kryer shumë veprimtari në këtë Kuvend, që në kohën kur ishim në opozitë edhe tani që jemi në pushtet. Është një ligj që e kemi pranuar kur kemi qenë në opozitë, është miratuar në vitin 2002 dhe ka qenë nisma juaj. Ju nuk mund të keni dy standarde për të njëjtin ligj: një herë kur jeni në opozitë dhe një herë kur vini në pushtet. Megjithatë, për shkak se ju tërhiqeni nga kjo nismë, ne në një farë mënyre e pranojmë, por nuk pranojmë tërheqjen nga komisioni hetimor dhe e bëjmë nismë tonën. E miratojmë sot me emrat tanë dhe lëmë bosh vendet tuaja. E bëjmë atë sot dhe ju e keni derën e hapur të zini vendet jo vetëm në karriget e Parlamentit, por edhe vendet e këtij komisioni në rast se doni t'u dëshmoni qytetarëve shqiptarë se e keni me gjithë mend të ashtuquajturën transparencë.

Ne jemi këtu, nëse doni, votojmë edhe projektligjin me amendamentet, duke e përshtatur atë me vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Nëse jo, votojmë vetëm komisionin. Aty e keni edhe transparencën, edhe gjithçka tjetër që kërkonti.

Falemnderit!

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Patozi!
Urdhëroni, zoti Ruçi!

Gramoz Ruçi - Vullnetet politike janë të qarta. Ato u shprehën individualisht në të gjithë kuorumin parlamentar, majtas dhe djathtas, në këto dy ditë dhe dy net; ato u shprehën publikisht në emër të grupeve si nga unë, edhe nga ju, zoti Patozi. Ne jemi tani në fazën e votimit në parim të nismave tona, si të amendeve të projektligjit, ashtu edhe të kërkesës për komisionin tonë hetimor. Duke parë edhe një herë mungesën e vullnetit tuaj politik për të realizuar atë qëllim, atë objekt, ato mjete që ne kërkojmë konform Kushtetutës, konform vendimit

të Gjykatës Kushtetuese, konform interpretimit të Komisionit të Venecias, konform precedentit të 2005-s, ne e tërheqim nismën tonë.

Jua thamë të gjithë anën politike dhe juridike të problemit. Ju keni dëshirë të ngrini komision hetimor. Por ju nuk mund të operoni mbi kërkesën tonë, se shkeli ligjin, shkeli procedurën. Doni ta miratoni? Por është e drejta juaj, merrni nismën, bëni kërkesën për ngritjen e një komisioni hetimor, silleni në Konferencën e Kryetarëve, procedura është e qartë, uluni në sallë dhe miratojeni! Atëherë do të shprehim ne pikëpamjet tona për kërkesën tuaj. Por sot ju nuk mund të gjykoni kërkesën tonë. Ne qëndrimin tonë politik e shprehëm, ne jemi brenda procedurës parlamentare, brenda Rregullores së Parlamentit.

Jozefina Topalli – Falemnderit, zoti Ruçi!

Atëherë, meqenëse është një premtim i maxhorancës, ne jemi për ngritjen e komisionit hetimor, ne jemi për transparencë të plotë, ne jemi për hetim të plotë dhe e gjithë kjo është në projektvendimin që unë kam përpara. Prandaj, të nderuar zotërinj, merrni kartat e votimit. Fillojmë votimin.

Hapet votimi për prezencën.

Mbyllet votimi.

72 deputetë të pranishëm.

Urdhëroni, zoti Ruçi!

Gramoz Ruçi – Zonja Kryetare,

Po krijoni një precedent parlamentar pas njëzet vjetësh ekzistence të këtij Parlamenti duke shkelur hapur atë që është shkruar e zeza mbi të bardhë. Nesër bëni kërkesën tuaj, por ju s'keni të drejtë të votoni, me apo pa kuorum, mbi një kërkesë tonën për ngritjen e komisionit hetimor, apo nisma, kur neni përkatës mua më jep të drejtën ta tërheq dhe ti ke detyrimin të deklarosh mbylljen e seancës dhe jo të votosh atë që të hoqa unë. Çfarë do të votosh?! Vendimi juaj është bërë mbi bazën e kërkesës sime. Unë e tërhoqa kërkesën time. Çfarë do të votosh? Kërkesa është në emër të grupit parlamentar.

Zonja Kryetare, mos bëni diversione të tilla! Ju e dini që ata deputetë që kanë firmosur atë nismë e kanë firmosur si deputetë të PS-së. Unë kërkesën që të kam bërë me shkrim ta kam bërë jo si Gramoz Ruçi, si deputet, por si kryetar i Grupit Parlamentar të PS-së. Megjithatë, lodrat e fjalëve janë tjetër gjë. Unë u bëj apel të gjithë deputetëve nënshkruar të ngrihen në këmbë dhe të tërheqin nismën.

Jozefina Topalli – Në fakt, ky është xhesti më i mirë që shqiptarët të kuptojnë përse kanë ardhur ata sot...

(Ndërhyn zoti Ruçi)

Gramoz Ruçi – Dakord, e bëjmë nominalisht.

Jozefina Topalli – Dakord.

Zoti Balla, tërhiqni nga ngritja e komisionit për transparencë të plotë dhe hetim të plotë?

(*Debate nga deputetët socialistë që janë ngritur në këmbë para foltores.*)

Taulant Balla – E nderuar zonja Kryetare e seancës,

Unë deputeti Taulant Balla tërhiqem nga nismat ligjore të propozuara...

Jozefina Topalli – Bravo! Ja, t'i shikojnë shqiptarët për çfarë keni folur për 7 muaj.

Zoti Fatmir Xhafa, a tërhiqeni nga ngritja e komisionit hetimor për transparencë të plotë dhe hetim të plotë? Ja, këtu është e shkruar. (*I tregon një dokument*).

Zoti Xhafa, urdhëroni!

(*Ka ndërhyrje nga deputetët socialistë.*)

Urdhëroni, zoti Ruçi!

Gramoz Ruçi – Ju lutem, zonja Kryetare!

Kësaj seance vetëm kjo i mungonte, kjo shfaqje e shëmtuar e këtij momenti. Edhe kjo që i mungonte ia dhatë si qershia mbi tortë, jo si qershia, por si një gjë tjetër. Prandaj...

Jozefina Topalli – Doni transparencë të plotë dhe hetim të plotë, apo nuk doni?

Gramoz Ruçi – Në emër të Grupit Parlamentar të PS-së ju kërkoi juve të mblidhni Konferencën e Kryetarëve lidhur me situatën dhe kërkesën tonë dhe pastaj të futemi në seancë. Kërkoj çerek ore pushim.

Jozefina Topalli – Ne do të vazhdojmë, sepse kemi 24 orë që diskutojmë këtu. Meqë ju tërhiqeni...,

Zonja Arta Dade, a tërhiqeni nga komisioni për transparencën e plotë për hetim të plotë?

Arta Dade – Zonjë që vetëm falënderoni Sali Berishën, të lutem shumë mos provoko më! Boll na keni mësuar se çfarë të bëjmë!

Jozefina Topalli – Zonjë, ju pyeta a tërhiqeni apo nuk tërhiqeni. Nuk tërhiqem, tha zonja Dade. (*Debate*) Tërhiqet edhe zonja Dade.

Ta kishit sjellë me shkrim ose thojeni nominalisht secili! Ja, këtu e kam me shkrim: Arta Dade, Meksi, Xhuvani, Ylli, Shkreli, Abazi, Hysa,....

Atëherë, hapim votimin me elektronikë.

(*Deputetët e PS-së kanë dalë para foltores dhe debatojnë.*)

Ja, ja, t'ju shohin shqiptarët juve që donit transparencën e plotë. Ja ku e keni transparencën e plotë në këtë projektvendim, transparencë dhe

Kushtetutë. Ju nuk e keni sjellë me shkrim, sepse sipas Rregullores, kur sillet kërkesa, duhen 35 firma, nuk sillet në emër të kryetarit të grupit.

Votojmë edhe një herë për kuorumin, meqenëse e keni merak.

Hapim votimin për kuorumin.

Mbyllim votimin.

(*I drejtohet zotit Ruçi që debaton nga foltorja.*)

Jam në votim, nuk mund të bëjmë pushim. Kur të mbarojë votimi, mund të bëjmë pushim.

Atëherë, 72 deputetë është kuorumi.

Votojmë për ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit për transparencën e zgjedhjeve të përgjithshme të mbajtura më 28 qershor 2009. Në mbështetje të neneve 77 dhe 78 të Kushtetutës dhe të piks 8 ...

(*Ndërpriet nga deputetët socialistë që debatojnë.*)

E shikoni si bërtasin këta që kërkojnë transparencën dhe tani që u themi të votojnë nuk duan transparencën? Janë kundër transparencës. Tani që u themi për hetim të plotë, këta ikin dhe nuk pranojnë.

Ne qëndrojmë përsëri. Të jap ngritjen e komisionit hetimor, siç e keni dashur, të jap edhe maxhorancën e këtij komisioni, të jap edhe kryetarin e komisionit hetimor, por Kryetarin e Parlamentit ta harroni.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë vendosi:

Pika e parë: Ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit për shqyrtimin e kërkesës për të realizuar transparencën e plotë të procesit të zgjedhjeve të përgjithshme, të mbajtura më 28 qershor 2009.

Pika e dytë: Objekti i punës së komisionit hetimor:

a. Hetimi i akuzave dhe i dyshimeve publike të bazuara, të ngritura nga partitë politike për zbatimin e legjislacionit në lidhje me procesin zgjedhor.

b. Hetimin e dyshimeve dhe akuzave të bazuara, të ngritura nga partitë politike për proces të parregullt votimi në qendrat e votimit

c. Hetimin e veprimtarisë së administratës të KQZ-së në lidhje me përdorimin e teknologjisë mbështetëse të monitorimit në procesin e numërimit të votave.

d. Hetimin e akuzave politike të bazuara për përdorim të mjeteve publike, si dhe të administratës në favor të subjekteve të caktuara zgjedhore.

dh. Hetimin e akuzave të bazuara për presione të ushtruara, për largim, transferim apo ngritje në detyrë të punonjësve në administratën qendrore,

lokale apo të çdo enti publik për shkaqe që lidhen me fushatën, të kryera gjatë periudhës 29 maj -28 qershor 2009, si dhe të periudhës vijuese të saj.

e. Hetimin e rasteve të dhënies në kundërshtim me ligjin të lejeve të përkohshme të personave të dënuar, duke vuajtur masën e sigurisë me arrest në burg, nga administrata e burgjeve gjatë periudhës 29 maj-28 qershor 2009.

f. Çdo shkelje tjetër që lidhet me procesin zgjedhor do të realizohet gjatë hetimit.

Pika e tretë: Komisioni ka të drejtë të hetojë dhe të bëjë transparencë të plotë për çdo çështje, përveç çështjeve për të cilat ka vendosur gjykata e vendit. Janë në shqyrtim gjyqësor ato çështje për të cilat është regjistruar kallëzim penal në Prokurori.

Objekti i hetimit duhet të jetë i argumentuar dhe duhet të përmbajë fakte apo komplekse faktesh, të cilat tregojnë qartë se për çfarë po hetohet.

Pika e katërt: Komisioni hetimor i ngritur sipas këtij vendimi, bashkë me raportin përfundimtar i paraqet Kuvendit ose seancës plenare rekomandimin në lidhje me nxjerrjen e përgjegjësive institucionale, ndryshime apo miratime ligjesh, me qëllim ndalimin përfundimtar të fenomeneve negative për shoqërinë e shtetin dhe sipas rastit njoftimin Prokurorisë për marrjen e masave të mëtejshme ligjore.

Pika e pestë: Komisioni hetimor parlamentar përbëhet nga 15 deputetë. Kryetari i përket Partisë Socialiste.

Komisioni përbëhet si më poshtë:

7 anëtarë, Partia Socialiste.

Kryetari, Partia Socialiste..

Ilir Rusmali.

Eduard Halimi.

Enkelejd Alibeaj.

Aldo Bumçi.

Arenca Trashani.

Viktor Gumi.

Edi Paloka.

Nasip Naço.

Pika e gjashtë: Komisioni ushtron veprimtarinë e tij për një afat 3-mujor nga miratimi i këtij vendimi.

Pika e shtatë: Ngarkohen Kryetarja e Kuvendit dhe Sekretari i Përgjithshëm të krijojnë kushtet e nevojshme logjistike për veprimtarinë normale të këtij komisioni.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

73 vota pro për ngritjen e komisionit hetimor për transparencë të plotë të zgjedhjeve të 28 qershorit. *(Duartrokitje.)*

Ja zotërinjtë që nuk pranojnë, që tërhiqen. Kjo është gënjeshtër që luani.

Kemi realizuar pikë për pikë atë që thotë edhe komisioneri Fule, dy parime themelore: transparencë të plotë dhe Kushtetutë. Që të dyja janë votuar në këtë projektvendim.

Falemnderit për bashkëpunimin!

Natën e mirë!

(Seanca u mbyll në orën 21:00)

TREGUESI I EMRAVE

A

Abazi, Sadri: 332, 333
Alibeaj, Enkelejd: 243
Aliolli, Ledina: 124, 143
Ahmetaj, Arben: 279

B

Balla, Taulant: 274, 401
Beqja, Ilir: 260
Bejtja, Ilir: 352
Berisha, Sali: 6, 42, 46, 132, 141, 180, 183, 193, 209, 216, 228, 236, 239, 247, 258, 260, 277, 279, 288
Besnik Baraj: 355
Beci, Astrit: 361
Beja, Fatos: 204, 318
Bizhga, Gazmir: 293, 383
Bumçi, Aldo: 50, 98, 153, 275
Bushati, Astrit: 35, 334
Bushati, Ditmir: 388
Bogdani, Gerti: 56, 65, 168
Bano, Ilir: 72, 83, 105, 369
Boçi, Luçiano: 102, 192, 362
Basha, Lulëzim: 17, 88, 211, 273
Bregu, Majlinda: 62, 110, 281
Bulku, Rajmonda: 378,
Bode, Ridvan: 70, 107, 121, 148, 196

C

Cara, Igli: 51, 85, 382

Ç

Çaçi, Albert: 315
Çuko, Arben: 368
Çota, Rrahim: 41, 125

D

Dalipi, Alfred: 309
Dadi, Arta: 204, 384, 401

Dushaj, Besnik: 81, 127

Deda, Eltar: 337
Dibra, Gëzim: 25, 68
Demi, Leonard: 39, 119, 171, 191, 316
Doda, Mesila: 24, 76, 115, 328
Dokle, Namik: 226, 297
Dogjani, Asllan: 341, 343
Dule, Vangjel: 210, 256, 260

F

Fino, Bashkim: 245, 249
Felaj, Ermonela: 380

G

Gumi, Viktor: 71, 105, 170, 220

Gj

Gjana, Jemin: 45, 58, 107, 127, 148, 298, 300
Gjermani, Eglantina: 325
Gjikhuri, Damian: 241
Gjonaj, Adriana: 80, 173, 389
Gjoni, Ilir: 304, 322, 323

H

Hasa, Skënder: 378
Hoxha, Bedri: 65, 198
Halimi, Eduard: 105, 120, 144, 252
Hoxha, Fatos: 326
Hoti, Pavlina: 32, 55, 67, 101, 150, 173, 295
Hida, Sybi: 194, 195, 197
Hysi, Vasilika: 250

I

Imami, Arben: 29, 63, 200, 290
Isaraj, Arben: 160
Islami, Kastriot: 327,

K

Kollozi, Ardian: 336, 339
Kadeli, Gjovalin: 312
Kadilli, Fatbardh: 86, 128, 130, 199, 360
Klosi, Blendi: 264, 391
Koçi, Ervin: 375
Kodheli, Mimi: 289
Ksera, Spiro: 48, 129, 197, 302

L

Lama, Ylli: 172, 332
Lutaj, Pirro: 330
Leka, Agim: 363, 365, 367
Leskaj, Valentina: 237
Ligori, Shegush: 271

M

Majko, Pandeli: 234
Malaj, Arben: 283
Mediu, Fatmir: 118, 199, 308, 314
Meksi, Ermelinda: 302
Mima, Florion: 47, 56, 348
Minxhozi, Qemal: 373
Meta, Ilir: 91
Maliqi, Lefter: 82, 255
Marku, Mark: 131, 351
Metalla, Osman: 49, 73, 88, 107, 108, 188, 339

N

Nishani, Bujar: 144, 187, 233, 267
Noka, Flamur: 78, 343, 374
Naço, Nasip: 91, 209, 269, 3587, 360, 361, 363, 365, 367, 368, 369, 370, 371, 373, 374, 375, 378, 379, 380, 382, 383
Ngresi, Vasillaq: 54, 85

O

Oketa, Gazmend: 105, 195, 311
Olldashi, Sokol: 36, 66, 107, 147, 148, 158, 262, 392

P

Patozi, Astrit: 43, 139, 169, 185, 296, 399
Peza, Dashamir: 297
Paloka, Edi: 28, 59, 160, 233
Paluca, Ndue: 130, 196
Pollo, Genc: 77, 189, 386

Papa, Gjergji: 164, 379
Përnaska, Lajla: 155, 158, 393
Prifti, Dritan: 14, 167

Q

Qefalia, Xhemal: 358, 360

R

Ruli, Genc: 21, 165
Ruka, Ethem: 320
Ruçi, Gramoz: 136, 142, 178, 179, 182, 183, 184, 185, 216, 217, 401, 236, 178, 293, 394, 399, 400
Rusmali, Ilir: 159, 184, 185
Ranko Krivokapiç (Kryetar i Parlamentit të Malit të Zi): 96

S

Subashi, Armando: 266
Sula, Dashnor: 127, 171, 195, 198, 371
Spaho, Edmond: 13, 55, 69, 84, 87, 99, 308
Strazimiri, Gent: 60, 149, 264
Spahiu, Klodiana: 370
Skuçi, Luan: 86, 171, 200
Sterkaj, Paulin: 40, 91

Sh

Shalsi, Eduard: 286, 289
Shehu, Sherefedin: 155, 354
Shehu, Tritan: 64, 85, 88, 104, 133, 134, 322, 323
Shkreli, Enkelejda: 317

T

Turku, Ardian: 17, 21, 25, 26, 28, 29, 33, 99, 100, 110, 114, 115, 116, 118, 119, 120, 121, 124, 125, 126, 127, 128, 130, 131, 133, 134, 145, 155, 156, 167, 192, 193, 243, 256, 267, 281, 296, 297, 298, 300, 302, 303, 317, 318, 327, 328, 330, 332, 333, 334, 335, 336, 337, 339, 341, 342, 343, 362, 365
Trashani, Arenca: 9, 54, 75, 150, 159, 285
Tahiri, Sajmir: 230
Tafaj, Myqerem: 53, 152, 174
Tushe, Fatos: 355
Topalli, Jozefina: 5, 9, 11, 14, 24, 31, 32, 33, 35,

36, 39, 40, 41, 42, 43, 45, 46, 47, 48, 49,
50, 51, 53, 54, 55, 56, 57, 58, 59, 60, 62,
63, 64, 65, 66, 67, 68, 70, 71, 72, 73, 74,
76, 77, 78, 80, 81, 82, 83, 84, 85, 86, 87,
88, 95, 96, 98, 101, 102, 103, 104, 105, 106,
107, 108, 135, 136, 139, 141, 142, 143, 144,
145, 147, 148, 149, 150, 152, 153, 158, 159,
160, 161, 164, 165, 168, 169, 171, 172, 173,
174, 176, 177, 179, 180, 182, 183, 184, 185,
186, 187, 188, 189, 190, 191, 194, 195, 196,
197, 198, 199, 200, 201, 204, 209, 210, 211,
216, 217, 218, 220, 226, 228, 230, 233, 234,
236, 237, 239, 241, 245, 247, 249, 252, 254,
255, 258, 260, 262, 264, 266, 269, 271, 273,
274, 275, 277, 278, 279, 283, 285, 286, 288,
289, 290, 291, 293, 295, 305, 307, 308, 309,
311, 312, 314, 315, 316, 320, 321, 322, 323,
325, 326, 346, 348, 351, 352, 354, 355, 357,
383, 384, 386, 388, 389, 390, 392, 393, 394,
396, 399, 400, 401

Toçi, Fatmir: 348

U

Uldedaj, Gjok: 26, 116, 163

V

Vokshi, Albana: 104, 108, 114, 153, 343

Vasili, Petrit (Ministër i Shëndetësisë): 31, 52, 156

Y

Ylli, Fidel: 346

Xh

Xhaçka, Olta: 291

Xhafaj, Fatmir: 218

Xhaferri, Ferdinand: 100, 305

Xhepa, Selami: 128, 190, 357

Xhuvani, Luiza: 307, 317, 323

PASQYRA E LËNDËS

Seanca e datës 18.01.2010

Në këtë seancë u informua dhe pati debat mbi situatën emergjente në qarkun e Shkodrës dhe masat e marra për përbalimin e saj si dhe u njoftua për miratimin e programit të punimeve të Kuvendit për periudhën 21 janar- 26 shkurt 2010 nga Konferenca e Kryetarëve dhe për miratimin e kalendarit të punimeve të Kuvendit për periudhën 21 janar - 4 shkurt 2010 nga Konferenca e Kryetarëve

5

Seanca e datës 21.01.2010

Në këtë seancë u diskutua për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60'); u miratua procesverbali i seancës plenare të datës 18.01. 2010; u shqyrtuan projektligjet: "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Kosovës për bashkëpunimin policor ndërkufitar", "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për riparimin, rindërtimin dhe mirëmbajtjen e piramidave e të shenjave të tjera kufitare në kufirin shtetëror shqiptaro - malazez", "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, dhe Qeverisë së Irlandës për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal, për tatimin mbi të ardhurat", "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7928, datë 27.04.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", të ndryshuar", "Për detergjentët" si dhe projektligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9875, datë 14.02.2008 "Për metrologjinë"

47

Seanca e datës 28.01.2010

Në këtë seancë u diskutua për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60 minuta); u miratua procesverbali i seancës plenare të datës 21.01.2010; u shqyrtuan projektligjet: "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjë-Hercegovinës për ripranimin e personave me qëndrim të parregullt", "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën ndërkombëtare për përgjegjësinë civile për dëmet e shkaktuara nga ndotja dhe nga karburanti i depozitave, 2001", Akt normativ nr.10 "Për disa ndryshime në ligjin "Për buxhetin e shtetit të vitit 2009", projektligji "Për një shtesë dhe ndryshim në ligjin nr.7651, datë 21.12.1992 "Për festat zyrtare dhe ditët përkujtimore", të ndryshuar", "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8366, datë 02.07.1998 "Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar", të ndryshuar", "Për Autoritetin e Aviacionit Civil" si dhe projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar"

59

Seanca e datës 04.02.2010

Në këtë seancë u diskutua për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60'); u miratua procesverbali i seancës plenare, datë 28.01.2010, kalendarit 3-javor i punimeve të Kuvendit (8 shkurt-25 shkurt 2010); u shqyrtuan projektligjet: "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9363, datë 24.03.2005 "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit", "Për disa shtesa në ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin

dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar”, “Për shpalljen e moratoriumit për mjetet motorike lundruese të Republikës së Shqipërisë”, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “Për miratimin e kontratës së lidhur ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqërisë “EUROCOPTER” për furnizimin me 5 helikopterë të mesëm shumërolësh” si dhe u votuan projektligjet: “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës për ripranimin e personave me qëndrim të parregullt”, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare për përgjegjësinë civile për dëmet e shkaktuara nga ndotja, nga karburanti i depozitave të vitit 2001”, akti normativ nr. 10, datë 23.12.2009 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, të ndryshuar”; projektligjet: “Për një shtesë dhe ndryshim në ligjin nr. 7651, datë 21.12.1992 “Për festat zyrtare e ditët përkujtimore”, të ndryshuar”, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8366, datë 02.07.1998 “Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH)”, të ndryshuar”, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar” si dhe u zhvillua interpelancë me Zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Punëve të Jashtme, kërkuar nga deputeti Paulin Sterkaj

74

Seanca e datës 11.02.2010

Në këtë seancë u diskutua për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60’); u miratua procesverbali i seancës plenare të datës 04.02.2010; u shqyrtuan projektligjet: “Për ratifikimin e marrëveshjes me shkëmbim notash ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Japonisë për financimin e projektit për përmirësimin e pajisjeve mjekësore të Qendrave Rajonale të Emergjencës në Republikën e Shqipërisë”, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas dhe të financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Kreditanstalt für Eiederaufbau (KfE), Frankfurt am Main dhe Fondacionit “FEFAD” për projektin “Promovimi i SME-ve”, “Për ratifikimin e statutit të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë së Rinovueshme (IRENA)”, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Saudit për Zhvillim për financimin e projektit “Ndërtimi i rrugës së mbikalimit të Durrësit”; u votua projektligji “Për Autoritetin e Aviacionit Civil” si dhe u zhvillua interpelancë me ministrin e Integritimit, kërkuar nga deputetja Albana Vokshi

95

Seanca e datës 18.02.2010

Në këtë seancë u diskutua për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60 minuta); u miratua procesverbali i seancës plenare të datës 11.02.2010; u shqyrtuan projektligjet: “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin “Për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare në Mesdhe” të Konventës së Barcelonës “Për mbrojtjen e mjedisit detar dhe të rajoneve bregdetare të Mesdheut”, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në traktatin ndërkombëtar për burimet gjenetike të bimëve, për bujqësinë dhe ushqimin”, “Për marrjen në kontroll të shoqërive publike”, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” si dhe projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9616, datë 27.09.2006 “Për librin në Republikën e Shqipërisë””

114

Seanca e datës 25.02.2010

Në këtë seancë u miratuan: procesverbali i seancës plenare të datës 18.02.2010, programi i punës për periudhën 1 mars-26 prill 2010, kalendari 3 javor i punimeve të Kuvendit (1-18 mars 2010); u shqyrtuan projektligjet: “Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave”, “Për disa shtesa në ligjin nr.9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”, “Për krijimin e Institutit të Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri” si dhe u zhvillua interpelancë me ministrin e Shëndetësisë, kërkuar nga deputetja Lajla Përnaska

135

Seanca e datës 04.03.2010

Në këtë seancë u diskutua për çështje jashtë rendit të ditës (deri në 60 minuta); u miratua procesverbali i seancës plenare të datës 25.02.2010; u shqyrtuan projektligjet: “Për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative dhe organizimin e drejtësisë administrative”, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut për sigurinë e informacionit”, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Sllovakisë për mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar”, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Letonisë për mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar”, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Çekisë për shkëmbimin dhe mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar”, “Për kornizën shqiptare të kualifikimeve” si dhe projektvendimi “Për shqyrtimin me procedurë të përsheptuar të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8891, datë 02.05.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”

160

Seanca e datës 11.03.2010

Në këtë seancë u diskutua për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60'), u miratua procesverbali i seancës plenare datë 04.03.2010; u shqyrtuan projektligjet “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Operatorit të Sistemit të Transmetimit, sh.a., si agjencia e zbatimit të projektit, dhe KfË Frankfurt am Mein për financimin e projektit “Linja e transmetimit 400 kë Shqipëri-Kosovë (Tiranë-Prishtinë), nëpërmjet një huaje prej 42.000.000 eurosh”, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Operatorit të Sistemit të Transmetimit, sh.a., si agjencia e zbatimit të projektit, dhe KfË Frankfurt am Mein për financimin e projektit “Linja unazore 110 kë e Shqipërisë së Jugut”, nëpërmjet një huaje prej 37.750.000 eurosh”, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Operatorit të Sistemit të Transmetimit, sh.a., si agjencia e zbatimit të projektit, dhe KfË për financimin e projektit “Linja unazore 110 kë e Shqipërisë së Jugut”, nëpërmjet një huaje prej 10.750.000 eurosh”, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Operatorit të Sistemit të Transmetimit, sh.a., si agjencia e zbatimit të projektit, dhe KfË Frankfurt am Mein për financimin e projektit “Linja unazore 110 kë e Shqipërisë së Jugut”, nëpërmjet një huaje prej 500 000 eurosh”, “Për disa shtesa në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, “Për gjuetinë”, “Për shtyrjen e afatit të qëndrimit të kompanisë së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në misionin “MINURCAT” të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Republikën e Çadit dhe në Republikën e Afrikës Qendrore” si dhe projektrezoluta “Për liberalizimin e vizave me Bashkimin Europian”

187

Seanca e datës 18.03.2010

Në këtë seancë u shqyrtuan projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”” si dhe projektvendimi për ngritjen e Komisionit Hetimor për zgjedhjet e 28 qershorit 2009

218

Treguesi i emrave

403

Shtypur në Shtypshkronjën e Kuvendit
Prill 2010